DAVID ICKE

SEKRETI MË I MADH

(THE BIGGEST SECRET)

libri që mund të ndryshojë botën

Përktheu: HASAN S. BREGU

Sig. 304 659
BIBLIOTEKA KOMBËTARE TIRANË

BOTA SHQIPTARE

LIBRI 24

8B

I marrë?

Pasi ta kenë lexuar këtë libër, shumë njerëz do të thonë se jam i marrë.
Atyre u përgjigjem kështu:

I MARRI I SOTËM MUND TË JETË I MËNÇURI I NESËRM.

Një botë e lirë?

"Jam një jashtëtokësor? I përkas ndonjë race të re tokësore, që e ka pasur prejardhjen nga bashkimi seksual i jashtëtokësorëve me gra që i përkisnin gjinisë njerëzore? Fëmijët e mi janë fryti i racës së parë ndërplanetare? Shkrirja e racave të ndryshme të shoqërisë ndërplanetare është krijuar ndoshta dikur në të njëjtën mënyrë në të cilën u bë e njohur shkrirja e racave të ndryshme të të gjitha kombeve të Tokës në SHBA 190 vjet më parë?"

"Apo ky mendim u referohet gjërave që do të ndodhin në të ardhmen? Kërkoj të drejtën dhe privilegjin që të ushqej mendime të tilla dhe të shtroj pyetje të tilla pa qenë i kërcënuar me arrestim nga ndonjë organ administrativ çfarëdo i shoqërisë... Përballë një hierarkie çensorësh të rreptë shkencorë, doktrinarë, të vetemëruar dhe që janë të gatshëm për të vrarë, mund të duken të krisura t`i publikosh mendime të tilla. Cilido prej tyre që mund të ishte aq sa duhet i lig, mund të bënte ç`të donte me këtë. E, megjithatë, e drejta për të gabuar duhet të jetë e mbrojtur. Nuk duhet të kemi kurrë frikë të hyjmë në një pyll, meqë nëpër pemë ka mace të egra. Nuk duhet të heqim kurrë dorë ndaj të drejtës sonë për një të menduar thellë të drejtuar mirë. Janë pyetjet e nënkuptuara në këtë të menduar thellë ato që u shtien më shumë frikën administratorëve të dijeve të sistemit... Por tani që po bëhemi gati të hyjmë në epokën kozmike, duhet sigurisht të këmbëngulim mbi të drejtën për të shtruar pyetje të reja, deri edhe të marra, pa qenë të përndjekur për këtë arsye".

Shkencëtari **Vilhelm Raik**, në një fragment të shkëputur nga libri i tij
Contact With Space (Kontakte me hapësirën).
Vilhelm Raiku është vrarë në një burg të
Shteteve të Bashkuara, më 13 nëntor 1957.

LIBRI 24

Kushtime

Lindës, për mbështetjen e saj të vendosur dhe të pakushtëzuar.
Një grua e jashtëzakonshme.

Aliçes, "motrës sime të vogël", për të gjithë mbështetjen dhe përkushtimin që më ka rezervuar në çastet në të cilat kisha më shumë nevojë.

Zhaklinës, "motrës sime të madhe".

Pamelës dhe Ruajalit, për punën e tyre të mrekullueshme në Shtetet e Bashkuara.

Falënderimet e mia shkojnë edhe për Brian Desborougun dhe Ivan Frazerin që lexuan dorëshkrimin tim dhe më dhanë informacione të mëtejshme; për Zhanin, për rishikimin e bocave; për Gerin që ka përpiluar treguesit; dhe për Semin, për hedhjen grafike dhe ilustrimet.

Titulli i origjinalit:
The biggest secret

copyright © by David Icke

Për botimin shqip copyright © BOTA SHQIPTARE
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Botohet në marrëveshje me Bridge of Love Publications, ENGLAND.

Redaktor: Kujtim Gjonaj
Përkujdesja grafike: Studio grafike BJORN
Design: Elvira Çiraku

ISBN 978-99956-11-60-6

Kolana: Të vërteta të fshehura

Botues: Genti Gjonaj
Shtëpia botuese BOTA SHQIPTARE
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla nr. 2, Tiranë
Tel. & Fax 00 355 4 25 31 73
E-mail: botashqiptare@kujtesa.com

LIBRI 24

HYRJE

Ditë vendimtare

Jemi në kulmin e një ndryshimi të pabesueshëm global. Një udhëkryq, në të cilin merren vendime, që do të ndikojnë jetën mbi Tokë në të ardhmen e asaj që e quajmë kohë. Mund t'i hapim kat më kat portat e burgjeve mendore dhe emocionale, që e kanë kufizuar gjininë njerëzore për mijëra vjet. Ose mund t'u lejojmë atyre, që e ushtrojnë atë kontroll, që t'i përmbushin planet e veta, duke e katandisur çdo burrë, çdo grua dhe çdo fëmijë mbi planet në një gjendje skllavërie mendore, emocionale, shpirtërore dhe fizike, nëpërmjet një qeverie dhe një ushtrie botërore, një banke qendrore, një monedhe të vetme dhe me mbështetjen e një popullsie të pajisur me mikroçipë.

E di që e gjitha kjo mund të duket e largët, por nëse gjinia njerëzore do ta shkëpuste vështrimin nga telenovela e fundit, apo nga ndeshja e futbollit, për një çast të mjaftueshëm sa për të vënë në lëvizje trurin, do ta kuptonte se ngjarje të këtij lloji jo vetëm që do të ndodhin, por janë duke ndodhur *tashmë*.

Krijimi i një kontrolli të centralizuar global të politikës, të ekonomisë, të bankave, të forcave të armatosura dhe të mediave është duke u përshpejtuar nga ora në orë. Aplikimi i mikroshipëve ndaj popullsisë është sugjeruar tashmë, madje, në shumë raste, tashmë është në veprim. Çdo vënie në veprim

e planeve të fshehta është paraprirë gjithmonë nga një periudhë kohe, në të cilën, ajo çka ka mbetur e fshehtë, duhet të dalë në sipërfaqe, me qëllim që të bëhet e njohur përfundimisht në realitetitn material. Kjo është saktësisht ajo në të cilën jemi të pranishëm tani: mjafton të mendosh për shpërthimin e shkrirjeve midis bankave botërore dhe perandorive industriale, për shpejtësinë me të cilën kontrolli politik dhe ekonomik centralizohet nëpërmjet Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara, Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), Marrëveshjes Shumëpalëshe mbi Investimet, dhe një deti me organizma të tjera globalizuese si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe samitet e G-7/G-8-ës.

Prapa këtij centralizimi të vazhdueshëm e të koordinuar qëndron një fis familjesh të lidhura në krushqi nëpërmjet tyre, prejardhja e të cilave mund të zërë fill në Lindjen e Mesme dhe të Afërt të kohërave të lashta. Janë nisur prej andej për t'u bërë dinastitë mbretërore, aristokracia dhe kleri i Evropës, para se ta shtrinin pushtetin e tyre në të gjithë botën, mbi të gjitha nëpërmjet Perandorisë së "madhe" britanike. Kjo i ka dhënë mundësinë fisit t'i eksportojë pinjollët e vet pasardhës në të gjithë vendet e pushtuara nga forcat britanike dhe evropiane, përfshirë Shtetet e Bashkuara, ku ata vazhdojnë ende sot të komandojnë. Ka pasur më shumë se 40 presidentë të Shteteve të Bashkuara dhe, 33 prej këtyre, kanë qenë gjenetikisht të lidhur me dy persona, me mbretin Alfredi i Madh i Anglisë dhe me Karlin e Madh, monarkun e famshën francez të shekullit IX. Në harkun e gjithë kësaj kohe, planet e këtij trungu, apo kësaj race, janë zbatuar gradualisht, gjersa sot është arritur në shkallën që është i mundur një kontroll global i centralizuar.

Po qe se dëshironi të dini se si do të jetë jeta jonë nëse nuk i hapim sytë menjëherë, mendoni për Gjermaninë naziste. *Ajo* është bota që e pret populsinë botërore, kur plani, që unë e quaj Urdhëri i Ditës së Vëllazërisë, do të bëhet i njohur duke nisur nga viti 2000 dhe për 12 vitet e para të shekullit të ri. 2012-ta në mënyrë të veçantë duket se do të jetë një vit vendimtar për arsye që do t'i rrahim në vijim. Njerëzit nuk e kanë idenë e humnerës ku jemi duke rënë, as të natyrës së botës që do t'u lëmë fëmijëve tanë, dhe pjesa më e madhe e njerëzve nuk duket se e çan kokën për këto gjëra. Parapëlqejnë të mos e njohin atë që duket sheshit dhe të mohojnë një të vërtetë, që paraqitet e qartë përpara tyre. Më kujtojnë një lopë që vrapon nëpër fushë duke ulëritur: "Ej, e dinë atë kamionin që çdo muaj merr me vete disa prej miqve tanë? Hëm, nuk i çon në ndonjë fushë tjetër, siç mendojmë ne. I qëllojnë në kokë, i varin t'u kullojë gjaku, i presin në copa dhe i paketojnë. Pastaj, qeniet njerëzore i blejnë dhe i hanë!" Imagjinoni cili mund të ishte reagimi i pjesës tjetër të

tufës: "Ti je e çmendur, bukuroshja ime. Si mund ta bëjnë një gjë të tillë? Sidoqoftë, zotëroj ca aksione të asaj ndërmarrjeje transporti dhe fitimet janë të mira. Mbylle sqepin, mos i turbullo ujrat".

Realizimi i planeve që do t'ju zbuloj ka filluar mijëra vjet më parë dhe është duke arritur tani përmbushjen e tij, meqë njerëzimi ka hequr dorë nga mendja e vet dhe nga përgjegjësia e vet. Njerëzimi parapëlqen të bëjë atë që gjykon se është e drejtë në vetvete në këtë çast, në vend që të peshojë pasojat më të gjera, që qëndrimi i tij do të ketë për ekzistencën njerëzore. Thuhet se paditurja është një gjendje lumturie e përkryer, dhe është e vërtetë, por vetëm për një çast. Mund të jetë lumturi e përkryer që të mos dish se është duke arritur një tornado, sepse kështu nuk shqetësohesh, as nuk merr masa paraprake. Por edhe pse e keni kokën nën rërë dhe prapanicën në erë, tornadoja do të arrijë prapëseprapë. Po t'i ngrinit sytë dhe t'i bënit ballë, mund ta shmangnit katastrofën, por mosdija dhe mospranimi do t'ju ekspozojnë kundrejt furisë më të madhe dhe pasojave më të skajshme, sepse ai do t'ju godasë kur nuk e prisni dhe do t'ju kapë krejt të papërgatitur. Për çdo veprim apo mosveprim ka një pasojë. Kur heqim dorë nga mendja jonë dhe nga përgjegjësia jonë, kemi hequr dorë nga jeta jonë. Nëse jemi shumë që e bëjmë këtë gjë, kemi hequr dorë nga bota dhe kjo është tamam ajo që kemi bërë gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Ja sepse pak njerëz kanë kontrolluar gjithmonë masat. I vetmi ndryshim sot qëndron në faktin se ata pak njerëz janë duke manipuluar tërë planetin falë globalizimit të industrive, të bankave dhe të komunikacioneve. Parimi themelor i këtij kontrolli ka qenë gjithmonë i njëjti: t'i mbajë njerëzit në gjendje paditurie, frike e konflikti me vetveten. Përça, sundo e pushto, pa i ndarë me të tjerët dijet më të rëndësishme (shiko *Figura 1*).




Figura 1. **(DIJA - PADIJA)** *Dija është në duart e pak njerëzve, kurse pjesa tjetër e popullsisë mbahet në paditurí. Struktura klasike që ka pasur gjithmonë si qëllim përfundimtar manipulimin dhe kontrollin.*

Dhe, siç do ta shohim në këtë libër, ata që prej mijëra vjetësh përdorin këto metoda me qëllimin për të kontrolluar, janë pjesëtarë të së *njëjtës* forcë, të të njëjtit fis e të të njëjtit gjak, që ndjek një plan me afat të gjatë, i cili tani është duke mbërritur në një pikë vendimtare. Shteti fashist global rri varur kërcënueshëm mbi ne. E, megjithatë, nuk duhet të jetë medoemos

kështu. Pushteti i vërtetë qëndron në duart e shumicës, jo të pakicës. Madje, në brendësi të çdo individi ekziston një pushtet i pakufishëm. Jemi kaq të kontrolluar, jo sepse nuk kemi pushtetin për të vendosur mbi fatin tonë, por sepse heqim dorë prej atij pushteti në çdo minutë të jetës sonë.

Kur ndodh ndonjë gjë që nuk na pëlqen, themi "Po tani çfarë *do të bëjnë*?". Në këtë pikë, *ata* që e kanë krijuar fshehurazi problemin që nga fillimi, i përgjigjen kësaj pyetjeje duke propozuar një "zgjidhje" – centralizim më i madh i pushtetit dhe gërryerje e lirisë. Nëse dëshironi t'i jepni pushtete më të mëdha policisë, shërbimeve të sigurimit dhe forcave të armatosura dhe doni që të jetë vetë populli ai që t'jua kërkojë, atëhere krijoni mundësinë që të rriten krimet, dhuna e terrorizmi dhe, në atë pikë, të realizoni qëllimet tuaja, do të jetë si një lojë fëmijësh. Sapo njerëzit të jetojnë me frikën se do të vidhen, do të sulmohen, apo do të bombardohen, do t'ju kërkojnë të privohen nga liria e tyre, për të përfituar mbrojtjen tuaj nga ajo që ju vetë i keni shtyrë t'i tremben përmes manipulimit. Atentati i Oklahomës është një shembull klasik i kësaj. E quaj këtë teknikë "problem-reagim-zgjidhje". Krijoni problemin, nxitni reagimin në valën "duhet bërë diçka", dhe pastaj ofroni zgjidhjen. Kjo përmblidhet mirë në moton masonike "*Ordo ab chao*", rregulli nga kaosi. Krijoni kaosin dhe pastaj tregoni rrugën për të rivendosur rregullin. Rregullin tuaj.

Masat grumbullohen e manipulohen nga shumë forma të ndryshme të kontrollit emocional dhe mendor. Është fjala për teknikën e vetme në gjendje për ta arritur këtë qëllim. Pak veta nuk munden të kontrollojnë fizikisht miliarda njerëz, po në atë mënyrë që kafshët e një ferme nuk mund të kontrollohen fizikisht, përveçse nga një numër i madh njerëzish. Pak kohë më parë dy derra u arratisën nga një thertore në Angli, duke i shpëtuar kapjes për aq shumë ditë, pavarësisht se ishin të shumtë ata që i kërkonin, sa që u bënë dy të famshëm kombëtarë. Një kontroll fizik i popullsisë botërore nuk mund të funksionojë. Por nuk është i nevojshëm, kur është e mundur të manipulosh mendimet dhe ndjenjat e njerëzve deri në atë pikë sa ata "vendosin" të bëjnë atë që ti gjithmonë ke dashur t'i detyrosh të bëjnë dhe kërkojnë futjen e ligjeve që ti doje të fusje. Është një proverb shumë i vjetër ai që thotë se, nëse dëshiron që dikush të bëjë diçka, duhet ta bësh të besojë se është fjala për një ide të tij. Njerëzimi është i kontrolluar mendërisht dhe është pak më shumë i vetëdijshëm se një *zombie* (njeri apatik, krejt pa karakter dhe pa vullnet të vetin) çfarëdo.

Mendoni se jam duke e tepruar? Aspak. E përkufizoj kontrollin mendor si manipulimin e mendjes së një njeriu, që e shtyn të mendojë dhe, për rrjedhojë, të veprojë, saktësisht në mënyrën e dëshiruar prej jush. Mbi bazën

e këtij përkufizimi, çështja nuk është se sa njerëz janë të kontrolluar mendërisht, por sa pak janë ata që nuk janë të kontrolluar. Të gjithë jemi, në një nivel pak a shumë të madh. Kur bindemi nga reklama, apo nga trillimet gazetareske, për të blerë diçka, që në realitet nuk e duam, apo nuk na shërben, rezultojmë mendërisht të kontrolluar. Kur lexojmë apo dëgjojmë një histori të re të paraqitur në mënyrë tendecioze dhe lejojmë që ajo të ndikojë perceptimin tonë për një njeri apo për një ngjarje, rezultojmë mendërisht të kontrolluar. Mendoni për stërvitjen e forcave të armatosura. Është kontroll i pastër mendor. Që ditën e parë të thuhet se duhet t'u bindesh pa kushte urdhërave dhe, nëse ndonjë kokëgdhë me kapelën me majë të thotë të qëllosh kundër njerëzve, të cilët nuk i ke parë kurrë dhe për të cilët nuk di asgjë, duhet t'u shtiesh atyre pa kushte. Kjo është mendësia "Si urdhëron, zotëri", që mbush edhe botën jo ushtarake. "Hëm, e di që nuk është e drejtë, por shefi më tha ta bëja dhe nuk kisha rrugëzgjidhje". Nuk kishe rrugëzgjidhje? Nuk ndodh *kurrë* të mos ketë rrugëzgjidhje. Ka zgjidhje që do të na pëlqente t'i bënim dhe zgjidhje që do të na pëlqente më pak t'i bënim. Por nuk ndodh *kurrë* të mos ketë rrugëzgjidhje. Të thuash një gjë të tillë do të thotë vetëm të kërkosh një tjetër justifikim.

Lista e teknikave të manipulimit mendor është e pafund. Duan mendjen tënde sepse me ta pasur, do të të kenë ty. E vetmja përgjigje qëndron në të rizotëruarit e mendjes sonë, që të mendojmë me kokën tonë dhe t'u lejojmë të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë pa pasur frikë se mund të përqeshen, apo mund të dënohen se kanë kryer krimin e të qenurit të ndryshëm. Nëse nuk do ta bëjmë, planet që do të përshkruaj do të realizohen. Por nëse përkundrazi do të bëhemi përsëri zotër të kontrollit mbi mendjet tona dhe do të shpallim sovranitetin e mendjes, ato plane nuk do të vihen në veprim sepse do të mungojnë kushtet paraprake. Kam bërë konferenca dhe kërkime në më shumë se 20 vende dhe, në secilin prej tyre, kam parë në veprim të njëjtin proces. Politika dhe institucione identike hyjnë në përputhje me një Urdhër të Ditës Globale, megjithatë, në të njëjtën kohë, regjistrohet natyrisht një rizgjim global, dora-dorës që gjithmonë e më shumë njerëz ndiejnë zgjimin shpirtëror dhe dalin nga gjumi i tyre emocional e mendor, nga *transi* (gjumi hipnotik) tokësor. Cila forcë do të mbizotërojë në këto vite të para të mijëvjeçarit deri në vitin 2012? Do të varet nga ne. Ne e krijojmë realitetin përmes mendimeve tona dhe veprimeve tona. Nëse i ndryshojmë mendimet tona dhe veprimet tona, do të ndryshojmë botën. Shumë e thjeshtë.

Në këtë libër do të ripërshkoj historinë e trungut, apo racës, të familjeve të lidhura në krushqi midis tyre, që sot kontrollon botën dhe do t'ju zbuloj

LIBRI 24

natyrën e vërtetë të Urdhërit të Ditës Globale. Dhe do të dëshiroja të nënvizoja faktin se ajo mbi të cilën do të hedh dritë është një seri planesh, jo një komplot si i tillë. Komploti realizohet në çastin kur njerëzit dhe ngjarjet manipulohen me qëllim për të siguruar realizimin e atyre planeve. Këto komplote marrin tri forma kryesore: komploti që i drejtohet heqjes qafe të personave dhe të organizatave, të cilat përbëjnë një kërcënim për vëvien në zbatim të Urdhërit të Ditës (vrasja e Dajanës, princeshës së Uellsit); komploti që ka për qëllim të vendosë në poste pushteti njerëz që do të kontribuojnë për vënien në zbatim të Urdhërit të Ditës (Xhorxh Bush, Henri Kisinger, Toni Bler e të tjerë); dhe komploti që synon të krijojë ngjarje, të cilat do ta shtyjnë opinionin publik të kërkojë që Urdhëri i Ditës të futet përmes strategjisë problem-reagim-zgjidhje (luftëra, atentate terroriste, kriza ekonomike). Në këtë mënyrë të gjitha këto ngjarje, në dukje të palidhura me njëra-tjetrën dhe të gjitha këto manipulime bëhen aspekte të *të njëjtit* komplot, që synon të fusë *vetë* Urdhërin e Ditës.

Në muajt dhe në vitet që do të pasojnë, sa herë që do të merrni në dorë ndonjë gazetë, do të ndizni televizorin, apo do të dëgjoni fjalimin e ndonjë lideri politik, ose të ndonjë industrialisti, do të ndeshni po ato informacione të paraqitura këtu. Mundeni ta bëni tashmë, nëse jeni të vetëdijshëm për mashtrimin. Shikoni disa libra të mi të mëparshëm si *Unë jam vetvetja unë jam i lirë*, *The Robots' Rebellion* (Rebelimi i Robotëve), videon *Turning Of The Tide* (Pikë kthese), dhe veprat e studiuesve të tjerë në harkun e dhjetëvjeçarëve të fundit dhe do të vini re se ajo që ata kanë parashikuar është *tashmë* duke ndodhur. Nuk është fjala për ndonjë profeci, por thjesht për vetëdijen e ekzistencës së Urdhërit të Ditës. Kjo do të thotë se në vitet e ardhshëm do të realizohet një shtet fashist global? Kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjesh vetëm me një tjetër pyetje: dëshirojmë të bëhemi njerëz, apo do të vazhdojmë të jemi *dele*?

Realizimi i Urdhërit të Ditës varet nga përgjigjja
që do t'i japim pyetjes së dytë.

LIBRI 24

KUJDES

Ky libër përmban një sasi shumë të madhe me informacione tronditëse. Ju lutem shumë, mos vazhdoni më tej, nëse nuk arrini të shkëputeni nga sistemi juaj aktual i vlerave, apo nëse e ndieni se nuk mundeni të përballeni në mënyrë emocionale me atë që me të vërtetë është duke ndodhur në këtë botë.

Nëse vendosni të vazhdoni, kujtohuni se nuk ka asgjë për t'u trembur. Jeta ekziston përgjithmonë dhe çdo gjë nuk është tjetër veçse një përvojë gjatë rrugës drejt ndriçimit. Nga pikëpamja e nivelit më të madh të perceptimit, nuk ekziston as e mira as e keqja, vetëm një ndërgjegje që bën ca zgjedhje për të eksperimentuar gjithçka që mund të eksperimentohet. Ngjarjet e pabesueshme të zbuluara nga ky libër janë duke u nisur drejt fundit, pasi drita e lirisë po lind më në fund mbi transformimin më të madh të ndërgjegjes që ky planet të ketë parë ndonjëherë në 26.000 vjet. Pavarësisht disa gjërave që do të lexoni, bëhet fjalë për një çast të mrekullueshëm për jetën tonë.

David Icke

Kapitulli 1

A kanë zbritur marsianët në Tokë?

Mund ta shkruaja këtë libër duke ndjekur dy rrugë të ndryshme. Mund të mos kisha zbuluar informacione që janë jashtëzakonisht të çuditshme, por të vërteta. Kjo ishte rruga më e lehtë, që do të më kishte dhënë mundësinë të mos e braktisja qetësinë time dhe të kumtoja vetëm atë që nuk do të trondiste perceptimin, që shumë njerëz kanë për realitetin.

Ose mundesha ta trajtoja lexuesin si një qenie njerëzore të rritur, plotësisht të formuar, plotësisht të ekuilibruar e shumëpërmasor dhe t'i komtoja të gjitha informacionet më të rëndësishme, përfshirë ato që do ta kishin shtyrë ndjenjën e tij të realitetit deri në një pikë shembjeje. Si gjithmonë, zgjodha rrugën e dytë. Nuk më takon mua të zgjedh informacionet për lexuesin, i takon lexuesit t'i zgjedhë për vetveten. Sa arrogante dhe paternaliste do të ishte të mendoja se nuk duhej t'ua zbuloja informacionet njerëzve, sepse "nuk janë gati për t'i mirëpritur". Kush jam unë që duhet të vendos për këto gjëra? Dhe si mund ta dish që njerëzit "janë gati për t'i mirëpritur", nëse më parë nuk i dëgjon dhe vendos mandej me kokën tënde? Disa prej miqve të mi më kanë nxitur të tregoj historinë që shërben si sfond, por kanë shtuar "për hir të Zotit, mos fol për zvarranikët!". Pas pak do ta kuptoni se çfarë kishin ndërmend të thoshin.

LIBRI 24

E kuptoj shqetësimin e tyre, por unë mund të jem vetëm vetvetja. Dhe duhet të them gjithçka që di dhe jo vetëm atë që nuk prek qetësinë. Jam i bërë kështu. Natyrisht, tema e këtij libri do të më vërë në rrezik të dukem qesharak përpara atyre që e kanë të madh sa një mizë e vogël vizionin e mundësisë dhe, natyrisht, përpara atyre që e dinë se bëhet fjalë për gjëra të vërteta, por nuk duan që publiku t'i njohë. E pastaj? Kujt i bëhet vonë? Mua aspak. Siç thoshte Gandi: "Edhe nëse je një pakicë e përbërë nga një njeri i vetëm, e vërteta është gjithmonë e vërtetë". Kështu pra, ja ku është këtu historia, pa kursim goditjesh.

Shkurtimisht, një racë, rezultat i një kryqëzimi fisesh, një racë tamam e vërtetë brenda racës, u ngul, në lashtësi, në Lindjen e Mesme e të Afërt dhe, që atëhere, mijëra vjet më parë, kjo racë e ka shtrirë pushtetin e saj mbi të gjithë globin. Një rëndësi themelore në të gjithë këtë ka marrë krijimi i një rrjeti shkollash misterike dhe shoqërish të fshehta, me qëllimin e caktuar për realizimin e fshehtë të planeve të përpikta, e shoqëruar në të njëjtën kohë nga krijimi i institucioneve si besimet fetare, të krijuara për të burgosur mendërisht dhe emocionalisht masat dhe për t'i shtyrë në konflikt me njëra-tjetrën. Klasa sunduese brenda kësaj përzierjeje racash nuk është vetëm mashkullore dhe disa prej roleve kyç janë mbajtur nga gra. Por në terma numerikë, ajo është kryesisht mashkullore dhe për këtë arsye do t'i drejtohem këtij grupi me termin e Vëllazërisë. Për saktësi më të madhe pastaj, duke parë rëndësinë që Babilonia e lashtë zë në të gjithë këtë histori, do ta quaj Vëllazëri Babilonase. Plani që anëtarët e saj e quajnë "Vepra e Madhe e Kohërave" është po ai që unë e quaj Urdhëri i Ditës i Vëllazërisë. Shtrirja e tanishme e kontrollit të ushtruar nga Vëllazëria nuk është rezultati i një pune që zë fill disa vite më parë, apo ndonjë dhjetëvjeçar, ose shekull më parë: ajo mund të zërë fill në fakt mijëra vjet më parë. Strukturat e institucioneve të sotme qeverisëse, bankare, industriale, ushtarake e mediatike nuk kanë qenë objekt depërtimi nga ana e këtyre forcave, por kanë qenë krijuar prej tyre *ex novo* (që nga fillimi). Urdhëri i Ditës i Vëllazërisë është, në realitet, Urdhëri i Ditës në fuqi që prej shumë mijëvjeçarësh. Është realizimi i një plani, hap pas hapi, me qëllimin e caktuar për kontrollin e centralizuar të planetit.

Anëtarët e klasës sunduese, që zë majat e piramidës njerëzore me kontroll dhe shtypje, i kalojnë stafetën e komandimit njëri-tjetrit, brez pas brezi, dhe zakonisht janë fëmijët meshkuj ata që zënë vendin e baballarëve. Pinjollët e këtyre familjeve, të zgjedhur si trashëgimtarë, rriten që nga lindja në mënyrë të tillë që të familjarizohen me Urdhërin e Ditës dhe me metodat e manipulimit, që t'i japin mundësi "Veprës së Madhe" të realizohet me të vërtetë. Të nxiturit

e Urdhërit të Ditës bëhet misioni i tyre, i indoktrinuar qysh nga mosha më e njomë. Kur për ata arrin çasti për të hyrë midis më të pushtetshmëve të Vëllazërisë dhe për t'i përcjellë shkopin e komandimit brezit pasardhës, edukimi që kanë marrë i ka bërë persona mjaft të çekuilibruar. Janë intelektualisht shumë të mprehtë, por aq shumë të pamëshirshëm e arrogantë sa besojnë se kanë të drejtën të qeverisin botën dhe të kontrollojnë masat e paditura, që i konsiderojnë më të ulëta.

Cilido fëmijë i Vëllazërisë që kërcënon ta sfidojë, apo ta kundërshtojë këtë tip edukimi, lihet mënjanë, ose i rezervohet një trajtim i ndryshëm, në mënyrë që të arrihet, sigurisht, që vetëm persona të "sigurtë" të kenë të drejtën të hyjnë në nivelet më të larta të piramidës dhe në dijet shumë të përparuara e të fshehta që ruhen atje. Mund të përmendim emrat e disa prej këtyre familjeve. Dera e madhe britanike e Uindsorëve është njëra prej tyre, ashtu sikurse Rotshildët, familjet mbretërore dhe aristokrate evropiane, Rokfelerët, dhe pjesa tjetër e të ashtuquajturës *establishment* lindore e Shteteve të Bashkuara, së cilës i përkasin presidentët amerikanë, manjatët e industrisë, bankierët dhe administratorët. Por mbi të gjitha, klika që kontrollon gjininë njerëzore vepron në hije, jashtë sundimit publik. Çdo grupi, kaq shumë të çekuilibruar sa të dëshirojë nxehtësisht kontrollin e plotë të planetit, do t'i duhet të përballojë luftëra të brendshme, pasi fraksione të ndryshme do të kërkojnë ta marrin atë kontroll. Kjo është e dukshme në rastin e Vëllazërisë. Në brendësi të saj lufta, konflikti dhe konkurrenca janë të tmerrshme. Një studiues e ka përshkruar si një bandë grabitësish banke, që janë të gjithë në një mendje për ta bërë, por që pastaj grinden mbi atë se si duhet të ndahet shuma e grabitur. Bëhet fjalë për një përkufizim të mrekullueshëm dhe, në rrjedhën e historisë, fraksione të ndryshme kanë hyrë në konflikt me njëri-tjetrin për mbisundimin. Në fund të fundit, sidoqoftë, ato rezultojnë të bashkuara në dëshirën për t'i parë të realizuar planet e tyre dhe, në çastet vendimtare, i bashkojnë në masë forcat e tyre, për të nxitur Urdhërin e Ditës, kur ai vihet në rrezik.

Do t'ju duhet, ka të ngjarë, të shkoni prapa qindra mijëra vjet për të kërkuar burimin e zanafillave të historisë së manipulimit njerëzor dhe të familjeve që orkestrojnë Veprën e Madhe. Sa më shumë kam kërkuar informacione mbi këtë fushë në rrjedhën e viteve, aq më shumë më është bërë e qartë se origjinat e këtyre fiseve dhe plani për pushtimin e Tokës shkon përtej planetit dhe përzien në çështje një kryqëzim racash të ardhura nga sfera apo nga përmasa të tjera evolutive. Jashtëtokësorë, siç i quajmë ne. Nëse e vini në dyshim ekzistencën e jashtëtokësorëve, atëherë mendoni për

një çast për këtë. Dielli ynë është vetëm një diçka si nja 100 miliardë yje të tjerë vetëm në këtë galaksi. Sër Frensis Krik, nobelist, mbron idenë së në universin tonë mendohet ekzistenca e 100 miliardë galaksive dhe beson se janë të paktën një milion planete në galaksinë tonë, që mund të përmbajnë jetën ashtu siç e njohim ne. Mendoni se sa mund të bëhej kjo shifër, në qoftë se merret parasysh i tërë universi, përpara akoma se të hamendësojmë përmasa të tjera ekzistence, që qëndrojnë përtej rrezes së frekuencës të aftësive tona shqisore. Sikur të udhëtonit me shpejtësinë e dritës, 186.000 milje në sekondë, do t'ju duheshin 4,3 vjet për të arritur yllin më të afërt në këtë sistem diellor. Kjo është kuptimplote për nivelin e indoktrinimit të njerëzimit që gjykon se, të flasësh për jetë jashtëtokësore tregon një dozë të mirë tuhafërie, ndërsa ta hedhësh poshtë këtë ide dhe të çosh përpara hipotezën se jeta është shfaqur vetëm në këtë planet të vogël, mund të quhet e besueshme! Mjafton të shikosh monumentet e mahnitshme dhe të panumërta të botës së lashtë, për t'u bindur ndaj faktit se në ato kohë ekzistonin qytetërime të përparuara. Na thuhet se atëhere ekzistonin vetëm popuj primitivë, nëse krahasohen me njerëzit modernë, por kjo është qartësisht qesharake. Sikurse gati krejt "mendimi" zyrtar, *establishmenti* i historianëve dhe i arkeologëve i sajon historitë e tij, i quan fakte të dëshmuara, dhe thjesht i shpërfillin provat e pakundërshtueshme, që i nxjerrin lakuriq gabimet e tyre. Ideja nuk është që të formosh, por të indoktrinosh. Cilido që nuk e pranon versionin zyrtar të historisë, izolohet nga kolegët e vet historianë dhe nga arkeologët që, ose e dinë se puna e tyre, emri i tyre dhe financimet e caktuara për ta janë më të sigurta nëse përqafojnë versionin zyrtar, ose, sinqerisht, nuk shohin më tej hundës së tyre. E njëjta gjë mund të thuhet për pjesën më të madhe të njerëzve, që punojnë në fushën e mësimdhënies, apo të "intelektualëve".

Në të gjithë planetin ekzistojnë struktura fantastike të ndërtuara mijëra vjet më parë, që mund të jenë krijuar falë një teknologjie të të njëjtit nivel, shpesh madje më të mirë, me atë aktuale. Në Balbek, në verilindje të Bejrutit, në Liban, tre blloqe të mëdhenj guri, secili me peshë 800 tonelata, qenë zhvendosur të paktën me rreth pesëqind metra dhe qenë vendosur lart mbi një mur. E gjitha kjo qe realizuar mijëra vjet përpara Krishtit! Një tjetër bllok guri aty afër peshon 1.000 tonelata, sa pesha e tre *jumbo jets*-ave (emërtim i aeroplanëve reaktivë të transportit Boing 747). Si janë të mundura këto gjëra? Historia zyrtare nuk i shtron këto pyetje, sepse ka frikë se ku mund ta çonin. E imagjinoni dot sot t'i telefononi një muratori e t'i kërkoni të bëjë një gjë të tillë? "Dëshironi që të bëj ÇFARË?", do t'ju përgjigjej. "Ju jeni i marrë".

Në Peru janë Vijat Nazka misterioze. Njerëzit e lashtë zhvendosnin

shtresën e sipërme të tokës në kërkim të shtresës së parë të bardhë të nëntokës dhe, nëpërmjet kësaj metode, janë krijuar figura të pabesueshme kafshësh, peshqish, insektesh dhe zogjsh. Disa prej tyre janë aq shumë të mëdhaja sa që mund të shihen në plotshmërinë e tyre vetëm nga një lartësi ajrore rreth 300 metra! Dijet, që u kanë dhënë mundësi mrekullive si ato të Nazkas, të Balbekut, Piramidës së Madhe të Gizës dhe krijimeve të tjera të mahnitshme, të ndërtoheshin me një saktësi të atillë dhe me përmasa të atilla, vinin nga një racë e përparuar që, në kohërat e lashta, jetonte në mes të një mase njerëzish mjaft më primitive. Një racë e tillë përshkruhet si "perënditë" në tekstet e Testamentit të Vjetër e në vepra të tjera dhe në traditat gojore të lashtësisë. Dëgjoj ithtarë të *Biblës* që e mohojnë se libri i tyre flet për "perëndi". Por është e vërteta. Sa herë që në Testamentin e Vjetër përdoret fjala "Zot", ajo është përkthyer nga një fjalë që do të thotë perënditë, në shumës; Alohimi dhe Adonai janë dy shembuj. Mund ta kuptoni me lehtësi se si një racë që realizonte mrekulli të tilla teknologjike duhet të jetë parë si një grup "perëndish" nga një popull i paaftë për të kuptuar zotësi të tilla. Në vitet tridhjetë të shekullit njëzet, aviatorë ushtarakë amerikanë e australianë zbrisnin me aeroplanët e tyre në zona të humbura të Guinesë së Re, për të furnizuar me rezerva shokët e tyre. Vendësit, që nuk kishin parë kurrë ndonjë aeroplan, besuan se ata ushtarakë të forcave ajrore ishin perëndi dhe i bënë objekt të një kulti fetar. Një reagim i tillë do të ketë qenë edhe më i theksuar midis popullsisë së botës së lashtë, nëse pjesëtarët e kësaj race të përparuar do të kenë ardhur nga planete, yje apo përmasa të tjera, në bordin e anijeve hapësinore akoma më të përparuara, në krahasim me gjithçka që sot (të paktën zyrtarisht!) përdoret në fluturim nga forcat e armatosura. Një ndikim dijesh nga jashtë këtij planeti, ose nga ndonjë tjetër burim, do të shpjegonte shumë prej "mistereve", ndaj të cilave historia zyrtare kundërvë një heshtje shurdhuese. Edhe veprat e pabesueshme të ndërtimit bëhen të shpjegueshme, ashtu sikurse edhe misteri se përse qytetërimet e lashta si ai egjiptian dhe ai sumer *(sumerët i përkasin një popullsie të lashtë që rreth mijëvjeçarit IV para Krishtit populloi Mesopotaminë jugore, para se të bëheshin të njohur babilonasit, duke krijuar qytetërimin më të lashtë urban të njohur prej nesh)* (në atë që në *Bibël* është toka e Shinarit) arritën që në agimet e qytetërimeve të tyre majën e zhvillimit dhe pastaj perënduan, ndërsa rruga normale evolutive parashikon që niveli fillestar të jetë i ulët dhe pastaj përparon gradualisht përmes mësimit dhe përvojës. Është e qartë se ka pasur një futje dijesh shumë të përparuara, të cilat më pas kanë humbur për pjesën më të madhe të popullsisë.

Çdo kulturë e botës së lashtë paraqet histori të vjetra dhe tekste që i

LIBRI
BIBLIOTEKA KOMBËTARE

përshkruajnë "perënditë" prurës të këtyre njohurive të përparuara. Kjo do të shpjegonte edhe misterin se pse të lashtët zotëronin dije të jashtëzakonshme në fushën e astronomisë. Ekzistojnë legjenda të panumërta në të gjithë botën që kanë lidhje me një epokë të quajtur Epoka e Arit, e cila u shkatërrua nga përmbytjet e përbotshme dhe nga "Rënia e Njeriut". Poeti i lashtë grek Hesiodi e përshkruan kështu botën përpara "rënies":

"Njeriu jetonte si Perënditë, pa vese apo pasione, pa bezdira apo mundime. Në shoqëri të lumtur me qenie hyjnore (jashtëtokësorë?), *njerëzit i kalonin ditët e tyre me qetësi dhe gëzim, duke bashkëjetuar në barazi të përkryer, të bashkuar nga besimi i ndërsjelltë dhe nga dashuria. Toka ishte më e bukur se tani, dhe vetvetiu jepte një shumëllojshmëri të bollshme frutash. Qeniet njerëzore dhe kafshët flisnin të njëjtën gjuhë dhe bashkëbisedonin midis tyre* (telepati). *Burrat konsideroheshin akoma djelmosha në moshën e njëqind vjeçëve. Nuk vuanin nga asnjë prej ankesave të moshës dhe kur kalonin në përmasa jete më të larta, kjo ndodhte në një gjumë të ëmbël"*[1].

Sado që kjo mund të duket utopike, ekzistojnë histori të panumërta që i përkasin çdo qytetërimi të së shkuarës, të cilat e përshkruajnë botën antike me këto terma. Mund ta rikrijojmë atë pamje vetëm nëse ndryshojmë mënyrën e të menduarit dhe të të ndierit. Raportet më të plota të një race të përparuar përmbahen në dhjetëra mijëra pllakëza argjile të gjetura në vitin 1850 rreth 250 milje larg Bagdatit, në Irak, nga një anglez, Sër Austen Lajardi, ndërsa kryente gërmime në afërsi të Ninives, kryeqytet i Asirisë. Ai gjendej afër qytetit aktual iraken Mosulit. Gjetje të tjera janë kryer në këtë zonë që dikur quhej Mesopotami. Burimi zanafillor i këtyre dijeve nuk ishin asirët, por sumerët, që mendohet të kenë jetuar në të njëjtën zonë nga vitet 4000 deri në vitet 2000 përpara Krishtit. Për këtë arsye do t'u referohem pllakëzave prej argjile si Tekste, apo Pllakëza sumere. Është fjala për një prej gjetjeve historike më të rëndësishme dhe, megjithatë, 150 vjet që nga zbulimi i tyre, ato qëndrojnë ende të shpërfillura nga historia konvencionale dhe nga programet shkollore. Përse? Sepse rrëzojnë versionin zyrtar të ngjarjeve. Interpretuesi më i famshëm i këtyre Pllakëzave është kritiku dhe studiuesi Zekaria Sitkin, që di të lexojë gjuhën sumerike, aramaike, hebraike dhe gjuhë të tjera të Lindjes së Mesme e të Afërt[2]. Ai i ka studiuar thellë dhe i ka përkthyer pllakëzat sumere dhe nuk ka asnjë dyshim mbi faktin që përshkruajnë ca jashtëtokësorë. Disa studiues mbrojnë idenë se ai ka përdorur një version më të vonë të gjuhës sumere, për të përkthyer mbishkrimet e mëparshme, gjë për të cilën disa prej

përkthimeve të tij mund të mos jenë të sakta qind për qind. Unë besoj se idetë e tij thelbësore janë të sakta, dhe këtë e dëshmojnë edhe raporte e prova të tjera, por disa hollësi më lënë të ndërdymtë. Mendoj se disa prej interpretimeve të Sitkinit janë mjaft të diskutueshme, ndërsa jam në një mendje me tezën e përgjithshme. Sipas përkthimeve të tij (dhe të tjera) tekstet zbulojnë se qytetërimi sumer, prej nga rrjedhin shumë aspekte të shoqërisë moderne, qe një "dhuratë e perëndive". Jo perëndi mitike, por perëndi me mish e me kocka, që jetonin midis tyre. Pllakëzat i quajnë këto perëndi AN.UNNAK.KI (ata që nga Qielli zbritën në Tokë) dhe DIN.GIR (të Drejtët mbi Raketat e Zjarrta). Vetë emri "Sumerí" ishte KI.EN.GIR (Tokë e Perëndisë së Raketave të Zjarrta dhe edhe Toka e Gardianëve, sipas Sitkinit). Edhe teksti i lashtë i njohur me titullin *Libri i Enokut* i quan këto perëndi "Gardianët", sikurse bënin edhe egjiptianët. Emri me të cilin egjiptianët quanin perënditë e tyre, Neturu, është përkthimi fjalë për fjalë i emrit "gardianët" dhe ata mbronin idenë se perënditë e tyre kishin ardhur mbi anije qiellore.

Sipas Zekaria Sitkinit, pllakëzat sumere përshkruajnë se si anunakët kishin ardhur nga një planet i quajtur Nibiru (Planeti i Kryqit), që ai mendon se përshkruan një orbitë eliptike prej 3.600 vjetësh që e shpie midis Jupiterit dhe Marsit dhe pastaj larg në hapësirë, përtej Plutonit. Shkenca moderne ka identifikuar një trup qiellor, të cilin e quan Planeti X, që është lokalizuar përtej Plutonit dhe që mendon se bën pjesë në këtë sistem diellor. Por një orbitë eliptike do të ishte jashtëzakonisht e paqëndrueshme dhe e vështirë për t'u mbajtur. Shkencëtarë, që i vlerësoj, mendojnë se Sitkini gabohet në lidhje me teorinë e tij të planetit Nibiru, megjithëse idetë e tij thelbësore mbi anunakët janë të drejta. Pllakëzat sumere, sipas përkthimit të Sitkinit, përshkruajnë se si, gjatë formimit të parë të sistemit diellor, Nibiru shkaktoi gati shkatërrimin e një planeti që dikur ekzistonte midis Jupiterit dhe Marsit. Sumerët e quanin Tiamat, i mbiquajtur Përbindëshi i Ujit. Ata mendojnë se nga mbeturinat e dala nga përplasja e Tiamatit me një hënë të planetit Nibiru u formua Brezi i Madh i Asteroidëve, brezi i asteroidëve që ndodhet midis Marsit dhe Jupiterit. Ajo çka mbeti prej Tiamatit u shty në një orbitë tjetër, vijojnë tekstet, dhe si pasojë u formua Toka (shiko **Figura 2**). Emri sumerik për planetin "Tokë" do të thotë "i çarë", për shkak të gropës së madhe të krijuar, me sa duket, nga përplasja. Është interesant fakti se, nëse eleminoni ujin nga Oqeani Paqësor, ajo që do t'ju mbetet do të jetë një gropë gjigante.

LIBRI 24




Figura 2. *(Dielli, Toka, Marsi)* Sistemi diellor tregon vendosjen e brezit të asteroidëve midis Marsit dhe Jupiterit që, pavarësisht veçorive të ndryshme, shumë raporte të lashta dhe moderne i përshkruajnë si mbetje ose pjesë të ndonjë planeti.

Pllakëzat janë raporte të shkruara të traditave gojore, të cilat u përkasin shumë shekujve më parë dhe duhet patur kujdes që asnjë hollësi të mos shtohet apo të mos humbet dhe që simbolizmi dhe parabola të mos merren në kuptimin e ngushtë të tyre. Jam i sigurtë që në këtë mënyrë është krijuar shumë ngatërrim. Unë vetë ushqej dyshime në lidhje me formimin e Nibiru-Tiamatit dhe me vendosjen e tij të supozuar kohore. Por tekstet përmbajnë edhe shumë të vërteta, që mund të dëshmohen, jo më të fundit janë ato që lidhen me njohuritë astronomike. Pllakëzat përshkruajnë në mënyrë të saktë sistemin diellor me planetet në vendet dhe orbitat e tyre, me përmasat përkatëse dhe saktësia e tyre është vërtetuar vetëm në 150 vjetët e fundit, kur disa prej këtyre planeteve janë gjetur. Përshkruajnë edhe natyrën dhe ngjyrën e Nepturnit dhe Uranit në terma që janë vërtetuar thjesht në vitet e fundit! Dhe ka edhe më: "ekspertët" modernë nuk e kishin kuptuar me intuitë natyrën e vërtetë të këtyre planeteve, ndëra sumerët dinin mijëra vjet përpara Krishtit gjëra që shkenca jonë e "përparuar" i ka zbuluar vetëm tani.

Gjëja më e mahnitshme në lidhje me Pllakëzat sumere është mënyra me të cilën ato përshkruajnë krijimin e *homo sapiensit*. Sitkini mbron idenë se anunakët arritën në Tokë rreth 450.000 vjet më parë, për të nxjerrë arin nga Afrika aktuale. Mendon edhe se qendra kryesore minerare gjendej në

Zimbabven e sotme, një zonë që sumerët e quanin AB.ZU (depozitim i thellë). Studime të kryera nga shoqëria *Anglo-American Corporation* kanë zbuluar prani të mëdha minierash ari në Afrikë, që i takojnë një periudhe të paktën 60.000 vjet më parë, ndoshta edhe 100.000 vjet[3]. Sipas Sitkinit, pllakëzat sumere tregojnë se ari i nxjerrë nga anunakët transportohej në planetin e tyre të origjinës përmes bazave në Lindjen e Mesme. Unë besoj se ka ende shumë për të zbuluar në lidhje me këto "miniera ari" dhe nuk mendoj që kjo të ketë qenë arsyeja kryesore për të cilën anunakët erdhën këtu, nëse mund të quhet një arsye. Sitkini mbron idenë se fillimisht nxjerrja e arit u ishte besuar shtresave punëtore të anunakëve, por më pas minatorët u rebeluan dhe elita mbretërore e anunakëve vendosi të krijonte një racë të re skllevërish, që të kryenin atë punë. Pllakëzat sumere përshkruajnë se si genet e anunakëve dhe ato të vendësve u përzien në një epruvetë, për t'i dhënë jetë një qenieje njerëzore të "zhvilluar", që të ishte në gjendje të zgjidhte detyrat e kërkuara nga anunakët. Ideja e fëmijëve në epruvetë do të jetë dukur qesharake kur pllakëzat sumere u zbuluan në vitin 1850, por kjo është saktësisht ajo çka shkencëtarët janë në gjendje të bëjnë sot. Kërkimi modern vazhdon të vërtetojë atë sa është zbuluar nga pllakëzat sumere. Për shembull, rreth 200.000 vjet më parë ndodhi një fuqizim i papritur dhe deri tani i pashpjegueshëm i strukturës fizike njerëzore. Shkenca zyrtare nuk e shpjegon shkakun e kësaj dhe përtyp nëpër dhëmbë shprehje si "hallka që mungon". Por duhet të ndalemi mbi disa fakte të pashmangshme. Papritmas struktura e mëparshme fizike e njohur me emrin *homo erectus* shndërrohet në atë që tani e quajmë *homo sapiens*. Që në krye *homo sapiensi* i ri qe në gjendje të fliste një gjuhë të ndërlikuar dhe përmasat e trurit njerëzor u rritën në mënyrë të konsiderueshme. E, megjithatë, biologu Tomas Huksleji mbronte idenë se ndryshime kaq rrënjësore mund të realizoheri vetëm në harkun e miliona viteve. Ky opinion vërtetohet nga provat që lidhen me *homo erektusin*, i cili duket se ka lindur në Afrikë rreth 1,5 milionë vjet më parë. Dhe pavarësisht se kanë kaluar shumë më tepër se një milion vite, struktura e tij fizike duket se ka mbetur e njëjta, por pastaj, si nga hiçi, ja ku ndodh ndryshimi drastik, që çoi tek *homo sapiensi*. Rreth 35.000 vjet më parë ndodhi një tjetër fuqizim i papritur dhe shfaqja e *homo sapiens sapiensit*, që paraqiste strukturën tonë aktuale fizike. Pllakëzat sumere i emërtojnë të dy personat që u përfshinë në krijimin e racës së skllevërve. Bëhej fjalë për kreun e shkencëtarëve të quajtur Enki, Perëndia e Tokës (Ki = Tokë) dhe të Ninkharsagut, e njohur edhe si Ninti (Perëndeshë e Jetës), për shkak të njohurive të saj mjekësore. Më pas iu referuan asaj si Mami, prej nga rrjedhin fjalët "mama" dhe "mëmë". Simboli

i Ninkharsagut në paraqitjet mesopotamike është një pajisje, që përdorej për të prerë kordonin ombelikal. Ai simbol ka formën e një patkoi kali dhe përdorej në lashtësi. Ajo bëhet edhe perëndesha nënë e shumë besimeve, duke marrë emra si mbretëresha Semiramidë, Isida, Baratia, Diana, Maria e shumë të tjera, që përmenden në legjendat e gjithë botës. Shpesh paraqitet si një grua shtatzënë.

Ja çfarë lexohet në tekstet e pllakëzave sumere në lidhje me klasën drejtuese të anunakëve:

E thirrën dhe i thanë perëndeshës,
Mamisë së perëndive, prodhueses së mençur,
"Jepi jetë një krijese, krijo punëtorë!
Krijo një punëtor primitiv,
Që mund të mbajë zgjedhën!
Që ai të mbajë zgjedhën që i është caktuar nga Enlili,
Që punëtori t'i durojë mundimet e perëndive!"[4].

Enlili ishte kreu i anunakëve dhe Enki ishte vëllai i tij i gjetur. Enki dhe Ninkharsagu kryen shumë gabime teksa përpiqeshin për të arritur kryqëzimin e duhur genetik, na thonë pllakëzat sumere. Ka pllakëza që flasin për persona të krijuar me të meta të mëdha dhe edhe për hibride midis qenieve njerëzore dhe kafshëve. Gjë për të vjellë, dhe është saktësisht ajo çka duket se po ndodh sot nëpër bazat e nëndheshme të jashtëtokësorëve të përhapura nëpër botë. Historia e Frankenshtajnit dhe e njeriut të krijuar në një laborator, mund të ishte, në lidhje me këtë, emblematike. U shkrua nga Meri Shelli, gruaja e poetit të famshëm anglez. Si ai edhe ajo ishin anëtarë të lartë të rrjetit të shoqërive sekrete, që i ruan dhe i mban të fshehura këto njohuri që nga kohët e lashta. Pllakëzat sumere bëjnë të ditur se Enki dhe Ninkharsagu arritën të realizojnë hibridin e duhur, që u bë *homo sapiensi* i parë, një qenie që sumerët e quajtën LU.LU (ai që është përzier). Është ky "Adami" biblik. LU.LU-ja ishte një hibrid gjenetik, shkrirja e *homo erectusit* me genet e "perëndive", i realizuar me qëllimin për të krijuar një skllav, një bletë punëtore njerëzore, krijim i realizuar rreth 200.000-300.000 vjet më parë. U krijua edhe versioni femëror. Emri sumerik për burrin ishte LU dhe kuptimi i një rrënje të tillë do të thotë "punëtor" apo "shërbëtor". Ajo u përdor edhe për të emërtuar kafshët e zbutura. Dhe kjo është ajo çka raca njerëzore ka qenë që nga ajo kohë e më pas. Për mijëra vjet anunakët e kanë sunduar hapur planetin dhe tani vazhdojnë ta bëjnë në mënyrë të fshehtë. Përkthimi i gabuar i *Biblës* dhe interpretimi në kuptimin e mirëfilltë i gjuhës së saj simbolike e kanë shkretuar

kuptimin zanafillor, duke na dhënë një histori fantazie. *Gjeneza* dhe *Eksodi* janë shkruar nga klasa e priftërinjve hebraikë, levitët, pasi patën shkuar në Babiloni, duke nisur nga viti 586 para Krishtit. Babilonia ndodhej në ato toka që dikur kishin qenë trojet e sumerëve dhe kështu që babilonasit, ashtu si edhe levitët, i njihnin historitë dhe tekstet sumere. Pikërisht, mbi të gjitha mbi bazën e këtyre dokumenteve levitët përpiluan *Gjenezën* dhe *Eksodin*. Burimi është i qartë. Pllakëzat sumere flasin për E.DIN-in (Banesa e të Drejtëve). Kjo lidhet përsëri me emrin që sumerët u jepnin perëndive të tyre, DIN.GIR (të Drejtët mbi Raketa). Ashtu sikurse sumerët flisnin për Edinin, *Gjeneza* flet për Kopshtin e Edenit. Bëhej fjalë për një qendër ku jetonin perënditë, anunakët. Pllakëzat sumere citojnë pastaj mbretin Sargon i Vjetri, i gjetur që fëmijë në një shportë mbi një lumë dhe i rritur nga një familje mbretërore. *Eksodi* flet për Moisiun të gjetur që fëmijë në një shportë mbi një lumë nga një princeshë dhe i rritur pastaj nga një familje mbretërore. Lista e këtyre "përkimeve" është shumë e gjatë.

Testamenti i Vjetër është një shembull klasik i riciklimit fetar që u ka interesuar të gjitha besimeve. Për këtë arsye, nëse kërkoni kuptimin zanafillor të *Gjenezës* dhe të historisë së Adamit, duhet ta kërkoni burimin tek raportet sumere, për të parë se si është manipuluar historia. *Gjeneza* thotë se "Perëndia" (perënditë) krijoi njeriun e parë, Adamin, nga "pluhuri i tokës" dhe pastaj përdori një brinjë të Adamit për të krijuar Evën, gruan e parë. Zekaria Sitkini mbron idenë se përkthimi i togfjalëshit "pluhuri i tokës" rrjedh nga fjala hebraike "tit" dhe kjo, nga ana e saj, rrjedh nga termi sumerik TI.IT, që do të thotë "ajo që ka jetë". Adami nuk u krijua nga pluhuri i tokës, por nga ajo që ka jetë: nga qelizat jetësore. Termi sumerik TI ka kuptimin edhe brinjë edhe jetë dhe prapë edhe një herë përkthyesit kanë bërë zgjedhjen e gabuar. Eva (Ajo që ka Jetë) nuk u krijua nga një brinjë, por nga ajo që ka jetë: nga qelizat jetësore. Sipas sumerëve veza-qelizë njerëzore për krijimin e Lulu/Adamit e kishte prejardhjen nga një femër Abzu, në Afrikë, dhe gjetjet e ditëve tona të fosileve dhe kërkimet antropologjike vërtetojnë se *homo sapiensi* e ka prejardhjen nga Afrika. Në vitet tetëdhjetë të shekullit të njëzetë, Douglas Uellshi i *Emory University*, në shtetin Xhorxha të SHBA-së, ballafaqoi ADN-në (kujtesën gjenetike të trupit njerëzor) e 800 grave dhe arriti në përfundimin se ajo rridhte nga një paraardhëse e vetme femërore[5]. Uesli Braun i Universitetit të Miçiganit tha, pasi kishte analizuar ADN-në e 21 grave me prejardhje të ndryshme gjenetike dhe të ardhura nga e gjithë bota, se të gjitha rridhnin nga një paraardhëse e vetme, që kishte jetuar në Afrikë në një periudhë të përfshirë ndërmjet 180.000 dhe 300.000 vjetëve më parë[6]. Rebeka

Kani e Universitetit të Berkelejit, në Kaliforni, bëri të njëjtën gjë me 147 gra që kishin një *background* etnik dhe gjeografik të ndryshëm dhe arriti në përfundimin se pasuria e tyre e përbashkët gjenetike rridhte nga një paraardhëse e vetme, që kishte jetuar në një periudhë të përfshirë ndërmjet 150.000 dhe 300.000 vjetëve më parë[7]. Një tjetër studim i kryer mbi 150 gra amerikane me origjinë evropiane, afrikane dhe të Lindjes së Mesme, së bashku me vendase të Australisë dhe të Guinesë së Re, ka arritur në përfundimin se ato kishin një paraardhëse të përbashkët, që kishte jetuar në Afrikë në një periudhë që shkon nga 140.000 deri në një 190.000 vjet më parë[8].

Pllakëzat sumere dhe historitë e mëvonshme të akadëve (*banorë të mbretërisë së Akadit, e themeluar rreth vitit 2500 para Krishtit në pjesën jugore të Mesopotamisë*) zbulojnë emrat dhe hierarkinë e anunakëve. "Ati" i perëndive emërtohet si AN, një fjalë që do të thotë qiell. Ati ynë që je në qiej? AN, apo Anuja për akadët, qëndronte më së shumti në qiell me gruan e tij, Antunë, dhe i bënte vizita të rralla planetit që e quanin E.Rl.DU (shtëpi e ndërtuar larg), një fjalë që pastaj u transformua në "Tokë". Ose të paktën ky është përkthimi i Zakaria Sitkinit. Përshkrimet mund të nënkuptonin që Anuja rrinte më së shumti në malet e lindjes së Afërt, ku mendohet, me të drejtë, se ishte i vendosur "Kopshti i Edenit", vendi i perëndive, dhe se bënte vetëm vizita të rralla në rrafshinat sumere. Një qytet sumer quhej Eridu. Pllakëzat pohojnë se Anuja dërgoi dy bij për të transformuar dhe qeverisur Tokën. Ishin Enki, ai që thuhet se ka krijuar *homo sapiensin* dhe vëllai i tij i gjetur, Enlili. Këta do të jenë ngrënë pastaj me njëri-tjetrin për kontrollin përfundimtar mbi planetin. Enki, fëmija i parë i Anusë, u nënshtrua nga Enlili për shkak të merakut të madh që anunakët ushqenin për pastërtinë gjenetike. E ëma e Enlilit ishte motra e gjetur e Anusë dhe ky bashkim (*pra bashkimi i Anusë me motrën e gjetur, nga i cili kishte lindur Enki*) i përçoi genet mashkullore në mënyrë më të efektshme nga sa do të kishte ndodhur nëse Enki do të kishte lindur nga një tjetër nënë. Më pas pllakëzat sumere përshkruajnë se si anunakët krijuan ca fise që qeverisën mbi njerëzimin në këmbë të tyre dhe këto, sipas meje, janë familjet që akoma edhe sot mbajnë kontrollin e botës. Pllakëzat sumere përshkruajnë se si sovraniteti i qe garantuar njerëzimit nga anunakët dhe ky sovranitet qe njohur në zanafillë si "Anuarkia", prej emrit An apo Anu, kreu i "perëndive". Familjet e Vëllazërisë e kanë merak të madh çështjen e racës dhe të pasurisë gjenetike dhe kryqëzohen midis tyre, duke mos i shpërfillur krejt ndjenjat. Familjet (familja!) mbretërore dhe aristokracia evropiane, së bashku me të ashtuquajturat familje amerikane të *establishment*-it lindor, japin një shembull

të qartë të një meraku të tillë. Ato i përkasin të njëjtit fis dhe janë gjenetikisht të lidhura në krushqi midis tyre. Ja përse familjet e Vëllazërisë kanë qenë gjithmonë të torturuara nga ideja fikse për t`u lidhur në krushqi midis tyre, pikërisht ashtu sikurse pllakëzat sumere thonë se bënë anunakët. Nuk lidhen në krushqi për arsye snobiste, por për të ruajtur të paprekur një pasuri gjenetike, që t`ju ruajë disa aftësi, mbi të gjitha aftësinë për të ndryshuar pamje dhe të shfaqen nën forma të tjera. Do t`i thelloj këto argumente në mënyrë më të hollësishme pas pak.

Pllakëzat sumere përshkruajnë se si qenieve njerëzore u jepet nga Enki aftësia për të lindur dhe se si kjo çoi në një shpërthim të popullsisë njerëzore që rrezikoi të nënshtronte anunakët, të cilët nuk qenë kurrë të shumtë. Anunakët kishin shumë konflikte të brendshme dhe zhvillonin ndërmjet tyre luftëra me teknologji të lartë, kurse fraksionet e Enlilit dhe Enkit luftonin për kontrollin. Është përgjithësisht e pranuar prej studiuesve të anunakëve teza sipas së cilës Enki mbante anën e qenieve njerëzore, por sipas meje që të dy grupet dëshironin ta sundonin këtë planet, dhe kjo është arsyeja e tyre e vërtetë. Sikurse dokumenton Zakaria Sitkini në përkthimet e tij (dhe lexuesit e librave të shenjtë indianë, *Vedave*, mund ta përforcojnë këtë), ekzistojnë shumë tregime të "perëndive" që luftojnë kundër njëri-tjetrit për të fituar epërsinë. Raportet sumere zbulojnë se ishin sidomos bijtë e "perëndive" anunakë ata që qenë përfshirë në këto luftëra. Bëhet fjalë për bijtë e Enkit dhe të Enlilit, vëllezërit e gjetur që u bënë rivalë të egër, dhe bijtë e tyre zhvilluan një luftë shumë teknologjike, thonë pllakëzat sumere. Një betejë, në të cilën duket se ishin të përfshirë, ka qenë ajo e shkatërrimit biblik të Sodomës dhe Gomorrës. Këto qytete sipas gjasës gjendeshin në skajin jugor të Detit të Vdekur ku, sot, ka një radioaktivitet shumë më të lartë se normalja. Kjo ndodhi kur, sipas *Biblës*, gruaja e Lotit u kthye për të vështruar dhe u shndërrua në një shtyllë kripe. Pasi i ishte referuar versionit origjinal sumerik, Zakaria Sitkini pohon se përkthimi i vërtetë i asaj pjese do të duhej të ishte se gruaja e Lotit qe shndërruar në një shtyllë avulli, gjë e cila, në fund të fundit, është mjaft më e mundshme!

Në të gjithë botën, në çdo kulturë vendase, do të gjeni histori që lidhen me një përmbytje të përbotshme dhe pllakëzat sumere nuk bëjnë përjashtim. Sitkini mbron idenë se ato tregojnë se si anunakët e lanë planetin duke u larguar mbi anije kozmike, teksa një masë e jashtëzakonshme uji rrëmbente me vete një numër të madh njerëzish. Nuk ka dyshim që një katastrofë e imagjinueshme, ose ndoshta shumë katastrofa, të kenë ndodhur në Tokë afërsisht ndërmjet vitit 11.000 dhe vitit 4000 para Krishtit. Provat gjeologjike

dhe biologjike, të cilat vërtetojnë historitë dhe traditat e panumërta që përshkruajnë këto ngjarje, janë me të vërtetë të pakundërshtueshme. Ato vijnë nga Evropa, nga Skandinavia, nga Rusia, nga Afrika, nga i gjithë kontinenti amerikan, nga Australia, nga Zelanda e Re, nga Azia, nga Kina, nga Japonia dhe nga Lindja e Mesme. Nga e gjithë bota. Disa flasin për një valë të madhe të nxehti, që i bëri detet të valonin; për male që villnin zjarr; për zhdukjen e Diellit dhe të Hënës dhe për errësirën që pasoi; për shiun me gjak, me akull e me gurë; për tokën që u përmbys mbi vetvete; për qiellin që rrëzohej; për tokën që u ngrit dhe u fundos; për zhdukjen e një kontinenti të madh; për ardhjen e akullit; dhe praktikisht që të gjitha përshkruajnë një përmbytje fantastike, një mur uji, që e përlau Tokën. Vërshimi i detit i provokuar nga kometa tek filmi *Deep Impact* ju jep një ide të asaj që duhet të ketë ndodhur. Tekste të vjetra kineze bëjnë të ditur se si shtyllat që mbajnë qiellin u thërrmuan; se si Dielli, Hëna dhe yjet u rrokullisën në veri-perëndim, ku qielli u ul; lumenj, dete e oqeane u ngritën përpjetë në jug-lindje, ku Toka u fundos dhe një flakërimë e madhe qe shuar nga një përmbytje e furishme. Në Amerikë, indianët Paune e tregojnë të njëjtën histori që i përket një kohe në të cilën ylli polar verior ndërroi vend me atë jugor. Tradita amerikanoveriore flet për re të mëdha e të dendura që u shfaqën dhe për një nxehtësi aq të fortë sa i bëri të valonin ujrat. Eskimezët e Groenlandës u bënë të ditur misionarëve të parë se shumë kohë përpara Toka qe përmbysur. Legjendat peruane thonë se Andet qenë ndarë në dy pjesë, kur qielli hyri në luftë me Tokën. Miti brazilian përshkruan se si qielli shpërtheu dhe copat e tij ranë duke vrarë gjithçka dhe të gjithë, ndërsa qielli dhe Toka këmbyen vendet me njëri-tjetrin. Dhe indianët Hopi të Amerikës së Veriut bëjnë të ditur se "mbi Tokë u hapën humnera të thella dhe uji mbuloi gjithçka, me përjashtim të një rripi të hollë balte"[9]. E gjitha kjo është ngushtësisht e lidhur me legjendën e Atlantidës dhe Musë, apo Leomurias: dy kontinente të mëdha, njëri në Atlantik dhe tjetri në Paqësor, që shumë njerëz mendojnë se qenë qeverisur nga raca jashtëzakonisht të zhvilluara. Thuhet se kontinentet janë zhdukur nën dete në rrethanat e përshkruara më sipër, duke lënë vetëm ishuj si Azoret si dëshmi të përmasave të tyre të lashta dhe të shkëlqimit të tyre. Atlantida që përshkruar nga Platoni (427-347 para Krishtit), filozofi i lashtë grek, anëtar i lartë i rrjetit të shoqërive të fshehta dhe i shkollave misterike. Akoma sot e kësaj dite ky rrjet i fshehtë ua përçon shumë prej dijeve të tij pak të zgjedhurve, duke ua mohuar, në të njëjtën kohë, këtë privilegj masave. Historia zyrtare e heq qafe tezën e mbështetur nga Platoni mbi ekzistencën e një kontinenti të tillë dhe ka me sa duket disa mospërkime

historike në shkrimet e tij, por ideja e tij në thelb mbështetet nga prova gjeologjike. Azoret, që sipas disave ishin pjesë e Atlantidës, gjenden mbi kreshtën mesatlantike, e cila është e lidhur me një vijë plase (thyerjeje) që rrethon planetin (shiko **Figura 3**).




Figura 3. Kreshta mesatlantike, qendra e aktivitetit sizmik dhe vullkanik në zonën e Oqeanit Atlantik, ku duket se Platoni vendoste Atlantidën.

Kjo vijë është e gjatë 40.000 milje. Kreshta mesatlantike është një nga zonat kryesore sizmike dhe vullkanike. Katër pllaka të mëdha teutonike, euroaziatikja, afrikania, amerikanoverioria dhe karaibikja, takohen dhe përplasen në këtë zonë, duke e bërë shumë të paqëndrueshme nga pikëpamja gjeologjike. Si ishujt Azore edhe ishujt Kanarie kanë qenë subjekte të një aktiviteti të përhapur vullkanik në periudhën në të cilën Platoni vendos fundin e Atlantidës. Llavës iu deshën 15.000 vjet për t'u shpërbërë në ujin e detit e, megjithatë, ajo gjendet ende në fundin detar përreth Azoreve, duke vërtetuar tronditje gjeologjike të vona[10]. Të tjera prova, përfshirë rërën prej plazhi të gjetur në një thellësi që shkon nga 3.200 në 5.600 metra, tregon se fundi detar në këtë zonë duhet të ketë qenë, në një periudhë gjeologjike të vonë, sipër nivelit të detit[11]. Oqeanografi Mauric Eving ka shkruajtur në revistën

National Geographic se: "Ose toka është fundosur me dy apo tri milje, ose deti duhet të ketë qenë dy apo tri milje më poshtë në krahasim me atë ku është tani. Që të dy përfundimet rezultojnë të mahnitshme"[12].

Prova gjeologjike dhe biologjike sugjerojnë edhe se aktiviteti i përhapur vullkanik, që e bëri të fundoset tokën në zonën e Azoreve, u zhvillua njëkohësisht me shpërbërjen dhe fundosjen e masës tokësore e njohur si Apalakia, e cila lidhte zonat që sot i quajmë Evropë, Amerikë e Veriut, Islandë dhe Groenlandë[13]. Edhe niveli i tyre i fundosjes duket ngushtësisht i lidhur. Prova të ngjashme mund të sillen për të mbështetur tezën sipas së cilës kontinenti i njohur si Mu apo Lemuria tani gjendet në fundin detar të Paqësorit[14]. I ashtuquajturi Trekëndësh i Bermudeve midis Bermudës, Floridës Jugore dhe një pike afër Antileve, i është bashkuar për një kohë të gjatë Atlantidës. Bëhet fjalë edhe për një zonë, e cila është shpesh në qendër të legjendave për anije dhe aeroplanë të zhdukur. Ndërtesa, mure, rrugë të fundosura dhe gurë të vendosur në rrathë si ato të Stonehenges (në Angli), përveç ndërtimeve të ngjashme me piramidat, janë zbuluar afër Biminit, në ujërat e ishujve Bahamas dhe në brendësi të "trekëndëshit"[15]. E njëjta gjë ka ndodhur me mure dhe rrugë që krijonin linja, që ndërpriteshin[16]. Këto janë disa fakte të tjera që pjesa më e madhe e njerëzve nuk i njeh: Himalaja, Alpet dhe Andet e kanë arritur lartësinë e tyre të tanishme vetëm 11.000 vjet më parë[17]. Liqeni Titikaka, në kufirin midis Perusë dhe Bolivisë, është sot liqeni i lundrueshëm më i lartë i botës, në rreth 3.800 metra lartësi. Rreth 11.000 vjet më parë pjesa më e madhe e asaj zone ishte në nivelin e detit! Pse mbi majat e maleve gjenden aq shumë fosile peshqish dhe fosile të tjera oqeanike? Sepse ato male dikur ishin në nivelin e detit. Dhe në një kohë madje të vonë, në terma gjeologjikë. Tashmë është bërë gjithmonë e më shumë opinion i përgjithshëm fakti që toka të ketë pësuar njëfarë tronditje kolosale gjeologjike. Debati ndizet (dhe shpesh ngjyroset me armiqësi) kur kërkohet të përcaktohet se kur dhe përse ndodhi kjo. Këto tronditje kolosale gjeologjike kanë përfshirë natyrisht sistemin diellor në tërësinë e tij, duke qenë se çdo planet tregon shenjat e njëfarë ngjarjeje përmbysëse, që ka pasur të bëjë ose me sipërfaqen e tij, me atmosferën, me shpejtësinë dhe me këndin e orbitës, ose me rrotullimin e tij. Unë besoj se tematikat thelbësore të paraqitura nga pllakëzat sumere janë të drejta, por disa prej hollësive më lënë mëdyshas, për të mos folur pastaj për periudhën e gjatë që kalon në mes ndërmjet 450.000 vjetëve më parë, kur thuhet se kanë ardhur anunakët, dhe kohës kur, vetëm disa mijëra vjetë më parë, u shkruan këto raporte në pllakëzat. Rreth 11000 vjet përpara Krishtit ka patur siguristë një përmbytje kolosale në Tokë, e cila shkatërroi

qytetërimet e përparuara të Epokës së Arit me teknologji të lartë dhe ajo e datuar 13.000 vjetë më parë është jashtëzakonisht domethënëse dhe mjaft e rëndësishme për periudhën në të cilën sot jemi duke jetuar. Pikërisht ashtu sikurse planetet e sistemit diellor rrotullohen përreth Diellit, ashtu edhe sistemi diellor rrotullohet përreth qendrës, ose të paktën përreth pjesës qendrore, të galaksisë. Ky "diell qendror", apo diell galaktik, është quajtur nganjëherë "diell i zi". Sistemit diellor i duhen rreth 26.000 vjet për të bërë një rrotullim të plotë përreth qendrës galaktike dhe në kulturën indiane kjo merr emrin *yuga*. Disa studiues mendojnë se për gjysmën e atyre 26.000 vjetëve Toka priret drejt diellit të zi, burimi i dritës, ndërsa për 13.000 vitet e tjerë ka një prirje të kundërt. Pavarësisht kësaj, këto cikle janë mjaft të ndryshme, duke qenë se planeti është i zhytur në dritë pozitive për 13.000 vjet dhe pastaj zhvendoset në "errësirë" për 13.000 vitet pasardhës. Kjo ndikon në mënyrë vendimtare mbi energjinë, në të cilën ne të gjithë jetojmë. Është interesant fakti që mendohet se pikërisht 13.000 vjet më parë Epoka e Arit ka përfunduar me përmbytje e konflikte, dhe sot, ndërsa cikli i 13.000 vjetëve "errësire" po niset drejt përfundimit të tij, marrim pjesë në një rizgjim të shpejtë shpirtëror global dhe ngjarje të pabesueshme na presin në vitet e ardhshëm. Jemi duke hyrë përsëri në dritë. Për këtë arsye ka patur një përmbytje të jashtëzakonshme të përbotshme rreth 13.000 vjet më parë, që i ka dhënë fund qytetërimit me teknologji të lartë të Epokës së Arit. Por a ka qenë e vetmja? Provat thonë se jo.

Një miku im kalifornian, Brian Desborougu, është një shkencëtar dhe një kërkues që e çmoj shumë. Ka punuar në fushën e kërkimit aerohapësinor dhe në fusha të tjera kërkimi shkencor për llogari të shumë shoqërive. Briani është një tip me këmbët në tokë që i analizon të gjitha provat që ka në dispozicion dhe ndjek drejtimin në të cilin ato, dhe jo bindjet, e çojnë. Ai ka grumbulluar informacione shumë të hollësishme dhe interesante mbi botën e lashtë dhe mbi lidhjet e tyre me manipulimet e sotme nga ana e Vëllazërisë. Në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të njëzetë, teksa ishte në varësi të një shoqërie të madhe amerikane, kolegët e tij fizikantë përfunduan një studim të pavarur, në të cilin pranohej si hipotezë se rreth vitit 4800 para Krishtit një trup jashtëmase i madh, që ne tani e njohim si Jupiteri, u rrokullis në sistemin tonë diellor. Planetet jashtë sistemit tonë qenë hedhur në kaos dhe Jupiteri, si pasojë, u përplas me një planet që sillej ndërmjet Jupiterit të tanishëm dhe Marsit. Fizikantët thanë se mbetjet e atij planeti formuan brezin e asteroideve dhe një pjesë e Jupiterit u shkëput, për t'u bërë ajo që sot e quajmë Afërdita. Sipas këtij studimi, kur Afërdita, asokohe një masë e madhe materjeje, u

LIBRI

lëshua në hapësirë, shkatërroi atmosferën dhe jetën e Marsit, para se të kapej nga qendra gravitacionale e Tokës. Afërdita përshkoi mjaft orbita tokësore përpara se çasti i saj kinematik ta shtynte në pozicionin që zë aktualisht në sistemin diellor. Sipas fizikantëve kanë qenë ato orbita që kanë shkaktuar, rreth vitit 4800 para Krishtit, shkatërrime e përmbytje. Ata mendonin, sikurse edhe Brian Desborougu, se para asaj kohe Marsi sillej në pozicionin e tanishëm të Tokës dhe se kjo ishte shumë më afër Diellit. Drita shkëlqyese e Afërditës, në çastin kur kalonte afër Tokës, mund të ketë çuar tek ideja e Luçiferit (*Engjëllit të dritës, që sipas tregimit biblik u bë kreu i engjëjve rebelë*), "sjellësit të dritës". Dokumentet më të vjetër mesopotamikë dhe amerikanoqendrorë nuk e përfshijnë planetin e Afërditës në përshkrimet e tyre planetare, përveçse në kohë të vonë. Në shumë kultura mbretëronte një ankth i vërtetë për Afërditën, së cilës i kushtoheshin flijime njerëzore.

Kur dy trupa janë duke u përplasur, ai me masën më të vogël fillon të shpërbëhet, duke pas mbërritur kufirin Roche[18]. Në këtë rast akulli do të jetë hedhur nga sipërfaqja e Afërditës drejt Tokës. Përveç kësaj, duke hyrë në të ashtuquajturin Brezi Van Allen, që përthith pjesën më të madhe të rrezatimeve të rrezikshme të Diellit, akulli do të jetë jonizuar – magnetizuar – dhe kështu që është tërhequr nga polet magnetike tokësore[19]. Miliarda tonelata akulli, të ftohura në një temperaturë prej %273 gradë Celsius, do të kenë rënë në zonat polare, duke e ngrirë çdo gjë në çast[20]. Kjo, më në fund, do të shpjegonte misterin e mamuthëve që patën ngrirë në pozicionin në të cilin qenë kapur. Mamuthi, në kundërshtim me sa mendohet, nuk ishte një kafshë e zonave të ftohta, por jetonte në rrafshinat e buta. Në një farë mënyre, ato zona të buta qenë mbuluar me akull në një çast të vetëm. Disa mamuthë janë gjetur të ngrirë në aktin e të ngrënit! Je aty duke brejtur me dhëmbë diçka dhe fap papritmas ja tek shndërrohesh në hell akulli! Sikur ky akull i jonizuar të ketë rënë vërtet nga Afërdita, masa më e madhe do të ketë përfunduar në afërsi të poleve magnetike, sepse këto do të kenë ushtruar tërheqjen më të fortë. Dhe në fakt ka ndodhur pikërisht kështu. Masa e akujve në zonat polare është më e madhe në pole se sa në periferi të tyre e, megjithatë, në pole ka më pak borë e shi për të krijuar një grumbullim të tillë[21]. Vetëm rënia e Afërditës e shpjegon këtë fenomen. Tek *Libri i Jobit*, që mendohet se është një vepër mjaft më e lashtë se pjesa tjetër e *Bibles*, shtrohet pyetja që vijon: "Prej nga vjen akulli?". Do të thosha se përgjigjja është e qartë. Kjo shpjegon më tej arsyen përse të lashtët kishin ca harta që tregonin pamjen e Polit të Veriut dhe Polit të Jugut para ardhjes së akujve. Polet ishin pa akuj deri rreth 7.000 vjet më parë. Nuk ka pasur asnjë epokë akullnajore, sikurse pohon shkenca zyrtare. Bëhet fjalë

për të satin gënjim. Nëse merrni në shqyrtim "provat" që shkenca zyrtare paraqit për të mbrojtur idenë e rëndomtë të një epoke akullnajore dhe mënyrën me të cilën këto "prova" kundërshtohen në thelb nga fakte demostrative, do të çuditeni të shikoni se si budallallëqe të tilla mund të jenë bërë në radhë të parë "të vërteta" të rëndomta[22]. Para kësaj përmbytjeje të pabesueshme, dhe/ose të njërës prej shumë të tjerave, Toka kishte një klimë tropikale të njëjtë, siç e kanë treguar bimët e fosilizuara. Kjo klimë do të jetë modifikuar jo vetëm nga ardhja e akujve në sipërfaqe të saj, por edhe nga shkatërrimi i një sfere avujsh ujorë përreth Tokës, siç është përshkruar tek *Gjeneza*, dhe në të tjera tekste të vjetra. Kjo sferë avujsh siguronte një klimë tropikale të njëjtë të përhapur, por papritmas u zhduk.

Ndryshimi i mahnitshëm i temperaturës në pole do të jetë ndeshur me ajrin e nxehtë, duke shkaktuar erëra shkretuese, pikërisht siç është përshkruar nga folklori kinez. Fizikantët mbështesin idenë se presionet e krijuara nga orbitat e Afërditës përreth Tokës do të kenë prodhuar një mori baticash oqeanike me rreth 3.000 metra dhe kjo prapë edhe një herë do të vërtetonte faktin se pse agrikultura filloi të praktikohet në lartësi jo më të vogla se 3.000 metra. Në veprën e tij *Ligjet* Platoni shkruan se agrikultura u përhap në lartësira të mëdha, pasi një dallgë gjigante i mbuloi të gjitha fushat. Botanisti Nikollai Ivanoviç Vavilov ka studiuar më shumë se 50.000 bimë të egra të mbledhura në të gjithë botën dhe ka zbuluar se ato ishin me prejardhje prej vetëm tetë rajoneve të ndryshme, të gjitha të ndodhura në zona malore[23]. Vërshimi i detit do të ketë shkaktuar mbi sipërfaqen e tokës presione të barabarta me një çikë më pak se një tonelatë për centimetër katror, duke krijuar kështu vargmale të reja dhe duke fosilizuar gjithçka në harkun e pak orëve[24]. Guri artificial sot krijohet nga presione të kësaj madhësie. Pemë të pacënuara janë gjetur të fosilizuara dhe kjo duhet të ketë ndodhur patjetër në një çast, sepse, në harkun e një periudhe të gjatë kohe, pema normalisht do të ishte shpërbërë para se të mund të folizohej[25]. Në fakt, fosile të këtij tipi sot nuk formohen[26]. Ato janë rezultat i ngjarjeve përmbytëse të përshkruara më sipër dhe studiuesi Emanuel Velikovski, ka skandalizuar *establishment*-in shkencor të viteve pesëdhjetë të shekullit të shkuar, kur ngriti hipotezën se Toka kishte pësuar tronditje shumë të mëdha kur Afërdita, që asokohe sipas mendimit të tij ishte një kometë, u rrokullis në këtë zonë të sistemit diellor, para se të merrte pozicionin e saj të tanishëm. Kur planeti i Afërditës u fotografua nga misioni hapësinor *Mariner 10*, shumë prej përshkrimeve të Velikovskit u zbuluan të sakta, përfshirë atë që duket se është mbetje e një bishti të ngjashëm me një kometë. Edhe fotografitë e shkrepura në Mars nga misioni *Mariner 9*

LIBRI

vërtetonin disa prej teorive të Velikovskit. Ai mbështeste idenë se "kometa" Afërdita ishte përplasur me Marsin teksa hynte me shpejtësi në sistemin diellor. Koha në të cilën i vendoste Velikovski këto ngjarje ishte rreth vitit 1500 para Krishtit. Të tjerë shkencëtarë përgënjeshtrojnë tezat e njëri-tjetrit, duke sugjeruar periudha shumë të ndryshme për përmbysjet më të mëdha, kur, në realitet, ka patur gati me siguri një sërë përmbytjesh në harkun kohor që shkon nga viti 11.000 deri në vitin 1500 para Krishtit dhe, edhe në kohë më të vona. Studimi i sipërpërmendur i fizikantëve mbështeste edhe idenë se Marsi qe shkretuar pikërisht nga këto ngjarje, përfshirë ardhjen e Afërditës. Ata mendonin se Marsi qe shtyrë jashtë orbitës së tij dhe kishte ndjekur një orbitë eliptike mjaft të paqëndrueshme, që e çonte ndërmjet Tokës dhe Hënës në çdo 56 vjet[27]. I fundit i këtyre kalimeve duket se ka ndodhur rreth vitit 1500 para Krishtit, kur në ishullin grek të Santorinos shpërtheu një vullkan i madh dhe qytetërimi minoik i Kretës kaloi në histori. Po në këtë periudhë, nga viti 1600 deri në vitin 1500 para Krishtit, niveli i oqeaneve zbriti me 20%, disa liqene akullnajorë u formuan në Kaliforni, dhe kjo ka qenë me shumë gjasë periudha kur liqeni i madh në Saharanë pjellore u boshatis dhe filloi të formohej shkretëtira që shohim sot[28]. Më pas, Marsi u fut në orbitën e tij aktuale, por në atë pikë jeta në sipërfaqen e tij ishte zhdukur. E, megjithatë, gjurmët e mbetura në Mars e vërtetojnë të gjithë këtë. Misioni në Mars i anijes *Pathfinder* ka zbuluar se shkëmbinjtë e atij planeti nuk paraqesin shenja të mjaftueshme erozioni, që të provojnë praninë e tyre mbi sipërfaqe prej më shumë se 10.000 vjetësh[29].

Brian Desborougu beson, sikurse të gjithë fizikantët që ka njohur dhe me të cilët ka punuar, se Toka ka qenë dikur mjaft më afër Diellit nga sa është sot dhe se orbita e Marsit ndodhej aty ku aktualisht ndodhet Toka. Nëse, sikurse ngrihet si hipotezë, *kanionët* e thellë në sipërfaqen e Marsit kanë qenë formuar nga prurje shumë të mëdha uji, atëhere në Mars duhet të ketë pasur një klimë më të nxehtë, duke qenë se sot bën aq shumë ftohtë sa uji ngrin në çast dhe atmosfera gati e zbrazët do ta bënte të avullonte menjëherë ujin[30]. Desborougu thotë se afërsia më e madhe e Tokës kundrejt Diellit bëri të mundur që banorët e parë njerëzorë të ishin racat e zeza, pigmentimi i të cilave ishte në gjendje t'u bënte ballë rrezeve më të fuqishme të Diellit. Skelete të lashta të gjetura afër Stonehengenit, në Angli, dhe gjatë bregut perëndimor të Francës tregojnë karakteristikat hundore dhe kurrizore tipike të shumë grave afrikane[31]. Desborougu shton se në Mars, që asokohe gëzonte një klimë shumë të ngjashme me tonën, jetonte një racë e bardhë, para përmbytjes së shkaktuar nga Afërdita. Përmes kërkimeve të tij ai është bindur për faktin se

Marsianët e bardhë ndërtuan piramidat, gjurmët e të cilave janë gjetur në Mars, dhe i shpallën pastaj luftë një race të zezë të përparuar, për sundimin në Tokë. Këto luftëra, vijon, janë luftërat e "perëndive" të përshkruara në një pafundësi tekstesh të vjetra dhe, sigurisht, jo të fundit tek *Vedat* indiane. Desborougu mbron pastaj idenë se pas përmbytjes, marsianët e bardhë që ishin vendosur në Tokë, pasi Marsi qe shkretuar, kishin mbetur të braktisur në planetin tonë, pa teknologjinë e tyre. Këta marsianë të bardhë, vazhdon ai, u bënë popullsia e bardhë e Tokës. Është magjepsëse hipoteza e çuar përpara nga disa shkencëtarë, sipas së cilës, kur popullsitë e bardha zhyten për një kohë të gjatë në pishina, për shkak të humbjes shqisore, ritmi i tyre çirkadian (*Term i përdorur për fenomene biologjike që përsëriten afërsisht në çdo 24 orë*) sistemohet për 24 orë e 40 minuta, gjë e cila i përgjigjet jo periudhës rrotulluese të Tokës, por asaj të Marsit[32]. Kjo nuk u ndodh racave jo të bardha, që janë të sinkronizuara me rrotullimin tokësor. Sipas Desborougut këta marsianë të bardhë ishin raca jashtëzakonisht e zhvilluar e botës së lashtë, të njohur si fenikasit apo arianët dhe ata filluan procesin e gjatë, që do t'i çonte në rizotërimin e fuqisë së tyre të lashtë teknologjike, pas përmbysjeve që shkatërruan sipërfaqen e planetit të tyre dhe shkretuan tonin. Kërkimet e kryera nga unë e vërtetojnë këtë ide në thelb, edhe pse, si të gjithë ata që kërkojnë të zbulojnë se çfarë ka ndodhur në realitet, edhe unë ushqej ndonjë dyshim. Një racë e bardhë, e njohur me emrin e fenikasve dhe me emra të tjerë, ka qenë me siguri "truri" që qëndron prapa qytetërimit egjiptian, të paktën duke nisur nga periudha rreth vitit 3000 para Krishtit dhe, fusha e Gizës, ku qe ndërtuar piramida e madhe, ishte e njohur më parë si El-Kahira, një emër që rridhte nga emri arab El-Kahir, me të cilin tregohej... Marsi[33]. Tekste të vjetra tregojnë se matja e kohës ishte e lidhur ngushtësisht me Marsin dhe, 15 marsi, Idet e marsit (Marsi), ishte një datë shumë e rëndësishme për kalendarin e tyre të modeluar sipas Marsit, si edhe 26 tetori. Data e parë shënonte fillimin e pranverës, ndërsa e dyta shënonte fundin e vitit në kalendarin kelt[34]. Edhe historitë e Gralit të Shenjtë e të mbretit Artù janë të lidhura me këto fakte. Duket se Kamelot do të thoshte Qytet Marsian ose Qytet i Marsit[35].

Mendoj se ka të vërteta në të gjitha tezat e përmbledhura në këtë kapitull mbi tronditjet kataklizmike që Toka ka pësuar në periudhën ndërmjet vitit 11.000 dhe vitit 1500 para Krishtit. Përmbytja e parë i dha fund Epokës së Arit dhe zhduku qytetërimet me teknologji të lartë, që kishin ekzistuar para asaj kohe. Racat jashtëtokësore ose e lanë planetin para përmbytjeve të tilla, ose mbijetuan në lartësira të mëdha, apo në angrrat e tokës. E njëjta gjë ndodhi

gjatë përmbytjes së fundit. Shumë prej jashtëtokësorëve, dhe pjesa më e madhe e qenieve njerëzore tokësore, nuk u shpëtuan gjallë këtyre ngjarjeve. Ata që ia dolën mbanë patën detyrën të rinisnin gjithçka nga fillimi pa teknologjinë, të paktën fillimisht, që kishin pasur dikur në dispozicion të tyre. Të mbijetuarit u përkisnin dy kategorive kryesore, ata me origjinë më së shumti jashtëtokësore, që zotëronin dijet më të përparuara, dhe njerëzit, masa e skllevërve, që ishte pa këto njuhuri. Të parët nga ana e tyre ndaheshin në dy grupe. Aty ishin ata që dëshironin t'i përdornin njohuritë që zotëronin për qëllime pozitive dhe t'ia tregonin njerëzimit, dhe ata që kërkonin t'i grumbullonin po ato njohuri dhe t'i përdornin për të manipuluar dhe për të kontrolluar. Lufta midis këtyre grupeve në lidhje me përdorimin e këtyre njohurive vazhdon ende sot. Kur shoqëritë shpëtuan nga përmbytjet e ndodhura rreth vitit 11.000 para Krishtit, u shkretuan më vonë nga përmbytje të tjera gjatë mijëvjeçarëve që pasuan dhe njerëzimit iu desh të riniste nga fillimi shumë herë.

Por një element i pandryshueshëm i krejt historisë ka qenë manipulimi i njerëzimit nga ana e një race, ose më shumë racave, me prejardhje jashtëtokësore, mendërisht, edhe pse jo shpirtërisht, të zhvilluara. Duke qëndruar në temë, dua të hedh dritë tani mbi aspekte të reja të kësaj historie, që do ta keni të vështirë t'i besoni.

LIBRI 24

Kapitulli 2

"Mos flisni për zvarranikët!"

Jeni gati për këtë hap? Do të dëshiroja të mos isha detyruar t'i paraqisja informacionet që vijojnë, pasi ato e ndërlikojnë historinë dhe më ekspozojnë si qesharak para masës. Por kujt i bëhet vonë! Unë shkoj gjithmonë në drejtimin që më çojnë provat.

Nuk besoj që anunakët e pllakëzave sumere dhe marsianët e bardhë, ekzistencën e të cilëve e ngre si hipotezë Brian Desborougu, të jenë të njëjtët njerëz, edhe pse midis tyre mund të ekzistojë një lidhje gjenetike. Duke bërë bashkë frytin e provave, të teorive, të kërkimeve dhe të opinioneve që kam lexuar, apo për të cilat kam dëgjuar të flitet gati çdo ditë në këto vite të shkuara, besoj se anunakët rrjedhin nga një racë gjenetike zvarranike. Në mjedisin e kërkimeve mbi UFO-t, atyre u është dhënë emri i racës së zvarranikëve. Dhe nuk jam i vetmi që e çoj përpara këtë hipotezë. Unë vetë kam mbetur i befasuar nga numri i madh i njerëzve që sot nuk e përjashtojnë këtë mundësi dhe, madje, që arrijnë në të njëjtat përfundime përmes kërkimeve të tyre vetjake. Midis këtyre janë mjaft që jo shumë kohë më parë do të kishin qeshur edhe vetëm ndaj idesë se mund t'u besonin teorive të tilla. Doktor Artur David Horni, ish profesor i antropologjisë biologjike në *Colorado State University* të Fort Kolinsit, dikur i besonte nxehtësisht teorisë darviniste të evolucionit

njerëzor, domethënë zhvillimit të ngadaltë të gjinisë njerëzore mbi bazën e parimit sipas të cilit vetëm më të mirët mbijetojnë. Thjesht, duke vlerësuar provat dhe përvojën e vet, ai tani është i bindur se njerëzimi ka qenë përzgjedhur nga jashtëtokësorët dhe se një racë zvarranikësh ka kontrolluar planetin për mijëra vjet dhe vazhdon ta bëjë ende sot. Ky është edhe mendimi im, ndonëse unë kam arritur në të njëjtin përfundim duke ndjekur një rrugë shumë të ndryshme. Kërkimet e doktor Hornit janë paraqitur në mënyrë të hollësishme në librin e tij të shkëlqyer *Humanity's Extraterrestrial Origins*[1], në të cilin sugjeron se ata, që pllakëzat sumere i quajnë anunakë, janë kjo racë zvarranikësh, një pikë tjetër mbi të cilën unë pajtohem. Astrofizikanti i famshëm britanik Fred Hojl ka deklaruar, gjatë një konference shtypi të mbajtur në Londër në vitin e largët 1971, se bota kontrollohej nga një forcë, që mund të shfaqej në forma të ndryshme. "Ata janë kudo", u tha gazetarëve të shtangur, "në qiell, në det dhe në Tokë...". Shtoi edhe se "ata" e kontrollonin njerëzimin nëpërmjet mendjes. E di që kjo mund të duket mjaft e çuditshme, por duhet të arrini në fund të këtij libri për të kuptuar përmasën e provave që mbështesin këtë hipotezë. Nëse hiqni dorë tani, apo pas nja dy kapitujsh, sepse sistemi juaj i besimeve është i mbingarkuar, jeni të lirë ta bëni, por do të humbisni mundësinë të vini re se kjo që në dukje është e pabesueshme, në realitet është e vërtetë.

Sa më shumë kërkoj të tërheq fijet e një morie informacionesh, aq më shumë kam përshtypjen se jemi duke folur për dy situata të ndryshme, që ecin paralelisht. Në Tokë kanë qenë përhapur, dhe janë ende, të tjera raca jashtëtokësore, përveç racës jashtëtokësore që sumerët i quanin anunakë dhe tekste të tjera të vjetra i quanin Raca e Gjarpërinjve. Mund edhe të ketë ndodhur që disa prej këtyre racave të tjera zvarranike të kenë luftuar kundër anunakëve. Tekstet e vjetra të të gjithë botës flasin për këto "luftëra të perëndive", që mund të nënkuptonin edhe konflikte ndërmjet racave të ndryshme jashtëtokësore, përveç atyre të përshkruara në pllakëzat sumere, që duket se kanë parë të përfshirë në konflikt fraksione të anunakëve, në luftë midis tyre. Sot shumë njerëz deklarojnë se kanë parë qenie me pamje njerëzore, lëkura dhe fytyra e të cilëve të kujton hardhucat dhe thithlopat, më sy të mëdhenj të dalë jashtë. Xhason Bishopi III-të, pseudonim i një kërkuesi të fenomenit jashtëtokësor, mbron idenë se raca e zvarranikëve janë shumë më të gjatë se njerëzit dhe se e kanë gjakun të ftohtë si zvarranikët tokësorë[2]. Ata duket se janë shumë më pak të ndjeshëm emocionalisht se sa njerëzit dhe pjesa më e madhe e tyre ka vështirësi për të shprehur dashurinë, ndonëse janë jashtëzakonisht inteligjentë dhe se kanë zhvilluar një teknologji

shumë të përparuar. Duhet të them se ky është një përshkrim i shkëlqyer i qëndrimeve dhe i sjelljes së Vëllazërisë, që sot kontrollon botën. Shkrimet e ditëve tona mbi racën e zvarranikëve përkojnë me përshkrimet e shumë "perëndive" të teksteve dhe të legjendave të botës së lashtë, që na kanë arritur. Kultura Ubaid lulëzoi midis vitit 5000 dhe vitit 4000 para Krishtit, akoma përpara sumerëve, në atë që është sot Iraku dhe statujat e perëndive të tyre janë paraqitje të qarta qeniesh njerëzore me pamje zvarranikësh, hardhucash. Në pjesën e ilustrimeve mund të shikoni një statujëz Ubaid në formë hardhuce, që mban në krah një vogëlush hardhuce. Zona në të cilën janë zhvilluar kultura ubaide dhe ajo sumere është thelbësore për të kuptuar të tërë historinë dhe, statujëzat ubaide, përfaqësojnë fizikisht përshkrimin e "perëndive" që zotëroi në shumë shoqëri të lashta. Kulturat e Amerikës Qendrore kishin perëndinë e tyre gjarpër me flatra, Kuetzalkoatlin; indianët Hopi kishin si perëndi gjarpërin me pupla, Baholinkongan, dhe kultura vendase amerikane është e mbushur me qenie imagjinare me forma zvarranikësh, përfshirë kodërzën misterioze në formë gjarpëri në Ohajo; indianët e lindjes flasin për zvarranikët me pamje njerëzore, Nagasët; egjiptianët kishin perëndinë e tyre gjarpër, Knefin, dhe faraonët i paraqisnin shpesh bashkë me gjarpërinj; fenikasit kishin Agathodemon, një tjetër figurë gjarpëri; populli vudù ka një perëndi të quajtur Damballah Vedo, që është paraqitur në formë gjarpëri; edhe hebrejtë kishin Nakhustan, gjarpërin e bakërt. Perëndia e lashtë britanike, e njohur si dragoi që qeveris botën, quhej HU dhe, me të drejtë, prej këtej mendoj se rrjedh termi "hu-man" (*njerëzor*). Simboli sumer i diskut me flatra, që gjendet në të gjithë botën e lashtë, paraqitej normalisht me dy gjarpërinj. Simbolizmi i gjarpërit dhe shoqërimi i tij me "perënditë" e lashta përsëritet herë pas here në të gjithë botën. Prifti Xhon Bathurst Din në librin e tij *The Worship Of The Serpent*[3], shkruan:

"... Njëri pre(j) pesë ndërtuesve të Tebës (në Egjipt) mbante emrin e perëndisë-gjarpër të fenikasve, Ofhion... Altari i parë që iu ngrit ciklopëve në Athinë i qe kushtuar "Ops"-it, hyjnisë-gjarpër... Kulti simbolik i gjarpërit ishte aq shumë i përhapur në Greqinë e Lashtë, saqë Justin Martiri i akuzon grekët se e kanë futur në misteret e të gjithë perëndive të tyre. Thuhet edhe se kinezët janë besëtytë, kur u duhet të zgjedhin ndonjë ngastër toke mbi të cilën të ngrejnë një banesë apo një varr dhe se këshillohen me kokën, me bishtin dhe me putrat e dragojve të ndryshëm, që jetojnë nën tokë".

Ideja e dragonjve që vjellin zjarr dhe e gjarpërinjve të ligj, që përsëritet

në legjendat dhe në tekstet e të gjithë botës, mundet shumë mirë ta ketë prejardhjen nga "perënditë" zvarranike botërisht vepruese mijëra vjet më parë. Këta formonin Popullin e Gjarpërinjve të teksteve të lashta, përfshirë *Biblën*, ku gjarpëri është një figurë e herëpashershme. Natyrisht, gjarpëri ka qenë përdorur si simbol i shumë gjërave dhe jo të gjitha referimet janë të tilla që të çojnë tek raca e zvarranikëve. Por shumë prej tyre po. Një tjetër temë që përsëritet është ajo sipas së cilës një vend i shenjtë ruhet nga një gjarpër, apo nga një dragua. Kemi gjarpërin e Kopshtit të Edenit dhe tema e gjarpër-dragoit gëzon një përhapje botërore. Persianët flisnin për një zonë lumturie dhe kënaqësie të përkryer e quajtur Eden, që ishte më e bukura e krejt botës. Thoshin se ishte vendbanimi zanafillës i njerëzve të parë, para se të ishin tunduar nga shpirti i së keqes, nën formën e gjarpërit, që i shtyri të shijonin frutin e pemës së ndaluar. Ekziston edhe Pema Banyon, nën të cilën "Jezusi" indu, i njohur si Krishna, rrinte ulur përsipër një gjarpëri të mbështjellë dhe i shpërndante dije shpirtërore njerëzimit. Grekët e lashtë kishin Ishujt e të Bekuarve dhe Kopshtin e Esperideve, në të cilin rritej një pemë që prodhonte mollët e arta të pavdekësisë. Ky kopsht ruhej nga një dragua[4]. Në tekstet e shenjta kineze ekziston një kopsht, në të cilin rriten pemë që prodhojnë frutin e pavdekësisë dhe, edhe ai, mbrohet nga një gjarpër me flatra i quajtur dragua. Shkrimet e vjetra meksikane paraqesin një version të historisë së Evës, ku duket një gjarpër i madh mashkull[5]. Një tjetër legjendë indu flet për malin e shenjtë Meru i mbrojtur nga një dragua i frikshëm[6]. Gjithandej gjejmë të njëjtën temë të vendeve të shenjta të ruajtura nga dragonj të tmerrshëm dhe nga një zvarranik, ose nga një qenie gjysmë zvarranik e gjysmë njeri, që u shpërndan dije shpirtërore njerëzve.

Specia zvarranike ka një lidhje mjaft të vjetër me Tokën, që i takon një periudhe më shumë se 150 milionë vjetësh më parë, periudhës së dinosaurve dhe edhe më përpara. Nëse duam të kuptojmë natyrën e vërtetë të jetës, duhet t'i çlirojmë mendjet tona nga leqet e kushtëzimit dhe të kuptojmë se ajo që shikojmë përreth nesh në Tokë është vetëm një fraksion shumë i vogël, në krahasim me atë çka mund të jetë. Specia zvarranike, si hardhucat dhe gjarpërinjtë, nuk është gjë tjetër veçse një shprehje e grupit gjenetik të racës së zvarranikëve që popullon këtë univers. Ndërsa jo të gjithë dinosaurët ishin zvarranikë me gjak të ftohtë, sikurse kanë dëshmuar studimet e kohëve të fundit, zvarranikët dhe dinosaurët janë bërë të afërt vetëm nga aspekti fizik dhe që të dy palët kanë marrë larmi të çuditshme formash të ndryshme. Dinosaurët janë shfaqur nën forma të ndryshme, që nga krijesat fluturuese, të mëdha e të vogla, deri tek Tiranosaurus Rex-i, që peshonte tetë tonelata. Mendojmë me të vërtetë se llojet gjenetike të zvarranikëve dhe të dinosaurve,

që mund të shfaqen në aq shumë llojshmëri, nuk mund të merrnin formën e një qenieje me dy këmbë e me dy krahë, të pajisur me një aftësi truri të tillë për të vënë në funksionim një vetëdije teknikisht të zhvilluar? Kohët e fundit një studim më i thelluar i dinosaurve ka zbuluar se njëqind milionë vjet më parë mjaft prej tyre ishin shumë inteligjentë. Saurornitoidi, i quajtur kështu për pamjen e tij prej zvarraniku të ngjashëm me një zog, kishte një tru të madh, sy të larguar, që i lejonin një shikim stereoskopik, dhe këmbë me gishtin e madh përkundrejt gishtave të tjerë, që i lejonin të kapte dhe të hante gjitarë të vegjël[7]. Adrian J. Desmondi, njëri prej kërkuesve më në zë në botë në fushën e dinosaurëve, mbron idenë se krijesat si saurornitoidi ndaheshin nga dinosaurët e tjerë nga një "humnerë e krahasueshme me atë që ndan njerëzit nga lopët"[8]. Ai pyet me vete: "Kushedi ç'maja do të kishin mbërritur këta të afërm të sofistikuar të zogjve sikur të kishin mbijetuar?"[9]. Studimet sugjerojnë se, nëse dinosaurët nuk do të ishin zhdukur nga një përmbytje e mëvonshme 65 milionë vjet më parë, tashmë do të ishin evoluar në qenie zvarranike me pamje njerëzore[10]. Deil Rasëll, dekan i profesorëve të paleontologjisë në *Northern California University*, qe ngarkuar nga NASA, agjensia hapësinore amerikane, të shkruante një raport mbi natyrën e mundshme të jetës jashtëtokësore[11]. Ai përshkroi evoluimin e dinosaurit Trudon në linjë me ndryshimet gjenetike natyrale të ndodhura në harkun e miliona vjetëve dhe ngriti hipotezën e ekzistencës së një qenieje, që e quajti Dinosauroid, që paraqiste një ngjashmëri befasuese me një qenie zvarranike me pamje njerëzore (umanoid) dhe ishte identik me qeniet e përshkruara nga ata që deklarojnë se kanë parë zvarranikë jashtëtokësorë. Kush mund të thotë se ky kërcim evolutiv nga dinosaurët klasikë tek qeniet zvarranike me pamje njerëzore (umanoidët) nuk ka ndodhur në një tjetër përmasë apo në një tjetër planet, ose ndoshta në Tokë, para se dinosaurët të zhdukeshin? Dhe, pastaj, u zhdukën me të vërtetë të gjithë? Paleontologjia moderne (studimi i fosileve) po çon tani përpara hipotezën se jo të gjithë dinosaurët janë vrarë nga meteoriti që goditi Tokën 65 milionë vjet më parë dhe se disa vazhdojnë të jetojnë ende sot. Janë duke dalë në dritë gjithmonë e më shumë prova, sipas të cilave zogjtë duhet të jenë pasardhës të dinosaurve. Dhe, ndërsa trupat e pjesës më të madhe të dinosaurve mund të kenë qenë shkatërruar, ndërgjegjja e tyre do të ketë mbijetuar, pasi ndërgjegjja është energji dhe energjia është e pashkatërrueshme. Mundet vetëm të jetë shndërruar në një formë tjetër. Çfarë i ndodhi asaj ndërgjegjeje të dinosaurve që sundoi Tokën për *150 milionë* vjet? Siç e kemi parë, shkrimet e para asire, babilonase, të Testamentit të Vjetër, kineze, latine, amerikane, afrikane, indiane dhe të vendeve të tjera, paraqesin histori dragonjsh. Simboli i gjarpërit gjendet në lashtësi edhe në Britaninë e Madhe, në Greqi, në Maltë, në Egjipt,

në Nju Meksiko, në Peru dhe në të gjithë ishujt e Paqësorit. Ka një ngjashmëri të pamohueshme midis disa dinosaurve dhe paraqitjeve të lashta të dragonjve. Disa lloje hardhucash të vogla indo-maleze me krahët të bashkuar nga një membranë u ngjajnë aq shumë dragonjve, sa u është dhënë atyre emri *drako*, prej emrit të yjësisë nga e cila thuhet se raca e zvarranikëve ka pasur prejardhjen. Me interes akoma më të madh për mua është hardhuca e koracuar e quajtur *Molok Horridus*, që paraqet edhe ajo një pamje që të kujton dragoin. Moloku është një hyjni e lashtë, së cilës i flijoheshin fëmijë mijëra vjet më parë dhe së cilës i bëhen fli akoma sot brenda organizatave të përhapura të riteve satanike.

Këta fëmijë i bëhen fli me një fjalë racës së zvarranikëve sepse, siç do ta kuptoni, shumë "demonë" të satanizmit janë zvarranikët, të cilët prej mijëra vjetësh kërkojnë të bëhen zotër të planetit. Sipas Çarl Gouldit, që ka shkruajtur shumë mbi dragonjtë dhe mbi zvarranikët, "ekzistonte një lloj, tashmë e zhdukur, hardhucash që binte në letargji dhe ishte mishngrënëse dhe kishte krahë të ngjashëm me ata të hardhucës *drako* dhe ishte e mbrojtur nga një koracë me thumba"[12]. Ai mendon se habitati (*ambienti me karakteristika të caktuara fizike dhe kimike, ku jeton një lloj i caktuar kafshësh ose bimësh*) i saj gjendej në rrafshnaltat e Azisë Qendrore dhe se zhdukja e saj përkoi me përmbytjen e përbotshme[13].

Kush janë dhe prej nga vijnë?

Mund të ngremë tri hipoteza mbi prejardhjen e anunakëve dhe mbi ndërhyrjen e tyre në çështjet njerëzore:

1) Janë ca jashtëtokësorë;

2) Janë ca "brenda-tokësorë" që jetonin në angrrat e Tokës;

3) Manipulojnë njerëzimin
që prej një tjetre përmase, nëpërmjet "zotërimit" të trupave.

Unë besoj se janë të vërteta që të tria.

Jashtëtokësorë?

Studiuesit e fenomenit zvarranik arrijnë në përfundimin se të paktën disa prej këtyre llojeve erdhën nga yllësia e Drakos apo Dragoit (shih ***Figura*** 4).




Figura 4 *(Ylli Polar-Arusha e vogël-Dragoi-Vega).* Yllësia e Drakos apo e "dragoit", në drejtim të së cilës rezulton se janë orientuar shumë prej monumenteve të lashta.

Sistemi i dragoit përfshin yllin Thurban, dikur Ylli i Veriut, në drejtim të të cilit rezulton se janë orientuar piramidat egjiptiane[14].

Sipas kërkimeve të studiuesit Graham Hankok, kompleksi i tempullit të lashtë Angkor Wat në Kamboxhia është një riprodhim i yllësisë së Dragoit, ashtu siç do të jetë dukur në vitin 10500 para Krishtit[15]. Ishte kjo epoka kur Toka dhe popullsia e saj, njerëzore dhe jashtëtokësore, ishin duke e rimarrë veten nga përmbytja e vitit 11.000 para Krishtit dhe qytetërimet e ndryshme po niseshin drejt rindërtimit. Kërkuesi Robert Bauval mbron idenë se piramidat e Gizës janë të orientuara drejt yjeve të "brezit" të Orionit, ashtu siç do të kenë qenë në vitin 10500 para Krishtit, kur Orioni zinte pikën më të ulët të ciklit të tij (nga sa kuptoj, orionët janë një tjetër racë jashtëtokësore që vepron në këtë planet). Sipas Hankokut dhe kërkuesve të tjerë, Sfinksi me trup luani i Gizës, që gjykohet mjaft më i lashtë në krahasim me datimin fillestar, po në atë periudhë, domethënë në vitin 10500 para Krishtit, do të ketë qenë i kthyer në drejtim të yllësisë së Leos apo të Luanit. Kërkimet vazhdojnë në oqean në gjerësi të brigjeve të Japonisë, në brendësi të një strukture fantastike, që mund t'i përkasë edhe ajo të paktën vitit 10500 para Krishtit. Shumë studiues kanë ngritur dyshime mbi këto zbulime, sidomos mbi orientimin e piramidës së Gizës në drejtim të Orionit, por edhe në rast se ato nuk do të ishin të përpikta deri në hollësitë më të vogla, do të nxisin të paktën një sektor të rëndësishëm kërkimi. Tek e fundit, të zbulosh të vërtetën, veçanërisht kur është e lidhur

LIBRI 24

me epoka kaq të largëta, nuk është sigurisht e lehtë. Është sigurisht e mahnitshme se si ndërtesa e tempuj të lashtë, të përhapur në të gjithë botën dhe në qytetërime në dukje të palidhur me njëri-tjetrin, të paraqesin një orientim të njëjtë me një saktësi astronomike, matematike e gjeometrike, sa duket e pabesueshme. Por, në fund të fundit, këto shoqëri *nuk* ishin aq të palidhura me njëra-tjetrën. Siç do ta shohim më pas, kishin një origjinë të përbashkët. Tempujt në Angkor Wat janë të mbushur me figura zvarranikësh, një karakteristikë e përbashkët për të gjitha kulturat e lashta, përfshirë egjiptianen, amerikanoqëndroren dhe indianen. Profesori Filip Kalahan në studimin e tij mbi kullat misterioze rrumbullake, që kanë mbijetuar në Irlandë, ka pohuar se ato rezultojnë të orientuara me njëkohshmëri të jashtëzakonshme me yllësitë e hemisferës veriore gjatë solsticit dimëror. Dhe këto kulla rezultojnë edhe të orientuara në mënyrë të përkryer drejt yllësisë së... Dragoit. Koka dhe sytë e figurës së dragoit, të gjetura në tokën irlandeze, ndodhen, sipas Kalahanit, mbi dy brigjet e lumit Lough Neagh, pikërisht në qendër të Irlandës së Veriut. Bregu lindor i lumit Lough Neagh është afër kryeqytetit, Belfastit[16]. Kështu që koka e yllësisë së dragoit përcaktohet në Irlandën e Veriut, ajo zonë e vogël që ka qenë teatër i aq shumë pështjellimi, dhune dhe vuajtjeje. Në fund të këtij libri, kush nuk ka njohje me këto koncepte, do të kuptojë se si simbolizmi ka fuqinë për të tërhequr në një vend energji negative e pozitive. Xhon Rhodesi[17], njëri prej studiuesve më autoritarë të fenomenit zvarranik, mbron idenë se mund të ekzistojnë pushtues nga hapësira, që zhvendosen nga njëri planet në tjetrin, duke u futur në mënyrë të fshehtë në shoqërinë që i mirëpret, për të marrë pastaj drejtimin. Thuhet se ushtarakët e racës së zvarranikëve rrëmbejnë disa forma jete, me qëllim që shkencëtarët e tyre t`i studiojnë nga një pikëpamje biologjike dhe fusin kodin e jetës së racës së zvarranikëve tek llojet që dëshirojnë t`i manipulojnë. Kjo parashikon një program kryqëzimi racash dhe i përkon saktësisht me atë që tekstet sumere përshkruajnë në lidhje me anunakët. Rhodesi shton se:

"Që nga bazat e tyre nëntokësore, jashtëtokësorët ushtarakë të racës së zvarranikëve... (krijojnë) *...një rrjet të futurish, rezultat i kryqëzimit midis njerëzve dhe zvarranikëve, brenda niveleve të ndryshme të kompleksеve industriale e ushtarake të shoqërisë, të organizmave qeverisëse, të grupeve paranormale/UFO, të urdhërave fetarë e klerikalë etj. Këta të kryqëzuar, ca të paditur të udhëzimeve të "kontrollit mendor" gjenetik të dhëna nga zvarranikët, luajnë rolin e tyre armiqësor të "agjentëve zvarranikë" dhe përgatisin terrenin për një pushtim të jashtëtokësorëve të udhëhequr nga zvarranikët"*[18].

Jam ndeshur vetëm kohët e fundit me studimet e Xhon Rhodesit, para se të plotësoja këtë libër dhe, siç do ta shihni më hollësisht në vijim, kam arritur saktësisht tek të njëjtat përfundime të tij. Rhodesi mbron idenë se pasi zvarranikët pushtojnë një planet që nga hapësira dhe nga bazat e tyre nëntokësore, popullsia në sipërfaqe dorëzohet me shpejtësi përballë armatimeve të tyre të përparuara. Në atë pikë zvarranikët plaçkitin planetin me pasuri si uji, mineralet dhe informacionet e përmbajtura në ADN. Depërtimi në shoqërinë njerëzore përmes shoqërive të fshehta është një metodë kyç e kontrollit të racës së zvarranikëve, siç do ta përshkruaj në mënyrë të hollësishme. Kërkuesi amerikan Uilliam Bramleji në librin e tij *Gods of Eden* ka arritur në përfundimin se anunakët krijuan një shoqëri të fshehtë të quajtur Vëllazëria e Gjarpërit, që është përdorur për të manipuluar njerëzimin në mënyrat që do të përshkruhen në kapitujt pasardhës[19]. Kjo Vëllazëri e Gjarpërit është bosht i rrjetit global të ditëve tona me shoqëri të fshehta të kontrolluara nga zvarranikët.

Brenda-tokësorë?

Në formën e tyre fizike, anunakët janë njëra prej shumë racave brenda-tokësore, që jetojnë nën sipërfaqen e tokës, në katakombe jashtëzakonisht të mëdha, galeri e tunele. Një legjendë e indianëve Hopi tregon se nën qytetin Los Anxheles ekziston një kompleks shumë i lashtë galerish i zënë, rreth 5000 vjet më parë, nga një racë "formëhardhuce". Në vitin 1933, G. Uorren Shufelt, një inxhinier minierash prej Los Anxhelesit, deklaroi se kishte rënë në gjurmë të këtyre galerive[20]. Sot thuhet se në atë vend zhvillohen disa rituale të kobshme masonike. Nga ana e autoriteteve është vepruar për t`i varrosur lajmet lidhur me ekzistencën e këtyre racave nëntokësore dhe me vendin në të cilin jetojnë. Në vitin 1909, një qytet nëntokësor i ndërtuar me saktësinë e Piramidës së Madhe është zbuluar nga G.E. Kinkaidi afër Kanionit të Madh, në Arizonë. Ishte i madh aq sa të strehonte 50.000 njerëz dhe trupat e mumjefikuara të gjetur në vend ishin, sipas kryesuesit të ekspeditës, profesorit S.A. Xhordan, me origjinë lindore, apo sipas gjasës egjiptiane[21]. Qenë gjetur edhe objekte të shumta të punuara me dorë, përfshirë vegla e enë prej bakri të fortë si çelik. Instituti Smithsonian në Uashington DC ka bërë të pamundurën që këto zbulime të mbeteshin të panjohura për opinionin publik (është kjo detyra e tij!) dhe askush nuk do të mësonte për këtë zbulim, po të mos kishte qenë për dy artikuj të publikuar në një gazetë lokale, *Gazeta e Arizonës*, në prill të vitit 1909. Kërkuesi Xhon Rhodes pohon se e kishte përcaktuar këtë vend dhe e lidh me sipapunët, botën nëntokësore prej nga

LIBRI

indianët Hopi deklarojnë se kanë ardhur. Sipas legjendave të tyre, hopët dikur jetonin në angrrat e tokës dhe ushqeheshin e visheshin nga një "popull milingonash", sipas gjasës jashtëtokësorët e njohur si të Hirtët. Hopët flasin për paraardhësit e tyre si për "vëllezërit gjarpërinj" dhe rituali i tyre nëntokësor më i shenjtë është vallzimi i gjarpërinjve. Siç nuk do të lodhem kurrë së nënvizuari, jo të gjitha racat e zvarranikëve kanë një natyrë negative dhe unë nuk kam asnjë synim të paraqes si djallëzore racën e zvarranikëve. Këtu po flasim vetëm për një grup prej tyre. Hopët tregojnë se një ditë, me urdhërin e perëndeshës së tyre, Gruas Merimangë, ata u ngjitën gjer në sipërfaqe të Tokës dhe dolën nga bota e tyre nëntokësore e quajtur Sipapuni. Me të dalë jashtë, vazhdojnë hopët, arriti një mullibardhë përqeshëse që e ngatërroi gjuhën e tyre, duke bërë që çdo fis të fliste një gjuhë të ndryshme. Analogjitë me episodin biblik të Kullës së Babelit janë aq shumë të dukshme, sa që një paralele midis të dy historive ngrihet vetvetiu. Akoma sot hopët nuk dëshirojnë t'i riprodhojnë shëmbëlltyrat e paraardhësve të tyre formëgjarpërinjsh prej frikës se mos vdesin. Harta e botës nëntokësore e zbuluar në Arizonë qe përshkruar nga G.E. Kinkaidi si një "... dhomë jashtëzakonisht e madhe nga e cila shpërndahen një mori kalimesh, si telat e një rrote biçiklete". Ky përshkrim imiton pikë për pikë atë të bazës nëntokësore të racës zvarranike të Dulçes, në Nju Meksiko, dhe struktura me rrathë koncentrikë, dhe ndarja në seksione me nivele të ndryshme dijesh, është tipike edhe për Vëllazërinë globale, që manipulon botën. Arizona, Nju Meksikoja dhe zona e Katër Këndeve, ku takohen shteti i Arizonës, i Utahut, i Kolorados dhe i Nju Meksikos, janë disa prej zonave më të rëndësishme të botës për sa i përket bazave nëntokësore të racës së zvarranikëve. Por botë e qytete nëntokësore, të lashta e moderne, ka plot në të gjithë planetin. Ka dëshmi okulare qeniesh gjigante jashtëtokësore me pamje njeriu (umanoidësh) të parë me sy në katakombet e Hal Salfinit, në Maltë, gjatë viteve tridhjetë të shekullit të njëzetë, që u mbyllën pasi një grup shkollarësh u zhdukën aty bashkë me udhërrëfyesin e tyre. Më shumë se 30 komplekse të mëdha galerish dhe qytete nëntokësore janë lokalizuar pranë Derinkujas, në Turqi. Dhe lista vazhdon. Krijesa misterioze e njohur si *Bigfoot* (Këmbëmadh), një qenie gjigante leshatore e ngjashme me një majmun, duket se banon në angrrat e Tokës. Midis studiuesve të UFO-ve është e përhapur bindja se ekzistojnë baza nëntokësore të racës zvarranike, prej nga vepron elita, rezultat i kryqëzimit ndërmjet zvarranikëve dhe njerëzve, dhe ish nëpunës të CIA-s, me të cilët kam biseduar, ma kanë përforcuar këtë. Është e sigurtë se një racë zvarranikësh jeton materialisht në këtë planet dhe i vetmi dyshim është nëse

e ka prejardhjen nga Toka apo vjen nga ndonjë planet tjetër. Prapë edhe një herë, sipas gjasës, janë të vërteta të dyja gjërat.

Vijnë nga përmasa të tjera?

Studimet e mia sugjerojnë se kontrolli dhe manipulimi orkestrohen kryesisht që prej një përmase tjetër, prej nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Pa kuptuar natyrën multidimensionale të jetës dhe të Universit, është e pamundur të kuptojmë manipulimin tokësor nga ana e forcave jonjerëzore. Sikurse janë duke vërtetuar tani shkencëtarët më të paparagjykueshëm, Krijimi konsiston në një numër të pafundëm frekuencash apo përmasash jete, që ndajnë bashkë të njëjtën hapësirë, në të njëjtën mënyrë siç e bëjnë frekuencat radiofonike dhe televizive. Në këtë çast ti je i sintonizuar me botën tripërmasore apo përmasën e tretë dhe kjo është ajo që e percepton si realitetin tënd. Me fjalë të tjera, je i sintonizuar me këtë stacion. Por, siç ndodh me radion dhe me televizorin, të gjitha stacionet e tjera janë duke transmetuar në të njëjtën kohë dhe, nëse rrotullon çelësin e radios apo ndërron kanal në TV, mund të lidhesh me to. Kur e bën, stacioni apo kanali, me të cilin ishe më parë i sintonizuar, nuk zhduken, por vazhdojnë të transmetojnë, por ti nuk i dëgjon dhe nuk i sheh më, sepse nuk je më në gjatësinë e tyre të valës. E njëjta gjë i ndodh ndërgjegjes njerëzore. Disa njerëz (të gjithë, të thuash të vërtetën) mund ta sintonizojnë ndërgjegjen e tyre me të tjera gjatësi vale dhe të kenë të drejtën të hyjnë tek informacionet dhe tek ndërgjegjja që vepron në atë frekuencë. Kjo quhet nga ne fuqi medianike (*aftësi për të hyrë në lidhje me shpirtrat*), por është fjala në realitet për aftësinë për të zhvendosur "çelësin" tonë në një "stacion" tjetër. Dhe pikërisht që nga njëri prej këtyre stacioneve apo përmasave të tjera raca formëgjarpërinjsh e anunakëve e kontrollon këtë botë, duke "zotëruar" disa grupe gjenetike. Po, po, e di, duket një marrëzi, por e vërteta është shpesh e tillë. Mund ta lini librin në këtë çast, nëse kjo ju duket tepër, por duhet përkundrazi ta lexoni të gjithë për të zbuluar masën e madhe të provave, që vërtetojnë se bëhet fjalë për gjëra të *vërteta*. "Stacioni" prej nga vepron raca e zvarranikëve është niveli më i ulët i përmasës së katërt, ai më afër kësaj bote fizike. Të tjerë njerëz e njohin si përmasa yjore më e ulët, shtëpia legjendare e demonëve dhe qenieve të këqia, që i përket lashtësisë. Dhe pikërisht prej këtej satanistët e sotëm ndjellin qeniet e tyre demoniake gjatë ritualeve të magjisë së zezë. Në realitet ndjellin zvarranikët e nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Disa studiues ngrejnë, me të drejtë, hipotezën se zvarranikët e pamaterializuar kanë mundur të hidhen në këtë përmasë përmes portash e vrimash të mbështjellës hapësirë-e përkohshme, që janë hapur pas

shpërthimeve bërthamore dhe testeve të kryera në shkretëtirën e Nju Meksikos në vitet e para të dyzetës së shekullit të kaluar. Por unë besoj se këto vrima kanë filluar të krijohen shumë kohë më parë, para përmbytjeve, kur bota kishte një nivel teknologjie edhe më të përparuar në krahasim me atë të sotëm.

Kontrolli i planetit Tokë nga ana e racës së zvarranikëve i përket që të tria pikave të paraqitura më sipër. Unë mendoj se raca zvarranike vepron në të gjithë Universin dhe se ajo nuk është aspak e keqe në tërësinë e saj. Sikurse në rastin e njerëzimit, ajo përfshin të tërë gamën e sjelljeve nga dashuria tek urrejtja, nga liria tek kontrolli. Unë i referohem vetëm një grupi të veçantë, jo krejt llojit, nuk do të lodhem kurrë së saktësuari. Ky grup sundues ka arritur këtu që nga Yllësia e Drakos (ose Dragoit) dhe yllësi të tjera, dhe kjo është prejardhja e një termi si "drakonian", një fjalë që i shpreh mirë sjelljet dhe qëllimet e tyre. Ata janë të dëshiruar për gjak njerëzor dhe nuk janë gjë tjetër veçse djajtë gjakpirës të legjendave. Historitë e vampirëve kanë në këtë kuptim një vlerë fort simbolike dhe, cili është në fakt emri i vampirit më të famshëm? Konti Drakula! Titulli "kont" i referohet familjeve aristokrate, rezultat i kryqëzimit midis zvarranikëve dhe njerëzve, që raca e zvarranikëve manipulon që nga niveli më i ulët i përmasës së katërt, ndërsa "Drakula" është një referim i qartë i mëtejshëm ndaj "Drakos". Përshkrimet e kohëve të fundit mbi popuj që ushqehen me gjak, si kupakabrat në Porto Riko, në Meksikë, në Florida dhe në Paqësorin Veriperëndimor, përputhen me përshkrimet e racës së zvarranikëve. Ata janë parë të thithin gjakun e kafshëve shtëpiake si dhitë, dhe emri i tyre do të thotë "thithësit e dhive". Zvarranikët po bëhen gati të hidhen në një sulm nga të dy krahët kundër njerëzimit. Ata ndërmjet tyre që janë materializuar jetojnë nën tokë dhe ndërveprojnë në bazat nëntokësore me shkencëtarë e ushtarakë njerëzorë dhe njerëzoro-zvarranikë. Herë pas here dalin në sipërfaqe edhe për të rrëmbyer ndonjë qenie njerëzore. Por kontrollin kryesor e ushtrojnë përmes zotërimit të plotë. Programi i kryqëzimit (me rrugë seksuale dhe me epruvetë) është përshkruar në pllakëzat sumere dhe në Testamentin e Vjetër (Bijtë e Zotit që bashkohen me bijat e njerëzve). Këta hibridë njerëzoro-zvarranikë ruajnë kodin gjenetik të racës zvarranike dhe mund të zotërohen kështu më me lehtësi nga ana e zvarranikëve të nivelit të ulët të përmasës së katërt. Siç do ta shohim, këto grupe gjenetike janë bërë pastaj aristokracia dhe familjet mbretërore të Britanisë së Madhe e të pjesës tjetër të Evropës dhe, falë Perandorisë së "madhe" britanike, janë eksportuar në të gjithë botën, për të qeverisur Amerikat, Afrikën, Azinë, Australinë, Zelandën e Re, e kështu me radhë. Përmes manipulimit ato arrijnë majat e pushtetit politik, ushtarak, mediatik,

financiar e industrial, dhe kështu këto pozita mbahen në realitet nga zvarranikët e nivelit të ulët të përmasës së katërt, nën tipare njerëzore, ose si kukulla të kontrolluara mendërisht nga vetë këto krijesa. Ato veprojnë në brendësi të të gjitha racave, por kryesisht midis të bardhëve.

Sikurse është e pranuar njëzëri, ekziston një zonë e trurit njerëzor e njohur në ditët tona si tru zvarranik. Në brendësi të trurit ka një segment origjinal, në krahasim me të cilin të gjitha pjesët e tjera nuk janë veçse shtesa. Dhe, sipas neuroanatomistit Pol MekLin, kjo zonë e hershme e trurit është vënë në veprim nga një tjetër segment parahistorik, të cilin disa neuroanatomistë e quajnë sistemi R[22]. R-ja përdoret për termin "reptile" (*"zvarranik"*), pikërisht sepse e kemi të njëjtë këtë pjesë me zvarranikët. MekLini thotë se ky sistem R luan një rol të rëndësishëm "në sjelljen agresive, në karakterin territorial, në karakterin ritual dhe në vendosjen e hierarkive shoqërore"[23]. Ky është saktësisht modeli i sjelljes së zvarranikëve dhe i hibridëve njerëzoro-zvarranikë, siç është përshkruar në këtë libër. Astronomi Karl Sagan dinte shumë më tepër gjëra se ato që bëri publike dhe, në fakt, e kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij duke u angazhuar që t`i largonte njerëzit nga e vërteta. Por vetëdija e tij se si qëndronin në të vërtetë gjërat nganjëherë dilte në dritë, si atëhere kur tha se: "... nuk është aspak e leverdisshme të mos përfillësh elementin zvarranik të natyrës njerëzore, sidomos sjelljen tonë ritualiste e hierarkike. Ai model mund të na ndihmonte përkundrazi për të kuptuar më mirë natyrën e qenieve njerëzore"[24]. Në librin e tij, *The Dragons Of Eden*, ai shton se deri edhe ana negative e sjelljes njerëzore shprehet në terma që i referohet botës së zvarranikëve, siç dëshmon shprehja "të vrasësh me gjak të ftohtë". Astronomi Sagan (emri i lexuar sëprapthi i përgjigjet perëndisë zvarranike të Indisë Lindore, Nagas) e dinte natyrisht shumë mirë, por vendosi të mos e zbulonte publikisht atë për të cilën ishte në dijeni. Embrioni njerëzor, që shndërrohet në të sapolindurin, përshkon shumë faza, të cilat rilidhen me pjesën më të madhe të etapave evolutive, që kanë çuar në zhvillimin e formës aktuale fizike. Në këtë proces dalin në dritë lidhje me gjitarë që nuk u përkasin primatëve, me zvarranikë dhe peshq. Për shembull, ka një moment kur embrioni zhvillon ca verza. Embrioni njerëzor është shumë i ngjashëm me atë të zogjve, të deleve dhe të derrave, deri në javën e tetë, kur hyn në rrugën e vet evolutive. Nganjëherë udhëzimet gjenetike duket sikur e shpërfillin modelin e fundit dhe kështu lindin fëmijë të pajisur me bisht. Ky quhet shtojcë bishtore dhe formohet në zonën e poshtme lombare. Në pjesën më të madhe të rasteve ai hiqet menjëherë nga mjekët, por në disa vende të varfëra ku strukturat mjekësore nuk janë aq shumë të përhapura, ka njerëz

LIBRI

që jetojnë me bishtin për gjithë jetën[25]. Kafshët sekretojnë dhe lëshojnë një substancë e quajtur feromone, në mënyrë që të njihen nga pjesëtarët e të njëjtit lloj. Feromonet e pranishme tek gratë dhe tek iguanat rezultojnë të njëjta nga pikëpamja kimike[26].

Rishikoni një çast ato shifra në fillim të kapitullit të parë që përshkruajnë në mënyrë të hollësishme numrin e planeteve dhe të yjeve që ekzistojnë në atë pjesë të Universit, për të cilën kemi njohuri. Numri i formave të jetës vetëm në këtë galaksi shkon përtej përfytyrimit dhe kjo vetëm në nivelin tripërmasor të ekzistencës. Nëse, sikurse bëjmë, e quajmë të mundshme vetëm atë çka shikojmë vetëm në një planet të vogël, vetëm në një sistem të vogël diellor, aftësia jonë e perceptimit, e imagjinimit dhe e përfytyrimit do të jetë aq mikroskopike sa të na pengojë të kuptojmë se çfarë është duke ndodhur realisht në këtë botë. Sipas atij niveli mendimi, ideja se një racë zvarranike është duke kontrolluar planetin që prej një tjetre përmase, do të jetë aq e largët sa të duket e pakuptueshme. Kjo do të jetë mënyra me të cilën pjesa dërrmuese e njerëzve do t'i presë, fillimisht, informacionet që përmban ky libër, por midis studiuesve që janë të interesuar për të vërtetën dhe që nuk janë vetëm të shqetësuar për të mbrojtur një sistem vlerash apo të kërkojnë miratimin publik, është duke hapur gjithmonë e më shumë rrugë hipoteza e një "lidhjeje zvarranike".

Në vitin 1998, gjatë një udhëtimi të jashtëzakonshëm prej 15 ditësh që bëra në Shtetet e Bashkuara, takova më shumë se një duzinë njerëzish, të cilët nuk njiheshin me njëri-tjetrin, që më pohuan se kishin parë me sytë e tyre ca qenie njerëzore që shndërroheshin në zvarranikë dhe mandej rishndërroheshin në njerëz. Dy paraqitësa programesh televizivë kishin patur të njëjtën përvojë teksa intervistonin njëri njeri, që ishte në favor të centralizimit global të pushtetit, i njohur si Rendi i Ri i Botës. Pas transmetimit të drejtëpërdrejtë të atij emisioni, paraqitësi i rrëfeu kolegut të tij se kishte pasur një përvojë mahnitëse gjatë asaj interviste. Kishte parë fytyrën e atij njeriu të shndërrohej në atë të një qenieje formëhardhuce dhe mandej të kthehej prapë në njerëzore. Kolegu i tij mbeti i shtangur, pasi i kishte parë duart e të intervistuarit të merrnin karakteristika të një qenieje zvarranike. Ai paraqitës programi më tregoi edhe për një përvojë që kishte pasur një miku i tij polic gjatë një kontrolli rutinë brenda një godine zyrash në Aurora, pranë Denverit, në shtetin Kolorado. Polici kishte diskutuar me një nëpunëse të njërës prej firmave në katin përdhes të godinës masat e forta të sigurisë të asaj ndërtese. Ajo i kishte sugjeruar të kontrollonte katet e sipërme, nëse donte të vinte re se sa të shtrira ishin ato masa. I tregoi edhe një ashensor që ngjitej vetëm në disa kate të asaj

ndërtese dhe, duke biseduar, e vuri në dijeni edhe për diçka që kishte parë disa javë më parë. Ashensori ishte hapur dhe prej andej kishte dalë një figurë shumë e çuditshme. Ishte i bardhë si një çubardh (*njerëz që kanë një mungesë të plotë të pigmentit në flokë, qime, lëkurë*), por kishte një turi si ato të hardhucave dhe bebet e syve të tij ishin vertikalë si ato të zvarranikëve. Kjo figurë formëhardhuce kishte dalë nga ashensori dhe kishte hyrë në një makinë të ngjashme me ato të përfaqësisë që priste jashtë. Policit i bëri aq shumë përshtypje sa që e shfrytëzoi kohën që kishte në dispozicion për të kontrolluar firmat në katin e fundit të ndërtesës, duke përdorur ashensorin misterioz. Zbuloi se ishin të gjitha fasada të Central Intelligence Agency, CIA-s.

Pastaj janë përvojat e Keti O'Brianit, një skllave, mendja e së cilës është kontrolluar nga qeveria amerikane për më shumë se 25 vjet, sikurse tregon ajo vetë në librin e saj të mahnitshëm, *Trance Formation Of America*, shkruar me Mark Filipsin[27]. Si në moshën fëmijërore edhe në atë të rritur, ka qenë viktimë abuzimesh seksuale nga ana e një sërë personalitetesh të famshëm, emrat e të cilëve i zbulon në libër. Midis tyre figurojnë presidentët amerikanë Xherald Ford, Bill Klinton dhe, gjë mjaft tmerruese, Xhorxh Bush, njëri prej përfaqësuesve më të mëdhenj të Vëllazërisë, siç kanë zbuluar jo vetëm librat e mi. Ka qenë Bushi, pedofil përveç se *serial killer*, ai që ka përdhunuar rregullisht të bijën e Ketit, Keli O'Brianin, dhe që ka abuzuar me të, kur kjo po hidhte akoma hapat e parë, gjersa denoncimi i guximshëm i së ëmës i detyroi autoritetet ta largonin Kelin nga programi i kontrollit mendor i njohur si *Project Monarch*. Në librin *Trance Formation Of America* Keti shkruan se Xhorxh Bushi rrinte ulur përpara saj, në zyrën e tij në Uashington DC, kur hapi një libër në një faqe që përmbante ilustrimin e "alienëve formëhardhucash të ardhur nga hapësira e largët"[28]. Bushi pastaj i pohoi se edhe ai ishte një "alien" dhe përpara syve të Ketit u duk të transformohej "si një kameleon" në një zvarranik. Keti besoi se për të bërë këtë kishte aktivizuar një farë tipi olograme (*pllakë fotografike që mund të japë figura tripërmasore*) dhe, duke u njëjtësuar me mendjen e saj të asokohe, mund ta kuptoj arsyen pse e racionalizoi përvojën e saj në atë mënyrë. Kushdo do ta kishte bërë, pasi e vërteta është tepër e pagjasë për t'u kuptuar me intuitë, pa pasur të drejtën të hysh tek provat e shumëfishta. Nuk ka dyshim që programe të tilla të kontrollit mendor të frymëzohen tek ato të bazuara mbi alienët dhe krejt fusha e jashtëtokësorëve-UFO ka qenë manipuluar gjerësisht, edhe nëpërmjet filmave të Hollivudit, që kanë çuar në kushtëzimin e opinionit publik. Në librin e saj, Keti mbron idenë se prodhuesi i filmit *Luftra Yjore*, Xhorxh Lukasi, është një agjent operativ i NASA-s dhe i National Security Agency, njësia

"paraardhëse" e CIA-s[29]. Por, duke parë provat e dhëna nga aq shumë njerëz të tjerë, nuk besoj se ajo që Bushi tha dhe që Keti pa të ishte një program i thjeshtë kontrolli mendor. Besoj se ai ishte duke zbuluar Sekretin e Madh, domethënë se një racë zvarranike e ardhur nga një tjetër përmasë kontrollon planetin që prej mijëra vjetësh. Njoh njerëz të tjerë që e kanë parë Bushin të shndërrohet në një zvarranik.

Edhe presidenti i Meksikës në fuqi gjatë viteve Tetëdhjetë, Miguel De La Madridi, e ka përdorur Ketin gjatë gjendjes së saj të kontrollit mendor. Ajo bëri të ditur se ka dëgjuar prej tij Legjendën e Iguanës dhe kishte mësuar se ca jashtëtokësorë formëhardhucash kishin zbritur midis banorëve maja të Meksikës. I tregoi edhe se piramidat e majave, që dëshmojnë njohuri të përparuara astronomike, dhe flijimi i çupave të virgjëra, qenë frymëzuar prej alienëve formëhardhucash[30]. Ka shtuar se këto qenie zvarranike ishin kryqëzuar me majatë për të prodhuar një formë jete, në të cilën mund të mishëroheshin. Gjatë përshkrimit të tipareve të këtyre hibridëve njerëzoro-zvarranikë, De La Madridi tha se pamja e tyre, falë aftësisë kameleoneske, mund të luhatej ndërmjet asaj të një qenie njerëzore dhe asaj të një iguane – gjë të cilën e përkufizoi "një instrument i përkryer për t'u shndërruar në udhëheqësa botërorë". De La Madridi mbronte idenë se rridhte prej majave formëhardhucash, gjë që i jepte mundësinë të merrte me dëshirën e tij tiparet e një iguane. Në këtë pikë u shndërrua përpara syve të Ketit, siç kishte bërë Bushi, dhe tregoi sy e gjuhë si ato të një hardhuce[31]. Keti natyrisht mendoi se bëhej fjalë për një tjetër projektim olografik, por a ishte me të vërtetë i tillë? Apo, përkundrazi, De La Madridi ishte duke thënë një gjë shumë afër së vërtetës? Ky fakt i të qenurit i ngjashëm me një kameleon është thjesht një mënyrë tjetër për të shprehur aftësinë për të "ndryshuar formë", një temë që do ta gjeni në të gjithë botën e lashtë dhe, midis njerëzve me mendje të hapur, edhe në atë të ditëve të sotme. Të ndryshosh formë është fryt i aftësisë që të përdorësh mendjen tënde për të projektuar një tjetër shëmbëllim fizik përpara syve të njerëzve. Gjithçka është energji që dridhet me shpejtësi të ndryshme, për këtë arsye nëse e përdor mendjen tënde për të bërë që të ridridhet ajo energji me një rezonancë të ndryshme, mund të materializohesh në formën që dëshiron. Shumë dëshmitarë kanë përshkruar se si të ashtuquajturit "Njerëz me të Zeza" materializohen dhe çmaterializohen kur duan të kërcënojnë njerëz, që janë duke zbuluar informacione mbi jashtëtokësorët dhe mbi UFO-t. Mund ta bëjnë, sepse janë qenie ndërpërmasore në gjendje të marrin format më të larmishme. Kjo është arsyeja kryesore e merakut të tyre të madh për kryqëzimet ndërmjet familjeve të Elitës. Ato janë duke u

përpjekur të ruajnë një strukturë gjenetike, e cila t'i lejojë të lëvizin midis përmasave të ndryshme dhe të ndryshojnë formë midis pamjes njerëzore dhe asaj zvarranike. Por struktura e tyre gjenetike nuk mund të marrë forma, që mund të largohen tepër nga origjina e tyre zvarranike. Në laboratorin e kontrollit mendor të *Goddard Space Flight Center* të NASA-s, pranë Uashington DC, Keti deklaron se ka mësuar të tjera gjëra mbi alienët nga Bill e Bob Beneti, dy personalitete mjaft të njohura në rrethet politike amerikane dhe thellësisht të lidhur me organizatat e Vëllazërisë. Ja çfarë deklaron Keti se ka eksperimentuar, pasi i patën dhënë substanca që tjetërsojnë mendjen:

"Në errësirën përreth meje mundesha të dëgjoja Bill Benetin që thoshte: 'Ky është vëllai im, Bobi. Ai dhe unë punojmë si një i vetëm. Jemi alienë në këtë përmasë – dy qenie të ardhur nga një tjetër nivel'".

Përhapja e dritave me teknologji të lartë që vorbullonin përreth meje më bindën për faktin se isha duke marrë pjesë bashkë me ata në një shndërrim përmasor. Një fashë drite lazër goditi murin e zi përpara meje, që u duk sikur u shqye, duke dhënë një pamje panorame të një pritjeje kokteil në Shtëpinë e Bardhë – sikur të kisha ndryshuar përmasë dhe tani të gjendesha në atë vend. Duke mos njohur asnjeri, pyeta e shqetësuar: 'Kush janë këta njerëz?'.

'Nuk janë njerëz dhe kjo nuk është një anije kozmike', tha Beneti. Ndërsa fliste, skena olografike vazhdonte të ndryshonte lehtë, gjersa ata njerëz morën pamjen e alienëve formëhardhucash. 'Mirëseerdhët në nivelin e dytë të nëntokës. Bëhet fjalë për një reflektim të pastër si pasqyrë të të parit, për një përmasë aliene. Ne vijmë nga një nivel përtejpërmasor, që përshkon dhe përqafon të gjitha përmasat...'

'...Të kam çuar mespërmes përmasave të mia, për të vendosur një ndikim më të fortë mbi mendjen tënde, aq sa nuk lejon niveli tokësor', tha Bill Beneti. 'Duke qenë alien, unë thjesht i bëj të tuat mendimet e mia, duke i projektuar në mendjen tënde. Mendimet e mia janë mendimet e tua'"[32].

Ky mund të ishte, prapë edhe një herë, një dispozitiv i thjeshtë programimi, por, mbi bazën e të tjera provave të dhënë nga unë, nuk është ndoshta më e mundshme që, nën efektin e drogave dhe të teknikave të tjera, mendja e Ketit të jetë sintonizuar me përmasën në të cilën veprojnë zvarranikët? Zvarranikët vijnë nga niveli më i ulët i përmasës së katërt dhe përdorin thjesht ca trupa fizikë si instrumente për të manipuluar këtë

LIBRI 24

përmasë. Ja sepse, nëse ia arrijmë të sintonizojmë mendjen tonë me përmasën e tyre të vërtetë, do t'ia dalim t'i shohim siç janë realisht. Përshkrimet e Ketit përputhen me ato të disa të "rrëmbyerish", që kanë bërë të ditur se rrëmbyesit e tyre jashtëtokësorë fillimisht kishin një pamje krejt njerëzore, por pastaj ndryshonin, duke marrë pamjen e hardhucave humanoide. Këta persona rrëmbehen me të vërtetë nga alienët me anijet e tyre kozmike, apo u janë nënshtruar teknikave të kontrollit mendor si ato të eksperimentuara tek Keti O'Briani, që e vënë në lidhje me nivelin më të ulët të përmasës së katërt? Hanter S. Tompsoni në librin *Fear And Loathing In Las Vegas*[33], deklaron se ka parë zvarranikë teksa ishte nën efektin e drogave dhe, një person që kam njohur në Shtetet e Bashkuara (gjatë atyre 15 ditëve për të cilat po flisja më parë), më ka treguar një histori të ngjashme. Në vitet Gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar kishte marrë një sasi të madhe LSD-je (*substancë psikoaktive haluçinogjene*) dhe në atë gjendje mendore thellësisht të tjetërsuar pa disa persona nën formën e qenieve njerëzore dhe të tjerë nën formën e hardhucave dhe të tjerë zvarranikë me pamje njerëzore (humanoidë). Për një grimë besoi se kishte haluçinacione, por, duke marrë rregullisht doza të mëdha droge, filloi të kuptonte se ajo që shikonte, zakonisht duke nisur nga e treta e pesë ditëve të tij të "udhëtimit", nuk ishte një haluçinacion, por ishin perdet e dridhshme që ngriheshin, duke e lejuar të shikonte, përtej botës fizike, ato forca që kontrollojnë njerëzit. Në ato çaste disa njerëz shfaqeshin gjithmonë me tipare formëhardhucash, kurse të tjerë kishin gjithmonë një pamje njerëzore. Nuk i shkëmbenin kurrë rolet. Filloi edhe të vinte re se ata përreth tij, që kishin marrë tipare hardhucash, teksa ai ishte nën efektin e drogave, dukeshin gjithmonë se silleshin në të njëjtën mënyrë me të cilën silleshin nëpër filma, nëpër programe televizive etj. "Ne ishim të zakonshmit që qeshnim e që thoshnim 'ja ku po vijnë hardhucat', më rrëfeu. Besonte se ekzistonte, për ta thënë me fjalët e tij, një "fushë morfogjenetike", e cila ishte e lidhur me ADN-në e qenieve formëhardhucash dhe që përshtaste strukturën qelizore me modelin gjenetik të qenieve zvarranike. Sa më shumë gene të qenieve zvarranike të zotërojë një njeri, aq më e lehtë është që lidhja, apo më mirë kontrolli, të realizohet. Dhe, midis atyre, struktura qelizore e të cilëve imiton pikë për pikë më nga afër modelin e qenieve zvarranike, figurojnë familjet e Elitës që akoma sot komandojnë botën. Nuk është një rastësi që Diana, princesha e Uellsit, i quante zakonisht uindsorët "hardhuca" dhe "zvarranikë" dhe thoshte krejt seriozisht: "Nuk janë njerëzorë". Kjo më është bërë e ditur nga një person që për 9 vjet ka qenë e besuara e ngushtë e Dajanës, dhe mbi të cilën do të ndalem më poshtë.

Në fund të atyre 15 ditëve, në të cilat takova shumë njerëz që vazhdonin të më tregonin se kishin parë qenie njerëzore të shndërroheshin në zvarranikë, mora pjesë në një takim në Mineapolis me rastin e *Whole Life Expo* dhe teksa po e hidhja fjalën për këto përvoja, një zonjë e pajisur me fuqi medianike më tha se e dinte se për çfarë isha duke folur, pasi ishte në gjendje t'i shihte zvarranikët brenda dhe përreth trupave të atyre që zinin majat e botës politike dhe të elitës industriale, financiare e ushtarake. Kjo ishte e mundur pasi, si kushdo që do të kishte të drejtën të hynte në aftësinë e tij ndijore, ajo mund të shikonte përtej fizikut dhe në brendësi të nivelit të ulët të përmasës së katërt ku janë me banim këto qenie zvarranike. Çfarë i kishte thënë Miguel De La Madridi Keti O'Brianit? Pamja e hibridëve njerëzoro-zvarranikë mund të luhatej ndërmjet asaj të një qenieje njerëzore dhe asaj të një iguane, falë aftësisë kameleoneske, "një instrument i përkryer për t'u shndërruar në udhëheqës botërorë". Zonja e mësipërme më tha se pjesa më e madhe e atyre që mbanin pushtetin dukeshin zvarranikë, por kishte të tjerë që ishin ende qenie njerëzore dhe këta, shtoi, "liheshin në hije e kontrolloheshin" nga zvarranikët, edhe pse duke mos qenë zvarranikë të vërtetë. Mund të themi se ishin viktima të zotërimit. Ky është një dallim i rëndësishëm. Ekzistojnë "gjakpastrit", që janë qenie zvarranike, që fshehin prapa tipareve njerëzore natyrën e tyre të vërtetë, dhe "hibridët", rezultat i kryqëzimit ndërmjet njerëzve dhe zvarranikëve, që janë zotëruar nga qeniet zvarranike të përmasës së katërt. Një tip i tretë janë qeniet zvarranike, të cilët shfaqen drejtpërdrejt në këtë përmasë, por nuk mund ta ruajnë këtë formë për një kohë të pakufizuar. Disa prej "Njerëzve me të Zeza" përbëjnë një shembull të këtij grupit të fundit. Shumë prej të zotëruarve nuk kanë as dyshimin më të vogël për gjendjen e vet, por mendimet e tyre janë në realitet mendimet e qenieve zvarranike dhe veprimet e tyre përfundojnë për të nxitur Urdhërin e Ditës, pa e kuptuar aspak se si e përse përdoren. Familjet më në pah të Elitës, si Rotshildët dhe Uindsorët, janë zvarranikë gjakpastër, që e përdorin trupin njerëzor si një pardesy, me vetëdije të plotë për identitetin dhe për planet e tyre, të cilat përpiqen t'i realizojnë. Zonja e mësipërme zbuloi edhe se, në një gjendje të tjetërsuar të ndërgjegjes, i ishte dukur Hilari Klinton në formë zvarraniku, ndërsa i shoqi, Bill Klintoni, presidenti i SHBA-së, dukej i lënë në hije prej saj dhe i kontrolluar. Kjo është interesante, sepse edhe kërkimet e mia, midis shumë të tjerave, kanë zbuluar se Hilari Klinton zë në hierarkinë e të pushtetshmëve një nivel shumë më të lartë se Billi, që, duke qenë një hibrid i racës, është vetëm një zar, për ta përdorur e për ta hedhur kur është e nevojshme.

Nuk ndodh shpesh që njerëzve më të pushtetshëm t'u besohen ato që duken si detyrat më të rëndësishme. Shpesh, përkundrazi, nuk është kështu. Peshojnë më shumë ata që manovrojnë fijet e atij që *duket* se mban pushtetin.

Ka një tjetër dallim thelbësor midis gjakpastërve dhe hibridëve. Gjithçka është krijuar nga tingulli. Kur mendoni apo provoni një përshtypje, lëshoni një valë energjie, e cila modifikon energjinë përreth jush, duke e bërë të jehojë në po atë nivel dridhjeje. Ajo valë është në realitet një tingull, lëshimi i të cilit e kapërcen rrezen e dëgjimit njerëzor. Forma nuk mund të ekzistojë pa tingullin. Siç mund të shikoni në një seri fantastike televizive me titullin *Cymatics*[34], është tingulli ai që i jep formë materies. Në atë seri, rëra dhe grimca të tjera vendosen mbi një pllakë metalike, e cila i nënshtrohet mandej dridhjeve të shkaktuara nga tinguj të ndryshëm, që e rishpërndajnë rërën mbi pllakë sipas vizatimesh të çuditshme, shpesh gjeometrike. Vizatimi ndryshon pas çdo ndryshimi tingulli. Tingulli është edhe një instrument i jashtëzakonshëm terapeutik, sepse duke bërë të intonohet trupi dhe organet e tij me dridhjet e duhura, ato mund të shërohen. Sëmundja është një shqetësim, një disharmoni e gjendjes dridhëse natyrore të trupit. Dhe, meqë mendimet dhe emocionet tona nuk janë në realitet gjë tjetër veçse valë tingulli, çekuilibri i mendimeve dhe emocioneve tona shkakton një prishje të harmonisë dridhëse e, për pasojë, shfaqjen e sëmundjes. Ja përse stresi emocional shkakton sëmundjen. Kaq. Sidoqoftë, një tjetër shembull i pabesueshëm i gjithë kësaj në serinë *Cymatics* është të shohësh figura gjysmë-njerëzore, të cilat formohen nga grimcat, kur lëshohen tinguj të veçantë. Edhe trupat tanë janë rezultat i energjisë së tingullit që merr formë dhe, nëse mendja jonë do të ketë aq sa duhet forcë për të ndryshuar gamën e tingullit të trupit, ai do të marrë një tjetër formë, ose do të zhduket krejt nga kjo përmasë. Ky proces quhet ndryshim forme. Nuk është një mrekulli, është shkencë, janë ligjet natyrore të krijimit. Qeniet zvarranike gjakpastër të nivelit të ulët të përmasës së katërt mund të lirohen pra prej formës së tyre fizike "njerëzore" dhe të marrin përsëri nivelin zvarranik të ekzistencës. Ata, domethënë, ndryshojnë formë. Neve, që i përkasim kësaj përmase, na duken njerëz, por është fjala vetëm për një mbulojë dridhëse.

Pasi kisha përfunduar dorën e parë të këtij kapitulli, takova një tjetër grua, këtë herë në Angli, e martuar me një njeri që ishte i përfshirë në ritet satanike dhe në organizatat e Vëllazërisë. Ky ishte përgjegjës i rojeve i një cope trualli të quajtur Burnham Beeks, pranë kufirit midis Bukinghamshirit dhe Berkshirit, disa milje larg nga Slougu, në perëndim të Londrës. Bëhet fjalë për një vend të lashtë të përmendur tek *Libri i Madh i Kadastrës së Anglisë*

të epokës së Uilliam Pushtuesit (shekulli XI), dhe që është i famshëm për praktikat satanike. Kjo zonjë më tregoi se një ditë, në vitet e para shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, ndërsa po nxirrte shëtitje qenin në atë rezervat, kur kishte rënë muzgu i mbrëmjes, pa një figurë njeriu me një veshje të gjatë të kuqe. Kur ai ngriti kokën, ajo pa se kishte turirin e një hardhuce. Mendoi natyrisht se ishte marrosur, por nuk qe fjala për haluçinacione, siguron ajo. "Hardhuca" ishte tamam e vërtetë dhe kishte një trup, nuk ishte një vegim. Ajo është shumë e ndjeshme dhe më pas filloi ose të shihte njerëz që shndërroheshin në hardhuca përpara syve të saj, ose ta shihte veten të sunduar prej tyre, saktësisht në mënyrën e përshkruar nga zonja amerikane e pajisur me fuqi medianike. Në qoftë se shihni pjesën e ilustrimeve, do të gjeni paraqitjen e përshtypjeve të asaj çka ajo perceptoi falë shikimit të saj medianik, dhe shumë njerëz të tjerë kanë përshkruar përvoja saktësisht të njëjta me të sajat. Më 20 korrik 1988, një grup njerëzish në Bishopsvil, në Karolinën e Jugut, pohuan se kishin mbetur të tronditur përballë "një njeriu-hardhucë të gjatë më shumë se dy metra, pa flokë, pa vetulla e pa buzë, dhe me nga tre gishta në çdo dorë e me sy të mëdhenj në formë bajameje të një ngjyre të kuqe flake". Pati pesë përshquarje të këtij "njeriu-hardhucë" dhe kjo histori u botua tek *Los Angeles Times* dhe tek *Herald Examiner*[35].

Nëse ndjek rrjedhën e jetës dhe i vë veshin intuitës tënde, do të mësosh atë që duhet të mësosh, falë sinkronisë së pabesueshme që të rrethon dhe çdo ditë të udhëheq përmes perdeve tymuese e sallave me pasqyra. Një ditë të shkurtit të vitit 1998 në Johanesburg, në Afrikën e Jugut, kalova gati pesë orë duke folur me një shaman (*në disa besime fetare aziatike e afrikane janë individë të pajisur me aftësi të veçanta taumaturgjike e hyjnore që i ushtrojnë në gjendje ekstaze për shërime sëmundjesh etj.*) zulu me emrin Kredo Mutva. Fjala "zulu" do të thotë "popull i yjeve", pasi ata besojnë se janë një racë mbretërore, të ardhur nga një tjetër planet. Folëm për manipulimin global dhe për bindjen e tij se një racë jashtëtokësorësh vepron nën hijen e Vëllazërisë globale të monarkëve, politikanëve, bankierëve dhe pronarëve të medias. Më pas u ktheva në hotelin ku kisha zënë vend dhe shënova në kompiuterin portativ gjërat kryesore që kishte thënë ai, para se të shkoja në sallën e katit më poshtë, ku kalova pjesën tjetër të mbrëmjes. Kur zbrita aty dhe u ula, sapo ishte duke filluar një film me titullin *The Arrival*[36], që fliste për një racë jashtëtokësorësh e ngjashme me zvarranikët, e cila kishte pushtuar planetin duke u futur tinëz brenda trupit njerëzor dhe duke marrë tipare njerëzore. Dikush po përpiqej të më thoshte diçka! Dhe ajo diçka është e vërteta. Një tjetër film më pak i njohur që pashë rreth asaj periudhe titullohej *They Live*[37] dhe edhe ky fliste

për një racë jashtëtokësorësh, e cila bëhej zot i botës duke vepruar përmes trupave të njerëzve. Edhe filmi *Alien Resurrection*[38] rinxori në skenë temën e alienëve, duke paraqitur përsëri ndërlikimin, sipas të cilit, alienët, do të jenë bërë zotër të trupit të qenieve njerëzore. Por filmi që i është afruar më shumë së vërtetës është seriali televiziv amerikan i viteve Tetëdhjetë të shekullit të kaluar i titulluar *V*[39]. Ky serial flet për një racë jashtëtokësore zvarranikësh që pushtojnë botën, duke marrë tipare njerëzore. Në film zvarranikët janë të mbuluar nga një farë membrane qumështore, që nuk përkon saktësisht me të vërtetën, por idea në thelb është qëlluar në shenjë dhe filmi jep një mostër të asaj që do të ndodhë, nëse nuk i hapim shpejt sytë! Ju këshilloj nxehtësisht ta shikoni këtë film, për të parë më mirë atë që jam duke paraqitur në këtë libër.

Njëra prej studiueseve më autoritare të këtij fenomeni është amerikania Aleks Kristoferi, autore e librave *Pandora's Box, Volumes I* dhe *II*[40], që ndalen, pjesërisht, mbi praninë e qenieve zvarranike në këtë planet. Aleksi i ka parë qeniet zvarranike dhe qeniet që i quan të "Hirtët me sy të mëdhenj". Një natë, në Panama Siti, në Florida, tregon se është zgjuar në orën dy e gjysmë të mëngjesit nga fqinjët e saj të zhurmshëm, një grua dhe i shoqi, pilot i një linje ajrore tregtare. Nxitoi në shtëpinë e tyre dhe e gjeti gruan që ishte gati duke humbur ndjenjat dhe s'arrinte dot të qëndronte në këmbë, ndërsa bebet e syrit i rrotulloheshin në orbita. Aleksi ka rrëfyer se kishte perceptuar në atë dhomë një energji të çuditshme, që dukej sikur përpiqej t'i depërtonte në kokë. Ndjeu ca rrezatime tamam të vërteta dhe ditën e mëpasshme të gjitha bimët në atë dhomë ishin tharë. I kapi ata të dy dhe i tërhoqi zvarrë jashtë, ku biseduan një copë herë. Ata pohuan se gjithçka kishte nisur teksa ishin duke bërë dashuri, dhe kjo është shumë domethënëse, sepse qeniet zvarranike ushqehen me energji emocionale e seksuale njerëzore, dhe është kjo arsyeja pse seksi është aq i rëndësishëm tek ritet satanike të praktikuara për "demonët" - apo për këtë grup qeniesh zvarranike. Ai çift tha se kishte parë një fashë drite dhe pastaj e panë veten të vërvitur jashtë shtratit. Burri kishte akoma në ije shenjën e lënë nga gishta që duhej të kishin qenë të gjatë rreth njëzet e pesë centimetra dhe të pajisur me kthetra, që u ngulën në lëkurën e tij. Ditën e mëpasshme ajo shenjë ishte aq e dhembshme, sa nuk mund ta prekte dot me dorë dhe Aleks Kristoferi e përjetësoi atë në një film me metrazh të shkurtër. Kur çifti u qetësua dhe Aleksi u kthye për të fjetur në shtëpinë e saj, ajo vetë pati një takim nga afër me një qenie zvarranike:

"U zgjova dhe pashë atë 'qenie' sipër shtratit tim. I kishte sytë tërësisht të qarkuar me ngjyrë të verdhë, me bebëzat prej gjarpëri dhe veshët me majë dhe

krejt turirin të përshkuar nga një ngërdheshje. Kishte të veshur një tutë të argjendtë dhe kjo më frikësoi për vdekje. Mbulova kokën me mbulesat dhe zura të bërtisja... imagjinoni një çikë, përpara meje është kjo qenie me një ngërdheshje përqeshëse dhe me sy të çuditshëm të përflakur... është me të vërtetë tepër. Kam parë krijesa të tilla në më shumë se një rast... kishte një hundë si grep dhe një pamje shumë njerëzore, përveç syve, dhe një lëkurë si të përhirtë..."

"Më vonë, më 1991, isha duke punuar brenda një pallati të një qyteti të madh, kur, rreth orës 18.00, vendosa të shkëputesha për një çast nga puna, por pak më pas, pavarësisht që mendoja se kisha bërë një pushim të shkurtër, vura re papritmas se ora ishte 22.30. Atëhere u kujtova se isha çuar në bordin e një anijeje(kozmike), *përtej katër kateve të ndërtesës dhe të çatisë. Atje, në anijen kozmike, takova gjermanë e amerikanë që punonin së bashku dhe, edhe alienë të hirtë, e pastaj të gjithë u çuam brenda një tjetër ndërtese, ku pashë përsëri ca qenie zvarranike... ata që i quaj "Bebi Goxilla", me dhëmbë të shkurtër e sy të verdhë në formë bajameje... Nuk arrij t`i largoj nga mendja qeniet që kanë pamje zvarranikësh, ose "grabitqarët e shpejtë". Janë qeniet më mizore që ekzistojnë dhe deri edhe era e tyre është e neveritshme"*[41].

Në "anijen kozmike" Aleksi kujton të ketë parë gjermanë e amerikanë që mbanin një stemë, një trekëndësh blu me një dragua me sy të kuq të mbyllur në një rreth. Një person i takuar nga ajo i tregoi, më pas, se e kishte parë të njëjtën stemë në Fort Ualden, në Shtetet e Bashkuara. Një stemë, që paraqiste një gjarpër me krahë, mund të shihej edhe në mëngën e ushtarit izraelit, që ngushëllonte të bijën e kryeministrit të vrarë, Jitzhak Rabinit, gjatë varrimit të këtij të fundit, në vitin 1995 (shih revistën *Newsweek* të 20 nëntorit 1995). Një vend, të cilit Alex Kristoferi i kushton një vëmendje të veçantë, është aeroporti i ri i Denverit, i cili mendohet se shërben si mbulesë për një bazë nëntokësore zvarraniko-njerëzore. Bëhet fjalë sigurisht për një vend të çuditshëm. Hera e parë që kam folur për këtë konspiracion ka ndodhur në Denver në gusht të vitit 1996, pasi kisha zbritur pikërisht në aeroportin e Denverit, krejtësisht i paditur për funksionin e tij të vërtetë. E, megjithatë, sapo aeroplani preku tokë, ndjeva një energji shumë të çuditshme, misterioze e të pakëndshme.

Aeroporti qe ndërtuar, me shpenzime shumë të mëdha parash, në fushë të hapur, shumë larg nga Denveri dhe është plot me simbole masonike. Ka edhe gargola, figurat e zvarranikëve me krahë, që gjenden nëpër vilat e aristokracisë zvarranike në Britaninë e Madhe dhe nëpër kishat e nëpër

LIBRI 24

katedralet e Evropës të ndërtuara nga rrjeti i Vëllazërisë. Ka gargola edhe mbi një ndërtesë të Sheshit Dejli, ku u vra presidenti Kenedi, dhe ja ku tani ato shfaqen në një aeroport modern, të ndërtuar sipër një baze të supozuar zvarranike nëntokësore.

Kjo shpjegohet vetëm duke mbajtur parasysh se ato janë një simbol i racës së zvarranikëve. Mbi gurin e kurorëzimit, apo mbi gurin e shugurimit të aeroportit, paraqitet busulla, simboli klasik i masonëve, dhe ajo gjendet në një zonë të terminalit e quajtur Salla e Madhe, një tjetër shprehje masonike. Mbi një faqe muri spikat një pikturë murale groteske plot me simbole negative, ndërmjet të cilave tri arkivole, që mbajnë tri kufoma grash: një vajzë hebreje, një indiane e Amerikës dhe një grua e zezë. Një vajzë tjetër mban një pllakëz majá që flet për shkatërrim e qytetërim. Një personazh gjigant, i përshkruar nga Aleks Kristoferi si një "Darth Vader i gjelbër", ngrihet përsipër një qyteti të shkatërruar, me shpatën të nxjerrë nga milli, ndërsa gratë ecin gjatë rrugës duke mbajtur në krahë fëmijë të vdekur. Të gjithë fëmijët e botës paraqiten në aktin e grabitjes së armëve në çdo vend, për t`ia dorëzuar një djali gjerman me grushtin prej hekuri dhe një kudhër në dorë. Duket se Denveri mbulon rolin e shtabit të përgjithshëm të rajonit perëndimor të Shteteve të Bashkuara në kuadrin e shtetit global fashist të quajtur Rendi i Ri i Botës, që do të realizohet pas vitit 2000. Thuhet se Atlanta është qendra e rajonit lindor dhe tani më kujtohet të kem menduar, disa vite më parë, se aeroportet e Denverit dhe të Atlantës ishin arkitektonikisht mjaft të ngjashëm, e tani e di edhe përse.

Koloradoja është njëra prej qendrave më të rëndësishme të Rendit të Ri të Botës dhe mbretëresha e Anglisë, nën emër të rremë, ka blerë aty shumë prona toke. Siç do ta shihni më poshtë, familja mbretërore britanike është thellësisht e përfshirë në këtë histori, dhe është e lidhur me të gjithë këtë edhe vrasja e Dajanës, princeshës së Uellsit. Njëri prej burimeve më të mëdha të Aleks Kristoferit ka qenë një njeri i quajtur Fil Shnajder, i biri i një komandanti nëndetëseje gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilit i qe porositur ndërtimi i një sërë bazash nëntokësore në Shtetet e Bashkuara. Pashë regjistrimin e disa konferencave të tij, në të cilat filloi të fliste publikisht për baza, për qytete e për galeri nëntokësore të përhapura nëpër të gjithë Shtetet e Bashkuara. Më pas shkoi drejt një vdekjeje shumë misterioze, e maskuar në mënyrë të tillë sa të dukej si një "vetëvrasje". Shnajderi tha se aeroporti i Denverit ishte i lidhur me një bazë nëntokësore, që ndodhej të paktën në tetë nivele thellësie. Shtoi se ajo përfshinte një qytet nëntokësor, sipërfaqja e të cilit arrinte 4,5 miljet, dhe një bazë të madhe. Sipas dëshmitarësh të tjerë

okularë, aty në bazën nëntokësore të aeroportit të Denverit do të kishte një numër të madh skllevërish njerëzorë, shumë prej të cilëve fëmijë, që punojnë nën kontrollin e qenieve zvarranike. Dy prej këtyre bazave, që Fil Shnajderi deklaron se ka kontribuar për t`i ndërtuar, janë Zona e turpshme 51 në Nevada dhe baza e Dulces në Nju Meksiko, e lidhur nëpërmjet një sërë galerish me Laboratorin Nacional të Los Alamosit. Kam qenë në Los Alamos dhe atmosfera atje është pak të thuash e llahtarshme. Pasi pata marrë pjesë në programin radiofonik amerikan *Sightings* mbi temën e përfshirjes së racës së zvarranikëve në çështjet njerëzore, m`u dërgua një raport i bërë nga një ushtar i thjeshtë i ushtrisë me vendqëndrim në Dulçe. Ai e kishte kuptuar me intuitë se kishte diçka "shumë të çuditshme" në atë vend, por nuk dinte të shpjegonte se çfarë.

Ja çfarë kujtonte:

"... Isha duke kryer një punë rutinë, kur një tjetër prej djemve të shërbimit, një mekanik, arriti me një punë të ngutshme, që kërkonte një saldim të shpejtë. E kishte shtampën dhe ma tregoi saktësisht atë që donte. Ndërsa ishim të përkulur mbi bankën e punës përpara saldatriçes, më erdhi ta vështroja në fytyrë. U duk papritmas i mbuluar me një cipë, ose me një perde tymi gjysmë e tejdukshme. Tiparet e tij u zhdukën dhe në vend të tyre u shfaq një "qenie" me sytë të dalë, pa flokë dhe me luspa në vend të lëkurës".

Më pas pa një roje në hyrjen kryesore të bazës së Dulçes të pësonte të njëjtin transformim. Dëshmitarë të tjerë kanë deklaruar se kanë parë kameleonë të tjerë të racës së zvarranikëve të punonin në spitalin ushtarak Medigan, pranë Fort Levisit, në jug të Siatëllit, në shtetin e Uashingtonit. Kam mbajtur një konferencë edhe në atë vend dhe më është dukur prapë edhe një herë jashtëzakonisht i çuditshëm, edhe sepse afër Fort Levisit është një qendër e shoqërisë së fshehtë "New Age". Xhason Bishopi III ka kryer studime të thelluara mbi aktivitetet që zhvillohen në Dulçe dhe ka vërtetuar përfshirjen e një trusti, që përfshin organizata si Rand Corporation, General Electric, AT & T, Hughes Aicraft, Northrop Corporation, Sandia Corporation, Stanford Research Institute, Walsh Construction, Bechtel Corporation, Scuola Mines në Kolorado e kështu me radhë. Bechtel-i (Beck-tul) përfaqëson një *trait d`union* të rëndësishëm midis rrjetit të racës së zvarranikëve dhe të Vëllazërisë. Në Dulçe ekzistojnë të paktën shtatë nivele nëntokësore dhe, sipas gjasës, edhe më shumë, dhe Bishopi ka mbledhur dëshmitë e atyre që punonin atje e ka përshkruar atë që ka parë. Raportet e tyre përkojnë me ato

të anunakëve të riprodhuara nga tekstet sumere, atje ku thuhet se ata kryqëzojnë racat për të prodhuar tipe të ndryshme hibridësh të frikshëm. Ja çfarë pohojnë këta persona në lidhje me Dulçen:

"Niveli numër gjashtë quhet midis nesh 'salla e ankthit' dhe strehon laboratorët gjenetikë. Disa njerëz që punonin atje kanë qenë të pranishëm në eksperimente të çuditshme, që i tregojnë kështu: «Kam parë 'qenie njerëzore' me më shumë se dy këmbë që dukeshin gjysmë njerëz e gjysmë polipë. Edhe qenie njerëzore zvarranike e krijesa leshatore, që i kanë duart si ato të njerëzve dhe qajnë si fëmijë dhe përpiqen të shqiptojnë fjalë njerëzore... përveç një larmie shumë të madhe me qenie njerëzore formëhardhucash të mbyllur në kafazë». Ka peshq, foka, zogj e minj, që nuk duken aspak se u përkasin atyre llojeve. Ka mjaft kafazë (dhe vaska) me humanoidë me flatra, krijesa groteske të ngjashme me lakuriqët e natës... por me një gjatësi që shkon nga një metër në më shumë se dy metra. Qenie të ngjashme me gargolat dhe zvarranikët, që të kujtojnë dragonjtë".

"Niveli numër shtatë është edhe më keq: mban radhë e radhë të tëra me qenie njerëzore dhe hibridë njerëzorë në qeli frigorifer. Edhe këtu ka vaska plot me embrionë humanoidë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. (Një person që punon aty tha:) *«Shpesh hasja qenie njerëzore në kafaz, zakonisht të shushatur, ose të droguar, por që nganjëherë bërtisnin e kërkonin ndihmë. Na thuhej se bëhej fjalë për të çmendur të pashërueshëm, që u nënshtroheshin testeve farmakologjike me rrezik të lartë në mjedisin e kërkimit mbi sëmundjet mendore. Na ndalonin edhe nga të folurit me ta. Në fillim i besuam kësaj historie. Por më në fund, në vitin 1978, një grup i vogël punëtorësh zbuloi të vërtetën»"*[42].

Duket se zbulimi ka çuar tek "luftrat e Dulçes", një konflikt midis njerëzve dhe qenieve jashtëtokësore, që ndodhi në vitin 1979 dhe në të cilin mbetën të vrarë shumë shkencëtarë e ushtarakë. Fil Shnajderi deklaroi se kishte marrë pjesë në një përleshje me armë zjarri me alienët, gjatë së cilës qe goditur me një armë me rreze lazer, që i shqeu kraharorin. Në fakt kishte një shenjë të çuditshme plage në kraharor, që e tregoi publikisht. Pas këtij konflikti, baza mbyllet për pak kohë, por pastaj u hap përsëri. Një tjetër bazë nëntokësore e qenieve zvarranike gjendet nën Kanionin e Bojntonit, në Sedona të Arizonës. Mendohet se qendra e bazës ndodhet në pozicion simetrik me Kanionin e Fshehtë dhe emri nuk mund të ishte më i qëlluar në shenjë se kaq! Baza e qytete të ngjashme nëntokësore ekzistojnë në të gjithë botën dhe janë të lidhura me galeri, në të cilat udhëtojnë anije të vogla nëntokësore tmerrësisht

të shpejta. Galeritë ndërtohen shumë shpejt falë shpikjeve të reja teknologjike si *Nëntokësorja*, një makinë me energji bërthamore, që shkrin shkëmbin dhe gërmon galeritë. Ajo qe vënë në punë në Los Alamos. Është domethënëse që testet bërthamore nëntokësore janë realizuar në Nevada dhe në Nju Meksiko, vendi ku ndodhen shumë struktura nëntokësore, që kanë pasur lidhje me zvarranikët. Nuk është për t`u përjashtuar, në fakt, që këto "teste" të jenë realizuar aty për të hapur katakombe të mëdha nëntokësore. Një zë që më ka mbërritur nga shumë anë është ai, sipas të cilit qeniet zvarranike ushqehen me energji bërthamore.

Pamja e tyre

Mbi bazën e studimeve të konsultuara prej meje, të njerëzve të takuar prej meje dhe të deklarimeve të atyre që këmbëngulin se i kanë parë këta humanoidë zvarranikë, apo këto qenie zvarranke, kam arritur në përfundimin që vijon: ka shumë nënlloje dhe hibridë midis racës së zvarranikëve. Elita e tyre është e njohur për ufologët si Drako. Pjesëtarët e saj janë ca "djelmosha" në çdo kuptim të fjalës, shtatlartë zakonisht ndërmjet rreth dy dhe tre metrave e gjysmë. Kanë krahë të përbërë nga membrana lëkure të mbajtura nga kocka të gjata[43]. Krahët mund të palosen pas trupit dhe prej këtej e ka prejardhjen termi "gjarpër me krahë". Rrjedh prej tyre edhe termi "engjëj të rënë" dhe gargolat me krahë janë pikërisht një simbol i Drakove. Pelerina që vesh konti Drakula simbolizon këta krahë dhe, në fakt, në historinë e Bram Stokerit na thuhet se Drakula ishte një egjëll i rënë nga qielli. Drakot me krahë janë të njuhur edhe si raca e Dragonjve dhe disa hyjni të lashta qenë përshkruar dhe paraqitur si njerëz-zogj. Prej këtej mund të kenë pasur prejardhje edhe disa simbole të Vëllazërisë, si feniksi e shqiponja, dhe të tjerë më të mistershëm. Edhe Satanaja tek Bibla është përshkruar si një qenie zvarranike.

Duket se disa prej pjesëtarëve më në pah të Drakove janë të bardhë ose çubardhë dhe nuk kanë ngjyrën e zakonshme të lëkurës të gjelbër apo gështenjë dhe kjo të sjell në mendje përshkrimin e humanoidit të çuditshëm çubardh formëhardhuce të pallatit të Aurorës, pranë Denverit. Drakot janë "familja mbretërore" e racës së zvarranikëve dhe kasta e tyre më e lartë përfaqësohet nga çubardhët, që duket se kanë brirë konikë të vendosur midis ballit dhe çaçkës së kokës. Kjo veçori më bëri përshtypje menjëherë, pasi "perënditë" e lashta dhe sovranët paraqiteshin me një kokore të pajisur me brirë, pa dyshim një simbol i këtyre qenieve zvarranike "mbretërore". Të tjera lloje, si klasa e ushtarëve dhe e shkencëtarëve, janë të njohur me emrin Reptoidë. Nuk janë të pajisur me krahë, por kanë të gjithë gjak të ftohtë[44].

Luspat e tyre janë shumë më të mëdha mbi shpinë dhe kanë tre gishta dhe gishtin e madh pëkundrejt të tjerëve. Për çdo këmbë kanë tre gishta dhe një të katërt në lartësinë e kyçit dhe kthetrat e tyre janë të shkurtra e me majë. Kanë sy të mëdhenj e inkandeshentë si ata të maceve dhe një gojë të mprehtë të ngjashme me një të çarë. Disa përshkruhen me sy të zinj, ndërsa të tjerët i kanë të bardhë, me bebëzat vertikale në ngjyrë të kuqe të ndezur. Prapë edhe një herë ky përshkrim përkon me atë të qenies zvarranike të parë në pallatin e Aurorës. Raca e zvarranikëve janë të gjatë nga një metër e gjysmë deri në tre metra e gjysmë dhe janë ata "gjigantët" e përshkruar në mënyrë aq të përhapur në tekstet dhe në legjendat e lashtësisë. Disa janë të pajisur me bisht, të tjerë jo. Mendohet se njëri prej aq shumë planeteve, mbi të cilin shumë kohë më parë kanë lënë gjurmë, ka qenë Marsi dhe kjo mund të na bëjë të hamendësojmë ekzistencën e hibridëve zvarranikë në Mars, më parë akoma se në planetin tonë. Edhe Zekaria Sitkini mbron idenë se anunakët u vendosën në Mars, para se të ankoroheshin në Tokë. Kjo duket krejt e besueshme dhe mund të ketë edhe të ngjarë që marsianët e bardhë të përshkruar nga Brian Desborougu dhe anunakët të kenë pasur lidhje të hershme gjenetike. Një priftëreshë e shquar e Vëllazërisë, tashmë e liruar nga detyrimi, ose që të paktën kështu ishte në kohën kur fola me të, mbron idenë se zvarranikët anunakë shumë kohë më parë pushtuan Marsin dhe se raca e bardhë e marsianëve më pas e braktisi atë planet, për t`u shpërngulur në Tokë. Sipas versionit të saj, anunakët e Marsit i ndoqën pas, edhe pse unë jam i bindur që disa prej tyre të jetojnë gjithmonë atje, në baza nëntokësore. Çdo herë që ndonjëra prej sondave të NASA-s paraqitet në Mars, rrezikon t`i zbulojë publikut diçka që nuk duhet t`i zbulohet, lidhja ndërpritet në mënyrë misterioze, ose sonda zhduket krejt. Por është jashtë dyshimit se raca e bardhë, kushdo qoftë origjina e saj, ka qenë instrumenti kryesor në rrethin e programit të hibridizimit të realizuar nga anunakët për pushtimin e Planetit Tokë. Studiuesit mbrojnë idenë se raca e zvarranikëve kontrollon të ashtuquajturit të Hirtët, jashtëtokësorët tipikë të kohëve moderne, me sytë e tyre të mëdhenj. Të Hirtët figurojnë në pjesën më të madhe të dëshmive të rrëmbimeve. Xhason Bishopi III në shkrimet e tij mbi këtë argument mbron idenë se hierarkia e klasave udhëheqëse është si më poshtë: Drakot me krahë; Drakot pa krahë; të Hirtët; Njerëzorët. Duket se ekziston edhe një "marrëveshje" zvarranike me disa grupe të tjera jashtëtokësore.

Është çuar përpara hipoteza se flijimet njerëzore kundrejt "perëndive" të botës së lashtë, sidomos ato të fëmijëve, u janë drejtuar qenieve zvarranike, që i kërkonin këto rite (një karakteristikë e mendjes zvarranike është prirja

ndaj ritualizmit). Jam i sigurtë që kjo është e vërtetë dhe do të marrë një rëndësi themelore në pjesën e fundit të këtij libri. Në çastin e vdekjes flijuese, adrenalina qarkullon përsëri nëpër të gjithë trupin, duke u grumbulluar në bazën e trurit dhe, me sa duket, tek fëmijët kjo shkarkesë është më e fortë se në të gjitha qeniet e tjera[45]. Thuhet se kjo është pikërisht ajo që dëshirojnë raca e zvarranikëve dhe hibridët e tyre dhe ata ushqehen sigurisht me gjak e me mish njerëzor. Në dukje këto flijime u kushtoheshin perëndive, racës së zvarranikëve anunakë, dhe vazhdojnë akoma sot. Aspekti që del në pah nga të gjitha studimet mbi racën e zvarranikëve është mungesa e tyre e ndjenjave dhe emocioneve dhe, në nivelin e përmasës së katërt, fakti që ushqehen me energji të emocioneve njerëzore me dridhje të ulët si frika, ndjenja e fajit dhe agresiviteti. Kur ne provojmë emocione të tilla, energjia e tyre nuk është e dukshme në këtë botë, sepse është e sintonizuar me frekuencën e nivelit më të ulët të përmasës së katërt, ku thithet nga qeniet zvarranike. Sa më shumë emocione të këtij tipi të nxiten, aq më e madhe do të jetë energjia, që mund ta kenë në dispozicion qeniet e zvarranikëve. Për këtë arsye nxitemi për të zhvilluar luftra, genocide njerëzore, masakrime të kafshëve e perversitete seksuale, të cilat krijojnë një energji me ngarkesë të lartë negative, dhe rite të magjisë së zezë e flijime, që janë aq shumë të përhapura, sa ta lënë pa mend atë që nuk ka përvojë në këtë fushë.

Bijtë e perëndive

Duket se programi i hibridizimit i racës së zvarranikëve ka prodhuar një hibrid midis anunakëve dhe qenieve njerëzore (Adami?) rreth 200.000-300.000 vjet më parë. Jam i sigurtë se edhe raca të tjera jashtëtokësore janë bashkuar me qeniet njerëzore, për të prodhuar llojin e lavdishëm të popujve të Tokës, por këtu po ndalem tek grupi i racës së zvarranikëve, për shkak të dëshirës së tyre për të kontrolluar dhe manipuluar çështjet njerëzore. Natyrisht, sa më shumë të shkoni prapa, aq më shumë historia bëhet e errët, por ka prova mjaft të qarta e të besueshme në lidhje me faktet kryesore. Sa më shumë i analizoj, aq më shumë më bëhet e qartë se atë që raca e zvarranikëve bënë në Mars, e kanë bërë edhe këtu. Ata kanë depërtuar tinëz midis popullsisë vendase nëpërmjet kryqëzimeve dhe kanë marrë kontrollin e planetit. Sipas meje, ekzistonin që më parë racat ariano-zvarranike midis marsianëve, kur këta arritën në Tokë. Një nga ngulimet kryesore të anunakëve dhe të marsianëve, apo arianëve, sidomos gjatë dhe pas përmbytjes së provokuar nga Afërdita përreth vitit 4800 para Krishtit, ndodhej midis maleve të Turqisë, të Iranit e të Kurdistanit, dhe që prej aty ata dolën përsri në

LIBRI 24

sipërfaqe, bashkë me hibridët e tyre, kur ujërat u tërhoqën. Qenë ata që i krijuan qytetërimet teknologjikisht të përparuara që në zanafillë në ultësirat e Sumerisë, të Egjiptit, të Babilonisë dhe të Luginës së Indos. Në mënyrë të veçantë, malet e Kaukazit duket se kanë qenë një qendër e racës zvarranike të anunakëve dhe kjo zonë do të përmendet shumë herë në rindërtimin tim të historisë. Mendoj se në këtë zonë ka qenë zbatuar një program i përhapur hibridizimi, sipas gjasës në nivel nëntokësor, që prodhoi një numër të madh kryqëzimesh njerëzoro-zvarranike. Një sektor kërkimi shumë i rëndësishëm në këtë zonë është ai që lidhet me numrin e njerëzve me elementin Rh, apo Rhesus negativ. Shpesh fëmijët me elementin Rhesus negativ bëhen ngjyrë blu menjëherë pas lindjes. Është kjo origjina e shprehjes "me gjak blu", për të treguar racat fisnike. Mendohet se familjet me "gjak blu" mund të rrjedhin nga Marsi dhe nga vendi, kudo qoftë ai, nga i cili patën prejardhje banorët e Marsit. Elementi Rh negativ është shumë më i përhapur ndërmjet të bardhëve se sa ndërmjet zezakëve apo aziatikëve.

Genet e racës mbretërore çubardhë të Drakove duket se kanë qenë manipuluar, për të krijuar hibridë njerëzoro-zvarranikë "mbretërorë", të cilët, që nga kohët e lashta, përdoren për të komanduar botën. Atyre, të njohur prej njerëzve të lashtë si gjysmëperëndi, u besohej detyra e ndërmjetësve: ata kontrollonin popullsinë dhe komandonin botën sipas planeve të padronëve të tyre zvarranikë. Rezulton qartë se, ndërsa anunakët u kryqëzuan me shumë raca tokësore, raca e bardhë ka qenë mjeti i tyre kryesor për të çuar deri në fund planin e pushtimit të planetit dhe "familja mbretërore" udhëheqëse e Drakove është e përbërë nga çubardhë. Nëse shqyrtojmë shkrimet e lashta, do të na bëjë përshtypje fakti se shumë prej krijesave të tyre hibride kishin flokë të verdhë e sy të kaltër. Një ndryshim i madh duket se ka ndodhur menjëherë pas përmbytjeve të shkaktuara nga Afërdita, pasi qytetërimi Ubaid (5000-4000 para Krishtit), që lulëzoi aty ku është Iraku aktual, adhuronte perëndi të përshkruara si humanoidë formëhardhucash, ndërsa hyjnitë e sumerëve (4000-5000 para Krishtit), që jetonin në të njëjtën zonë, paraqesin karakteristika krejtësisht njerëzore. Sipas meje, ky ndryshim dhe programi i hibridizimit i vënë në zbatim në zonën e Kaukazi janë ngushtësisht të lidhura. Elita, rezultat i hibridizimit midis anunakëve dhe njerëzve, përshkruhet nga sumerët dhe ka shumë shkrime të tjera të kryqëzimit midis jashtëtokësorëve dhe qenieve njerëzore, apo ndërmjet "perëndive" e "banorëve të qiellit" dhe racës njerëzore. Për këtë flitet, siç dihet, edhe tek *Gjeneza*:

"Kur njerëzit filluan të shumoheshin në tokë dhe lindën bijat e tyre, bijtë e Perëndisë panë se bijat e njerëzve ishin të bukura, dhe morën për gra sa deshën prej tyre... Ishin në tokë nefilimët në ato kohëra – dhe edhe më pas – kur bijtë e Perëndisë bashkoheshin me bijat e njerëzve dhe këto lindnin bijtë e tyre perëndi. Janë këta heronjtë e lashtësisë, njerëz të famshëm". Gjeneza, 6, 1-4.

Sipas përkthimit të Zekaria Sitkinit, fjala "nefilimët" u referohet "atyre që zbritën", ndërsa për të tjerët do të thoshte "të rënët" ose "ata që kanë rënë". Fjala "të famshëm", në copën e mësipërme të *Gjenezës*, është përkthyer nga fjala sumere "shem", që në *Bibël* është kuptuar si e barasvlerëshme me shprehjen "të bësh emër", apo të bëhesh i famshëm. Sitkini këmbëngul përkundrazi se kuptimi i vërtetë i fjalës "shem" është "mjet qiellor" dhe se rrjedh nga rrënja "shu-mu", që do të thotë "ajo që është një MU", dhe një MU, sipas mendimit të tij, ishte një anije e vogël hapësinore. Kështu "njerëz të famshëm" bëhet "njerëz apo persona të anijeve të vogla hapësinore". Kanë qenë këta që janë bashkuar me gratë që i përkisnin racës njerëzore. Mendoj se kjo copë e *Gjenezës* flet për kryqëzimin ndërmjet jashtëtokësorëve, apo brenda-tokësorëve, dhe qenieve njerëzore, prej nga lindën hibridët njerëzoro-zvarranikë. Termi "bij të Perëndisë" në fakt rrjedh nga hebraishtja "bene-ha-elohim", që fjalë për fjalë do të thotë "bij të perëndive". Fruti zanafillës i këtyre kryqëzimeve gjenetike qenë gjigantët legjendarë dhe ka shumë dokumente që provojnë lindjen e këtyre hibridëve. Në të gjithë botën e lashtë, në çdo kontinent, ka shkrime të panumërta në lidhje me një racë gjigantësh, së cilës i përkiste sipas gjasës edhe Golia biblik. Në tregimet e indianëve të Amerikës figuron shpesh Populli i Yjeve, i cili zbret nga qiejtë për t'u çiftëzuar me gratë dhe, Aleks Kristoferi, mbron idenë se një aspekt i përbashkët i shumë rrëmbimeve të qenieve njerëzore nga ana e qenieve të zvarranikëve të ndodhura në Shtetet e Bashkuara i takon përkatësisë së personit të rrëmbyer në një familje të caktuar, sidomos në rastet që i përkasin indigjenëve të Amerikës, apo indianëve të lashtë. Hopët, sikurse do t'u kujtohet, mbrojnë idenë se e kanë pasur prejardhjen nga angrrat e Tokës. Teksti etiopas *Kebra Nagast* (nagasët ishin "perënditë gjarpërinj" indianë) i takon shumë shekujve më parë dhe e hedh fjalën për përmasa shumë të mëdha të fëmijëve të lindur nga bashkimet seksuale, apo gjenetike, midis njerëzve dhe "perëndive". Në të lexohet se "... bijat e Kainit, me të cilat engjëjt (jashtëtokësorët) kishin ngjizur fëmijë... nuk arritën dot t'i lindnin dhe vdiqën". Përshkruhet edhe lindja e disa prej këtyre gjigantëve nëpërmjet prerjes çezariane: "... duke hapur barkun e nënave, ata dolën nga kërthizat e tyre"[46]. Në tekstin e vjetër

hebraik të *Librit të Noes*, dhe në versionin e tij më të vonë, *Libri i Enoch*-ut, përshkruhet lindja e çuditshme e një fëmije, që nuk i përkiste racës njerëzore dhe që pastaj do të zbulohet si Noeja i Përmbytjes së Përbotshme. Referime të këtij tipi janë të pranishme edhe tek *Rrotullat e Detit të Vdekur*, tekstet e komunitetit esen të Palestinës, që u përkasin 2.000 vjetëve më parë, prej të cilave frymëzohet pastaj *Libri i Enoch*-ut. Fëmija i çuditshëm i përshkruar në këto tekste është i biri i Lamekut. Thuhet se ai ishte i ndryshëm nga qeniet njerëzore dhe më i ngjashëm me "bijtë e engjëjve të qiellit". I biri i Lamekut, Noeja, përshkruhet me lëkurë të bardhë, me flokët të verdhë dhe me sytë që e bëjnë të "shkëlqejë si Dielli" krejt shtëpinë. Flokët e verdhë dhe sytë e kaltër të ngjashëm me tufa rrezesh lazër janë tipare tipike të personave misteriozë, apo "perëndive", që përmenden prej mijëra vjetësh, deri në ditët e sotme, në të gjitha qytetërimet e botës. Lameku i kërkon së shoqes shpjegime në lidhje me atin e fëmijës:

"Shiko, kam menduar në thellësinë e zemrës sime se ngjizja i detyrohet Gardianëve dhe të Shuguruarëve... dhe Nefilimëve... dhe zemra ime ka qenë e angështuar për shkak të kësaj fëmije"[47].

Tek *Shahnemehu* ose *Libri i Mbretërve*, historia legjendare e Iranit e përfunduar në vitin 1010 nga poeti arab Firdusi, përshkruhet lindja e një fëmije të quajtur Zal, bir i një mbreti me emrin Sam. Edhe këtu mbreti është i frikësuar nga pamja jotokësore e të birit, që ka një trup shumë të stërmadh, "të shndritshëm si argjendi", flokët të bardhë si një plak e të "ngjashëm me borën", dhe një fytyrë të krahasueshme me Diellin. Sami e quan "bir i demonëve", "bir i Daevave" - Gardianëve. Ashtu si patriarkët e Testamentit të Vjetër, duket se edhe iranianët i shikonin me sy të keq fëmijët që lindnin me një ngjyrë lëkure jashtëzakonisht të bardhë. Dhe kush përshkruhet jashtëzakonisht e bardhë, me një bardhësi çubardhë, pa pikë pigmenti? Familja mbretërore e Drakove. Teksti i Shahnemehëve thotë në lidhje më Zalin:

"Asnjë qenie njerëzore e kësaj toke
Nuk mund t'i jepte jetë një përbindëshi të tillë,
Ky duhet t'i përkasë ndonjë race demonësh,
Ndonëse ka një trup dhe tipare njerëzore,
Në mos një Demon, të paktën
Ka tiparet e një kafshe shumëngjyrëshe"[48].

LIBRI 24

Zali më pas martohet me një princeshë të huaj me emrin Rudabeh, e bija e Mehrabit, mbret i Karbulit, dhe pasardhës i mbretit gjarpër Zahak, që thuhet se ka qeverisur Iranin për nja njëmijë vjet. Kjo racë ishte zvarranike dhe, në përputhje me përkatësinë e saj, Rudabehu përshkruhet shtatlartë si një pemë bredhi, e bardhë si fildishi, dhe me të gjitha karakteristikat e tjera tipike të kryqëzimit ndërmjet qenieve njerëzore dhe gardianëve. Përshkrime të këtij lloji janë të përsëritura atje ku flitet për familjet mbretërore të Iranit dhe të Lindjes së Afërt, ashtu sikurse është i përsëritur krahasimi midis shtatlartësisë së tyre të konsiderueshme dhe pemëve. Në këto tekste nënvizohet nevoja për të pasur tipare trupore tipike të nefilim-gardianëve, për të synuar titullin e mbretit. Prej këtej, pa dyshim, rrjedh "e drejta mbretërore hyjnore", domethënë e drejta për të qeverisur mbi bazën e përkatësisë së vet gjenetike, një sistem qeverisjeje që u përhap mandej kur këto popullsi u shpërngulën në Evropë. Deri edhe titulli anglez *Sir*, që u jepet nga mbretëresha nënshtetasve të përzgjedhur prej saj, rrjedh nga një perëndeshë-gjarpër (qenie zvarranike) e lashtë e quajtur Sir, që në pllakëzat sumere paraqitet në cilësitë e perëndeshës anunake Ninhil apo Ninkharsag. I shoqi, Enlili, quhej Gjarpëri i Shndritshëm, për shkak të syve përshkënditës. Edhe i vëllai i këtij, Enki, ishte një hyjni formëgjarpëri, emblema e të cilit paraqiste dy gjarpërinj të gërshetuar, simbol i "qendrës së kultit" të Eridusë dhe i profesionit modern mjekësor. Ky simbol është i njohur me emrin shkopi i Mërkurit - lajmëtari i perëndive (shiko ***Figura 5***).



Figura 5. Shkopi i lashtë i Mërkurit, simbol i profesionit modern të mjekësisë dhe i shumë gjërave të tjera, midis të cilave, me shumë gjasë, i spirales së dyfishtë të ADN-së ose, ndoshta, i një gjatësie të veçantë vale apo frekuence.

Informacione të tilla kanë ardhur përmes pllakëzave sumere, të përkthyera nga Zekaria Sitkini dhe të komentuara në librin e tij. Për këtë arsye më habit fakti që vetë Sitkini më ka thënë se nuk kishte asnjë provë të ekzistencës së një race zvarranikësh dhe më ka këshilluar t'i braktis kërkimet e mia. Ideja se nuk ekzistojnë prova është thjesht absurde, atëhere si

shpjegohet sjellja e Sitkinit? Ai më ka lënë të kuptoj qartë që të mos vazhdoj në këtë linjë kërkimi. Nuk ushqej absolutisht asnjë dyshim mbi faktin që anunakët dhe gardianët i përkasin të njëjtës race zvarranikësh, "gjarpërinjve me sytë të shndritshëm" të identifikuar nga Kristian dhe Barbara O'Briani në veprën e tyre *Genius Of The Few*[49].

Studiuesi dhe kërkuesi Andrej Kolins thotë se është në zotërim të një statujëze kananease (*që i përket zonës së Kananit, emërtim i vjetër i Palestinës*) në bakër, që i përket vitit 2000 para Krishtit, ku paraqitet një hyjni vendase[50]. Ajo ka një qafë formëgjarpëri dhe një kokë të ngjashme me atë të kobrës, e mbuluar nga një kokore në formë gjarpëri[51]. Mijëra vjet pas krijimit të këtyre hibridëve njerëzoro-zvarranikë, ata rezultojnë më shumë të shkrirë midis popullsisë dhe më pak lehtësisht të dallueshëm nga pikëpamja fizike, por struktura e tyre gjenetike në thelb mbetet po ajo dhe Vëllazëria zotëron skeda gjenetike shumë të hollësishme të këtyre qenieve. Në veprën *Genius Of The Few*, Kristian e Barbara O'Briani mbrojnë idenë se anunakët janë përzier me racën njerëzore qindra mijëra vjet më parë dhe, mandej, prapë edhe një herë rreth 30.000 vjet më parë, dhe se rezultati i këtij kryqëzimit të dytë do të kete qenë një strukturë gjenetike që për 75% i përket anunakëve dhe 25% i përket qenieve njerëzore. Unë mendoj se një tjetër program hibridizimi është vënë në zbatim shumë më vonë, pas përmbytjes së shkaktuar nga Afërdita, e ndodhur rreth 7.000 vjet më parë. Këto kryqëzime të vona paraqesin natyrisht tipare edhe më tipike të anunakëve se ato të mëparshmet. Bëhet fjalë për hibridët zvarranikë, që sot qeverisin botën dhe ky bollëk genesh të racës së zvarranikëve u lejon këtyre personave të shndërrohen në zvarranikë dhe pastaj të marrin përsëri një formë njerëzore. Këto raca janë të pajisura edhe me një vështrim hipnotizues jashtëzakonisht të fuqishëm, pikërisht si ato të një gjarpëri që hipnotizon prenë e tij, dhe prej këtej e ka prejardhjen shprehja "t'i hedhësh syrin e keq dikujt". Këtu qëndron arsyeja e vërtetë se përse familjet me "gjak blu" dhe pinjollët e tyre i mundon aq shumë si në ankth ideja e lidhjeve të gjakut dhe e bashkimeve midis pjesëtarëve të një gjaku. Ja përse, që nga kohët më të lashta të historisë së njohur, trashëgimtarët me gjak blu martoheshin me motrat e tyre të gjetura e me kushërirat e tyre, pikërisht ashtu siç bënin edhe anunakët, sipas asaj që thuhet në pllakëzat sumere. Në këtë pasardhje, geni më i rëndësishëm trashëgohet nëpërmjet linjës femërore. Ja përse zgjedhja e partnerës seksuale është për ata aq shumë e rëndësishme.

Është shumë domethënës fakti që raca e "mbretit gjarpër" e ka pasur zanafillën në Iran, pasi që nga Irani, nga Kurdistani, nga Armenia, nga Turqia dhe nga malet e Kaukazit këto raca njerëzoro-zvarranike u nisën për të

pushtuar botën. Emri "Iran" rrjedh nga fjala e lashtë "Airy-ana", ose "Air-an", që do të thotë "tokë e Aryasve ose Arianëve"[52]. Akoma sot në Kurdistan banojnë dy grupe të ndryshme etnike, ata me lëkurë në ngjyrë të ullirit, me gjatësi mesatare e me sytë të errët dhe ata shumë më shtatlartë, me lëkurë të bardhë dhe shpesh me sy të kaltër. Do t'ju kujtohet që këto tiparet e fundit trupore konsideroheshin nga nazistët si tipike të "racës superiore" dhe kjo sepse nazistët e njihnin historinë dhe lidhjet me racën e zvarranikëve. Andrej Kolinsi, në librin e tij *From The Ashes Of Angels*, paraqet prova interesante të faktit që Kopshti biblik i Edenit ndodhej në një zonë të ngritur të këtij rajoni të Iran-Kurdistanit dhe, natyrisht, tema e gjarpërit zë një vend qendror në historinë e Edenit. Në Medinë e afërt mbretërit njiheshin nga iranianët si Mar, që në persishte do të thotë "gjarpër"[53]. Mars = Gjarpër? Ata quheshin edhe "dinastia e dragonjve të Medisë" ose "pasardhës të dragoit"[54]. Jam i sigurtë se qeniet zvarranike të racës Draco janë përzier me qeniet njerëzore, për t'u dhënë jetë ca hibridëve brenda racës së bardhë dhe, në fakt, sot ka shumë njerëz të shpërndarë në të gjithë botën që deklarojnë se janë bashkuar seksualisht me ca qenie zvarranike. Oborri Mbretëror i Dragoit u themelua përpara vitit 2200 para Krishtit nga priftërinjtë e Mendesit në Egjipt, dhe ai mbijeton ende sot, 4000 vjet më pas, si Oborri Mbretëror i Sovranitetit të Dragos, dhe e ka selinë në Britaninë e Madhe. Disa e quajnë Vëllazëri e Gjarpërit. Mbretërit e parë sumerë, egjiptianë dhe, më pas, izraelitë, shuguroheshin, në çastin e kurorëzimit, me "dhjamin e Dragoit", që ishte dhjami i krokodilit të shenjtë. Krokodili në Egjipt njihej si "meseh" dhe prej këtej rrjedh termi hebraik "Mesia", që do të thotë i "shuguruari". Mbretërit pasardhës njiheshin edhe si "Dragonj" dhe i gjithë ky simbolizëm shpjegohet mbi bazën e faktit se këto familje mbretërore rridhnin nga hibridë njerëzoro-zvarranikë. Kur shumë mbretëri bënin aleancë për arsye lufte, emëronin një mbret të mbretërve, i njohur si Dragoi apo... Drakoi i Madh. Titulli i famshëm kelt "pendragon" (princ) është një tjetër shembull i kësaj. Fjala "kingship" (pushtet sovran) rrjedh në realitet nga "kin" (i afërm gjaku), dhe "kinship" bëhet pastaj "kingship". Pikërisht për të nënvizuar rëndësinë e racës së zvarranikëve, emri që egjiptianët i dhanë "meseh"-ut të tyre të shenjtë, apo krokodilit qe... Draco. Ai u bë një simbol i terapeutëve (*mjekëve*) egjiptianë dhe sivëllezërve të tyre izraelitë, esenëve, ndërsa në Francë paraqitet në formën e gjarpërit detar, ose *Bistea Neptunis* nga dinastia "mbretërore" e Merovingëve dhe nga pasardhësit e tyre. Bëhet fjalë sidoqoftë për të njëjtën racë. Nëse shikoni në pjesën e ilustrimeve do të gjeni një figurë të lashtë egjiptiane të një "perëndie" që paraqitet në faqen e murit të tempullit të Saqaras: bëhet fjalë

për një figurë më tipare zvarranikësh, në dukje e pajisur me krahë.

Ende sot flitet për ekzistencën e qenieve me flokë të verdha dhe me sy të kaltër të shndritshëm si rreze lazer. Një mik amerikan më ka treguar për një përvojë që i kishte ndodhur të atit në vitet e para shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Në atë kohë jetonin në Turqi, ku i ati punonte pranë një vendi zbulimi të shërbimeve sekrete ushtarake amerikane. Një mbrëmje arriti në shtëpi në gjendje të tmerrshme. Kur e pyetën se çfarë kishte ndodhur, ai arriti vetëm të murmuriste nëpër dhëmbë: "Bota nuk është ajo që mendojmë se është". Ndonëse pinte rrallë, kërkoi një skotç dhe pastaj menjëherë një tjetër. Pasi ishte shtendosur, i tregoi të birit se kishte marrë një njoftim nga ana e një piloti të një avioni me shërbim garnizoni në bazën turke. Piloti i bëri të ditur se ndërsa ishte duke fluturuar afër polit të Veriut, papritmas motorët e tij u bllokuan dhe i gjithë sistemi elektrik u shua. Avioni atëhere filloi ngadalë-ngadalë të ulej vertikalisht drejt tokës dhe, për habinë e tij të madhe, maja e një mali u hap e aeroplani ishte gëlltitur brenda tij. Atëhere kishte qenë i pranishëm në një skenë, që dukej si pjesë e ndonjë filmi me Xhejms Bondin. Doli nga aeroplani duke pyetur se ç`djallin po ndodhte dhe i erdhën përballë ca qenie shtatlarta, me flokë të verdhë, me lëkurën në një ngjyrë të bardhë perle dhe me sytë ngjyrë manushaqe në blu, që dukeshin si elektrikë, si rreze lazer. Të gjithë ishin me veshje të gjata të bardha dhe, ndoshta jo rastësisht, ky përshkrim përkon me atë të "perëndisë" së Amerikës qendrore e jugore, Kuetzalkoatlit. Mbanin edhe nga një zinxhir në qafë me një medalion, ku paraqitej një kryq maltez. Piloti i kujtonte vetëm turbull çastet që pasuan në takimin e tij me qeniet me sy të kaltër, por e dinte se kishte hyrë në një dhomë dhe se kishte parë një grup prej këtyre individëve të ulur përreth një tavoline konferencash. Më pas, qe çuar përsëri në aeroplanin e tij: motorët dhe impiantet elektrike u vunë përsëri në funksionim dhe ai arriti të dilte nga mali. Tani që keni dëgjuar se si një pilot amerikan i ditëve tona i përshkruan këto qenie, le të shohim se si paraqiten gardianët tek *Libri i Enoch*-ut:

"Dhe ja tek m`u shfaqën dy njerëz shumë shtatlartë, siç nuk kisha para kurrë në Tokë. Dhe fytyrat e tyre shndrisnin si dielli, dhe sytë e tyre ishin të ngjashëm me llampa inkandeshente... duart e tyre ishin më të shndritshme se bora"[55].

Kjo duket se të sjell ndërmend edhe përshkrimin e lashtë të "perëndive" si të "shndritshëm". Sigurisht, gjatë historisë sonë kanë ndodhur shumë më tepër gjëra se ato që na tregohen dhe, edhe shumë më tepër, nga sa pjesa më e madhe e njerëzve mundet vetëm të marrë me mend, janë duke ndodhur

sot. Përveç asaj të zvarranikëve, shumë raca të tjera jashtëtokësorësh veprojnë në Tokë apo përreth saj, në këtë apo në më shumë përmasa të larta. Qeniet e ardhura nga Orioni dhe nga Plejada i përkasin vetëm disa prej shumë racave që, sipas të rrëmbyerve dhe studiuesve, ndërveprojnë me qeniet njerëzore. Sipas asaj që më është bërë e ditur nga njerëz të infiltruar brenda Vëllazërisë, që kanë parë disa prej këtyre jashtëtokësorëve, orionët (një racë mizore por shumë e bukur, sipas burimeve të mia) kanë lidhur një farë aleance të ngushtë me racën e zvarranikëve. Jam i sigurtë se engjëjt, për të cilët flet *Bibla*, ishin gardianët, qeniet e zvarranikëve, me ose pa krahë. Vetë shprehja "bijtë e perëndive" përkthehet në versionin grek të Testamentit të Vjetër "perëndi Shtatëdhjetë" si "angelos" - engjëj. Nga kërkimet e mia del se ekzistojnë grupe të ndryshme të racës së zvarranikëve; ata që ushqejnë synime pozitive kundrejt njerëzimit dhe ata që dëshirojnë vetëm ta sundojnë dhe kontrollojnë. Që të dy u bënë të njohur me emrin gardianë ose engjëj, grupi i dytë, në mënyrë të veçantë, me atë të "engjëjve të rënë nga qielli". Legjenda e shën Mikelit që, pas shumë luftrash, mposht dragoin dhe ajo e shën Gjergjit që mund dragoin, mund t`i referoheshin shumë mirë konfliktit të gjatë ndërmjet marsianëve të vërtetë të bardhë dhe anunakëve zvarranikë. Shën Mikeli dhe shën Gjergji janë heronj të lashtë fenikas me prejardhje pikërisht prej asaj zone të botës ku anunakët përhapën programin e tyre të hibridizimit dhe, për një kohë të gjatë, u shfaqën hapur në cilësinë e tyre prej zvarranikësh. Në librin e fundit të *Biblës, Libri i Zbulimit*, shohim lidhjen e qartë midis qenies së njohur si Satanai dhe gjarpërit, apo zvarranikut:

"Dhe dragoi i madh, gjarpëri i lashtë, ai që e quajmë djalli dhe Satanai dhe që josh e mashtron krejt botën, që rrokullisur në tokë dhe bashkë me të qenë rrokullisur edhe engjëjt e tij"[56].

"... E kapi dragoin, gjarpërin e lashtë, domethënë djallin, Satananë, dhe e lidhi me zinxhirë për njëmijë vjet, dhe e hodhi në humnerë, e mbylli aty dhe e vulosi derën përsipër tij, me qëllim që të mos i joshte më kombet gjer në plotësimin e njëmijë vjetëve"[57].

Në një fragment të një *Rotulle të Detit të Vdekur* të përkthyer nga studiuesi hebre Robert Ajseman, ka një përshkrim të një gardiani me emrin Belial (Bel?), të paraqitur si Princi i Errësirës dhe Mbreti i së Keqes. Thuhet se pamja e tij është e frikshme, e ngjashme me një gjarpër me fytyrë nepërke. Njëri prej grupeve kryesore të engjëjve të traditës hebraike është ai i serafinëve, ose i

LIBRI 24

"gjarpërinjve të zjarrtë" dhe pamja e gardianëve të kujton nga afër atë të një gjarpëri. Doktrinat persiane flasin edhe për një qenie të përshkruar si "gjarpëri i vjetër dykëmbësh", në të njëjtën mënyrë me të cilën *Libri i Enoch*-ut flet për gjarpërinj që ecin. Nëse mendoni që raca mbretërore e Drakove duket se ka një gjatësi më të madhe se tri metra e gjysmë dhe një lëkurë të bardhë si çubardhët pa pikë pigmenti, "më të bardhë se dëbora", do të vini re lidhjen me lëkurën shumë të bardhë të hibridëve të lindur nga kryqëzimi ndërmjet gardianëve gjigantë dhe qenieve njerëzore. Ashtu siç përshkruhet tek *Libri i Enoch*-ut dhe gjetkë. Dhe, ngulmoj ta nënvizoj, lindja e fëmijës gjysmë njeri e gjysmë gardian, për të cilin flitet në *Librin e Enoch*-ut, i referohet lindjes së Noes. Nëse kjo është e vërtetë, Noeja do të ketë qenë pra një hibrid njerëzoro-zvarranik dhe janë të shumtë popujt që kanë kërkuar të mbrojnë prejardhjen e tyre prej Noes – prejardhjen, pra, prej gardianëve dhe prej anunakëve zvarranikë. Në mitologjinë hebraike, nefilimët përshkruhen si "awwim" që do të thotë shkretues ose gjarpërinj. Tek *Rrotullat e Detit të Vdekur*, Noeja përshkruhet me tipare të ngjashme me ato të "bijve të engjëjve (*të rënë*) nga qielli", "ngjizja e të cilëve ndodh falë gardianëve... dhe nefilimëve". Në traditën hebraike, Eva shikohet si nëna stërgjyshore e nefilimëve dhe i shoqërohet fjalëve hebraike që do të thonë "jetë" dhe "gjarpër". Sipas mitit, që i përket Testamentit të Vjetër dhe të tjera burimeve, Eva ka qenë tunduar, natyrisht, nga gjarpëri. Në kapitullin 69 të *Librit të Enoch*-ut, lexojmë se midis gardianëve, që u zbuluan sekretet njerëzve, figuronte Gadreli, engjëlli i rënë, i cili është identifikuar si tunduesi i Evës. *Libri i Enoch*-ut është përjashtuar nga Kisha Katolike, që është përpjekur të mohojë besimin e krishterë me zanafillë tek ekzistenca e engjëjve me mish e kocka dhe e atyre të mishëruar, apo kryqëzuar, me njerëzit. E gjitha kjo ka pasur si synim t'i pengonte masat të kuptonin se si kishin shkuar me të vërtetë gjërat. Por masonët, që sot kontrollojnë Kishën Katolike Romake bashkë me të tjera degë të Vëllazërisë, e kanë parë gjithmonë Enoch-un (Noen) si njërin prej themeluesve të tyre legjendarë. Vetë emri Enoch do të thotë "anëtar" (*i një shoqërie të fshehtë*).

Tema e engjëjve të rënë nga qielli, që i treguan njerëzimit sekrete të ndaluara, mund të haset tek *Libri i Enoch*-ut dhe në tekste të tjera. Midis këtyre personazheve që zbuluan sekrete figuron Azazeli, i cili u mësoi njerëzve artin e për t'u dhënë trajtë metaleve, dhe Shemyaza, që u mësoi atyre artet magjike. Më pas, hasim të tjerë heronj protagonistë të historive të ngjashme, midis të cilëve më i famshmi është perëndia greke Prometeu, që thuhet se u ka vjedhur zjarrin (dijen) perëndive për t'ua dhënë njerëzve (një grupi të ngushtë njerëzish). Një statujë ari e Prometeut ngrihet në Rockefeller Center

të Nju Jorkut. Rokfelerët janë racë zvarranikë gjakpastër dhe prandaj janë absolutisht në dijeni të kuptimit të vërtetë të fshehtë të legjendës së Prometeut. Pa vini re, pikërisht tek gardiani me emrin Azazel e ka burimin përdorimi i kokës së dhisë në ritet satanike, përveç shprehjes "cjap (dash) kurbani". Sipas *Librit të Levitikut*, izraelitët flijonin dy cjepë me rastin e *Yom Kippur*-it, Ditës së Shpërblimit. Njëri i ofrohej Zotit, tjetri Azazelit. Prifti i vendoste të dyja duart mbi kokën e cjapit kushtuar Azazelit dhe rrëfente mëkatet e njerëzve. Cjapi pastaj çohej në shkretëtirë dhe hidhej poshtë nga ndonjë rrëpirë: një rindërtim simbolik i fundit të engjëllit të rënë Azazel, që ishte parë i lidhur me zinxhirë në shkretëtirë – në "humnerë", për të përdorur gjuhën e *Librit të Zbulimeve;* mendoj se ky episod aludon për burgimin në nivelin më të ulët të përmasës së katërt. E gjitha kjo të kujton edhe idenë e vjetër të "cjapit (dashit) të kurbanit", e shprehur simbolikisht prej figurës së "Jezusit". Koka e dhisë (cjapit) së Azazelit, një engjëll i racës së zvarranikëve i rënë nga qielli, simbolizohet nga ylli me pesë cepa i përmbysur i satanizmit.

Mund të diskutojmë mbi hollësitë dhe, madje, duhet ta bëjmë, sepse ka ende një sasi shumë të madhe informacionesh, që duhet të zbulohen. Unë vetë kam një radhë të gjatë pyetjesh, të cilave nuk di ende t'u jap një përgjigje. Por disa ide të vlefshme në thelb janë duke dalë në dritë: raca jashtëtokësore janë ankoruar në Tokë, me synime të ndryshme, sipas gjasës miliona vjet më parë dhe, bashkimi i tyre seksual me njerëzit, u ka dhënë jetë shumë etnive. Në të kaluarën e largët kanë ekzistuar qytetërime mjaft të zhvilluara nga pikëpamja teknologjike, që bazoheshin mbi dijet jashtëtokësore: një Epokë e Artë, siç e quanin të lashtët. Rreth 450.000 vjet më parë arritën anunakët, një racë e qenieve zvarranike, e udhëhequr nga grupi me krahë e çubardh i Drakove, që kërkuan të pushtonin planetin. Përveç kësaj, ka të ngjarë që në atë epokë ata ta kishin pushtuar dhe kolonizuar ndërkohë Marsin. Për shumë kohë anunakët jetuan hapur si qenie zvarranike, por për ndonjë arsye, sipas gjasës për shkak të armiqësisë nga ana e racave të tjera jashtëtokësore dhe të njerëzimit, vendosën të "maskoheshin" dhe ta plaçkisnin planetin, duke marrë tipare njerëzore. Për këtë qëllim vunë në zbatim edhe një program hibridizimi, që krijoi raca hibride njerëzoro-zvarranike, nëpërmjet të cilave ata mund të vepronin që nga niveli më i ulët i përmasës së katërt. Qeniet e zvarranikëve të përmasës së katërt përdorin trupin njerëzor si një tutë gjenetike dhe, kur një trup vdes, "shpërngulen" tek një tjetër dhe vazhdojnë të ndjekin të njëtat plane në rrethin e brezit pasardhës. Ashtu si një njeri që më parë vesh një tutë hapësinore dhe pastaj e heq. Këto krijesa janë ato qenie zvarranike, që njerëzit sensitivë (*në psikologji, persona që mund të kapin stimuj, që nurmalisht*

nuk ndihen) i shohin të zotërojnë trupa njerëzorë. Për ta bërë duket se duhet t'i përkasin një race gjenetikisht të zotëruara nga qeniet zvarranike dhe është kjo arsyeja pse familjet që zënë pozita pushteti janë gjithmonë të njëjtat. Të tjerë hibridë njerëzoro-zvarranikë më pak të pastër janë ata trupa të zotëruar nga një vetëdije zvarranike e përmasës së katërt dhe, këta persona, fizikisht paraqesin një pamje tipikisht njerëzore, edhe pse duke qenë të "manipuluar" nga një qenie zvarranike. Hibridizimi, që ka futur gene zvarranike tek këto raca, i ka bërë më lehtësisht të manipulueshme se sa ato të pajisura me pak gene zvarranike. Edhe pse duke e ditur, pra, se cilët persona mund të jenë lehtësisht të zotërueshëm, zvarranikët kërkojnë megjithatë të ndikojnë tek të gjithë, duke nxitur modele sjelljeje që e kanë qendrën në zonën zvarranike të trurit: mendimin hierarkik, agresivitetin, konfliktin, ndarjen, egërsinë dhe prirjen ritualiste. Me këtë epitet nuk u referohem vetëm meshave me skena tipike të ceremonive satanike. Ka shumë shembuj të idesë fikse njerëzore për ritualin, përfshirë atë gjë që bëhet gjithmonë në të njëjtën orë, ditë pas dite, javë pas jave. Raca e zvarranikëve e kanë përdorur racën e bardhë si instrumentin e tyre kryesor për të vënë në zbatim një kontroll global, por janë përzier me të gjitha etnitë, përfshirë kinezët, japonezët, arabët dhe popullin e njohur me emrin e hebrejve. E gjitha kjo i jep mundësi racës së zvarranikëve të kontrollojë njerëz dhe organizata në dukje të palidhura me njëra-tjetrën. Është fjala për versionin jashtëtokësor të të njëjtës shoqëri të fshehtë, e cila vepron në zona të ndryshme influence, në padituri të plotë të pjesës më të madhe të popullsisë. Ajo që shikojmë është një sërë qeniesh njerëzore në dukje të ndryshëm, që mbulojnë pozicione të ndryshme pushteti dhe që, megjithatë, arrijnë në të njëjtat përfundime dhe përshtatin të njëjtën politikë. Një politikë e tillë na paraqitet si frut i demokracisë dhe që përshkohet nga debati publik. Por, në qoftë se të gjithë kontrollohen nga e njëjta forcë? Atëhere do të gjendemi përballë një diktature, por, si do të mundemi ta vëmë re, pa njohur situatën e vërtetë? Është kjo ajo që ndoh me racën e zvarranikëve, të cilët veprojnë përmes trupash njerëzorë dhe me anë të rrjetit të shoqërive të fshehta, që këto raca kanë krijuar, apo në të cilat kanë depërtuar.

Libri i Enoch-ut thotë se të lindurit me gjak nefilimi (hibridët njerëzoro-zvarranikë), për shkak të shpirtit të tyre stërgjyshor, janë të paracaktuar për të "brengosur, për të shtypur, për të shkatërruar, për të sulmuar, për të hapur luftë, dhe për të kryer shkatërrimin në Tokë"[58]. Me fjalë të tjera, ata trupa mund të zotërohen nga "shpirti i tyre stërgjyshor" – nga qeniet e zvarranikëve të nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Në Shtetet e Bashkuara ekziston një organizatë që quhet Bijtë e Jaredit, nga emri i të atit të Enoch-ut. Anëtarët

e saj angazhohen për të zhvilluar një "luftë të pamëshirshme" kundër pasardhësve të gardianëve që "në cilësinë e faraonëve, mbretërve dhe diktatorëve të famshëm kanë sunduar gjininë njerëzore gjatë gjithë historisë". Në revistën e tyre, *Jaredite Advocate* (Përkrahësi jaredit), i dënojnë gardianët si "një farë super-gangsterësh, një mafie qiellore që sundon botën"[59]. Shumë njerëz më pyesin se si mundet elita e sotme e Vëllazërisë të shkaktojë aq shumë vdekje, shkatërrime e vuajtje, pa treguar emocionin më të vogël. Të paktën një pjesë e grupeve gjenetike zvarranike, në fakt, nuk duket se provojnë të njëjtat emocione që provojnë qeniet njerëzore dhe shfaqen edhe shumë më tepër të pashpirtë. Kam folur më lart për Xhorxh Bushin, Henri Kisingerin, David Rokfelerin e kështu me radhë dhe, këta emra, nuk shkaktojnë çudi, sepse bëhet fjalë për anëtarë të racës së zvarranikëve, e cila vepron midis njerëzve.

Ajo çka kam përvijuar në këtë kapitull do të mahnisë edhe pjesën më të madhe të atyre që kanë ndjekur dhe mbështetur punën time në harkun e viteve të fundit, dhe unë i kuptoj. Por, përmes përvojave të jashtëzakonshme, dhe nganjëherë të skajshme, kam mësuar të ndjek rrjedhën e jetës, kudo që të çon ajo. Kur ndiej ritmin e jetës, vallëzoj. Kur e ndiej se jeta më flet, e dëgjoj. Shkoj ku më çon muzika, pa e çarë kokën se sa e pabesueshme mund të duket ajo, apo për rrjedhojat që mund të ketë mbi jetën time. Atyre që ende nuk i kanë provuar këto përshtypje u them se do të mahniten përballë aventurës, kur do të gjenden papritmas për ta jetuar, përballë dijes dhe përballë kuptimit, në të cilat do të kenë të drejtën të hyjnë kur do të ndjekin rrjedhën dhe do të pushojnë së penguari atë, prej frikës për të qenë të ndryshëm. Shpesh pjesa më e madhe e njerëzve njëtrajtësohen me të tjerët, sepse kanë frikë të çlirohen prej konvencioneve. I tremben asaj që të tjerët do të mendojnë e do të thonë për ta. Por si është e mundur të flasësh për atë që është e papërfytyrueshme pa menduar për të papërfytyrueshmen? Dëshirojmë të themi ndoshta se dimë gjithçka? Nuk ka mbetur asgjë për t'u zbuluar? Sigurisht që po. Ne jemi në dijeni vetëm të një pjese të vogël të gjithçkasë. Dhe, kush janë ata që na kanë çuar në nivelin tonë, edhe pse të kufizuar, të tanishëm të dijeve? Sigurisht ata që kanë guxuar të mendojnë dhe të kumtojnë të papërfytyrueshmen. Pa ata njerëz gjinia njerëzore nuk mund të evoluojë; qëndron e palëvizur aty ku është, brenda një burgu të përjetshëm mendor. Ç'është ajo që kanë thënë? Qenie njerëzore që fluturojnë? Qesharake! Që ne mund të udhëtojmë përtej shpejtësisë së zërit? Marrëzi! Që mund të krijojmë fëmijë në epruvetë dhe të klonojmë lloje njerëzish dhe kafshësh? Absurde! E, megjithatë, të gjitha këto gjëra dhe, edhe më shumë,

LIBRI 24

janë realizuar nga ana e atyre që kanë guxuar të mendojnë të papërfytyrueshmen, teksa masat ishin angazhuar t'i tallnin. Provojeni, para se të harroni se si bëhet! Mendoni përtej kufijve të asaj që ju thuhet se është realiteti.

Të mos pranosh ta bësh do të thotë të mbyllesh përfundimisht në burg, në amullinë mendore dhe emocionale, në kontrollin përfundimtar. Pikërisht kështu na kontrollojnë që nga koha kur ka filluar i tërë mashtrimi.

LIBRI 24

Kapitulli 3

Vëllazëria Babilonase

Kur ujrat e përmbytjes u tërhoqën pas përmbytjes së shkaktuar nga Afërdita, të mbijetuarit zbritën nga malet dhe dolën nga angrrat e tokës. Pasi qenë vendosur nëpër ultësira e nëpër fusha, filluan punën e rindërtimit. Pikërisht atëhere qytetërimi sumer, ai egjiptian dhe ai i Luginës së Indusë arritën një nivel shumë të lartë të zhvillimit teknologjik, ndonëse zanafillat e tyre i takojnë një periudhe shumë më të përparshme dhe ato thjesht janë rimëkëmbur pas këtyre përmbysjeve.

Në agimet e tij qytetërimi sumer arriti ndërkohë kulmin e zhvillimit të vet falë kësaj futjeje të papritur dijesh dhe, raca ariane e bardhë, me prejardhje nga Marsi, u përhap nga malet e Kaukazit dhe nga Lindja e Afërt deri tek toka e sumerëve, në Egjipt e në Luginën e Indos, ku, siç na pohohet nga historia zyrtare, shoqëri mjaft të zhvilluara dolën nga hiçi. Megjithatë, brenda kësaj race të bardhë, sikurse edhe brenda të tjerave, u bë e njohur një rrymë gjenetike që do ta quaj ariano-zvarranike, ose njerëzoro-zvarranike. Kur përdor termin "arian", i referohem racës së bardhë. Kjo rridhte nga kryqëzimi i racave të dala nga manipulimi gjenetik i anunakëve. Në botën e lashtë, pasi ujërat e përmbytjes u tërhoqën, qendra më e rëndësishme e këtyre racave ariano-zvarranike ka qenë Babilonia, në jug të rajonit sumerik, gjatë lumit

Eufrat. Një analizë më e kujdesshme e gjurmëve që kanë mbërritur gjer tek ne duket se na bën ta kërkojmë zanafillën e themelimit të Babilonisë në një epokë mjaft më të përparshme se sa ajo që është besuar gjithmonë; ajo ka qenë pra njëri prej qyteteve të para të erës post-përmbytëse. Pikërisht këtu janë themeluar shkollat misterike dhe shoqëritë e fshehta, të cilat në mijëvjeçarët e mëpasëm do të përhapeshin në të gjithë globin. Vëllazëria, që sot kontrollon botën, nuk është gjë tjetër veçse një version modern i Vëllazërisë Babilonase, e përbërë nga priftërinj ariano-zvarranikë dhe nga "raca mbretërore" që, pas përmbytjes, u derdhën së bashku në po atë vend. Pikërisht në Babiloni, në periudhën pas përmbytjes, rreth 6.000 vjet më parë, u shpallën parimet themelore të besimeve të sotme botërore, me qëllimin për të kontrolluar dhe sunduar popujt.

Sipas teksteve të lashta dhe legjendave, themeluesi i Babilonisë ka qenë Nimrodi, që mbretëroi bashkë me të shoqen, mbretëreshën Semiramidë. Nimrodi përshkruhet si një "tiran i fuqishëm" dhe si njëri prej "gjigantëve". Arabët besonin se, pas përmbytjes, Nimrodi kishte ndërtuar, ose rindërtuar, ndërtesat e fuqishme të Balbekut në Liban, tre gurët e të cilave peshojnë 800 tonelata secili. Thuhet se ai ka qeverisur rajonin e Libanit të sotëm dhe, sipas *Gjenezës*, qendrat e para të mbretërisë së Nimrodit kanë qenë Babilonia, Akadi dhe qytete të tjera në tokën e Shinarëve (Sumeria). Më pas vazhdoi të shtrihej në Asiri, për të ndërtuar qytete si Ninive, ku janë gjetur shumë prej pllakëzave sumere. Nimrodi dhe Semiramida (apo individët që qëndrojnë prapa këtyre emrave) rridhnin nga raca zvarranikësh, të njohur edhe si Titanë, domethënë nga grupet gjenetike të krijuara prej qenieve njerëzore të zotëruara nga racat e zvarranikëve dhe prej racave të zvarranikëve gjakpastër. Thuhej se kjo racë "gjigantësh" ose "titanësh" rridhte nga Noeja, fëmija që *Libri i Enoch*-ut (së lashti *Libri i Noes*) e përshkruan si një hibrid midis racës njerëzore dhe asaj të gardianëve, një hibrid me lëkurën shumë të bardhë. I ati i Nimrodit në tekstin e *Gjenezës* ishte me emrin Kush, i njohur edhe si Bel, ose Belus, nip i Noes dhe i biri i Hamit. Kushi bëhet i famshëm me emrin Hermes, që do të thotë Bir i Hamit[1]. Ham, ose Khem, do të thotë "i djegur", dhe ai ishte sipas gjasës i lidhur me kultin e Diellit[2]. Një rrjet i ndërlikuar hyjnish doli në dritë nga Babolonia dhe nga lidhjet e saj me Egjiptin. Nimrodi dhe Semiramida kanë mbetur gjer sot e kësaj dite, ndonëse me emra e simbole të ndryshme, hyjnitë themelore të Vëllazërisë. Simboli që i bashkëshoqërohej Nimrodit ishte një peshk, kurse simbolet e mbretëreshës Semiramidë ishin një peshk dhe një pëllumbeshë. Sipas gjasës, Semiramida simbolizonte Ninkharsagun, krijuese e kryqëzimeve ndërmjet qenieve njerëzore dhe qenieve të zvarranikëve.

Nimrodi ishte perëndia-peshk Dagon, i paraqitur gjysmë njeri e gjysmë peshk[3]. Kjo sipas gjasës aludonte për identitetin e tij të dyfishtë, që ishte edhe njeri edhe zvarranik me luspa. Edhe mbretëresha Semiramidë paraqitej me tiparet e një peshku, pasi babilonasit besonin se peshku ishte afrodiziak (*me substanca që nxitin stimujt seksualë*), dhe ai bëhet për këtë arsye simbol i Perëndeshës së Dashurisë[4]. Prej këtej rrjedh prania e peshkut në simbologji dhe në arkitekturën e krishterë. Në cilësinë e "Shpirtit të Shenjtë", Semiramida paraqitej si një pëllumbeshë që sjell një degë ulliri dhe Semiramidë do të thotë në fakt "sjellëse dege", nga "Ze" (i) "emir" (degë) dhe "amit" (sjellëse)[5]. Vini re edhe përmendjen e kësaj simbologjie në historinë e Noes dhe të Përmbytjes së Përbotshme, kur pëllumbesha u kthye përsëri, duke transportuar një degëz ulliri. Kthimi i zvarranikëve pas përmbytjes? Emri Semiramidë rrjedh nga një hyjni e mëparshme indiane, Sami-Rama-isi, ose Semi-Ramis[6]. Peshku dhe pëllumbesha janë dy simbole që përmenden akoma më shpesh në ritet fetare dhe në ceremonitë qytetare, edhe pse pjesa më e madhe e njerëzve që marrin pjesë në ato nuk e dinë kuptimin e vërtetë. Shin Fejni, krahu politik i grupit terrorist verioroirlandez i IRA-s, ka për simbol një pëllumbeshë, dhe një pëllumbeshë gjendet gjithashtu edhe mbi shumë prej skeptrave të monarkëve britanikë (shih pjesën e ilustrimeve). Bëhet fjalë në të dy rastet për paraqitje moderne të Vëllazërisë Babilonase dhe, pëllumbeshat, të rikthejnë simbolikisht tek mbretëresha Semiramidë. Larg prej të përfaqësuarit e paqes, pëllumbesha është për ta një simbol i vdekjes dhe shkatërrimit, sipas kuptimit të përmbysur së simboleve të realizuar nga Vëllazëria. Nëse një gjë është pozitive për masat, do të jetë negative për Vëllazërinë dhe e kundërta. Pikërisht mbi bazën e këtij parimi simbolet e tyre negative përhapen publikisht. Askush nuk ankohet, sepse askush nuk e ka idenë se çfarë përfaqësojnë me të vërtetë simbole si pëllumbesha.

Disa prej epiteteve të Semiramidës ishin Mbretëresha e Qiellit (edhe Rhea), Nëna Virgjëreshë dhe, nganjëherë, edhe Nëna e Madhe Tokë. Nderohej edhe me emrin Astarte, "gruaja që ndërtonte kulla", dhe kjo aludon sipas gjasës për Kullën e Babelit (Babiloni) që, sipas traditës, qe ndërtuar nga Nimrodi. Racat mbretërore evropiane rrjedhin nga racat ariano-zvarranike të Babilonisë dhe kurora e ka prejardhjen nga kokorja e pajisur me brirë, e mbajtur në kokë nga Nimrodi. Brirët ishin një simbol i autoritetit të monarkut dhe më pas gjithçka u shndërrua në një brez me tre brirë, simbole të pushtetit mbretëror të bashkuar me pushtetin hyjnor[7]. Për këtë aludon edhe simboli i zambakut, që e gjejmë në të gjitha stemat mbretërore të monarkive moderne (shih *Figura 6*). Sikurse e kam përmendur më parë, thuhet se raca

LIBRI

"mbretërore" e Drakove, çubardhët me krahë, ishte e pajisur me brirë dhe jam i sigurtë se është kjo origjina e kokores me brirë të sovranëve të lashtë. Edhe figura klasike e djallit paraqitet me brirë të ngjashëm me ato të racës së Drakove. Nimrodit i qe dhënë titulli Baal (Zotëria), ndërsa Semiramida u bë Baalti (Zonja ime).



Figura 6. Zambaku, simbol, midis gjërave të tjera, i trinitetit babilonas të Nimrodit, të mbretëreshës Semiramidë dhe të Tamuzit.

Përkthimi latin i termit "Zonja ime" është Mea Domina, që në italisht bëhet Madonna[8]. Nimrodi paraqitej në rol të dyfishtë të Zotit At dhe të Ninusit, bir i Semiramidës, dhe degëza e ullirit e kësaj të fundit aludonte për virgjërinë e saj. Ninusi ishte i njohur edhe si Tamuz, që thuhej se qe mbërthyer në kryq me një qingj tek këmbët e tij dhe qe vendosur në një shpellë. Kur, tri ditë më pas, guri që mbyllte hyrjen e shpellës qe lëvizur nga vendi, trupi i tij rezultoi i zhdukur. Kjo histori nuk ju duket e re, apo jo? Triniteti burrë-grua-bir në personat e Nimrodit-Semiramidës-Ninus/Tamuzit, u shndërrua në trinitetit Osirid-Isidë-Horus të mitologjisë egjiptiane, me të barasvlerëshmit e saj në Indi, Azi, Kinë e gjetkë. Shumë më vonë do të bëhej Jozef-Maria-Jezus.

Kur babilonasit kremtonin, gjatë ritualeve pranverore, ringjalljen e Tamuz-Ninusit, ngjarë tri ditë pas vdekjes së tij, shkëmbeheshin kuleçë të shtypur, mbi të cilët ishte gdhendur një kryq diellor. Por, edhe kuleçët e nxehtë me kryqin të gdhendur sipër tyre të traditës britanike të pashkëve kanë prejardhje babiloneze. Pashka rrjedh nga një tjetër hyjni e mishëruar nga mbretëresha Semiramidë – Ishtari. Pikërisht prej kësaj, dhe sipas gjasës nga një tjetër perëndi e Vëllazërisë, Ashtarothi, rrjedh fjala "Ashtar", të cilën e gjejmë tek shprehja "Komandë Ashtar", që, sipas një besimi të shtrembëruar të shoqërisë së fshehtë amerikane *New Age*, do të thotë një "hero" jashtëtokësor i ardhur për të na shpëtuar. Mitet dhe simbologjia babolinase kanë hedhur bazat e të gjitha besimeve më të mëdha fetare, veçanërisht të krishtërimit. Kisha Romake ka qenë një krijesë e Vëllazërisë Babilonase dhe papa mban ende në kokë një kësulë në formën e kokës së peshkut, që të rikthen simbolikisht tek Nimrodi. Të njëjtin kuptim ka Unaza e tij e Peshkatarit. Katedra e Shën Pjetrit në Vatikan që mbajtur për një kohë të gjatë si një relike e shenjtë, gjersa në vitin 1968 një komision studiuesish vërtetoi se ajo i takonte një periudhe jo më të përparshme se shekulli IX. Edhe më domethënës akoma,

sipas traditës katolike, është fakti se ajo është zbukuruar me dymbëdhjetë medaljone, të cilat paraqesin dymbëdhjetë bëmat e Herakliut. Po në këtë libër mbroj idenë se Herakliu nuk ishte tjetër veçse Nimrodi, kur ky i fundit bëhet një hyjni greke[9]. Në vitin 1825, papa Leoni XII autorizoi stampimin e një medaljeje jubilare, e cila paraqiste portretin e një gruaje në një qëndrim që të rikthente në mendje simbolizmin e mbretëreshës Semiramidë. Ajo mbante një kryq në dorën e majtë, një kupë në dorën e djathtë dhe, mbi kokë, një kurorë me shtatë rreze si ato të Statujës së Lirisë, një simbolizim tjetër i Semiramidës, që i është dhuruar qytetit të Nju Jorkut nga masonët francezë. Një informatori im, që ka të afërm të cilët mbulojnë pozita të rëndësishme brenda Vatikanit, më ka rrëfyer se kishte mbetur i tronditur pas një vizite të kryer brenda rezidencës papnore, gjatë papatit të Gjon Palit II. Në atë rast i treguan vaskën e banjës së papës në ar safi dhe të zbukuruar me simbole astrologjike dhe pa brenda dhomave të blinduara mijëra tekste të lashta ekzoterike, që ishin grabitur dhe grumbulluar në harkun e qindra vjetëve të diktaturës fetare dhe për të cilat, pra, ishte e ndaluar që të qarkullonin lirisht. Kisha Romake dhe Vëllazëria Babilonase janë një gjë e vetme.

Nimrodi ishte edhe Eanus, perëndia dyballësh, më pas i njohur për romakët si Xhiano. Njëri prej vëllezërve anunakë, Enki, "perëndia gjarpër", ishte i njohur si Ea. Shqiponja masone ka dy koka, e kthyer njëra nga e majta dhe tjetra nga e djathta, në lindje dhe në perëndim, paraqet Nimrodin në cilësinë e Eanusit dhe mendoj se shqiponja të shpie simbolikisht tek Dragoi me krahë. Sipas traditës Eanusi ruante çelësat e portave të qiellit dhe ishte i vetmi ndërmjetës midis Zotit dhe gjinisë njerëzore, gjë për të cilën çfarëdo besimi i pamiratuar prej tij ishte i rremë dhe si i tillë duhej të ndëshkohej. Ky e tregoi veten si një instrument i hatashëm në duart e klerit babilonas, që mundi kështu të diktojë vullnetin e vet mbi popullin, dhe po ky i njëjti mashtrim është përjetësuar nga pasardhësit e tij, priftërinjtë e krishterë, rabinët, kleri islamik, ai induist dhe të gjithë të tjerët. Titulli katolik i kardinalit rrjedh nga fjala "kardo" që do të thotë kardine (*menteshë*) dhe i referohet rolit të Nimrodit si roje i portës së parajsës[10]. Priftërinjtë babilonas themeluan deri edhe një organ institucional që e quajtën Koncili i Madh i Papëve, një emër që pastaj kaloi tek Kisha Katolike[11]. Prifti më i madh babilonas, që informonte një rreth të ngushtë anëtarësh, ishte i njohur si... Pjetër, që do të thoshte "Interpretuesi i Madh". Festa e krishterë e Shën Pjetrit kremtohej tradicionalisht në ditën kur Dielli hynte në shenjën zodiakale të Ujorit, tamam dita në të cilën i bëheshin nderime Eanusit dhe Xhianos[12]. Besimi babilonas, si të gjitha besimet e tjera që do të rrjedhin prej tij, artikulohej në dy nivele.

LIBRI

Masat manipuloheshin, me qëllim që të besonin tek besëtytnitë dhe t`i interpretonin në kuptimin e ngushtë historitë simbolike, ndërsa pak të zgjedhur kishin të drejtën të hynin tek e vërteta, të cilën megjithatë nuk mund ta zbulonin, përndryshe dënimi me vdekje. Në këtë mënyrë të vërtetat mbi jetën, mbi fuqinë njerëzore, mbi historinë dhe mbi planet e racës së zvarranikëve, ishin të ndaluara për popullsinë dhe të rezervuara vetëm për një pakicë.

Flijimi njerëzor ishte themelor në mjedisin e besimit babilonas dhe, kudo që është e përhapur Vëllazëria Babilonase e raca zvarranike, atje është i përhapur edhe flijimi njerëzor, pasi racat e zvarranikëve i kërkojnë këto praktika. Ata më të këqinjtë duket se kanë përftuar varësi prej gjakut dhe se ua kanë kaluar si trashëgim një varësi të tillë pasardhësve të tyre, siç do ta tregoj. Priftërinjve babilonas u kërkohej të hanin disa prej mblatimeve të flijuara dhe kështu fjala që do të thotë prift, Kahna Bal, bëhet termi që emërton atë që ushqehet me mish njeriu: kanibal[13]. Moloku, emri i hardhucës fluturuese mbi të cilën jam ndalur më përpara, ishte një tjetër emër i Nimrod-Tamuzit. Tam do të thotë të "djegësh". Për këtë arsye mund ta ndeshësh simbolizmin e Tamuz-Molokut tek ritet, në të cilat disa fëmijë digjen të gjallë për nder të kësaj hyjnie, rite që, diçka tmerruese, praktikohen edhe sot e kësaj dite. Riti i Beltanit i kremtuar menjëherë më pas në Britaninë e Madhe më 2 maj, festa e Ditës së Verës, parashikonte që ca fëmijë të digjeshin të gjallë në barkun e një figure të stërmadhe njerëzore e realizuar me thupra shelgu. Nga babilonezët kjo praktikë u përhap në krejt Evropën me shtrirjen e Vëllazërisë. Mund edhe të ketë ndodhur që zvarranikët të jenë vendosur në Mbretërinë e Bashkuar aktuale dhe në Irlandë, para se të zhvendosnin interesin e tyre drejt Lindjes së Afërt dhe Afrikës. Festa e Tamuzit binte më 23 qershor dhe kremtonte ngjitjen e tij nga ferri. Me t`u ringjallur, Tamuzi merrte emrin Oanes, perëndia peshk, dhe Oanes është një shqiptim i vjetër i emrit Gjon[14]. Për këtë arsye, Gjoni ka qenë përdorur si simbol i Tamuz-Nimrodit, duke u mishëruar në personazhe simbolike si Gjon Pagëzori. 23 qershori, festa e Tamuzit, bëhet një festim i krishterë i quajtur Vigjilja e shën Gjonit! Çifti Nimrod-Semiramidë është paraqitur me një pafundësi emrash në qytetërimet dhe në kulturat pasardhëse. Këto hyjni të përhapura nëpër botë, në dukje një mori e pafund me emra, nuk janë në realitet gjë tjetër veçse emërtime të ndryshme të po këtyre dy figura. Një tjetër hyjni, e cila rishfaqet tek ritualet satanike që parashikojnë akoma sot flijimin e fëmijëve, është Kronosi, mbreti i Ciklopëve të legjendës greke. Ai ishte gjithashtu i njohur si ndërtues kullash dhe bëhet fjalë gati me siguri për një tjetër version të Nimrodit, ndërtuesit të Kullës biblike të Babelit[15].

Këto raca të zvarranikëve rezultojnë të përfshira në ritualet e këtij tipi thjesht sepse i praktikojnë që nga zanafilla. Nëse ndiqni ngjarjet e tyre në harkun e historisë, do të vini re se ato kanë kremtuar gjithmonë të njëjtat rite dhe flijime për nder të të njëjtave hyjni dhe vazhdojnë ta bëjnë akoma sot. Një tjetër fragment i *Librit të Enoch*-ut ndalet mbi bashkimin (seksual) midis gardianëve dhe grave të racës njerëzore dhe mbi sjelljen e pasardhësve të tyre:

"Dhe ato mbetën shtatzëna dhe lindën ca gjigantë shumë të mëdhenj... që hëngrën të gjitha pasuritë e njerëzve. Dhe kur njerëzit nuk mundën t`i mbanin dot më, gjigantët u rebeluan kundër tyre dhe e përlanë gjininë njerëzore. Dhe filluan të mëkatonin kundër zogjve, dhe kundër kafshëve, dhe kundër zvarranikëve, dhe kundër peshqve, dhe të hanin njëri-tjetrin e të pinin gjak. Dhe Toka i denoncoi ata që s`njihnin ligj"[16].

Kjo copë flet për ato raca, mbi të cilat unë po ndalem në këtë libër dhe që u mblodhën bashkë tek Vëllazëria Babilonase, e cila qysh nga ajo kohë është shtrirë në të gjithë planetin. Teksa vështrojmë përreth dhe ndihemi pjesë e kësaj bote fizike, zvarranikët hedhin një vështrim në këtë përmasë të tretë, si dikush që vështron nga një dritare. Në këtë rast, nëpërmjet syve të trupit. Ne jemi në mënyrë të vetëdijshme në përmasën e tretë, ata janë në mënyrë të vetëdijshme në përmasën e katërt, por me vështrimin të drejtuar tek e treta. Nëse do të dini t'i kërkoni, do t'i dalloni nga sytë. I kanë të errët, depërtues dhe të ftohtë. Zvarranikët gjakpastër nuk janë të ngjitur pas trupit të tyre si qeniet njerëzore. E përdorin (*trupin*) në mënyrë të vetëdjishme si një "tutë hapësinore", për të vepruar në këtë botë dhe kur ai vjetrohet, thjesht zënë një tjetër. Pikërisht mbi këtë proces "zotërimi" nga ana e racave të zvarranikëve dhe të qenieve të tjera me dridhje të ulët bazohen tregimet e lashta, si edhe ato moderne, për demonë, djaj, dhe shpirtëra të së keqes, që bëhen zotër të një trupi dhe të një mendjeje njerëzore. Janë racat e zvarranikëve dhe ndërgjegje të tjera të nivelit më të ulët të përmasës së katërt, "dridhjet e gjirizeve", siç i quaj unë, ato që ndillen gjatë riteve satanike dhe gjatë ritit të magjisë së zezë, gjatë të cilave shumë "kukulla" të paditura "sintonizohen" me vetëdijen e zvarranikëve dhe zotërohen prej tyre. Kështu ndodhte në Babiloni, dhe kështu ndodh edhe sot. Sikurse kam zbuluar në librin tim *Unë jam vetvetja unë jam i lirë*, dhe siç do ta thelloj më tej në këtë libër, nivelet më të larta të Vëllazërisë janë të përfshira seriozisht në praktika si ritet satanike, flijime fëmijësh, pirje gjaku dhe poshtërsi të tjera, që do t'ju

bëjnë të mbeteni pa frymë. Po, jam duke folur për disa prej emrave më të spikatur të mjediseve mbretërore, politike, ekonomike, financiare dhe gazetareske në nivel botëror. Persona si Henri Kisingeri, Xhorxh Bushi, familja mbretërore britanike dhe shumë presidentë të tjerë, kryeministra dhe anëtarë të familjeve mbretërore. E pabesueshme? Sigurisht, por që nga ç'kohë e vërteta nuk tingëllon e pabesueshme në një botë si e jona, e bazuar mbi mohimin dhe zhgënjimin?

Tri prej elementeve kryesore të besimit babilonas ishin zjarri, gjarpëri dhe Diellí. Do të ndalem mbi rëndësinë e Diellit, pasi mendoj se është një aspekt themelor i çështjes. Pjesa më e madhe e popullsisë globale e nderonte Diellin për dhuntitë e tij të natyrshme, si nxehtësinë dhe dritën dhe për efektin që ai kishte mbi të korrat e mbi mirëqenien e njerëzve. Megjithatë, brenda hierarkisë së Vëllazërisë Babilonase dhe të grupeve të tjera të elitës, që kishin në zotërim dije të përparuara, kulti i Diellit paraqiste edhe motivime të mëtejshme. Ata e kuptuan natyrën e vërtetë të Diellit si vetëdije shumëpërmasore që shtrihet brenda sistemit diellor në nivele frekuence të pakapshme. Edhe në këtë përmasë fizike, shpërhapjet diellore me energji magnetike na ndikojnë në mënyrë të vazhdueshme, sekondë pas sekonde. Dielli ka një diametër me rreth 864.000 milje dhe përmban 99% të materies së Sistemit Diellor[17]. Është një rruzull i stërmadh energjie, që funksionon në mënyrë mjaft të ngjashme me një bombë atomike dhe temperatura e brendëshme e të cilit mund të arrij edhe 14 milionë gradë celsius[18]. Ai rrotullohet më shpejt në ekuator se në pole dhe aktiviteti e nxitja e fushës magnetike diellore është thjesht me përmasa kolosale. Autori dhe kërkuesi Mauric Kotereli ka realizuar një studim të gjatë dhe të hollësishëm mbi njollat diellore dhe mbi aktivitetin e shpërthimit diellor, gjë për të cilën Dielli lëshon energji magnetike tejet të fuqishme. Ky fenomen është fotografuar dhe duket si një sërë unazash gjigante zjarri, që arrijnë edhe 100.000 milje lartësi[19]. Kjo energji arrin Tokën e zhvendosur prej erës diellore dhe mund të ndërveprojë me sistemet informatike e të shkaktojë ca *blackout* energjie. Po të mos ishin Brezat e Van Alenit, zonat e rrezatimit që rrethojnë planetin dhe lidhen me fushën magnetike tokësore, energjia e Diellit do të na "tiganiste".

Mauric Kotereli ka studiuar ciklet e njollave diellore, duke përcaktuar cikle të shkurtra, të gjata dhe të mëdha të aktivitetit diellor, sikurse shpjegon në librin e tij të shkruar bashkë me Adrian G. Xhilbertin dhe të titulluar *The Mayan Prophecies*[20]. Kur kërkimi i Koterelit kishte mbërritur tashmë në një pikë të mirë, ai hasi në sistemin e mahnitshëm matematikor të numrave dhe të simboleve të lëna nga populli i lashtë i majave në Amerikën Qendrore.

Majatë mbronin idenë se rridhnin nga "perënditë" dhe njihnin një ishull të zhdukur si tokën e tyre të origjinës. Sistemet e tyre matematikore e astronomike çuditërisht të sakta dha matja e tyre e kohës, qenë trashëguar nga qytetërime të tjera shumë më të lashta dhe, sipas gjasës, jashtëtokësore. E kemi parë tashmë se si presidenti i Meksikës Miguel De La Madridi mbronte idenë se majatë ishin përzier me racat e zvarranikëve, "raca e iguanës", siç i quante ai.

Mauric Kotereli mbeti i dalldisur kur zbuloi se ciklet majá të evolucionit njerëzor përkonin qartë me cilket e tij të lëshimit magnetik të njollave diellore. Pavarësisht largësisë prej mijëra vjetësh, ishin pabesueshmërisht të afërt. Kjo është krejt e shpjegueshme, pasi gjithçka është energji. Jeta është ndërveprim fushash të dridhshme magnetike. Duke ndryshuar forcën magnetike, ndryshon edhe natyra e jetës mendore, emocionale, shpirtërore e fizike, secila prej të cilave është energji në formë të ndryshme. Planetët e tjerë bëjnë të njëjtën gjë teksa rrotullohen përreth Diellit dhe ndikojnë fushën magnetike të Tokës; disiplina që studion këto fenomene quhet astrologji. Sipas Koterelit ne rezultojmë të ndikuar më shumë nga këto fusha në çastin e ngjizjes se sa në atë të lindjes, një pikëpamje që duket krejt e bazuar. Unë mendoj sidoqoftë se *që të dy* këto çaste na ndikojnë thellësisht. Kërkimet e tij arrijnë në përfundimin se aktiviteti i njollave diellore përkon me ciklet e pjellshmërisë njerëzore dhe me ngjitjen dhe me rënien e qytetërimeve të mëdha e të perandorive. Shkencëtarët kanë zbuluar se qeniet njerëzore kanë një orë të brendshme, e cila është e sinkronizuar me Diellin. Me një fjalë, efekti i Diellit mbi jetën njerëzore është themelor dhe shkon përtej faktit të natyrshëm që përhap nxehtësi dhe dritë. Në lashtësi jashtëtokësorët ishin në dijeni të kësaj dhe ushqenin një frikë plot nderim kundrejt diellit. Ai është zemra fizike dhe shpirtërore e sistemit diellor dhe përfundoi për të simbolizuar krijuesin, në mënyrë të veçantë aspektin mashkullor të forcës krijuese... "Ai që është Drita e Botës". Ky koncept i Diellit do të përsëritet herë pas here gjatë gjithë këtij libri, dora-dorës që do të ripërshkojmë historinë gjer në ditët e sotme. Megjithatë, ai do ta bëjë edhe një çikë më të ndërlikuar interpretimin e historisë, pasi të lashtët e përdornin vazhdimisht Diellin dhe simbolizmin astrologjik në historitë e tyre dhe disa prej emrave të perëndive të tyre përdoreshin si simbole të Diellit dhe të planeteve. Të dallosh atë që ka një vlerë të mirëfilltë nga ajo që ka një vlerë simbolike është një gjë mjaft e ndërlikuar. Mendoj për më tepër se shprehja "Perëndia Diell" është përdorur për të emërtuar jashtëtokësorët dhe hibridët e tyre, që në tekstet e lashta thuhet se kishin fytyra që shndrisnin si Dielli, prej nga rrjedh emri që u atribuohej atyre "të Shndritshmit". Përfytyroni sa e thjeshtë do t'u ishte bërë

LIBRI 24

të vinit në zbatim planet tuaja dhe të manipulonit racën njerëzore sikur të njihnit ciklet e energjisë diellore e të planeteve të tjera dhe të dinit se si ndikojnë ato në vetëdijen njerëzore. Do të dinit se kur njerëzit janë më të prirur ndaj zemërimit, ndaj agresivitetit, ndaj frikës, ndaj dyshimit dhe ndaj ndjenjës së fajit, dhe për këtë arsye do të dinit se kur është më e përshtatshme për të hapur luftra, për të shkaktuar kolapse ekonomike e kështu me radhë. Vëllazëria i zotëron që nga zanafilla këto dije dhe sot i përdor me përfitim, siç do ta dokumentoj.

Vëllazëria Babilonase dhe grupet e saj të racës së zvarranikëve u shtrinë në të gjithë Lindjen dhe në Lindjen e Afërt, veçanërisht në Egjipt, dhe pastaj në Evropë e në Amerikat. Mendoj se qytetërimi i parë i Egjiptit, pas përmbytjes së shkaktuar nga Afërdita, ka qenë vepër e arianëve të Marsit, fenikasve, me ose pa mbështetjen e racave zvarranike të anunakëve. Por përpara vitit 2000 para Krishtit racat e zvarranikëve morën epërsinë. Oborri Mbretëror i Dragoit u themelua nga priftërinjtë e Mendesit rreth vitit 2200 para Krishtit dhe ekziston akoma edhe sot si Oborri Mbretëror dhe Perandorak i Sovranitetit të Dragoit. Autori Lorenc Gardneri është Kancelari aktual i Oborrit Perandorak të Sovranitetit të Dragoit dhe vendbanimi i tij në Devon, në Angli, gjendet në Kolomba Houz. Kolomba (*pëllumbesha*) mbretëresha Semiramidë. Sipas Gardnerit, emri Drakula do të thotë "bir i Drakulit" dhe qe frymëzuar nga princi Vlad III i Transilvani-Valakias, kancelar i Oborrit të Dragoit në shekullin XV. Brenda oborrit i ati i princit njihej si Drakul. Drakul = Drako. Kudo që shkoi, Vëllazëria Babilonase krijoi shkollat e saj misterike për ta shtyrë popullsinë, mendërisht të manipuluar, që të besonte tek budallallëqet dhe të hiqte dorë prej fuqive të saj përmes bestytnive dhe frikës. Në të njëjtën kohë, nivelet më të larta të këtyre strukturave piramidale ua përcillnin dijet e përparuara atyre që punonin për të vënë në zbatim planet e racës së zvarranikëve. Atje ku ekzistonin të tjera shkolla dijesh jo zvarranike, në to u futën tinëz priftërinjtë e Vëllazërisë, që morën pastaj epërsinë. Shkollat misterike ekzistojnë që prej dhjetëra mijëra vjetësh, sipas gjasës që prej qindra mijëra vjetësh, dhe përdoren për t`ua kaluar dijet më të përparuara atyre që, sipas niveleve të larta të Vëllazërisë dhe priftërinjve, e meritojnë. Në librin e tij *The Masters Of Wisdom*, J.G. Beneti mbron idenë se ka mësuar prej mistikut rus Gregori Gurdjef që shkollat misterike u takojnë 30.000-40.000 vjetëve më parë[21]. Gurdjefi nga ana e tij e kishte mësuar si përfundim këtë prej disa grafiteve në shpellat e maleve të Kaukazit dhe të Turkistanit (prapë ai rajon!). Më ndodh shpesh të dëgjoj ithtarët e organizatës së fshehtë amerikane Nju Age të indinjohen ndaj idesë se shkollat e lashta misterike hynin në planin e

manipulimit. Hëm, mbi të gjitha, nuk duhej të ekzistonte asnjë strukturë, cilido që të ishte qëllimi i saj, që t`i mohonte popullit dijen. Nuk më intereson se cili ishte qëllimi i tyre: cilido që e quan si të drejtën e vet të mohojë dijen dhe të vendosë se kush duhet apo nuk duhet të ketë të drejtën të hyjë në të, bën një lojë shumë të rrezikshme dhe arrogante. Me siguri disa kanë qenë shtyrë nga qëllime pozitive dhe dëshironin t`i përdornin shkollat misterike për të përhapur dijet midis njerëzve që, sipas gjykimit të tyre, do t`i kishin përdorur me mençuri dhe unë nuk dua të them se të gjitha ato institucione ishin të këqija, këtë jo. Por edhe brenda atyre pozitive më pas depërtuan tinëz shërbëtorët e racës së zvarranikëve. Siç ka shkruajtur Menli P. Hall, historiani i masonerisë:

"Ndonëse magjia e lashtë, e karakterizuar nga një tërësi ceremonialesh, nuk ishte domosdoshmërisht e keqe, nga një interpretim pervers i saj lindën mjaft shkolla të rreme të shtrigërisë ose magjisë së zezë... (Në Egjipt) magjistarët e Atlantidës vazhduan t`i ushtronin fuqitë e tyre të mbinatyrshme gjersa minuan dhe korruptuan plotësisht moralin e Mistereve primitive... ata uzurpuan vendin e zënë më parë nga antarët e shoqërisë së fshehtë, dhe zotëruan frerët e sundimit shpirtëror.

"Kështu magjia e zezë diktoi besimin e shtetit dhe paralizoi aktivitetet intelektuale e shpirtërore të individit, duke kërkuar prej tij pranimin e plotë e të pakushtëzuar të dogmës së formuluar nga kleri. Faraoni bëhet një kukull në duart e Këshillit të Purpurtë, një komitet me kryeshtriganë i ngritur në pushtet nga kleri"[22].

Shtriganët, që sipas Hallit vinin nga Atlantida, ishin, sipas gjykimit tim, hibridët njerëzoro-zvarranikë të asaj që unë e quaj Vëllazëri Babilonase. Rrjeti i tyre i shoqërive të fshehta është i përhapur sot në të gjithë rruzullin dhe vepron praktikisht në çdo vend. Ajo mbikëqyr dhe kujdeset për koordinimin e planeve në nivel ndërkombëtar dhe midis organizmave e sektorëve në dukje të ndarë si ato të politikës, të bankave, të tregtisë, të ushtrisë dhe të mediave. Dija nuk është në vetvete as e mirë, as e keqe, thjesht është. Është përdorimi, që ne i bëjme asaj, ai që është i mirë apo negativ. Në nivelet më të larta të kësaj organizate janë të njohura shumë gjëra, midis të cilave fuqia e vërtetë e Diellit, e magnetizmit dhe e mendjes; efekti i planetëve mbi sjelljen njerëzore; si të manipulosh kohën, vetëdijen, energjinë, meteorologjinë e shumë gjëra të tjera. Nëse i përdorni në mënyrë negative, këto dije mund të jenë jashtëzakonisht shkatërruese e mund të shpien në rrugë të keqe. Kjo është pikërisht ajo që ka ndodhur. Në të njëjtën kohë, racat e zvarranikëve i kanë

përdorur shoqëritë e tyre të fshehta për të krijuar institucione publike si besimet fetare dhe partitë politike, për të penguar që këto dije të përparuara të qarkullonin lirisht. Inkuizicioni ka qenë një shembull i mrekullueshëm i kësaj strategjie. Vetëm të flisje për çështje të mistershme, do të thoshte të nënshkruaje dënimin tënd me vdekje. Ky mashtrim ka qenë aq shumë i efektshëm, sa akoma sot gjeni të krishterë që i dënojnë doktrinat ekzoterike si "djallin", kur vetë ato nocione qëndrojnë në bazën e besimit të tyre. Nëse dëshironi me të vërtetë të dini se nga rrjedh krishtërimi, mos u largoni! Është paganizëm i ricikluar dhe për këtë ka prova. Megjithatë, krishtërimi është përdorur në mënyrë të shkëlqyer si mjeti më i efektshëm për të mbytur dijet themelore. Sa herë që krishtërimi dhe besimet e tjera kanë marrë kontrollin e një vendi apo të një rajoni, tekstet dhe dokumentet e lashta janë hequr ose shkatërruar. Kjo ka penguar përhapjen e atyre dijeve që racat e zvarranikëve kanë përdorur, dhe ende përdorin, për të manipuluar një popullsi të paditur. Ka ndodhur gjithmonë në emër të krishtërimit që pjesa më e madhe e shkrimeve mbi historinë e vërtetë të gjinisë njerëzore janë zhdukur, bashkë me vetëdijen e ndërhyrjes në çështjet njerëzore të racave jashtëtokësore, pozitive dhe negative. Kjo ka lejuar që të shkruhej një "histori" e sajuar alternative, e cila e ka larguar njerëzimin nga zanafillat e tij. Të kontrollosh historinë është shumë e rëndësishme sepse, nëse manipuloni mënyrën me të cilën njerëzit vlerësojnë atë që e quajmë të kaluar, do të ndikoni rëndë në mënyrën se si ai vlerëson të tashmen.

Temat mbi të cilat deri këtu kam tërhequr vëmendjen tuaj, bashkë me hyjni e simbole të ndryshme, do të na çojnë deri në kohërat moderne, dora-dorës që do të ndjekim shtrirjen e Vëllazërisë Babilonase në të gjithë botën. Në mënyrë të pandryshuar, gjakpastërit dhe hibridët zvarranikë babilonas kanë arritur, nëpërmjet manipulimit, pozitat më të fuqishme e më me ndikim në vendet ku janë vendosur. Ata zotërojnë një nivel dijesh shumë më të lartë se ajo që zotërojnë pjesa më e madhe e njerëzve dhe, në cilësinë e përçuesve të racave të zvarranikëve të përmasës së katërt, kanë pasur që më parë një plan me afat të gjatë për të cilin punonin, Veprën e Madhe të Kohërave, siç e quajtën masonët. Ata i lejuan popullsisë jo-zvarranike të zhvillonte punën dhe, pastaj, kur qenë themeluar shoqëri të reja, priftërinjtë dhe anëtarët e Vëllazërisë u bënë zotër të pozitave të pushtetit fetar dhe politik, duke u siguruar që çfarëdo dije e përparuar asokohe në qarkullim t'i hiqej zotërimit publik dhe të derdhej brenda shkollave të tyre misterike e shoqërive të fshehta. Raca e bardhë dhe hibridët ariano-zvarranikë kishin dalë, pas përmbytjes, nga malet e Kaukazit e nga ato të Iranit dhe të Kurdistanit, për t'u vendosur

në Egjipt, në Izrael/Palestinë dhe në tokat që sot quhen Jordani, Siri, Irak, Iran e Turqi, duke u shtyrë deri tek malet e Kaukazit (shiko ***Figura 7***). Është domethënëse dhe jo e rastësishme që të gjitha besimet më të mëdha të botës kanë lindur po në këtë rajon. Në kohërat e lashta qytetërimi sumer, ai babilonas dhe ai asir u shtrinë në zonën e Irakut aktual, ndërsa Turqia ishte e njohur dikur si Azia e Vogël dhe Persia. Rikard Lorenci, arqipeshkvi i Kashelit që përktheu nga etiopishtja botimin e parë anglisht të *Librit të Enoch*-ut, nxori si përfundim nga përshkrimi i ditës më të gjatë të vitit se autori i këtij *Libri* duhet të ketë jetuar në rajonin e Kaukazit dhe jo në Palestinë, siç besohej përgjithësisht[23]. Pikërisht prej këtej kanë dalë pjesa më e madhe e racave njerëzoro-zvarranike, dhe versioni zanafillor i *Librit të Enoch*-ut nuk ishte gjë tjetër veçse versioni më i vjetër i *Librit të Noes*, hibridit të racës së zvarranikëve. Raca ariane, gjatë shtrirjes së saj në territore të reja, bëhet e njohur me emra të ndryshëm, midis të cilëve më domethënësit janë ata të ititëve dhe të fenikasve. Mendoj se ka pasur patjetër ngulime të tjera ariane




Figura 7. Toka e perëndive të botës së lashtë, prej nga dolën racat ariane dhe ariano-zvarranike dhe që përfshin malet e Kaukazit, Sumerinë, Babilonin dhe Egjiptin. Kishte megjithatë të tjera popullsi të zhvilluara në pjesë të tjera të botës, jo vetëm këtu.

LIBRI

jashtë këtij rajoni, midis të cilëve ndoshta edhe në Britaninë e Madhe, dhe sigurisht që racat e zvarranikëve vepronin edhe në pjesë të tjera të botës, si në Amerikat. Por ky rajon malor përreth Kaukazit dhe gjatë fushave të Sumerisë e të Egjiptit merr një rol themelor për të kuptuar historinë e vërtetë të njerëzimit në shtatë mijë vjetët e fundit.

Malet e Kaukazit përmenden herë pas here në këtë studimin tim dhe nuk është një rastësi që në Amerikën e Veriut popullsia njihet si "kaukaze". Deri edhe sipas historisë zyrtare, një racë "ariane" e ardhur nga rajoni malor i Kaukazit u shpërngul në Luginën e Indosit, në Indi, në vitin 1550 para Krishtit dhe krijoi atë që sot është rajoni indu. Ka qenë po kjo racë ariane (ata vetë i kishin dhënë vetes emrin "Arya") që futi në Indi gjuhën e lashtë sanskrishte, së bashku me historitë e me mitet që përmbaheshin në librat e shenjtë indu, *Vedat*. L.A. Uadeli, në studimin e tij të jashtëzakonshëm mbi këtë racë ariane, ka zbuluar se i ati i të parit mbret arian të historisë së Indisë (i dokumentuar në eposin *Maha-Bharata* dhe në historinë indiane budiste) ka qenë mbreti i fundit i ititëve në Azinë e Vogël (*Turqi*)[24]. Arianët e indisë e nderonin Diellin si Perëndia-At Indra, dhe fenikasit-ititë e quanin Perëndinë-At Bel të tyre me emrin Indarra[25]. Me shumë emra të tjerë po kjo popullsi ariane u vendos edhe në Sumeri, në Babiloni, në Egjipt dhe në Azinë e Vogël (Turqia aktuale) e në vende të tjera të Lindjes së Afërt, duke sjellë me vete të njëjtat histori, mite e besime. Ja përse, siç do të shohim më vonë në mënyrë më të hollësishme, të gjitha besimet më të mëdha tregojnë të njëjtën histori, duke përdorur megjithatë emra të ndryshëm. Duke rrjedhur të gjitha nga i njëjti burim, nga kjo racë ariane, që duket se ka ardhur nga Marsi, dhe nga racat njerëzoro-zvarranike, që bashkëpunonin fshehurazi me të. Edhe ajo që e quajmë racë hebreje e ka pasur origjinën në rajonin e Kaukazit dhe jo, sikurse kërkon të mbrohet, në Izrael. Burime historike dhe antropologjike hebraike kanë dëshmuar se vetëm pak elementë të popullsisë së njohur me emrin hebrej kanë një lidhje gjenetike me Izraelin. Në shekullin VIII midis popullit të khazarëve, që jetonte në malet e Kaukazit dhe në Rusinë Jugore, pati një kthim në masë në fenë hebraike. Më pas, kur perandoria ra, po këto popullsi u shtrinë drejt veriut, për t'u vendosur në pjesë të tjera të Rusisë, të Lituanisë e të Estonisë. Prej këtej depërtuan në Evropën Perëndimore dhe, më pas, në Shtetet e Bashkuara. Familja e Rotshildëve rrjedh nga këto popullsi. Janë të njëjtit njerëz që poshtëruan pushtimin e Palestinës arabe pas luftës së fundit, duke thënë se "Zoti" u kishte dhënë atyre, në cilësinë e "popullit të zgjedhur", një të drejtë të lashtë mbi atë tokë. Në të vërtetë, toka e tyre e vërtetë e origjinës është rajoni i Kaukazit dhe i Rusisë Jugore, jo Izraeli.

Raca e bardhë u shtri drejt veriut, në Evropë. Populli i parë, i quajtur i fenikasve, e arriti nëpërmjet detit dhe, në harkun e shumë shekujve, të tjerë emigruan nëpërmjet tokës (shih ***Figura 8***). Dy prej këtyre të fundit qenë kimerët dhe shitët dhe, përmes shumë ndryshimesh emrash, po këto etni populluan krejt Evropën, duke iu bashkuar kolonëve të parë arianë të Britanisë së Madhe e të Evropës Veriore, që ishin ngulur aty nga lundruesit fenikas. Fenikasit marrin një rëndësi themelore në këtë histori dhe do të kthehem tek ata pas pak. Kimerët emigruan nga rajoni veriperëndimor i Kaukazit dhe i Azisë së Vogël (Turqisë) në vendet që sot i quajmë Belgjikë, Hollandë, Gjermani, Danimarkë. Historianët romakë Plini e Taçiti mbronin idenë se e gjithë popullsia gjatë bregdetit që shkon nga Hollanda në Danimarkë i përkiste të njëjtit grup etnik dhe kjo përcaktohet mbi të gjitha nga gjetjet arkeologjike, të cilat tregojnë se ky popull arriti në atë zonë midis viteve 300 dhe 250 para Krishtit. Një tjetër grup i kimerëve iu ngjit rrjedhës së Danubit përmes Hungarisë e Austrisë dhe arriti në Gjermaninë Jugore e në Francë. Romakët i quajtën Galë, ndërsa grekët i njihnin me emrin Keltoi ose Keltë. Grupe të këtyre fiseve kelte u ngulën edhe në Bohemi e në Bavari dhe të tjerë u dyndën në Italinë veriore. Tek Salusti, historiani romak, lexohet se romakët qenë mundur shumë herë nga kimbrët, që ai i identifikon më galët. Të tjerë historianë romakë mbrojnë idenë se kimbrët ishin keltë. Ata ishin ndarë në tri fise, belgët (Franca Verilindore), galët (Franca Qendrore) dhe akuitanët (Franca Jugore deri në Pirenej). Në shekullin e dytë përpara Krishtit galët/keltë (kimerët e bardhë të maleve të Kaukazit dhe të Lindjes së Mesme) zinin gjithë Evropën Qendrore e Italinë Veriore dhe po bëheshin gati për ta pushtuar krejt atë komb. Rreth vitit 280 para Krishtit u hodhën në Azinë e Vogël (Turqi) dhe ripushtuan tokat e paraardhësve të tyre. Siç ka thënë historiani, profesor Henri Raulinson: "Këto dy dyndje të mëdha në Azinë e Vogël (Turqi) u realizuan nga po e njëjta racë, që fillimisht mori emrin e kimerëve, më pas të galëve"[26]. Këta pushtues galë u ngulën në një vend të quajtur Frigji, që bëhet pastaj e njohur me emrin Galatia (Galia) dhe këtij populli mendohet që shën Pali i ka dërguar *Letrat drejtuar Galatëve* të Testamentit të Ri. Kimerët ose kimbrët u vendosën edhe në Uells (Galles) dhe akoma sot emri i këtij vendi në gjuhën galeze është Kimru (Cymru).

Edhe shitët, një tjetër grup arian, u shpërngulën nga Kaukazi drejt veriut, në Evropë, ku emri i tyre ndryshohet nga romakët, për t'i dalluar nga popullsitë e tjera. Midis simboleve të shenjta të shitëve figuronin gjarpëri, kau (Nimrod/Dem), zjarri (Dielli, dija) dhe Tho apo Theo, perëndia që egjiptianët e quanin Pan. Romakët i ripagëzuan shitët si sarmatë apo xhermanë nga fjala latine "germanus", që do të thotë "origjinal". Për këtë arsye shitët u




Figura 8. Ekspansioni i Arianëve dhe i racave zvarraniko-ariane drejt Europës dhe luginës së Indusë 3000 vjet para Krishtit.

bënë të njohur si "populli origjinal" dhe, natyrisht, nga "xhermanë" rrodhi fjala Gjermani. Ndryshimi i emrit vërtetohet nga shkrimet e historianëve romakë Plini dhe Straboni. Edhe anglosaksonët që u dyndën në Britaninë e Madhe ishin të njohur për romakët si xhermanë. Rajoni i quajtur Saksonia e Vjetër i përgjigjet sot Gjermanisë Veriore dhe Vendeve të Ulëta. Qoftë anglot qoftë saksonët rrjedhin nga i njëjti trung gjenetik, nga kimerët dhe nga shitët e bardhë të Kaukazit dhe të Lindjes së Mesme e të Afërt.

E njëjta gjë ka ndodhur me Uilliam Pushtuesin dhe normanët e tij, populli i fundit që u dynd në Britaninë e Madhe, më 1066, pas betejës së Hastingsit. Termat "norman" dhe "Normandia" rrjedhin nga njerëzit e Veriut që u nisën nga Skandinavia për të pushtuar atë rajon të Francës. Historia e heroit skandinav Odinit tregon se ky vinte nga Azalandi ose Azaheimi, që, pa shih njëherë, përkon me rajonin e Shicias dhe mund të identifikohet me Indinë ariane. Thuhet se prej aty, rreth viteve 200-300 para Krishtit, Odini ka udhëhequr një ushtri të madhe drejt veriut, në pushtimin e Suedisë. Kjo ushtri quhej Svear (Suear) dhe në suedisht "Suedi" thuhet ende Sverige, Toka e Svearit.

Një tjetër grup shitësh, që u bënë pastaj të njohur si sakë, që nga Kaukazi u drejtuan për në lindje, duke ndjekur gjurmët e arianëve paraardhës, dhe arritën kufijtë e Kinës rreth vitit 175 para Krishtit. Dokumentet kineze të

kohës bëjnë të ditur për ekzistencën e një populli të quajtur Sai-vang apo Sok-vang, që qe i detyruar të ikte në Indi. Sok-vang do të thotë "princa të sakëve". Duke qëndruar tek dokumentet e mbërritura, këta sakë u tërhoqën drejt jugut, në Indi, përmes qafave të maleve të Afganistanit, dhe disa monedha që i pëkasin jo më shumë se rreth 100 vjetëve para Krishtit, vërtetojnë themelimin e një mbretërie të sakëve në luginat e sipërme të Indos, midis Kashmirit dhe Afganistanit. Prapë edhe një herë nuk është rastësi që besimi budist të ketë lindur në toka të pushtuara nga sakët (shitët arianë). Të paktën rreth vitit 500 para Krishtit, një fis i quajtur Sakya jetonte në zonën në të cilën hamendësohet se ka lindur Buda rreth 63 vjet më parë. Guatmas (Budës Perëndi) iu dhanë epitetet Sakyashima, Sakamuni, Sakya i urtë, Sakya mjeshtri dhe luani i fisit Sakya. E gjitha kjo do të marrë një kuptim të veçantë kur do të kalojmë për të marrë në shqyrtim prejardhjen e vetme të të gjitha besimeve më të mëdha dhe të pjesës më të madhe të më të voglave, përveçse të "heronjve" të tyre.

Shitë/sakët dhe kimerë/kimbrët ishin në realitet të gjithë i njëjti popull dhe kjo është vërtetuar nga mbishkrimet e zbuluara në Gurin Behistuni, në malet e Zargos, gjatë një rruge të vjetër karvani e ardhur nga Babilonia. Mbishkrimet qenë urdhëruar nga Dari i Madh që të bëheshin rreth vitit 515 para Krishtit dhe qenë shkruar në tri gjuhë: babilonase, elamite dhe persiane. Atje ku versionet elamite e persiane citojnë fjalën "sakë", ato persiano/babilonase përdorin termin "kimerë".

Kështu këto popullsi ariane, të quajtura në mënyra të ndryshme, me të njëjtin besim fetar dhe me të njëjtët heronj fetarë, të cilëve u dhanë emra të ndryshëm, u zhvendosën nga tokat e tyre të origjinës në Kaukaz dhe në Lindjen e Mesme e të Afërt, duke u përhapur në Evropë, në Indi e duke arritur deri edhe në Kinë. Dhe brenda tyre ekzistonin racat njerëzoro-zvarranike që luftuan, me sukses, për marrjen e epërsisë dhe të kontrollit, në cilësinë e mbretërve, mbretëreshave, priftërinjve dhe udhëheqësve ushtarakë, që unë, me një emër të vetëm, e quaj Vëllazëria Babilonase. Që babilonasit ishin pjesë e racës ariane është e vërtetuar nga mbishkrimet e lashta dhe titujt. Titulli i Kasëve qe përdorur fillimisht nga fenikasit rreth vitit 3000 para Krishtit dhe qe përshtatur pastaj nga babilonasit, që qeverisën perandorinë mesopotamike. Kasë ishte edhe emri që u jepej fenikasve në Egjipt dhe nga Kasë rrjedh emri i dinastisë së mbretërve të njohur si Katë në Britaninë e Madhe para-romake, njëri prej të cilëve stampoi monedhën "Kas", ku paraqitej kali-diell dhe simbole të tjera diellore[27].

Një shtrirje e tillë ariane filloi në vitin e largët 3000 para Krishtit, ndoshta

edhe më parë, falë lundruesve fenikas. Ky i fundit ishte një popull teknologjikisht i përparuar, që ka qenë nënvleftësuar nga historia zyrtare, identitetin e vërtetë të të cilit e ka errësuar. Por nuk mund t'i lëmë mënjanë ata, nëse duam të kuptojmë se nga vijmë dhe ku ndodhemi aktualisht. Mijëra vjet më parë, në fakt, ata u shpërngulën në Evropë, në Skandinavi dhe në Amerikat, si fiset, ashtu edhe dijet e tyre. Për të mësuar më shumë mund të lexoni librin e L.A. Uadelit, *The Phoenician Origin Of Britons, Scots And Anglo-Saxons*. Uadeli ishte një profesor i Institutit Antropologjik Mbretëror dhe e kaloi të gjithë jetën duke shqyrtuar provat e tezave të tij. Ai tregon se si fenikasit nuk ishin një popull i racës semite, sikurse besohej dikur, por një racë ariane e bardhë. Përmes analizës së disa skeleteve fenikase u kuptua se ata qenë një racë ariane dolikoçefale, që i përkiste një etnie krejt të ndryshme në krahasim me atë semite. Fenikasit e botës së lashtë u nisën nëpërmjet detit që nga bazat e tyre në Azinë e Vogël (Turqi), në Siri, në Egjipt për t'u vendosur në disa ishuj të Mesdheut si Kreta dhe Qiprua, por edhe në Greqi e në Itali. Qenë fenikasit ata që sollën kulturën, e cila më pas lulëzoi në qytetërimet e Kretës minoike, të Greqisë klasike dhe të Italisë romake. Edhe kultura egjiptiane e kësaj periudhe i detyrohet në pjesën më të madhe atyre, para se ta zotëronin racat e zvarranikëve. Egjiptianët i njihnin fenikasit si Panag, Panaza e Fenkha: grekët i quanin Phoinik-as, ndërsa për romakët ata ishin Phoenic-es[28]. Egjiptianët, ashtu si mjaft qytetërime të tjera në të gjithë botën, i paraqisnin shumë prej perëndive të tyre me lëkurën të bardhë dhe me sytë të kaltër, dhe arsyeja e kësaj është shumë e thjeshtë. Raca e zhvilluar e fenikasve e kishte në fakt lëkurën të bardhë dhe shpesh sytë të kaltër – pikërisht si kryqëzimet njerëzoro-zvarranike dhe, me sa duket, si populli i Marsit. Prej tyre rrjedhin racat skandinave, që qenë ngulur në vendet ku banojnë sot nga fenikasit dhe nga popullsi të tjera të të njëjtit trung. Prej këtej rrjedh edhe koncepti absurd i "racës superiore" ariane, që u bë ide fikse e nazistëve dhe shoqërive të fshehta, prej të cilave ata lindën. Akoma sot perëndia mbrojtëse e shoqërisë së fshehtë të masonerisë është Hiram Abifi mitik, ndërtuesi legjendar i Tempullit të mbretit Solomon. Mendohet që Abifi ka qenë fenikas. Gjyshi i faraonit të famshëm egjiptian Akhenaten, i ati i Tutankhamenit, ka qenë një prift shumë i lartë fenikas. Feniksi, zogu mitik egjiptian, ishte në fakt zogu diellor i fenikasve, simboli i perëndisë Diell, Bil ose Bel, më pas i paraqitur në formën e palloit, ose të shqiponjës[29]. Në vitet e fundit kanë dalë në dritë prova të ekzistencës së piramidave në Mars, kur shkencëtarët e NASA-s Vinsent DiPietroja dhe Gregor Molinari, zbuluan gjashtë piramida shumë të mëdha, të ngjashme me ato egjiptiane, në rajonin e Marsit të quajtur

Cydonia[30] (Kidonia). Duket atëhere e arsyeshme të ngresh hipotezën se ka qenë po ajo racë marsiane që ka ndërtuar piramidat kur arriti në Tokë, dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për anunakët nëse, siç këmbëngul Zekaria Sitkini dhe sikurse unë jam i një mendjeje me të, ata kishin ngulime në Mars.

Fenikasit nuk qëndruan të kufizuar në Mesdhe e në Lindjen e Mesme. Rreth vitit 3000 para Krishtit ata u ankoruan në Britaninë e Madhe dhe produkte të qarta manifakture fenikase janë gjetur në Brazil, sikurse gjithashtu prova të mundshme egjiptiane janë gjetur në Kanionin e Madh në Amerikë. Fenikasit u ankoruan në Amerikat mijëra vjet përpara atij "trillimi" të krijuar në art, e bërë pastaj e njohur si "ekspedita" e Kristofor Kolombit. Arsyeja pse legjendat e vendasve amerikanë flasin për "perëndi të bardha" shtatlarta që arritën nga deti me ngarkesën e dijeve të tyre të përparuara qëndron në faktin se kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur, veç perëndive. Bëhej fjalë në fakt për racën ariane dhe për racën ariano-zvarranike, të cilat që nga Lindja u ankoruan në Amerikat mijëra vjet më parë, po ajo racë ariane apo "hyjnore" që, pas përmbytjes, i fali sumerëve, me pëlqimin e vetë atyre, dhuntinë e qytetërimit. Kjo është edhe arsyeja pse pushtuesit e bardhë, që më vonë morën pjesë në ekspeditën e Kolombit, mbetën të mahnitur kur vunë re se vendasit e kontinentit amerikan kishin të njëjtat besime fetare dhe të njëjtat mite me ta. Kjo duket sot plotësisht e shpjegueshme. Ata rridhnin në fakt nga i njëjti trung, nga raca ariane e njohur me emrin fenikas, përveçse me shumë të tjerë, ndërmjet të cilëve sumerë e ititë, dhe përmbanin brenda tyre raca ariano-zvarranike. Duket edhe që në kohëra të largëta të ketë ndodhur një pushtim i drejtpërdrejtë i Amerikave nga ana e racave të zvarranikëve. Provën e pranisë së një race të përparuar që dinte për ekzistencën e Amerikave na e japin disa harta gjeografike shekullore, si Harta Portolane e Haxhi Ahmetit, e përpiluar në vitin 1519, që e paraqet kontinentin amerikanoverior në mënyrë të tillë që një rrip i gjerë toke të lidhë Alaskën me Siberinë. Ka edhe një vizatim të hollësishëm të Antarktidës pa akuj.

Ardhja e fenikasve në Britaninë e Madhe përkon edhe me ndërtimin e rrathëve të mëdhenj prej guri dhe observatorëve si Stonehenge dhe Ejvbëri në Uiltshir, edhe pse sipas disa studiuesve ata do t'i përkisnin një periudhe shumë më të mëparshme. Populli i zhvilluar i fenikas-sumerëve, që kishte njohuri shumë të zhvilluara të astronomisë, të astrologjisë, të gjeometrisë së shenjtë, të matematikës dhe të rrjetit të vijave magnetike tokësore, e njohur si rrjetë e energjisë globale, zotëronte të gjitha dijet e nevojshme për të ndërtuar këto struktura madhështore. L.A. Uadeli ka thënë se ka gjetur mbishkrime sumerike mbi njërin prej gurëve të Stonehengenit[31]. Aleksandër Tomi, profesor

i shquar i shkencave të ndërtimeve në Universitetin e Oksfordit nga viti 1945 deri në vitin 1961, zbuloi se të lashtët që ndërtuan Stonehengenin ishin në dijeni të parimeve matematike e gjeometrike "pitagoriane" mijëra vjet përpara lindjes së Pitagorës. Në librin e tij të vitit 1967, *Megalithic Sites In Britain* (Vende megalitike në Britaninë e Madhe), Tomi ka shpjeguar se gurët jo vetëm formonin figura gjeometrike brenda dhe përreth rrethit, por rezultonin edhe të orientuar me elementet e mjedisit rrethues dhe me pozicionet e Diellit, të Hënës e të yjeve të rëndësishme në momente të veçanta, sidomos kur Dielli dukej dhe zhdukej gjatë ekuinoksit ose solsticit dhe Hëna zinte pozicionin e skajshëm të ciklit të saj. Ai vend ishte një farë ore astronomike gjigante, ka thënë. Por është diçka më shumë. Është një marrës dhe një transmetues energjie. Rrjeta (ose rrjetat) magnetike tokësore përbëhet prej vijash energjie magnetike, meridianë ose, për kinezët, vijat e dragoit. Kur këto vija kryqëzohen, energjia mbështillet në një vorbull dhe, atje ku shumë vija kryqëzohen, do të keni një shtjellë shumë të madhe energjie. Ato janë vendet e ngarkuar me energji, vendet e shenjta për të lashtët, që ishin në dijeni të këtij sistemi. Shtjella, ose spiralja, është një konstante në të gjithë universin. Galaksia jonë është një spirale, uji zbret poshtë me një lëvizje formëspirale, mbi dredhën e çaçkës së kokës flokët rriten në formë spirale, molekula e ADN-së, që përmban pasurinë tonë gjenetike, është një spirale e dyfishtë. Brian Desborougu, miku im shkencëtar prej Kalifornie, më ka thënë se ekziston një pikë mbi rrjetat tokësore, dhe saktësisht mbi atë të quajtur pika e Hartmanit, ku dymbëdhjetë prej këtyre vijave të energjisë kryqëzohen dhe depërtojnë në brendësi të Tokës. "Por ku ishte ky vend?", e pyeta. "Është një vend i quajtur Ejvbëri, në Angli", m'u përgjigj. Dhe është pikërisht ai vend që, të paktën pesë mijë vjet më parë, populli i përparuar i fenikas-sumerëve zgjodhi për të ndërtuar rrathët e tij prej guri, bashkë me një sërë vendesh pranë, përfshirë Silburi Hillin, kodra më e madhe e realizuar nga njeriu në Evropë, dhe të tjerë si Uest Kenet Long Barrou. Ata formojnë një farë "kuadri qarqesh" në zemër të rrjetës energjitike që ndikon në mënyrë vendimtare mbi natyrën e fushës magnetike tokësore. Kam jetuar pranë Ejvbërit për dy vjet dhe mund t'ju them se bëhet fjalë për një vend pabesueshmërisht të "ngarkuar" me energji për atë që është i ndjeshëm ndaj saj. Është edhe zona ku janë gjetur pjesa më e madhe e "rrathëve apo figurave të vizatuara në tokë", disa prej të cilave ndërmjet më të ndërlikuarave.

Edhe më interesante është lidhja e dukshme midis Ejvbërit dhe Marsit. Studiuesi më i famshëm i strukturës që duket se është realizuar nga njeriu dhe që merr emrin "Fytyra e Marsit" dhe e një zone të atij planeti e njohur si

Kidonia (Cydonia), është amerikani Rikard C. Hoiglandi. Ai ka punuar si gazetar shkencor, si drejtor i revistave planetare të Uest Hartfordit dhe të Nju Jorkut, dhe si konsulent në *Goddard Space Flight Center* të NASA-s. Në librin e tij *Monuments On Mars*[32], ai dëshmon se e supozuara "fytyrë" dhe piramidat janë pjesë e nje zone të gjerë me ndërtime të vendosura në mënyrë të tillë që të jetë të orientuara me agimin e solsticit veror të Marsit të 500.000 vjetëve më parë – deri 50.000 vjet përpara mbërritjes së supozuar në Tokë të anunakëve. Jam gati i sigurtë se i njëjti popull që ndërtoi strukturat e Kidonias (Cydonia), përfshirë piramidat, ka ndërtuar edhe Stonehengenin dhe Ajvbërin. Ekzistojnë prova, në fakt, që Ajvbëri mund të përfaqësojë një imazh të pasqyruar të kompleksit të Kidonias (Cydonia). Nëse merrni harta të të dy vendeve me të njëjtën shkallë dhe i mbivendosni njërën mbi tjetrën, bashkëlidhja e pjesëve dhe largësitë që i ndajnë do të rezultojnë pabesueshmërisht të ngjashme, sikurse kanë treguar disa bashkëpunëtorë të Hoiglandit. Ky i fundit zbuloi edhe se ky "qytet" i Marsit ka qenë ndërtuar sipas të njëjtave ligje të ndjekura për të ndërtuar komplekse të ngjashme në Tokë. Të njëjtat rregulla matematike, të njëjtat orientime dhe të njëjtat elemente të gjeometrisë së shenjtë mund të gjenden në Kidonia (Cydonia), në Mars, dhe në komplekset arkitektonike madhështore të botës së lashtë, si ato të Stonehengenit, piramidat e Gizës në Egjipt, të Teotihuakanit në Meksikë dhe të tjera në Zimbabve. Këto parime matematike frymëzohen nga gjeometria e "të mesmes së artë", siç është paraqitur nga artisti italian Leonardo da Vinçi (1452-1519) në vizatimin e njeriut brenda rrethit (shih ***Figura 9***). Leonardoja, siç do ta shikojmë, ishte një anëtar i shquar i shoqërive të ndryshme të fshehta dhe është kjo arsyeja pse qe në gjendje, në harkun e shekullit XV dhe të shekullit XVI, të shëmbëllente ardhjen e telefonit, të projektonte makina fluturuese, tanke e biçikleta, që nuk ndryshojnë shumë nga modelet moderne.

Një tjetër konstante është gjerësia e 19,5 gradëve. Në këtë gjerësi janë ndërtuar në fakt piramidat dhe shumë komplekse të lashta tempujsh e ndërtesash të tjera të shenjta. Në të njëjtën gjerësi do të gjeni edhe vullkanet e ishujve Havai, vullkanet Shild në Aferditë, vullkanin madhështor Mons Olympus në Mars, njollën e zezë të Nepturnit, njollën e kuqe të Jupiterit dhe zonën kryesore të aktivitetit të njollave diellore, në pjesën veriore e jugore të Diellit[33]. E gjitha kjo shkon përbukuri, pasi njollat diellore janë lëshim i fuqishëm energjie diellore elektromagnetike dhe vullkanet janë natyrisht lëshim energjie nga ana e planeteve. Nuk çudit pra fakti që gjerësia 19,5 gradë të jetë pika e shkëmbimit energjitik midis sferave rrotulluese dhe, klasat sunduese të popujve të lashtë, ishin plotësisht në dijeni për këtë. Sumerët,

LIBRI

për shembull, ishin në dijeni të ciklit të quajtur preçesion: është fjala për veprimin e luhatjes së Tokës, që e lëviz mengadalë planetin mbi boshtin e tij në mënyrë që ai (*planeti Tokë*), në harkun e mijëvjeçarëve, të orientohet drejt sistemeve të ndryshme yjore, apo shenjave astrologjike. Sikurse dëshmojnë dokumente të lashta, sumerët e dinin që Tokës i duheshin 2.160 vjet për t'u zhvendosur nga një "shenjë" në tjetrën dhe 25.920 vjet për të plotësuar ciklin – e njëjta periudhë kohe që i duhet sistemit diellor për të plotësuar përshkimin e vet përreth qendrës së tij galaktike. Sot jemi duke plotësuar njërin prej këtyre cikleve, dhe kjo shpjegon ndryshimin e madh që është duke u kryer. Parimet gjeometrike dhe astronomike, mbi bazën e të cilave janë ndërtuar shumë tempuj të lashtë në të gjithë botën, reflektojnë këtë cikël preçesioni. A nuk është e mahnitshme se çfarë ishin në gjendje të bënin popullsitë "primitive"? Elita e fenikas-arianëve zotëronte dije të pakufishme në lidhje me rrjetën energjitike tokësore dhe për fuqinë e saj për të ndikuar mbi personalitetin njerëzor. Tek e fundit, ne jetojmë brenda fushës magnetike tokësore. Kur kjo ndryshon, ndryshojmë edhe ne. Nëse jetoni në ujë dhe ujët ndryshon, kjo do të ketë një efekt edhe mbi ju, dhe e njëjta gjë ndodh edhe me "oqeanin" energjitik në të cilin jemi të zhytur. Prandaj, lëvizja e planeteve ndikon mbi fushën magnetike tokësore dhe, përmes saj, ndikon mbi ne. Vëllazëria nuk dëshiron që ne t'i zbulojmë këto gjëra dhe kështu ka përdorur ca besime, si krishtërimin, për ta dënuar astrologjinë si vepër e djallit, dhe njëfarë "shkence", për ta hequr qafe atë (*astrologjinë*) si një tërësi besimesh qesharake.

Rrathët "misteriozë" prej guri rezultojnë mjaft më pak misteriozë nëse i analizojmë me mendje të zbrazur prej paragjykimeve. Provat duket se sugjerojnë që ata janë ndërtuar nga fenikas-arianët, të cilët erdhën këtu nga Lindja e Mesme dhe e Afërt. E njëjta gjë vlen për misterin e figurave në formë kali të gdhendura në faqet e kodrave prej gipsi të Britanisë së Madhe. Pikërisht para se të shkruaja këtë kapitull, shkova të shikoja kalin e bardhë më të vjetër dhe më të famshëm anglez, në Ufington, në zonën e Uiltshirit, jo larg nga Ejvbëri (shiko pjesën e ilustrimeve). Tabela thotë se ai i përket afërsisht vitit 3000 para Krishtit, saktësisht epokës kur fenikasit u ankoruan në ishujt britanikë. Por përse u ishte dashur fenikasve të gdhendnin kuaj të bardhë mbi shpatet e kodrave britanike? Edhe këtë herë përgjigjja është e thjeshtë. Besimi i tyre bazohej tek Dielli dhe kali i bardhë ishte një simbol fenikas i Diellit. Rrathët e mëdhenj dhe komplekset prej guri të shpërndarë në të gjithë Britaninë e Madhe, si Stonehengeni dhe Ejvbëri, kanë qenë ndërtuar mbi bazën e dijeve që zotëroheshin prej qeveritarëve dhe priftërinjve fenikas e të Vëllazërisë Babilonase, që u futën tinëz brenda klasës udhëheqëse ariane dhe




Figura 9. Paraqitja leonardiane e Njeriut sipas gjeometrisë së shenjtë të "së mesmes së artë".

morën kontrollin e saj. Midis këtyre dijeve figuronin aftësia për të përdorur tingullin dhe të tjera teknika për të lëshuar një fushë magnetike përreth një guri të madh, duke ia shmangur kështu ligjeve të gravitetit. Në këtë mënyrë ai humbiste peshën e vet. Kjo epokë rreth vitit 3000 para Krishtit është shumë e rëndësishme. Në ato vite fenikasit ishin me punë në Britaninë e Madhe dhe gjetiu, por edhe piramidat egjiptiane të Gizës janë të datuara rreth vitit 3000 para Krishtit, falë metodave më të fundit të datimit me karbon. Për ta bërë të mundur përdorimin e këtyre metodave duket se kanë shërbyer gjurmët e karbonit të gjetura brenda llaçit të përdorur në ato ndërtime[34].

Arianët e Lindjes së Mesme e të Largët kanë qenë quajtur me shumë emra, midis të cilëve ititë, fenikas, gotë e kështu me radhë. Në rrethin e këtyre kulturave në dukje të largëta me njëra-tjetrën, do të gjeni emra e terma që

IIPBI

kanë një zanafillë të përbashkët. Disa rrathë gurësh quhen "gurë-Hare", një fjalë që, sipas kërkimeve të L.A. Uadelit, rrjedh nga Harri ose Heria, titulli që u jepej krerëve të gotëve, dhe nga titulli itit Harri, Arri ose Aryan: gurët Hare janë pra gurë arianë. Në të njëjtën mënyrë "Hari-Krishna" bëhet "Aryan-Krishna", dhe jo rastësisht, duke parë që besimi indu është vepër e arianëve. Edhe afër Kesuikut (Keswick), në Kamberlend, do të gjeni një rreth gurësh, i quajtur Kastëllrig. Fjala "rig" tregonte një titull fisnik që i jepej mbretit dhe princave gotë, dhe gotishtja kishte rrjedhur nga arianët. Mbretërit arianë që paraqiten në figurat e lashta në Kiliki (në Azinë e Vogël, ose Turqi) mbajnë veshjen tipike të gotëve. Vetë toponimi Keswick (Kesuik) do të thotë "banesa e Kesit" - fisi itit i kasëve apo katëve - dhe kontea e Kambërlendit, që ka origjinë sumere, ka marrë në harkun e shekujve emra të ndryshëm, midis të cilëve Cymry (Kimri) dhe Cumbers (Kambërs). Termi "arian" rrjedh nga një fjalë fenikase, Arri, që do të thotë "fisniku". Prej këtej rrjedhin termat "Sum-ARIAN" (sumer) dhe "aristokraci" ose "ARIANO-stokracia". Gjatë shekujve, luani ka marrë gjithmonë një kuptim domethënës simbolik, duke qenë i lidhur me kultin arian të Diellit dhe, si i tillë, vendosej shpesh në hyrje të tempujve dhe të vendeve të shenjta. Prej këtej rrjedh Sfinge (*Sfinksi*) me trup luani që të sjell në mendje edhe shenjën e Luanit, që, nga një pikëpamje astrologjike, rezulton i mbizotëruar nga Dielli. Themelet e kulturës dhe të legjendave "britanike" gjenden në qytetërimin fenikas. Legjenda e famshme e shën Gjergjit dhe dragoit rrjedh nga Shën Gjergji i Kapadokias, një qendër fenikase në Azinë e Vogël (Turqi). Luftërat ndërmjet shën Gjergjit dhe dragoit mund të jenë një paraqitje simbolike të konflikteve marsiano-zvarranike, që u përkasin shumë kohëve më parë. Kryqi i kuq i Shën Gjergjit (Angli), kryqi i Shën Andreas (Skoci) dhe ai i Shën Patrikut në Irlandë, ashtu sikurse edhe simbolet e Skandinavisë, ekspozoheshin të gjitha nga fenikasit si flamuj të shenjtë fitoreje. Kryqi i kuq ishte kryq zjarri, një simbol fenikas-arian i Diellit, sikurse edhe kryqi i thyer, i përdorur më pas nga nazistët. Një kryq i thyer është i dukshëm edhe mbi një gur kushtuar perëndisë-Diell fenikase Bel, i gjetur në Kraig-Narget në Skoci dhe i njëjti simbol ka qenë përdorur edhe për të zbukuruar veshjet e një priftëreshe të lartë (shih ***Figura 10 dhe 11***). Kam lexuar se fjala "svastica" (*kryq i thyer*) rrjedh nga fjala sanskrishte "svasti", që do të thotë "të jesh mirë" dhe ai (*kryqi i thyer*) ka qenë konsideruar një simbol pozitiv, gjersa nazistët ia shtrembëruan kuptimin, duke e shndërruar në një simbol shkatërrimi.

LIBRI 24




Figura 10. Kryqi i thyer, simbol i diellit fenikas, mbi gurin fenikas të Kraig-Nargetit, në Skoci dhe, në **Figurën 11,** në veshjen e një priftëreshe të lartë fenikase.




Figura 12. Paraqitja fenikase e Baratisë (në të djathtë) dhe simboli anglez i Britanisë. Bëhet fjalë për të njëjtën hyjni dhe për një version alternativ të mbretëreshës babilonase Semiramidë e të mbretëreshës egjiptiane Isidë.

L.A. Uadeli zbuloi se mbishkrimet e pranishme mbi një gur tjetër në Skoci, mbi gurin Njuton në rajonin e Damfrisit dhe Gallouejit, ishin në gjuhën fenikase-itite dhe i ishin kushtuar perëndisë Diell të atyre popujve, Bel ose Bil. Simboli klasik i Britanisë rrjedh nga perëndesha fenikase Baratia. ***Figura 12*** do t'ju tregojë se si fenikasit e paraqisnin simbolikisht Baratinë dhe se si britanët paraqesin Britaninë.

Njëra prej qendrave kryesore të fenikasve ariano-itité ishte Kilikia, në Azinë e Vogël (Turqi) dhe këtu Baratia nderohej si Paretea e, më pas, si Diana. Kështu që Diana dhe Britania rrjedhin nga një burim i përbashkët. Baratia

ishte mbretëresha/perëndi e fenikasve, ndërsa Barati ishte perëndia/mbret. Bëhet fjalë sipas gjasës për dy emra të tjerë që u janë dhënë hyjnive Nimrod dhe Semiramidë. Fisi "mbretëror" i arianëve quhej Baratët dhe është kjo arsyeja pse në kulturën e lashtë indiane gjendet termi Barat ose Brihat, ashtu sikurse edhe tek termat "Britain" e "British" (Barat-ain e Barat-ish). *Vedat* indiane pohojnë se "mbreti Barat i dha emrin e tij dinastisë, themelues i së cilës ishte; dhe ndodhi pra që duke nisur prej tij fama e asaj dinastie u përhap aq shumë"[35]. Parat, Prat e Prydi janë disa prej emrave të tjerë që rrjedhin nga Barat. Shqiptimi zanafillor ishte Barat-ana ose Brithad-ana[36]. Prapashtesa "ana" në gjuhën itito-sumere (ariane) do të thotë "një". "Ana" është transformuar në fakt në fjalën angleze "One" (*Një*) dhe në gjuhën skoceze "ane". Barat-ana ose Briton (britanik) kanë pra kuptimin "një prej Baratëve" (Bruit). E njëjta gjë ndodh në shumë vende të tjera të pushtuar nga raca e bardhë. Emri Iran rrjedh nga emri i lashtë "Airy-Ana" ose "Air-an", që do të thotë Toka e Arrayve ose e Arianëve[37].

Edhe *Vedat* indiane flasin për perëndeshën Barati (që u përket baratëve), e njohur si "Brihad Hyjnorja". Ato bëjnë të ditur se banesa e saj ishte në lumin Saras-vati që përkon me lumin e ditëve të sotme Sarus në rajonin fenikas-itit të Kilikisë. Lumi derdhej në det në Tarso, që Testamenti i Ri, një vepër e shkruar mbi bazën e miteve diellore ariane, e tregon si qytetin e mundshëm të lindjes së shën Palit. Për më tepër, fenikasit dhe arianët nderonin gjarpërin, ndërsa zvarranikët shumëformësh të quajtur Nagas nderoheshin nga indutë. *Vedat*, të ideuara nga arianët, tregojnë se si njerëzit-gjarpërinj, nagasët, mundën të shkaktonin dëme të pabesueshme dhe vdekje në çast. Thuhet se nagasët janë shfaqur edhe në lindjen e atij që u bë i njohur si Buda dhe gjarpëri ka një rol të rëndësishëm në legjendën e Krishnës. Emri romak për Baratinë ishte Fortuna (*Fat*), mbi bazën e famës së saj si perëndeshë e fatit. Romakët e paraqisnin simbolikisht Fortunën në të njëjtën mënyrë me të cilën fenikasit paraqisnin Baratinë dhe britanët Britaninë. Që të tria këto hyjni i shoqëroheshin ujit, siç është normale për një popull lundërtarësh si fenikasit. Edhe egjiptianët kishin një perëndeshë të quajtur Nashita, perëndesha e ujërave dhe, edhe ajo ishte një tjetër version i Baratisë, pasi prapa qytetërimit egjiptian qëndronin fenikas-arianët. Rreth vitit 680 para Krishtit, Nashita ishte përshkruar nga një perandor babilonas si "një hyjni fenikase e përtejdetit"[38]. Në Kretë, një tjetër qytetërim fenikas, që mori emrin "minoik", nderonte perëndeshën Brito-Martis. Sipas traditës greke dhe romake bëhej fjalë për një perëndeshë fenikase (me fjalë të tjera, Baratia) dhe për të bijën hyjnore të Feniksit, mbretit të Fenikisë. Brito-Martisi u identifikua pastaj me perëndeshën Diana, një hyjni e rëndësishme e botës së lashtë, dhe se si kjo qe

armatosur për gjah. Konti Spenser ka nënvizuar gjatë fjalës së tij të mbajtur në ceremoninë mortore të së motrës, Dianës, se ajo qe pagëzuar me emrin e perëndëshës së gjahut.

Mbretërit e parë britanë zgjodhën për veten e tyre dhe për racën e tyre emrin "Catti" (Katët) dhe ky është emri që shfaqet mbi monedhat e tyre. Ititë-arianët e Azisë së Vogël (Turqi) dhe të Siri-Fenikisë quheshin Catti ose Khatti. Raca e arianëve, që la Kaukazin për t'u bërë klasa sunduese e Indisë ishte e njohur me emrin Khatiyo. Termi "katët", përmes përkthimeve hebraishte dhe angleze, u transformua në "ititë", siç shfaqet tek Testamenti i Vjetër. Kasët ishe titulli i përshtatur nga dinastia e parë fenikase rreth vitit 3000 para Krishtit dhe nga ajo babilonase. Dhe kjo nuk çudit, sepse bëhet fjalë për fise të ndryshme të të njëjtit popull. Listat e lashta të mbretërve të eposit indian përmendin disa prej po të njëjtëve persona të cituar nga listat e mbretërve mesopotamë dhe edhe kolonizatorët e periudhës paraprirëse të dinastive të Egjiptit të lashtë rezultojnë se i përkasin racës ariane. Nuk ka asnjë dyshim të faktit se ndodhemi këtu përballë të njëjtit popull, dhe se brenda kësaj race gjejmë fiset ariano-zvarranike që, gjatë kalimit të shekujve, kanë forcuar në mënyrë progresive pushtetin e tyre. Siç nënvizon L.A. Uadeli, anglishtja, skocishtja, irlandishtja, galishtja, uellsjania, gotishtja e gjuhët anglosaksone dhe shkrimi i tyre, bashkë me krejt familjen e gjuhëve ariane, rrjedhin nga gjuha fenikase-ariane, nëpërmjet ititishtes dhe sumerishtes. Rreth gjysma e fjalëve më të përdorshme të së ashtuquajturës gjuhë angleze janë me origjinë sumere, qipriote ose itite dhe paraqesin të njëjtin tingëllim dhe të njëjtin kuptim të atyre nga të cilat rrjedhin. Sumerishtja, gjuha e "perëndive", është gjuha nënë e pjesës më të madhe të gjuhëve të botës, edhe pse, unë mendoj se ajo ka lindur në një tjetër vend dhe në një periudhë historke mjaft më të mëparshme, ndoshta në Atlantidë, ose në zonën që sot përkon me Britaninë e Madhe. Ky është edhe mendimi i Uadelit:

"Kisha vënë re se mbishkrimet e ndryshme të lashta të gjetura në përkim, apo në afërsi, të ngulimeve të lashta fenikase dhe runat (shkrime me alfabetin e lashtë të popujve nordikë) (e gjetura) *qipriote, aramaike ose siriane, likiase, lidiase, korinthiote, jonike, kretase ose "minoike", pellazgjike, frigjiase, kilikiase, tebane, libike, kelto-iberike, gotike dhe të Kapadokias etj., ishin të gjitha variacione vendase të shkrimit standard itito-sumero-arian të lundërtarëve fenikas arianë, të atyre pionerëve të lashtë që përhapën qytetërimin itit gjatë brigjeve mesdhetare dhe përtej Shtyllave të Herakliut* (dy kepet e ngushticës së Gjibraltarit, ku sipas legjendës ndaloi Herakliu), *deri në ishujt britanikë"*[39].

LIBRA

Historia zyrtare do të dëshironte të na bënte t'i besonim teorisë, sipas së cilës, popullsia e Britanisë së Madhe përbëhej nga njerëz të egër, që u "qytetëruan" vetëm pas ardhjes së romakëve. Kjo nuk është e vërtetë dhe, madje, vetë romakët kanë deklaruar të kundërtën. Dokumente romake zbulojnë se britanët ishin në tërësi të qytetëruar dhe traditat e tyre ishin të ngjashme me ato të galëve. Dhe kjo është sigurisht e vërtetë, duke qenë se bëhej fjalë për të njëjtin popull, me të njëjtat origjina. Britanët përdornin monedha ari dhe shkëmbime tregtare zhvilloheshin midis kontinetit aziatik e atij evropian, siç vërtetojnë monedhat britanike të kohës. Qenë vetëm popullsitë në brendësi të Britanisë së Madhe, ende të pandikuara nga kultura fenikase që ishte më e përhapur gjatë brigjeve, ato që romakët i kanë quajtur të paqytetëruara në kohën e ardhjes së tyre. Shumë rrugë të quajtura "romake" nuk qenë ndërtuar aspak prej romakëve. Ishin rrugë para-romake, që ata u kufizuan për t'i ndrequr. Romakët admiruan aftësinë e ushtrive britane, në mënyrë të veçantë përdorimin e tyre të karrove të luftës. Në këtë pikë nuk do t'ju befasojë të mësoni se këto karro të famshme "britane" ishin të njëjta me ato të përdorura nga itit ët ose katët, siç janë të përshkruara nga faraoni egjiptian Ramseti II rreth vitit 1295 para Krishtit, gjatë betejës së Kadeshit, një port itito-fenikas. Rreth vitit 350 para Krishtit, tre shekuj para ardhjes së romakëve, eksploratori dhe shkencëtari Pytheas, lundroi rreth brigjeve britanike dhe përpiloi një hartë gjeografike të atyre tokave të pajisur me gjerësi. Pytheasi ishte i lindur në Fokë (Phocca) të Azisë së Vogël (Turqi), dhe toponimi Fokë (Phocca) rrjedh nga emri "Feniki", si edhe një port aty pranë i quajtur Feniks (Phoenice)[40]. Në atë epokë fenikasit kishin organizuar ndërkohë tregtinë e kallajit, të nxjerrë nga minierat e Kornovaljes, në perëndim të Anglisë, drejt Gali/Francës, deri në Marsejë, prej nga ngarkohej nëpër anije drejt vendeve të Mesdheut dhe të Egjeut. Porti i parë i kallajit në Kornovalje ka qenë Iktisi ose Shën Mikel Monti në Gjirin e Penzancit. Shën Mikeli, njëri prej heronjve të mëdhenj të krishtërimit, ishte në realitet një hyjni fenikase.

Ekzistojnë prova të ndryshme që vërtetojnë lidhjen e lashtë midis Ishujve Britanikë e Irlandës dhe kulturës së Afrikës së Veriut e të Lindjes së Afërt. Thuhet se, nëse dëshiron të hedhësh dritë mbi korrupsionin, mjafton të ndjekësh paranë. Hëm, nëse dëshirohet të identifikohen shtegëtimet e popujve dhe të kulturave, mjafton të ndjekësh gjuhën e tyre. Sot në Irlandë flitet gjuha angleze, që ka zëvendësuar gaelishten, dhe, vetë gaelishtja, rrjedh nga një gjuhë e mëparshme sot e zhdukur. Misionarëve që flisnin gaelisht gjatë Mesjetës u duhej të përdornin përkthyes, për të komunikuar me pitët, banorët

e lashtë të Skocisë aktuale dhe, Kormaku, një mbret irlandez i shekullit të nëntë që fliste gaelisht, duke iu referuar gjuhës së banorëve të Munsterit, në Jug-Perëndim të Irlandës, foli për "gjuhë hekuri". Por edhe gaelishtja na çon në Lindjen e Mesme. Në Konemara, në Irlandën Perëndimore, ekziston një komunitet që flet ende gaelishten si gjuhë të parë. Këngët e tyre "sean-nos" (këngë tradicionale), baza e të gjithë muzikës irlandeze, janë pabesueshmërisht të ngjashme me këngët e vendasve të Lindjes së Mesme. Deri edhe veshë të stërvitur nuk do të arrinin t`i dallonin këngët e këngëtarëve gaelezë nga ato libike.

Çarl Aktoni, kritik muzike i revistës *Irish Times*, shkruan:

"Nëse një njeri ndonjë mbrëmje do të dëgjonte për orë të tëra arabët beduinë që këndojnë në shkretëtirë baladat e tyre... dhe pastaj të kthehej përsëri në Irlandë e të dëgjonte ndonjë këngëtar të zotë të "sean-nos"-it, që përdor të njëjtat melizma dhe të njëjtat ritme, do të vinte re një ngjashmëri gati të pabesueshme. E njëjta gjë do të ndodhte po të dëgjonte (spanjollen) *"këngë dondo"*[41].

Në kohërat e lashta lundrime të rëndësishme tregtare lidhnin Irlandën me Spanjën dhe Spanjën me Afrikën e Veriut dhe, nëpërmjet tyre, u zhvillua përhapja e etnive, e dijeve dhe e kulturave. Harku spanjoll i Galuejit, në Irlandën Perëndimore, është një dëshmi e kësaj, ashtu sikurse vallëzimi i Konemarës i njohur si "batering", që është praktikisht i njëjtë me flamengon spanjolle. Vallja e shkopinjve e luajtur nga "mummer"-ët (= ndyranikët) e Ueksfordit, në Irlandë, është me origjinë afrikano-veriore. Fjala "mummer" rrjedh nga fjala "muhamedan". Simboli i Irlandës, harpa, vinte nga Afrika e Veriut, ashtu sikurse edhe emri i simbolit tjetër klasik, tërfilit (*shamrock*). Në Egjipt çdo bimë me tri gjethe quhet "shamrukh". Rruazat e rruzares, simboli i devocionit katolik, e kanë prejardhjen nga Lindja e Mesme dhe përdoren sot e kësaj dite nga egjiptianët. Fjala angleze "nun" (= motër, murgeshë) është egjiptiane, ndërsa rrobat e veshura nga motrat-murgesha kanë prejardhje nga Lindja e Mesme. Sipas Arbois Juvainvilit, autor i një vepre me titullin *Cours De Literature Celtigue* (Kurs i letërsisë kelte), në Mesjetë irlandezët njiheshin me emrin "egjiptianë". Ekzistojnë lidhje të qarta midis librave irlandezë dhe atyre egjiptianë. Ata përdorin të njëjtat teknika ilustrimi dhe ngjyrat e përdorura tek *Libri i Kelsit* dhe tek *Libri i Durrout*, që të dy irlandezë, janë me origjinë mesdhetare. E kuqja e përdorur në këta libra nxirrej nga një insekt i zonës mesdhetare, nga *Kermococcus vermilio*, ndërsa ngjyra të tjera nxirreshin nga një bimë mesdhetare, nga *Crozophora tinctoria*. Qëndrimi me

krahë të kryqëzuar, tipike për shumë paraqitje simbolike të perëndeshës egjiptiane Osiridë, mund të gjendet edhe në disa dorëshkime irlandeze. Fanellat e trasha irlandeze të realizuara në Ishujt Aran riprodhojnë, të paktën sipas një eksperti të historisë së bluzës, skica të sjella në atë vend nga murgjit koptë egjiptianë[42]. Grupi i gjakut më i përhapur në Ishujt Aran (arianë?) është i ndryshëm nga ai i pjesës më të madhe të popullsisë irlandeze.

Anija e lashtë me vela e quajtur "pukan" ka qenë shpikur nga afrikanoveriorët që e përdornin në Nil. Gërmime pranë Navan Fortit, afër qytetit të Armagut, kanë nxjerrë në dritë mbeturina majmunësh pa bisht, që i përkasin kohës rreth vitit 500 para Krishtit. Majmuni pa bisht sot më së shumti i shoqërohet Gjibraltarit, por në vitin 500 para Krishtit jetonte në Afrikën e Veriut. Mendohet se një numër i madh mercenarësh libikë gjendej në Irlandë 2.000 vjet më parë. Në shekullin e dytë, gjeografi Tolomeo, që jetoi në Aleksandri, renditi plot gjashtëmbëdhjetë fise irlandeze. Sporti irlandez i quajtur *hurling* ka një të barasvlershëm në Marok të quajtur *takourt*. Ritualet irlandeze, si ato të të gjitha kulturave të frymëzuara nga fenikas-arianët, bazoheshin tek Dielli. Kodra e dheut e Njugranzhit, në Irlandë, ka një kalim të ngushtë rreth 2 kilometra të gjatë, që rezulton e orientuar në mënyrë të përkryer me Diellin në çastin kur ai lind më 21/22 dhjetor, që është dita e solsticit dimëror. Drita e praruar diellore mbush dhe ndriçon krejt kalimin dhe dhomën e brendshme qendrore. Hyrja e shumë ndërtesave mesdhetare, në mënyrë të veçantë ajo e Pallatit të Minosit në Kretë, paraqet të njëjtat karakteristika. Kullat tipike rrumbullake të Irlandës janë, sipas disa orientalistëve, me origjinë fenikase[43]. Prapë edhe njëherë e gjitha kjo hyn në mënyrë të përkryer brenda kuadrit që jam duke ravijëzuar. Fenikasit vinin nga Lindja e Mesme dhe e Afërt, njëra prej qendrave më të mëdha të anunako-zvarranikëve dhe, sipas studimeve të profesor Filip Kalahanit, që e kam përmendur më përpara, kullat e rrumbullakëta rezultojnë të orientuara ndaj sistemeve yjore të hemisferës veriore, sodomos me Yjësinë e Dragoit.

Vëmendje të veçantë meritojnë lidhjet midis Irlandës dhe berberëve të Marokut. Është fjala për një popullsi malësore me lëkurë të bardhë dhe, pjesërisht, me sy të kaltër e flokë të verdhë. Ata i shoqërohen maleve të Atlantit, që nga ana e tyre i shoqërohen Atlantidës dhe emri i së cilës rrjedh nga Atlanti, i biri i mbretit legjendar Poseidon. Arti berber paraqet shumë ngjashmëri me atë irlandez dhe kushdo që flet gaeishten nuk do të ketë probleme për të kuptuar të folmen berbere. Nga klanet më të rëndësishme berbere, si M'Tir, M'Tuga e M'Ghill, kanë rrjedhur gartë fjalët skocezo-irlandeze MacTier (Mek Tier), MacDougal (MekDagëll) e MacGhill (MekGill), ose e kundërta. Termi

"Mac" (Mek) do të thotë "bij ose bir i" dhe të njëjtin kuptim ka fjala arabe "Bini" në mbiemra si Bini M'Tir. Misionarët që ishin të parët që eksploruan tokat berbere zbuluan se ata i binin gajdes, siç bëjnë edhe irlandezët e skocezët. Pushtuesit e parë të Irlandës janë njohur si "njerëzit me çanta lëkure". Një tambur irlandez prej lëkure dhije i gjetur në Kerri është një kopje e përpiktë e tamburit maroken, *bindirit*. Edhe violina e kitara kanë lindur në Afrikën e Veriut. Krahu viking i arianëve pushtoi Irlandën dhe themeloi shumë qytete, përfshirë kryeqytetin aktual, Dublinin. Por në dritën e asaj që keni mësuar gjer këtu nuk do t'ju befasojë të mësoni se galera e famshme vikinge me bashin dhe kiçin shumë të lartë ishte një model fenikas e përdorur nga egjiptianët. Gdhendje shkëmbore të gjetura në Njugranzh, dhe që i përkasin mijëra viteve më parë, duken se paraqesin këtë model. Emri Idris është mjaft i përhapur në Uells dhe përmendet edhe midis shenjtorëve dhe mbretërve myslimanë që kanë ndërruar njëri-tjetrin gjatë shekujve. Në British Museum (Muzeumin Britanik) ruhet një monedhë myslimane, një dinar i artë, mbi të cilën është gdhendur emri "Offa". Ofa ka qenë mbreti i Mersias, në Anglinë e shekullit VIII, dhe atij i atribuohet ndërtimi i "murit" prej dheu i gjatë 120 milje që ndan Anglinë nga Uellsi dhe që është i njohur si Hendeku i Ofës. Fjala "Uells" rrjedh nga "Weallas", që do të thotë "Toka e të huajve". Uellsianët, ashtu si irlandezët, eksploruan detet veriorë përreth Islandës para vikingëve dhe thuhet se princi uellsian Madok zbarkoi në Amerikë tre shekuj përpara Kolombit. Kjo është absolutisht e mundur sepse, nëse kishte hyrë në njohuritë e fenikasve, e dinte me siguri për ekzistencën e Amerikës. Beda i Përnderuari ka thënë se kambrët (pak a shumë uellsianët) ishin një popullsi lindore që, pas përmbytjes, u zhvendos nga tokat biblike në Ishujt Britanikë[44].

Kur irlandezët u ngulën në disa zona të Uellsit dhe të Kornovaljes, disa prej atyre që u dëbuan nga ato territore u shpërngulën në Armorikë, Bretanja e sotme, përgjatë brigjeve franceze. Aty ngrihet pylli fantastik *menhir* i quajtur Carnac, një emër që rrjedh nga Karnak, në Egjipt. Gjuha bretone është një përzierje midis uellsianes së lashtë dhe kornovaljo-arianes. "Bretanjë" do të thotë "Britania e vogël" dhe rifillon prapë edhe një herë me Baratin dhe Baratinë. "Armorikë" do të thotë "tokë përballë detit", një përshkrim i përkryer i Amerikës e parë nga Atlantiku. Kjo është me siguri origjina e emrit Amerikë, dhe jo Amerigo Vespuçi, eksploratori fiorentinas, që luajti rolin e ndërmjetësit të Kristofor Kolombit në Spanjë. Edhe ishulli Man qe populluar nga arianët irlandezë dhe u bë një tokë shumë e shenjtë. Qe njëri prej dy qendrave të Britanisë së Madhe, tjetra ishte Anglezea në Uellsin e Veriut, ku ishin vendosur arkidruidët. Këta ishin anëtarët më të shquar të klasës së lashtë

priftërore britanike, që i kishte trashëguar njohuritë e saj nga fenikasit dhe, më pas, nga Vëllazëria Babilonase. Simbolizmi me tri këmbë i ishullit Man nuk është i ndryshëm nga simboli fenikas i Diellit, kryqi i thyer. Janë shquar lidhje edhe midis Irlandës dhe Etiopisë. Një studiuese amerikane, Uintrop Palmer Bosuell, ka shkruar një libër të titulluar *Irish Wizards In The Woods Of Ethiopia* (Magjistarë irlandezë në pyjet e Etiopisë), në të cilin tregon ngjashmëritë ndërmjet legjendave popullore irlandeze dhe atyre etiopase. Pema e *baobab*-it nderohej nga etiopasit e nga berberët dhe "banba" është një emër i vjetër i Irlandës.

I njëjti kult i pemëve, tipike për Afrikën e Veriut, në Evropë respektohej nga druidët (*priftërinj keltë*); përveç racës gjigante të Titanëve, hibridët njerëzoro-zvarranikë të Lindjes së Afërt qenë paraqitur shpesh në formën e pemëve, për shkak të lartësisë së tyre të konsiderueshme. Në një libër të publikuar në vitin 1833 me titullin *Phoenican Ireland* (Irlanda fenikase), Hoakim Vilnëvi, mbronte idenë se druidët irlandezë ishin "priftërinjtë gjarpërinj" të lundërtarëve fenikas. Kjo do të shpjegonte sigurisht origjinën e "Balorit me sy të keq", versioni irlandez i perëndisë afrikanoveriore Baal, dhe i Beltanit, kremtimeve të majit për nder të Baalit. Syri i keq aludon për vështrimin hipnotizues të zvarranikëve. Perëndia Diell e finikasve ishte Bel ose Bil, më pas i ripagëzuar Baal-Nimrod nga kananët (*emërtim i palestinezëve të lashtë*) dhe nga babilonasit. Druidët e përcollën traditën e shkollave misterike në Britaninë e Madhe, në Irlandë, në Francë apo Bretanjë, në Skoci dhe Uells, siç quheshin asokohe, dhe disa prej tyre degjeneruan thellësisht nën ndikimin e racave njerëzoro-zvarranike të Vëllazërisë Babilonase, që, me kalimin e shekujve, mori kontrollin e klerit arian. Origjina e fjalës "druid" nuk është e qartë. Mund të rridhte nga një fjalë gaelishte, "druidh", që do të thotë "njeri i urtë" ose "shtrig", por edhe nga fjala irlandeze "drui", që do të thotë "njerëz të lisave"[45]. Misteret druide jepeshin mësim në errësirën e guvave, të korijeve dhe të pyjeve, ku lisi simbolizonte Hyjninë Supreme (në përputhje të plotë me simbolizmin drungjashëm të gardianëve). Druidët nuk nderonin lisin, ai ishte një simbol dhe gjithçka që rritej përsipër tij, si veshtulla, bëhej e shenjtë. Shkurrja e ashes (*dafinë me gjemba*) ishte një tjetër simbol i shenjtë për druidët dhe prej këtej rrjedh toponimi Hollivud (= pyll me ashe), në Los Anxhelos, qendër e industrisë kinematografike botërore, e themeluar nga anëtarët bashkëkohorë të Vëllazërisë Babilonase. Hollivudi ka mbetur në duart e tyre dhe përfaqëson një prej mjeteve më të fuqishme për kushtëzimin mendor të masave. Hollivudi është me të vërtetë një vend magjik, pasi shtrembëron perceptimin që njerëzimi ka për veten dhe për botën. Druidët zotëronin dije

të konsiderueshme astrologjike e astronomike dhe më 25 dhjetor kremtonin lindjen e Diellit. Për ta edhe Hëna kishte shumë e rëndësishme. Në mënyrë të veçantë e shenjtë ishte nata e hënës së re, dita e gjashtë e hënës së re dhe nata e hënës së plotë.

Ashtu sikurse ndodh me shkallët blu të masonerisë moderne, edhe anëtarët druidë ndaheshin në tre grupe. Mësimet e dhëna në çdo nivel nëpër pyjet e lashtësisë dhe nëpër tempujt masonë bashkëkohorë janë praktikisht e njëjta gjë. Niveli i parë i Shkollës Druide përfaqësohej nga vatët, që ishin të veshur me ngjyrë jeshile, ngjyrë që për druidët përfaqësonte dijen. Niveli i dytë zihej nga bardët, që visheshin me ngjyrë të kaltër qielli, simbol i harmonisë dhe i së vërtetës. Ata kishin detyrën të mësonin përmendësh një pjesë të 20.000 vargjeve të poezisë druide, brenda së cilës fshiheshin misteret. Niveli i tretë, ai i druidëve vërtet të mbiquajtur, vishte një veshje të bardhë, ngjyrë simbolike e pastërtisë dhe e Diellit. Për t'u bërë një kryedruid, një udhëheqës shpirtëror, ishte e nevojshme të ngjisje gjashtë nivele. Druidët kanë pasur për një kohë të gjatë një pushtet të plotë mbi popullsinë dhe, kur rrjeti i tyre i shkollave misterike kaloi nën kontrollin e Vëllazërisë Babilonase, u zbulua se ata praktikonin rite me të vërtetë pak të këndshme. Kodi moral në thelb i mësohej të gjithë popullsisë, por dijet e fshehta, sikurse ndodh në të gjitha këto organizata, u rezervoheshin anëtarëve, në fshehtësi të plotë. Elifas Levi, studiues i famshëm i ekzoterizmit, ka thënë në lidhje me metodat e tyre kuruese:

"Druidët ishin priftërinj dhe mjekë që kuronin me magnetizëm... ilaçet e tyre universale ishin veshtulla dhe veza e gjarpërit, pasi këto stubstanca tërheqin dritën yjore në mënyrë të veçantë. Solemniteti me të cilën pritej veshtulla ngjalli besimin popullor kundrejt kësaj bime dhe e bëri fuqishëm magnetike"[46].

Druidët, ashtu si përfaqësuesit e besimeve të tjera misterike, ishin zotërues të dijeve të përparuara, që i ishin mbajtur fshehur popullit dhe, pjesërisht, të përdorura për qëllime absolutisht negative. Nuk jam duke dënuar druidët në tërësinë e tyre dhe sigurisht nuk dëshiroj të hedh hije mbi punën e druidëve të sotëm. Dija është e natyrshme dhe mund të përdoret me qëllime të mira ose të këqija. Por nuk ka asnjë dyshim se ka patur depërtime brenda besimit druid, që filloi pra të shfaqte rite e sjellje tipike të racave të zvarranikëve, përfshirë flijimin njerëzor. Vëllazëria sot kremton ende rite druide gjatë ceremonisë së saj të magjisë së zezë.

Një kthim në shtëpi?

Provat e lidhjeve ndërmjet Lindjes së Mesme e të Afërt dhe Ishujve Britanikë e Irlandës janë thjesht të pakundërshtueshme. Me lehtësi të skajshme mund të ndiqni rrjedhën e popujve, të dijeve, të kulturave, të gjuhëve, të hyjnive, të simboleve dhe të ritualeve. Pyes me vete, megjithatë, nëse kjo vajtje-ardhje midis këtyre dy zonave të botës ka filluar me të vërtetë rreth vitit 3000 para Krishtit, apo ka ndodhur në drejtim të kundërt në kohëra akoma më të lashta, para përmbytjes së përbotshme të shkaktuar nga Afërdita. Mund edhe të ketë ndodhur, domethënë, që qytetërimet e Lindjes së Mesme e të Afërt të kenë lindur në ishujt aktualë britanikë dhe në Evropë dhe që, pas vitit 3000 para Krishtit, lëvizja të ketë marrë drejtimin e kundërt. Tani për tani nuk jam në gjendje të jap prova të hollësishme të kësaj, por kërkimet e mia janë duke lëvizur në atë drejtim. Nëse është e vërtetë që ishujt britanikë dhe pjesë të Evropës kanë qenë shkatërruar nga përmbytjet tokësore, atëhere mund të ketë ndodhur një zhvendosje në masë e racave më të përparuara drejt tokave më të sigurta, sidomos në Lindjen e Afërt. Sigurisht, Vëllazëria Babilonase dhe të tjera organizata që ishin në zotërim të dijeve të përparuara nuk e lanë t'u shpëtonte rasti për t'u shpërngulur në Britaninë e Madhe dhe të vendosnin atje shtabin e tyre të përgjithshëm. Londra u bë epiqendra e veprimeve të tyre dhe e tillë ka mbetur gjer në ditët e sotme. Duhet të ketë qenë një rajon shumë i rëndësishëm, nëse kjo ka ndodhur, dhe unë besoj se ka pasur të bëjë me fushat energjitike të këtyre trojeve. Ishujt britanikë janë një vend me të vërtetë i shenjtë për Vëllazërinë, pasi përkojnë me qendrën e rrjetës energjitike tokësore. Jo rastësisht përqëndrimi i rrathëve prej guri, *menhir*-ëve, kodrave të lashta dhe vendeve arkeologjike, është më i madh në disa zona të Britanisë së Madhe, se në çdo vend tjetër të botës. Kush kupton se si të manipulojë energjinë dhe vetëdijen e njerëzve, do të kërkojë atëhere t'i vendosë veprimtaritë e veta në zemër të rrjetës energjitike planetare dhe, në fakt, shumë prej planeve të këtyre njerëzve janë realizuar pikërisht në Ishujt Britanikë.

Edhe Londra është njëra prej qendrave kryesore të rrjetës magnetike tokësore dhe është bërë kryeqytet jo vetëm i Britanisë së Madhe, tokës së baratit, por edhe i Vëllazërisë Babilonase. Për anëtarët e kësaj të fundit, ajo është një "Trojë e Re" ose një "Babiloni e Re". Qyteti i Trojës, në Azinë e Vogël (Turqi), vendi i bërë i famshëm prej luftës së Trojës dhe prej legjendës së kalit prej druri, ka qenë një tjetër qendër ariane, përveçse ka qenë kryeqyteti i lashtë i ititëve. Shumë fise ariano-zvarranike duket se kanë qenë ngulur në Trojë, që mbetet një vend i shenjtë për krerët e rrjetit të shoqërive të fshehta, që janë të

vetëdijshëm për prejardhjet e tyre të vërteta. Në greqisht dhe në hebraisht "Trojë" do të thotë "tre vende", një aludim për Trinitetin, një tjetër besim që krishtërimi e huazoi nga bota e lashtë. Në anglisht Troy ose Trojë është Tripoli, emri i kryeqytetit aktual të Libisë dhe atdheu i atij njeriut në dukje i Vëllazërisë, që është kolonel Kadafi. Prapë edhe njëherë Troja lidhet me gjakpastrit dhe me hibridët jashtëtokësorë: prej këtej rrjedh ankthi i vazhdueshëm për atë emër që kanë anëtarët e Vëllazërisë. Në poemën epike të Iliadës, që i atribuohet poetit grek Homerit, bëhet e njohur se Troja ka qenë themeluar nga Dardani, bir i perëndisë greke Zeusit, që ishte një Titan – domethënë një pjesëtar i racës së zvarranikëve. Zeusi paraqitej si në formën e shqiponjës, edhe në atë të gjarpërit. Thuhej se kishte lindur në Spartë, në Arkadi dhe, pas luftës së Trojës, shumë spartanë shtegtuan drejt Francës aktuale. Shprehje si "Troja e Re", pra, i referohen qendrave të po këtyre fiseve.

Pjesa më e madhe e njerëzve nuk e di që Londra është themeluar si "Troja e Re". Sipas traditës, pas shkatërrimit të Trojës, e ndodhur rreth vitit 1200 para Krishtit, Enea fisnik u largua bashkë me ata që shpëtuan gjallë prej popullit të tij dhe u vendos në Itali. Aty u martua me të bijën e Latinit, mbretit të latinëve, dhe prej tij rrodhi pastaj perandoria romake. Sipas shumë legjendave, Brutusi, i nipi i Eneas, zbarkoi në Britaninë e Madhe rreth vitit 1103 para Krishtit me një grup trojanësh, përfshirë disa të ardhur nga kolonitë spanjolle. Ata e quajtën Britaninë e Madhe "Ishulli i Madh i Bardhë" për shkak të shkëmbinjve të bardhë që gjenden me bollëk gjatë bregut jugor. Në anglinë jug-perëndimore, në Devon, ngrihet qyteti Totnes, pak milje në brendësi të Torbajit, portit më të lashtë detar të rajonit. Këtu ka një gur të quajtur "Guri i Brutusit", mbi të cilin, tregon legjenda, ish princi trojan hipi menjëherë pasi kishte zbarkuar. Sipas disa dokumenteve uellsiane, Brutusi qe pritur nga tre fise britanësh, që e shpallën mbret. Ai themeloi pastaj një qytet të quajtur "Caer Troia" – Troja e Re. Romakët, më pas, do ta quanin Londinium. Londra u bë qendra operative e perandorisë së Vëllazërisë Babilonase, dhe është edhe sot e kësaj dite, bashkë me Parisin dhe Vatikanin. Në legjendat e mbretit Artù, Londra, ose Troja e Re, është Troynavant, qyteti me hyrje lindore në mbretërinë e mbretit Artù, ndërsa Camelot (Kamelot) duket se do të thotë "Qytet marsian" ose "Qytet i Marsit". Objekte të gjetura nga arkeologu gjerman Hajnrih Shliman në vendin e Trojës së lashtë përmbanin shumë prej gdhendjeve të dukshme mbi monumentet megalitike britane. Ato ishin të zbukuruara edhe me kryqin e thyer, simboli fenikas-arian i Diellit. Prapë edhe një herë bëhet fjalë për të njëjtin popull, i njëjti, prej të cilit rrjedhin të gjitha racat e bardha që, siç mund të dëshmohet, kanë

marrë kontrollin e botës. Vështroni përreth dhe do të shikoni se kush i kontrollon mbretëritë e pushtetit global: të bardhët.

Duke shkuar prapa në kohë gjejmë, brenda kësaj dhe brenda të tjera racave, racat e zvarranikëve, të cilat sot kanë si bazë Londrën, Trojën e re, ose, më me vend, Babiloninë e re. Trupat e këtyre racave të zvarranikëve zotërohen apo kontrollohen nga zvarranikët e nivelit më të ulët të përmasës së katërt dhe pjesa më e madhe e atyre që zënë nivelet më të ulëta të piramidës ariane nuk dyshojnë fare për të gjithë këtë. Do të ndalem mbi këtë rrjet të anunakëve-zvarranikë dhe do të ndjek evolucionin e tyre deri në ditët tona, pasi të kem hedhur dritë mbi besimet fetare që racat e zvarranikëve i kanë përdorur me sukses të madh për ta katandisur gjininë njerëzore në një gjen nënshtrimi mendor, emocional e shpirtëror.

LIBRI 24

Kapitulli 4

Djej hyjnorë

Asgjë nuk e ka favorizuar realizimin e planeve të racës së zvarranikëve më shumë se sa besimi fetar. Akoma sot, në Amerikë, besimi fetar kontrollon mendjet dhe kufizon mendimin e Patriotëve të Krishterë, një lëvizje kjo që gjithashtu ka arritur të zbulojë shumë aspekte të përbetimit të Vëllazërisë. Ajo çka anëtarët e kësaj lëvizjeje nuk arrijnë të pranojnë, megjithatë, është se besimi i tyre është një pjesë e qëndrueshme e atij përbetimi.

E them këtë jo për të dënuar të gjithë njerëzit që quhen të krishterë. Ka shumë prej tyre që, nëpërmjet besimit të krishterë, shprehin një devotshmëri shpirtërore. Jam duke folur për institucionin e krishtërimit, për indoktrinimin e tij arrogant dhe për detyrimin e tij të një përfytyrimi dëshpërimisht të kufizuar të jetës që, në harkun e 2.000 vjetëve, ka krijuar një burg mendor për miliarda njerëz. Të gjitha besimet më të mëdha të botës, induizmi, krishtërimi, judaizmi dhe islamizmi, kanë lindur në të njëjtin rajon të Lindjes së Mesme e të Afërt, atje ku dolën në dritë raca ariane dhe hibridët e racës së zvarranikëve, pas përmbytjes së përbotshme të ndodhur sipas gjasës 7.000 vjet më parë. Qëllimi i këtyre besimeve ishte ai i burgosjes së mendjes dhe i shtypjes së emocioneve nëpërmjet frikës dhe ndjenjës së fajit. Ato zakonisht

bazohen mbi një farë figure "perëndie-shpëtimtare", si Jezusi apo Muhameti, dhe vetëm duke besuar tek ata e duke ndjekur urdhërat e tyre mund të gjesh "Perëndinë" e të shpëtosh. Kjo është saktësisht ajo që thoshin priftërinjtë babilonas për Nimrodin, kur vunë në zbatim një program kontrolli nëpërmjet besimit. Kush kundërshton të besojë në këto gjepura është i dënuar të ushqejë flakët e ferrit në përjetësi. Në mënyrë të pabesueshme, në harkun e mijëvjeçarëve, miliarda e miliarda njerëz kanë rënë në këtë grackë dhe vazhdojnë të bien. Nuk ka asgjë të keqe nëse dëshirojnë t'ia dorëzojnë dikujt tjetër mendjen dhe jetën e tyre, por të kërkosh që të gjithë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë nuk është e drejtë. Nuk është e drejtë aspak. Meqë shumë prej njerëzve që janë duke u bërë gati për ta lexuar këtë libër kanë lindur sipas gjasës në ato zona të botës të sunduara nga krishtërimi dhe nga judaizmi, do të nisem nga këto dy besime për të treguar se si historitë simbolike janë bërë të vërteta të mirëfillta dhe se si manipulimi i tyre ka prodhuar formën më të fuqishme të kontrollit mendor masiv të shpikur ndonjëherë.

Për të kuptuar se çfarë qëndron me të vërtetë prapa besimeve fetare, duhet të analizojmë bazat e të gjitha atyre më të lashtave, duke u ngjitur deri tek fenikasit, tek babilonasit dhe akoma më parë. Është fjala për Diellin. Struktura e tyre hierarkike bazohej mbi Diellin sepse, siç e kam shpjeguar më parë, ishte e njohur fuqia e tij si prodhues i mahnitshëm energjie elektromagnetike, në gjendje që të ndikonte vazhdimisht mbi jetët dhe sjelljet tona. Dielli përmban 99% të masës së këtij sistemi diellor. Mendoni vetëm këtë. Dielli *është* sistemi diellor dhe çdo ndryshim i tij bashkëmbart një ndryshim nga ana jonë. Të kuptosh këto cikle diellore dhe natyrën e ndryshueshme të energjisë që Dielli projekton, të jep mundësinë të dish para kohe se cili do të jetë reagimi më i mundshëm i qenieve njerëzore përballë ngjarjeve të ndryshme, në çaste të ndryshme. Sipas teksteve që formojnë bazën e besimeve të ndryshme, ekzistojnë dy nivele interpretimi të kultit të Diellit. Në botën e lashtë, klasat sunduese frymëzoheshin tek Dielli pasi ishin në dijeni të efektit veprues të tij në nivel të thellë, ndërsa masat e nderonin Diellin sepse nxehtësia dhe drita e lëshuar prej tij luanin një rol të qartë e vendimtar për të siguruar të korra të bollshme. Në të njëjtën mënyrë, një anëtar i shoqërive ekzoterike do ta lexojë *Biblën* në mënyrë të ndryshme në krahasim me një ithtar të krishtërimit apo të hebraizmit. Anëtari i i shoqërive ekzoterike do ta njohë simbolizmin, numerologjinë dhe kodet ekzoterike, ndërsa ithtari i krishtërimit apo judaizmit do ta marrë tekstin në kuptimin e ngushtë të fjalës. Kështu i njëjti tekst bën punën si mjet përçjellës i dijeve ekzoterike për anëtarët e ekzoterizmit dhe krijon një besim-burg për masat,

që nuk janë anëtare të shoqërive ekzoterike. Një mashtrim i bukur.

Të kuptosh simbolizmin e lashtë diellor është e barasvlershme me të kuptuarit e besimeve më të mëdha. Në botën e lashtë rruga që përshkonte Dielli gjatë vitit paraqitej në mënyrë simbolike (shiko ***Figura 13***). Siç do ta shohim në një kapitull të mëpasëm, kjo paraqitje simbolike përdoret edhe sot e kësaj dite nga Vëllazëria Babilonase. E gjejmë edhe në paraqitjet fenikase të Baratisë, përveçse në mburojën e hyjnisë përkatëse britanike, Britanisë. Të lashtët morën rrethin e zodiakut (një fjalë greke që do të thotë "rreth i kafshëve") dhe aty futën një kryq që përfaqësonte të katër stinët. Në qendër të kryqit vendosën Diellin. Mbi bazën e këtij simbolizmi shumë prej hyjnive para-të krishtera mendohej se kishin lindur më 25 dhjetor. Midis 21 dhe 22 dhjetorit është solstici dimëror kur, në hemisferën veriore, Dielli prek pikën më të ulët të ciklit të tij vjetor. Në atë pikë, sipas të lashtëve, Dielli, ishte simbolikisht i "vdekur". Brenda 25 dhjetorit, Dielli riniste udhëtimin e tij të kthimit drejt verës dhe drejt kulmit të fuqisë së tij. Për këtë arsye, të lashtët thoshin se Dielli kishte "lindur" më 25 dhjetor. Krishtlindja e krishterë nuk është gjë tjetër veçse një festë pagane, së cilës i është dhënë një tjetër emër, siç janë në realitet të gjitha festat e krishtera, përfshirë Pashkën. Rreth 25 marsit, data e vjetër e caktuar për Pashkën, Dielli hyn në shenjën astrologjike të Dashit, ose qingjit. Në atë periudhë të lashtët zakonisht flijonin qingja, sepse besonin se kjo do t'i zbuste perënditë, sidomos perëndinë Diell, duke u siguruar të korra të bollshme. Me fjalë të tjera, besonin se nëpërmjet gjakut të qingjit do të kishin përfituar faljen e mëkateve të tyre.

Në Babiloninë e lashtë, thuhej se Tamuzi, i biri i mbretëreshës Semiramidë, ishte kryqëzuar me një qingj tek këmbët e tij dhe ishte vendosur në një shpellë. Kur, tri ditë më pas, duke zhvendosur gurin që mbyllte hyrjen e shpellës, vunë re se trupi i tij ishte zhdukur. E, megjithatë, këtë histori e kam dëgjuar tashmë! Të lashtët e pareqisnin Diellin si një fëmijë në dhjetor, një djalosh në Pashkë, një burrë në verë, një i moshuar që është duke humbur forcat në vjeshtë dhe një plak në ditën e solsticit dimëror. Paraqitja bashkëkohore e Atit Plak Kohë bazohet mbi këtë. Dielli paraqitej edhe me flokë të gjata të arta (rrezet diellore), të cilat shkurtoheshin dora-dorës që ai hymbiste forcën e tij, në muajt e vjeshtës. Tani rimerrni në shqyrtim historinë Sansonit – Samsun, që shkruhet tek Testamenti i Vjetër. Ky ishte në mëyrë të pabesueshme i fortë dhe kishte flokë të gjata, por e humbi forcën e tij kur ia prenë flokët. Problemet filluan kur hyri në shenjën e Dalilës – shenja astrologjike e Virgjëreshës, përmes së cilës Dielli kalon kur dimri afrohet. Duke mbledhur forcat e tij të fundit, Sansoni i rrëzon të dy shtyllat, që janë simbole klasike të

LIBRI 24




Figura 13. Paraqitja e lashtë simbolike e ciklit vjetor të Diellit, prej nga kanë pasur prejardhje simbole të shumta dhe histori simbolike. E gjeni këtë paraqitje edhe në simbolizimet e Baratit dhe të Baratisë të figurës 12.

Vëllazërisë dhe që e kanë burimin të paktën në Egjiptin e lashtë e që përdoren akoma edhe sot nga masonët. Sansoni është Sam-sun, një paraqitje simbolike e rrugës së përshkuar prej Diellit në harkun e një viti. Kjo figurë nuk ka ekzistuar kurrë. Në hebraisht më rezulton që Sanson do të thotë "Perëndia e Diellit".

Sipas ortodoksisë së krishterë, Jezusi është i vetmi fëmijë i lindur prej Perëndisë dhe vdiq për të na çliruar prej mëkateve tona. Por do të kujtoheni se po këto karakteristika janë të përbashkëta tek një mori "hyjnish" të lashta, që i përkasin një periudhe kur "Jezusit" nuk i ndihej ende as era më e vogël. Përkundrazi, ne e dimë që emri i tij nuk ishte Jezus, pasi ai është një përkthim grek i një emri hebre. Shprehja "Bir i Perëndisë" do të dukej se i takonte të paktën mbretërve gotikë arianë të Kilikisë (Azia e Vogël – Turqi), që morën titullin "Bijtë e Perëndisë Diell", një traditë e përshtatur prej faraonëve egjiptianë[1]. Për shumë ithtarë të lëvizjes *New Age*, Jezusi është Sananda, një anëtar i lartë i njëfarë elite shpirtërore, që është mishëruar për të ngjallur në tokë energjinë e "Krishtit". Të tjerë do t'ju thonë që ishte një jashtëtokësor i

ngarkuar me një mision të tillë. Për të tjerë akoma ai ishte mbreti i "Judejve" prej të drejtës së lindjes, pasi rridhte nga mbreti David. Por a ka ekzistuar me të vërtetë Jezusi? A kanë ekzistuar Moisiu, Solomoni dhe mbreti David? Do të thosha në mënyrë kategorike jo. Nuk ka prova të ekzistencës së asnjërit prej tyre jashtë teksteve biblike, që sigurisht nuk janë të besueshme. Atëhere prej nga kanë ardhur?

Testamenti i Vjetër

Duket se në vitin 721 para Krishtit Izraeli ka qenë pushtuar nga asirët dhe se izraelitët, ose kananët, janë katandisur në gjendje skllevërie. Megjithatë, fiset, që historia zyrtare i identifikon me emrat Judah dhe Benjamin, mbijetuan edhe për më shumë se njëqind vjet, para se të pushtoheshin dhe kapeshin nga miqtë tanë, babilonasit, rreth vitit 506 para Krishtit. Ndodhi pikërisht në Babiloni, kryeqyteti i lashtë i klerit dhe i krerëve ariano-zvarranikë, që priftërinjtë hebrej, levitët, filluan të trillonin një histori, për të mbajtur të fshehur të vërtetën e fakteve. Si mundet, në fakt, një Vëllazëri që kudo ka shkatërruar dije të lashta dhe biblioteka, të zbulojë në tekstet e veta se si kanë shkuar me të vërtetë gjërat? Është mjaft më e mundshme që t'i përdorë ato tekste për të përhapur versionin e fakteve, që ajo dëshiron t'i bëjë njerëzit t'i besojnë. Gjatë dhe pas qëndrimit të tyre në Babiloni, të pasuruar prej dijeve dhe legjendave të trashëguara nga sumerët, levitët (priftërinjtë hebrej) përzien të vërtetën, një e vërtetë shpesh simbolike, me fantazinë dhe mbi këtë përzierje bazohet Testamenti i Vjetër. Të ashtuquajturit izraelitë nuk i kanë shkruar këto tekste, as nuk kanë qenë të një mendjeje me ato supozime. Edhe duke pranuar se kanë ekzistuar, izraelitët u shkapërdanë shumë kohë më parë në krahasim me epokën kur levitët ngjyen penën në bojë. *Gjeneza, Eksodi, Levitikja* dhe *Numrat*, që së bashku formojnë *Torah*-ën "hebraike", kanë qenë shkruar që të gjitha nga levitët, apo nën drejtimin e tyre, gjatë ose pas qëndrimit në Babiloni. Ky grup fanatikësh të gjakut, të flijimit njerëzor dhe të magjisë së zezë, të cilit nuk do t'i besoja për asnjë arsye në botë, përpiloi ligjin që populli hebraik detyrohet të ndjekë edhe sot e kësaj dite. Në të njëjtën mënyrë, shumë fanatikë të krishterë e citojnë këtë mall si fjalë të Perëndisë! Nuk është fjala e Perëndisë, është fjala e levitëve, të drejtuar e të kontrolluar nga gjakpastrit dhe nga hibridët zvarranikë të Vëllazërisë Babilonase. Pllakëzat sumere dëshmojë përtej çdo dyshimi se *Gjeneza* ka qenë një version shumë i rivizituar dhe i përmbledhur i dokumenteve sumere. Historia sumere e Edenit ka qenë marrë nga *Bibla* atje ku ajo flet për Kopshtin e Edenit. Ju kujtohet historia e "Moisiut", që gjendet midis xunkthave nga një princeshë egjiptiane? Të njëjtën

histori e tregonin sumero-babilonasit në lidhje me mbretin Sargon i Vjetri. Historia e Moisiut është një shpikje, ashtu siç janë "ligësia" egjiptiane, eksodi (të paktën në formën e përshkruar) dhe të 12 fiset që rrodhën nga Jakobi.

Këto tekste kanë qenë shkruar nga levitët, krerët e të cilëve ishin anëtarë të shkollave misterike të racës së zvarranikëve babilonas. Historitë që ata paraqesin janë simbolike, por vetëm anëtarët e këtyre shkollave janë në gjendje t'i deshifrojnë, ndërsa masat ndalen në kuptimin e tyre të fjalëpërfjalshëm. Sipas levitëve, Perëndia ia dorëzoi Moisiut ligjet dhe urdhërat mbi majën e një mali. Prapë edhe një herë mali merr një kuptim simbolik. Kjo shpjegohet mbi bazën e faktit se maja e një mali është afër simbolit të Perëndisë, Diellit. Mali Sion do të thotë Mali i Diellit. Dielli që ngrihet mbi malet lindore është akoma edhe sot një simbol i rëndësishëm për Vëllazërinë. Historia e izraelitëve dhe e hebrejve është më së shumti frut i fantazisë: velloja, prapa së cilës e vërteta ka qenë mbajtur e fshehur. Askush nuk është mashtruar më shumë, gjatë mijëvjeçarëve, se sa populli që quhet hebre. Këta janë terrorizuar, janë përdorur dhe manipuluar në mënyrën më groteske dhe më të pamëshirshme nga nivelet më të larta të pushtetit, për të çuar përpara plane, për ekzistencën e të cilave populli hebre në tërësinë e tij nuk dyshon aspak. Nuk ka shembull më të mirë të këtij manipulimi se sa parkrahja dhe mbështetja që disa fise zvarranike, si "hebrejtë" Rotshildë, u kanë dhënë nazistëve, duke bërë që t'i paguante pasojat e papërshkrueshme masa e popullit hebre. Historia levitike e *Eksodit*, është një perde tymi, prapa së cilës fshihet fakti që dijet "hebraike" qenë vjedhur prej shkollave misterike egjiptiane, pasi tek ato depërtoi tinëz Vëllazëria Babilonase. Egjiptianët e quajtën zbulimin e "Jehovait" si një vjedhje të kryer në dëm të shkencave të shenjta[2]. Menli P. Hall, historian dhe anëtar i masonerisë, mbron idenë se magjia e zezë diktoi në Egjipt besimin fetar të shtetit dhe se veprimtaritë intelektuale e shpirtërore të popullsisë u paralizuan nga një respektim i plotë i dogmës së formuluar mjeshtërisht nga klasa e klerit. Bëhet fjalë për një përshkrim të përkryer të metodës së manipulimit levitiko-babilonas dhe të asaj të të gjitha besimeve të ardhshme, si krishtërimi, që u bazuan mbi gënjeshtrat e përhapura nga levitët. Dhe kjo është një pikë themelore për t'u mbajtur në mendje. Parimet themelore të judaizmit, të krishtërimit dhe të islamit bazohen mbi të njëjtat histori të shkruara nga levitët, pas qëndrimit të tyre në Babiloni. Jemi duke shqyrtuar një çast të historisë, që do të tregohet pastaj vendimtare për botën e asokohe si edhe për atë të sotme. Dijet që levitët vodhën në Egjipt dhe që i përhapën pas qëndrimit të tyre në Babiloni, u bënë të njohura me emrin Kabala (Qaballa), që rrjedh nga rrënja hebraike "QBC", që do të thotë "goja afër veshit". Kjo është metoda e përdorur

për t'u përcjellë anëtarëve të Vëllazërisë informacionet shumë të fshehta. Kabala është rryma ekzoterike e atij që quhet judaizëm, që është në realitet një fasadë e Vëllazërisë Babilonase, sikurse është edhe Vatikani. Kabala bazohet tek dijet sekrete të fshehura me kod brenda Testamentit të Vjetër dhe brenda teksteve të tjera. Judaizmi është një interpretim i mirëfilltë i tyre. Kjo është një teknikë që mund të ndeshet tek të gjitha besimet. Një shembull i kodifikimit levitik janë emrat e pesë skribëve (interpretues të *Biblës* tek izraelitët e lashtë) Garia, Dabria, Tzelemia, Echanu dhe Azrel, që shfaqen tek *Libri i Dytë i Esdras* ose Ezras. Ja kuptimet e vërteta të këtyre emrave:

- **Garia:** shenja që skribët e lashtë i përdornin për të treguar se një tekst është lakonik ose paraqet një kuptim të dyfishtë.
- **Dabria:** fjalë që përmabjnë një frazë ose një tekst.
- **Tzelemia:** shifra, shprehje të paraqitura ose të treguara në mënyrë të errët.
- **Echanu:** diçka që është ndryshuar ose dyfishuar.
- **Azrel:** emri Esdra/Ezra; prapashtesa "el" do të thotë "vepra e Ezras"[3].

Për këtë arsye këta pesë emra të "skribëve" tingëllojnë si një frazë e vetme drejtuar anëtarëve të Vëllazërisë: "Shenja paralajmërimi - fjalë të shifruara në mënyrë të errët - që janë ndryshuar apo dyfishuar - vepër e Ezras"[4]. Ka një libër të titulluar *The Bible Code*[5], që mbron idenë se ka identifikuar brenda versionit hebraik të Testamentit të Vjetër disa parashikime të shkruara me kod. Duke qenë se njëri prej këtyre parashikimeve i takon vrasjes së presidentit Kenedi nga ana e Li Harvej Osvaldit, do të më falnit nëse them se besueshmëria e tij nuk më bind. Ka akoma njeri që beson se e ka vrarë Osvaldi Kenedin? Por teksa ngre dyshimet përsa është pohuar tek *The Bible Code*, pranoj se *ekziston* një kod brenda *Biblës*, një kod ekzoterik, për anëtarët e Vëllazërisë. Ata, ose shpikën personazhe që të mundeshin të mishëronin simbolet e tyre, ose i bazuan pa dallim tek persona të gjallë, që i paraqitën megjithatë në mënyrë të shtrembëruar. Ja disa shembuj shprehjesh biblike të shkruara me kod. Një temë e përbashkët e të gjitha traditave të shkollave misterike është prania e 12 apostujve (dishepujve), kalorës ose ithtarë që rrethojnë perëndinë. Midis gjërave të tjera, numri 12 është një shprehje me kod për të treguar 12 muajt e vitit dhe shenjat e zodiakut përmes të cilave kalon Dielli, "perëndia", i simbolizuar nga numri 13. Bëhet fjalë për "12 të shenjtët plus një", siç quhen nga disa njerëz dhe është kjo njëra prej arsyeve kryesore e të rendurit pas numrave 12 e 13. Kështu pra, keni 12 fiset e Izraelit, 12 princat e Ismailit, 12 apostujt apo ithtarët e Jezusit, Budës, Osiridit,

LIBRI

Kuetzalkoatlit. Është edhe mbreti Artù me 12 kalorësit e tij të Tavolinës së Rrumbullakët (rrethi i zodiakut), Himleri dhe 12 kalorësit e tij të SS-ve naziste, dhe gruaja (Isida, Semiramida) me një kurorë me 12 yje e *Librit të Zbulesës*. Në Skandinavi dhe në të tërë zonën nordike, do të gjeni misteret e Odinit, të frymëzuara prapë edhe një herë prej së njëjtës racë ariane të Lindjes së Mesme. Bëjnë pjesë në traditën nordike edhe dymbëdhjetë "Drottars"-at që u prijnë mistereve bashkë me Odinin. Prapë edhe një herë "dymbëdhjetë të shenjtët plus një". Këto histori nuk duhen marrë në kuptimin e ngushtë të fjalës, pasi bazohen mbi simbolizmin e shkollave misterike. Po këto simbole përdoren akoma sot nga rrjeti i shoqërisë së fshehtë të Vëllazërisë dhe gjenden në flamujt kombëtarë, në stemat, në reklamat dhe në vendet e industrive. Ajo krijesë e Vëllazërisë si Bashkimi Evropian ka për simbol një rreth të formuar nga dymbëdhjetë yje. Këtu jemi duke folur për numra dhe gjeometri të shenjtë. Përmasat e statujave egjiptiane, të mëdha e të vogla, bazohen tek shumëfishi ose nënfishi i 12-ës, ose 6-ës.

Edhe numrat 7 dhe 40, të pranishëm tek *Bibla* dhe tek misteret, janë numra me kod. Tek *Bibla* kemi për shembull shtatë shpirtra të Perëndisë, shtatë kisha të Azisë, shtatë shandanë të artë, shtatë yje, shtatë llampa të zjarrta, shtatë vula, shtatë tromba, shtatë engjëj, shtatë bubullima dhe dragoi i kuq i Zbulesës me shtatë kokë e shtatë kurora. Në historinë e Xherikos, Xhosueja i urdhëron të marshojnë trupat e tij rreth qytetit për shtatë ditë, të shoqëruar nga shtatë priftërinj që mbajnë shtatë tromba. Ditën e shtatë ata e rrethuan Xherikon shtatë herë dhe muret u rrokullisën për tokë. Në historinë e Noes, shtatë çifte të çdo lloji kafshësh hynë në arkë, bashkë me shtatë çifte të çdo lloji zogjsh. Shtatë ditë kaluan midis parashikimit të rrebeshit dhe vetë rrebeshit dhe shtatë ditë midis nisjes së njërës pëllumbeshë dhe tjetrës. Arka arriti në vendmbërritje ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit të shtatë, Noeja e braktisi arkën ditën e njëzet e shtatë, dhe pas përmbytjes ai nisi shekullin e tij të shtatë të jetës. Shumë prej emrave simbol të perëndive, si Abraksasi (Abraxas) tek librat gnostikë dhe greku Serapis, janë të përbërë prej shtatë gërmash. Pastaj është 40-a. Adami hyn në Parajsë në moshën 40 vjeç; Eva e ndjek 40 vjet më pas; gjatë Përmbytjes së Përbotshme bie shi për 40 ditë e 40 netë; Sethi rrëmbehet nga engjëjt në moshën 40 vjeç dhe nuk shihet më për 40 ditë; Moisiu është 40 vjeç kur arratiset në vendin Madian, ku qëndron për 40 vjet; Jozefi është 40 vjeç kur Jakobi arrin në Egjipt; Jezusi shkon në shkretëtirë për 40 ditë. *Bibla* është fjala e Perëndisë? Jo. Është shkruar me kodin ekzoterik të shkollave misterike. Edhe letërsia arabe që hartuar nga dhe për anëtarët e mistereve dhe ajo paraqet në fakt të njëjtat shpreh je me kod. *Arbaindt*-at (të dyzetat)

janë histori që u referohen që të gjitha numrit 40 dhe kalendari arab ka 40 ditë me shi dhe 40 ditë me erë. Ligjet arabe i referohen në mënyrë të vazhdushme numrit 40. Një tjetër seri me libra arabë, *Sebaydt*-at ose "shtatat", bazohen përkundrazi natyrisht tek numri shtatë. Këto kode numerike kanë kuptime edhe më të thella se ato të ditëve dhe të muajve të zodiakut. Numrat përfaqësojnë edhe frekuenca dridhëse. Çdo frekuencë bie mbi një farë numri, ngjyre e tingulli. Disa frekuenca, të përfaqësuara nga numra, ngjyra e tinguj, janë veçanërisht të fuqishme. Edhe simbolet përfaqësojnë frekuencat dhe ndikojnë nënvetëdijen e njeriut pa e kuptuar ai. Kjo është një tjetër arsye pse disa simbole përsëriten midis shoqërive të fshehta, mbi flamujt kombëtarë, në vendet e industrisë, në reklama e kështu me radhë.

Nuk ka prova historike të ekzistencës së një njeriu të quajtur Moisi, përveçse në tekstet e prodhuara nga levitët dhe në shkrime të tjera e ndërhyrje, që bazohen tek ato. Disa mbrojnë idenë se bëhet fjalë për një emër maskues i faraonit egjiptian Arkenaten, dhe unë nuk do ta përjashtoja, duke qenë se historia zyrtare lidhur me figurën e Moisiut nuk ka asnjë bazë historike. Asgjë nuk dihej për "Moisiun" ose për "plagët" shkaktuar egjiptianëve, gjersa levitët e Babilonisë nuk kishin shkruar *Eksodin*, shumë shekuj më pas në krahasim me faktet e supozuara. Sipas asaj që tregohet në të, të gjitha kafshët e Egjiptit qenë vrarë tri herë! Çfarë bënin, ngordhnin e ringjalleshin në çast? Nuk ka patur asnjë vrasje të fëmijës së parë të Egjiptit, për këtë arsye festa e Pashkës hebraike nuk ka asnjë bazë historike, por bazohet vetëm tek një histori e shpikur nga levitët. Përmendja e tyre e gjakut të qengjit, me të cilin zhyheshin portat, është një mesazh i koduar lidhur me simbolizmin e lashtë të qengjit. Nuk ka asnjë libër zyrtar hebraik që të përmendë Pentateukon (ligjet e Moisiut) para qëndrimit në Babiloni të levitëve. Përsa i përket izraelitëve robër në Egjipt, deri edhe Deuteronomio i përshkruan si të "huaj", jo skllevër[6]. Atëhere që nga vjen emri Moisi? Çdo anëtar që arrinte nivelin më të lartë të shkollave misterike egjiptiane quhej Muse, Mose ose... Moisi[7]. Manethi, historian egjiptian që ka jetuar në shekullin e tretë para Krishtit dhe i cituar nga historiani hebre Jozefus, mbron idenë se Moisiu ka qenë një prift i Heliopolisit ose ON-së (Vend i Diellit) dhe se, vetëm më pas, mori emrin Mosheh ose Moisi[8]. Fjala "Moisi" do të thotë "ai që është rrëmbyer tutje, ai që është nxjerrë nga ujërat, që është bërë misionar, ambasador, apostull"[9]. Prifti më i Lartë i tempujve egjiptianë quhej EOVE ose EOVA, prej nga rrjedh emri Jehova[10], dhe gjuha hebraike është pikërisht gjuha e shenjtë e shkollave misterike egjiptiane[11]. Gjuha më e përhapur në Egjipt quhej QBT ose KBT dhe është e njohur më së shumti si gjuhë kopte. Gjuha e shenjtë e shkollave misterike e

mori emrin e saj nga "OBR" ose "ABR" që, në atë epokë, tregonte kalimin nga njëri vend në tjetrin dhe një farë tipi gjendjeje kalimtare. Më saktë, ajo i referohej thelbit të mësimdhënieve origjinale, të dhëna nga shkollat misterike: një gjendje kalimtare drejt një ndriçimi më të madh. ABR u bë "Ambres", emri i doktrinës së shenjtë e rezervuar për anëtarët këtyre shkollave, dhe ka qenë shkruar edhe Ambric, Hebric, Hebraic dhe Ebraico (Hebraik)[12]. Alfabeti hebraik ka 22 gërma, por ai origjinal, para epokës së Moisiut, përmbante vetëm dhjetë, dhe kuptimi i tij i vërtetë ishte i njohur vetëm prej priftërinjve.

Hebrejtë nuk ishin izraelitë ose judej; ishin anëtarë të shkollave misterike egjiptiane, ose të paktën ishin themeluesit e tyre. Nuk të çudit pra që ka qenë e pamundur të identifikoje një "racë" gjenetike hebraike apo judaike. Kohen, emri hebraik i rezervuar për priftërinjtë, rrjedh nga Kahen, shqiptim egjiptian i fjalës "prift" dhe "princ"[13]. Deri edhe tradita tipikisht hebraike e synetit rrjedh nga shkollat misterike egjiptiane dhe ishte praktikuar që prej të paktën 4000 vjetësh para Krishtit. Nuk mund të ishe anëtar i shkollave misterike pa prerjen e synetit. Feja hebraike nuk ekzistonte në Egjipt dhe nuk ka patur asnjë ligj hebraik, sepse nuk ka pasur asnjë "racë" hebraike. I vetmi kult ishte ai egjiptian. Feja, gjuha dhe raca hebraike dolën në dritë vetëm kur anëtarët e mistereve egjiptiane, që pastaj do të jene bërë të njohur si levitë, i morën me vete ato dije jashtë Egjiptit dhe shpikën një histori të bukur për të mbuluar atë çka ishin duke bërë, ata për të cilët ishin duke punuar dhe origjinën e tyre të vërtetë. Termi "hebraik" dhe "judaizëm" janë një tjetër mënyrë për të thënë "egjiptian". Kjo është një arsye përse sot vëmë re përdorimin e vazhdueshëm nga ana e Vëllazërisë të simboleve që rifillojnë në Egjipt, përfshirë piramidën pa gurin e kurorëzimit. Kjo të sjell ndërmend Piramidën e Madhe të Gizës dhe shkollat misterike egjiptiane, përveç se kanë kuptime mjaft më të thella. Në hyrje të tempullit të shkollës misterike egjiptiane ngriheshin dy obelisqe madhështorë. Ato paraqiten shpesh si dy shtylla nga masonët dhe në ndërtesat e projektura e të financuara nga anëtarët e Vëllazërisë. Prej këtej rrjedhin dy shtyllat e shkatërruara prej Sansonit. Çdo anëtar i shkollave misterike merrte një emër sekret dhe kjo praktikë ekziston edhe sot e kësaj dite brenda Vëllazërisë. Një lidhje me hebrejtë e Egjiptit mund të jetë përfaqësuar nga dyndja e Hyksosve ose mbretit Pastori. Historiani egjiptian Manethi shkruan se një fis i çuditshëm barbar u dynd dhe pushtoi Egjiptin. Kur, më pas, që dëbuar, vazhdon Manethi, ai fis përshkoi Sirinë dhe themeloi një qytet të quajtur Jeruzalem[14]. Hyksosët mund të jenë identifikuar edhe me një popull të përshkruar në mënyrë të ngjashme dhe të quajtur Habiru, që vinte nga ato troje që kishin qenë tokat e sumerëve, si edhe gjithashtu, duke qëndruar tek Testamenti i Vjetër, me popullin e Abrahamëve.

Gjejmë të tjera kuptime simbolike në figurën e mbretit Solomon dhe në tempullin e tij. Prapë edhe një herë, nuk kemi as edhe një provë të vogël të ekzistrencës së ndonjë njeriu të quajtur Solomon. As edhe emri i tij nuk është shfaqur kurrë në ndonjë mbishkrim. Para se levitët të shkruanin tekstet e tyre, historiani grek Herodoti (rreth viteve 485-425 para Krishtit) udhëtoi në tokat e Egjiptit e të Lindjes së Afërt dhe studioi historinë e tyre. Nuk gjeti asgjë mbi perandorinë e Solomonit, mbi eksodin në masë të izraelitëve prej Egjiptit, apo mbi disfatën në Detin e Kuq të ushtrisë egjiptiane, që i ndiqte. Dhe nuk pati asnjë dijeni për të gjithë këtë as edhe Platoni që udhëtoi në po ato troje. Pse? Sepse janë të gjitha trillime. Të tria rrokjet që përbëjnë emrin "Sol-om-on" janë të gjitha emra të Diellit në tri gjuhë të ndryshme. Menli P. Hall ka shkruar se Solomoni dhe gratë e tij e konkuibinat simbolizonin planetet, hënat, asteroidët dhe trupa të tjerë që përceptoheshin brenda shtëpisë së tij - pallatit diellor[15]. Tempulli i Solomonit është një simbol i sundimit të Diellit. Në legjendën talmudike, Solomoni paraqitej si një magjistar ekspert që kuptonte Kabalën dhe largonte djajtë. Dijet sekrete të mbajtura fshehur brenda historive të trilluara, që përbëjnë "historinë" hebraike, paraqesin të tjera kuptime simbolike. *Libri i Mbretërve* dhe ai i *Kronikave*, që tregojnë për ndërtimin e Tempullit të Solomonit, kanë qenë shkruar 500 apo 600 vjet pas ngjarjeve që pretendojnë se kanë përshkruar. Kronistët hebrej, që tregojnë për Tempullin e Solomonit, e teprojnë deri në atë pikë sa të bëhen qesharakë. Nëse e besojmë si të vërtetë atë që ata pohojnë, duhej të arrinim në përfundimin se për ndërtimi e tij u përdorën plot 153.600 punëtorë për shtatë vjet dhe kostoja e tij, e llogaritur nga Artur Dynot Tomsoni, arrin në 6.900 stërlina. Dhe Tomsoni i bëri këto llogaritje në vitin 1872! Sot sa do të arrinte shifra? Shifra të tilla janë absurde dhe përfaqësojnë një vërtetim të mëtejshëm të faktit se këto tregime janë të trilluara. Ato janë simbolike, jo të mirëfillta.

Dhe pastaj ka një çështje tjetër. Nëse Solomoni nuk ka ekzistuar, përse duhet të besojmë se ka ekzistuar "ati" i tij, mbreti David? Unë vazhdoj të lexoj raporte mbi jetën e tij, por të vetmet burime të cituara janë tekstet e Testamentit të Vjetër, të shkruar prej levitëve! Nuk ekzistojnë prova të tjera. Është një mashtrim! E njëjta gjë mund të thuhet për fisin që rrodhi nga mbreti David-Jezus dhe që u shpërngul në Francë bashkë me Maria Magdalenën, ku, sipas shumë studimeve të fundit, u bë fisi i Merovingëve.

Sikurse nënvizon kritiku dhe kërkuesi L.A. Uadëll:

"Nuk ka absolutisht asnjë provë të shkruar të ndonjë farë tipi, as ndonjë vërtetim të lashtë romak apo grek të ekzistencës së Abrahamit, apo të të tjerë patriarkëve ose

profetëve hebrej të Testamentit të Vjetër, as të Moisiut, as të Saulit, as të Davidit, as të Solomonit, as të askujt prej mbretërve hebrej, me përjashtimin e thjesht dyve, apo më e shumta e treve, të mbretërve më të vonë"[16].

Pasojat e gjithë kësaj për ata që e quajnë veten hebrej dhe për njerëzimin në përgjithësi kanë qenë me të vërtetë tronditëse. Ligji Moisinian, ligji i "Moisiut", është ligji i Levitëve – ligji i gjakpastërve dhe i hibridëve të racës së zvarranikëve të Vëllazërisë Babilonase. Ajo çka ai (ligji i "Moisiut") *nuk* është, është ligji apo fjala e Perëndisë. *Toraha* dhe *Talmudi*, që të dy në pjesën më të madhe të përpiluar gjatë ose pas qëndrimimit në Babiloni, të bombardojnë mendjen me një listë ligjesh mjaft të hollësishme, që rregullojnë çdo fushë të jetës njerëzore. Nuk ka asnjë porosi aty të dhënë nga "Perëndia" mbi majën e ndonjë mali. Levitët i kanë shkruar ato ligje dhe pastaj kanë shpikur Moisiun për të fshehur të vërtetën. Që nga ajo kohë disa "ligje" vazhdimisht janë shtuar ose rishikuar, në mënyrë për të parashikuar çdo mundësi. Të gjitha faqet e këtyre teksteve levitike shprehin pikëpamje jashtëzakonisht dhe në mënyrë të neveritshme raciste kundrejt jo-hebrejve dhe mbështesin idenë e nevojës për të "shkatërruar plotësisht" cilindo që nuk respekton këto ligje, saktësisht siç bënin priftërinjtë e magjisë së zezë, sipas asaj të përshkruar nga Menli Halli. Tekstet levitike inkurajojnë çfarëdo tipi vrasjeje dhe sakatimi. Besoj se *Talmudi* është dokumenti më racist i Tokës. Ja këtu më poshtë disa shembuj për të treguar se sa i thellë është korrupsioni shpirtëror që ai shpreh:

"Vetëm Hebrejtë janë qenie njerëzore, jo-Hebrejtë nuk janë qenie njerëzore, por kafshë" **Kerithuth 6b, fq. 78, Jebhammoth 61.**

"Jo-hebrejtë janë krijuar për t`u shërbyer hebrejve si skllevër" **Midrasch Talpioth 225.**

"Marrëdhëniet seksuale me jo-hebrejtë janë si marrëdhëniet seksuale me kafshët" **Kethuboth 3b.**

"Jo-hebrejtë janë për t`ju shmangur më shumë se kafshëve të sëmura" **Orach Chaiim 57, 6a.**

"Përqindja e lindshmërisë së jo-hebrejve duhet të zvogëlohet në mënyrë drastike" **Zohar 11, 4b.**

LIBRI 24

"Siç zëvendësoni mushkat dhe gomerët e humbur, ashtu duhet t`i zëvendësoni jo-hebrejtë" **Lore Dea 377,1.**

Por nuk është fjala vetëm për një doktrinë groteske raciste. Vini re mirë. Bëhet fjalë për të njëjtën sjellje që raca e zvarranikëve Drako dhe vartësit e tyre ushqejnë kundrejt qenieve njerëzore. Mos harroni se këto shpifësira nuk kanë qenë shkruar nga judejtë ose nga "hebrejtë" si popull. Ata janë viktima të këtyre parimeve të besimit, nuk janë autorët e tyre. Ata që i kanë shkruar kanë qenë levitët, përfaqësuesit e familjeve klerikale të racës së zvarranikëve dhe të Vëllazërisë Babilonase, që nuk kanë më shumë lidhje me popullin hebrej nga sa kishte Hitleri me të. T`ua atribuosh "hebrejve" është një absurditet dhe është saktësisht kjo ajo që Vëllazëria dëshiron të bëjnë njerëzit, sepse kjo lejon zbatimin e metodës "përça e sundo", mbi të cilën ajo bazon kontrollin e saj. Çfarë tmerresh ka shkaktuar ky manipulim si për "hebrejtë" edhe për "paganët"! E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ligjin gojor hebraik të quajtur *Mishnah*, i përfunduar në shekullin e dytë pas Krishtit. Izrael Shahaku, një i mbijetuar i kampit të përqëndrimit të Belsenit, është njëri prej të paktëve njerëz midis atyre që sot e quajnë veten hebre, që ka pasur guximin ta sfidojë hapur *Talmudin*. Shahaku, në librin e tij *Jewish History, Jewish Religion*, hedh dritë mbi nivelin e mahnitshëm të racizmit të shprehur nga ligji "hebraik" (levitik, i Vëllazërisë). Ai mbron idenë se, sipas interpretimit më radikal të këtij "besimi", i përfaqësuar nga rabinët e sotëm ortodoksë, të shpëtosh jetën e një "pagani" konsiderohet një mëkat, mjaft që të mos bërit të mos ketë pasoja shkatërrimtare për hebrejtë. Vënia e interesave mbi huatë e dhëna një vëllai hebre është e përjashtuar, por ligji talmudik parashikon se, nëse huaja i jepet një pagani, interesat duhet të jenë sa më të larta që të jetë e mundur. Është parashkruar edhe që hebrejtë të shqiptojnë një mallkim sa herë që kalojnë pranë ndonjë varreze pagane dhe kur të kalojnë pranë ndonjë ndërtese pagane t`i luten Zotit ta shkatërrojë. Hebrejve u është e ndaluar t`i hanë hakun njëri-tjetrit, por një ligj i tillë nuk shtrihet kundrejt paganëve. Me disa prej lutjeve të tyre hebrejtë falënderojnë Zotin që nuk i ka krijuar paganë, ndërsa me të tjera luten për vdekjen e menjëhershme të të krishterëve. Një hebre respektues i besimit nuk duhet të pijë nga një shishe vere që, pas hapjes së saj, është prekur nga një pagan. Shkrimtari hebre Agnon, pasi iu dha çmimi Nobel për letërsinë, tha në radion izraeliane: "Nuk e kam harruar që është e ndaluar të lavdërosh paganët, por këtu ka një arsye të veçantë për ta bërë... domethënë ajo që ia kanë dhënë çmimin një hebreji"[17].

Këto janë ligjet e sistemit të besimeve të ashtuquajtur "hebraik", që qahet

vazhdimisht, dhe dënon, ndaj racizmit kundrejt hebrejve! Vetë ky sistem besimesh bazohet mbi racizmin më të skajshëm që ju mund të gjeni. E, megjithatë, akuza për "antisemitizëm" përdoret për të diskreditуar ata kërkues që i afrohen tepër së vërtetës mbi përbetimin global. Benjamin Fridmani, një hebre që ka njohur sionistët më të spikatur (Ithtarët e kultit të Diellit) të viteve Tridhjetë dhe Dyzet të shekullit të kaluar, ka thënë se fjala "antisemitizëm" duhej të hiqej nga gjuha angleze.

Dhe ka shtuar:

"Antisemitizmi ka vetëm një qëllim sot: përdoret si një epitet. Kur të ashtuquajturit hebrej kuptojnë se dikush pengon objektivat e tyre të vërteta, i diskreditojnë viktimat e tyre duke i quajtur "antisemitë" ose "antisemitikë", duke iu drejtuar të gjitha kanaleve që kanë në dispozicionin e tyre dhe nën kontrollin e tyre"[18].

Njëri prej këtyre kanaleve është një organizatë, e cila e ka selinë në Shtetet e Bashkuara e që vepron në të gjithë botën dhe që ka qenë themeluar me qëllimin e përpiktë për të damkosur me racizëm të gjithë ata që përhapin lajme mbi Vëllazërinë. Quhet Lidhja Anti-Shpifje (ADL) dhe unë vetë kam qenë një objektiv i saj, diçka që e quaj ngushëlluese dhe që vërteton se jam duke ecur në drejtimin e duhur. Ajo përkrahet nga mbështetës jo-hebrej, të cilët dëshirojnë ta mbajnë urtë dhe kënaqin kështu dëshirën e tyre për t'u treguar të pastër. Do të filloj t'i marr seriozisht lëvizjet "antiraciste" hipokrite e fanatike, kur të fillojnë të protestojnë kundër të gjitha formave të racizmit dhe jo vetëm ato që nxjerrin në pah korrektësinë e tyre politike. Era e qelbur e hipokrizisë më mbyt! Racizmi i levitëve nuk pranohet nga shumica dërrmuese e popullsisë hebreje dhe shumë prej tyre janë rebeluar ndaj ligjeve të rrepta hebraike, që i urdhërojnë hebrejtë të martohen vetëm me bashkëgjakësit hebrej. Pjesa më e madhe e njerëzve që e quajnë veten hebrej janë rritur që nga lindja në mënyrë të atillë për t'u bërë kukulla të indoktrinuara dhe të terrorizuar nga klasa levitike e pabesë, e cila është shndërruar në klasën e farisejve, të talmudistëve dhe të sionistëve ekztremistë të sotëm, të kontrolluar nga kabinët fanatikë, që përhapin "ligjin" e levitëve të Babilonisë për llogari të racës së zvarranikëve. Pjesa më e madhe e ithtarëve të besimeve të krijuara kështu nuk e ka idenë e origjinës së vërtetë të atyre planeve. Kjo mbetet privilegj i një elite shumë të vogël në nivelet më të larta të rrjetit të shoqërive të fshehta, e cila themelon e manipulon besimet dhe përkrahësit e tyre. Atyre nuk u bëhet vonë aspak për ithtarët e tyre, qofshin ata hebrej, katolikë, myslimanë,

apo të tjerë. Një dëshmim i mëtejshëm i faktit që, të gjitha këto besime fetare dhe këto raca, janë në realitet një mashtrim që furnizojnë popullsitë e njohura si "hebreje". Sikurse kanë zbuluar shkrimtarë dhe antropologë hebrej, nuk ekziston diçka si "raca hebreje". Të qenurit hebre i referohet besimit fetar, jo racës. Koncepti i popullit "hebre" ka qenë fabrikuar artificialisht, si mbulesë. Alfred M. Lilenthali, autor dhe kërkues hebre, ka thënë:

"Nuk ekziston antropolog i respektueshëm që të mos pajtohet mbi faktin se racizmi hebre është po aq shumë i marrë sa edhe racizmi arian... Antropologjia e ndan gjininë njerëzore në tri raca të njohura: ajo e zezë, ajo mongole ose lindore dhe ajo kaukazike ose e bardhë (edhe pse disa shkencëtarë me autoritet aludojnë për një racë të katërt: australoidët... Përkrahësit e besimit hebraik gjenden në të tria këto raca e nëndarje"[19].

Fakti është, megjithatë, se brenda besimit hebraik dhe të kulturave të tjera, vepron nën paraqitje të rreme një racë e fshehtë, e përbërë prej familje hibridësh dhe gjakpastrish të racës së zvarranikëve. Këto familje, duken në pamje të jashtme sikur bëjnë pjesë në ato besime e në ato kultura, ndërsa në realitet ndjekin të vetmin qëllim për t'i burgosur mendërisht dhe manipuluar. E njëjta gjë ndodh edhe me levitët. Çështja bëhet edhe më komike e më e kuptueshme se bota me perde tymi në të cilën jetojmë, nëse mendohet se pjesa më e madhe e njerëzve, që sot e quajnë veten hebre, nuk kanë asnjë lidhje gjenetike me tokën që e quajmë Izrael. E, megjithatë, pikërisht mbi bazën e kësaj lidhjeje u justifikua diktimi i një kombi "hebraik" ndaj popujve arabë të Palestinës! Prapë edhe një herë, sikurse është nënvizuar nga shkrimtarë hebrej si Artur Koestleri, të gjithë ata që themeluan dhe populluan Shtetin e Izraelit, me përjashtim të një pakice të vogël, vinin me origjinë nga Rusia, jo nga Izraeli. Hunda si sqep, e quajtur tipikisht "hebreje" është një tipar trupor tipik i Rusisë jugore dhe i Kaukazit, jo i Izraelit. Në vitin 740 pas Krishtit populli i quajtur Khazar u konvertua në masë në judaizëm. Shkruan Koestleri:

"Khazarët nuk vinin nga lumi Jordan, por nga Vollga, jo nga Kanani (Palestina), *por nga Kaukazi. Gjenetikisht ata janë më afër Hunëve, Ugrëve dhe Hungarezëve se sa sojit të Abrahamit, të Isakut dhe të Jakobit. Historia e perandorisë Khazar, sikurse po del mengadalë në dritë nga e kaluara, po fillon të përvijohet si rrengu më mizor që historia ka bërë ndonjëherë"*[20].

LIBRI 24

Ekzistojnë dy nëngrupe kryesore të atyre që vetëquhen hebrej, sefardimët dhe ashkenazimët. Sefardimët janë pasardhës të atyre që kanë jetuar në Spanjë nga kohërat e lashta deri në shekullin XV, kur u dëbuan. Ashkenazimët janë paraardhësit e khazarëve. Në vitet Shtatëdhjetë të shekullit të kaluar qe llogaritur se numri i sefardimëve rrotullohej rreth një gjysmë milioni, ndërsa ai i ashkenazimëve arrinte tek njëmbëdhjetë milionët. Këta njëmbëdhjetë milionë, edhe pse duke mos pasur asnjë lidhje historike me Izraelin, pushtuan Palestinën dhe themeluan Shtetin e Izraelit me justifikimin se "Zoti" ua kishte premtuar atyre tokën në Testamentin e Vjetër. Kush e kishte shkruar Testamentin e Vjetër? Priftërinjtë e tyre, levitët! Dhe kush e shkroi Testamentin e Ri, mbi të cilin bazohet krishtërimi? Njerëzit e kontrolluar nga po ajo forcë që kontrollonte levitët, Vëllazëria Babilonase.

Testamenti i Ri

Në rregull, bëjmë një kuic të vogël. Për çfarë jam duke folur?

Lindi nga një virgjëreshë nëpërmjet ngjizjes së papërlyer përmes ndërhyrjes së shpirtit të shenjtë. Me këtë vërtetohej një profeci e lashtë. Kur lindi, tirani asokohe në fuqi donte ta vriste. Prindërit e tij u detyruan të arratiseshin në një vend të sigurtë. Të gjithë fëmijët e seksit mashkull nën moshën dy vjeç u vranë me urdhër të sovranit, që donte ta vriste atë fëmijë. Engjëj dhe barinj shpirtërorë e pritën në lindje dhe i dhanë pa kursyer si dhuratë ar, temjan e mirrë. U nderua si shpëtimtar i njerëzve dhe bëri një jetë të virtytshme e të thjeshtë. Kreu mrekulli, midis të cilave shërimin e të sëmurëve, kthimin e shikimit të verbërve, largimin e shpirtrave të këqinj dhe ringjalljen e të vdekurve. U ekzekutua në kryq midis dy hajdutëve. Zbriti në ferr dhe u ringjall prej të vdekurve, për t'u ngjitur përsëri në parajsë[21].

Duket pikërisht sikur është fjala për Jezusin, apo jo?

Por nuk është ai. Kështu përshkruhet perëndia shpëtimtare lindore e njohur si Virishna, 1.200 vjet përpara lindjes së hamendësuar të Krishtit. Nëse kërkoni një perëndi shpëtimtare që të vdesë me qëllim që mëkatet tona të mund të falen, nuk ju duhet shumë mund përveç sikletit të zgjedhjes, sepse bota e lashtë na ofron një mori të tillë, të gjithë të lidhur me racën ariane dhe ariano-zvarranike të ardhur nga Lindja e Afërt dhe nga malet e Kaukazit. Ja vetëm disa prej figurave heroike prej "Bijve të Perëndisë", protagonistë historish shumë të ngjashme me atë të Jezusit, por mjaft më të lashta:

Khrishna në Hindustan; Buda Sakia në Indi; Salivahana në ishujt

Bermude; Osiridi dhe Horusi në Egjipt; Odini në Skandinavi; Kriti në Kaldea; Zarathustra në Persi; Baal e Taut në Feniki; Indra në Tibet; Bali në Afganistan; Jao në Nepal; Vitoba në Bilingo; Tamuzi në Siri e Babiloni; Atisi në Frigji; Ksamolksis në Trakì; Zoar i Bonzëve; Adadi në Asiri; Deva Tatí e Samonokadami në Siam; Alkidi në Tebë; Mikadoja midis sintove; Bedrui në Japoni; Hesusi ose Erosi dhe Bremrillahmi midis druidëve; Thori, i biri i Odinit, midis galëve; Kadmi në Greqi; Hili e Feta midis mandejve; Xhentauti dhe Kuetzalkoatli në Meksikë; Monarku Universal i Sibileve; Iski i Formozës; Mjeshtri Hyjnor i Platonit; I Shenjti i Ksakës; Fohi dhe Tieni në Kinë; Adoni, i biri i virgjëreshës Io në Greqi; Isioni dhe Kuirinoja në Romë; Prometeu në Kaukaz dhe Muhameti në Arabi[22].

Gati të gjithë këta "Bij të Perëndisë", ose "profetë" dhe besimet fetare që burgosin mendjen, të themeluara në emër të tyre, vijnë pikërisht nga ato toka të pushtuara, ose të kontrolluara nga populsitë me prejardhje të Lindjes së afërt dhe të Kaukazit: tokat e arianëve dhe të ariano-zvarranikëve. Është një "bir i Perëndisë" edhe Mitra ose Mithrasi, një mbret romako-persian para-i krishterë, ndërsa në Greqi dhe në Azinë e Vogël (Turqi) ishin Dionisi dhe Baku. Këta bij të Perëndisë që vdiqën me qëllim që mëkatet tona të mund të faleshin, ishin lindur të gjithë nga nëna të virgjëra, dhe dita e lindjes së tyre binte më... 25 dhjetor! Mitra kryqëzohet, por ringjallet më 25 mars, për Pashkë! Ceremonitë ndaj Mitras kryheshin në shpella të zbukuruara me simbolet e Bricjapit dhe të Gaforres, që përfaqësojnë solsticin dimëror dhe atë veror, pikën më të ulët dhe pikën më të lartë të Diellit. Mitra paraqitej shpesh si një luan me krah, një simbol i Diellit i përdorur akoma sot e kësaj dite nga disa shoqëri të fshehta. Shenjat e luanit dhe të "kapjes së putrës së luanit", që i referohen gradës masonike të Mjeshtrit Mason, rrjedhin nga po ky simbolizëm i përhapur prej shkollave misterike. Anëtarët e shoqërisë së fshehtë të riteve të Mitras quheshin "luanë" dhe damkoseshin në ballë me kryqin egjiptian. Anëtarëve të nivelit të parë u vendosej mbi kokë një kurorë e artë, që përfaqësonte unin e tyre shpirtëror dhe, një kurorë të tillë, që simbolizonte rrezet e Diellit, e gjejmë edhe mbi Statujën e Lirisë, në portin e Nju Jorkut. Të gjitha këto rituale e kanë burimin mijëra vjet më parë, në kohërat e Babilonisë dhe tek historitë e Nimrodit, të mbretëreshës Semiramidë dhe të Tamuzit, që përkon me Jezusin tonë. Besohej se Mitra ishte i biri (Diell) i perëndisë së vdekur për të shpëtuar njerëzimin dhe për t'i dhuruar jetën e përjetshme. Një paraqitje simbolike klasike e Mitras është ajo e luanit që mban çelësat e parajsës, me një gjarpër të përdredhur përreth trupit. Ky simbolizëm përsëritet

LIBRI 24

herë pas here edhe në paraqitjet e Nimrodit dhe prej këtej e ka prejardhjen historia e shën Pjetrit, njërit prej dymbëdhjetë apostujve të Jezusit, që mban çelësat e Parajsës. Pjetër ishte emri me të cilin, në shkollat misterike Babilonase, quhej prifti më i lartë. Pasi njëri anëtar i kultit të Mitras e kishte kryer ritualin, anëtarët e tjerë hanin bukë e verë, duke besuar se hanin trupin e Mitras dhe se pinin gjakun e tij. Thuhej se Mitra, sikurse një radhë shumë e gjatë perëndish para-të krishtere, ishte nderuar, në çastin e lindjes, nga vizita e njerëzve të urtë që i kishin dhuruar ar, temian dhe mirrë. Në Greqinë e lashtë, Platoni tregonte të njëjtat gjëra për mësuesin e tij, Sokratin. Krishtërimi është një kult diellor pagan dhe të mendosh që përkrahja ndaj kulteve të këtij lloji dënohet pikërisht nga krishtërimi! Është edhe një besim astrologjik e, megjithatë, vetë krishtërimi, dhe papa para të gjithëve, e quan astrologjinë si një të "keqe"! Gjëra prej të marrësh! Hierarkia kishtare di gjithçka, natyrisht. Por nuk dëshiron që *ju* t'i dini. Kulti misterik i Mitras u përhap nga Persia në Perandorinë Romake dhe pastaj në të gjithë Evropën. Vendi, në të cilin sot ngrihet Vatikani, ka qenë i shenjtë për ithtarët e Mitras dhe figura e tij e disa simbole të lidhura me të janë gjetur mbi shkëmbinj të gdhendur e mbi pllakëza qeramike në të gjitha provincat perëndimore të Perandorisë Romake, përfshirë Gjermaninë, Francën dhe Britaninë e Madhe. Krishtërimi dhe Kisha Katolike e kanë bazuar kultin e tyre mbi perëndinë-Diell persiano-romake të quajtur Mitra (Nimrod), që ka një të barasvlershëm të mëparshëm në Indi, i quajtur gjithashtu Mitra. Thuhej se Tamuzi ose Adonisi (Perëndi), perëndi e nderuar në Babiloni dhe Siri, kishte lindur në mesnatën e 24 dhjetorit. Edhe këta ishin "bij" të Perëndisë.

Horusi ishte "bir" i Perëndisë egjiptiane. Rridhte nga babilonasi Tamuz dhe, nga ana e tij, dha pikënisjen për më të mëvonshmin Jezus. Këto lidhje janë shkatërruese për besueshmërinë e Kishës së Krishterë: Jezusi ishte "Drita e Botës"; Horusi ishte "Drita e Botës"; Jezusi thoshte se ishte "rruga, e vërteta dhe jeta"; Horusi thoshte se ishte "e vërteta, jeta"; Jezusi lindi në Betlehem, "shtëpia e bukës"; Horusi lindi në Annu, "vendi i bukës"; Jezusi ishte Bariu i Mirë; Horusi ishte Bariu i Mirë; shtatë peshkatarë hipën në bordin e një barke me Jezusin; shtatë njerëz hipën në bordin e një barke me Horusin; Jezusi ishte engjëll; Horusi ishte engjëll; simboli i Jezusit është kryqi; simboli i Horusit ishte një kryq; Jezusi qe pagëzuar në moshën 30 vjeç; Horusi qe pagëzuar në moshën 30 vjeç; Jezusi lindi nga një virgjëreshë, Maria; Horusi lindi nga një virgjëreshë, Isida; lindja e Jezusit qe paralajmëruar nga një yll; lindja e Horusit qe paralajmëruar nga një yll; Jezusi qe mësuesi fëmijë në tempull; Horusi qe mësuesi fëmijë në tempull; Jezusi pati 12 apostuj; Horusi pati 12 ithtarë; Jezusi qe "Ylli i Mëngjesit"; Horusi qe "Ylli i Mëngjesit"; Jezusi

qe Krishti; Horusi qe Krst-i; Jezusi qe joshur nga Satanaja mbi një mal; Horusi qe joshur nga Set-i mbi një mal[23].

Thuhet se Jezusi është "gjykatësi i të vdekurve". Por dikush tjetër përpiqet t'i marrë titullin. E njëjta gjë, në fakt, thuhej edhe për të mëparshmit Nimrod, Khrishna, Buda, Ormuzd, Osirid, Aekus e të tjerë. Jezusi është alfa dhe omega, kreu dhe fundi. E njëjta gjë thuhej për Khrishnën, Budën, Lao-kiun, Bakun, Zeusin e të tjerë. Jezusit i janë atribuar mrekulli, si shërimi i të sëmurëve ose ringjallja e të vdekurve. Të njëjtat mrekulli u qenë atribuar Khrishnës, Budës, Zarathustrës, Bokias, Horusit, Osiridit, Serapisit, Mardukut, Bakut, Hermesit e të tjerëve. Jezusi ishte me gjak mbretëror. Kështu Buda, Rama, Fo-hi, Horusi, Herakliu, Baku, Perseu e të tjerë. Jezusi lindi nga një virgjëreshë. Kështu Khrishna, Buda, Lao-kiuni ose Tszeu, Konfuci, Horusi, Raja, Zarathustra, Prometeu, Perseu, Apolloni, Merkuri, Balduri, Kuetzalkoatli dhe shumë të tjerë, që do të ishte e pamundur t'i përmendnim të gjithë. Jezusi, kështu na thuhet, do të rilindë një herë tjetër. Qielli atëhere do të jetë mjaft i populluar, duke qenë se do të jenë edhe Khrishna, Vishnuja, Buda, Kuatzalkoatli e të tjerë. "Ylli" që u shfaq në lindjen e Jezusit është një tjetër element i njëjtë për shumë perëndi dhe e ka burimin të paktën tek legjenda babilonase e Nimrodit që, në ëndërr, pa një yll vezullues të ngrihej sipër horizontit. Falltarët i thanë se ai paralajmëronte lindjen e një fëmije, që do të ishte bërë një princ i madh[24]. Është gjithçka një riciklim. Jezusi është një figurë mitike.

Personazi i trilluar i Jezusit bazohej mbi një figurë të perëndisë-diell, një simbol i "Diellit" hyjnor... "Drita e Botës". Pikërisht kjo shprehje, "Drita e Botës", që përdorur nga fenikas-arianët për ta hedhur fjalën për "perëndinë e vetme të vërtetë" mijëra vjet përpara lindjes së Abrahamit të hamendësuar, të cilit gabimisht i atribuohet autorësia e idesë së besimit monoteist[25]. Ata paraqisnin edhe të vetmin perëndi të vërtetë, Diellin, me të "vetmin kryq të vërtetë"[26]. Të krishterët e paraqesin Jezusin me një brerore përreth kokës, në të njëjtën mënyrë identike me të cilën fenikasit paraqisnin rrezet e Diellit përreth kokës së perëndisë-Diell të tyre, Bel apo Bil. Mund të shihet në një shtyllë varri fenikase, që i takon afërsisht shekullit IV para Krishtit (shiko ***Figura 14***). Dielli ishte thelbi i besimit egjiptian dhe, në mesditë, kur Dielli mbërrinte kulmin e rrugës së tij të përditshme, egjiptianët faleshin duke iu drejtuar "Shumë të Lartit". Në atë çast, thoshin, Dielli i kushtohej veprës së të atit në tempull. Nënat virgjëresha, që u shoqërohen të gjitha këtyre perëndive diellore, ishin versione të ndryshme të mbretëreshës Semiramidë dhe të Ninkharsagut, e njohur edhe si Isidë, simbol egjiptian i fuqisë krijuese femërore, pa të cilin asgjë, as edhe Dielli, nuk mund të ekzistonte. Gjatë shekujve, emrat dikur të përdorur për të treguar "perëndi"

LIBRI 24

jashtëtokësore, u përdorën për të përshkruar koncepte e parime ekzoterike. Epoka e kultura të ndryshme u dhanë emra të ndryshëm po këtyre koncepteve dhe kështu tek Ungjijtë, Horusi bëhet Jezus dhe Isida bëhet Marie, nëna virgjëreshë e Jezusit, Diellit. Maria vazhdimisht paraqitet me në krah Jezusin Fëmijë, por është fjala për një riparaqitje të thjeshtë të skemës ikonografike egjiptiane, në të cilën Isida mban në krah Horusin (shiko ***Figura 15***). Këta persona nuk kanë ekzistuar me të vërtetë, janë vetëm ca simbole. Isida i qe shoqëruar shenjës astrologjike të Virgjëreshës, si edhe Maria. Titujt "Ylli i Detit" dhe "Mbretëresha e Qiellit" që i qenë dhënë Isidës, qenë shtrirë pastaj edhe për Marien; që të dy këta tituj rridhnin nga mbretëresha Semiramidë, që në Babiloni ishte quajtur "Mbretëreshë e Qiellit". Krishtërimi dhe judaizmi nuk janë gjë tjetër veçse një tjetër faqe e besimit babilonas. Në të gjithë botën do të gjeni të njëjtat kulte e rituale të lidhura me Diellin: në Sumeri, në Babiloni, në Asiri, në Egjipt, në Britaninë e Madhe, në Greqi, në Evropë, në Meksikë, në Amerikën Qendrore, në Australi... kudo.



Figura 14. *Një shtyllë varri fenikase që paraqet perëndinë-Diell Bel apo Bil, me brerorën, që simbolizon rrezet e Diellit. Kjo paraqitje përkon në mënyrë të përkryer me atë të Jezusit, pasi edhe ai ishte një simbol i Diellit.*



Figura 15. *Maria dhe Jezusi? Jo, kjo është mënyra me të cilën egjiptianët paraqisnin Isidën dhe Horusin. Për babilonasit, përkundrazi, ky imazh paraqiste mbretëreshën Semiramidë dhe Tamuzin.*

Bëhet fjalë për një besim të përbotshëm, që frymëzohet nga i njëjti burim, me natyrë jashtëtokësore, dhe që i takon një periudhe mijëra vjet para krishtërimit. Kulti i Diellit dhe i zjarrit ka qenë në qendër të shumë besimeve indiane, kremtimet e të cilave ishin të lidhura me lëvizjen e Diellit në harkun e vitit[27], dhe në historinë e Jezusit do të gjeni referime të vazhdueshme simbolike ndaj Diellit, përveçse ndaj astrologjisë dhe ndaj

simbolizmit të shkollave misterike. Kurora me gjemba simbolizon rrezet e Diellit, pikërisht ashtu sikurse kurora me maja mbi kokën e Statujës së Lirisë.

Edhe kryqi të rikthen tek simbolizmi diellor dhe astrologjik, sikurse keni parë më parë në rastin e kryqit dhe të rrethit. Leonardo da Vinçi, Mjeshtri i Madh i Manastirit të Sionit (Diellit), i përdori po këto simbole në pikturën e tij të famshme të Darkës së Fundit (shiko ***Figura 16***). Ai i ndan të dymbëdhjetë apostujt në katër grupe me nga tre, duke e vendosur në mes Jezusin, "Diellin". Bëhet fjalë përsëri për simbolizëm astrologjik të riparaqitur nga një anëtar i lartë i shoqërive të fshehta dhe i shkollave misterike, që ishte në dijeni të së vërtetës. Nuk është për t`u përjashtuar që Leonardoja ta ketë paraqitur njërin prej apostujve me tipare femërore, në nderim të hyjneshës që përkon me të larmishmet Isidë, Barati, Semiramidë etj. Ajo simbolizohej me një "M" që do të thoshte "Marie" apo "Madonë" (Semiramidë).



Figura 16. *Darka e Fundit* e Leonardo da Vinçit. Vrojtoni se si artisti ia atribuon Jezusit vlerën simbolike të Diellit, duke i ndarë të dymbëdhjetë apostujt në katër grupe me nga tre - shenjat e zodiakut. Bëhet fjalë për një version piktoresk të rrethit diellor dhe të kryqit që e kemi parë tashmë më përpara.

Thuhet se Jezusi ka lindur më 25 dhjetor, një datë që të krishterët e huazuan nga kultet diellore të "Sol Invictus"-it (Diell i Pamposhtur) për arsyet që i kam shpjeguar më lart. Thuhet edhe se ai është kryqëzuar në Pashkë. Ja pra një rivizitë e mëtejshme në të njëjtën histori të lashtë. Në simbolizmin astrologjik egjiptianët e paraqisnin Osiridin vetë mbi një kryq. Sipas të lashtëve, Diellit iu deshën tri ditë për ta rimarrë veten nga "vdekja" e ndodhur më 21/22 dhjetor. Sa ditë kalojnë tek Ungjijtë midis "vdekjes" dhe "ringjalljes" së Jezusit? Tri! E njëjta kohë që ju desh Tamuzit, bir i Perëndisë babilonase, për t`u ringjallur. Ja se si e përshkruan *Ungjilli i Lukës* atë që ndodhi kur Jezusi (Dielli) vdiq në kryq:

"Ishte afër mesditës, kur dielli u zu dhe u bë errësirë në të gjithë tokën gjer në orën tre të pasdites..." **Luka, 23, 44-45.**

Biri/Diell kishte vdekur dhe prandaj mbretëronte errësira. Dhe shikoni për sa orë zgjati e gjitha kjo: tri orë. Të njëjtën histori, sipas së cilës pas vdekjes pason errësira, induistët e tregojnë për Khrishnën, budistët për Budën, grekët për Herakliun, meksikanët për Kuetzalkoatlin, dhe kështu me radhë në pafundësi, derisa arrin tek Jezusi. Kur vdiq, Jezusi "zbriti në ferr", pikërisht ashtu sikurse para tij kishin bërë Khrishna, Buda, Zarathustra, Adonis/Tamuzi, Osiridi, Mitra, Herakliu dhe Balduri. Jezusi kryqëzohet simbolikisht në Pashkë, pasi në atë periudhë bie ekuinoksi i pranverës, kur Dielli (Jezusi) hyn në shenjën astrologjike të Dashit apo... qengjit. Me këtë simbol të qengjit rifilloi *Libri i Zbulesës*. Afërsisht rreth vitit 2200 para Krishtit grupi i njohur si Priftërinj të Melkizedekut filloi të vishte përparëse me lesh qengji, një praktikë simbolike akoma sot e ndjekur nga një fraksion modern i Vëllazërisë dhe Masonerisë. Ndodh pikërisht në Pashkë, në përkim me ekuinoksin e pranverës, që Jezusi (Dielli) triumfon mbi errësirën – në periudhën e vitit kur orët e dritës i kalojnë ato të errësirës. Bota shpëtohet falë fuqisë së Diellit që rilind: prej këtej rrjedh karakteri i shenjtë që egjiptianët i atribuonin ekuinoksit të pranverës. Mbretëresha Isidë paraqitej shpesh me kokën e dashit, për të simbolizuar se periudha e Dashit, pranvera, përkonte me periudhën e rilindjes së natyrës. Festa e Pashkës për të krishterët e parë ishte po aq e rëndësishme sa edhe 25 dhjetori. Sipas legjendës, Mitra qe kryqëzuar dhe u ringjall më 25 Mars. Sot Pashka nuk bie më ditën e parë të Dashit, por simbolizmi zanafillor mbetet. E diela (në anglisht "SUNday", fjalë për fjalë, "ditë e diellit") është për të krishterët një ditë festive. Kishat e krishtera orientohen mbi boshtin lindje-perëndim me altarin të kthyer nga lindja. Kjo do të thotë që grumbulli i besimtarëve të vështrojë drejt lindjes – drejtimi i Diellit që lind. Deri edhe vezët e Pashkës, ashtu sikurse edhe kuleçët anglezë me kryqin të gdhendur përsipër, nuk janë një traditë e krishterë. Në Egjipt dhe në Persi, përveçse në shumë vende të tjera, me rastin e Pashkës u ofroheshin perëndive vezë të pikturuara. Në këtë pikë të bën për të qeshur ideja që autoritetet e Uestmanster Abejit të kenë ushqyer dyshime mbi mundësinë për të zbukuruar një pemë Krishtlindjeje brenda Kishës, duke e quajtur një simbol pagan. Mbarë besimi është pagan!

Përveç simbolizmit diellor, në rrethin e historisë së Jezusit dhe të versioneve të tij të ndryshme të mëparshme gjejmë edhe fillimin simbolik tipik të shkollave mistike. Kryqi si simbol besimi përdoret në çdo kulturë, që nga ajo vendëse

amerikane tek ajo kineze, indiane, japoneze, egjiptiane, sumere, deri tek popujt e Evropës e të Amerikës qëndroro-jugore. Rrota e Jetës budiste është e përbërë nga dy kryqe të mbivënë njëri mbi tjetrin, ndërsa zogj me krahët të hapur përdoren si simbole të kryqit në vende, stema e emblema të ndryshme. Njëri prej tipeve më të lashtë të kryqit është kryqi Tau apo Tav, që të kujton gërmën T. Duket se ka qenë ky kryqi, në të cilin romakët kryqëzonin kundërshtarët politikë. Ai ishte edhe një simbol i perëndisë së druidëve, Husë, dhe nga ai frymëzohet edhe simboli i ditëve të sotme të masonëve, skuadra në formë T-je. Crux Ansata (Kruks Ansata) egjiptiane, "kryqi i jetës", paraqet një nyjë në majën e tij. Cruxs Ansata dhe kryqi Tau shfaqen mbi statuja dhe mbi figura të ndryshme në të gjithë Amerikën Qendrore. Kryqi i shoqërohej ujit dhe babilonasit e transformuan në një simbol të perëndive të ujit, tek i cili thoshin se zinte fill prejardhja e qytetërimit të tyre. Në lidhje me këtë, edhe për Nagasët, perënditë njerëzoro-zvarranike të Lindjes, thuhej se kishin jetuar në ujë. E lashtë është tradita sipas së cilës një figurë shpëtimtare hyjnore vdes për të çliruar njerëzimin. Besimet e Indisë e kanë paraqitur figurën e shpëtimtarit të kryqëzuar shekuj përpara ardhjes së krishtërimit, duke e huazuar nga ana e tyre nga arianët e Kaukazit. Në disa figura simbolike, Khrishna, "Krishti" i induizmit, paraqitet i gozhduar në një kryq në pozicionin klasik që pastaj i është atribuar Jezusit[28]. Thuhet se Kuetzalkoatli ka dalë nga deti me një kryq mbi shpinë dhe në fakt shpesh paraqitet i gozhduar në një kryq. Sipas simbolizmit të shkollave misterike kryqi i artë përfaqëson ndriçimin shpirtëror; ai i argjendtë, pastrimin shpirtëror; ai prej metali, përuljen dhe ai prej druri aspiratën. Ky i fundit rifitoi kuptimin e përhapur simbolik të pemës dhe të shumë figurave shpëtimtarësh hyjnorë që kanë vdekur në pemë ose në kryqe druri. Disa prej ritualeve misterike pagane parashikonin që nxënësi të varej nga një kryq ose të shtrihej mbi një altar sikur të ishte një kryq[29]. Kjo simbolizonte vdekjen e trupit, të botës së zotëruar nga ndjenjat dhe nga dëshirat, hapjen drejt unit shpirtëror. Gozhdët e ngulura dhe gjaku që gufon hyjnë gjithmonë tek simbolizmi i shkollave misterike. Kryqëzimi i Jezusit ka qenë një alegori, një ngjarje simbolike, që aludonte për një domethënie të fshehtë. Nuk ka ndodhur realisht, por këtë ju nuk duhet ta dini. E ç`të thuash për të vdekurit që Jezusi ringjalli? Në letrën e tij të parë drejtuar korinthasve shën Pali ka thënë në lidhje me këtë ngjarje:

"Nëse nuk ekziston ringjallja e të vdekurve, as Krishti nuk është ringjallur. Dhe nëse Krishti nuk është ringjallur, atëhere është i kotë predikimi ynë dhe është i kotë edhe besimi ynë. Ne, pastaj, rezultojmë dëshmitarë të rremë të Zotit, sepse

kundrejt Zotit kemi dëshmuar se ai ka ringjallur Krishtin, teksa në fakt nuk e ka ringjallur, nëse është e vërtetë që të vdekurit nuk ringjallen." **Letra e parë drejtuar korinthasve 15, 13-16.**

Ai mbron idenë se, nëse Jezusi nuk u ringjall materialisht nga të vdekurit, atëhere nuk ka bazë për besimin dhe fenë e krishterë. Nëse kjo është e vërtetë, krishtërimi është me të vërtetë në hall. Mbi të gjitha, raportet mbi ringjalljen të paraqitur tek Ungjijtë zbulojnë kontradikta të panumërta, pasi çdo Ungjill e ka kopjuar historinë origjinale në mënyrë të ndryshme, ose e ka ndryshuar qëllimisht. Përveç kësaj, ringjallja është një simbol i mëtejshëm diellor, që rrjedh nga besimet e lashta. Në Persi, shumë përpara krishtërimit, ishte i përhapur një ritual, në të cilin një të riu, në dukje i vdekur, i dhurohej përsëri jeta. Ai quhej "shpëtimtar" dhe thuhej se vuajtjet e tij i siguronin shpëtimin popullsisë. Priftërinjtë e përgjonin varrin e tij deri në mesnatën e ekuinoksit dhe pastaj bërtisnin: "Gëzohuni, o anëtarë të kultit të shenjtë! Perëndia juaj u ringjall. Vdekja dhe vuajtjet e tij kanë garantuar shpëtimin tuaj". E njëjta histori tregohej në Egjipt në lidhje me Horusin dhe në Indi në lidhje me Khrishnën, njëmijë vjet përpara përhapjes së krishtërimit. *Bibla* na thotë se Jezusi do të kthehet përsëri mbi një re dhe çfarë është midis reve? Dielli. Varri i Jezusit simbolizon errësirën në të cilën ka zbritur Dielli para rilindjes së tij dhe gati të gjitha ceremonitë në shkollat misterike zhvilloheshin në një farë tipi shpelle, një dhomë nëntokësore, ose ndonjë hapësirë të mbyllur dhe të errët, si dhomat që vendësit amerikanë përdornin për të bërë saunën. Edhe historia e heshtës që shpoi tejpërtej kraharorin e Jezusit pasi qe ulur nga kryqi hyn në simbolizmin e shkollave misterike. Legjenda e krishterë thotë se ai që e vërviti atë heshtë ishte një çenturion *(në ushtrinë romake, komandanti i një reparti qindësh)* romak i verbër me emrin Lonxhino dhe se një çikë prej gjakut të Jezusit i spërkati sytë, duke e shëruar nga verbëria. Lonxhinoja u konvertua në besimin e krishterë dhe e kaloi pjesën e mbetur të jetës duke shkelur idhujt paganë. E gjitha kjo nuk qëndron në këmbë! Çenturionët nuk mund të ishin të verbër, përndryshe nuk do të ishin në gjendje të kryenin detyrën e tyre dhe, pastaj, prapë edhe një herë, kjo histori nuk është gjë tjetër veçse një përsëritje e historive të tjera të mëparshme. Shpëtimtari skandinav, Balderi, biri i Odinit, qe shpuar tejpërtej nga një shigjetë e vërvitur nga Hudi, një perëndi e verbër. 15 Marsi, Idet e marsit, ishte dita në të cilën kanë vdekur edhe shumë shpëtimtarë paganë. Kjo ditë i ishte kushtuar Hudit dhe më pas u bë një ditë feste e krishterë për nder të "Lonxhinos së Bekuar"[30]! Është vërtet për të qeshur!

LIBRI 24

Simboli i peshkut përsëritet në shumë episode të Ungjijve dhe ka zënë nga e para me Nimrod/Tamuzin, çiftin babilonas at-bir. Një tjetër arsye pse Jezusi i është shoqëruar peshkut mund të ketë të bëjë me shenjën astrologjike të Peshqve. Rreth kohës në të cilën vendoset lindja e Jezusit, Toka ka hyrë në shenjën e Peshqve. Një erë e re po bëhej gati të hapej dhe Jezusi, peshku, mund të kishte qenë një simbol i erës së Peshqve. Tani përkundrazi jemi duke hyrë në një erë të re, në atë të Ujorit, sipas asaj që është parashikuar nga ligjet e preçesionit tokësor *(që ndodh në çdo 26.000 vjet, siç është thënë më lart)*. Kur *Bibla* flet për fundin e botës, bëhet fjalë për të satin gabim përkthimi. Është përkthyer në fakt si "botë" termi grek "aeon", por *aeon* nuk do të thotë botë, por "erë"[31]. Nuk gjendemi përpara fundit të botës, por përpara fundit të një ere, fundit të 2.160 vjetëve të erës së Peshqve. Krishtërimi nuk ka zëvendësuar besimet pagane, ai vetë *është* një besim pagan. Persianët, që i trashëguan besimet e tyre nga sumerët, nga egjiptianët dhe nga babilonasit, kishin pagëzimin, kreshmën, parajsën dhe ferrin, engjëjt e dritës dhe të errësirës dhe, edhe një engjëll të rënë nga qielli. Të gjitha këto elemente janë përvetësuar nga krishtërimi, që pastaj ka kërkuar t`i mbrojë si të vetët.

Në periudhën, në të cilën supuzohet se ka jetuar Jezusi, Vëllazëria Esena e kishte qendrën në Kumran, në skajin verior të Detit të Vdekur, ose të paktën kjo është ajo çka është bërë e ditur. Studimet e Brian Desborougut tregojnë përkundrazi se ai vend në atë kohë banohej nga një koloni lebrozësh, ndërsa esenët *(ithtarë të një sekti hebraik para-i krishter, që praktikonte forma të asketizmit)* jetonin në një vend mjaft më të rehatshëm, përgjatë bregut të Detit të Vdekur. *Rrotullat e Detit të Vdekur*, të gjetura në një shpellë afër Kumranit në vitin 1947, na kanë lejuar të njohim më mirë mënyrat e tyre të jetesës dhe besimin e tyre fetar, pavarësisht fshehjes nga ana e autoriteteve, të dëshiruar për të vazhdur të diktojnë versionin e tyre zyrtar të historisë. Rrotullat u qenë fshehur romakëve gjatë revoltës fatkeqe hebraike të rreth vitit 70 para Krishtit. Midis rreth 500 dorëshkrimeve hebraike e aramaike të gjetura, figurojnë disa tekste të Testamentit të Vjetër, midis të cilëve një bocë e plotë e *Librit të Isait*, shumë më i lashtë në krahasim me versionin biblik. Të shumta ishin dokumentet lidhur me zakonet dhe organizimin esen. Rrotujt bëjnë të ditur se esenët ishin ca fanatikë, që u besonin verbërisht fantazive levitike, që përmbaheshin në tekstet e Testamentit të Vjetër. E konsideronin, për më tepër, armik këdo që nuk pajtohej me fenë e tyre dhe iu kundërvunë trimërisht pushtimit romak. Bëhej fjalë për degëzimin palestinez të një sekti egjiptian edhe më shumë ekstremist të quajtur Terapeutë ("shëruesa", prej nga rrjedh "teraupet", të përmendur më përpara) që i bëri të vetat dijet e shenjta të

Egjiptit dhe të botës së lashtë. Teraupeutët dhe esenët përvetësuan edhe simbolin e "meseh"-ut, krokodilin "Drako" të Egjiptit, me dhjamin e të cilit lyheshin faraonët, pas një autorizimi paraprak të Oborrit Mbretëror të Dragos. Esenët kishin dije të thella në çështjen e drogave, përfshirë varietetin haluçinogjen, që përdoreshin gjatë ceremonive të shkollave misterike dhe për të hyrë në të tjera përmasa vetëdijeje.

"Kërpudhat e shenjta" apo "bimët e shenjta" ishin pjesë e jetës së përditshme të vëllazërive të fshehta deri në atë pikë sa prifti më i lartë hebraik mbante në kokë një kokore në formë kërpudhe (shiko ***Figura 17***), për t'ia theksuar më tej rëndësinë. Ata kremtonin rituale të veçanta për përgatitjen dhe përdorimin e tyre. Edhe kërpudhës i atribuoheshin shenja dalluese tipike të "birit të Perëndisë" (dhe kujt nuk i atribuoheshin ?) dhe ajo ishte e lidhur me ciklin diellor. Kërpudhat mblidheshin me kujdes të madh para agimit dhe shumë simbole të lidhura me këto rituale hasen tek *Bibla* dhe në tekste mjaft më të lashta. Prapë edhe njëherë, është qytetërimi sumer ai, të cilit i detyrohet origjina e përdorimit të kërpudhës së shenjtë dhe të drogave të tjera, përveç dijeve të fshehta të vetive të tyre[33]. Terapeutët kishin themeluar një universitet të lulëzuar në Aleksandri dhe prej aty nisën misionarët e tyre lart e poshtë nëpër Lindjen e Mesme, që u dhanë jetë komuniteteve anëtare. Prapë edhe një herë mendimi shkon tek Egjipti dhe tek shkollat misterike



Esenët ishin përkrahës të Pitagorës, filozof grek dhe matematikan ekzoterik, përveçse anëtar i lartë si i shkollave misterike greke edhe i atyre egjiptiane[34]. Sipas historianit më të famshëm të kohës, Jozefusit, esenët betoheshin që t'i mbanin të fshehtë emrat e të fuqishmëve që qeverisnin universin, sipas asaj që parashikonin shkollat misterike. Eseno-terapeutët praktikonin rituale shumë të ngjashme me atë që më vonë do të jetë pagëzimi i krishterë dhe e shënonin ballin e anëtarëve të kultit me një kryq, simbol që, sipas *Librit të Ezekielit*, ishte për të treguar

Figura 17. Prifti më i lartë hebraik me kokoren në formë kërpudhe, që tregon rëndësinë e kërpudhave magjike haluçinogjene brenda ritualeve të tyre.

shpirtndriçuarit dhe përdorej edhe në ceremonitë ndaj mistereve të Mitras dhe perëndive të tjera diellore. Esenët i konsideronin të neveritshme funksionet natyrale trupore, përfshirë seksin dhe, në këtë kuptim, kanë qenë pararendës të përkryer të Kishës Katolike, që iu desh të përvetësonte shumë prej besimeve, fjalëve dhe praktikave të tyre. Dy prej *Rrotullave të Detit të Vdekur*, njëra në hebraisht, tjetra në aramaikisht, përmbajnë atë që ne e quajmë horoskop, domethënë idenë se lëvizja e planeteve ndikon mbi karakterin dhe fatin e një njeriu. Esenët e praktikonin astrologjinë, simbolizmi i së cilës mbush të gjithë Ungjijtë dhe Testamentin e Vjetër. Të njëjtën gjë bënin të krishterët e parë, një degëzim që rridhte prej eseno-terapeutëve, ashtu sikurse edhe romakët dhe të gjitha kombet pagane përreth Judesë[35]. Shkrimtari Filone, që ka jetuar në kohën që supozohet se ka jetuar Krishti, ka thënë në librin e tij *Traktat mbi jetën soditëse* se, kur terapeutët i luteshin Perëndisë, ktheheshin drejt Diellit dhe se studionin librat e shenjtë për t'u zbuluar domethënien e fshehtë të koduar. Ka shkruar edhe se meditonin mbi të fshehtat e natyrës që përmbanin librat nën velin e alegorisë[36]. Kjo është saktësisht mënyra me të cilën është shkruar *Bibla*. Sot kjo gjuhë e fshehtë përdoret në logot, në stemat dhe në flamujt e shoqërive, të vendeve e të organizatave të tjera të kontrolluara nga Vëllazëria.

E lidhur me esenët, dhe element i përbashkët si në Testamentin e Ri ashtu edhe në të Vjetrin, është shoqëria e fshehtë e quajtur e Nazarenëve ose Nazirejve. Duket se personazhe të Testamentit të Vjetër si Moisiu dhe Sansoni ishin anëtarë të këtij grupi, sikurse edhe Jezusi, sivëllai i tij Jakobi, Gjon Pagëzori dhe shën Pali. *Aktet e Apostujve* thonë për shën Palin: "Kemi zbuluar se ky njeri është një murtajë, nxit revolta të vazhdueshme midis të gjithë judejve që janë në botë dhe është kreu i sektit të Nazirejve (nazarenëve)"[37]. Asnjë prej këtyre personave nuk ka ekzistuar realisht, por simbolizmi nazaren e lidh *Biblën* me shoqëritë e fshehta. Esenët dhe nazirei-nazarenët duket se janë degëzime të ndryshme që rrjedhin nga i njëjti grup. Sipas historianit hebre, Jozefus, esenët visheshin me ngjyrë të bardhë, por nazarenët visheshin me ngjyrë të zezë, e njëjta ngjyrë e priftërinjve të Isidës në Egjipt. E zeza është ngjyra e Vëllazërisë Babilonase, që i është diktuar gjatë historisë përmes manipulimit. Në përputhje me këtë, e zeza është bërë ngjyra që i shoqërohet autoritetit (mendoni për profesionet gjyqësore) dhe vdekjes. Është edhe ngjyra tradicionale e katedrave, që veshin rrobën e zezë dhe kapelën e zezë të quajtur "togë", në të cilën riparaqiten simbolet e rrethit dhe të katrorit, që janë simbolet tipike të masonerisë. Duket se mrekullia më e madhe e Jezusit ka të bëjë me Nazaretin, meqë Nazareti asokohe nuk ekzistonte dhe Jezusi tha:

LIBRI 24

"Që Nazaret qoftë. Dhe Nazaret qe". Ose më mirë, nuk qe. Ky emër nuk shfaqet në asnjërin prej dokumenteve të hollësishme romake, as në ndonjë libër, tekst apo raport të asnjë tipi të lidhur me kohën që trajtojnë Ungjijtë. Titulli i "Nazarenit" që i atribuohet Jezusit nuk i referohet Nazaretit, por shoqërisë së fshehtë të nazarenëve.

Eseno-terapeuto-nazarenët kanë bërë punën e urës ndërmjet Testamentit të Vjetër e të Riut dhe krijimit të krishtërimit. Të "krishterët" e parë ishin quajtur nazarenë para se të quheshin të krishterë[38]. Ritualet e Vëllazërisë Nazarene mund të hasen sot tek Kisha e krishterë. Nazarenët visheshin me ngjyrë të zezë, dhe kështu bën pjesa më e madhe e priftërinjve të krishterë. Në Kumran ata bënin një banjë rituale për t`u pastruar nga "mëkatet" e tyre. Prej këtej rrjedh pagëzimi i krishterë. Hanin bukë e verë dhe prej këtej lindi mesha e krishterë. W. Wynn Westcott ka qenë ndërmjet themeluesve të Urdhërit satanik të Agimit të Artë në Angli, që do të kishte luajtur pastaj një rol domethënës në ngjitjen në pushtet të Adolf Hitlerit dhe të nazistëve. Ai ishte në dijeni të prapaskenave dhe në librin e tij *The Magical Mason* (Masoni magjik) ka pohuar se masonët e ditëve të sotme rrjedhin prej esenëve, përveçse prej sekteve të tjera të lashta me karakteristika të ngjashme. Sot fjala arabe që emërton të krishterët është "Nasranë" dhe Kurani mysliman përdor termin "Nasara" ose "Nazara". Këto fjalë rrjedhin nga termi hebraisht "Nozrim", i cili nga ana e tij ka rrjedhur nga termi "Nozrei ha-Brit" – "Ruajtësit e Aleancës". Termi "Nozrei ha-Brit" mund ta ketë zanafillën në kohën në të cilën Testamenti i Vjetër vendos Samuelin dhe Sansonin. Samueli përshkruhet si njeriu më në pah i levitëve dhe qenë këta të fundit që e kanë orkestruar krejt mashtrimin, ku mbështetet *Bibla* dhe *Talmudi*, nën drejtimin e Vëllazërisë Babilonase. "Aleanca" është Vepra e Madhe e Kohërave të Masonëve – Urdhëri i Ditës që ka si qëllim përfundimtar pushtimin e planetit nga ana e racës së zvarranikëve.

Tek *Bibla* dhe tek një pafundësi shkrimesh të tjera e figurash, racat e të "zgjedhurve" prej perëndive dhe dijet e tyre të fshehta, simbolizohen nga "vreshti" dhe nga "vreshtat". Testamenti i Vjetër flet për "hardhi që i ke shkulur nga Egjipti"[39]. Mësojmë edhe se "vreshti i Zotit të ushtrive është shtëpia e Izraelit dhe banorët e Judesë janë plantacioni i tij i parapëlqyer"[40]. Raca e simbolizuar nga vreshti nuk është aspak, sipas meje, raca e mbretit David. Në radhë të parë sepse ky nuk ka ekzistuar kurrë dhe kjo vërteton përfundimisht pikëpamjen time. Simbolizmi i lidhur me vreshtin mund ta ketë burimin prapë edhe një herë tek Babilonia dhe tek Egjipti. Në shkollat misterike të Greqisë, perënditë e Dijellit, Dionisi dhe Baku, ishin edhe perënditë

mbrojtëse të vreshtit[41]. Çfarë është thelbësore për pjekjen e rrushit? Dielli. Vreshti dhe raca e "Jezusit", të lidhura me simbolizmin diellor, i përkasin njërit prej grupeve mbretërore dhe priftërore që zë fill tek raca e zvarranikëve, anunakët. Tek Testamenti i Ri flitet për Dasmën e Kanës, por kjo nuk ka qenë një martesë e vërtetë. Bëhet fjalë prapë edhe një herë për një paraqitje simbolike të Diellit dhe Tokës, perëndisë dhe perëndeshës. Në rajonin e Kananit (*emërtim i Palestinës së lashtë*) çdo pranverë kremtoheshin rite të pjellorisë që merrnin emrin "Festa e dasmës së Kananit"[42]. Ndodhi gjatë martesës simbolike të Kanës, e treguar prej Ungjijve, që Jezusi e shndërroi ujin në verë. Falë nxehtësisë së Diellit dhe ujit, që buron nga Toka, ndodh pjeka e rrushit, me të cilin prodhohet vera. Thuhej se edhe Baku, perëndia greke bir i Zeusit dhe i virgjëreshës Semelë, e kishte shndërruar ujin në verë. Ekzistonin edhe fjalë rituale esene lidhur me ujin dhe me verën. Esenët, terapeutët dhe gnostikët përdornin shpesh një gjuhë të fshehtë dhe historia e Jezusit është një lëmsh i ngatërruar me alegori të lidhura me Diellin, me astronominë, me astrologjinë, me sektet, me dijet e fshehta, me ritualet dhe me emrat e përdorur nga shkollat misterike. Testamenti i Ri është një pasqyrë e të Vjetrit, për arsye se disa fakte, shumë trillime dhe një masë kodesh ekzoterike janë shkrirë, dhe shpesh ngatërruar, për të krijuar një histori, që mund të të çojë në rrugë të gabuar, nëse merret në kuptimin e ngushtë të fjalës. Siç thotë proverbi i famshëm: "Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë". Kush është anëtar i shoqërive të dijeve të fshehta do ta kuptojë domethënien e vërtetë të kësaj që po them. Kush nuk është anëtar i këtyre shoqërive të dijeve të fshehta le t`u besojë pra këtyre broçkullave të vjetra.

Ja këtu më poshtë ndonjë mit tjetër biblik për t'i nxjerrë bojën:

Ideja e "zdrukthëtarit" është një gabim përkthimi. Fjala "zdrukthëtar" është përkthim i fjalës hebraike "naggar", përmes fjalës greke "ho tekton". Këto fjalë në kuptimin e vërtet të fjalës nuk do të thonë "zdrukthëtar", por i referohen personave që shkëlqenin në zanatin e tyre dhe u jepeshin si mësuesve e intelektualëve edhe artizanëve.

Jezusi nuk ka lindur aspak në një ahur dhe nuk ka as edhe një Ungjill të vetëm që ta thotë këtë. Lindja e kremtuar për Krishtlindje është një trillim i pastër. Ideja rrjedh nga *Ungjilli i Lukës*[43] që mbështet idenë se Jezusi qe vendosur në një grazhd, në të cilin vendoset ushqimi për kafshët, sepse në bujtinë nuk kishte më vend. Por versioni grek, mbi të cilin bazohet përkthimi anglez, thotë se nuk kishte "topos" në "kataluma" – nuk kishte vend në dhomë[44]. *Ungjilli i Mateut* deklaron qartë se Jezusi ndodhej në një shtëpi:

"Me të hyrë në shtëpi, panë fëmijën me Marien, të ëmën dhe, duke rënë në gjunjë, e adhuruan"[45]. Grazhdet (*këtu është fjala për govatat prej druri ku u hidhet ushqimi kafshëve*) përdoreshin shpesh për fëmijët, kur nuk kishte një djep të përshtatshëm, por ishte grazhdi (*d.m.th, govata*) që çohej drejt fëmijës, jo fëmija drejt grazhdit (*d.m.th, govatës*)!

Duket që skena e lindjes ta ketë pasur origjinën në Greçio, Itali, prej veprës së shën Françeskut të Asizit, në vitin 1223 pas Krishtit [46]. Ai mblodhi disa njerëz të fshatit bashkë me kafshët e tyre për të ilustruar lindjen e Jezusit dhe kjo paraqitje simbolike e lindjes u përhap shumë shpejt. Gdhendje në dru të kësaj skene përreth grazhdit u bënë shumë popullore në të gjithë Italinë gjatë periudhës së krishtlindjes dhe, ç'mbetet, është histori. As edhe shkëmbimi i dhuratave nuk është një traditë e krishterë. Është fjala për një zakon pagan i praktikuar në çdo fillim viti, shumë kohë përpara ardhjes së krishtërimit. Të krishterët thjesht e kanë huazuar, si gjithçka tjetër.

Profecitë thoshin se "messiah" ("messeh", krokodili egjiptian) do të quhej Emanuel, por emri që Ungjijtë i japin "messiah"-s ishte Jezus, ose të paktën i barasvlershmi i tij hebraik. Oh! Është qesharake se si të krishterët duket se nuk kuptojnë gjënë më të rëndësishme kur, në çdo Krishtlindje, citojnë profecinë që është e lidhur me ardhjen e Emanuelit. Mendoni për të gjithë ata fëmijë që kanë interpretuar Marien, Jozefin, barinjtë shpirtërorë, të diturit, gomerët, lopët dhe delet. Këto fantazi janë përdorur për të indoktrinuar një pafundësi brezash, me qëllim që të besonin se ka qenë kjo ajo që ka ndodhur, kur, në realitet, lindja dhe historia e Krishtlindjeve janë rezultati i një sërë gabimesh përkthimi, i një trillimi të Shën Françeskut dhe të riteve të mesit të dimrit të besimit pagan. Të dashur fëmijë, para se edhe këtë vit t`i vishni ato kostume, mund t`ju them një fjalëz të vogël?

Kungimi i krishterë, riti fetar që qëndron tek ngrënia e bukës dhe pirja e verës, simbolet e trupit dhe të gjakut të Krishtit, e kanë origjinën nga një rit kanibalesk, që parashikonte të ushqeheshin me trupa të vërtetë dhe gjak të vërtetë, gjatë flijimeve të kafshëve dhe të njerëzve. Pjesa më e madhe e termave të krishterë rrjedhin nga greqishtja, përfshirë fjalët "Krisht" e "krishtërim". Midis shumë të tjerave figurojnë fjala "Kishë" (shtëpi e Zotit), "ekleziastik (kishtar)" (nga "Eklezia", asambleja ose parlamenti grek), "apostull" (misionar), "presbiter"/"prift" (i moshuar) dhe "pagëzim" (zhytje). Deri edhe sipas Ungjijve, Jezusi rrethohej nga terroristë. Simon Magjistari ishte i njohur si Simon Xelota (i zellshmi), për të nënvizuar rolin e tij si kapoja i Xelotëve, "luftëtarëve për lirinë", pro luftës kundër romakëve. Një tjetër titull që i ishte dhënë atij ishte Simon "Kananita", një fjalë greke që do të thotë "fanatik".

Ajo që përkthyer në anglisht si Simon Kananeu (*që ka lidhje me kananët, emër i banorëve të Palestinës së lashtë, siç është thënë më lart*)! Juda "Iskarioti" rrjedh nga fjala "sikarius" që do të thotë "vrasës". Kishte një grup terrorist të quajtur Sikarë ose Bij të Kamës, dhe ky emër rrjedh nga fjala "sika", kuptomi i së cilës është "kamë e përkulur". Nga "sikarius" ka rrjedhur fjala greke "sikariotes" dhe ky term që përkthyer pastaj më tej në mënyrë të gabuar si Iskariot. Xeloto-sikarët plaçkitnin karvanet romake të ngarkuara me rezerva ushqimore dhe i përdornin ushtarët e tyre për të ngritur pusira, pikërisht ashtu sikurse bëjnë sot disa grupe terroriste si IRA në Irlandën e Veriut.

Njerëzit nuk kryqëzoheshin nëse ishin fajtorë për vjedhje, prandaj historia e dy hajdutëve të kryqëzuar bashkë me Jezusin, është një tjetër trillim. Bëhet prapë edhe një herë fjalë për një "vjedhje", pasi e njëjta histori tregohej edhe në lidhje me disa figura para të krishtere. Dënimi për "krimet", për të cilat Jezusi qe akuzuar tek Ungjijtë, duhej të ishte vrasja me gurë e kryer nga autoritetet hebraike, jo nga ato romake.

Na thuhet se Ponc Pilati, prokurori romak i asaj kohe, lau duart dhe e shkarkoi përgjegjësinë e vdekjes së "Jezusit" mbi turmën. Larja e duarve si shenjë pafajësie ishte një zakon i komunitetit esen[47]. *Bibla* mbron idenë se ishte zakon romak, në kohën e kremtimeve për Pashkën hebraike, të falje një të burgosur, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Ky zakon nuk ekzistonte dhe e gjithë skena është një trillim.

Mund të shkruhej një libër mbi mitet e *Biblës* dhe, në fakt, dikush e ka bërë. Titullohet, me të drejtë, *Bible Myths*, dhe jua këshilloj nxehtësisht, nëse kërkoni një dokumentim të hollësishëm të informacioneve që ju kam dhënë në këtë kapitull. Nuk ka asnjë provë të besueshme të ekzistencës së Jezusit. Asnjë provë arkeologjike, asnjë provë të shkruar, asgjë. E njëjta gjë vlen për Solomonin, Moisiun, Davidin, Abrahamin, Sansonin dhe një pafundësi "yjesh" të tjerë biblikë. Gjithçka që disponojmë janë tekstet levitike dhe historitë e Ungjijve, në variante të ndryshme. Manipuluesit fetarë, duke mos ditur se si të bënin, për t`i dhënë një mbështetje figurës së "Jezusit", u bënë shtesa në mënyrë patetike të dukshme veprave të historianit hebre Jozefus, me qëllimin për të mbajtur në këmbë të pambajtshmen. Njohim më shumë se dyzet autorë që kanë treguar ngjarjet e atyre tokave në kohën që supozohet se ka jetuar Jezusi, pa e zënë në gojë aspak asnjeri[48]. Por si është e mundur që, një njeri që ka bërë të gjitha ato gjëra që i atribuohen, nuk përmendet nga askush? Filoni duhet të ketë qenë një bashkëkohës i Jezusit dhe ka shkruar një histori të judejve, e cila mbulon të gjithë këtë periudhë. Banonte madje edhe në Jeruzalem, ose në rrethinat e tij, në kohën kur thuhet se Jezusi ka

LIBRI

lindur dhe Herodi ka urdhëruar të vriteshin fëmijët, e megjithatë nuk flet për asnjë prej këtyre gjërave. Ndodhej atje në kohën kur thuhet se Jezusi ka bërë hyrjen e tij ngadhnjyese në Jeruzalem dhe kur ishte kryqëzuar e ringjallur pas tri ditësh. Çfarë thotë Filoni për këto ngjarje të jashtëzakonshme? Asgjë. As edhe një fjalë. As edhe një zënie në gojë[49]. Asnjë prej këtyre fakteve nuk është përmendur në asnjë dokument romak, apo në raportet bashkëkohëse të autorëve grekë e aleksandrinë, që ishin në dijeni të gjithçkaje që ndodhte në ato rajone[50].

Pse? Thjesht sepse këto ngjarje nuk kanë ndodhur. Ka qenë një histori simbolike, e shifruar, e ndërtuar për të kaluar brez pas brezi dije ekzoterike dhe astrologjike të llojeve të ndryshme dhe, mbi të gjitha, për të krijuar një tjetër besim-burg të bazuar mbi simbolet e Vëllazërisë Babilonase. Raca njerëzore është mashtruar. Një rreng i bukur!

LIBRI 24

Kapitulli 5

Të pushtuar me anë të kryqit

Kisha e krishterë është një farsë e bazuar mbi një fantazi. Nëse dikush do të kërkonte një vërtetim të asaj se sa e lehtë është për një pakicë të kontrolojë masat, do të mjaftonte të mendonte për miliarda njerëz që në 2000 vjetët e fundit u kanë besuar përrallave të hedhura në qarkullim nga njerëz me veladonë të gjatë. Dhe ajo që vlen për krishtërimin, vlen edhe për të gjitha besimet e tjera: judaizmin, islamizmin, induizmin e kështu me radhë.

Këto besime fetare janë krijuar nga të njëjtat fuqi, për të të njëjtin rezultat dhe, për këtë arsye, mitet e bazuara mbi perëndinë-shpëtimtar gjatë gjithë lashtësisë paraqesin të njëjtën strategji: 1.Ke lindur me mëkatin origjinal dhe, për këtë arsye, që nga dita kur vjen në këtë planet nuk je gjë tjetër veçse një copë muti i lig. 2.Mund të shpëtohesh vetëm nëse beson tek "Shpëtimtari" dhe kjo është e barasvlershme me detyrimin që të bësh atë që të thonë priftërinjtë të bësh. 3.Nëse nuk e bën, do të jesh i dënuar përgjithmonë në rropullitë e ferrit. Çfarë ndjenje faji dhe tmerri ka krijuar e gjitha kjo gjatë mijëvjeçarëve! Kam dëgjuar nëna katolike të vuanin nga ankthi ndaj mendimit të asaj se ç`mund t`u ndodhte fëmijëve të tyre, pasi kishin vdekur. Fëmijët nuk kishin mundur të besonin tek Jezusi, sepse ishin vetëm pak ditësh, kështu

që, do të kishin shkuar në parajsë apo në ferr? Në Shtetet e Bashkuara isha duke parë në një kanal televiziv katolik, kur njeriut me veshje të bardhë i drejtohet pikërisht kjo pyetje. U përgjigj se bëhej fjalë për një çështje të ndërlikuar teologjike. Oh, me të vërtetë? Tha se ose shpirti i fëmijës do të kishte përfunduar në limb (*sipas traditës katolike, vendi në të cilin ndodhen shpirtrat e atyre që kanë marrë me vete vetëm fajin e mëkatit origjinal, në mënyrë të veçantë fëmijë të papagëzuar)* (dhe deri kur, pyes unë me vete?), ose do të ishte gjykuar mbi bazën e sjelljes së prindërve. Çfarë budallallëqesh të bujshme! Falë Zotit, fëmija nuk do të jetë gjykuar mbi bazën e sjelljes së priftërinjve! Dhe, nëse mund të shpëtohesh vetëm duke besuar tek Jezusi, çfarë ndodh me të gjithë ata miliarda njerëz që, gjatë gjithë periudhës së krishtërimit, kanë jetuar në zona të gjera të botës pa iu mbërritur fjala e Jezusit? Janë dënuar të gjithë për të ushqyer flakët e ferrit, sepse kanë qenë të painformuar? Një goxha hajvan ky Zoti i krishterë, apo jo? Por, natyrisht, kjo nuk është e vërtetë. Është e gjitha një trillim, e përgatitur nga raca e zvarranikëve të Vëllazërisë Babilonase, për të kontrolluar mendjet e masave.

Teksa isha duke shkruar këtë pjesë të librit dhe po bëja kërkime mbi origjinën e Ungjijve, zgjata krahun për të marrë një libër mbi një raft të lartë të zyrës sime. Kur e tërhoqa poshtë, një tjetër më i vogël ra mbi dysheme. Nuk më kujtohej ta kisha parë më parë, por titulli më bëri përshtypje menjëherë. Ishte *The True Autorship Of The New Testament* (Autori i vërtetë i Testamentit të Ri) i Abelard Reuklinit, i shtypur për herë të parë në Shtetet e Bashkuara në vitin 1979[1]. Fliste për një rreth të ngushtë, ose klikë sekrete, klubi më i pashembëllt i historisë, që ishte në dijeni të "Sekretit të Madh". Në këtë rreth, apo klub, bënin pjesë udhëheqësit fetarë, politikë e letrarë, që dinin të vërtetën mbi Jezusin, por që nuk dëshironin ta dinte askush tjetër. Ajo që më bëri përshtypje ishte fakti se ky libër arrinte në të njëjtin përfundim në të cilin kisha arritur unë. Ungjijtë janë një trillim, që ia kanë arritur qëllimit të krijojnë një besim-burg të ri. Libri nuk hyn në të gjithë simbolizmin që kam paraqitur këtu, por zë në gojë emrin e familjes dhe të njerëzve të tjerë që kanë shkruar Testamentin e Ri dhe kodet që kanë përdorur për të "vënë nënshkrimin e tyre". Njëri prej këtyre kodeve është, një gjë interesante, numri 40, mbi të cilin jam ndalur më lart. Numri dyzet paraqitej edhe me gërmën "M" të Maries. Gërma "M" është akoma sot e kësaj dite shumë domethënëse për Vëllazërinë dhe e hasim kudo në simbolin e zinxhirit të dyqaneve të *fast food*-it MCDonalds. Do të shohim më pas se si shoqëritë e mëdha përdorin simbolizmin e Vëllazërisë në logot dhe në emrat e tyre. "M" përdoret në vend të Marie ose Madonë, që do të thotë Semiramidë. Bollëku me prova që

ofron libri i Reuklinit, shumë prej të cilave të ndërlikuara dhe të lidhura me kode matematikore ekzoterike, është jashtëzakonisht interesant. Ju këshilloj me të vërtetë ta siguroni një kopje të tij, nëse dëshironi të thelloni argumentin. Paragrafi i fillimit përmban *in nunce* (në mënyrë sintetike) zbulimet e tij:

"Testamenti i Ri, Kisha dhe krishtërimi kanë qenë të gjitha krijim i familjes së Kalpurino Pizones, që i përkiste aristokracisë romake. Testamenti i Ri dhe të gjithë personazhet që shfaqen aty – Jezusi, të gjithë Jozefët, të gjitha Mariet, të gjithë ithtarët, apostujt, Pali, Gjon Pagëzori – janë të ë trilluar. Pizonët e kanë krijuar atë histori dhe ato personazhe; e kanë vendosur në një kohë dhe në një vend të të përcaktuar të historisë; dhe e kanë lidhur me personazhe anësorë që kanë ekzistuar realisht, si Herodi, Gamalieli dhe prokurorët romakë etj. Por Jezusi dhe të gjithë të tjerët afër tij kanë qenë personazhe të rremë (domethënë të trilluar!)".

Xhinsi i Pizonëve rridhte prej burrave të shtetit, konsuj, poetë e historianë, dhe këta sigurisht ishin anëtarë të rrjetit të shoqërive të fshehta të Perandorisë Romake, akoma sot e kësaj dite njëra prej etapave më të rëndësishme për gjakpastrit dhe për hibridët e racës së zvarranikëve. Ja përse një ushtar romak paraqitet në logon e atij pinjolli të Vëllazërisë, sic është *American Express*-i. Familja e Pizonëve mbronte idenë se rridhte nga Kalpoja, i cili, thoshin, ishte i biri i Numa Pompilios, pasardhësit të Romolos, themeluesit të Romës. Këta persona kishin me të vërtetë lidhje midis tyre. Thuhet se këto familje të mëdha romake kishin ardhur nga Troja dhe këtu jemi duke marrë në shqyrtim një familje, origjinat e së cilës janë për t'u kërkuar në Kaukaz dhe në Lindjen e Afërt. Pas shkatërrimit të Trojës, rreth vitit 1200 para Krishtit, na tregohet se një njeri me emrin Enea prej race "mbretërore" (ose zvarranike) u nis me atë që i mbetej prej popullit të tij dhe u shpërngul në Itali. Atje u martua me të bijën e mbretit të latinëve dhe nga kjo racë rrodhi pastaj Perandoria Romake. Sipas shumë legjendave, nipi i Eneas, një njeri me emrin Brutus, zbarkoi në Britaninë e Madhe rreth vitit 1103 para Krishtit me një grup trojanësh, përfshirë disa prej atyre që kishin kolonizuar Spanjën, dhe atje qe shpallur mbret i britanëve dhe themeloi qytetin Troja e Re, Londrën.

Luçio Kalpurino Pizoneja, stërgjyshi i parë i fisit, ishte martuar me stërmbesën e Herodit të Madh. Sipas hulumtimeve të Reuklinit, Pizoneja, që ka përdorur shumë pseudonime, krijoi "Ur-Marcus"-in e tij, versioni i parë i Ungjillit të Markut, rreth vitit 60 pas Krishtit. Njëri prej miqve që e inkurajoi ka qenë autori i famshëm romak Aneo Seneka, por duket se që të dy janë vrarë nga perandori Neron në vitin 65. Në atë pikë emri Pizone zhduket nga

historia romake dhe nuk shfaqet më përpara vitit 138 pas Krishtit, atëhere kur nipi i Pizones, Antoninoja, bëhet perandor. Por që nga ajo kohë *xhinsi* është njohur më së shumti si Antoninët dhe jo më si Pizonët. Gjatë 73 vjetëve që kaluan ndërmjet vdekjes së Pizones dhe hipjes në pushtet të Antoninos, qenë hedhur themelet e krishtërimit, duke përdorur, si në shkrimet edhe në tregimet gojore, emra të rremë. Pas vdekjes së të atit me urdhër të Neronit, i biri i Pizones, Arioja, që ka përdorur një sërë pseudonimesh, midis të cilave Çestio Galo, u emërua guvernator i Sirisë. Kjo i dha kontrollin e ushtrisë romake në Judé. U përfshi në revoltën judease (çifute) të vitit 66 pas Krishtit, që Vespasianoja qe dërguar ta shtypte. Sipas Reuklinit, perandori Neron u vra në vitin 68 pas Krishtit nga një agjent i Pizones (Arios). Dhe kjo duket se ka një kuptim, duke qenë se Neroni i kishte vrarë të atin. Kështu, fisi i Pizonëve përdori fuqinë dhe zotësinë e tij të manipulimit për të mbështetur Vespasianon, që u bë perandor i Romës në vitin 69 pas Krishtit. Një vit pasi romakët shkatërruan Jeruzalemin, plaçkitën thesaret e tempujve, përfshirë, duket, Arkën e Aleancës dhe, me sa thuhet, i çuan në Romë, ku i vendosën pranë shoqërive të fshehta ilegale. Këto shoqëri të fshehta nuk ishin gjë tjetër veçse Vëllazëria Babilonase.

Reuklini mbron idenë se Ario Kalpurnio Pizoneja shkruajti pastaj tre prej Ungjijve sipas radhës që vijon: *Ungjillniei Mateut* (70-75 pas Krishtit); versionin e përditësuar të *Markut* (75-80); dhe, me ndihmën e shkrimtarit dhe burrit të shtetit romak Plinit të Ri, versionin e përditësuar të *Lukës* (85-90). Pasoi në vitin 105 *Ungjilli i Gjonit*, vepër e Justit, i biri i Arios[3]. Sikurse mbron Reuklini, "Jezusi" ishte një figurë e përzier dhe Ungjijtë rimarrin elemente prej tregimeve të Jozefit në Egjipt dhe prej personazheve të tjerë të Testamentit të Vjetër, përveçse bazohen mbi disa shkrime esene dhe pagane. E gjitha kjo është lehtësisht e dokumentueshme. Jozefët e ndryshëm që figurojnë tek Ungjijtë janë frut i fantazisë së Pizones (Arios) dhe të kthejnë tek gjuha me kod, tipike për veprën. Gërmat e emrit "Pizone" të përkthyer në hebraisht rezultojnë *Yud, Vov, Samech, Fey*, dhe ato përbëjnë edhe emrin "Jozef". Një tjetër kod i përdorur nga Pizoneja (Ario) për t`iu referuar vetvetes është numri 60. Reuklini nënvizon ngjashmëritë e shumta ndërmjet historisë së Jezusit dhe asaj të Jozefit në Testamentin e Vjetër, që Pizoneja (Ario) e përdor si model: Jozefi kishte 12 vëllezër, Jezusi 12 apostuj; Jozefi qe shitur për 20 copa argjendi, Jezusi për 30 copa argjendi (efekt i inflacionit); i vëllai Juda sugjeron që ta shesin Jozefin, Juda shet Jezusin; Jozefi është në Egjipt, ku i vriten vëllezërit që janë para tij, Jezusi dhe familja arratisen drejt Egjiptit, për t`i shpëtuar masakrës së fëmijëve të seksit mashkullor. Pizoneja (Ario) u

frymëzua tek katër bijtë e tij për figurat e apostujve (ithtarëve) Gjoni, Jakovi, Simon Pjetri dhe Andrea[4]. Julioja, Justi dhe Prokuli do të shkruanin pastaj tekstet e Testamentit të Ri. Pizoneja (Ario) bën që t`i realizohen Jezusit një sërë profecish, që i përkasin Testamentit të Vjetër, sidomos ato të Isakut. Reuklini mbron idenë se Pizonët bënë edhe ndryshime e shtesa në disa tekste të Testamenit të Vjetër dhe shkruan pjesën më të madhe të 14 librave të Testamentit të Vjetër të njohur si apokrifë *(që nuk janë njohur si kanonikë nga feja katolike)*. Midis këtyre figuronin *Esdra, Makabei I, Juditi, Tobiti, Beli* dhe *Dragoi*[5]. Pizonët ishin stoikë dhe stoikët besonin se njerëzit mund të motivoheshin, edhe të kontrolloheshin, me anë të frikës dhe shpresës[6] (saktësisht metodat e përdoruara nga Vëllazëria Babilonase). Ç`mënyrë më të mirë mund të ketë për të përshkruar besimet që janë përhapur nga Testamenti i Vjetër dhe i Ri?

Një tjetër pseudonim i përdorur nga Ario Pizoneja ka qenë Flavio Jozefus, autori i përmendur prej meje më përpara. Arsyeja pse Pizoneja (Ario), në cilësinë e Jozefusit, dhe burri i mbesës së tij, Plini i Riu, nuk flasin për Jezusin në shkrimet e tyre zyrtare është sepse, në atë kohë, ato histori nuk do të ishin fare të besueshme. Ndodhi vetëm me kalimin e kohës, dora-dorës që kujtesa e origjinës së vërtetë të "Jezusit" zhdukej, që këto histori u pranuan si "fakte". Sipas historisë zyrtare, Jozefusi ishte një judeas që rridhte nga një familje mbretërore asmonease. Ai luftoi kundër romakëve dhe, ndonëse shokët e tij u vetëvranë kur revolta dështoi, ai përkundrazi u dorëzua dhe u kursye. Përveç kësaj na thuhet edhe se u prit si mik në oborrin perandorak romak për 30 vjet, ndërsa shkruante libra mbi "historinë" hebraike dhe pastaj arriti që të martonte të mbesën brenda aristokracisë romake. Oh, hajt, t`i japim fund! Jozefusi ishte romaku fisnik Ario Kalpurino Pizone, autor, bashkë me bijtë e tij dhe me Plinin i Riu, i Ungjijve dhe i librave të tjerë të Testamentit të Ri.

Plini shkroi edhe një sërë epistolatesh me emrin e shën Injacios. Ja pra se kush janë "etërit" e vërtetë të themelimit të Kishës! E kush do ta shndërronte këtë trillim të Vëllazërisë Romake në atë besim-burg të gjerë, që do të ishte bërë pastaj? Një perandor romak, që i përkiste të njëjtës Vëllazëri Babilonase të Pizonëve dhe që quhej Kostandini i Madh. Dhe cili qe mjeti falë të cilit e arriti këtë objektiv? Kisha e Romës! Xhefrei Higinsi në studimin e tij epik *Anacalypsis*, tregon se Roma u krijua si një Babiloni e re. Kështu që nuk të çudit fakti që krishtërimi është i mbushur me simbole babilonase. I tërë procesi nuk ka qenë gjë tjetër veçse një mashtrim me qëllimin e arritur të krijimit të një tjetër besimi për të zënë në kurth mendjen njerëzore dhe, hierarkia e

ditëve të sotme të Kishës së Krishterë, i di në mënyrë të përkryer këto gjëra! Elita kishtare i ka ditur gjithmonë, pasi ajo është pjesë e fillit të shoqërive të fshehta, që ka krijuar mitin e quajtur krishtërim. Gënjeshtra të tilla cinike si Sindoni i Shenjtë i Torinos (*çarçafi me të cilin supozohet se qe mbështjellë Jezusi i vdekur e që ruan format e trupit të tij, i cili ruhet në katedralen e Torinos*), që lidhet me shoqërinë e fshehtë të Kalorësve Templularë, janë përgatitur për të përjetësuar propagandën. Autoriteti që ka shpikur Jezusin dhe krishtërimin është i njëjti autoritet që sot kontrollon botën. Për shembull, Kolegji Romak i Arkitektëve ka qenë një prototip i Masonerisë së ditëve të sotme, vetëm emri është ndërruar. Romakët morën shumë prej simboleve të tyre, midis të cilëve skuadrën dhe kompasin. Një tempull i përdorur nga ky kolegj në Pompei u fundos nga shpërthimi i vullkanit të Vezuvit në vitin 71 pas Krishtit, por disa gërmime në përkim me vendin e tempullit kanë nxjerrë në dritë një ekzagramë, e quajtur edhe "Ylli i Davidit", një kafkë dhe një dërrasë e bardhë dhe e zezë e përdorur për herë të parë nga Artizanët e Dionisit[7]. Të gjitha këto simbole përdoren sot nga masonët.

Beteja judease kundër Romës vazhdoi deri në mundjen përfundimtare të Xelotëve në vitin 71 pas Krishtit në Masada, fortesa mbi majën e sheshtë të malit që shikon nga ana e Detit të Vdekur. Bëhej fjalë për fortesën e fundit të komunitetit esen, që e kishte shpërngulur vendbanimin e tij më poshtë, gjatë bregut të detit. Kur xelotët judeas qenë rrethuar nga romakët, shumë anëtarë të shoqërisë së fshehtë të Nazarenëve u drejtuan për në Jordani, Mesopotami, Siri e Turqi, siç është dokumentuar nga Julio Afrikani, që jetoi në Turqi rreth vitit 200 pas Krishtit. Thuhet se Jozefi i Arimatesë, "ungji" biblik i Jezusit, arriti në Francë për të përhapur doktrinën. Kardinali Baronio, bibliotekar i Vatikanit, ka thënë se Jozefi arriti së pari në Marsejë në vitin 35 para Krishtit dhe pastaj vazhdoi në Britaninë e Madhe[8]. Thuhet edhe se prej "Maria Magdalenës" dhe disa pasardhësve të Jezusit patën prejardhjen Merovingët francezë. Hëm, këto janë hajvanllëqe, sepse persona të tillë nuk kanë ekzistuar kurrë dhe, në fakt, burimi i këtyre historive është bibliotekari i Bibliotekës së Vatikanit të Kishës Katolike të Romës. Dhe çfarë ndodhi papritmas aq shumë e veçantë në Provansë dhe në Francën jugore? I bini më të një çikë se ku kishte zotërime të gjera *xhinsi* i Pizonëve? Në Gali dhe, më saktësisht, në... Provansë[9]! Nuk të çudit atëhere që "vreshti" (raca/dija) i shoqërohet pikërisht kësaj pjese të Francës. Shekuj më vonë ai u materializua në historinë e Graalit të Shenjtë, që të kthen tek aq shumë mite e legjenda. Bëhet fjalë për historitë simbolike të mbretit Artù (një tjetër "Diell"), që prej shekujsh hasen edhe në letrat e bixhozit, në muzikë e në artet evropiane. Graali është paraqitur si

kupa që mbledh gjakun e Jezusit në çastin e kryqëzimit. Por ky gjak ishte vetëm një simbol i atij të derdhur gjatë ritualeve të lashta të ekuinoksit të pranverës, në të cilat flijoheshin qingja ose, sikurse ndodhte midis sferave të larta të anëtarëve të kultit, flijoheshin pjesëtarë familjesh që zinin fill tek "perënditë" zvarranike. Në dorëshkrimet e vjetra të historive të "Graalit të Shenjtë", ai quhet Sangraal. Ky term të kujton shumë termin e lashtë francez *Sang Raal*, që do të thotë "gjak mbretëror". Ky gjak mbretëror, siç do ta shohim, ishte gjaku i racave të hibridëve njerëzoro-zvarranikë dhe nuk kishte të bënte fare më "Jezusin".

Përzierja "perëndi-Diell", simbolikisht e njohur si Jezusi, u shndërrua në një Bir i Zotit të mbinatyrshëm nga njeriu që e quajmë shën Pali, emri origjinal i të cilit ishte Saul i Tarsos. Zyrtarisht, shën Pali lindi nga prindër hebrej dhe, ashtu si ata, u bë qytetar romak, pavarësisht se ishte një farisej dhe respektonte ngushtësisht besimin hebraik. Kush tjetër, midis atyre që e quanin veten se ishin hebrej, u bë romak? Jozefusi, pseudonim i Pizones (Ario), autor i Ungjijve! Thuhet se shën Pali ka përkrahur përndjekjen e të krishterëve të parë, por ndërroi besim pastaj në rrugën e Damaskut, kur Jezusi iu "shfaq" mrekullisht dhe i tha: "Përse më përndjek?". Sidoqoftë, Pali dha tre versione të kësaj historie. Në njërin version dëgjoi zërin e Jezusit që i fliste (*Aktet*, 9, 7). Në një tjetër pa një dritë të fortë, por pa dëgjuar asnjë zë (*Aktet*, 22, 9). Dhe në versionin e tretë Jezusi i dha udhëzime mbi misionin e tij të ardhshëm (*Aktet*, 26, 13). Pali ka qenë një krijim i Plinit të Riut (pseudonimi, Masimo) dhe e Just Pizones[10]. Ata futën në historinë e shën Palit shumë prej miqve dhe shokëve të tyre, përveçse personazhe të historisë së tyre familjare. Për shembull, njeriu i quajtur "Anania", që tek *Aktet* shëron Palin prej verbërisë, qe frymëzuar nga Aneo Seneka, i cili vdiq bashkë me Pizonen (Luçio Kalpurnio Pizone) me urdhër të Neronit[11]. Dhe tek *Letër drejtuar romakëve* lexohet fraza: "Përshëndetje Herod, farefisi im", një shprehje me kod që i referohet lidhjes së *xhinsit* të Pizonëve me Herodin e Madh[12]. Nuk është e vërtetë se Pali përhapi mesazhin e Jezusit në Qipro, në Kretë, në Maqedoni, në Azi, në Greqi dhe në Romë. Këtë, përkundrazi, e bënë Plini dhe Pizonët. Midis vitit 100 dhe vitit 105 Justi, i ati dhe Plini, së bashku me familjet e tyre, me miqtë dhe me skllevërit, shkuan, midis vendeve të tjera, edhe në Azinë e Vogël (Turqinë aktuale), në qytetet greke dhe në Aleksandri për të "inkurajuar" të varfërit dhe skllevërit të hynin në besimin e tyre të ri[13]. Kishat e para u ngritën nga Plini në Bitinia dhe në Ponto. Ai i kishte vizituar këto vende shumë herë duke nisur nga viti 85 pas Krishtit dhe prej këtej e pati origjinën emri i parë i Ponc Pilatit. Ky quhet vetëm Pilat tek *Mateu* dhe *Marku*,

LIBRI

Ungjijtë e parë të shkruar nga Pizonët, por tek *Luka*, ai që Pizoneja (Ario) e shkruajti bashkë me Plinin, Pilati papritmas merr emrin Ponc[14]. Letrat e Plinit, të nënshkruara nga ai vetë, mbrojnë idenë se Just Pizoneja ndodhej në Bitinia në vitet 96 dhe 98 dhe përdorte emrin Tulio Justi dhe se edhe Pizonët u vendosën në Hefes, qendër e kultit dhe e tempullit kushtuar perëndeshës Diana, një tjetër version i Isidës, Semiramidës, Baratisë e kështu me radhë, në pafundësi. Duke u zhvendosur nga njëri vend në tjetrin e mbanin veten për apostuj e peshkopë, pasardhës të personazheve të krijuar prej vetë atyre, Pjetrit dhe Palit. Deklaronin se ishin Injacioja (Plini), Justini (Justi), Klementi i Romës (Julio), Polikarpi (Prokuli) dhe Papia (Juliani, biri i Justit)[15]. Në këtë pikë, një grua që i përkiste *xhinsit* të Pizonëve, Pompeia Plotina (emri i vërtetë Klaudia Febe) u martua me perandorin romak Trajanin, dhe Pizonët përfituan kështu mbështetje të plotë nga ana e niveleve më të larta të pushtetit romak[16]. Ajo shfaqet edhe si "motra jonë Febe", "Klaudia" dhe "Klaudia e vogël" në tekstet e quajtura të *Romakëve*, të *Timoteos* dhe të *Klementit*[17].

Pizonët dhe Plini futën në historitë e tyre të gjitha simbolet e kulteve diellore dhe të miteve të Vëllazërisë Babilonase. Ata e vendosin Saul/Palin e tyre në Tarso, në Azinë e Vogël (Turqia e sotme), që ishte qendra kryesore e kilikiasve. Ky qytet ishte, pa shih, njëra prej qendrave kryesore të kultit diellor të Mitras dhe kanë qenë kilikiasit ata që e çuan këtë kult në Romë, prej nga pastaj u përhap në pjesën tjetër të perandorisë. Edhe Azia e Vogël (Turqia e sotme) qe një rajon ku respektohej kulti i Dionisit. Që të dyja këto perëndi, të lindura më 25 dhjetor dhe të vdekura për të të na çliruar prej mëkateve tona, ishin simbole të Diellit. Gjithçka që të krishterët e besojnë të Jezusit, romakët dhe persianët e besonin të Mitras. E diela ishte një ditë e shenjtë për besnikët e Mitras, sepse ai ishte një perëndi e Diellit, dhe ata e ripagëzuan atë ditë si Dita e Perëndisë. Dionisi lindi nga një nënë virgjëreshë dhe u bë i famshëm si: Vreshti, Perëndia Jonë, Shpëtimtari, Gjykatësi i të Vdekurve, Çlirimtari, Ai që ka rilindur dhe i vetmi Bir i Zotit i lindur. Përsipër kokës së Dionisit lexoheshin fjalët: "Unë jam Jeta, Vdekja, Ringjallja, unë mbaj kurorën me krahë (Diellin)"[18]. Shkrimatri H.G. Uelsh ka bërë të njohur se shumë prej shprehjeve që Pali ka përdorur për të përshkruar Jezusin përkonin me ato të përdorura nga ithtarët e Mitras. Liturgjia e Mitras përkon me liturgjinë e Jezusit. Kur Pali thotë: "Pinë nga një shkëmb shpirtëror dhe ai shkëmb shpirtëror ishte Krishti" (*Letra e parë drejtuar korinthasve*, 10, 4), përdor saktësisht të njëjtat fjalë që hasen në shkrimet e Mitras. Vetëm emrat qenë ndërruar. Tek Ungjijtë, Pjetri u bë "guri" i krishterë, mbi të cilin do të ishte ngritur Kisha e re. Thuhej se kodra e Vatikanit në Romë ishte e shenjtë për

Pjetrin, por, shumë kohë më parë, ai vend kishte qenë i shenjtë për Mitran dhe shumë sende arkeologjike të lidhura me kultin e tij janë gjetur aty! *Xhinsi* i Pizonëve e shndërroi kultin e Mitras në besimin e krishterë.

Të gjithë papët kanë mbrojtur rolin e tyre si trashëgimtarë të Pjetrit, papës së parë. Kjo mbrojtje bazohet tek një frazë e *Biblës*, në të cilën Jezusi thotë: "Ti je Pjetri dhe mbi këtë gur do të ngresh kishën time"[19]. Vetëm katër rreshta më pas në krahasim me këtë lavdërim të supozuar të Pjetrit si "gur" ("pietra"), mbi të cilën të ngrinte Kishën e re, vjen hedhja poshtë e saj: "Por ai (*Jezusi*), duke u kthyer, i tha Pjetrit: «Larg nga unë, Satana! Ti je për turp, sepse nuk mendon sipas Zotit, por sipas njerëzve!»"[20]. "Guri" ("pietra") është një simbol klasik i shkollave misterike, ashtu sikurse "guri (pietra) i qoshes" që i shoqërohet Jezusit dhe që përdoret ende sot në simbolizmin mason. Pjetri është ruajtësi i supozuar i çelësave të Parajsës, por kjo nuk është gjë tjetër veçse një përsëritje e simbolit të shkollave misterike e përfaqësuar nga perëndia latine Xhiano, që paraqitej me dy faqe të kundërta, ruajtës i Tempullit të Urtësisë, dhe nga Mitra, ruajtës i çelësave të Parajsës. Dhe Xhianoja ishte Eanus, një titull që i atribuohej babilonasit Nimrod. Çelësat e artë dhe të argjendtë të pasardhësit të supozuar të shën Pjetrit, papës, janë simbole të mëtejshme të doktrinës sekrete. Papët dhe ata që i kontrollojnë e dinë se ç`do të thonë me të vërtetë të gjitha këto gjëra. Ari dhe argjendi janë metalet e çmuara të përdurura si simbole të Diellit dhe të Hënës. Thuhet se si Pjetri edhe Pali janë vrarë në Romë gjatë spastrimit të të krishterëve i urdhëruar nga perandori Neron, por nuk ka prova që ta mbështesin këtë tezë, thjesht sepse nuk është e vërtetë. Dy personat e tjerë që thuhet se janë vrarë nga Neroni janë Luçio Kalpurnio Pizoneja, kreu i *xhinsit*, dhe miku i tij Aneo Seneka! Me kalimin e viteve, kulti i Diellit dhe simbolizmi ekzoterik i shkollave misterike u shndërruan në një besim të bazuar mbi përkthimet e fjalëpërfjalshme të teksteve simbolike.

Mbi këto fjalë me dy kuptime dhe mbi këto gënjeshtra u themelua krishtrimi. Na kanë çuar të besojmë se Kisha e Krishterë doli si forcë e bashkuar, por nuk ka qenë aspak kështu. Brenda saj kishte shumë fraksione që pasqyronin një spektër të gjerë opinionesh dhe që përplaseshin e luftonin për t'u njohur si të vetmet mbajtëse të së "vërtetës". Konflikti më i ashpër u zhvillua ndërmjet përkrahësve të versionit të Jezusit të dhënë nga shën Pali, që e paraqisnin si Bir të mbinatyrshëm të Zotit, dhe arianëve, që mendonin se ai kishte një natyrë njerëzore, dhe jo hyjnore. Arianët e morën emrin nga Arioja, një klerik i Aleksandrisë së Egjiptit, që vuri në dyshim natyrën hyjnore të Jezusit. Jehovai a nuk kishte thënë vallë se ishte i vetmi Zot? Si mund të ekzistonin atëhere tri pjesë tek Zoti: i Ati, i Biri, dhe Shpirti i Shenjtë?

LIBRI 24

"Triniteti" është një koncept pagan dhe rrjedh nga besimi babilonas dhe ai egjiptian. Tani, sikur ne të jetonim në një botë të banuar nga të rritur të pjekur, do t'u jepnim të tjerëve lirinë që të besonin në atë që dëshirojnë, me kusht, megjithatë, që kjo të mos u diktohet të tjerëve. Fakti që ne mendojmë se këto gjëra janë të rreme ose të marra, nuk duhej të ishte absolutisht vendimtare. Problemi im me krishtërimin dhe me besimin në përgjithësi nuk është pse dikush beson, gjë që hyn në të drejtat e tij, ajo që unë kundërshtoj është mënyra me të cilën ky besim u është diktuar njerëzve, duke mbjellë frikë, ndjenjë faji e dhunë dhe duke shtypur çfarëdolloj mendimi të ndryshëm. Fatkeqësisht, t'u japësh të tjerëve të drejtën të besojnë në diçka në të cilën ti nuk beson, quhet krim dhe kështu që përkrahësit e Palit dhe përkrahësit e Arioskanë vazhduar të luftojnë kundër njëri-tjetrit. Në këtë pikë ja ku ndërhyn Kostandini i Madh që, bashkë me Pizonen dhe Plinin, ka qenë krijuesi i asaj që u bë e njohur si krishtërim.

Kostandini u kurorëzua perandor i Romës në vitin 312 pas Krishtit. Fitoi emrin (namin) e ushtarit trim dhe të pamëshirshëm dhe për një periudhë kohe shërbeu në Britaninë e Madhe, para se të ishte emëruar Cezar i Perëndimit. Filloi pastaj të vriste rivalët e tij, dhe shumë prej bijve të tyre, pasi dëshironte të ishte perandor i të gjithëve. Sipas legjendës së krishterë, gjatë njërës së betejave të tij për *leadership*-in romak, në Ponte Milvio, pranë Romës, atij iu shfaq vegimi i një kryqi në qiell me fjalët: "Me këtë shenjë do të fitosh". Legjenda vazhdon se natën e mëpasshme iu shfaq Jezusi, që i tha të shtonte një kryq në flamurin e tij për të siguruar fitoren mbi armiqtë. Histori e bukur, por fjala e parë që më vjen në mendje është "gjepura". Thuhet se Kostandini u kthye në fenë e krishterë falë vegimeve të tij, por ka një problem të vogël. Nuk u bë kurrë një i krishterë i vërtetë, me përjashtim ndoshta në shtratin e vdekjes, sa për të mos rrezikuar. Ai nderonte perëndinë greke Apollonin (Diellin) dhe Sol Inviktusin (Diell i pamposhtur) dhe mbeti gjer në vdekje Papa më i Madh i Kishës Pagane! Për këtë arsye, dita e lindjes së Jezusit u caktua 25 dhjetori dhe e tillë ka mbetur deri sot. Kostandinit i detyrohet edhe faltorja e madhe e krishterë e Jeruzalemit. E ëma Helena qe dërguar në qytet për të rënë në gjurmët e vendeve dhe objekteve të historisë së krishterë. Ishte ajo që deklaroi se kishte gjetur vendin e saktë të lindjes së Jezusit, të kryqëzimit të tij, varrin e tij, dhe vendin prej nga ishte ngjitur në qiell. Mundeni ende t'i shihni këto vende, nëse bëni ndonjë vizitë me udhërrëfyes në Jeruzalem! Në vitin 326 pas Krishtit Kostandini ndërtoi një bazilikë në vendin ku e ëma thoshte se ishte kryqëzuar Krishti dhe, po në atë vend, sot ngrihet kisha e Varrit të Shenjtë që tërheq miliona të krishterë të

dëshiruar për të parë se ku "është kryqëzuar Jezusi". Helena ka thënë edhe se kishte gjetur tre kryqe druri, rreth 300 vjet pas ngjarjes. Duhet të ketë qenë një grua me të vërtetë e zonja!

Por e vërteta ishte shumë e ndryshme. Kostandini i përkiste të njëjtës Vëllazëri Babilonase, nëpërmjet së cilës vepronin edhe Pizonët e Plini. Sipas disa studiuesve, bazilika, që Kostandini ngriti në Jeruzalem, hyn në skemën e shenjtë planimetrike të atij qyteti. Kolegji Romak i Arkitektëve ishte i lidhur me Urdhërin e Mjeshtrave Komaçinë, që u shtri me shpejtësi gjatë mbretërimeve të Kostandinit dhe Teodosit, pikërisht teksa krishtërimi po bëhej besimi sundues brenda Perandorisë Romake[21]. Të dy këta urdhëra përfaqësonin degëzime të rëndësishme të shoqërive të fshehta të Vëllazërisë. Urdhëri i Komaçinëve e kishte qendrën në Itali, në ishullin me të njëjtin emër të Liqenit të Komos. Liqeni i Komos, që sot është afër qendrave zvicerane të riciklimit të parave të pista si Luganoja, është një vend shumë i rëndësishëm për Vëllazërinë Babilonase. Në vitin 1965, dy prej anëtarëve të saj britanikë, princi Filip dhe miku i tij i besuar lordi Mountbaten, morën pjesë, në Liqenin e Komos, në një mbledhje të Grupit të Bilderbergut, pjesë e Vëllazërisë. Urdhëri i Komaçinëve ndahej në lozha të drejtuara nga Mjeshtra të Mëdhenj dhe anëtarët e tij mbanin dorashka e përparëse të bardha dhe komunikonin përmes shenjave të fshehta e shtrëngimit të duarve[22]. E gjitha kjo ndodhte më shumë se njëmijë vjet përpara themelimit zyrtar të Masonerisë! Ata mbroheshin nga mbreti longobard (*longobardët, popullsi e lashtë gjermanike në veri të Italisë*) dhe u bënë mësuesit e të gjithë ndërtuesve dhe arkitektëve italianë[23]. Ka qenë ky urdhër i fshehtë, pasardhës i arkitektëve të mëparshëm të Vëllazërisë, Artizanëve të Dionisit, që luajti rolin e urës lidhëse midis ndërtuesve të tempujve të lashtë paganë dhe sivëllezërve të tyre që do të kishin ndërtuar katedralet më të mëdha të Evropës. E njëjta Vëllazëri ndërtoi si tempujt edhe katedralet! Tempujt e lashtë ishin faltoret e perëndive pagane, saktësisht sikurse edhe katedralet e krishtera. I vetmi ndryshim ka qenë se njerëzit besonin që të dytat ndërtoheshin për të nderuar "Jezusin". Shën Bernardi, personalitet i krishterë i famshëm, e ka përkufizuar Zotin si "gjatësi, gjerësi, lartësi dhe thellësi", sepse kuptoi ndikimin e gjeometrisë dhe të numrave në fushat energjitike. Edhe Pitagora deklaroi se "numri është gjithçka". Pushteti i formës, i numrave, i gjeometrisë dhe i përmasave janë disa prej "mistereve të mëdha" të pakuptueshme për masat.

Sigurisht, Kostandini dhe Vëllazëria, që i kontrollonte perandorët, panë një përfitim politik në mbështetjen e dhënë ndaj lëvizjes së krishterë. Dhe populli nuk do të kishte pasur asnjë problem për ta futur Jezusin brenda

sistemit të tij të besimeve, pasi besimi i ri imitonte pikë për pikë atë të perëndive diellore të kohës, përfshirë Mitran. Krishtërimi mori shumë prej ithtarëve të Mitras, pasi për ata asgjë, përveç emrit, nuk ishte e ndryshme nga ajo në të cilën besonin edhe më parë. Kostandini i dha fund përndjekjes së të krishterëve brenda perandorisë romake duke shpallur Ediktin e Milanos, por ai nuk u drejtohej vetëm të krishterëve, por ndalonte përndjekjen kundrejt të gjitha besimeve monoteiste. Megjithatë, ende pa marrë fund mirë ajo përndjekje, filloi menjëherë një tjetër, pasi Kisha Katolike përndiqte, digjte dhe torturonte cilindo që kundërshtonte të përqafonte besimin e krishterë, ose, më mirë, atë që ishte versioni i tij i atij besimi. Dhjetëra miliona njerëz kanë vdekur në emër të të ashtuquajturit "Parim i Paqes". Në vitin 325 pas Krishtit Kostandini vrau të shoqen dhe djalin e tij të madh, para se të shkonte në pallatin e tij në Nikea (Izniku aktual, në Turqi), për të vendosur se në çfarë duhej të besonin të krishterët deri në ditët e sotme. Ai deshi t`i jepte fund konfliktit midis përkrahësve të Palit dhe atyre të Arios dhe të themelonte një besim të vetëm të krishterë. Mblodhi në Nikea 318 peshkopë (një tjetër numër mistik) për t`u shpjeguar se cili do të ishte besimi i tyre. Grindje të ashpra u zhvilluan midis fraksioneve mbi tema aq shumë përvëluese për të ardhmen e botës: a ishte Jezusi pjesë e një triniteti të shenjtë të përbërë nga Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë? Një mut i shenjtë. Disa dokumente u grisën dhe krisën grushtet. Nëse jeni të krishterë, jeni sepse kështu është vendosur besimi juaj. Përkrahësit e Arios e humbën ndeshjen dhe mbi këtë rrëmujë e mbi diktaturën romake bazohet kredoja themelore e krishtërimit, Kredoja Nikease. Kjo gjë e neveritshme thotë sa vijon. Ju lutem të përqëndroheni, sepse pastaj do t`ju bëj ca pyetje:

"Besoj në një Zot të vetëm, Ati i gjithfuqishëm, krijuesi i të gjitha gjërave, i dukshëm e i padukshëm; besoj në një Perëndi të vetme, Jezu Krishti, bir i vetëm i Zotit, i lindur nga Ati para të gjithë shekujve, Zot nga Zoti, Dritë nga Drita, Zot i Vërtetë nga Zoti i Vërtetë, i lindur, jo i krijuar, prej të njëjtës lëndë të të Atit; me anë të tij janë krijuar të gjitha gjërat, si në qiell edhe në tokë; për ne njerëzit (kupto burrat) *dhe për shpëtimin tonë zbriti nga qielli dhe u bë njeri, vdiq dhe u ringjall ditën e tretë, u ngjit në qiell, dhe përsëri do të vijë për të gjykuar të gjallët e të vdekurit; besoj në shpirtin e shenjtë".*

E thjeshtë, apo jo? U vendos që Jezusi ishte i së njëjtës lëndë me të atin, sepse në Babilonin e lashtë thuhej që Nimrodi dhe i biri, Tamuzi, ishin i njëjti person. Së ëmës, mbretëreshës Semiramidë, iu dha titulli i Shpirtit të

Shenjtë. Për këtë arsye Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë janë në realitet Nimrodi, Tamuzi dhe Semiramida. Krishtërimi është besimi babilonas dhe i tillë ka qenë që në zanafillë. Sot Roma dhe Italia mbeten një nga qendrat më të mëdha të Vëllazërisë. Vetë Vatikani kontrollohet tërësisht nga Vëllazëria, një nga bazat më të rëndësishme të së cilës përfaqëson.

Krishtërimi, ashtu sikurse edhe judaizmi e islamizmi, ka qenë projektuar për të realizuar një tjetër pikë themelore të Urdhërit të Ditës të racës së Zvarranikëve: mbytjen e energjisë femërore, domethënë të lidhjes intuitive me nivelet më të larta të vetëdijes sonë shumëpërmasore. Nëse mbyt energjinë tënde femërore, intuitën tënde, shuan vetëdijen tënde më të lartë dhe përfundon të jesh i zotëruar prej vetëdijes tënde më të ulët. Duke bërë kështu, nuk mund të hysh në përmasën tënde më të lartë të dashurisë, të urtësisë e të dijes, dhe je nën pushtetin e informacioneve të "manipuluara", që të bombardojnë sy e veshë. Kjo është arsyeja pse Vëllazëria është përpjekur të krijojë një botë, në të cilën energjia mashkullore të jetë mbizotëruese, të paktën në nivelin sipërfaqësor. Sjellja që ne e përkufizojmë si sjellje prej "burri *maço*" është sjellja tipike e njeriut që i është hequr energjia femërore dhe, për këtë arsye, është thellësisht i çekuilibruar. Vini re që tek Kredoja Nikease e Kostandinit nuk ka asnjë referim ndaj grave. Thuhet se Zoti është mishëruar tek Jezusi "për ne njerëzit (*kupto burrat*) dhe për shpëtimin tonë". Krishtërimi ka qenë një fortesë mashkullore që në themelet e tij, i krijuar për të mbytur energjinë ekuilibruese femërore. Etërit themelues të Kishës, si Kuinto Tertuliani, i përjashtuan gratë nga zyra priftërore, duke i ndaluar ato deri edhe për të folur në kishë. Ndodhi vetëm në Koncilin e Trentos, në vitin 1545, që Kisha Katolike vendosi zyrtarisht se edhe gratë kishin një shpirt, dhe ky vendim u mor me një avantazh të vetëm tri votave! Farët e kësaj dogme antifemërore tipike e Kishës Katolike hasen edhe në atë pasqyrë të krishtërimit sikurse është zarathustrizmi, sekti i profetit (perëndia-Diell mitike) Zarathustra.

Ky besim ka lindur prapë edhe një herë në Persi, në një zonë që sot i përket Turqisë, ku ngrihet mali Taurus dhe qyteti i shën Palit, Tarsoja. Zarathustra tregonte një sjellje të dhunshme mizogjine (*urrejtës i grave*) dhe deklaronte se «asnjë grua nuk mund të hyjë në Parajsë, me përjashtim të atyre "që i nështroheshin kontrollit nga ana e burrit dhe i konsideronin zotër burrat e tyre"». Krejt kjo filozofi është thuajse një përsëritje e fjalëpërfjalshme e brahmaneizmit, kredoja e llahtarshme induiste e futur në Indi nga arianët shumë shekuj më parë. Shën Pali (Pizonët dhe Plini) vazhdoi të vërë në zbatim planin e tij (*Zarathustrës*) armiqësor ndaj grave, në përputhje me urdhërat e

LIBRI

krishtera, duke i hapur rrugën përndjekjes së tmerrshme të grave, që u krye në gati dymijë vjetët e mëpasshëm. Midis perlave të shën Palit lexohet:

"Gra nënshtrojuni burrave tuaj, pasi burri është kreu i gruas, ashtu sikurse Krishti është kreu i Kishës. Tani, nëse Kisha i nënshtrohet Krishtit, në të njëjtën mënyrë gratë duhet t`i nënshtrohen në çdo gjë burrit".

Dhe:

"Nuk lejoj as që një grua të edukojë, as që të uzurpojë autoritetin e burrit, por vetëm që të qëndrojë në heshtje"

Kisha e krishterë u krijua për të përfaqësuar dhe për të përjetësuar dridhjen e skajshme mashkullore, energjinë diellore, dhe për t'i ruajtur të fshehta dijet e lashta. Ajo bëhet një mjet shumë i fuqishëm dhe thelbësor për t'i mbajtur të fshehura dijet, në mënyrë që të mundej pastaj t'i përdorte në fshehtësi e me qëllime negative. Mbytja e energjisë ekuilibruese femërore dhe grumbullimi i dijeve solli si pasojë përndjekjen e "shtrigave" – komunikuese medianike e vegimtare të të gjitha llojeve. Komunikimi me përmasat e tjera përbënte një element themelor të jetës para-të krishterë. Asokohe komunikuesit medianikë quheshin "profetë", "orakuj" "enë komunikuese të Zotit" e kështu me radhë. Njëri prej krerëve të gjuetisë ndaj shtrigave ka qenë Xhirolamoja, i lindur në vitin 341, të cilit i atribuohet mbledhja e teksteve për versionin kryesor latinisht të *"Biblës së Shenjtë"*. Ishte Xherolamoja ai që e bindi papën të ndalonte komunikimin medianik me përmasat e tjera. Vetëm me këtë dekret papnor, "enët" e Zotit u bënë "enë" dhe "shtriga" të djallit, terma që përdoren ende nga shumë të krishterë. Mbreti Xhejmsi I, mbreti i parë i Anglisë dhe Skocisë, nxori një dënim të ashpër për shtrigat në versionin e tij të *Biblës* të vitit 1611 dhe i mbajti premtimet, duke urdhëruar të torturoheshin dhe të vriteshin mijëra gra të akuzuara për shtrigëri. Xhirolamoja donte që priftërinjtë të vepronin si ndërmjetësues midis njerëzimit dhe Zotit. Nuk donte që njerëzit të kishin të drejtën të hynin drejpërdrejt tek Shkrimet, të kundërshtonin qëndrimet zyrtare, apo të përhapnin dije të paniratura nga Kisha. Për ta thënë me fjalët e tij:

"Ne u themi atyre (komunikuesave medianikë) *se nuk është aq shumë profecia ajo që nuk e pranojmë, se sa prania e profetëve, deklarimet e të cilëve nuk janë në përputhje me Shkrimet e vjetra dhe të reja"*[24].

E, megjithatë, edhe anëtarët e Vëllazërisë Babilonase, që krijuan Kishën Katolike, i shfrytëzonin në të njëjtën kohë këto fuqi medianike e metoda të komunikimit ndërpërmasor. Okej, në çfarë mënyre tjetër mund t'i kontrollosh e t'i diskreditosh masat? U kemi shitur një histori të bukur të trilluar mbi Jezusin dhe i kemi mashtruar në mënyrë të tillë sa i kemi bërë të besojnë se pas kësaj jete tokësore Zoti do të vendosë t'i dërgojë në ferr apo në parajsë. I kemi bërë të besojnë edhe se ne, njerëzit me veladon, e dimë se si dëshiron Perëndia që të jetojnë dhe se gjithçka që është ekzoterike ka të bëjë me djallin. Asgjë tjetër? Po, duhet t'i ruajmë nga energjia seksuale, që është forca krijuese. Duhet ta bllokojmë, përndryshe burimi i fuqisë së masave do të vazhdojë të ushqehet. Kam tani këtu pikërisht njeriun që bën për rastin tonë. Thuajini të hyjë Agostinit në zyrën time, ju lutem. Shën Agostini i Iponës, si pjesa më e madhe e personaliteteve të Kishës, vinte nga Afrika e Veriut. Kur ishte i ri ushqeu dëshira sfilitëse seksuale, por në moshën 31 vjeç, pas konvertimit të supozuar në besimin e krishterë, e ndryshoi rrënjësisht mënyrën e jetës dhe e ndau mendjen se seksi ishte një gjë e llahtarshme. E dini, një çikë siç bëjnë pirësit e duhanit, kur heqin dorë prej tij. Nuk i lejonte asnjë gruaje të hynte në shtëpinë e tij po të mos ishte e shoqëruar, dhe kjo vlente deri edhe për të motrën. Por nuk mundi të shpikte një mënyrë tjetër për të lindur, prandaj qe i detyruar ta prononte seksin, për të shmangur shuarjen e njerëzimit. Megjithatë, ngulmoi në faktin që për asnjë arsye ai (*d.m.th, seksi*) nuk duhej të ishte një burim kënaqësie. Unë e kam provuar, por nuk funksionon. Por ja cila ishte ideja e seksualitetit që kishte Agostini:

"Burrat t`i duan gratë e tyre, por t`i duan dlirësisht. Ta zgjatin qëndrimin në mish vetëm për aq kohë sa kjo është e nevojshme për lindjen e fëmijëve. Duke qenë se nuk është e mundur të linden fëmijë në asnjë mënyrë tjetër, jeni të detyruar ta ulni veten për këtë kundër dëshirës suaj, pasi ky është ndëshkimi i Adamit".

Këto qëndrime çuan, shkallë-shkallë, tek detyrimi i beqarisë për klerin i vendosur nga ana e papës Gregor VII, në vitin 1074. Tamam, sot në Kishën Katolike priftërinjtë janë beqarë sepse kjo është ajo që ka vendosur një papë nja njëmijë vjet më parë dhe, një pafundësi fëmijësh, të përdhunuar nga njerëz të kishës të zhgënjyer e të çekuilibruar, kanë paguar pasojat e këtij vendimi. Agostini e lidhte seksin me mëkatin origjinal, me idenë, domethënë, që lindim të gjithë mëkatarë, pasi rrjedhim nga Adami dhe Eva. Jezusi, sipas teorisë së tij, ka qenë i vetmi që ka lindur pa mëkatin origjinal, pasi qe ngjizur

LIBRI 24

nga një virgjëreshë. Por çfarë kishte ngjarë me të ëmën? Ajo duhej të ishte përlyer nga mëkati origjinal, kështu që një çikë prej mëkatit të saj duhet të ketë kaluar edhe tek i biri. Më pas, Kisha Katolike u kujtua për kontradiktën dhe shpalli se edhe Maria ishte ngjizur nga një virgjëreshë. Por çfarë kishte ndodhur atëhere me të ëmën e *saj*? E kishte mëkatin origjinal? Nëse po, ai do të kishte kaluar tek Maria. O Zot i Madh, ju lutem shumë, ndalomëni para se të jetë tepër vonë! Çfarë rrangulline është kjo! Por miliarda njerëz janë kontrolluar e manipuluar në këtë mënyrë, sepse kredoja e krishterë ka futur tinëz frikën, ndjenjën e fajit dhe dhunën në thellësinë e shpirtit njerëzor. Të thuash të vërtetën, edhe unë besoj tek mëkati origjinal. Disa prej "mëkateve" të mia kanë qenë shumë origjinale. Nëse dëshironi vërtet të mëkatoni, bëjeni në mënyrë origjinale, kjo është ajo që ju them.

Nivelet shpirtërore, mendore, emocionale dhe fizike të qenies sonë janë të lidhura me vorbuj energjie të njohur si *chakra* (një fjalë sanskrishte që do të thotë "rreth i dritës"). Dhe përmes këtyre vorbujve *chakra* që i çekuilibron kalojnë nga njëri nivel në tjetrin (shiko ***Figura 18***). Kështu, kur u jemi nënshtruar tensioneve emocionale, e para gjë që ndodh është se pushojmë së menduari në mënyrë të përshtatshme. Çekuilibri i nivelit emocional përcillet në nivelin mendor. Nëse çekuilibri nuk rregullohet, ai përcillet pastaj në nivelin fizik dhe ja arsyeja pse stresi dhe çrregullimi emocional shkaktojnë sëmundje e shqetësime, apo siklete. Këto çekuilibrime emocionale manifestohen në nivel trupor në formën e reaksioneve kimike dhe janë pikërisht këto reaksione që mjekësia zyrtare (shumëkombëshet farmaceutike) përpiqet t'i "kurojë" me një kosto të pabesueshme, qoftë në terma monetare, qoftë përsa i përket pasojave për një kohë të gjatë në trup. Ajo kuron simptomat, dhe jo shkakun, sepse pjesa më e madhe e mjekëve janë aq të "indoktrinuar", sa që nuk e kanë idenë se si funksionon trupi me të vërtetë, as idenë e natyrës së qenies njerëzore. Por për këtë janë përkundrazi në dijeni ata që kontrollojnë ndërmarrjet farmaceutike dhe përdorin çdo mjet të mundshëm për të hequr qafe metodat "alternative" të kurimit, që kurojnë shkakun dhe jo simptomën.

Janë gjithmonë *chakra*-t ato që tërheqin energjinë në sferën e vetëdijes sonë dhe, në nivelin më të mirë, ne marrim në zotërim sasi të mëdha energjie, sidomos nëpërmjet *chakra*-s së bazës, në fund të shtyllës kurrizore. Prej këtej ajo ngjitet përmes të shtatë *chakra*-ve më të mëdha derisa të mbërrijë atë të kurorës, në majë të kokës. E shpjegoj këtë fenomen në mënyrë më të hollësishme në të tjera libra të mi si tek *Unë jam vetvetja, unë jam i lirë*. Për arsye që do t'i paraqes më pas, sa më shumë energji të tërheqim në fushën tonë energjitike, aq më e madhe do të jetë aftësia jonë për të ngjizur dhe për




Figura 18. *(chakra e kurorës, chakra e syrit të tretë, chakra e fytit, chakra e zemrës, chakra e gërshetimit diellor, chakra lombare, chakra e bazës)* Sistemi i "chakra"-ve apo vorbujve njerëzorë, që përshkon nivelet tona të qenies. Kur ato janë të hapura, lidhemi me kozmosin dhe tërheqim drejt nesh sasi të pakufizuara energjie. Kur përkundrazi mbyllen, ndërpritet lidhja jonë me kozmosin dhe atëhere ne disponojmë vetëm një fraksion të fuqisë sonë mendore, emocionale, fizike dhe shpirtërore.

të kontrolluar fatin tonë. Për këtë arsye, është jetike për ata që duan të na diskreditojnë e të na sundojnë që të gjejnë një mënyrë për të kufizuar sasinë e energjisë që thithim. Ja pra, këtu hyn në lojë manipulimi i seksit. Të tre *chakra*-t më të poshtme janë ajo e bazës, *chakra* seksuale është menjëherë mbi të, dhe pastaj ajo e gërshetimit diellor, e lidhur me nivelin tonë emocional.

Kjo e fundit është *chakra* përgjegjëse e "ngërçeve" në stomak dhe e manifestimeve të tjera të stresit dhe shqetësimeve. Kështu që, ideja e krishterë dhe moraliste e seksit bllokon *chakra*-n e bazës dhe energjia e thithur hidhet në pështjellim, për shkak të frikës dhe të ndjenjës së fajit të nxitura nga ajo ide. Kjo çrregullon dhe zvogëlon të tërë fushën energjitike të vetëdijes njerëzore. Pjesa më e madhe e priftërinjve të krishterë nuk e ka idenë e kësaj, në dallim prej atyre që zënë nivelet më të larta të Kishës dhe të institucioneve të krishtera, që kanë përkundrazi të drejtën e hyrjes tek dijet e ndaluara për popullsinë. Çdo brez është kushtëzuar t'i bashkohet idesë së krishterë për seksin, qoftë në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme dhe, nga ana e tij, ka kushtëzuar brezin pasardhës të mendojë në të njëjtën mënyrë. Por seksi është një gjë e mrekullueshme. Është një burim kënaqësie. Aftësia për të shprehur fizikisht dashurinë tënde për një tjetër qenie njerëzore është një dhunti e jashtëzakonshme. Nuk ka rëndësi se cilat janë shijet tuaja seksuale.

LIBRI 24

Dashuria është dashuri, është dashuri. Le ta shprehim. Nëse Agostini dhe papa dëshirojnë ta lidhin të tyren, janë të lirë ta bëjnë, mjaft që të mos vijnë e të më thonë se si duhet ta jetoj jetën time.

Në Lindje, në azi dhe në Kinë, prej mijëra vjetësh nënvizohet fuqia e energjisë seksuale dhe këto dije janë shfrytëzuar të Perëndim brenda shoqërive të fshehta dhe riteve satanike. Prapë edhe një herë energjia seksuale nuk është gjë tjetër veçse energji dhe mund të përdoret për të krijuar, ose për të shkatërruar. Në besimet lindore (orientale), krijimi i vetëdijshëm i energjisë seksuale dhe nxitja e saj janë njohur si Tantra. Marrëdhënia seksuale është konsideruar, me të drejtë, si bashkim dhe ekuilibër i energjisë mashkullore dhe asaj femërore, *yang*-ut (mashkullore) dhe *yin*-it (femërore). Ideja mbi të cilën bazohet seksi tantraist është ajo e nxitjes së energjisë seksuale që përmbahet në fund të shtyllës kurrizore, energjisë *kundalini*, siç quhet normalisht. Ajo paraqitej si një gjarpër që shpërdridhet dhe kush praktikon Tantran e kontrollon dhe e vonon orgazmën për ta shndërruar *kundalini*-n nga gjendja e saj origjinale (*ching*) në një energji të lartë (*ch'i*) dhe, më në fund, në shprehjen e saj më të lartë (*shen*). Kjo realizohet duke e bërë energjinë të ngjitet përgjatë shtyllës kurrizore dhe pastaj duke e bërë të zbresë përsëri gjersa të arrijë një gjendje dridhëse, falë së cilës njeriu mund të rilidhet me kozmosin. Kur të arrini në fund të këtij libri do ta kuptoni rëndësinë e kësaj teorie dhe do të njihni bazat e saj shkencore. Kur *kundalini* shpërthen në fushën tënde energjitike, siç më ka ndodhur mua më 1990-91, mund të të bëjë "të shkosh në orbitë" nga pikëpamja mendore, emocionale, shpirtërore, nganjëherë edhe fizike, gjersa të mos kesh mësuar ta mbash nën kontroll fuqinë e saj. Të nxiturit e *kundalini*-t mund të përshkruhet si "ndezja e zjarrit të brendshëm". Ai imi nuk qe një zjarr, por një shpërthim bërthamor! Tantra parashikon që ky proces të çohet në përfundim në mënyrë të kontrolluar, por nganjëherë, humbja e kontrollit mund të të ofrojë përvojat më të jashtëzakonshme dhe më ndriçuese. Nga çasti që *kundalini* do të jetë nxitur, do të keni vazhdimisht në dispozicion një energji jashtëzakonisht të fuqishme, me të cilën të krijoni atë që dëshironi. Satanistët e konsiderojnë seksin një element themelor për ritualet e tyre dhe e shfrytëzojnë energjinë seksuale, *kundalini*-n, për qëllimet e tyre të poshtra. Por ajo njëlloj mund të përdoret për të na çliruar dhe në dritën e kësaj shpjegohet ideja fikse që e mundon klerin e krishterë për ta shndërruar seksin në një përvojë të ndyrë dhe imorale, burim ndjenjash faji të parrëfyeshme, një aukth që mbyt dhe çekuilibron energjinë *kundalini* dhe ndërpret lidhjen midis njeriut dhe niveleve kozmike të qenies.

Përpilimi i *Biblës* ka qenë një tjetër farsë. Nëse do t'u kërkonit pjesës më të madhe të njerëzve informacione mbi autorët e Ungjijve, do t'ju përgjigjen se Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni ishin apostuj të Jezusit. Kjo është përshtypja që njerëzit kanë dhe që janë nxitur të kenë, por nuk është e vërtetë dhe as Kisha nuk e ka pohuar kurrë zyrtarisht. Ungjijtë dhe librat e tjerë të *Biblës* janë zgjedhur nga krerët të Kishës së Krishterë ndërmjet teksteve të shkruara nga Pizonët dhe Plini e ndërmjet shumë kopjeve dhe rivizatimeve që i pasuan. Ekzistonin shumë tekste të tjera po aq të vlefshëm, në disa raste edhe më shumë, se sa ato që u përfshinë në "Librin e Shenjtë". Disa prej tyre qenë hedhur poshtë, qenë shkatërruar apo rishkruar me qëllim që të përputheshin me qëndrimet zyrtare dhe, në shekullin e tretë, filozofi Çelsi shkroi në lidhje me krerët e Kishës:

"Ju tregoni përralla, pa zotëruar as edhe dhuntinë për t'i bërë të besueshme... I keni ndryshuar tri-katër herë dhe edhe më shumë, tekstet e Ungjijve tuaj me qëllim që t'i mbyllni gojën çfarëdolloj tipi kundërshtimi"[25].

Në vitin 1958, në një manastir të Mar Sabës, në lindje të Jeruzalemit, zbulohet një dorëshkrim që provon se historia e Jezusit është rishkruar nga Kisha sa herë që paraqitej nevoja. Ai që e gjeti ishte amerikani Morton Smith[26], profesor i historisë së lashtë në *Columbia University*, dhe ai dorëshkrim përfshinte tekstin e një letre të dërguar nga peshkopi Klemente i Aleksandrisë së Egjiptit, njëri prej etërve themelues të Kishës, një kolegu me emrin Teodor. Dorëshkrimi përmbante edhe një pjesë të papublikuar të *Ungjillit të Markut*, që ishte prerë. Historia e "Jezusit" paraqiste pastaj disa hollësi tipike të ceremonive të shkollave misterike dhe një përmbledhje të ringjalljes së famshme të Lazarit si vepër e Jezusit. Në këtë tekst të hequr, Lazari takonte Jezusin para se të ndodhte njëfarë "ringjalljeje", duke treguar kështu se nuk ishte i vdekur fizikisht. Ky dorëshkrim përmbante edhe një zbulim tjetër dërrmues për krishtërimin: ai e hedh fjalën në fakt për pasojat e shkaktuara nga përfshirja e Jezusit në praktika të mundshme homoseksuale, në të cilat rezultonte se ishte ngatërruar "djaloshi i pasur", e përmendur nga *Ungjilli i Markut*[27]. Më lejoni të them që nuk kam asgjë kundër homoseksualizmit. U shkoftë mbarë atyre që vendosin të përshkojnë atë rrugë, mjaft që të bëhet fjalë për një zgjedhje të lirë. Ajo që dua të vë në dukje është se krerët e kishës që në fillim kanë gënjyer, duke mashtruar ithtarët e tyre. Me atë letër peshkopi Klemente i përgjigjej një të krishteri, që kishte mbetur i tronditur nga historia e "Jezusit" e paraqitur më lart, që i ishte bërë e ditur nga grupi gnostik i

quajtur Karpokracianë. Duket se kjo histori kishte arritur në veshët e tyre falë kallëzimit të ndonjë funksionari të Aleksandrisë. Këshilla e Klementit, që sidoqoftë e ripohonte historinë, ishte se gjithçka që binte në kundërshtim me qëndrimin zyrtar të Kishës duhej hedhur poshtë, edhe nëse ishte e vërtetë. Ja çfarë thotë letra në lidhje me ata që vënë në dyshim ortodoksinë zyrtare:

"Pasi, edhe nëse do të thonin diçka të vërtetë, kush e dashuron të Vërtetën nuk duhej, as edhe në atë rast, të pajtohej me ta... Atyre nuk u duhet besuar kurrë; dhe, kur paraqesin falsifikimet e tyre, askush nuk duhet të pranojë se Ungjilli i fshehtë është i Markut – por duhet ta mohojë nën betim. Sepse jo të gjitha gjërat mund t`u thuhen të gjithë njerëzve"[28].

Klementi rimerr përbukuri qëndrimin e Vëllazërisë dhe të fasadave të saj të ndryshme fetare në harkun e historisë. Pjesa më e madhe e anëtarëve të Kishës u bashkohen qëndrimeve zyrtare, pasi kjo është ajo çka janë kushtëzuar të besojnë, por brenda këtyre "besimeve" ekzistojnë sekte të fshehta që e dinë të vërtetën. Është fjala për organizata, ose më mirë për një organizatë të vetme (Vëllazërinë e racës së zvarranikëve), të pranishme brenda organizimeve të ndryshme. Kanë qenë këta njerëz që e krijuan nga hiçi besimin (*e krishterë*) dhe që përpiluan e përkthyen *Biblën*, libri që për shekuj do të kontrollonte mendjet e botës dhe që, në pjesën më të madhe, vazhdon ta bëjë akoma sot. Xhirolamoja u bë sekretar i papës Damazo rreth vitit 382 dhe ju dha porosia t`i bashkonte tekstet e ndryshme për të krijuar versionin e parë të *Biblës* në latinisht, në gjuhën zyrtare të Romës. Ja një tjetër përkthim, nga hebraishtja dhe nga greqishtja, mbi të cilat Xherolamoja bëri ca shtesa. Versioni i tij është i njohur si *Vulgata*, një fjalë latine që do të thotë "për përdorim të përgjithshëm". Një domethënie e derivatit anglez "vulgar", që do të thotë "me shije të keqe", do të ishte në këtë rast më e përshtatshme. Xherolamoja mori parasysh vetëm tekstet që i quajti me vend dhe përjashtoi ato që nuk ishin në përputhje me kredon e Nikeas. Punoi me një tjetër "at" të Kishës, me atë "bombë të seksit", Agostinin. Xherolamoja dhe Agostini ishin në një mendje mbi faktin që gratë ishin moralisht e shpirtërisht më të ulëta dhe se seksi e kënaqësitë tokësore ishin një burim vesesh që i largonte njerëzit nga rruga e tyre shpirtërore. Budallenj të mjerë! Do të shqyrtojnë 13 Ungjij, 9 akte dhe mësime të Apostujve, më shumë se 31 letra e shkrime të tjera. Vendosën ata se cilat ishin "ortodokse" dhe cilat duheshin përjashtuar. Zgjedhja e tyre u mbështet nga Koncili i Kartagjenës në vitin 397 dhe u përforcua më tej nga papa Inoçenti I, hjëqind vjet më vonë. *Vulgata* e

Xhirolamos u pranua njëzëri si versioni zyrtar. Koncili i Trentos i vitit 1545 shpalli se ishte i vetmi version i pranueshëm për katolikët.

Pjesa më e madhe e të krishterëve nuk e kuptonin se çfarë thoshte, sepse nuk e dinin latinishten, por mundeshin gjithmonë t'u besonin priftërinjve, që u thoshin atyre se si të silleshin. Shumë njerëz u dënuan dhe u vranë, pasi u akuzuan se e kishin përkthyer *Biblën* në anglisht, gjë që do t'u kishte dhënë mundësi miliona njerëzve t'i lexonin drejtpërdrejt këto tekste, që priftërinjtë i përdornin për t'i kontrolluar dhe terrorizuar. Në vitin 553 pas Krishtit, besimi tek rimishërimi u nxorr jashtë ligjit nga Koncili i Dytë Sinodal i Kostandinopolit, nën ndikimin e perandorit Justinian. Koncili vendosi, në mungesë të papës, se: "Kushdo që pohon paraekzistencën fantazioze të shpirtit dhe i bashkohet doktrinës së përbindshme që rrjedh prej saj, duhet të ...shkishërohet". "Doktrina e përbindshme" ishte ajo, sipas së cilës ne jetojmë përgjithmonë dhe kryejmë një udhëtim të përjetshëm evoluimi nëpërmjet përvojës dhe jemi të gjithë përgjegjës të veprimeve tona në këtë jetë materiale, ashtu si edhe në atë të ardhshme. Të pranoje rimishërimin do të thoshte t'ia hiqje fuqinë asaj bande kriminelësh, që e përdorte ferrin dhe parajsën për ta shtyrë popullin, me anë të frikës, të bënte atë që ata, më falni, "Zoti", i thoshin të bënte. Dija vazhdoi t'i largohej zotërimit publik. Kostandinit të Madh ia zunë vendin të tjerë perandorë, që ndikuan kursin e fesë së atëhershme të krishterë. Midis tyre figuron Teodosi që, në vitin 380, e shndërroi krishtërimin në fenë zyrtare të perandorisë. Pushteti i njerëzve me veladon u rrit në mënyrë marramendëse, kur kleri babilonas u vendos në Romë. Kushdo që largohej qoftë edhe pak nga doktrina zyrtare ekzekutohej egërsisht dhe shkrimet e tij zhdukeshin – pikërisht ashtu siç parashikonte doktrina e Nimrodit në Babiloni. Ata nuk ishin thjesht një tufë psikopatësh të marrosur nga pushteti, që e improvizuan strategjinë e tyre duke iu drejtuar masakrave groteske; përkundrazi, strategjia e tyre ishte një plan i llogaritur me mendje të ftohtë, me qëllimin për të qeverisur me anë të terrorit dhe, si pasojë, të pengonin çdo dije apo version tjetër të qarkullonte lirisht. Në cilësinë e zvarranikëve dhe të kukullave në shërbim të zvarranikëve, ata donin të krijonin një burg mendor dhe emocional, jashtë të cilit do të rezultonte fatale po të shtyheshe.

Populli i cubave Vizigotë, një racë gjermane (ariane) e vendosur në Francën Jugore, plaçkiti Romën në vitin 410, por asokohe Kisha Katolike kishte tashmë një ndikim të tillë mbi mendjet e shumë banorëve të ish-perandorisë romake, sa që atje ku binin nga fuqia perandorët romakë, e zinin vendin papët. Diktatura romake u shndërrua në diktaturën papnore dhe, në shekujt që pasuan, Evropa u bë teatër i masakrave të fshehta. Papa

komandonte, por kush komandonte mbi papën? Vëllazëria Babilonase, saktësisht ashtu siç ndodh edhe sot. Besimi hebraik dhe ai i krishterë janë shpikur nga ata që kontrollonin rrjedhën sekrete të dijeve të fshehta. Deri edhe veshjet e zbukurimet liturgjike, në shumë aspekte, janë të njëjtat. Çfarë vënë në kokë hebrejtë? Një kësulë të sheshtë. Ajo është e lidhur me faktin se priftërinjtë e shkollave misterike ishin të vetmit që e rruanin zverkun. Edhe kokoret (kësulat) dhe ritualet më solemne të judaizmit dhe të krishtërimit janë shumë të ngjashme, sepse rrjedhin nga i njëjti burim dhe mitra (kësula) e papës bëhet në formën e kokës së peshkut, që simbolizon Nimrodin.

Për ta plotësuar treshen shtohet kësula e sheshtë që vënë myslimanët dhe besimi islamik, e frymëzuar nga "profeti" Muhamet, të cilit në vitin 612 iu shfaq një "vegim". Prapë edhe një herë zbulojmë se rrënjët e Islamit zhyten tek krishtërimi dhe tek judaizmi dhe, prandaj, tek Babilonia. Myslimanët e shohin Islamin si një vazhdim të përditësuar të versionit judeo-i krishterë dhe, edhe ata e kërkojnë zanafillën e prejardhjes së tyre tek miku ynë i vjetër Abrahami, që thuhet se u nis nga qyteti sumer Ur, për t`u drejtuar për në Egjipt. Ata besojnë se Abrahami ka ndërtuar Kabanë, faltoren e shenjtë të Mekës, vend pelegrinazhi për myslimanët e të gjithë botës. Por në zanafillë ai ka qenë një tempull pagan kushtuar kultit të një perëndeshe (Semiramidës), në të cilin, midis të tjerave, ruhej i famshmi Gur i Zi. V. Uin Uestkoti, themeluesi i Urdhërit hermetik të Agimit të Artë, ka shkruar në librin e tij *The Magical Mason*, se Guri i Zi, që supozohet se e ka çuar Abrahami në Mekë, në zanafillë përdorej për ritet pagane[29]. Prapë edhe një herë hasim simbolizmin pagan brenda këtij besimi të "ri". Simbolet e gjysmëhënës dhe të shpatës së përkulur, kordhës, identifikohen me Hënën dhe Afërditën, Yllin e Mëngjesit, e quajtur edhe Dritësjellës. Afërdita ishte edhe një epitet që i jepej mbretëreshës Semiramidë. Myslimanët e kanë bërë të tyren idenë se Moisiu, Davidi dhe Jezusi ishin profetë hyjnorë të dërguar nga i vetmi Zot i Gjithëfuqishëm, kur në realitet që të tre janë trillim i Vëllazërisë. Libri i tyre i shenjtë, *Kurani*, që supozohet se është frymëzuar nga Zoti, ndalet mbi Jezusin për 93 rreshta, duke folur për të si për një njeri të gjallë. Islami është krijuar nga po ato organizata të Vëllazërisë që krijuan edhe besimet e krishtera, për ta burgosur më tej njerëzimin, për ta përçarë dhe për ta sunduar. Muhameti ka qenë profeti i fundit dhe kështu që, sipas myslimanëve, më i vlefshmi. Për këtë arsye, sipas ortodoksisë myslimane, të gjithë të krishterët dhe hebrejtë duhet të kthehen tek Islami. Termi "Xhihad" tregon "luftën e shenjtë" që myslimanët janë të inkurajuar ta zhvillojnë kundër të gjithë atyre që nuk e pranojnë besimin e Muhametit. Në këtë kuptim duket me të vërtetë i

përshtatshëm kuptimi i termit "Islam" ("nënshtrohu ose dorëzohu") dhe i termit "mysliman" ("ai që nënshtrohet"). Disa prej konflikteve më të përgjakshme të historisë kanë shpërthyer nga dëshira e myslimanëve, e të krishterëve dhe e hebrejve për t`i diktuar besimin e tyre njëri-tjetrit, kur në realitet që të gjitha rrjedhin nga i njëjti burim dhe janë rezultat i një manipulimi të vetëm! Më falni, u bëra vonë a kam humbur ndonjë gjë? Më ndihmoni të dal që këtu...

Sipas myslimanëve zoti islamik Allahu është i njëjti "zot" judeo-i krishterë, Jehovai. *Kurani* është libri i shenjtë i Islamit, por myslimanët i besojnë edhe *Pentateukos*, pesë librave të parë të Testamentit të Vjetër, që i atribuohen Moisiut. Në realitet ata qenë shkruar nga levitët pas qëndrimit të tyre në Babiloni dhe jo nga "Moisiu", që ishte një titull i përdorur në rrethin e shkollave misterike egjiptiane. Është vetëm një rastësi që këto tre burgje të mëdha mendore, që mbysin aspektin femëror dhe krijojnë konflikte të përgjakshme, e kanë prejardhjen të gjitha nga e njëjta pjesë e botës? Apo njerëz që kanë pasur vegime e vizita të mbinatyrshme duhet të luajnë një rol kaq të rëndësishëm brenda legjendave mbi të cilat bazohen përçudnime të tilla? Muhameti tha se e kishte pasur vegimin e tij pranë shpellës, tek e cila shkonte shpesh. Shpellat dhe vendet e errëta përsëriten vazhdimisht në historitë e heronjve të besimeve dhe të perëndive diellore si Mitra e Jezusi. Muhameti deklaroi se ai që iu shfaq ishte kryengjëlli Gabriel (Xhebrail) me famë biblike dhe gjatë atij takimi ai deklaroi se kishte humbur ndjenjat dhe se kishte hyrë në një gjendje *transi* (gjumi hipnotik). Teksa ndodhej në atë gjendje *transi* apo hipnoze, "Gabrieli" i dorëzoi një mesazh, për ta kujtuar dhe recituar. Muhameti shtoi se kur u zgjua mesazhi ishte gdhendur në zemrën e tij. Ajo që pasoi takimin me "Gabrielin" ka qenë një banjë gjaku, që ka përshkuar shekujt derisa ka arritur tek ne, pasi Muhameti dhe pasardhësit e tij kanë kërkuar t`i diktojnë besimin e tyre botës. Islami nuk është versioni i kundërt i krishtërimit dhe i judaizmit, janë që të tre e njëjta gjë: bëhet fjalë për të njëjtin *habitus* mendor me një emër të ndryshëm, i kontrolluar nga të njëjtit persona, zvarranikët. Islami është një tjetër besim që ka rrjedhur nga shkollat misterike, tekstet e tij janë të shkruara me kod ekzoterik, por masat duhet t`i marrin në kuptimin e mirëfilltë. Ka pasur momente, gjatë shekujve, kur disa prej këtyre dijeve të fshehta janë lejuar të qarkullojnë lirisht nga disa krerë myslimanë mendjendritur dhe ata qenë modele për shoqëritë e përparuara që dolën nga Spanja myslimane dhe nga Bagdati. Sot të nxiturit e konfliktit me kombet islamike, duke shkaktuar përçarje midis botës islamike dhe asaj judeo-e krishterë, hyn në planet e Vëllazërisë.

Kisha mormone (*e themeluar në SHBA në shek XIX*) është një tjetër besim i bazuar mbi një "vegim", e përfshirë fort brenda rrjetit të Vëllazërisë, si të gjitha besimet e tjera. Kisha mormone, ose më saktë, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditës së Fundit, u themelua nga Jozef Smithi pasi që, sipas thënies së tij, një "engjëll" i quajtur Moroni ju shfaq në vitin 1823. Moroni, vijonte Smithi, i zbuloi ekzistencën e një libri të shkruar mbi pllaka ari që përmbante "tërësinë e ungjillit të përjetshëm", përveçse "një përmbledhje mbi banorët e parë të këtij kontinenti dhe burimet se nga rridhnin ata". Duke qenë se i ishte treguar vendi ku ruhej libri, Smithi, në vitin 1827, me ndihmën e dy "gurëve magjikë" të quajtur Urim dhe Thumim, i përktheu pllakat në anglisht. Urim e Thumim ishin, në realitet, emrat e astragalëve, apo zareve, të përdorur nga priftërinjtë levitë dhe me të cilët mbretërit e Izraelit ndiqnin profecitë. Ata ruheshin në atë vend të shenjtë të shkollave misterike i njohur si tabernakull. Ndodhemi përpara një tjetër besimi që rrjedh nga i njëjti burim dhe përpara një tjetër rivizitimi të mitit të Jezusit. Pllakat prej ari, mbron idenë Smithi, ishin të shkruara në "egjiptianen e reformuar". Prej këtyre, dy vjet më vonë, zuri fill *Libri i Mormonit* dhe, në vitin 1830, pasuesit e tij themeluan Kishën Mormone. Figurat mbajtëse të kësaj Kishe qenë në zanafillë Smithi dhe një njeri tjetër me emrin Brigham Jung. Që të dy ishin masonë me gradë të lartë, që i përkisnin lozhës së rëndësishme të Nju Jorkut dhe shtrirja e Kishës së tyre u financua, në Shtetet e Bashkuara, nga *Kuhn-i, Loeb and Company* dhe nga *Rothschild Bank*[30], që kontribuan edhe për financimin e Revolucionit Rus dhe të dy rreshtimeve kundërshtare të Luftës së Parë Botërore. Mormonët ishin një krijesë e Vëllazërisë. Ata e njohin *Biblën*, por mbrojnë idenë se edhe shkrimet e Smithit kanë një bazë hyjnore. Përveç kësaj, ata i kanë dhënë jetë komunitetit të quajtur "Pali i Zionit" (Sion, Dielli) dhe, më pas, janë vendosur në Salt Lake Siti, në shtetin Utah, qyteti mormon prej nga orkestrohen programet e tyre të kontrollit mendor, mbi të cilin do të ndalem në një kapitull të mëpasshëm. Është qesharake që të gjitha këto besime të bazohen mbi një vegim apo vizitë të mbinatyrshme, pas së cilës vjen themelimi i ndonjë besimi ekstremist, dogmatik dhe autokratik, që qeveris përmes frikës, indoktrinimit dhe manipulimit mendor.

Një tjetër sekt i kontrollit mendor, që e ka pasur origjinën nga krishtërimo-judaizmi, është ai i Dëshmitarëve të Jehovait, që nderojnë pikërisht Jehovain, perëndinë e zemëruar të hebrejve, dhe njëri prej themeluesve të të cilit ka qenë Çarl Taze Rasëll, një mason me gradë të lartë. Këto besime janë krijuar për të kontrolluar, për të krijuar konflikte ndërmjet popujve dhe për të përçarë e sunduar masat. Gjatë shekujve kanë ndodhur vegime të personazheve

biblike si Virgjëresha Maria, mbi bazën e të cilave janë themeluar pastaj besimet kryesore të krishtera. Nuk e kemi idenë e pamjes së elementëve të "skuadrës" së Jezusit, por njerëzit janë drejtuar gjithmonë t`i përfytyrojnë sipas paraqitjes tradicionale artistike. Për nder të atyre që kanë pasur vegime të lidhura me episode biblike janë ngritur faltore, por ata që përkundrazi kanë pasur vegime jo biblike dënohen si bashkëpunëtorë të djallit. Uilliam Kuperi, një ish agjent operativ i shërbimeve të fshehta detare amerikane, deklaroi se kishte lexuar në disa dokumente sekrete që jashtëtokësorët u kishin rrëfyer autoriteteve amerikane se kishin manipuluar racën njerëzore nëpërmjet besimeve, satanizmit, shtrigërisë, magjisë dhe misterit. Sigurisht, raca njerëzore është manipuluar dhe kontrolluar përmes besimit dhe satanizmit. Por pyetja e vërtetë është: prapa gjithë kësaj qëndrojnë jashtëtokësorët (apo brendatokësorët)? Sikurse pyet me vete Kuperi: "... kanë qenë me të vërtetë ata burimi i besimeve tona, përmes të cilave na kanë manipuluar për një kohë kaq të gjatë?"[31].

Përgjigjen po jua jap me zë të lartë: "Po!".

PJESA II

LIBRI 24

Kapitulli 6

Sundo, o Britani

Në shekujt e parë të erës së krishterë, sapo besimet fetare e kishin vendosur në mënyrë të qëndrueshme kontrollin e tyre mbi masat, u përshpejtua edhe shtrirja e Vëllazërisë Babilonase në mjedisin politik dhe financiar.

Themelor për këtë shtrirje e tregoi veten ai grup gjakpastrish dhe hibridësh të racës së zvarranikëve që, pas një emigrimi që kishte zgjatur shumë shekuj, arriti Trojën e Re-Londër, përmes Italisë, Zvicrës, Gjermanisë dhe Vendeve të Ulëta. Ishte fjala për ndjekësit e kultit të Nimrodit dhe, jo rastësisht, vetë emri "Itali" rrjedh nga fjala "toro" ("dem"), simbol i Nimrodit.

Prapë edhe një herë udhëtonin me emrin e fenikasve dhe, në vitin 1466 pas Krishtit, u vendosën në Italinë e Veriut, në qytetin e tanishëm të Venecias. Këta fenikas u bënë të njohur pastaj si venecianë. Themeluan një perandori të fuqishme detare (natyrisht) dhe financiare, që bazohej mbi dhënien hua të parave që nuk ekzistonin dhe mbi vënien e interesave mbi po ato pará. Kjo është një tjetër temë që përsëritet në harkun e mijëvjeçarëve kur flitet për Vëllazërinë Babilonase dhe, sot, ky mashtrim financiar kontrollon fijet e bursës së planetit. Kur shkoni në bankë për të marrë një hua, banka nuk stampon as edhe një kartëmonedhë të re, as pret monedha të reja. Mjaftohet të shënojë

LIBRI 24

mbi numrin e llogarisë suaj rrjedhëse shifrën e huas suaj dhe, që nga ai çast, filloni të paguani interesa mbi atë që nuk është gjë tjetër veçse një sërë shifrash mbi një ekran. Banka ka krijuar "pará" nga hiçi dhe këmbëngul që ju ta paguani për këtë. Po ta bënte kushdo tjetër një gjë të tillë, do të arrestohej për mashtrim, por bankat e bëjnë çdo ditë para syve të të gjithëve, në dritë të diellit. Ky sistem përdorej në Babiloni dhe u përhap mandej gjatë mijëvjeçarëve. Nuk është vënë thuajse kurrë në rrezik, pasi Vëllazëria që e ka shpikur këtë sistem kontrollonte edhe mbretërit, mbretëreshat e politikanët më të rëndësishëm, që nga ana e tyre ia kanë diktuar popullit. Madje, Vëllazëria është e *formuar* nga mbretërit, nga mbretëreshat dhe nga politikanët më të rëndësishëm!

Fenikas-venecianët, nën kontrollin e Vëllazërisë Babilonase, e zgjeruan pasurinë dhe pushtetin e tyre përmes luftrave, vrasjeve, akteve pirateske dhe manipulimeve të pamëshirshme tregtare e financiare. E mbështesnin një vend kur u leverdiste dhe pastaj kërkonin menjëherë ta shkatërronin, nëse kjo ishte me përfitim për çuarjen përpara të planeve të tyre. Njëra prej strategjive më të zakonshme të tyre ishte ta detyronin të falimentonte çdo njeri, çdo ndërmarrje apo çdo vend që i kundërshtonte. Nëse kjo imiton pikë për pikë në mënyrë të përkryer strategjinë që sot është në veprim në shkallë globale, ka një arsye të saktë. Po ajo Vëllazëri, në fakt, kontrollon sot sistemin bankar dhe tregtar botëror nëpërmjet organizatës bankare globale, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Organizatës Botërore të Tregtisë, Bankës së Rregullimeve Ndërkombëtare, e kështu me radhë. Ariano-zvarranikët e Venecias u lidhën në krushqi me fisnikërinë, blenë titujt e fisnikërisë, ose thjesht shpikën ca të tjerë. Kështu, duke nisur nga viti 1171, u bënë të famshëm në të tërë Evropën si "Fisnikëria e Zezë". Prapë edhe një herë fenikasit (ose më mirë, zvarraniko-fenikasit) hynë për t'u bërë pjesë e aristokracisë. Ata vepronin në të gjithë Italinë Veriore deri në Gjenovë dhe në zonën që u quajt pastaj Lombardi, duke u shtyrë akoma më në veri, në Zvicrën e sotme. "Lombard" është një emër ende shumë i përhapur në botën financiare dhe Lombard Strit është njëra prej rrugëve më të famshme të qendrës financiare të *Sitit* (qytetit) londinez. Rreth shekullit të katërt para Krishtit, Italia Veriore, apo Lombardia, ishte rajon i pushtuar nga "keltët" arianë të quajtur lombardë, që sollën aty ndikimin e gjakut nordik të Gjermanisë. Ata u përthithën pastaj nga një tjetër popull arian, frankët, prej nga rrodhi emri "Francë". Shkurt, bëhej fjalë për degë të ndryshme të së njëjtës racë të bardhë, vazhdimisht të manovruar nga ariano-zvarranikët, të panjohur për pjesën tjetër të popullsisë. Ashtu siç ndodh sot, këta zvarranikë dhe kukullat e tyre, edhe pse duke u

paraqitur me pamje njerëzore, kontrolloheshin nga një forcë shumë e ndryshme, e cila synonte të vinte ne jetë një plan me afat të gjatë. Me afat të gjatë, sipas perceptimit tonë, sidoqoftë. Zvicra është akoma sot e kësaj dite një fortesë financiare me rëndësi themelore për Vëllazërinë. Kjo është arsyeja pse nuk sulmohet asnjëherë dhe nuk merr pjesë kurrë në luftëra, edhe kur në luftë përfshihen të gjitha vendet kufitare. Zvicra është njëra prej qendrave kryesore financiare botërore dhe, për këtë arsye, kush shpërthen luftërat, e bën në mënyrë të atillë që ajo të mbetet jashtë tyre. Shikoni sa e thjeshtë bëhet historia, sapo je në dijeni të Urdhërit të Ditës!

Venecia ka qenë për shekuj pikëmbështetja e racave të zvarranikëve, që u shtrinë në Lindjen e largët falë udhëtimeve të venecianit Marko Polo, për të cilin dimë shumë më tepër gjëra nga ato që na paraqet historia zyrtare. Familjet e tanishme mbretërore evropiane, përfshirë shtëpinë e madhe angleze të Uindsorëve, rrjedhin nga raca zvarranike e kësaj Fisnikërie të Zezë. Ja përse këto familje mbretërore, përfshirë Uindsorët, i janë kushtuar satanizmit dhe rezultojnë të lidhura fort me Masonerinë dhe me shoqëritë e tjera të fshehta të elitës. Në njërin prej kapitujve të ardhshëm do të ripërshkoj historinë e Uindsorëve, të kaluarën e tyre groteske me manipulime dhe praktikat e tyre sataniko-zvarranike. Fisnikëria e Zezë vendosi lidhje të forta me këto familje britanike dhe ideoi dyndjen e vitit 1066 nga ana e një dege tjetër të "familjes", nga normanët e Uilliam Pushtuesit dhe të shën Klerit, këta të fundit me origjinë vikinge. Prapë edhe një herë Fisnikëria e Zezë u lidh në krushqi me familjet aristokrate britanike, bleu tituj fisnikërie, ose i shpiku nga hiçi. Dy familje luajtën një rëndësi të veçantë në pushtimin e Britanisë së Madhe me urdhër të Fisnikërisë së Zezë: Savojat dhe Estetë. Savojat (prej të cilëve mori emrin Hoteli i famshëm Savoji i Londrës) mbretëruan në Itali nga viti 1146 deri në vitin 1945 dhe Estetë qeverisën Ferrarën nga viti 1100 deri në bashkimin me Italinë, në vitin 1860. Ekzistojnë shembuj të ndryshëm se si Fisnikëria e Zezë depërtoi tinëz brenda klasës udhëheqëse britanike, duke marrë kontrollin e saj. Eleonora, e bija e Pjetrit, konti i nëntë i Savojës, u martua me mbretin anglez Henriku III. Pjetri i Savojës, konti i Fisnikërisë së Zezë, sot kont i Riçmondit, organizoi një sërë martesash të tjera midis Fisnikërisë së Zezë dhe aristokracisë angleze. Vëllai i tij më i vogël, Bonifaci, u emërua deri madje argjipeshkëv i Kantërberit! Fisnikëria e Zezë kontrollon Kishën e Anglisë prej shekujsh, që nga zanafilla e saj dhe, sot, njëra prej përfaqësueseve të saj (*kupto Fisnikërisë së Zezë*) më aktive, mbretëresha Elisabetë II, është ende kreu zyrtar i asaj Kishe. Midis familjeve të Fisnikërisë së Zezë figurojnë raca zvarranikësh gjakpastër, hibridë dhe anëtarë autentikë të

Vëllazërisë Babilonase. Ata kanë shtënë në dorë frerët e pushtetit në Evropë, për t'i krijuar mundësinë Urdhërit të Ditës që të bëjë një tjetër hap përpara.

Themeluesit e shtëpive mbretërore evropiane, shumë prej të cilave janë akoma sot në pushtet, kanë qenë Ruperti, kont i Nasaut dhe Kristiani, kont i Oldenburgut. Që të dy jetuan midis shekujve XI dhe XII, e njëjta periudhë kur Fisnikëria e Zezë-Vëllazëria Babilonase nxorën në shesh planin e kontrollit mbi të gjithë Evropën. Prej Rupertit rrodhën familjet e mëdha të Hese-Darmstadtve dhe Hese-Kasalëve, dukët e Luksemburgut, Batenborg/Batenbergët (më pas Mountbaten), princi i Oranzhit dhe i Nasaut dhe mbretërit e Vendeve të Ulëta. Nga Kristiani rrodhën mbretërit e Danimarkës dhe të Norvegjisë, familjet e mëdha të Shlesvig-Holshtejnëve dhe të Hanovërve, më pas sovranë të Anglisë. Pikërisht prej Hanovërve rrodhi familja e madhe aktuale e Uindsorëve. I përkisnin racave të zvarranikëve të Fisnikërisë së Zezë edhe dukët e Normandisë (si Uilliam Pushtuesi, gjë për të cilën kuptohet aryeja e mbështetjes që iu dha atij dhe shën Klerit), familjet e Sasoni-Koburgëve (një tjetër familje e madhe e lidhur në kryshqi me Uindsorët) dhe Plantaxhenetët, prej të cilëve rrodhën dinastitë Tudor dhe Stjuart. Në këtë pikë do ta keni kuptuar, besoj, që fisnikët dhe sovranët anglezë i përkisnin në realitet Fisnikërisë së Zezë. Edhe fisnikëria skoceze, fiset dhe familjet aristokrate më të njohura si Shën Klerët, Brusët dhe të tjera që i kam përmendur, janë Fisnikëria e Zezë nën pamje të rreme, apo ariano-zvarranikët e botës së lashtë. Natyrisht, luftojnë me njëra-tjetrën për pushtetin dhe shumë prej tyre nuk janë as edhe në dijeni të identitetit të tyre të vërtetë, as se kush i komandon, por përfaqësojnë sidoqoftë racat zvarranike të anunakëve dhe mbulojnë si përherë pozita pushteti mbretëror, fetar e politik.

Shumë prej familjeve më të famshme të botës ekonomike e financiare të ditëve të sotme u përkasin radhëve të Fisnikërisë së Zezë, në rrethin e Vëllazërisë Babilonase. Dinastia e bankierëve Varburg rrjedh në fakt nga familja e Abraham del Bankos, familja më e rëndësishme e bankierëve të Venicias në kohën kur qyteti arriti kulmin e fuqisë dhe të rëndësisë së tij. Edhe familja Anjeli, e famshme për *Fiat*-in, gjigantin e automobilit, i përket Fisnikërisë së Zezë. Kjo është arsyeja pse Anjelët kontrollojnë Italinë dhe diktojnë politikën e saj. Një tjetër prej familjeve më të fuqishme të Fisnikërisë së Zezë të Venecias ka qenë ajo e De Mediçëve, e cila sponsorizoi udhëtimin e Kristofor Kolombit në "zbulimin" e Amerikave. Arsyeja e kësaj do t'ju bëhet shumë shpejt e qartë. Përveç kësaj, De Mediçët sponsorizuan edhe artistin Leonardo da Vinçi, njërin prej anëtarëve më të shquar të shoqërive të fshehta. Leonardoja qe në gjendje të parashikonte disa prej zhvillimeve të mëvonshme

të teknologjisë, sepse dinte atë që pjesës më të madhe të njerëzve nuk u ishte lejuar ta dinin. Vizatimi i tij i famshëm i njeriut brenda rrethit imitonte gjeometrinë e "mesit të artë", mbi bazën e së cilës janë përcaktuar vendet kryesore të shenjta të botës.

Ndikimi i Fisnikërisë së Zezë u shtri drejt veriut, në Gjermani, dhe pikërisht prej këtij damari ka rrjedhur familja e madhe e Uindsorëve. Gjersa nuk kishte ndërruar emrin në vitin 1917, ajo njihej si familja e madhe e Sasonia-Koburg-Gotasve, një familje mbretërore gjermane, që e kishte zanafillën tek Fisnikëria e Zezë e Venecias dhe e Lombardisë dhe, akoma më prapa, në Babiloni. Uindsorët janë gjakpastër të racës së zvarranikëve dhe e dinë. Kur Fisnikëria e Zezë u shtri në Gjermani, familja veneciane e del Bankove u bë e njohur me emrin Varburg. Megjithëse mbrojnë idenë se janë hebrej, Varburgët janë në realitet ariano-zvarranikë. Kjo e shpjegon arsyen se pse u bënë bankierë të Adolf Hitlerit dhe pse familjet e tjera ariano-zvarranike si Rotshildët, edhe pse duke u deklaruar hebrej, kanë financuar dhe mbështetur njerëz si Hitleri. Në vitin 1998, teksa mbaja një sërë konferencash në Afrikën e Jugut, më takoi ish presidenti P.W. Botha, që dëshironte të më jepte informacione mbi njerëz, të cilët aktualisht kontrollojnë vendin e tij. Më tha se gjatë presidencës së tij, në vitet e mëparshëm tetëdhjetë, i ishte kërkuar që të priste në Kejptaun një delegacion të degës angleze të Rotshildëve. Gjatë atij takimi Rotshildët i bënë të ditur se paratë, që dikur u përkisnin hebrejve, tani ishin të depozituara në Zvicër, në llogari rrjedhëse bankare, dhe mund të investoheshin në Afrikën e Jugut, me kusht që të merreshin vesh mbi përqindjet e interesit. Botha tha se ishte ndier i fyer rëndë dhe kundërshtoi të qëndronte në lojë. Por ato pará, të depozituara pak më parë në bankat zvicerane, u ishin grabitur hebrejve, viktima të holokaustit nazist. Që nga përfundimi i luftës Rotshildët i japin hua dhe përfitojnë prej tyre pará të tjera. Ky, të dashur miqtë e mi, është vlerësimi që Rotshildët ushqejnë për hebrejtë e, megjithatë, t'i zbulosh këto gjëra të Rotshildëve do të thotë të damkosesh për "antisemitizëm" si nga hebrejtë, që nuk dyshojnë se janë manipuluar, si nga hipokritët "Robot Radikalë", gjithmonë të dhembshur me vetveten dhe më së shumti të njohur si politikanë të së "majtës". Për një përkufizim të mendimit dhe të sjelljes të së "majtës", mund t'i drejtoheni një përkufizimi çfarëdo të mendimit dhe të sjelljes të së "djathtës"! Rotshildët kanë qenë njohur fillimisht si Bauer, njëra prej familjeve më misterioze të Gjermanisë mesjetare, dhe ata nuk janë me prejardhje nga Izraeli, por nga malet e Kaukazit. Janë të racës së zvarranikëve në gjendje që të ndryshojnë formë, që e fshehin natyrën e tyre të vërtetë prapa një pamjeje njerëzore. Familjet më të njohura të Vëllazërisë herë pas

here ndryshojnë emrin, për të bërë të mundur që njerëzit të mos e vënë re se janë gjithmonë po ato që e mbajnë pushtetin në rrjedhën e shekujve.

Për një farë periudhe Fisnikëria e Zezë zgjodhi Amsterdamin si selinë e saj qendrore. Prapë edhe një herë shumë prej anëtarëve të saj deklaroheshin hebrej, por nuk ishin, duke qenë përkundrazi arianë, që kishin mbërritur në atë vend pas shtegtimesh të ndryshme. Disa rridhnin nga fenikas-venecianët, ndërsa të tjerët ishin arianë-kahzarë të maleve të Kaukazit, paraardhësit e të cilëve, në shekullin VIII, ishin kthyer në masë në besimin judaist. Sikurse në rastin e krishtërimit, ai që quajmë "judaizëm" është vetëm një tjetër prejardhje e kultit arian të Diellit. Nivelet më të larta të Fisnikërisë së Zezë të Amsterdamit qenë zënë nga pasardhësit e shtriganëve babilonas. Bëhej fjalë për raca zvarranikësh që vepronin, më së shumti, por jo gjithmonë, brenda racës së bardhë. Pikërisht në kohën kur Fisnikëria e Zezë e kishte selinë e saj në Amsterdam populli hollandez filloi të ngulej në Afrikën e Jugut. Në vitin 1689, një anëtar i kësaj Fisnikërie të Zezë, me emrin Uilliam d`Oranzhi, u shty me anën e manipulimit në fronin e Anglisë dhe, në atë periudhë, selia e krerëve ariano-zvarranikë u shpërngul nga Amsterdami në Londër, për t`u bashkuar me familjet e tjera ariano-zvarranike, të cilat ishin ngulur në Londër dhe në Britaninë e Madhe mijëra vjet më parë. Londra u bë përfundimisht epiqendra e veprimeve të tyre gjithmonë e më globale. Më pas, anglezët filluan të kolonizonin Afrikën e Jugut, ku u ndeshën me hollandezët, boerët, për të fituar epërsinë në ato toka. Që të dy popujt e përfshirë në atë përplasje ishin gurë shahu të një loje, të cilën nuk e kuptonin dhe që pasardhësit e tyre nuk e kuptojnë akoma sot e kësaj dite. Uilliam d`Oranzhi zbarkoi në Angli, apo në Barat-land, në bregdetin e Torbajit në vitin 1688, në të njëjtin vend ku trojani Brutis kishte zbarkuar në vitin 1103 para Krishtit, kur themeloi Londrën me emrin Troja e Re. Akoma sot në portin e vogël të Brixhemit ngrihet një statujë e Uilliam d`Oranzhit, që përkujton arritjen e tij në qytetin pranë. Uilliami interesohej, natyrisht, për artet ekzoterike dhe mjeku i tij, Johan Shvaitzeri, i njohur edhe si Helvetius, ka thënë njëherë se praktikonte alkiminë dhe se e kishte shndërruar plumbin në ar.

Duke u martuar me mbretëreshën Maria, Uilliam d'Oranzhi u bë Uilliami III i Anglisë. Ishte pikërisht trajtimi grotesk që Uilliami u rezervoi irlandezëve ai që filloi konfliktin shekullor, i cili vazhdon gjer sot e kësaj dite në Irlandë. Në vitin 1694, nënshkroi lejen për Bankën e Anglisë dhe Fisnikëria e Zezë, së bashku me aristokracinë ariano-zvarranike, tashmë e rrënjosur mirë në Angli, e shndërroi *Sitin* e Londër-Trojës së Re në qendrën e financës botërore, rol që e mbulon ende sot e kësaj dite. Nuk të çudit atëhere fakti pse hyrja në qendrën

financiare të Londrës, në *Siti* pikërisht, dallohet nga statuja zvarranikësh me krahë, që mbajnë mburoja të bardha me një kryq të kuq përsipër, simbolin e lashtë arian të Diellit, përveçse simbol i *Rosi Crucis*-it, apo Graalit sumer, domethënë i zvarranikëve (mbi këtë argument do të kthehemi më pas). Të tjera banka qendrore ishin krijuar ndërkohë më parë nga degë të ndryshme të Fisnikërisë së Zezë ariano-zvarranike. Bëhej fjalë për Bankën e Amsterdamit (1609), për Bankën e Hamburgut (1619) dhe për Bankën e Suedisë (1661), por Banka e Anglisë ishte qershia mbi tortë. Këto banka kishin detyrën t'u jepnin qeverive të ndryshme hua pará që nuk ekzistonin, duke rënduar (dhe duke i rënduar njerëzit përmes taksave) detyrimet e interesave. Sa më i madh ishte detyrimi, aq më i lartë ishte interesi dhe, për këtë arsye, aq më e madhe vënia e taksave. E kuptuat ku rrihte çekani? Na e kanë hedhur, miqtë e mi, dhe tani po i hapim sytë! Qeveritë, natyrisht, mund të krijonin paranë e tyre pa interesa, pa qenë të detyruara t'i paguanin asnjë interes kartelit të bankave private. Arsyeja pse ato nuk e fusin këtë sistem mjaft më të lehtë qëndron në faktin se janë të kontrolluara nga ata që kontrollojnë bankat: nga Vëllazëria Babilonase. Dhe përmes degëzimeve të saj në vende të ndryshme, ajo vepron në mënyrë të atillë që kushdo që përpiqet t'i shpëtojë kontrollit të saj, të asgjësohet menjëherë nga pikëpamja ekonomike dhe politike. Organizmi kryesor që koordinon bankat e ndryshme qendrore quhet Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare dhe e ka selinë në fortesën zvicerane të Vëllazërisë, në Gjenevë. Në të njëjtën mënyrë me të cilën Vëllazëria e zvarranikëve kontrollon monarkitë, duke qenë ajo vetë ato monarki, po ashtu ka krijuar dhe kontrollon të gjitha partitë politike, qofshin ato të djathta, të majta, apo të qendrës. Partia liberale "radikale" angleze, që sot quhet Demokratët Liberalë, ishte e njohur dikur si Partia Veneciane dhe nivelet e saj më të larta janë të gjitha të zëna nga anëtarë të partisë ariano-zvarranike nën pamje të rreme. E keni pyetur vallë ndonjëherë veten se përse politikanë në dukje shumë të ndryshëm, me të hipur në pushtet, zbatojnë të njëjtat politika? Bëhet fjalë për një përbetim në dëm të mendjes njerëzore.

Lista e personave që organizuan hipjen e Uilliam d'Oranzhit në fronin britanik është një listë tamam e vërtetë me anëtarë të elitës ariano-fenikase-zvarranike. Midis emrave të shumtë të aristokracisë fenikase, më falni, britanike, që kontribuan në krijimin e Bankës së Anglisë (duke nxjerrë përfitime të pabesueshme), figuronte Uilliam Kavendishi, duka i Devonshirit, që nënshkroi edhe ftesën për në fron dërguar Uilliamit. Rezidenca e Kavendishëve është Ketsuorth Hauzi, në Derbishir, sot një vend tërheqës turistik, përveçse njëri prej vendeve më të zymtë që unë kam parë ndonjëherë.

LIBRI

Si në të gjitha shtëpitë aristokrate të Vëllazërisë, vetëm Zoti e di se çfarë veprimesh të turpshme janë konsumuar midis mureve të saj në rrjedhën e shekujve. Mbi stemën e fisit të familjes Kavendish paraqiten një zvarranik dhe një gjarpër dhe, cilado qoftë origjina e saj, nuk mund të kishte aty stemë më të përshtatshme. Kavendishët u përzien me familjen amerikane të Kenedëve kur Ketlina, e bija e presidentit Xhon F. Kenedi, u martua me trashëgimtarin e çifligut të Devonshirit. Kur ky vdiq, ajo vetë u bë zotëruesja e pronës, por vdiq pak më pas në një aksident "të shumëpritur)" ajror. Kenedët janë një tjetër familje e elitës që e kanë zanafillën tek mbretërit e lashtë irlandezë dhe edhe më përpara. Edhe ardhja e Uilliam d'Oranzhit ishte përkrahur nga aristokracia ariano-zvarranike e Skocisë, ku kishin vendbanimin shumë prej atyre familjeve. Fenikasit arritën në Skoci mijëra vjet përpara Krishtit, por disa prej familjeve më të famshme "skoceze" arritën më vonë nga Franca Veriore dhe nga Belgjika gjatë mbretërimeve të mbretërve skocezë, David I dhe Malkolm IV, midis vitit 1124 dhe vitit 1165. Emrat tipikë "skocezë" si Stjuart, Seton, Hamilton, Kempbell, Douglas, Montgomeri, Baliol, Graham, Lindseji, Kameron dhe Komin, u bënë të njohur në këtë periudhë. Ky popull "flameng" rridhte nga sumerët, nga babilonasit dhe nga banorët e Azisë së Vogël (Turqisë) e të Kaukazit, që kishin arritur në Evropë nëpërmjet tokës. Pas 150 vjetësh nga arritja e tyre në Skoci, ishin tashmë në krye të vendit. Njëri prej mbretërve më të famshëm skocezë, Robert Brusi, rridhte nga familja e Robertit të Bryzhit, qytet i Belgjikës aktuale, sot njëri prej qendrave kryesore të Vëllazërisë. Edhe pse njerëzit këto gjëra nuk i kanë ditur kurrë, betejat midis skocezëve dhe anglezëve kanë qenë thjesht beteja midis rrymave të ndryshme të elitës për të siguruar epërsinë në zbatimin e Urdhërit të Ditës. Disa familje ishin ariano-zvarranike, të tjerat jo. Brusi dhe Shën Kler/Sinkleri ishin me siguri. Njëri prej pasardhësve të Brusit, fisniku skocez Xhejms Brus i Kinajrdit, në vitin 1768 e la Britaninë e Madhe për të shkuar në Abisini, Etiopia aktuale, ku gjeti një kopje të rrallë të *Kebra Nagast*-it, libri i shenjtë i etiopasve, dhe tri kopje të *Librit të Enoch*-ut, që i solli në Evropë në vitin 1773. Xhejms Brusi ishte një mason, një anëtar i Lozhës *Canongate Kilwinning n.2* të Edimburgut, njëra prej më të vjetrave të Skocisë[1]. Familja aktuale mbretërore britanike, Uindsorët, rrjedh pjesërisht nga Robert Brusi dhe nga elita skoceze, irlandeze e uellsiane, sikurse gjithashtu nga rryma gjenetike e fiseve ariano-zvarranike gjermane. Uindsorët, si të gjitha familjet (ose më mirë, familja) mbretërore të Evropës janë përfaqësues të Fisnikërisë së Zezë e të Vëllazërisë Babilonase dhe rrjedhin nga Uilliam d'Oranzhi. Janë, siç do ta tregoj, zvarranikë shumëformësh.

Ana Kempbelli, konteshë e Balkarasit dhe e Argilit, ka qenë guvernante e princit të ri Uilliam dhe, Arçibald Kempbelli, duka i parë i Argilit, ishte në krah të princit kur ky u nis në drejtim të Anglisë, në vitin 1688, për të rrëzuar nga pushteti monarkun në fuqi, Xhejmsin II. Një pasardhëse e Ana Kempbellit ka qenë Xheni fon Vestfaleni, në lidhje krushqie si me Kempbellët edhe me dukët e Argilit. Xheni fon Vestfaleni ishte gruaja e... Karl Marksit, kloni që Vëllazëria përdori për të krijuar komunizmin. Kjo lëvizje ka qenë një prej mjeteve më të mëdha të përdorura për të përçarë dhe sunduar popullsinë botërore nëpërmjet frikës. Arsyeja pse pastaj Marksi i dënoi hebrejtë që ironte në faktin se, në kundërshtim me sa besohet përgjithësisht, ai nuk ish aspak hebre. I përkiste në fakt një familjeje të Vëllazërisë dhe, për këtë arsye, mbuloi rolin vetëm në dukje të njeriut të marksizmit, një ideologji e formuluar ai, por për të. Këto familje të lidhura me njëra-tjetrën, kanë vazhduar të lidhen në krushqi ndërmjet tyre dhe të mbajnë, gjatë shekujve, pushtetin ekonomik e politik dhe kjo gjenealogji mund të rindërtohet deri në hollësinë më të vogël. Dihet se cilat fise janë më shumë të prirura për ta lënë veten të zotërohen nga racat e zvarranikëve dhe cilat më pak. Kur duhet të mbulohet një farë pozicioni, përzgjidhet një anëtar i ndonjë familjeje ariano-zvarranike dhe, nëse ky nuk është "sintonizuar" ende me vetëdijen zvarranike, procedohet me futjen e tij në shoqëritë e fshehta. përmes të cilave do të hyjë për t'u bërë pjesë e "bandës".

Lidhjet dhe kryqëzimet që vendosen ndërmjet këtyre familjeve janë thjesht të pafundme. Kontët e tanishëm të Balkarasit janë lidhur në krushqi me viskontin Koudrej (Uitman Xhon Çurçill P in e familjes londineze që zotëron *Financial Times*). E ëma e tij ishte e bija e dit Spenser Çurçill, gjyshi i Uinston Çurçillit, ndërsa motra e saj u martua me dukën skocez të Atolit. Familjet që rrjedhin nga fisi Argil-Balkaras mbajnë emrat Lindseji dhe Kempbell. Robert A. Lindseji, konti i dymbëdhjetë i Balkarasit, u bë president i *National Westminster Bank*, njëra prej katër bankave më të rëndësishme angleze që janë anëtare të dhomës së dëmshpërblimit të Londrës, përveçse drejtor i sigurimeve *Sun Alliance* të Rotshildëve. Po ky kont ka mbuluar edhe detyrën e ministrit të Mbrojtjes e të Punëve të Jashtme dhe të *Commonwealth*-it (Komunuellthit) në përbërje të qeverisë britanike. E ëma e tij ishte një Kavendish, një familje dukësh e Devonshirit, që banon pranë Ketsuorth Hauzit. Dhe kjo është vetëm një provë e vogël se si këto familje lidhen midis tyre.

Edhe familja e Marlborougut, njëra prej më të fuqishmeve të aristokracisë britanike, luajti një rol kyç për hipjen Uilliam d'Oranzhit në fronin britanik. Ajo është e lidhur në krushqi me Çurçillët dhe, Uinston Çurçilli, ka lindur në

rezidencën e tyre të familjes, në Blenhejm Palas, pranë Oksfordit, porta me kangjella hekuri e së cilës është e zbukuruar me stemën e fisit të Marlborougëve, mbi të cilën spikasin dy zvarranikë (shiko ***Figura 19***). Çurçilli ishte absolutisht i vetëdijshëm për rolin e tij kur, gjatë luftës, mbuloi detyrën e kryeministrit britanik. Imazhi që na ka lënë trashëgim historia zyrtare për të është qeshuracak. Ai nuk i shpëtoi ishujt britanikë nga tirania, ishte më e shumta shpresa e vetë asaj tiranie që krijoi një luftë, në të cilën të gjitha rreshtimet drejtuesheshin e financoheshin nga të njëjtët njerëz. Mund të rrija këtu e të përshkruaja me hollësi familjet ariano-zvarranike të elitës dhe mënyrën se si, gjatë shekujve, janë kryqëzuar dhe lidhur midis tyre për mbajtur nerët e pasurisë në të gjitha fushat e jetës njerëzore. Kjo botë e kontrolluar që nga lashtësia nga i *njëjti* fis, krerët e të cilit veprojnë që sivjeli më i madh i perandorisë së katërt.




Figura 19. Stema familjare e dragoit e familjes Marlboroug në Blenhejm Palas.

Urdhëri zvarranik i Ditës është duke u vënë në zbatim që prej shumë shekujsh. Bëhet fjalë për një plan me afat të gjatë, që ky fis zvarranikësh ndjek për pushtimin e plotë të planetit. Urdhëri i Ditës përbën një zbërthim kronologjik dhe një sekuencë të përcaktuar mirë. Kjo duket e qartë nëse vihet re se si çdo lëvizje ndjek të mëparshmen me veprimin e mahnitshëm në kohën e duhur nën drejtimin e përgjithshëm të grupit të [illegible]dror, që vepron tinëz dhe, mbi të gjitha, që nga një tjetër përmasë. Për shembull, në vitin 1665 [illegible] përtheu një luftë midis hollandezëve dhe anglezëve dhe Murtaja e Madhe [illegible] rreth 68.000 londinezë e i shtyu dy të treatë e popullsisë që ta braktisnin qytetin. Më 2 shtator 1666 Zjarri i Madh shkatërroi Londrën dhe përgjegjësia iu vesh përsipër, për arsye historike, një furrëtari të Puding Lines. E gjitha kjo ndodhi teksa po viheshin në vijë planet për hipjen në fronin e Anglisë të William d'Oranzhit. Kur ky arriti nga Hollanda për t'u kurorëzuar mbret, shumë anëtarë të familjeve të Vëllazërisë u mblodhën në Londër, apo në Trojën e Re, për të organizuar selinë e tyre

operative. Londra, falë zjarrit, ishte rrafshuar për tokë, dhe ata mundën të ndërtonin qendrën e tyre të re financiare. Dhe kush qe arkitekti kryesor i Londrës së re? Një anëtar i lartë i rrjetit të Vëllazërisë me emrin Sër Kristofer Uoren. Vetëm një rastësi? Kopje të katedrales së Shën Palit, me kupolën e saj madhështore, simbol i lashtë ritual për Vëllazërinë, gjenden në Paris dhe në Uashington DC. E para quhet Panteon, kurse tjetra është pallati i Kongresit në Kapitol Hill (që merr emrin e kodrës së Kampidolios, një vend i Romës së lashtë i shenjtë për Vëllazërinë Babilonase). Në vitet që pasuan ardhjen e Uilliam d'Oranzhit u krijua e ashtuquajtura "Perandoria e Madhe Britanike". Që fëmijë e kam pyetur gjithmonë veten se si një grusht ishujsh, që mezi dallohen mbi globin tokësor, mund të mbanin një perandori, që kishte një shtrirje botërore. Tani arsyeja më duket e qartë. Nuk ka qenë fjala aspak për "Perandorinë e Madhe *Britanike*". Ka qenë fjala, përkundrazi, për Perandorinë e Vëllazërisë Babilonase, e cila zgjodhi Britaninë e Madhe, në mënyrë të veçantë Londrën, si qendrën e vet. Dora-dorës që perandoria "britanike" shtrihej në të dy Amerikat, në Afrikë, në Azi, në Kinë, në Australi dhe në Zelandën e Re, shtrihej edhe kontrolli mbi botën nga ana e Vëllazërisë Babilonase. Degëzime të mëtejshme ariano-zvarranike të pranishme në vende si Spanja, Portugalia, Franca, Belgjika dhe Gjermania, pushtuan zona të tjera të Afrikës; dhe spanjollët e portugezët u ngulën në Amerikën qendrore e jugore. Mbreti Leopoldi II i Belgjikës, pjesëtar i familjes zvarranike të Uindsorëve, e quajtur edhe Sasonia-Koburg-Gota, luajti një rol themelor në pushtimin dhe në shfrytëzimin e Afrikës nga ana e evropianëve. Kudo që shkuan, ariano-zvarranikët, u përpoqën të shkatërronin kulturat dhe traditat vendase. I fshehën doktrinat ekzoterike, kujtimet dhe tregimet që lidheshin me historinë e vërtetë të atyre tokave. Shkrimet e lashta mbi racën e zvarranikëve dhe mbi prejardhjen e racës së bardhë më së shumti qenë zhdukur, ose qenë fshehur nëpër bibliotekat sekrete të Vëllazërisë, midis të cilave edhe bibliotekat e nëndheshme të Vatikanit. Krishtërimi ishte përdoruar si një instrument për të hequr qafe informacione, të cilat për ne rezultojnë thelbësore.

Fundi i Perandorisë Britanike dhe i perandorive të tjera evropiane, sidomos në këtë shekull, do të dukej sikur tregonte pakësimin e këtij kontrolli. Por nuk është kështu. Përkundrazi, ai është rritur. Kontrolli i hapur, si në rastin e një diktature të deklaruar, ka gjithmonë një jetë të shkurtër, sepse herët a vonë do të shpërthejë ndonjë revoltë. Por kontrolli i fshehur, kontrolli që nuk arrin ta shohësh, ta identifikosh, apo ta vësh në shenjestër, mund të shkojë përpara përgjithmonë, sepse askush nuk rebelohet kundër diçkaje,

LIBRI

ekzistencën e së cilës nuk e dyshon. Kush mendon se është i lirë, nuk do të ankohet për faktin se nuk është. Kështu që, ajo që ka ndodhur në Afrikë, në Amerikën e Jugut, në Azi, në Shtetet e Bashkuara e në Kanada është se, kontrolli i hapur nga ana e Britanisë së Madhe dhe e Evropës, është zvendësuar nga një kontroll i fshehtë. Me të hyrë në krizë këto perandori, në mënyrë të veçantë ajo britanike, në ato vende mbetën shoqëritë e ndryshme të fshehta, familjet e vjetra dhe strukturat, me qëllim që të qeverisnin me të njëjtat fuqi të mëparshme, por këtë herë të siguruara nga çdo rrezik e kërcënim nga ana e popullsisë, që nuk e kishte idenë se kush e mbante në të vërtetë pushtetin. Struktura globale është shumë e thjeshtë. Urdhëri qendror i Ditës kordinohet që nga Londra, që përfshin qendrën financiare të njohur si *Siti* (Qytet) dhe brigjet e lumit Tamiz, që lëpin shtabet e përgjithshme të forumit britanik, dhomat e parlamentit, qendrat e qeverisë dhe të shërbimeve të fshehta britanike dhe, pastaj, në bregun e kundërt, Bukingham Palasin, rezidencën e familjes zvarranike e njohur me emrin Uindsor. Qeveria britanike është vetëm një fasadë e Urdhërit të vërtetë të Ditës, që vihet në zbatim nga këto zona të kufizuara të *Sitit* dhe të Uestminsterit. Parisi është një tjetër qendër shumë e rëndësishme e Vëllazërisë Babilonase, sikurse edhe Vatikani. Mendoni për format e qeverive të njohura, në mënyrë qesharake, si "demokraci", për tipin e ligjeve, për ekonomitë, për mjetet e komunikimit dhe për të gjitha institucionet që sot hasni në pjesën më të madhe të vendeve. Prej nga ka rrjedhur modeli origjinal i këtyre strukturave? Pikërisht nga Londra. Në fakt, flitet ende për Britaninë e Madhe si për "Nënën e Parlamenteve". Këto struktura janë projektuar për të dhënë një dukje të jashtme lirie, ndërsa, në realitet, që prapa kuintave, kontrolli nga ana e forcave të sipërpërmendura duket i pakufizuar. Janë pikërisht këto strukturat që perandoria britanike ka lënë pas vetes kur u tërhoq formalisht nga kolonitë, për t`u dhënë atyre autonomi të plotë qeverisjeje. Aspak nuk jua ka dhënë! Pushtimit fizik ia ka zënë vendin pushtimi financiar dhe kontrollit të hapur ia ka zënë vendin kontrolli i fshehtë.

Që nga Londra elita ariano-zvarranike dikton politikën e saj dhe Urdhërin e saj të Ditës ndaj "drejtorëve të filialeve" të ndryshme, ose ndaj familjeve që i përkasin të njëjtës racë, të pranishme në çdo vend; kjo strategji siguron që Urdhëri i Ditës i koordinuar nga Londra të vihet në zbatim në shkallë globale. Ja përse në të gjitha vendet që shkoj, shoh të zbatohen të njëjtat politika. Në Shtetet e Bashkuara "drejtorë filialesh" më të rëndësishëm të varur nga Londra janë Rokfelerët, që koordinojnë një kartel familjesh dhe njerëzish fasadë si Morganët, Harrimanët, Karnixhët, Melonsët etj, nën drejtimin e përgjithshëm

londinez. "Drejtorë filialesh" jugafrikanë janë përkundrazi Openhajmerët. Në vitin 1998 kam kaluar tri javë lart e poshtë nëpër Afrikën e Jugut, ku mbajta konferenca dhe dëgjova njerëzit vendas, dhe ky vend përfaqëson në mënyrë emblematike tezën që jam duke paraqitur këtu. Mbi të gjitha, merrni parasysh historinë e saj. Së pari, kur Fisnikëria e Zezë e kishte qendrën në Amsterdam, hollandezët kolonizuan Kepin e Shpresës së Mirë. Pastaj, kur Fisnikëria e Zezë kapërceu Kanalin e La Manshit dhe u vendos në Londër, britanikët u përdorën si gurë shahu të kolonizimit. Në Afrikën e Jugut, Kompania hollandeze e Indive Lindore qe zëvendësuar nga Kompania britanike e Indive Lindore. Eksploratorët e zonave të brendshme të Afrikës, si doktor David Livingstoni, qenë financuar nga organizata si *National Geographical Society*, e kontrolluar drejtpërdrejt nga Londra. Një tjetër valë kolonësh ariano-zvarranikë britanikë qe kryesuar nga Sesil Rodsi dhe *South African Company* e tij ishte një tjetër operacion i drejtuar nga Siti i Londrës. Rodsi ishte njëri prej njerëzve kryesorë fasadë të Vëllazërisë, dhe vepronte mbi të gjitha përmes një shoqërie të fshehtë, ekzistuese akoma sot e kësaj ditë, e quajtur Tavolina e Rrumbullakët. Sesil Rodsi dhe *South African Company* e tij i dhanë udhë perandorive të diamantit dhe të minierave të arit të quajtura respektivisht *De Beers* dhe *Consolidated Goldfields*, që Openhajmerët i kontrollojnë sot për llogari të së njëjtës Vëllazëri, që financoi Sesil Rodsin. Një tjetër degëzim i *South African Company* ishte e njohura botërisht *London-Rhodesia Company*, e quajtur *Lonrho*, e drejtuar, siç është e njohur, nga i ndjeri Tini Roland. *Lonrho*-ja e ka manipuluar dhe shfrytëzuar Afrikën dhe popullin e saj në mënyrë të frikshme, siç ishte e parashikuar nga Urdhëri i Ditës. Është deri madje tepër e qartë që i njëjti grup e ka kontrolluar kontinentin afrikan përmes shoqërive, njerëzve dhe formave të ndryshme, që nga koha kur arritën kolonizatorët e parë britanikë.

Në Afrikën e Jugut, para se pushteti të kalonte nga pakica e bardhë tek shumica e zezë, gjatë presidencës së Nelson Mandelës, familja Openhajmer kontrollonte diçka si 80% të shoqërive jugafrikane të kuotuara në bursë dhe zotëronte industri të ndryshme minerare, midis të cilave atë të arit dhe të diamanteve, mbi të cilat bazohet ekonomia e vendit. Kontrollonte edhe mjetet e komunikimit nëpërmjet njerëzve fasadë. Pastaj ndodhi papritur një "ndryshim radikal", në momentin kur Nelson Mandela u lirua dhe zezakëve iu rikthye "liria". Tani, pas kësaj kthese demokratike, Openhajmerët kontrollojnë ende diçka si 80% të shoqërive jugafrikane të kuotuara në bursë, zotërojnë industri të ndryshme minerare, midis të cilave atë të arit dhe të diamanteve, mbi të cilat bazohet ekonomia e vendit dhe kontrollojnë mjetet

e komunikimit nëpërmjet njerëzve fasadë si Toni O'Rejli, miku i Henri Kisingerit, përveçse miliarder irlandez. O'Rejli dha dorëheqjen nga drejtimi i shoqërisë Heinz të kontrolluar nga Vëllazëria dhe filloi të blinte gazeta në të gjithë botën, pa probleme çmimi. Atëhere, si ka ndryshuar kontrolli mbi Afrikën e Jugut nga ana e Vëllazërisë para e pas "kthesës"? Një dhe vetëm një gjë ka ndryshuar: tani askush nuk ankohet më, sepse kontrollit të hapur ia ka zënë vendin ai i fshehur. Kur ekzistonte një diktaturë nga ana e një pakice të bardhë, kudo ngrihej një kor dënimi: "Nuk është e drejtë", bërtisnin Robot Radikalët, "Ky është racizëm, është diktaturë. Është një turp!". Dhe ishte me të vërtetë. Por tani manifestimet dhe protestat kanë pushuar dhe Mandela për botën është një hero, ndërsa ata që e kontrollojnë Afrikën e Jugut janë gjithmonë të njëjtit njerëz të mëparshëm, edhe pse tani nuk ngrihet as edhe një zë i vetëm kundërshtimi nga ana e mercenarëve që "flasin me zemrën në dorë" dhe valëvisin flamurin e tyre. Në Soveto, dhe sot edhe në vende të tjera, ekzistojnë ende komplekset e barakave të mjera dhe getot prej llamarine, por nuk mbushin më faqet e gazetave, sepse tani të gjithë e dinë që Afrika e Jugut është e lirë. Qeveria e *African National Congress*-it (ANC) është po aq e kontrolluar dhe e korruptuar sa edhe ajo e bardhë, së cilës i zuri vendin.

Në kohën e kthesës, *Shell Oil*-i, kompania e naftës e Vëllazërisë Babilonase, e kontrolluar nga persona si princi Bernhard i Vendeve të Ulëta, i ka lëshuar një grataçiel të tërë ANC-ës, dhe është diçka me sa duket e ditur midis gazetarëve të denjë për këtë emër që Mandela nuk merr asnjë vendim me një farë rëndësie pa u konsultuar më parë me Openhajmerin. Në vitin 1993 Mandela i kaloi Krishtlindjet në shtëpinë e pushimeve të Toni O'Rejlit, në Nasau. Në muajt e parë të vitit 1994 O'Rejli shtiu në dorë grupin botues më të rëndësishëm të Afrikës së Jugut. Më falni, nëse jam duke ngritur ca dyshime mbi një hero me famë botërore. Më jepni ca pëllëmba. Në realitet, Mandela është sipas gjasës një njeri i ndershëm, që thjesht ka kuptuar se ku qëndron pushteti i vërtetë dhe nuk ka më aq shumë guxim, ose dëshirë, të sfidojë sistemin. Por ka shumë njerëz me ngjyrë me të vërtetë të korruptuar, si Robert Mugabe, presidenti i Zimbabves, që s'u durohet të marrin paratë dhe të mbulojnë rolin e njerëzve fasadë të Vëllazërisë Babilonase me shpenzimet groteske të popullit. Vetëm në këtë mënyrë kontrolli mund të veprojë që prapa fytyrave të zeza dhe ka elementë të racës së zvarranikëve midis të zinjve ashtu sikurse midis të bardhëve.

Situata është e njëjtë në të gjithë botën. Në krye të vendeve të ndryshme, para e pas kuintave, do të hasni në fakt të njëjtat familje dhe kukullat e tyre.

Natyrisht, kush qëndron prapa kuintave mban pushtetin e vërtetë. Për këtë arsye, nëse Urdhëri i Ditës parashikon fundosjen e dollarit amerikan, ose të *pesos* meksikane, ose rënien e ndonjë qeverie, ose shpërthimin e ndonjë lufte civile, "drejtorë filialesh" të vendeve të interesuara vihen në punë, duke skicuar operacione financiare e mediatike, ose duke përdorur shoqëritë e fshehta, për të realizuar qëllimin e tyre. Në këtë mënyrë, bota mund të qeveriset nga një pakicë shumë e vogël, që ndodhet në *Siti* të Londrës dhe në qendra të tjera të Vëllazërisë, si Parisi, Boni, Brukseli, Uashingtoni, Nju Jorku, Zvicra dhe Vatikani. Bëhet fjalë për një strukturë të thjeshtë dhe përsosmërisht të organizuar, e drejtuar nga krerë që përdorin grushtin e hekurt dhe nuk kanë as mëshirën më të vogël për atë që nuk respekton urdhërat. Ja përse ka funksionuar kaq mirë për kaq shumë kohë. Kësaj shtojini faktin se e vërteta e asaj që po ndodh është aq shumë e çuditshme, sa që pjesa më e madhe e njerëzve nuk pranon të na besojë dhe do të keni kështu kuadrin e përkryer për një situatë kontrolli të pakundërshtuar dhe të vazhdueshëm.

Deri sot.

Kapitulli 7

Kalorës të Diellit

Në harkun e mijëvjeçarëve, zvarranikët gjakpastër dhe hibridët kanë krijuar një rrjet të jashtëzakonshëm me shoqëri të fshehta të lidhura njëra me tjetrën, për të nxitur vënien në zbatim të Urdhërit të Ditës. Megjithatë, njerëzit në përgjithësi nuk e kanë kuptuar faktin se ishte në veprim një njësi koordinimi më e lartë, e cila manipulonte qeveritë dhe jetët e tyre. Në tre kapitujt pasardhës do të tregoj se si këto organizata kanë marrë kontrollin e institucioneve reale, politike dhe fetare dhe kanë themeluar Shtetet e Bashkuara. Kjo "superfuqi" në dukje, është megjithatë gjithmonë një "kukull" e manovruar nga Vëllazëria Babilonase e Londrës.

Në harkun e shekullit XII dolën në dritë tri prej shoqërive të fshehta më të rëndësishme. Ato ekzistojnë ende sot dhe përfshijnë midis anëtarëve të tyre figura të spikatura në nivelin botëror në fushat e politikës, të financës, të industrisë, të ushtrisë dhe të medias. Bëhet fjalë për Kalorësit Templlarë, për Kalorësit Ospedalierë të shën Gjonit të Jeruzalemit dhe për Kalorësit Teutonë. Kalorësit Ospedalierë kanë ndryshuar emër shumë herë. Dikur quheshin Kalorësit e Rodit, kurse sot quhen Kalorësit e Maltës, në versionin "katolik" dhe Kalorësit e Shën Gjonit të Jeruzalemit në atë "protestant". Si

LIBRI 24

Kalorës të Maltës, kreu i tyre zyrtar është papa dhe selia e tyre është në Romë. Si Kalorës të Shën Gjonit e kanë selinë në Londër dhe njohin si kreun e tyre zyrtar mbretin, ose mbretëreshën. Krahu katolik dhe ai protestant janë pra dy faqet e të njëjtës organizate të përgjithshme. Urdhëri i Kalorësve Tempullarë u formua afërsisht në njëjtën periudhë, rreth vitit 1118, ose ndoshta katër vjet më parë, dhe fillimisht qenë njohur me emrin e Ushtarëve të Krishtit. Tempullarët janë të rrethuar nga një brerore misteri dhe kontradikte, por është e njohur se ia kushtuan urdhërin e tyre "Nënës së Zotit". Ata u shtirën sikur ishin një lëvizje e krishterë dhe për këtë arsye shprehja "Nëna e Zotit" qe interpretuar si një referim ndaj Maries, nënës së Jezusit, por, në rrethin e shoqërive të fshehta ariano-zvarranike, ai titull, përkundrazi, i atribuohet simbolikisht Isidës, që tradita egjiptiane e beson si nënën virgjëreshë të birit të perëndisë, Horusit, dhe si grua të perëndisë Diell, Osiridit. Isida, nga ana e saj, është një tjetër emër i mbretëreshës Semiramidë, që paraqitet në trinitetin Nimrod-Semiramidë-Tamuz. Çifti Isidë/Semiramidë është i njohur me një seri të pafund emrash të tjerë në besimet, në kulturat dhe në vendet e ndryshme. Midis tyre figurojnë Baratia, Diana, Rea, Minerva, Afërdita, Venera, Hekatja, Junonja, Çerereja, Hëna e shumë të tjerë. Thuhet se janë të gjitha simbole të Hënës, energjisë femërore në forma të ndryshme. Selia e Lozhës së Nënës së Madhe të masonerisë angleze (Nënë e Madhe = Semiramidë/Isidë) gjendet në Londër, në Great Queen Street (*Great Queen* = Mbretëresha e Madhe = Semiramidë/Isidë). Si përfundim, të gjithë emrat janë frymëzuar prej Ninkharsagut, "Perëndesha Nënë" e anunakëve, "nëna" e hibridëve njerëzoro-zvarranikë. Perëndi të lashta si Nimrod/Osiridi dhe seria e pafund me emra të tjerë, me të cilët quhen, përfaqësojnë fuqinë e Diellit, energjinë mashkullore. Mbi këto doktrina u themelua Urdhëri i Tempullarëve dhe një provë e faktit se ata u frymëzuan prej fenikasve dhe prej racës së zvarranikëve mund të dallohet në simbolin e tyre, kryqi i kuq në sfondin e bardhë, ku kryqi i zjarrtë të kujton simbolin fenikas të Diellit dhe të racave të ndryshme zvarranike. Sot e gjejmë këtë simbol në flamurin anglez.

Që në fillim historia zyrtare e tempullarëve paraqiti pavërtetësi të dukshme. Ata deklaronin se urdhëri i tyre ishte themeluar për të mbrojtur pelegrinët në Tokën e Shenjtë, por në nëntë vitet e parë të jetës së tij, duket se ky urdhër numëronte vetëm nëntë anëtarë. Mbrojtje e bukur! Nuk është e nevojshme të jesh gjeni për të kuptuar se bëhej fjalë për një perde tymi, që mbulonte diçka tjetër. Në fakt, dukej se një urdhër ishte themeluar si krahu ushtarak i një shoqërie të fshehtë të quajtur Urdhëri i Sionit, më pas Manastiri i Sionit. Fjala "Sion" rrjedh nga "Siona", emri i lashtë sanskrisht (arian) i...

Diellit[1]. Le të qeshim! Midis Mjeshtave të fundit të Mëdhenj të Manastirit të Sionit, sipas librit *Holy Blood, Holy Grail*[2], figuronte Leonardo da Vinçi, që ishte financuar nga familja e bankierëve të Mediçëve, e cila i përkiste Fisnikërisë së Zezë veneciane. Kjo e fundit do të sponsorizonte pastaj edhe Kristofor Kolombin. Ndërmjet financuesve dhe përkrahësve më të mëdhenj të tempullarëve të parë figuronin edhe shën Bernardoja, themelues i Urdhërit të Çisterçensëve, dhe familja franceze e shën Klerit, që u bë pastaj Sinkler, sapo u shpërngul në Skoci, pas pushtimit norman të Britanisë së Madhe, që ndodhi në vitin 1066 nga Uilliam Pushtuesi. Shën Kler/Sinklerët rrjedhin nga raca e zvarranikëve dhe krerët e tempullarëve ishin në dijeni të planeve të fshehta të zvarranikëve. Mjeshtri i parë i Madh i Kalorësve Tempullarë ka qenë Huges de Pajens, që hyri në urdhër në vitin 1124. Ky ishte një fisnik francez (gjë që do të thotë një arian) aleat i kontit të Shampanjës dhe i shoqi i një gruaje skoceze me origjinë normane, që quhej Katerinë Shën Kler. Qendra e parë, apo "komuniteti" i parë, i tempullarëve jashtë Tokës së Shenjtë ka qenë ndërtuar në pronat e tokave të Shën Klerëve, në Skoci. U përkiste tempullarëve dhe Folkoja, konti i Anzhusë, i ati i Gofrid Plantaxhenetit dhe gjysh i mbretit anglez Henriku II. Ishte Henriku ai që sponsorizoi ndërtimin e Abacisë benediktine të Glastonberit, në Anglinë Perëndimore, një vend i shenjtë që nga kohërat e lashta. Krerët e tempullarëve ishin të lidhur me ata të Kalorësve të Maltës dhe këto lidhje vazhdojnë akoma edhe sot. Tregohen shumë histori mbi atë se sa shumë këto dy urdhëra urrehen me njëri-tjetrin dhe, padyshim, kanë kaluar periudha kundërshtish dhe konfliktesh. Por, në nivelet më të larta, bëhet fjalë për dy faqe të ndryshme të së njëjtës organizatë dhe, për ato nivele, ajo që ka rëndësi është Urdhëri i Ditës. Në qershor të vitit 1099, iu dha një tjetër goditje e fortë "armiqve" të Perëndisë nga kryqëtarët e krishterë, që pushtuan Jeruzalemin dhe masakruan turqit, saraçenët dhe judejtë, që banonin aty. Kjo e rihapi "Qytetin e Shenjtë" për pelegrinët e krishterë, që filluan të dyndeshin në masë përmes portave të Xhafas, Tiros dhe Akros. Tiroja ishte njëra prej qendrave më të rëndësishme të qytetërimit fenikas. Kalorësit Ospedalierë themeluan në Jeruzalem Bujtinën Amalfi, për t'u siguruar ushqim e strehim vizitorëve. Dora-dorës që rritej pasuria dhe fama e tyre, ata krijuan një krah ushtarak, të cilit iu dha mbështetja papnore në vitin 1118, po atë vit kur arritën në Jeruzalem Kalorësit Tempullarë, për të "mbrojtur" pelegrinët.

Tempullarët u strehuan afër Malit të Tempullit, vendi në të cilin hamendësohet, dhe e nënvizoj fjalën "hamendësohet", se ngrihej Tempulli i Solomonit. Sipas disa studiuesve, duke gërmuar nën Malin e Tempullit,

LIBRI 24

tempullarët do të kenë gjetur diçka me të vërtetë të çmuar, ndoshta dorëshkrime, ndoshta sasi të mëdha ari. Por, sidoqë të ketë shkuar, ngjarjet filluan të rrokulliseshin pas vitit 1126, kur Mjeshtri i Madh, Hugues de Pajensi, u nis nga Jeruzalemi për të mbledhur trupa dhe për të zgjeruar urdhërin. U kthye në Francë për të takuar shën Bernardin, atëhere abat i Kleirvosë, dhe mori me vete të ungjin tempullar të Bernardit, Andre de Montbardin. Bernardi i thuri papës Honorio ll lëvdatat e Urdhërit të Tempullarëve, që u njoh zyrtarisht më 31 janar 1128, gjatë Koncilit të Trojës. Po, ai vend e kishte marrë emrin nga *Troja*, qendra e rëndësishme e arianëve dhe e ariano-zvarranikëve të Azisë së Vogël (Turqisë së sotme), që frymëzoi edhe emrin e parë të Londrës. Tempullarët ishin pjesë e po asaj bande, edhe pse shumë prej anëtarëve të niveleve më të ulëta nuk e dyshonin aspak këtë gjë. Midis simboleve të tyre, përveç kryqit të kuq fenikas, ishte edhe një flamur bardhë e zi (i formuar nga dy katrorë), kafka me kockat të kryqëzuara dhe kulla e rojes. Të gjitha këto simbole kanë mbërritur deri tek ne dhe përdoren nga organizatat bashkëkohore të Vëllazërisë. Katrorët bardhë e zi gjenden në dyshemetë e çdo tempulli mason, pasi masonët janë tempullarët nën pamje të rreme. Edhe shumë kisha e katedrale, si Abacia e Uestminsterit në Londër dhe katedralja Notre Dam e Parisit, paraqesin në dysheme katrorë bardhë e zi, pasi Kisha e Krishterë është një fasadë e Vëllazërisë Babilonase. Shumë forca policie, përfshirë ato britanike e amerikane, kanë ca katrorë bardhë e zi mbi uniformat e tyre, pasi kontrollohen nga masonët dhe tempullarët. Kafka është, pjesërisht, një simbol i riteve të magjisë së zezë, që Vëllazëria e praktikon qysh nga zanafilla dhe, po këto rite të neveritshme, që shpesh kërkojnë flijime njerëzore, zhvillohen ende sot. Nëse vështroni stemën papnore, apo të Vatikanit, do të shikoni se edhe kupola e bazilikës së Shën Pjetrit formon me çelësat e Pjetrit një kafkë me kockat të kryqëzuara. Janë të gjitha shprehje të të njëjtit realitet. Kjo mund të ishte edhe arsyeja pse familja e Pizonëve tek Ungjijtë ka shkruar se vendi i "kryqëzimit" të Jezusit quhej Golgotha, që do të thotë, "vendi i kafkës". Një tjetër organizatë që i referohet Vëllazërisë Babilonase dhe që mban emërtimin e duhur, Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave, e ka selinë përpara *campus*-it të *Yale University* të Nju Hevënit, në Konektikat të ShBA-së. Është një sekt i fshehtë satanik, ithtarët e të cilit i kushtohen pirjes së gjakut dhe, ndërmjet tyre, më i famshmi është Xhorxh Bushi, ish presidenti i Shtetëve të Bashkuara, përveçse zvarranik shumëformësh. Ai është edhe njëri prej trafikantëve kryesorë të drogës të Amerikës, një satanist, një përdhunues fëmijësh dhe një *serial killer*. Në njërin prej kapitujve pasardhës do të gjeni hollësi më të mëdha për të gjithë këtë. Simboli i Kullës së Rojes

është përshtatur nga organizata e Dëshmitarëve të Jehovait, një fasadë e mëtejshme e Vëllazërisë dhe jo një sekt i krishterë, sikurse janë shtyrë të besojnë, gabimisht, ndjekësit e tyre të shumtë. Njëri prej themeluesve të tyre ka qenë Çarls Taze Rasëlli, një mason me gradë të lartë, i varrosur në Irlandë nën një piramidë.

Pas vetëm një viti që nga themelimi zyrtar i urdhërit në Koncilin e Trojës, tempullarët ishin përhapur në mënyrë të pabesueshme. Ata gëzonin tashmë njohje papnore, pasuri e toka dhe numëronin treqind ithtarë, të gjithë me përkatësi nga familje fisnike, që, me të hyrë në urdhër, duhej t'ua dorëzonin të gjitha pasuritë e tyre tempullarëve. Si rrjedhojë, tempullarët zotëronin toka në Francë, në Angli, në Skoci, në Spanjë e në Portugali dhe në harkun e dhjetë viteve këto pasuri u shtrinë në Itali, në Austri, në Gjermani, në Hungari dhe në Kostandinopojë. Ata themeluan shumë komunitete e fshatra, qytete e ferma në të gjithë Anglinë. Sa herë që ndeshni emrin "Temple" në ndonjë toponim britanik (për shembull në Templekombe) bëhet fjalë për një ish pronë të tempullarëve. Selia e tyre kombëtare gjendej në Londër, në zonën që sot përkon me High Holbornin dhe në vitin 1611 u zhvendosën në një zonë afër, që ende sot quhet Temple Bar. Këtu ende mund të admirohet kisha e ndërtuar sipas stilit të tempullarëve, përveç disa varreve. Në një pozicion veçanërisht të goditur në brendësi të Temple Barit, në qendër të rrugës kryesore, ngrihet statuja e një zvarraniku me krahë. Figuronte midis pronave të tempullarëve edhe zona e Londrës e njohur si Strand dhe pjesa më e madhe e Flit Stritit, që, deri pak kohë më parë, ka qenë selia e gazetave kombëtare britanike. Simboli i *tabloid*-it kombëtar, gazetës *The Daily Exspress*, që dikur e kishte selinë e saj qendrore pikërisht në Flit Strit, është një kalorës i pajisur me një shqyt, që mban simbolin tempullar-fenikas të kryqit të kuq në një sfond të bardhë. Pronat e tempullarëve shtriheshin gjatë brigjeve të lumit Tamiz, ku ata kishin magazinat dhe zyrat e tyre. Gjatë mbretërimit të mbretëreshës Viktoria, Vëllazëria ngriti një obelisk pikërisht në atë zonë, dhe u vendos nga një sfinks në të dy anët e tij. Obelisku vinte që nga qyteti egjiptian On, apo Heliopoli ("qytet ose vend i Diellit") dhe sot njihet si Obelisku i Kleopatrës (shih pjesën e ilustrimeve). Bëhet fjalë për një simbol të lashtë egjiptiano-arian të Diellit, të energjisë mashkullore dhe të falusit (*emblemë e organit burrëror tek besimet greko-romake*). Këto simbole hasen në shumë vende dhe shpesh janë maskuar nga manipuluesit masonë si monumente kushtuar të rënëve. A e ka pyetur veten ndonjëherë vallë ndokush se përse një monument kushtuar të rënëve duhet të jetë thuajse gjithmonë një obelisk? Dhe për ç'arsye mendoni që monumenti në qendër të Uashingtonit është një obelisk gjigant?

Sepse obeliskët, si të gjitha këto simbole e forma gjeometrike, prodhojnë energjinë që përfaqësojnë. Më kujtohet të kem ngjitur disa shkallë në brendësi të një obelisku të madh afër Hebden Brixhit, në Angli, dhe të jem ndier i rrethuar nga një energji mashkullore shumë e fuqishme. Pyeta me vete se çfarë djallin po ndodhte, gjersa u kujtova se ku isha... në brendësi të një penisi, të thuash të vërtetën. Ajo që simboli paraqet është ngushtësisht e lidhur me energjinë që do të prodhojë, pasi simbolet janë shfaqje fizike të mendimeve që i krijojnë. Këta njerëz nuk i vendosin simbolet e tyre gjithandej të shtyrë vetëm prej qejfit për t'i vendosur aty. E bëjnë sepse kjo ndihmon për të sintonizuar fushën tonë të energjisë me frekuencën dridhëse të dëshiruar. Nga ana e saj, kjo do të ndikojë mendimet dhe përshtypjet tona.

Sot pronat londineze të tempullarëve strehojnë profesionistët e gjykatës. Një avokat fiton prestigj kur arrin në Temple Bar dhe hyn për t'u bërë pjesë e Tempullit të Brendshëm, të Tempullit të Mesëm, apo të atij të Jashtëm. Kam folur me njerëz që kanë pasur një përvojë të drejtpërdrejtë të këtyre organizatave dhe u janë dukur me të vërtetë të dyshimta. Janë me siguri. Nëse dëshiron të kontrollosh popullin, duhet të kontrollosh ligjin dhe kush procedohet apo nuk procedohet. Kështu në radhët e policisë ka anëtarë të shumtë të masonerisë, përveçse eksponentë të profesionit ligjor, apo gjyqësor. Këto prona të lashta tempullare gjenden në zemër të asaj zone të Londrës, e cila shkon nga distrikti financiar i *Sitit* deri tek Parlamenti dhe Bukingham Palasi. Bashkë me Parisin dhe me Vatikanin, është ky vendi që aktualisht kontrollon botën, të paktën në nivel operativ. Dhe Parisi ka qenë qendra tjetër kryesore e Kalorësve Tempullarë. Në sheshin Konkord, një pikë strategjike e rrjetit urban parizien, ngrihet një tjetër obelisk egjiptian, që i përket një kohe 3.200 vjet më parë. Në vitin 1997, princesha Dajana, në bordin e një Mercedesi, kaloi përpara atij obelisku saktësisht një minutë para se të përplasej në galerinë Pont de L'Alma.

Në mesin e shekullit XII tempullarët ishin vetëm të dytët, pas Kishës Romake, përsa i përket pasurisë dhe pushtetit. Kishin flotën e tyre të anijeve (mbi të cilat valëvitej flamuri me kafkën) dhe qendrat e tyre financiare të Londrës dhe Parisit përfaqësonin, në realitet, fillimin e sistemit bankar modern, që i ka bërë njerëzit skllevër të një "paraje" që nuk ekziston. Edhe ata jepnin hua "para" inekzistente, duke e rënduar me interesa, pikërisht sipas stilit të Vëllazërisë Babilonase. Një rast i dokumentuar zbulon se tempullarët diktuan një interes prej 60% mbi pagesën e një borxhi përtej afateve të caktuara. Një prej projekteve të përkrahura prej tempullarëve ka qenë krijimi i Shteteve të Bashkuara të Evropës dhe, me mënyra e me mjete të ndryshme, krerët e tyre

brenda Vëllazërisë e kanë arritur këtë qëllim. Krijimi i Bashkimit Evropian, me një bankë të vetme qendrore dhe me një monedhë të vetme, është një prej themeleve të Urdhërit të Ditës së Vëllazërisë.

Disa prej dijeve të përparuara, që tempullarët trashëguan nga të lashtët, i përkisnin rrjetës energjitike tokësore dhe rrjetës së vijave me forcë magnetike, të njohura edhe si vija të dragoit ose meridiane. Vendet e shenjta më të rëndësishme gjenden atje ku këto vija ndërpriten me njëra-tjetrën, duke krijuar vorbuj të mëdhenj energjie. Nëse në ato vende praktikoni ndonjë rit magjik, apo ndonjë flijim njerëzor, energjia thellësisht negative aq shumë e gufuar do të zhvendoset gjatë gjithë rrjetës nëpërmjet vijave të forcës magnetike, që zënë fill nga vorbulla. Kjo do të ndikojë mbi gjendjen dridhëse të fushës magnetike tokësore, brenda së cilës të gjithë ne jetojmë. Nëse ajo fushë energjitike është e mbushur plot me frikë, njerëzit do të jenë më shumë të prirur për të provuar atë përshtypje. Dhe frika është ajo fjalë e ndyrë që kontrollon botën. Arma më e rëndësishme, që ka përdorur Vëllazëria Babilonase që në zanafillën e saj, është pikërisht manipulimi me zotësi i frikës. Asgjë më shumë se sa frika nuk e kufizon aftësinë njerëzore për të shprehur personalitetin e vet të vërtetë. Kuptohet atëhere se pse vallë kaq shumë kisha të krishtera janë ndërtuar në afërsi të vendeve të lashta pagane dhe pse kaq shumë rite satanike praktikohen nëpër kisha të zhytura në errësirë. Ishin pikërisht tempullarët, me vetëdijen e tyre të arteve ekzoterike, ata që financuan, midis viteve 1130-1250, ndërtimin e katedraleve të mëdha gotike evropiane. Mund të provohet që stili gotik ka lindur pranë popullit arian, në Lindjen e Mesme e të Afërt. Midis katedraleve gotike të financuara dhe të projektuara nga tempullarët figurojnë Abacia e Uestminsterit, katedralja e Jorkut, në Anglinë Veriore, ajo e Shartrit, jo larg nga Parisi, dhe vetë Notrë Damë në Paris. Katedralja Notrë Damë (Zonja Jonë: Isidë-Semiramidë-Ninkharsag) është ngritur në një vend që i kushtohej perëndeshës Diana, ndërsa ajo e Shartrit është ndërtuar në një vend dikur i quajtur i shenjtë, në të cilin druidët mblidheshin nga e gjithë Evropa. Kisha e famshme e Kings Kolexhit, në Kembrixh, e bazuar mbi simbolin kabalist të Pemës së Jetës, është përshkruar si një prej shembujve të fundit të mëdhenj britanikë të arkitekturës gotike[3]. Projekti i saj frymëzohej në dukje tek katedralja e viteve treqind e Albit, në rajonin jugor francez të Linguadokës, njëra nga qendrat më të rëndësishme si për tempullarët edhe për katarët. Në shekujt XII dhe XIII, besimi katar, që vuri në dyshim shumë prej dogmave të Kishës Katolike dhe që përmbante mjaft elementë ekzoterikë, u bë besimi sundues i Francës Jugore. Kjo e vuri në alarm Vëllazërinë Babilonase dhe papa-kukull, Inoçenti III, i

shkatërroi katarët nëpërmjet një "kryqëzate" të tmerrshme torturash dhe zjarresh, që kulmoi me rrethimin e kështjellës katarase të Montsegurit, në vitin 1244. Dhe pa shikoni një herë, përdorimi i figurave zvarranike të quajtura gargola u shtri nëpër kishat dhe nëpër katedralet e "krishtera". Notrë Damë e Parisit është e mbushur plot e përplot me to (shih pjesën e ilustrimeve) dhe shumë prej tyre janë versione të zvogëluara të të njëjtave figura, të cilat gjenden në piramidat dhe në vendet e popullsisë maja të Meksikës. Presidenti meksikan, Miguel De La Madridi, ka deklaruar se majatë janë kryqëzuar me "racën e iguanave" – racën e zvarranikëve.

Si Shartri, edhe Notre Damë kanë qenë qendra të kultit të Madonës së Zezë, një tjetër ide fikse e tempullarëve. Kulti i Madonës së Zezë nuk lidhej me Marien, nënën e Jezusit, ndonëse kjo ka qenë përshtypja që është dashur t'i përcillet njerëzve. Objekt i këtij nderimi ishte përkundrazi mbretëresha Semiramidë, apo Isidë/Baratia. Egjiptianët e paraqisnin anën pozitive të Isidës me ngjyrë të bardhë, ndërsa përdornin të zezën për të paraqitur anën e saj negative. Madona e Zezë ishte Isidë/Baratia e zezë ose, më me vend, mbretëresha Semiramidë e njohur në Babiloni si Madona. Madona e Zezë simbolizon degjenerimin e energjisë "hënore" femërore, kurse dielli i zi simbolizon degjenerimin e energjisë diellore mashkullore, dhe pikërisht me termin e fshehtë "diell i zi" emërtohet edhe Dielli galaktik, rreth të cilit ky sistem diellor sillet që prej më shumë se 26.000 vjetësh. Për shembull, meqë kali i bardhë ishte për fenikasit një simbol i Diellit, kali i zi, si pasojë e përmbysjes së simboleve nga ana e Vëllazërisë, përdoret për të paraqitur përdorimin jo korrekt të energjisë diellore. Kali i zi është simbol edhe i asaj fasadës britanike të Vëllazërisë, sikurse është banka *Lloyds Bank*. Statujat e Maries që mban në krah Jezusin fëmijë, të cilat gjenden nëpër kishat e krishtera, janë një reflektim i mënyrës me të cilën egjiptianët paraqisnin Isidën me në krah të birin, Horusin. Shën Bernardi ka qenë qartë një ndjekës i fshehtë i kultit të kësaj perëndeshe, duke qenë se kishte lindur, midis të tjerash, në Fontaine, afër Dizhonit, qendër e kultit të Madonës së Zezë. Tempullarët u pajtuan me pasionin e tij dhe i ndërtuan kishat e tyre duke përshtatur planin rrethor, një aludim për elementin femëror. Këtë e dëshmon, midis gjërave të tjera, edhe përdorimi i përhapur nga ana e Vëllazërisë i kupolës, mbulesë kjo, që të kujton barkun e gruas shtatzënë.

E ashtuquajtura kulturë Nju Age ka besuar shpesh gabimisht se energjia femërore është e mirë, kurse ajo mashkullore jo, mbi bazën e bindjes se bota është e sunduar nga mashkulli. Në realitet bota është e sunduar nga ekstremet e të dyja energjive, si ajo mashkullore edhe ajo femërore. Nuk jam duke folur

për trupa mashkullorë e femërorë, por për energji mashkullore dhe femërore, që, si meshkujt, si femrat e kanë aftësinë t'i krijojnë. Kur një burrë e shtyp, e mbyt, polin e tij femëror bëhet një "*maço*" dhe beson se mund të jetë "burrë i vërtetë" vetëm duke përshtatur një sjellje mbisunduese dhe agresive. Kjo formë ekstreme e energjisë mashkullore paraqitet nga ushtarët, që shfaqin me anë të armëve forcën dhe agresivitetin e tyre. Ne mendojmë se bota është e sunduar nga mashkulli, sepse çdo mbrëmje, në emisionin e lajmeve, shohim format ekstreme të energjisë mashkullore. Kjo është ajo që shohim. Por, në realitet, prapa manipulimit qëndrojnë format ekstreme të energjisë femërore negative: janë ato që merren me regjinë e fshehtë të ngjarjeve dhe të konflikteve, në të cilën pastaj ekstremet e energjisë mashkullore mund të marrin pjesë publikisht. Por ne të gjithë këtë nuk e shohim. Është kjo energjia që përdorin agjentët e Vëllazërisë Babilonase dhe që paraqitet përmes figurash simbolike si Semiramida, Isida e shumë të tjera. Ata e dinë edhe që energjia krijuese është ajo femërore, që ka lindur deri edhe Diellin, sikurse egjiptianët thoshin zakonisht për Isidën. Kjo forcë femërore, si e gjithë energjia, është neutrale. Nëpërmjet saj mund të krijohet diçka pozitive ose negative, por në të dy rastet është e nevojshme të mbahet në fre forca krijuese femërore. Ja pse në rrethin e Vëllazërisë simbolizmi femëror përdoret në të gjitha format e saj. Eksponentët e saj kanë kërkuar të shtypin, të mbytin, shprehjen pozitive, të ekuilibruar, të energjisë femërore, jo energjinë femërore në përgjithësi.

Katedralet gotike dhe kishat e krishtera janë plot me simbole diellore, astrologjike, seksuale e me të tjera të lidhura me hyjnitë femërore. Portalët e mëdhenj gotikë dhe relievët që i rrethojnë janë paraqitje të organit femëror, të vulvës, dhe shumë prej tyre të kujtojnë deri madje një paraqitje të klitorisit, në majën e harkut. E njëjta skemë përsëritet tek dritaret dhe, veçanërisht, në motivin zbukurues të katedraleve gotike të kthyera drejt perëndimit, që është orientimi i shenjtë ndaj hyjnive femërore. Në kisha të tjera mesjetare janë gjetur figura që paraqesin murgj e priftërinj me kokën prej kafshësh gjatë bashkimit seksual me vajza të reja. Kjo është një praktikë akoma sot e kësaj dite në përdorim midis satanistëve. Figurat e Shelana-gigave që gjenden nëpër kishat e lashta, sidomos në Irlandë, paraqesin gra lakuriq me këmbët të hapura, dhe brenda altarëve janë gjetur simbole të organit mashkullor prej guri. Zot i Madh, çfarë do të mendojë famullitari? Mbajtësja e ujit të bekuar në formë guaske është një tjetër simbol i lidhur me kultin e hyjnisë femërore, dhe vetë kishat janë ndërtuar si barqe të fryrë simbolikë. Zbukurimet në formë rrjete merimange dhe në formë labirinti, tipike për shumë katedrale dhe kisha, gotike apo jo, i referohen energjisë së "perëndeshës", forcës intuitive dhe

krijuese, që end dhe tjerr fatet e botës. Hyjnë brenda këtij simbolizmi edhe legjendat mbi Gruan Merimangë, tipike e traditës indiano-amerikane dhe disa toponime të shenjta si Spider Rock (Shkëmbi i merimangës) në Arizonë. Një libër i shkruar nga Fred Xhetingsi dhe i titulluar *The Secret Zodiac* (Routledge and Kegan Paul, 1987) flet për mozaikun, që paraqet zodiakun, i pranishëm mbi dyshemenë prej mermeri të kishës gotike të Shën Miniatos në Firence dhe që i takon vitit 1207. Sipas Xhetingsit kisha është ndërtuar në mënyrë të atillë që të rezultojë e orientuar ndaj bashkimit midis Mërkurit, Afërditës dhe Saturnit, që ndodh në fund të majit të çdo viti, nën shenjën e Demit. Astrologjia, origjinat e së cilës zënë fill që në fillim të historisë së njohur, ka qenë një art shumë i rëndësishëm për tempullarët dhe mësohej në shkollën e Shartrit. Kur të krishterët shkojnë në kishë, nuk dyshojnë aspak se po hyjnë në një tempull "pagan", por kjo është saktësisht ajo që bëjnë. Tempullarët kishin lidhje të ngushta me pjesën më të madhe të sovranëve të kohës, ndonëse në masë më të vogël me ata francezë. Duke patur parasysh pasurinë e tyre të pafund, tempullarët ishin "padronët" e shumë prej mbretërve asokohe në fuqi, pikërisht ashtu sikurse sot pasardhësit e Vëllazërisë janë "padronët" e qeverive aktuale. Tempullarët ishin të afërt me Henrikun II të Anglisë, financuesin e Glastonberit. Është interesante të mësosh se armiqësia e famshme ndërmjet mbretit dhe argjipeshkëvit të Kanterberit, Tomas Beketit, pushoi në vitin 1170, kur dy kalorës arritën nga Franca për të vrarë këtë të fundit në katedralen e Kanterberit. I biri i Henrikut, Rikard Zemërluani, ishte vetë një tempullar, edhe pse jo zyrtarisht. Përdori anijet dhe komunitetin e tyre dhe, kur u detyrua t`ia mbathte nga Anglia, i kërcënuar nga i vëllai Xhoni, e bëri i veshur si tempullar. U mbrojt prej tyre dhe mori pjesë në kryqëzatat në Tokën e Shenjtë kundër saraçenëve. Rikardi ua shiti Qipron (një ish ngulim fenikas) tempullarëve dhe mori pjesë në negociatat midis këtyre dhe homologëve të tyre islamikë, sektin e fshehtë të Vrasësve. Kjo fjalë sot përdoret për të përshkruar një vrasës dhe rrjedh nga metoda e veçantë e qeverisjes së Vrasësve, e bazuar mbi dhunën dhe terrorin. Duket se "Vrasës" do të thotë "konsumues *hashashi*", pasi e përdornin këtë drogë për t`i gënjyer të rinjtë dhe për t`i shtyrë që të vrisnin në emër të "Zotit", të mbajtur nga shpresa se kjo do t`u kishte siguruar atyre një vend në parajsë. Ata zhvilluan një luftë terroriste ndërkombëtare që nga shtabi i tyre i përgjithshëm i Alumutit, ose Folesë së Shpiponjave, në Persi. Sende e objekte në qeramikë të zbukuruara me yje me pesë cepa dhe me simbolin e organit femëror, vulvës, janë gjetur në këtë vend; Vrasësit mbanin për më tepër një tunikë të bardhë me një brez të kuq. Vrasësit, sot ende aktivë nën pamje të jashtme të ndryshme, dolën

nga një sekt i themeluar prej një persiani me emrin Hasan Sabah (një tjetër origjinë e pranueshme për emrin e tyre) në vitin 1090, në të njëjtën periudhë kur themeloheshin urdhërat e Tempullarëve, të Kalorësve të Maltës dhe të Kalorësve Teutonë.

Tempullarët dhe Vrasësit bashkëpunonin ndërmjet tyre, edhe pse formalisht u përkisnin dy rreshtimeve të kundërta. Opinioni publik prapë shtyhet të besojë në gënjeshtrën se, nëse dy grupe luftojnë publikisht me njëri-tjetrin, duhet detyrimisht t'u përkasin dy rreshtimeve kundërshtare. Nëse dëshironi të kushtëzoni rezultatin e një ndeshjeje, duhet t'i kontrolloni *që të dy* rreshtimet, por, për të dalë të padëmtuar, duhet të bindni njerëzit për faktin se të dy rreshtimet kanë krerë të ndryshëm dhe ndjekin qëllime të ndryshme. Njëra prej metodave më të efektshme të manipulimit të përdurur nga Vëllazëria është ajo që t'i krijosh të gjitha rreshtimet në fushë, ose të futësh tinëz brenda tyre ca njerëz të tutë, për të kontrolluar kështu rezultatin përfundimtar. Tempullarët ishin në këtë gjë mjaft të zotë. Ndërsa shoqëronin me roje Rikard Zemërluanin nëpër kryqëzata, përkrahnin edhe mbretin Xhon, vëllanë dhe rivalin e tij të egër. Ata kontribuan përveç kësaj në ratifikimin e Kartës së Madhe (Magna Charta) në vitin 1215, duke kurorëzuar kështu përpjekjet e Ajmerik de Shën Murit, që ishte Mjeshtri i Madh i tempullarëve anglezë dhe këshilltari më i afërt i mbretit Xhon. Karta e Madhe kufizonte shumë prej pushteteve të monarkisë, duke rritur kështu kontrollin nga ana e tempullarëve e duke bërë të kryhej një tjetër hap përpara në planin me afat të gjatë, që parashikonte futjen e "demokracisë": domethënë, robërimin e maskuar nga liria, kontrollin e fshehtë në vend të kontrollit publik. Nuk po them se të gjithë tempullarët kanë ndjekur synime negative. Jam i sigurtë se nuk është kështu. Por siç ndodh shpesh në këto shoqëri të fshehta, dijet dhe planet ndaheshin në nivele të ndryshme. Shkrimtari dhe studiuesi francez Zhan Robin, arriti në përfundimin se Urdhëri i Tempullit përbëhej prej shtatë rrathësh të jashtëm, në të cilët jepeshin misteret më të "vogla" dhe prej tre rrathësh të brendshëm, që vepronin përkundrazi me misteret më të "mëdha". E njëjta gjë ndodh në rastin e masonerisë dhe të të gjitha shoqërive të fshehta të ditëve të sotme. Masa e anëtarëve nuk e ka idenë e asaj për të cilën janë në dijeni krerët, as të Urdhërit të Ditës që ata nxitin.

Pavarësisht pasurisë së tyre, tempullarët gëzonin përjashtime fiskale (pikërisht ashtu sikurse fondacionet e sotme të Vëllazërisë janë të përjashtuara nga taksat) dhe kishin ca gjykata të tyre speciale. Kontrollonin sovranët, njerëzit me influencë, tregtitë dhe kombet. Metoda e tyre qëndronte në të shtyrit e "viktimave" të tyre në një pozicion varësie, zakonisht duke përdorur

LIBRI

shantazhin, ose borxhin. Në këtë mënyrë pastaj tempullarët mundeshin të diktonin lëvizjet e tyre. Asgjë nuk ka ndryshuar. Eduardi I mori hua shuma të mëdha nga tempullarët, ndërsa mbreti Xhon dhe Henriku III ishin në borxh me ta deri në fyt. Në një farë pike, Henriku la peng xhevahirët e Kurorës pranë tempullarëve, për të paguar harxhimet e luftës. Kjo është një tjetër teknikë e vjetër e Vëllazërisë Babilonase edhe sot e kësaj dite në përdorim. Funksionon kështu: manipulon luftrat, u jep hua të gjitha rreshtimeve paratë e nevojshme për të luftuar dhe nxjerr përfitime maramendëse nga llahtaritë që ka shkaktuar fshehurazi. Po atyre vendeve u huan edhe paratë e nevojshme për rindërtimin dhe kjo do t`i bëjë akoma më shumë borxhlinj kundrejt teje dhe akoma më shumë nën kontrollin tënd. Mund ta përdorësh luftën edhe për të hequr krerët që s`të shërbejnë, për të zotëruar toka e për të modifikuar kufinj, në përputhje me Urdhërin tënd të Ditës. Mendoni për dy luftërat botërore të shekullit XX dhe do ta kuptoni më mirë se si ndodhin këto gjëra. Xhevahirët e Kurorës angleze, në atë kohë të mbretit Xhon, ruheshin pranë Tempullit të tempullarëve të Londrës, që, gjatë mbretërimeve të Xhonit, Henrikut II, Henrikut III dhe Eduardit I, ishte edhe njëra prej arkave mbretërore. Tempullarët vilnin taksat për papën dhe për Kurorën, përveç taksave të njohura si të dhjeta. Organizata e tyre ishte një organizatë private me plane të fshehta, që vilte taksa nga populli për llogari të të tjerëve, dhe një pjesë e madhe e këtyre parave u përkiste drejtpërdrejt atyre, nën formën e pagesës me interes mbi huatë. Duket se nuk kishin mëshirë me ata që nuk paguanin. Këto metoda përdoren akoma sot në të gjithë botën. Shprehja e përkorjes dhe e dlirësisë e paraqitur nga tempullarët ishte shpesh një shprehje e qartë hipokrizie. Një krahasim i përdorur në Anglinë mesjetare, për të treguar një që pinte shumë, ishte "të pish si një tempullar". Por, kur bëhej fjalë për çështje monetare, ishin po aq të pamëshirshëm me njëri-tjetrin, saç ishin me pjesën tjetër të popullit. E njëjta gjë ndodh sot me ata anëtarë të Vëllazërisë, dhe me lakejtë e tyre, që kundërshtojnë linjat zyrtare. Në Francë, qendra e tempullarëve në Paris ishte arka kryesore mbretërore dhe, edhe monarkia franceze, ishte seriozisht në borxh me ta. Por duket se mbreti francez, Filipi IV, i quajtur edhe "i Bukuri", nuk po i duronte dot më dhe mori disa masa për t`i shkatërruar tempullarët, duke nxitur në tetor të vitit 1307 një spastrim kundër tyre. Ose të paktën kështu reciton historia zyrtare. Ka akoma shumë gjëra për t`u mësuar, në mënyrë që të mundim të kuptojmë se ç`ka ndohur me të vërtetë dhe rëndësinë që ajo pati për ngjarjet që pasuan. Do të ravijëzoj për krerët më të lartë një kuadër të atij konteksti.

LIBRI 24

Dinastia e Merovingëve

Që nga themelimi i tyre, Urdhëri i Tempullarëve dhe Urdhëri i Sionit, më pas Manastiri i Sionit, e treguan veten si dy faqe të së njëjtës organizatë. Roli i Manastirit të Sionit, sipas asaj që deklaron libri *Holy Blood, Holy Grail*, është ai që të mbrojë një dinasti "mbretërore", e quajtur dinastia e Merovingëve, por në të gjithë këtë histori janë të shumta perdet e tymit, që e errësojnë të vërtetën. Njëra prej këtyre është teza, sipas së cilës Merovingët rridhnin nga Jezusi, nëpërmjet të birit, apo të bijve, që ai pati nga Maria Magdalena, e cila u arratis bashkë me ta në Francën Jugore pas "Kryqëzimit". Por nuk ka pasur asnjë Jezus dhe asnjë Marie, pasi këto janë vetëm figura simbolike brenda një historie, që është treguar shumë e shumë herë në të gjithë botën para-të krishterë, me emra të ndryshëm. Prandaj më duket e vështirë të kuptoj se si dy personazhe simbolike mund t`i kenë dhënë zanafillë atij që më pas do të bëhet fisi i Merovingëve. Janë përralla, të trilluara qëllimisht për të çuar në rrugë të gabuar ata që kërkojnë të vërtetën mbi dinastitë e ndryshme, prej të cilave ajo e Merovingëve është padyshim njëra prej më të rëndësishmeve, edhe pse nuk ka të bëjë fare me Jezusin. Në Francën e shekullit V dhe VI kjo familje e veçantë bëhet e njohur me emrin e Merovingëve. Për historinë e prejardhjes së saj i jemi mirënjohës *Kronikës* së Fredegarit, një kopje e së cilës është ruajtur në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Fredegari ka qenë një historian i Burgundias, që ka jetuar në shekullin VII, i cili punoi 35 vjet për të plotësuar përmbledhjen e tij mbi vitet e para të mbretërisë së Frankëve dhe të Merovingëve. Një fis i quajtur fisi i Frankëve Sikambri, prej nga rrodhi emri "Francë", ishte një hallkë tjetër e "zinxhirit" arian dhe ariano-zvarranik. Frankët e morën emrin nga kreu i tyre, Franci, që vdiq në vitin 11 para Krishtit. Pasardhësit e tij shtegtuan nga Troja në Turqinë aktuale, ku morën në fillim emrin Shitë dhe pastaj, në fund të shekullit të katërt, Frankë Sikambri, nga emri i mbretëreshës së tyre, Kambra. Ata ishin me origjinë nga Shicia, në veri të Detiti të Zi, midis maleve të Kaukazit, prej nga arianët dhe ariano-zvarranikët ishin nisur në drejtim të Evropës. Frankët Sikambri e kishin zakon të quheshin Magët (Magjistarët) e Rinj, ose Popull i Aleancës; që i referohej aleancës me anunakët.

Frankët Sikambër jetuan më pas në një zonë në perëndim të lumit Danub dhe u vendosën në Gjermani (të quajtur kështu nga romakët mbi bazën e fjalës shite që do të thotë "autentikët") dhe qendra e tyre ishte Këlni. Ndodhi që nga koha e mbret Meroveut, i emëruar Gardian i Frankëve në vitin 448, që kjo linjë dinastike u bë e njohur me emrin dinastia e Merovingëve. Bëhej fjalë për mbretër shtriganë, të famshëm për dijet e tyre ekzoterike dhe për fuqitë e

tyre magjike, që i kishin trashëguar nga rrymat e fshehta të sekteve sekrete dhe nga ceremonitë e ritualeve. Franci, themeluesi i frankëve, deklaronte se rridhte nga Noeja dhe paraardhësit e tij dikur banonin në Trojën e lashtë. Personalisht mendoj se historia e Noes përfaqëson simbolikisht faktin se si racat e hibridëve zvarranikë i shpëtuan gjallë përmbytjes, duke ia kthyer pastaj pushtetin pëllumbeshës dhe degës së ullirit (Semiramidë-Nimrodit).

Pasardhësit e Noes janë hibridët njerëzoro-zvarranikë, ose të paktën ata që janë kryqëzuar në mënyrë të atillë, për të ruajtur pasurinë gjenetike origjinale. Qyteti francez i Troyes, ku tempullarët u organizuan zyrtarisht, ishte quajtur kështu nga frankët sikambër për nder të atdheut të tyre. Qyteti i Parisit qe themeluar prej tyre në shekullin VI, pasi tashmë ishin njohur me emrin e Merovingëve, dhe e mori emrin nga princ Paridi, i biri i Priamit të Trojës. Kishte qenë pikërisht marrëdhënia midis princit Parid dhe Helenës së Spartës ajo që kishte shkaktuar, duke iu përmbajtur traditës, luftën e Trojës, në të cilën, futja e kalit në qytet, u siguroi spartanëve fitoren. Si spartanët, si trojanët rridhnin nga popuj të arianëve dhe të ariano-zvarranikëve. Merovingët e themeluan qytetin e Parisit në afërsi të një vorbulle të madhe energjie dhe përdorën një dhomë të nëndheshme për ritet e tyre, përfshirë flijimet njerëzore, për nder të perëndeshës Diana. Këtu mbretërit zgjidhnin me luftë grindje të mundshme, që u përkisnin pasurisë. Meroveu, themeluesi i dinastisë merovinge, ishte një ithtar i kultit pagan të perëndeshës Diana, një tjetër version i Isidë-Semiramidës. Kjo nuk të çudit, duke qenë se qendra e kultit të Dianës ishte Efesi, në Azinë e Vogël, jo larg nga vendi ku mendohet se ngrihej Troja. Vendi, në të cilin gjendeshin së lashti ambientet nëntokësore, ku merovingët nderonin Dianën dhe i kushtonin flijimet, është edhe sot e kësaj dite i dukshëm pranë Pont e Plas de L'Almas. Sot në atë vend ka një galeri dhe, pikërisht këtu, makina me të cilën udhëtonte Dajana, princesha e Uellsit, u përplas në orët e para të mëngjesit të së dielës, më 31 gusht 1997. Të tjerë pasardhës të fiseve të Shitë-Frankëve dhe të Skambër-Merovingëve emigruan nga Franca Veriore dhe nga Belgjika, në shekullin XII, për t'u bërë dega e famshme "skoceze" e aristokracisë britanike, së cilës i përkisnin paraardhësit e princeshës Dajana.

Mbreti meroving Klodoveu zgjodhi shpatoren, ose zambakun e verdhë, si emblemë mbretërore, një lule që në Lindjen e Mesme rritet vetvetiu. Ai njihet edhe si zambak me tri cepa dhe përdoret si simbol i Nimrodit, ose, më mirë, i racës së zvarranikëve, që ka në krye Nimrodin. Në latinisht do të thotë "shpatë e vogël" dhe u bë simbol i dinastisë së asaj që është sot Franca, pasi së lashti, pranë sumerëve, prejardhja zvarranike, që trashëgohej

nëpërmjet linjës së nënës, simbolizohej nga një zambak. Ja përse mbartëseve kryesore të geneve zvarranike iu dhanë emra si Lilith, Lili, Lilutu e Lilete. Një tjetër version është Lilibet, apo Elisabetë dhe, ky, është edhe emri i mbretëreshës aktuale të Anglisë, që brenda familjes njihet me emrin Lilibet. Kjo është njëra prej mbartëseve kryesore të geneve zvarranike dhe ka lindur njërin prej gjakpastërve më të mëdhenj zvarranikë sot të gjallë, princin Karl. Që të dy janë zvarranikë në gjendje të ndryshojnë formë, siç do të tregohet më pas. Zambaku është një simbol i lashtë i pranishëm edhe tek shtyllat binjake me formë falike (*që ka lidhje me falusin, organin mashkullor*) të Jakinit dhe Boazit në Tempullin e Solomonit, mbi të cilat qenë gdhendur "figura me formë zambaku", siç është përshkruar tek *Libri i Mbretërve*, 7, 22. Sot do ta vini re se zambaku është përdorur pa hesap nëpër stemat mbretërore të monarkisë britanike, mbi ndërtesat mbretërore dhe mbi portat me kangjella hekuri përreth tyre, përveçse nëpër kisha. Ai gjendet, me të drejtë, mbi një portë me kangjella prej nga hyhet në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, një tjetër seli e rëndësishme e këtyre racave. Tërfili i Irlandës është njësoj një simbol i lashtë i këtyre dinastive dhe fjala "shamrock" (tërfil) rrjedh nga termi afrikanoverior "shamrukh". Të gjitha këto simbole zënë fill tek paraqitja babilonase e Nimrodit, i pajisur me tre brirë dhe me parime të tjera ekzoterike. Të tjerë simbole merovinge ishin peshku (prapë Nimrodi), luani (Dielli, autoriteti) dhe bleta. Treqind bletë të arta qenë gjetur mbi manton e përmortshme të mbretit Çilderiku I, i biri i Meroveut, vdekur në shekullin V. Bletët janë një simbol i lashtë i perëndeshës së dashurisë (Semiramidës) dhe në Egjipt simbolizonin pushtetin mbretëror. Ato të sjellin ndërmend edhe Bletën mbretëreshë, një simbol i Isidë/Semiramidës.

Emri i Merovingëve ishte vetëm një tjetër emër i Vëllazërisë Babilonase dhe ideja se ata rrjedhin nga Jezusi është vetëm një mënyrë për të luajtur me fjalët, ose më mirë, për të luajtur me perënditë, sipas synimeve të Manastirit të Sionit. Jezus nuk është veçse një tjetër emër i Nimrod/Tamuzit, diada at-bir babilonase. Prandaj, do të sugjeroja tezën sipas së cilës raca, së cilës i përkiste Jezusi, është në realitet raca e Vëllazërisë së "Nimrodit", ariano-zvarranikëve. Për më tepër, Manastiri i Sionit deklaron të angazhohet për rivendosjen e dinastisë së Merovingëve në fronin francez. Por këta të fundit nuk qenë kurrë sovranë të Francës, pasi në atë epokë monarkia nuk ekzistonte. Bëhet fjalë vetëm për marrëzira, që kanë si qëllim të fshehin planet e vërteta të Manastirit të Sionit, i cili në realitet është një fasadë e Vëllazërisë Babilonase. Janë të gjitha mënyra për të fshehur një të vërtetë të thjeshtë dhe tronditëse. Stema, apo simboli, i racës sumere të Dragoit quhej Gra-al, ose edhe "Simboli

i Kainit". Personazhi biblik i Kainit ishte njëri prej hibridëve të parë mbretërorë ndërmjet anunakëve dhe njerëzve, që rrodhën nga "Adami". Ishte ky Graal, që u bë pastaj i ashtuquajturi Gral i Shenjtë dhe kjo është arsyeja pse i barasvlerëshmi i tij në gjuhën e lashtë franceze do të thotë "gjak mbretëror". Stema mbretërore sumere ishte... një kupë uji, ose *Rosi-Crucis*, apo "Kupa e Vesës". Në dokumentet egjiptiane, sumere, fenikase dhe hebraike, ajo përshkruhet si një kupë e zbukuruar me një kryq të kuq brenda një rrethi. Kjo është origjina e vërtetë e "kupës së Gralit". Ajo nuk ka qenë kupa që mblodhi gjakun e Jezusit në çastin e kryqëzimit, duke qenë se nuk ka pasur asnjë Jezus, as asnjë kryqëzim. Ka qenë përkundrazi kupa që simbolizonte barkun e gruas shtatzënë dhe racën e më të "pastërve" midis hibridëve zvarranikë, të trashëguar mbi të gjitha nëpërmjet linjës së nënës. Termi "Rosi-Crucis" ("Trëndafil-Kryqi") është, sigurisht, edhe në origjinën e Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve, një shoqëri e fshehtë e vjetër, që ka thurur intriga dhe ka manipuluar me qëllim që racat e zvarranikëve të vazhdonin të zinin pozitat e pushtetit. Njëri prej autorëve, që mbron tezën sipas së cilës ky fis (i Merovingëve) rridhte prej Jezusit, është Sër Laurenc Gardneri, "një studiues i gjenealogjive mbretërore dhe kalorsiake".

Qesharak, sepse ai duhej ta dinte që kjo nuk është e vërtetë. Sër Laurenci është Kancelar i Oborrit Perandorak dhe Mbretëror të Sovranitetit të Dragoit, ish Oborri Mbretëror i Dragoit në Egjipt. Është edhe igumen i Kishës Kelte të të Afërmëve të Shenjtë të Shën Pëllumbeshës (Semiramidës); ndihmës presidencial i Këshillit Evropian të Princërve; dhe ka qenë i lidhur me Rojen Fisnike të familjes mbretërore të Stjuartëve (Stuart, dinastia merovinge); ai është i njohur edhe si Le Chevalier Labhran de Saint Germain, dhe është mësues privat i Kalorësve Tempullarë të Shën Antonit. Besoj se është e drejtë të mendosh që është brenda gjërave të fshehta. Atëhere përse vazhdon të na thotë se fisi i Gralit të Shenjtë është ai i Jezusit, kur, duke pasur përvojat që ka pasur, e di me siguri që nuk është kështu?

Më vonë, Kisha Katolike e tërhoqi mbështetjen e saj kundrejt Merovingëve, që e humbën kështu pushtetin e tyre dhe dolën nga skena publike. Një tjetër monark i racës zvarranike u bë mbret i Frankëve. Emri i tij ishte Karl, më së shumti i njohur si Karli i Madh, njëri prej sovranëve që i janë thurur më shumë lëvdata në historinë e Evropës. Ai ka qenë njëri prej mbrojtësve të parë të muratorëve, që pastaj ndërtuan katedralet e Evropës për tempullarët. Në Tuluzë i atribuohet atij themelimi i një lozhe të Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve, që i ka zanafillat të paktën në Egjiptin e lashtë[4], dhe të rikujton, siç është deklaruar, *Rosi-Crucis*-in, simbolin e racës së zvarranikëve.

Karli i Madh e zgjeroi shumë perandorinë e frankëve dhe në vitin 800 u kurorëzua Perandor i Perëndimit, nën pontifikatin e Leonit III. Kisha e Romë/Babilonisë kontrollonte pjesën më të madhe të Evropës perëndimore e qendrore. Ky sundim u bë i plotë kur fraksioni që i kundërvihej ushtarakisht Romës, Hohenstaufenët apo Gibelinët, u mundën në vitin 1268 nga Guelfët, që e morën emrin nga Uelfi, duka i Bavarisë. Kjo çoi në krijimin e Perandorisë së Shenjtë Romake, një diktaturë e tmerrshme papnore. Dinastia perandorake më e njohur ishte ajo e Habsburgëve, një familje prej race zvarranikësh, njoftimet e para për të cilën hasen në Zvicër gjatë shekullit X. Ata hipën në fronin perandorak falë mbështetjes papnore dhe e mbajtën për pesëqind vjet, deri në rënien e perandorisë, në vitin 1806. Qeverisën Austrinë që nga viti 1278 dhe, në shekullin XVI, trashëguan kurorën e Spanjës. Habsburgët janë një familje zvarranike dhe unë njoh një priftëreshë që ka shërbyer rite satanike të nivelit të lartë dhe që i ka parë pasardhësit bashkëkohorë të Habsburgëve të shndërrohen në zvarranikë gjatë këtyre riteve. Por për të do të flasim më pas. Karli i Madh ishte një shërbëtor i pashoq i Vëllazërisë Babilonase dhe pasardhësit e tij vazhdojnë të mbajnë frerët e pushtetit. Të paktën 33 presidentë amerikanë janë gjenetikisht të afërm me të.

Misteri i Rëne-lë-Shatosë

Merovingët janë kthyer në skenë kohët e fundit në një sërë librash, që përpiqen të zgjidhin misterin e fshatit të vogël të Rëne-lë-Shatosë, në majën e maleve të Linguadokës, në Francën Jugore. Ky ishte dikur një prej qendrave më të rëndësishme të Manastirit të Sionit, të Urdhërit të Tempullarëve, të Urdhërit të Katarëve dhe të shumë të tjerëve, që bëjnë pjesë në rrethin e atyre që zotërojnë dijet e fshehta. Kjo zonë ka qenë dikur e populluar nga keltët, kimerët dhe shitët e lashtë, të ardhur nga Lindja e Afërt dhe nga malet e Kaukazit dhe, Rëne-lë-Shatoja, quhej Rhedae, nga emri i njërit prej fiseve. Nderohej nga druidët si një vend i shenjtë, pasi edhe ky është një rajon me nivel të lartë magnetizmi. Në fund të viteve shtatëdhjetë të shekullit të njëzetë, një dokument me origjinë të panjohur i quajtur "Gjarpëri i Kuq", apo *Le Serpent Rouge*, doli në dritë në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Përmbante pemën gjenealogjike të Merovingëve, dy harta të Francës së periudhës merovinge dhe një plan të Shën Sulpisit, qendra e Kishës Katolike ku zhvilloheshin studime okultizmi (magjie)[5]. Shën Sulpisi ishte ndërtuar mbi mbeturinat e një tempulli kushtuar Isidë/Semiramidës dhe ishte vendi ku varroseshin mbretërit merovingë. *Le Serpent Rouge* (Gjarpëri i Kuq) mbante datën 17 janar 1967 dhe skeda e Bibliotekës Kombëtare ishte e datuar më 15

LIBRI

shkurt[6]. Por kjo data e fundit pastaj rezultoi e falsifikuar, pasi data e vërtetë në të cilën ishte depozituar ishte 20 marsi[7]. Në atë kohë të gjithë autorët e supozuar të veprës, Pier Fuzheri, Luis Shën-Maksenti dhe Gaston de Kokeri, kishin vdekur në një largësi kohore prej 24 orësh nga njëri-tjetri, më 6 dhe 7 mars[8]. Por çështja bëhet akoma më e çuditshme, pasi këta të tre, sikurse doli mandej në dritë, nuk ishin aspak autorët e tij[9]. Dikush, mendohet, ua kishte atribuar atyre autorësinë e asaj vepre, për ta mbështjellë gjithçka akoma më shumë me mister. Trembëdhjetë ditë kishin kaluar midis atyre tri vdekjeve dhe depozitimit të librit në bibliotekë. Dokumenti me trembëdhjetë faqe përfshinte poema të vogla në prozë lidhur me çdo shenjë të zodiakut dhe rreshtonte të trembëdhjetë shenjat. E trembëdhjeta ishte quajtur Ofiucus (mbartësi i gjarpërit), dhe ishte i vendosur ndërmjet Akrepit dhe Shigjetarit. 13-a ishte numri më i rëndësishëm për tempullarët dhe kjo do të bëhet gjithmonë e më e qartë dora-dorës që historia jonë do të vijojë. Besoj prej shumë kohësh që shenjat e zodiakut në fillim kanë qenë 13. *Le Serpent Rouge* (Gjarpëri i Kuq), që duket se i referohet peizazhit përreth Rëne-lë-Shatosë, paraqet një version të përrallës së Bukuroshes së Fjetur, në të cilën princesha (energjia femërore) është e dënuar të flejë gjersa princi i bukur të arrijë për ta zgjuar. Kjo është mjaft e rëndësishme edhe për numrin 13, për arsye që do t'i shpjegoj më poshtë. *Le Serpent Rouge* (Gjarpëri i Kuq) ripohonte edhe se Maria Magdalena nuk ishte gjë tjetër veçse i sati simbol i Isidës. Thoshte në fakt:

"...Fillimisht dikush e thërriste ISIDË, mbretëreshë e burimeve mirëbërëse, EJANI ME MUA TË GJITHË JU QË VUANI DHE QË JENI TË MUNDUR DHE UNË DO T'JU NGUSHËLLOJ, të tjerë e quanin Magdalena e vazos së famshme plot me balsam shërues. Anëtarët e kultit e njehnin emrin e saj të vërtetë: NOTRE DAME DES CROSS"[10].

Energjia femërore dhe prejardhja zvarranike trashëgohen nëpërmjet linjës së nënës dhe, që nga kohërat e Ninkharsagut e të Enkit, kjo energji simbolizohej nga Maria, nga Isida e nga Semiramida, si edhe nga Diana. Princesha Diana u vra përballë me një vend të lashtë flijimesh merovinge, që i kushtoheshin perëndeshës Diana, kur makina e saj u përplas pas shtyllës së trembëdhjetë të galerisë. Një shpellë në Sainte-Baume, në Francën Jugore, është një shenjtërore e njohur zyrtarisht nga Kisha Katolike sepse, thuhet, dhe kjo gjë është absolutisht e pabazuar, që aty ka pasur jetuar Maria Magdalena[11]. Në realitet, gjatë sundimit romak, ajo shpellë ka qenë një qendër e kultit të Perëndeshës Diana Luçifera – Dianës së lëngëshme e dritës, ose Ndriçuese. Ka qenë

pikërisht ky epiteti që i ishte dhënë Maria Magdalenës nga Jakobus de Vorazhi, argjipeshkëvi domenikan i Fisnikërisë së Zezë gjenoveze[12]. Një tjetër pikë interesante është se, ndërsa tempullarët e përhapur në pjesën tjetër të Francës qenë arrestuar e torturuar pas spastrimit të urdhëruar nga Filipi i Bukur në vitin 1307, ata që jetonin në zonën përreth Rëne-lë-Shatosë, në Le Bezu, në le Valdieu dhe në Blanshfort, u lanë në paqe. Kjo zonë ishte sigurisht shumë e rëndësishme për tempullarët, që ishin të lidhur me familjen Blanshfort të Sható de Blanshfortit, rreth dy milje larg nga Rëne-lë-Shatoja. Disa studiues mendojnë se tempullarët e kanë groposur pjesën më të madhe të arit të tyre afër Rëne-lë-Shatosë. Sigurisht, një e treta e krejt pasurisë së tyre evropiane gjendej dikur në rajonin e Linguadokës. Edhe romakët e mbanin të shenjtë këtë zonë dhe aty nderonin hyjnitë e tyre pagane. Në shekullin VI Rëne-lë-Shatoja ishte një qytet në lulëzim me 30.000 banorë, kryeqyteti verior i perandorisë vizigote, që shtrihej përtej Pirenejve, në Spanjë. Vizigotët ishin një popull gjermanik, apo teutonik, sikurse Kalorësit Teutonë të mëpastajmë, që dolën në dritë në të njëjtën periudhë me Kalorësit Tempullarë. Edhe vizigotët ishin paraardhësit e kimerëve dhe të shitëve, popullsitë e bardha të Kaukazit. Qenë vizigotët ata që u lëshuan si plumb poshtë që nga Evropa Qendrore, për të plaçkitur Romën dhe për t'i dhënë fund sundimit romak.

Një kështjellë e lashtë vizigote, Shato d'Hetpul, është ende e dukshme në Rëne-lë-Shato dhe ka në përbërje një kullëz, dikur e përdorur për eksperimente alkimie. Alkimia është shndërrimi i qenies njerëzore të ulët në shpirt të pastër, por parashikon edhe shndërrimin e metaleve pa vlerë në ar. Teoria mbi të cilën ajo bazohet ka qenë formuluar nga anëtari grek i shoqërive të fshehta Aristoteli, sipas të cilit në bazën e botës fizike qëndronte ajo që ai e quante materia themelore, ose primare. Kjo, sipas mendimit të tij, ishte një energji jomateriale, që as nuk mund të shihej, as nuk mund të prekej. Ai besonte se materia primare mund të shfaqej fizikisht duke marrë formën e katër elementeve: tokës, zjarrit, ujit dhe ajrit. Këto elemente janë të ndryshëm njëri nga tjetri, por secili është i lidhur me të tjerët nga një vlerë e përbashkët thatësie, lagështie, nxehtësie ose të ftohti. Çdo element zotëron dy prej këtyre cilësive, prej të cilave njërën në mënyrë mbizotëruese. Toka është e ftohtë dhe e thatë dhe ajo që mbizotëron është thatësira. Zjarri është i nxehtë e i thatë dhe në këtë rast është nxehtësia ajo që mbizotëron. Uji është i lagësht e i ftohtë dhe të ftohtit është elementi i tij mbizotërues. Ajri është i nxehtë e i lagësht dhe aty mbizotëron lagështia. Ideja është ajo, sipas së cilës, çdo element mund të shndërrohet në një tjetër mbi bazën e karakteristikës që e kanë të përbashkët: për shembull, zjarri bëhet ajër nëpërmjet karakteristikës së

LIBRI 24

përbashkët të nxehtësisë. Substancat janë të përbëra prej elementesh dhe, nëse elementet mund të shndërrohen në njëri-tjetrin, atëhere je në gjendje që t'i shndërrosh substancat, që ato elemente përbëjnë. Për shembull, plumbi mund të shndërrohet në ar. Besohet se ekziston një pluhur sekret që është i nevojshëm për të kryer këto shndërrime dhe që është bërë i njohur me emrin e Gurit Filozofal. Thuhet edhe se familja d'Hetpul ishte mbajtëse e këtyre sekreteve. Në dokumentin e quajtur *Le Serpent Rouge* lexohet kështu në lidhje me shenjën e trembëdhjetë të zodiakut, Ofiukus: "plumbi i pavlerë i fjalëve të mia mund të përmbajë arin më të pastër"[13]. Për pesëqind vjet Rënë-lë-Shatoja ka qenë pronë e kontit të Razës dhe u bë qendër e rëndësishme për katarët. Rënia e këtyre të fundit shënoi edhe pakësimin e ndikimit të asaj qendre. Murtaja dhe banditët katalanas plotësuan rënien e saj nga një qytet i rëndësishëm që ishte në atë fshat të vogël që do të katandisej pastaj[14]. Sot është një vend me bukuri e mister të madh, që ofron pamje të konsiderueshme mbi malet dhe mbi luginat që e rrethojnë. Do ta klasifikoja pa ngurrim midis vendeve parajsore të Tokës, sikur të mos ishte ajo përshtypje me të vërtetë e pakëndshme e nxitur nga energjia që mbush atë vend. Unë i kam rënë në të së "keqes", që përshkon atë vend.

Skemat imagjinare gjeometrike që lidhin malet, vendet e shenjta dhe kishat e këtij rajoni, janë rindërtuar në kohërat moderne nga persona si Henri Linkolni, një pionier i studimeve mbi misteret e Rënë-lë-Shatosë, dhe nga David Vudi e Ian Kempbelli në librat e tyre *Genisis* e *Geneset* (shih ***Figura 20***). Perëndesha Isidë përmendet në regjistrat e vjetër të Rënë-lë-Bainsit, që është jo larg nga Rënë-lë-Shatoja, dhe në shekullin e kaluar një statujë e Isidës është gjetur afër fshatit[15]. Vudi dhe Kempbelli sugjerojnë se toponimet Rënë-lë-Shato dhe Rënë-lë-Bains do të thonë "mbretëresha e shtëpisë" dhe "mbretëresha e ujërave" – atribute që u jepeshin nga egjiptianët e lashtë perëndëshave të tyre Neftisit dhe Isidës[16]. Zona përreth Rënë-lë-Shatosë është me forcë dhe me rëndësi shumë të madhe brenda rrjetës energjitike tokësore dhe, për këtë arsye, ka qenë një pikë vatërore që nga lashtësia për ata që ishin në dijeni të këtyre gjërave dhe që dinin si ta mbanin në fre energjinë. Bota moderne e njohu historinë e Rene-le-Shatosë falë prodhimeve televizive të BBC-së së Henri Linkolnit dhe librit *Holy Blood, Holy Grail*, i shkruar nga Linkolni me Majkëll Baixhentin dhe Riçard Leon. Ai libër frymëzohej tek historia e Beranzhe Sonierit që, në vitin 1855, qe urdhëruar prift në kishën e Shën Maria Magdalenës, në Rënë-lë-Shato. Sonieri kishte lindur në Montazelsin e afërt. Kisha ishte në një gjendje të tmerrshme dhe, vijon historia, në vitin 1887 ai dhe dy punëtorë ndërmorrën punën e jashtëzakonshme të

përmirësimit të brendshëm. Ngritën një pllakë guri afër altarit dhe panë se ajo kishte në pjesën e brendshme një figurë të gdhendur, që paraqiste dy njerëz mbi një kalë të vetëm. Ai simbol ishte vula e parë e Kalorësve Tempullarë. Pllaka e gurit u bë e njohur si Guri i Kalorësve dhe mund të admirohet në muzeun e fshatit. Kur Sonieri e kuptoi se mund të gjendej ndonjë gjë e rëndësishme, i vazhdoi kërkimet e tij vetëm. Kthesa ndodhi kur prishi altarin dhe, në brendësi të njërës prej shtyllave mbajtëse, gjeti ca tuba druri bosh përbrenda të vulosura me dyllë. Në brendësi të tyre zbuloi pergamena që, siç i vërtetoi më pas, ishin të shkruara me kod. Pasi u këshillua me eprorët e tij kishtarë të Karkasonës, u drejtua për në Paris, në qendrën e studimeve okulte të Kishës Katolike të Shën Sulpisit, që ndodhet kundrejt meridianit të Parisit, në një vend kushtuar së lashti kultit të Isidë/Semiramidës. Këtu punojnë ekspertë tekstesh, shkrimesh dhe kodikësh mesjetarë. Kërkimet e kryera deri këtu kanë zbuluar se pergamenat e Sonierit përmbanin një pemë gjenealogjike që i përkiste vitit 1244 (vit në të cilin katarët qenë masakruar në Montsegur) dhe që vërtetonte mbijetesën e linjës dinastike merovinge; përmbanin, përveç kësaj, një pemë të mëtejshme gjenealogjike merovinge që shkonte nga viti 1244 deri në vitin 1644 dhe dy përpilime të tjera, në vitet tetëdhjetë të shekullit të tetëmbëdhjetë, sipas gjasës prej abatit Antuan Bigó, ish prift i Rënë-lë-Shatosë, përveçse kapelan personal i familjes Blanshfort. Nuk besoj absolutisht se kjo është gjithçka që Sonieri gjeti. Po të kishte gjetur me të vërtetë diçka të një farë rëndësie, nuk do ta kishte zbuluar kurrë publikisht dhe është shumë e mundshme që Sonieri të mos i ketë gjetur aspak ato pergamena në kishë. Ndoshta është fjala për një mbulesë, për të fshehur se si kanë shkuar gjërat realisht.

Urdhëri i Manastirit të Sionit bëri të qarkullonin ca kopje të dy pergamenave të Bigosë në vitin 1967, apo, sidoqoftë, gjatë viteve gjashtëdhjetë. Mendohet se Urdhëri i Manastirit të Sionit ka lindur në qytetin francez të Troyes, i themeluar nga frankët sikambër (merovingët), ku u organizuan zyrtarisht tempullarët. Manastiri i Sionit doli në skenë afërsisht në të njëjtën periudhë të Kalorësve Tempullarë, të Kalorësve të Maltës dhe të Kalorësve Teutonë, dhe pati një lidhje veçanërisht të ngushtë me tempullarët. Por, duke iu përmbajtur disa hulumtuesve, origjina e vërtetë e Urdhërit të Manastirit të Sionit i përket kohërave mjaft më të vjetra. Mjeshtrat e tij të Mëdhenj quhen Nautoniers, ose Lundërtarë, dhe ata që e kanë mbajtur këtë titull midis viteve 1188-1918 janë të radhitur në dokumentet të njohura si *Dosjet Sekrete*, tekste të publikuara privatisht dhe të depozituara në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Midis tyre figurojnë Marie e Zhan de Shën-Kleri; Leonardo da Vinçi; Sandro

LIBRI 24




Figura 20. Ylli i shtrirë me pesë cepa i identifikuar nga David Vudi dhe Jan Kempbelli në zonën përreth Rëne-lë-Shatosë. Ata kanë lidhur kishat dhe të tjera pika gjeografike vendimtare.

Botiçeli, artist i madh italian, mik i Leonardos; Nikolas Flameli, alkimisti i famshëm mesjetar; Robert Fludi, filozof; Isak Njutoni, që "zbuloi" ligjin e gravitetit dhe që ishte njëri prej përkrahësve më të mëdhenj të tezës "shkencore", sipas së cilës "kjo botë është gjithçka që ekziston"; Robert Bojli, mik i ngushtë i Njutonit dhe themeluesi tjetër i "shkencës" moderne; Zhan Koktoja, shkrimtar dhe artist francez. Dy të tjerët që e mbanin këtë titull në kohën e Sonierit ishin autori dhe poeti francez Viktor Hygoi dhe miku i tij kompozitor Klod Debysia, një Mjeshtër i Madh i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve. Njëra prej veprave më të famshme të Debysisë ka qenë një dramë merovinge. Një Mjeshtër i Madh i kohëve të fundit duket se ka qenë Pier Plantard de Shën-Kleri që, sipas burimeve të zbuluara tek libri *Holy Blood, Holy Grail*, duhej të rridhte nga Dagoberti II dhe nga dinastia merovinge. Dagoberti ishte trashëgimtar meroving, i dërguar në mërgim në Irlandë që fëmijë. Ai u kthye për të bërë të veten kurorën, por u vra. Mendohet, megjithatë, se i biri ka mbijetuar. Mendoj, megjithatë, që Pier Plantardi, për

shumë drejtime, t`i ketë çuar në rrugë të gabuar autorët e librit *Holy Blood, Holy Grail* dhe ideja se fisi i Merovingëve përkon me atë të Jezusit nuk ka asnjë bazë. Ai fis në fakt nuk ka të bëjë fare me Jezusin. Arsyeja se pse ekzistojnë kaq shumë referime ndaj Arkadisë (*emër që rrjedh nga rajoni përrallor e mitik grek i Arkadisë, ku sipas mitologjisë ndodhej banesa legjendare e Zeusit*) në lidhje me Rëne-lë-Shatonë është për t`u kërkuar në faktin që Arkadia në Spartë ishte banesa legjendare e Zeusit dhe e Titanëve – fiseve zvarranike të Trojës. Kjo ka qenë origjina e atyre fiseve, jo Jezusi, i cili as që ka ekzistuar. Pier Plantardi, që është në dijeni të së vërtetës, por nuk dëshiron t`jua bëjë të ditur *juve*, lindi në vitin 1920 dhe, me miratimin e shtypësve gjermanë, në vitin 1942 mori drejtimin e një reviste në Francën e pushtuar nga nazistët me titullin *Conquest For A Young Knighthood* (Pushtimi i një kalorësie të re)[17]. Ishte revista e një shoqërie kalorsiako-masonike që e kishte selinë në Paris dhe quhej Urdhëri i Galatë-Alfës, Mjeshtër i Madh i së cilës Plantardi u bë në moshën 22 vjeç[18]. Nuk bëhet fjalë sigurisht për një njeri të cilit mund t`i zihet besë në fjalë.

Në Shën Sulpis, në Paris, famullitari i fshatit don Berenzhe Sonieri u takua me don Bjeilin, drejtor i përgjithshëm i seminarit, dhe me nipin e këtij të fundit, Emil Hofetin[19]. Nëpërmjet Emilit u prit me mirëdashje brenda një rrethi adhuruesish të ekzoterizmit, midis të cilëve figuronin këngëtarja e famshme e operas Ema Kalveja dhe Klod Debysia, Mjeshtri i Madh i Manastirit të Sionit dhe i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve. Sonieri dhe Kalveja filluan një frekuentim të rregullt dhe ajo shkoi ta takonte në Rëne-lë-Shato. Ema Kalveja ishte e futur më së miri brenda rretheve franceze që i kushtoheshin okultizmit dhe njëri prej miqve të saj të ngushtë ishte markezi Stanislas de Golta, themelues i versionit bashkëkohor të Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve[20].

Pjesa më e madhe e Mjeshtrave të Mëdhenj të Manastirit të Sionit kanë pasur lidhje me trëndafilkryqëtarët. Një tjetër mik i Kalvesë ishte Zhyl Bojsi, satanist i njohur, përveçse mik i ngushtë i një tjetër satanisti, MekGregor Matersit[21]. I nxitur nga Bojsi, Matersi themeloi shoqërinë britanike të okultizmit, Urdhërin e Agimit të Artë, njëri prej anëtarëve më të spikatur të të cilit ishte satanisti Aleister Krouli. Urdhëri i Agimit të Artë dhe degëzimet e vartësit e tij, si Krouli, kanë qenë si në krah të nazistëve, ashtu edhe në krah të satanistit, druid, përveçse kryeministër britanik, Sër Uinston Çurçillit. Krahu i ngritur në përshëndetjen "Hail Hitler" ishte në fakt një shenjë rituale e Urdhërit të Agimit të Artë. Një anëtar tjetër i famshëm i Urdhërit të Agimit të Artë ishte poeti V.B. Jetsi, mik i Klod Debysisë. Jetsi bëri në mënyrë mjaft të shkëlqyer

përmbledhjen e qëllimeve të Vëllazërisë Babilonase, kur përshkroi shoqërinë e tij ideale:

"...një qytetërim aristokrat në formën e tij më të plotë, në të cilën jeta strukturohet mbi baza hierarkike, në të cilën tek porta e çdo njeriu të madh mblidhen në agim lutësit, pasuri të mëdha kudo në duart e pak njerëzve, të gjithë që varen nga të paktit, deri tek vetë perandori, që është një Zot që varet nga një Zot akoma më i madh dhe, kudo, në gjykatë, në familje, pabarazia është bërë ligj"[22].

Ky është saktësisht vizioni për racën njerëzore i konceptuar nga raca e zvarranikëve. Nëse Sonieri dhe miqtë e tij vepronin brenda rrethit të Ema Kalvesë, atëhere jemi duke folur për satanizëm. Nuk po them se Sonieri ishte një satanist, sepse këtë nuk e di, por se njihte njerëz që ishin. Të tjerë njerëz të famshëm që shkonin të takonin Sonierin në Rëne-lë-Shato ishin ministri i Kulturës Franceze dhe arkiduka Johan fon Absburgu, një kushëri i Franc Jozefit, perandor i Austrisë[23]. Habsburgët, një familje zvarranike e rangut të parë, e sunduan Perandorinë e Shenjtë Romake për 500 vjet, deri në rënien e tyre, që ndodhi në vitin 1806. Manastiri i Sionit, dinastia e Merovingëve dhe Rëne-lë-Shatoja, janë të gjithë pjesë e rrjetit të shtrirë, të cilin jam duke e përshkruar.

Ndërmjet lozhave masonike, sot më të rëndësishme, gjejmë në Zvicër Lozhën e Madhe Alpine. Midis anëtarëve të saj figuron Henri Kisingeri, njëri prej shërbëtorëve më të zellshëm të zvarranikëve (racë, në të cilën, nga ana tjetër, bën pjesë) që mund të gjenden në planet. Kjo lozhë është e përfshirë në nivele shumë të larta në manipulimin global dhe ka shenjat dalluese tipike të një sekti satanik. Një libër me titullin *The Merovingian Descendants And The Enigma Of The Visigoth Razes* (Pasardhësit merovingë dhe enigma e rajonit vizigot të Razës) është publikuar, sipas asaj që bëhet e ditur në ballinën e tij, nga Lozha e Madhe Alpine, edhe pse tani ajo e mohon[24]. Razes është emri i vjetër i rajonit përreth Rene-le-Shatosë[25]. Ky libër ishte botuar së pari në gjermanisht dhe pastaj u përkthye në frëngjisht nga Valter Selse-Nazairi, një pseudonim i formuar nga emrat e shenjtorëve, të cilëve u është kushtuar kisha e Rëne-lë-Bainsit. Sekretet e ruajtura në Rëne-lë-Shato dhe në Languadoka janë themelore për këta njerëz. Kompozitori Rikard Vagner përdori në operat e tij ca emra të çuditshëm, që i referohen rajonit të Rënesë dhe në njërën prej tyre, *Valkiriet*, rihasim temën e njeriut të dënuar me gjumë të përjetshëm brenda një kështjelle të magjepsur. Në zonën përreth Rëne-lë-Shatosë ka shumë rrënoja kështjellash të magjepsura dhe kështjella

vagneriane e Valhallas gjendet mbi meridianin e Parisit, pak milje larg fshatit[26]. Adolf Hitleri, që ishte i rrëmbyer si në ankth nga magjia e zezë, thoshte se, për të kuptuar nazistët, duhej të kuptoje Vagnerin. Sipas një legjende, Vagneri ka shkuar për të takuar Sonierin në Rëne-lë-Shato. Zhyl Verni, autor librash "fantastiko-shkencorë", ishte një anëtar i lartë i shoqërive të fshehta në dijeni të shumë sekreteve. Libri i tij Kështjella në Karpate risjell shumë emra tipikë të rajonit të Rëne-lë-Shatosë, ndërsa në librin tjetër të tij *Clovis d'Ardentor*, njëri prej personazheve është Kapiteni Bugarash – emër i një maje mali afër Rëne-lë-Shatosë, i njohur lokalisht si mali magnetik. Klodoveu ka qenë edhe emri i njërit prej të parëve mbretër merovingë. Një fermë pranë Rëne-lë-Bainsit quhet Zhuan, një tjetër emër ky, që Zhyl Verni e përdori për njërin prej personazheve të tij[27].

Kur u kthye në Rëne-lë-Shato, pas vizitës së tij në Paris, Sonieri filloi të bënte një jetë të dhënë pas qejfeve, shumë përtej mjeteve modeste të një famullitari të varfër fshati. Prej nga vinin ato pasuri të papritura? Pranë kishës ndërtoi një shtëpi për vete dhe për guvernanten e tij, Marie Denarnodin, shtëpi së cilës i dha emrin Vila Bethania. Jo larg prej aty porositi të ngrinin një kullë roje në buzën e një shkëmbi që binte thikë, në një pozicion të tillë që të mbizotëronte luginën dhe malet. E quajti Tour (Kulla) Magdala dhe tha se ishte një bibliotekë. Unë e kam parë dhe nuk besoj se ishte ai funksioni i saj. Ka shumë pak hapësirë për librat dhe nuk ka absolutisht strukturën e një biblioteke. Megjithatë, ajo është e vendosur në pikën e saktë, në të cilën, një rreth që bashkon kisha të ndryshme, prek njërin cep të yllit pesëcepësh, sipas skemës gjeometrike të ravijëzuar nga Vudi dhe Kempbelli (shih Fig. 20). Emri Magdala do të thotë "kulla e rojes" dhe kulla e rojes është një simbol, të cilin e përdor Vëllazëria për të paraqitur Maria Magdalenën, energjinë femërore, Isidën, Semiramidën. Mos harroni që ajo është edhe simboli i Dëshmitarëve të Jehovait, një tjetër besim-burg i krijuar nga njerëz të rëndësishëm të Vëllazërisë, si masoni me gradë të lartë Çarls Taze Rasëll. Shoqëritë e fshehta dhe besimet fetare të krijuara prej tyre janë të gjitha të lidhura. Sonieri shpenzoi shumë pará për objekte arti dhe antikuariati; financoi blerjen e një rezervuari uji të mbingritur, për të përmirësuar furnizimin me ujë të fshatit; dhe shpenzoi një pasuri të tërë, për të ndërtuar një rrugë, që të zëvendësonte shtegun e vjetër e të ndyrë, i cili i ngjitej malit deri në Rëne-lë-Shato. Filloi edhe të shkëmbente letra me njerëz të shpërndarë në të gjithë Evropën. Dhe, gjëja më e rëndësishme, e shndërroi kishën e vet, falë pasurive të tij të reja. Ajo u restaurua plotësisht dhe u zbukurua me statuja të çuditshme e simbole ekzoterike. Në hyrje të kishës Sonieri porositi të shkruanin në frëngjisht: "Ky

vend është i tmerrshëm". Sapo kalon pragun gjendesh përpara statujës, që paraqet një personifikim të veçantë të djallit. Është fjala për Asmodeusin që, siç siç thotë legjenda, qe detyruar nga mbreti Solomon të kontribuonte në ndërtimin e tempullit të tij në Jeruzalem. Një figurë e gdhendur e Asmodeusit në zinxhirë ishte gjetur midis objekteve personale të Sonierit. Mbi një vetratë paraqitet Maria Magdalena, që i fërkon këmbët Jezusit dhe, tek këmbët e një statuje të Marie Magdalenës, është shtuar një kafkë – simboli i riteve të tempullarëve. Dyshemeja është e mbuluar me katrorë të bardhë e të zinj, tipikë për tempujt masonikë. Njëri prej motiveve zbukuruese, i dëshiruar prej Sonierit brenda kishës, është trëndafili me kryqin. Është fjala për simbolin e sektit të fshehtë i quajtur Urdhëri i Trëndafilkryqëtarëve, ose Rose Croix, që i përket lashtësisë. Objekte, që u përkasin tempullarëve, të gjetura në Paris dhe në Qipro tregojnë trëndafilin dhe kryqin[28]. Trëndafili lidhet edhe një herë me kultin e perëndeshës dhe me simbolizmin seksual. Romakët mendonin se trëndafili ishte Lulja e Afërditës (Afërditë = Semiramidë), dhe ai (trëndafili) ishte edhe emblemë e "prostitutave të shenjta" të saj. Tek misteret seksuale të Afërditës, ajo që ishte "*sub rosa*", apo "nën trëndafil" nuk duhej t`u zbulohej atyre që nuk ishin anëtarë të kultit[29]. Madre Maries, e kuptuar si simbol i energjisë së perëndeshës, i jepej epiteti "Trëndafil", "Kaçubë trëndafili", "Kurorë trëndafili", ose "Trëndafil Mistik"[30]. Emri "Trëndafil" mund të rrjedhë edhe nga Eros, simbol i dashurisë seksuale. Trëndafilkryqëtarët janë pjesë e rrjetit të Vëllazërisë, ashtu sikurse edhe jezuitët. I vëllai i Sonierit, Alfredi, ishte një jezuit. Roja e muzeut të Rëne-lë-Shatosë më ka thënë se Sonieri sipas gjasës ishte një anëtar i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve dhe kjo nuk më habit aspak. Mbi varrin e tij, në varreza, janë të gdhendur një trëndafil e një kryq. Një trëndafil i kuq mbi një varr mund të tregojë një jetë shembullore, ose vdekjen e parakohshme të të vdekurit. Kur Pier Plantard Shën-Kleri, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit, bëri vizitë në Rëne-lë-Shato, ishte parë të kryente një ceremoni të çuditshme mbi varrin e Sonierit. Natyrisht, disa sektorë të Kishës Katolike ngritën pyetje mbi jetën luksoze të bërë nga Sonieri, por kur u arrit në një pikë vendimtare, në mbrojtje të tij rendi papa vetë.

Sonieri bashkëpunonte fshehurazi me dy priftërinj të tjerë vendas. Me abatin Bodé në Rëne-lë-Bains dhe me abatin Gelis në Koutusa. Të dy fshatrat ishin janë larg nga Rëne-lë-Shatoja. Disa dokumente provojnë se Bodeja, mik i gjyshit të Pier Plantardit, i pagoi shuma të mëdha parash Sonierit dhe të vëllait jezuit[31]. Duket se që të tre përfitonin të ardhura të papritura e misterioze. Në vitin 1897, miqësia e tyre e ngushtë u prish për shkak të

konfliktit ndërmjet Sonierit dhe Bodesë dhe për shkak të vrasjes mizore të Gelisit, që ishte bërë një i ngujuar dhe jetonte në një dhomë të blinduar, pasi i trembej sigurisë së tij. Dhe jo pa të drejtë, sigurisht. Ai, në fakt, u masakrua për vdekje nga dikush që e njihte dhe të cilit i besonte, pasi i hapi derën dhe çaktivizoi alarmin, që kishte instaluar. Pavarësisht vdekjes së dhunshme dhe luftës së ashpër që i kishte paraprirë, kufoma u ndreq mbi dysheme, sikur të ishte fjala për një ritual[32]. Në kishën e tij të Koutusas janë të dukshëm disa simbole për ne tashmë të njohur, si këmbët e luanit, rrushi e vreshti, dhe një lloj Ylli i Davidit, ylli me pesë cepa, në të cilin një trekëndësh i mbivihet një tjetri, në vend që të shkrihet me të, si në versionin normal. I njëjti simbol identik qe gjetur tek *ex libris* i Sonierit[33]. Mbi varrin e Gelisit, mbi të cilin ngrihet një kryq maltezo-tempullar, shquhet fjala "Vrasës" dhe pllaka është e zbukuruar me një trëndafil, simboli trëndafilkryqëtar i vdekjes së parakohshme. Sonieri vdiq nga infarkti në vitin 1917. Infarkti e goditi më 17 janar 1917, datë mjaft domethënëse për Vëllazërinë Babilonase. Është fjala në fakt për festën e Shën Sulpisit. Pikërisht në kishën e Shën Sulpisit, në Paris, kishte shkuar Sonieri me pergamenat e tij; dhe kishte qenë pikërisht plani i kishës së Shën Sulpisit ai që paraqitej në dokumentet misterioze të quajtura *Le Serpent Rouge* (Gjarpëri i Kuq); Shën Sulpisi ishte projektuar në vitin 1645, sipas ligjeve të gjeometrisë së shenjtë, mbi rrënojat e një tempulli kushtuar Isidës dhe kishte qenë seli e *Compagnie du Saint-Sacrament*, një fasadë e supozuar e Manastirit të Sionit; Viktor Hygoi, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit, u martua në Shën Sulpis. *Le Serpent Rouge* mban datën e 17 janarit dhe nënvizon faktin se 17 janari bie në shenjën astrologjike të Bricjapit, dhisë, që, në paraqitjen e saj negative, përkon me *Baphomet*-in dhe me Dhinë e Mendesit, simbol i satanizmit dhe i tempullarëve (shih *Figura* 21). Ky simbol e merr origjinën nga flijimi i një dhije nga ana e izraelitëve për nder të gardianit (zvarranik) të quajtur Azazel, që paraqitet edhe me një yll pesëcepash të përmbysur – ("koka e dhisë") 14 Janar 1468 - Vdekja e Skënderbeut

Thuhet se Nikolas Flameli, një tjetër Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit, i ka kryer eksperimentet e tij të para të shndërrimeve alkimike në mesditën e 17 janarit. Një statujë e Sharl de Loranit, Mjeshtër i Madh si i Manastirit të Sionit si i Urdhërit të Kalorësve Teutonë, ishte zbuluar në Bruksel më 17 janar 1775[34]. Nëse mendoni se bëhet fjalë vetëm për përkime të rastësishme, do t'ju lutesha të mos nënvlerësonit faktin se sa të rëndësishme janë datat për Vëllazërinë Babilonase. Çdo fraksion i sekondës paraqet një dridhje të ndryshme, pasi fusha magnetike tokësore ndryshohet lehtë nga Dielli dhe nga lëvizja e planetëve dhe çdo numër, apo kombinim numrash, mban me



Figura 21. Simboli i ndërlikuar i forcës së keqe, *Bafometit.*

vete gjurmën e vet të vetme dridhëse. Sonieri ia la të gjitha paratë dhe të gjithë pasurinë e tij guvernantes, Marie Denarnodit, që për të kishte luajtur edhe rolin e njeriut të besuar. Duket se kjo ka qenë ajo çka guvernantja i ka bërë të ditur një miku:

"Njerëzit këtu përreth ecin mbi ar dhe nuk e dinë... Me atë që na ka lënë Imzoti mund t`i shuajmë urinë Renesë për nja njëqind vjet, dhe do të mbetej prapë mjaft... ndonjë ditë do t`ju besoj një të fshehtë, që do t`ju bëjë një njeri të pasur... të pasur, shumë të pasur"[35].

Por nuk e bëri kurrë. Rëne-lë-Shatoja është një vend aq misterioz, sa mund ta bëjë të ngjashme me një "sallë pasqyrash", që për shumë kohë u ka penguar njerëzve hyrjen tek e vërteta. Por perdja po fillon të ngrihet dhe e vërteta është duke dalë në dritë. Ajo që i ndërlikon gjërat në historinë e Rëne-lë-Shatosë, dhe të Vëllazërisë në përgjithësi, është pakti i nënshkruar nga fraksione konkurente, që veprojnë nën të njëjtin *leadership*. Kjo do të thotë që, njerëz të përfshirë publikisht në ato lojëra, diskreditohen ose vriten nga të tjerë, po aq të përfshirë publikisht aty. Kjo mund të duket çorientuese për ata që nuk janë në dijeni të rregullave të lojës. Këto luftëra të brendshme bëjnë pjesë në *habitus*-in mendor, që është tipike për këta njerëz dhe, shpesh, është interes i liderëve të Vëllazërisë të bëjnë të mundur që këto luftëra të konsumohen në dritën e diellit. Kjo krijon në fakt atë klimë kaosi, të motos "përça e sundo", që është thelbësore për vënien në zbatim të Urdhërit të tyre të Ditës nëpërmjet manipulimit. Por krerët e Vëllazërisë mund t`i vënë përsëri në rresht me shpejtësi fraksionet e ndryshme, atëhere kur luftërat e tyre rrezikojnë planin e përgjithshëm, që të gjitha rreshtimet ndjekin: kontrollin e botës. Pikërisht një betejë e këtij tipi ka

qenë zhvilluar ndërmjet Manastirit të Sionit dhe krahut të tij ushtarak, Kalorësve Tempullarë, dhe ajo shkaktoi konflikte të ashpra në shekujt që pasuan.

Në vitin 1187, tempullarët humbën, sipas gjasës enkas, kontrollin e Jeruzalemit, i cili u kaloi saraçenëve, dhe u ndeshën pastaj me aleatët e mëparshëm dhe mësuesit e tyre zyrtarë, anëtarët e Manastirit të Sionit. Një vit më pas, u ndanë përfundimisht gjatë një rituali të njohur si Prerja e Vidhit të Gisorsit, një qytet afër bregdetit verior francez. Urdhëri i Sionit ndryshoi emrin e tij në Manastiri i Sionit dhe përshtati si emblemë të tij kryqin e kuq të tempullarëve. Edhe Manastiri mori titullin *Ordre de la Rose-Cross Veritas*, Urdhëri i Kryqit të Kuq të Vërtetë. Të dy sektet e fshehta vendosën të vepronin në mënyrë të pavarur, por Manastiri i Sionit luftonte për të marrë pasurinë e tempullarëve dhe, sipas gjasës, përdori mbretin meroving të Francës, Filipin e Bukur, për të realizuar qëllimin e tij.

Spastrimi i tempullarëve

Së pari Filipi hoqi dy papë, gjersa gjeti atë që do t'i ishte bindur urdhërave të tij. Dërgoi njërën prej ushtrive të veta për të sulmuar papën Bonifaci VIII, që vdiq pak më pas. Helmoi pastaj një papë të dytë, Benediktin XI. Kjo i dha mundësinë që të arrinte të hipte në fronin papnor njeriun e zgjedhur prej tij, argjipeshkëvin e Bordosë, që u bë papë me emrin Klementi V. Ky e shpërnguli papatin në Avinjon, duke shkaktuar një përçarje brenda Kishës Katolike që zgjati 68 vjet, gjatë së cilës të dy papët rivalë qëndronin njëri në Romë, tjetri në Francë. Pasi kishte vendosur papën e tij personal, Filipi vuri dorë në çështjen e Kalorësve Tempullarë. Dëshironte fort pasurinë e tyre, e urrente pushtetin e tyre dhe vepronte si një kukull e manovruar nga Urdhëri i Manastirit të Sionit. Në vitin 1291, me mundjen e kryqëtarëve të krishterë nga ana e saraçenëve dhe dëbimin e tyre nga Toka e Shenjtë, tempullarët humbën shumë prej ndikimit të tyre mbi Kishën. Filipi, në bashkëpunim më papën e tij kukull, vendosi t'i shkatërronte tempullarët. Në vitin 1306 arrestoi të gjithë hebrenjtë me qëndrim në Francë, i dëboi nga vendi dhe konfiskoi të gjitha pasuritë e tyre. Planifikoi pastaj një tjetër operacion të ngjashëm dhe organizoi arrestimin e fshehtë të tempullarëve francezë në agimin e të premtes së 13 tetorit 1307. Që nga ajo kohë, mendohet se e premtja e datës 13 është një ditë fatkeqe. Shumë tempullarë u kapën, përfshirë Mjeshtrin e Madh, Zhak de Molein, dhe iu nënshtruan torturave të paimagjinueshme të Inkuizicionit. Por ka prova të qarta të faktit se shumë tempullarë ishin në dijeni të këtij plani dhe u arratisën.

LIBRI 24

Dokumentet që përshkruanin rregullat dhe ritet e tyre ishin sekuestruar e shkatërruar para *inkursioneve* të ndryshme dhe, kur u hapën kriptat e selisë pariziene të tempullarëve, pasuria e pafund, e dëshiruar aq shumë nga Filipi, ishte zhdukur. Bashkë me papën e tij, ai ushtroi presione mbi sovranët e tjerë me qëllim që t'i arrestonin tempullarët, por nuk qe diçka e lehtë. Duka i rajonit gjerman, sot rajon francez, të Lorenës i mbështeti tempullarët dhe, edhe në zona të tjera të Gjermanisë tempullarët nuk u përndoqën. Disa prej tyre ndryshuan identitet dhe vazhduan të bënin atë që kishin bërë gjithmonë, por nën pamje të rreme. Të tjerë hynë për të bërë pjesë në Urdhërin e Shën Gjonit të Jeruzalemit (Maltës), apo në Urdhërin e Kalorësve Teutonë. Familjet aristokrate të Lorenës përbëjnë shembujt "më të pastër" të hibridëve zvarranikë dhe njëra prej këtyre sot mbulon një prej roleve më të rëndësishëm brenda rrjetit botëror të sekteve satanike. Ndërsa zyrtarisht këto tre urdhëra nuk kishin asnjë lidhje midis tyre dhe, përkundrazi, urreheshin, në realitet, në nivel të krerëve, ata i përkisnin të gjithë të njëjtës organizatë.

Mbreti anglez Eduardi II u përpoq ta shpërfillte sa mundi urdhërin e dërguar nga papa për arrestimin e tempullarëve dhe, kur presionet mbi të u bënë më këmbëngulëse, u tregua sa më shumë mundi i mëshirshëm kundrejt tyre. Skocia dhe Irlanda bënë të njëjtën gjë. Por, më pas, arritën inkuizitorët, dhe tempullarët ose u arratisën nga Anglia e nga Irlanda, ose u përballën me fatin e tyre. Skocia qe një rast më vete. Flota e tempullarëve u arratis nga Franca në kohën e spastrimit, sidomos nëpërmjet portit kryesor të La Roshelit, duke marrë me vete pasuritë e veta. Por ekziston edhe mundësia që Filipi i Bukur të jetë gënjyer nga Manastiri i Sionit, i cili i kishte organizuar gjërat në mënyrë të atillë që flota angleze t'i kapte tempullarët në arrati, për të grabitur thesarët e tyre. Është e mundur që të ketë ndodhur kështu. Tempullarët u drejtuan për në Skoci, për në Portugali dhe, mbi të gjitha, për në Amerikë, ekzistencën e së cilës ata e njihnin, pasi zotëronin dijet e fshehta të elitës ariane dhe e dinin që fenikasit kishin qenë në kontinentin amerikan mijëra vjet më parë.

Zgjedhja e Skocisë ishte e natyrshme për shumë arsye. Aty banonin Shën Kler-Sinklerët, sikurse edhe familjet e tjera të lashta të Vëllazërisë, që kishin arritur me fenikasit, ose që ishin shpërngulur në atë vend shumë vite më pas, që nga Belgjika apo nga Franca Veriore. Kreu i njërës prej këtyre familjeve, Robert Brusi, ishte në luftë me një tjetër degë të arianëve, me anglezët, për kontrollin mbi Skocinë dhe ishte shkishëruar nga papa. Kjo do të thoshte se urdhëri papnor për të shkatërruar tempullarët nuk kishte asnjë fuqi në zonat e kontrolluara nga Brusi. Pikërisht këtu u shpërngulën shumë tempullarë

pas spastrimit francez. Lundruan rreth bregut perëndimor të Irlandës, për të zbarkuar në bregun veriperëndimor të Skocisë. Gjatë kësaj pjese të bregut, në vende si Kilmori dhe Kilmartini, janë gjetur shumë varre dhe relike të tempullarëve. Tempullarët u vendosën edhe në rajonin e quajtur Dalriada, sot i njohur si Argil, dhe luajtën pastaj një rol vendimtar në betejën më të famshme të historisë skoceze.

Kapitulli 8

E njëjta fytyrë, tjetër maskë

Në vitet që i paraprinë ardhjes në numër të madh të tempullarëve nga Franca, fushata që Robert Brusi kishte udhëhequr kundër anglezëve rezultoi vërtet shkatërrimtare. Ai qe detyruar (shtrënguar) të gjente strehë në malet e Portshirit dhe, më pas, në rajonin e Argilit. Prej këtej lëvizi drejt Irlandës së Veriut.

Brusi kishte lidhje të ngushta me rajonin e Ulsterit, ku zotëronte edhe sipërfaqe të mëdha tokash. Ai ishte përveç kësaj kont i Karrikut, një emër që përsëritet në shumë toponime të kësaj zone të Irlandës, përfshirë Karrikfergusin. Popullsia e Ulsterit ka lidhje të vjetra politike dhe etnike me skocezët, sidomos me ata të bregut perëndimor të Skocisë, me të cilët ka qenë megjithatë shpesh në konflikt, falë një manipulimi të bërë me zotësi. Në qendër të konflikteve të Ulsterit janë gjer sot e kësaj dite përleshjet ndërmjet irlandezëve (katolikë) dhe irlandezo-skocezëve (protestantë), të cilët që nga Skocia u shpërngulën në Ulster. Këto konflikte manovrohen dhe ushqehen nga Vëllazëria nëpërmjet emisarëve të saj. Me mbështetjen e familjeve fisnike irlandeze, Brusi u kthye në Skoci në vitin 1307, vit i spastrimit të tempullarëve nga Franca, dhe u gjend shumë shpejt duke luftuar kundër një mbreti të ri anglez, kur Eduardi II i zuri vendin Eduardit I. Fushata e Brusit mori hov

LIBRI 24

falë mbështetjes dhe armëve të tempullarëve që arratiseshin nga Franca dhe arriti kulmin në betejën e Banokburnit, pranë Kështjellës së Stirlingut, më 23 qershor 1314, ditën e Shën Gjon Pagëzorit (dita e Nimrodit). Skocezët i thyen keqas anglezët pas një dite luftimesh, falë një reparti kalorësish të "panjohur", që kishin ngarendur në ndihmë të tyre. Për ndonjëfarë arsye të pasqaruar kurrë, anglezët e lanë veten të pushtoheshin nga paniku dhe ia mbathën vetëm sa panë përforcimet. Duhej të ishin trupa speciale, përveçse menjëherë të dallueshëm nga shenjat e jashtme, duke qenë se shkaktuan një reagim të menjëhershëm. Tempullarët ishin që të dyja këto gjëra dhe, ky repart i "panjohur", duhej të përbëhej pikërisht prej Kalorësve Tempullarë, luftëtarët aq të frikshëm të kryqëzatave, që tani ishin riorganizuar në Skoci. Fitorja në Banokburn do t'i siguronte Skocisë pavarësinë për 289 vitet e ardhshëm dhe, ndërmjet atyre që luftuan në atë kohë përkrah Brusit, figuronte Sër Uiliam Shën Kleri i Roslinit. Pas vdekjes së Brusit, që ndodhi në vitin 1329, filloi dinastia Stjuart. Në Francën e epokës merovinge emëroheshin ca njerëz të parisë së pallatit në mbështetje të monarkut dhe, duke nisur nga epoka e mbretit David I, Skocia vendosi një sistem të ngjashëm. Ata u quajtën *Royal Stewards* (Shefa ceremonie mbretërorë) dhe funksioni i tyre u bë i trashëgueshëm. Emri pastaj u modifikua në Stewart dhe nga ata rrodhën Stjuartët. Sikurse në rastin e Merovingëve, edhe këtu shefat e ceremonisë së dinastisë zyrtare, që ishin të trashëgueshëm, përfunduan të jenë një gjë e vetme me vetë dinastinë mbretërore. Kjo ndodhi pasi e bija e Brusit u martua me Uolter Steward-in, apo Stewart-in. Pas vdekjes së Brusit, fëmija i parë i këtij bashkimi të matur u kurorëzua si Roberti II i Skocisë. Dinastia Stjuart kishte mbretin e saj të parë.

Vepër e Kalorësve Tempullarë, zyrtarisht të shpartalluar, ishte edhe Urdhëri i Zharrëtierës, urdhëri më i rëndësishëm i kalorësisë, i krijuar nga Eduardi III në vitin 1348 dhe ende i drejtuar nga monarku britanik. Është fjala për një fasadë të Vëllazërisë Babilonase, i përbërë nga anëtarë të elitës dhe që i kushtohet "Virgjëreshës Marie" – Semiramidë/Ninkharsagut. Gjatë mbretërimit të Eduardit, mbledhjet e Urdhërit zhvilloheshin në një dhomë të veçantë të kështjellës Uindsor, përreth një tavoline, e cila të kujtonte atë të legjendës së mbretit Artur. Kështjella e Uindsorit ngrihet në afërsi të një vorbulle të lashtë dhe shumë të fuqishme energjie të shenjtë dhe, pikërisht në atë vend, satanisti, përveçse zvarranik, Kisinger, u kurorëzua nga mbretëresha. Kjo e fundit bashkëpunon hapur për realizimin e programit të Vëllazërisë dhe Urdhëri i Zharrëtierës është njëri prej referentëve të saj kryesorë. Emri i fisit të Eduardit III ishte Uindsor dhe kur, gjatë luftës së parë

botërore, familja aktuale mbretërore vendosi, për arsye të marrdhënieve publike, të braktiste emrin e vet gjerman dhe të merrte një anglez, zgjodhi pikërisht emrin Uindsor, për nder të njeriut që kishte themeluar këtë urdhër të rëndësishëm të Vëllazërisë. Stema e Urdhërit të Zharrëtierës është një kurorë e zbukuruar me trëndafila të kuq, në të cilën 26 nyje të arta, që përfaqësojnë 26 kalorës, janë ndarë në dy grupe me 13[1]. Në Francë lindën urdhëra të ngjashëm, si Urdhëri i Yllit, dhe Urdhëri i Shën Mikelit. Masonët përfaqësojnë Kalorësit Tempullarë dhe Manastirin e Sionit nën pamje të rreme dhe Urdhëri i Jezusit, apo Jezuitëve, paraqet të njëjtën strukturë të tempullarëve e ndjek një qëllim të njëjtë. Jezuitët dhe Kalorësit e Maltës janë shoqëri të fshehta ekzoterike, që grumbullojnë dhe shfrytëzojnë dije të fshehta, edhe pse deklarohen formalisht si shoqëri katolike e të "krishtera". Bëjnë saktësisht të njëjtën gjë që bënë tempullarët në kohën e kryqëzatave dhe, përveç kësaj, kontrollojnë, bashkë me nivelet më të larta të Urdhërit të Masonëve, Vatikanin, papën dhe Kishën Katolike Romane. Me fjalë të tjera, kontrollojnë që të dyja rreshtimet: lëvizjen e fshehtë ekzoterike dhe Kishën, që e dënon vetë atë lëvizje. Kështu kontrollojnë edhe lojën. Edhe rezultatin përfundimtar të asaj loje – dhe do ta bëjnë deri sa të mos i kemi hapur sytë. Një shembull i qartë i kësaj ndodhi pas spastrimit papnor të tempullarëve. Në vitin 1312, të gjitha tokat dhe pasuritë e tempullarëve iu ndanë nga papa "rivalëve" të tyre, Kalorësve të Maltës të Shën Gjonit, më pas të quajtur Kalorësit e Rodit dhe sot Kalorësit e Maltës (katolikët) dhe Kalorësit e Shën Gjonit (protestantët). Që të dy janë shprehje të së njëjtës forcë, sikurse ndodhte, dhe ndodh ende, me Kalorësit Teutonë. Të gjithë ishin të përfshirë në të njëjtat çështje, përfshirë bankat, dhe përdornin të njëjtat metoda pa skrupuj për të fituar. Për më shumë se 200 vjet, gjer në mes të shekullit XVI, ospedalierët dhe tempullarët bënë pjesë në të njëjtin urdhër dhe shumë prej tokave e pasurive të tempullarëve nuk kaluan në duart e Kalorësve Ospidalierë, pavarësisht se pjesa më e madhe e atyre rezultonte në dispozicion të tyre.

Rreth gjysmës së shekullit XV, tempullarët e rivendosën ndikimin e tyre në Francë duke marrë emrin e Rojeve Skoceze. Kur Robert Brusi u vendos, pa ndonjë kundërshtim, në fronin e Skocisë, nënshkroi një pakt me Karlin IV të Francës, duke ripërtërirë atë që ishte e njohur si "aleanca e vjetër". Kjo nuk të çudit, duke qenë se familjet që kontrollonin Skocinë, përfshirë Brusët dhe Sinklerët, e kishin prejardhjen nga Franca dhe nga Flandra. Në vitin 1445, mbreti i ardhshëm Karli VII formoi të parën ushtri të përhershme të Evropës që nga koha e tempullarëve dhe, në fakt, ajo ishte e përbërë pikërisht nga tempullarët. Një vend nderi brenda ushtrisë së Karlit i ishte rezervuar

Kompanisë Skoceze, që gjatë paradave zinte gjithmonë rreshtat e parë. Por akoma më e fuqishme dhe më me ndikim ishte Garda Skoceze elitare, e përbërë nga 33 burra, një numër ekzoterik mjaft domethënës, që do të ishte rimarrë pastaj nga 33 shkallët, apo gradët, e Ritit Skocez të Masonerisë. Garda Skoceze kishte detyrën të mbronte mbretin dhe flinte deri madje në të njëjtën dhomë me të. Jo që të tridhjetë e tre, shpresoj! Numri i pjesëtarëve të Gardës shtohej me 13 veta për çdo herë, gjithmonë në përputhje me ligjet e numerologjisë ekzoterike dhe me simbolizmin numerik të Kalorësve Tempullarë. Komandantët e Gardës Skoceze emëroheshin automatikisht anëtarë të shoqërisë së fshehtë të quajtur Urdhëri i Shën Mikelit, që më pas u përhap edhe në Skoci. Një tjetër aspekt që përsëritet herë pas here në procesin e manipulimit, i cili vazhdon edhe sot e kësaj dite, është ai sipas të cilit njerëzit që zakonisht veprojnë prapa një "maske", vënë shpesh shumë maska të tjera, të cilat ndjekin të njëjtat plane. Prapë edhe një herë, anëtarët e Gardës Soceze (tempullarët) zbatuan me sukses strategjinë e kalit të drurit të Trojës. Ata u futën tinëz brenda rangjeve të administratës franceze si "këshilltarë" e "ambasadorë" dhe morën kontrollin e saj. Karli ishte kukull në duart e tyre dhe emrat e elitës të Gardës së tij Skoceze tashmë na janë të njohur: Sinkler, Stjuart, Hamilton, Heji, Montgomeri, Kuningham, Kokburn e Seton. Këto ishin familjet që ishin shpërngulur në Skoci që nga Franca e nga Flandra dhe pema gjenealogjike e të cilave zinte fill në Lindjen e Afërt dhe tek anunakët. Ato u bënë zotër të Skocisë dhe pastaj rivendosën pushtetin e tyre në Francë. Garda Skoceze ishte një tjetër front që zotëronte dije të fshehta, ndiqte vënien në zbatim të Urdhërit të Ditës dhe praktikonte ritet satanike, për të cilat ishin akuzuar tempullarët. Asgjë nuk ndryshon, përveç emrit. Një anëtar aktual i familjes Montgomeri u ka treguar autorëve të librit *The Temple And The Lodge* (Tempulli dhe lozha) se në kohën e Gardës Skoceze ishte themeluar një urdhër, i quajtur Urdhëri i Tempullit, në të cilin mund të bënini pjesë të gjithë anëtarët e familjes Montgomeri[2]. Tempullarët do të rishfaqeshin pastaj brenda Ritit Skocez të Masonerisë.

Një tjetër lidhje domethënëse, po me këtë rrjet, përfaqësohet nga familja e Lorenëve, në rajonin veri-perëndimor të Francës, që kufizohet me Gjermaninë dhe, në mënyrë të veçantë, nga duka i Lorenës i njohur si Rëne d'Anzhu, i lindur në vitin 1408. Ai u bë Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit në moshën dhjetë vjeç dhe veproi nën drejtimin e ungjit Luigj, kardinal i dukatit Bar, deri në moshën njëzet vjeç[3]. Familja e tij ishte njëra prej familjeve kryesore zvarranike. Miids titujve fisnikë të Rënesë figurojnë ata të kontit të Provansës (që, ashtu si Rëne-le-Shatoja gjendet në Francë), konti i Guisit,

duka d'Anzhu, mbret i Hungarisë, mbret i Napolit dhe i Siçilisë, mbret i Aragonës, Valencias, Majorkës dhe Sardenjës, përveç titullit simbolik të mbretit të Jeruzalemit[4]. Ky titulli i fundit është shumë i rëndësishëm për Vëllazërinë dhe, pas tij, iu dha zvarranikut Karl Absburgut, emri i të cilit, sipas numurologjisë, është i barasvlershëm me 666. Në vitin 1445 njëra prej bijave të Rëne d'Anzhusë u martua me Henrikun VI të Anglisë dhe u dallua në luftën e dy trëndafilëve, që shpërtheu në vitin 1455 ndërmjet Henrikut të Lankasterit (trëndafili i kuq) dhe Jorkëve (trëndafili i bardhë). Rëne d'Anzhu kishte marrdhënie me të gjithë dhe ishte një personazh klasik i Vëllazërisë, në qendër të një rrjeti të gjerë. Ndërmjet shumë personaliteteve të famshëm historikë, me të cilët qe i lidhur, mund të kujtojmë Kristofor Kolombin dhe Zhanë d'Arkën. Në një farë kohe ai vendosi të rekrutonte Kristofor Kolombin dhe rëndësia shumë e madhe e këtij vendimi do të bëhet shpejt e qartë. Duket se Zhanë d'Arka ishte një nënshtetase e Rëne d'Anzhusë, e lindur në dukatin Bar. Sipas historisë zyrtare, në vitin 1445 ajo bëri të ditur "misionin e saj hyjnor" për të shpëtuar Francën nga pushtuesi anglez dhe për t'i garantuar Karlit hipjen në fronin francez me emrin Karli VII. Ajo kërkoi një audiencë pranë vjehrrit dhe ungjit të babait të Rëne d'Anzhusë dhe u prit prej tij në praninë e Rënesë[5]. Sipas asaj që është trashëguar zyrtarisht, ajo i tha se, për të realizuar misionin e saj, kishte nevojë për Renaton, për një kalë dhe për "disa njerëz të zotë që do të më çojnë në Francë". Historianët që kanë rindërtuar jetën e Rënesë mbrojnë idenë se ky ka shkuar tek Karli bashkë me Zhanën dhe se i ka qëndruar përkrah gjatë betejave fitimtare kundër anglezëve, të cilat sollën hipjen në fron të Karlit. Nuk ka qenë e mundur të rindërtoje zhvendosjet e Rënesë në periudhën që shkon nga viti 1429 deri në vitin 1431, pikërisht në vitet kur Zhanë d'Arka ishte në majat e karrierës së saj ushtarake. Më pas ajo vdiq e djegur në turrën e druve, pasi u gjykua shtrigë nga inkuizicioni, por, mjafton të marrësh në shqyrtim provat, për të kuptuar se e gjithë kjo histori nuk ka qenë gjë tjetër veçse një trillim i radhës. Ne na detyrojnë të besojmë se kjo vajzë e varfër me prejardhje të ulët trokiti në portën e fisnikëve dhe se këta e lejuan të udhëhiqte një luftë kundër anglezëve. Po, në rregull, edhe unë kam parë një gomar të fluturojë! Prapa kësaj fushate ushtarake ishte në realitet Rëne d'Anzhuja, ndërsa historia e Zhanë d'Arkës (e bazuar mbi legjendën e "Virgjëreshës së Lorenës") nuk ka qenë gjë tjetër veçse një mënyrë e leverdisshme, për të fshehur se si ishin gjërat realisht.

Ishte Rëne d'Anzhuja ai që shpiku kryqin e dyfishtë, i cili u bë i njohur si Kryqi i Lorenës. Ky simbol pastaj u mor nga disa sektorë të Kishës së Krishterë

LIBRI

dhe është në origjinën e shprehjes angleze "*double crossed*", që do të thotë i "manipuluar". Bëhet fjalë për një tjetër simbol të Vëllazërisë së racës së zvarranikëve, që mund të shihet edhe në logon e naftëmbajtëses gjigante *Exxon*, e kontrolluar prej disa emisarëve të saj, Rokfelerët. Rëne d'Anzhuja ishte plot me dije ekzoterike, përveçse ishte një studiues i legjendave të ciklit arturian dhe të Gralit të Shenjtë. Falë pronave të tij të shtrira dhe lidhjeve të tij në Itali, ishte futur brenda Fisnikërisë së Zezë e familjeve të tjera aristokrate dhe qe ndër përkrahësit e Rilindjes, periudha kur doktrinat e lashta egjiptiane dhe greke u përkthyen në gjuhët evropiane. Në oborrin e Rëne d'Anzhusë ishte një astrolog i quajtur Zhan de Shën-Remi që, sipas mjaft dëshmive, ishte gjyshi i astrologut më të famshëm të të gjitha kohërave, Nostradamusit. Kjo nuk të çudit, duke qenë se Nostradamusi, në shekullin XVI, ka qenë shumë afër familjes së Lorenëve dhe degëzimit të saj, familjes Guis, në periudhën kur këto udhëhoqën një fushatë të përgjakshme vdekjeje kundër rivalëve të tyre të të njëjtit gjak, në përpjekjen, që pastaj rezultoi e kotë, për të arritur të fitonin fronin e Francës. Tashmë vetë emri i këtij personazhi thotë gjithçka për të. Emri i vërtetë i Nostradamusit ishte Mishel de Notre Dame, Misheli i Zonjës Sonë. Autori dhe kërkuesi anglez Gerard de Sede, që duket se kishte lidhje me njerëz që ishin brenda gjërave të fshehta, mbron idenë se Nostradamusi ishte një agjent i familjeve të Lorenëve dhe të Guisëve dhe se e përdorte rolin e tij të astrologut të oborrit për të kryer një vepër manipulimi për llogari të oborrit francez. De Sede sugjeron edhe se shumë prej profecive të Nostradamusit nuk ishin edhe aq profeci se sa mesazhe, shifra, orare, udhëzime dhe simbole të marra nga grupe e nga ngjarje të së kaluarës. Shton se Nostradamusi kaloi një periudhë të gjatë kohe formimi në Lorenë, para se të hynte në oborrin mbretëror të rivalëve të asaj familjeje dhe, gjatë asaj periudhe, pati të drejtën të hynte në një libër të lashtë, mbi të cilin pastaj bazoi krejt veprën e tij. Nuk të çudit, pra, fakti që ai u bë një astrolog aq i shkëlqyer, duke qenë se dinte gjëra, të cilat vetëm pak të tjerëve të privilegjuar u ishte lejuar t'i dinin. Pa shikoni njëherë, Gerard de Sede mbron edhe idenë se dinastia merovinge është e përbërë nga jashtëtokësorë, tezë që, natyrisht, është hequr qafe si qesharake, por që unë e mendoj të vlefshme. Është fjala, të paktën, për një racë "mbretërore" që ka qenë zotëruar dhe kontrolluar nga raca e zvarranikëve të nivelit më të ulët të përmasës së katërt[6]. Në harkun e shekujve të XVI dhe XVII pasuan njëra-tjetrën një sërë ngjarjesh që i dhanë mundësinë Urdhërit të Ditës së Vëllazërisë të bënte hapa të konsiderueshëm përpara.

Ishte rritur në mënyrë të konsiderueshme përhapja e rrjeteve ekzoterike të fshehta dhe tani ishte e mundur të nisje fazën pasuese të pushtimit global.

Rëne d'Anzhuja e tregoi veten si njëri prej njerëzve kyç për zhvillimin e Rilindjes kur, përmes lidhjeve të tij të shumta në Itali dhe, në mënyrë të veçantë në Firence, kontribuoi për të organizuar përkthimin, publikimin dhe përhapjen e veprave të lashta greke, egjiptiane e gnostike, përfshirë ato të Platonit e të Pitagorës. Kjo e revolucionarizoi artin dhe kulturën midis klasave të privilegjuara të Evropës dhe kurrë si në atë kohë nuk ishte kërcënuar pushteti i Kishës. Shumë personalitete të tjera të famshme hynë për të bërë pjesë në rrjetin e shoqërive të fshehta. Presioni mbi *establishment*-in kishtar u rrit më tej me publikimin e Manifesteve të Trëndafilkryqëtarëve në vitin 1614 dhe 1616, të nënshkruar nga një grup i fshehtë anëtarësh gjermanë e francezë të këtij urdhëri. Ata angazhoheshin ta ndryshonin botën nëpërmjet dijeve të tyre ekzoterike dhe paralajmëronin një epokë të re lirie politike e besimi. Kisha Katolike dhe Perandoria e Shenjtë Romake dënoheshin ashpër. Por Urdhëri i Trëndafilkryqëtarëve nuk ishte një gjë e re. Duket në fakt se ka qenë themeluar të paktën në epokën e faraonit Tutmesi III, në shekullin XV para Krishtit. Vula personale (figura me formë ovale, që mban emrin e faraonit) e atij faraoni përdoret në letërsinë moderne të trëndafilkryqëtarëve[7] dhe, trëndafilkryqëtarët, janë të lidhur me Oborrin Mbretëror të Dragoit të Egjiptit të lashtë. Sot mendohet nga shumë anë se Manifestet qenë shkruar nga eksperti i ekzoterizmit Johan Valentin Andrea, që figuron si Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit. Një tjetër zë me mjaft ndikim në rrethin e mendimit trëndafilkryqëtar ishte ai i Robert Flojdit, njeriu që i parapriu Andreas në detyrën e Mjeshtrit të Madh të Manastirit të Sionit.

Trashëgimia e Bekonit

Njëri prej njerëzve më të rëndësishëm të të gjithë kësaj periudhe ka qenë trëndafilkryqëtari Frensis Bekoni. Ndikimi i tij qe kolosal. Ai ishte Mjeshtër i Madh i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve në Angli, mbuloi një rol vendimtar në themelimin e Urdhërit të Masonerisë, ka qenë "babai" i "shkencës" moderne dhe autori i vërtetë i dramave të "Shekspirit". Ishte edhe anëtar i një shoqërie të fshehtë të quajtur Urdhëri i Përkrenares, që nderonte kultin e perëndeshës së urtësisë Paladë Athinës, e paraqitur me një përkrenare në kokë e me një heshtë në dorë[8]. Kërkues dhe studiues si Menli P. Hill, historian i famshëm i Masonerisë, nuk kanë dyshime mbi faktin se Bekoni ka lindur nga marrëdhënia ndërmjet mbretëreshës Elisabetë I, "mbretëresha virgjëreshë" dhe të dashurit të saj Robert Dadlejit, kont i Lejçesterit[9]. Ai ishte rritur nga Nikolas dhe Ana Bekoni, për t'u bërë njeriu më me ndikim i vendit të tij, në nivel publik dhe jo vetëm, me titullin e viskontit të Shën Albansit

dhe me rolin e Lordit Kancelar. (Mund të themi se ai ka qenë pikërisht roli i tij). Nëse Bekoni ishte i biri i Elisabetës I, atëhere i përkiste një race zvarranike, dhe kjo do të shpjegonte ngjitjen e tij të shpejtë në nivelet më të larta të politikës dhe të shoqërive të fshehta. Ai veproi në fshehtësi përmes kanalesh klandestine, midis të cilëve *Inns of Court*-i, qendra londineze e profesionit avokator e kontrolluar nga Vëllazëria, e cila e ka selinë mbi atë që dikur ishte një pronë e tempullarëve dhe që sot ka marrë emrin Temple Bar. Ishte një kohë e konflikteve dhe përmbysjeve të mëdha, pasi Vëllazëria kërkonte ta përdorte Kishën si një instrument, për të përhapur luftëra e kaos. Njëri prej njerëzve të saj fasadë ishte Martin Luteri, një produkt i shoqërive të fshehta gjermane, përveçse trëndafilkryqëtar. Vula e tij personale paraqiste një trëndafil dhe një kryq. Në vitin 1517 ky profesor i teologjisë së Universitetit të Vitenbergut formuloi 95 teza polemike kundër Vatikanit, që e quante fajtor sepse kishte shitur ndjesa për të mbledhur pará për ndërtimin e bazilikës së Shën Pjetrit. Luteri u shkishërua, por e dogji atë dekret papnor bashkë me kopje të ndryshme të rregullores kishtare romane dhe krijoi Kishën e tij Luteriane. Lindi kështu besimi i krishterë protestant dhe, në të gjithë Evropën, u përhap konflikti ndërmjet protestantëve e katolikëve, që do të luftojnë ashpër për të vendosur se cili version i të njëjtave marrëzira do të fitonte mbi tjetrin. Është qesharake që trëndafilkryqëtarët të deklaronin se ishin në favor të lirisë fetare dhe politike, kur njëri prej kukullave të tij, Martin Luteri, nuk ishte aspak. Ai e urrente mendimin e lirë dhe kërkimin e lirë nga paragjykimet. Në një nga predikimet e veta deklaroi se ithtarët e tij duhej t`i pështynin në fytyrë arsyes, pasi ajo ishte kurva e djallit, qelb lebre dhe e denjë vetëm për të ndenjur në nevojtore[10]. E bukur! Shkruajti edhe:

"Qoftë e dënuar me humnerën e ferrit dashuria, nëse mbahet me shpenzimet e besimit... Është më mirë që tiranët të mëkatojnë nja njëqind herë kundër popullit, se sa populli të mëkatojë një herë të vetme kundër tiranëve... gomari duhet rrahur, populli duhet qeverisur me anë të forcës"[11].

Flet për ty, i dashur. Edhe një francez, i njohur me emrin Zhan Kalvin, ka prodhuar versionin e tij protestant të krishtërimit, një besim tjetër ekstremist e arrogant i quajtur kalvinizëm. Kjo prodhoi lëvizjen puritane, e cila pati aq shumë ndikim në pushtimin e Amerikës së Veriut nga ana e evropianëve. Kisha Protestante u përhap në Angli, pasi mbreti Henriku VIII dëshironte një trashëgimtar mashkull, por gruaja e tij e parë Katerina e Aragonës kishte lindur "vetëm" një femër. Ai donte të shkurorëzohej prej saj dhe të provonte

fatin me ndonjë tjetër, por papa Klementi VII ia refuzoi shkurorëzimin. Në atë kohë Henriku ishte një katolik i zjarrtë, të paktën në publik dhe papa e kishte nderuar me titullin e Mbrojtësit të Besimit Katolik. Të bën të qeshësh që po ky titull, i dhënë nga një papë katolik, u jepet akoma sot e kësaj dite sovranëve britanikë si mbrojtës të besimit protestant! Është një gjë me të vërtetë qesharake! Henriku, duke qenë mjaft i acaruar nga refuzimi i papës për t`i dhënë shkurorëzimin, i dha urdhër parlamentit të krijonte një Kishë të Anglisë të pavarur nga Roma. Me Aktin e Epërsisë së Plotë të vitit 1534 u vetemërua kryetar i Kishës së Re dhe shpërtheu një përndjekje të përgjakshme kundër katolikëve. Henrikut ia zuri vendin i biri i tij i vetëm, Eduardi, por, pas vdekjes së këtij, në moshën pesëmbëdhjetë vjeç, u ngjit në fron e bija e Henrikut, Maria. Ajo ishte një përkrahëse e hekurt e katoliçizmit dhe fitoi epitetin "Maria gjakatarja", për përndjekjen e saj ndaj protestantëve. Maria e kishte siguruar fronin duke dënuar me vdekje rivalen e saj, Ledi Zhanë Grejin, "mbretëresha për gjashtë ditë". Por, pas vdekjes së Maries, filloi mbretërimi legjendar i Elisabetës së parë, e bija e Henrikut dhe e Ana Bolenës. Pasi kishte ekzekutuar rivalen Marie, mbretëreshë e skocezëve dhe pjesëtare e familjes së Stjuartëve, Elisabeta iu përvesh punës për rimëkëmbjen e Kishës së Anglisë, kryetare supreme e së cilës u bë ajo vetë. Urdhëroi një spastrim të katolikëve, që e bëri të fitonte epitetin "Elisabeta gjakatarja". E bukur familje!

Pikërisht në këtë kontekst, Frensis Bekoni u shqua si një zotërues i lartë i dijeve të fshehta, gjatë mbretërimit të nënës së tij të supozuar Elisabetës I dhe të pasardhësit të saj Xhejmsit I, mbretit skocez që, në vitin 1603, bashkoi monarkinë angleze me atë skoceze. Ishte Bekoni, bashkë me Robert Flojdin, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit, ai që drejtoi përkthimin e Biblës së mbretit Xhejms, një libër që, sipas një studimi të vitit 1881, përmban të paktën 36.191 gabime përkthimi. Duke qenë se Bekoni ishte një njeri jashtëzakonisht i kulturuar dhe inteligjent, sikurse dëshmojnë qartë dramat e tij, një përkthim aq i ngatërruar i *Biblës* mund të jetë bërë vetëm me dashje. Bekoni hoqi nga versioni i tij edhe të dy *Librat e Makabeit* që, pa shihni, vërsuleshin kundër shoqërisë së fshehtë të Nazarenëve, një degëzim i Vëllazërisë, që ekzistonte në kohën e personazhit mitik të Jezusit. Bekoni është quajtur edhe "babai" i shkencës moderne – shkencës, sipas së cilës kjo botë është gjithçka që ekziston – që është e përqëndruar vetëm në nivelin fizik të ekzistencës. Përse Bekoni mbështeste këtë version të "shkencës", kur në realitet ishte një anëtar i lartë i sekteve të fshehta dhe e njihte të vërtetën? Ka diçka që nuk të bindë në të gjithë këtë, veçanërisht nëse mendohet që edhe të tjerë "baballarë" të shkencës moderne, si Isak Njutoni e Robert Bojli, ishin anëtarë të lartë, në cilësinë e

Mjeshtrit të Madh të Manastirit të Sionit. Bekoni, njëri prej anëtarëve kryesorë të shoqërive të fshehta, rezulton pra i përfshirë, përmes Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve dhe rrjeteve të tjera, në përçarjen e Kishës së Krishterë, në përpilimin e *Biblës* dhe në krijimin e "shkencës" moderne, e cila ka vënë në diskutim shumë prej tezave themelore të krishtërimit. Ai i shtynte në përleshje të dy rreshtimet e kundërta për të krijuar një klimë, në të cilën një tjetër urdhër, i fshehtë, Urdhër i Ditës, të mund ta kishte më mirë. Ka ndodhur me siguri në këtë periudhë që u zhvillua sistemi klasik i kontrollit "përça e sundo". E tërë Evropa ishte shqyer e bërë copa-copa nga luftërat ndërmjet protestantëve dhe katolikëve, ndërsa, në të njëjtën kohë, që të dyja ato besime viheshin në diskutim nga dogma "shkencore", që asakohe po lindte.

Gjithmonë nën ndikimin e Bekonit dhe të magjistarëve të tjerë ekzoterikë si Xhon Di e Sër Frensis Ualsinghami, u bë i mundur krijimi i shërbimeve të fshehta në të gjithë Evropën, të njohura sot me emrin *British Intelligence*. Shërbimet e fshehta britanike u themeluan nga familjet zvarranike të Vëllazërisë Babilonase dhe u dhanë pastaj jetë shërbimeve të fshehta amerikane dhe organizatave të ngjashme, akoma sot e kësaj dite ekzistuese, në të gjithë Perandorinë Britanike, që asokohe ishte duke u zgjeruar. CIA është krijuar nga anëtarë të elitës së shërbimeve të fshehta britanike gjatë presidencës së masonit të gradës së 33-të, Herri S. Trumanit, njeriu që urdhëroi zyrtarisht të hidheshin bombat mbi Japoninë. Për këtë qe këshilluar nga Bill Donovani, kreu i organizatës paraardhëse të CIA-s, Zyrës së Shërbimeve Strategjike (OSS), që, sipas një ish agjenti sekret të shërbimeve detare amerikane me emrin Bill Koper, ishte e përbërë tërësisht nga Kalorës Tempullarë. Ualsinghami qe dërguar si ambasador në Francë për të zgjeruar organizimin e shërbimeve të fshehta, dhe nuk jam çuditur aspak kur një agjent i shërbimeve të fshehta franceze më ka zbuluar se shërbimet e fshehta britanike dhe ato franceze janë në realitet e njëjta organizatë. Kjo e bën shumë më të lehtë varrosjen e vrasjes së princeshës Dajana. Shërbimet e fshehta botërore, në nivel krerësh, janë shoqëri të fshehta kushtuar magjisë së zezë, që veprojnë për realizimin e të njëjtit Urdhër të Ditës: kontrollin global. Xhon Di ishte astrolog i oborrit, Mjeshtër i Madh i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve, magjistar dhe agjent i fshehtë i shërbimeve të reja të fshehta. Duket se kishte arritur të siguronte në një farë mënyre një kopje të *Librit të Enoch*-ut dhe se kishte saktësuar, bashkë me magjistarin Eduard Keli, një gjuhë të shkruar të quajtur "shkrim i shifruar enokian", mbi bazën e komunikimeve me engjëjt, domethënë zvarranikët. Xhon Di e nënshkroi përmbledhjen e tij me kodin 007, pikërisht ashtu si Xhejms Bondi, personazhi i historive të shkruara në

shekullin XX nga Jan Flemingu, mik i shtriganit Aleister Krouli, përveçse agjent i po atyre shërbimeve të fshehta. Xhon Di udhëtoi në të gjithë Evropën duke manipuluar, duke mbledhur informacione e duke korruptuar organizatat e ndryshme. Njëra prej çerdheve të tija ishte Bohemia, ku ishte shumë i lidhur me perandorin Rudolfi II, një tjetër i apasionuar i okultizmit, që i përkiste dinastisë zvarranike të Habsburgëve[12]. Xhon Di ka qenë ndërmjet zërave me ndikim që orkestruan atë politikë ekspansionizmi britanik, e cila çoi pastaj në themelimin e perandorisë. Teksa ndodhej në Pragë, Xhon Di i dorëzoi perandorit Rudolf një dorëshkrim të ilustruar, të shkruar me kod, që ia atribuoi Roxher Bekonit (Roxher, jo Frensis), murgut françeskan, i cili në shekullin XIII kishte tronditur autoritetet kishtare me pikëpamjet dhe me idetë e tij. Ai, midis të tjerash, kishte formuluar parashikime mbi mikroskopin, mbi teleskopin, mbi automobilin, mbi nëndetësen e mbi aeroplanin dhe kishte shprehur bindjen se Toka ishte e rrumbullakët dhe jo e sheshtë. Në vitin 1912 ky dorëshkrim ishte blerë nga një librar amerikan me emrin Vilfred Vojnish dhe u bë i njohur me emrin Dorëshkrimi Vojnish. Kur ky librar u dërgoi kopje të tij ekspertëve të kohës, ata iu përgjigjën se pjesa më e madhe e qindra bimëve të ilustruara në atë libër nuk rriteshin në këtë planet. Disa ilustrime kishin pamjen e indeve të parë me anë të mikroskopit, ndërsa të tjera paraqisnin sisteme yjore dhe yjësi të ndryshme. Deshifruesit më të mirë të kodeve në dispozicion të shërbimeve të fshehta amerikane, qoftë gjatë Luftës së Parë, qoftë gjatë Luftës së Dytë Botërore, u përpoqën të deshifronin atë që e quajtën "dorëshkrimi më misterioz i botës", por askush prej tyre nuk ia arriti kurrë. Në vitin 1921 Uiliam Roman Njuboldi, profesor në *University of Pennsylvania*, deklaroi se kishte deshifruar një pjesë që e transkriptoi:

"Në një pasqyrë konkave, pashë një yll në formë kërmilli ndërmjet kërthizës së Pegasit, bustit të Andromedës dhe kokës së Kasiopeas"[13].

Ajo që është përshkruar në dorëshkrimin e blerë prej doktor Xhon Disë është pranuar sot si e saktë dhe, edhe ilustrimi i mjegullnajës së Andromedës, që përmbahet në të, është i saktë, por ajo është paraqitur sipas një këndi marrjeje, i cili nuk mund të vlerësohet që nga Toka! Ky dorëshkrim është vetëm një shembull i nivelit të dijeve që kanë qenë në zotërim të Vëllazërisë qindra vjet më parë, teksa krahu tjetër, besimet fetare, i mbanin masat në padijen më të thellë. Në këtë rreth të drejtuar prej Xhon Disë e Frensis Bekonit bënin pjesë të gjithë përsonazhet më të spikatur të shoqërisë elisabetiane, përfshirë Sër Uolter Relajgun. Frensis Bekoni u kumtoi disa prej dijeve të

fshehta "atyre që kanë veshë" përmes kodesh e simbolesh të futura nëpër dramat, të cilat, natyrisht, i atribuohen Shekspirit. Ashtu sikurse autorët e Testamentit të Vjetër e të Ri dhe të legjendave të ciklit të Gralit të Shenjtë, edhe ai ishte një zotërues i madh i mistereve të fshehta, që i kumtonte përmes kodesh dhe referimesh okulte. Nëpërmjet një sërë kodesh, Bekoni zbuloi pastaj se ishte autori i vërtetë i atyre veprave. Numri i tij ekzoterik ishte 33-shi dhe, në njërën prej faqeve të para të dramës së "Shekspirit" *Henriku IV*, emri "Frensis" shfaqet 33 herë. Bekoni përdori edhe filigrana mbi letër, për të përçuar simbolet e tij, siç bënin trëndafilkryqëtarët dhe shoqëritë e fshehta në përgjithësi. Midis këtyre simboleve figuronin trëndafili e kryqi dhe vilet e rrushit - vreshti, domethënë familjet e ndryshme[14]. Në kodet e tij Bekoni përdori edhe simbolizmin e tarokëve (*letrave të një loje bixhozi me origjinë të lashtë*), përfshirë numrat 21, 56 dhe 78, që në tufën e tarokëve i referohen mosmarrëveshjes, përçarjes, grindjes[15]. Në botimin e veprave shekspiriane të vitit 1623, emri i pagëzimit i Bekonit shfaqet 21 herë në faqen 56[16]. Shprehja *Rota Mundi* shfaqet rregullisht në manifestet e para të Vëllazërisë së Trëndafilkryqëtarëve. Nëse bëni anagramin e fjalës "Rota", do të fitoni fjalën Taro, që është emri i lashtë i tarokëve[17]. Shekspiri është i njohur si Bard. Bardi ishte një druid që zotëronte dije të fshehta dhe, sipas fjalorit *Oxford Concise Dictionary*, "bard"-i është edhe... "një fetë *baconi* (pançetë, sallo derri), me të cilën bëhet mishi, apo gjahu i egër, para se të piqet". Mos ai donte të tallej me ne? I famshmi Globe Theatre në Londër, ku u shfaqën dramat e tij, ishte ndërtuar sipas parimeve të gjeometrisë së shenjtë dhe vepra e fundit e Shekspirit (Bekonit), *Stuhia*, paraqet shumë referime ndaj doktrinës së trëndafilkryqëtarëve[18].

Ideja që dramat më të famshme të botës të jenë shkruar nga një i pa ditur i Stratford-upon-Avonit me emrin Uilliam Shekspir është sigurisht qesharake dhe, sikurse shumë të "vërteta" të pranuara, nuk qëndron dot përballë një studimi të thelluar. Shekspiri, "Bardi", u rrit në Stratford, një fshat në të cilin nuk ekzistonte ndonjë shkollë, e cila të ishte në gjendje t`i jepte një përgatitje aq të përparuar, si ajo që tregojnë veprat e tij. Prindërit e tij ishin analfabetë dhe ai tregoi një mosinteresim të plotë për studimin. E, megjithatë, dramat e tij qenë shkruar nga dikush që kishte një njohje të madhe të botës, e cila mund të rridhte vetëm nga leximi i librave të ndryshëm dhe nga përvoja udhëtimesh personale e të panumërta. Shekspiri nuk zotëronte një bibliotekë të tillë, as nuk do të kishte mundur ta përdorte, në rast se do ta kishte, dhe nuk rezulton që të ketë bërë kurrë udhëtime jashtë vendit. Bekoni, përkundrazi, zotëronte një bibliotekë të asaj përmase dhe vizitoi shumë prej atyre vendeve,

që paraqiten në ato drama. Ku e fitoi Shekspiri njohjen e tij të frëngjishtes, të italishtes, të spanjishtes, të danishtes, të latinishtes dhe të greqishtes klasike? Përgjigjja është se nuk e fitoi aspak. Ben Xhonsoni, mik i ngushtë i Shekspirit, kā deklaruar se "Bardi" kuptonte "pak latinisht dhe akoma më pak greqisht!"[19]. Por Bekoni ishte i fortë në këto gjuhë. Dihet që e bija e Shekspirit, Xhuditi, ishte analfabete dhe në moshën njëzet e shtatë vjeçe nuk dinte ende të shkruante emrin e vet[20]. Nuk ka kuptim të mendosh se, një njeri që shkruante aq mirë, të mund të kishte një vajzë, e cila nuk ishte në gjendje të bënte nënshkrimin e saj. Ekzistojnë vetëm gjashtë ekzemplarë të njohur të shkrimit të Shekspirit, të gjithë nënshkrime, tre prej të cilave janë mbi testamentin e tij. Ato tregojnë një mosafërsi me shkrimin dhe me një dorë sipas gjasës të drejtuar nga dikush tjetër. Në testament janë përmendur shtrati i tij i dytë më i mirë dhe një tas i madh i veshur me argjend, por asgjë tjetër që të të bëjë të mendosh se ai ka shkruar, apo ka zotëruar ndonjë vepër të vetme letrare[21]! As nuk ekziston ndonjë portret i vërtetë i Shekspirit. Ndryshimet në paraqitjet figurative, që na kanë lënë për të artistë të ndryshëm, vërtetojnë se askush nuk e kishte idenë se cila ishte pamja e tij e vërtetë. Megjithatë, forca e kushtëzimit dhe e pranimit të qëndrimeve zyrtare tërheq në Stratford miliona njerëz të ardhur nga e gjithë bota, të dëshiruar për të parë shtëpinë e njeriut që *nuk* i shkroi ato drama! Ky është vetëm një shembull i vogël se si përralla zyrtare e quajtur "histori" përdoret për të kontrolluar sjelljen dhe perceptimin e njerëzve. Çfarë tjetër nuk është e vërtetë prej asaj që është përshkruar nga historia? Pak a shumë gjithçka. Prapa dramave shekspiriane fshihet dora okulte, që qëndron prapa pjesës më të madhe të ngjarjeve historike më të rëndësishme: rrjeti i Vëllazërisë. Dhe asgjë nuk e përmbledh më mirë qëndrimin e këtij grupi se sa fjalët që Bekoni i vuri në gojën e shtrigave në tragjedinë e tij *Makbethi*: "E mira është e keqe dhe e keqja është e mirë". Ja çfarë ka shkruar Menli P. Hill, historiani i Masonerisë, në lidhje me Bekonin:

"Ai ishte një trëndafilkryqëtar. Nëse nuk ishte Mendjendrituri At C.R.C., të cilit i referohen në manifestet e trëndafilkryqëtarëve, me siguri ishte një anëtar i lartë i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve... Kush prej vitesh lufton me entuziazëm për të vërtetuar tezën, sipas së cilës Frensis Bakoni ishte "Bardi i Avonit" i vërtetë, mund t`ia dilte mbanë nëse do të përqëndrohej mbi aspektin më të rëndësishëm, domethënë, mbi faktin që Sër Frensis Bekoni, anëtar trëndafilkryqëtar, futi brenda dramave shekspiriane mësimet e fshehta të Vëllazërisë së Trëndafilkryqëtarëve dhe ritet e vërteta të Urdhërit të Masonerisë, themelues i vërtetë i të cilit ai edhe mund të rezultojë"[22].

Ritet dhe simbolet e Urdhërit të Masonëve mund të zënë fill që në Egjiptin e lashtë e akoma më përpara. Në të vërtetë, njohuritë që Bekoni kishte për gjeometrinë e shenjtë, për numrat dhe për formën, i përket një periudhe përpara përmbytjes së fundit. Artizanët dhe Arkitektët e Dionisit, zotëruesve të Mistereve të Baku-Dionisit (Diellit), roli i të cilëve ishte ai i projektimit të ndërtesave dhe monumenteve publike, i përkasin një periudhe të paktën tremijë vjet më parë, në mos edhe më herët[23]. Qenë këta arkitektë-anëtarë të urdhërit ata që projektuan pallatet e mëdha të Kostandinopolit, Rodit, Athinës e Romës dhe qe po ky grup njerëzish që ndërtoi në Hefes tempullin për nder të perëndeshës Diana[24], i cili kujtohet si njëra prej mrekullive të lashtësisë. Arkitektët e Dionisit ishin të lidhur me një shoqëri të fshehtë të quajtur Shoqërai e Jonikëve (prej këtej rrodhi emri i ishullit Jona, në Skoci), që duket se porositi ndërtimin e Tempullit të Dianës. Nën emra të tjerë, Arkitektët e Dionisit dhe anëtarët e shkollës misterike të Frater Solomonis-it ndërtuan edhe katedrale të mëdha të krishtera, të financuara nga Kalorësit Tempullarë. Shumë emblema trëndafilkryqëtare dhe masonike mund të shiheshin të gdhendura në katedralen Notrë Damë të Parisit, sikurse gjithashtu edhe paraqitje figurative të panumërta kompasësh, skuadrash dhe veglash prej muratori, para se të shkatërroheshin nga Revolucioni Francez[25]. Arkitektët e Baku-Dionisit, të ndarë në bashkësi të kryesuara nga Mjeshtra e Mbrojtësa, pikërisht si tek masoneria bashkëkohore, u vendosën në Izrael ku, sipas disa studiuesve, patën kontakte me esenët, sektin egjiptian që krijoi *Rrotullat e Detit të Vdekur*[26]. Baku-Dionisi (dy emra për të njëjtën perëndi) ishte një hyjni diellore, që thuhej se kishte lindur nga një virgjëreshë më 25 dhjetor. Themelimi i legjendës dhe i "historisë" masone bazohet mbi ndërtesën simbolike të Tempullit të mbretit Solomon në Jeruzalem. Heroi mason është Hiram Abifi, i "biri i vejushës", sipas legjendës. Gjendemi përpara simboleve të mëtejshme. Në Egjipt Horusi (Tamuzi) ishte i biri i vejushës, Isidës.

Krijimi i Masonerisë në shekujt e XVI dhe XVII bashkoi shumë prej temave, planeve dhe organizatave të ndryshme, që deri tani kanë shkuar duke u përvijuar. Bashkoi trëndafilkryqëtarët dhe tempullarët e Anglisë, si Bekoni, me historinë e tempullarëve pas arritjes së tyre nga Franca në kohën e Filipit të Bukur dhe me kthimin e tyre të mëpasshëm në Francë, si Garda Skoceze. Lidhi edhe këtë grup me Manastirin e Sionit. Personazhi që mishëroi këto lidhje të ndryshme ishte Xhejmsi VI i Skocisë, që zëvendësoi Elisabetën I dhe u bë Xhejmsi I i Anglisë dhe i Skocisë. Ky ishte biri i vetëm i Maries, mbretëreshës së Skocisë. Dinastia e Stjuartëve, me lidhjet e saj me Merovingët zvarranikë, ndodhej tashmë si mbi fronin anglez edhe mbi atë skocez. Nën

mbrojtjen e Xhejmsit, doktrina e tempullarëve dhe e skocezëve, bashkë me doktrinat trëndafilkryqëtare të Frensis Bekonit dhe të të tjerëve, mundën të shkrihen e të bëhen një gjë e vetme me emrin Masoneri. Të njëjtën gjë mundi të bënte edhe familja zvarranike e Lorenëve, një tjetër familje e lidhur me mbretin Xhejms. Kështu që ky kishte kontroll të plotë të situatës. Për këtë dhe për të tjera arsye "Xhejmsi" dhe "shën Xhejmsi" përdoren në titujt e kompanive, të organizatave dhe të selive të Vëllazërisë. Ambasadori amerikan në Londër njihet si Ambasador i Oborrit të Shën Xhejmsit. Pranë dhomave të Parlamentit në Londër ndodhet St. James Square, ku kanë seli Partia Konservatore dhe sindikata më e madhe britanike, Bashkimi i Transporteve; këtu gjendet edhe një ndërtesë në pronësi të një familjeje zvarranike, familjes së Kesuiksve (tek e cila do të kthehemi më pas), dhe në qendër ngrihet një kishë madhështore me plan rrethor kushtuar Shën Gjonit (Nimrodit).

Një prej masave të para të marra nga Xhejmsi I, pas kurorëzimit të tij mbret i Anglisë dhe i Skocisë, ishte dhënia e titullit të kalorësit Bekonit; më pas do ta emëronte zëvendësprokuror të përgjithshëm, prokuror të përgjithshëm, Lord Vulëmbajtës dhe, në vitin 1618, Lord Kancelar e baron të Verulamit. Më pas, Bekoni u akuzua për korrupsion dhe u tërhoq nga jeta publike. Në vitet e para të mbretërimit të Jakomit I, u krijuan kushtet ideale për t'i bërë që të qarkullonin dijet e mbajtura fshehur në lashtësi dhe kjo mund ta kishte justifikuar interesin e Jakomit dhe Bekonit për ekzoterizmin. Por gjendemi përballë të satës kontradiktë. Ajo që ndodhi në fakt ishte e kundërta. Jakomi ngarkoi Bekonin të merrej me botimin e "Biblës së mbretit Jakom" dhe nisi një fushatë të ashpër dënimi të "shtrigave dhe të magjistarëve" – të atyre që përdornin e përhapnin dijet ekzoterike midis masave. Përveç kësaj, i dha udhë një përndjekjeje të vërtetë kundër tyre, duke vrarë me mijëra, dhe shkroi deri madje një libër, në të cilin shpjegonte se si mund të identifikoheshin këta njerëz dhe se si duhej të trajtoheshin. Përse ta bësh të gjithë këtë nëse, siç është deklaruar, objektivi i sekteve të fshehta ishte që t'i mbronin dhe më pas t'i përhapnin këto informacione? Sepse ky nuk ka qenë kurrë objektivi i tyre i vërtetë. Është me leverdi t'i bësh të besojnë njerëzit, për të cilët ke nevojë, se ky është objektivi yt dhe pastaj, kur arrin në pikën vendimtare, u kthen shpinën. Krerët e grupeve që kam zbuluar gjer këtu nuk duan t'i bëjnë të qarkullojnë ato dije, duan t'i grumbullojnë ato dhe t'i përdorin për të shtënë në dorë pushtetin në shkallë globale. Nëse duhet të jem i sinqertë, më ka ardhur në majë të hundës së dëgjuari se masonët, tempullarët, trëndafilkryqëtarët, Bekoni e të tjerët i kanë mbrojtur ato dije, kur, sa herë që është paraqitur rasti për t'i bërë publike,

LIBRI 24

edhe në kohët tona, ajo mundësi është shpërfillur. Janë të gjitha dokërra. Ata krerë e dinë se monopoli i dijes do të thotë pushtet, kështu që gjëja e fundit që dëshirojnë është një popullsi e informuar. Në të gjithë Evropën, magjistarët dhe shtrigat, me fjalë të tjera sensitivët dhe mediumet, u dogjën të gjallë, u mbytën, u burgosën dhe u torturuan, me urdhër të njerëzve si Xhejmsi dhe Martin Luteri. E, megjithatë, këta të fundit ishin anëtarë të urdhërave që shfrytëzonin të njëjtat dije e që përhapnin edhe "magjistarët e shtrigat". Në të dyja rastet bëhej fjalë, dhe bëhet akoma, për lëvizje ekzoterike të fshehta. Njëri grup i përhapte në fshehtësi këto dije midis popullsisë, përmes mitit dhe legjendës, për të shmangur zemërimin e *establishment*-it fetar e politik; grupi tjetër, lëvizja e Vëllazërisë Babilonase, i përdorte po ato dije për të manipuluar dhe kontrolluar *establishment*-in politik e fetar. Kështu lëvizja e fshehtë popullore ka qenë sulmuar e përndjekur, dhe është ende, në mënyrë të vazhdueshme nga lëvizja e fshehtë e Vëllazërisë. Rreth 250.000 njerëz u vranë të akuzuar se ishin "magjistarë e shtriga", prej të cilëve 30.000 vetëm në ishujt britanikë[27].

Lëvizja masone duhej të bëhej një farë pike takimi dhe koordinimi të elementëve të ndryshëm të rrjetit të Vëllazërisë. U. Uejn Uestkoti, themeluesi i Urdhërit hermetik (satanik) të Agimit të Artë, ishte në dijeni të prapaskenave të Urdhërit të Masonëve, falë lidhjeve të tij me lëvizjet e fshehta ekzoterike. Në librin e tij *The Magical Mason* ka shkruar se masonët rridhnin nga esenët, nga hebrejtë farisej (levitët), nga shkollat misterike egjiptiane e greke, nga *Vehm-Gerichte*-t e Vestfalisë, nga Gjermania, nga *Collegia*-t romake, nga *Compagnos*-at franceze dhe nga trëndafilkryqëtarët[28]. Sipas historisë zyrtare (dhe të pasaktë) Masoneria lindi prej lozhave të muratorëve, të cilët punonin në kishat dhe në katedralet e mëdha, domethënë prej artizanëve që ishin në zotërim të nocioneve të gjeometrisë së shenjtë. Që nga koha kur u ndërtuan katedralet gotike, ata gëzuan të drejtën e një afërsie të ngushtë me Kalorësit Tempullarë. Në kohën e Henrikut VIII fama e tyre ishte tashmë në rënie. Larg idesë për të urdhëruar ndërtimin e katedraleve të reja, Henriku iu përvesh punës për të plaçkitur manastiret, vëllazëritë dhe shoqëritë huadhënëse, në mënyrë që të mblidhte paratë, për të cilat kishte aq shumë nevojë. Për të mbijetuar, vëllazëritë masone filluan t'u hapnin dyert e tyre jomasonëve, anëtarëve të klasave profesionale, afaristëve, tregtarëve, pronarëve të tokave dhe aristokratëve. Bëhej fjalë tani për një "*free*masonry" (Framasoneri, por, etimologjikisht, "masoneria e lirë") dhe, natyrisht, duke iu përmbajtur asaj që na është bërë e ditur, të ardhurit e rinj nuk vonuan të merrnin në dorë kontrollin e situatës. Ajo që ndodhi, në realitet, ishte se lëvizja

e fshehtë e Tempullarë-Trëndafilkryqëtarë-Vëllazëri Babilonasve krijoi strukturën e vet të bazuar në shkallët e ndryshme të njohjes, përmes të cilave dijet e fshehta u kalohen pak të zgjedhurve dhe i bilokohen publikut. Lëvizja e vëllazërive masonike është vetëm një mbulesë, për të fshehur këtë.

Masoneria lindi në Skoci midis familjeve tashmë të njohura të Vëllazërisë, ndërmjet të cilave figuron familja e zvarranikëve Shën Kler-Sinkler. Ata banonin në Roslin, ose Roslin Kastle, paksa në jug të Edinburgut, në një rajon ku traditat tempullare ishin mjaft të rrënjosura. Si të gjitha familjet që u përkisnin këtyre fiseve, edhe kjo ndërronte periodikisht emrin, për të fshehur më mirë prejardhjen e vet. Kjo linjë dinastie u bë e njohur si Shën Kler në periudhën kur u vendos në Normandi, para se të kapërcente Kanalin e La Manshit me Uilliam Pushtuesin, për të zhvilluar betejën e Hastingsit në vitin 1066, dhe të bëhej kështu familja e Sinklerëve skocezë. Pesë prej nëntë Shën Klerëve që morën pjesë në betejë ishin kushërinj të parë të Uilliamit dhe njëri prej tyre u vendos në Skoci, ku themeloi dinastinë skoceze[29]. Duket se familja ka vendosur të quhet Shën Kler për nder të një heremiti martir me emrin Kler, ose të paktën kështu thotë versioni zyrtar[30]. Ata rridhnin prej vikingëve të zbritur nga Skandinavia për të pushtuar atë që e quajtën Normandi, por origjina e tyre e vërtetë zë fill tek racat e bardha dhe tek ariano-zvarranikët, që dolën nga Lindja e Afërt e nga Kaukazi. Në vitin 1446 qenë hedhur themelet e Kishës së Roslinit, e përfunduar në vitet tetëdhjetë të 1400-ës. Ajo paraqet simbole të panumërta ekzoterike e masonike (këto të fundit më vonë) dhe për Vëllazërinë është si një faltore. Sinklerët kishin shtrirë lidhje me lëvizjet e fshehta franceze, në Lorenë e në Guis, dhe me Skandinavinë, me Danimarkën e me Venecian, asokohe qendër financiare e Vëllazërisë. Ishin pjesë, domethënë, me të gjitha efektet e rrjetit të zvarranikëve. Një Sinkler u ankorua në Amerikën e Veriut bashkë me një anëtar venecian të Fisnikërisë së Zezë me emrin Nikolo Xeno, një shekull më parë në krahasim me misionin zyrtar të Kristofor Kolombit. Njëri prej simboleve të Kishës së Roslinit është perëndia pagane e bimësisë, i quajtur edhe "Njeriu i Gjelbër". Tim Uelsh Mërfi ka shkruar në historinë e tij zyrtare të Kishës së Roslinit se Njeriu i Gjelbër mund të identifikohej me Tamuzin, perëndinë babilonase që vdes e ringjallet dhe që mishëron shumë karakteristika të Nimrodit. Tamuzi, apo e njëjta perëndi me emra të tjerë, paraqitej shpesh figurativisht me fytyrën të gjelbër. Një shembull i kësaj është Osiridi, burri-vëlla i Isidës. Historia e Robin Hudit, me veshjen e tij "të gjelbër Linkoln", mori pikënisje nga kjo perëndi e Njeriut të Gjelbër. Në legjendën origjinale, Robin Hudi ishte fillimisht një farë "çamarroku", i njohur edhe me emrat Robin Grin, Robin i Grinvudit

dhe Robin Gudfellou[31]. Homologu i tij shekspirian (bekonian), xhindi Puk, tek *Ëndërr e një nate vere*, kryesonte ritet e pjellorisë me rastin e solsticit të verës. Ditën e parë të majit, Ditën e Verës, mbaheshin ceremonitë e "pemës së majit". Pema e majit është një simbol falik (i Priapit) kushtuar perëndeshës së seksualitetit dhe të pjellorisë dhe atë ditë, në çdo fshat, një virgjëreshë emërohej Mbretëreshë e Majit (mbretëresha Semiramidë). Shumë prej tyre përfundonin në pyllin e gjelbër, për t`iu nënshtruar një riti të hyrjes në të fshehtat e seksit nga ana e një të riu, që mishëronte rolin e Robin Hudit, apo të Robin Gudfellout. Fëmijëve, që shpesh lindnin nëntë muaj më pas, u jepeshin emra sot të zakonshëm, si Robinson (i biri i Robinit) dhe Robertson[32]. Historia e Robin Hudit ka qenë një tjetër tregim simbolik, me qëllimin për të ruajtur kujtimin e riteve seksuale pagane midis atyre përfaqësuesve prapanikë të ortodoksisë së krishterë. Një komedi me titullin *Robin Hudi dhe Litëll Xhoni* shfaqej në maj dhe në qershor të çdo viti në Roslin nga ciganë dhe aktorë të tjerë nomadë[33]. Sër Uiliam Sinkleri u bë, të paktën një herë, mbrojtës i ciganëve, kur në Skoci u miratua një ligj, që parashikonte zhdukjen e tyre. Ciganët ishin me prejardhje prej Egjiptit dhe i kalonin dijet e tyre nga vendi në vend e nga brezi në brez. Ja përse janë ndjekur e përndjekur aq shumë, derisa pjesa më e madhe e dijeve të tyre janë zhdukur.

Riti më i përhapur i masonerisë botërore përfaqësohet nga 33 shkallët e Ritit Skocez. Ai e mori emrin nga ai rajon i vogël në veri të Britanisë së Madhe siç është Skocia, pasi pikërisht aty ishin vendosur shumë familje të lashta dhe që ishin mbërritur pastaj nga tempullarët në kohën e Filipit të Bukur. Tani tempullarët ishin kthyer publikisht në skenë me një tjetër emër: Masoneri. Rryma tjetër kryesore e "koorporatës" u përfaqësua nga Riti i Jorkut, nga i cili mori emrin Nju Jork, që është akoma sot qendra e masonerisë amerikane. Disa studiues mendojnë se Urdhëri i Manastirit të Sionit ia mori me forcë kontrollin e Ritit Skocez dhe atë të Jorkut tempullarëve, që më pas kaluan përsëri kanalin e La Manshit, për të themeluar Masonerinë Franceze. Kjo mund të jetë e vërtetë, por në fund të fundit, në nivel krerësh, bëhet fjalë gjithmonë për të njëjtën organizatë. Në nivelet e Ritit të Jorkut mund të dallohet ende ndikimi i tempullarëve. Shkalla më e lartë është ajo e Kalorësit Tempullar, e ndjekur nga ajo e Kalorësit të Maltës dhe nga ajo e Kryqit të Kuq. Por shkallët zyrtare janë vetëm ato, tek të cilat është e mundur të hysh. Sipër këtyre niveleve qëndrojnë ata që unë i quaj nivele të Mendjendriturve, ekzistencën e të cilëve vetëm pak njerëz e njohin, dhe hyrja tek të cilët është jashtë çdo diskutimi. Pjesa dërrmuese e shumicës së masonëve nuk ngjiten kurrë përtej tre niveleve të para, "niveleve blu", dhe përdoren si një fasadë

respektueshmërie, prapa së cilës fshihet Urdhëri i vërtetë i Ditës, për të cilin baza nuk është në dijeni. Albert Pajku ka qenë në krye të Juridiksionit Jugor të Ritit Skocez të masonerisë amerikane të shekullit të kaluar dhe, në Amerikë, është konsideruar si një "perëndi", aq sa një statujë e tij ngrihet në Uashington DC. Në librin e tij mbi masonerinë *Morals And Dogma* (Morali dhe dogma), ai shkruan në faqen 819:

"Nivelet blu nuk janë gjë tjetër veçse oborri, apo portiku i jashtëm i një tempulli. Një pjesë e simboleve i tregohen anëtarit të atyre niveleve, por ai vihet në rrugë të rreme me dashje nga interpretime false. Nuk është parashikuar që t`i kuptojë ato simbole, por është parashikuar që të besojë se i ka kuptuar".

Për ta thënë me fjalë të tjera: "mbajini në errësirë dhe ushqejini me hajvanllëqe". Kjo është struktura klasike e shoqërive të fshehta, në të cilat vetëm nivelet më të larta e dinë atë që është duke ndodhur realisht. Të tjerëve u shitet një mit. Në mesin e shekullit XVII, lufta tridhjetëvjeçare ndërmjet besimtarëve protestantë dhe atyre katolikë e kishte shndërruar Evropën në një skenë vdekjeje e rrëmuje. Në një farë pike, lindi frika se lëvizja e re protestante mund të ishte shpartalluar dhe se mund të ishte rivendosur ligji i Romës. Britania e madhe u bë një liman i sigurtë për çështjen protestante, sidomos gjatë mbretërimit të Stjuartëve, që ironikisht nuk ishin aspak të krishterë. Por përçarja, që protestantët kishin krijuar brenda Kishës së krishterë dhe mënyra se si pushteti i Romës ia kishte dalë të riorganizohej, i përgjigjeshin dëshirave të Vëllazërisë. Ishujt britanikë u bënë qendra evropiane e mendimit ekzoterik dhe krijimi i Masonerisë i mbajti këto fije në një strukturë të vetme. Masoneria do të bëhej shpejt një mjet manipulimi ekonomik e politik, anëtarët e së cilës vepronin në nivele të ndryshme për të njëjtin qëllim. Urdhëri i Ditës i asaj periudhe parashikonte rënien e pushtetit të monarkive evropiane dhe zëvendësimin e tyre me sisteme politike të strukturuara në mënyrë të tillë që të ishin të kontrolluara nga Vëllazëria. Bëhet fjalë për të njëjtin sistem të përdorur në lashtësi nga sumerët dhe nga babilonasit dhe që konsiderohet i vlefshëm akoma sot. Në të gjithë Evropën u nxit shpërthimi i një sërë luftrash civile, të cilat çuan ose në shfuqizimin e monarkisë, ose në rënien e rolit të sovranit, i katandisur thjesht në një kukull. Gjatë luftës civile angleze të viteve 1642-1646, mbreti Karli I, i dinastisë Stjuart, përveçse mason, u mund dhe më pas u ekzekutua. Monarkia u shfuqizua për një periudhë të shkurtër dhe u zëvendësua nga një Lord Protektor, Oliver Kromuelli, edhe ai mason. Kjo mund të duket e çuditshme ose kontradiktore,

por nuk është. Urdhëri i Ditës është motivacioni parësor, në fakt i *vetmi* motivacion i Vëllazërisë. Nëse kjo kërkon zëvendësimin e një masoni dhe Stjuarti, i cili nuk respekton Urdhërin e Ditës, me një mason që e respekton, atëherë kështu u bëftë. Fundi i dinastisë së Stjuartëve nuk ishte mandej aq e rëndësishme. Elitës së Vëllazërisë dhe zvarranikëve nuk u bëhet vonë se kush e respekton Urdhërin e tyre të Ditës, gjersa është dikush që e bën. Dhe njerëzit më me ndikim midis familjeve të saj shpesh nuk përkojnë me njerëzit më të famshëm. Shpesh njerëzit më me ndikim punojnë në hije, ku qëndron pushteti i vërtetë. Stjuartët për një farë periudhe po shkonin mirë, por të gjithë mund të flijohen për çështjen. Dhe, në atë kohë, ishte e mundur të qeveriseshin vendet nëpërmjet shoqërive të fshehta të ndryshme, që përdornin burra e gra fasadë. Pushteti i një monarku të vetëm kishte marrë fund dhe ky ishte sigurisht rasti i Britanisë së Madhe, pas prerjes së kokës Karlit I. Edhe kur monarkia u rivendos me Karlin II, ky ishte një kukull e manovruar nga Vëllazëria, nga e cila merrte urdhëra në të njëjtën mënyrë siç bëri Oliver Kromuelli kur, në vitin 1655, u lejoi "hebrejve" (arianëve) të ktheheshin në Angli për herë të parë që nga koha kur ishin dëbuar nga Eduardi I në vitin 1290. Siç e kam përshkruar më parë, ishte kjo koha kur Fisnikëria e Zezë e Amsterdamit po përgatitej për të vendosur në fronin britanik njeriun e saj, Uilliam d'Oranzhin. Gjithçka është e lidhur në mënyrë të mahnitshme, sepse është e kordinuar që nga niveli më i ulët i përmasës së katërt, që mban nën kontroll përmasën tonë. Kisha e Krishterë qe ndarë në fraksione të egra e rivale nga trëndafilkryqëtari Martin Luteri dhe nga lindja e një rryme perverse e besimit protestant, e quajtur kalvinizëm dhe, më vonë, e njohur si puritanizëm. Emri i vërtetë i Zhan Kalvinit, themelues i kësaj lëvizjeje, ishte Zhan Kuin nga Nojonsi, Francë, dhe ai kishte studiuar në *College du Montagu*, i kontrolluar nga Vëllazëria.

Bëhej fjalë për të njëjtën shkollë ku kishte studiuar edhe Injacio i Lojolës, themeluesi "katolik" i Urdhërit të Jezusit, ose të Jezuitëve. Kuini u shpërngul në Paris dhe pastaj në Gjenevë, Zvicër, ku u bë i njohur me emrin Kohen. Ky emër do të thotë "prift" dhe e ka zanafillën tek shkollat misterike egjiptiane. Në Gjenevë ai, ose dikush tjetër, formuloi filozofinë që mori emrin kalvinizëm. E ndryshoi përsëri emrin e tij nga Kohen në Kalvin, për ta bërë më familjar ndaj anglezëve, që u bënë frekuentuesit kryesorë të këtij besimi të ri – i cili, megjithatë, ishte krijuar nga të njëjtët njerëz që kishin krijuar edhe besimet e tjera. Me kalvinizmin plani përfundimtar bënte një hap përpara. Kjo doktrinë bazohej rreptësisht mbi dhjetë porositë e "Moisiut" dhe mbi tekstet e Testamentit të Vjetër (natyrisht, të interpretuara në kuptimin e ngushtë të

fjalës dhe jo simbolikisht). Por kishte një pikë vendimtare. Deri atëhere feja e krishterë e kishte përjashtuar fajdenë, domethënë vënien e interesave mbi huatë. Tani, ndërsa bankierët e Fisnikërisë së Zezë po bënin çmos për të pushtuar një vend të krishtrerë si Anglia, duke përdorur aristokracinë që deklarohej e "krishterë", kishte mbërritur çasti për ta shfuqizuar atë ndalim dhe për ta shndërruar fajdenë në një praktikë të zakonshme. Për këtë arsye, kalvinizmi e mbështeti vendosjen e interesave dhe, midis subjekteve që përfituan më shumë, figuronte Zvicra, ku ai komplot ishte sajuar, pasi ajo u bë qendra botërore e sistemit bankar privat. Një tjetër rol i kalvinizmit ishte ai i mbështetjes së dënimit me djegie në turrën e druve të shtrigave, duke i hequr kështu qarkullimit publik shumë prej dijeve të shenjta. Fisnikëria e Zezë donte njeriun e saj, Uilliam d'Oranzhin, në fron, por, për të realizuar këtë plan, ishte e nevojshme të hiqte Karlin I, të cilit iu pre koka në vitin 1649. Kalvinizmi kontribuoi të nxiste në shpirtrat e njerëzve armiqësinë kundrejt monarkisë, duke i përgatitur rrugën masonit dhe kalvinistit Oliver Kromuell, i cili u shqua në luftën civile angleze, i sati konflikt i krijuar artificialisht, që pa të ndesheshin Kokat e Rrumbullakëta me Ruajalistët. Më 3 shtator 1921, një vepër e publikuar nga Lord Alfred Duglasi me titullin *Plain English*, paraqiste tekstet e disa letrave lidhur me komplotin, që çoi në vdekjen e Karlit I. Sipas atyre letrave, volume me dokumenta ishin gjetur në sinagogën e Mylhejmit nga L.A. Van Valkerti. Këto dokumente, të shkruara në gjermanisht, kishin humbur në kohërat e luftërave napoleonike. Në njërën letër të datuar më 6 qershor 1647 dhe që i dërgohej një farë Ebenezer Pratit nga Oliver Kromuelli lexohet (në përkthimin bashkëkohor):

"Në këmbim të mbështetjes financiare do të përkrah pranimin e hebrejve në Angli; ai (pranimi i hebrejve), megjithatë, do të jetë i pamundur gjersa jeton Karli. Karli nuk mund të ekzekutohet pa proces, por për këtë tani për tani nuk ekzistojnë premisat. Për këtë arsye, do të mbështes mocionin e vrasjes së Karlit, por nuk do të angazhohem në gjetjen e vrasësit; do të jem, përkundrazi, i gatshëm të bashkëpunoj për organizimin e një arratisjeje të tij".

Përgjigjja e Ebenezer Pratit datohet më 12 korrik 1647:

"Do të garantoj ndihma financiare sapo Karli të jetë hequr dhe hebrejtë të jenë pranuar. Vrasje tepër e rrezikshme. Më mirë t'i jepet Karlit mundësia të arratiset. Kapja e tij do ta bëjë atëhere të mundshme procesin dhe ekzekutimin. Mbështetja do të jetë liberale, por është e kotë të diskutojmë termat para fillimit të procesit"[34].

Këto tekste qenë aq shumë zbuluese, sa që rrjeti i Vëllazërisë bëri të mundur të arrestohej botuesi që i publikoi, Lord Alfred Duglasi, për shkak të një shkrimi denigrues e shpifës në dëm të Uinston Çurçillit, i botuar prej tij. Se si mund ta denigrosh e çnderosh një satanist si Uinston Çurçilli, është e vështirë për t'u kuptuar. Ai letërshkëmbim midis Kromuellit dhe Pratit pati një reflektim në ngjarjet reale. Më 12 nëntor 1647 Karlit I iu dha mundësia të arratisej dhe të gjente një "strofull" në ishullin Uajt, jo larg brigjeve jugore angleze, ku edhe unë ndodhem në këto momente. Ai pastaj u kap përsëri dhe, kur po dukej se ndërmjet tij e parlamentit ishte duke u arritur një marrëveshje, që do t'ia kishte kursyer jetën, Kromuelli, i cili tashmë ishte Lord Protektor, i hoqi qafe të gjithë parlamentarët, që ishin në favor të gjetjes së një marrëveshjeje. Parlamentarët e mbetur formuan atë që historia e quan *Rump Parliament*. Kromuelli atëhere shpalli një tjetër proces, pasi kishte vendosur me financuesit e tij në Amsterdam që Karli të ekzekutohej. Akuza kundër Karlit u formulua nga Isak Dorislausi, agjent në Angli i Manaseh ben Izraelit, njërit prej financuesve kryesorë hollandezë të "revolucionit" të Kromuellit[35]. Vendimi i "procesit" çoi në prerjen e kokës publikisht të Karlit, si rrjedhojë e së cilës Kromuelli u lejoi "hebrejve" të riktheheshin në Angli. Këmbëngul të nënvizoj prapë edhe një herë se nuk jemi duke folur për ca hebrej në përgjithësi, por për ca krerë financiarë të Fisnikërisë së Zezë dhe të Vëllazërisë, që e përdorin përkatësinë e tyre hebraike për ta manipuluar në mënyrë të pamëshirshme masën e atyre që e quajnë veten hebrej. Pas vdekjes së Kromuellit, që ndodhi në vitin 1661, shumë prej ndjekësve të tij kalvinisto-puritanë u drejtuan për në Amerikë, për t'i shpëtuar "përndjekjes fetare" që pasoi gjatë rivendosjes së monarkisë nën Karlin II. Ata ishin fanatikët fetarë që masakruan vendasit amerikanë nën flamurin e "Zotit". Bankierët e Fisnikërisë së Zezë të Amsterdamit provokuan në Angli një sërë krizash ekonomike, për ta dobësuar Karlin II. Më pas, në vitin 1667, Hollanda dhe Anglia lidhën një marrëveshje "paqeje", e cila parashikonte që Uilliam d'Oranzhi (Fisnikëria e Zezë) të martohej me Marien, të bijën e dukës së Jorkut. Kur në vitin 1685 vdiq Karli II, ishte duka i Jorkut ai që u bë mbret me emrin Xhejmsi II. Tani gjithçka që Vëllazëria duhej të bënte ishte ta hiqte nga froni, për t'i dhënë mundësinë njeriut të saj që të bëhej mbret. Filluan të korruptonin mbështetësit aristokratë më me ndikim të Jakomit II dhe, i pari që ra brenda, ishte Xhon Çurçilli, duka zvarranik i Marlborugut. Komisari i Llogarive Publike zbuloi se Çurçilli kishte marrë ryshfete për një shumë të përgjithshme prej 60.000 stërlinash (në ato kohëra një pasuri shumë e madhe)

nga ana e përfaqësuesve të familjeve të financës së lartë hollandeze e spanjolle, si Sër Solomon de Medina dhe Antonio Makadoja. Studiuesi Eustash Mulinsi mendon madje se shuma e përgjithshme ngjitet në 350.000 stërlina[36].

Xhon Çurçilli, dukë i Marlborugut, ishte një paraardhës i kryeministrit britanik të epokës së Luftës së Dytë Botërore, Sër Uinston Çurçillit, dhe lidhjet ndërmjet Vëllazërisë e Çurçillëve vazhdojnë akoma sot. E reja e Sër Uinstonit, Pamela, u martua me amerikanin Havarel Harriman, njëri prej manipuluesve më të mëdhenj të Vëllazërisë të këtij shekulli. Pamela Harrimani, që kishte qenë martuar më parë me të birin e Sër Uinstonit, Randolfin, fitoi shumë ndikim brenda Partisë Demokrate Amerikane dhe asaj duket se i detyrohet zgjedhja e Bill Klintonit si president i Amerikës. Si shpërblim për këtë, u dërgua si ambasadore në Paris, një qytet kyç ky për Vëllazërinë, ku vdiq në vitin 1997, në moshën 76 vjeçare. I biri i saj, që edhe ai quhet Uinston, është një anëtar i parlamentit shumë afër Rotshildëve. Para se të martohej me Havarel Harrimanin, Pamela Çurçill-Harrimani pati një lidhje me Elie de Rotshildin. Në vitin 1995, familjes Çurçill iu adresuan 12.5 milionë stërlina, të përfituara nga të ardhurat e llotos, në shkëmbim të fjalimeve drejtuar "kombit", që, Sër Uinston Çurçilli, kishte mbajtur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fjalimet u blenë me paratë publike nga National Heritage Memorial Board, i kryesuar nga... Lordi Jakob Rotshild. Por është vetëm një përkim i rastit, asgjë për t`u shqetësuar! Çurçillët dhe Harrimanët janë familje të Vëllazërisë. Njëri prej paraardhësve të Pamela Harrimanit komplotoi me familjen Persi, nga e cila rrjedh Xhorxh Bushi, për të bërë të mundur hedhjen në erë të Parlamentit, në të ashtuquajturin Komploti i Barutit, i kryesuar nga Gaji Faukes, më 5 nëntor 1605. Si anëtare e familjes Harriman, Pamela përfaqësonte krahun "demokrat" të Vëllazërisë, ndërsa Bushët, ortakë dhe partnerë me Harrimanët në afarizëm, përfaqësojnë krahun "republikan". Të dy u janë përgjigjur të njëjtit padron, për të bërë të mundur që Shtetet e Bashkuara, si çdo vend tjetër, të beheshin një shtet me një parti të vetme. Bushët janë miq të ngushtë me Uindsorët, gjë që nuk do t`i çudisë ata që i kanë lexuar ato ç`ka kam shkruar më parë, duke qenë se anëtarët e të dyja atyre familjeve janë zvarranikë në gjendje të ndryshojnë formë. Si Bushi, si ortaku i tij, manipuluesi i palodhshëm global i Vëllazërisë që mban emrin Henri Kisinger, janë emëruar kalorës nga mbretëresha Elisabetë II.

Versioni modern i Masonerisë me prejardhje të errëta u përhap me shpejtësi midis tempullarëve dhe zotëruesve të tjerë të mistereve. Lozha e Madhe e Anglisë – qendra e organizatës – u themelua zyrtarisht më 24 qershor 1717, ditën e shën Gjon Pagëzorit, festë e shenjtë për Kalorësit tempullarë

dhe referim i qartë ndaj Kalorësve të Shën Xhonit të Jeruzalemit (Maltës). Gjon Pagëzori është mbrojtësi i shenjtë si i masonëve edhe i tempullarëve, pasi në Babiloni Gjoni ishte Oanes, tjetër emër i Nimrodit. Gjashtë apo shtatë vjet më pas u krijua Lozha e Madhe Irlandeze. Pjesa më e madhe e lozhave të shkëputura, që linden brenda regjimenteve të ushtrisë britanike, qenë autorizuar nga Lozha e Madhe Irlandeze dhe jo nga ajo angleze. Klanet skoceze e futën masonerinë midis sivëllezërve të tyre francezë dhe në lidhje me këtë duhet të përmend një njeri, Andrej Majkëll Ramsejin, mësues privat i Karl Stjuartit, pretendent për fronin dhe i njohur midis popullit si Bonie Prins (Princi i Mirë). Ramseji lindi në Skoci në vitet tetëdhjetë të 1600-ës dhe rrinte shumë afër Isak Njutonit, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit. Bëri pjesë në shumë organizata të elitës, midis të cilave në një farë shoqërie trëndafilkryqëtare e quajtur Urdhëri i Filadelfianëve (nga emri i qytetit, në të cilin u orkestrua lufta amerikane për pavarësi) dhe në Urdhërin kalorsiak francez të Shën Lazarit. Shumë prej këtyre grupeve të elitës u japin anëtarëve të tyre ca emra ekzoterikë dhe emri që Vëllazëria i dha Ramsejit qe "Kalorës"[37]. Ai luajti një rol vendimtar në përhapjen e masonerisë dhe kujtohet në mënyrë të veçantë në rrethet masonike për dy versione të të njëjtit fjalim që mbajti në dhjetor 1736 dhe në mars 1737. Në atë fjalim, që u bë i njohur si Ligjërata e Ramsejit, skicohet nëpërmjet krerëve më të lartë historia e Masonerisë. Ramseji deklaroi se ajo rridhte nga shkollat misterike të lashtësisë që respektonin kultin e Dianës, Minervës dhe Isidës (Semiramidës). Tha edhe se Masoneria kishte lindur në Tokën e Shenjtë në kohën e kryqëzatave (Kalorësve Tempullarë) dhe jo midis muratorëve. Shtoi përveç kësaj se "urdhëri ynë" (i Kalorësve Tempullarë) kishte krijuar një lidhje të fortë me Kalorësit e Shën Gjonit të Jeruzalemit (Maltës) dhe se që nga ajo kohë "lozhat tona morën emrin Lozha të Shën Gjonit"[38]. Në Francë, Masoneria, me mbështetjen e fortë të Ramsejit, realizoi një shkrirje të rëndësishme me lëvizjen jakobiste dhe u bë e njohur me emrin Masoneria e *Grand Orient*-it. Ajo ka lidhje edhe në vende të tjera si Brazili dhe Portugalia. "Grand Orient" do të thotë "Lindja e Madhe" dhe ritualet e saj frymëzohen tek kulti i Zarathustrës në Persi, tek kulti i Ishtarit dhe i Tamuzit (Semiramidë e Nimrod) në Babiloni, tek kulti i Demetrës, Persefonit dhe Dionisit në Greqi, tek kulti i Afërditës dhe Adonit në Siri, tek kulti i Isidës dhe Osiridit në Egjipt dhe tek kulti i Mitras në Persi[39]. Në Francë Lindja e Madhe do të bëhej strumbullari i manipulimit dhe i koordinimit të Revolucionit Francez. Nga pikëpamja e Vëllazërisë, ky revolucion i "popullit" nuk kishte të bënte fare me lirinë, por kishte lidhje vetëm me Urdhërin e vet të Ditës dhe me realizimin e një kontrolli

global. Motoja e famshme e revolucionarëve francezë "liri, barazi, vëllazëri" është në realitet një moto masonike.

Shkenca e manipulimit

Kur pushteti i fesë filloi të mungojë, u krijua një tjetër burg mendor. E quajmë, me shumë guxim, "shkencë". Jo shkencë reale. Shkencë zyrtare, ajo sipas së cilës kjo botë është gjithçka që ekziston dhe nuk ka asnjë vazhdim të jetës pas "vdekjes". Vëllazëria duhej të gjente një alternativë për ata që më parë besonin tek një fe dhe që tani do të kishin mundur të kuptonin se vetëdija jonë është një vetëdije shumëpërmasore dhe e pafund, e mishëruar në një trup fizik për një periudhë kohe me përvojë të fortë gjatë rrugës së evoluimit; dhe se ne nuk vdesim, sepse nuk mund të vdesim. Energjia është vetëdije dhe energjia nuk mund të zhduket, por vetëm mund të shndërrohet në një shprehje tjetër të vetvetes. Kur të kuptoni se ju nuk jeni trupi juaj fizik, por vetëdija e pafund, e përjetshme, që i jep jetë atij trupi, vizioni juaj për veten tuaj dhe për fuqinë tuaj do të zgjerohet përtej mase. Çfarë ankthi do të jetë për ata që duan t'ju kontrollojnë! Kështu, nëpërmjet rrjetit të Masonerisë, u themelua *Royal Society*, prapë edhe një herë në Londër, falë një autorizimi mbretëror të nënshkruar nga Karli II në vitin 1662. Ishte shoqata e parë botërore e shkencëtarëve dhe inxhinierëve, që ndikoi në mënyrë të konsiderueshme në udhën e "shkencës". Praktikisht të gjithë anëtarët e parë të *Royal Society* ishin masonë, të cilët e dinin se rruga e ndërmarrë nga shkenca ishte e gabuar dhe e rreme. Dhe, pa dyshim, kjo është e vërtetë akoma sot. Disa emra tashmë të njohur do të rishfaqen shpejt. "Babai" i *Royal Society*, që thuhet se e frymëzoi themelimin e saj para se të "vdiste" (apo të shpërngulej), ishte Frensis Bekoni, njëri prej trëndafilkryqëtarëve më të spikatur, përveçse përkthyes i *Bibliës* dhe mjeshtër i Masonerisë. Midis shtyllave të *Royal Society* figurojnë edhe: Isak Njutoni, Mjeshtër i Madh trëndafilkryqëtar i Manastirit të Sionit, që hyri për të bërë pjesë në të në vitin 1672; Lord Mori, mason skocez; Elias Ashmoli, njëri prej anëtarëve të parë; Andrej Majkëll "Kalorës" Ramseji, një aktor i parë i Masonerisë, që u pranua në *Royal Society* pa asnjë titull shkencor. Atyre u shtohet Xhon Biromi, mason dhe anëtar i Klubit të Kabalës, i njohur edhe si Klubi i Diellit[40]. Në vitin 1984, në një shtëpi të Mançesterit u gjetën më shumë se 500 prej shkrimeve të tij, që përmbanin informacione mbi gjeometrinë dhe arkitekturën e shenjtë, përveçse mbi simbolet kabaliste, masone, alkimike dhe ekzoterike[41].

Ashmoli, një alkimist dhe trëndafilkryqëtar që kishte shumë lidhje në Gjermani, ishte mik i ngushtë i Karlit II dhe Kalorës i Urdhërit të Zharrëtierës,

i pari urdhër i "kalorësisë" i kryesuar nga monarku. Ai shkruajti një libër bashkë me Artur Dinë (i biri i doktor Xhon Disë), mjek personal i carit Ivani i Tmerrshëm. Kur Ivani vdiq, Artur Dija intrigoi me qëllim që dinastia e Romanovëve të vendosej në fronin rus[42]. Ashmoli ishte shumë i futur dhe mbajti lidhje të ngushta me "Grupin e Padukshëm", që u mblodh në Oksford duke nisur nga viti 1650. Një grup i ngjashëm ishte propozuar nga Frensis Bekoni në librin e tij *Antlatida e re*. Ky "Grup i Padukshëm" përfshinte shkencëtarin e dëgjuar Robert Bojli, një Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit, dhe Sër Kristofer Uorenin, arkitekt, emri i të cilit është i lidhur me katedralen e Shën Palit në *Sitin* londinez, qendrën financiare të Fisnikërisë së Zezë dhe të Vëllazërisë Babilonase. Që të dy ishin Mjeshtra të Mëdhenj të Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve. Ndërtimi i katedrales së Shën Palit dhe rikonstruksioni i *Sitit* londinez në përgjithësi, ishte bërë i mundur nga Zjarri i Madh, i cili në vitin 1666 shaktërroi Londrën dhe është interesant fakti se qoftë Uoreni, arkitekti që e projektoi katedralen e Shën Palit në një vend dikur kushtuar Dianës, qoftë Robert Huku, njëri prej tre të mbijetuarve të atij zjarri, ishin që të dy anëtarë të *Royal Society* dhe anëtarë të lartë të shoqërive të fshehta. Qyteti i ri i Londrës u ndërtua sipas një plani rregullues masonik, në të cilin vendosja e ndërtesave i përgjigjej rrjetës energjitike të asaj zone dhe mënyrës më të mirë që mund ta manipuloje.

Royal Society ishte – dhe është – diçka më shumë se një grup shkencëtarësh. Bëhet fjalë në themel për një shoqëri të fshehtë të kontrolluar, madje të krijuar, nga Vëllazëria, për të kufizuar përfytyrimin dhe madhësinë e dijeve shpirtërore e shkencore. Për një vërtetim të kësaj, mendoni për zotëruesit e dijeve ekzoterike, të cilët qëndrojnë prapa organizatave që nuk e pranojnë ekzoterizmin. Kjo bëhet akoma më shumë e qartë, nëse merret parasysh sfera e interesave të atij grupi zotërues dijesh ekzoterike, që i dha jetë pastaj *Royal Society*-së. Fillimisht u quajtën *Lunar Society*, pasi mblidheshin një herë në muaj, gjatë natës së hënës së plotë[43]. Midis anëtarëve të saj figuronte Benjamin Franklini, që, përveç se ishte një mason i shkallës së lartë dhe një trëndafilkryqëtar, ka qenë midis themeluesve të Shteteve të Bashkuara dhe ka pasur lidhje të ngushta me masonët që organizuan Revolucionin Francez. Do të kthehem tek ai në kapitullin e ardhshëm. Të tjerë anëtarë të *Lunar Society* ishin Erazmus Darvini, gjyshi i Çarls Darvinit, njeriu që pastaj do të ishte përdorur për të nxitur shkencën sipas së cilës "kjo-botë-është gjithçka-që-ekziston" dhe për të hedhur tezën e mbijetesës së më të mirëve nëpërmjet seleksionimit natyror. Unë mendoj se as vetë Darvini nuk e besonte, sigurisht jo në fund të jetës së tij, por ai imazh, ai mit, ka mbaruar së mbizotëruari.

Sidoqoftë, ideja se Darvini ka "zbuluar" teorinë e seleksionimit natyror dhe të mbijetesës së më të mirëve është thjesht qesharake. Gjyshi i tij, Erazmusi i *Lunar Society*-së, në vitin 1794 kishte shkruar një libër të titulluar *Zoonomia*, në të cilin kishte ekspozuar të njëjtën tezë[44]. Xhosiah Uedgvudi i perandorisë së qeramikave Uedgvud, ishte një tjetër anëtar i *Lunar Society*-së dhe e bija e tij u martua me të birin e Erazmus Darvinit, me Robert Darvinin, dhe prej tyre lindi Çarls Darvini[45]! Po nga kjo familje rrodhi edhe Tomas Maltusi, teoria e të cilit, në mënyrë të neveritshme raciste, u rimor nga Adolf Hitleri, Henri Kisingeri dhe nga një sërë e pafund njerëzish të tjerë fasadë të Vëllaërisë, për të justifikuar genocidin e racave "më të ulëta" dhe për të ruajtur pastërtinë gjenetike të gjinisë njerëzore. Bëhet fjalë, pra, për teorinë e ariano-zvarranikëve[46]. Maltusi, prift anglikan, deklaroi se për të ndaluar superpopullimin dhe për të shmangur dobësimin e racës superiore (të bardhë) ishte e nevojshme të përhapeshin sëmundjet midis masave dhe t'i detyroje të jetonin në kushte mjerimi. Ja vetëm një perlë e urtësisë së tij:

"Për drejtësi dhe nder jemi përmbajtur të mos e njohim formalisht të drejtën e të varfërve në mbajtjen me ushqim. Për këtë qëllim, do të propozoja të ndërmerrnim një dispozitë sipas së cilës asnjë fëmije... nuk duhet t'i jepet e drejta të përfitojë ndihmën e famullisë... Fëmija (i paligjshëm) *është me vlerë të pakët për shoqërinë, pasi të tjerë do të zënë menjëherë vendin e tij... Të gjithë fëmijët përtej asaj që do të kërkohej për të mbajtur popullsinë në këtë nivel, duhet domosdoshmërisht të zhduken, me përjashtim të rastit nëse për ta hapet ndonjë hapësirë si pasojë e vdekjes së të rriturve"*[47].

Ekonomisti Xhon Mejnard Kejni, parimet e të cilit kanë mbizotëruar politikën ekonomike, mendonte se Maltusi ishte një gjeni, kurse Darvini dhe rrethi i tij e vlerësonin si një kampion të logjikës[48]. Politikat e kontrollit të popullsisë të përshtatura në këtë shekull janë frymëzuar nga parimet e teorisë së genocidit të formuluara nga Maltusi. Ja ku del përsëri në dritë lidhja skoceze. Gjashtë prej anëtarëve të *Lunar Society*-së kishin studiuar në Edinburg, pikërisht ashtu sikurse edhe Çarls Darvini. Një tjetër prej zërave më autoritarë në procesin e çmontimit të "Zotit" dhe në hedhjen poshtë të idesë së një shpirti të përjetshëm ka qenë francezi Renato Kartezio, i lindur në vitin 1596 dhe i konsideruar si "babai i filozofisë moderne"[49]. Kartezioja u formua në shkollën e degës katolike të Vëllazërisë Babilonase, në shkollën e Jezuitëve. E quajti veten për gjithë jetën një katolik roman, megjithatë librat e tij ishin përfshirë në indeksin (treguesin) katolik të librave të ndaluar. Teoritë e tij do

të ishin rimarrë pastaj nga Isak Njutoni. Që të dy ishin të magjepsur prej alkimisë dhe prej ekzoterizmit. Prej këtej rezulton e qartë se e njëjta forcë që krijoi hesimet e botës së lashtë, i dha trajtë edhe "shkencës" së re. Kush e ka krijuar dhe e ka përhapur idenë e një Zoti gjykues dhe të një parajse të rezervuar vetëm për besimtarët? Pikërisht po ata njerëz që e dinin se e gjitha kjo ishte e gënjeshtërt. Kush e ka krijuar versionin materialist të "shkencës", të bazuar mbi "aksidentin kozmik", që mohon përjetësinë e shpirtit? Pikërisht po ata njerëz që e dinin se e gjitha kjo ishte e gënjeshtërt. Kjo traditë mbahet akoma sot në jetë nga lëvizja e njohur si Humanizëm. Manifesti i saj i botuar në vitin 1953, mbron idenë se universi është formuar vetë dhe nuk është krijuar; shkenca moderne ofron të vetmin version të pranueshëm të universit dhe të vlerave njerëzore; dhe vdekja shënon fundin e ekzistencës.

Ato të dyja në dukje të kundërta, siç janë feja dhe shkenca, kanë shumë gjëra të përbashkëta, por mbi të gjitha një. Që të dyja mohojnë natyrën e vërtetë të identitetit tonë dhe fuqinë që kemi përbrenda, për të kontrolluar fatin tonë. Sapo ta kuptojmë këtë dhe të kuptojmë me intuitë se kemi një fuqi të pakufishme, e cila pret të vihet në lëvizje, atëhere ja ku do të mungojë kontrolli nga ana e zvarranikëve dhe e racave të tyre. Vëllazëria Babilonase mund të marrë maska të ndryshme të shumta, por, krijimi i Masonerisë, ka dhënë një rrjet koordinimi global, duke e lehtësuar lidhjen midis këtyre mijëra "maskave". Disa prej këtyre maskave veprojnë brenda ndonjë grupi, apo zone të shoqërisë, por pjesa më e madhe, sidomos ato më të mëdhatë, si Masoneria, veprojnë nga brenda organizatave dhe grupeve, të cilat, në pamje të jashtme, duken sikur janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.Kjo i ka dhënë mundësi të njëjtës "maske" të manipulojë konflikte e luftëra dhe të kushtëzojë shkencën, politikën e fenë, në mënyrë që të nxisë Urdhërin e Ditës.

Në këtë pikë, ekzistonte një strukturë, që ishte në gjendje të hidhte fazën e mëpasshme të planit: kontrollin ariano-zvarranik mbi Afrikën, mbi Australinë, mbi Zelandën e Re dhe, gjëja më e shumëdëshiruar se të gjitha, mbi Amerikën.

LIBRI 24

Kapitulli 9

Toka e të "lirëve"

Duke iu përmbajtur asaj që na thuhet, vendi më i rëndësishëm sot në planet duket se janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por Shtetet e Bashkuara kanë qenë gjithmonë të kontrolluara nga Londra dhe vazhdojnë të jenë. Amerika nuk ka qenë kurrë toka e të "lirëve" dhe, nëse ka qenë, që atëhere kanë kaluar shekuj.

Vëmendja e botës është përqëndruar mbi Amerikën e madhe, të ndyrë, që luan rolin e të keqit në nivel botëror, ndërsa ngjarjet, përgjegjësia e të cilave është shkarkuar mbi amerikanët, janë orkestruar në Angli e gjetkë, nga Elita e Vëllazërisë Babilonase. Copëtimi në dukje i Perandorisë Britanike dhe rënia e Britanisë së Madhe si superfuqi ka penguar më tej dhe qëllimisht të shohim se ku qëndron me të vërtetë pushteti. Ngulmoj të nënvizoj se, kur flas për Londrën, nuk i referohem qeverisë britanike, që është një tjetër fasadë, pavarësisht se kush është në pushtet. Për arsye historike dhe të natyrave të tjera, qendra më e madhe operative e rrjetit të shoqërive të fshehta të Vëllazërisë zvarranike është në Londër, apo në Trojën e Re, e ndjekur nga Parisi, Brukseli dhe Roma. Prapë edhe një herë, për të kuptuar se çfarë ka ndodhur në Shtetet e Bashkuara, na duhet të shkojmë shumë prapa në kohë. Fenikasit zbarkuan këtu në lashtësi dhe objekte në dukje egjiptiane (fenikase),

ose lindore, janë gjetur në Kanionin e Madh në vitet e para të këtij shekulli, edhe pse këto lajme janë varrosur. Toponimi Phoenix (Feniks), që i atribuohet një qyteti të Luginës së Diellit, në Arizonë, shpjegohet vetëm mbi bazën e historisë së vërtetë të këtij rajoni, pavarësisht nga ajo që versioni zyrtar do të donte të na bënte të besonim. Ka prova që uellsianët, irlandezët, anglezët dhe skocezët kanë zbarkuar në Amerikën e Veriut shumë shekuj përpara Kolombit.

Historia zyrtare, sipas së cilës Kristofor Kolombi ka zbuluar Amerikën, është qesharake. Në Skoci, pak milje larg Edinburgut, sot ngrihet ende Kisha e Roslinit, faltore e Elitës së Vëllazërisë. Ajo është ndërtuar në formë kryqi tempullar nga familja Shën Kler-Sinkler dhe është një grumbullim simbolesh ekzoterike. Themelet e saj qenë hedhur në vitin 1446 dhe u përfundua në vitet tetëdhjetë të 1400-ës. Të bën përshtypje që relievet skulpturore paraqesin figura bimësh, të cilat mund të gjendeshin vetëm në Amerikë, si misri dhe kaktusi, duke qenë se Kristofor Kolombi e "zbuloi" atë kontinent vetëm në vitin 1492! Si mund të shpjegohej e gjitha kjo? Në realitet, nuk ka asnjë mister. Kristofor Kolombi nuk ka qenë njeriu i parë i bardhë që ka zbarkuar në Amerikë. Fenikasit, skandinavët, irlandezët, uellsianët, bretonët, baskët dhe portugezët, kishin udhëtuar të gjithë drejt Amerikës para tij dhe të njëjtën gjë kishte bërë edhe princi Henri Sinkler Roslin, sikurse është dokumentuar në një libër të rrallë të Frederik J. Pohlit, me titullin *Prince Henry Sinclair's Voyage To The New World 1398* (Princi Henri Sinkler dhe ekspedita e tij e vitit 1398 në Botën e Re). Sinkleri e bëri atë udhëtim bashkë me një tjetër familje të Vëllazërisë, Xenot, njëra prej familjeve më të spikatura të Fisnikërisë së Zezë veneciane. Sinkleri dhe Antonio Xenoja ankoruan në atë që sot quhet Toka e Re dhe në vitin 1398 zbarkuan në Skocinë e Re. Përshkrimet që Antonioja bën në letrat e tij për tokën që zbuluan përkojnë në mënyrë të përkryer, deri në hollësinë më të vogël, me zonën e pasur me shtresa sere (asfalti) të Kontesë Piktou, në Skocinë e Re, jo larg prej qytetit aktual të Nju Glazgout. Sinkleri vazhdoi pastaj udhëtimin e tij dhe ankoroi në Nju Englandin aktual. Në Masaçusets, në një vend të quajtur Prospekt Hill, pranë Uestfordit, 25 milje larg nga Bostoni, është gjetur në shkëmb figuara e gdhendur e një shpate dhe e një kalorësi me armaturë. T.C. Lethbridxhi, arkivist i muzeut arkeologjik dhe etnologjik të Universitetit të Kembridxhit, në Angli, ia ka atribuar armët, armaturën dhe stemat heraldike (të fisnikërisë) një kalorësi të fundit të shekullit të katërmbëdhjetë, me prejardhje nga Skocia Veriore dhe "fis i Sinklerit të parë, kontit Orkneji"[1]. Vëllazëria e njihte ekzistencën e Amerikave prej mijëra vjetësh dhe Kristofor Kolombi u përdor për të kryer

zbulimin zyrtar, në mënyrë që të mund t`i hapej udhë pushtimit të Amerikave.

Ja si kanë shkuar faktet.

Pas spastrimit të vitit 1307, sikurse e kemi parë, shumë tempullarë e lanë Francën dhe u drejtuan për në Skoci. Por të tjerë u shpërngulën në Portugali, ku vepruan nën emrin e urdhërit Kalorësit e Krishtit, duke iu kushtuar mbi të gjitha aktivitetit detar. Më i famshmi Mjeshtër i Madh i Kalorësve të Krishtit ishte princi Henrik Lundërtari (një tjetër princ Henrik!), që ka jetuar midis viteve 1394-1460. Termi "lundërtar" përdorej nga Kalorësit Tempullarë dhe nga Manastiri i Sionit për të treguar një Mjeshtër të Madh dhe, për këtë arsye, nuk të çudit fakti që është rimarrë nga ata njerëz fasadë të tempullarëve, sikurse ishin Kalorësit e Krishtit. Princi Henrik ishte një eksplorator me gjak mbretëror dhe ishin marinarët e tij ata që "zbuluan" ishujt Madera dhe ishujt Azore, ato çka sipas gjasës kanë mbetur nga Atlantida. Falë lidhjeve me Vëllazërinë, ai mundi të konsultohej me shumë harta të përpiluara nga lundërtarët fenikas dhe nga të tjerë, përfshirë ata që kishin hedhur në hartë ekzistencën e kontinentit amerikan. Vetëm njëzet vjet më pas se Kolombi të ishte nisur në drejtim të Amerikave, më falni, të "Indisë", admirali otoman turk, Piri Reis, realizoi një hartë të asaj që duhej të ishte Antarktida, 300 vjet përpara zbulimit të saj zyrtar! Saktësia e hartës së tij është vërtetuar nga teknikat moderne. Por si mundi ta bënte një gjë të tillë? Ai tha se ishte bazuar mbi ekzemplarë të mëparshëm, që ishin të njëjtat burime nga të cilat kishin huazuar edhe princi Henrik Lundërtari dhe Kalorësit e Krishtit - Kalorësit Tempullarë. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme, nëse mendoni që njëri prej kapitenëve të princit Henrik, përveçse Kalorës i Krishtit, ishte vjehrri i... Kristofor Kolombit. Ky zotëri nuk ishte duke kërkuar aspak Indinë. E dinte përbukuri se ku ishte duke shkuar. Kjo është arsyeja se përse aq shumë eksploratorë dhe lundrues përreth botës, si Vasko de Gama e Ameriko Vespuçi, e kishin prejardhjen nga Portugalia. Sikurse ka shpjeguar historiani i Masonerisë, Menli P. Hill, Kolombi kishte lidhje me rrjetin e shoqërive të fshehta të pranishme në Gjenovë dhe në Italinë Veriore, fortesë e fenikas-venecianëve dhe e racave zvarranike të Fisnikërisë së Zezë. Ai u rekrutua nga Rëne d`Anzhuja i familjes zvarranike të Lorenëve, një anëtar fisnik i Vëllazërisë Babilonase, që kishte lidhje të ndryshme në të gjithë Evropën, përfshirë Gjenovën dhe Venecian. Kolombi (emri i vërtetë i të cilit ishte Kolon) i përkiste një grupi që kënaqej me doktrinat heretike të poetit Dante, që ishte një katar shumë aktiv dhe flamuri, që valëvitej mbi anijet e Kolombit gjatë udhëtimit të tij në Amerikë, paraqiste... një kryq të kuq në sfond të bardhë.

LIBRI 24

Një mbështetje vendimtare për ndërmarrjen e Kolombit erdhi nga dy anëtarë të lartë të rrjetit të Vëllazërisë Babilonase, nga Lorenco de Mediçi, që i përkiste njërës prej familjeve zvarranike më me ndikim të Venecias, dhe nga Leonardo da Vinçi, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit.

Pesë vjet pasi Kolombi kishte zbarkuar në Karaibe, një italian me emrin Xhon Kabot, u nis nga porti tempullar i Bristolit, në Anglinë Perëndimore, për të zbuluar zyrtarisht Tokën e Re, Skocinë e Re dhe Amerikën Veriore. Toponimi Bristol rrjedh nga perëndesha Baratia dhe ai qytet dikur quhej Kaer Brito. Bristoli ishte një qendër e Kalorësve Tempullarë dhe ajo zonë e qytetit që sot quhet Temple Mids është një dëshmi e qartë e kësaj. Kaboti ishte financuar nga mbreti anglez Henriku VII dhe i biri i Kabotit, Sebastiani, i lindur në Venecia, ka qenë nga ana e tij eksplorator dhe hartograf në oborrin e Henrikut. Sebastiani arriti edhe në Gjirin e Hudsonit, në Kanada, dhe udhëhoqi një ekspeditë në Amerikën e Jugut për llogari të spanjollëve. Kabotët thanë se ishin duke kërkuar Azinë! Ekspeditat spanjolle në Amerikën e Jugut dhe ato të francezëve e të anglezëve në Amerikën e Veriut qenë të gjitha të koordinuara nga i njëjti burim, domethënë nga sektorë të saktë të Vëllazërisë. Historia zyrtare nuk e lidh Kabotin me Kolombin, por jo se nuk zotëron prova të mjaftueshme për ta bërë. Emri i vërtetë i Xhon Kabotit ishte Xhovani Kaboti. Ai ishte një venecian i natyralizuar që vinte nga Gjenova – qyteti në të cilin ishte aktiv Kolombi në të njëjtën periudhë kur aty banonte Kaboti. Menli P. Hill, që është vetë një mason i shkallës së lartë, mbron idenë se që të dy silleshin përreth të njëjtave shoqëri të fshehta dhe shoqërisë "Njerëzit e Urtë të Lindjes". Në librin e tij *Amerika's Assignment With Destiny*, ai shton:

"Eksploratorët që përuruan Botën e Re kontribuan në vënien në zbatim të një plani më të lartë dhe realizuan ca rizbulime, më shumë se ca zbulime tamam të vërteta. Shumë pak dihet për origjinën, për jetën dhe për taktikat e këtyre aventurierëve sypatrembur. Ndonëse ata kanë jetuar në një shekull që gëlonte prej historianëve dhe biografëve, këta e quajtën me vend ose të heshtnin, ose të trillonin shkrime të besueshme të bazuar mbi hiçin"[2].

Dhe zgjedhja e tyre është e kuptueshme. Nuk dëshironin që njerëzit të mësonin të vërtetën, domethënë, që ishte gjithçka një mashtrim, i cili hynte në planet me afat të gjatë të Vëllazërisë. Në harkun e katër shekujve pasues, vendet evropiane të kontrolluara nga Vëllazëria, sidomos Britania e Madhe, por edhe Hollanda, Franca, Belgjika, Spanja, Portugalia, Gjermania e të tjera, plaçkitën planetin, duke marrë tamam kontrollin e vërtetë të botës dhe e

shtrinë kontrollin ariano-zvarranik si kurrë më parë. Hernando Kortesi, që e udhëhoqi Spanjën në pushtimin e Amerikës Qendrore pas Kolombit, mund të merret si simbol i mendësisë dhe i metodave të përdorura nga ato kombe. Popullsitë vendase kishin një sistem të vetin të matjes së kohës dhe prisnin të gjitha kthimin e perëndisë së tyre, Quetzalkoatlit, për shumë aspekte një homolog i Jezusit. Episodet që tregohen mbi jetën e Jezusit në Lindjen e Mesme dhe në Evropë reflektojnë atë që në Amerikën Qendrore tregohet në lidhje me Quetzalkoatlin, pasi që të dyja këto perëndi rrjedhin nga një burim i përbashkët. Data e ardhjes së dytë të supozuar të perëndisë së bardhë, Quetzalkoatlit, ishte, sipas sistemit të matjes së kohës evropiane, viti 1519, dhe ata besonin se perëndia e tyre do të kishte ardhur me një veshje që përputhej me epitetin e tij të Gjarpërit me Pupla. Kortesi ankoroi në Meksikë në vitin 1519, duke qenë i veshur me pupla dhe zbarkoi madje pikërisht në vendin ku pritej Quetzalkoatli. Dhe, gjithmonë në përputhje me legjendën e Quetzalkoatlit, solli edhe një kryq. Për shkak të kësaj, mbreti aztek Montexuma besoi, ashtu si edhe populli i tij, se Kortesi ishte perëndia e aq shumëpritur. Kjo i dha mundësi Kortesit, me vetëm 58 burra, të merrte kontrollin e një numri shumë të madh njerëzish. Kur e kuptuan se ardhja e Kortesit nuk ishte ardhja e dytë e famshme e Zotit, tashmë ishte tepër vonë. Pasuan masakra tamam të vërteta të vendasve dhe një historian spanjoll ka llogaritur se, vetëm në Amerikën e Jugut, janë vrarë 12 milionë vendas pas ardhjes së evropianëve (arianë dhe ariano-zvarranikë), dhe një numër akoma më i madh u kthyen në skllavëri. Midis pushtimeve spanjolle figuronin tokat e inkasve dhe të majave, dhe shumë prej dijeve të tyre humbën e u shkatërruan sistematikisht. E njëjta gjë ndodhi në Amerikën e Veriut, ku evropianët vranë një numër të pabesueshëm të vendasve amerikanë, duke e zhdukur praktikisht atë kulturë nga faqja e dheut. Vendasve të Afrikës, të Australisë, të Zelandës së Re dhe të vendeve të tjera nuk u takoi një fat i ndryshëm. Arianët, të kontrolluar në mënyrë të pavetëdijshme nga ariano-zvarranikët, e pushtuan planetin nëpërmjet Perandorisë Britanike dhe perandorive të tjera evropiane dhe, kudo që shkuan, grabitën ose shkatërruan pasurinë e dijeve mbi jetën dhe mbi historinë (që zbulonte qartë përfshirjen e racës së zvarranikëve në çështjet njerëzore). Njëri prej shembujve të parë e më të qartë të kësaj përfaqësohet nga shkatërrimi i bibliotekës së madhe ekzoterike të Aleksandrisë së Egjiptit, urdhëruar nga romakët në shekullin IV. Librat që nuk qenë shkatërruar, u grumbulluan në Vatikan. Një i njohuri im, i cili ka ca të afërm që punojnë brenda Vatikanit, më ka bërë të ditur se ka parë, nën të pallatit, ca kripta të blinduara plot me mijëra tekstesh të lashta ekzoterike. "E pabesueshme!", ka komentuar.

Ngulimi i parë anglez i përhershëm në ato që pastaj u bënë Shtetet e Bashkuara ndodhi në Xhejmstaun, në Virxhinia, në vitet e para të shekullit XVII. Thuhet se Virxhinia mori emrin e Elisabetës I, që, pa asnjë bazë, ishte quajtur "mbretëresha e virgjër". Është, megjithatë, mjaft më e mundshme, duke parë prapaskenat, që emri i saj të jetë frymëzuar nga mbretëresha e virgjër e Babilonisë së lashtë, mbretëresha Semiramidë, dhe nga homologia e saj egjiptiane, Isida. Shumë anëtarë të familjes së Frensis Bekonit figurojnë midis koloneve të parë, sikurse edhe kalvinisto-puritanët me veshjet e tyre të zeza dhe kapelet e larta, që i trajtonin vendasit siç trajtonin gratë e tyre, me egërsi dhe arrogancë të papërshkrueshme. Me këta kolonë, ndërsa po shkonte duke u konsoliduar pushtimi i planetit nga ana e Vëllazërisë, mbërritën edhe familjet zvarranike të aristokratëve dhe të sovranëve evropianë, që do të bëheshin afaristët, bankierët, presidentët dhe administratorët e Shteteve të reja të Bashkuara. Financat dhe tokat e Amerikës qenë siguruar që në fillim nga krijimi i shoqërisë *Virginia Company*, e themeluar nga mbreti Xhejmsi I në vitin 1606. Xhejmsi e emëroi kalorës Frensis Bekonin dhe i besoi shumë detyra të rëndësishme, ndërmjet të cilave atë të Lordit Kancelar anglez. Nën mbrojtjen e Xhejmsit, tempullarët, trëndafilkryqëtarët dhe të tjera shoqëri të fshehta u shkrinë në një organizatë të vetme, në Urdhërin e Masonëve. Shikoni disa prej anëtarëve të parë të shoqërisë *Virginia Company*: Frensis Bekoni, konti i Pembrukut, konti i Montgomerit, konti i Salisburit, konti i Northamptonit dhe Lordi Southampton. I përkasin të gjithë familjeve të Vëllazërisë. *Virginia Company* ekziston ende nën emra të tjerë dhe vazhdon të kontrollojë Shtetet e Bashkuara, siç do ta shpjegoj pas pak.

Masonët qenë përgjegjësit më të mëdhenj të kalimit nga kontrolli anglez i deklaruar mbi kontinentin amerikanoverior në kontrollin e fshehtë. Ky kalim është njohur në histori si Lufta Amerikane për Pavarësi. Planet, që Vëllazëria kishte ndërmend të realizonte në kontinentin amerikan, janë paraqitur në veprën e Frensis Bekonit me titullin *Atlantida e Re*, publikuar në vitin 1607, në të cilën një "grup i padukshëm" intelektualësh elitarë bënë edhe kohën e mirë edhe kohën e keqe. Njëri prej masonëve më të spikatur të kolonive amerikane ka qenë Benjamin Franklini, që nderohet akoma si një nga Etërit Themelues, të cilët besonin në lirinë për popullin e tyre. Fytyra e tij është stampuar mbi kartëmonedhën prej 100 dollarësh. Deri edhe lëvizja e Patriotëve të Krishterë, që gjithashtu ka kuptuar me intuitë shumë elemente të konspiracionit global, e hëngri idenë se Franklini ishte nga ana e saj. I lejoj vetes të kem mendim krejtësisht të kundërt. Franklini ishte një anëtar i shërbimeve të fshehta angleze, një satanist, një ithtar i zjarrtë i Vëllazërisë

Babilonase dhe një njeri që i kushtohej flijimit të fëmijëve. Nëse amerikanët në këtë pikë nuk dëshirojnë të gabojnë rrugë, duhet të vështrojnë me një sy të ri kontekstin në të cilin kanë vepruar shumë prej Etërve të tyre Themelues dhe motivacionet e tyre. Franklini ka qenë Henri Kisingeri i atyre kohërave. Ishte Franklini ai që, më 8 dhjetor 1730, publikoi në gazetën e tij, *The Pennsylvania Gazette*, artikullin e parë të dokumentuar mbi Masonerinë. U bë zyrtarisht anëtar i Masonerisë në shkurt të vitit 1731 dhe, në vitin 1734, u emërua Mjeshtër i Madh i distriktit të Pensilvanisë. Në të njëjtin vit që Franklini shtypi të parin libër mason të Amerikës, regjistrohet edhe themelimi i lozhës së parë amerikane në distriktin e tij, në Filadelfia. Prej nga u orkestrua lufta amerikane për pavarësi? Nga Filadelfia. Dhe pikërisht atje e gjeni Kambanën e Lirisë, simbol i Bel-it, perëndisë-Diell të fenikasve dhe të arianëve. Gjuha fenikase bazohet mbi tingullin dhe jo mbi shkrimin dhe tingëllima e një fjale është aspekti thelbësor i gjuhës simbolike e të fshehtë të ariano-zvarranikëve. Franklini, që ishte edhe një Mjeshtër i Madh trëndafilkryqëtar, ishte përgjegjës i operacionit të Vëllazërisë, i cili çoi në pushtimin e Amerikës dhe në zëvendësimin e kontrollit të hapur nga ana e Londrës me kontrollin e fshehtë, forma më e efektshme dhe më e përhapur e kontrollit të masave. Do t`u bëja thirrje atyre, që mendojnë se Franklini dhe shumë Etër Themelues të tjerë ishin përkrahës të lirisë, që të mos e gënjejnë veten. Nëse je i gatshëm të më japësh pushtetin dhe të më mbështetësh në zgjedhje, do të të them atë që dëshiron të më dëgjosh të them, apo atë që unë e di se nuk dëshiron ta dëgjosh? Shumë prej Etërve Themelues kryesorë, si Franklini e Xhefersoni, ishin ca hipokritë të paturpshëm, që thoshin një gjë e bënin një tjetër. Të gjithë nganjëherë jemi të tillë, por është shpeshtësia me të cilën marrim këtë qëndrim ajo që bën ndryshimin. Xhefersoni ka shkruar se të gjithë njerëzit ishin të barabartë që në lindje, por, ndërkohë, kishte në varësinë e tij 200 skllevër zezakë dhe gjetkë ka shkruar se zezakët janë gjenetikisht dhe intelektualisht më të ulët se të bardhët. Si mund të pajtohen këto dy pohime? Nuk mundet. Edhe Franklini kishte skllevër zezakë, ndërsa përralliste për liri.

Franklini ishte mason i rangut të parë pikërisht në vendin ku u organizua lufta për pavarësi; ka qenë edhe anëtar i organizatave masone franceze, si Lozha e Nëntë Motrave dhe ajo e Shën Zhuanit, që kontribuan për të manipuluar Revolucionin Francez të vitit 1789; ai ka qenë një anëtar i Lozhës së vetme Mbretërore të Komandantëve të Tempullit në perëndim të Karkasonit; ishte edhe anëtar i klubit satanik *Hellfire*, së bashku me mikun e tij të ngushtë, Kancelarin e Thesarit britanik Sër Frensis Dashvudin, që ishte shumë afër grupeve ekzoterike, përfshirë Lidhjen Universale të Druidëve. Dashvudi kishte

LIBRI 24

një shpellë të madhe në çifligun e tij të Uest Uajkombit (Vika), ku zhvillonte rite satanike dhe ceremoni të "magjisë" seksuale[3]. Do të ndalem mbi arsyet që qëndrojnë prapa ankthit të idesë fikse për ritualet seksuale në një kapitull të ardhshëm. Më lejoni të them prapë edhe një herë se këtu nuk jam duke dënuar të gjithë druidët apo traditat e Vikës. Aspak. Jam duke folur për përdorimin e keq të këtyre dijeve, që mund të ishin (nganjëherë janë) përdorur përkundrazi në mënyrë shumë pozitive e të përzemërt edhe nga ata që e quajnë veten druidë apo ndjekës të riteve të Vikës. Arsyeja pse po e zbuloj që këta njerëz ishin ithtarë të një kulti të veçantë është se dua të tregoj që ata i kuptonin dhe i përdornin dijet ekzoterike, edhe pse duke i dënuar publikisht e duke u fshehur prapa besimit të krishterë. Një tjetë anëtar i klubit *Hellfire* të asaj kohe ka qenë Frederiku, princ i Uellsit, sikurse gjithashtu kryeministri i asaj kohe, Lordi i parë i Admiraliatit dhe kryetari i bashkisë së qytetit të Londrës[4]. Prej këtyre njerëzve rrethohej Benjamin Franklini, njeriu që do të udhëhiqte një "rebelim" kundër vetë Kurorës angleze! Në të vërtetë, ai ishte agjenti 72 i shërbimeve të fshehta britanike, e njëjta organizatë e krijuar nga njerëz si Frensis Bekoni dhe nga mjeku Xhon Di, gjatë mbretërimit të Elisabetës I. Në vitin 1998, disa gërmime të bëra nën atë që kishte qenë banesa e Franklinit, në banesën me numur 36 të Kraven Stritit, afër Trafalgar Skuerit në Londër, nxorën në dritë mbeturinat e dhjetë trupave, prej të cilëve gjashtë u përkisnin fëmijëve, që u datuan të kohës së Franklinit. Sipas historisë, që është montuar për të mbuluar të vërtetën, ai dhe bashkëbanuesi i tij ishin të përfshirë në grabitjet në varreza, ose i blinin trupat për arsye kërkimesh mjekësore. Duke qenë se Franklini bënte pjesë në një grup që u kushtohej flijimeve rituale, në përputhje me ritualet e lashta të Vëllazërisë Babilonase, kush mund t'i besojë seriozisht asaj historie? Ah, po, pastaj ka një fakt tjetër. Kanë qenë këta dy satanistë, Benjamin Franklini dhe Frensis Dashvudi, ata që nxorën një libër lutjesh, mbi të cilin u bazua pastaj *Libri i Lutjeve* i liturgjisë anglikane! Meqë Dashvudi njihej edhe si Lord le DeSpenser, vepra e tyre u bë e njohur si *Libri i Lutjeve Franklin-DeSpenser* dhe, në Shtetet e Bashkuara, si *Libri i Lutjeve Franklin*[5]. Franklini punoi si në frontin amerikan edhe në atë anglez për të vënë në zbatim Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë, sikurse bënë edhe të tjerë Etër Themelues, dhe nuk është një rastësi e thjeshtë që si Franklini, si Xhefersoni ishin ngarkuar në momente të ndryshme për të përfaqësuar interesat amerikane në atë qendër të rëndësishme siç ishte Parisi, ku edhe Sër Frensis Bekoni mbulonte rolin e përfaqësuesit "britanik". Qenë lidhjet e ngushta të Franklinit me rrjetin e shoqërive të fshehta franceze ato që i shtynë shumë revolucionarë e masonë francezë, si Lafajeti, të rreshtoheshin në luftën

amerikane për pavarësi. Ai siguroi nën dorë edhe mbështetjen e masonit gjerman, baronit fon Stribe, që kishte shërbyer në ushtrinë e Frederikut të Prusisë. Baroni Stribe luajti një rol domethënës në luftë, sikurse, natyrisht, bëri edhe masoni i gradës së lartë Xhorxh Uashingtoni, komandanti i forcave ushtarake amerikane dhe presidenti i parë i Shteteve të Bashkuara. Pjesa më e madhe e oficerëve të tij ishin masonë, sikurse gjithashtu komandantët dhe shumë prej ushtarëve të ushtrisë britanike.

Lordi Xhefri Amherst ishte komandanti suprem i forcave të armatosura britanike gjatë luftës për pavarësi dhe njeriu që pagoi për emërimin e tij zyrtar ishte në radhë të parë Lionel Sakvili, duka i parë i Dorsetit dhe mik i dukës së Uhartonit. Në vitin 1741, Sakvili dhe Uhartoni u bënë Kalorës të Zharrëtierës, urdhëri kalorsiak elitar i monarkut britanik, i cili u përfshi midis urdhërave të tjerë "kalorsiakë" me emrin Kalorësit e Shën Gjonit të Jeruzalemit (Maltës). Simboli i Kalorësve të Zharrëtierës është një kryq i kuq dhe një mburojë e bardhë. Sakvili themeloi në Itali degën masone të Lindjes së Madhe, që bashkëpunonte me lëvizjen shumë të fshehtë të Karbonarëve dhe me atë të Shtjes së Lartë. Bijtë e tij, Xhorxhi dhe Çarlsi, kont i Midëllseksit, ishin që të dy shumë aktivë brenda Masonerisë. Në vitin 1733, Çarls Sakvili themeloi një lozhë në atë fortesë të Fisnikërisë së Zezë siç ishte Firenceja dhe mori pjesë edhe në themelimin e Shoqërisë së Diletantëve së bashku me Frensis Dashvudin, mikun e Benjamin Franklinit. Çarls Sakvili dhe Frensis Dashvudi ishin anëtarë të një grupi elitar të Masonerisë, që sillej rrotull Frederikut, princ i Uellsit dhe anëtar i *Hellfire Club*-it. Vëllai më i vogël i Çarlsit, Xhorxhi, u bë kolonel i regjimentit XX të këmbësorisë (pastaj i emëruar Pushkatar i Lankshirit) dhe Mjeshtër i lozhës së tyre masone të fushimit. Njëri prej gardianëve të kësaj lozhe ishte nënkoloneli Eduard Kornualis, një tjetër prej komandantëve të lartë të ushtrisë britanike gjatë luftës me kolonitë amerikane. Kornualisi, vëllai binjak i të cilit ishte argjipeshkëv i Kantërberit, u emërua guvernator i Skocisë së Re në vitin 1750 dhe themeloi atje një lozhë masonike. Nën komandën e Kornualisit shërbente edhe kapiteni Xhejms Uolf, një tjetër figurë kyçe për fatet e Britanisë në luftën për pavarësi. Në vitin 1751, Xhorxh Sakvili u bë Mjeshtër i Madh i Lozhës së Madhe Irlandeze, organizatë në të cilën kryesonin lozhat e fushimit të ushtrisë britanike në kolonitë. Dhe në vitin 1775, pikërisht teksa lufta në Amerikë ishte në kulmin e zhvillimit të saj, po ky Xhorxh Sakvil, mik i ngushtë i atij anëtarit të Fisnikërisë së Zezë siç ishte mbreti Xhorxh III, emërohet sekretar kolonial në Amerikë! Ky ishte po ai rrjet, në të cilin rezultoi i përfshirë edhe Benjamin Franklini. Shkurt, Vëllazëria Babilonase, nëpërmjet masonëve, kontrolloi dhe manipuloi që të

LIBRI

dyja rreshtimet që përballeshin në luftën për pavarësinë amerikane, pikërisht sikurse bën zakonisht në çdo luftë.

Sikurse kanë dokumentuar historianët, operacionet ushtarake dhe detare gjatë luftës për pavarësi kanë qenë në mënyrë të pabesueshme të pavendta. Nuk ndodhi që kolonitë ta fitonin luftën, por që Britania e Madhe vendosi ta humbiste. Tani e kuptojmë përse, dhe i shohim kanalet nëpërmjet të cilave kjo ka qenë e mundur. Për më tepër, regjimentet britanike gëlonin prej lozhave masonike, të cilat vendosnin lidhje me homologet e tyre amerikane. Gjatë periudhës vendimtare, Benjamin Franklini u vendos në Paris, nga ku mundi të komunikonte lehtësisht me lozhat franceze dhe me britanikët. Parisi ishte (dhe është akoma) edhe njëra prej qendrave kryesore të spiunazhit britanik. Ministri britanik i Postave tradicionalisht ka pasur të bëjë me aktivitetin e spiunazhit, në mos për tjetër, për arsye se ai kishte kontrollin e plotë mbi ndërlidhjet. Britania e Madhe ua besoi detyrën dy personave, Sër Frensis Dashvudit, satanistit mik i Franklinit, dhe kontit të Sanduiçit që, bashkë me Dashvudin, themeloi një tjetër shoqëri të fshehtë të quajtur Urdhëri i shën Franceskut. Konti i Sanduiçit qe emëruar Lord i Parë i admiraliatit të ngarkuar me luftën detare kundër kolonive amerikane dhe *Enciklopedia britanike* thotë se administrata e kontit të Sanduiçit u shqua në historinë e Marinës Britanike për korrupsion dhe paaftësi. Njësoj (dhe qëllimisht) të paaftë e tregoi veten komandanti i operacioneve detare, admirali Lord Riçmond Houi, që ishte vënë në lidhje me Franklinin në vitin 1774 nga e motra e Franklinit, me banim në Angli dhe e përfshirë në organizime spiunazhi. Më pas Riçmond Houi pohoi publikisht se nuk i kishte vënë eprorët e vet në dijeni për takimet e tij me Franklinin. Në tre apo katër vitet që çuan tek Deklarata Amerikane e Pavarësisë e vitit 1776, Franklini e kaloi verën në çifligun e Dashvudit, në Uest Uajkomb, në veri të Londrës, ku mori pjesë në "ritualet" në shpellën e gërmuar enkas nga Dashvudi, me qëllim për të krijuar një vend të përshtatshëm për praktikat e tyre satanike. Një statujë e Harpokratit, perëndisë greke të sekretit dhe të heshtjes e paraqitur me një gisht mbi buzë, është gjetur në ambjentet e *Hellfire Club*-it[6]. Statujat e Harpokratit gjendeshin shpesh në hyrje të tempujve, të shpellave dhe të tjera vendeve, në të cilat kryheshin dhe përhapeshin misteret. Kanë qenë Dashvudi dhe Franklini, ky i fundit zëvendësministër i Postave për kolonitë, ata që e kordinuan luftën në të dy frontet, në mënyrë që të sigurohej rezultati: kontrolli i fshehtë i Shteteve të reja të Bashkuara nga ana e Vëllazërisë Babilonase të Londrës. Në një letër të datuar më 3 qershor 1778, shkruar nga Xhon Norrisi, një agjent i Dashvudit, lexohet se ai "ka transmetuar sot me heliograf në

Uajkomb mesazhe sekrete nga ana e doktor Franklinit, që ndodhej në Paris"[7].

Lufta amerikane për pavarësi shpërtheu zyrtarisht në vitin 1775, si pasojë e vendosjes nga ana e kurorës angleze e taksave më të larta ndaj kolonive, për të përballuar kostot shumë të mëdha të shkaktuara nga lufta shtatëvjeçare midis Britanisë së Madhe dhe Francës, një tjetër konflikt ky i manipuluar nga Vëllazëria. Vetë lufta shtatëvjeçare shpërtheu, duket, pasi Xhorxh Uashingtoni, asokohe komandant i ri i ushtrisë koloniale britanike, urdhëroi vrasjen e ushtarëve francezë në Ohaio. Farët e revolucionit amerikan qenë hedhur kur Vëllazëria londineze bëri të mundur që të futeshin taksa të reja dhe nxiti pastaj rebelimin kundër tyre nëpërmjet përfaqësuesve të saj në kolonitë. Kjo është një teknikë klasike e përdorur që nga kohët që s'mbahet mend. Masa e popullsisë rrinte pezull midis dy zjarreve, pa pasur as idenë më të vogël të asaj që po ndodhte, dhe i besonte gjithçkaje që i thuhej. Midis "rebelëve" amerikanë figuronin masonët Patrik Henri e Riçard Henri Li, i cili në vitin 1769 udhëhoqi revoltën e Asamblesë së Virxhinias. Situata kulmoi me miratimin e *Tea Act*-it, që i dha mundësi degës operative të Vëllazërisë, Kompanisë Britanike të Indive Lindore, t'i shkarkonte tepricat e çajit në kolonitë, pa paguar taksa doganore. Kjo do të thoshte në mënyrë të qartë se për këdo tjetër tregu ishte i mbyllur. Sipas historisë zyrtare të kohës, një grup indianësh Mohauk sulmoi një anije të quajtur *Dartmouth* e ankuruar në portin e Bostonit dhe e hodhi në det ngarkesën e saj me çaj. I gjithë ky operacion qe pagëzuar me emrin *Boston Tea Party*. Në realitet, rebelët nuk ishin indianët Mohauk, por anëtarë të lozhës masonike të Shën Andreas së Bostonit, të veshur si indianë. Ata qenë udhëhequr nga komandanti i tyre i dytë, Pol Revere. Ky fakt nuk mund të kishte ndodhur pa mbështetjen e milicisë koloniale të kontrolluar nga britanikët, që ishte dërguar për të ruajtur anijen *Dartmouth*. Kapiteni i një detashmenti, Eduard Proktori, ishte anëtar i... Lozhës së Shën Andreas. Kjo lozhë ka qenë e para në botë që ka dhënë një gradë të re masonike të quajtur Kalorës Tempullar. Mjeshtri i Madh, Xhozef Uorreni, qe emëruar Mjeshtër i Madh i të gjithë Amerikës së Veriut nga Lozha e Madhe e Skocisë. Midis anëtarëve të tjerë të Lozhës së Shën Andreas figuronte edhe Xhon Hankoku. Ai do të ishte pastaj një lider i të ashtuquajturit Kongres Kontinental, që ratifikoi Deklaratën e Pavarësisë. Të paktën tre anëtarë të Lozhës së Shën Andreas, përfshirë Pol Reveren, figuronin midis "nëntë më besnikëve", që ishte rrethi i ngushtë i një grupi të rëndësishëm revolucionar të quajtur Bijtë e Lirisë. Ishte ky grup ai që organizoi *Boston Tea Party*-n.

Shumë prej këtyre informacioneve dokumentohen nga historiani i Masonerisë Menli P. Hill, që zbulon edhe se, midis 56 firmëtarëve të Deklaratës

së Pavarësisë amerikane, rreth 50 ishin masonë të njohur dhe vetëm njëri nuk ishte me siguri. Më 3 shtator 1783 kolonitë u njohën, nëpërmjet atij që me të drejtë quhet Traktati i Parisit, një republikë e pavarur, Shtetet e Bashkuara. Kushtetuta e re ishte kryesisht vepër e Xhorxh Uashingtonit, Benjamin Franklinit, Edmund Randolfit, Tomas Xhefersonit dhe Xhon Adamsit, të paktën sipas historisë zyrtare. Pjesa më e madhe e Etërve Themelues, të cilët e kishin shumë për zemër lirinë, ishin, ashtu si Franklini dhe Xhefersoni, skllavopronarë të pamëshirshëm. Franklini pati skllevër në shërbim të tij për tridhjetë vjet dhe i shiste në qendrën e vet tregtare. Në vitin 1733, botoi një njoftim për të shitur një skllave, në të cilin thuhej: "Vajzë e besueshme rreth 15 vjeçe, që ka kaluar linë, prej një viti me banim në qytetin tonë, dhe që flet anglisht. Për informacione drejtojuni botuesit". Edhe Xhorxh Uashingtoni zotëronte skllevër si shumë të tjerë emra të mëdhenj të luftës për pavarësi të kalibrit të Xhon Hankokut dhe të Patrik Henrit. Ishte Henri ai që tha: "Më jepni lirinë ose vdekjen". Me kusht që të mos e kesh fytyrën të zezë, duhej shtuar. Gjithsej, nëntë presidentë zotëronin skllevër dhe njëri, Andrej Xhonsoni, vuri një lajmërim për të rikapur një skllav të arratisur, duke ofruar një shtesë prej dhjetë dollarësh për çdo njëqind fshikullima me kamzhik, që do t'i jepeshin skllavit. Edmund Randolfi, bashkëpunëtor i Xhorxh Uashingtonit dhe më pas Mjeshtër i Madh i Lozhës së Madhe të Virxhinias, u emërua i pari prokuror i përgjithshëm dhe sekretar shteti i Shteteve të Bashkuara. Ishte Randolfi ai që propozoi një sistem qeverisjeje qendrore, të bazuar mbi strukturën e propozuar prej shumë kohësh nga "Grupi i Padukshëm" dhe nga organizata e Frensis Bekonit.

Pjesa më e madhe e amerikanëve besojnë se Kushtetuta u hartua për të garantuar lirinë, por, në realitet, qe formuluar me kujdes, në mënyrë që të lejonte vërien në zbatim të Urdhërit të Ditës nga ana e Vëllazërisë. Mbi të gjitha, ajo përcakton se, në qoftë se presidenti vendos veton mbi një projektligj të miratuar nga Kongresi, ai kthehet në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senat, ku, për të eleminuar veton presidenciale, duhet të rivotohet nga një shumicë prej të paktën dy të tretave në të dyja dhomat. Kjo do të thotë që mjafton të kontrollosh presidentin dhe një të tretën e një dhome, për të penguar çfarëdo projektligji që të kthehet në ligj. Çfarë mjeti tjetër më të fuqishëm se ky mund të kesh brenda një shoqërie të "lirë" për të mbrojtur *status quo*-në dhe për të eleminuar gjithçka që mund të vërë në rrezik pushtetin tënd? Patriotët besojnë se prerja e parasë nga ana e bankave private është antikushtetuese në Shtetet e Bashkuara, pasi Kushtetuta thekson se është Kongresi ai që duhet të presë valutën. Por, në realitet, nuk thotë pikërisht

kështu. Në nenin një, paragrafi 8 lexohet se: "Kongresi do të ketë fuqinë të presë monedhën dhe të rregullojë vlerën e saj". Nuk thotë (qëllimisht) se *vetëm* Kongresi do ta ketë atë fuqi, as që duhet ta ushtrojë atë fuqi. Në paragrafin 10 lexohet se asnjë shtet nuk do të presë pará dhe se monedhat e arta e të argjendta duhet të jenë e vetmja formë pagimi i borxheve. Mos kjo do të thotë se paraja letër është antikushtetuese? Jo. Një zonë e Merilandit i kaloi Kongresit të ri për të krijuar *distriktin*, jo shtetin, e Kolumbias për kryeqytetin e ri federal, të quajtur Uashington DC. Brenda këtij distrikti ndodhet banka private qendrore e Amerikës, Rezerva Federale, e cila nxjerr valutën letër në qarkullim. Distrikti i Kolumbias, në fakt, nuk i është përmbajtur respektimit të shumë prej klauzolave të Kushtetutës, që vlejnë përkundrazi për pjesën tjetër të shteteve. Etërit Themelues këtë e dinin.

I pari president ishte Xhorxh Uashingtoni, që rrinte ulur mbi një karrige, në pjesën e pasme të së cilës ishte gdhendur një Diell tek lindte, një simbol i lashtë i besimit diellor arian. Ai ishte Mjeshtër i Madh i Lozhës masone të Aleksandrisë (që e mori emrin nga qytetit egjiptian me të njëjtin emër), pranë Uashington DC-së. Kur ai u emërua president më 30 prill 1789, një ditë para festës më të madhe të Vëllazërisë, një majit, apo Ditës së Verës, betimi u pranua nga Robert Levingstoni, Mjeshtër i Madh i Lozhës së Madhe të Nju Jorkut. Ceremonia, e karakterit në mënyrë tipike masone, u shërbye nga masonë. U zhvillua një procesion i madh, në të cilin morën pjesë, përveç Uashingtonit, oficerë dhe anëtarë të lozhave amerikane me veshje parade. Ashtu si pjesa më e madhe e Etërve Themelues më të rëndësishëm, Uashingtoni i përkiste një familjeje aristokrate angleze dhe, midis paraardhësve të tij, numëronte një kalorës anglez të shekullit XII, koha kur ishte themeluar Urdhëri i Kalorësve Tempullarë, dhe një të afërm të dukës së Bukinghamit, që kishte luftuar për Kurorën gjatë luftës civile angleze. Xhorxh Uashingtoni ishte vetëm shembulli i parë se si Vëllazëria Babilonase, e cila e kishte qendrën në Britaninë e Madhe, që nga ajo kohë e më pas ka përdorur zvarranikët për të qeverisur Shtetet e Bashkuara. Shikoni prejardhjet e presidentëve amerikanë, të politikanëve më të spikatur, të manjatëve të financës e të industrisë, të udhëheqësve ushtarakë, të pronarëve të medias, të funksionarëve të qeverisë, të shefave të shërbimeve të fshehta e kështu me radhë dhe do të vini re se ata rrjedhin që të gjithë nga të njëjtat familje aristokrate e mbretërore (ariano-zvarranike) britanike dhe evropiane, të ardhura nga Lindja e Mesme dhe e Afërt, në epokën e sumerëve dhe të babilonasve. Dy shembuj: të paktën 33, prej 42 presidentëve të Shteteve të Bashkuara, rridhnin nga mbreti anglez Alfredi i Madh (849-899) dhe nga

Karli i Madh (742-814), sovrani i famshëm francez, ndërsa 19 presidentë mburren me një lidhje farefisnie me mbretin anglez Eduardi III (1312-1377), nga i cili rrjedh edhe princi Karl. Edhe Xhorxh e Barbara Bushi rrjedhin nga e njëjta linjë dinastie britanike. Ata i përkasin familjes Pirs, që mori emrin Persi, pasi ishte arratisur nga Anglia si pasojë e Komplotit të Barutit, me të cilin u bë përpjekje të hidhej në erë parlamenti anglez. Bushët u martuan me kujdesin që të ruanin pastërtinë gjenetike, siç kanë bërë gjithmonë familjet amerikane të *Establishment*-it Lindor, duke imituar të afërmit e tyre zvarranikë të familjeve aristokrate e mbretërore evropiane. Deri edhe Bill Klintoni e Bob Dojli, që ishin "kundërshtarë" në zgjedhjet presidenciale të vitit 1996, janë kushërinj të largët. Pema e tyre gjenealogjike mund ta ketë zanafillën gjer tek mbreti anglez Henriku III, që mbretëroi nga viti 1227 gjer në vitin 1273, gjatë viteve kur ishin në apogjé tempullarët, përveç presidentëve amerikanë Uiliam Henri Harrison e Benjamin Harrison. Këto informacione janë nxjerrë nga botimi *Burkes Peerage*, që skicon pemën gjenealogjike të familjeve aristokrate e mbretërore. Klintoni ka më shumë gjak mbretëror se Dojli dhe rrjedh drejtpërdrejt nga e njëjta familje nga e cila rrjedhin edhe Uindsorët, të gjithë sovranët skocezë dhe mbreti Roberti I i Francës. Ja përse Vëllazëria zgjodhi pikërisht atë. Harold Bruks Bejkeri, botuesi i librit gjenealogjik *Burkes Peerage*, ka thënë: "Kandidati presidencial me numrin më të madh të geneve mbretërore ka pasur gjithmonë më shumë përparësi ndaj të tjerëve, pa asnjë përjashtim, që nga koha e Xhorxh Uashingtonit". Gjendemi përballë kësaj barasvlere të pabesueshme: gene "mbretërore" = gene zvarranike. I njëjti fis që ka kontrolluar Evropën thjesht është shtrirë në Shtetet e Bashkuara nën emrin e lirisë. Shtetet e Bashkuara nuk janë liruar kurrë prej kontrollit nga ana e Londrës. Përkundrazi, janë *krijuar* nga Londra. Britania e Madhe dhe kurora britanike i kanë zotëruar, po, zotëruar, Shtetet e Bashkuara. Nëse jeni amerikanë dhe deri tani nuk keni dëgjuar kurrë të thuhen këto gjëra, dhe në fakt vetëm pak i kanë dëgjuar, ju kështilloj të uleni e të pini një filxhan të mirë me çaj, sepse pas pak do të mbeteni të shushatur.

Në vitin 1604, një grup politikanësh të rëndësishëm, afaristë, tregtarë, prodhues e bankierë u takuan në Grenuiç, atëhere në kontenë angleze të Kentit, dhe formuan një korporatë që e quajtën *Virginia Company*, duke patur parasysh ndikimin shumë të madh që evropianët e bardhë, së pari sidomos britanikët, do të kishin ushtruar mbi kontinentin amerikan. Aksionisti i saj kryesor ishte mbreti zvarranik Xhejmsi I dhe statuti origjinal i shoqërisë ishte përfunduar brenda 10 prillit 1606. Ai statut, bashkë me plotësimet e mëpasshme, përcaktonte sa vijon:

Virginia Company bazohej në dy degë, *London Company* dhe *Plymouth*, apo *New England Company*. Të parës i detyrohej kolonia e parë e përhershme e Amerikës, e themeluar në Xhejmstoun, më 14 maj 1607, ndërsa e dyta ishte themeluar nga "Etërit Pelegrinë", që arritën në Kep Kod mbi anijen *Mayflower*, në nëntor të vitit 1620, dhe vazhduan duke zbarkuar pastaj në Plymouth më 21 dhjetor. "Pelegrinët" mitikë amerikanë ishin, në realitet, anëtarë të degës së dytë të korporatës *Virginia Company*, të quajtur *New England Company*.

Virginia Company zotëronte pjesën më të madhe të tokës së atyre që sot i quajmë Shtetet e Bashkuara dhe të gjitha tokat të përfshira në një rreze prej 900 miljesh që nga bregu i detit. Midis këtyre të fundit figuronin Bermudet dhe pjesa më e madhe e ishujve aktualë të Karaibeve. *Virginia Company* (kurora britanike dhe familjet zvarranike) kishin të drejtën e 50%, po të 50%, të të gjithë arit dhe argjendit të nxjerrë nga ato toka (tokat e saj), përveçse një përqindjeje të mineraleve të tjera dhe të lëndëve të para dhe 5% të të gjitha të ardhurave të nxjerra nga iniciativat e tjera sipërmarrëse. Duke iu përmbajtur statutit, këto të drejta duhej t'u kaloheshin trashëgimtarëve të pronarëve të korporatës *Virginia Company*, duke e treguar veten kështu... të përjetshëm! Anëtarët më të spikatur të korporatës *Virginia Company*, që do t'i gëzonin këto të drejta, ishin arkëtari i shoqërisë dhe anëtarët e Kompanisë së Aventurierëve e të Kolonëve të qytetit të Londrës. Pas 21 viteve të para nga themelimi i korporatës *Virginia Company*, të gjitha "tagrat doganore, tatimet dhe taksat", të paguara mbi aktivitetet tregtare të kolonive, duhej të derdheshin drejtpërdrejt tek kurora britanike nëpërmjet thesarmbajtësit të Kurorës. Asnjë tregtar nuk mund të eksportonte mallra jashtë kolonive pa lejen e kurorës britanike dhe kush e bënte i nënshtrohej sekuestrimit të të gjitha mallrave, përveç anijes, ose të mjetit me të cilin i transportonte. Padronia e vërtetë e kolonive ishte Kurora Britanike.

Kolonitë duhej të qeveriseshin nga dy Këshilla Kolonialë, secili i përbërë prej 13 anëtarësh (prapë ky numër!), por Këshilli i Kurorës së Londrës kishte fjalën e fundit mbi të gjitha vendimet. Monarku britanik në fuqi zgjidhte edhe guvernatorin e kolonive amerikane, që sot e quajmë president.

Monarku, përmes Këshillit të tij të Kolonive, e vërtiti punën në mëyrë të tillë që kolonët t'i diktonin besimin e krishterë të gjithë popullsisë, përfshirë vendasve amerikanë. Për të përdorur gjuhën e kohës... "me zellin, me kujdesin e me respektin më të madh veproni në mënyrë që fjala e vërtetë e Zotit dhe e besimit të krishterë të predikohet, të rrënjoset dhe praktikohet, jo vetëm brenda kolonive dhe plantacioneve të sipërpërmendura, por edhe midis popujve të

egër, që kufizohen me tokat tona, sipas doktrinës, të drejtës dhe besimit sot të ushtruara e të konsoliduara në mbretërinë tonë të Anglisë". Kurora vijonte duke thënë se, në rast se vendasit amerikanë nuk do ta kishin pranuar besimin e krishterë, ajo duhej t'u diktohej atyre. Nga kjo rrodhi urdhëri për të shkatërruar kulturën dhe dijet e popujve vendas të Amerikë së Veriut dhe për t'i mbajtur edhe kolonët e bardhë nën zgjedhën e egër të terrorizmit të krishterë, të diktuar nga puritano-kalvinistët. Ishte fjala për një leje të qartë për të vrarë, për të torturuar, për të grabitur popullsitë vendase, që u garantonte një imunitet të plotë autorëve të këtyre krimeve.

Gjykatat penale të tokave të korporatës *Virginia Company* duhej të vepronin sipas Ligjit të Admiraliatit, domethënë sipas të drejtës detare, kurse gjykatat civile, sipas ligjit të zakonshëm, të drejtës tokësore. Kjo është një pikë vendimtare, mbi të cilën do të ndalem pas pak.

Tani më ndiqni. E gjitha ajo që keni lexuar këtu më lart, ka kuptim akoma sot! Lexojini prapë edhe një herë ato përqindje dhe do ta kuptoni rëndësinë e të gjithë kësaj. Pasi 13 (prapë ky numër!) kolonitë amerikane fituan "pavarësinë" e tyre dhe një komb i "pavarur" u krijua pas vitit 1783, korporata *Virginia Company* ndryshoi thjesht emër, duke u bërë... Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Do të shihni se ekzistojnë dy SHBA ose, më mirë, një SHBA dhe një shbA. Shtetet e bashkuara të Amerikës, të shkruara me "sh" e me "b" të vogël janë tokat e shteteve të ndryshme. Këto toka, siç e kemi parë, janë ende pronë e Kurorës Britanike, në cilësinë e kreut të korporatës së vjetër *Virginia Company*, edhe pse pas pak për këtë do të më duhet të shtoj diçka. Pastaj janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me "SH" e me "B" të madhe, që i përkojnë 68 miljeve katrore të tokave në perëndim të lumit Potomak, mbi të cilat ndodhet kryeqyteti federal, Uashington DC dhe distrikti i Kolumbias. Ato përfshijnë edhe protektoratet amerikane të Guamos dhe të Porto Rikos. Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë një vend, janë një shoqëri pronash të po atyre zvarranikëve të Vëllazërisë që zotëronin edhe korporatën *Virginia Company*, sepse SHBA-t janë *Virginia Company*! Kur amerikanët pranojnë se kanë një kod sigurimi shoqëror, qytetarët e shteteve të bashkuara heqin dorë prej sovranitetit të tyre dhe pranojnë të bëhen anëtarë të federuar të Shteteve të Bashkuara (të korporatës *Virginia Company* e të Kurorës Britanike). Atëherë, përse e bëjnë? Sepse nuk e kanë idenë e asaj që janë duke bërë. I kanë bindur të besojnë se ekziston vetëm një komb, që quhet Shtetet e Bashkuara dhe se qeveria federale është qeveria e duhur. Nuk ekziston asnjë ligj që të thotë se amerikanët duhet të paguajnë një taksë federale, por ata vazhdojnë ta

paguajnë, sepse besojnë që duhet ta bëjnë. Shërbimi Detyrime të Brendshme vepron me metoda aq terroriste sa që, edhe ata madje që e dinë se bëhet fjalë për një mashtrim, vazhdojnë të paguajnë, sepse ideja që të heqin dorë i terrorizon. Pini një gllënjkë të mirë çaji tani dhe mbushuni me frymë, sepse nuk kam mbaruar akoma.

Kjo do të thotë se të gjitha të drejtat që i gëzonin pronarët e korporatës *Virginia Company* përsa i përkiste arit, argjendit, mineraleve dhe taksave të nxjerra e të paguara në Amerikë, i kanë kaluar sot familjeve britanike, të cilat zotërojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tokat e shteteve të bashkuara të Amerikës. Po ato të njëjtat përqindje kanë vazhduar të paguhen që nga kohërat e "pavarësisë" dhe vazhdojnë deri sot e kësaj dite të paguhen nga populli amerikan nëpërmjet funksionarëve të tyre federalë që, në realitet, janë funksionarë të korporatës *Virginia Company* – po, përfshirë presidenti. Kurora Britanike zotëron tokat e shteteve të bashkuara dhe tokën e institucionet e Shteteve të Bashkuara, përfshirë Shërbimin e Detyrimeve të Brendshme, që vjel taksat, dhe Komisionin e Rezervës Federale, "bankën qendrore" private të Amerikës, që i jep qeverisë hua para që nuk ekzistojnë, duke i ngarkuar me interesa, të cilat paguhen pastaj nga taksapaguesit. Komisioni i Rezervës Federale është në duart e të njëjtave familje evropiane të Vëllazërisë, që zotërojnë edhe pjesën tjetër të Amerikës. Por këtu ka një tjetër të papritur. Kush e zotëron pasurinë, në dukje në duart e korporatës *Virginia Company*? Përgjigje: Vatikani. Më 3 tetor të vitit 1213, mbreti Xhon, në cilësinë "mbret i ndërmarrjes vetjake Angli", përqëndroi mbi vete të gjitha të drejtat më të larta të shtetit anglez dhe ia dha papës që, në cilësinë e mëkëmbësit të Krishtit, mundi kështu të rivendikojë sundimin mbi të gjithë botën. Në këmbim, papa i garantoi Kurorës angleze qeverisjen e të gjitha këtyre tokave. Me fjalë të tjera, Kurora ushtron funksionin e guvernatorit, ndërsa Vatikani është pronar i tyre, edhe pse, natyrisht, pronari i vërtetë është kush kontrollon Vatikanin. Ja përse vazhdoj të them që Londra është qendra e degës operative të Vëllazërisë. Por një pushtet edhe më i madh është i përqëndruar në duart e dikujt tjetër, pjesërisht në Vatikan, përveçse, në nivel material, në njëfarë vendi nëntokësor të Tibetit, në Azi. Populli amerikan i janë shterur fuqitë nga ky mashtrim dhe vazhdojnë t'i shteren. Toka e të lirëve? Më vjen për të qeshur! Njerëz të Amerikës, presidentët tuaj dhe funksionarët tuaj të qeverisë këto gjëra i dinë. Duhet thënë edhe se marrëveshja midis mbretit Xhon dhe papës çoi sipas gjasës në rënien e sovranitetit të Anglisë. Por kush e kontrollonte mbretin Xhon? Tempullarët.

Nëse e dini se çfarë jeni duke kërkuar, e vërteta do t'ju brofë përpara

syve. Thashë se *Virginia Company* dhe mbreti Jakomi I dekretuan që gjykatat penale të kolonive të zbatonin Ligjin e Admiraliatit, të drejtën detare. Por për cilin Admiraliat bëhej fjalë? Për Admiraliatin britanik, natyrisht. Kur një gjykatë ushtron të drejtën detare, flamuri brenda sallës së gjyqit duhet të jetë i rrethuar me një bordurë zbukuruese të praruar. Vështroni brenda cilësdo gjykate penale të Shteteve të Bashkuara, ose të shteteve të bashkuara, dhe do të shihni bordurën zbukuruese të praruar. E njëjta gjë ndodh me shumë ndërtesa të tjera zyrtare. Këto gjykata penale "amerikane" ushtrojnë të drejtën detare BRITANIKE. Edhe familjet e kurorës e të Vëllazërisë britanike kontrollojnë gjykatat penale dhe, prapa këtij kontrolli, qëndrojnë shoqëritë e fshehta, të cilat e kanë selinë në Temple Bar, në Londër, në tokat që dikur u përkisnin tempullarëve e që sot janë qendra e profesionit avokator britanik. Lozha e Madhe e Masonerisë angleze është në Great Queen (Isidë) Street, në Londër dhe, që nga viti 1717, vit i themelimit të saj, kontrollon pjesën më të madhe të lozhave masone të përhapura në të gjithë globin. Nëpërmjet saj, ariano-zvarranikët britanikë kontrollojnë gjykatësit, avokatët e policët amerikanë dhe nëpërmjet të tjera organizatave, si Këshilli i Marrdhënieve me Jashtë dhe Komisioni Tripalësh, manipulojnë sistemin politik amerikan. Gjykatësit amerikanë janë krejtësisht të vetëdijshëm për faktin se gjykatat e tyre janë të kontrolluara nga Admiraliati britanik, por rrinë urtë dhe arkëtojnë paratë. Familja Rokfeler është anëtarja amerikane zvarranike që varet nga Londra dhe janë Rokfelerët ata që, sikurse është e dëshmueshme, vendosin se kush duhet të bëhet president i SHBA-ve. Me fjalë të tjera, ajo që vendos është Elita londineze. Mbretëresha e Anglisë, princi Filip dhe anëtarët kryesorë të familjes mbretërore britanike janë të gjithë në dijeni të kësaj situate, që kontribuojnë për ta krijuar. Kush është Mjeshtri i Madh i Lozhës nënë angleze të Masonerisë? Kushëriri i mbretëreshës, duka i Kentit.

Por e gjitha kjo ka një lidhje edhe me Francën. Dhe është e natyrshme që të jetë kështu, duke qenë se Londra dhe Parisi janë qendrat kryesore operative të Vëllazërisë. Shumë herë dega franceze dhe ajo angleze kanë luftuar midis tyre për epërsinë e plotë, por, në fund të fundit, bëhet fjalë gjithmonë për dy faqe të së njëjtës medalje. Revolucioni francez i vitit 1789 (vit në të cilin Xhorxh Uashingtoni u bë presidenti i parë i Shteteve të Bashkuara) ka qenë orkestruar tërësisht nga masonët dhe nga degëzimi i tyre i Mendjendriturve Bavarezë. Pasi "revolucionarët" ekzekutuan Marie Antonetën, i biri i saj, ende fëmijë, princi trashëgimtar Luigj, u vendos në arrest shtëpie në Tempullin e Parisit. Dy vjet më pas u nxor fshehurazi në një shportë me rroba të pista nga mjeku i tij, doktor Naudini. Princi u çua në mënyrë të fshehtë në Pallatin Vende, ku

u prit e u strehua nga princi Kond. Më pas u martua në një fortesë mbi lumin Rin, ku jetoi me emrin e baronit të Riçmondit. Arriti në Angli në shkurt të vitit 1804 bashkë me ish nënoficerin mbretëror të Francës të ngarkuar me pagesat, Zhorzh Paisuanë, dhe u mor në mbrojtje nga mbreti Xhorxh III, sovrani në fuqi gjatë luftës amerikane për pavarësi. Princi ndryshoi përsëri emër, duke marrë emrin Daniel Paisua, ndërsa Zhorzh Paisuaja u bë Zhorzh Baishua. Mbreti Xhorxh III i dha princit, tani Daniel Paisua, një anije, dhe Zhorzh Baishuasë 600 akra tokë në Karolinën e Veriut. Kur arritën në Amerikë, u ndihmuan nga familja Bodie, që ishte në lidhje farefisnie me familjet mbretërore britanike. Para se të linte Anglinë, princi bleu aksione të korporatës *Virginia Company* dhe, me të arritur në Amerikë, bleu disa miniera ari, përfshirë *Gold Hill Mining Company*, të cilën e bleu fshehurazi, duke përdorur Xhorxh Njumanin si administrator kujdestar, njeri fasadë dhe i besuar. Me shpikjen e motorit me avull, Daniel Paisuaja filloi të ndërtonte hekurudha dhe t`ua jepte me qira ndërmarrjeve të ndryshme. Themeloi edhe *Lancaster Manufacturing Company*, që përpunonte drurin për zbatime në sektorin hekurudhor dhe *Lincolnton Iron Company*, që më pas u zhvendos në Çikago dhe krijoi dy filiale, *Carnegie Steel* dhe *Pullman Standard Company*. Për të furnizuar karburant për lokomotivat (ose të paktën kështu u tha), qeveria federale (korporata *Virginia Company*, aksionist i së cilës ishte Daniel Paisuaja) u ndau privatëve të gjitha trojet që shtriheshin për rreth 300 metra në të dyja anët e hekurudhës. Edhe ngastrat shumë më të mëdha të tokës gjatë linjave të hekurta u ndanë në pjesë prej dhjetë miljesh katrore dhe gjysma e tyre iu dhanë Daniel Paisuasë, që bleu edhe shumë të tjera. Kështu, së bashku me hekurudhat, arriti të zotëronte një pjesë të mirë të pronave më të mira të patundshme. Shumë prej këtyre ligjeve përmbahen në Regjistrin e Kongresit të vitit 1854. Nëpërmjet shoqërisë *Alabama Mineral Company*, kompania *Lancaster Railway* e Paisuave ushtronte kontroll mbi *Coca-Cola*-n, mbi *Pepsi-Cola*-n, mbi *General Motors*-in, mbi *Boing*-un, mbi *Ford*-in, mbi *Standard Oil*-in. Pas luftës civile amerikane të manipuluar të viteve gjashtëdhjetë të 1800-ës, të gjitha hekurudhat dhe pasuritë e patundshme në zotërim të mbështetësve të të mundurve, anëtarëve të Konfederatës së Jugut, u konfiskuan dhe u shitën në ankand në Uilmington, në Karolinën e Veriut. U blenë nga nëntë administratorë kujdestarë të Daniel Paisuasë me çmime jashtëzakonisht të ulëta. Një akt noterial u nënshkrua në Naushvil ndërmjet pronarëve të hekurudhave dhe qeverisë, që përcaktoi krijimin e sistemit hekurudhor ushtarak të Shteteve të Bashkuara, i cili u garantonte atyre pronarëve monopolin mbi transportet dhe mbi komunikacionet.

Të gjitha këto marrëveshje janë akoma sot të vlefshme. Administratori kryesor kujdestar i Daniel Paisuasë ishte një i afërt i Rotshildëve me emrin Leroi Springs, më parë me emrin Leroi Springshtejn. Duket se Leroi Springsi ishte vëlla i gjetur i presidentit amerikan Abraham Linkoln. Në vitin 1808, një grua me emrin Nensi Hanks nxori në dritë një fëmijë, pas një marrëdhënieje me të atin e Springsit. Në testament i ati i la një ngastër të madhe trualli në Hantsvil, në Alabama, një fëmije me emrin Abraham Linkoln. Thashethemet, sipas të cilave Linkolni ishte një Rotshild, duket se kishin një farë baze. Në vitin 1856, nga marrëdhënia e Linkolnit me një vajzë të mbretit gjerman Leopold, lindën dy binjake, Ela dhe Emilia. Njëri praj pasardhësve të kësaj familjeje ishte miliarderi Houard Hungs. Shumë prej familjeve të famshme amerikane, që duket se e mbajnë legjitimisht pushtetin, rezultojnë përkundrazi të kenë qenë qojle të Daniel Paisuasë dhe të korporatës *Virginia Company*. Andrej Karnegie ishte një nëpunës i ri i industrisë së çelikut Paisua, i përdorur si fasadë për një tjetër kompani, që Daniel Paisuaja e quajti *Carnegie Steel*. Familja Vanderbilt kërkon të drejtën e pronësisë së një rezidence fshati të quajtur Biltmur. Por pa asnjë bazë. Biltmuri qe ndërtuar nga familja Paisua si hotel në vitet tetëdhjetë të 1800-ës dhe u administrua pastaj nga administratorët kujdestarë të Paisuasë, Vanderbiltët, mbi bazën e një koncesioni në përdorim me një kohëzgjatje për 99 vjet. Një tjetër administrator kujdestar i Paisuasë ka qenë J.P. Morgani, njëri prej industrialistëve dhe bankierëve më të famshëm të historisë amerikane. Bëhej fjalë për një tjetër fytyrë, prapa së cilës mund të fshihej kush mbante me të vërtetë pushtetin.

Shumë prej vendburimeve naftëmbajtëse e minerare të SHBA-ve gjenden në tokat në pronësi të kompanive hekurudhore dhe, të drejtat që Paisuaja kishte mbi këto vendburime, iu transferuan kompanive minerare e naftëmbajtëse në këmbim të pjesëmarrjes me shumicë në to. Të tjera të drejta iu dhanë industrive të drurit. Pas vdekjes së Daniel Paisuasë, që ndodhi në vitin 1860, drejtimi i perandorisë së tij të jashtëzakonshme kaloi në duart e të nipit, Luis Kas Paisuasë, dhe shtrirja vazhdoi me ritëm të përmbajtur. Në vitin 1872, një shoqëri e Paisuasë, shoqëria *Charleston, Cincinnati e Chicago Railroad*, themeloi një shoqëri të telegrafëvë të quajtur *Western Union*. Në vitin 1875 kjo pastaj i dha jetë një shoqërie ndihmëse të quajtur *AT and T*, që sot është njëra prej shoqërive më të mëdha të telefonave dhe të telekomunikacioneve të Amerikës. Nga shoqëria *Charleston, Cincinnati e Chicago Railroad* rrodhi pastaj Rezerva Federale, banka "qendrore" private e Shteteve të Bashkuara. Perandoria e Paisuasë u shtri gjithmonë e më shumë në sektorin e bankave. *Bank of Lancaster* u bë *North Carolina Bank*, dhe pastaj

Nationsbank. Banka më e madhe e Teksasit, *Interfirst*, një drejtues i së cilës është Xhorxh Bushi, në vitin 1987 u shkri me *Republic Bank* për t'i dhënë jetë bankës *First Republic*. Kjo u thith pastaj nga *Nationsbank*, që mandej u shkri me Bankën e Amerikës. Këto dy të fundit riciklojnë paratë që CIA nxjerr nga trafiqet e saj të drogës dhe kjo duket krejtësisht me vend, nëse mendohet që organizmi, nga i cili rrodhi pastaj CIA, OSS-i, apo Zyra për Shërbimet Strategjike, ishte themeluar nga rrjeti personal i sherbimeve të sigurisë së Paisuasë, i formuar nga *Selma, Rome e Dalton Railroad*, për të mbrojtur sistemin hekurudhor ushtarak. Është një çështje mjaft e ndërlikuar, që u përket gjithmonë të njëjtave familje dhe amerikanët nuk e kanë as idenë më të vogël se kush e drejton me të vërtetë jetën e tyre dhe vendin e tyre. Pyetja është: kush i kontrollonte Paisuatë?

Familja Paisua e ka humbur tani kontrollin e perandorisë së saj, por në timon është gjithmonë i njëjti fis zvarranik. Administratori kryesor kujdestar i Paisuasë, Leroi Springsi, vdiq në vitin 1931 dhe atij ia zuri vendin i biri Elioti. Ai doli vullnetar për të plotësuar sistemin e regjistrimit të kontesë dhe hoqi ca regjistra nga gjykata e Lankasterit. Kur i ktheu përsëri, qindra akte noteriale mbi pronësitë e Paisuasë i ishin kaluar Eliot Springsit, i afërt i Rotshildëve. Sigurisht ishte udhëzuar se ç'duhej të bënte për t'i penguar të bijat e Paisuasë të trashëgonin perandorinë e të atit. Në fillim të viteve pesëdhjetë të shekullit të njëzetë, Ana, e bija e Eliot Springsit u martua me një personazh të krimit të organizuar të Nju Xhersit me emrin Hug Klose, që u emërua pastaj president i të gjitha shoqërive të Paisuasë, të grabitura nga Eliot Springsi. E bija e Kloses, zonja Krandal Klose Boulis, u bë drejtoreshë e Bankës së Rezervës Federale të Karolinës. Beteja për kontrollin mbi pasuritë e Paisuasë vazhdon edhe sot e kësaj dite, por aktualisht duket se kontrollohen nga Rotshildët. Kush beson se zotëron toka, që i ka blerë nga kompanitë hekurudhore, do të jetë shumë i zhgënjyer. Kontratat e tyre nuk janë të ligjshme, sepse kompanitë hekurudhore nuk i zotëronin ato toka dhe, për këtë arsye, nuk mund t'i shisnin. Kishin pasur vetëm koncesionin nga Paisuaja. Në fund të fundit, pronari i vërtetë është *Virginia Company*.

Franklin Delano Rusvelti, president i Shteteve të Bashkuara gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka thënë se në politikë asgjë nuk ndodh kurrë rastësisht. Nëse ndodh, do të thotë se duhej të ndodhte. Kjo është e vërtetë për ngjarjet kryesore, të cilat kanë kontribuar për ta shtyrë Urdhërin e Ditës drejt centralizimit të pushtetit global, qofshin këto luftëra, kriza ekonomike, vrasje apo "skandale" me qëllimin për të hequr qafe politikanë, që nuk qëndronin në lojë. Tri luftërat më të mëdha në tokën amerikane kanë qenë: lufta kundër

populllsisë vendase amerikane, pas arritjes së parë të të bardhëve, lufta për "pavarësi" dhe lufta civile, kur shtetet jugore kërkuan, në vitin 1860, të tërhiqeshin nga Unioni. Kemi parë se lufta kundër vendasve amerikanë dhe ajo për pavarësinë kanë qenë arkitektuar nga Vëllazëria dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për luftën civile. Masonë të vijës së parë nga çdo anë e Evropës morën pjesë në gjashtë festivale të Masonerisë, që u mbajtën në Paris midis viteve 1841-1845 dhe, pikërisht gjatë atyre gjashtë takimeve të fshehta të Këshillit Suprem, që u zhvilluan nën hijen e këtyre kremtimeve, u projektua lufta civile amerikane, për të zgjeruar kontrollin mason dhe ariano-zvarranik në Amerikë. Lord Palmerstoni, ministër i Jashtëm britanik dhe kryeministër, përveçse Patriark i Madh i Masonerisë, ka qenë arkitekti i të gjitha këtyre komploteve[8]. Masonët e gradës së 33-të të Ritit Skocez qenë zgjedhur për të manipuluar konfliktin. Ishin Kaleb Kashingu, që veproi në veri midis unionistëve, dhe Albert Pajku, Komandant i Madh Suprem i juridiksionit jugor të Ritit Skocez, që organizoi rebelimin e sudistëve (jugorëve)[9]. Ironikisht, por në mënyrë mjaft të përshtatshme, financimet për rebelimin sudist qenë marrë nga bankierët masonë të Londrës nëpërmjet Kashingut, që vepronte në veri[10]! Pajku, një satanist që besonte në teorinë e Racës Superiore Ariane (ariano-zvarranike), mundi të mbështetej mbi ndihmën e Xhuzepe Macinit, që ishte kreu i masonerisë italiane të Lindjes së Madhe, nga e cila doli në dritë organizata e turpshme e krimit të organizuar, që mori emrin mafie. Në vitin 1851, Macini filloi të krijonte në të gjithë Amerikën grupe që i kundërviheshin skllavërisë. Masonët i përdorën këto grupe si mbulesë të motiveve të vërteta që qëndronin prapa luftës civile. Financimet më të mëdha erdhën nga britaniku Xhorxh Pejbodi, bankier mason, përveçse njeri fasadë i Rotshildëve, që ngarkoi J.P. Morgan plakun t`i administronte ato financime në Amerikë. Morgani, do t`ju kujtohet, ishte një kukull e Daniel Paisuasë. E shihni se kudo të vështroni, përsëriten gjithmonë të njëjtët emra.

Franklin Pirsi (në lidhje farefisnie me Xhorxh e Barbara Bushin) u zgjodh president në vitin 1853 dhe Macini ka shkruar se "gati të gjitha emërimet e tij i përgjigjen dëshirave tona"[11]. Njëri prej këtyre "emërimeve" i përkiste Kaleb Kashingut, që u bë prokuror i përgjithshëm. Kashingu kontrollohej nga masoneria angleze dhe ishte i përfshirë në eksportimet britanike të opiumit në Kinë, nëpërmjet të atit armator dhe të kushëririt, Xhon Parkins Kashingut. Kaleb Kashingu shkruajti shumë kundër skllavërisë dhe arkitektoi luftën civile, bashkë me Pajkun. Pajku kishte qenë drejtor shkolle në qytetin e lindjes së Kashingut, Njuport, në Masaçusets, por jetonte në Litël Rok, në Arkansas. Një grup i elitës, që rezultoi vendimtar për luftën civile, qenë Kalorësit e Rrethit

të Artë, edhe ata me qendër në Çinçinati, në Ohajo. Midis anëtarëve të tyre figuronte banditi i poshtër me emrin Xhes Xhejmsi, një mason i gradës së 33-të i ngarkuar nga Albert Pajku për të grabitur bankat në veri, për të siguruar financime të mëtejshme për luftën. Një tjetër kalorës i Rrethit të Artë ishte masoni gjeneral P.T. Beauregard, që i dha nismën luftës civile duke sulmuar Fortesën Sumter në vitin 1861. Njëri prej zërave më të famshëm kundër skllavërisë ishte ai i Xhon Braunit. Brauni, në realitet, ishte anëtar i mjaft shoqërive të fshehta, përfshirë Masonerinë. Më 11 maj 1824 u bë Mjeshtër Mason i Lozhës nr. 68 të Hudsonit, në Ohajo[12], dhe ishte anëtar edhe i Amerikës së Re të Macinit. Brauni ishte financuar nga familja e Xhon Jakob Astorit, një tjetër fis zvarranik i Vëllazërisë. Falë lëmshit që masonët krijuan në të dyja rreshtimet, sipas strategjisë së tyre klasike, shpërthimi i luftës civile ishte gjithmonë e më i afërt. Në janar të vitit 1857, masoni Xhon Bukanan ishte zgjedhur president dhe emëroi masonin Xhon B. Flojd si ministrin e tij të luftës. Zëvendëspresident ishte Xhon K. Brekinridxh i Kentakit, që mori gradën e 33-të të Ritit Skocez nga Albert Pajku, më 28 mars 1860. Presidenti i rebelëve, ose i Shteteve të Konfederuara të Jugut, ishte masoni Xheferson Dejvis dhe, i pari shtet që u tërhoq nga Unioni ishte Karolina e Jugut, ku kishte selinë Juridiksioni Jugor i Ritit Skocez të Pajkut. Dhe të tjerë masonë gjendeshin në krye të të gjitha shteteve të tjera, që e pasuan. Është domethënës fakti që, pavarësisht se vetëm njëmbëdhjetë shtete kishin dalë nga Unioni, flamuri i Shteteve të Konfederatës së Jugut kishte 13 yje, një numër i shenjtë për masonët dhe për Kalorësit Tempullarë.

Kur Abraham Linkolni u bë president i Shteteve të Unionit të Veriut më 4 mars 1861, iu ofrua mbulimi financiar po nga ata njerëz që ishin duke financuar edhe Jugun, domethënë nga bankierët masonë të Londrës. Por me një hile. Linkolni duhej të pranonte futjen në Amerikë të një "banke qendrore" private. Njëra prej arsyeve më të mëdha të shpërthimit të luftës civile ishte pikërisht fakti se dëshirohej të përfundonte Amerika në falimentim deri në atë pikë sa të detyrohej të pranonte futjen e një banke qendrore private, që të jepte financimet e nevojshme për të zhvilluar luftën. Por Linkolni nuk pranoi dhe futi një politikë të qartë e që çdo qeveri sot mund ta përshtaste, po të mos ishte e kontrolluar nga bankierët. Linkolni filloi thjesht të shtypte paranë e tij pa interesa të quajtur *greenbacks*, që e përdori për të financuar qeverinë. Presidenti Xhon F. Kenedi kishte nisur një politikë të ngjashme, që për bankierët e vëllazërisë është një ankth i vërtetë. Më 4 prill 1865 Linkolni u vra, në të njëjtën mënyrë me të cilën u vra Kenedi më 22 nëntor 1963. Vrasësi i Linkolnit ishte Xhon Uilkis Buti, një mason i gradës së 33-të, përveçse anëtar

i Amerikës së Re të Macinit[13]. Ai qe zgjedhur nga Kalorësit e Rrethit të Artë, të financuar nga ana e tyre nga bankierët masonë të Londrës. Krimi ishte orkestruar nga masoni Eduin Stantoni, që urdhëroi bllokimin e të gjitha rrugëdaljeve të Uashingtonit, me përjashtim të asaj që Buti e përdori për të dalë. Gjatë kësaj rruge, një i dehur me pamje dhe trup të ngjashëm me atë të Butit, u vra dhe trupi i tij u dogj në një hambar. Kush e "gjeti" zyrtarisht këtë njeri? Vetëm Eduin Stantoni që, natyrisht, e identifikoi menjëherë si Xhon Uilkis Butin[14]. Disa prej njerëzve të thirrur për t`u paraqitur në procesin, që duhej të hidhte dritë mbi vrasjen e Linkolnit në Indianapolis në qershor të vitit 1865, si të përfshirë drejtpërdrejt në ngjarjen, ishin: Lord Palmerstoni, kryeministër britanik dhe mason i gradës së 33-të, që vdiq po atë vit; Xhon Uilkis Buti, mason i gradës së 33-të; Xhudah P. Benjamini, zëdhënës i bankierëve masonë të Londrës, që kishin porositur vrasjen; dhe Jakob Tomsoni, ish ministër i Brendshëm, që tërhoqi 180.000 dollarë nga Banka e Montrealit, në Kanada, për të financuar krejt operacionin. Doli në dritë edhe përfshirja e Kalorësve të Rrethit të Artë dhe Albert Pajku vendosi t`u ndërronte emrin. I quajti... Ku Kluks Klan, satanistët me veshje të bardhë, që kanë terrorizuar zezakët e Amerikës. Ky emër rrjedh nga fjala greke "kuklos", që do të thotë rreth[15]. Pajku kishte lindur në Boston në vitin 1809 dhe kishte studiuar në Universitetin e Harvardit. Ishte bërë Komandant i Madh i masonerisë amerikane dhe Mjeshtër i Madh i Lozhës së Ritit Skocez të Litëll Rokut, në Arkansas, që më pas do të jetë lozha e Bill Klintonit. Kur Pajku vdiq në vitin 1891 në Uashington, funerali i tij u shërbye në tempullin mason në mesnatë, në një dhomë të veshur tërësisht me pëlhurë të zezë[16]. Ky njeri ishte një satanist me të gjitha efektet. Ai u bë një "perëndi" për masonët dhe statuja e tij ngrihet afër selisë së policisë së Uashingtonit, jo larg Kapitol Hillit.

Para vdekjes së Linkolnit, në vitin 1863, Kongresi i kontrolluar nga masonët kishte miratuar ligjin mbi sistemin bankar nacional, që krijoi një bankë nacionale me koncesion federal, e cila kishte fuqinë të emetonte kartmonedhën amerikane. Ishte fjala për kartmonedha që bankierët masonë ia huanin qeverisë me një farë përqindjeje interesi. Bankierët i kishin mbijetuar parasë pa interesa dhe ideatori i këtij ligji të ri, ministri i Thesarit i qeverisë Linkoln, Salmon P. Kashëja, u bë një hero i tillë sa masonët i dhanë emrin e tij njërës prej bankave, *Chase Bank*, që sot quhet *Chase Manhatan* dhe kontrollohet (të paktën zyrtarisht) nga David Rokfeleri. Besoj që në këtë pikë do t'ju jetë bërë e qartë se ngjarjet e mëdha, që e kanë përçarë njerëzimin, duke shkaktuar konflikte të vazhdueshme, si luftëra, përçarje fetare, e kështu me radhë, janë udhëhequr të gjitha nga i njëjti burim e nga të njëjtat plane.

Për më tepër, këto ngjarje rezultojnë të lidhura gjithmonë me të njëjtët njerëz në mënyrë me të vërtetë të mahnitshme.

Në historinë e krijimit të Shteteve të Bashkuara, që sapo përvijova, do të gjeni lidhje edhe me konfliktin në Irlandën e Veriut. Protagonist i këtyre ngjarjeve ka qenë një natyralist e kimist me emrin Eduard Bankroft, mik i ngushtë i Benjamin Franklinit, që kishte sponsorizuar dhënien e një burse studimi Bankroftit pranë atij fronti "shkencor" të elitës sikurse është *Royal Society*[17]. Më pas, ai u bë sekretar privat i Franklinit në Paris, qendër e spiunazhit të Vëllazërisë, dhe hyri për të bërë pjesë në Lozhën elitare të Nëntë Motrave, në periudhën kur Franklini mbulonte aty rolin e Mjeshtrit të Madh. Në vitin 1779, Bankrofti udhëhoqi një mision të fshehtë në Irlandë dhe, një vit më vonë, Lord Stormonti, ambasador britanik në Francë, informoi mbretin se një delegacion i fshehtë irlandez kishte qenë në Paris për të takuar mbretin Luigj XVI, për t`i propozuar një Irlandë të pavarur. Ambasadori tha se "delegatët janë të gjithë të lidhur me Franklinin..."[18]. Në vitet që pasuan u krijua një shoqëri e fshehtë në emër të Vëllazërisë, e quajtur Shoqëria e Irlandezëve të Bashkuar, midis anëtarëve të së cilës figuronin njerëz si Lord Eduard Fitzxheraldi dhe Uolf Toni[19]. Ishte kjo shoqëri që nxiti rebelimet e viteve 1798 e 1803 dhe, konflikti kështu i shpërthyer, vazhdon në Irlandë që nga ajo kohë. Do të shikoni që Vëllazëria është e përfshirë në të gjitha ngjarjet kryesore të historisë botërore. Simon Bolivari, i njohur si themeluesi i shtetit jugamerikan të Bolivisë dhe si çlirimtar i Venezuelës, i Granadës së Re, i Ekuadorit dhe i Perusë, ka qenë një anëtar i Lozhës masone të Kadiksit, në Spanjë, dhe Mjeshtër i Lozhës pariziene të Nëntë Motrave. Në këtë lozhën e fundit bënte pjesë edhe Benjamin Franklini, shkrimtari Volter dhe të tjerë revolucionarë francezë[20]. Një tufë flokësh e Xhorxh Uashingtonit i qe dërguar Bolivarit nëpërmjet revolucionarit francez e amerikan Lafajet, si dëshmi e nderimit të tij[21].

Amerika, tokë e të lirëve? Më vjen për të qeshur!

Kapitulli 10

Pará nga hiçi

Sot anëtarët dhe njerëzit fasadë të Vëllazërisë Babilonase kontrollojnë politikën, bankat, tregtitë, shërbimet e fshehta, policinë, ushtritë, arsimin dhe mediat e të gjithë botës. Ndoshta më i rëndësishmi i këtyre sektorëve, në kuptimin e kontrollit, është ai i bankave. Krijimi dhe manipulimi i parasë.

Mashtrimi, i vënë në veprim nga Vëllazëria në sektorin financiar, është shumë i thjeshtë dhe përfshin të gjithë periudhën, për të cilën jemi duke folur, që nga koha e sumerëve e të babilonasve deri sot. Bazohet mbi krijimin e parasë që nuk ekziston e që i jepet hua njerëzve dhe ndërmarrjeve në këmbim interesash. Kjo krijon një borxh shumë të madh për qeveritë, për ndërmarrjet dhe për njerëzit në përgjithësi, që janë kështu më lehtësisht të kontrollueshëm. Thelbësore në të gjithë këtë ka qenë fakti që t'u lejohej bankierëve të jepnin hua pará, të cilat nuk i zotërojnë. Funksionon kështu: nëse unë apo ju kemi një milion stërlina, mund të japim hua një milion stërlina. Shumë e thjeshtë. Por, nëse një bankë zotëron një milion stërlina, mund të japë hua dhjetë herë aq e më shumë, dhe t'i rëndojë ato para me interesa. Edhe sikur vetëm një numër i vogël i atyre njerëzve, që teorikisht kanë "pará" të depozituara nëpër banka, të shkonin sot e t'i tërhiqnin, bankat do t'i mbyllnin kanatat e dyerve

LIBRI 24

në një gjysmë ore, sepse ato pará nuk i kanë. Paraja e bankave është një mit, një tjetër mashtrim. Kur shkoni në bankë për të kërkuar një hua, banka nuk stampon as edhe një kartëmonedhë të re, as nuk pret monedha të reja. Mjaftohet të shënojë shumën e huasë suaj në llogarinë tuaj rrjedhëse. Që nga ai çast e më pas ju i paguani bankës interesa mbi atë që nuk është gjë tjetër veçse pará e shënuar në një ekran. E, megjithatë, nëse nuk arrini të shlyeni huanë që nuk ekziston, banka mund të ndërhyjë dhe, krejt sipas ligjit, t'ju shpronësojë pasuri, të cilat përkundrazi ekzistojnë, si shtëpinë, makinën, tokën dhe gjithçka që zotëroni, për një vlerë të barabartë me atë që shfaqet në ekran. Për më tepër, meqë paraja nuk vihet në qarkullim nga qeveritë, por nga bankat private, që u japin huara klientëve, bankat kontrollojnë sasinë e parasë në qarkullim. Cili është ndryshimi ndërmjet një *bumi* ekonomik (periudhë begatie) dhe një krize ekonomike (periudhë varfërie)? Vetëm një: grumbullimi i parasë në qarkullim. Kjo është e gjitha. Dhe, nëpërmjet këtij sistemi, bankat private, të kontrolluara po nga ata njerëz, vendosin se sa pará do të jenë në qarkullim. Kështu munden të krijojnë periudha begatie e periudha krize sipas dëshirës së tyre. E njëjta gjë ndodh me bursat, agjentët e të cilave zhvendosin miliarda e miliarda dollarë në ditë në rrethin e tregjeve financiare e bankare, duke përcaktuar kështu ngjitjen apo rënien e tyre, zhvillimin apo shembjen. Rëniet e bursës nuk ndodhin ashtu rastësisht, bien sepse dikush i bën të bien.

Pjesa më e madhe e "parasë" në qarkullim nuk është pará materiale, kartëmonedha e monedha. Është e përbërë nga shifra që kalojnë në mënyrë elektronike nga njëra llogari rrjedhëse në një kompiuter në një llogari tjetër, nëpërmjet urdhërxhirimeve bankare, kartave të kreditit dhe blloqeve të çeqeve. Sa më shumë pará, elektronike apo të natyrës tjetër, ka në qarkullim, aq më shumë veprimtari ekonomike mund të zhvillohen dhe, për këtë arsye, sa më shumë prodhime të blihen e të shiten, aq më të mëdha janë të ardhurat, të cilat i kanë në dispozicion njerëzit, dhe aq më të shumta janë vendet e lira të punës. Por klika financiare ariano-zvarranike ka kërkuar gjithmonë të krijojë ca *bume*, duke dhënë pa kursyer shumë huara dhe pastaj shkëput spinën. Ekonomistë dhe gazetarë ekonomikë të stërpaguar, pjesa më e madhe e të cilëve nuk e ka idenë e asaj që është duke ndodhur, do t'ju thonë se *bumet* dhe krizat bëjnë pjesë në të ashtuquajturin "cikël ekonomik". Gjepura! Bëhet fjalë përkundrazi për një manipulim sistematik të përgatitur nga Vëllazëria, për të përvetësuar pasurinë e vërtetë të botës. Gjatë një *bumi*, shumë njerëz përfundojnë të hyjnë në borxh akoma më të mëdha. Një aktivitet ekonomik në lulëzim nënkupton që ndërmarrjet të kërkojnë huara të mëtejshme, për të

blerë makineri të reja dhe për të rritur kështu prodhimin. Njerëzit kërkojnë huara për të blerë shtëpi më të mëdha e makina të reja e më të shtrenjta, sepse kanë besim në të ardhmen e tyre ekonomike. Pastaj, në çastin më të leverdisshëm, bankierët më të mëdhenj, të koordinuar nga rrjeti i shoqërive të fshehta, ngrejnë përqindjet e interesit, për të zvogëluar kërkesën e huave dhe fillojnë të kërkojnë pagimin e huave të hapura. Duke bërë kështu, huatë zvogëlohen dhe kjo sjell si pasojë zhdukjen nga qarkullimi të njësisë monetare (parasë në format e saj të ndryshme). Kjo bën të zvogëlohet kërkesa dhe sjell me vete edhe një pakësim të vendeve të punës, sepse nuk ka aq sa duhet pará në qarkullim për të ushqyer aktivitetin ekonomik. Kështu që njerëzit dhe ndërmarrjet nuk fitojnë aq sa duhet që të arrijnë të shlyejnë huatë e tyre dhe përfundojnë në falimentim. Në këtë pikë bankat përvetësojnë pasuritë e tyre të vërteta, ndërmarrjet, shtëpitë, makinat, tokën e tyre, në këmbim të pagesës së munguar të një huaje, e cila nuk ka qenë kurrë asgjë më shumë se ca shifra të shënuara në një ekran. Kjo është përsëritur me ritme të rregullta në harkun e mijëvjeçarëve, veçanërisht në shekujt e fundit, dhe pasuria e vërtetë e botës i është marrë popullsisë, duke përfunduar në duart e atyre që kontrollojnë sistemin bankar – në duart e fiseve zvarranike. E njëjta gjë vlen edhe për shtetet. Në vend që të krijojnë para të tyren pa interesa, qeveritë i marrin hua paratë nga karteli i bankave private dhe shlyejnë si interesin edhe kapitalin, duke taksuar popullsinë. Shumat fantastike të parasë, që paguani në formën e taksave, shkojnë drejt e në bankat private, për të shlyer huatë e parave, që qeveritë mund t'i krijonin vetë, duke emetuar pará pa interesa! Përse nuk e bëjnë? Sepse Vëllazëria i kontrollon qeveritë po aq saç kontrollon bankat.

Ajo që quajmë "privatizim" është shitja nën çmim, pra me humbje, e pasurive të shtetit, me qëllim për të penguar falimentimin e shkaktuar nga borxhi i krijuar prej bankave. Vendet e Botës së Tretë janë duke ia dorëzuar kontrollin e tokave dhe të burimeve të tyre bankierëve ndërkombëtarë, pasi nuk janë në gjendje të shlyejnë huatë e mëdha që u janë dhënë, qëllimisht, nga bankat pikërisht për t'i zënë në kurth në këtë situatë. Varfëria dhe konfliktet nuk janë ca fatkeqësi të pashmangshme, por janë frut i manipulimit dhe bëjnë pjesë në realizimin e Urdhërit të Ditës. Në shekujt XII dhe XIII Kalorësit Tempullarë përdorën taktikën që sapo përshkrova më lart, për të hedhur bazat e sistemit modern bankar dhe, e gjitha kjo, është qartësisht e lidhur me rrjetin venecian të Fisnikërisë së Zezë, aktive në po atë periudhë. Manipulimi financiar botëror është sot i koordinuar nga "bankat qendrore" të çdo vendi, që duket sikur janë të pavarura nga njëra-tjetra, por që në realitet bashkëpunojnë për një qëllim të përbashkët. Banka e Anglisë, e krijuar

me status mbretëror nga ai anëtar i Fisnikërisë së Zezë sikurse ishte Uilliam d'Oranzhi, është strumbullari i këtij rrjeti, sikurse është gjithashtu, që nga vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, edhe Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare në Zvicër. Ashtu si Banka e Anglisë, bankat qendrore janë krijuar nga pasardhësit e familjeve zvarranike të bankierëve gjenovezë e venecianë.

Rotshildët

Një familje me prejardhje nga ariano-zvarranikët e Perandorisë Khazar, midis maleve të Kaukazit, është ajo e Rotshildëve. Anëtarët e saj më të rëndësishëm janë zvarranikë gjakpastër, që kanë marrë në mënyrë të vetëdijshme tipare njerëzore. Nuk mund të flitet për manipulimin financiar, pa u ndalur mbi bandën e Rotshildëve. Ata kanë ndryshuar emër nga Bauer në Rotshild dhe, duke u nisur nga qendra e tyre zanafillore, Frankfurti i shekullit XVIII, u shtrinë në të gjithë botën, duke marrë kontrollin e manipulimit global deri në ditët e sotme. Dinastia e bankierëve Rotshild e ka prejardhjen nga Majer Amshel Baueri. Familjet zvarranike ndryshojnë shpesh emër, për t'i fshehur origjinat e tyre të vërteta dhe përdorin e krijojnë tituj fisnikërie, për t'ia dalë mbanë më mirë në synimet e tyre. Baueri zgjodhi mbiemrin Rotshild, që rrjedh nga fjalët gjermane "rotes Schild", shqyti i kuq i varur tek porta e shtëpisë së tij, në Frankfurt. Që nga lashtësia e kuqja ka qenë gjithmonë ngjyra simbol e revolucionit dhe kjo e shpjegon faktin se përse revolucionarët rusë i quanin të "kuqtë". Mbi shqyt paraqitej një ekzagramë, ylli i Davidit dhe vula e Solomonit, i njëjti simbol që sot paraqitet në flamurin izraelit. Njerëzit besojnë se bëhet fjalë për një simbol hebraik, për shkak të emrit dhe të përdorimit të tij, por nuk është absolutisht kështu. Njëri prej këtyre yjeve është gjetur në dyshemenë e një xhamie myslimane, që i përket 1.200 vjetëve më parë, e cila ngrihej kundrejt Tel Avivit të sotëm[1]. Autori hebre O.J. Graham thotë në librin e tij *The Six Pointed Star*:

"...ylli me gjashtë cepa e merr origjinën nga ritualet pagane egjiptiane për nder të perëndeshës Ashteroth dhe të Molokut... pastaj kaloi përmes arteve magjike, shtriganërisë (përfshirë magjistarët arabë, druidët dhe satanistët)... *përmes Kabalës së Isak Lurias, një kabalist i shekullit XVI, për të arritur deri tek Majer Amshel Baueri, që ndryshoi emër, duke përshtatur atë të këtij simboli, dhe mandej tek Knesset-i* (Parlamenti) *i shtetit të ri të Izraelit, tek flamuri izraelit dhe tek organizata mjekësore izraelite që i përkon Kryqit të Kuq"*[2].

Kështu që vetë emri "Rotshild" rrjedh nga një simbol i lashtë ekzoterik i

lidhur me Egjiptin siç ishte Moloku (Nimrodi), "perëndia" e flijimit. Ekzagrama u përdor vetëm nga krerët hebrej si simbol i ngjitjes së Rotshildëve dhe nuk ka të bëjë absolutisht aspak me "mbretin David", sikurse e dinë shumë mirë krerët hebrej. Paraqitet në flamurin e Izraelit, sepse Izraeli nuk është toka e hebrejve, por ajo e Rotshildëve dhe e atyre që i kontrollojnë që nga shkallët më të larta të piramidës së Vëllazërisë. Janë ata që e kanë krijuar Izraelin dhe që e kontrollojnë. Shqyti i kuq, i përdorur si emblemë e Ushtrisë së Shpëtimit, frymëzohej pra tek Rotshildët.

Frankfurti, qyteti i prejardhjes së dinastisë së Rotshildëve, ka qenë vendi ku u shpërnda për herë të parë paraja letër dhe, pikërisht aty, e ka selinë Banka e re Qendrore Evropiane. Kjo bankë u lejon pak bankierëve jo të zgjedhur që të përcaktojnë përqindjet e interesit për të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, që kanë hyrë në monedhën e përbashkët evropiane. Duket që Majer Amshel Rotshildi të ketë thënë: "Më jepni kontrollin mbi valutën e një kombi, dhe nuk do të më bëhet vonë fare për ata që bëjnë ligjet"[3]. Majer Rotshildi u martua me gjashtëmbëdhjetëvjeçaren Gutel Shnaper dhe prej saj pati dhjetë fëmijë, pesë femra e pesë meshkuj, që u dërguan për të krijuar degët e dinastisë në Londër, në Paris, në Vjenë, në Berlin dhe në Napoli. Bijtë e Rotshildit bënë martesa të kombinuara me fisnikët dhe midis tyre, në nivel kushërinjsh, për të mos molepsur racën zvarranike dhe për ta mbajtur pushtetin "në shtëpi". Testamenti i të parit të familjes këmbëngulte mbi këtë pikë në mënyrë të veçantë, sikurse gjithashtu edhe mbi faktin që meshkujt e familjes Rotshild duhej t'i drejtonin gjithmonë ndërmarrjet dhe se llogaritë duhej të mbaheshin absolutisht të fshehta. Testamenti përjashtonte nga ndërmarrjet dhe nga mjedisi i tyre vajzat e Rotshildëve, bashkëshortët dhe trëshëgimtarët e tyre. Jo të gjithë ata që quhen Rotshild janë satanistë, apo janë në dijeni të asaj që është duke ndodhur. Unë këtu po flas për ata që zënë majat e kësaj perandorie dhe, të njëjtat gjëra që do t'ju them, vlejnë për të gjitha familjet që do të përmend. Pjesa më e madhe e anëtarëve të këtyre familjeve do të mbeten të shastisur, kur të dëgjojnë atë që ndodh përreth tyre. Ajo që nuk dëshirojmë është një gjueti shtrigash kundër të gjithë atyre që mbajnë këtë mbiemër, apo kundër racës zvarranike në përgjithësi. Është e nevojshme të përmenden emrat e atyre që janë me të vërtetë përgjegjës, jo të kukullave të pafajshme, që i përkasin të njëjtës familjeje, apo që mbajnë të njëjtin emër.

Majer Rotshildi u bë bankier dhe manipulues i princit Vilhelm IX i dinastisë Hese-Hanau, që ishte një tjetër anëtar i familjes zvarranike të Fisnikërisë së Zezë, dhe së bashku me të merrte pjesë në takimet masonike. Sipas librit *Jews And Freemasons In Europe 1723-1939* (Hebrej dhe masonë në Evropë 1723-

LIBRI

1939), vëllai më i vogël i Vilhelmit, Karli, u pranua si kreu i masonëve gjermanë dhe anëtarët e linjës dinastike Hese ishin shumë pranë një grupi elitar të Masonerisë, të quajtur Respektim i Ngushtë. Ky i fundit mori pastaj emrin Kalorësit Përdëllimtarë të Qytetit të Shenjtë[4], të njohur në Gjermani si Sivëllezërit e Gjon Pagëzorit (emër me kod i Nimrodit)[5]. Familja Hese mbështeti Hitlerin gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe princi Filip i familjes Hese luajti rolin e kasnecit ndërmjet Hitlerit dhe Musolinit[6]. Pasi kishin zotëruar fronin britanik, Vilhelmi dhe Rotshildi bënë një pasuri të tërë, duke ia dhënë me qira ushtarët e dinastisë Hese anëtarëve gjermanë të familjes Hanovër. Shumë prej ushtarëve, që luftuan për "Britaninë e Madhe" në luftën amerikane për pavarësi, ishin mercenarë gjermanë në varësi të Vilhelmit. Vilhelmi ishte nip i Xhorxhit II, i dinastisë së Hanovërve të Anglisë, dhe kështu pra paraardhës i mbretëreshës Elisabetë II. Nëpërmjet një dege tjetër të familjes, ai është në lidhje farefisnie edhe me të shoqin e mbretëreshës, princin Filip. Vetëm Zoti e di se sa janë familjet zvarranike të dinastisë Hese, duke qenë se llogaritet që vetëm Vilhelmi ka pasur 70, po 70, fëmijë nga gra të ndryshme[7]. Ku e gjente kohën? Por kjo është një tjetër çështje e rëndësishme. Pasardhësit arianozvarranikë, të lindur përmes këtyre martesave të kombinuara, përbëjnë trashëgimtarët zyrtarë të Rotshildëve. Por mijëra kanë qenë ata të lindur në mënyrë klandestine, jashtë martese, dhe që nuk njihen si anëtarë të familjes. Megjithatë, këto prejardhje janë dokumentuar me kujdes dhe Vëllazëria e di me saktësi se kush janë këta njerëz. Është interesi i saj të dijë se cilat janë familjet zvarranike, sepse e di që kështu do të jetë më e lehtë "të lidhet" me zvarranikët e nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Kjo është njëra prej arsyeve të ekzistencës së një regjistri gjenetik mjaft të hollësishëm të mbajtur prej mormonëve, krerët e të cilëve përbëjnë një tjetër prej degëve operative të Vëllazërisë. Për këtë arsye, kur ai që mban pushtetin nuk duket se ka ndonjë lidhje gjaku me këto familje, ka më shumë gjasë që të jetë e vërtetë e kundërta. Disa hulumtues mendojnë se Bill Klintoni është një kukull e Rokfelerëve dhe ai ka me siguri një lidhje gjaku me monarkinë britanike, me të gjithë mbretërit skocezë dhe me mbretin Robert I të Francës. Shën Zhermeni, që sot është për shumë ithtarë të organizatës së fshehtë New Age një figurë "mesianike", ishte mik i Vilhelm Hese-Hanaut dhe i të vëllait, Karlit. Duket se Karli ka shkruar që Zhermeni, alkimist dhe magjistar, është rritur në Itali nga familja e De Mediçëve (Fisnikëria e Zezë)[8]. Shumë ithtarë të New Age sot flasin për Vëllazërinë e Madhe të Bardhë me "shpirtra të lartë", në të cilën bën pjesë Zhermeni. Bëhet fjalë prapë edhe një herë për një operacion të kontrollit mendor nga ana e Vëllazërisë, i kryer me qëllim për ta devijuar dhe ngujuar

degën ekstremiste të ithtarëve të lëvizjes New Age.

Konfliktet politike të shkaktuara nga Napoleon Bonaparti e detyruan Vilhelmin e dinastisë Hese-Hanau të kërkonte strehim në Danimarkë për një farë periudhe, gjatë së cilës, djali më i madh i Majer Rotshildit, Natani, edhe ai mason, i grabiti 600.000 stërlina, që Vilhelmit do të kishin shërbyer për të paguar ushtarët mercenarë. I çoi në Londër, ku themeloi një bankë të Rotshildëve. Pasuria që realizoi duke financuar luftën e Uelingtonit kundër Napoleonit dhe të tjera "investime" të manipuluara krijuan bazat mbi të cilat u mbështet dinastia. Si Uelingtoni, edhe Napoleoni, ishin të manipuluar dhe të financuar nga të njëjtët njerëz, midis të cilëve figuronte i vëllai i Napoleonit, Zhozef Napoleoni, Mjeshtër i Madh i Masonerisë. Rotshildët, duke iu referuar edhe disa prej biografive të tyre, financuan vazhdimisht që të dyja rreshtimet në çdo luftë. I arkitektonin këto luftëra nëpërmjet rrjetit të shoqërive të fshehta dhe të agjensisë së tyre të shërbimeve të fshehta, edhe sot e kësaj dite në veprim. Është fjala për Mosadin, që zyrtarisht është agjensia e shërbimeve të fshehta izraelite, por Izraeli në realitet mund të quhej Rotshaele dhe Mosadi Rotsh-ad. Anka Muhlshtejn, autori hebre i librit *Baron James, The Rise Of The French Rothschilds* (Baroni Xhejms, ngjitja e Rotshildëve francezë), mbron idenë se rrjeti familjar i shërbimeve të fshehta përdorte gërmat hebraike si kod. Hebraishtja ishte gjuha e shenjtë e shkollave misterike egjiptiane, që lanë trashëgim shumë prej nocioneve, të cilat zotërohen prej Vëllazërisë, bashkë me doktrinat e lashta të Azisë dhe të Lindjes së Largët, toka edhe ato të lidhura me fiset Khazar. Rrjeti i ndërlidhjes i Rotshildëve ishte më i shpejtë se i çdo sistemi qeveritar dhe njëri prej shembujve të famshëm të qëndrimit të lojës së dyfishtë të Rotshildëve ishte kur ata përhapën zërat se Uelingtoni ishte mundur nga Napoleoni në betejën e Vaterlosë të vitit 1815. Kjo shkaktoi një rënie të bursës së Londrës dhe Rotshildët blenë fshehurazi aksione me çmime të ulëta. Kur arriti lajmi se Uelingtoni në realitet kishte fituar, kuotat e bursës u rritën përsëri dhe Rotshildët kishin shtuar kështu shumë pasuritë e tyre. Kur, si në rastin e Rotshildëve, kontrollohen mediat, politikanët dhe bursat, të bësh pará, ashtu sikurse të bësh luftërat, është si një lojë fëmijësh. Çdo ditë çmimi botëror i arit ende caktohet pranë zyrave londineze të N.M. Rotshildit dhe bursat e të gjithë botës kontrollohen nga Vëllazëria Babilonase nëpërmjet familjeve bankiere e financiare si Rotshildët. Nëse ka një rënie të bursave dhe të bankave në Lindjen e Largët, do të thotë se kjo është parashikuar nga Urdhëri i Ditës. Një tjetër strategji e tyre është që t'i inkurajojnë njerëzit të investojnë në bursë, ku shoqëritë e kuotuara mbivlerësohen shumë. Në atë pikë, Vëllazëria bën që të bien ato kuota (jo

LIBRI 24

para se të ketë shitur aksionet e saj) dhe, ndërsa pjesa më e madhe e njerëzve humbasin paratë e tyre, Vëllazëria blen sasira shumë të mëdha aksionesh me çmime të ulëta. Tregu aksioner ngrihet, sikurse edhe vlera e shoqërive të sapoblera dhe pasuria e pushteti i Vëllazërisë forcohen më tej. Kur mbarova versionin e parë të këtij kapitulli, thashë se ishte i afërt një tjetër rënie e tregut aksioner, pasi ishin të gjitha premisat e sipërpërmendura. Ndërkohë, para se t'ia jepja shtypit librin, rënia ishte tashmë në zhvillim. Është gjithçka frut i manipulimit, me qëllimin për të arritur objektivin përfundimtar të kontrollit të plotë global.

Të krijosh luftëra është një mënyrë e jashtëzakonshme për të realizuar pasurira shumë të mëdha dhe të përmbysësh *status quo*-në. Për të financuar luftën mjafton t'u huash pará që të dyja rreshtimeve dhe pastaj t'u huash akoma më shumë për të rindërtuar vendet e tyre të shkatërruara. Do të mundeni kështu t'i kontrolloni ato vende që janë në borxh me ju, duke shtuar pasurinë tuaj, domethënë pushtetin tuaj. Ky kontroll dhe ky pushtet do t'ju japin mundësinë të ndërtoni një shoqëri të re sipas planeve tuaja, sapo që lufta e krijuar dhe e financuar nga ju do ta ketë shkatërruar strukturën e vjetër. Të ashtuquajturat *Protokolle të Paraardhësve të Zionit* u zbuluan shekullin e shkuar dhe tregojnë në mënyrë çuditërisht të hollësishme ngjarjet dhe metodat e manipulimit që kemi parë në shekullin XX. Këto dokumente kanë qenë padyshim një krijim i Rotshildëve dhe i ariano-zvarranikëve. Por në realitet nuk quhen *Protokollet e Paraardhësve të Zionit*, por *Protokolle të SION*-it, të Diellit dhe të Manastirit të Sionit. *Protokollet* dhe kush është marrë me to – përfshirë mua – janë bërë objekt i një fushate disinformacioni dhe agresioni, pasi Vëllazëria kërkon në mënyrë të dëshpëruar të diskreditojë përmbajtjen e tyre. Është e lehtë në fakt të shkosh nga përmbajtja tek origjina e atyre dokumentave. Hitleri i përdori *Protokollet* pjesërisht për të justifikuar përndjekjen e hebrejve, por ai që ia dha ato *Protokolle* ishte një agjent i Rotshildëve, që rridhte nga Kahzarët dhe që quhej Alfred Rozenberg. Nuk e pranoj tezën, sipas së cilës *Protokollet* duhej të ishin "hebraike", në kuptimin më të zakonshëm të këtij termi. Ato janë vepër e ariano-zvarranikëve dhe na paraqiten si "hebraike", për të na shmangur nga rruga.

Rotshildët u bënë njëra prej familjeve më të rëndësishme për Urdhërin e Dites financiar e politik të Vëllazërisë dhe vazhduan të kushtëzojnë gjithçka që ndodhte në Evropë, para se të shtriheshin në Amerikat, në Afrikën e Jugut dhe mandej në pjesën tjetër të botës. Ata që hynin në borxhe kundrejt tyre ishin kokat e kurorëzuara të të gjithë Evropës, përfshirë dinastinë e Fisnikërisë së Zezë, domethënë Habsburgët, të cilët qeverisën Perandorinë e Shenjtë

Romane për 600 vjet. Rotshildët morën edhe kontrollin e Bankës së Anglisë. Kur shpërthente një luftë, prapa kuintave ishin Rotshildët, që krijonin konfliktin dhe financonin që të dyja rreshtimet. Krerët e Rotshildëve nuk janë hebrej, janë zvarranikë, që kanë bërë të vdesin shumë hebrej, për të kënaqur ambicien e tyre të neveritshme. Ata kanë qenë ortakë në tregti me familjen e Uindsorëve dhe kanë kontrolluar njerëz si Eduardi VII, Mjeshtër i Madh i masonerisë angleze. Eduardi ishte i biri i mbretëreshës Viktoria dhe i princit Albert, mason gjerman. Mountbatenët (me origjinë nga Batenbergu i Gjermanisë) kanë lidhje gjaku me Rotshildët dhe Lordi Luis Mountbaten kombinoi martesën e mbretëreshës Elisabetë II me nipin e tij, princin Filip, dy pinjollë me gradë të barabartë të Fisnikërisë së Zezë. Mountbateni ka qenë edhe këshilltar i princit Karl. Dhe kuadri plotësohet kur disa prej viktimave të riteve satanike më rrëfejnë se Lordi Luis Montbaten figuronte midis përdhunuesve të tyre. Rotshildët dhe Bauerët (edhe Bower) janë ithtarë të vjetër të satanizmit dhe si Rotshildët, edhe Uindsor-Mountbatenët, i përkasin racave zvarranike, që rrjedhin nga anunakët. Bauerët, në mënyrë të veçantë një njeri me emrin Riçard Bauer, ishin alkimistë dhe magjistarë të famshëm të Gjermanisë mesjetare[9]. Karl Marksi, njeriu që i shërbeu Vëllazërisë për të krijuar komunizmin, ishte nxënës i Bruno Bauerit në Universitetin e Berlinit dhe ky Bauer ka qenë i vetmi studiues i *Biblës*, që ka shkruar publikisht se Testamenti i Ri ishte një sintezë e ideve të Senekës dhe të Jozefusit (Pizones)[10]. Ai ka thënë edhe se Jezusi ishte një trillim i autorit të *Ungjillit të Markut*[11]. Ja, pra, një provë e mëtejshme e faktit se familjet e Vëllazërisë kanë qenë gjithmonë në dijeni të së vërtetës.

Rotshildët bënin pjesë në Lidhjen Tugenbund (e quajtur edhe Lidhja e Virtytit) që ishte krijuar në vitin 1786 si "shoqatë seksuale". Anëtarët e saj, me gratë dhe vajzat, takoheshin në shtëpinë e një gruaje me emrin Henrieta Herc dhe merrnin pjesë në lojëra dhe në rite seksuale. Midis tyre figuronin të dy vajzat e Moisi Mendelsonit, agjentit të Rotshildëve, përgjegjës i manipulimit që çoi në Revolucionin Francez; markezi i Mirabosë, një tjetër mason thellësisht i përfshirë në revolucion; dhe Frederik fon Gentzi, që do të bëhej pastaj një agjent me shumë ndikim i Rotshildëve[12]. Në vitin 1807, u krijua Lidhja e dytë e Tugenbundit, që i pa përsëri Rotshildët midis pjesëmarrësve të saj. U krijua nga baroni fon Shtejn dhe u zgjerua me shpejtësi, gjersa përfshiu pjesën më të madhe të politikanëve më të spikatur të Gjermanisë, përveçse shumë krerë ushtarakë dhe profesorë të letërsisë e të shkencës. Aty hyri edhe Uiliami i dinastisë Hese-Kasal dhe detyra zyrtare e kësaj lidhjeje të dytë ishte t'i kundërvihej pushtimit napoleonian të Gjermanisë[13]. Ajo lidhje

LIBRI

ishte afër grupeve të tjera masonike si Kalorësit e Zinj, Kalorësit e mbretëreshës së Prusisë dhe Konkordistët. Të gjitha këto grupe frymëzoheshin tek Kalorësit e lashtë Teutonë gjermanë dhe u bënë model për shoqëri të mëpasshme, si Shoqëria e Tulës, *Edelweiss*-i dhe *Vril*-i, që do t'i jepnin pastaj jetë Partisë Naziste. Bëhet fjalë gjithmonë për të njëjtën fytyrë, që merr një maskë të ndryshme dhe Rotshildët kanë vepruar gjithmonë në hije të këtyre grupeve, përfshirë nazistët. Në fund të fundit, nëse gërmohet në thellësi, vihet re se të gjitha këto shoqëri kanë një rrënjë të përbashkët.

Ky rrjet në dukje aq i ndërlikuar (por në realitet shumë i thjeshtë) bankash, industrish, partish, mediash e shoqërish të fshehta, kontrollon botën për llogari të qendrës operative të Vëllazërisë në Londër. Kontrolli i parasë dhe i bankave nëpërmjet Rotshildëve dhe të tjerëve është themelore për të gjithë këtë. Njëra prej lëvizjeve më të rëndësishme të Vëllazërisë ka qenë krijimi në vitin 1913 i Rezervës Federale, e ashtuquajtura "bankë qendrore" e Shteteve të Bashkuara. Ky institucion nuk është as federal, as nuk mund të quhet një rezervë. Bëhet fjalë për një kartel bankash private në pronësi të 20 familjeve themeluese, për më tepër evropiane, që sot vendos përqindjet e interesit për Shtetet e Bashkuara dhe i jep hua para inekzistuese (shifra mbi një ekran) qeverisë amerikane, mbi të cilën pastaj taksapaguesit duhet të paguajnë interesat. Kjo është ajo që e quajmë "defiçiti amerikan", domethënë ajër i freskët. Qeveria federale e Shteteve të Bashkuara nuk zotëron asnjë aksion të vetëm të Rezervës Federale dhe qytetarët amerikanë nuk mund t'i blejnë. Përfitimet i kalojnë 150 miliardë dollarë në vit dhe Rezerva Federale nuk ka publikuar kurrë as edhe një herë në harkun e historisë së vet bilancin e saj. Këto të ardhura janë siguruar sepse: 1.Vëllazëria kontrollon qeverinë amerikane (emri i dytë i së cilës është *Virginia Company*), që vazhdon të marrë "para" hua nga Rezerva Federale; 2.Kontrollon edhe Shërbimin e Detyrimeve të Brendshme (IRS), organizatën teroriste ilegale dhe private që vjel taksat; 3.Kontrollon mediat, për të bërë të mundur që popullsia të mos e marrë vesh kurrë atë që u tha në pikat 1 dhe 2.

Vëllazëria dëshironte prej kohësh një "bankë qendrore" private në Amerikë, për të kurorëzuar kontrollin e vet mbi ekonominë. Kur masoni më i spikatur, Xhorxh Uashingtoni, u bë presidenti i parë, emëroi një njeri kukull të Vëllazërisë, me emrin Aleksandër Hamilton, si ministër të Thesarit. Hamiltoni themeloi Bankën e Shteteve të Bashkuara, një bankë qendrore private, e cila filloi t'i jepte para hua qeverisë së Shteteve të Bashkuara, duke siguruar kështu që në fillim kontrollin mbi të. Nëse shikoni se çfarë ndodhi kur Fisnikëria e Zezë krijoi Bankën e Anglisë, do t'ju kujtohet se skenari është

saktësisht i njëjti. Banka e Shteteve të Bashkuara shkaktoi kështu shumë mjerime, falimentime e rebelime, saqë u mbyll, por u zëvendësua shpejt nga Rezerva Federale. Njësia më e madhe operative e Rotshildëve në Amerikë, në pjesën e parë të shekullit XX, ka qenë *Kuhn, Loeb and Company* e Nju Jorkut, e kryesuar nga Jakob Shifi. Familja Shif kishte jetuar në të njëjtën shtëpi të Frankfurtit, ku kishte banuar edhe themeluesi i familjes Rotshild, Amsheli. Në vitin 1902, Rotshildët dërguan në Amerikë agjentët e tyre, Pol e Feliks Varburgun, për të ideuar krijimin e Rezervës Federale. Vëllai i tyre, Maks Varburgu, nuk doli sheshit dhe vazhdoi të drejtonte bankat e familjes, që ishin krijuar në Venecie nga paraardhësi i tij, Abraham del Banko. Kur Varburgët arritën në Shtetet e Bashkuara, Poli u martua me Nina Loebin e kompanisë *Kuhn, Loeb and Company*, ndërsa Feliksi u martua me Frida Shifin, të bijën e Jakob Shifit. Bëhej fjalë për të satat martesa të kombinuara, që u përgjigjeshin kërkesave të Vëllazërisë dhe Urdhërit të saj të Ditës. Që të dy vëllezërit u bënë ortakë të *Kuhn, Loeb and Company* dhe, në fillim të shekullit XX, Polit iu dha një rrogë vjetore prej rreth një milion dollarësh. Janë këto shifrat, me të cilat ndeshesh, kur flitet për financat e kësaj klike. Mund ta përfytyroni shumë mirë në sa arrijnë sot.

Rrjeti i Vëllazërisë e vërtiti në atë mënyrë që, "demokrati" dhe trëndafilkryqëtari Vudrou Uillson, të zgjidhej president në vitin 1909 dhe sekretari i tij servil ishte një anëtar i spikatur i Vëllazërisë, i quajtur "kolonel" Mandel Hauzi. Uillsoni fliste për të si "vetja ime e dytë", "alter egoja im", dhe ka thënë: "Mendimet e tij dhe të miat janë një gjë e vetme". Kurrë një president nuk ka thënë gjë më të vërtetë. Sikurse sot është e dokumentuar mirë nga shumë studime, bankierët e elitës, që formonin kartelet Rokfeler-Morgan-Rotshild-Harriman, u takuan fshehurazi në Xhekil Island, në Xheorxhia, për të diskutuar taktikat dhe natyrën e ligjit që donin të arrinin të miratohej, për t'i dhënë jetë bankës aq shumë të dëshiruar. Duket se Xhekil Island ishte pronë e Paisuave dhe çdo anëtar i grupit ishte një administrator kujdestar i Paisuasë. Zëdhënësi i tyre politik ishte senatori Nelson Aldrish, gjyshi i Nelson Rokfelerit, i zgjedhur për katër herë guvernator i Nju Jorkut dhe zëvendëspresident i Shteteve të Bashkuara, kur Xherald Fordi zëvendësoi Riçard Niksonin pas skandalit të Uatergejtit të vitit 1974. E bija e Aldrishit, Abi, u martua me Xhon D. Rokfelerin i riu. Kur ligji, që krijonte Rezervën Federale, po bëhej gati të paraqitej në Kongres, bankierët që e kishin shkruar, e kritikuan ashpër dhe publikisht. Bankierët ishin tashmë shumë jopopullorë dhe donin të jepnin përshtypjen se ligji ishte në dëm të tyre, duke rritur kështu miratimin popullor në favor të miratimit të tij. Ky tip manipulimi është i

përsëritur dhe nuk duhet marrë kurrë parasysh ajo që dikush thotë publikisht, por duhet pyetur gjithmonë vetja "Kujt i leverdis kjo gjë?" dhe "Kujt i leverdis që unë të besoj në atë që më thuhet?"

Ligji u miratua pikërisht para Krishtlindjeve të vitit 1913, kur shumë deputetë ishin tashmë në shtëpi me pushime me familjet e tyre. Tani bankierët mund të kontrollonin përqindjet e interesit dhe të realizonin një pasuri të tërë, duke i dhënë qeverisë hua para inekzistente dhe duke e ngarkuar me interesa. Për të plotësuar ciklin, megjithatë, duhej të siguronin të ardhura të vazhdueshme që të financonin qeverinë dhe, në vitin 1913, futën kështu një taksë federale mbi të ardhurat. Për ta arritur këtë, iu desh të bënin një ndryshim neni, të nenit 16, në Kushtetutën amerikane, i cili kërkonte miratimin e të paktën 36 shteteve. Vetëm dy shtete e dhanë miratimin, por Filander Knoksi, Sekretar i Shtetit, njoftoi thjesht se shumica e kërkuar ishte arritur dhe ligji u miratua. Deri sot vjelja e detyruar e taksës federale mbi të ardhurat është e paligjshme dhe, megjithatë, Shërbimi i Detyrimeve të Brendshme vazhdon të kërkojë pagimin e kësaj takse në të gjithë Shtetet e Bashkuara. Dikush mund të thotë se është e tepruar ta quash një operacion terrorist, por, për të terrorizuar dikë, nuk ka nevojë të përdorësh ndonjë pushkë, apo ndonjë bombë. Mund ta bësh edhe duke kërcënuar me heqjen e mjeteve të jetesës dhe me shpronësimin e shtëpisë, për pagesën e munguar të një takse, që është e paligjshme. Tashmë që e keni kuptuar, do të doja të vinit re vitin kur kanë ndodhur këto dy ngjarje, krijimi i Rezervës Federale dhe vendosja e taksës federale mbi të ardhurat: 1913. Numrat dhe vitet janë të rëndësishëm për këta njerëz për shkak të Diellit dhe të cikleve astrologjike, prandaj mund të mendojmë se nuk ka qenë fjala për një rastësi të thjeshtë. Mendoni njëherë se sa ankth e merak të madh kanë ushqyer gjithmonë për numrin 13 që të gjithë grupet që kanë në krye Vëllazërinë. Kur Rokfelerët krijuan Këshillin e tyre të qeverisjeve shtetërore, për të kontrolluar legjislaturat shtetërore amerikane, zgjodhën si seli një ndërtesë që ishte e shënuar me numrin 1313. Për të njëjtën arsye, shumë gjëra ndodhën në vitin 1933, sepse 33-shi është njëri prej numrave kryesorë ekzoterikë, që përfaqësojnë një frekuencë dridhëse.


Shërbimi i Detyrimeve të Brendshme, që vjel taksat në Amerikë, është edhe një ndërmarrje private, ndonëse njerëzit besojnë se është pjesë e qeverisë. Në vitin 1863 u krijua Zyra e Tatimeve e ngarkuar me vjeljen e taksave, por në vitin 1933, prapë ai vit, u krye një lëvizje tjetër në dëm të popullit amerikan. Tre anëtarë të rrethit të Preskot Bushit, Helen e Klifton Bartoni dhe Hektor Eçeverria, krijuan Shërbimin Vjelje Taksash dhe Revizionim Kontabël, me

LIBRI

qendër në Delauar, shteti hije i konfederatës, ku nuk shtrohen shumë pyetje. Preskot Bushi ishte i ati i Xhorxh Bushit. Në vitin 1936, ky institucion ndryshoi emër dhe u bë Zyra e Tatimeve dhe u ngarkua të vilte të gjitha taksat, edhe ato të paligjshme. Kjo zyrë kontrollohet nga të njëjtët njerëz që zotërojnë Rezervën Federale dhe korporatën *Virginia Company* dhe është duke i tharë burimet amerikane. Shërbimi Vjelje Taksash u krijua, në mënyrë të qartë, nga nazistët amerikanë, të cilët financonin Adolf Hitlerin, nën koordinimin e Preskot Bushit, të atit të Xhorxhit.

Shtriganët e Vëllazërisë Babilonase e kanë shtrirë që nga kohërat e lashta fillin e tyre të mashtrimeve, por, meqë në publik kapardisen me kostume elegante, duke u rezervuar t'i veshin pelerinat e gjata dhe maskat satanike gjatë ritualeve të tyre private, pjesa më e madhe e njerëzve gati nuk arrin ta kuptojë të vërtetën e asaj çka është duke u zhvilluar para syve të tyre.






Në të majtë, statuja e Gjarpërit me Krahë në qendër të Temple Bar-it, në Londër, në zonën dikur pronë e Kalorësve Templullarë dhe ku kishin selinë e tyre disa prej shoqërive të fshehta më të rëndësishme, që kryesohen nga Vëllazëria Babilonase.



Në të djathtë, dragoi me krahë e zjarrtë i vendosur në hyrje të distriktit financiar të Sitit të Londrës, njëra prej institucioneve më të rëndësishme të planetit për Vëllazërinë. Kryqi i kuq në sfondin e bardhë ishte një simbol i Diellit dhe logoja e Kalorësve Templullarë, ndërsa sot paraqitet në flamurin e Anglisë.




Sipër, statujë figure zvarraniku e gjetur në varret e popullit ubaid, që ka jetuar në Irakun aktual deri rreth vitit 4000 para Krishtit. Si e ëma edhe fëmija paraqesin tipare formëhardhuce. Kjo kulturë i përket një periudhe përpara përmbytjes së shkaktuar nga Afërdita, që sipas gjasës i detyroi zvarranikët e mbijetuar të gjenin strehim nën tokë, apo në përmasa të tjera.




Sipër, gorgola e gjarpërinj me krahë janë vendosur me bollëk në katedralen Notre Dame të Parisit dhe shumë prej tyre janë riprodhime të zvogëluara të simboleve formëgjarpërinjsh në vendet e popullsisë maja të Meksikës. Gargolat janë simbole të zvarranikëve dhe qenë përshtatur prej shoqërive të fshehta të Vëllazërisë, veçanërisht prej Kalorësve Templullarë, për të "zbukuruar" një pafundësi katedralesh, kishash e banesash rezidenciale të familjeve fisnike, përveç ndërtesave të tjera.


Poshtë, Kali i Bardhë i Uffingtonit, në Uiltshir, që i përket një periudhe 3000 vjet përpara Krishtit, epokës kur fenikasit u vendosën në Britaninë e Madhe. Kali i bardhë ishte një simbol fenikas i Diellit.


LIBRI







Këto ilustrime të realizuara nga artisti Kliv Barrou i ishullit Uajt, tregojnë atë që njerëzit shikojnë kur ca qenie njerëzore marrin tipare zvarranike. Ky shndërrim është veçanërisht i shpeshtë midis liderve politikë, financiarë, industrialë dhe ushtarakë të të gjithë botës.











Këto ilustrime të tjera të Kliv Barrout tregojnë se si zvarranikët mund të errësojnë një qenie njerëzore, edhe pse duke mos e zotëruar fizikisht trupin e tyre. Për këto vizatime Barrou është bazuar tek dëshmitë e njërit prej shumë njerëzve të takuar prej meje, që i kanë parë zvarranikët e nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Dy prej chakra-ve më të poshtme i afrojnë me qeniet njerëzore.








Një pikturë e Tredo Mjutvas për një prej zvarranikëve që, pohon ai, kanë kontrolluar Afrikën dhe botën për mijëra vjet.

Figurat e lashta të pranishme në faqet e mureve të tempullit të Saqaras, në Egjipt, që paraqesin një prej hyjnive egjiptiane. Nëse vrojtoni imazhin e zmadhuar të kësaj hyjnie, do të vini re se ajo duket sikur imiton pikë për pikë në mënyrë të jashtëzakonshme përshkrimet e "racës gjarpër". Mua më duket madje se ka krahë, si nga me krahë e Drakove.







Simbolet e kryqëzimeve ndërmjet jashtëtokësorëve dhe qenieve njerëzore, mbi një gjerdan të realizuar nga Vredo Mjutvn, që i përket një periudhe më shumë se 500 apo njëmijë vjetëve më parë.


Jashtëtokësori është realizuar në formë simbolike, pasi njerëzve u është bërë të besojnë se do të vdisnin, nëse do të zbulonin tiparet e vërteta.

Gjerdani mbajnë edhe një disk futuristik, që zvarranikët do ta kenë përdorur për t'u zhvendosur.


LIBER27



Papa me kësulën e tij në formën e kokës së peshkut, simbol i hyjnisë babilonase Nimrod.



Pëllumbesha mbi skeptrat mbretërorë britanikë. Pëllumbesha është simbol i mbretëreshës babilonase Semiramidë, shoqja e Nimrodit. Vini re edhe përdorimin e kryqeve malteze të gjetura në disa shpella në rajonin turk të Kapadokias, dikur e banuar nga fenikasit.



Kryqi maltez mund të shihet edhe mbi kurorën britanike...







...dhe mbi uniformën naziste. Përkrahësit fanatikë të Hitlerit përshtaten edhe kafkën me kockat, kryqin e thyer të përmbysur (simbol fenikas i Diellit) dhe shqiponjën, një simbol që ka rrjedhur nga zogu diellor fenikas-egjiptian, Feniksi.









Londra, Parisi e Uashingtoni dhe shumë qytete të tjera të mëdha kanë qenë projektuar sipas ligjeve të gjeometrisë së shenjtë dhe paraqesin shumë ndërtesa e monumente jashtëzakonisht të ngjashme. Kupolat dhe obeliskët mbizotërojnë mbi gjithë të tjerat. Këtu, nga e majta në të djathtë, kemi katedralen e Shën Palit (Londër), Pantconin (Paris) dhe pallatin e Kongresit (Uashington)...








...dhe (nga e majta në të djathtë) obeliskun egjiptian të quajtur "Cleopatra`s Needle" në Londër, obeliskun e ardhur nga Luksori në Sheshin Konkord në Paris dhe monumentin e Uashingtonit në Uashington DC.


LIBRI




Në të majtë, flaka e përjetshme, simboli klasik i Vëllazërisë Babilonase. Këtu ai që e mban në dorë është heroi i Vëllazërisë, Prometeu, në Qendrën Rokfeler të Nju Jorkut...


...ajo është e dukshme edhe mbi Statujën e Lirisë, në një ishull të portit të Nju Jorkut (në të majtë) dhe mbi kopjen e saj të përpiktë, në një ishull të lumit Sena, në Paris (në të djathtë).

Flaka është përdorur si nënshkrim i Vëllazërisë pas vrasjeve të kryera prej saj. Një flakë është vendosur mbi varrin e presidentit Kenedi në varrezën Arlington (poshtë) dhe masonët kanë [illegible] në krye në Sheshin [illegible] vendit ku u vra.











Një kopje e flakës së Statujës së Lirisë e vendosur në qendër të një ylli të zi pesëcepash ngrihet sipër tunelit të Pont de l'Alma-s, në Paris, ku vdiq Dajana.


Një vazo hiri dhe një flakë janë vendosur në ishullin ku është "varrosur".







Ishulli ku thuhet se është varrosur Dajana, në mes të një liqeni në rezidencën e familjes Spenser pranë Parkut Altorp, në Northamptonshir. Ishujt, liqenet dhe pyjet e vegjël janë të gjithë simbole, që përmendën në legjendën e lashtë të hyjneshës Diana.



Harku i Triumfit, qendra simbolike e Diellit brenda skemës së pamatë gjeometrike rrugore të Parisit. Dymbëdhjetë rrugë të çojnë tek "Étoile", ose rrethi yjor dhe rrezet e diellit janë ravijëzuar deri madje mbi shesh. Harku është i orientuar në mënyrë të përkryer ne Champs Elysées dhe me të tjerë harqe, me obeliskun e Luksorit të Sheshit Konkord dhe me piramidën e stërmadhe prej xhami të zi të ndërtuar në pjesën e jashtme të Muzeut të Luvrit.




Vargani i automobilave të presidentit Kenedi në Sheshin Dejli në çastin kur u vra, më 22 nëntor 1963 – 656 vjet pasi Inkuizicioni kishte nisur spastrimin e Kalorësve Templarë. Vini re që automobili i Kenedit, në plan të parë, nuk është i shoqëruar nga truprojet, ndërsa ai prapa ka plot katër! Vrasjet nuk ndodhin aq rastësisht, është gjithmonë dikush që i bën të ndodhin.




Në të majtë, tuneli i Pont de l'Alma-s, ura apo vendi i hyjneshës Hënë, dhe sipër tunelit janë kryqëzimet, të cilave tradicionalisht i bashkëshoqërohet Hekati.






Njëra prej 17 telekamerave me qark të mbyllur (në të djathtë në kuadrim), të pranishme gjatë rrugës që shkon nga Ritzi në Pont de l'Alma, është kthyer drejt hyrjes së tunelit (në të djathtë). Duhej ta kishte parë, pra, makinën e Dianës, që po hynte në tunel dhe të regjistronte gjithçka që ndodhi. Por si të gjitha të tjerat, në atë çast ishte e fikur.




Në të djathtë, Mercedesi i shkatërruar pasi ishte përplasur pas shtyllës së trembëdhjetë (sipër). Diana vdiq në atë vend të lashtë flijues kushtuar hyjneshës Diana.







Mohamed al Fajedi (sipër) me kokoren simbolike të Diellit në një fotografi të publikuar nga Daily Exspress. Luani i artë është një simbol i kultit të Diellit dhe dy brirët janë të ngjashëm me ata që thuhej se mbante Nimrodi i Babilonisë. Kjo kokore është jashtëzakonisht e ngjashme me atë të mbajtur nga Isida (sipër, në të djathtë) në paraqitjet figurative egjiptiane.









(Nga e majta në të djathtë) Henri Pol u bë dashi i kurbanit i aksidentit, ndërsa truproja Trevor Res-Xhonsi dhe i vëllai i Dajanës, konti Spenser, duhet t'u përgjigjen ende një sërë pyetjesh.

Bufi i lartë rreth 12 metra pranë zjarrit flijues të Pyllit Bohem në Kaliforninë veriore, gjatë një kampi veror të Elitës së Vëllazërisë Babilonase. Bufi është një simbol i Molokut, hyjnisë, në nderim të së cilës në botën e lashtë digjeshin – dhe digjen ende sot – të gjallë fëmijët.







Prapë obelisku dhe kupola. Një fotografi artistike që paraqet pallatin Canary Wharf në brigjet e Tamizit, ndërtesa më e lartë e Evropës dhe, në bregun e kundërt ndërtesa e re e Millennium Dome. Meridiani zero i Grinuiçit kalon, jo rastësisht, afër këtij vendi.



Pushtim jashtëtokësor? Jo, manipulim nga ana e Vëllazërisë. Ky thuhet se është VRIL-7, njëri prej "disqeve fluturuese" naziste të realizuar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas i përsosur në Shtetet e Bashkuara e gjetkë.

LIBRI

Kapitulli 11

Babilonia globale

Shfrytëzimi i atij kontinenti të mahnitshëm, siç është Afrika, është një shembull klasik i asaj që ka ndodhur në shumë pjesë të botës. Ky operacion i turpshëm, i udhëhequr nga Rotshildët, nga Openhajmerët, nga Sesil Rodi, nga Alfred Milneri, nga Zhan Smutsi dhe një sërë e pafund emrash të tjerë, ka qenë organizuar nëpërmjet një shoqërie të fshehtë të elitës, e njohur si Tavolina e Rrumbullakët dhe e themeluar në vitet e fundit të shekullit XIX. Në krye të kësaj shoqërie ishte Sesil Rodi, që deklaroi se dëshironte të krijonte një qeveri botërore, qendra e së cilës të ishte Britania e Madhe. Ai ka qenë në krye të korporatës *South Africa Company* dhe themeloi shoqëri si *De Beers Consolidated Mines and Gold Fields*. Sesil Rodi ka qenë edhe kryeministër i Kolonisë së Kejptaunit dhe, një ish agjent i fshehtë MI6 (*Shërbimi sekret i informacionit dhe spiunazhit ushtarak anglez*), Xhon Kolemani, thotë se ka qenë anëtar i një organizate të quajtur Komiteti i 300-ve, i njohur edhe si Olimpikët. Është fjala për treqind familje, të cilat, brez pas brezi, qeverisin botën nën drejtimin e përgjithshëm të grupeve edhe më të vegjël, që zënë nivelet më të larta të piramidës. Do të përdor shkurtimin "Kom 300", për t'iu referuar të tjerëve që, sipas Kolemanit, bënin pjesë në këtë organizatë[1]. Një njeri që ka punuar në nivelet më të larta të botës

LIBRI 24

finaciare, sidomos në Zvicër, mendon se këto 300 familje janë më zvarraniket e planetit dhe kjo i bën të përshtatshme që të bëjnë pjesë në këtë rrjet. Sesil Rodi e ka nisur karrierën e tij të manipuluesit teksa ishte ende student në Universitetin e Oksfordit, qendër e formimit për anëtarët e Vëllazërisë. Udhëheqësi i tij ishte Xhon Ruskini, profesori i arteve të bukura, që në Oksford konsiderohet ende një legjendë. Ruskini ka deklaruar se besonte në pushtetin e centralizuar, në të cilin shteti zotëron mjetet e prodhimit dhe të shpërndarjes. Idetë e tij do të përbënin pastaj, deri pak kohë më parë, bazat e ideologjisë zyrtare të Partisë Laburiste Britanike dhe qenë marrë edhe nga Karl Marksi e Frederik Engelsi në shkrimet e tyre e mbi ato u bazua komunizmi marksist, që do të robëronte më pas kombet e Evropës Lindore. Shumë studiues mendojnë se Ruskini ka pasur lidhje me Mendjendriturit Bavarezë dhe se ka frymëzuar lindjen e Shoqërisë Fabiane (*lëvizje politike me tendencë socialiste reformiste, e lindur në Angli në fund të shekullit XIX, nga e cila e ka pasur origjinën laburizmi*), një tjetër instrument operativ i Vëllazërisë, i cili vazhdon të manipolojë Partinë Laburiste Britanike, përveçse vepron në sektorë të tjerë të ndryshëm. Ruskini thelloi studimin e veprave të Platonit, sikurse bënë edhe pjesa më e madhe e klonëve të Vëllazërisë, midis të cilëve Sesil Rodi, Engelsi, Ueishaupti, Rotshildët, Moisi Mendelsoni, njëri prej manipuluesve kryesorë të Revolucionit Francez. Sesil Rodi ushqente një druajtje aq plot nderim kundrejt Ruskinit, sa që e kopjoi me dorë ligjëratën e tij përuruese dhe e ruajti për tërë jetën. Ruskini ushtroi një magji të jashtëzakonshme mbi shumë prej të diplomuarëve të Oksfordit e të Kembridxhit, sa që do të bëhej pastaj pjesë e tyre në manipulimin e shekullit XX, përfshirë Alfred Milnerin, bankierin e kontrolluar nga elita.

Ndërsa Rodi ishte njeriu fasadë i Tavolinës së Rrumbullakët, ata që kishin kontrollin ishin Rotshildët dhe familje të tjera të Vëllazërisë, si Astorët dhe Sesilët. Astorët ishin financues të rëndësishëm të organizatave të Vëllazërisë, si Instituti Mbretëror i Çështjeve Ndërkombëtare, njëri prej krerëve të të cilit Ualdorf Astori ishte. Astorët ishin edhe në qendër të shoqërisë së njohur si Grupi i Klivedenit, nga emri i pronës tokësore me të njëjtin emër. Emri Astor rrjedh nga perëndesha e lashtë Ashtoreth. Njëri prej Sesilëve ishte Lord Salsburi (Kom 300), kryeministër britanik dhe ministër i Jashtëm në periudhën kur Tavolina e Rrumbullakët ishte duke arkitektuar luftën boere ne Afrikën e Jugut, që shkaktoi vdekjen e mijëra burrave, grave dhe fëmijëve. Shumë prej tyre vdiqën në kampet e përqëndrimit të masonit Lordit Kitçener (Kom 300). Lord Salsburi ishte mik i ngushtë i Uinston Churçillit, një tjetër njeri-fasadë i Vëllazërisë, që do të ishte treguar pastaj tepër i rëndësishëm gjatë Luftës së

Dytë Botërore. Nëpërmjet kësaj veprimtarie manipulimi dhe këtij genocidi, Sesil Rodi dhe Tavolina e Rrumbullakët siguruan kontrollin e minierave të Afrikës së Jugut, gjë që ndodh akoma sot e kësaj dite nëpërmjet familjes Openhajmer. Vetë Bashkimi i Afrikës së Jugut ishte krijuar nga Tavolina e Rrumbullakët, pas një fushate të drejtpërdrejtë nga bankieri Alfred Milner (Kom 300), që vepronte edhe si manipulues për llogari të Rotshildëve dhe që, në vitin 1902, pas vdekjes së Rodit, u bë kreu i ri i shoqërisë së fshehtë. Në testamentin e tij Sesil Rodi i la ca fonde Tavolinës së Rrumbullakët, ndonëse financuesit e saj kryesorë ishin Rotshildët. Në mënyrë të veçantë, la një shumë të konsiderueshme për të financuar një projekt të njohur si "bursa studimi Rodi". Këto bursa u jepen një numri të përzgjedhur studentësh të përtejoqeanit (të përzgjedhur nga Vëllazëria) që frekuentojnë kështu Universitetin e Oksfordit, ku atyre u ngulitet Urdhëri i Ditës i "qeverisë botërore". Numri i atyre që, prej këtyre studentëve, kthehen në vendet e tyre të origjinës dhe shkojnë të mbulojnë pozita pushteti të hapur, apo të fshehtë, është jashtëzakonisht i lartë dhe procesi i përzgjedhjes bazohet më së shumti mbi dallime gjenetike e shoqërore. Për shembull, sot bursisti më i famshëm i "bursës së studimit Rodi" është Bill Klintoni, ish presidenti i Shteteve të Bashkuara, dhe ka përfituar një "bursë studimi Rodi" edhe këshilltari i tij kryesor në të dyja zgjedhjet, Xhorxh Stefanopulos. Krerët e së ardhmes nuk zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve, ata formohen e manipulohen mendërisht që në moshë të njomë, në mos që nga lindja, me qëllim që të jenë të gatshëm për të mbuluar këto pozita, siç do ta shohim më pas. Një tjetër njeri i përzgjedhur për një "bursë studimi Rodi" ka qenë Fred Franci, ish president i Shoqërisë së Kullës së Rojes (Dëshmitarët e Jehovait), që s`e pranoi ftesën në Oksford, duke u vënë përkundrazi në shërbim të Vëllazërisë dhe duke zëvendësuar kreun e Dëshmitarëve të Jehovait, masonin Çarls Taze Rasëll, i vrarë gjatë një rituali natën e Hallouinit të vitit 1916[2]. Revista e Dëshmitarëve të Jehovait, *Kulla e Rojes*, është një grumbullim simbolesh ekzoterike dhe imazhesh sublime. Edhe Xhorxh Estebruku, që u ka mësuar teknikat e hipnozës dhe të kontrollit mendor shërbimeve të fshehta britanike, ka përfituar një "bursë studimi Rodi"[3]

Brenda vitit 1915 të tjera degë të Tavolinës së Rrumbullakët ishin krijuar në Afrikën e Jugut, në Kanada, në Shtetet e Bashkuara, në Australi, në Zelandën e Re dhe në Indi. Në Shtetet e Bashkuara, Tavolina e Rrumbullakët dhe krejt rrjeti, përfaqësoheshin nga familje e financierë që kishin ardhur nga Evropa, si Rokfelerët, J.P. Morgani dhe Eduard Harrimani, edhe pse, siç e kemi parë, bëhej fjalë për ca të pasur "servilë", që duhej t`u përgjigjeshin

LIBRI

pushteteve më të forta. Ata përdorën financime të Rotshildëve dhe të Paisuasë, për të krijuar perandori të mëdha që kontrollonin bankat, ndërmarrjet, naftën, çelikun etj. Dhe administruan ekonominë amerikane në të njëjtën mënyrë me të cilën Openhajmerët administronin Afrikën e Jugut. Të gjitha këto degëzime, megjithatë, janë të varura nga qendra evropiane e kontrollit operativ, që shpesh përkon me Londrën. Në Amerikë vetë këto familje, i ashtuquajturi "*Establishment* lindor", veprojnë prapa kuintave të njërës prej shoqërive të fshehta më të këqija e më satanike të Amerikës, Shoqërisë së Kafkës dhe të Kockave, që e ka selinë në Konektikut, në një mauzoleum pa dritare pranë *Yale University*, i njohur me të drejtë si "Varri". Këtu, studentë fort të zgjedhur mblidhen dy herë në javë gjatë periudhës shkollore. E gjitha kjo të kujton tempullarët, masonët dhe rrjetin e Tavolinës së Rrumbullakët. Simboli i kafkës dhe i kockave e ka origjinën tek ceremonitë e kafkës së Urdhërit të Kalorësve Tempullarë dhe të shumë grupeve të tjera të Vëllazërisë, tek të cilët frymëzohet kjo shoqëri e fshehtë, ithtarët e së cilës i kushtohen praktikave satanike dhe pirjes së gjakut. Të tjera universitete amerikane të Vëllazërisë, si Harvardi, paraqesin shoqëri të ngjashme, por Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave duket se është ajo më me ndikim. Një organizatë e të njëjtit lloj vepron në Britaninë e Madhe, në Oksford, në Kembridxh, në Edinburg dhe pranë universiteteve të tjera. Mendohet se Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave ka lindur në Shtetet e Bashkuara më shumë se 150 vjet më parë si Kapitulli 322 i një shoqërie të fshehtë gjermane dhe, për një farë periudhe, është njohur edhe si Vëllazëria e Vdekjes. Duke parë se Xhorxh Bushi është anëtar i saj, nuk më vjen në mendje një emër më i mirë. Ajo që dihet me siguri është fakti se Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave qe krijuar në vitet 1832-33 nga një grup, në të cilin figuronte edhe Daniel Kolt Gilmani, njeriu të cilit i detyohet krijimi i shoqërive amerikane të përjashtuara nga taksat, si Fondacioni Rokfeler dhe Fondacioni Karnexhie për Paqen Ndërkombëtare. Ndërmjet themeluesve të tjerë të Shoqërisë së Kafkës dhe të Kockave gjejmë gjeneralin Uiliam Huntington Rasëll dhe Alfonso Taftin, që i përket një familjeje të famshme amerikane. Tafti ka qenë ministër i Luftës në administratën e Grantit dhe i biri, Uiliam Houard Tafti, ka qenë i vetmi njeri që ka mbuluar të dyja detyrat, edhe atë të presidentit edhe atë të gjykatësit të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara. Ashtu sikurse Rasëllat, edhe Taftët janë një familje e vjetër në lidhje farefisnie me atë anëtar të Shoqërisë së Kafkës dhe të Kockave, siç është Xhorxh Bushi. Kjo shoqëri është thellësisht raciste dhe është krijuar me paratë e ardhura nga trafiqet e paligjshme të drogës së Rasëllve. Përveç kësaj, ajo bën pjesë në *Russell Trust* dhe ritet e

ceremonisë së pranimit kryhen në një ishull të lumit Shën Lorenc, pronë e *Russell Trust Association*. Vetë kjo shoqëri është dhe pronare e pjesës më të madhe të truallit, mbi të cilin ngrihet *Yale University*.

Familja Rasëll u pasurua me tregtinë e opiumit nga Turqia e nga Kina gjatë luftërave të opiumit që Britania e Madhe zhvilloi kundër Kinës, kur Fisnikëria e Zezë-Vëllazëria e Londrës e pllakosi, duke e përmbytur me narkotikë. Më pas, Rasëllat u bënë ortakë në tregti me familje të tjera të Vëllazërisë si Kolidxhët dhe Delanot (Kom 300), të cilave u përkisnin presidentët e Shteteve të Bashkuara Kalvin Kolidxhi dhe Franklin Delano Rusvelti. Rasëllat e kishin zakon të mbanin flamurin me simbolin e kafkës dhe të kockave në anijet e tyre që transportonin narkotikë dhe Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave e vazhdon këtë tip tregtie duke shfrytëzuar njerëz si Xhorxh Bushi, njëri prej manjatëve më të mëdhenj të narkotikëve të Amerikës së Veriut. Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave sundohet nga rreth 20-30 familje, më së shumti me origjinë prej bregut lindor. Pjesa më e madhe e tyre pretendon (me të drejtë) një prejardhje nga aristokracia britanike, ose paraqet një pemë gjenealogjike që zë fill tek familjet angleze "puritane", të cilat arritën në Amerikë rreth viteve 1630-1660, në kuadrin e një politike emigrimi, e cila e kishte origjinën tek idetë e Sër Frensis Bekonit dhe të rrethit të tij. Këto familje ose e siguruan vetë pushtetin financiar, ose kanë lidhur martesa me interes me bijtë e manjatëve si Rokfelerët dhe Harrimanët. Kriteri themelor për t`u pranuar në Shoqërinë e Kafkës dhe të Kockave është ai përkatësisë gjenetike. Je aq sa duhet zvarranik? Mjeshtërit më të mëdhenj të manipulimit të shekullit XX kanë qenë anëtarë të Shoqërisë së Kafkës dhe të Kockave, teksa ishin ende studentë në *Yale University*. Midis tyre figuron Avarel Harrimani, i biri i Eduardit dhe njëri prej manipuluesve më të mëdhenj të Vëllazërisë, vdekur në moshën 91 vjeçare, në vitin 1986. Edhe i ati i Xhorxh Bushit, Preskot Bushi, ka qenë anëtar i Shoqërisë së Kafkës dhe i Kockave, dhe ishte ai që e plaçkiti varrin e kreut të shoqërisë, Apash Jeronimit, dhe që e çoi kafkën e tij në shtabin e përgjithshëm të Harvardit, për rite të bazuara mbi kafkën. Preskot Bushi i vuri pasuritë e tij nëpërmjet perandorisë Harriman (Paisua-Rotshild) dhe më pas kontribuoi për të financuar Adolf Hitlerin.

Kështu, në vitet e para të shekullit XX situata ishte si vijon: rrjeti operativ i Vëllazërisë Babilonase me qendër në Londër i kishte dhënë jetë një tjetër grupi të quajtur Tavolina e Rrumbullakët, i cili kishte degë në të gjithë botën. Kjo organizatë, bashkë me shoqëritë e ndryshme të fshehta, banka, ndërmarrje, gazeta e kukulla politike të lidhura me të, kontrollonte Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Afrikën e Jugut dhe vende të tjera afrikane, Australinë,

LIBRI

Zelandën e Re, Indinë, shumë pjesë të Lindjes së Largët, si Hong Kongun, dhe pjesë të mëdha të pjesës tjetër të botës, nën emrin e "Perandorisë Britanike". Krejtësisht e përfshirë në këtë rrjet ishte familja mbretërore britanike e kryesuar, pas vdekjes së mbretëreshës Viktoria, nga i biri mason, Eduardi VII dhe, më pas, pas vdekjes së këtij në vitin 1910, Xhorxh V. Eduardi, në bashkëpunim me miqtë e tij londinezë të Fisnikërisë së Zezë, e shtoi në mënyrë të konsiderueshme pasurinë personale të familjes mbretërore. Kjo, pas pak, e braktisi emrin e dinastisë gjermane të Saksonia-Koburg-Gotas dhe mori atë të Uindsorëve, për të fshehur prejardhjen e saj gjermane gjatë tmerreve të Luftës së Parë Botërore. Me këto organizata globale tashmë të afirmuara fort, terreni ishte gati për manipulimin grotesk të shekullit XX.

Lufta e Parë Botërore

Vëllazëria dëshironte një luftë globale, që të shërbente si problem-reagim-zgjidhje në shkallë të plotë dhe të prishte *status quo*-në, duke i dhënë mundësinë mandej ta rindërtonte botën e pasluftës sipas skemave të saj. Dhe ia arriti në mënyrë të shkëlqyer. Qeveria britanike dhe ajo amerikane, të dala menjëherë pas luftës, ishin të kontrolluara nga krerët e Tavolinës së Rrumbullakët. Në Britaninë e Madhe bëhej fjalë për njerëz si Alfred Milneri (Kom 300) dhe Lord Balfori, ndërsa në Amerikë figuronte koloneli Hauz (Kom 300), që diktoi linjat politike të qeverisë së presidentit Uillson. Në Gjermani, kreu zyrtar i vendit ishte kajzeri Vilhelm II, i afërm i familjes mbretërore britaniko-gjermane, e cila pas pak do të quhej Uindsor. Për të "ruajtur" kajzerin ishte masoni i shquar Oto fon Bismarku, ideatori i perandorisë gjermane, dhe të tjerë masonë e familje të Vëllazërisë. Kancelar i Vilhelmit ishte Betman-Holvegu, anëtar i familjes së bankierëve Betman të Frankfurtit dhe kushëri i Rotshildëve. Bankieri personal i Vilhelmit ishte Maks Varburgu, vëlla i Polit dhe i Feliksit, dy manipulues që kishin kontribuar për të bërë të mundur lindjen e Rezervës Federale amerikane. Ndërkohë, Rotshildët kishin blerë agjensinë gjermane të shtypit Wolff, për të kontrolluar fluksin e informacioneve drejtuar popullit gjerman dhe pjesës tjetër të botës. Njëri prej drejtuesve kryesorë të agjensisë Wolff ishte... Maks Varburgu. Më pas Rotshildët do të blinin një kuotë të agjensisë së shtypit Havas në Francë dhe të Rojterit në Londër (agjensitë e shtypit furnizojnë me "lajme" të gjitha mjetet e komunikimit). Shkëndija që shërbente për të shpërthyer luftën ishte një episod, mbi bazën e të cilit mund të justifikoheshin armiqësitë, dhe kjo u vërtetua kur një agjent i një shoqërie të fshehtë serbe e quajtur Urdhëri i Dorës së Zezë vrau arkidukën Ferdinand, trashëgimtar i fronit austro-

hungarez, më 28 qershor 1914. Saktësisht në të njëjtën kohë në Rusi i bëhej atentat këshilltarit më të besuar të carit, Grigori Jefimoviç Rasputinit, që po i kundërvihej luftës. Dora e Zezë u krijua në vitin 1911 me emrin Urdhëri i Vdekjes dhe vula e tij paraqiste një grusht, që mbante të mbyllur brenda një kafkë me kockat e pranë kishte një thikë, një bombë e një shishe helmi[4]. Me të vërtet bukur! Duket se anëtarët më të rëndësishëm të Dorës së Zezë janë takuar me masonët francezë dhe me ata të Lindjes së Madhe në hotelin Shën Zherom të Tuluzës, në janar të vitit 1914, për të organizuar vrasjen e Sarajevës[5]. Ekzekutuesit materialë të vrasjes, të udhëhequr nga Gavrilo Prinçipi, vuanin të gjithë nga tuberkulozi dhe i kishin ditët të numëruara. Bëhej fjalë për viktima të paracaktuara, të manipuluara për të kryer një akt, që duhej ta quanin të dobishëm për nacionalizmin serb, ndërsa ishte në realitet shkëndija, që duhej për të çuar përpara një plan, për ekzistencën e të cilit sipas gjasës ata nuk dyshonin aspak. Ka ndodhur gjithmonë kështu me terroristët dhe vrasësit gjatë mijëvjeçarëve. Si të bëjnë këta njerëz që të mos përdoren më në këtë mënyrë? Shumë e thjeshtë. Mjaft që të mos vrasë më asnjeri, as mos të vërë bomba për asnjë arsye në botë. Ja u bë.

Degët gjermane të Vëllazërisë filluan veprimet luftarake dhe degët në pjesën tjetër të Evropës ndoqën shembullin e tyre. Njerëzit që e kryen materialisht këtë luftë ishin gurë shahu të pafajshëm të një loje që nuk e kuptuan. Një gjysmë milioni me njerëz vdiqën në një betejë të vetme në llogoret e Francës Veriore, një orgji gjigante gjaku në një zonë që konsiderohet e shenjtë nga satanistët dhe nga gjakpirësit që qeverisin botën. Për zvarranikët këto janë flijime rituale në masë. Lufta u krijua mbi bazën e strategjisë problem-reagim-zgjidhje, e përdorur për të tërhequr edhe Shtetet e Bashkuara në konflikt. Në fushatën e tij për zgjedhjet presidenciale, Uillsoni i kishte thënë popullit amerikan se nuk do të kishte lejuar që Amerika të përfshihej në një luftë evropiane. Duhej t'ia thoshte, nëse dëshironte të zgjidhej. Por e dinte që e gjitha kjo bënte pjesë në Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë dhe kështu, në vitin 1916, një anije udhëtarësh amerikanë me emrin *Lusitania* u fundos dhe ky fakt shërbeu si pretekst për të hyrë në luftë. Në të njëjtën mënyrë Gjermania përdori pretekstin e vrasjes së Ferdinandit dhe, në vitin 1941, sulmi i japonezëve në Perl Harbor u përdor nga presidenti amerikan ariano-zvarranik, Franklin Delano Rusvelti, si pretekst për të hyrë në Luftën e Dytë Botërore. Një anëtar i njërës prej familjeve të Vëllazërisë, Alfred Guejn Vanderbilt, ishte mbi anijen *Lusitania* në çastin e mbytjes së saj. Një telegram urgjent, që e paralajmëronte të mos hipte në anije, nuk arriti ta mbërrinte në kohë. Kreu i Komisionit Amerikan të Industrive të Luftës ishte një tjetër rrotëz në

ingranazhin e Vëllazërisë të këtij shekulli. Ishte fjala për Bernard Barushin (Kom 300), që ka thënë se kishte... "sipas gjasës më shumë pushtet se kushdo tjetër i përfshirë në luftë..."[6]. Bernard Barushi dhe Mandel Hauzi kanë qenë nga dita në ditë përgjegjësit e vendimeve të marra brenda degës amerikane të Tavolinës së Rrumbullakët Londineze.

Në vitet pesëdhjetë të shekullit XX, të tjera prova të faktit se Lufta e Parë Botërore ishte manipuluar dolën nga hetimi parlamentar mbi fondacionet amerikane të përjashtuara nga taksat, si Fondacioni Rokfeler, Fondacioni Ford dhe Fondacioni Karnixhe për Paqen Botërore, që u gjykua përgjegjës për manipulimin e luftës! Një tjetër gjë kjo, për të mos u lënë jashtë vëmendjes. Vëllazëria u jep organizatave të saj ca emra të tillë që ta bëjë popullsinë të besojë se qëllimi i tyre është saktësisht e kundërta e asaj që në realitet është detyra e tyre. Për shembull, nëse doni të tregtoni drogë pa ngjallur dyshime, bëjeni nëpërmjet ndonjë organi që lufton kundër drogës. Nëse doni të shkatërroni ambientin e të vrisni kafshët, bëjeni nëpërmjet ndonjë organi që mbron kafshët. Nëse doni të drejtoni ndonjë rreth satanik, bëjeni nëpërmjet Kishës së Krishterë. Hetimi parlamentar i udhëhequr nga Komisioni Ris vërtetoi se krerët e këtyre fondacioneve ishin të lidhur midis tyre dhe se ato financonin "shkollat" dhe "shkencën" për të nxitur planin e tyre të centralizimit të pushtetit global. Përfundimet e "kërkimit" shkencor vendoseshin para se të akordoheshin financimet. Nëse nuk arrihej një pajtim mbi përfundimet, financimi nuk bëhej. Kjo është njëra prej metodave më të përdorura për të mbytur dijen. Një dije, që mund të çlironte botën nga uria e nga nevoja e teknologjisë "energjitike" me shumë shpenzime dhe ndotëse, që disponojmë sot. Zbulimet e rëndësishme të Komisionit Ris në lidhje me Luftën e Parë Botërore dolën në çastin kur ai hetoi mbi Fondacionin Karnixhe për Paqen Botërore. Norman Dodi, drejtues i hetimeve, bëri të ditur se gjatë një mbledhje të administratorëve të Fondacionit Karnixhe, u shtrua kjo pyetje:

"«Çfarë mjetesh të tjera më të efektshme se lufta janë të njohura prej njeriut, për të ndryshuar jetën e një populli të tërë?». Nuk u gjet ndonjë përgjigje dhe kështu që pyetja për administratorët u bë: «Si të bëjmë që të përfshijmë Shtetet e Bshkuara në luftë?»".

Dodi vazhdon kështu:

"Dhe atëhere pyetën: «Si ta kontrollojmë makinën diplomatike të Shteteve të Bashkuara?». Dhe përgjigjja ishte: «Duhet të kontrollojmë Departamentin e

Shtetit». Në këtë pikë le të bëjmë lidhjen me atë që kemi zbuluar tashmë... që çdo emërim brenda Departamentit të Shtetit kërkonte miratimin nga ana e një agjensie të krijuar nga Fondacioni Karnixhe. Më në fund u gjendëm në luftë. Në një mbledhje të vitit 1917 anëtarët e këtij fondacioni patën paturpësinë të përgëzoheshin me njëri-tjetrin për urtësinë e vendimit të tyre origjinal, duke qenë se tashmë fillimi i luftës linte të kuptohej se ajo do të kishte ndryshuar jetën e këtij vendi. Patën deri madje pafytyrësinë t'i shkruanin një telegram Mr. Uillsonit, në të cilin nuk besohej se do të arrinin të bënin që lufta të përfundonte tepër shpejt"[7].

Dodi thotë se Ketrin Kaseji gjeti pastaj të tjera dokumente që tregonin se Fondacioni Karnixhe ishte përdorur për të shmangur mundësinë që jeta amerikane të kthehej në kushtetet e paraluftës. Të ndryshoje mënyrën me të cilën njerëzit jetonin e mendonin ishte, tek e fundit, qëllimi kryesor i luftës. Dodi citon se:

"Arritën në përfundimin se, për të shmangur regresin, duhej të kontrollonin sistemin shkollor. Dhe atëhere iu drejtuan Fondacionit Rokfeler dhe i thanë: «Merreni ju kontrollin e sistemit shkollor, pasi ai përfshin fusha që janë prej natyre të brendshme». Dhe kështu u morën vesh. Pastaj, së bashku, vendosën se gjëja më e rëndësishme në atë kontekst ishte mësimdhënia e historisë amerikane dhe se ishte e nevojshme ta transformonin. Kështu u drejtuan tek më të rëndësishmit e atyre që mund t'i quajmë historianë amerikanë të kohës me synimin për t'i bindur që të ndryshonin mënyrën me të cilën paraqisnin lëndën"[8].

Ja përse në librat zyrtarë të historisë nuk lexoni atë që ka ndodhur realisht. Lexoni vetëm atë që Vëllazëria dëshiron t'ju bëjë të lexoni, domethënë gjërat e neveritshme që u mësohen fëmijëve tanë në shkolla e në universitete dhe që bëjnë pjesë në atë që quhet "arsim". E njëjta gjë ndodh me të gjitha lëndët e tjera. Është ky "arsimi", për të cilin familjet amerikane shtrëngojnë rripin gjithë jetën. Shtrëngojnë rripin për t'u dhënë mundësi familjeve të tyre që të indoktrinohen, kjo është e vërteta. Qëllimi i Luftës së Parë Botërore ishte që t'i rijepte trajtë botës së pasluftës sipas modelit të dëshiruar prej zvarranikëve. Për këtë arsye pikërisht ata njerëz, që, në rrethin e të gjitha "rreshtimeve", kishin ideuar luftën, morën pjesë në vitin 1919 në Konferencën e Paqes së Versajës, pranë Parisit (prapë!), për të vendosur se cilat do të ishin përfundimet e luftës që kishin arkitektuar vetë. Pallati mbretëror i Versajës është i njohur edhe si pallati mbretëror i Mbretit Diell. Kukullat (më falni, krerët) fituese të pranishme në Versajë ishin Vudrou Uillsoni për Shtetet e Bashkuara, Llojd

LIBRI 24

Xhorxhi (Kom 300) për Britaninë e Madhe dhe Zhorzh Klemansoja për Francën. Por çfarë po ndodhte me të vërtetë prapa kuintave? Uillsoni ishte "këshilluar" nga koloneli Mandel Hauz (Kom 300) dhe nga Bernard Barushi (Kom 300), që të dy përfaqësues të rrethit Rotshild-Tavolinë e Rrumbullakët; Llojd Xhorxhi ishte këshilluar nga Alfred Milneri (Kom 300), kreu zyrtar i Tavolinës së Rrumbullakët dhe nga Sër Filip Sasoni, pasardhës i drejtëpërdrejtë i Majer Amshel Rotshildit; Klemansoja shoqërohej nga Zhorzh Mandeli, ministri i tij i Brendshëm, emri i vërtetë i të cilit ishte Jeroboam Rotshild. Në përbërje të komisionit amerikan, që negocionte paqen, figuronin vëllezërit e turpshëm Dalles; edhe Uolter Lipmani (Kom 300), themeluesi i degës amerikane të Shoqërisë Fabiane. Të gjitha familje zvarranike. Delegacioni gjerman përfshinte Maks Varburgun, vëlla i Pol Varburgut, anëtar i delegacionit amerikan! Ai që e drejtonte konferencën ishte baroni Edmund de Rotshildi, njëri prej krerëve të fushatës në favor të shtetit izraelit në Palestinë, të cilit Konferenca e Paqes e Versajës i konfirmoi mbështetjen e saj. Dhe nuk ka asnjë libër historie që t'jua thotë këto gjëra. Konferenca vendosi krijimin e Gjykatës Botërore të Hagës, në Vendet e Ulëta, dhe të Lidhjes së Kombeve, përpjekja e parë e bërë nga Vëllazëria për të krijuar një organizatë globale, që mund të evoluonte pastaj në një qeveri botërore. Projekti i parë i asaj që u bë pastaj Marrëveshja ishte shkruar nga koloneli Hauz, sikurse edhe "katërmbëdhjetë pikat" e famshme të Vudrou Uillsonit në Versajë. Vite më parë, Mandel Hauzi kishte shkruar një roman me titullin *Philip Dru: Administrator*, që pastaj tregoi se bazohej mbi fakte reale të romanizuara. Në libër, i botuar në mënyrë anonime dy vjet *para* Luftës së Parë Botërore, ai kishte ngritur propozimin për të krijuar një organizatë të quajtur... Lidhje e Kombeve. Lufta ishte e gjitha një komplot për të nxitur Urdhërin e Ditës dhe kushtoi jetën e miliona njerëzve. Më pas Lidhja e Kombeve dështoi, por, falë një lufte tjetër, ëndërra e atyre njerëzve u kurorëzua nëpërmjet krijimit të Kombeve të Bashkuara, në vitin 1945.

Revolucioni Rus/Lufta e Ftohtë

Revolucioni Rus i vitit 1917, që u zhvillua në të njëjtën kohë me Luftën e Parë Botërore, çoi në formimin e Bashkimit Sovjetik dhe pastaj në Luftën e Ftohtë. Një aspekt i herëpashershëm i manipulimit të Vëllazërisë gjatë shekujve është krijimi i përbindshave, që i kallin frikë popullsisë, si komunizmi sovjetik e kinez. Krerët e këtyre dy vendeve janë të lidhur me rrjetin e familjeve të Vëllazërisë, por, natyrisht, këto gjëra njerëzit nuk i dinë. Publiku besonte se krerët amerikanë përfaqësonin polin e kundërt në krahasim me ata sovjetikë,

duke qenë se vendi i parë ishte kapitalist, i dyti komunist. Por nuk është kështu. Bëhet fjalë vetëm për dy kartelë të ndryshëm, të kontrolluar, si përfundim, nga të njëjtët njerëz. Komunizmi është krijuar nga Uoll Striti dhe nga *Siti* i Londrës, për të krijuar një frikë e një konflikt të përbindshëm dhe për t'i bërë planet e Vëllazërisë të bënin një hap përpara. Si zakonisht, ai ishte planifikuar shumë më parë në krahasim me kohën kur u realizua publikisht. *Manifesti komunist* ishte shkruar nga (ose për) Karl Marksi e Frederik Engelsi. Marksi ishte nxënës i okultistit gjerman Bruno Bauerit (Rotshild) dhe u martua me një anëtare të një familjeje zvarranike, që i përkiste aristokracisë skoceze. Disa prej shkrimeve të tij janë ashpërsisht antisemite, gjë që duket kontradiktore, duke qenë se mendohet që ai vetë ishte hebre. Por nuk ishte. Ishte një tjetër "arian" në shërbim të kauzës – të kauzës zvarranike. Gjatë gjithë këtyre viteve, e majta ekstreme e ka nderuar Marksin si një "njeri të popullit", ndërsa në realitet ai ka qenë një njeri që e "burgosi" popullin. Gjithçka nisi në Rusi në vitin 1905, kur Rotshildët manipuluan carin deri në atë pikë, sa ta shtynin në luftë kundër Japonisë. Rotshildët evropianë u dhanë para hua rusëve për atë konflikt, ndërsa dega e tyre amerikane, *Kuhn, Loeb and Company*, financoi japonezët. Lufta shkatërroi ekonominë ruse, edhe për shkak të zhdëmtimeve të rënda të huave të dhëna prej Rotshildëve dhe, tani, të rënduara nga interesat. Kjo kontribuoi për të nxitur revoltën fillestare. Kur Lufta e Parë Botërore filloi dhe Rusia u rreshtua kundër Gjermanisë, furnizimet me armë për ushtrinë ruse vonoheshin në mënyrë sistematike nga shoqëritë e Rotshildëve si *Vickers Maxim* dhe, më në fund, ushtarët u rebeluan. Shoqëria *Vickers Maxim* kontrollohej nga Ernest Kaseli, një oratak në tregti me shoqërinë *Kuhn, Loeb and Company* dhe aksionerët e saj më të mëdhenj ishin Rotshildët. E bija e Ernest Kaselit do të martohej pastaj me Lordin Mauntbaten, një Rotshild[9], që kombinoi martesën e mbretëreshës Elisabetë II me nipin e tij, princin Filip. Takimet e këtyre familjeve zvarranike janë thjesht mahnitëse.

Revolucioni rus i dha fund 300 vjetëve qeverisjeje të familjes së Romanovëve, që kishte filluar në shekullin XVII me Mikail Romanovin, i cili mendohet se ka qenë mbështetur nga okultisti dhe trëndafilkryqëtari Artur Di, dhe nga shërbimet e fshehta britanike. Artur Dija ishte i biri i doktor Xhon Disë, astrologut të turpshëm të mbretëreshës Elisabeta I. Por këto familje janë të gjitha qole të Urdhërit të Ditës dhe, për Romanovët, kishte arritur koha të largoheshin. E njëjta gjë u ndodhi në të njëjtën kohë dinastive të Habsburgëve dhe të Hohenstaufenëve. Prej kohësh ishte vënë në veprim infrastruktura për të shfronësuar Romanovët, nëpërmjet Urdhërit të

Masonerisë, Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve dhe grupeve të tjera të fshehta, që dolën në skenë në Rusi duke nisur nga gjysma e dytë e shekullit XVIII. Përpjekja e parë për të shfronësuar Romanovët u udhëhoq nga Kerenski, një mason i financuar nga Uoll Striti. Një fushatë e dytë më e keqe u udhëhoq nga Leon Trocki dhe Lenini. Trocki e la Gjermaninë e u shpërngul në Nju Jork dhe pikërisht prej këtej lëvizi drejt Rusisë, për të drejtuar Revolucionin Bolshevik. Hyri në Rusi me një pasaportë amerikane, që i ishte dhënë nga presidenti Vudrou Uillson, dhe me 10.000 dollarë me vete, që ia kishin dhënë Rokfelerët. Në Rusi e arriti Lenini, që kishte përshkuar Gjrmaninë në një tren të blinduar, i cili vinte nga Zvicra dhe që kishte kaluar nga Suedia. Pjesa më e madhe e propagandës bolshevike u financua nga gjermanët. Edhe pse duke e dënuar hapur "kapitalizmin", Lenini, Trocki e të tjerët u financuan nga bankierët e Vëllazërisë së Uoll Stritit dhe të Londrës, të njëjtët njerëz që do të kishin mbështetur pastaj Hitlerin. Në autobiografinë e tij Trocki ka folur për disa prej këtyre huave, shumë prej të cilave ishin vendosur nga Alfred Milneri dhe "Aleksandër" Gruzenbergu (emri i vërtetë Mikail) i Tavolinës së Rrumbullakët, kryeagjent bolshevik në Skandinavi. Ai ka qenë këshilltar i veçantë i *Chase National Bank* të Nju Jorkut, pronë e J.P. Morganit (Paisuasë). Njëri prej ndërmjetësuesve më aktivë midis bolshevikëve, Londrës dhe Uoll Stritit, ishte Olof Ashbergu, që u bë i njohur si bankier i bolshevikëve. Zotëronte *Nya Banken*, të themeluar në Stokholm në vitin 1912. Ajo që e përfaqësonte Ashbergun në Londër ishte *North Commerce Bank*, e drejtuar nga Earl Greji, anëtar i Tavolinës së Rrumbullakët dhe mik i Sesil Rodit. Një tjetër njeri shumë afër Ashbergut ishte Maks Meji, zëvendëspresident i Fondit të Garancisë të J.P. Morganit (Paisuasë) dhe kreu i operacioneve të përtejoqeanit.

Në vitin 1915, ishte krijuar *American International Corporation*, për të financuar Revolucionin Rus. Drejtuesit e tij përfaqësonin interesat e Rokfelerëve, të *Kuhn, Loeb and Company* (Rotshildët), të DyPontit, të Harrimanit dhe të Rezervës Federale. Midis tyre ka figuruar edhe Xhorxh Herbert Uolker Bushi, gjyshi i Xhorxh Bushit. Rotshildët e financuan drejtpërdrejt revolucionin nëpërmjet Jakob Shifit të *Kuhn, Loeb and Company*. Bankierët e Vëllazërisë ndërkombëtare të ardhur nga Britania e Madhe, nga Shtetet e Bashkuara, nga Rusia, nga Gjermania dhe nga Franca u takuan në Suedi në verën e vitit 1917. Vendosën që *Kuhn, Loeb and Company* do të depozitonte 50 milionë dollarë në llogarinë mjedhëse të një banke suedeze në dobi të Leninit dhe të Trockit. Në një artikull të *New York American Journal* të 3 shkurtit 1949 nipi i Jakob Shifit tha se gjyshi i tij u kishte paguar dy "revolucionarëve" 20 milionë dollarë të tjerë. Pagesa e 20 milionë dollarëve

bolshevikëve nga ana e Elishu Rutit (avokat i *Kuhn, Loeb and Company* dhe ish Sekretar Shteti) nëpërmjet Fondit të veçantë të luftës, është e regjistruar në Regjistrin Kongresual me datën e 2 shtatorit 1919. Ky investim jo vetëm ka qenë në dobi të Urdhërit të Ditës të Vëllazërisë, por përbënte edhe një përfitim të pabesueshëm. Sipas disa hulumtuesve, Lenini i shleu *Kuhn-Loebit* në rubla shumën e barasvlefshme me 450 milionë dollarë midis viteve 1918-1922. Kjo nuk ishte asgjë, po ta krahasoje me përfitimet që rridhnin nga shfrytëzimi i tokës ruse, i ekonomisë dhe i popullit të saj, përfshirë grabitjen e arit të carit dhe pasurinë e tij të madhe financiare, e ruajtur dhe e grabitur nga po ato banka, që kishin financuar revolucionin. Rusia, sikurse pjesa tjetër e botës, është dhunuar nga zvarranikët. Revolucioni Rus, dhe gjithçka që rrodhi prej tij, ishte një tjetër operacion i arkitektuar nga Vëllazëria.

Në të njëjtën mënyrë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, komunizmi iu kundërvu fashizmit (që është në realitet e njëjta gjë) dhe, kur lufta përfundoi, frika e "përbindëshit" sovjetik u përdor për të manipuluar më tej ngjarjet në shkallë globale dhe për të justifikuar shpenzimet jashtëzakonisht të mëdha për armatimet, në dobi të industrive të luftës dhe të industrisë aeronautike, të zotëruara nga zvarranikët. Për këtë arsye, u veprua në mënyrë të atillë që furnizimet me armë të ishin në baraspeshë, ose që Bashkimi Sovjetik të ishte lehtësisht më përpara, duke ngjallur kështu frikë nga të dyja anët dhe duke i shtyrë të gjithë të blinin armatime gjithmonë e më të shtrenjta nga po ato ndërmarrje, sipas parimit "Të mos lejojmë të kalohemi ngá rusët!". Lufta e Ftohtë ishte një shembull klasik i manipulimit. Populsitë perëndimore ishin të terrorizuara nga Bashkimi Sovjetik dhe popullsia e Bashkimit Sovjetik ishte e terrorizuar nga Perëndimi, ndërsa që të dyja rreshtimet kontrolloheshin në mënyrë të fshehtë nga të njëjtët njerëz. Në qendër të gjithë kësaj ishte dalja e armëve atomike gjatë Luftës së Dytë Botërore, falë Projektit Amerikan Manhatan, të drejtuar nga Robert Openhajmeri. Projekti Manhatan u mbështet nga Instituti i Studimeve të Përparuara të *Princeton University*, një institucion i kontrolluar nga Vëllazëria, që Albert Ajnshtajni e frekuentonte rregullisht. Ajnshtajni, që bashkëpunoi në zhvillimin e bombës atomike, ishte shumë afër Bernard Barushit dhe Lordit Viktor Rotshild (Kom 300), njeriut që kontrolloi për dhjetëra vjet shërbimet e fshehta britanike. Rotshildi i shfrytëzoi këto lidhje për t'i dhënë shtetit të Izraelit *know-how (tërësia e aftësive dhe përvojave të nevojshme për zhvillimin dhe përdorimin e një teknologjie të caktuar)* e nevojshëm për të prodhuar armatime bërthamore. Por, natyrisht, sikur Shtetet e Bashkuara të ishin në zotërim të këtyre armëve shkatërruese dhe rusët jo, nuk do të kishte pasur asnjë Luftë të Ftohtë, kështu që njohuritë

teknike iu kaluan atyre. Pavël A. Sudoplatovi, kreu i divizionit të shërbimeve të fshehta ruse, që u mor me problemin bërthamor gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka pohuar se Openhajmeri, gjatë luftës, i tregoi Bashkimit Sovjetik të dhëna mbi bombën[10]. Mjeku gjerman Klaus Fuks punoi në Projektin Manhatan, pasi ishte arratisur nga Gjermania në Britaninë e Madhe, në vitin 1933. Fuksi, një ortak i Lordit Viktor Rotshild, u burgos më pas për katërmbëdhjetë vjet, sepse u kishte zbuluar rusëve sekrete bërthamore britanike e amerikane. Di nga njerëz afër mjediseve të shërbimeve të fshehta britanike e amerikane dhe nga kërkimet e kryera nga të tjerë autorë, se *know-how*-i i armëve bërthamore ka kaluar nga Shtetet e Bshkuara tek Bashkimi Sovjetik gjatë tërë periudhës të Luftës së Ftohtë edhe nëpërmjet Konferencave të Paguashit, të cilat vazhduan mendimin e Albert Ajnshtajnit dhe të Bertrand Rasëllit (Kom 300), të familjes zvarranike të Rasëllve. "Paguash" rrjedh nga emri i çifligut kanadez të sipërmarrësit Sirus Ajton, ku u mbajtën konferencat. Ajtoni e nisi karrierën e tij si sekretar i J.D. Rokfelerit dhe u bë ortak në tregti me dinastinë e Rokfelerëve. Në vitin 1946, Bertrand Rasëlli, mik i Ajnshtajnit, tha se ishte e nevojshme të shfrytëzoje frikën e armëve bërthamore, për t`i detyruar të gjitha kombet të hiqnin dorë prej sovranitetit të tyre dhe t`i nënshtroheshin diktaturës së Kombeve të Bashkuara[11].

Më pas Urdhëri i Ditës parashikonte që vendet e Bashkimit Sovjetik të përfshiheshin brenda Bashkimit Evropian dhe NATO-s, në përputhje me planin për një qeveri dhe një ushtri botërore. Kjo nuk mund të bëhej gjersa ekzistonte Bashkimi Sovjetik, i cili shihej si "perandoria e së keqes". Papritmas doli në skenë Mikail Gorbaçovi, një ortak dhe vartës i atyre dy manipuluesve të Vëllazërisë, siç ishin Henri Kisingeri e David Rokfeleri, dhe roli i tij ishte që të luante pjesën e trimit për të shkatërruar Bashkimin Sovjetik. Muri i Berlinit u rrëzua dhe njerëzit menduan se ishte fjala për një arritje për lirinë, por, në realitet, ishte vetëm një hap tjetër përpara në rrugën e sundimit global. Gorbaçovi e ka lënë detyrën dhe tani drejton Fondacionin Gorbaçov, të financuar nga Vëllazëria, që organizon konferenca prestigjoze në favor të një qeverije botërore. Bëhet fjalë për një tjetër zvarranik në gjendje të ndryshojë formë, sikurse më kanë pohuar disa njerëz të takuar prej meje.

Krijimi i Izraelit

Thuhet shpesh se sionizmi qëndron në qendër të Konspiracionit, por unë nuk jam i të njëjtës mendje. Ai përbën sigurisht një pjesë të tij, por rrjeti i Vëllazërisë është mjaft më i gjerë. Sionizmi nuk përkon me popullin hebre, por është një lëvizje politike. Shumë hebrej nuk e mbështesin, shumë johebrej

LIBRI

po. Të thuash që sionizmi përkon me popullin hebraik është njësoj si të thuash që Partia Demokrate përkon me popullin amerikan. E, megjithatë, të kritikosh ekstremizmat e sionizmit do të thotë të damkosesh me antisemitizëm ose me antihebraizëm. Çfarë gjepurash! Ashtu sikurse republika e Afrikës së Jugut është në realitet një feud i Openhajmërve, ashtu edhe shteti i Izraelit është në realitet shteti i Rotshildëve. Sionizmi është krijuar nga Rotshildët për llogari të Vëllazërisë dhe SION-i është një degë e kultit ariano-zvarranik të Diellit. Dy janë arsyet kryesore pse ai është përdorur për të siguruar kontrollin e Palestinës arabe. Kjo është në fakt një tokë e shenjtë për ariano-zvarranikët që nga kohërat e levitëve dhe të botës së lashtë. Përveç kësaj, të grabisje paturpësisht një vend arab, ofronte mundësi të pafundta për të ushqyer konfliktin dhe përçarjen në Lindjen e Mesme dhe, kjo taktikë, rezultoi veçanërisht e efektshme për manipulimin e vendeve arabe prodhuese nafte. Çasti vendimtar në planin e Rotshildëve për krijimin e "Izraelit" ishte Deklarata Balfur, kur ministri i Jashtëm britanik, Artur (Lord) Barfuri, njoftoi, më 6 nëntor 1917, se Britania e Madhe mbështeste të drejtën e një shteti hebraik në Palestinë. Edhe Konferenca e Paqes e Versajës, e kontrolluar nga Rotshildët, deklaroi mbështetjen e saj. Çudi, çudi! Por ç`ishte kjo Deklaratë Balfur? Nuk u drejtohej anëtarëve të Parlamentit të Uestminsterit. Ishte thjesht një letër e dërguar nga Lordi Balfur (Kom 300), një anëtari të rrethit të ngushtë të shoqërisë së fshehtë të Tavolinës së Rrumbullakët, Lordit Lionel Uolter Rotshild (Kom 300), që ka financuar Tavolinën e Rrumbullakët! Ishte një letër midis dy anëtarësh të së njëjtës shoqërie të fshehtë. Rotshildi ishte një përfaqësues i Fondacionit Anglez të Sionistëve, që ishte krijuar me paratë e Rotshildëve. Nga shumë anë besohet se letra "Balfur" ka qenë shkruar në realitet nga Lordi Rotshild bashkë me Alfred Milnerin (Kom 300), një shtyllë mbajtëse e Tavolinës së Rrumbullakët, që u emërua president i gjigantit minerar *Rio Tinto Zinc* nga vetë Lordi Rotshild. Gjiganti minerar *Rio Tinto Zinc* ka shumë lidhje me Afrikën e Jugut dhe, midis aksionistëve të shumicës, figuron mbretëresha e Anglisë. Arabët e Palestinës u përdorën për të luftuar turqit gjatë Luftës së Parë Botërore nën komandën e anglezit T.E. Laurencit (Laurenci i Arabisë), i cili u premtoi sovranitet të plotë në këmbim të përpjekjeve të tyre. Ai e dinte që në fillim se plani i Vëllazërisë parashikonte krijimin e një shteti "hebraik" (khazaro-arian) në Palestinë. Ishte vetë Laurenci, mik i ngushtë i Uinston Çurçillit, që e pohoi këtë disa kohë më pas, kur tha:

"Guxova mashtrimin, pasi isha i bindur se ndihma e arabëve ishte e domosdoshme për një fitore tonën, të shpejtë e me çmim të ulët, në Lindje, dhe se

ishte më mirë të fitonim e të mos e mbanim fjalën e dhënë se sa të humbisnim... Frymëzimi arab ishte instrumenti ynë kryesor për të fituar luftën e Lindjes. Kështu që i sigurova ata se Anglia do ta kishte mbajtur premtimin me fjalë e me fakte. Të mbështetur tek kjo, ata kryen bëmat e tyre të bukura; por, natyrisht, në vend që të isha krenar për atë që po bënim bashkarisht, provoja hidhërim e turp të vazhdueshëm"[12].

Kjo ka qenë prej mijëra vjetësh *modus operandi* ariano-zvarranik. Ishin Rotshildët ata që i financuan kolonët e parë "hebrej" në Palestinë; ishin Rotshildët ata që kontribuan për të krijuar e për të financuar Hitlerin dhe nazistët gjatë Luftës së Dytë.Botërore dhe përndjekjen e neveritshme që pasoi të hebrejve, të ciganëve, të komunistëve dhe të tjerëve; ishin Rotshildët ata që e përdorën solidaritetin e kuptueshëm të manifestuar pas luftës kundrejt hebrejve, që ata i kishin shfrytëzuar pa mëshirë, për të ushtruar presione në favor të pushtimit hebraik të Palestinës arabe; ishin Rotshildët ata që i financuan grupet "terroriste" palestineze, të cilët bombarduan, vranë e terrorizuan Izraelin që në zanafillë të tij; dhe ishin Rotshildët ata që i financuan këta terroristë dhe që i shtynë të zinin pozita kyçe brenda shtetit, sikurse tregojnë ministrat e parë Ben-Gurioni, Shamiri, Begini dhe Rabini. Këta njerëz pastaj do ta kishin kaluar pjesën tjetër të jetës së tyre për të dënuar aktet terroriste të kryera nga të tjerët, me një hipokrizi që është e vështirë ta besosh; ishte Lordi Viktor Rotshild, kontrolluesi i shëbimeve të fshehta britanike, ai që i dha Izraelit *know-how*-in e armëve bërthamore; ishin Rotshildët, që e kanë kontrolluar Izraelin që në fillim dhe që vazhdojnë ta kontrollojnë ende, ata që ia kanë diktuar politikën; ishin Rotshildët dhe pjesa tjetër e Vëllazërisë ata që e kanë fshehur dhe varrosur faktin, e vërtetuar nga historianët hebrej, se pjesa më e madhe dërrmuese e popullit "hebre" të Izraelit e ka prejardhjen gjenetikisht nga malet e Kaukazit dhe jo nga toka që ka pushtuar aktualisht. Populli hebre është sakrifikuar nga Rotshildët në altarin e babëzisë dhe të etjes për pushtet, por edhe Rotshildët duhet t'i binden një autoriteti më të lartë që, sipas meje, e ka selinë sipas gjasës në Azi dhe Lindja e Largët i jep udhëzime shtabit të përgjithshëm operativ të Londrës. Si përfundim, krejt mashtrimi orkestrohet që nga niveli më i ulët i përmasës së katërt.

Lufta e Dytë Botërore

Në Konferencën e Paqes së Versajës të vitit 1919 ishin marrë një sërë vendimesh, të cilat kulmuan me genocidin e njohur si Lufta e Dytë Botërore. Së pari, dëmshpërblimet që iu diktuan popullit gjerman ishin aq shumë të

tepruara, sa që Republika e Vajmarit, që erdhi pas luftës, nuk kishte asnjë mundësi të mbijetonte ekonomikisht. E gjitha kjo ishte planifikuar me kujdes. Ai kaos ekonomik ishte një problem shumë i madh që duhej zgjidhur dhe zgjidhja qe Adolf Hitleri. Arritja e dytë e rëndësishme, gjatë një takimi të fshehtë në Hotelin Maxhestik të Parisit midis atyre që kishin marrë pjesë në Konferencën e Versajës, ishte krijimi i organizatave të shkëputura prej Tavolinës së Rrumbullakët. E para u krijua në vitin 1920 me emrin Instituti i Çështjeve Ndërkombëtare, i njohur edhe si Katam Hauz, me numrin 10 të St. James's Square, në Londër. Kreu i tij zyrtar ishte monarku dhe, në vitin 1926, emri i tij u bë Instituti Mbretëror. Filiali i tij amerikan, Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme, u krijua nga anëtarët amerikanë të Tavolinës së Rrumbullakët në vitin 1921, falë financimeve të Rokfelerëve dhe të të tjerëve. Bëhej fjalë për degëzime të rrjetit të Vëllazërisë, me qëllimin për të kontrolluar në mënyrë akoma më të plotë politikën britanike e amerikane dhe, si përfundim, krejt botën. Instituti Mbretëror i Çështjeve Ndërkombëtare (RIIA) u krijua nga miqtë e Sesil Rodit dhe nga emra të tjerë të ndryshëm tashmë të njohur, përfshirë Astorët. Financohej, sikurse vazhdon edhe sot e kësaj dite, nga një listë e gjatë shumëkombëshesh dhe grupesh të medias, pronë e familjeve të Vëllazërisë.

Instituti Mbretëror i Çështjeve Ndërkombëtare ka lidhje me krerët e botës politike, financiare, ekonomike, gazetareske e kështu me radhë. Për shembull, njëri prej anëtarëve të tij më domethënës ka qenë Xhon (Jakob) Astori (Kom 300), drejtor i *Hambros Bank* (Vëllazëria) dhe, që nga viti 1922, pronar i gazetës *Times*. Midis themeluesve të tjerë figurojnë Sër Abe Bejli, pronar i *Transvaal Mines* në Afrikën e Jugut, që bashkëpunoi me Alfred Milnerin për të shkaktuar shpërthimin e luftës boere; dhe Xhon U. Uiler Beneti, që do të bëhej "këshilltari politik" i gjeneralit Ajzenhauer në Londër, në vitet e fundit vendimtare të Luftës së Dytë Botërore, kur vendosej rendi i botës së pasluftës. Instituti është jashtëzakonisht i lidhur me universitetet britanike si Oksfordi e Kembridxhi dhe me *London School of Economics*, që ka prodhuar shumë "radikalë" të së "majtës". Libri i turpshëm i Hitlerit me titullin *Mein Kampf*, ishte shkruar në realitet nga gjeneral majori Karl Haushofer, që ka pohuar se burimi kryesor i ideve të shprehura në libër ishte Halford Xh. MekKinderi, drejtori i *London School of Economics*. Ashtu si në rastin e Tavolinës së Rrumbullakët, disa filiale të Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare qenë hapur në Australi, në Kanada, në Zelandën e Re, në Nigeri, në Trinidad e Tabako, në Indi, ku njihet si Këshilli i Çështjeve Botërore. Filiali i tij amerikan, Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme (CFR), u vendos në Harold Prat Hauz të Nju Jorkut,

LIBRI

me numrin 58 East të Rrugës së 68-të, që kishte qenë rezidencë e familjes Prat, mike e Rokfelerëve. Ky institucion ishte organizuar nga koloneli Mandel Hauz, nga J.P. Morgani (Paisuaja), nga Rokfelerët dhe nga ortakët e tyre. CFR-ja mori shpejt kontrollin e Shteteve të Bashkuara dhe e mban ende sot. Shikoni anëtarët e këtij Këshilli dhe do t`i gjeni në nivelet më të larta brenda të gjitha institucioneve që kontrollojnë jetën e popullit amerikan, përfshirë sektorin e arsimit. Këto organizata, ashtu si Tavolina e Rrumbullakët, janë ndërtuar mbi bazën e grupeve të brendshme e të jashtme. Grupi i brendshëm është në dijeni të Urdhërit të Ditës dhe punon me kohë të plotë për ta realizuar. Ai i jashtëm është në dijeni të pjesës më të madhe të atyre planeve dhe punon për ta arritur atë qëllim në sferën e tij të ndikimit. Rrethi që vjen akoma më pas nuk është aspak në dijeni të Urdhërit të vërtetë të Ditës, por manipulohet me qëllim që të marrë vendimet e "duhura" në sektorin e kompetencave të tij, pa e njohur arsyen e vërtetë. Admirali amerikan Çester Uard, ish këshilltari më i lartë juridik i Marinës, ka qenë anëtar i CFR-së për gjashtëmbëdhjetë vjet. Ai ka deklaruar se qëllimi i organizatës ishte: "...shfuqizimi i sovranitetit amerikan dhe i pavarësisë kombëtare nëpërmjet një qeverie të vetme botërore e të gjithëfuqishme". Në librin e tij *Kissinger On The Couch*, të shkruar bashkë me Filis Sheflin, Uardi thotë:

"...vullneti për të hequr dorë prej sovranitetit dhe prej pavarësisë së Shteteve të Bashkuara është i përbashkët për pjesën më të madhe të anëtarëve dhe, në mënyrë të veçantë, midis krerëve të mjaft klikave të ndryshme që e përbëjnë atë organizatë, e cila është me të vërtetë një organizatë policentrike... (klika kryesore) *përbëhet nga ideologët e qeverisë së vetme e globale – që plot respekt e quajnë veten si internacionalistë të organizuar. Janë ata që e çojnë përpara traditën e themeluesve".*

Që nga viti 1921 praktikisht çdo president i Shteteve të Bashkuara ka qenë anëtar i CFR-së, bashkë me pjesën më të madhe të atyre që mbulonin detyra qeveritare, përfshirë shumë (e sot të gjithë) ambasadorë amerikanë të shpërndarë nëpër botë. CFR-ja përfshin edhe pronarë mjetesh të komunikimit, gazetarë e botues të rëndësishëm, edukatorë, krerë ushtarakë e kështu me radhë. Anëtarët e Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare qëndrojnë të fshehtë, por midis tyre figurojnë edhe njerëz që mbulojnë të njëjtat role në Mbretërinë e Bashkuar dhe dua të nënvizoj se CFR-ja amerikane varet e merr urdhëra nga Instituti Mbretëror i Londrës. Që të dyja këto organizma janë të lidhura me Mendjendriturit, me urdhërat "kalorsiakë" si ai i Kalorësve të Shën Gjonit të Jeruzalemit (Malitës), me rrjetin e kontrolluar nga monarku

britanik, mbi të cilin do të ndalem më pas; me masonët, me trëndafilkryqëtarët dhe me Tavolinën e Rrumbullakët; me rrjetin e "fondacioneve" amerikane, si Fondacioni Rokfeler dhe një rrjet i pafund grupesh të lidhura ndërmjet tyre, që veprojnë për të njëjtin qëllim të *leadership*-it global. Në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar ky rrjet ishte përhapur në të gjithë botën dhe, Vëllazëria, ishte tashmë gati për projektin e saj më ambicioz, Luftën e Dytë Botërore. Ajo luftë ishte një përpjekje për të centralizuar më tej pushtetin dhe për të krijuar një organizëm global, që mund të evoluonte pastaj në një qeveri botërore. Sot e njohim atë organizëm me emrin Kombet e Bashkuara.

Me ekonominë gjermane copë e çikë dhe me inflacionin që arrinte një nivel të barabartë me disa mijëra pikë përqindjeje, populli gjerman e pa Adolf Hitlerin si shpëtimtarin e tij. Problem-reagim-zgjidhje. Nazistët u financuan nga Uoll Striti dhe nga *Siti* i Londrës. E gjitha kjo u krye nëpërmjet filialeve gjermane të shoqërive britanike e amerikane dhe huave amerikane të njohura si Plani Jung e Plani Daues. Këto huara duhej ta ndihmonin Gjermaninë për të paguar dëmshpërblimet, por në realitet përfunduan drejtpërdrejt tek makina e luftës e Hitlerit. Kompania *Standard Oil* (Rokfelerët) dhe *I.G. Farben*, trusti kimik gjerman që drejtoi kampin e përqëndrimit të Aushvicit, ishin, në realitet, e njëjta ndërmarrje. Hitleri hipi në pushtet në vitin 1933 dhe po në atë vit, jo rastësisht, Franklin Delano Rusvelti u bë president i Shteteve të Bashkuara. Ngjitja e tij në pushtet ishte e njëjtë me atë të Hitlerit. Në vitin 1929, bankierët e Vëllazërisë bënë që të binte bursa e Uoll Stritit, duke shkaktuar krizën e madhe. Rusvelti u përpoq ta zgjidhte këtë problem me paketën ekonomike të quajtur "Kursi i Ri", që i dha mundësinë të fitonte zgjedhjet presidenciale të vitit 1933. Ky "Kurs i Ri" ishte një kopje e saktë e paketës ekonomike që Hitleri i kishte ofruar popullit gjerman, për të zgjidhur problemet ekonomike të krijuara artificialisht. Kur mori pushtetin, Rusvelti vuri në shenjë një prej grabitjeve më të mëdha të historisë njerëzore, duke miratuar ligjet, që e detyronin popullin amerikan t`ia dorëzonte të gjithë arin e tij qeverisë, në shkëmbim copash letre pa vlere, të njohura si kartëmonedha të Rezervës Federale. Kjo ishte e nevojshme, u tha, për të zgjidhur problemet e rënda ekonomike. Pas pak, kur ekonomia amerikane ishte tashmë plotësisht nën kontrollin e Vëllazërisë, Rusvelti e vendosi simbolin e kësaj të fundit, piramidën me syrin që sheh gjithçka, në kartëmonedhën prej një dollari. Ishte sikur t`u thoshte amerikanëve: "Ua futa!".

Franklin Rusvelti, një mason i shkallës së 33-të, qe stolisur me titullin e Kalorësit të Pitias, në përbërje të një shoqërie të fshehtë të quajtur Urdhëri i Lashtë arab i Fisnikëve dhe i Mistikëve. Midis anëtarëve të tij të mëparshëm

figuronin Frensis Bekoni dhe revolucionari francez Miraboja. Hyrja në këtë sekt u lejohet vetëm masonëve që kanë arritur të paktën shkallën e 32-të, ose që janë anëtarë të lozhave tempullare të Masonerisë[13]. Urdhëri sipas gjasës është themeluar nga një pasardhës i Muhametit, që e bëri pjesë të një shoqërie të fshehtë të Evropës mesjetare, e cila përbëhej nga hebrej, arabë e të krishterë[14]. Simboli i tij është një drapër hëne i formuar nga putrat e një tigri të Bengalit, i shoqëruar nga një piramidë, nga një vazo e nga një yll pesëcepash, një kombinim ky që zë fill tek Nëna Universale: Isidë-Semiramidë-Ninkharsag[15]. Ministri i Bujqësisë i Rusveltit, përveçse okultist, Henri Uelshi, ka qenë përfshirë në vendimin për të paraqitur simbolin e syrit që gjithçka sheh në kartëmonedhën prej një dollari[16]. Uelshi kishte një mësues shpirtëror, mistikun dhe artistin rus Nikolas Roeriçin, që kaloi shumë vite në udhëtim midis Nepalit dhe Tibetit, ku studioi me lamat dhe shkoi në kërkim të qytetit të zhdukur të Shamballës, atdheut legjendar të ithtarëve të fshehtë të okultizmit, apo "mjeshtrave", që thuhet se kanë ndikuar fshehurazi punët e botës në krejt harkun e historisë. Ata janë njohur në mënyrë të larmishme si Krerët e fshehtë, Mjeshtrit e fshehtë, apo Vëllazëria e Madhe e Bardhë dhe disa studiues mendojnë se qëndrojnë ata prapa krijimit të Urdhërit të Masonëve, të Urdhërit të Sufijve, të Urdhërit të Kalorësve Tempullarë, të Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve, të Shoqërisë Teozofike dhe të Urdhërit hermetik të Agimit të Artë[17]. Unë besoj se të paktën disa prej këtyre njerëzve janë zvarranikë. Nikolas Roeriçi bëri pjesë në krijimin e Lidhjes së Kombeve, përpjekja e parë e qeverisë botërore, dhe mbështeti veprën e doktor Andrej Puhariçit, një shkencëtar që ndihmoi një të ri izraelit me emrin Uri Geler të zhvillonte fuqitë e tij medianike[18].

Në Britaninë e Madhe, anëtarët e Tavolinës së Rrumbullakët-Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare të zgjedhur në parlament, së pari u shprehën në favor të një politike konçesionesh kundrejt Gjermanisë, duke i dhënë kështu mundësi makinës ushtarake të ngritur në këmbë nga Hitleri të arrinte një nivel të atillë sa të mundej të përballonte një luftë të gjatë. Në atë pikë, papritmas, ata ndryshuan mendim dhe bënë thirrje për një luftë pa kushte kundër Hitlerit. Midis figurave më groteske që mbështetën këtë pikëpamje figurojnë Ledi Astor, Leopold Ameri, Lionel Kurtis dhe Lord Lotiani, të gjithë anëtarë të Tavolinës së Rrumbullakët dhe/ose të Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare. Lord Halifaksi, ministër i Jashtëm dhe anëtar i Tavolinës së Rrumbullakët gati që nga themelimi i saj, ishte një tjetër përkrahës i mocionit për marrëveshjen me Hitlerin. E takoi më 19 nëntor të vitit 1937 dhe përfaqësuesi i Hitlerit, Alfred Rozenbergu, kishte ardhur në

Britaninë e Madhe në maj të vitit 1933 për të takuar Sër Henri Deterdingun (Kom 300), kreu i kompanisë *Royal Dutch Shell*, Gofrej Dausonin, drejtor i gazetës *Times*, gazeta pronë e Astorëve (Tavolina e Rrumbullakët, Instituti Mbretëror, Kom 300), viskontin e parë Heilsham, ministër i Luftës, deputetin Uolter Eliot, dukën e Kentit, vëlla i mbretit Eduard VIII dhe mbret Xhorxhi VI. Do të kthehemi më pas mbi lidhjet midis familjeve mbretërore britanike dhe nazizmit. Kalimi i beftë nga një politikë koncesionesh në favor të Hitlerit në një tjetër që bënte thirrje për luftë kundër tij, pati një reflektim edhe në Douning Strit, ku më 11 maj 1940 Nevil Çamberleni, kryeministri në favor të një marrëveshjeje me Gjermaninë, u zëvendësua nga intervencionisti i Vëllazërisë, Uinston Çurçilli. Pak pas emërimit të tij, në Gjermani filloi bombardimi në shkallë të gjerë i objektivave civilë. Shtriganët arianozvarranikë po bëheshin gati të kryenin një ritual gjaku në shkallë globale.

Përkatësisë së Çurçillit në Urdhërin e Masonëve shpesh i është ulur rëndësia, sikurse ka ndodhur në rastin e princ Filipit. Por, në realitet, prapa kuintave, Çurçilli ka qenë një mason shumë aktiv, që nga koha e hyrjes së tij brenda Lozhës Studholm (nr. 1591) pranë Café Royal-it, në maj të vitit 1901[19]. Historianët vendas të Bradfordit, në Angli, kanë gjetur prova që vërtetonin se disa prej masave të marra nga Çurçilli në kohën e luftës shpjegoheshin vetëm duke mbajtur parasysh se qoftë ai, qoftë Jorgua II i Greqisë ishin masonë. Një shembull i kësaj u pa në vitin 1943, kur Çurçilli dërgoi 5.000 ushtarë në Athinë, për të rivendosur Jorgon në fron, pavarësisht se sovrani i ngujuar urrehej nga të gjitha palët dhe ushtarët ishin të nevojshëm gjetkë[20]. Familja Çurçill ka lidhje të ngushta me Rotshildët dhe rrethet ekzoterike. Uinston Çurçilli hyri në Lozhën e Albionit të Urdhërit të Lashtë të Druidëve, pranë Blenhejm Palasit, më 5 gusht 1908[21]. I ati i tij, Lord Randolf Çurçilli, ishte financuar nga familja e Rotshildëve kur ishte Kancelar i Thesarit në mesin e shekullit XIX dhe miku i tij më i shtrenjtë ishte Nataniel Rotshildi. Kur Randolfi vdiq, kishte hyrë në borxh me Rotshildët me një shifër prej 65.000 stërlinash, një shumë tepër e madhe për ato kohëra[22]. Edhe Uinstoni hyri në borxh me ta dhe ka qenë në miqësi me Lordin Viktor Rotshild, orkestrues i shërbimeve të fshehta britanike, dhe me Bernard Barushin, kryemanipulues për llogari të Rotshildëve në Shtetet e Bashkuara. Çurçilli ka pasur lidhje të ngushta me familjen e Sesilëve, dhe Sesilët kanë prej kohësh lidhje me organizatat e krijuara nga ai front i Vëllazërisë siç janë jezuitët, me Habsburgët, me monarkët britanikë dhe me familjet italiane të Fisnikërisë së Zezë. Çurçillët janë në lidhje farefisnie me familjen e dukës së Marlborougut, e cila ka qenë vendimtare në vendosjen e Uilliam d'Oranzhit në fronin britanik dhe, në

fakt, Uinston Çurçilli lindi pikërisht në rezidencën e familjes së tyre, në Blenhejm Palas, pranë Oksfordit. Çurçilli e dinte me saktësi atë që bënte dhe imazhi, që historia zyrtare na ka përcjellë për të, është qesharak. Nuk i shpëtoi aspak ishujt britanikë nga tirania, por kontribuoi për ta krijuar vetë atë tirani.

Një redaktor i mesazheve të shifruara pranë ambasadës amerikane të Londrës, me emrin Tajler Kent, u mbajt i burgosur gjatë gjithë kohës që zgjati lufta, sepse i kishte dhënë një deputeti konservator, kolonelit Ramsej, provat e faktit se Çurçilli, ende jo kryeministër, dhe Rusvelti kishin intriguar për të shpërthyer lufta, duke komunikuar me njëri-tjetrin nëpërmjet mesazheve të shifruara. Edhe Ramseji u burgos mbi bazën e një ligji të quajtur Dispozita 18b, që, duke iu përmbajtur asaj që tha qeveria, qe futur paksa para luftës për t'u bërë ballë akteve terroriste të organizatës *Irish Republikan Army* (IRA). Një tjetër zbatim i teknikës problem-reagim-zgjidhje. Ky qe thjesht preteksti që përdorën për të futur një ligj, që do t'u kishte dhënë atyre mundësi, gjatë luftës, të fusnin në burg njerëz pa një proces dhe të vazhdonin kështu të fshihnin kalbësirën, që kishin në shtëpi. Një grua, e shoqja e një admirali, ishte burgosur mbi bazën e Dispozitës 18b teksa po linte sallën e gjyqit, që e kishte liruar nga të gjitha akuzat! Njeriu që e ideoi këtë ligj ishte Lordi Viktor Rotshild, njëri prej manipuluesve më të rëndësishëm të gjysmës së dytë të shekullit XX, përveçse mik i Uinston Çurçillit. Ishte Çurçilli ai që filloi ta zbatonte Dispozitën 18b sapo hyri në fuqi, me qëllim që të burgoste të gjithë ata që e dinin se çfarë po ndodhte realisht dhe kishin ndërmend ta zbulonin. Ambasadori amerikan në Londër gjatë luftës ishte Xhozef Kenedi, i ati thellësisht i pandershëm i Xhon F. Kenedit. Kenedët janë një familje e elitës, që i përket kohërave të mbretërve irlandezë e më tej. Për ta plotësuar të gjithën, ambasadorët britanikë në Amerikë gjatë luftës ishin Lordi Lotian i Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare dhe Lordi Halifaks i Institutit Mbretëror, i Tavolinës së Rrumbullakët dhe i Komitetit të 300-ëve. Franklin Rusvelti i fitoi për herë të dytë zgjedhjet presidenciale në vitin 1937, duke përsëritur shumë herë se djemtë amerikanë nuk do të shkonin për të zhvilluar një luftë tjetër në Evropë, teksa e dinte në mënyrë të përkryer se kjo ishte pikërisht ajo që do të bënin. Deputeti Filip Beneti i Misourit tha në Kongres:

"Por djemtë tanë nuk do të dërgohen jashtë, thotë presidenti. Gjepura, zoti president; ndërkohë tani janë duke u marrë masat për përgatitjen e shtretërve në anijet tona të transportit. Ndërkohë tani skedat për identifikimin e të vdekurve dhe të të plagosurve po prodhohen nga ndërmarrja e Uiliam K. Ballantajnit & Ko. në Uashington"[23].

Rusvelti ishte zgjedhur për herë të dytë duke thënë se Amerika nuk do të kishte zhvilluar një tjetër luftë në Evropë dhe, kështu, kur u rikthye në Shtëpinë e Bardhë, iu desh të përballonte një problem të marrëdhënieve me publikun, pasi ishte duke kontribuar tashmë për ta organizuar atë luftë. Ashtu si në rastin e Vudrou Uillsonit dhe të mbytjes së anijes *Lusitania*, sajoi një situatë të tipit problem-reagim-zgjidhje, që të mund t'i jepte një pretekst për të mos i mbajtur "premtimet". Në vitin 1939, senatori P. Neji i Dakotës së Veriut tha se kishte parë një sërë vëllimesh të titulluar *Lufta e afërme*, prej të cilëve njëri me titullin *Propaganda në luftën e afërme*, që vinte nga Londra (natyrisht!). Ky tekst zbulonte strategjinë e manipulimit, që do ta kishte tërhequr Amerikën në Luftën e Dytë Botërore. Ja çfarë thoshte ky dokument i shkruar midis dy luftërave:

"T`i bindësh (Shtetet e Bashkuara) *të marrin pjesë do të jetë shumë më e vështirë, aq e vështirë sa mund të rezultojë e pamundur. Do të na duhet një kërcënim i qartë për Amerikën, një kërcënim që propaganda duhet ta çojë në shtëpinë e çdo qytetari, para se shteti të marrë përsëri armët në një konflikt të jashtëm..."*

"...Kjo do të rezultonte natyrisht më pak e vështirë, nëse përfshihej ***Japonia*** (theksimi me të zezë është imi), *pasi kjo gati me siguri do ta tërhiqte brenda Amerikën pa ngurrime të mëtejshme. Sidoqoftë, ky do të jetë qëllimi i natyrshëm dhe i qartë i propagandistëve tanë, që dikur gjatë Luftës së Madhe arritën t`i përfshinin Shtetet e Bashkuara kundër Gjermanisë".*

"Fatmirësisht për Amerikën, propaganda jonë mbështetet mbi një terren të fortë. Mund të jemi krejtësisht të sinqertë, pasi baza jonë do të jetë gjithmonë ajo e demokracisë. Duhet ta formulojmë qartë besimin tonë tek forma demokratike e qeverisjes dhe bindjen tonë të vendosur për të nderuar... perëndeshën e vjetër të demokracisë së përditshme"[24].

Më 7 dhjetor 1941 aeroplanët japonezë sulmuan Perl Harborin, në ishujt Hauai, dhe Shtetet e Bashkuara hynë në luftë. Që në atë kohë u vërtetua nga shumë mesazhe të kapura se Rusvelti qe paralajmëruar shumë kohë përpara sulmit japonez, por asnjë masë paraprake nuk u mor dhe amerikanët u sakrifikuan për Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë, sikurse u ka ndodhur miliarda njerëzve në mijëvjeçarët e fundit. Vetë sulmi arriti pas një fushate të gjatë të drejtuar nga amerikanët, me qëllimin për ta shtyrë Japoninë t'i sulmonte. Henri Stimsoni, ministri i Luftës nën presidencën e Rusveltit, përveçse

LIBRI 24

themelues i Këshillit mbi Marrëdhëniet e Jashtme (CFR), kishte thënë: "Duhet të realizojmë një punë delikate diplomatike në mënyrë që të sigurohemi që Japonia të jetë nga ana e kundërt dhe të kryejë hapur e para lëvizjen e gabuar"[25].

Ja një përmbledhje e vogël se si Lufta e Dytë Botërore pllakosi mbi planet dhe se si dhjetëra miliona burra, gra e fëmijë humbën jetën e tyre. Kulmi u arrit kur dy bomba atomike u lëshuan mbi Japoninë, e cila e kishte pranuar tashmë dorëzimin me të njëjtat kushte që e pranoi pas shkatërrimit të shkaktuar nga bombat. Njeriu që urdhëroi lëshimin atyre bombave ishte presidenti Harri S. Truman, që në fund të luftës kishte zëvendësuar Franklin Rusveltin. Trumani ishte një mason i shkallës së 33-të dhe, me të arritur atë nivel, shtoi një S ndërmjet emrit dhe mbiemrit, që i përkon emrit Solomon. Trumani ishte një tregtar i falimentuar dhe ishte gjykuar i paaftë për çfarëdolloj pune, para se masonët ta nisnin për karrierë politike. E ëma e tij e humbi fermën për shkak të borxheve të të birit, që, tashmë president, e kishte zakon ta kalonte mbrëmjen duke u dehur nëpër mejhanet e rrugicave të Uashingtonit, i ndjekur së largu nga dy agjentë të FBI-së, që Edgar Huveri i kishte ngarkuar të kujdeseshin për të[26]. Karriera e Trumanit u ngjit kur u bë kreu organizator i lozhave masonike të Misourit, dhe ishte pastaj kandidat për detyrën e gjykatësit, para se të transferohej në Shtëpinë e Bardhë[27]. Njeriu përgjegjës i kësaj ngjitjeje stratosferike ishte masoni Bos Prendergast, që mbulonte edhe rolin e kreut të krimit të organizuar të Kansas Sitit[28]. Njeriu i besuar më i afërt për Trumanin ka qenë David Nilsi, ose Nejhusi, i cili kishte një motër që mbulonte një detyrë të rëndësishme brenda qeverisë së Izraelit dhe një tjetër që bënte politikë në Moskë[29]! Ja pra se cili ishte mjedisi në të cilin lëvizte Herri S. Trumani, funksionari oportunist i Masonerisë, që kundërshtoi të pranonte kushtet e dorëzimit të Japonisë, urdhëroi shkatërrimin atomik, dhe pastaj pranoi dorëzimin me të njëjtat kushte, të cilat më parë i kishte kundërshtuar. Bombat u lëshuan sepse, në çastin kur u mbyll një fazë e Urdhërit zvarranik të Ditës, u hap menjëherë një tjetër – Lufta e Ftohtë – dhe në atë pikë ishte më e lehtë të nxisje frikën e nevojshme për të realizuar ato plane, duke qenë se njerëzit e kishin parë se çfarë ndodhte kur shpërthente një prej atyre bombave.

Pas luftës, bota u shkatërrua mendërisht, emocionalisht, shpirtërisht e fizikisht. Kjo u dha mundësi bankave të realizonin pasuri shumë të mëdha, duke u dhënë para hua qeverive, për të rindërtuar shoqëritë e shkatërruara nga një luftë që vetë ato banka e kishin financuar. Kjo e rriti në mënyrë marramendëse borxhin e kombeve kundrejt bankave private dhe kontrolli

mbi ato vende u rrit në mënyrë përpjesëtimore. Dëshira e dëshpëruar për paqe e shtyu botën të pranonte atë që Vëllazëria e kishte vënë si objektiv kur kishte ideuar luftën: krijimin e Kombeve të Bashkuara. Problem-reagim-zgjidhje (shih *Figura* 22). Statuti i Kombeve të Bashkuara, organizmi global aq shumë i dëshiruar prej Vëllazërisë, ishte shkruar nga një komision i Këshillit mbi Marrëdhëniet e Jashtme (CFR). Autori Xhejms Perlof, i ka zbuluar prapaskenat e kësaj në librin e tij të vitit 1988, me titullin *The Shadows Of Power: The Council On Foreign Relations And The American Decline*:

"Në janër të vitit 1943, sekretari i Shtetit, Korder Halli, krijoi një komitet drejtues të përbërë nga ai vetë, Leo Pasvolski, Isaia Baumani, Samer Uelshi, Norman Dejvisi e Morton Tejlori. Të gjithë këta njerëz – me përjashtim të Hallit – bënin pjesë në CFR. Ata hartuan projektin origjinal për krijimin e Kombeve të Bashkuara dhe për këtë arsye morën pastaj emrin Grupi Jozyrtar i Punës. Ishte Baumani – themelues i CFR-së – ai që e shtroi i pari propozimin. Thirrën tre juristë, të gjithë njerëz të CFR-së, që deklaruan se kjo ishte kushtetuese. Pastaj folën për këtë me Franklin Rusveltin, më 15 qershor 1944. Presidenti e miratoi planin dhe e njoftoi në publik ditën e mëpasshme"[30].




Figura 22. *(Problem-reagim-zgjidhje) (Lufta e Dytë Botërore) – Financim dhe manipulim politik, Financim dhe manipulim politik;* ***Elita Globale – Komunizmi sovjetik/Kapitalizmi – Nazifashizmi – Konflikt-Luftë e Dytë Botërore – Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian.*** – Lufta e Dytë Botërore. Ajo që e fitoi ishte vetëm Vëllazëria Babilonase.

LIBRI

Në librin e tij me titullin *The American Language* (Gjuha amerikane), H.L. Menkeni thotë se emri "Kombet e Bashkuara" ishte zgjedhur nga presidenti Rusvelt gjatë një takimi me Uinston Çurçillin në Shtëpinë e Bardhë në dhjetor të vitit 1941, pak përpara sulmit të Perl Harborit. Kur u krijuan zyrtarisht Kombet e Bashkuara në San Francisko më 26 qershor të vitit 1945, delegacioni amerikan kishte në përbërje 74 anëtarë të CFR-së, midis të cilëve Xhon Xh. MekKlojin, president i CFR-së në vitet 1953-1970, anëtar i Komitetit të 300-ëve, president i Fondacionit Ford e i *Chase Manhattan Bank* të Rokfelerëve dhe mik e këshilltar i nëntë presidentëve, nga Rusvelti tek Regani. Ishin edhe Xhon Foster Dallesi, mbështetës i Hitlerit, themelues i CFR-së dhe sekretar i ardhshëm i Shtetit, dhe Nelson Rokfeleri, satanist e kryemanipulues, që për katër herë ka qenë guvernator i Nju Jorkut dhe zëvendëspresident nën presidencën e Xherald Fordit, kur Riçard Niksoni u hoq pas skandalit të Uotergejtit. Por mos harroni që, edhe pse CFR-ja i krijoi Kombet e Bashkuara, ajo mbetet përgjithmonë një degë e Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare të Londrës, i cili nga ana e tij është vetëm një degëzim i Tavolinës së Rrumbullakët, organizmi që zë nivelin më të lartë hierarkik. Rokfelerët, që kishin marrë përsipër shpenzimet për selinë e Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, tani dhuruan truallin, mbi të cilin u ndërtua pallati i Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Mbi atë terren ngrihej më përpara një thertore dhe kjo ishte saktësisht ajo që dëshironin satanistët e Vëllazërisë. Një tokë e mbytur me gjak, me frikë e me dhimbje, mbi të cilën të themeloje një organizatë, që ndiqte të njëjtat qëllime midis qenieve njerëzore.

OKB-ja është një kalë Troje për arritjen e qëllimit final të një qeverie botërore, që kontrollon një mori organizatash, të cilat deklarojnë se janë në shërbim të popullit, kur në realitet nuk janë gjë tjetër veçse fasada të manipulimit më grotesk edhe në vendet në zhvillim të Afrikës, të Azisë, të Amerikës së Jugut e të Amerikës Qendrore. Rrjeti i OKB-së përfshin Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH), një ndihmëse e trustit farmaceutik zvicerano-anglo-amerikan, nga i cili merr hua edhe drejtuesit. OBSH-ja paralajmëron botën se do të shpërthejë një epidemi e një gjëje apo e një gjëje tjetër dhe ato që e kontrollojnë, domethënë ndërmarrjet farmaceutike, furnizojnë vaksinën. Ja pra ku jemi përsëri përballë strategjisë problem-reagim-zgjidhje, teksa vaksinat shkaktojnë dëme të pallogaritshme për mirëqenien fizike dhe shpirtërore të miliarda njerëzve. Fondacioni demografik i OKB-së e përdor "kontrollin demografik" për të vënë në zbatim një politikë eugjenetike (përmirësimi të racës njerëzore) kundrejt atyre që e kanë fytyrën me ngjyrë, ose kundrejt atyre, që, edhe duke e pasur fytyrën të bardhë, nuk

janë gjenetikisht të "pastër" (domethënë, zvarranikë), ashtu siç do të dëshironin këta të çejkulibruar. Programi mjedisor i OKB-së e përdor mjedisin si pretekst për të krijuar ligje ndërkombëtare, për të marrë kontrollin e ngastrave të mëdha të tokave dhe për t`u grabitur tokën vendeve në zhvillim, si "dëmshpërblim" të borxheve ku ato kanë hyrë. UNESKO-ja, institucion shkencor e kulturor, nxit Urdhërin e Ditës në shumë sektorë të jetës. Kombet e Bashkuara, të cilat, sipas propagandës, u krijuan për t`i dhënë fund luftës, tani përkundrazi marrin pjesë në luftë. Është pikërisht kjo ajo që ndodhi në Gjirin Persik, kur ushtarët dhe pilotët amerikanë, britanikë e francezë vranë mijëra civilë irakenë nën flamurin e OKB-së.

Sot, kukulla e fundit e shtyrë në poltronën e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së është Kofi Anani, një njeri me ngjyrë, të cilit duhej t'i vinte neveri prej trajtimit që organizata e tij është duke i rezevuar kontinentit të vet afrikan. Midis këshilltarëve të tij figuron Mauric Strongu, manjati amerikan i naftës, klon i Rokfelerëve dhe manipulues i jashtëzakonshëm, deri madje i lëvizjes ambientaliste. Kombet e Bashkuara kanë si qëllim të mirën e botës? Oh, po sigurisht! Vështroni, është një tjetër gomar që fluturon!

PJESA III

LIBRI 24

Kapitulli 12

Dielli i zi

Shumë prej elementeve kryesore të historisë që po paraqes në këtë libër gjenden tek idetë e Adolf Hitlerit dhe të nazistëve. Kjo nuk të çudit, duke qenë se Partia Naziste është krijuar nga shoqëri të fshehta, që kishin të drejtën të hynin në rrjedhën sekrete të dijeve, në të cilat përmbahet historia e vërtetë, ose më e vërtetë, e origjinës njerëzore.

Gjermania është prej shumë kohësh një qendër mendimi ekzoterik e sektesh të fshehta dhe, siç e kemi parë, midis familjeve okulte më të spikatura të Gjermanisë mesjetare figuronin Bauerët, një degë e të cilëve mori emrin Rotshild. Shumë prej gjakut Umdsor e ka prejardhjen nga Gjermania. Urdhëri i Mendjendriturve Bavarezë, të përzier në shumë prej revolucioneve "popullore" evropiane, përfshirë atë francez, u themelua në Gjermani më 1 maj të vitit 1776 nga okultisti Adam Veishaupt dhe Kisha e Krishterë u nda në katolikë e protestantë nga Martin Luteri, agjenti gjerman i Urdhërit Trëndafilkryqëtar. Gjermania është një tjetër qendër e manipulimit global. Hitleri nuk ishte krijuesi i ideologjisë naziste, por vetëm ai që e shprehu publikisht. Në shekullin XIX, njëri prej profetëve para-hitlerianë ishte kompozitori Rikard Vagner dhe vepra e tij e titulluar *Kalimi i valkirieve*, shpreh idenë e tij fikse për fuqitë thellësisht depërtuese të së keqes. Vagneri deklaroi

LIBRI 24

mbërritjen e afërt të Racës Superiore. Një tjetër operë e Vagnerit, *Unaza*, ishte shprehja në muzikë e besimit të tij tek "mbinjerëzit" gjermanë, që kalërojnë në skenën e botës si të lashtët e paganëve, Votani dhe Thori. Hitleri do të thoshte më pas se për të kuptuar Gjermaninë naziste, duhej të njihje Vagnerin. Njëri prej nxënësve të atij fanatikut të racës superiore, Vagnerit, ishte kompozitori Gustav Mahler. Studimet e tij mbi Vagnerin qenë financuar nga baroni Albert de Rotshild. Njëri prej vendeve, që Vagneri vizitoi dhe mbi të cilin ndali për të bërë studime, ishte Rëne-lë-Shatoja, fshati misterioz i Francës Jugore shumë i lidhur me Urdhërin e Kalorësve Tempullarë dhe me Urdhërin e Katarëve. Në të vërtetë, rrjeti i shoqërive të fshehta gjermane është shumë afër me traditat tempullare dhe me ato të Kalorësve Teutonë, bashkëkohës të Kalorësve Tempullarë.

Adolf Hitleri lindi zyrtarisht në vitin 1889 në Branau-am-In, në kufirin midis Gjermanisë dhe Perandorisë Austro-hungareze. Ka, megjithatë, të tjera teori që thonë se ishte i të njëjtit gjak me Rotshildët, ose, deri madje, me princin Albert, dukë i Klarensit dhe i Avondalit, djali i dytë i mbretëreshës Viktoria, që duket se ka vdekur me pneumoni në Sandringam në janar të vitit 1892. U vendos që me rastin e varrimit të tij nuk do të bëhej asnjë ekspozim, as balsamim i trupit dhe se do të shmangej çdo "teprim" zije. Alberti duket vërtet se nuk ishte një "shaka" dhe e njëjta gjë mund të thuhet sigurisht për Hitlerin. Në atë kohë pështëritej se vdekja e Albertit ishte bërë sikur kishte ndodhur, pasi paqëndrueshmëria e tij mendore e bënte të paaftë të merrte përgjegjësitë e një mbreti (nuk e kuptoj përse!). Ka shumë teori mbi princin Albert, përshirë atë, sipas së cilës, ai ishte serial killeri i famshëm i Londrës viktoriane i njohur si Xhek Vrasësi, që vriste prostitutat sipas një rituali të përpiktë dhe linte mesazhe masonike në skenën e krimit.

Një gjë është vërtetuar nga provat, që ne zotërojmë: Xhek Vrasësi ishte i lidhur me nivelet më të larta të *establishment*-it britanik dhe, me shumë gjasë, me familjen mbretërore. Është pështëritur shpesh se princi Albert nuk vdiq në Sandringam, por ishte çuar në Gjermani. Kjo do të kishte qenë e lehtë për t'u bërë, duke qenë se familja mbretërore britanike e mbretëreshës Viktoria dhe e princit Albert ishte me prejardhje gjermane dhe ata kishin më shumë të afërm në Gjermani se sa në Angli. Emri i dinastisë së atëhershme mbretërore "britanike" ishte ai i dinastisë gjermane të Saksoni-Koburg-Gotas. Në vitet e para të Partisë Naziste, kur Hitleri ishte ende praktikisht i panjohur jashtë Bavarisë, tre prej funksionarëve të saj ishin duka i Saksoni-Koburg-Gotas, duka i madh Hese dhe dukesha e madhe Viktoria, ish e shoqja e dukës së madh Hese. Të gjithë ishin kushërinj të parë të princit Albert, dukë i Klarensit!

Një tjetër kushëri i tij i parë ishte Kajzeri Vilhelmi II. Përse dinastia mbretërore gjermane e mbështeti aq shumë Hitlerin, një rreshter të thjeshtë, që kishte marrë pjesë në Luftën e Parë Botërore? Nëse është e vërtetë që Alberti u bë Hitler, atëherë "Fyhreri" duhej të ishte shumë më i moshuar nga sa është deklaruar. Disa prova fotografike sugjerojnë, në fakt, se Hitleri ishte shumë më i moshuar nga sa thoshte historia zyrtare. E dashura e tij, Eva Braun, ia përshkroi së motrës si "një njeri i moshuar me moshë të papërcaktuar". Dua të nënvizoj se nuk jam duke thënë që këto histori janë të vlefshme, sepse nuk e di, por po të ishte e mundur për ju të gjenit ilustrime, apo fotografi, të Hitlerit dhe të princit Albert, do ta kuptoni arsyen e këtyre të thënave. Ata të dy ngjajnë shumë, nëse merret parasysh largësia prej 25 vjetësh. Ndoshta do të jetë vetëm një rastësi, por nëse dini ndonjë gjë më shumë, do të më bënit nder të vihesha në lidhje me ju. Do ta gjeni adresën, ku t'i dërgoni informacionet, në fund të librit.

Ekzoterizmi u bë një pasion i shfrenuar për Hitlerin, veçanërisht në periudhën e ngjitjes së tij në pushtet. Ai ishte i ndikuar fort nga vepra e Helena Petrovna Blavatskit, e lindur në Ukrahinë në vitin 1831 dhe që u bë më vonë, sipas asaj që më ka thënë një studiues i besuar, agjente e shërbimeve sekrete britanike. Sipas të tjerë hulumtuesve, ajo duhej të kishte pasur lidhje me shoqërinë e fshehtë të revolucionarëve italianë, Karbonarët, që ishin të lidhur ngushtë me Fisnikërinë e Zezë dhe duhej të bënte pjesë në shoqërinë egjiptiane të Vëllazërisë Luksor, të cilën mandej e denoncoi si "një çerdhe imoraliteti të neveritshëm, e etur për pushtet personal dhe fitim". Madamë Blavatski arriti në Nju Jork në vitin 1873 dhe, me ndihmën e një farë koloneli Henri Olkot, dy vjet më vonë themeloi Shoqërinë Teozofike, që ekziston edhe sot e kësaj dite. Selia amerikane e Shoqërisë Teozofike ishte në Kaliforni, në Krotona. Shkolla misterike pitagoriane në Greqinë e lashtë ishte në Crotona (Krotona). Shoqëria e Blavatskit frymëzohej, prapë edhe një herë, tek shkollat misterike. Doktrinat e propaganduara nga ky sekt bazohen mbi disa libra të Blavatskit si *Isis Unveiled* (Isida e zbuluar), shkruar në vitin 1877 dhe *The Secret Doctrine* (Doktrina e fshehtë), publikuar në vitin 1888, që të dy të bazuar nga ana e tyre tek Kabala hebraike. Blavatski deklaronte se ishte në lidhje medianike me mjeshtra, apo supernjerëz okultë. Këta mjeshtra okultë, vazhdonte ajo, jetonin në Azinë Qendrore dhe mund të takoheshin në mënyrë telepatike prej atyre që njihnin sekretet e mistereve ekzoterike. Sot ky proces komunikimi quhet "transmetim". Shumë përshquarje UFO-sh dhe shumë studime kanë treguar ekzistencën e bazave sekrete të nëndheshme e nëndetare jashtëtokësore të përhapura nëpër botë, sidomos në Azinë

Qendrore. Kjo na lidh përsëri me legjendat e shumta dhe me traditat e lashta, që në të gjithë botën flasin për një Racë Superiore, e cila jeton në angrrat e Tokës. Besimi në ekzistencën e Mjeshtrave dhe të Vëllazërisë së Madhe të Bardhë e përbërë nga qenie jolëndore, i mbështetur nga njerëz si Alis Bejli, një medium sensitive që ka jetuar në periudhën post-Blavatski, është një temë që qëndron e rrënjosur fort në atë që ne sot e quajmë lëvizja *New Age*. Alis Bejli themeloi shkollën ekzoterike Arkana. Deklaronte se "përçonte" një qenie të quajtur prej saj "tibetiani" dhe shkruajti një sërë librash, midis të cilëve *Hierarchy Of The Masters* (Një hierarki padronësh), *The Seven Rays* (Shtatë rrezet), *A New Group Of World Servers* (Një grup i ri shërbëtorësh botërorë) dhe *New World Religion* (Besimi i botës së re), Bejli ka thënë se Mjeshtri i saj Tibetian i kishte pohuar se Lufta e Dytë Botërore ishte e nevojshme për të mbrojtur planin e Zotit. E gjitha kjo më duket qesharake, por ka ca njerëz brenda lëvizjes New Age që besojnë se çdo gjë hyn tek "plani" dhe i përgjigjet vullnetit të Zotit, edhe një holokaust global. Duket një pretekst i madh për të mos bërë asgjë, një dredhim me përmasa globale. Ne e krijojmë realitetin tonë dhe, nëse ndryshojmë identitetin tonë të brendshëm, do të ndryshojmë edhe reflektimin e tij të jashtëm. Paqe e brendshme = paqe e jashtme. Luftërat nuk duhet të ndodhin domosdoshmërisht, sikur të ishin pjesë e ndonjë plani hyjnor. Jemi ne që i krijojmë dhe, nëse ndryshojmë unin tonë të brendshëm, sjelljet tona, mund të pushojmë së krijuari. Është vetëm një çështje zgjedhjeje. Sipas meje, Mjeshtrit, Vëllazëria e Madhe e Bardhë dhe krejt çështja kërkojnë një dozë të mirë kujdesi. Dridhem sa herë që dëgjoj fjalën "Mjeshtër".

Dy organizatat, me të cilat merren librat e Alis Bejlit, *Lucis Trust* (më parë *Lucifer Trust*) dhe *World Goodwill Organisation*, mbështesin që të dyja me ngulm Kombet e Bashkuara. Aq e madhe është devotshmëria e tyre, sa mund t'i quaje "tifoze" të OKB-së. Është interesant të vësh re se si lëvizja New Age në harkun e dhjetvjeçarëve i ka trashëguar të "vërtetat" në të njëjtën mënyrë që feja e zakonshme e ka bërë në harkun e shekujve. Ashtu sikurse ithtarët e krishtërimit kanë trashëguar figurën e dyshimtë të Jezusit, po kështu ithtarët e lëvizjes New Age kanë trashëguar Mjeshtrit. Besoj se në të dyja rastet bëhet fjalë për një pranim të verbër të besimeve të trashëguara. Me siguri kështu ka qenë në rastin e Mjeshtrave dhe të Vëllazërisë së Madhe të Bardhë të Blavatskit, duke qenë se kjo ka pohuar në letrat dërguar së motrës, se i kishte trilluar emrat e tyre, duke përdorur ofiqet e trëndafilkryqëtarëve dhe të masonëve që e financonin. Megjithatë, sot në të gjithë botën ekzistojnë qindra mijëra (të paktën) "përçuesa" të lëvizjes New Age, që deklarojnë se komunikojnë me këta Mjeshtra dhe me Kryengjëllin Mikel, i cili është një

LIBRI

hyjni e lashtë fenikase. Nëse lëvizja New Age nuk do të bëjë kujdes, do të përfundojë të bëhet një krishtërim i rivizituar. Është duke u bërë tashmë. Besoj se koncepti i Mjeshtrit mund të jetë një mjet, nëpërmjet të cilit, kush ka kundërshtuar *status quo*-në e fesë dhe të shkencës, mundet ende të lejojë që t'i kontrollojnë mendjen.

Një tjetër ndikim të madh mbi Hitlerin e ushtroi romani *The Coming Race* (Raca e ardhshme) e anglezit Lord Eduard Baluer-Liton (Kom 300), një ministër kolonial britanik i përfshirë në fushatën e diktatit të opiumit ndaj kinezëve. Ai ishte një mik i ngushtë i kryeministrit britanik Benjamin Dizrael dhe i shkrimtarit Çarls Dikens dhe ishte Padron i Madh i shoqërisë trëndafilkryqëtare angleze, e cila midis anëtarëve të parë të saj kishte pasur Frensis Bekonin dhe Xhon Dinë. Baluer-Litoni ishte edhe Mjeshtër i Madh i Ritit Skocez të Masonerisë dhe shef i shërbimeve të fshehta. Sipas një burimit tim, midis agjentëve të tij figuronte Helena Blavatski dhe libri i saj *Isis Unveiled* përmban shumë referime ndaj Baluer-Litonit. Ai është më shumë i njohur për veprën e tij *The Last Days Of Pompeii* (Ditët e fundit të Pompeit), por pasioni i tij ishte bota e magjisë ekzoterike. Tek libri *The Coming Race* shkruan për një qytetërim të madh të lulëzuar në angrrat e Tokës, shumë më i përparuar në krahasim me tonin. Anëtarët e këtij qytetërimi kishin zbuluar një forcë të quajtur *"Vril"*, e cila, duke shfrytëzuar psiqikën, mund të përdorej për të kryer "mrekulli". Sipas romanit të Baluer-Litonit, këta mbinjerëz të nëndheshëm një ditë do të dilnin në sipërfaqe dhe do të merrnin kontrollin e botës. Shumë nazistë i besuan të gjithë kësaj historie. Tema e mbinjerëzve të nëndheshëm, apo e mjeshtrave të fshehur, mund të haset në pjesën më të madhe të sekteve të fshehta dhe të legjendave të të gjithë botës. Sigurisht, kjo është e vërtetë për Urdhërin e Agimit të Artë, të krijuar në vitin 1888 nga masoni Uejn Uestkot dhe nga S.L. Metju. Ata i quanin Mjeshtrit e tyre "Krerët e Fshehtë". Kjo shtron përsëri temën e lashtë e bashkëkohore të racave jashtëtokësore, apo brenda-tokësore, që banojnë nën tokë. Metjui shpiku një sërë ritualesh dhe ceremonish, me qëllimin për t'i ndihmuar anëtarët e sektit që të hynin në fuqinë e tyre të plotë psiqike e fizike. Megjithatë, ai besonte se kjo dhunti ishte privilegj i pak njerëzve dhe ishte pro një qeverisjeje autoritare. Këto rituale do të kishin tërhequr energji jashtëzakonisht negative, që krijonin mundësi sinkronizimi e dridhës – zotërimi – me zvarranikët, apo me qenie të tjera "yjore" të nivelit më të ulët të përmasës së katërt, që banojnë aty. Njëra prej arsyeve kryesore të ceremonive magjike është që të sintonizojnë vetëdijen e anëtarit të sektit me atë të zvarranikëve dhe të të tjerëve, që populljonë nivelin më të ulët të përmasës së katërt. Në mesin e viteve nëntëdhjetë të

1800-ës kishte tempuj të Urdhërit të Agimit të Artë në Londër, në Edinburg, në Bradford, në Ueston Super Mare dhe në Paris, ku Metjui u vendos për të banuar. Agimi i Artë fliste edhe për forcën *Vril* dhe njëra prej shenjave të saj të fshehta ishte përshëndetja me krahun të ngritur, që nazistët e përdornin duke thënë "Hail Hitler". Ishte fjala për një prej bazave të tjera ekzoterike, tek të cilat mbështetej nazizmi. Metjui e kishte njohur Madamë Blavatskin, siç kishte bërë edhe Mjeshtri i tempullit londinez të Urdhërit, poeti Uiliam Batler Jets, që do të kishte marrë pastaj çmimin Nobel.

Sot ka mbetur diçka prej Urdhërit të Agimit të Artë, por versioni origjinal u shkri pas një grindjeje midis Jetsit, Metjusë dhe kryesatanistit Alejster Krouli, që i përçau anëtarët në fraksione kundërshtare. Midis mendimtarëve të tjerë dhe grupeve domethënëse, që ndikuan filozofinë e atëhershme naziste që po lindte, figuronin Urdhëri i Tempullarëve Lindorë (UTL), që përdorte rituale seksuale për të krijuar dhe mbajtur në fre energjinë e njohur si *Vril*, dhe dy magjistarë ekzoterikë, Guido fon Listi dhe Lanc fon Liebenfelsi. Në kremtimet e tij për solsticin e verës, Listi vendoste ca shishe vere në tokë për të formuar simbolin e Kryqit Hermetik, i njohur edhe si Hamer apo Thor. Bëhej fjalë për emblemën e Pushtetit të Urdhërit të Agimit të Artë dhe që ne e njohim këtë simbol si kryqi i thyer, simboli i lashtë diellor i fenikas-arianëve. Lanc fon Liebenfelsi (emri i vërtetë Adolf Lanc) porositi ta paraqisnin kryqin e thyer në një flamur, që valëvitej mbi "tempullin" e tij të kthyer nga ana e Danubit dhe, për këta dy shtriganë ai (*kryqi i thyer* - përkth.) simbolizonte fundin e krishtërimit dhe fillimin e epokës së mbinjerëzve arianë me flokë të verdhë e sy të kaltër. Ata besonin në inferioritetin racor të atyre që i quanin "forca të errëta", si hebrejtë, sllavët dhe zezakët. Për këta njerëz Liebenfelsi sugjeronte tredhjen. Të dy "fonët", Listi dhe Liebenfelsi, do të ndikonin në mënyrë të konsiderueshme mbi Adolf Hitlerin. Në vitin 1932, ndërsa Hitleri po bëhej gati për të marrë pushtetin, fon Liebenfelsi i shkruante këto fjalë një tjetër ithtari të atyre ideve:

"Hitleri është njëri prej nxënësve tanë... Një ditë do ta shohësh që ai, e nëpërmjet tij edhe ne, do të jemi fitimtarë dhe do të ngrejmë një lëvizje, që do ta bëjë botën të dridhet"[1].

Dy të tjerë që do të ndikonin mendimin dhe idetë e Adolf Hitlerit ishin anglezët Alejster Kroulej dhe Hjuston Stjuart Çamberleni. Kroulej lindi në Uarkshir në vitin 1875. U rebelua kundrejt edukimit të rreptë fetar dhe u fut në Urdhërin e Agimit të Artë në vitin 1898, pasi kishte lënë Universitetin e Kembrixhit. E braktisi urdhërin pasi u grind me themeluesit e tij dhe mandej

udhëtoi në Meksikë, në Indi, në Cejlon, ku iu afrua jogës dhe budizmit. U bë edhe një alpinist me përvojë. Interesit të tij për okultizmin ia zuri vendin budizmi, gjer në kohën kur, në Kajro, përjetoi një përvojë të veçantë në prill të vitit 1904. E shoqja, Rozi, i kërkoi të realizonte një ceremoni ekzoterike, për të parë se çfarë do të ndodhte. Gjatë ceremonisë, ajo hyri në një gjendje *transi* (gjumi hipnotik) dhe filloi të "përçonte" fjalët e një "transmetuesi". "Ata janë duke të të pritur", i tha Kroulit. Fjala "ata", i shpjegoi ajo, i referohej Horusit, që për kultin e lashtë egjiptian ishte perëndia e luftës dhe i biri i Osiridit. Kroulej nuk i besoi aspak të gjithë kësaj dhe i bëri së shoqes një sërë pyetjesh të hollësishme, me synimin që ajo të gabonte. Por Rozi, që dinte shumë pak prej ekzoterizmit, u përgjigj gjithmonë në mënyrë të saktë, sipas tregimit zyrtar. Bëhej fjalë për të satën interferencë zvarranike. Përçuesi i kumtoi Kroulit që të gjendej në tryezën e shkrimit të dhomës së tij të hotelit midis orës dymbëdhjetë dhe orës një të tri ditëve të veçanta. Ai pranoi dhe gjatë atyre çasteve krijoi, nëpërmjet shkrimit automatik, një dokument të titulluar *Book Of The Law* (Libri i ligjit). Shkrimi automatik ndodh kur krahu yt dhe dora jote rezultojnë të drejtuara nga një forcë e jashtme dhe, shpesh, askush nuk është më shumë i befasuar prej asaj që ka shkruar, se sa vetë personi që e ka bërë. Sipas asaj që i ishte komunikuar Kroulit, epoka e vjetër e Osiridit po bëhej gati të zëvendësohej prej epokës së re të Horusit, por epoka e vjetër do të ishte dashur të shkatërrohej me anë të barbarisë dhe Toka do t'i ishte nënshtruar një banje gjaku. Do të kishte shpërthyer, pra, një luftë botërore. Dokumenti *Book Of The Law* fliste për një racë mbinjerëzish dhe dënonte besimet e vjetra, pacifizmin, demokracinë, mëshirën dhe humanizmin. «Se shërbëtorët e mi janë të pakët e të fshehtë: ata do të qeverisin mbi të shumtit e të njohurit», vazhdonte "supernjeriu". Mesazhi thoshte edhe:

"Nuk duam të kemi të bëjmë aspak me të dobtit dhe me të përjashtuarit; që vdekshin në mjerimin e tyre, pasi ata nuk janë në gjendje të provojnë përshtypje. Mëshira është ves i mbretërve; shkeli të mjerët dhe të dobtit: ky është ligji i më të fortit; ky është ligji ynë dhe gëzimi i botës... të duash njëri-tjetrin me zemra të zjarrta; dërrmoi më të ultit me vrullin e egër të krenarisë tënde, në çastin e zemërimit tënd... Mos të të vijë keq për viktimat! Unë nuk i kam njohur kurrë. Unë nuk jam nga ana e tyre. Nuk i ngushëlloj; i urrej të ngushëlluarit dhe ngushëlluesit...".

"Unë jam i pashoq dhe pushtues. Nuk u përkas skllevërve që zhduken. Që qofshin të mallkuar e të vdekur. Amin... Për këtë arsye goditi fort e ligsht dhe dërgoi në ferr, mjeshtër... Fshihu! Largohu! Sulmoi! Ky është ligji i betejës së fitores;

LIBRI 24

kështu kulti im do të jetojë në shtëpinë time të fshehtë... Nderomë me zjarr e gjak; nderomë me shpatat dhe me heshtat. Që gruaja rrokte shpatën faqe meje: që gjaku rrjedhtë në emrin tim. Shkeli paganët; shkatërroi, o luftëtar, do të të dorëzoj mishin e tyre, që ti ta hash... Flijo bagëtinë, të imëta e të trasha; pastaj një fëmijë... vrije dhe torturoje; mos kurse asnjë; sulmoi!"[2].

Ky është një shembull tipik i mënyrës së të ndierit të zvarranikëve të nivelit më të ulët të përmasës së katërt dhe e satanistëve në shërbim të tyre. Nëse e gjitha kjo i ngjan në mënyrë të jashtëzakonshme asaj që lexohet tek Testamenti i Vjetër në lidhje me zemërimin e Zotit, arsyeja është se sigurisht ka qenë e njëjta forcë që ka frymëzuar të lashtët, Kroulin dhe të gjithë të tjerët që, duke u gjendur në atë dridhje, do të kishin kontribuar për të provokuar konflikte dhe për të nxitur energjinë e mjerimit njerëzor, me të cilën ushqehen zvarranikët. Është kjo forca që kontrollon vetëdijen e atij që, që nga kohërat e lashta, kontrollon Vëllazërinë Babilonase. Sapo t'i keni lexuar këto fjalë, do të hyni në lidhje me mendësinë që ka qenë në gjendje të krijojë tmerret, të cilat i kanë bërë mënxyra gjinisë njerëzore. Krouli u përpoq në dukje ta shpërfillte atë që kishte shkruar me dorën e tij të drejtuar, por nuk ia arriti dhe, që nga viti 1909, filloi t'i merrte parasysh seriozisht ato gjëra. Shumë seriozisht. Thotë:

"Pas pesë vjetësh çmendurie dhe dobësie, mirësjelljeje të keqkuptuar, takti, maturie dhe solidariteti për ndjenjat e të tjerëve, më ka ardhur me të vërtetë në majë të hundës. E them sot: në djall krishtërimi, racionalizmi, budizmi, rrangullina të shekujve. Po ju sjell një gjë pozitive e origjinale, që quhet magji; dhe me të do të ndërtoj një Parajsë të re mbi Tokë. Nuk kërkoj as pëlqimin tuaj të dobët, as përbuzjen tuaj të dobët; kërkoj pabesinë, vrasjen, përdhunimin, gjithçka që është e fortë, e mirë apo e mbrapshtë qoftë".

Krouli e braktisi mësuesin e vet të mëparshëm, MekGrigor Metjunë, një njeri i mbaruar pas luftës psikologjike të drejtuar kundër Kroulit. Që të dy thirrën në ndihmë ndërhyrjen e djajve në dëm të tjetrit, por ai që doli i mundur nga kjo ishte Metjui. Sot, luftëra psikologjike të këtij tipi janë një gjë e vazhdueshme brenda Vëllazërisë. Anëtarët e saj luftojnë ndërmjet tyre, por mbi të gjitha kundër popullsisë dhe njerëzve që kërcënojnë pushtetin e tyre. Unë vetë kam qenë objekt i këtyre sulmeve dhe, në këtë mënyrë, e di se si është e mundur të vrasësh një njeri. Komunikuesit e Kroulit u bënë zotër edhe të psiqikës së Adolf Hitlerit dhe të ideatorëve të tjerë të nazizmit. Shumë kohë pas vdekjes së tij, Krouli do të bëhej një hero për shumë "bij të luleve"

të viteve gjashtëdhjetë të 1900-ës, një lëvizje të rinjsh që i bënin thirrje dashurisë dhe paqes. Këtu ironia shkon dëm. Krouli e priti me krahët hapur Luftën e Parë Botërore, duke e konsideruar një ngjarje të nevojshme për të fshirë nga faqja e dheut epokën e vjetër dhe për të futur atë të renë. Pasi i kishte zbuluar publikisht mendimet e tij, Krouli u emërua kreu botëror i Urdhërit të Tempullit Lindor, që e kishte selinë në Gjermani dhe kjo i dha mundësinë të ushtronte një ndikim të jashtëzakonshëm mbi ata që, në Gjermani, ishin afër mendimit të tij.

Hjuston Stjuart Çamberleni (Kom 300) kishte lindur në Angli në vitin 1855, por u shpërngul në Gjermani në vitin 1882. Në vitin 1908 u martua me Evën, të bijën e Rikard Vagnerit dhe u bë një shkrimtar i shquar. Vepra e tij më e famshme ka qenë *Foundations Of The Nineteenth Century* (Bazat e shekullit të nëntëmbëdhjetë), një vëllim me 1.200 faqe, nga i cili u shitën më shumë se 250.000 kopje dhe që e bëri të famshëm në të gjithë vendin. Megjithatë ai vuante nga kriza të shpeshta nervore. Besonte se ishte pushtuar nga djajtë dhe librat e tij ishin shkruar në gjendje *transi* e gjatë krizave të etheve, gjë e cila të bën të mendosh se ka qenë i burgosur në një vetëdije me dridhje të ulët, zvarranike apo të ndonjë lloji tjetër, dhe se shkruante nëpërmjet shkrimit automatik. Në autobiografinë e tij ka deklaruar në fakt se nuk i njeh si të vetat pjesën më të madhe të shkrimeve të tij. Temat e veprave të tij janë shumë të zakonshme: të gjitha qytetërimet rrjedhin nga raca ariane dhe gjermanët janë më të pastrit se të gjithë; hebrejtë janë armiqtë që ndotin prejardhjen ariane. Kajzeri Vilhelm II dhe Adolf Hitleri e kanë quajtur Çamberlenin profet. Ai u bë këshilltari kryesor i Kajzerit Vilhelm dhe, në vitin 1914, e shtyu sovranin të hynte në luftë, për të realizuar profecinë e sundimit gjerman mbi botën. Kur lufta mbaroi, Vilhelmi, që kishte abdikuar, e kuptoi se kishte qenë manipuluar. Mblodhi një sasi librash mbi okultizmin dhe mbi sektet e fshehta gjermane dhe u bind për faktin se Lufta e Parë Botërore dhe mundja e Gjermanisë kishin qenë frut i një komploti. Çamberleni, që Kajzeri e kishte nderuar me Kryqin e Hekurt, vdiq në vitin 1927, pasi i kishte kaluar vitet e fundit të jetës së tij në një karrige me rrota, i shkatërruar në trup e në shpirt. Kjo u ndodh shpesh atyre që përdoren si përçuesa dhe kanale të kësaj dege fort negative dhe shkatërruese të vetëdijes zvarranike. Por ndikimi i tij mbi mendjen e Adolf Hitlerit do të rezultonte i qëndrueshëm. Çamberleni i ishte paraqitur rastësisht Hitlerit nga refugjati rus Alfred Rozenberg, një tjetër satanist. Ishte Rozenbergu ai që, pavarësisht prejardhjes së tij hebraike, i dorëzoi Hitlerit një kopje të *Protokolleve të njerëzve të ditur paraardhës të Sionit*, nëpërmjet një tjetër okultisti, Ditrih Ekartit[4]. *Protokollet* u përdorën nga Hitleri për të justifikuar fushatën e tij përndjekëse kundër hebrejve.

Këta qenë disa prej njerëzve dhe prej ideve që i dhanë trajtë mendimit të një njeriu, i cili deklaronte se ishte një i ri austriak me emrin Shiklgruber, por që më pas u njoh më mirë me emrin e Adolf Hitlerit. "Heil Shiklgruber", në fakt, nuk do të kishte tingëlluar vërtet në të njëjtën mënyrë. Sipas asaj që pohon historia zyrtare, ai e urrente shkollën dhe ëndërronte të bëhej një artist, një ambicie kjo e fundit që e shtyu gjer në Vjenë. Kaloi orë të tëra në bibliotekë për të lexuar libra mbi astrologjinë, mbi mistiçizmin dhe mbi besimet lindore. Mbeti i magjepsur prej librave të Blavatskit, të Çamberlenit, të Listit e të Liebenfelsit dhe shkëputi pjesë prej tyre që i bashkangjiti në një farë përzierje ideale, në një koktejl tmerresh dhe urrejtjeje, që do të konkretizoheshin pastaj tek nazizmi. E rrëmbente shumë pushteti i vullnetit. Fuqia e forcës së vullnetit për të realizuar ca dëshira të vetat do të bëhej ideja e tij fikse dhe udhërrëfyesja e tij në të gjithë vitet që do të pasonin. Një koncept i tillë mund të shprehet edhe me formulën "të krijosh realitetin tënd". Ai praktikoi artet ekzoterike në përpjekjen për të hyrë në nivelin e dijeve, që ishte i bindur se do ta kishin shndërruar në njërin prej atyre mbinjerëzve, për të cilët kishte lexuar aq shumë dhe tek të cilët besonte vendosmërisht. Psiqika e tij u burgos më shumë se kurrë brenda dridhjes zvarranike. U pushtua, sipas gjasës gjatë ndonjë rituali të magjisë së zezë, ku ua hapi psiqikën e tij zvarranikëve. Mjafton të marrësh për një çast në shqyrtim idetë e tij, për të kuptuar se ai shprehte një "përputhshmëri dridhëse" me këtë vetëdije. Pikërisht atëherë ndodhi që, një njeri i paaftë dhe pa karizëm, filloi të përhapte karizmën dhe magnetizmin e tij, të cilat do të helmonin një komb të tërë.

Disa njerëzve u atribuojmë dhunti magnetizmi e një "personalitet magnetik", dhe kjo është saktësisht ajo me të cilën janë të pajisur. Ne të gjithë prodhojmë energji magnetike. Disa njerëz përçojnë një magnetizëm të fortë, të tjerë më pak. Energjitë negative janë po aq magnetike, sa edhe ato pozitivet. Ato që janë të lidhura me dridhjen jashtëzakonisht negative, që kontribuojnë për ta krijuar, do të jenë shumë magnetike. Shpesh njerëzit jashtëzakonisht negativë përshkruhen sikur të kishin ndonjë personalitet magnetik, apo sikur të ushtronin ndonjë "tërheqje fatale". Dhe arsyeja është pikërisht kjo. Dhe pikërisht kjo është edhe në origjinën e magnetizmit e të karizmës së papritur të Adolf Hitlerit. Teksa qëndronte mbi një tribunë përpara publikut, me fytyrën të shtrembëruar dhe i pushtuar nga një ligjërim i çmendur, Hitleri transmetonte vetëdijen zvarranike, duke ia përcjellë dridhjen e saj një deti të pafund njerëzish. Kjo ndikonte në gjendjen dridhëse të njerëzve që ishin tërhequr prej saj, duke i shndërruar në përfaqësues po aq të çmendur të urrejtjes. Është fjala për "parimin e Fyelltarit Magjik", që

përdor një dridhje, në vend të një fyelli. Ja çfarë ka thënë një shkrimtar në lidhje me Hitlerin:

"Fuqia e tij për të magjepsur publikun është krahasuar me artet okulte të magjistarit afrikan dhe të shamanit aziatik; të tjerë i kanë krahasuar aftësitë e tij me aftësitë e një mediumi dhe me magnetizmin e një hipnotizuesi"[5].

Dhe ja çfarë ka deklaruar në librin e tij *Hitler Speaks*, Herman Raushningu, një ndihmës i Hitlerit:

"Nuk mund të rrish dot pa menduar për të si për një medium. Për pjesën më të madhe të kohës mediumët janë njerëz të zakonshëm dhe të parëndësishëm. Pastaj, papritmas, pajisen me ato që duket se janë fuqi të mbinatyrshme, të cilat i ngrejnë mbi pjesën tjetër të njerëzimit. Mediumi në atë çast është zotëruar. Sapo kriza të ketë kaluar, bie në mediokritet. Ka ndodhur me siguri në këtë mënyrë kur Hitleri u zotërua nga forca jashtë vetvetes – forca thuajse djallëzore, gjë për të cilën individi me emrin Hitler bënte vetëm punën e përçuesit të përkohshëm. Bashkimi i të rëndomtës me të mbinatyrshmen krijoi atë dualitet të padurueshëm, që perceptohej qartë në praninë e tij... Ishte si të vështroje një fytyrë të çuditshme, shprehja e së cilës duket se reflekton një gjendje mendore të çekuilibruar, të shoqëruar nga një përshtypje shqetësuese pushteti okult"[6].

Hitleri dukej sikur jetonte në një frikë të vazhdueshme prej "mbinjerëzve". Raushningu ka treguar se si Hitleri vuante prej anktheve të tmerrshme dhe se zgjohej i pushtuar nga paniku, duke klithur kundër qeniesh që askush, përveç tij, nuk arrinte t'i shikonte. Një herë i tha ndihmësit të vet:

"Si do të jetë rendi shoqëror i së ardhmes? Miku im, ta them unë. Do të ketë një klasë zotërinjsh shumë të lartë, poshtë tyre tërësia e anëtarëve të partisë në radhë hierarkike dhe, pastaj, masa e madhe e ithtarëve anonimë, shërbëtorë e punëtorë të përjetshëm dhe, akoma më poshtë tyre, të gjitha racat e huaja të pushtuara, skllevërit modernë. Dhe përmbi të gjithë këta do të mbretërojë një fisnikëri e re e fanatike, mbi të cilën nuk mund të shprehem... Por, për të gjitha këto plane, anëtarët militantë nuk do të dinë asgjë... Njeriu i ri jeton tani në mes nesh! Është këtu. Nuk të mjafton kjo? Do të të besoj një sekret. E kam parë njeriun e ri. Ai është sypatrembur dhe i pamëshirshëm. Pata frikë prej tij"[7].

Ky është projekti i shoqërisë që do të realizohet nga zvarranikët dhe nga raca superiore e ariano-zvarranikëve, nëse në vitet e ardhshme do t'i lejojmë

Rendit të Ri të Botës të fitojë. "Krerët e fshehtë" të Hitlerit janë zvarranikët dhe vini re merakun e madh që ata ushqejnë kundrejt hierarkisë dhe ritualit, tipare tipike këto të kompleksit Z, apo të trurit zvarranik. Me t'u shpërngulur në Gjermani, Hitleri kaloi një periudhë të gjatë në Bavari, trualli ku kishin patur zanafillën Mendjendriturit e Veishauptit dhe u kthye aty mandej në vitin 1918, pasi kishte kryer luftën. Ose të paktën kështu reciton historia zyrtare. Vitin pasardhës hasi në një parti politike shumë të vogël e mjaft patetike, e quajtur Partia e Punëtorëve Gjermanë. Ishte fjala për degën e një sekti ekzoterik të fshehtë të quajtur Urdhëri Gjerman, tmerrësisht nacionalist dhe antisemit. Nga ky urdhër zunë fill shoqëri të ngjashme, përfshirë të urryerën *Thule Gesellschaft* (Shoqëria e Tulës) dhe Lozha e Ndritur e Shoqërisë Vril. Hitleri bënte pjesë në të dyja. *Vril*-i ishte emri që shkrimtari anglez Lordi Baluer-Liton i dha asaj fuqie të gjakut që, sipas tij, rizgjon tek njerëzit pushtetin dhe fuqinë e tyre të vërtetë prej mbinjerëzish. Çfarë është atëherë kjo forcë *Vril*? Hindutë e quanin "forca e gjarpërit", duke iu referuar strukturës gjenetike të trupit, që lejon "ndryshime forme" dhe zhvendosje ndërpërmasore të vetëdijshme. Forca *Vril* është një tjetër karakteristikë e racave njerëzoro-zvarranike. Në vitin 1933, eksperti i racave Vili Leji, u arratis nga Gjermania dhe zbuloi ekzistencën e Shoqërisë Vril e të besimit, që nazistët kishin në vetvete si mbinjerëzit e ardhshëm krejt të ngjashëm me ata që banojnë në angrrat e Tokës, falë përdorimit të doktrinave ekzoterike dhe ekspansionit të mendjes. Besonin se kjo do të kishte rizgjuar forcën *Vril*, që ishte e fshehur në gjak. Midis anëtarëve të sektit *Vril Society* figuronin dy njerëz, që do të ishin bërë pastaj nazistë të famshëm: Heinrik Himleri dhe Herman Geringu. Anëtarët e *Vril*-it ishin të bindur se ishin në lidhje me lozhat ekzoterike misterioze të Tibetit dhe me njërin prej të ashtuquajturve "mbinjerëz të panjohur", i mbiquajtur Mbret i Frikës. Rudolf Hesi[8], zëvendësfyhrer i Hitlerit që vdiq në një aksident fatkeq në Angli në vitin 1941, ishte një okultist aktiv dhe një anëtar, së bashku me Herman Geringun, i Shoqërisë Edelveis, një sekt që besonte në racën padrone nordike. Hesi e nderonte Hitlerin si "shpëtimtarin", edhe pse nuk kuptohet se si e bënte, duke qenë se Fyhreri nuk i kishte as sytë të kaltër, as flokët të verdhë. Sipas gjasës, vetë Hitleri pati njëfarë problemi ta pranonte këtë fakt, por do të ketë gjetur ndonjë shpjegim qesharak, jam i sigurtë. Boshti i shoqërisë ishte Urdhëri i Zi, akoma edhe sot ekzistues, që mendohet se është rrethi më i brendshëm i CIA-s[9].

Studiuesi gjerman Jan van Helsingu ka shkruar në librin e tij *Secret Societes Of The 20th Century*[10] se Shoqëria Vril dhe Shoqëria e Tulës, në dhjetor të vitit 1919, besuan se kishin vendosur një lidhje me jashtëtokësorët nëpërmjet dy

mediumeve të njohura si Maria Orsik dhe Sigrun të lozhës pranë Berkshtesgadenit. Sipas dokumenteve të Shoqërisë Vril, shton ai, këto transmetime përçoheshin nga një sistem diellor i quajtur Aldebaran, 68 vite drite larg në yllësinë e Demit, ku dy planete të banuara formonin Perandorinë "sumere". Popullsia e Aldebaranit ndahet në një racë më të lartë arianësh me flokët të verdhë e me sytë të kaltër, të njohur si "Populli hyjnor i Dritës" dhe në mjaft raca të tjera humanoidësh, që kanë pësuar një regres gjenetik për shkak të ndryshimeve klimaterike, sipas asaj që është bërë e ditur prej transmetimeve[11]. Më shumë se 500 milionë vjet më parë dielli Aldebaran filloi të bymehej, duke e rritur kështu në mënyrë të konsiderueshme temperaturën. Racat më të "ulëta" u evakuan dhe u internuan në planete të tjera të banueshme. Pastaj Populli arian i Dritës filloi të kolonizonte planete të ngjashme me Tokën, pasi planetet e tyre ishin bërë të pabanueshme. Në sistemin tonë diellor thuhej se më parë kishin pushtuar planetin Malona, i njohur edhe si Marduk, Mardek dhe, për rusët e romakët, Fetonte, që mendonin se ndodhej midis Marsit dhe Jupiterit, në brezin aktual të asteroidëve. Ky përkon me shkrimet sumere mbi planetin Tiamat. Shoqëria Vril besonte se, më pas, popullsia e Aldebaranit me flokë të verdhë e me sy të kaltër kishte kolonizuar Marsin, para se të zbarkonte në Tokë dhe t'i jepte udhë qytetërimit sumer. Transmetuesat *Vril* thanë se gjuha sumere ishte e njëjtë me atë të aldebaranëve dhe i ngjante një "gjermanishteje të pakuptueshme". Frekuenca linguistike e sumerishtes së Aldebaranit dhe e gjermanishtes ishte gati e njëjtë, shtuan[12] ata. Hollësitë mund të ndryshojnë nga versioni në version, por gjendemi përherë përballë së njëjtës temë. Një racë superiore jashtëtokësorësh me flokë të verdhë e me sy të kaltër zbarkon në Tokë nga Marsi dhe shndërrohet në hyjnitë e legjendës së lashtë. Ata bëhen frymëzuesit e kulturës së përparuar sumere dhe prodhojnë rrymën gjenetike më të pastër të planetit. Qysh atëherë vetë këto perëndi kontrollojnë planetin që nga qytetet e tyre të nëndheshme. Ajo që mendoj se është lënë mënjanë, megjithatë, është fakti se brenda racës ariane janë familjet arianozvarranike. Di nga burime të depërtuara brenda Vëllazërisë se zvarranikët, për ndonjëfarë arsyeje, kanë nevojë për gjakun e njerëzve me flokë të verdhë e me sy të kaltër dhe ideja fikse naziste për Racën Superiore kishte qëllimin për të ruajtur pastërtinë e kësaj race dhe për të shkurajuar përpjekjet për kryqëzime me raca e fise të tjera.

Shoqëria e Tulës e mori emrin nga Ultima Tula, që është identifikuar me qytetin mitik të Hiperboreas, kontinenti i parë i kolonizuar nga raca jashtëtokësore ariane e ardhur prej Aldebaranit. Sipas disave, e gjitha kjo do

LIBRI

t'i përkiste një periudhe shumë më përpara Atlantidës dhe Lemurias, ndërsa sipas të tjerëve, Hiperborea ishte Atlantida, ose ndodhej madje në angrrat e Tokës. Legjendat skandinave e përshkruajnë Ultima Tulën si një tokë të mrekullueshme të kufirit verior, ku dielli nuk perëndon kurrë dhe ku banojnë paraardhësit e Arianëve. Kur Hiperborea filloi të fundosej, vazhdojnë legjendat, arianët jashtëtokësorë përdorën teknologjinë e tyre fort të përparuar për të gërmuar tunele gjigante në koren e tokës dhe u vendosën nën malet Himalaje. Sipas mbështetësve të tezës së ekzistencës së Tulës, kjo mbretëri u bë e famshme me emrin Agarta dhe kryeqyteti i saj ishte Shamballahu. Persianët e quanin këtë zonë Aryana, toka e arianëve. Sipas sistemit të besimeve naziste, popullsia e Agartës ishte e mirë, ndërsa ajo e Shamballahut ishte e keqe. Të dy popujt ishin në konflikt prej mijëra vjetësh dhe nazistët besonin se mbështesnin të "mirët" e Agartës kundër "masonëve dhe sionistëve" të Shamballahut. Mund të ketë qenë fjala për konfliktin mijëravjeçar midis marsianëve arianë dhe zvarranikëve anunakë, edhe sot e kësaj dite në zhvillim? Së pari duket se kanë luftuar në Mars, pastaj në Hënë dhe tani në Tokë. Hitlerin e turturonte si në ankth ideja që të gjente një rrugë hyrjeje në këtë botë të nëndheshme, e cila do t'i kishte dhënë mundësinë të takonte racën superiore ariane, por e vërteta është se ai ishte një kukull zvarranike i kontrolluar nga "engjëlli i vdekjes", Jozef Mengele. Ka shumë mundësi, siç e kam përmendur më përpara, që zvarranikët të jenë në konflikt me të tjera raca jashtëtokësore apo brenda-tokësore, për kontrollin e planetit dhe do të ketë me siguri shumë fraksione në luftë midis tyre në atë pus të errët të vetëdijes, siç është niveli më i ulët i përmasës së katërt. Midis themeluesve të Shoqërisë së Tulës figuronte astrologu Rudolf Glauer, që mori emrin kumbues të baronit fon Sebotendorf. Ideja e përkëdhelur prej tij për një revolucion kundër hebrejve dhe marksistëve e shndërroi Shoqërinë e Tulës në një strofull antisemite e antimarksiste dhe të mbështetësve të epërsisë së racës ariane. Nga e gjithë kjo rrodhi Partia e Punëtorëve Gjermanë, që një ditë do të bëhej Partia Naziste. Një tjetër okultist i angazhuar, përveçse mik i Sebotendorfit, fiton në këtë kohë gjithmonë e më shumë peshë. Është fjala për Ditrih Ekartin, një shkrimtar i alkolizuar dhe përdorues droge, i cili besonte se detyra e tij ishte që t'i hapte rrugën një diktatori gjerman. Ai e njohu Hitlerin në vitin 1919 dhe e ridau mendjen se ishte pikërisht ai "shpëtimtari", që ishte duke kërkuar. Është pikërisht Ekarti ai të cilit i atribuohet autorësia e doktrinave të vona ekzoterike, si edhe i ritualeve të magjisë së zezë, që e bllokuan plotësisht brenda dridhjeve zvarranike. Që këtej e më pas, aftësia e Hitlerit në të

tërhequrit e pëlqimeve rritet në mënyrë marramendëse. Në vitin 1923, Ekarti i shkruante një miku:

"Ndiq Hitlerin! Ai do të vallëzojë, por jam unë që e zgjedh muzikën. Ne i kemi dhënë mjetet e komunikimit së bashku me Ata. Mos të të vijë keq për mua: unë do ta ndikoj historinë më shumë se kushdo gjerman tjetër"[13].

Një tjetër ide fikse torturuese e Hitlerit ka qenë e ashtyquajtura Heshtë e Fatit, arma që thuhet se u përdor për të shpuar tejpërtej kraharorin e "Jezusit" gjatë kryqëzimit. Në vitin 1938, kur nazistët pushtuan Austrinë, ai grabiti atë që mendohej se ishte heshta origjinale dhe ajo u çua në Nuremberg. Sipas legjendës, cilido që vihet në zotërim të asaj heshte dhe deshifron sekretet e saj do të ketë kontrollin mbi botën, në të mirë e në të keq. Heshta e grabitur prej Hitlerit gjendet tani në Muzeun Hofburg të Vjenës, ku në vitin 1992 shpërtheu një zjarr i madh, shtatë ditë përpara se flakët të shkatërronin një pjesë të Pallatit të Uindsorëve. Një tjetër okultist aktiv dhe ekspert i ekzoterizmit ishte Hajnrih Himleri. Ai i përdori këto dije të tij mënyrën më tw errët. Ishte veçanërisht i interesuar për gurët e runave (*gërmat e shkrimit nordik*). Ishte Himleri ai që krijoi SS-të e njohura botërisht dhe, ashtu si në rastin e kryqit të thyer, zgjodhi një simbol ekzoterik për organizatën e tij të tmerrshme: S-në e dyfishtë, ose runën "sig", që ka pamjen e dy shigjetash rrufeje. SS-të ishin praktikisht një korpus më vete dhe përfaqësonin përmbledhjen e të gjitha doktrinave ekzoterike të përqafuara nga nazistët. Vetëm kush konsiderohej i pastër nga pikëpamja gjenetike mund të hynte e të bënte pjesë në atë korpus dhe studimi i arteve ekzoterike, përfshirë gurët e runave, përbënte një pjesë themelore të stërvitjes së tij. SS-të drejtoheshin dhe komandoheshin si një sekt i fshehtë i magjisë së zezë. Ritualet e tyre rridhnin nga organizata të tjera si Urdhëri i Jezuitëve dhe Urdhëri i Kalorësve Tempullarë. Anëtarët e rangjeve më të larta ishin trembëdhjetë anëtarë të Këshillit të Madh të Kalorësve (i kryesuar nga Mjeshtri i Madh i tyre, Hajnrih Himleri), dhe ritualet e zeza kryheshin në kështjellën e lashtë të Vevelsbergut, në Vestfali. Ata kremtonin festat nordike pagane dhe ato të solsticit të verës. Nderonin Satananë, Luçiferin, Setin, apo si të dëshironi ta quani. Bënte pjesë tek SS-të edhe princi Bernhard, njëri prej themeluesve të frontit të Vëllazërisë siç ishte Grupi Bilderberg, përveçse mik i ngushtë i princit Filip të Anglisë. Magjia e zezë dhe doktrinat ekzoterike depërtuan tek Hitleri dhe tek nazistët deri në atë pikë sa ata përdornin lavjerësa e harta për të gjetur pozicionin e saktë të trupave armike. Kryqi i thyer, simboli origjinal i Diellit, ishte i kthyer

LIBRI 24

në të djathtë, gjë e cila, në terma ekzoterikë, aludon ndaj forcave pozitive të dritës e të krijimit. Nazistët deshën ta kthenin në të majtë, për të simbolizuar magjinë e zezë dhe shkatërrimin, sipas procesit të përmbysjes tipike për satanizmin. Ylli me pesë cepa i përmbysur është një tjetër shembull emblematik. Mitingjet para masës, që Hitleri dinte t`i përdorte me aq shumë zotësi, organizoheshin në bazë të njohjes së psiqikës njerëzore dhe se si ajo mund të manipulohej. Në librin e tij *Satan And Swastika* (Satanaja dhe kryqi i thyer), Frensis Kingu pohon:

"Paraqitjet në publik të Hitlerit, sidomos ato në kuadrin e mitingjeve të Nurembergut të Partisë Naziste, ishin shembuj të shkëlqyer të këtij tipi të ceremonisë magjike. Fanfarat, marrshimet ushtarake dhe muzika e Vagnerit e bënin solemne krejt idenë e lavdisë ushtarake gjermane. Grumbujt e flamujve me kryqet e thyera në ngjyrë të zezë, të bardhë e të kuqe kënaqnin shpirtin e pjesëmarrësve në mitingjet nacionalsocialiste. Saktësia gati prej vallëzimi e lëvizjeve të anëtarëve të partisë me uniformë, që vepronin të gjithë njëzëri, ringjallte tek nënvetëdija parimet e luftës dhe të dhunës, të simbolizuara në lashtësi nga Marsi. Dhe rituali kryesor i mitingjeve – Hitleri që u shtonte flamujve të tjerë "flamurin me gjak", që e kishte valëvitur gjatë grushtit të shtetit të Mynihut në vitin 1923 – ishte një ceremoni gati magjike, që kishte për qëllim të bashkonte mendjet e nazistëve të gjallë me imazhet tipike të simbolizuara nga heronjtë nacionalsocialistë të vdekur në të kaluarën. Aspektet fetaro-magjike të mitingjeve u bënë solemne nga fakti se kulmi i manifestimit arrihej pas rënies së muzgut, në një "Katedrale Drite", një ambient i hapur, i rrethuar nga fasha drite, që vinin nga reflektorët elektrikë të projektuar drejt qiellit. Nëse ndonjë magjistar bashkëkohor jashtëzakonisht ekspert do të përgatiste ndonjë ritual me qëllimin për të "thirrur Marsin", nuk do të kishte mundur të shpikte asgjë më të efektshme se sa ceremonitë që u zhvilluan në Nyremberg".

Dhe ajo që përdorej asokohe, përdoret edhe sot. Doktrina ekzoterike e shfrytëzuar nga nazistët për ta çuar popullin gjerman në një gjendje hipnoze në masë, përdoret sot për të hipnotizuar racën njerëzore në nivel global. Simbole, fjalë, ngjyra, tinguj e teknika, për të cilat publiku nuk është aspak i vetëdijshëm, përdoren nga mediat dhe nga reklamat me qëllimin për të na hipnotizuar. Ministria e Propagandës e Jozef Gëbelsit bazohej mbi njohjen ekzoterike të psiqikës njerëzore. Ai e dinte se njerëzit i besojnë çdo gjëje që u përsëritet mjaft shpesh dhe se është themelore të arkitektosh ngjarje të atilla, për të krijuar në mendjen kolektive mendësinë e tipit "duhet bërë diçka". Përdori atëherë ngjyra, simbole e sloganë me sukses të madh. Sloganet

përdoreshin si formula *mantra* dhe përsëriteshin vazhdimisht, duke fituar kështu hipnotizimin e masave. Të gjitha opinionet dhe informacionet alternative çensuroheshin dhe njerëzit ishin programuar të përgjigjeshin në mënyrën e dëshiruar. Cili është ndryshimi midis gjithë kësaj dhe avazit të vazhdueshëm gjer në mërzi të informacioneve pak të sakta e të shtrembëruara, që sot na jepen që t`i gëlltisim ne e fëmijët tanë? Nuk është i shënuar nga ndonjë kryq i thyer, por bëhet prapë se prapë gjithmonë fjalë për hipnotizim mase. Do të duket si një kontradiktë fakti që Hitleri u përpoq të shkatërronte shoqëri të fshehta si Masonerinë dhe të ndalonte përhapjen e doktrinave ekzoterike brenda shoqërisë gjermane, por nuk është. E dinte, sikurse të gjithë e dinë, se kush ishte në gjendje t`i shfrytëzonte këto nocione, kishte në duar një pushtet të madh dhe donte ta mbante të gjithë për vete. Në vitin 1934, të gjitha format e kiromancisë (*leximi i dorës, hedhja e fallit*) u ndaluan në Berlin dhe, më pas, u ndaluan librat ekzoterikë në të gjithë Gjermaninë. Shoqëritë e fshehta u shkrinë dhe deri madje Shoqëria e Tulës dhe Urdhëri Gjerman (që së bashku i kishin dhënë jetë nazizmit) u vunë në shenjestër. Astrologët sulmoheshin e vriteshin dhe disave, si Lanc fon Liebenfelsit, iu ndalua t`i publikonin veprat e tyre. Ky spastrim kishte dy arsye kryesore: t'i ndante në mendjet e gjermanëve e të popujve të tjerë Hitlerin dhe nazistët nga okultizmi dhe, gjëja më e rëndësishme, t`i ndalonte kujtdo tjetër t`i përdorte ato dije ekzoterike kundër tyre, ashtu sikurse ata i përdornin kundër të tjerëve. Kjo teknikë reflekton në mënyrë të përkryer atë të përdorur nga ariano-zvarranikët në harkun e historisë së njohur, ose përdorimin e ekzoterizmit për të kontrolluar e për të fshehur dhe, në të njëjtën kohë, për të krijuar diktatura fetare, që ua ndalojnë vetë atyre doktrinave ekzoterike të qarkullojnë lirisht. Në realitet, nazistët qenë krijuar dhe kontrolluar në çdo nivel nga shoqëritë e fshehta klandestine dhe, si përfundim, nga zvarranikët. Ata besonin se hyjnitë sumere i përkisnin racës superiore jashtëtokësore; besonin në ekzistencën e Atlantidës; dhe organizuan ekspedita në Afrikën e Veriut, në Rëne-lë-Shato e në Montsegur, në mbretërinë e Katarëve, përveçse në Tibet, domethënë në të gjitha ato vende ku mendonin se kishin seli shoqëri të nëndheshme mbinjerëzish. Ekziston një rrymë pozitive e mendimit budist dhe një tjetër jashtëzakonisht negative. Nazistët kënaqeshin me këtë të fundit dhe, kur rusët arritën në Berlin në fund të luftës, gjetën të vdekur shumë murgj budistë, të cilët kishin bashkëpunuar me nazistët.

Teoria e Tokës së zgavërt

Nazistët besonin edhe se Toka ishte e zgavërt e se përmbante hyrje në

drejtim të poleve dhe, sipas disa hulumtuesve, afër fundit të luftës ata krijuan një bazë nëntokësore në Antarktidë, edhe sot e kësaj dite në veprim. Mbi bazën e provave që kam parë, nuk kam asnjë dyshim mbi faktin se Toka është e zgavërt ose, të paktën, që ekzistojnë zona të gjera në brendësi të saj, ku jetojnë qytetërime jashtëzakonisht të zhvilluara. Besoj edhe se ekzistojnë shoqëri të lashta, të cilat jetojnë midis sipërfaqes tokësore dhe brendësisë së "zgavërt". Është fjala për tre popuj, që jetojnë në po aq nivele, sipër dhe në brendësi të vetë planetit. Shkrimtari Zhyl Vern ishte një anëtar i lartë i rrjetit të shoqërive të fshehta, që sillen rreth Shoqërisë Teozofike, Urdhërit të Agimit të Artë dhe Urdhërit të Tempullarëve Lindorë. Për këtë arsye, dinte shumë më tepër gjëra nga sa i është dhënë publikut të dijë. Historitë e tij fantastiko-shkencore bazoheshin mbi fakte reale. Ai shkruajti për dy hënat e Marsit para se ato të identifikoheshin (zyrtarisht) në vitin 1877. Epika e Zhyl Vernit, e titulluar *Udhëtim në qendrën e Tokës*, nuk ishte tërësisht frut i fantazisë së tij. Autori e dinte se bazat e saj ishin reale. Ata që mbështesin tezën, sipas së cilës Toka është e zgavërt, pohojnë se uji rrjedh nga njëra hyrje, që është në drejtim të njërit pol, deri tek ajo e polit të kundërt dhe se në qendër të planetit ekziston një det i gjerë dhe një "diell qendror" i brendshëm, që furnizon nxehtësi e dritë. Në versionin kinematografik të Zhyl Vernit, që e kam parë përsëri kohët e fundit, skena paraqitet në të njëjtën mënyrë. Është interesante se pengesa më e madhe, që eksploratorët e Zhyl Vernit duhet të kapërcejnë, përbëhet nga zvarranikë të përbindshëm, njëri prej të cilëve gjendet në qytetin e fundosur të Atlantidës. Ka nga ata që mendojnë, mbi bazën e provave të panumërta, se dinosaurët ka të ngjarë t'i kenë shpëtuar përmbytjes së 65 milionë viteve më parë, duke jetuar në angrrat e Tokës, sidomos në rajonin e Polit të Jugut. Tom Riçi, paleontolog i muzeut të Viktorias, në Australi, e ka çuar përpara këtë hipotezë pasi kishte zbuluar, në vitin 1987, mbetje fosilesh të një dinosauri në një tunel të nëndheshëm në kufirin jugor të shtetit të Viktorias, në një vend të njohur si Strofulla e Dinosaurëve[14]. Zhyl Verni, duke qenë një anëtar i lartë i shoqërive të fshehta, ishte me siguri në dijeni të këtyre prapaskenave dhe shumë gjëra të vërteta shprehen përmes simbolesh nëpër historitë "fantastike" e nëpër filma. Filmat e Stiven Spielbergut janë një shembull i qartë për këtë, sidomos seria e Indiana Xhonsit dhe, sipas mendimit tim, *Jurassic Park*-u, ku ADN-ja manipulohet për të krijuar dinosaura zvarranikë. Unë mendoj se ADN-ja njerëzore ka qenë manipuluar, për të krijuar njerëzit zvarranikë.

Ekzistojnë sigurisht prova të ndryshme të ekzistencës së qytetërimeve që jetojnë në angrrat e Tokës, si edhe të faktit që Toka është e Zgavërt. Pohime në këtë kuptim na arrijnë nga legjendat dhe nga traditat e lashta. Qeniet

njerëzore janë bërë deri në atë pikë kukulla në duart e të fuqishmëve, sa që, po t'u thuash se Toka është e zgavërt brenda saj, ka rrezik të dukesh qesharak. Tek e fundit, a nuk është kjo në kundërshtim me atë që thonë shkencëtarët e shquar? Po, ashtu sikurse ishte në kundërshtim hipoteza se Toka ishte e rrumbullakët dhe jo e rrafshtë. Po të studiohet kjo materie, vihet re që shkencëtarët japin me të vërtetë shumë pak prova të atyre që i quajnë "fakte" të pakundërshtueshme. Ata kanë depërtuar vetëm pak milje në brendësi të Tokës dhe teoritë e tyre mbi atë që ekziston në nivelet më të thella nuk janë gjë tjetër veçse kjo: teori. Nëse u bëjmë ndonjë pyetje përfaqësuesve zyrtarë të shkencës, do t'i dëgjojmë të japin si përgjigje gjëra të palidhura dhe pa kuptim, si ajo sipas së cilës vetë rrotullimi i planetit krijon një forcë centrifuge, që e shtyn materien jashtë, në mënyrë të ngjashme me centrifugën e një lavatriçeje, në të cilën rrobat rrotullohen përreth një vrime qendrore. Kur planeti ishte ende në gjendje të shkrirë dhe po formohej duke u rrotulluar para se të ftohej, si mund të arrinte të mbetej i ngjeshur në qendër? Bëhet fjalë prapë edhe një herë për një pohim që shkon kundër logjikës dhe ligjeve të fizikës dhe, po të vështroni ***Figurën 23***, do të shihni nga vizatimi i Kometës së Donatit të vitit 1853 se materia shtyhet jashtë, me qëllim që të rrotullohet rreth bërthamës së ndriçuar, apo "diellit".




Figura 23. Një vizatim i Kometës së Donatit të vitit 1853, e cila tregon se si masa që shpërbëhet shtyhet jashtë nga forca centrifugale dhe shkon të sillet rrotull një burimi qendror energjie. Ky proces e lë brendësinë të zgavërt, pikërisht ashtu si centrifuga e lavatriçes. Me siguri kjo do të ketë ndodhur edhe në çastin kur Toka u formua.

Toka është pak a shumë e njëjta gjë. Mbështetësit e teorisë së Tokës së zgavërt kanë sugjeruar se korja e jashtme tokësore është e trashë rreth 800 milje dhe se përtej asaj planeti është i zgavërt. Ka një popull që jeton në anën e kundërt të Tokës në krahasim me atë në të cilën jetojmë ne. Nëse besoni që kjo është e pamundur, atëherë pyeteni veten se përse australianët nuk bien nga Toka, edhe pse janë në anën e kundërt të sipërfaqes tokësore në krahasim me ata që jetojnë në hemisferën veriore. Përgjigjja është se mbahen mbi Tokë nga forca e gravitetit. E njëjta gjë ndodh me ata që jetojnë në brendësi të Tokës. Forca e gravitetit e mban bashkë materien dhe kështu banorët e të dy anëve të masës tokësore të planetit, brenda e jashtë, do të mbahen të ankoruar në sipërfaqen tokësore nga graviteti dhe nuk "do të bien" kurrë poshtë. Qendra e gravitetit tokësor nuk përkon me bërthamën e planetit, por gjendet në një thellësi prej rreth 400 miljesh në krahasim me masën tokësore të jashtme dhe kështu graviteti vepron njësoj në të dy anët. (shiko ***Figurën 24***).



Figura 24. Brendësia e Tokës, sipas tezës së disa kërkuesve. E zgavërt në qendër, me një diell qendror të brendshëm dhe uji që rrjedh ndërmjet dy hyrjeve në pole. Graviteti do të vepronte në të njëjtën mënyrë në të dy anët e kores tokësore, pasi graviteti tërheq drejt masës.

Hyrjet e supozuara në pole duken krejt të pranueshme, pasi intensiteti i forcës centrifuge gjatë periudhës së formimit do të ketë qenë mjaft i ulët në afërsi të atyre zonave. Sipas mbështetësve të kësaj teorie, në rreth 70-75 gradë gjerësi në veri e në jug, Toka fillon të përkulet, dora-dorës që u afrohet hyrjeve

polare, të cilat komunikojnë drejtpërdrejt me brendësinë e Tokës. Bëhet fjalë për një kalim aq gradual sa që njerëzit, të cilët deklarojnë se kanë pasur një përvojë të drejtpërdrejtë, nuk e kanë vënë re aspak se po hynin në brendësi të Tokës, gjersa kanë filluar të shohin toka, të cilat nuk paraqiteshin në asnjë hartë. Llogaritet që këto të çara (hyrje) të kenë një gjerësi prej 1.400 miljesh dhe se përreth tyre ka një rreth magnetik. Hyrjet janë të zhytura në mjegull për pjesën më të madhe të kohës dhe ligji e ndalon të përshkosh hapësirën ajrore sipër tyre. Kur eksploruesit, të drejtuar për në polin e Jugut dhe për në polin e Veriut, e arrijnë këtë rreth magnetik, gjilpëra e busullave të tyre drejtohet poshtë dhe ata mendojnë se gjenden në pole. Në realitet nuk është kështu. Gjenden në brendësi të rrethit magnetik, që qarkon polet. Mendohet se drita dhe nxehtësia në brendësi të Tokës vijnë nga një "diell" i brendshëm. Marshalli B. Gardner, njëri prej mbështetësve më të njohur të tezës së Tokës së zgavërt, besonte se ky "diell" ishte formuar nga bërthama qendrore e zjarrtë, përreth së cilës në fillim rrotullohej Toka në formim, diçka që të kujton nga afër ilustrimin e Kometës Donati. Nëse Toka është e zgavërt, atëherë edhe planetët e tjerë, që janë formuar në të njëjtën mënyrë dhe që u janë nënshtruat të njëjtave ligje, do të jenë të zgavërt. Sa qytetërime jetojnë në brendësi të këtyre planetëve, ndërsa qeniet njerëzore vazhdojnë ta kërkojnë jetën vetëm në sipërfaqe?

Ja ndonjë pyetje tjetër për ata që mbrojnë idenë se Toka është e plotë edhe në brendësi: përse *aisbergët* janë formuar prej uji të ëmbël, kur i vetmi ujë që gjendet në pole, sipas teorisë zyrtare, është uji i detit? Prej nga vjen e gjithë ajo bimësi, që gjendet në brendësi të *aisbergëve*? Përse eksploruesit, që kanë guxuar të shkojnë përtej poleve magnetike, kanë zbuluar që klima bëhet më e butë dhe se detet janë pa akuj? Përse disa kafshë e zogj të rajonit polar verior, si kau ripërtypës me veshë të vegjël e qime shumë të gjatë të dredhur, në dimër emigrojnë drejt Veriut? Shkenca zyrtare nuk mund t'u përgjigjet këtyre pyetjeve, në dallim prej teorisë së Tokës së zgavërt. Ekzistojnë lumenj me ujë të ëmbël, që rrjedhin nga brendësia e Tokës dhe ky ujë i ngrohtë, që mbart bimësi e polen, ngrin, duke krijuar kështu *aisbergët* me ujë të ëmbël në një zonë të përbërë në dukje vetëm nga ujë i kripur. Ka libra që paraqesin prova të hollësishme mbi brendësinë e Tokës, duke dhënë hollësi shumë më të shumta se këto që unë kam këtu hapësirën t'ua parashtroj dhe, midis të gjithëve, ju këshilloj *The Hollow Earth* të doktor Rajmond Bernardit, një sintezë e shkëlqyer e të gjitha këtyre provave[15].

Një njeri, që u bë pastaj i famshëm, fluturoi në qendër të Tokës që nga poli i Veriut në vitin 1947 në një largësi prej 1.700 miljesh përtej Veriut

LIBRI 24

magnetik dhe në polin e Jugut në vitin 1956 në një largësi prej 2.300 miljesh përtej Jugut magnetik. Ishte admirali Riçard E. Bird, një personazh mjaft i njohur në rrethin e Marinës së Shteteve të Bashkuara. Ai e quajti tokën e zbuluar prej tij "ai kontinent magjik në qiell" dhe "toka e misterit të përjetshëm"[16]. Në vitin 1947, Birdi dhe ekuipazhi i tij e transmetuan drejtpërdrejt në radio kronikën e fluturimit të tyre në brendësi të planetit, ku panë, në vend të akullit të rajonit verior, toka pa akull dhe liqene e male të mbuluara me pemë. Përshkruan kafshë të çuditshme të ngjashme me mamuthët dhe, toka që panë, akoma sot e kësaj dite nuk paraqitet në asnjë hartë gjeografike.

Pas publicitetit fillestar, informacionet që lidheshin me ekspeditën e Birdit u fshehën dhe ai vdiq në vitin 1957, një vit pas udhëtimit të tij në Antarktidë. Dy vjet më pas, në dhjetor 1959, Rej Palmeri, drejtor i revistës *Flying Sucers* botoi një numër kushtuar zbulimeve të admiralit Bird, por kur arriti kamioni i tipografit me atë botim, të gjitha revistat ishin zhdukur. Palmeri thirri tipografin, i cili i tha se nuk kishte asnjë faturë që të provonte dërgesën e atyre revistave dhe, kur i kërkoi që ta rishtypte atë botim, Palmeri dëgjoi t'i përgjigjeshin se klishetë ishin aq shumë të dëmtuara, sa që nuk ishte e mundur asnjë rishtypje. Palmeri besonte se UFO-t nuk vinin nga hapësira, por nga angrrat e Tokës dhe pikërisht kjo ishte ajo që zbulonte në një artikull që përmbante ai botim fatkeq i revistës. Mendoj se ka të ngjarë që kishte të drejtë dhe poema e lashtë epike *Ramayana* e përshkruan Ramën si një emisar të Agartës, që arrin me një mjet fluturues.

Legjendat mbi popujt brenda-tokësorë dhe mbi racat superiore të pajisura me flokë të verdhë e me sy të kaltër mund të hasen në një pafundësi kulturash të lashta, midis të cilave në atë të Kinës, të Tibetit, të Egjiptit, të Indisë, të Evropës, të Amerikave e të Skandinavisë. Uiliam F. Uoreni, në librin e tij *Paradise Found, Or The Cradle Of The Human Race* (Parajsa e gjetur, ose djepi i gjinisë njerëzore), sugjeron se qeniet njerëzore e kanë pasur zanafillën në një kontinent tropikal të Arktikut, një tokë me diell, ku një racë perëndish ka jetuar për më shumë se njëmijë vjet pa u plakur. Uoreni e lidh këtë parajsë veriore me idenë e lashtë greke të Hyperboreas. Eskimezët, që mund të rrjedhin prej popullsive brenda-tokësore, kanë ca legjenda që tregojnë për një ishull parajsor që ndodhet në veri, një tokë e mrekullueshme me dritë të përjetshme, ku nuk ka errësirë, as dritë diellore ekstreme, një vend ku njerëzit jetojnë mijëra vjet në paqe e lumturi. I njëjti vend haset në mitin irlandez. Pikërisht në brendësi të Tokës, tregojnë disa legjenda, gjeti strehim një pjesë e popullsisë së Lemurias dhe e Atlantidës në epokën e përmbysjeve të mëdha gjeologjike

dhe të përmbytjeve në sipërfaqen tokësore. Platoni ka shkruar për kalime misterioze në brendësi dhe përreth kontinentit të Atlantidës, "tunele si të gjera edhe të ngushta, në angrrat e Tokës"[17]. Ai ka përshkruar edhe kreun e madh "që rri ulur në qendër, mbi kërthizën e Tokës... interpreti i besimit për të gjithë gjininë njerëzore"[18]. Autori romak, Gaius Plinius Secondus, i njohur më së shumti si Plini, përmend popuj të nëndheshëm që ishin arratisur nga Atlantida dhe ka legjenda mbi banuesit e angrrave të Tokës, të quajtur troglodite, të cilët, sipas Plinit, kanë fshehur në galeritë e tyre një thesar të lashtë të madh[19]. Histori të këtij tipi ka me shumicë në çdo kulturë.

Disqet fluturuese naziste

Janë me shumicë edhe historitë mbi "disqet fluturues" të ndërtuar prej nazistëve para e gjatë luftës, sipas programeve të kontrolluara nga Shoqëria e Tulës dhe nga Shoqëria Vril. Studiuesi gjerman Jan van Helsingu, bashkë me shumë të tjerë, ka përshkruar në mënyrë të hollësishme disa prej shpikjeve teknologjike pas vitit 1934, përfshirë aeroplanët gjuajtës Vril-1, Vril-7 (shih pjesën e ilustrimeve) dhe Haunebun 1, 2, 3[20]. Këta dhe të tjerë avionë njiheshin përgjithësisht prej Aleatëve si Gjuajtësit Foo. Uindëll K. Stivensi, pilot i aviacionit amerikan gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe sot studiues i fenomenit UFO, thotë se Gjuajtësit Foo ishin nganjëherë në ngjyrë të gjelbër-gri, nganjëherë në ngjyrë të kuqe-portokalli. Ai thotë se i ka parë të palëvizur në një largësi prej pesë metrash nga aeroplani i vet. Nuk mundeshin as të largoheshin, as të rrëzoheshin dhe detyruan më shumë se një skuadrilje të kthehej prapa, apo të ulej në tokë[21]. Helsingu paraqet fotografi të këtyre mjeteve fluturuese dhe studiues të tjerë i përforcojnë këto informacione. Unë jam gjithmonë shumë i kujdesshëm përballë fotografive të këtij tipi, pasi ato mund të jenë falsifikuar me lehtësi dhe të hidhen në qarkullim derisa të pranohen si fakte reale, por në këtë rast ekziston një video, *UFO – The Secret Of The Third Reich* dhe, edhe studiuesi e profesori Vladimir Terzicki, ka dhënë shumë materiale mbi këtë argument. Duket se disqet fluturuese naziste kanë paraqitur shumë probleme teknike dhe kufizime, që u eleminuan mandej pas lufte. Në vitin 1938, sipas një sërë studiuesish të kësaj fushe, një ekspeditë gjermane në Antarktidë u udhëhoq nga një aeroplanmbajtëse, *Neuschwabenland*-i, dhe një rajon me një sipërfaqe të barabartë me 600.000 kilometra^2, e mbuluar me male pa akuj dhe me liqene, u shpall territor gjerman[22]. Ajo mori emrin Neushvabenland dhe u bë një bazë shumë e madhe ushtarake naziste. Në vitin 1947, thuhet se u krye një mision i çuditshëm detar në Antarktidë, i udhëhequr nga admirali E. Bird, njeriu që kishte

fluturuar në qendër të Tokës si nga poli i Veriut edhe nga poli i Jugut. Ai udhëhoqi me vete 4.000 ushtarë dhe një aeroplanmbajtëse krejtësisht të pajisur. Duket se pas tetë javësh dhe shumë viktimave, vendosën të tërhiqeshin. Ajo që ka ndodhur me të vërtetë mbetet një mister, por Birdi kishte thënë pastaj publikisht se fatkeqësisht, në rast të një luftë të re, do t`u duhej të prisnin sulme nga ana e aeroplanëve që fluturonin nga njëri pol në tjetrin. Ai shtoi se në Antarktidë ekzistonte një qytetërim i zhvilluar, i cili, së bashku me SS-të, përdorte sisteme të përparuara teknologjike[23].

Atëherë përse nazistët nuk e fituan luftën? Hëm, mbi të gjitha, duket se ka lindur një konflikt ndërmjet shoqërive të fshehta naziste dhe, pastaj, teknologjia e "disqeve fluturuese" ishte ende larg për të qenë e përkryer. Por përgjigjja e thjeshtë e arsyes përse gjermanët nuk e fituan luftën është se nuk ishin ata që duhej ta fitonin. Zvarranikët e nivelit më të ulët të përmasës së katërt i manipuluan, sigurisht, por ata vepronin edhe në fronte të tjera. Dëshironin një luftë dhe kështu i manipulonin të gjitha palët për ta bërë që të shpërthente. Sikurse e dokumentoj dhe e tregoj hollësisht tek libri im *...dhe e vërteta do t`ju bëjë të lirë*, nazistët u financuan nga familjet klasike të Vëllazërisë, që financuan edhe Aleatët, të cilët iu "kundërvunë" Hitlerit. Rotshildët ishin në qendër të të gjithë kësaj, dhe vepruan prapë edhe njëherë nëpërmjet kanaleve të tyre angleze, amerikane e gjermane. *Standard Oil*-i, i kontrolluar nga Rokfelerët, përkonte, në fakt, me *I.G. Farben*-in, gjigantin kimik të Hitlerit, që drejtoi kampin e përqëndrimit të Aushvicit. *I.G. Farben*-i ishte bërthama e makinës naziste të luftës dhe qenë njohuritë e tij të përparuara teknologjike, të cilat i kishte marrë nga *Standard Oil*-i, ato që i dhanë mundësi Hitlerit të zhvillonte luftën. Midis këtyre njohurive figuronte edhe *know-how*-i i nevojshëm për t`i shndërruar rezervat e mëdha qymyrmbajtëse gjermane në naftë. Furnizime të tjera nafte iu dhanë Gjermanisë nga *Standard Oil* nëpërmjet Zvicrës, qendër financiare dhe fortesë e Vëllazërisë. Presidenti i *Standard Oil*-it të Nju Xhersit (sot *Exxon*), ishte Uiliam Stamps Farishi, një mik i ngushtë i Herman Shmitcit, presidentit të *I.G. Farben*-it. Nipi i Farishit, Uiliam Farish III, i përket rrethit të ngushtë që sillet përreth Xhorxh Bushit dhe pret në shtëpinë e vet edhe mbretëreshën e Anglisë e princin Filip. Farishi e mbretëresha rrisin së bashku kuaj. I ati i Bushit, Preskot Bushi, një shtyllë e Shoqërisë së Kafkës dhe të Kockave, ka qenë ndër financuesit e Hitlerit. Ai veproi nëpërmjet një kompanie ndihmëse të quajtur *United Banking Corporation* (UBC). UBC-ja lidhte shoqërinë *W.A. Harriman* të Nju Jorkut (Vëllezërit Braun, Harriman, pas vitit 1933) me rrjetin tregtar të Fritc Tisenit, sipërmarrësit gjerman të çelikut, përveçse bankier, që financoi Hitlerin duke

nisur nga vitet njëzet të 1900-ës. Veprimtaritë e *Harriman*-it, sikurse edhe perandoritë J.P. Morgan e Rokfeler, u financuan nga Paisuatë dhe nga Rotshildët. Ndërkohë, Rotshildët kontrollonin edhe *I.G. Farben*-in e Hitlerit.

Midis anëtarëve të këshillit administrativ të kompanisë ndihmëse të *Farben*-it, amerikanes *I.G.*, figuronte Pol Varburgu, administrator kujdestar dhe përfaqësues i Paisua-Rotshildëve, i dërguar në Shtetet e Bashkuara në vitin 1913 për të përmbushur mashtrimin financiar të Rezervës Federale. I vëllai i tij, Maks Varburgu, ishte bankieri i Hitlerit, gjersa në vitin 1938 e braktisi Gjermaninë pa asnjë problem dhe u shpërngul në Shtetet e Bashkuara. Ndërmjet financuesve të tjerë të Hitlerit figurojnë *General Electric*-u, që ka lidhje të ngushta financiare me Franklin Delano Rusveltin, presidentin që iu "kundërvu" Hitlerit; *Ford Motor Company* e Henri Fordit, që u vlerësua me dekoratën më të lartë që u jepej jogjermanëve, me Kryqin e Madh të Shqiponjës Gjermane; dhe *International Telephone and Telegraph* (ITT), që, në bashkëpunim me bankierin personal të Hitlerit dhe oficerin e SS-ve, baronin Kurt Fon Shröder, kontribuoi nga ana e saj për të financuar përpjekjen luftarake naziste. Mendja drejtuese e kësaj mbështetjeje të kordinuar ishte Montagu Norman (Kom 300), guvernator i Bankës së Anglisë, e kontrolluar nga Rotshildët. Normani ishte një ortak i Hjalmar Shaktit, që do të bëhej më vonë këshilltar financiar i Hitlerit dhe i presidentit të *Reichsbank*-ës gjermane. Këta të dy ishin aq shumë miq, sa që Shakti i dha emrin Norman njërit prej nipërve të tij. Kur nazistët pushtuan Çekosllovakinë, Normani i dorëzoi Hitlerit një sasi ari çek të barabartë me një vlerë prej gjashtë milionë stërlinash, që u depozitua mandej në Londër. Pa shihni, dy firmat që janë mbi dokumentin, i cili vërteton emërimin e Shaktit si president i *Reichsbank*-ës më 17 mars të vitit 1933, ishin ato të Adolf Hitlerit dhe të njeriut fasadë të Rotshildëve, Maks Varburgut. Pjesa më e madhe e popullit "hebre" mendon se familje si ato të Rotshildëve dhe të Varburgëve, që deklarohen të dyja hebreje, janë nga ana e tyre. Asgjë nuk mund të jetë më larg nga e vërteta. Sikurse e kam thënë më përpara, pista e arit dhe e parave të grabitura hebrejve gjermanë nga bankat zvicerane të shpie prapë edhe një herë tek Rotshildët.

Edhe Rotshildët dhe ortakët e tyre, Rokfelerët, Hermanët e Bushët, ishin përgjegjës të programit nazist të pastërtisë racore. Medoemos që ishin. Eksperti i pastërtisë raciale të Hitlerit ishte doktor Ernst Rudini, një psikiatër i Institutit të Gjenealogjisë dhe Demografisë "Kajzer Vilhelm" të Berlinit. Atje zinte një kat të tërë me kërkimet e tij, që ishin bërë të mundura falë fondeve të dhëna prej... Rotshildëve[24]. Po këto familje financuan lëvizjen e eugjenetikës, që kishte synim të eleminonte racat gjenetikisht më të ulëta dhe të bënte që të

mbijetonin vetëm ato superiore. Eugjenetika sot merr shpesh emrin "kontroll demografik". Organizata më e njohur e kontrollit demografik është *Planned Parenthood* (Mëmësi dhe atësi e planifikuar), që lindi me një tjetër emër pranë selisë londineze të Shoqërisë Eugjenetike Britanike. Nuk të çudit fakti që Xhorxh Bushi ka shfrytëzuar çdo rast për të bërë të mundur që të derdheshin sasi të madha parash amerikane e të Kombeve të Bashkuara në atë organizatë. Bushi dhe Henri Kisingeri mbështesin teoritë e Maltusit, masonit të rrethit të Darvinit, që vdiq më 1834. Maltusi sugjeronte të eleminoheshin popullsitë me ngjyrë dhe ato të bardhat që u përkisnin racave më të ulëta. Maltusi dhe miku i tij ekonomist, masoni Xhon Stjuart Mill, mbështesnin idenë se raca ariane, e pajisur me flokë të verdhë e me sy të kaltër, ishte dhurata që Zoti i kishte bërë botës. Ose, më mirë, dhurata e perëndive. Që të dy shtonin se raca superiore e të bardhëve duhej të kontrollonte racat e "paditura" me lëkurë të zezë. Tani, kjo filozofi nuk shkëputet nga ajo naziste, ose nga ajo e *establishment*-it britanik dhe amerikan, pasi rrjedhin të gjitha nga i njëjti burim. Përse në Afrikë, në Amerikën Qendrore e Jugore dhe në Azi janë futur politika që kanë shkaktuar aq shumë sëmundje, vdekje e shkatërrime? E gjitha kjo është pjesë e një plani.

Megjithatë, një vërtetim të faktit se e njëjta forcë kontrollonte të gjitha rreshtimet e Luftës së Dytë Botërore vjen nga operacioni i shërbimeve sekrete britaniko-amerikane i quajtur Plani Paperklip, falë të cilit krerët kryesorë, shkencëtarët, inxhinierët dhe ekspertët nazistë të kontrollit mendor arritën të arratiseshin nga Gjermania, para se të vinin Aleatët. Ata u çuan në Afrikën e Jugut dhe në Shtetet e Bashkuara, ku vazhduan të punonin për realizimin e Urdhërit zvarranik të Ditës. Nazistët e gjykuar dhe të dënuar në Nyremberg ishin vetëm ca gurë shahu të ekspozuar në një proces-spektakël, për të qetësuar zemërimin e opinionit publik. Mbretërit, mbretëreshat, peshkopët dhe kalorësit e regjimit nazist u arratisën për të vazhduar fushatën e tyre kundër njerëzimit nëpërmjet organizatave të ngritura në këmbë nga "kundërshtarët" e tyre, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Ndër nazistët që u arratisën falë Planit Paperklip figuronte vrasësi i shumëfishtë dhe torturuesi Jozef Mengele. CIA ishte krijuar prej shërbimeve sekrete britanike dhe, në mënyrë të veçantë, nga rrethi i ngushtë i elitës, i njohur si Operacione Ekzekutive Speciale (SOE). CIA zëvendësoi organin e shërbimeve sekrete amerikane të përjudhës së luftës, Zyrën e Shërbimeve Strategjike (OSS), që ishte njohur nga operacioni i shërbimeve të fshehta të perandorisë së Paisuasë. OSS-i ishte drejtuar nga Bill Donovani, një kukull e rrethit Paisua-Rotshild-Rokfeler, përveçse një shok shkolle i Franklin Delano Rusveltit. Profesori i të drejtës i

Donovanit në *Columbia University*, universiteti i Vëllazërisë, ishte Harland F. Stoni, që do të bëhej më vonë prokuror i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara. Një tjetër prej beniaminëve të Stonit ishte Xh. Edgar Huveri, mason i shkallës së 33-të dhe kreu i turpshëm i FBI-së në kohën e vrasjes së Kenedit. Nuk është një rastësi, që një sërë figurash kyç në vrasjen e presidentit Kenedi ishin ish agjentë të OSS-it të dërguar në selinë londineze të shërbimeve sekrete britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ndër këta figuronte Kleji Shau, agjenti i CIA-s, i cili qe i vetmi njeri që u gjykua për vrasjen e Kenedit, sikurse tregon filmi *JFK*. Ai u shfajësua vetëm sepse akuzuesit e tij kryesorë qenë vrarë para se ai të paraqitej në gjyq. Shau ishte këshilltar i atij satanistit dhe klonit të Rotshildëve, siç qe Uinston Çurçilli dhe, si të gjithë agjentët e OSS-it të pranishëm në Londër gjatë luftës, merrte urdhëra nga njerëz si Lord Viktor Rotshildi, manovruesi i fshehtë i organit të shërbimeve sekrete britanike.

Drejtori i parë i CIA-s ishte Alen Dallesi, vetë ai një nazist, si i vëllai Xhon Foster Dallesi, i emëruar pastaj Sekretar Shteti. Dallesat janë një tjetër familje e aristokracisë britanike. Të dy vëllezërit Dalles ishin të përfshirë në Planin Paperklip, sikurse edhe Henri Kisingeri[25], një "hebre gjerman", ithtar jo i judaizmit, por i satanizmit dhe i shokëve të tij zvarranikë. Dallesat i përkisnin një familjeje skllavopronarësh të Jugut dhe ishin kushërinj të Rokfelerëve. Dallesat ishin ndihmuar nga studioja ligjore *Sulivan e Kromuell*, që merrej edhe me çështjet tregtare amerikane të *I.G. Farben*-it dhe financuesi kryesor i Hitlerit, Fritc Tiseni, ia paraqiti Alen Dallesin vetë Hitlerit. Xhon Foster Dallesi shkruante "Hail Hitler" mbi letrat që u dërgonte klientëve gjermanë dhe u dërgua në Gjermani për të negociuar huara të reja për nazistët, për llogari të grupit Rotshild-Rokfeler-Tavolinë e Rrumbullakët. Huatë u dhanë për të ndihmuar gjermanët të paguanin dëmshpërblimet e luftës, që vetë Xhon Foster Dallesi kishte kontribuar t`u diktoheshin atyre, në cilësinë e anëtarit të delegacionit amerikan në Konferencën e Paqes së Versajës të vitit 1919. Nuk të çudit atëherë fakti që CIA të jetë krijuar nga nazistët, për nazistët. Midis anëtarëve të saj figuronte edhe Rejnhard Gehleni, spiun i SS-ve hitlerianë në frontin rus, që u ngarkua nga Alen Dallesi të ngrinte organizmat e CIA-s në Evropë. Autori dhe studiuesi Noam Çomski thotë se Gehleni krijoi për CIA-n një ushtri të fshehtë naziste, e cila i shtriu operacionet e saj në Amerikën Latine. Edhe organizmi i policisë i quajtur Interpol lindi në rrethana të ngjashme. Mendësia naziste nuk e ka humbur luftën. Ka kontrolluar të gjitha rreshtimet dhe pas masakrës ka vazhduar të kryejë punët e saj e të realizojë planet e veta, si gjithmonë. Hitleri vdiq në një bunker? Sigurisht që jo. Doktor Robert Dorioni, drejtor i departamentit të odontoiatrisë

LIBRI 24

(*shkencë që studion sëmundjet e dhëmbëve*) gjyqësore të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Kuebekut, në Montreal, ka hasur mospërkime të mëdha midis radiografive të dhëmbëve të kufomës dhe të mijëra fotografive, në të cilat Hitleri ishte përjetësuar me gojën hapur. Hapësira ndërmjet njërit dhëmb dhe tjetrit rezulton në fakt e ndryshme. Hitleri kishte një kanal radiokolar dhe një dhemb porcelani, që kufoma nuk i kishte, dhe ura e harkut të poshtëm paraqiste shumë ndryshime[26].

Pas luftës, krerët nazistë u mjaftuan të hiqnin çizmet e rënda e helmetat, të vishnin kostumet dopiopetë e kapelën prej shkencëtarësh dhe Urdhëri i Ditës shkoi përpara. Me ta përforcuar këtë, të vjen vetvetiu të besosh se ka qenë grupi sundues nazisto-satanist i qeverisë amerikane ai që vendosi të urdhëronte të vdisnin në një zjarr të madh fëmijët e Vakos, apo që urdhëroi të hidheshin në erë të tjerë në Oklahoma, me qëllimin për të realizuar planin e tij të sundimit global. Është kjo mendësia që kontrollon botën tonë dhe pesë miliardë njerëz e lejojnë të veprojë i pashqetësuar. Dhe gjersa njerëzit do të vazhdojnë ta bëjnë këtë, mendësia nazisto-ariano-zvarranike do të ruajë pushtetin e saj mbi planetin Tokë.

LIBRI 24

Kapitulli 13

Rrjeti sot

Pas mijëra vitesh evoluimi, organizimi zvarranik është sot një rrjet i gjerë dhe shpesh i padepërtueshëm shoqërish të fshehta, bankash, ndërmarrjesh, partish politike, shërbimesh sigurimi, pronarësh mediash, të gjitha të lidhura midis tyre. Por struktura e tij bazë dhe Urdhëri i tij i Ditës mbeten shumë të thjeshtë.

Qendra operative e këtij rrjeti është *Siti* i Londrës me filialet drejtuese në vende si Franca, Gjermania, Belgjika, Zvicra, Italia e Shtetet e Bashkuara. Këto janë merimangat e kapura nga rrjeta dhe *Siti* i Londrës, "Trojës së Re", që përkon me qendrën më të rëndësishme. Që këtej orkestrohen Urdhëri global i Ditës e politikat e ndryshme dhe "drejtorët e filialeve" të tyre i fusin ato politika në vendet e ndryshme. Kështu, nëse Urdhëri global i Ditës parashikon që duhet të bjerë dollari amerikan, pesosi meksikan, randi jugafrikan, apo tregjet e Lindjes së Largët, "drejtorët e filialeve" të pranishëm në ato zona do të marrin masat e nevojshme që kjo të ndodhë. Vëllazëria nuk vuan, përkundrazi, sepse është në dijeni të qëllimit të fundit. Në vitin 1991, vit kur pesosi meksikan u shvlerësua, pjesa më e madhe e bankave amerikane të Vëllazërisë, si *Chase Manhattan*-i i Rokfelerëve, rritën përfitimet e veta, pasi i shitën të gjithë titujt e tyre një çast përpara rënies së bursave botërore. Natyrisht, bëhet fjalë vetëm për përkime të rastësishme!

Në qendër të rrjetit, apo në majë të piramidës, sipas analogjisë që parapëlqeni, janë zvarranikët. Këta veprojnë më së shumti në errësirën e bazave të nëndheshme, sidomos duke zotëruar racat njerëzoro-zvarranike, që janë më afër vetëdijes zvarranike të nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Këta zvarranikë gjakpastër dhe këta njerëz të zotëruar nga zvarranikët zënë pozitat më të mëdha të pushtetit të botës, ose veprojnë në hije dhe kontrollojnë ata që mbulojnë formalisht detyra pushteti, si kryeministra e presidentë. Ideja që të kesh një zvarranik, apo një qenie njerëzore të kontrolluar nga një zvarranik, si president, mund t'i duket e çuditshme vetëm atij që ka lejuar që vizioni i vet i të mundshmes të jetë katandisur në një kokërr rëre. Por, nëse mbani parasysh provat që janë grumbulluar në harkun e mijëvjeçarëve, ja ku do t'ju duket e lehtë të kuptoni "misteret" e historisë. Njerëzit më pyesin me të drejtë se kush vallë do të mund t'ia kushtonte të gjithë jetën çështjes së pushtimit të planetit, kur e di që do të vdesë mjaft më përpara se ta shohë të realizuar qëllimin e tij. Përgjigjja është kjo: vetëdija, që kontrollon trupin, e përdor atë thjesht si një kostum, si një tutë speciale, gjersa ai të mos jetë ngrënë. Kur ai të hahet, do të veshë një tjetër. Vetë këta zvarranikë pushtojnë trupat e të gjithë aktorëve më të mëdhenj të konspiracionit që nga kohët më të lashta. Ideja fikse torturuese për t'u lidhur në krushqi vetëm me familjet e Vëllazërisë rrjedh nga nevoja për të ruajtur pasurinë gjenetike zvarranike dhe, kështu që, për të ruajtur lidhjen dridhëse midis trupit njerëzor në përmasën e tretë dhe forcës që e kontrollon, në nivelin më të ulët të përmasës së katërt. Pikërisht për të fshehur këtë të vërtetë ka ndodhur, gjatë shekujve, që të shkatërrohen dokumente të lashta, tekste e përmbledhje historike, nëpërmjet një operacioni rrënimesh e plaçkitjesh të kulturave indigjene të botës. Zvarranikët donin të shkatërronin e të zhduknin të gjitha kujtimet dhe dokumentet që lidheshin me ekzistencën e tyre të mëparshme dhe me kontrollin që kishin ushtruar në të kaluarën. Duke bërë kështu, njerëzimi nuk do ta kishte pasur idenë se kontrollohej nga një forcë jonjerëzore e përmasës së katërt, që merr tipare njerëzore.

E vërteta e asaj që ka ndodhur dhe që vazhdon të ndodhë mbahet krejtësisht e fshehur nga niveli më i lartë i rrjetit të shoqërive të fshehta dhe vetëm një grusht njerëzish është në dijeni të saj. Çdo seksion i piramidës globale përbën një piramidë më vete në shkallë të zvogëluar. Është fjala për diçka të ngjashme me të ndarat e padepërtueshme të një arijeje, ose, do të ishte më mirë të themi, duke parë natyrën e saj të fshehtë, të një nëndetëseje. Struktura e niveleve më të larta reflektohet tek ato më të ulëtat. Për shembull, piramida e Masonerisë i përgjigjet një kreu të përgjithshëm dhe ky, nga ana e tij, i përgjigjet një tjetër kreu edhe më

lart. Shkallët e Mendjendriturve fillojnë atje ku mbarojnë shkallët e masonëve, kështu shkalla e 33-të e Ritit Skocez dhe shkalla e dhjetë e Ritit të Jorkut duhej t'i përkonin shkallëve më të larta dhe kjo është e vërtetë në rastin e pjesës më të madhe të masonëve. Por kush mendohet se ka mendësinë e duhur, apo se i përket racës së Vëllazërisë, ngrihet në nivelin më të lartë, në shkallën e Mendjendriturve, apo në një shkallë tjetër të grupeve dhe të rretheve të ngushta okulte, si Tavolina e Rrumbullakët, që veprojnë përmbi nivelet e shoqërive të fshehta zyrtare, si masonët dhe Kalorësit e Shën Gjonit të Jeruzalemit (Maltës). Në nivelet më të larta, shoqëritë e fshehta paraqesin të gjitha të njëjtin organizim dhe veprojnë të gjitha për të realizuar të njëjtin Urdhër të Ditës, pavarësisht grindjeve të tyre të pafundta dhe konflikteve të brendshme.

Ky rrjet i shoqërive të fshehta i vendos anëtarët e saj më të besuar në pozicionet më me ndikim të botës së bankave, të industrive, të politikës, të mediave, të ushtrisë, të mjekësisë etj. dhe, në nivel krerësh, edhe këto organizata e institucione, në dukje të palidhura ndërmjet tyre, shkrihen në një majë të vetme piramidale dhe janë të kontrolluara nga të njëjtët njerëz. Kjo strukturë të kujton kukullat ruse, ku njëra kukull, ose në këtë rast, njëra piramidë, qëndron brenda një tjetre, gjersa arrin në piramidën globale, që i përmban të gjitha (shih ***Figurën*** 25). Fytyrat publike të këtyre organizatave dhe ata që i kontrollojnë nga prapa kuintave, mund të hyjnë e të bëjnë pjesë në rrjet si masonë, si Kalorës të Maltës, si anëtarë të Shoqërisë së Kafkës e të Kockave, ose si anëtarë të shoqërive të fshehta e gjysmë të fshehta, si Instituti Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare, Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme, Grupi Bilderberg, Klubi i Romës dhe Komisioni




Figura 25. ***Piramida e manipulimit*** *– Anunakë/zvarranikët (Përmasa e Katërt) – Elita Globale – Nivelet e dijes dhe të hierarkisë brenda institucioneve – për shembull, nga arkëtari i bankës tek presidenti i këshillit administrativ. – Banka; Industri; Forca ushtarake; Politikë; Arsim; Mjekësi/ Ndërmarrje farmaceutike; Shërbime sekrete; Besime fetare; Media; Drogë/Krim i organizuar.* Piramida e pushtetit, ku të gjitha institucionet shkrihen në të njëjtën Elitë të vogël. Kjo i jep mundësi vetë Urdhërit të Ditës që të orkestrohet nëpërmjet rretheve të ndryshme të shoqërisë.

Tripalësh, mbi të cilin do të ndalem pas pak. Gjëja që dua të nënvizoj këtu është se, ndërsa të gjitha këto grupe kanë emra të ndryshëm dhe qëllime në dukje të ndryshme, në realitet është fjala për të njëjtën organizatë të kontrolluar si përfundim nga të njëjtët krerë.

Merimanga

Sektet sekrete dhe grupet që formojnë rrjetin e gjerë të organizmave të ndërvarura përbëjnë një version të zgjeruar të së njëjtës organizatë të lashtë. Sipas disa studiuesve, nivelet më të larta të hierarkisë do të ishin Këshilli i 3-ve, Këshilli i 5-ve, Këshilli i 7-ve, Këshilli i 9-ve, Këshilli i 13-ve, Këshilli i 33-ve, Këshilli i Madh i druidëve, Komiteti i 300-ve (i njohur edhe si "Olimpikët") dhe Komiteti i 500-ve. Shumë grupe nuk kanë ndonjë emër prapa të cilit të fshihen[1]. Jam i sigurtë se në nivelet më të larta të kësaj piramide qëndrojnë një apo dy njerëz, një lloj kryeprifti, ose kryepriftëreshe, botëror, sepse, siç do ta shpjegoj më pas, hierarkia më e rëndësishme, ndaj së cilës të gjitha të tjerat rezultojnë vartëse, është ajo sataniste. Nëse dëshironi të kontrolloni lojën, duhet të kontrolloni të gjitha rreshtimet dhe kjo strukturë lejon ta bësh këtë gjë. Vëllazëria kontrollon "pro"-të dhe "kundra"-t në fushën e politikës, të bankave, të industrive e të mediave. Ajo ka agjentë të futur në të gjitha qeveritë dhe në partitë politike, që u "kundërvihen" atyre qeverive; ka agjentë në të dy rreshtimet e luftrave dhe të konflikteve politike; në kartelët që tregtojnë drogë dhe në agjensitë që luftojnë drogën e që u "kundërvihen" atyre kartelëve; brenda organizatave të krimit të organizuar dhe agjensive të policisë e të *intelligence*-s, që "drejtojnë hetimet" mbi ato grupe. Nuk mjafton të thuash se je pro lirisë dhe paqes, për të qenë me të vërtetë i tillë. Në fakt, po të ishte kështu, nuk do të kishte nevojë ta thoshe, sepse do të bëhëj fjalë për një gjë të natyrshme. Unë kam një rregull të thjeshtë. Gjithçka që quhet "demokratike", është krejt e kundërta e kësaj. Vështroni se sa fronte demokratike vendosin diktatura rreth e rrotull nëpër botë.

Rrjeti i Tavolinës së Rrumbullakët

Njëri prej rrjeteve më të mëdha rezulton i qeverisur drejtpërdrejt nga qendra, nëpërmjet Tavolinës së Rrumbullakët (shih ***Figurën*** 26). Sikurse e kemi parë, Tavolina e Rrumbullakët ka degëzime të përhapura nëpër të gjithë botën dhe në vitet 1920 e 1921 asaj iu shtuan Instituti Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare (RIIA) dhe Këshilli mbi Marrdhëniet e Jashtme (CFR). Vetë RIIA u ka dhënë pastaj jetë degëve të tij. Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme i Nju Jorkut krijoi një rrjet me institucione në varësi të tij brenda Shteteve të

Bashkuar, që lidhin Vëllazërinë Babilonase me departamentet e qeverisë amerikane, me Kongresin, me pronarët e mediave, me drejtorët e gazetave, me gazetarët, me fondacionet e përjashtuara nga taksat, si Fondacioni Rokfeler, me universitetet, me shkencëtarët, me krerët ushtarakë, me "historianët", me bankierët dhe me afaristët. Çdo vend i një farë niveli e përmban këtë rrjet, i cili ndjek Urdhërin e Ditës të diktuar nga qendra globale si ajo e *Sitit* të Londrës, e Gjermanisë, e Francës dhe e Zvicrës. Jam sulmuar, edhe pse duke mos qenë i pranishëm, prej një stacioni radioje të Kejptaunit nga një "astrolog", i cili deklaroi se konspiracioni, për të cilin unë flas, nuk mund të ekzistonte, sepse nuk mund të ishte i organizuar prej kaq shumë kohe. Si zakonisht, nuk kishte lexuar as edhe një prej librave të mi, as nuk kishte kryer ndonjë studim për të hequr qafe tezën time dhe, po ta kishte bërë, do të kishte kuptuar se, duke patur parasysh natyrën e strukturës që jam duke përshkruar, jo vetëm që është e mundur të vësh në zbatim të njëjtin Urdhër të Ditës brez pas brezi, por është krejtësisht e pranueshme. Përse shumëkombëshet, apo bankat e mëdha, nuk e pushojnë aktivitetin e tyre kur një brez krerësh shkon në pension, ose vdes? Sepse hyn brezi pasardhës. Pikërisht kështu. E njëjta gjë ndodh me Vëllazërinë dhe me Urdhërin e saj të Ditës. Ndoshta ai astrolog duhet të shohë të dhënat që lidhen me lindjen e tij dhe të identifikojë bashkimin yjor që e pengon të shohë atë që është e qartë dhe planetin që e shtyn, sikurse miliarda njerëz të tjerë, të heqë qafe e të dënojë informacione, të cilat as që i ka lexuar, as që i ka kontrolluar, apo as që i kuptuar.




Figura 26. *(Tavolina e rrumbullakët – Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme, Komisioni Tripalësh, Instituti Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare, Klubi i Romës, Grupi Bilderberg, Kombet e Bashkuara; Amerika, Amerika-Evropa-Japonia, Mbretëria e Bashkuar Globale, Eugjenetika Ambientale, Evropa-SHBA globale).* Rrjeti i Tavolinës së Rrumbullakët.

Në maj të vitit 1954 u bë mbledhja e parë zyrtare e organizatës, që pastaj hyri të bënte pjesë në rrjetin e Tavolinës së Rrumbullakët, Grupit Bilderberg (Bil), i cili e mori këtë emër nga Hoteli Bilderberg i Osterbekut, në Vendet e Ulëta, ku u zhvillua ai takim fillestar. Ose, të paktën, kjo është ajo që na bën të ditur historia zyrtare. Bil, apo Bel, ishte edhe perëndia Diell e fenikasve. Nga viti 1954 gjer në vitin 1976 Grupi Bilderberg u kryesua nga princi Bernhard i Vendeve të Ulëta, ish oficer i SS-ve naziste dhe spiun gjerman në varësi të departamentit të shërbimeve sekrete NW7, që vepronte brenda gjigantit kimik famëkeq *I.G. Farben*, i cili administroi kampin e përqëndrimit të Aushvitcit[2]. Sipas disa kërkuesve, edhe papa Gjon Pali II do të kishte bashkëpunuar me *I.G. Farben*-in. Kjo duket se ka një kuptim, natyrisht, është Vëllazëria ajo që i zgjedh papët. Princi Bernhard, një gjerman që u martua me një grua të familjes mbretërore hollandeze, pikërisht ashtu siç kishte bërë Uilliam d'Oranzhi, është një i aferm zvarranik dhe një mik i ngushtë i princit britanik, Filipit. Së bashku, i dhanë jetë fondacionit *World Wildlife*, sot *Worldwide Fund for Nature* (WWF). E fundit gjë që u interesonte, ishte të mbronin natyrën, siç do të kemi mundësi ta shohim në kapitullin e mëpasshëm. Në vitin 1968, lindi Klubi i Romës, i kryesuar nga anëtari i Bilderbergut dhe masoni Aurelio Peçei (Kom 300), zëvendës i Xhovani Anjelit, anëtar i Bilderbergut dhe i Fisnikërisë së Zezë. Peçei i tha një herë mikut të tij, ish sekretarit amerikan të shtetit Aleksandër Hajg (anëtar i Komisionit Tripalësh, Kalorës i Maltës) se e ndiente veten një Adam Veishaupt i mishëruar[3]. Ishte Veishaupti prapa Mendjendriturve Bavarezë. Klubi i Romës, i themeluar në çifligun privat italian të familjes Rokfeler, në Belaxhio, krijoi lëvizjen ambientaliste. Rokfelerët dhe Rotshildët e kanë manovruar lëvizjen ambientaliste sipas qejfit të tyre. Klubi i Romës e ka përdorur ambientin për të centralizuar pushtetin e për të konfiskuar tokën. Deklaron se bën propagandë për të "shpëtuar planetin" kur, në realitet, bëhet fjalë vetëm për një tjetër front të rreshtuar në favor të planit për kontrollin e botës dhe, mbi të gjitha, një front i përbërë pikërisht nga ata që i krijojnë vetë problemet ambientale, që thonë se duan t'i ndalojnë. E njëjta gjë vlen edhe për të ashtuquajturin Klub i Budapestit, i cili kërkon të bëjë me "karakterin shpirtëror" atë që Klubi i Romës ka bërë me ambientin. Klubi i Budapestit drejtohet nga Ervin Laszio, mik i Aurelio Peçeit të Klubit të Romës. Një tjetër satelit i rëndësishëm i Tavolinës së Rrumbullakët është Komisioni Tripalësh, i krijuar nga Rokfeleri në Shtetet e Bashkuara në vitin 1972 me qëllimin për të koordinuar Urdhërin e Ditës midis tri zonave të botës, Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe Japonisë.

Këto organizata dhe anëtarët e tyre ushtrojnë ndikim çdo ditë mbi jetën

dhe mbi çështjet e botës. Sa herë që do të citoj ndonjë që ishte, është, ose do të bëhet më pas anëtar i këtyre grupeve, do të përdor shkurtimet RIIA, CFR, Bil e TC. Në këtë kohë nuk jam në gjendje t'ju them shumë për anëtarët aktualë të Institutit Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare (RIIA), sepse është fjala për një organizatë shumë sekrete, dhe do t'i isha jashtëzakonisht mirënjohës kujtdo që do të dëshironte të më jepte informacione lidhur me të. Njoh, megjithatë, disa prej anëtarëve të tij më të rëndësishëm.

Brenda këtyre grupeve, të gjithë të lidhur midis tyre, figurojnë krerët e botës bankare, industriale, mediatike, ushtarake, të shërbimeve sekrete, të arsimit e të policisë. Po t'u hidhni një shikim disa prej njerëzve që morën pjesë në takimin e parë të Bilderbergut në vitin 1954 e do t'ju bëjë të kuptoni më mirë se për çfarë tipi njerëzish jemi duke folur. Presidenti ishte princi Bernhard, i shoqi i mbretëreshës Xhuliana të Vendeve të Ulëta (Kom 300), edhe ajo një *habituée* e Bilderbergut. Mbretëresha aktuale, Beatriçja, është një tjetër mbështetëse e Bilderbergut. Kanë qenë presidentë të Bilderbergut edhe Sër Aleks Duglas Homi (Lordi Hom), pinjoll skocez i elitës, përveçse ish kryeministër britanik dhe një tjetër anëtar i aristokracisë britanike, Lordi Karrington, i bërë president në vitin 1991. Pas pak do të ndalem tek ai. Princi Bernhard u kandidua për poltronën e presidentit të Bilderbergut nga Lordi Viktor Rotshild, spiun dhe mashtrues me përmasa kolosale, përveçse njëri prej manipuluesve më të mëdhenj të shekullit XX. Ndër pjesëmarrësit e tjerë në takimin e parë figuronin: David Rokfeleri (CFR, TC); Dik Rusku (CFR, TC, ithtar i Rodit), kreu i Fondacionit Rokfeler dhe sekretar shteti nën presidencën e Xhon F. Kenedit; Xhozef E. Xhonsoni (CFR), kreu i Fondacionit Karnige për Paqen (Luftën!) Ndërkombëtare dhe sekretar shteti i dëshiruar nga Bilderbergu; Denis Haleji (TC, RIIA, Kom 300, Shoqëria Fabiane), ministër laburist i mbrojtjes nga viti 1964 deri në vitin 1970 dhe ministër i Financave dhe i Thesarit nga viti 1974 deri në vitin 1979; dhe Lord Butbi, që bashkëpunoi me Uinston Çurçillin në operacionin e unifikimit të Evropës, i njohur më pas si Bashkimi Evropian.

NATO-ja është krijuar nga Vëllazëria dhe është parashikuar të evoluojë fshehurazi në një ushtri botërore, që përfshin gjithmonë e më shumë vende dhe krijon, nëpërmjet manipulimit, "probleme", të cilat t'i japin pastaj mundësinë të veprojë jashtë zonës së saj të kompetencës. Pesë sekretarët e fundit të përgjithshëm të NATO-s ishin të gjithë anëtarë të Bilderbergut: Xhozef Lundsi, Lordi Karrington, Manfred Vërner, Uili Klars dhe Havier Solana. Kreu i Bankës Botërore, ortaku i Rotshildëve Xhejms Volfenson, dhe një sërë e gjatë paraardhësish të tij, janë anëtarë të Bilderbergut. Siç janë

edhe dy krerët e parë të Organizatës së re Botërore për Tregtinë, një krijesë e Vëllazërisë, e cila u dikton gjoba të kripura vendeve që kërkojnë të mbrojnë popullsinë e tyre nga sistemi i pamëshirshëm tregtar e financiar global. Kreu i parë i Organizatës Botërore për Tregtinë (WTO) ka qenë irlandezi Piter D. Sutherlandi, drejtor i Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Taksat Doganore dhe Tregtinë (GATT-it), Komisar i Komunitetit (Bashkimit) Evropian dhe president i *Irish Allied Banks* e i *Goldman Sachs*-it. Sutherlandi është një klon i Elitës, mund të jeni të sigurtë, dhe u zëvendësua në WTO nga një anëtar i Bilderbergut, nga italiani me emrin Renato Ruxheri. Si Banka Botërore edhe Organizata Botërore për Tregtinë janë të lidhura me të tjera institucione financiare globale, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe grupi G7/G8, që duan të diktojnë vullnetin dhe politikat e tyre mbi vendet në zhvillim të Afrikës, të Amerikës jugore e qendrore dhe të Azisë, dhe të bëjnë të mundur që ato të jenë të kontrolluara nga shumëkombëshet, të cilat i përgjigjen të gjitha të njëjtit *leadership* botëror. Marrëveshja Shumëpalëshe mbi Investimet (MAI) është një tjetër mashtrim me qëllimin për të rritur në mënyrë dramatike kapacitetin e shumëkombësheve, që pastaj të shkatërrojnë bazën ekonomike të një vendi, duke i diktuar vullnetin e tyre qeverisë dhe për të arritur përfitime, pa paguar taksat dhe pa qenë të detyruara të respektojnë ligjet që rregullojnë botën ekonomike. Rrjeti bankar qendror është i përfshirë në aktivitetet e Tavolinës së Rrumbullakët – Grupit Bilderberg. Disa prej krerëve të Bankës së Anglisë, përfshirë Sër Gordon Riçardsonin, kanë qenë anëtarë të Bilderbergut dhe e njëjta gjë mund të thuhet për të tjera banka qendrore, si Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara, karteli i bankave private që kontrollon ekonominë amerikane dhe që është, nga ana e vet, e kontrolluar nga Evropa. Kreu aktual i Rezervës Federale është Alen Grinspani (CFR, TC, Bil), i cili ka zëvendësuar Pol A. Volkerin (CFR, TC, Bil). E kuptuat tipin. Nuk kalon javë që, në Shtetet e Bashkuara dhe në Britaninë e Madhe, mediat të mos spekullojnë mbi përmbajtjen e mundshme të deklaratave që lëshojnë Grisnpani dhe guvernatori i Bankës së Anglisë, apo i *Bundesbank*-ës, mbi gjendjen ekonomike të atyre vendeve. Deklaratat e këtyre njerëzve mund të bëjnë, dhe shpesh e bëjnë, që të bien apo të ngrihen tregjet aksionare. Të bësh të ngrihen apo të bësh të bien përqindjet e interesit mund të ketë efekte të jashtëzakonshme mbi tregjet dhe mbi jetën e njerëzve. Kush mendoni se i kontrollon këta persona dhe deklaratat që lëshojnë? Pikërisht kështu. Një miku im, që investon shumë në tregjet amerikane, ka filluar të studiojë modelet e investimit të shumëkombësheve më të mëdha, të bankave dhe të kompanive të sigurimit në periudhën paksa më përpara në krahasim me atë kur anëtari

i Bilderbergut, Grinspani, duhej të lëshonte deklaratat e tij. Çdo herë zbulonte se spekulatorët e mëdhenj ose shisnin, ose blinin në masë aksione dhe tituj të një tipi të veçantë tre ditë para se Grinspani të fliste. Dhe deklaratat e lëshuara nga Grinspani, çdo herë, kanë pasur një efekt vendimtar pikërisht mbi ato aksione e mbi ato tituj që Vëllazëria ka blerë ose ka shitur. Nëse doni të dini se çfarë bëjnë tregjet aksionare, shikoni se çfarë shesin e çfarë blejnë familjet dhe shumëkombëshet e Vëllazërisë, që kontrollojnë tregjet. Për të mbajtur lidhjet me "servilët" e kalibrit të Grinspanit dhe me spekulatorët më të mëdhenj si Rotshildët dhe Rokfelerët, shërbejnë financierë "renegatë" si Xhorxh Sorosi (Bil), që mjaftohet të ndjekë urdhërat. Ishte Sorosi ai që përfitoi miliarda, duke sulmuar stërlinën britanike në shtator të vitit 1992, një operacion që i kushtoi popullsisë shuma të pabesueshme parash, pasi ministri i Financave dhe Thesarit u përpoq të mbronte valutën. Por kush ishte ai ministër? Norman Lemonti... Grupi Bilderberg. Sorosi bëri të njëjtën gjë me valutën suedeze dhe përftoi të njëjtin rezultat. Kush ishte në atë kohë kryeministri suedez? Karl Bildti... Grupi Bilderberg. Ishte frika se mund të mbeteshin të izoluar nga ajo lëvizje e Sorosit, ajo që e shtyu pjesën më të madhe të popullit suedez të pranonte hyrjen në Bashkimin Evropian, një gjë për të cilën po ata suedezë sot duken të penduar.

Karrierat e shumë politikanëve janë ngritur në mënyrë marramendëse pasi ata kanë bërë pjesë në takimet e Bilderbergut. Në vitet shtatëdhjetë të 1900-ës karriera e anëtares së Partisë Konservatore Margaret Theçer pësoi një përshpejtim të papritur, pasi ajo filloi të merrte pjesë në takimet e Bilderbergut dhe, në vitin 1979, zgjedhja e saj kryeministre u sigurua nga shpërthimi i skandaleve dhe i grevave, që e futën në krizë qeverinë laburiste. Një vit më pas Ronald Regani dhe Xhorxh Bushi u zgjodhën në Shtëpinë e Bardhë dhe futën saktësisht të njëjtën politikë ekonomike ekstremiste, që Margaret Theçeri ishte duke vënë në zbatim nën emrin "theçerizëm". Nuk ishte fjala aspak për ndonjë theçerizëm, por për zbatimin e Urdhërit të Ditës, duke qenë se përqindjet e interesit u ngritën në nivele të tilla sa ta paralizonin Botën e Tretë dhe ta bënin të arrirë për programin e rikolonizimit nëpërmjet kontrollit financiar. Për më tepër, mania e privatizimit tipike për administratat Theçer-Regan-Bush lejoi që pasuritë e shtetit t`u jepeshin shumëkombësheve me çmime qesharake. Kur Theçeri nuk ishte më e nevojshme, u shkarkua, pasi të gjithë janë të sakrifikueshëm për të mirën e çështjes. Në vitin 1991, një guvernator i Arkansasit praktikisht i panjohur, që mbante emrin Bill Klinton, u dërgua nga David Rokfeleri në takimin e Bilderbergut, i cili u mbajt në Baden-Baden të Gjermanisë. Një vit më pas, ky njeri me gjak mbretëror

britanik (Fisnikëria e Zezë), u bë president i Shteteve të Bashkuara. Në vitin 1993, në Britaninë e Madhe, një zëdhënës i ministrisë së Brendshme, një laburist me emrin Toni Bler, u dërgua në takimin e Bilderbergut të Vouliagmentit, në Greqi dhe, një vit më pas, pas vdekjes së papritur e të papandehur të liderit laburist Xhon Smith, Bleri u bë kryetar i partisë. Që nga ai çast, një sërë skandalesh e konfliktesh e minuan besueshmërinë e Xhon Mejxhërit, duke e bërë të sigurtë e dërrmuese fitoren e Blerit në zgjedhjet politike të vitit 1997. Gjatë një turi konferencash, që mbajta në Australi në muajt e parë të vitit 1997, parashikova jo vetëm që Bleri do të ishte zgjedhur kryeministër, por edhe që zgjedhjet do të ishin mbajtur më 1 maj, sepse në lashtësi ajo ishte një ditë shumë e rëndësishme për Vëllazërinë Babilonase. Një shembull për këtë janë ritet e pjellorisë të Ditës së Verës, ashtu sikurse edhe kremtimet e Një Majit në atë shtet të krijuar nga Vëllazëria, siç ishte Bashkimi Sovjetik. Mendjendriturit Bavarezë ishin themeluar zyrtarisht më 1 maj 1776. Toni Bler ishte një njeri fasadë aq shumë i rëndësishëm për Vëllazërinë, sa që unë isha i sigurtë se do të ishte çuar në pushtet më 1 maj. Në Britaninë e Madhe qeveritë nuk janë me mandat të caktuar, kryeministri mund t`i thërrasë zgjedhjet kur dëshiron në harkun e mandatit të vet pesëvjeçar dhe është ai që e njofton datën e tyre zyrtarisht. Çfarë bëri Xhon Mejxhëri? Sipas udhëzimeve të elitës, shpalli zgjedhjet e përgjithshme më 1997, duke caktuar datën 1 maj dhe Toni Bler, njëri prej favoritëve të Vëllazërisë, u zgjodh kryeministër pikërisht atë ditë. Nga çasti kur morën pushtetin, Bleri dhe Kancelari i tij i Bilderbergut, Gordon Brauni, filluan të zbatonin Urdhërin e Ditës të parashikuar për vitet e fundit të mijëvjeçarit. Ai parashikonte që qeveria ta lëshonte pushtetin për të caktuar përqindjet e interesit ndaj Bankës së Anglisë, një lëvizje që u realizua disa ditë pas zgjedhjeve. Politikat ekonomike të përshtatura nga anëtari i Bilderbergut Brauni nuk ndryshonin në thelb nga ato të Kancelarit të mëparshëm konservator, Kenet Klarkut, që Brauni zëvendësoi. Ky fakt nuk të befason, pasi edhe Klarku bën pjesë në Grupin Bilderberg dhe ka marrë pjesë me Toni Blerin në takimin e Greqisë dhe, edhe në Turnberi të Skocisë, në maj 1997. Një shërbëtor servil laburist i Vëllazërisë shkon të zëvendësojë një shërbëtor servil konservator të Vëllazërisë si administrator zyrtar i financave të kombit dhe e vetmja gjë që ndryshon është emri që shfaqet mbi derë. Britania e Madhe, ashtu si Amerika dhe praktikisht si çdo vend tjetër i botës, është një shtet me një parti të vetme, ndërsa opinioni publik vazhdon të besojë se është i lirë, sepse në çdo pesë vjet ka të drejtën të bëjë një kryq mbi një fletë letre dhe të dërgojë në qeverinë e vendit të vet një tjetër kukull të manovruar nga

Vëllazëria. Në Shtetet e Bashkuara, cuditërisht, përdoret votimi elektronik dhe kjo e bën më të lehtë çdo manipulim.

Toni Bler u bë menjëherë mik i Bill Klintonit (CFR, TC, Bil) dhe të dy filluan të flisnin me një zë të vetëm (atë të Vëllazërisë). "Mbikëqyrësi" i Blerit në qeverinë laburiste ka qenë Piter Mendelsoni (RIIA), i mbiquajtur Princi i Errësirës. Është fjala për njërin prej ndërmjetësve më të rëndësishëm brenda Partisë Laburiste, që vazhdon të jetë i tillë, pavarësisht dorëheqjes së tij nga qeveria, si pasojë e një skandali financiar. Pa shihni, pikërisht në vitet tetëdhjetë të 1900-ës, kur Piter Mendelsoni u ngarkua të merrej me imazhin e Partisë Laburiste, ndodhi që u vendos të hiqej nga kjo parti simboli i flamurit të kuq në favor të simbolit klasik të Vëllazërisë... trëndafilit të kuq. Kancelari gjerman Kohl është një anëtar i Bilderbergut, sikurse kanë qenë edhe paraardhësit e tij, Brandi e Shmidi. Shumë kryeministra e politikanë të rangut të parë të Vendeve të Ulëta, përfshirë Rud Lubersin, janë anëtarë të Bilderbergut dhe e njëjta gjë ndodh në pjesën tjetër të Evropës me persona si Karl Bildi dhe kryeministrin e vrarë suedez Olof Palmin, Ufe Eleman-Jansonin dhe Rit Bjergegardin (Danimarkë). Zhak Santeri, kreu i Komisionit Evropian, është një anëtar i Bilderbergut. Ai është zëri publik më i rëndësishëm i Bashkimit Evropian dhe e udhëheq diktaturën e tij të centralizuar me arrogancën e pabesueshme që anëtarët e Vëllazërisë manifestojnë hapur. Familjet mbretërore evropiane që marrin pjesë në takimet e Bilderbergut janë ato hollandeze, suedeze, spanjolle e britanike; do të ishte më mirë të thuhej se bëhet fjalë për një familje të vetme të madhe. Lordi Mountbaten, princi Filip dhe princi Karl kanë marrë pjesë në takimet e Bilderbergut.

"Tutorët e paqes"

Emrat që u jepen organizatave të Vëllazërisë kanë përherë një kuptim të kundërt në krahasim me atë të mirëfilltë. Fondacioni Karnige për Paqen Ndërkombëtare intrigon për të bërë të mundur shpërthimin e luftërave dhe "Frontet demokratike" të shpërndara nëpër të gjithë botën përhapin në fakt diktaturat. E njëjta gjë mund të thuhet për "tutorët e paqes" dhe për "negociatorët e paqes". Henri Kisingeri sillet nëpër botë për të folur për "paqe" e, megjithatë, sapo largohet nga një vend, ja ku shpërthen ferri. Kjo ndodh jo për shkak se ai është një paqësor i keq, por vetëm për shkak se ai është duke kryer detyrën e tij në favor të Vëllazërisë. Ndërrmarrja e tij, *Kissinger Associates* (drejtor themelues Lordi Karrington (RIIA, Bil, TC)) ishte fort përgjegjëse për fillimin e luftës në Bosnje, që e shndërroi botën në një ushtri globale nën kontrollin e NATO-s. Kjo është një temë që përsëritet herë pas here. Fillon

luftën dhe pastaj negocion "paqen" për të realizuar Urdhërin tënd të Ditës. Në fillim të konfliktit në Bosnje, *status quo*-ja ishte e siguruar nga Forca e Paqes e Kombeve të Bashkuara. Por ajo u pikturua me qëllim si e paefektshme dhe, përballë imazheve të llahtarshme që dilnin nga ekrani çdo mbrëmje, ulërima e protestës globale ishte: "Duhet bërë diçka, nuk mund të vazhdohet kështu, tani çfarë do të bëjnë?". Ajo "diçka", e ofruar nga po ata njerëz që kishin ideuar luftën, ishte një ushtri botërore e NATO-s së fortë me 60.000 njerëz, forca më e madhe shumëkombëshe e bërë bashkë ndonjëherë që nga Lufta e Dytë Botërore. Dhe pikërisht në këto rrethana rrjeti i Tavolinës së Rrumbullakët mund të përdoret për të garantuar se janë emëruar njerëzit e duhur. Negociatori i parë i paqes i emëruar nga Bashkimi Evropian në Bosnje ishte, po pikërisht ai, Lordi Karrington, president i Grupit Bilderberg, president i Institutit Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare (RIIA), anëtar i Komisionit Tripalësh (TC) dhe anëtar i Komitetit të 300-ve (Kom 300). Ai u zëvendësua nga Lordi David Ouen (Bil, TC) dhe Karl Bildi (Bil), ish kryeministri suedez. Negociatorët e emëruar nga Kombet e Bashkuara ishin Sirus Vansi (Bil, CFR, TC) dhe norvegjezi Thorvald Stoltenberg (Bil, TC). Kur negociatat e tyre nuk arritën asgjë, ja ku del në skenë një negociator i "pavarur", Xhimi Karteri, presidenti i parë i Komisionit Tripalësh (TC) të Shteteve të Bashkuara, përveçse anëtar i CFR-së. Ulërima "bëni diçka" u bë edhe më e fortë kur llahtaritë e Bosnjes vazhduan të pashqetësuara dhe atëherë arriti Riçard Hollbruku (CFR, TC, Bil), i dërguari i paqes i Bill Klintonit, që negocjoi Marrëveshjen e Dejtonit, nëpërmjet së cilës u vendos futja e ushtrisë botërore të NATO-s në Bosnje. Hollbruku varej drejtpërdrejt nga sekretari i atëhershëm i shtetit, Uorren Kristoferi (CFR, TC), dhe nga ministri i Mbrojtjes, Uiliam Perri (Bil). Këta i raportonin presidentit Bill Klinton (CFR, TC, Bil), i cili ndiqte urdhërat e David Rokfelerit dhe të Henri Kisingerit, që ishin shtyllat mbajtëse të CFR-së, TC-së, Bil-it dhe RIIA-s. Kreu i parë i ushtrisë botërore të NATO-s në Bosnje ishte admirali Lejgton Smith (CFR), ndërsa sektori civil i operacionit kontrollohej nga Karl Bildi (Bil). Oh, po, ambasadori amerikan në ish Jugosllavi ishte Uorren Zimermani (CFR). Përveç kësaj, financieri Xhorxh Soros (Bil) zotëronte, pa shihni, një sërë "fondacionesh" të përjashtuara nga taksat në të gjithë ish Jugosllavinë, përpara dhe gjatë luftës. Por bëhet fjalë vetëm për një përkim të rastësishëm, asgjë më shumë! Ky është njëri prej shembujve të teknikave e të organizatave të përdorura për të ndryshuar botën, të gjitha të bazuara mbi luftën. Problem-reagim-zgjidhje. Disa prej emrave prapa Grupit Bilderberg dhe prapa këtij rrjeti më të gjerë janë mjaft të njohur: është fjala për Rotshildët, për David Rokfelerin, për

Henri Kisingerin dhe për Lord Karringtonin. Kam shkruajtur më parë shumë për Rotshildët, por është e rëndësishme të njihni edhe të tjerët.

Nuk janë tamam vërtet krerët e piramidës, por, në nivelin operativ, zënë nivelin më të lartë:

David Rokfeleri (CFR, TC, Bil, RIIA, Kom 300)

Rokfelerët (emri origjinal i të cilëve ishte Rokenfelder) u bënë familja më e rëndësishme e Shteteve të Bashkuara me ndihmën e parave të Rotshildëve dhe, pa dyshim, edhe falë mbështetjeve të tjera. Manipulimi i Shteteve të Bashkuara dhe, më në përgjithësi, i botës, ka parë të përfshirë shumë Rokfelerë, si Xh.D. Rokfelerin, Nelson Rokfelerin, Uintrop Rokfelerin, Laurenc Rokfelerin, ose më të famshmin e shekullit XX, David Rokfelerin. Sikur familja Rokfeler dhe degët e saj të ndryshme të mos kishin ekzistuar kurrë, Shtetet e Bashkuara sot do të ishin një vend shumë i ndryshëm: një tokë me shumë më tepër liri nga sa gëzon aktualisht, sikurse edhe pjesa tjetër e botës. David Rokfeleri, për një kohë të gjatë drejtor i *Chase Manhattan Bank*-ës dhe edhe sot e kësaj dite në atë detyrë ndonëse jo zyrtarisht, ka qenë sekretar i grupit të studimit të Këshillit mbi Marrëdhëniet e Jashtme që formuloi Planin Marshall, për rindërtimin evropian pas Luftës së Dytë Botërore. Fondet e Planit Marshall u përdorën për të nxitur krijimin e Bashkimit Evropian dhe për të minuar autoritetin e shteteve nacionaliste. Njeriu i ngarkuar për të drejtuar Planin Marshall në Evropë ishte... Avarel Harrimani (Kom 300, Shoqëria e Kafkës dhe e Kockave), që u vendos në rezidencën pariziene të Rotshildëve. David Rokfeleri ka qenë president i Këshillit mbi Marrëdhëniet e Jashtme nga viti 1946 deri në vitin 1953 dhe krijoi Komisionin Tripalësh (TC) nën *leadership*-in e Henri Kisingerit (CFR, TC, Bil, RIIA, Kom 300) dhe të Zbignjev Brzhezhinskit (CFR, TC, Bil). Brzhezhinski ishte profesor në *Columbia University* të themeluar nga Vëllazëria dhe autor i librit *Between Two Ages: America's Role In The Technocronic Era* (Midis dy epokave: roli i Amerikës në erën teknokronike), që pasqyronte pikëpamjen që Vëllazëria kishte për botën. Ai ka qenë këshilltar i Xhimi Karterit mbi sigurinë kombëtare, njeriu që David Rokfeleri e zgjodhi në vitin 1976 si presidentin e parë të Komisionit Tripalësh të Shteteve të Bashkuara. David Rokfeleri është njeriu që qëndron prapa të gjithë presidentëve, sepse kontrollon paratë, mediat dhe politikën, duke u siguruar që të dy kandidatët për presidentë t'i përgjigjen drejtpërdrejt atij. Kjo ishte e vërtetë për Xhorxh Bushin e Bill Klintonin në vitin 1992 dhe për Bob Dolin e Bill Klintonin në vitin 1996. Nëse kontrolloni paratë, mediat dhe lojërat e partive, mund të vendosni kë të dëshironi në

LIBRI

Shtëpinë e Bardhë dhe mund të liroheni prej tij, pavarësisht se nuk i ka mbaruar mandati, nëse kjo i përgjigjet urdhërit tuaj të ditës dhe respekton kohët e programuara për zbatimin e tij. Ja përse kush përfaqëson me të vërtetë interesat e popullit nuk arrin kurrë në majat e politikës. Por kjo nuk ndodh vetëm në Shtetet e Bashkuara. David Rokfeleri ka qenë bankieri dhe manovruesi i Rusisë e i Bashkimit Sovjetik dhe ka udhëzuar e manovruar njerëz si Mikail Gorbaçovi e Boris Jelcini. Gorbaçovi, një zvarranik në gjendje të ndërrojë formë, u përdor nga David Rokfeleri dhe nga Kisingeri për të shpërbërë Bashkimin Sovjetik, duke u dhënë mundësi atyre vendeve të fillonin një proces integrimi në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Jelcini merrte pjesë në takimet e Komisionit Tripalësh para se të bëhej president i Rusisë. Kudo do të gjeni dorën e David Rokfelerit, për shembull, prapa asaj kukullës me emrin Mauric Strong (Bil, Kom 300), milioneri apo miliarderi që ka manipuluar rëndë lëvizjen ambientaliste si drejtori i parë i Agjensisë Ambientaliste të Kombeve të Bashkuara dhe si njeriu më përfaqësues i Samitit mbi Tokën, i mbajtur në Brazil në vitin 1992. Kudo që shkon David Rokfeleri, e ndjek era e qelbur e korrupsionit, e manipulimit dhe e genocidit. Gjë që më kujton dikë tjetër...

Henri Kisingeri (CFR, TC, RIIA, Com 300)

Henri Kisingeri u bë i famshëm në të gjithë botën pas vitit 1968 si sekretar i shtetit dhe si këshilltar i sigurisë kombëtare nën presidencën e Riçard Niksonit, dhe ka qenë i vetmi njeri i historisë amerikane që i ka mbuluar në të njëjtën kohë që të dyja këto detyra. Por shërbimi shumë i madh që Kisingeri i bëri Vëllazërisë Babilonase i përket një periudhe mjaft më të mëparshme dhe vazhdon akoma sot e kësaj dite. Me prejardhje hebraike, ai lindi në Gjermani në vitin 1923 dhe u rrit në vitet e Adolf Hitlerit. Por, në qoftë se Kisingeri është me të vërtetë një "hebre", atëherë përse ka qenë i përfshirë në Planin Paperklip, operacioni i shërbimeve sekrete anglo-amerikane, i cili u dha mundësi nazistëve që kryenin eksperimente gjenetike dhe torturuesve si Jozef Mengele të arratiseshin nga Gjermania në fund të luftës, për të vazhduar të punonin në Shtetet e Bashkuara dhe në Amerikën e Jugut? Sepse as që i bëhej vonë për popullin hebre, ja përse. Për të hebrejtë janë vetëm kafshë, si çdo racë tjetër, përveç racës së tij, domethënë asaj të zvarranikëve. Kisingeri është një satanist, një vrasës i shumëfishtë, një ekspert i kontrollit mendor dhe një foshnjëvrasës. Ai arriti në Shtetet e Bashkuara më 5 shtator të vitit 1938 dhe më pas u bë qytetar i natyralizuar amerikan. Në vitin 1972, agjenti polak i KGB-së Mikail Golenjevski i tha qeverisë britanike se dokumenta të KGB-së, që i kishte parë para arratisjes së tij në vitin 1959, citonin emrin e Henri Kisingerit si agjent të Bashkimit Sovjetik. Sipas Golenjevskit,

Kisingeri ishte rekrutuar nga KGB-ja në një celulë spiunazhi të quajtur ADRA dhe iu caktua emri i koduar BOR, ose koloneli BOR. E fitoi "emrin" e vet në Harvard dhe prej këtej filloi ngjitja e tij në karrierë. Kisingeri ka qenë njeriu prapa të gjithë presidentëve duke nisur nga Niksoni, edhe pse nuk ka qenë kurrë zyrtarisht i përfshirë.

Ishte ai që e organizoi skandalin e Uotergejtit, që çoi në dorëheqjen e Niksonit dhe në emërimin e Xherald Fordit (CFR, Bil) si president i Shteteve të Bashkuara dhe të Nelson Rokfelerit, mikut dhe këshilltarit të Kisingerit, si zëvendëspresident. Ishte Nelson Rokfeleri ai që e kishte këshilluar Niksonin ta emëronte menjëherë Kisingerin. Skandali i Uotergejtit u zbulua nga gazetarët Vudvud e Bernshtajn të gazetës *Washington Post*, një gazetë në pronësi të mikeshës së Kisingerit, Katerinë Grahamit (CFR, TC, Bil). Kam njohur një shkencëtar të detyruar të punonte për Vëllazërinë kundër dëshirës së tij, i cili qe ftuar në një takim në Shtëpinë e Bardhë gjatë administratës së Bushit (1988-1992). Kishte mbetur i befasuar tek kishte parë Kisingerin në Zyrën Ovale që shprehte mendime të prera mbi atë çka duhej bërë, ndërsa Bushi rrinte ulur dhe pohonte me kokë. Për opinionin publik amerikan, Kisingeri nuk kishte detyra zyrtare në administratën e Bushit e, megjithatë, ishte atje duke komanduar. Diplomacia "ndërmjetësuese" qëndronte, dhe qëndron akoma sot, në dhënien e një paraqitjeje jo të vërtetë të kundërshtarit, duke shpërthyer kështu njërën luftë pas tjetrës. Në vitin 1973, Kisingerit iu akordua Çmimi Nobel për paqen sepse i dha fund luftës së Jom Kipurit, të cilën kishte ndihmuar për të shpërthyer pikërisht ai vetë. Kur Kisingeri dhe Karringtoni arrijnë në vendin tuaj, atëherë ju bëhet mirë të shkoni me pushime, sepse, normalisht, sapo largohen, shpërthen ferri. Pyetni popullsitë e Burundit dhe të Ruandës...

Kur Xhorxh Bushi u bë president në vitin 1988, emëroi dy drejtues të shoqërisë *Kissinger Associates* në përbërje të administratës së tij. Brent Skoukrofti, kreu i zyrës së Uashingtonit të kësaj shoqërie, u bë drejtor i Këshillit Kombëtar të Sigurisë dhe, Laurenc Igëllburgeri, president i *Kissinger Associates*, u bë nënsekretar i Departamentit të Shtetit. Sikurse e kam thënë, *Kissinger Associates* është përgjegjëse për luftën në Bosnje dhe negociatori i parë i "paqes" i emëruar nga Bashkimi Evropian ishte Lordi Karrington, drejtor dhe bashkëthemelues i *Kissinger Associates*. Kjo ndërmarrje rezultoi me rëndësi themelore edhe në rastin e luftës së Gjirit, sepse i dha huara Irakut nëpërmjet Bankës Kombëtare të Punës (BNL) në vitin 1984, duke i dhënë mundësi kështu Sadam Huseinit të financonte blerjen e armatimeve nëpërmjet një filiali ndihmës gjysmë të njohur të *Fiat*-it, gjigantit italian të automobilit të Xhovani Anjelit, anëtar i Bilderbergut dhe i Fisnikërisë së Zezë. Çarls Barleta, ish hetues

i ministrisë së Drejtësisë, është cituar në lidhje me këtë nga gazeta *Sportlight* më 9 nëntor të vitit 1992 në Uashington. Ja çfarë thoshte gazeta:

"Barleta ka shtuar se hetuesit federalë kishin mbledhur duzina me dëshmi akuzuese në dëm të shoqërisë së Kisingerit. Por Henri Kisingeri duket se gëzon një tip të veçantë imuniteti. Nuk di se si ia bën, por Kisingeri ushtron sot po aq shumë pushtet kundrejt zyrave të sigurisë kombëtare të Uashingtonit, saç ushtronte edhe në kohërat kur ishte cari i politikës së jashtme të administratës së Niksonit. Ai merr lavdërimet, të tjerët marrin kritikat. Kisingeri do të mbetet i pacënuar gjersa Kongresi të mos ketë gjetur guximin të shpallë një hetim ashtu siç duhet mbi këtë manipulues të kalitur".

Kisingeri vepron në nivelet më të larta të Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare (RIIA), të Grupit të Bilderbergut (Bil), të Komisionit Tripalësh (TC), të Këshillit mbi Marrëdhëniet e Jashtme (CFR) e të Klubit të Romës dhe është anëtar i Lozhës së Madhë Alpine të masonerisë në Zvicër, që kontrollonte Lozhën e famshme terroriste italiane e njohur si P2. Bota nuk do të jetë e sigurtë gjersa ky njeri është me këmbë të lira. Një tjetër prej "specialiteteve" të tij është genocidi në Botën e Tretë, për të zvogëluar në mënyrë drastike numrin e fytyrave jo të bardha dhe për të eleminuar nga raca e bardhë ata individë të quajtur prej race më të ulët. Ky program vihet në zbatim nëpërmjet përhapjes së urisë, sëmundjeve (përfshirë ato të krijuara në laborator), luftës, sterilizimit dhe "kontrollit të popullsisë".

Karringtoni (RIIA, TC, BIL, Kom 300)

Piter Rupert Karringtoni i përket një familjeje bankierësh dhe është shumë afër Kisingerit. Janë ata të dy që ushtrojnë në masë të barabartë manipulimin global. Karringtoni ka qenë në këshillin administrativ të *Hambros Bank* (si përfaqësues i Kom 300), e cila ishte e lidhur me skandalin italian të Lozhës masonike P2 të Mikele Sindonës. Lozha masonike elitare P2, e kontrolluar nga fashisti musolinian Licio Xheli, ka qenë frymëzuesja e atentateve terroriste të Brigadave të Kuqe në vitet shtatëdhjetë të 1900-ës, përgjegjëse të shkretimit në stacionin hekurudhor të Bolonjës dhe të vrasjes së liderit politik Aldo Moro, që nuk kishte pranuar urdhërin e dërguar nga Henri Kisingeri, për të ndryshuar kursin e politikës së tij. P2-ja dhe Mikele Sindona, i lidhur me *Hambros* dhe me Karringtonin, qenë përfshirë edhe në kontrollin e Bankës së Vatikanit.

Një tjetër viktimë ishte masoni italian i P2-së, përveçse bankier, Roberto

Kalvi, i varur poshtë urës së Blejkfriarsit afër *Sitit* të Londrës në vitin 1982, pasi skandali kishte dalë në publik. Të tjera interesa financiare të Karringtonit lidheshin me të tjerë emra të njohur si *Rio Tinto Zinc, Barclas Bank, Cadbury Schweppes, Amalgamated Metal, British Metal,* shtëpia e ankandit *Christie* dhe presidenca e *Australian New Zealand Bank*. Në librin e tij *The English Rothschild* (Rotshildët anglezë), Riçard Devis thotë se Lionel Rotshildi ishte një frekuentues i rregullt i shtëpisë së Karringtonit në Vhithall. Të dy familjet janë lidhur në krushqi falë martesës së kontit të Rosburit me Hana Rotshildin, e bija e Majerit, e ndodhur në vitin 1878. Gjatë ceremonisë nusja u shoqërua në altar nga kryeministri Dizrael. Karringtoni, pra, i përket fisit zvarranik aristokrat të Rotshildëve të Britanisë së Madhe.

Ai shpreh prejardhjen dhe sjelljen e përkryer të një manipuluesi të Vëllazërisë, nga e cila ka marrë shumë emërime.

Ka qenë Karringtoni në rolin e ministrit të Jshtëm britanik ai që bëri të mundur kalimin e pushtetit në Rodezi nga qeveria e pakicës së bardhë e Ian Smithit tek diktatori me ngjyrë Robert Mugabe, dhe gjërat u përkeqësuan, sigurisht nuk u përmirësuan, për popullsinë, pikërisht siç ishte parashikuar. Ishte Karringtoni që dha dorëheqjen nga detyra e ministrit të Jashtëm për shkak të "gabimeve" të kryera prej tij, që çuan në luftën e ishujve Folkland të vitit 1982.

Të vjen të mendosh se, pas atyre gabimeve, ka qëndruar larg nga çështjet ushtarake, por nuk është kështu, duke qenë se nga viti 1984 deri në vitin 1988 ka qenë sekretar i përgjithshëm i NATO-s dhe, në vitin 1991, u bë president i Grupit Bilderberg. Ndërsa mbulonte atë detyrë, u emërua negociatori i parë për "paqen" në Bosnje.

Kontrolli i mediave

Emrat Rotshild, Rokfeler, Kisinger e Karrington shfaqen në këshillat administrative e midis "këshilltarëve" të shumëkombësheve të mediave dhe kjo nuk të çudit. Për të kontrolluar njerëzimin nëpërmjet mendjes dhe emocioneve, mjafton të kontrollosh mediat. Pa këto është e pamundur. Kjo është bërë shumë më e lehtë nga fakti se pjesa dërrmuese e gazetarëve të të gjithë botës, përfshirë të ashtuquajturit "emra të mëdhenj" të çdo vendi, janë ose agjentë të Vëllazërisë (pakica e vogël), ose nuk dinë asgjë për atë që ndodh në botë. Unë kam punuar si gazetar dhe kështu që kam qenë në kontakt me të dy këto grupe gazetarësh dhe, ajo që quhet industri e komunikacioneve, përbëhet në realitet nga ca të verbër (gazetarët) që drejtojnë të tjerë të verbër (lexuesit dhe spektatorët). Përvoja ime si gazetar dhe si objektiv i gazetarëve,

LIBRI 24

më ka treguar shumë qartë se sa pak qeliza cerebrale janë të nevojshme për të bërë atë punë. Çdo ditë nëpër stacionet televizive të të gjithë botës gazetarët e ndryshëm dhe korrespodentët i japin publikut të tyre versionin zyrtar të fakteve, të cilave u referohen. "Burime të afërta me Shtëpinë e Bardhë pohojnë këtë... kryeministri thotë atë..., FBI-ja deklaron këtë tjetrën...". Në të gjithë karrierën time të gazetarit nuk më kujtohet as edhe një bisedë e vetme në ndonjë redaksi, që të mos i referohej versionit zyrtar të jetës e të botës. Pjesa më e madhe e gazetarëve nuk janë ca manipulues, janë thjesht krejtësisht të painformuar dhe shpesh në mënyrë të pabesueshme arrogantë. Besojnë se, nëse diçka e rëndësishme do të ndodhte me të vërtetë, ata do të viheshin në dijeni si "gazetarë". Në realitet, janë të fundit që i marrin vesh gjërat. Arroganca dhe leshtësia, ai bashkim tipik i aq shumë gazetarëve, është emblematike dhe fort shkatërruese. Shtojini kësaj edhe një dozë të mirë mbylljeje mendore dhe do të kini kuadrin e plotë të situatës. Një intervistues i BBC-së më ka thënë krejt seriozisht se nuk duhet të shqetësohemi për anëtarët e Masonerisë më shumë nga ç'mund të shqetësoheshim për anëtarët e skuadrës lokale të *squash*-it. Dhe nuk jam duke bërë shaka. Unë u kam dhënë shumë gazetarëve zbulime të rëndësishme të asaj që është duke ndodhur realisht, por ata ose i kanë hequr qafe pa i shqyrtuar as provat, ose kanë qeshur me to, gjithmonë pa i shqyrtuar provat. Në muajt e parë të vitit 1997 më kujtohet të kem takuar një njeri në Los Anxheles, që quhej Tejlor, ose diçka e tillë. Punonte për gazetën londineze *The Observer*. I fola për praktikat pedofile të Xhorxh Bushit dhe për trafiqet e tij të narkotikëve. U tregova i gatshëm ta vija në lidhje me disa njerëz që kishin pësuar abuzime nga ana e Bushit. Por çfarë bëri ky "gazetar"? U largua dhe shkruajti një artikull, në të cilin më sulmonte rëndë dhe thoshte edhe se sytë e mi dukeshin të rrëmbushur me gjak. Kjo gjë nuk më befasoi aspak, duke qenë se sapo isha kthyer nga një tur konferencash, që kishte zgjatur dy muaj, në Australi, në Zelandën e Re dhe në Shtetet e Bashkuara. Por si mundet dikush të ndalet mbi gjendjen e syve të një njeriu, kur i është dhënë, sikurse ai vetë e quajti, "lajmi i shekullit"? Mund ta bësh vetëm nëse je një gazetar. Sikurse thotë një shprehje e vjetër: "Nuk do t'ia dalësh ta korruptosh, apo ta manipulosh gazetarin e madh anglez, por duke parë atë që bën pa qenë i korruptuar, nuk ka asnjë arsye ta korruptosh". Natyrisht, edhe midis gazetarëve ka përjashtime dhe persona të respektueshëm, por janë me të vërtetë të rrallë dhe provoni t'i pyesni ata se çfarë u ndodh kor provojnë ta shkruajnë ngjarjen siç është realisht.

Gazetarët u përshtaten qëndrimeve zyrtare dhe shkruajnë versionin zyrtar të jetës. Janë "korrierët" e atyre që zënë nivelet më të larta të piramidës.

Në majë janë bankierët, që japin paratë e nevojshme për të blerë grupet mediatike. Këta bankierë kontrollojnë edhe pjesën më të madhe të industrive e të shoqërive sipërmarrëse dhe, gazetat, televizionet e radiot nuk mund të mbijetojnë pa të ardhurat e vëna në dispozicion nga këta njerëz, në shkëmbim të reklamës. Kërcënimi për të bllokuar reklamën ka bërë të mundur që shumë zbulime të përfundojnë në kosh. Poshtë bankierëve dhe industrialistëve janë "baronët" e mediave, Murdokët, Blejkët, O'Rejllët dhe Pakerët. Këta u nënshtrohen urdhërave të financuesve dhe emërojnë drejtorë të mediave të tyre vetëm ata që u garantojnë se e njëjta linjë politike do të shfaqet në gazetat dhe në kanalet televizive ditë pas dite. Drejtori zgjedh gazetarët, të cilët duhet të përshtaten me të njëjtin orientim që atij i është diktuar. Gazetari i përgjigjet drejtorit të gazetës, drejtori i gazetës i përgjigjet botuesit, dhe botuesi i përgjigjet bankave dhe shumëkombësheve – domethënë, Vëllazërisë.

Këto janë ato që i quajmë "lajme". Na kanë detyruar të besojmë se personalitete të mëdha të botimit si Murdoku, Pakeri e Ted Tërneri e urrejnë njëri-tjetrin. Ndoshta është kështu, ose ndoshta bëhet fjalë vetëm për një perde tymi, por kjo gjë nuk ka rëndësi. Cilido që të jetë prej tyre në krye të një shoqërie çfarëdo, do të vërë gjithmonë në zbatim të njëjtën politikë. Për këtë arsye Vëllazërisë nuk i intereson aspak se cila prej kukullave të veta zotëron një gazetë, sepse politika e saj do të çohet gjithmonë përpara. Nuk janë këta "baronë" ata që ushtrojnë me të vërtetë kontrollin. Ata nuk janë gjë tjetër veçse njerëz fasadë, kaq. Mendoni për Ted Tërnerin, anëtarin e Këshillit mbi Marrdhëniet e Jashtme (CFR), që mendohej se do t'i përshtatej sistemit me *network*-un e tij në rrugë kabllore (*CNN*). Ai ia shiti kanalin e tij *Time Warner*-it, njërës prej kompanive më të mëdha të Vëllazërisë, dhe *CNN*-i shpalos qëndrimet zyrtare orë pas ore. Kur dikush vendos ndershmërisht të ngrejë një kanal televiziv, apo një gazetë, për të zbuluar të vërtetën, ose nuk arrin të marrë reklama e financime, ose kurset e tij aksionare futen në krizë nga shuma të paimagjinueshme parash që bankat, shumëkombëshet dhe kompanitë e sigurimit të Vëllazërisë vënë në lëvizje çdo ditë. Kjo i ekspozon këto ndërmarrje mediatike ndaj rrezikut të një pushtimi armiqësor. Tre kanalet televizive të shteteve të Bshkuara, *CBS*, *ABC* dhe *NBC* kontrollohen nga anëtarë të organizatës së Tavolinës së Rrumbullakët, ashtu sikurse edhe gazetat *Washington Post*, *Los Angeles Times*, *New York Times*, *Wall Street Journal* e shumë të tjera. E njëjta gjë ndodh në të gjitha vendet.

Dy prej grupeve më pak të njohura që ushtrojnë kontroll mbi mediat janë *Hollinger Inc.* dhe gazeta *"Independent"*. Hollinger-i zotëron 68% të gazetave të Kanadasë dhe më shumë se 250 gazeta e revista në të gjithë botën, përfshirë

gazetat më të mëdha amerikane, *Jerusalem Post*-in dhe gazetat e grupit *Telegraph* të Londrës. Kompania *Hollinger* është një fasadë e shërbimeve të fshehta britanike. Gjatë luftës së fundit botërore, një seksion elitar i shërbimeve të fshehta britanike, i quajtur Operacione Ekzekutive Speciale (SOE), krijoi një organizatë fasadë të quajtur *War Supplies Ltd* nën *leadership*-in e dy agjentëve britanikë, Xhorxh Montagu Blejkut dhe Eduard Plunket Tejlorit. Ishte Tejlori ai që shkroi më pas ligjet bankare të Ishujve Bahamas dhe të ishujve Kajman. Pas luftës kjo kompani shërbimesh të fshehta vazhdoi të ekzistonte me emrin *Argus Corporation* dhe, më vonë, mori emrin *Hollinger*. Sot kryesohet nga Konrad Blejku, i biri i spiunit britanik Xhorxh Montagu Blejkut, që e themeloi nga hiçi. Konrad Blejku është anëtar i *sancta sanctorum* të Grupit Bilderberg. I ati i tij ishte i afërt me familjen gangstere të Bronfmanëve që, ashtu si Kenedët, vuri një pasuri të tërë duke tregtuar në mënyrë ilegale pije alkoolike gjatë periudhës së prohibicionizmit, e futur nga vetë Vëllazëria.

Sot Bronfmanët janë titullarë të gjigantit të likernave *Seagrams*, ashtu sikurse edhe të trafiqeve të ndryshme të drogës. Ndërmjet këshilltarëve të kompanisë *Hollinger* figurojnë Henri Kisingeri, Lordi Karrington dhe Edmond de Rotshildi! Gazetat e grupit *Independent* janë në pronësi të miliarderit irlandez dhe të ish lojtarit të regbisë Toni O'Rejlit. Ky grup zotëron gazeta në Irlandë, në Britaninë e Madhe, në Francë, në Portugali, në Meksikë, në Afrikën e Jugut, në Zelandën e Re. Presidenti jugafrikan Nelson Mandela i ka kaluar krishtlindjet e vitit 1993 në shtëpinë e pushimit të O'Rejlit në Nasau, në ishujt Bahamas dhe, menjëherë më pas, irlandezi bleu *Grupin Argus*, zinxhiri më i madh i gazetave të Afrikës së Jugut[4]. Ai grup sot është zëdhënësi i Kongresit Kombëtar Afrikan të Nelson Mandelës (ANC). Që nga viti 1994 deri sot O'Rejli ka blerë 60% të *Grupit Argus*, 43% të botimeve gazetareske britanike, 55% të gazetave provinciale australiane, 25% të gazetave irlandeze dhe 44% të *Wilson and Horton*, grupi më i madh gazetaresk i Zelandës së Re[5]. Ai ka interesa të gjera edhe në mjedisin e televizionit kabllor në Irlandë, të radios e të televizionit në Australi e në Zelandën e Re. Gazeta e tij *Sunday Independent* e Irlandës i ka kushtuar një suplement prej tetë faqesh me titullin "Një njeri për të gjitha kontinentet", që përmbante shtatëmbëdhjetë fotografi të tij në shoqëri miqsh si... Henri Kisingeri (Bil, CFR, TC, RIIA, Kom 300), Margaret Theçeri (Bil), Valeri Giskard D'Estanj (Bil) dhe Robert Mugabe. Njëri prej miqve më të ngushtë të O'Rejlit në Irlandë është ish kryeministri Garret Fitcxherald (Bil, TC)[6]. O'Rejli duket se nderon edhe Çurçillin. Miqësia e tij me diktatorin e Zimbabves, Robert Mugaben, filloi kur O'Rejli ishte ende president i kompanisë *Heinz*; akoma sot e kësaj dite Mugabe vendos në kokë një kuti teneqeje, format gjigante, fasulesh *Heinz*, për të argëtuar vizitorët e Pallatit të Presidentit[7].

LIBRI 24

Në vitin 1992, Mugabe u takua me O'Rejlin në rezidencën e tij në kontenë e Kildarit, në Irlandë dhe, këta dy anëtarë të rritur nga jezuitët, kremtuan mesha të kënduara në një kishë mesjetare private të ndërtuar rreth varrit të një kryqëtari (Kalorësi Tempullar)[8]. O'Rejli dhe ortakët e tij që nga ajo kohë kanë blerë 60% të kuotave të *Associated Newspapers* të Zimbvaves (ANZ), me qëllimin për të krijuar nga dita në ditë një gjuhë të re[9].

Urdhëri i Ditës sot

Kontrolli dhe manipulimi i mediave dhe i institucioneve të tjera, që ndikojnë mendimin dhe perceptimin njerëzor, nuk kanë vetëm qëllimin të arrijnë pushtetin për pushtet, por fshehin një tjetër arsye shumë më të rëndësishme. Urdhëri i Ditës parashikon pushtimin e plotë të planetit nga ana e zvarranikëve, pa arritur ta vërë re askush atë që ka ndodhur. Dhe pas pak ky objektiv do të jetë arritur, nëse njerëzit nuk zgjohen. Struktura qendrore bazohet tek një qeveri botërore, e cila do të marrë të gjitha vendimet më të rëndësishme në nivel global (shih ***Figurën 27***).




Figura 27 – *(QEVERIA BOTËRORE (Bankë qendrore-Valutë e vetme; Ushtri botërore; Populli e pajisur me mikroship) – **Bashkimi Evropian** (i prejardhur nga EEC) – **Bashkimi Amerikan** (i prejardhur nga Nafta) – **Bashkimi i Paqësorit** (i prejardhur nga APEC) – **Shtete nacionale dhe rajone** – **POPULLI**)* – Struktura e Vëllazërisë Babilonase është duke u zgjeruar në mijëvjeçarin e ri.

Ajo do të kontrollonte një bankë qendrore botërore, një valutë të vetme (elektronike, pa kartëmonedha) dhe një ushtri botërore. E gjitha kjo do të mbështetej nga një popullsi e pajisur me mikroshipë, të lidhur me një kompiuter global. Do të ishin pjesë e kësaj strukture tre supershtete: Bashkimi Evropian, Bashkimi Amerikan dhe Bashkimi i Paqësorit (Azia, Lindja e Largët, Australia).

Kjo strukturë pushteti do të përcaktonte politikën e shteteve të veçanta nacionale, që është parashikuar të jenë të fraksionuar në rajone, në mënyrë për të bllokuar çdo mundësi reagimi të përbashkët kundrejt strukturës që përshkrova. Me pak fjalë, do të ishte fjala për një diktaturë fashiste globale dhe jemi shumë afër kësaj mundësie, në qoftë se nuk do të ketë një revolucion mendimi nga ana e masës së gjinisë njerëzore. Rrjeti që kam përshkruar në mënyrë sintetike në këtë kapitull lejon realizimin e këtij Urdhëri të Ditës, sepse ka agjentë të Vëllazërisë, të cilët veprojnë brenda të gjitha grupeve politike e ekonomike të nevojshme për të bërë të mundur që kjo të ndodhë. Sa më shumë probleme globale të mund të krijohen, aq më i madh do të jetë presioni për zgjidhje globale – domethënë, për një kontroll të centralizuar.

Faza e dytë, "bashkimi" i supershteteve, është tashmë në një shkallë të mirë ecurije.

"Bashkimet" e supershteteve

Bashkimi Evropian, me bankën e tij qendrore dhe me monedhën e vetme, e ka prejardhjen nga një zonë e shkëmbimit të lirë i quajtur Komuniteti Ekonomik Evropian, ose Tregu i Përbashkët. Në kohën kur hymë për të bërë pjesë në të, askush nuk foli për supershtet, por ky ka qenë gjithmonë objektivi përfundimtar që na është propozuar për ta arritur nëpërmjet një afrimi të shkallëzuar: të shkonim drejt qëllimit të fundit hap pas hapi, pa i dhënë mundësi shumicës të kuptojë se ku janë duke na çuar ato hapa. Sikur Adolf Hitleri ta kishte fituar luftën, do të kishte pasur një plan ekonomik për ta realizuar në Evropë, të cilin e quante *Europäische Wirtschaft/Gemeinschaft*. E përkthyer, kjo do të thotë... Komuniteti Ekonomik Evropian! Hitleri e humbi luftën, të paktën në letër, por ajo politikë sidoqoftë mbeti, sepse ishte parashikuar nga Urdhëri i Ditës. Po t'i bëj një përmbledhje procesit, nëpërmjet të cilit u ideua Bashkimi Evropian dhe organizatave të njerëzve që qëndronin prapa tij, do të shikoni në veprim dorën e fshehur dhe do të kuptoni më mirë teknikat e përdorura për të realizuar saktësisht të njëjtin objektiv në Amerikat, në rajonin e Paqësorit dhe në Afrikë. Krijimi i Shteteve të Bashkuara të

Evropës nën kontrollin e centralizuar ka qenë objektivi i Kalorësve Tempullarë në shekujt XI e XII dhe, nën emra e personifikime të ndryshme, po kjo forcë e ka arritur atë objektiv nëpërmjet masonëve, Grupit Bilderberg e të tjerëve. Grupi Bilderberg është veçanërisht i rëndësishëm, megjithatë, në krijimin e supershtetit aktual. Njerëzit përgjegjës të krijimit të Komunitetit Ekonomik Evropian për llogari të Vëllazërisë kanë qenë Zhan Moneti (Kom 300), konti austriak Rikard N. Koudenhove-Kalergi (Kom 300) dhe Jozef Retingeri (Kom 300), një "socialist" polak, i cili ndihmoi princin Bernhard për të krijuar Grupin Bilderberg. Moneti, i biri i një tregtari francez të konjakut, shkoi në Kanada në vitin 1910, ku krijoi lidhje të ngushta me *Hudson Bay Company* dhe Bankën e vëllezërve Lazard. U bë i besuar presidentësh e kryeministrash, përfshirë Franklin Delano Rusveltin dhe, miqtë e tij me ndikim, e ndihmuan të përfitonte një kontratë mjaft të majme për transportin e materialeve nga Kanadaja në Francë gjatë Luftës së Parë Botërore. Kur lufta mbaroi, u emërua brenda Këshillit Suprem Ekonomik të aleatëve e u bë këshilltar i grupit që sillej rreth Lord Milnerit (Tavolina e Rrumbullakët, CFR, Kom 300) dhe kolonel Mandelit (Tavolina e Rrumbullakët, RIIA, Kom 300), i cili ishte duke përgatitur Traktatin e Versajës e po bëhej gati për t'i dhënë jetë Lidhjes së Kombeve. Moneti u emërua nënsekretar i Lidhjes së Kombeve dhe, më pas, zëvendëspresident i një kompanie të quajtur *Transamerica*, pronë e Bankës së Amerikës, që i kushtohej pastrimit të parave të pista. Ai ka qenë një kukull e përkryer e manovruar nga pushtete të tjera me qëllimin për të krijuar Komunitetin Ekonomik Evropian. Konti Rikard N. Koudenhove-Kalergi shkruajti një libër në vitin 1923, në të cilin profetizonte krijimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës. Ai mbante të njëjtin emër pagëzimi të Vagnerit, që Hitleri e kishte përmendur duke thënë se për të kuptuar Gjermaninë naziste duhej të kuptoje Vagnerin. Një mik i ngushtë i të atit të kontit ka qenë Teodor Herzli, themeluesi i sionizmit (kultit të Diellit). Libri i kontit titullohej *Pan Europa* dhe ai bëri çmos edhe për të krijuar Bashkimin Panevropian, me degëzime pikërisht brenda kontinentit evropian, me mbështetjen e politikanëve evropianë më të spikatur dhe të *establishment*-it anglo-amerikan, në të cilin bënin pjesë edhe koloneli Mandel Hauz e Herbert Huveri. Ja çfarë thotë konti në autobiografinë e tij:

"Në fillim të vitit 1924 morëm një telefonatë nga ana e baronit Luis de Rotshild; njëri prej miqve të tij, hamburgasi Maks Varburgu (bankieri i Hitlerit), *kishte lexuar librin tim dhe dëshironte të njiheshim. Për çudinë time të madhe* (sigurisht), *Varburgu na ofroi vetë 60.000 marka ari për të subvencionuar lëvizjen në tre vitet*

e para... Maks Varburgu, që ishte një nga njerëzit më të mënçur e më të shquar që më kishte qëlluar të takoja ndonjëherë, u tregua i gatshëm t`i financonte këto lëvizje. Gjatë gjithë jetës tregoi një interes të sinqertë për Panevropën. Në vitin 1925, Maks Varburgu organizoi udhëtimin e tij në Shtetet e Bashkuara, për të më njohur me Pol Varburgun dhe me Bernard Barushin"[10].

Komuniteti Evropian, sot Bashkimi Evropian, është një tjetër krijim i Vëllazërisë, që shehë të përfshirë të gjithë emrat tashmë të njohur. Uinston Çurçilli (Kom 300) ishte një përkrahës i supershtetit evropian dhe në vitin 1930 shkruajti një artikull për gazetën amerikane *The Saturday Evening Post*, të titulluar "Shtetet e Bashkuara të Evropës". Disa vjet më vonë do të luante rolin e tij në nxitjen e luftës, e cila çoi pikërisht në krijimin e asaj strukture. Konti Koudenhove-Kalergi u mbështet në mënyrë entuziaste nga njerëz si Xhon Foster Dallesi, Nikolas Murreji Batleri, president i *Columbia University* dhe i Fondacionit Karnige për Paqen ("Luftën") Ndërkombëtare dhe doktor Stefan Degani, themelues dhe president i parë i *Institute of Education*, i kontrolluar në 100% nga Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme (CFR). Kongresi i Shteteve të Bashkuara miratoi shtatë rezoluta mbi bashkimin politik të Evropës dhe në njërën prej tyre thuhej: "Krijimi i një Evrope të bashkuar duhet të konsiderohet si një hap thelbësor drejt krijimit të një Bote të Bashkuar (qeverie botërore)". Zhan Moneti drejtoi edhe Komitetin për Shtetet e Bashkuara të Evropës, që i ishte caktuar i njëjti qëllim. Që nga çasti i krijimit të tij, Komuniteti Ekonomik Evropian (EEC) ka pësuar transformimet e parashikuara, sipas metodës shkallë-shkallë, drejt atij shteti fashist të centralizuar, i cili ka qenë gjithmonë qëllimi i fundit i themeluesve të tij. Dy admirues të Monetit, Merri dhe Serge Brombergeri, e kanë paraqitur këtë plan në librin *Jean Monnet And The United States Of Europe*:

"Mendohej se organizmat mbinacionale, të drejtuara nga Këshilli i Ministrave Evropian i Brukselit dhe nga Asamblea e Strasburgut, do të administronin gradualisht të gjitha veprimtaritë e kontinentit. Herët a vonë qeveritë do të ishin detyruar të pranonin se një Evropë e integruar ishte një realitet i kryer, pa mundur të ndërhynin në përcaktimin e parimeve të saj themeluese. Gjithçka që do t`u ishte dashur të bënin, ishte që t`i shkrinin të gjitha këto institucione të pavarura në një administratë të vetme federale dhe mandej të shpallnin Shtetet e Bashkuara të Evropës"[11].

LIBRI 24

Dhe sot gjendemi pikërisht në këtë pikë. Mund të shikoni prapë edhe një herë një strukturë, brenda së cilës një qendër e formuar nga një pakicë e vogël përcakton e vendos planin e përgjithshëm dhe përhap në çdo vend një sërë organizmash të lidhura me njëra-tjetrën, duke e shtyrë popullsinë, nëpërmjet manipulimit, të ndjekë Urdhërin e përgjithshëm të Ditës. Dy kryeministrat e Britanisë së Madhe para, gjatë dhe pas hyrjes sonë në Komunitetin Evropian ishin laburisti Harold Uilsoni (Bil) dhe konservatori Eduard Hethi (Bil, TC). Ata ishin që të dy në miqësi të ngushtë me Lordin Viktor Rotshild dhe Eduard Hethi e zgjodhi Rotshildin në krye të "skuadrës së tij politike" gjatë katër viteve që mbuloi detyrën e kryeministrit, midis viteve 1970-1974. Ndodhi pikërisht në këtë periudhë, saktësisht në vitin 1972, që Eduard Hethi nënshkroi Traktatin e Romës, i cili e kapi Mbretërinë e Bashkuar në kurthin e rrjetës evropiane të Vëllazërisë. I ulur pranë Hethit në ceremoninë e nënshkrimit rrinte ministri i Jashtëm, Alek Duglas Homi (Lordi Hom), president i Grupit Bilderberg dhe anëtar i një familjeje të lashtë skoceze. I gjithë operacioni ishte një manipulim në shkallë të gjerë. Partia Laburiste, "opozita", në kohën e hyrjes sonë në Evropë nën presidencën e Harold Uilsonit (Bil), kishte ndërmjet krerëve të saj Roj Xhenkinsin (Bil, TC, RIIA), që do të bëhej pastaj president i Komisionit Evropian, Xhejms Kallaganin (Bil, RIIA) dhe Denis Halejin (Bil, TC, Kom 300), president i Komisionit të Përkohshëm të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe anëtar i këshillit të Institutit Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare. Haleji ishte i pranishëm në takimin e parë të Bilderbergut në vitin 1954 dhe mori pjesë në më shumë takime se çdo politikan tjetër britanik, në kohën e angazhimit të tij aktiv në politikë. I zotë plaku ynë Denis, njeri i popullit, ë? Më falni një çast. Po në këtë periudhë, krerët e partisë së tretë të Britanisë së Madhe, liberalëve (sot liberalët demokratë), ishin Xho Grimondi (Bil) dhe Xheremi Thorpi, autor i librit *Europe: The Case For Going In* (Evropa: përse të hyjmë në të). Të gjithë këta kishin studiuar në të njëjtën periudhë në Oksford. Uilsoni, Hethi, Xhenkinsi dhe Haleji rrinin gjithmonë bashkë e vrisnin mendjen mbi shakanë e jashtëzakonshme të fatit, që i çoi katër njerëz, të cilët kishin frekuentuar Universitetin e Oksfordit në të njëjtën periudhë, të bëheshin personazhet politike më të spikatura të viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë të shekullit XX, pikërisht teksa Mbretëria e Bashkuar po bëhej gati të hynte në Komunitetin Evropian. Uilsoni (*Jesus College, University College*), Xhenkinsi (*Balliol*), Hethi (*Balliol*), Haleji (*Balliol*), Grimondi (*Balliol*) dhe Thorpi (*Trinity College*), janë shembuj emblematikë se çfarë mund të të ndodhë nëse ke studiuar në Oksford. Fakti që Oksfordi ka qenë gjithmonë një prej qendrave kryesore të Vëllazërisë dhe, së bashku me

Kembrixhin, është një vend i privilegjuar rekrutimi manipuluesish për brezin e ardhshëm, është, natyrisht, një përkim rastësor i pastër!

Gjatë viteve gjashtëdhjetë të 1900-ës Hethi, një zvarranik në gjendje të ndryshonte formë, manipuloi Britaninë e Madhe me qëllim që të hynte në Komunitet. Para se ta çonte Britaninë e Madhe në Evropë, Hethi mori pjesë në një takim në Paris në tetor të vitit 1972, për të negociuar kushtet me presidentin francez Zhorzh Pompidu (Bil), një ish vartës i Gaji Rotshildit. Duglas Hardi ishte ministri i Jashtëm britanik që nënshkroi Traktatin e Mastrikhtit, i cili e shndërroi Komunitetitn Evropian në Bashkim Evropian, një supershtet. Hardi ishte sekretar personal i Ted (Eduard) Hethit nga viti 1968 deri në vitin 1970 dhe sekretari i tij politik nga viti 1970 deri në vitin 1974, kur Hethi ishte kryeministër dhe e bëri Britaninë e Madhe të hynte në Evropë. Hardi ka qenë edhe sekretar shteti nën Lord Karringtonin, në periudhën që i parapriu shpërthimit të luftës së ishujve Folkland dhe ishte Hardi ai që nxiti për t'i dhënë Henri Kisingerit titullin e "nderit" kalorës. Duke nisur që nga ajo kohë, figura politike me ndikim dhe në dukje në fronte të kundërta, si konservatorët Ted (Eduard) Heth (Bil, TC), Kenet Klark (Bil), Xhefri (Lord) Hou (Bil, Kom 300), laburistët Toni Bler (Bil), Gordon Braun (Bil, TC) dhe liderat liberalë demokratë David Stil (Bil, TC) e Padi Ashdaun (Bil), kanë ushtruar gjithmonë e më shumë presione në favor të një gërryerjeje të mëtejshme të pavarësisë së Britanisë së Madhe dhe të shtypjes së lirisë nga ana e një Bashkimi Evropian të centralizuar e burokratik. Bleri e ka mbushur dukshëm skuadrën e tij ministrore, që negocion me Bashkimin Evropian, me njerëz të cilët duan që Mbretëria e Bashkuar të bëjë pjesë në planin e një banke dhe të një monedhe të vetme. Midis këtyre, para se të jepte dorëheqjen më pas për shkak të një skandali financiar, figuronte miku ynë Piter Mendelsoni, njeriu të cilin disa parlamentarë e kanë damkosur si "Princi i Errësirës". Në atë kohë për të cilën po shkruaj, në udhëheqje të tri partive kryesore politike britanike janë Toni Bler (Bil), Uiliam Hajg (Bil) e Padi Ashdaun (Bil).

Janë duke na e hedhur dhe anëtarët e Vëllazërisë, që zënë nivelet më të larta të bankave e të korporatave, janë aktivizuar me qëllim që t'i shtyjnë me anë të terrorit njerëzit të besojnë se, nëse nuk hyjmë në monedhën e përbashkët e në bankën qendrore, do të ndeshemi me një krizë ekonomike. Çfarë budallallëqesh! Norvegjia s'pranoi të hynte në Bashkimin Evropian dhe gëzon një mirëqenie të madhe ekonomike, edhe falë eksporteve në vendet e Bashkimit Evropian! Skenari, që unë kam përshkruar për Evropën, është planifikuar edhe për Amerikat, për rajonin e Paqesorit dhe për Afrikën. Bashkimi

Amerikan duhet të evoluojë nga NAFTA, Marrëveshja Amerikane për Shkëmbimin e Lirë, ndërsa Bashkimi i Paqësorit duhet të lindë nga APEC-u, Kooperimi Ekonomik i Rajoneve të Paqësorit Aziatik, "zona e shkëmbimit të lirë" e krijuar në vitin 1994 pas shumë fushatash të udhëhequra në mbështetje të saj nga ithtarët e Rodit, përveçse prej ish kryeministrit australian, Bob Haukes. NAFTA qe negociuar midis Xhorxh Bushit (CFR, TC, Kafka dhe Kocka); presidentit pedofil të Shteteve të Bashkuara dhe Brian Mulronejit, përdhunuesit të grave me mendjen të kontrolluar, që ishte kryeministër i Kanadasë. Do të ndalem mbi aktivitetin e këtyre dy personazheve në një kapitull të mëpasshëm. Kur nënshkroi marrëveshjen mbi shkëmbimin e lirë me Kanadanë dhe me Meksikën, më 12 gusht 1992, Bushi shprehu urimin që NAFTA të zgjerohej nga pika e skajshme e Amerikës së Veriut deri në pikën e skajshme të Amerikës së Jugut. "Kundërshtari" i tij, Bill Klintoni, tha gjatë një takimi të krerëve të shteteve amerikane të mbajtur më 10 dhjetor 1994:

"Historia u ka dhënë popujve të Amerikës mundësinë që të krijojnë një komunitet kombesh të kushtuar ndaj lirisë dhe mirëqenies... në vitet e para të shekullit të ardhshëm (këtë dëshiroj vërtet ta shoh!)... *një zonë shumë të madhe shkëmbimi të lirë, që të shtrihet nga Alaska në Argjentinë".*

Midis pikave të tjera në Urdhërin e Ditës figurojnë krijimi i një popullsie të pajisur me mikroship; kontrolli i plotë i furnizimeve energjitike, shkatërrimi i çdo forme alternative të mjekësisë, i cili zbulon mashtrimin që qëndron prapa mjekësisë tradicionale; dhe ligjin marcial (të kohës së luftës) global. Do të kthehem mbi këtë pikë para fundit të librit. Shteti me parti të vetme dhe Urdhëri i Ditës i botës së centralizuar vazhdojnë të ecin dhe këtu desha vetëm t'ju jap një ide të njerëzve, të organizatave dhe të fakteve që kam përmendur, pa hyrë në brendi të hollësive të shumta e të gërshetuara.

LIBRI

Kapitulli 14

Nën ndikim

Njëra prej armëve më të fuqishme, e përdorur në luftën e Vëllazërisë kundër njerëzimit në harkun e mijëvjeçarëve, është përfaqësuar nga narkotikët dhe nga drogat. Në shkollat e lashta misterike, drogat përdoreshin gjerësisht për të hyrë në përmasa të ndryshme psiqike dhe për të manipuluar mendimin e perceptimin.

Opiumi, nga i cili rrjedh heroina, është narkotiku më i lashtë që njihet. Disa referime për përdorim të kësaj droge janë gjetur në pllakëzat sumere, që u përkasin sipas gjasës 6.000 vjetëve më parë[1]. Sumerët e quanin "bima e gëzimit"[2]. Përmendet edhe nga egjiptianët e nga grekët përkatësisht rreth viteve 1500 dhe viteve 1000 para Krishtit. Lulekuqja e opiumit bënte aq shumë pjesë në kulturën greke, sa që paraqitej edhe në monedhat e arta[3]. Gjurmë drogash haluçinogjene janë gjetur në varrin e një indiani të Amerikës së Jugut, që i përkiste një periudhe 4.500 vjet më parë dhe në të gjithë botën e lashtë mund të gjenden dokumenta, që dëshmojnë përdorimin e drogave. Haomoa dhe Soma, pijet e shenjta të ithtarëve të Zorathustrës e të hinduve, nxirreshin nga bimët dhe, me shumë gjasë, nga kërpudha *Amanita Muscaria*, që tjetërson gjendjen mendore[4]. Substancat kimike, që ato përmbajnë, kalojnë në urinë, gati pa asnjë humbje force, dhe shkrimet hindu flasin për urinën si për një

LIBRI 24

pije të shenjtë, burim ndriçimi mendor e intuite. Aztekët shfrytëzonin pasurinë halucinogjene të kërpudhës *Psilocybe Mexicana* gjatë ritualeve të tyre të shenjta, duke e quajtur "mish Zoti"[5]. E kam përmendur më parë përdorimin e kërpudhave nga ana e priftërinjve hebrej, tek të cilat u frymëzua pastaj forma e kësulave të tyre. Priftërinjtë ariano-zvarranikë të Babilonisë ishin mjaft të zotë në manipulimin e popullsisë nëpërmjet drogave dhe kjo praktikë është trashëguar tek shoqëritë e fshehta të krijuara prej tyre. Trëndafilkryqëtarët e përhapën përdorimin e narkotikëve dhe, sipas gjasës, Vrasësit e morën emrin nga mënyra me të cilën u drejtoheshin drogave, për të kontrolluar vrasësit e tyre me pagesë. Më shumë se çdo gjë tjetër, drogat janë përdorur nga Vëllazëria në harkun e krejt historisë për t`i shkatërruar shoqëritë, në mënyrë që pastaj të mundeshin t`i pushtonin me lehtësi. Kjo është saktësisht ajo që po ndodh sot në një shkallë më të gjerë. Por kjo politikë nuk është e re. Vetëm shkalla ka ndryshuar. Është e njohur se opiumi ishte arma që përdorën "britanikët" (Vëllazëria Babilonase, e cila e ka selinë në Londër) gjatë luftërave të opiumit kundër Kinës në vitin 1840 dhe në vitin 1858. Përpjekjet kineze për të bllokuar furnizimin me opium në shtetin e tyre u bënë të kota nga fuqia e Perandorisë Britanike. Ministri i Jashtëm Britanik në kohën e mbretëreshës Viktoria dhe gjatë luftërave të opiumit ishte Lordi Palmerston, Patriarku i Madh ose Mjeshtri i Masonerisë së Lindjes së Madhe dhe anëtar i Komitetit të 300-ve. Palmerstonët ishin në fakt familja Temple dhe ky titull i tyre i përket vitit 1723, kur Henri Temple u bë baroni Temple i Mount Temple-s, në kontenë e Sligos, në Irlandë dhe viskont Palmerston i Palmerstonit, në kontenë e Dublinit, tjetër titull fisnikërie irlandez. Temple rrjedh nga "Tempullar". Titulli i kaloi si trashëgim të nipit, edhe ai me emrin Henri, që ishte anëtar i Dhomës së Komuneve britanike për 40 vjet dhe ka qenë ai që zotëronte një tablo të artistit David Teniers, të titulluar *Sant' Antonio e San Paolo*, me përmasën e saj që i referohej gjeometrisë së shenjtë, të cilën studiuesit e kanë lidhur me doreshkrimet e koduara dhe me misteret e Rënelë-Shatosë. Në atë kohë, Temple jetonte në Brodlands të Romsejit, në Hampshir, në atë që pastaj u bë rezidenca e Lordit Luis Mountbaten. Edhe familja Mountbaten e bleu pikturën e Teniersit. Qe djali i dytë i Lordit Palmerston, Henri Xhon Temple, ai që u bë kryeministri legjendar, ministër i Jashtëm dhe trafikant droge për Kurorën Britanike në Kinë. U martua me një grua që i përkiste aristokracisë angleze, domethënë me motrën e Lordit Melburn, i cili kishte qenë kryeministër në fillim të mbretërimit të mbretëreshës Viktoria dhe u bë pastaj kreu i Partisë Liberale, e njohur edhe si Partia Veneciane dhe drejtoi forcat e armatosura britanike gjatë luftës së Krimesë e

luftërave të opiumit kundër Kinës. Hyri në Dhomën e Komuneve për herë të parë si anëtar i Parlamentit për Njuportin, në ishullin Uajt, një emër që përsëritet herë pas here më shpesh nga ç`do të mund ta prisnim, duke qenë se bëhet fjalë për një ishull të vogël të humbur në gjerësinë e brigjeve jugore të Anglisë. Mbretëresha Viktoria dhe princi Albert urdhëruan të ndërtohej Osborn Hauzi në atë ishull, dhe pikërisht aty i kaloi mbretëresha pjesën më të madhe të ditëve pas vdekjes së Albertit. Më pas Lordi Mountbaten u zgjodh guvernator i ishullit. Ishulli Uajt është një qendër e rëndësishme satanike, përveçse është një vend i mrekullueshëm për t`u vizituar. Një tjetër qytet i Vëllazërisë është Edinburgu, në Skoci, jo larg Kishës Roslin të Sinklerëve. Palmerstoni kaloi tre vjet në Edinburg, mysafir i filozofit të Partisë Liberale, profesorit Dugald Stjuart, dhe Universiteti i Edinburgut përbënte hallkën lidhëse ndërmjet Shoqërisë Lunare dhe Çarls Darvinit. I parazgjedhuri prej Vëllazërisë, Toni Bler, i zgjedhur kryeministër më 1 maj 1997, u rrit në Edinburg, ku frekuentoi shkollën private Fetes. I ati i tij ishte një profesor i Universitetit të Edinburgut.

Mjeti për tregtinë e opiumit nga India në Kinë dhe gjetkë ishte Kompania e Indive Lindore, një grup tregtarësh dhe masonësh skocezë, që ishin rreshtuar me qëndrimet e Kalorësve të shën Gjonit të Jeruzalemit (Maltës) dhe të Urdhërit të Jezusit, jezuitëve. Disa kërkues besojnë se padronët e vërtetë të kompanisë ishin familjet e bankierëve të Italisë Veriore, Fisnikërisë së Zezë, në atë kohë me banim në Londër. Strategjia e përdorur nga britanikët në Kinë u bë që prej asaj kohe një model pushtimi nëpërmjet diktatit të drogave. Ata sponsorizuan një varësi në masë ndaj drogave nëpërmjet opiumit, gjersa shoqëria kineze dhe vitaliteti i popullit të saj u bënë copë e thërrime. Qeveria britanike përdori një rrjet terrorizmi dhe krimi të organizuar, si Triadat, *Hong Society* dhe Vrasësit, me qëllim që ta çonin përpara atë tregti për ta. Këto shoqëri të fshehta, që heqin qafe pa pikë mëshire këdo, veçanërisht ata që nuk ndjekin urdhërat e tyre, janë thjesht fije të të njëjtit rrjet global të lidhur me Masonerinë. Bëhet fjalë, prapë edhe një herë, për maska të ndryshme të së njëjtës fytyrë. Tregtia e drogave ka qenë (dhe është) e organizuar nga lozhat e Lindjes së Largët të Masonerisë. Lozha e Madhe e Anglisë (Mjeshtri i Madh aktual i së cilës është kushëriri i mbretëreshës, duka i Kentit) krijoi lozha në Kinë, në Amoi, Kanton, Fushou, Suatou, Kefu, Kinkiang, Hankou, Neukang, Tongshan, Uei-Hai-Uei, dy në Tinstin, tri në Shangai dhe pesë në Hong Kong[6]. Kur qeveritarët kinezë u përpoqën të bllokonin furnizimet me opium, britanikët përdorën fuqinë e tyre ushtarake dhe detare për t'i mundur. Dhe traktati i "paqes" pas konfliktit u garantoi pastaj britanikëve të drejtën

e shtimit të prurjes së opiumit, si dëmshpërblim për opiumin që qeveritarët kinezë u kishin konfiskuar dhe për të pasur sovranitetin mbi portet strategjike e mbi ishujt e përtejdetit. Pikërisht për këtë arsye Hong Kongu përfundoi nën sovranitetin britanik. Ai u përdor si qendër e trafikut të drogës të Lindjes së Largët dhe ky është ende sot e kësaj dite roli i tij, pasi i është rikthyer Kinës. Pjesa më e madhe e arit dhe e transaksioneve mbi tregjet financiare të Hong Kongut janë rezultat i pagesave dhe i riciklimit të parave të nxjerra nga tregtia e drogës.

Traktati i Nankinit i vitit 1842 i dha Britanisë së Madhe kontrollin mbi Hong Kongun, përveç 15 milionë stërlinave argjendi. Ai u përpilua nga masoni dhe ministri kolonial Eduard Baluer-Litoni (Kom 300), shkrimet e të cilit do të frymëzonin pastaj Hitlerin, nazistët dhe disa mistikë të kalibrit të Madamë Blavatskit. Baluer-Litoni ka shkruajtur për forcën *Vril* (forcën e gjarpërit) e pranishme në gjakun e "mbinjerëzve të nëndheshëm". I biri i Baluer-Litonit ishte mëkëmbësmbret i Indisë në periudhën e shkëmbimit më të madh të opiumit midis Indisë dhe Kinës, një periudhë e "shpërfytyruar" nga veprat e Rudiard Kiplingut mbi *Raj*-ët britanikë (trafikantët britanikë të drogës). Në librin *The Opium Klippers* (Velierët e opiumit – përkth.), Basil Luboku jep emrat e pronarëve të anijeve britanike që morën pjesë në tregtinë e opiumit nëpërmjet Kompanisë së Indive Lindore; Xhardin Metjusoni (i familjes skoceze të Kesuikëve, shumë anëtarë të së cilës janë satanistë); *Dent & Co.*; *Pybus Bros*; *Russell & Co.*; *Cama Bros*; dukesha e Atolit; konti i Balkarrasit; mbreti Xhorxh IV (ish princ regjent); markezi i Kamdenit; dhe Ledi Melvil. Ishte paraardhësi i Ledi Melvilit, Xhorxhi, ai që ndihmoi hipjen në fron të Uilliam d`Oranzhit dhe u shpërblye me emërimin Lordi mbajtës i Vulës Private. Kesuikët dhe Xhardin Metjusoni kanë qenë anëtarë të Komitetit të 300-ve. Të tjera familje anglo-amerikane të përfshira në tregtinë e drogës ishin Satherlandët, Baringët dhe Lehmanët, kushërinj të Rotshildëve. Satherlandët, njëra prej familjeve më të rëndësishme kushtuar tregtisë së pambukut e të opiumit në Amerikën Jugore, ishin kushërinj të Metjusonëve dhe familja e bankierëve Baring krijoi kompaninë e lundrimit me avull lindore e gadishullore (të famshmen ndërmarrje britanike të lundrimit *P&O*), për të transportuar opiumin.

Familjet zvarranike britanike bashkëpunuan me të afërmit amerikanë për të zgjeruar tregtinë e opiumit, gjë që vazhdojnë ta bëjnë ende sot e kësaj dite. Familja e Rasëllve i vuri pasuritë e saj shumë të mëdha falë tregtisë së opiumit në shekullin e nëntëmbëdhjetë, nëpërmjet asaj shoqërisë së shitjes së narkotikëve e njohur si *Russell & Company*. Detyra e saj ishte të trasportonte

ilegalisht opiumin nga Turqia në Kinë. Rivalët e tyre të vetëm ishin anëtarët e bandës mafioze të Perkinsve, që e kishte selinë në Boston, të cilët ishin lidhur në krushqi me familje të tjera me prejardhje britanike, që ishin përfshirë në tregtinë e skllevërve. Më pas Rasëllët u zunë vendin me marifet Perkinsve dhe zotëruan bandën e organizuar amerikane të opiumit, në luftë me të tjera familje zvarranike si Kulidxhët dhe Delanot (Kom 300), të cilat "prodhuan" që të dyja presidentë të Shteteve të Bashkuara. President i *Russell & Co.* në Kanton, në kohën kur lulëzonte tregtia e drogës, ishte Uoren Delano junior, gjyshi i presidentit Franklin Delano Rusvelt, me prejardhje nga një familje aristokrate franceze. Në vitin 1986, një histori e tregtisë së drogës në Amerikë, e publikuar në gazetën *US News And World Report*, thoshte: "Për Delanot nuk kishte ndryshim midis shitjes së opiumit dhe tregtisë së pijeve alkolike: që të dyja ishin me leverdi dhe përbënin dy sektorë themelorë të aktivitetit të familjes"[7]. Në këtë kuptim, nuk të çudit fakti që Franklin Delano Rusvelti ishte lidhur në krushqi me Xhorxh Bushin, i cili vazhdon ende të tregtojë drogra në shkallë të gjerë. Të tjerë ortakë të Rasëllit ishin Xhon Kliv Grini, që përdori një pjesë të fitimeve të nxjerra nga opiumi për të financuar *Princeton University*; Abiel Abot Lou, që përdori të njëjtat fitime për të financuar krijimin e *Columbia University*; Xhozef Kulidxhi, i biri i të cilit krijoi shoqërinë e shpërndarjes së drogës, të quajtur *United Fruit Company*. I nipi i tij, Arçibald Keri Kulidxh, qe njëri prej drejtuesve themelues të Këshillit mbi Marrdhëniet e Jashtme (CFR). Rasëllët së bashku me Taftët krijuan Shoqërinë e Kafkës dhe të Kockave dhe flamuri i zi me kafkën e bardhë dhe kockat e kryqëzuara ishte flamuri i pranishëm mbi të gjitha anijet e *Russell Trust Company*. Ai ka qenë edhe flamuri që valëvitej mbi anijet e flotës së Kalorësve Tempullarë. Një tjetër amerikan, që kishte lidhje me tregtinë e opiumit, ishte masoni Xhon Xhakob Astor, themelues i dinastisë Astor, që u bë aksioniste e Kompanisë britanike të Indive Lindore[8]. Filadelfia dhe Bostoni, seli të juridiksionit verior të Ritit Skocez të Masonerisë, ishin (dhe janë) të tjera qendra të tregtisë së opiumit. Një pasardhës i Astorit, Ualdorf Astori i hotelit Waldorf Astoria të Nju Jorkut, ka qenë një mason i nivelit të lartë, që u bë president i Institutit Mbretëror të Çështjeve Ndërkombëtare (RIIA) pas Luftës së Dytë Botërore[9]. RIIA është thellësisht i përfshirë në kordinimin e tregtisë botërore të drogës (shiko librin *Dope Inc.*, i renditur në bibliografi).

Pas Luftës së Dytë të Opiumit, që përfundoi në vitin 1860, bankat britanike dhe kompanitë tregtare themeluan *Hong Kong e Shanghai Corporation* si bankë qendrore të industrisë së drogës të Lindjes së Largët. Duke iu përmbajtur studimeve të lexuara prej meje mbi trafikun e drogës, *Hong Kong and Shanghai*

Bank, me lidhjet e saj në nivel botëror, vazhdon ende sot të jetë një qendër financiare e industrisë së drogës[10]. Që nga koha që Kina e rimori Hong Kongun, *Hong Kong and Shanghai Bank* është bërë *HSBC Holdings*, dhe ajo zotëron *Midland Bank*-ën, njëra prej katër bankave që i kushtohet pastrimit të parave. Kjo bankë e ka impostuar prej një kohë të gjatë reklamën e vet mbi përkufizimin "banka që dëgjon" dhe "banka, së cilës i pëlqen të thotë po". Kushedi sa herë pronarët e saj i kanë thënë "po" propozimit për pastrimin e fitimeve të industrisë së drogës, që është duke shkatërruar jetën e aq shumë njerëzve. *Nugan Hand Bank* (që e ka selinë në Sidnej, Australi) ishte një tjetër organizëm e CIA-Mosadit, e drejtuar nga Frensis Nugani dhe Majkëll Handi, një beretëblertë, përveçse kolonel i ushtrisë amerikane i transferuar në CIA. Handi ka qenë në lidhje të vazhdueshme me Xhorxh Bushin, pas zgjedhjes së këtij të fundit si zëvendëspresident i Shteteve të Bashkuara, sipas asaj që pohon agjenti operativ i CIA-s, Trenton Parkeri[11]. Le të shohim disa prej funksionarëve kryesorë të *Nugan Hand Bank*: ai që mbulonte detyrën e presidentit ishte admirali F. Jets, president dhe kreu i stafit të programimit strategjik të forcave të armatosura amerikane në Azi e në Paqësor gjatë luftës së Vietnamit; gjenerali Edvin F. Blejk, president i filialit të ishujve Hauai, komandant i trupave amerikane në Tailandë gjatë konfliktit në Vietnam; Xhorxh Ferris, operativ në rrethin e filialeve të *Nugan Hand*-it të Uashingtonit dhe Hong Kongut, dhe ekspert i shërbimeve sekrete ushtarake; Bernie Hugtoni, përfaqësues saudit dhe agjent i maskuar i shërbimeve sekrete detare amerikane; Tomas Klajn, i *Nugan Hand*-it të Londrës, përgjegjës i stervitjes së sektorit klandestin të CIA-s, i ngatërruar në çështjen Iran-*Contras* dhe bashkëpunëtor i Majkëll Handit dhe Teodor Shaklejit gjatë luftës në Vietnam; Dejl Holmgrini, i zyrës së Taivanit, drejtor i shërbimeve ajrore në Vietnam në përbërje të aviacionit civil, që më pas u bë kompania e turpshme ajrore e CIA-s, *Air America*; Uolter MekDonald, drejtor i filialit të Anapolisit, në Meriland, ish zëvendësdrejtor i grupit të kërkimeve ekonomike të CIA-s; gjenerali Roi Manor, i filialit të Filipineve, kreu i stafit të Komandës Amerikane të Paqësorit dhe hallka lidhëse midis qeverisë amerikane dhe presidentit Ferdinando Markos; Uiliam Kolbi, avokat (këshilltar juridik) i *Nugan Hand* dhe ish drejtor i CIA-s[12]. Pikërisht njerëzit e përshtatshëm për të drejtuar një bankë, apo jo? Bëhej fjalë në realitet për të satin operacion të tregtisë së drogës. Një drejtor i bankës *Nugan Hand*, Donald Bazleji, ishte edhe president i *City National Bank* të Majamit, që menaxhoi financimet për atë fasadë të Mosadit, sikurse është Lidhja Anti-Shpifje[13].

Një hetim i drejtuar nga qeveria australiane zbuloi se miliona dollarë të

depozituar pranë bankës *Nugan Hand* kishin një prejardhje të mistershme dhe shërbenin për të pastruar fitimet e trafiqeve të drogës. Këto para qenë përdorur në të gjithë botën nga CIA për të financuar kontrabandën e armëve dhe operacione sekrete e ilegale. Ka prova edhe se CIA e ka përdorur atë bankë për të financuar fushata shpifjeje kundër disa krerëve politikë në pjesë të ndryshme të botës, përfshirë Australinë, duke u siguruar kështu se zgjedhësit do të mbështesnin njerëzit e zgjedhur nga CIA. Po, kjo është bota e "lirë", për të cilën vazhdojmë të flasim. Në të gjithë botën, bankat që mbajnë emra familjesh të rëndësishme shërbejnë për të pastruar paratë e nxjerra nga tregtia e drogës, që zhvendosen nga njëra llogari në tjetrën, gjersa prejardhjet e tyre humbasin në rrjetën e transaksioneve. Edhe industria e arit dhe e diamanteve, e sunduar nga Rotshildët dhe nga Openhajmerët, nëpërmjet ndërmarrjeve si *De Beers*, përdoret për të pastruar paranë e pistë. Me këtë para blihen ar dhe diamante nga ato ndërmarrje dhe gjithçka pastaj shitet përsëri për të prodhuar para të "pastër". Intriga e familjeve anglo-amerikane të lidhura me njëra-tjetrën brenda rrjetit të manipulimit të Vëllazërisë, përgjegjëse të sajimit të luftërave dhe të krizave ekonomike brez pas brezi, qëndron edhe prapa tregtisë ilegale të drogës. Disa prej emrave më të famshëm, të bankave tregtare dhe të ndërmarrjeve të të gjithë botës, e vënë pjesën më të madhe të pasurisë së tyre drejtpërdrejt, ose jodrejtpërdrejt, nga vartësia e të rinjve prej drogës. Bëhet fjalë për të njëjtat familje e organizata përgjegjëse të tregtisë së skllevërve nga Afrika dhe të tregtisë së *coolie*-ve (shërbëtorëve – përkth.) nga Kina. Shprehja angleze "të jesh shangajuar" rrjedh nga zakoni i grabitjes së kinezëve dhe i ngarkimit të tyre në anije për në Shtetet e Bashkuara, ku shfrytëzoheshin si shërbëtorë. Prohibicionizmi ishte një instrument për të krijuar në Shtetet e Bashkuara një rrjet të dendur të krimit të organizuar. Struktura e krijuar në këtë mënyrë ishte e përkryer, siç ishte e parashikuar prej planeve, për të tregtuar drogë, sapo të hiqej prohibicionizmi. Grupet kryesore që manifestuan në favor të prohibicionizmit dhe për t`i dhënë fund të "këqijave të të pirit", si Bashkimi i Grave Kristiane në favor të përkorjes dhe Lidhja e saj Anti-salon (saloon – *lokal karakteristik i Shteteve të Bashkuara në kohën e pushtimit të Perëndimit (West) në mesin e shek. XIX, ku konsumoheshin pije alkolike*), u financuan nga Rokfelerët, nga Vanderbildët dhe nga Varburgët, nëpërmjet Fondacionit Rokfeler, Fondacionit Rasëll Sage dhe të tjerë fondacionesh të përjashtuar nga taksat. Proibicionizmi ishte një tjetër mashtrim i vënë në veprim nga Vëllazëria, për të realizuar qëllime me afat të gjatë. Pa shihni, krijoi pasurinë e Xhozef Kenedit, të atit të Xhon F. Kenedit.

LIBRI 24

Libri i vitit 1972, tashmë i shndërruar në një klasik, i profesorit Alfred MekKoi, me titullin *The Politics Of Heroin In South East Asia* (Politika e heroinës në Jug-Lindjen aziatike) dhe botimi i tij i plotësuar i vitit 1991 me titullin *The Politics Of Heroin – CIA Complicity In The Global Drug Trade* (Politika e heroinës – Bashkëpunimi i CIA-s në tregtinë botërore të drogës) zbulojnë se si helikopterët e CIA-s transportonin droga nga fushat deri në pikat e shpërndarjes, ndërsa populli amerikan besonte se ata gjendeshin në ato vende për të luftuar komunizmin. Ai përshkruan për më tepër se si një impiant mbushjeje i *Pepsi-Cola*-s ishte përdorur për këtë tregti dhe se si mediat i varrosën këto informacione. Pesëdhjetë e tetë mijë amerikanë, dhe Zoti vetëm e di se sa vietnamezë, u vranë në harkun e atij konflikti dhe asgjë nuk e shpreh më mirë mungesën e respektit, që këta njerëz kanë për jetën njerëzore, se sa operacioni i drejtuar nga CIA, që e transportoi drogën në qese plastike të fshehur brenda trupave të ushtarëve që çoheshin në shtëpi nga Vietnami, për t'u varrosur. Agjenti operativ i CIA-s Gynter Rusbaker ka treguar se disa trupa u boshatisën përbrenda dhe u mbushën me droga, për t'u ngarkuar pastaj drejt Shteteve të Bashkuara[14]. Mbi trupat ishin vulosur kode sekrete, që u dhanë mundësi atyre që mbartnin droga të identifikoheshin menjëherë në çastin e mbërritjes në bazat ajrore të bregut perëndimor, sidomos në bazën Travis të Kalifornisë. Në atë pikë drogat merreshin dhe shpërndaheshin midis të rinjve amerikanë.

Heroina është një nënprodukt i opiumit, nga i cili prodhohet edhe morfina, një emër i frymëzuar nga hyu grek i gjumit, Morfeu. Pikërisht në laboratorët gjermanë të *Bayer*-it u krijua në vitin 1898 heroina nëpërmjet shtimit të disa përbërësve molekulës së morfinës. Kompania *Bayer* më pas hyri të bënte pjesë në kartelin farmaceutik të *I.G. Farben*-it, që rezultoi vendimtar për makinën e luftës së Hitlerit. Midis narkotikëve, heroina është ajo që krijon më shumë vartësi, por *Bayer*-i e quajti: "një drogë heroike, pa fuqinë që jep të mësuarit tipik i morfinës". Emri "heroinë" rrjedh nga fjala "heroik" dhe shpikësit e saj ishin për Vëllazërinë ca heronj të vërtetë, nëse kihet parasysh konflikti dhe vuajtjet që do të kishin shkaktuar. Sot tregtia e heroinës e ardhur nga Lindja e Largët organizohet ende nga masonët nëpërmjet agjentëve të tyre të ndryshëm, Triadat. Bëhet fjalë për mafien lindore, e cila po përhapet gjithmonë e më shumë në botën perëndimore, si në Vankuver të Kanadasë. Duajt ju jap një tjetër shembull se si ndodhin këto lojëra. Para revolucionit kinez, kreu i Kinës ishte Çang Kai Shia, anëtar i njërës prej organizatave të para mafioze. Lideri "komunist" që e zboi nga pushteti ishte Mao Ce Duni, një mason i Lindjes së Madhe[15]! Ai ia njohu lëshimin e Hong Kongut Britanisë

së Madhe (me pahir, ishte një vartës i Vëllazërisë!) dhe trafiku i zakonshëm i drogës vazhdoi si më parë. Në vitin 1963, komunistët kinezë mund të llogarisnin mbi nëntë milionë akra tokë të mbuluara nga plantacione opiumi dhe mbi këtë bazohet ekonomia kineze, ashtu sikurse edhe ekonomia perëndimore[16]. Pa tregtinë e drogës, ekonomia botërore do të shembej, aq shumë ajo tashmë varet nga fitimet e nga investimet e bazuara mbi shkatërrimin e jetës njerëzore. Mafia kineze organizon prodhimin e heroinës në të ashtuquajturin Trekëndësh i Artë. Paguhet nga bankierët e Vëllazërisë britanike të Hong Kongut në lingota floriri, një pjesë e të cilave përdoret po nga vetë ajo mafie për të blerë opium në gjendjen e papërpunuar nga fshatarët. Kështu cikli vjetor vazhdon të zgjerohet. Tregtia e kokainës nga Amerika e Jugut drejtohet nga të njëjtët njerëz nëpërmjet agjensive si CIA. Kokaina prodhohet nga gjethja e kokës që, gjer në vitin 1903, përdorej për të prodhuar pijen *Coca-Cola*, gjë që e shpjegon ai emër.

Tregtia e drogës nuk ka pasur qëllim vetëm krijimin e shumave të mëdha të parasë, edhe pse kjo është e rëndësishme për të financuar Urdhërin e Ditës, por është përdorur edhe për shkatërrimin e disa shoqërive dhe për t'i penguar të rinjtë të shprehin vlerën e tyre të vërtetë e të fuqishme. Sapo njerëzit të jenë përdorues drogash, ata nuk do të përbëjnë më ndonjë problem për planet e mëdha të Vëllazërisë. Dhuna dhe krimi janë në mënyrë të pashmangshme të lidhura me tregtinë e drogave, pasi tregtarët e drogave luftojnë për supremacinë, ndërsa përdoruesit e narkotikëve vjedhin e grabisin për të siguruar drogën. Kjo i jep Vëllazërisë një mundësi të mrekullueshme për t'i ofruar "zgjidhjen" këtij "problemi": më shumë pushtet policisë dhe gërryerje e mëtejshme e lirive themelore. Kam parë një sondazh opinionesh të publikuar nga gazeta *Los Angeles Times* disa vjet më parë, në të cilin rreth 84% e të intervistuarve deklaronin se ishin të gatshëm të hiqnin dorë prej lirive themelore, nëse kjo do t'u siguronte atyre fitoren e luftës kundër drogave. Problem-reagim-zgjidhje. Ajo që ata njerëz duhej të mësonin menjëherë është se drogat *shpërndahen* pikërisht nga ata që janë në vijën e parë në luftën kundër drogave, që ofrojnë pastaj në të njëjtën kohë një "zgjidhje". Pjesa më e madhe e organizmave që luftojnë "kundër" drogës janë thellësisht të korruptuara dhe përdoren si instrumente të sigurta e të padyshuara për shpërndarjen e drogës. Xhorxh Bushi ka drejtuar më shumë luftëra kundër drogës se cilido politikan tjetër amerikan e, megjithatë, është njëri prej baronëve më të mëdhenj të drogës të Amerikës së Veriut. Një gazetar i gazetës *San José Mercury News* ka zbuluar përfshirjen e CIA-s në përhapjen e *crack*-ut (lloj droge me bazë kokainën, me çmim të ulët) midis komunitetit me ngjyrë

të Los Anxhelesit. Kjo ka ndodhur gjatë periudhës kur Xhorxh Bushi ishte në Shtëpinë e Bardhë dhe qoftë gazetari, qoftë gazeta e tij u bënë objekt kritikash dhe talljesh nga ana e gazetave që mbështesin sistemin, si *Washington Post*-i dhe *Los Angeles Times*-i, pasi Vëllazëria kërkonte ta minonte besueshmërinë e kësaj historie. Edhe në rrethin e tregtisë së drogave ka rëndësi përkatësia ndaj familjeve të caktuara. Një të njohuri të një mikut tim iu ofrua roli i korrierit nga ana e një agjensie qeveritare amerikane. Ai e kundërshtoi, por kërkoi të dinte se pse kishin kontaktuar pikërisht atë. Përgjigjja ishte: "E dimë se ç'familjeje i përket". Një prej shenjave të koduara, zbuloi ai, ishte të bëje një prerje horizontale brenda pëllëmbës së dorës. Po të kapeshe, u tregoje dorën autoriteteve dhe ata të linin të ikje.

Agjensitë që luftojnë drogën kontrollohen nga kartelët e drogës dhe kur dëgjoni të flitet për "kapje të mëdha në rrjetë të shpërndarësve të drogës", duhet të dini se bëhet fjalë në përgjithësi për Vëllazërinë që heq qafe konkurrentët, duke dhënë përshtypjen sikur po reagon. Është e vështirë t'i zbulosh shpërndarësit e drogës? Atëherë si është e mundur që një i ri sapo zbret nga autobusi diku në një qytet të panjohur për të arrin ta gjejë në harkun e një ore? Nëse merrni droga të rënda, apo mendoni ta bëni, mos harroni këtë: nuk do të jeni "rebelë", as "kundërrymë", por do të vrisni veten nga pikëpamja mendore, emocionale, shpirtërore dhe, më pas, edhe fizike, e do të bëni saktësisht atë që, kush e kontrollon këtë botë, dëshiron që ju të bëni. Zgjedhja u përket juve, por bëhuni të vetëdijshëm për atë se si janë gjërat, para se të filloni. Ka vetëm një fitues, kur bihet në kurthin e drogës. Dhe ai nuk jeni ju.

LIBRI 24

Kapitulli 15

Bijtë e Satanait

Ritualet e magjisë së zezë, që i njohim nën emrin e satanizmit, janë shprehje moderne të ritualeve e të flijimeve tipike të Babilonisë së lashtë dhe të shoqërive, në të cilat figuronin njerëzit e futur prej Vëllazërisë, të përhapura midis sumerëve, fenikasve, itivëve, egjiptianëve, kananeasve dhe akadëve, vetëm sa për të përmendur disa prej popullsive të botës së lashtë. Bëhet fjalë për një proces, që përqafon krejt historinë dhe që sheh kremtimin e të njëjtave rituale në nderim të të njëjtave hyjni dhe kjo është e një rëndësie themelore për anëtarët e ditëve të sotme të Vëllazërisë.

Përdorimi që unë i bëj termit "satanizëm" nuk ka të bëjë fare me versionin e krishterë të Satanait. Unë e përdor vetëm për të përshkruar një sistem flijimesh e torturash rituale që, sado që mund t'u duket e pabesueshme më të shumtëve, sot është i përhapur në të gjithë botën. "Satanizmi" është vetëm një tjetër emër që emërton kultin me forca negative tejet shkatërruese, i cili gjatë shekujve ka marrë emra të ndryshëm: Nimrod, Baal, Molok, Set, djall, Luçifer, e kështu me radhë në pafundësi. Satanizmi prish çdo gjë që është pozitive, në të njëjtën mënyrë me të cilën nazistët morën një simbol pozitiv, kryqin e thyer, dhe e përmbysën, duke e bërë një simbol negativ. Ja përse

satanistët e përmbysin yllin pesëcepash dhe përdorin të zezën si simbol të errësirës, nga e cila rrjedh Mesha e tyre e Zezë. Por ata përmbysin edhe simbolizmin e të bardhës, që për ata është një ngjyrë jashtëzakonisht negative. Organizatat satanike, nën emrin e hyjnive të ndryshme, kanë qenë krijuar nga Vëllazëria Babilonase, për të realizuar qëllimet e tyre. Kemi parë se shkrimet e Gardianëve dhe të paraardhësve të tyre, Nefilimëve, përmbajnë referime ndaj zakonit të tyre për të pirë gjak. Vëllazëria e di se gjaku përmban energjinë e forcës jetësore. Të pirit e gjakut të të përmuajshmeve (zakoneve) të grave ka qenë gjithmonë një gjë e zakonshme midis familjeve zvarranike, sepse ato kanë nevojë për gjak, për të jetuar në këtë përmasë. Ai njihej si zjarr yjor, ose si esencë hënore femërore. Cikli i të përmuajshmeve (zakoneve) femërore komandohet nga ciklet e Hënës dhe gjaku përmban atë energji. Mendohet se përbërësit e tij sigurojnë jetë të gjatë. Në Indi kjo substancë quhej "soma", në greqi "ambrozia". Thuhej, me të drejtë, se ishte nektari i hyjnive (perëndive) – i perëndive zvarranike që tradicionalisht konsumojnë gjak. Edhe kupa e "Gralit të Shenjtë" është një simbol i barkut dhe i konsumimit të gjakut të të përmuajshmeve (zakoneve), përveçse është një simbol i vetë racës "mbretërore" zvarranike. Gjaku i të përmuajshmeve (zakoneve) i jepet elitës së dinastisë "mbretërore" zvarranike nga priftëresha të virgjëra dhe prej të cilave e ka prejardhjen shprehja "Grua e purpurtë" (për të treguar Kishën e Romës), ose, për grekët , "Grua e shenjtë". Termi përkatës grek, *hierodulai*, qe përkthyer më pas në anglisht si "harlot" ("grua e përdalë") dhe në gjermanisht si "hores", nga e cila rrjedh fjala anglishte "whore" ("prostitutë"). Fjala "*ritual*" rrjedh nga kjo praktikë (*ritu* = skuqje), sikurse edhe fjalët "rit" dhe "e kuqe". Njëra prej arsyeve pse ngjyra e kuqe është aq e rëndësishme për satanistët duhet kërkuar pikërisht në gjakun e të përmuajshmeve (zakoneve), dhe tek ajo e ka origjinën edhe përdorimi i vazhdueshëm i ngjyrës së artë nga ana e fiseve "mbretërore". Ari quhet metal i hyjnive (perëndive), por për anunakët e pllakëzave sumere gjaku i të përmuajshmeve ishte "ari i hyjnive (perëndive)".

Racat e zvarranikëve dhe hibridët e tyre e pijnë gjakun sepse nëpërmjet tij thithin forcën jetësore të një njeriu dhe sepse ai është i domosdoshëm për ta, për të jetuar në këtë përmasë. Disa dëshmitarë okularë më kanë pohuar se shpesh, teksa pijnë gjakun dhe ushqehen me mish njerëzor, ata shndërrohen në zvarranikë. Konsumi i gjakut është shkruar në genet e tyre dhe një priftëreshë e lartë e Elitës, ose "Hyjnesha Nënë", që ka kryer rituale për krerët e Vëllazërisë, më ka pohuar se pa gjak njerëzor raca e zvarranikëve nuk mund të mbijetojë në këtë përmasë. Emri aktual i kësaj gruaje është

Arizona Uilder, por më parë quhej Xhenifer An Grin. Ajo më ka pohuar edhe një gjë tjetër mjaft interesante, sipas së cilës zvarranikët i kanë ndjekur arianët në të gjithë universin, sepse gjaku i racës së bardhë ishte për ta, për kushedi ç`arsye, veçanërisht i rëndësishëm dhe ishin të interesuar sidomos për racën më flokët të verdha e sytë të kaltër. Ajo shtoi pastaj se zvarranikët e kishin ndjekur racën e bardhë gjer në Mars, dhe e kishin ndjekur mandej në Tokë. Nuk është krejt e pamundur që ardhja në numër të madh e racës së zvarranikëve në këtë planet të jetë shumë më e vonë nga sa e imagjinojnë shumë studiues. Një program hibridizimi, që i përket vetëm disa mijëra vjetëve më parë, ndërmjet anunakëve dhe racave të bardha marsiane, të kryqëzuara më parë me zvarranikët në Mars, do t`i ketë dhënë jetë një race me gene tejet zvarranike. Kjo është jetësore për arsyen që shpjegova më lart. Duket në fakt se është e nevojshme një farë doze genesh të racës së zvarranikëve, në mënyrë që të mund të ndryshojnë formë, sikurse bëjnë ata. Por të dish se kur ka ndodhur hibridizimi, është mjaft më pak e rëndësishme se fakti që ka ndodhur.

Satanizmi bazohet mbi manipulimin e energjisë dhe të vetëdijes. Këto rituale tejet patologjike krijojnë një fushë energjitike, një frekuencë dridhëse, që lidh vetëdijen e pjesëmarrësve me zvarranikët dhe me të tjera vetëdije të nivelit më të ulët të përmasës së katërt. Kjo është fusha përmasore, e njohur për shumë studiues si fusha yjore më e ulët, e sintonizuar me frekuencën e emocioneve me dridhje të ulët si frika, ndjenja e fajit, urrejtja e kështu me radhë. Kur një ritual vë në fokus këto emocione, sikurse bëjnë ritet satanike, vendoset një lidhje e fuqishme me nivelin më të ulët të përmasës së katërt, atë të zvarranikëve. Këta janë disa prej "demonëve", që këto rituale kanë pasur gjithmonë detyrën t`i ndjellin, që nga fillimi i kësaj historie të trishtuar, e cila zë fill mijëra vjet më parë. Kjo ndodh nëpërmjet zotërimit, kur zvarranikët bëhen zotër të trupit fizik të anëtarit të kultit. Satanistët kryesorë janë të racës së zvarranikëve gjakpastër të zbritur poshtë, me formë njerëzore. Satanizmi nuk është vetëm një sëmundje dhe një perversitet, edhe pse është edhe kështu; nga pikëpamja e Vëllazërisë, ai ekziston sepse lejon, midis të tjerave, kontrollin e fushës magnetike tokësore, kultin dhe lidhjen me padronët zvarranikë, konsumin e forcës jetësore të viktimave të flijuara dhe furnizimin me energji për zvarranikët, të cilët duket se ushqehen me emocione njerëzore, veçanërisht me frikë. Këto flijime janë, në kuptimin fjalë për fjalë, flijime ndaj "perëndive", zvarranikëve, dhe kryhen prej mijëra vjetësh. Flijimet kolektive që kryenin aztekët e Amerikës Qendrore, bashkë me shumë popuj të tjerë, shërbenin për t`u dhënë ushqim zvarranikëve gjakpastër e hibridëve, të cilët ushqeheshin me ato trupa e me atë gjak dhe për t`u dhënë energji

zvarranikëve, që nuk kishin marrë formë fizike dhe që banonin në nivelin më të ulët të përmasës së katërt. Fil Shnajderi, një murator që ka punuar në bazat nëntokësore amerikane, i ka pohuar autores dhe kërkueses Aleks Kristofer se, kur fëmijët arrinin në një pikë që nuk mund të punonin më si skllevër nëpër bazat nëntokësore, haheshin nga zvarranikët. Këta të fundit parapëlqejnë fëmijë të vegjël, sepse nuk janë të infektuar si të rriturit. Është e vështirë për t'u gëlltitur kjo, apo jo? Jam i sigurtë se mendja juaj është duke ulëritur "nuk është e mundur!", sepse kush mund ta pranojë një të vërtetë si kjo? Por nëse nuk e bëjmë, si mund ta ndalojmë të gjithë këtë?

Ritet satanike përgjithësisht kryhen natën, sepse atëhere fusha magnetike është më e qëndrueshme. Gjatë ditës grimcat e ngarkuara elektrikisht nga era diellore shkaktojnë turbolenca në atë fushë dhe e bëjnë më të vështirë lidhjen ndërpërmasore. Përkundrazi, ajo është shumë e qëndrueshme gjatë eklipseve të plota dhe pikërisht në atë kohë indigjenët i kremtojnë ceremonitë e tyre më të rëndësishme, për t'u lidhur me të tjera qenie përtejpërmasore. Ritet satanike dhe flijimi njerëzor, veçanërisht ai i fëmijëve, kremtohen në shkallë të gjerë dhe përfshijnë disa prej politikanëve, të afaristëve dhe të pronarëve të mediave më të famshme të planetit. Dhe është logjike që të jetë kështu. Do të ishte e çuditshme po të mos e bënin, duke pasur parasysh prapaskenat. Këto rite e këto flijime njerëzore kanë qenë gjithmonë në bazën e "besimit" të Vëllazërisë, që nga kohërat e lashta. Dhe Vëllazëria përdori manipulimin, për të vendosur anëtarët dhe servilët e saj në postet me pushtet politik, ekonomik, financiar, ushtarak, mjekësor e gazetaresk dhe u beson atyre role të rëndësishme brenda botës së spektaklit. Prandaj përqindja e satanistëve dhe e flijuesve të fëmijëve në nivelet më të larta të këtyre profesioneve dhe institucioneve është jashtëzakonisht e lartë kundrejt popullsisë së përgjithshme.

Tema e flijimit të njerëzve dhe kafshëve mbush krejt historinë, që nga bota e lashtë gjer në ditët tona. Mund të duket ironike, por përkundrazi është absolutisht koherente me atë sa është pohuar në këtë libër, fakti që shumë prej atyre flijimeve kishin qëllimin për ta ruajtur, në vend që ta shkatërronin jetën. Mendohej se një flijim do t'i kishte zbutur "perënditë", duke mbrojtur kështu jetën e shumë njerëzve. Kjo është një tjetër origjinë e konceptit të gjakut (dashit) të kurbanit, domethënë ai që vritet për "mëkatet" e të tjerëve. Kjo u ka ndodhur shumë "heronjve" mitikë fetarë që "kanë vdekur me qëllim që mëkatet tona të faleshin". Flijimi i mbretit, apo i kryetarit, për të zbutur perënditë është një tjetër traditë e lashtë. Në të ashtuquajturin djep të qytetërimit, Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Afërt, ku janë gjetur gjurmë të

Anunakëve e të Gardianëve, kremtohen flijime njerëzore, sidomos të fëmijëve. Rite të ngjashme kryheshin edhe ne Kinë, në Romë, në Afrikë, në Azi, në Greqi, në Amerikën e Jugut dhe, sikurse është e njohur, në Meksikë, ku aztekët kryenin flijime në masë në nderim të "perëndive". Ky është rajoni ku ish presidenti i Meksikës, Miguel De La Madridi, i pohoi Keti O'Brianit, një skllaveje me mendje të kontrolluar nga CIA, se jashtëtokësorët zvarranikë kishin zbritur në Tokë dhe kishin krijuar ca trupa njerëzorë për t'i pushtuar, pikërisht siç kishin bërë gjerësisht midis popullsisë ariane. Zvarranikët dhe flijimet njerëzore janë ngushtësisht të lidhur. Skandinavët i varrosnin të gjallë fëmijët, në përpjekjen për të ndaluar fatkeqësitë dhe për të marrë me të mirë perëndinë e madhe të Veriut, skandinavin Odin, ose gjermanin Vodan, apo Voden. Perënditë e shkollave misterike ishin në mënyrë të vazhdueshme të lidhura me flijimin njerëzor dhe qenë pikërisht këto shkolla që i kaluan si trashëgim ritet dhe dijet deri në ditët e sotme, nëpërmjet Vëllazërisë globale dhe organizatave satanike. Inkasit e Perusë i flijonin fëmijët dhe flijimi njerëzor praktikohej në Evropë që nga kohët e lashta. Rituali druid qëndronte tek të varrosurit e një fëmije nën themelet e një ndërtese të re, ose në të spërkaturit e atij vendi me gjakun e një fëmije. E gjejmë po këtë ritual në shumë pjesë të botës. Historitë e shën Kolumbës (Semiramidës), tregojnë se ky hero i "krishterë" u tha murgjve të vet se njëri prej tyre duhej të varrosej nën themelet e një manastiri të ri mbi ishullin skocez të Ionës (Diellit) për ta "shuguruar" atë zonë. Doli vullnetar një farë shën Orani që, si rrjedhojë, shkoi dejt e në Parajsë[1]. Shkrimet e historianit romak Tacitit zbulojnë se druidët e quanin një detyrim t'i mbulonin altarët e tyre me gjakun e të burgosurve dhe se këshilloheshin me perënditë, duke shqyrtuar rropullitë njerëzore. Të njëjtat histori hasen në Irlandë e në Skoci. Sipas mitit irlandez, Irlanda qe populluar fillimisht nga një grup perëndish grykës, të quajtur Formorians, që kërkonin dy të tretat e fëmijëve të lindur çdo vit. Fenikasit dhe të afërmit e tyre, kartagjenasit, flijonin qenie njerëzore në shkallë të gjerë dhe kështu bënin edhe kananeasit (palestinezët e lashtë). Kur Kartagjena zhvilloi luftën kundër Romës, 200 familje fisnike i flijuan fëmijët e tyre ndaj perëndisë Baal (perëndia fenikase e Diellit, Bel ose Bil)[2].

Një tjetër aspekt që përsëritet herë pas here është flijimi i fëmijës së parë, shpesh i mashkullit të parë. Midis disa fiseve aborigjene të Australisë, nëna vriste dhe hante fëmijën e parë, duke siguruar kështu për vete aftësinë për të lindur të tjerë fëmijë[3]. Flijimi i pjellës së parë të kafshës, apo të njeriut, ishte mjaft i zakonshëm dhe përmendet edhe në Testamentin e Vjetër. *Libri i Mbretërve* tregon se Masha, mbreti i Mohabit, ishte aq shumë i tronditur pas

mundjes nga izraelitët, sa që flijoi djalin e tij më të madh e trashëgimtar. Kujtoni se tek *Gjeneza*, "Zoti" (perënditë) ngulmoi me Abrahamin me qëllim që të flijonte fëmijën e tij të parë, për të vënë në provë besimin dhe bindjen e tij. I njëjti ritual kryhet ende sot e kësaj dite nga satanistët, familjet e Vëllazërisë dhe nga pjellat e tyre kriminale si mafia. Të flijosh fëmijën e parë është një mënyrë nëpërmjet së cilës këta njerëz të çuditshëm vënë në provë kushtimin ndaj çështjes së një njeriu. Jehovai deklaron hapur tek *Libri i Numrave* se "... të gjitha pjellat e para të Izraelit janë të mijat, qofshin njerëz apo kafshë" dhe, tek *Eksodi*, Jehovai kërkon që "të parët e fëmijëve tuaj të më dorëzohen mua". *Bibla* pohon se Abrahami e kishte prejardhjen nga qyteti sumer Ur dhe disa gërmime të kryera në vitin 1927 nga Sër Leonard Uolleji në varrezën mbretërore kanë nxjerrë në dritë prova të qarta të flijimeve njerëzore në varre, që i përkisnin një periudhe rreth 2.800 vjet përpara Krishtit. Shitët, popullsia që përhapi në Evropë shumë prej fiseve dhe prej ritualeve ariane, kishin të njëjtat tradita. Prova të flijimit njerëzor, veçanërisht të fëmijëve, mund të hasen në të gjitha vendet dhe pranë të gjitha qytetërimeve kryesore të përmendura në këtë libër, përfshirë Pallatin e Knosos në Kretë[4]. Kultin e kafkës, si boshti i ritualit, e gjejmë pranë Kalorësve Tempullarë, në rrethin e misterit të Rënë-së-Shatosë dhe të Shoqërisë së Kafkës e të Kockave në Shtetet e Bashkuara. Duke analizuar trupin e Njeriut të Pekinit, që i përket një periudhe ndoshta njëmilion vjet më parë, dhe të Njeriut të Neandertalit, që i përket një periudhe rreth 200.000 vjet më parë, mund të gjenden gjurmë të këtyre ritualeve edhe në kohëra aq të largëta. Kulti i kokës, që parashikonte edhe të ushqyerit me trurin e viktimës, bëhet më i përpunuar në Xheriko, rreth tetë mijë vjet më parë dhe prova të po këtyre ritualeve janë gjetur në besimin shintoist të Japonisë e të Kinës së lashtë. Anathi, motra legjendare e perëndisë Baal, paraqitej e stolisur me vargje zbukuruese, nga të cilët vareshin koka të prera, ndërsa duar njerëzore rrinin varur nga brezi i saj, në të njëjtën mënyrë si tek perëndeshat nëna të Meksikës dhe të Indisë[5].

Disa tekste të Egjiptit të lashtë zbulojnë shumë tipe flijimesh e torturash, të caktuara pastaj për t'u përhapur[6]. Egjiptianët flijonin njerëz me flokë të kuq mbi varrin e Osiridit, sepse e kuqja ishte ngjyra që i bashkëshoqërohej Setit, versionit egjiptian të Satanasë. Disa rituale të rievokuara sot nga njerëz që i kanë eksperimentuar në mënyrë të dhimbshme mbi lëkurën e vet, pasqyrojnë ato të përshkruara hollësisht tek *Libri egjiptian i të vdekurve* dhe përfshijnë praktikën e të ruajturit të zemrave në një vazo[7]. Në Egjipt zemrat vendoseshin në një peshore, për t'u peshuar dhe gjykuar nga perëndesha Maat. Ja kuptimi i vërtetë i gruas me diellin si kurorë, që mban në dorë

Peshoren e Drejtësisë, e pranishme në shumë ndërtesa gjyqësore. Në botën e lashtë fakirët braminë të Indisë dhe të shkollave të tjera misterike ishin në dijeni të drogave, të torturave dhe të "magjive", që krijonin haluçinacione. Fakirë budallenj. Hipnoza përdorej gjerësisht nëpër tempuj. Adhuruesit e demonit Bel/Baal/Nimrod në Kanan (emri i Palestinës së lashtë), në Babiloni dhe në Feniki u kushtoheshin flijimeve njerëzore, kanibalizmit dhe foshnjëvrasjes në emër të Molokut, njërës prej fytyrave të shumta të Nimrod/Balit, dhe këto flijime përbënin një pjesë të rëndësishme të ritualeve të tyre fetare[8]. Thuhej se Bali (zotëri, ose qeveritar), hyjnia më e lartë e kananasve dhe e fenikasve, ishte shpërndarësi i jetës, ndërsa Moloku ishte shkatërruesi i saj. Që të dy kërkonin të merreshin me të mirë nëpërmjet flijimeve. Bali, apo Moloku, identifikoheshin me hyjninë romake Saturnin.

Në nderim të Balit, perëndisë së diellit e të zjarrit, kartagjenasit, duke ndjekur ritualet e fenikasve dhe të kananasve, i hidhnin fëmijët brenda një pusi të zjarrtë, i gërmuar sipas një forme që të kujtonte Bal/Molokun. Në një vend afër Tunisit aktual janë gjetur gjashtë mijë vazo hiri, që përmbanin mbetjet e karbonizuara të disa fëmijëve. Mos harroni që këto rituale e këto kulte janë po ato që satanistët dhe Vëllazëria praktikojnë sot. Ja përse, më 19 prill 1993, fëmijët e Vakos u dogjën të gjallë gjatë atij ferri të shkaktuar tërësisht mga FBI-ja, e kontrolluar nga satanistët dhe nga ATF-ja, zyra e alkoolit, e duhanit dhe e armëve të zjarrit. Bëhet fjalë për të njëjtët njerëz thellësisht të sëmurë, që bënë të hidhej në erë pallati Xhejms P. Murrah në Oklahoma, më 19 prill 1995, në të cilin vdiqën shumë fëmijë. 19 prilli është një datë satanike rituale e lidhur me zjarrin – perëndinë e zjarrit, Balin ose Molokun. Dhe çfarë kërkon Moloku? Flijimin e fëmijëve. Vakoja dhe Oklahoma ishin flijime fëmijësh në nderim të Bal/Molokut, pikërisht ashtu siç është parashikuar nga kultet që respektoheshin prej njerëzve të lashtë. Në të njëjtën mënyrë, lufta është për këta njerëz një banjë gjaku ritual, në të cilën një numër i paimagjinueshëm njerëzish vriten dhe planeti përmbytet nga energjia emocionale negative. Pikërisht me këtë energji ushqehen shumë zvarranikë të nivelit më të ulët të përmasës së katërt, apo, sidoqoftë, e përdorin për t'u shfaqur në këtë përmasë. Nëse dëshironi prova të pakundërshtueshme të faktit se ithtarët e Davidit dhe fëmijët e tyre u flijuan në Vako, ju këshilloj nxehtësisht videon *Waco: The Rules Of Enga Gement*[9]. Mos i besoni kurrë më ndonjë deklarate zyrtare. Emrat ritualë të "demonëve" vazhdojnë ende të jenë të njëjtët me ata të përdorur në botën e lashtë dhe nga grupe më të vonë si Kalorësit Tempullarë. Një provë e kësaj vjen nga një mori dëshmish të lëna sot nga viktima të satanizmit. Një mikja ime, teraupetja britanike Vera

LIBRI

Diamond, punon që prej rreth 20 vjetësh me njerëz që kanë pësuar abuzime të lidhura me praktikat satanike dhe me kontrollin mendor. Ja çfarë thotë:

"Fëmijët thonë se fjala Satana është ajo më e përdorura, por midis demonëve të tjerë figurojnë Bafometi dhe Behemothi. Moloku dhe një tjetër demon me emrin Koronzon duken, në mënyrë të veçantë, të lidhur me ngrënien e fëmijëve. Këta duken veçanërisht të përfshirë në flijimet e fëmijëve"[10].

Koronzoni është i lidhur me Kronosin, versionin grek të Nimrodit. Sipas legjendës greke, Kronosi i gëlltiste fëmijët e vet sapo lindnin, prej frikës se mos e shfronësonin. Kronosi ishte më i fuqishmi midis Titanëve, emër grek ky, që përdoret për të treguar kryqëzimet midis zvarranikëve dhe "bijave të njerëzve". Miti grek u referohej simbolikisht atyre si bijtë frut i bashkimit seksual midis Qiellit (jashtëtokësorëve) dhe Tokës (njerëzve). Kronosi ishte i ati i Zeusit dhe, ky i fundit, kishte mbijetuar sepse e ëma e kishte shpëtuar fshehurazi prej tërbimit fëmijëngrënës të të shoqit. Zeusi më pas zhvilloi një luftë fitimtare kundër të atit dhe Titanëve të tjerë e pastaj qeverisi si Mbret i Hyjnive mbi një dinasti, që praktikonte rregullisht flijim fëmijësh. Duke ballafaquar popullsitë e ndryshme, brez pas brezi, do të gjeni të njëjtën praktikë të flijimit të fëmijëve. Kananasit-hebrej flijonin rregullisht qenie njerëzore dhe kafshë. Sot satanistët, që qëndrojnë në nivelet më të larta të shoqërisë hebraike, vazhdojnë të praktikojnë të njëjtat rituale, ndërsa masa e popullit hebraik, e shpërndarë në të gjithë botën, nuk dyshon që kjo të ndodhë. Sapo të kuptohet domethënia e vërtetë e Pashkës hebraike, mund të dëshmohet se si kanë një bazë historike historitë e çdo epoke, përfshirë atë aktuale, të lidhura me flijimet e fëmijëve nga ana e fanatikëve hebrej me rastin e atyre festimeve. Pashka hebraike nuk kishte të bënte fare me "Zotin", që linte mënjanë shtëpitë e fëmijëve izraelitë, për të vrarë vetëm të parët e fëmijëve egjiptianë. Dokumente, që i takojnë shekullit VIII dhe VII para Krishtit, tregojnë se izraelitët i digjnin fëmijët e tyre në zjarre flijimi në Luginën Jehinon, paksa jashtë Jeruzalemit[11]. Gjatë flijimit në nderim të Molok/Balit thuhej se fëmijët "kaloheshin përmbi" apo "kaloheshin përmes" zjarrit. Tek *Libri i Levitikut* gjejmë rreshtin: "Ti nuk do të lejosh që fara jote të kalojë përmes zjarrit të Molokut". Profeti Jeremi thotë se disa njerëz "i digjnin fëmijët e tyre në zjarr, sikur të ishin mblatime kushtuar Balit" dhe gjithmonë tek *Libri i Jeremisë* na thuhet se: "Ata kanë krijuar majat e Tofetit, domethënë Luginën e Jehinonit, për t'i djegur të gjallë bijtë dhe bijat e tyre...". Edhe Xhon Miltoni ka shkruar për Molokun tek *Parajsa e humbur* e tij:

"Së pari Moloku, mbret i llahtarshëm, i ndotur me gjak,
Me flijime njerëzore dhe me lotë prindërish.
Por, për shkak të zhurmës së fortë të tambureve dhe daulleve,
Nuk e dëgjoi të qarën e fëmijëve, që përshkonin zjarrin,
Drejt idhullit të tij mizor".

Testamenti i Vjetër është i mbushur plot me referime ndaj flijimeve të njerëzve dhe të kafshëve. Të njëjtat simbole që lidhen me flijimin e pjellave të para, apo të fëmijëve të vegjël, mund të hasen në shumë tekste të vjetra. Edhe historia e Jezusit e paraqet këtë temë, natyrisht. Në nivelin e saj më të skajshëm, dogma hebraike është thellësisht e rrënjosur në praktikën e flijimit. Tempujt hebraikë ishin thertore, të furnizuar vazhdimisht me kafshë, për vrasjen dhe flijimin ritual. Kini parasysh mënyrën që hebrejtë ndjekin sot për të vrarë kafshët. Mishi quhet "kosher" vetëm nëse kafsha është therur dhe ngordh e zhgjakësuar. E njëjta mënyrë ndiqet për mishin "hallall" tek myslimanët. Ritualet e lashta janë ruajtur rreptësisht nëpërmjet familjeve të Vëllazërisë dhe Elita aktualisht në komandë flijon fëmijët e pi gjakun e tyre, saktësisht siç bëhej në botën e lashtë. Besimi hindu dhe doktrinat mbi të cilat bazohen librat e tij të shenjtë, *Vedat*, qenë përhapur në nënkontinentin indian nga arianët e ardhur nga malet e Kaukazit, njëra prej qendrave të populluara nga jashtë-brenda-tokësorët dhe nga pasardhësit e tyre. Për këtë arsye ka të ngjarë që *Vedat* të përmbajnë të njëjtat udhëzime se si t`u kushtosh flijime perëndive. *Vedat*, të shkruara rreth vitit 1400 para Krishtit, rendisin emrat e perëndive dhe viktimën më të përshtatshme për secilën prej tyre. Në botën e ditëve tona, çdo vit i flijoheshin disa viktima Hyjneshës Nënë Kali, gruas së hyut Shiva, që gjithmonë është besuar se ushqehej me mish njerëzor. Çdo të premte në mbrëmje një fëmijë mashkull mblatohej në tempullin e Shivas në Tanjor, gjersa kjo praktikë u ndalua (zyrtarisht) në mes të shekullit XIX. Thugët, njëra prej shoqërive të fshehta të lashta, që kryeson Vëllazërinë, i vrisnin viktimat e tyre sipas ritualeve të përpunuara kushtuar perëndeshës Kali, e paraqitur me një kurorë kafkash.

Fëmijët, apo të ashtuquajturat "çupa të virgjëra", përdoren në këto rite flijimi, sepse satanistët dhe padronët e tye duan të zotërojnë energjinë e pastër para-adoleshenciale për qëllimet e tyre. Satanisti i moshuar, nganjëherë anëtar i nivelit të lartë të Vëllazërisë, vendoset në qendër të një rrethi me të posalindur, apo fëmijë të vegjël. Dora-dorës që këta flijohen, rituali i jep mundësi satanistit të thithë esencën e tyre jetësore, forcën jetësore, dhe të ripërtërijë kështu trupin e vet. Satanisti më i famshëm i botës, Aleister Krouli, që kishte lidhje si me

Uinston Çurçillin edhe me nazistët, ka përkrahur flijimin njerëzor dhe ka pranuar flijimin e fëmijëve. Në librin e tij të vitit 1929 të titulluar *Magick In Theory And Practice*, shpjegon arësyet e vdekjes rituale dhe motivin pse viktimat më të mira janë fëmijët e vegjël të seksit mashkull:

"Sipas teorisë së magjistarëve të lashtë, çdo qenie e gjallë është një pus energjie që ndryshon për sasinë sipas përmasës së trupit dhe për cilësinë sipas karakterit të saj mendor e moral. Në çastin e vdekjes së kësaj qenieje, kjo energji papritmas çlirohet. Nëse dëshiron të kesh rezultatin më të madh në terma shpirtërorë, është e nevojshme pra që të zgjedhësh një viktimë që të përmbajë forcën më të madhe e më të pastër. Një fëmijë mashkull me një pafajësi të përkryer dhe me zgjuarësi të konsiderueshme është viktima më e kënaqshme dhe më e përshtatshme"[12].

Krouli shton në një shënim në fund të faqes se, sipas dokumenteve të lëna prej tij, satanisti Frater Perurabo e kreu një flijim të këtij tipi të paktën 150 herë në vit midis viteve 1912-1928. Mendoni një çikë! Kjo do të thotë që vetëm ky njeri ka flijuar gati 2.500 fëmijë vetëm në atë periudhë. Ju duket ende e vështirë të kuptoni se çfarë u ndodh miliona, po miliona, fëmijëve që zhduken çdo vit në të gjithë botën dhe për të cilët nuk dihet më asgjë? Pa llogaritur të gjithë ata që rriten me qëllimin e vetëm për t'u flijuar dhe për të cilët publiku nuk di asgjë. Mund të fillojmë të kuptojmë se shifrat vjetore, që lidhen me flijimet rituale, nuk janë aspak të tepruara. Satanizmi, në thelbin e tij, synon manipulimin dhe grabitjen e energjisë e të vetëdijes së një njeriu tjetër. Në kohërat e lashta ky proces quhej "grabitja e shpirtit". Mund të duket thjesht një perversitet i sëmurë, por, kush ka kuptuar se çfarë qëndron me të vërtetë prapa këtyre ritualeve, e di se ajo që ka me të vërtetë rëndësi nuk është ceremonia në vetvete, por pasoja që ajo prodhon. Bëhet fjalë për një mjet, që shërben për të arritur një qëllim – grabitjen apo manipulimin e energjisë. Seksi është një element themelor i riteve satanike, sepse në çastin e orgazmës, ndodh një shpërthim energjie, që kapet pastaj dhe thithet nga satanistët e nga zvarranikët. Seksi gjatë një riti satanik, apo një flijimi, megjithatë, liron energjinë e orgazmës me një frekuencë shumë të ulët, për shkak të qëllimit të fundit për të cilin nxitet dhe, kështuqë, energjia e seksit satanik rezulton e sintonizuar me frekuencën zvarranike. Energjitë astrologjike të prodhuara vazhdimisht nga lëvizja e planeteve dhe nga ciklet e Diellit e të Hënës përdoren edhe për të shtuar efektin e ritualeve. Kështu ekzistojnë ditë të caktuara për ceremonitë më të rëndësishme satanike. Në ato ditë flijohen një numër i pamasë njerëzish, më së shumti fëmijë. Disa nga

datat kryesore janë: 1-2 shkurt, festa e Kandelorës (festa e Purifikimit të Madonës, në të cilën bekohen qirinjtë – përkth.); 21-22 mars, ekuinoksi i pranverës; 30 prill-1 maj, nata e Valpurgës, Beltanit; 21-22 qershor, solstici i verës; 31 korrik-1 gusht, festa e korrjes/Saba e Madhe; 21-22 shtator, ekuinoksi i vjeshtës; 31 tetor-1 nëntor, Samhain/Hallouen; 21-22 dhjetor, solstici i dimrit, ose Krishtëlindjet.

Më lejoni të them prapë edhe një herë se këto festa nuk janë satanike në vetvete. Janë çaste në harkun e ciklit planetar vjetor, kur energji shumë të fuqishme e të llojeve të ndryshme shfaqen në Tokë dhe rite të ndryshme e ceremoni, qoftë të natyrës pozitive, qoftë të natyrës negative, mbahen pikërisht në përkitmëri me ato ditë. Cikli prodhon energji dhe satanistët mjaftohen ta mbajnë në fre atë energji për qëllimet e tyre, pikërisht sikurse ndodh gjatë riteve pozitive, të kremtuara nga pjesa më e madhe e druidëve të ditëve tona. Të tjera çaste, kur kremtohen ritet satanike, janë netët e hënës së plotë, pasi në këtë rast energjia e reflektuar e Diellit arrin shkallën më të lartë. Vini re edhe rëndësinë që ka për satanistët data e 1 majit, dita kur, në vitin 1776, u themelua Urdhëri i Mendjendriturve Bavarezë dhe ditë feste sipas kalendarit socialist e komunist të krijuar nga Vëllazëria.

Çelësi i Solomonit është një libër me magji okulte që, sipas legjendës, qe shkruar nga vetë "Mbreti Solomon". Ky tekst i lashtë u ka dhënë brezave të ndryshëm bazat mbi të cilat të ngrejnë të njëjtat rite. Grupi qendror i Kalorësve Tempullarë u kushtohej riteve të magjisë së zezë dhe tempullarët në përgjithësi qenë akuzuar për atë që ne sot e quajmë satanizëm dhe se kishin kundërshtuar krishtërimin, kishin mohuar Krishtin e kishin pështyrë mbi kryq. Thuhej se ata nderonin një fuqi demoniake të quajtur Bafomet, një simbol i magjisë së zezë, e njohur edhe si Dhia e Mendesit. Bricjapi (dhia, edhe ajo e simbolizuar nga njëbrirëshi) është shenja që i dallon anëtarët e kultit dhe përfaqëson pushtetin politik, ndërsa Luani (Dielli) përfaqëson pushtetin mbretëror. Ja përse luani është mbreti i xhunglës dhe është simboli kryesor që paraqitet mbi flamurin e familjes mbretërore britanike. Planeti i Saturnit rrotullohet përreth yllësisë së Bricjapit, kurse Dielli rrotullohet përreth yllësisë së Luanit dhe satanistë e magjistarët e okultizmit i bazojnë ritet e tyre tek Dielli dhe tek Saturni. Sipas astrologjisë, Saturni është planeti i ligjit dhe i autoritetit. Emri "Bafomet" rrjedh nga fjalët greke që do të thonë "pagëzim urtësie, apo diturie" dhe doktor Hug Skonfieldi, njëri prej ekspertëve të *Rrotullave të Detit të Vdekur*, thotë se sipas kodit të esenëve, fjala "Bafomet" mund të përkthehet si "Sofia", hyjnesha e gnostikëve, dhe fjala greke që do të thotë "urtësi"[13]. Sofia është një tjetër emër, që përdoret për të emërtuar

energjinë femërore. Skonfieldi është i sigurtë, dhe edhe unë jam, se ekziston një lidhje midis tempullarëve dhe esenëve. Ai ka treguar se tempullarët përdornin të njëjtin kod, Shifrën Atbash, të përdorur tek disa prej *Rrotullave të Detiti të Vdekur*[14]. Tempullarët u akuzuan edhe se vrisnin fëmijë e u mësonin grave të abortonin[15]. Është e vërtetë se pjesa më e madhe e këtyre pohimeve u lëshuan nga tempullarët nën tortura të paimagjinueshme të ushtruara mbi ta prej satanistëve katolikë, domethënë prej Inkuizicionit. Por jo të gjitha pohimet u morën në këtë mënyrë dhe temat janë kaq bindëse e historia rezulton kaq koherente, sa që do të ishte qesharake t`i hiqje qafe të gjitha. Dhe ka një gjë që mund të dëshmohet me siguri. Vetë këto ceremoni, që përfshinin vrasjen rituale të fëmijëve dhe përdorimin e grave të quajtura riprodhuese për të pjellë fëmijë e fetusa të dështuar për t`ia flijuar një "perëndie" diabolike, kryhen gati me siguri edhe sot dhe, kjo strukturë satanike abuzimesh e vrasjesh rituale, kontrollohet nga i njëjti rrjet i shoqërive të fshehta, që tempullarët kontribuan të zgjerohej. Sipas dëshmisë së një tempullari, Skuin de Fleksianit, të gjithë anëtarët duhej të betoheshin që të mos e braktisnin kurrë Urdhërin dhe të favorizonin interesat e tij me çfarëdo mjeti, të ligjshëm apo të paligjshëm. Asnjë krim i kryer për nderimin, apo për të mirën e Urdhërit, nuk quhej mëkatar. Ai ka treguar dhe mbi flijimin e fëmijëve e të fetusve të dështuar[16].

E njëjta gjë ndodh brenda rrathëve të brendshëm të Masonerisë. Kredo Mutva, një shaman zulu, më ka thënë se në krahasim me ritet masonike, në të cilat kishte marrë pjesë në Shtetet e Bashkuara e në Mbretërinë e Bashkuar, magjia vudú dhe magjia e zezë e Afrikës nuk ishin asgjë. Fjala çelës e Masonerisë është Tubal Kain, një pasardhës i Kainit biblik, përveçse hibrid anunak. Thuhet se ka qenë motra e Tubal Kainit, Namahu[17], ajo që e ka përhapur në Tokë praktikën e flijimit njerëzor dhe të kanibalizmit[18]. Tubal Kaini është i njohur si babai i shtrigërisë e i magjisë dhe është kjo arësyeja pse emri i tij është bërë një fjalë çelës për masonët[19]. "G"-ja, që paraqitet në simbolin e Masonerisë, do të thotë "Gnostiçizëm" (njohje, dije) dhe "gjenerim" (lindje), ritet e pjellorisë të kulteve të lidhura me seksin dhe me hyjnitë e lashta Bal e Ashoreth[20]. Pa dyshim është një simbol i lidhur edhe me gjeneratën e me gjenetikën, sidomos për familjet zvarranike. E gjeni "G"-në në logon e grupit *Gannet*, që ka blerë gazeta e kanale televizive në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe boton të përditshmen nacionale *USA Today*[21]. Familjes De Mediçi të Fisnikërisë së Zezë së Venecies, që financoi Kristofor Kolombin, i përkiste Katerina de Mediçi, mbretëresha e Francës, e cila thuhet se në shekulli XVI ka urdhëruar flijime njerëzore gjatë një Meshe të Zezë. Një i ri u

flijua dhe gjaku i tij u përdor në një ceremoni me qëllimin për të shpëtuar të birin që po vdiste, Filipin[22]. Katerina de Mediçi mbante rreth qafës një talisman me emrin e një demoni satanik, Asmodeit[23]. Benjamin Franklini, një i ashtuquajtur shtyllë e Kishës së Krishterë, përveçse njëri prej etërve themelues të Shteteve të Bashkuara, ishte anëtar i klubit satanik *Hellfire* dhe trupat e gjashtë fëmijëve dhe katër të rriturve janë gjetur nën atë që ishte shtëpia e tij në Londër. Ato trupa i përkasin saktësisht periudhës kur ai banoi aty. Adolf Hitleri dhe nazistët ishin satanistë dhe të tillë ishin edhe disa "kundërshtarë" të tyre si Uinston Çurçilli e Franklin Delano Rusvelti. Rotshildët, që me prejardhje ishin një familje e turpshme gjermane të kushtuar pas okultistit me emrin Bauer, duket se praktikonin ritet satanike kananease[24], ndërsa disa familje të Vëllazërisë, të cilat kanë prej një kohe të gjatë lidhje me tokat kelte, si Shën Kler-Sinklerët, parapëlqejnë sistemin druidik[25]. Ishte hyjnia satanike Ashtoreth që i ka frymëzuar Astorët, njëra prej familjeve të Vëllazërisë, e cila rezulton thellësisht e përfshirë në satanizëm[26]. Astorët kanë lidhje të ngushta me familjen mbretërore britanike dhe rezultuan të përfshirë në skandalim Profum të vitit 1963, kur ministri britanik i Mbrojtjes, Xhon Profumi, që i detyruar të jepte dorëheqjen, pasi kishte gënjyer përpara Dhomës së Komuneve rreth lidhjeve të tij me Kristinë Kelerin, një vajzë-zile (*vajzat që thirren me telefon për shërbime seksi*), që kishte pasur një marrëdhënie seksuale edhe me një agjent rus të KGB-së. Historia midis Profumit dhe Kelerit qe arkitektuar nga Stefan Uardi, një sadomazokist përveçse shtrigan, me banim pranë çifligut të Astorëve në Kliveden, Berkshir. Janë të shumta aspektet e kësaj historie, që nuk janë bërë publike dhe që përkundrazi mund të hidhnin dritë mbi disa praktika me të vërtetë të errëta, duke zbuluar përzierjen e të mëdhenjve më të lartë të shoqërisë britanike, përfshirë Uindsorët. Princi Filip e njihte Stefan Uardin dhe Lordi Mountbaten ka marrë pjesë në të turpshmen "festë në pishinë" të Klivedenit, e cila qe vendimtare për rënien e Profumit.

Ajo që quhet satanizëm, përfaqësohet nga nivelet më të larta të piramidës së Vëllazërisë, nën komandën e Zvarranikëve. Ashtu si të gjitha nivelet e tjera të rrjetit satanik, edhe kjo është një strukturë rreptësisht e ndarë në nivele. Nivelet më të larta të organizatës satanike i përgjigjen niveleve më të larta të Vëllazërisë, por nivelet më të ulëta nuk janë të autorizuara të njohin natyrën e vërtetë të organizatave, në të cilat bëjnë pjesë. Disa prej niveleve të satanizmit janë të njohura si Motra të Dritës, Gjeneralë me Pesë Yje, Mjeshtra Këshilltarë, Ruajtës të Vulave, dhe ka një pozicion të quajtur Asmodeu[27]. Njëra prej qendrave globale të satanizmit është Kështjella e Errësirës, Château des Amerois, apo Kështjella e Mbretërve, në Belgjikë, afër fshatit që mban me

të drejtë emrin Muno Bel. Kështjella është afër kufirit francez dhe në një largësi rreth 20 kilometra nga Luksemburgu. Është e fshehur nga pyje të dendura dhe rojet i mbajnë larg kureshtarët. Brenda këtij çifligu ka një katedrale të mbuluar nga një kupolë me njëmijë të çara[28]. Kur presidenti Xhorxh Bush foli për 1.000 pika drite, ka përdorur një gjuhë të shifruar, për t'iu referuar këtij vendi kulti, i rezervuar për nivelet më të larta të piramidës satanike. Në këtë katedrale satanike është froni i priftëreshës më të lartë të krerëve të hierarkisë, një pozitë e njohur si Mbretëresha Nënë[29]. Duket se çdo ditë një fëmijë flijohet në bodrumet e katedrales. Këtu kremtohen ritualet në nderim të "hyjneshës" satanike e njohur si Lilith, demone e Kabalës hebraike. Për sumerët e lashtë, raca e zvarranikëve, genet e së cilës trashëgohen nëpërmjet linjës së nënës, simbolizohej nga një zambak ("lily", në anglisht) dhe mbartësit e geneve të racës së zvarranikëve kishin emra si Lilith, Lili, Lilitu e Lilete. Një tjetër demone e përmendur quhet Bilair, Bilar apo Bilid, emra kabalistikë këta, për të emërtuar forca që të tjerët i quajnë Satana etj.[31]. Pikërisht nga tokat e Belgjikës e të Francës Veriore ndodhi që, shumë shekuj më parë, të niseshin familjet e Vëllazërisë, përfshirë Brusët, për të pushtuar Skocinë. Belgjika, ky vend i vogël midis Francës dhe Vendeve të Ulëta, është edhe atdheu i Bashkimit Evropian e i NATO-s dhe është bërë e ditur se zotëron një qendër shumë të madhe informatike, ku përpilohen bazat e të dhënave, që u përkasin të gjithë banorëve të botës. Duket se kjo qendër njihet si "Bisha" dhe se ka të tjera të përhapura nëpër botë. Edhe një grup kontrolli mendor i Elitës, i quajtur Grupi Xhano, e ka selinë pranë shtabit të përgjithshëm të NATO-s. Nimrodi ishte Eanus, perëndia dyballësh, që qe njohur pastaj për romakët si Xhano. Arësyeja pse Belgjika është qendra e satanizmit dhe e kaq shumë institucioneve evropiane është shumë e thjeshtë. Në vitin 1831, Vëllazëria e krijoi Belgjikën pikërisht për këtë arësye dhe ka vënë në krye të këtij vendi një dinasti "zvarranike", dinastinë e Saksoni-Koburg-Gotës, familjen mbretërore britanike dhe, nëpërmjet lidhjeve me Prusinë, përkrahësit e Adam Veishauptit, themeluesit të Urdhërit të Mendjendriturve Bavarezë.

Rrethi i vrasësve pedofilë, që doli në dritë në Belgjikë në vitin 1996, nuk është veçse një pjesë e rrjetit satanik, i cili vepron në atë vend. Në krye të atij rrethi ishte Mark Dutroksi, i lidhur me urdhërin satanik të Abrasaksit, që e ka selinë pranë fshatit Forshié-la-Marsh, afër Sharleroit, në Belgjikën jugore, jo larg nga Kështjella e Errësirës. Abrasaksi është Abraksas, një demon me bark të madh, nga i cili, sipas gjasës, e ka prejardhjen termi *abrakadabra*. Dutroksi varrosi të gjallë një bashkëpunëtor me emrin Bernard Ueinshtejn dhe, midis sendeve personale të Ueinshtejnit, është gjetur një letër e grupit

Abrasaks e nënshkruar nga dikush që e quante veten perëndia egjiptiane Anubi. Me këtë letër urdhërohej t'i jepte "dhurata" Priftëreshës më të Lartë të Urdhërit, së cilës i duheshin dhënë edhe hollësitë e kërkuara specifike mbi moshën dhe seksin e viktimave. Gazeta britanike *Sunday Times* solli dëshmi të viktimave, që përshkruanin disa Mesha të Zeza, gjatë të cilave fëmijët vriteshin përpara një publiku të formuar nga anëtarë të spikatur të shoqërisë belge[32]. Një gazetë belge nxori në dritë se një ish komisar i Bashkimit Evropian bënte pjesë në këtë grup gjykatësish, politikanësh të nivelit të lartë, avokatësh dhe policësh, që morën pjesë në orgjitë e organizuara në *château*-në belge nga Mishel Nihouli, njëri prej bashkëpunëtorëve të Mark Dutroksit, kreut të supozuar të rrethit të pedofilëve. Një hetues tha se ngjante "sikur të ktheheshe prapa në Mesjetë"[33]. Në realitet, përballë këtyre ritualeve nuk ka kuptim të flasësh për epokë të lashtë, mesjetare, apo të ditëve tona. Bëhet fjalë për një fenomen gjithmonë të pranishëm në harkun e historisë, nën kontrollin e të njëjtave raca. Thuhet se grupi satanik, që qëndron prapa vrasjeve belge, ka lidhje me rrethet e ngjashme të pranishme në Hollandë, në Gjermani e në Amerikë[34]. Në realitet, bëhet fjalë vetëm për një pjesë të rrjetit global, i cili vepron në të gjitha vendet. Satanizmi drejtohet si një shumëkombëshe.

Ritet e magjisë së zezë kryhen në të gjithë botën dhe unë kam folur me viktima të vendeve të ndryshme. Në Angli kam takuar një grua guximtare 40 vjeçare. Përmbledhja që më ka bërë për përvojat e saj reflekton atë të shumë të tjerëve. Ajo kishte lindur në Darlington në vitet pesëdhjetë të shekullit XX dhe, pak më pas, iu shit nga i ati satanist dy satanistëve të tjerë, që ajo i kishte njohur vetëm me emrat Tomas dhe Helenë. Qe rritur në kushte të frikshme, në një jetimore të Hallit, të drejtuar nga dy pedofilë. Natën një pishtar ndriçonte dhomat e tyre dhe, kur drita binte mbi një fëmijë për një minutë apo dy, ai fëmijë e dinte se duhej të zbriste në katin e mëposhtëm, për t'u përdhunuar. Gjatë pushimeve të kaluara në Darlington, në moshën e vetëm shtatë apo tetë vjeçëve, kjo vajzë takoi të atin, i cili e vuri në lidhje me dy satanistët, Tomasin dhe Helenën. Ata ia nënshtruan drogave të tretura në lëngun e portokallit, apo në akullore dhe, natën, e patën çuar me një furgon në kisha të ndryshme në fushën përreth Darlingtonit. Drogat duhej ta bënin më të prirur ndaj kontrollit mendor, duke e penguar të kujtonte atë që shikonte. Do të ndalem mbi këtë aspekt në kapitullin e mëpasshëm. Një numër gjithmonë e më i madh njerëzish, që i kanë mbijetuar të kaluarës së tyre të llahtarshme, fillojnë tani t'i kujtojnë dhe tregojnë të gjithë pak a shumë të njëjtën histori. Disa ditë pas takimit tonë, m'u bë e ditur se ajo zonjë angleze ishte sulmuar nga gjashtë satanistë dhe ishte mbyllur në një furgon. Me një

shiringë të drejtuar në fyt, e urdhëruan të hiqte dorë së foluri me "atë Ikun budalla të rrezikshëm" dhe të mos tregonte emra të tjerë. I thanë se, nëse do të vazhdonte, jeta e saj dhe ajo e fëmijëve të vet do të kishte qenë në rrezik serioz. I thanë edhe se, nëse nuk mbyllte gojën, do t'i kishin rrëmbyer qenin e do t'ia kishin "ridërguar copa-copa". Çfarë njerëzish!

Gjatë riteve të ndyra që konsumoheshin pranë kishave të Darlingtonit, sikurse kujton informatorja ime, ajo dhe të tjerë fëmijë përdoreshin për rite me sfond seksual, që mbartnin me vete edhe tortura e vrasje. Dritaret e kishës errësoheshin me pëlhura të zeza dhe brenda zbukurohej, sipas ligjit satanik, me ngjyra të ndryshme, të përdorura për ceremoni të ndryshme dhe sipas stinës. Informatorja ime kujton qartë (Zot, ndihem keq edhe vetëm kur e mendoj!) se ka qenë e detyruar të shtrihej me barkun lart në dyshemenë e një kishe, teksa një fëmijë i pushtuar nga dënesat, që nuk ishte më shumë se gjashtë vjeç, mbahej pezull prej flokësh përsipër saj, dhe një burrë, që pastaj e njohu si njërin prej politikanëve më të spikatur të Irlandës së Veriut, e përdhunonte nga prapa. Kur pati mbaruar, nxorën një thikë dhe e therën fëmijën e gjaku u derdh sipër saj. "Kujtoj sytë e atij njeriu", më tha. "Ftohtësinë e syve të tij nuk do ta harroj kurrë". Shtoi edhe se ai parapëlqente meshkujt, në vend të femrave.

Informatorja ime më tha se më shumë se një herë ishte përdhunuar egërsisht nga një njeri, i cili për vite kishte qenë një politikan i rëndësishëm i Mbretërisë së Bashkuar. Nuk ishte veçse një fëmijë, kur ndodhte e gjitha kjo. Më tregoi se ai njeri ishte Eduard Hethi dhe emri i tij përmendet në intervistat e viktimave angleze të satanizmit. Hethi ka qenë kryeministër anglez nga viti 1970 deri në vitin 1974 dhe ka qenë anëtar i Grupit Bilderberg, të cilit i detyrohet futja e Mbretërisë së Bashkuar në Komunitetin (sot Bashkimin) Evropian. Një tjetër prej njerëzve të shumtë e të ndryshëm, që e kanë akuzuar Hethin për satanizëm, ka qenë zonja, për të cilën kam folur më përpara, që pa një figurë "formëhardhuce" pranë Burnham Beksit në Bukingamshir, afër rezidencës zyrtare të fshatit të kryeministrit britanik, e quajtur Chequers (loja e damës – përkth.). Dama luhet në një tavolinë me kuti të bardha e të zeza, që të kujton shresën e dyshemesë tipike të tempujve masonë. Kjo grua ishte e shoqja e përgjegjësit të rojeve të Burnham Beksit dhe banonte në atë vend bashkë me të shoqin. Ajo ishte rritur në Skoci brenda një familjeje satanistësh dhe që e vogël kishte pësuar abuzime seksuale nga ana e rrjetit skocez të Vëllazërisë. Edhe i shoqi ishte një satanist dhe kjo e shpjegon arësyen se pse i ishte besuar atij detyra për të mbikëqyrur Burnham Beksin, një zonë e mbuluar nga pyje të lashtë, e cila ra nën administrimin londinez dhe përfshin

një zonë të quajtur Pylli Egjiptian. Një natë, në orë të vonë, në fillim të viteve Shtatëdhjetë, gjatë qeverisë Heth, kjo grua ishte duke nxjerrë qenin shëtitje, kur pa disa drita. Ngadalë-ngadalë u afrua, për të parë se çfarë po ndodhte. Me llahtari të madhe pa se bëhej fjalë për një rit satanik dhe, midis të pranishmëve, figuronte kryeministri Eduard Heth dhe ministri i tij i Financave, Antoni Barberi. Gruaja shton se, teksa po e vrojtonte, Hethi filloi të shndërrohej në një zvarranik dhe se ajo që e befasoi më shumë ishte fakti se askush midis atyre njerëzve nuk u çudit aspak për këtë. "Pastaj u bë një zvarranik me të gjitha tiparet dhe u rrit në lartësi me rreth gjashtëdhjetë centimetra". Ajo shton se ishte "lehtësisht me luspa" dhe se "fliste në mënyrë mjaft të natyrshme, edhe pse dukej sikur zëri i tij vinte 'nga larg', pavarësisht se nuk kishte kaluar shumë kohë". Më kujtohet shumë mirë se e kam takuar Hethin në televizion në vitin 1989, gjatë një tribune politike elektorale, kur isha zëdhënës i Partisë së Gjelbër Britanike dhe nuk kam parë kurrë sy më të ftohtë e më shqetësues së të tijtë. Atëhere nuk kisha as idenë më të vogël të këtyre gjërave, por atë vështrim nuk e kam harruar dot më kurrë.

Një tjetër pedofil i famshëm dhe satanist britanik është Lordi MekAlpin, ish financieri i Partisë Konservatore të Hethit dhe drejtues i perandorisë "Ndërtime McAlpine". Ai i zuri vendin të ndjerit Xhimi Goldsmith si kreu i Partisë Referendare Britanike, e krijuar për t`u ndryshuar kursin grupeve që i kundërviheshin Bashkimit Evropian dhe për t`i shtyrë drejt dështimit të plotë. MekAlpini, që është i përfshirë gjer në grykë në një rrjet sektesh të fshehta në krye të Vëllazërisë, përfshirë Urdhërin e Masonëve, ka qenë akuzuar publikisht për pedofili nga revista investigative *Scallywag*[35]. Në vitin 1965, u akuzua se kishte pasur një marrëdhënie orale me një djalosh të mitur dhe pati marrë formalisht një njoftim nga policia e Strathklidit se kishte kryer abuzime seksuale me të mitur. Familja MekAlpin rrjedh nga një fis zvarranik skocez, sipas gjasës i lidhur me mbretin e lashtë skocez Kenet MekAlpin. Familja MekAlpin ka një histori të gjatë satanizmi pas shpine, ashtu sikurse edhe familja skoceze e Kesuikëve. Që të dyja bëjnë pjesë në një rrjet që vepron në të gjithë botën, nga Lindja e Largët në Australi. Një mik i ngushtë i familjes së MekAlpinëve është Uili Vitelau, president i Partisë Konservatore. Ai ka mbuluar edhe detyrën e zëvendëskryeministrit në qeverinë e Margaret Thetçerit, e cila gjatë viteve të saj në qeveri u "manovrua" nga Vitelau, nga MekAlpini dhe nga Sër Xhefri Hou. Vitelau është quajtur një satanist i vijës së parë nga satanisti, që e ka pranuar fajin, Derri Majnuaring-Knajt, pranë gjykatës mbretërore të Mejdstonit, në vitin 1986. Si zakonisht, ky pohim nuk pati asnjë pasojë[36].

LIBRI 24

Në Skoci, njëra prej qendrave më të rëndësishme satanike është Lok Nesi, afër Invernes, vendi që, sipas legjendës, strehon zvarranikun e famshëm, i quajtur "përbindëshi i Lok Nesit". Por cili mund të jetë simbolizmi i këtyre legjendave? Alejster Krouli, satanisti më i famshëm i shekullit XX, kishte një shtëpi në Lok Nes dhe pikërisht në këtë zonë ai u kthye për të kremtuar disa prej riteve të tij të fuqishme të magjisë së zezë. Një formacion shkëmbor pranë liqenit, i quajtur Shkëmbi i Mallkimeve, përdoret prej shtriganëve që prej mijëra vjetësh dhe Krouli ishte posaçërisht i terhequr nga energjia që lëshohej prej një mali të afërt, i njohur si Mealfuorvonie[37]. Të shumta janë aspektet e legjendës së përbindëshit të Lok Nesit, të cilin nuk e njohim dhe e njëjta gjë mund të thuhet për të tjera krijesa të paidentifikuara, si i ashtuquajturi Këmbëmadhi. Disa shamanë vendas amerikanë besojnë se qenia që shfaqet si Këmbëmadhi mund të paraqitet edhe në formën e një përbindëshi ujor, apo pantere, pasi zotëron aftësinë për të ndryshuar formë[38].

Shumë e shumë herë më janë përshkruar nga viktimat abuzimet që ato kanë pësuar, midis të cilave edhe programimi i trurit të tyre, pranë banesave elegante të aristokracisë, apo në dhoma nën *British Museum* dhe ndërtesave të tjera zyrtare londineze. Në këto dëshmi vazhdojnë të përsëriten emra ministrash konservatorë. Një tjetër pedofil është ish anëtari i parlamentit të Leikasterit, Gravil Xheneri, përkrahas këmbëngulës i çështjes hebreje në Britaninë e Madhe. Një vend, në të cilin konsumohen botërisht akte pedofilie, është pallati i quajtur Dolfin Skuar në Pimliko, pallati më i madh i Evropës, përveçse rezidenca londineze për shumë anëtarë të parlamentit. Ndërtesa është nën mbikëqyrjen e Doganës Britanike, që nga koha kur brenda saj është gjetur material pornografik i ardhur nga Amsterdami. Duket se një rezident i atyshëm ka thënë: "Shpesh enden nëpër korridore fëmijë të mitur krejtësisht të hutuar, që pyesin për apartamenrin e ndonjë deputeti të veçantë". Një rezident i Dolfin Skuarit me emrin David Stil, që ka qenë lider i demokratëve liberalë, ka mbështetur aktivisht fushatat në favor të të drejtave të homoseksualëve, të udhëhequra nga Ian Kempbell Dani, një arkitekt i komunës së Edinburgut. Por Mr.Kempbelli dëshiron diçka më shumë se sa njohja e të drejtave të homoseksualëve. Ai është një anëtar themelues i *Paedophile Information Exchange* (PIE), që kërkon të ligjërojë marrëdhëniet seksuale me fëmijët[39]. Atëherë përse Mr. Stili e mbështet këtë personazh? Duket se ish ministrat e qeverisë Majkëll Portilo e Piter Lilleji janë frekuentues të zakonshëm të restorantit të Dolfin Skuarit, bashkë me shumë politikanë të tjerë të famshëm. Pyes veten se çfarë ka që i tërheq aty. Ndoshta ushqimi. Vërtet, duhet të jetë pikërisht ushqimi!

Njerëzit mendojnë se abuzimet dhe flijimet e kryera gjatë ritualeve, nëse ekzistojnë, janë shumë të rralla. Përkundrazi. Flijimi njerëzor dhe abuzimet rituale janë në rendin e ditës. Mendoni për organizatën që kreu vrasje dhe abuzime mbi të miturit në Belgjikë dhe që zbuloi përfshirjen e policëve, gjykatësve dhe politikanëve të spikatur. E njëjta gjë është duke ndodhur në Uellsin e Veriut dhe në zona të tjera të Mbretërisë së Bashkuar. Mungesa e interesit nga ana e mediave është shokuese. Ted Gundersoni, një njeri që ka punuar 28 vjet brenda FBI-së, ka treguar gjatë një konference mbi kontrollin mendor në Shtetet e Bashkuara, se pas një kërkimi të gjatë e të thelluar, ka arritur në përfundimin se në SHBA ekzistojnë 3.750.000 satanistë praktikantë dhe se kryhen 50.000 deri 60.000 flijime njerëzore në vit. Terapeutët e pranishëm në konferencë kanë thënë se kishin mësuar prej pacientëve të tyre për ekzistencën e një varreze madhështore satanike në fushë të hapur, në rrethinat e Lankasterit, në Kaliforni[40]. Një tjetër duhej të ekzistonte në Matamoros të Meksikës.

Pak përpara se ky libër të çohej për t'u shtypur, më takoi një mik amerikan, i cili ishte duke shprogramuar një skllave me mendje të kontrolluar prej Vëllazërisë, që quhej Arizona Uilder. Në kapitullin e ardhshëm do të tregoj se si realizohet kontrolli mendor. Kjo grua ka qenë kontrolluar mendërisht që nga fëmijëria me qëllim që të besonte se ishte një e ashtuquajtur Hyjneshë Nënë, e cila kryen rite flijuese për nivelet më të larta të Vëllazërisë globale. Arizona ishte njëra prej vetëm tri grave në botë, që zinin ato nivele. Ajo ka kryer rituale për familjen mbretërore britanike, siç do ta shikoni në kapitullin e titulluar *Hyjnesha dhe mbreti*, dhe është një grua aq shumë e rëndësishme brenda krerëve të satanistëve, sa që duket se deri edhe mbretëreshës i është ndaluar t'i drejtojë fjalën gjatë ritualeve. Ajo është rritur për të mbuluar këtë rol dhe e ëma e saj rrjedh nga fisnikëria franceze. Arizona thotë se ka qenë programuar nga vetë Jozef Mengele (që e njeh si Grin, apo Grinbaum), një zvarranik në gjendje të ndryshojë formë, përveçse kontrollues mendor nazist i turpshëm dhe manipulues gjenetik, që u arratis në fund të luftës me ndihmën e shërbimeve sekrete britanike e amerikane, për të vazhduar të kryente krimet e tij në Mbretërinë e Bashkuar, në Shtetet e Bashkuara dhe në Amerikën e Jugut. Një herë ky i tregoi një merimangë të madhe sa një këmbë, frut i një eksperimenti gjenetik dhe, në vitet gjashtëdhjetë, e paraqiti tek Adolf Hitleri në Shtetet e Bashkuara. Ajo ka përshkruar mjaft struktura shumë sekrete të pranishme në territorin amerikan, që një miku im i ka parë me sytë e tij dhe çdo herë ka rezultuar i besueshëm në 100%. Arizona thotë se secila prej 13 familjeve në krye të Vëllazërisë globale ka Këshillin e vet të 13-ve. Këshilli më

i rëndësishëm i Shteteve të Bashkuara e ka selinë në Kaliforni dhe midis anëtarëve të tij figurojnë Robert Kalduelli, i biri i tij Riçardi, Xhim Kristenseni, Riçard Hoehni, Riçard Bredburi, Xhim Efersoni, Fred Dangeri dhe Frenk Koheni. Por kreu i atij këshilli, dhe anëtari më i lartë i Mendjendriturve (Vëllazërisë) i njohur prej saj, është një njeri, emri i të cilit me kod është Pindar dhe që e ka prejardhjen nga rajoni francez i Alzasë-Lorenës. Pindar do të thotë "penis i dragoit". Emri i tij, vazhdon Arizona, është markezi de Libo. Nuk e kam kuptuar ende nëse ky është emri i tij i vërtetë, apo mos bëhet fjalë për një tjetër pseudonim – ju mund të më ndihmoni? Kjo priftëreshë e lartë/Nënë Hyjneshë me mendje të kontrolluar qe fekonduar nga Pindari, duke iu përmbajtur asaj që ka thënë ajo vetë, por mendja e saj filloi të mos e pranonte programimin dhe ajo dështoi, duke dalë nga Vëllazëria. Sikurse ndodh shpesh, programimi i saj filloi të shpërbëhej kur programuesi i saj, Mengele, vdiq në fund të viteve tetëdhjetë të shekullit XX. Arizona thotë se Pindari, si të gjithë zvarranikët që ndryshojnë formë, ka ca sy tejet hipnotikë ("syri i keq" i legjendës) dhe se gjatë flijimeve, në çastin e vdekjes, fytyra e viktimës kthehet nga Pindari, në mënyrë që ky të grabisë shpirtin, ose energjinë e atij njeriu falë "syrit të keq" magnetik të tij.

Informacionet që vijojnë më janë dhënë nga Arizona: Pindari merr pjesë në ceremonitë më të rëndësishme satanike të Evropës dhe pastaj fluturon për në Kaliforni, për të qenë i pranishëm në ritet që kryhen atje. Në ceremonitë e kremtuara jashtë, në ambient të hapur, Arizona vishte një rrobë të kuqe dhe vendosej në mesin e një ylli pesëcepësh i rrethuar nga një ekzagramë, apo Ylli i Davidit... Viktimat për t'u flijuar, të cilat që nga lindja janë të caktuara për këtë qëllim, vriten sipas një rituali të përpiktë, gjatë të cilit atyre fyti u pritet nga e majta në të djathtë. Prej këtej e ka prejardhjen gjesti tipik masonik i të kaluarit të dorës përpara fytit, nga e majta në të djathtë, një lëvizje që do të thotë: "Je i vdekur". Gjaku i viktimave mblidhet dhe përzihet me arsenik, që duket se është një element thelbësor për familjet njerëzoro-zvarranike. Ai hidhet pastaj nëpër kupa dhe pihet prej satanistëve, së bashku me mëlçinë dhe me sytë e viktimës, pasi mendohet se këto pjesë të trupit i japin forcë një aftësie më të mprehtë perceptimi. Dhjami hiqet prej zorrëve dhe me të lyhen trupat e pjesëmarrësve – ashtu si dhjami i "messeh"-ut në Egjiptin e lashtë. Kufoma pastaj varet në një pemë dhe satanistët i kalojnë nën të lakuriq, në mënyrë që gjaku të kullojë mbi trupat e tyre. Nëna Hyjneshë thotë se në këtë pikë pjesëmarrësit janë në një gjendje të tillë eksitimi, sa shpesh marrin tipare zvarranike dhe një ngjyrë lëkure të bardhëllemë. Janë edhe të frikësuar, sepse në këtë kohë Nëna Hyjneshë zgjedh kafër prej tyre, që vriten sipas një rituali

të përpiktë. Klara Rivsi, presidente e shoqatës amerikane "Nëna kundër abuzimeve seksuale", më ka thënë se të paktën 12 fëmijë që pësonin rregullisht abuzime seksuale i kishin bërë të ditur se pjesëmarrësit në ato rite merrnin pamje zvarranikësh. Duke iu përmbajtur tregimit të Arizonës, familja mbretërore britanike, Ronald e Nensi Regani, Xherald Fordi, Xhorxh Bushi, dy djemtë e Bushit, që të dy guvernatorë, Henri Kisingeri, Njut Gingriçi, Bill e Hilari Klintoni, Rotshildët, Habsburgët, Bop Hopi, Rupert Murdoku dhe një sërë emrash të tjerë të famshëm, kanë marrë që të gjithë pjesë në ritet flijuese të drejtuara nga kjo Nënë Hyjneshë. Arizona ka pohuar edhe se i ka parë zvarranikët, të Hirtët, dhe hibridët njerëzoro-zvarranikë në shumë struktura të nëndheshme, përfshirë Zonën e turpshme 51, në Nevada. Gjithmonë sipas tregimit të saj, austronauti Neil Armstrong ka bërë në Hënë fotografi strukturash të ndritshme dhe banesash të nëndheshme. Duket se këto imazhe gjenden në një ndërtesë të Oklahoma Sitit. Nëna Hyjneshë ka thënë edhe se ka kryer ceremoni satanike në Francë, në të cilat ka marrë pjesë papa Gjon Pali II: duke iu përmbajtur te tjera burimeve brenda komunitetit të kontrollit mendor, edhe papa duhej të ishte një kukull me mendje të kontrolluar. Dhe një njeri, që ka lidhje me Vatikanin, më ka bërë të ditur se po ecet drejt helmimit të papës pak nga pak, për të bërë të mundur që ai të vdesë dhe të zëvendësohet nga dikush tjetër, i cili do të gjykohet i padëmshëm në çastin e duhur. Në javët dhe në muajt që vijnë do ta shohim papën gjithmonë e më të brishtë e më të sëmurë.

Do ta kisha të vështirë ta besoja atë që viktimat më kanë bërë të ditur, po të mos kisha dëgjuar aq shumë burime të ndryshme të palidhura midis tyre dhe po të ishte se historitë, të mbledhura në të gjithë botën, të mos përbënin analogji thelbësore, deri edhe përsa i përket hollësive të riteve dhe teknikave të programimit mendor. Ata fëmijë, të rritur të ardhshëm të traumatizuar, nuk dinë kujt t'i drejtohen. Historitë e tyre janë aq shumë mahnitëse e që të lënë pa mend, sa janë të paktë ata që i besojnë. Dhe ata fëmijë nuk guxojnë t'ia denoncojnë faktet policisë, sepse e dinë që organizata satanike përfshin midis radhëve të saj oficerë të lartë policie, gjykatës, funksionarë publikë, gazetarë, politikanë e shumë të tjerë, që kontrollojnë shoqërinë tonë të "lirë". Ndjenja e tyre e pafuqisë i shtyn të mendojnë se nuk ka asgjë që mund të bëjnë për të kërkuar drejtësi, kështu që heqin dorë nga gjithçka. Pjesa më e madhe dërrmuese e masonëve nuk janë satanistë, apo përdhunues fëmijësh, por ka një përqindje më të madhe pedofilësh brenda shoqërive të fshehta si Masoneria, se sa jashtë tyre. Prandaj, si mund të kesh besim tek drejtësia kur, për shembull, në distriktin e policisë të Lozhës masonike të Shën Xhejmsit,

LIBRI

nr. 9179, figurojnë agjentët kryesorë operativë të policisë të të gjitha njësive më të mëdha të Policisë metropolitane londineze, përfshirë skuadrën antiterroriste, skuadrën kundër mashtrimeve industriale dhe seksionin e hetimit mbi ankesat, që do të duhej të hetonin si pasojë e denoncimeve mbi gabimet e mundshme të kryera nga policia! Lozha e Shën Xhejmsit përfshin edhe funksionarë të rëndësishëm të ministrisë së Brendshme, të botës juridike dhe të drejtimit të Prokurorisë, që vendos nëse një njeri duhet, apo nuk duhet ndjekur. Si mundet një fëmijë të mbrohet nga e gjitha kjo?

Historitë, që disa njerëz më kanë treguar dhe raportet e lëna nga të tjerë, që kam lexuar, flasin për fakte që shkojnë përtej çdo përfytyrimi ose, të paktën, do të shkonin po të mos ishte se ndodhin me të vërtetë. Të pish gjak, të hash mish kufomash, mijëra fëmijë e të rritur të varrosur në gropa të thella, vrasje njerëzish të filmuara për të realizuar të ashtuquajturat *snuff video*, të gjitha këto gjëra janë thjesht të frikshme. Gjatë një serie të serialit të dokumentarëve *Dispatches* të transmetuar në Mbretërinë e Bashkuar nga *Channel Four*, një nënë ka treguar se ishte detyruar ta vendoste fëmijën e saj të posalindur sipër një altari satanik dhe të ngulte një thikë në zemrën e tij. Një satanist pastaj përdhunoi kufomën e tij. Këto gjëra ndodhin në vendin tuaj, TANI!

Shumë prej viktimave u përkasin familjeve të satanistëve, ndërsa të tjera rriten enkas për t'u flijuar pastaj, nëpërmjet grash të veçanta riprodhimi, që mbahen në robëri me qëllimin e vetëm që të pjellin njërin familjë pas tjetrit, i cili nuk regjistrohet formalisht në asnjë dokument zyrtar dhe, kështu që, nuk ekziston. Nuk mund të vritet dikush që nuk ekziston dhe, kështu që, këta fëmijë e këto fetuse flijohen pa dyshuar fare askush, jashtë rrethit të satanistëve, për ekzistencën e tyre. Ku Kluks Klani, organizata e fanatikëve të racës superiore ariane e themeluar nga satanisti mason Albert Pajk, është njëri prej grupeve të shumta, që i mbajnë gratë të izoluara për këtë qëllim[41]. Këto grupe kanë në dispozicion mami të tyret që mbikëqyrin lindjen, por shumë prej këtyre lindjeve ndodhin nëpër spitalet, nën kontrollin e personelit të lidhur me Vëllazërinë dhe besnikë ndaj satanistëve[42]. Të tjerë fëmijë, të cilët u përkasin familjeve që nuk i kushtohen satanizmit, grabiten në çastin e lindjes dhe prindërve u thuhet se fëmija ka vdekur, ndërsa, në realitet, është grabitur për t'u sekuestruar, ose për t'u përdorur në eksperimentet e kontrollit mendor, mbi të cilin do të ndalem në kapitullin e ardhshëm.

Një projekt hetimi mbi abuzimet rituale, i kryer nga Universiteti i Kolorados, ka vërtetuar se të gjithë të intervistuarit kanë pësuar dhunë ose ngacmime seksuale; 97% e tyre kishte marrë pjesë në flijime kafshësh; 97% ishte detyruar të merrte pjesë në marrëdhënie seksuale me të rritur; 97%

kishte pësuar tortura; 94% kishte pësuar marrdhënie seksuale nga prapa; 88% ishte detyruar të ishte i pranishëm, apo të merrte pjesë në flijime njerëzore; 88% të merrte pjesë në rite kanibalizmi. Rezultati i veprës së këtyre satanistëve është një listë shumë e gjatë vrasjesh foshnjash dhe jofoshnjash, përfshirë, për këtë jam i sigurtë, vrasjen ende të pashpjeguar të trembëdhjetëvjeçares Xhenet Tati, që ka ndodhur pranë Eksterit në Devon në vitin 1978. Trupi i saj nuk u gjet kurrë. Kam takuar njerëz që janë angazhuar prej vitesh në hetimet mbi këtë rast dhe provat dukeshin se tregonin përfshirjen e nje grupi satanist, në të cilin sipas gjasës bënin pjesë disa prej punonjësve më të spikatur të komisariateve të Devonit e të Kornovalies, pak milje larg vendit ku Xheneti ishte parë e gjallë për herë të fundit. Edhe i ati, Xhon Tati, duhet ende t'u përgjigjet pyetjeve të rëndësishme. Skeptikët, që pyesin me vete se si është e mundur që ky satanizëm i përhapur, këto dhuna seksuale e këto vrasje mund të mbahen fshehur, duhet të mbajnë parasysh tipin e njerëzve që janë të përfshirë në këto rrethe. David Berkovitci, *serial killer*-i i Nju Jorkut, i njohur si i Biri i Samit, ka shkruar se bënte pjesë në një grup satanik, që kishte orkestruar vrasje. Në disa letra drejtuar një prifti, Berkovitci rrëfen:

"...ky grup praktikonte rite të ndryshme satanike, disa prej të cilave bazoheshin mbi mësimet e Alejster Kroulit dhe të Elifas Levit (tjetër satanist i famshëm). *Ai praktikonte* (dhe praktikon ende) *akte vërtet të përgjakshme... Doktrinat e grupit janë një përzierje e druidizmit të lashtë, mësimeve të urdhërit të fshehtë të Agimit të Artë, magjisë së zezë dhe një sërë e gjatë me praktika të tjera të paligjshme e të neveritshme...".*

"...satanistët (ata të vërtetët) *janë njerëz të vecantë. Nuk janë fshatarë injorantë apo gjysmë-analfabetë. Përkundrazi, midis radhëve të tyre figurojnë mjekë, avokatë, afaristë dhe qytetarë në themel mjaft të përgjegjshëm... Nuk bëhet fjalë për ndonjë grup kokëkrisurish, të prirur për të kryer paudhësi. Ata janë përkundrazi nga ata që nuk flasin e të lidhur nga një nevojë dhe dëshirë e përbashkët për të mbjellë shkatërrim në të gjithë shoqërinë. Ka qenë Alejster Krouli ai që ka thënë: «Dëshiroj mbrapshtinë, vrasjen, përdhunimin, revolucionin, gjithçka që është e keqe»"*[44].

Satanizmi ka qenë krijuar nga zvarranikët, "engjëjt e rënë", dhe është interesant fakti se edhe ata, duke iu përmbajtur një shkrimi që i përket mijëra viteve më parë, kishin një "bir të Samit". Poeti arab Firdusi e përfundoi në vitin 1010 para Krishtit historinë e tij legjendare të Iranit, një vepër e quajtur

Shahnameh, apo *Libri i Mbretërve*. Ai shkruan për një mbret të quajtur Sam, që u martua me një grua shumë të bukur, e cila lindi një fëmijë me pamje jashtëtokësore. Përshkrimi i tipareve trupore të fëmijës imiton pikë për pikë atë të fëmijëve të lindur nga kryqëzimi i Gardianëve dhe grave njerëzore: ai ishte në fakt shumë i madh, e kishte lëkurën të bardhë dhe flokët si bora. Emri i tij ishte Zal, një fëmijë Nefilim, një Gardian (zvarranik) – një hibrid njerëzor. Dhe Zali ishte i biri i Samit. Në vitin 1969, Çarls Mansoni dhe "familja" e tij satanike vranë nëntë njerëz, përfshirë aktoren Sharon Tati. Mansoni veproi në Kaliforni gjatë periudhës së Fëmijëve të Luleve, kur në qytete si San Françiskoja doli në skenë një grup i quajtur "Procesi". "Procesi" kishte lindur në Britaninë e Madhe dhe pastaj kishte krijuar filiale në Kaliforni e në Nju Jork. Ky grup ngre lart figurën e Adolf Hitlerit dhe nderon një Trinitet të përbërë nga Jehovai, Luçiferi dhe Satanaja. Në revistën britanike të okultizmit me titullin *The Lamp Of Thoth* një autor me emrin Horor H. ka thënë për Çarls Mansonin: "(Ai) na ka treguar se ç'do të thotë të kryesh me të vërtetë krimin që ne do të dëshironim të kryenim... Mansoni e humbi atje ku të tjerë si Procesi patën sukses. Ai u kap"[45]. Një tjetër *serial killer* me emrin Henri Li Lukas, të cilit i atribuohet vrasja e 360 personave, përfshirë të ëmën, ka deklaruar se bënte pjesë në grupin satanik të quajtur "Dora e vdekjes". Ai ka thënë se vrasja ishte pjesë e ceremonisë së pranimit në këtë sekt dhe ka pohuar se ka pirë gjakun e disa prej viktimave të tij. "Dora e vdekjes", ka shtuar, ka qenë e përfshirë në trafikun e drogës dhe në grabitje fëmijësh të destinuar për skllavërinë, apo për flijimin. Lukasi ka rrëfyer edhe se, pasi i vriste këta fëmijë, grupi u pinte gjakun dhe ushqehej me disa pjesë të trupit të tyre. Riçard Ramirez, *serial killer*-i i njohur si "gjahtar në pritë", ka rrëfyer se ka vrarë trembëdhjetë viktima në emër të Satanasë. Yje pesëcepash të përmbysur, simbole klasike të Satanasë, janë gjetur të vizatuara me spraj nëpër shtëpitë e shumë prej viktimave të tij.

Numri i vrasjeve, që në të gjithë botën bëjnë pjesë në praktikat satanike, është thjesht tepër i lartë. Teksa shkruaja këtë libër, dëgjova të flitej për vrasjen rituale të Alfred Kuncit, një prift katolik rebel, që i ishte kushtuar namatisjes. Ai u gjet në mars të vitit 1998 në kishën e tij të Medisonit, në Uinskonsin, i varur me kokë poshtë, me fytin të prerë nga njëra anë në tjetrën. I ishte prerë pastaj koka dhe gjaku i tij ishte marrë. Këto qenë rrethanat, mbi të cilat FBI-ja ka ngarkuar të hetonte. Edhe vrasjet e presidentit Kenedi dhe të princeshës Dajana ishin të mbushur me simbolizëm satanik, siç do ta tregoj më pas. Në çdo shtet ku shkoj, dëgjoj të njëjtat histori me rite satanike, përdhunime seksuale e flijime dhe, deri edhe në ishullin Uajt, ishulli i vogël në gjerësitë e

brigjeve jogore të Anglisë ku kam jetuar për shumë vite, praktikohen rite të panumërta satanike. Gazeta *tabloid* e së dielës më e shitura në Britaninë e Madhe, *The News Of The World*, ka publikuar rrëfimet e një punonjëseje të ndihmës sociale të ishullit Uajt, që ka nxjerrë në dritë natyrën dhe nivelin e abuzimeve të kryera. Ajo ka thënë se njerëzit që i kushtoheshin flijimit të fëmijëve ishin tamam shtylla të vërteta të komunitetit lokal, pronarë hotelesh përgjatë plazhit, afaristë, funksionarë të qeverisjes lokale dhe politikanë. Ajo ka përshkruar edhe programin që parashikon rritjen e fëmijëve të caktuar për flijim dhe, tjetër element që përsëritet herë pas here, ka zbuluar lidhjet midis këtij programi dhe rrethit të pedofilëve e të trafikantëve të drogës. Kryeinspektori i ngarkuar me hetimet, Neil Kingmani, ka thënë: "E kam takuar këtë ndihmëse sociale shumë herë dhe kam pyetur të tjerë njerëz mbi këtë argument. Nuk kam arsye të dyshoj për atë që më është bërë e ditur"[46].

Ka pasur shumë raste të famshme, në të cilat është folur për abuzime rituale, por gjithçka pastaj është mbuluar në heshtje nga autoritetet politike e gjyqësore dhe nga disa medja të disinformuara e të njëanshme. Njëri prej rasteve më të bujshme ka qenë, në Shtetet e Bashkuara, rasti MekMartin i Los Anxhelesit, që doli në dritë në vitin 1983. Ai bazohej mbi dëshmitë e 369 fëmijëve, të cilët frekuentonin kopshtin e fëmijëve MekMartin dhe që treguan se ishin përdhunuar. Ata treguan për kafshë që vriteshin dhe për të tjera rite satanike. Përshkruan se si varroseshin, të mbyllur në errësirë, dhe se si çoheshin në vende të tjera për t'u përdhunuar. Midis këtyre vendeve figuronte një dyqan bakalli, një varrezë, një kishë dhe një krematorium. Fëmijët treguan se ishin detyruar të pinin gjak e urinë dhe kishin parë një të posalindur, të cilit i ishin shkulur sytë dhe trupi i të cilit ishte shkrumbuar. Ky rast qe objekt hetimesh për katër vjet, qe nën proces për dy vjet e gjysmë, pa të përfshirë 124 dëshmitarë, çoi në përpilimin e 50.000 faqeve procesverbali dhe kushtoi gati 23.000 dollarë në ditë. Por, më në fund, nuk u bë asgjë dhe përgjegjësit u kthyen në liri. Në themel të historive të fëmijëve ishte përshkrimi i një rrjeti galerish të fshehta nën ndërtesë, ku thoshin se i çonin për t'i përdhunuar. Gjatë procesit u deklarua se nuk ekzistonte asnjë provë e ekzistencës së këtyre galerive, por, pesë muaj pas mbylljes së fashikujve të rastit MekMartin dhe mbulimit zyrtar të provave, një skuadër hetuesish dhe gërmuesish ekspertë zbuloi sistemin e galerive, i cili të çonte në një dhomë të mbuluar me qemerë, nën kopshtin e fëmijëve. Këto galeri vazhdonin nën ndërtesat ngjitur, ku fëmijët patën thënë se i kishin çuar para se të transferoheshin në vende të tjera. Në vitin 1991, një arkeolog pohoi ekzistencën e galerive dhe të një sistemi alarmi brenda kopshtit të fëmijëve. Me fjalë të tjera, fëmijët kishin thënë të

vërtetën. Rezultati i kësaj fshehjeje të çekuilibruar dhe, natyrisht, i faktit që provat e dhëna nga fëmijët janë tmerrësisht tronditëse, është se në pjesën më të madhe të rasteve as edhe nuk arrihet fare në një proces dhe, edhe kur arrihet, janë të pakët ata që përfundojnë në burg. Publiku parapëlqen të besojë se ato akuza nuk janë të vërteta, sepse dëshiron të besojë që ato llahtari nuk ndodhin realisht. Fatkeqësisht ndodhin që ç'ke me të e në një shkallë të gjerë dhe, nëse i mohoni sepse nuk doni të përballeni me të vërtetën që i përket botës suaj, atëherë do të kontribuoni që fëmijët të trajtohen në këtë mënyrë të poshtër. Siç ka thënë Karolinë Lekiari e Shoqatës kombëtare për kujdesin e të rinjve:

"Nuk çuditem që njerëzit e kanë të vështirë t`u besojnë këtyre gjërave të paimagjinueshme e, megjithatë, çdo element vërteton se janë duke ndodhur realisht. Fëmijët e vegjël vizatojnë gjëra që nuk paraqiten në televizion. Në dy vitet e fundit jam marrë me këtë fenomen, jam ndeshur në shumë raste abuzimesh të kryera brenda ceremonive rituale dhe shumë prej këtyre gjërave ndodhin kudo; njerëzit duhet me të vërtetë të hapin sytë"[47].

Abuzimet e kryera gjatë riteve satanike janë të përhapura në nivel botëror, brenda grupeve ku figurojnë emrat e të fuqishmëve midis politikanëve më të spikatur, funksionarëve të qeverisë, bankierëve, industrialistëve, avokatëve, gjykatësve, mjekëve, mjekëve ligjorë, botuesve, drejtorëve të gazetave dhe gazetarëve. Të gjithë njerëz që shërbejnë, në fakt, për t'i realizuar dhe mbajtur fshehur këto rite dhe këto krime kundër njerëzimit. Nuk është se kush studion këtë fenomen shikon satanistë kudo. Përqindja e tyre në pozitat e kreut është shumë e lartë, sepse kështu duhet të jetë. Organizatat satanike kontrollojnë sistemin, duke siguruar kështu që të ketë një numër shumë të madh satanistësh në pozita pushteti, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

Këngëtarja Xhoan Baez këndon një këngë, në të cilën flitet për abuzimet e pësuara në fëmijëri, që ridalin në dritë dora-dorës që pengesat e amnezisë fillojnë të bien, që kontrolli mendor lirohet dhe kujtimet dalin përsëri në sipërfaqe. Fjalët e kësaj kënge shprehin në mënyrë të shkëlqyer përshtypjet që provojnë këta individë:

Nuk duhet të më dëgjosh përsëri një tjetër herë
Për të kapur kuptimin e vargjeve të mia,
Nuk duhet të vdesësh e të shkosh në ferr
Për të provuar mallkimin e Djallit.

LIBRI 24

Besoja me të vërtetë se jeta ime ishte një fotografi,
Mbi kartolinën e ditëlindjes që tregon një familje.
Fëmijët të gjithë të veshur me sumbulla e fjongo,
Dhe të vendosur në rresht në oborr.
Ditët e praruara të fëmijërisë
Ishin me të vërtetë kaq poetike e të nxehta?
Apo imazhi ka filluar të zbërdhylet,
Ditën kur unë linda.

Që nata të fillojë, ka një kërcitje lëkure,
Dhe një skuqje të papritur,
Është një djalë i vogël që kapërcen një kokë dhie,
Dhe një vajzë e vogël që bën rolin e prostitutës.
Ka një flijim në një kishë të zbrazët,
Të Rozit të vogël e të dashur,
Dhe një njeri me një maskë mesianike,
Është duke më zhveshur.
I pashë të ndezin qirinjtë,
I dëgjova t'i bien tamburit,
Dhe bërtita "nënë, nënë, jam e ftohtë si akull,
Dhe nuk di ku të iki që shpëtoj".

Kështu paguaj për të pasur mbrojtje,
Dhe zbuloj të vërtetën,
Duke ndjekur kujtimet,
Duke gozhduar provat.

Do të ndaloj përpara altarit tuaj,
Dhe do të them gjithçka që di,
Kam ardhur për të kërkuar kthimin e fëmijërisë sime,
Në kishëzën e Rozit të vogël[48].

Kjo këngë përshkruan me fjalë një përvojë me të vërtetë dramatike dhe shumë mijëra fëmijë duhet të provojnë të njëjtin ankth në të gjithë botën, sot dhe çdo ditë tjetër. Ka ende ndonjë që mendon se duhet të kthehemi nga ana tjetër dhe të mos e çajmë kokën? Apo që duhet të gënjejmë veten, duke thënë se nuk bëhet fjalë për gjëra të vërteta? Apo ka arritur çasti të shkundemi? Çasti për të bërë një kthesë?

Kapitulli 16

Ku kanë përfunduar të gjithë fëmijët?

Organizatat satanike janë një pjesë vitale e programit të kontrollit mendor, me qëllimin për të krijuar një racë automatësh pa inteligjencë dhe një seri të pafund vrasësish me mendje të pilotuar, banditësh të çmendur dhe agjentësh provokues. Robotët njerëzorë – skllevër me mendje të kontrolluar – janë të pranishëm midis nesh që prej mijëra vjetësh dhe sot janë shumëfishuar. Sikurse pohojnë Fritc Springmejeri dhe Sisko Veleri në studimin e tyre të hollësishëm mbi kontrollin mendor:

"Teknikat themelore janë vënë në veprim brenda familjeve gjermane, skoceze, italiane e angleze dhe janë zbatuar prej shekujsh. Disa thonë se këto teknika i përkasin Egjiptit të lashtë e Babilonisë së lashtë dhe besimeve të lashta misterike. Është e njohur që nazistët studiuan tekste të lashta egjiptiane, për kërkimet e tyre mbi kontrollin mendor. Dokumentet dhe sekretet, që këto familje trashëgojnë nga brezi në brez, janë krejt të padepërtueshme"[1].

Kontrolli i mendjes dhe i emocioneve njerëzore është themeli mbi të cilin bazohet kontrolli zvarranik i gjinisë njerëzore. Nëse kontrolloni mendjen e

LIBRI 24

një njeriu, kontrolloni vetë atë njeri. Manipulimi i jashtëm i mendjes merr forma të shumta dhe çështja nuk është se sa shumë janë ata që janë mendërisht të kontrolluar, por sa pak janë ata që nuk janë të kontrolluar. Lindja e qendrave të shumta aktuale të kontrollit mendor mund ta ketë zanafillën tek Drejtoria e seksionit të luftës psikologjike e ushtrisë britanike, e komanduar nga gjenerali i brigadës Xhon Raulings Ris. Kjo strukturë ishte e lidhur me Klinikën Tavistok, e krijuar në vitin 1920 me mbështetjen e drejtpërdrejtë të familjes mbretërore britanike, nëpërmjet dukës së Kentit. Më pas lindi në Londër Instituti Tavistok për Marrëdhëniet Njerëzore, që është qendra e një rrjeti global, i cili përfshin edhe Institutin Stanford në Shtetet e Bashkuara. Qëllimi i këtyre qendrave është kontrolli i njerëzimit nëpërmjet manipulimit të jashtëm të mendjes. Raulings Risi ka qenë një racist këmbëngulës dhe një përkrahës i lëvizjes eugjenetike për një "racë superiore". Gjatë Luftës së Parë Botërore ai studioi "neurozat e luftës" dhe kuptoi se, në kushtet e duhura, sjellja me nerva të sëmura mund të nxitej e të kontrollohej. Në librin e tij të titulluar *The Shaping Of Psychiatry By War* (Modelimi i psikiatrisë nëpërmjet luftës), të publikuar në vitin 1945, shkruan se Grupi Tavistok kishte treguar gjatë Luftës së Dytë Botërore se, midis popullsisë, ekzistonte "një e dhjeta psikopate", që rezultonte budallaqe. Numëri i këtyre njerëzve, thotë, duhej kontrolluar për të mbrojtur shoqërinë e qytetëruar dhe ishte e nevojshme të merreshin masa paraprake, përfshirë trajtimin psikiatrik, për të penguar që ky numër të rritej - veçanërisht në vendet koloniale të pazhvilluara, që kërcënonin botën e qytetëruar. Bëhej fjalë për hajvanllëqet e zakonshme ariano-zvarranike dhe Henri Kisingeri, David Rokfeleri e Adolf Hitleri nuk do të kishin mundur t'i thoshin më mirë. Raulings Risi thotë pastaj se ishte një tjetër një e dhjetë e popullsisë që, për shkak të epërsisë së saj gjenetike dhe stërvitjes së saj psikologjike, ishte e përshtatshme për të zënë pozita pushteti (zvarranikët dhe hibridët e tyre). Tetëdhjetë përqindshi tjetër midis këtyre dy skajeve mundej, sipas mendimit të tij, t'i shërbente në mënyrë të dobishme elitës gjenetike, me kusht që neurozat e saj të mund të ishin të kontrolluara. Raulings Risi kërkonte që psikiatrit të vepronin në të gjitha nivelet e shoqërisë, në shtëpi, në punë e në shkolla, dhe bëri të mundur që Grupi Tavistok të stërviste ato që i quajti "trupa shok", ose psikiatër që bënin punën e "këshilltarëve" në mjedisin e administratës së afarizmit, në atë ushtarake, politike e shkollore. Një anëtar i Dhomës së Lordëve më ka pohuar se doktor David Oueni, sot Lordi Ouen (Bil, TC), ministër i Jashtëm britanik në vitet shtatëdhjetë, themelues i Partisë Socialdemokrate dhe negociator paqeje për Bashkimin Evropian në Bosnje, ka qenë ushtruar tek Instituti

Tavistok, por deri tani nuk kam arritur ende të kem provën e kësaj.

Në vitin 1947, Raulings Risi e bëri të njohur "pikëpamjen" e tij në Kombet e Bashkuara dhe formoi Federatën Botërore të Shëndetit Mendor së bashku me Monteg Normanin, guvernatorin e Bankës së Anglisë, që është financuar e manipuluar Adolf Hitlerin dhe nazistët gjatë ngjitjes së tyre në pushtet. Si zakonisht, lindën në të gjithë botën duzina me organizata të varura e të kontrolluara nga qendra me të njëjtin urdhër dite. Në çdo vend këto grupe ia nënshtruan popullsinë një pune manipulimi të tillë mendor, që të siguronin angazhimin e saj të pakushtëzuar në shërbim të Urdhërit të Ditës së Vëllazërisë. Shumë prej këtyre njerëzve u bënë krerë të vendeve të Botës së Tretë që, në dukje, po fitonin "pavarësinë" e tyre. Në realitet, ato vende vazhduan të jenë të kontrolluara gjithmonë nga të njëjtët njerëz të mëparshëm. Në të njëjtin drejtim ecte edhe Organizata Kulturore e Sociale e Kombeve të Bashkuara nën *leadership*-in e një tjetër programuesi mendor të Vëllazërisë, Xhulian Hukslejit. I ndjeri doktor Fred Uils, ministër i Jashtëm i Guajanës, e ka përshkruar situatën në mënyrë të shkëlqyer, kur tha se Kombet e Bashkuara çonin përpara programin më të gjerë e të pareshtur të shpëlarjes së trurit, i rezervuar për krerërt e vendeve në rrugën e zhvillimit. E njëjta gjë vlen edhe për krerët e vendeve të zhvilluara industriale, mendjet e të cilëve manipulohen para se të munden të mbulojnë pozita pushteti politik dhe ekonomik. Shoqëritë më të mëdha përdorin sot ca "psikologë" dhe ca "lehtësuesa" apo "përgjegjësa grupi" për të drejtuar mbledhjet e ndërmarrjeve. Por cili është funksioni i tyre i vërtetë? Dhe për kë punojnë? E gjitha kjo bën pjesë në planin Tavistok, i cili parashikon futjen e "psikiatërve" në çdo nivel të shoqërisë, të fshehur prapa figurave të tjera profesionale. Prapa kulturës së drogës dhe të lëvizjes *hipi* të viteve gjashtëdhjetë të shekullit XX qëndronte pikërisht Tavistoku. Në vitin 1961, Aldous Huksleji, agjent i Institutit Tavistok, përveçse udhëheqës shpirtëror i "revolucionit" të viteve që pasuan, i ka zbuluar këto plane gjatë një konference në Shkollën Mjekësore kaliforniane të San Françiskos. Ja ajo që ka thënë:

"Brezi i ardhshëm, ose thuajse, do të njohë një metodë farmakologjike, që do të jetë në gjendje t'i bëjë njerëzit ta duan gjendjen e tyre të nënshtrimit dhe të prodhojnë diktatura, si të thuash, pa përjashtime. Të krijojë një farë kampi përqëndrimi të padhembshëm për tërë shoqëritë, në mënyrë që njerëzit të jenë të privuar nga liritë e tyre, por do të jenë të lumtur për këtë, sepse do të jenë zhveshur nga çdo dëshirë rebelimi - nëpërmjet propagandës, apo larjes së trurit me metoda farmakologjike. Dhe ky duket se është revolucioni përfundimtar".

Sot kemi mbërritur pikërisht në këtë pikë. Vepra e Xhon Raulings Risit është çuar përpara nga të tjerë operativë të Institutit Tavistok, si doktor Kurt Leuini dhe Tavistoku ka vënë në veprim teknika edhe më të sofistikuara për kontrollin individual e kolektiv të mendjes njerëzore. Falë këtyre të fundit, njerëzimi është bërë gjithmonë e më shumë pa mendim dhe gjithmonë e më shumë i ngjashëm me robotin. Instituti Tavistok u bë qendra e një rrjeti global, dora-dorës që financime të pakufizuar i jepeshin nëpërmjet fondacioneve "bamirëse" të sponsorizuara nga familja mbretërore dhe nga familjet tashmë të njohura, si Rokfelerët, Rotshildët, Melonët e Morganët. Grupet "terroriste" të krijuara nga Tavistok përdoren për të mbjellë konflikte dhe pështjellime në vende ku Vëllazëria dëshiron të ndryshojë qeverinë, ose të justifikojë vendosjen e trupave "ruajtëse të paqes". Kjo është ajo që ka ndodhur në Kenia, në Algjeri, në Ruanda, në Burundi, në Kongo dhe lista duket e pafund. Po ai gjeneral brigade, Frenk Kitson, përgjegjës i konflikteve të tilla dhe i tmerreve në Afrikë, në vitin 1970 u dërgua në Irlandën e Veriut, për të nisur fushatën fillestare të bombardimeve dhe të vrasjeve, që pastaj shpuri në konfliktin verioro-irlandez, në zhvillim edhe sot e kësaj dite. Këto konflikte të përhapura në të gjithë botën nxisin dëshirën që të bëhet diçka dhe ajo "diçka" është gjithmonë centralizim i mëtejshëm i pushtetit.

Në vitin 1991, gazeta e Institutit Tavistok, *Human Relations*, foli për projektin e qeverisë botërore, duke thënë se shembja e Bashkimit Sovjetik (e orkestruar nga Vëllazëria) kishte krijuar mundësi të mëdha për një qeveri botërore dhe për fundin e shteteve nacionale. Gazeta propozonte një reformim të Kombeve të Bashkuara, që do të ishte detyruar t'ia dorëzonte të gjitha operacionet një rrjeti me disa qindra mijëra "organizata joqeveritare" (të kontrolluara nga qendra). Këto do të vepronin përtej kufijve kombëtarë dhe nuk do të ishin subjekt i asnjë kontrolli nga ana e qeverive të zgjedhura. E gjitha kjo bën pjesë në një plan sistematik të diktimit të vullnetit të zvarranikëve mbi mendjen njerëzore kolektive, një plan që ekziston që nga vitet pesëdhjetë të shekullit XX dhe që ka bërë gjithmonë e më shumë përparime. Pas Luftës së Dytë Botërore, Vëllazëria nuk u mbështet më në kontrollin e territorit, por në kontrollin e mendjeve dhe të financave. Njerëzit rebelohen kundër pushtimit të tokave të tyre, por është shumë më e vështirë të dallosh dhe, pra, të pengosh, pushtimin e mendjes tënde dhe kontrollin e zgjedhjeve të tua financiare. Më 6 shtator 1943, gjatë një konference në *Harvard University*, Uinston Çurçilli tha se, të kontrolluarit e asaj që njerëzit mendojnë, të jepte mundësi shumë më të mëdha në krahasim me pushtimin e tokave dhe të provincave, apo të shfrytëzimit të tyre.

Bashkë me Departamentin britanik të luftës psikologjike dhe me planin Tavistok, ky tip kërkimi u shtri me shpejtësi nën regjimin fashist, në Gjermani dhe në Itali. Jozef Mengel, "engjëlli i vdekjes", drejtoi eksperimente të kontrollit mendor mbi mijëra binjakë nën mbikëqyrjen e Hajnrih Himlerit, në Instituin Mjekësor "Kaizer Vilhelmi" të Berlinit. Mengele rridhte nga një familje e pasur zvarranike, që i kushtohej satanizmit. Ishte një ekspert i demonologjisë dhe i Kabalës dhe ishte të paktën Mjeshtër i Madh i Urdhërit të Mendjendriturve[2]. Si "mjek" i kampit të përqëndrimit të Aushvicit, i drejtuar nga gjigandi kimik *I.G. Farben*, ai mundi të kryente eksperimente mbi mijëra të burgosur. Kur në vitin 1945 trupat aleate ishin duke përparuar në Gjermani, u realizua operacioni i shërbimeve sekrete të Shteteve të Bashkuara dhe të Britanisë së Madhe i quajtur Plani Paperklip, për t'i dhënë mundësi Mengelit dhe lidershipit nazist të Elitës, "shkencëtarëve", "mjekëve" dhe personelit ushtarak, të largoheshin. Mengele u zhduk nga Aushvitci në janar të vitit 1945 dhe opinionit publik iu tha se ishte arratisur në Amerikën e Jugut. Në realitet, ai udhëtoi në të gjithë botën dhe punoi si për Institutin Tavistok të Londrës edhe për Shtetet e Bshkuara, ku njihej si doktor Grini, apo Grinbaum[3]. Dokumentet zyrtare gjermane, që përshkruanin studimet e Mengelit mbi kontrollin mendor, u sekuestruan nga amerikanët në mbarim të luftës dhe ato miliona fletë gjenden ende në *Suitland Annex* të Uashingtonit, ku ruhen nën një mbikëqyrje të rreptë[4]. Shumë dokumenta, që kanë të bëjnë me ato eksperimente të kontrollit mendor mbi të internuarit, janë shkatërruar në galeritë e nëndheshme të shtabit të përgjithshëm të CIA-s, në Langlej të Virxhinias, në bregun tjetër të lumit në krahasim me Uashingtonin, ku ekziston një zonë gjysmë e nëndheshme e njohur si "Miniera" dhe ku dokumentet shkatërrohen njëzetë e katër orë në njëzet e katër orë[5].

Të mbijetuarit e kontrollit mendor të asaj kohe kujtojnë uniformën e pastër e të rregullt të Mengeles dhe çizmet e lustruara, që mbante gjatë seancave të programimit. Kujtojnë theksin e tij të fortë gjerman, hapësirën që ndante dhëmbët e tij prerës, dhe mënyrën që i ishte bërë zakon të ngulte gishtin e madh në pëllëmbën e dorës[6]. Ata që e koordinuan Planin Paperklip dhe programet e mëpasshme të kontrollit mendor në Shtetet e Bashkuara ishin vëllezërit Dalles, kushërinj të Rokfelerëve, që të dy satanistë, zvarranikë dhe nazistë këmbëngulës. Xhon Foster Dallesi u bë sekretar i shtetit pas luftës, ndërsa i vëllai Allen Dallesi u emërua në krye të Agjensisë së re të Shërbimeve Sekrete, CIA-s. Përgjegjësi i këtij projekti programimi të kontrollit mendor zyrtarisht ishte Euin Kameroni, një individ jashtëzakonisht i sëmurë, anëtar i njërës prej familjeve skoceze zvarranike të Elitës. Që fëmijë, libri i tij i preferuar

ishte *Frankenstein*-i që, siç ka thënë ai, e shtyu të ndërmerrte një karrierë në fushën e psikiatrisë. Që nga baza e tij në Montreal të Kanadasë, ai koordinoi operacionin e turpshëm të kontrollit mendor MKUltra falë financimeve nga ana e emrave të njohur si Rokfelerët, dhe pati lidhje të rregullta me Alen Dallesin dhe CIA-n. Njëri prej institucioneve të Kameronit ushtroi 60.000 elektroshokë ndaj pacientëve në një vit të vetëm: më 1961. Emri i koduar i Kameronit ishte "Doktori i Bardhë" dhe në fakt ngjyra merrte një rëndësi themelore për kërkimet e tij. Ai u përpoq të zbulonte mënyrën për t`i shndërruar sytë gështenjë në të kaltër. Do të jetë vetëm një përkim i rastësishëm fakti që këngëtarja *country* Kristal Gejli, që thuhet se ka qenë një skllave me mendje të kontrolluar[7], ka inçizuar një disk të titulluar *Don`t It Make Your Brown Eyes Blue?* (Sytë e tu gështenjë nuk bëhen blu?)!

Shumë prej riteve dhe prej metodave të përdorura në mjedisin e projekteve të kontrollit mendor frymëzohen tek shkollat misterike. Admirali Stanfield Tërner, drejtori i CIA-s, ka pranuar publikisht në vitin 1977 se miliona dollarë ishin shpenzuar për të studiuar ritet vudú, shtrigërinë dhe artet medianike dhe, gjatë audiencës në Senat më 3 gusht 1977, tha se CIA kishte kontrolluar mendërisht një numër të madh njerëzish pa dijeninë dhe pa pëlqimin e tyre. Operacioni MKUltra ka përfshirë të paktën 185 shkencëtarë, 80 institucione amerikane, midis të cilëve burgje, firma farmaceutike dhe 44 spitale mjekësore. Rreth 700 droga përdoren nga profesorët e çmendur të Vëllazërisë në mjedisin e projekteve të tyre të kontrollit mendor, për të krijuar robotë njerëzorë. Ja përse qenë gjetur aq shumë droga brenda kompleksit të Xhonestounit, në Guajana, në vitin 1978, kur u vranë qindra anëtarë të një sekti. Bëhej fjalë për "kultin" e Tempullit të Popullit, i krijuar nga agjenti operativ i CIA-s Xhim Xhonsi. Nuk bëhej fjalë për një besim të ri, siç deshën ta paraqesin mediat, por për një eksperiment të kontrollit mendor. Drogat përdoren që nga kohërat e lashta për të manipuluar mendjen e njerëzve dhe për t`i çuar në gjendje të ndryshuar të vetëdijes. Organizmat e CIA-s dhe të shërbimeve sekrete britanike financojnë kërkime mbi drogat (me fjalë të tjera janë taksapaguesit që i financojnë), për të zbuluar metoda gjithmonë e më të efektshme për të shtypur vetëdijen dhe vullnetin. Njëra prej qendrave të përfshira në kërkimet mbi drogat për CIA-n është *California Medical Facility* e Vakavilit, ku punonte doktor Artur Nugenti. Janë realizuar dhe vazhdojnë të realizohen eksperimente të panumërta. Bën pjesë midis këtyre përhapja e drogave, që kontrollojnë mendjen, ndërmjet pjesëtarëve të forcave të armatosura të spitalit të marinës të Batesdas, në Meriland (sikurse është treguar në një dokumentar televiziv).

Prozac-u është një ilaç që shfaqet vazhdimisht në studimet në këtë fushë dhe nuk është i kufizuar në projektet e kontrollit mendor individual, por jepet si hape nga mjekë më shumë të interesuar për përfitimet dhe për ambiciet e kartelit farmaceutik, se sa për shërimin e pacientëve të tyre.

Është fjala për njërin prej ilaçeve, që jepet më shumë në botë për të kuruar depresionin dhe, ndërsa jam duke shkruar, firma *Eli Lilly* po përpiqet të marrë lejen për të hedhur në treg një version të *Prozac*-ut të destinuar për fëmijët, me shije menteje dhe portokalli.

Vetëm në Shtetet e Bshkuara tashmë 400.000 të rinj nën moshën 18 vjeç kurohen me *Prozac* dhe jemi vetëm në fillim. Është fjala për një operacion të kontrollit mendor në masë, me qëllimin për të krijuar një racë automatësh. Firma *Eli Lilly* ka lidhje të ngushta me organizma të Morganëve e të Rokfelerëve, me shërbimet sekrete amerikane dhe me Xhorxh Bushin. Midis firmave të tjera farmaceutike të angazhuara në kërkimet mbi drogat për projekte të kontrollit mendor figurojnë *Sterling Drug* (e lindur nga *I.G. Farben*-i i Hitlerit), që është e lidhur me familjen zvarranike të Krupëve, me Fondacionin Tinker të CIA-s dhe me Urdhërin e Shën Gjonit të Jeruzalemit; dhe shoqëria kimike *Monsanto*, presidenti i së cilës Irl H. Harbison i riu është edhe president i Shoqatës së Shëndetit Mendor, drejtor i të turpshmit *Bethesda General Hospital*, ku skllevërit programohen për një projekt të kontrollit mendor të quajtur Projekti Monark[8].

Kontrolli mendor i bazuar mbi traumën

Projekti Monark është njëri prej degëve të shumta të operacionit MKUltra, një program që, në kundërshtim me përgënjeshtrimet zyrtare, jo vetëm sot vazhdon të zbatohet nën emra të tjerë, por edhe e ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme zonën e zbatimit të tij. Këto projekte, të përhapura në nivel botëror, shfrytëzojnë një teknikë të quajtur kontroll mendor, i cili bazohet mbi traumën dhe tani mund ta kuptojmë se si arganizatat sataniste futen në këtë kuadër. Mendja është e pajisur me një mekanizëm mbrojtës, që e ndan kujtimin e traumave të skajshme. Ja përse njerëzit nuk arrijnë të kujtojnë aksidentet e rënda me automobil, viktimë e të cilave kanë qenë. Mendja krijon një barrierë amnezie përreth ngjarjes, në mënyrë që të mos jesh i detyruar t`i rijetosh ato kujtime të tmerrshme. Që nga kohërat më të lashta, Vëllazëria ishte në dijeni të të gjithë kësaj. Në kampet e përqëndrimit të Gjermanisë naziste u perfeksionuan më tej metodat e shfrytëzimit të këtyre fenomeneve për kontrollin mendor. Jozef Mengeli dhe nazistët e kishin parasysh se, nëse traumatizohej sistematikisht dikush nëpërmjet torturave, dhunës seksuale,

ose duke flijuar e duke torturuar dikë tjetër përpara syve të tij, mund të shkatërrohej mendja e atij njeriu, duke e shndërruar në diçka të ngjashme me një zgjua bletësh, të përbërë me të ndara të pavarura, të veçuara nga barriera amnezie. Për të arritur këtë qëllim iu drejtuan shpesh riteve satanike. Sapo uniteti i mendjes të jetë shkatërruar, të ndarat e ndryshme, secila e paditur për ekzistencën e tjetrës, mund të programohen për detyra, apo për përvoja të ndryshme. Duke përdorur fjalë-kapsollë, fjalë-çelës, tinguj apo shenja hipnotike, këto të ndara mund të zhvendosen përpara apo prapa si një skedar mendor. Një e ndarë e pavarur, domethënë një fragment mendjeje, bëhet niveli i vetëdijshëm i individit, dhe rifundoset pastaj në pavetëdije, në çastin kur hyn në një tjetër të ndarë. Kjo do të thotë që pasi të ketë kryer një detyrë, viktima e harron atë që ka bërë dhe me kë e ka bërë. Kjo gjendje është bërë e njohur si Çrregullim i Personalitetit të Shumëfishtë, ose Çrregullim i Identitetit të Veçuar. Kam zbuluar përmes kërkimeve të mia se satanistët dhe pedofilët i mundon si në ankth ideja fikse që të kenë marrëdhënie anale me vajza të mitura, sikurse edhe me djem të mitur, dhe terapeutja Vera Diamond më ka pohuar se nëpërmjet këtyre marrëdhënieve krijohen personalitete të shumëfishta. Depërtimi anal është aq shumë i dhimbshëm për një fëmijë, sa që i dërgon një valë energjie përgjatë shtyllës kurrizore që shpërthen në tru, duke shkaktuar një dyzim të mëtejshëm të "personalitetit". Ajo më ka treguar një vizatim të realizuar nga një viktimë e seksit femëror, e cila paraqiste një valë energjie të bardhë, që ngjitej nga baza e shtyllës kurrizore, duke shpërthyer në trurin e saj në drejtime të ndryshme.

Shumë ushtarë bëhen me çrregullime të personalitetit të shumëfishtë, kur marrin pjesë në masakra të paimagjinueshme, pasi mendja e tyre e heq kujtimin dhe ata nuk kanë më asnjë përfytyrim të asaj që kanë parë. Në vitin 1921, Traugot Konstandin Oesterajku, një profesor i Universitetit të Tubingenit, në Gjermani, ka shkruar një studim, që pastaj u bë klasik, mbi Çrregullimin e Personalitetit të Shumëfishtë dhe mbi "zotërimin demoniak" me titullin *Possession, Demonical And Other* (Zotërimi, demoniak e të tjerë - përkth.). Ky libër ka zbuluar se kontrolli mendor i bazuar mbi traumën përdorej në Francë, në Gjermani e në Belgjikë shumë përpara shekullit XX. Disa të mbijetuar dhe profesionistë kanë pohuar se britanikët përdorën agjentë të programuar nëpërmjet Çrregullimit të Personalitetit të Shumëfishtë gjatë Luftës së Parë Botërore". Shumë njerëz, që pësojnë abuzime seksuale dhe që traumatizohen sistematikisht që fëmijë, shfaqen mendërisht e fizikisht të paqëndrueshëm, veçanërisht nëse programimi është ndalur dhe muret, që veçojnë të ndarat e ndryshme të trurit, fillojnë të shemben. Kam qenë i

pranishëm në seancat e drejtuara nga terapeutja britanike Vera Diamond dhe kam parë njerëz të mermin "personalitete" shumë të ndryshme, njërin pas tjetrit, falë përdorimit të një fjale, apo të një fraze të vetme. Është një përvojë e pabesueshme. Dhe njërës prej pacienteve të saj i duhej aplikuar një qese plastike për të mbajtur urinën, pasi fshikëza e saj e urinës i ishte shkatërruar nga torturat. Kartela e saj mjekësore është aq e gjatë, sa mund të trondiste deri edhe mjekët. Kur e takova, kjo grua ishte vetëm 30... 30... vjeçe. Në Mbretërinë e Bashkuar psikologët, ndihmësit socialë dhe policia, e bazojnë njohjen e tyre të Çrregullimit të Personalitetit të Shumëfishtë tek Grupi Tavistok, që deklaron se është një autoritet në rrethin e kurimit të këtij problemi, kur, në realitet, e përdor për të programuar njerëzit. Doktor Uiliam Sarganti, një psikiatër i Institutit Tavistok, ka shkruar në librin e tij të vitit 1957 me titullin *Battle For The Mind* (Beteja për mendjen):

"Tipe të ndryshme besimi mund të nguliten tek shumë njerëz, pasi funksioni cerebral është prishur me qëllim nga frika, nga zemërimi, apo nga ngacmime aksidentale, ose të futura qëllimisht. Midis pasojave më të zakonshme të këtyre turbullimeve mund të vërehen një aftësi gjykimi përkohësisht i pakësuar dhe një të qenët i sugjestionueshëm i zmadhuar. Ky fenomen manifestohet në mënyrë të dukshme në kohë lufte, gjatë epidemive serioze dhe në të gjitha çastet e rrezikut të përhapur, gjatë të cilave shtohet ankthi dhe, si pasojë, edhe të qënët i sugjestionueshëm individual e kolektiv".

Ja pra ku është këtu një tjetër arësye pse publikut i diktohet vazhdimisht një varg ngjarjesh të tilla për të nxitur frikën, zemërimin, ose eksitimin. Njerëzit, ose më mirë automatët, me mendje të programuar përdoren për qëllime të ndryshme. Aktivizohen për të kryer vrasje, siç ka ndodhur me vrasësit e Xhon Lenonit dhe të Robert Kenedit. Sirhan Sirhani, kukulla me mendje të programuar i gjykuar si përgjegjës për vrasjen e Robert Kenedit në vitin 1968, frekuentonte një kurs të "ekspansionit mendor" tek trëndafilkryqëtarët kur filloi të dëgjonte mesazhe, që i thoshin të vriste Robert Kenedin. Tani mund ta kuptojmë përse kaq shumë vrasje kryhen nga njerëz më të njëjtin profil mendor - të ashtuquajturit "të çmendur të vetmuar". Në vetvete ata nuk janë as të vetmuar, as, në pjesën më të madhe të rasteve, të sëmurë mendorë. Janë njerëz të programuar, shpesh që nga fëmijëria. Me këtë metodë këta robotë me mendje të kontrolluar mund të përdoren për të vendosur ndonjë bombë diku dhe, pastaj, të bëhet e mundur që po këta robotë të gjenden në vendin e duhur në kohën e duhur e, si rrjedhim, të akuzohen për krimin.

Në shumë vende kemi parë një mori me "të çmendur të vetmuar" që kryejnë vrasje në masë, pasi kanë humbur në dukje mendjen. Në Skoci, më 13 mars 1996, një i "çmendur" me emrin Tomas Hamilton hyri në një shkollë të Dunblejnit dhe hapi zjarr mbi disa fëmijë në palestër. Vrau 16 prej tyre të një moshe pesë e gjashtë vjeçare, përveçse një mësues. Efekti mbi psiqikën kolektive të qindra milionë njerëzve në të gjithë botën, sidomos në Mbretërinë e Bashkuar, ishte lemerisës. Pas pak ndodhi masakra e Port Arturit, një qytet i vogël i Tasmanisë, në Australi, ku një tjetër *killer* i vetmuar me emrin Martin Brajant u bë i "çmendur" më 28 prill 1996 dhe vrau 35 njerëz. Pastaj, në Angli, një njeri sulmoi ca fëmijë dhe mësuesit e tyre me një thikë të madhe në një shkollë të Uolverhamptonit. Në mars të vitit 1998 ndodhi "Dunblejni amerikan", kur dy të rinj, Mitçëll Xhonsoni 13 vjeç dhe i kushëriri, njëmbëdhjetëvjeçari Andrju Golden, hapën zjarr mbi shokët e tyre të shkollës dhe mbi mësuesit e tyre në *Westside Middle School* të Xhonesburit në Arkansas, vetëm 130 milje larg nga zyra e Bill Klintonit në Litël Rok. Zbrazën 27 plumba dhe u vranë katër nxënës e një mësues, ndërsa njëmbëdhjetë të tjerë u plagosën. Shpesh, pas këtyre fakteve, dalin lajme, sipas të cilave disa prej këtyre vrasësve praktikonin satanizmin. Fakte të ngjashme kanë ndodhur në Perl të Misisipit, më 1 tetor 1997 dhe, në dhjetorin e të njëjtit vit, në Uest Paduka të Kontikit e në Stamps të Arkansasit. Prapë edhe një herë u deklarua se përgjegjësit e sulmit të Perlit i kushtoheshin praktikave satanike. Dhe që atëherë kanë ndodhur shumë fakte të tjera të ngjashme. Këto ngjarje mbajnë të gjitha damkën e operacioneve të kontrollit mendor. Atëherë, çfarë po ndodh?

Le të mendojmë për profilet e shumë prej këtyre njerëzve. Pjesa më e madhe e tyre na paraqiten një çikë të çuditshëm, të turbulluar, ose të thjeshtë – "jo vërtet të zgjuar", sikurse fqinjët e shtëpisë kanë përshkruar *killer*-in e Port Arturit, Martin Brajantin. Kjo është e përkryer, kur kërkohet të kalohen krimet e kryera prej tyre si akte të një të çmenduri të vetmuar. Në rastin e Brajantit, duket se sapo ishte kthyer nga një qëndrim prej dy javësh në Shtetet e Bashkuara, kur hapi zjarr me pushkën e tij. Disa njerëz, që i rrinin afër, thanë se pas atij udhëtimi në SHBA karakteri i tij kishte ndryshuar, ndonëse kishte një të kaluar si i sëmurë psiqik. Ai ishte në thelb një krijim i qendrës së kontrollit mendor Tavistok të Londrës. Në vitet 1983-84 qe "vizituar" nga doktor Erik Kuningam Daksi i Institutit Tavistok, që vendosi se cilës "kurë" i nënshtrohej. Daksi punoi për dhjetëra vjet në krah të doktor Raulings Risit, ideatorit të programit të larjes së trurit të marrë nga Instituti Tavistok. Është dëshmuar se grupe terroriste si IRA kanë në dispozicion të tyre njerëz

që i quajnë agjentë "në letargji", domethënë njerëz që për vite, edhe dhjetëra, nuk përdoren, gjersa arrin një ditë që ata dhe mbuluesit e tyre mund të përdoren për një detyrë të veçantë. E njëjta gjë ndodh brenda kësaj bote të kontrollit mendor. Ka njerëz të programuar, që jetojnë brenda komunitetit me një farë profili karakterial, gjersa vjen dita kur mund të përdoren. Ata nuk e kanë idenë që përdoren në këtë mënyrë, sepse nuk janë ata që e kanë kontrollin e aftësisë së vet mendore, por kontrolluesit e tyre. Të shumta janë pyetjet që nuk kanë gjetur përgjigje mbi arsyet pse *killer*-i i Dunblejnit, masoni Tomas Hamilton, ishte i autorizuar nga ligji të mbante armë, kur, duke patur parasysh sjelljen e tij të çuditshme, nuk duhej të ishte lejuar të mbante armë. Dhe përse policia e Port Arturit la të kalonte një orë para se të ndërhynte, kur skena e masakrës ishte afër komisariatit, që është lajmëruar pak minuta pas të shtënës së parë të Brajantit? Përveç kësaj, Brajanti, Hamiltoni dhe shumë persona të tjerë, që kryejnë akte të këtij tipi, marrin rregullisht *Prozac*. Efektet anësore të këtij ilaçi përfshijnë nervozizëm, ankth, prirje vetëvrasëse dhe ipomani, ndërsa ndërprerja e ilaçit provokon reagime të dhunshme. Një sërë njerëzish të përfshirë në vrasjet në masë në Shtetet e Bashkuara mermin këtë ilaç. Gjurmë të elementeve aktivë të *Prozac*-ut janë gjetur edhe në gjakun e Henri Polit, shoferit të Mercedesit me të cilin udhëtonte princesha Dajana, që u përplas në Paris në vitin 1997.

Atëherë, cila është arsyeja që qëndron prapa këtyre masakrave? Manipulimi i mendjeve dhe i emocioneve. Ku kanë ndodhur këto vrasje në masë? Jo në botën e krimit të Londrës, Gllasgout, Los Anxhelesit, apo Sidnejit, por në komunitete të vogla e të qeta, ku të gjithë ndiheshin në mënyrë të përkryer në vend të sigurtë. Në të njëjtën mënyrë, bomba "McVeigh" dhe masakrat në shkolla nuk ndodhën në Nju Jork, apo në Uashington, por në Oklahoma. Ju kështilloj të mos e nënvleftësoni efektin që e gjitha kjo ka mbi psiqikën kolektive në terma frike dhe dëshire që autoritetet t'i "mbrojnë" njerëzit nga ajo frikë. Kjo do të thotë më shumë telekamera gjatë rrugëve dhe më shumë roje sigurie e telekamera nëpër shkolla, në mënyrë që fëmijët ta pranojnë që nga fëmijëria kulturën e të qenurit të "mbrojtur" nga rreziqet prej një autoriteti të ngjashëm me "Vëllanë e Madh". Mediat, në lidhje me masakrën në Australi, shprehnin po atë reagim që manipuluesit dëshironin të nxisnin: "Nuk ka më asnjë vend të sigurtë në botë?". Kur këto gjëra ndodhin në komunitete të qeta, reagimi më i përhapur do të jetë ai i tipit "Zot i Madh, mund të më kishte ndodhur edhe mua e fëmijëve të mi – hëm, kemi nevojë të jemi të mbrojtur".

Robotët me mendje të kontrolluar, përfshirë fëmijët, përdoren për

shërbime të çuditshme seksuale për presidentët, për krerët e huaj, për politikanët dhe për afaristët. Shpesh e gjitha kjo bëhet me qëllimin për t'i nxitur këta krerë që të hyjnë në sistemin e të menduarit të Vëllazërisë, ose për t'i shtyrë në kompromis, duke u bërë shantazh pastaj me anë të asaj që u është thënë të bëjnë. Kur them "të çuditshme" e them në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe nuk e kam të lehtë të shkruaj, apo të flas, për atë që pas pak do të lexoni. Por është me të vërtetë e rëndësishme që perdja të ngrihet. Për arsyet më të natyrshme, këta robotë njerëzorë nuk janë thuajse kurrë në gjendje të flasin për atë që atyre u ka ndodhur. Ose janë si automatë e nuk arrijnë të kujtojnë asgjë, ose, kur Vëllazëria nuk i quan më mjaft të rinj, vriten dhe nganjëherë disa pjesë të trupave të tyre përdoren për rite të magjisë së zezë, në të cilat marrin pjesë personalitete të famshme. Mendoni ndoshta se e njihni personalitetin e atyre që shihni në televizion? Atëherë vazhdoni të lexoni. Fatmirësisht, një grua shumë e guximshme, që kur ishte e vogël ka qenë mendërisht e kontrolluar, e ka denoncuar këtë gjë pasi arriti t'i shpëtonte gjendjes së skllavërisë, që i ishte diktuar nga qeveria amerikane. Ajo i është nënshtruar seancave të gjata e të dhimbshme të shprogramimit, të cilat zgjatën për më shumë se një vit, që i hoqën të ndarat e mendjes së saj dhe i lejuan të kujtonte atë që i kishte ndodhur – dhe kush ishin përgjegjësit. Kjo grua është Keti O'Brian, një amerikane me origjinë irlandeze, e cila bashkë me Mark Filipsin ka botuar me shpenzimet e veta një libër që tregon përvojat e saj dhe që titullohet *Trance Formation of America*[10]. Çka ajo tregon është një histori shokuese, por histori si kjo ka shumë e shumë të tjera e do të vazhdojë të ketë, gjersa njerëzimi të mos ketë hapur sytë e të mbajë qëndrim për përgjegjësitë e veta. Keti përshkruan me hollësi bisedat në të cilat ka qenë e pranishme, dhomat dhe mobilimet e Shtëpisë së Bardhë, të Pentagonit e të institucioneve të ndryshme ushtarake shumë sekrete të shpërndara nëpër Shtetet e Bashkuara. Ajo përshkruan edhe veçori fizike të personave të përfshirë, që mund t'i dijë vetëm kush i ka parë lakuriq. Ka disa studiues që ngrejnë dyshime mbi disa hollësi të përshkruara në librin *Trance Formation Of America* dhe, si gjithmonë, edhe unë do të kisha shumë pyetje për të bërë. Por shumë aspekte e shumë prej emrave të zbuluar në librin e Ketit vazhdojnë të dalin në përmbledhjet e skllevërve të tjerë me mendje të kontrolluar, në trugën e shërimit, dhe në kërkimet e drejtuara nga unë e nga të tjerë. Historia e saj përmbledh atë çka është duke ndodhur në të gjithë botën, për këtë arsye kam vendosur t'jua tregoj.

Ketlin (Keti) O'Briani ka lindur në Muskegon të Miçiganit në vitin 1957. I ati, Earl O'Briani, është një pedofil dhe njëri prej kujtimeve të para të Ketit

është se nuk arrinte të merrte frymë, sepse penisi i tij i zinte gojën. Trauma të këtij lloji provokojnë automatikisht Çrregullimin e Personalitetit të Shumëfishtë, pa psur nevojë që ai të programohet, sepse medja e fëmijës dëshiron ta largojë tmerrin. Edhe mjqve të të atit u ishte lejuar të abuzonin me Ketin e vogël dhe me vëllezërit e saj, pikërisht ashtu sikurse, në fëmijërinë e tyre, edhe prindërit vetë kishin qenë viktima abuzimesh. E ëma kishte pësuar dhunë seksuale nga gjyshi i Ketit, që ishte kreu i Lozhës masonike Blue. I vëllai i së ëmës, për Ketin daja Bob, ishte një pilot i shërbimit sekret të aviacionit amerikan, që pohonte se punonte për llogari të Vatikanit. Daja Bob tregtonte edhe materiale pornografike dhe i ati i Ketit e detyroi të bijën dhe të birin më të madh, Billin, të xhironin filma pornografikë të realizuar për mafien lokale të Miçiganit, e cila, sipas asaj që pohon Keti, ishte e lidhur me "mbretin e pornos" Xherald Fordin, deputet i ardhshëm amerikan. Ai do të mbulonte më pas detyrën e zëvendëspresidentit të Shteteve të Bashkuara gjatë presidencës së Riçard Niksonit dhe atë të presidentit, kur Niksoni u largua prej Henri Kisingerit e kompani si pasojë e skandalit të Uotergejtit. Fordi ka bërë pjesë edhe në Komisionin Uorren, i cili "hetoi" mbi vrasjen e presidentit Kenedi dhe vendosi që versioni zyrtar i fakteve ishte i vërtetë, edhe pse ishte e pamundur. Keti O'Briani pohon se është përdhunuar, kur shkonte ende në shkollë, nga Xherald Fordi, anëtar i stafit të Gaj Vanderjagtit, senator i shtetit të Miçiganit, që e ka përdhunuar edhe ai nga ana e tij. Vandergajti do të bëhej pastaj president i Komitetit të Kongresit Kombëtar të Partisë Republikane që mbështeti përdhunuesin e fëmijëve dhe vrasësin, përveçse mik i mbretëreshës së Anglisë, Xhorxh Bushin në fushatën e tij elektorale për presidencën e Shteteve të Bashkuara.

Më pas, duket se i ati i Ketit u zbulua teksa shpërndante materiale pornografiko-pedofile – një film i shkurtër që e nxirrte Ketin e vogël teksa kryente marrëdhënie me një qen bokser. Për t'i shpëtuar akuzës, ia dorëzoi Ketin qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe shërbimeve sekrete të Mbrojtjes. Shërbimet sekrete kërkonin fëmijë viktima abuzimesh seksuale, të infektuar nga Çrregullimi i Personalitetit të Shumëfishtë, që vinin nga familje, të cilat kishin pas shpine një histori të gjatë abuzimesh ndër breza. Donin fëmijë për studimet e tyre mbi kontrollin gjenetik të mendjeve, që vepronte nën emrin Projekti Monark. Njeriu që u paraqit në shtëpinë e Ketit për t'i dhënë të atit ultimatumin të dorëzonte të bijën, nëse nuk dëshironte të ishte i akuzuar, ishte... Xherald Fordi. I ati i Ketit u dërgua në Universitetin e Harvardit, pranë Bostonit, për t'u udhëzuar mbi atë se si ta përgatiste të bijën për profesorët e çmendur të shërbimeve sekrete. Ja ajo që Keti tregon në librin e saj:

"...në përputhje me udhëzimet e marra nga qeveia, im atë filloi të më trajtonte si Hirushen e përrallës. Largoja hirin nga oxhaku, transportoja dhe stivosja drutë, pastroja gjethet, largoja dëborën me lopatë, pastroja akullin dhe pastroja... "me qëllim që", thoshte im atë, "duart e tua të vogla ta kapin aq mirë rashqelën, fshesën, lopatën dhe kapësen e granatës...". Në atë kohë im atë më shfrytëzonte deri në atë pikë, sa që më detyronte të prostituoja me miqtë e tij, me kriminelët dhe masonikët lokalë, të huajt dhe oficerët e policisë...".

"...Funksionarët e qeverisë të përfshirë në Projektin Monark të MKUltra-s e dinin natyrisht se kush është i infektuar me Çrregullimin e Personalitetit të Shumfishtë ka një kujtesë të madhe fotografike, përveçse cilësi të tjera njerëzore super të zhvilluara. Mprehtësia e të parit e atij që vuan nga Çrregullimi i Personalitetit të Shumëfishtë është 44 herë më e madhe se mesatarja. Pragu im i dhimbjes jashtëzakonisht i lartë dhe të ndarat e kujtesës sime ishin cilësi "të nevojshme" për aplikimet ushtarake dhe operacionet sekrete. Përveç kësaj, sensualiteti im ishte ndryshuar që nga fëmijëria. Ky program rezultoi i çmuar dhe i dobishëm për politikanët perversë, që menduan kështu t`i fshihnin veprimet e tyre në thellësinë e atyre të ndarave të kujtesës sime, që profesorët e klinikës i quajnë "personalitet""[11].

Të gjitha këto metoda të bazuara mbi traumën, dhe të tjera që do t'ju zbuloj, nuk janë vetëm tortura falas. Për shembull, një aktivitet i fortë fizik me pak gjumë shkakton një superprodhim endorfine në tru, që e shtyn njeriun të reagojë ndaj komandave si një robot[12]. Kjo bën pjesë natyrisht në metodat e stërvitjes ushtarake, që nuk është asgjë më shumë veçse një shkollë e kontrollit mendor. Mendësia "Si urdhëron zotëri" është kontroll i pastër mendor dhe nënshtrim ndaj vullnetit të një tjetri. Ushtarët nuk inkurajohen të mendojnë, apo të shtrojnë pyetje, por vetëm të bëjnë atë që u thuhet. Doni të jeni mendërisht të kontrolluar? Okej, është e thjeshtë... mjafton që të hyni në ushtri. Edhe programimi e abuzimet seksuale bazohen tek manipulimi i energjisë seksuale, tek forca krijuese dhe, në çastin e orgazmës, psiqika hapet krejtësisht, për të arritur përmasa pak a shumë të ngritura, sipas gjendjes së atij që është përfshirë në këtë përvojë. Teknikat e programimit janë jashtëzakonisht të sofistikuara. Një teknikë e përdorur gjerësisht në rrethin e Projektit Monark është "dilema", me anë të së cilës në të njëjtën frazë afrohen dy koncepte të kundërta, për të shkaktuar përshtjellim: "Mos i beso aspak të gjithë kësaj, është e gjitha e vërtetë", është një shembull i kësaj teknike[13]. Skallavëria nuk është një fenomen i kufizuar në histori. Skllavëria ekziston

ende sot e kësaj dite, në të gjithë botën, përfshirë Britaninë e Madhe (përkundrazi, sidomos aty), Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera të "qytetëruara". Herë pas here, episode pedofilie gjallërojnë kronikat, por bëhet fjalë vetëm për një pikë shumë të vogël të një organizate të gjerë, që arrin majën (më falni, gjirizin) e shoqërive të "lira". E vërteta mbi abuzimet e pësuara nga nxënësit e *Kincora School*, në Irlandën e Veriut, u mbulua, sepse njëri prej përdhunuesve ishte një agjent i shërbimeve sekrete britanike. Aty ishte i implikuar edhe të paktën një politikan i famshëm i Irlandës së Veriut, por ky aspekt u fsheh hiç më pak se nga vetë një oficer, tashmë në pension, i shërbimeve sekrete britanike me emrin Ian Kameron. Kjo organizatë përdhunuesish fëmijësh ofron mjetin e përkryer për të kënaqur dëshirën seksuale të atyre që ushtrojnë kontrollin dhe për të frikësuar ata që i janë nështruar kontrollit.

Kur kërkoi strehim në një kishë katolike të Muskegonit, Keti O'Briani pohon se u përdhunua nga At Xhejms Tyleni, ndërsa një tjetër prift pedofil, At Doni, e ndihmoi mikun e Xherald Fordit, Gaj Vaderjagtin, që ta çorientonte dhe të abuzonte me të, në përputhje me "kërkesat" e Projektit Monark. Më pas, e dërguan në një shkollë katolike, njëra prej të shumtave e përdorur nga qeveria për të strehuar në vend të sigurtë fëmijët me mendje të kontrolluar, nën regjimin e rreptë të parashikuar për ta rënduar më tej Çrregullimin e tyre të Personalitetit të Shumëfishtë. Shkolla e Ketit ishte shkolla qëndrore katolike e Muskegonit, ku u përdhunua shumë herë nga At Vesbiti, një herë gjatë një riti satanik, që u zhvillua në kishëzën e tij private dhe në të cilin morën pjesë edhe fëmijë të tjerë me mendje të kontrolluar. Kisha Katolike është mishërimi i hipokrizisë dhe është thellësisht, e nënvizoj thellësisht, e shthurur. Siç e kam dëshmuar në këtë libër, ajo është krijuar nga Vëllazëria Babilonase në kohën e Perandorisë Romake. Lëvizja katolike e Urdhërit të Jezuitëve është një mjet i rëndësishëm manipulimi për konspiracionin global dhe, ashtu sikurse Kalorësit e Maltës, që kontribuojnë për të kontrolluar Vatikanin, kjo lëvizje nuk beson aspak tek parimet e krishtërimit! Është fjala vetëm për një fasadë. Jezuitët, Kalorësit e Maltës dhe hierarkia kishtare janë pjesë e kastës së Urdhërit të Mendjendrituve. Ata ishin, dhe janë, përkrahës të zjarrtë të kontrollit të turpshëm mendor të parashikuar nga Projekti Monark dhe nga MKUltra. Kjo nuk të çudit aspak, duke qenë se Kisha Katolike ka mbijetuar duke mbjellë terror, duke bërë larje të trurit dhe duke kontrolluar mendjet e bashkësisë së saj globale. Keti pohon se ka marrë presione dhe se është manipuluar që nga fëmijëria prej degës katolike të CIA-s, me qëllim që të ruante disa sekrete, nëpërmjet një teknike të njohur si Riti i Heshtjes. Dhe,

sekrete për të ruajtur, kishte shumë në mendjen e saj të ndarë në seksione.

Në vitet që pasuan, Keti pohon se ka qenë nën kontrollin e senatorit "demokrat" të Virxhinias Perëndimore Robert K. Bird dhe se mbi të u shtuan abuzimet nga ana e këtij të fundit e të agjensive qeveritare. Birdi është një ekspert "kostitucionalist", që punon për të minuar dhe shkatërruar kushtetutën amerikane. Sipas Ketit, Birdi kontrollon një sërë skllevërish me mendje të manipuluar dhe, gjëja që i pëlqen më shumë, është që t'i kamxhikojë për vdekje pa mëshirë. Më pas, sipas asaj që pohohet në librin e saj, njëri prej bashkëpunëtorëve të Birdit, senatori Patrik Lajhi i Vermontit, e torturoi Ketin duke i futur një gjilpërë në sy, ndërsa e bija e saj, Keli, që detyruar të ishte e pranishme në këtë skenë[14]. Lajhi ishte zëvendëspresident i Komisionit të Senatit për shërbimet sekrete. Birdi, një kokainoman[15], mburrej shpesh me persona të "besuar" se si arriti të pilotonte mendjen e presidentit Xhimi Karter, teksa mbulonte rolin e "të besuarit dhe të këshilltarit" të tij. Zëri hipnotik i Birdit kumbonte si "zëri i Zotit" në veshët e një Karteri në lutje e meditim, që ndiqte besnikërisht "udhëheqësin shpirtëror", që e quante hyjnor[16].

Qenë të shumta institucionet qeveritare të Shteteve të Bashkuara, në të cilat Keti i qe nënshtruar torturave dhe kontrollit mendor, përfshirë qendrën hapësinore NASA, në Hantsvil të Alabamës, ku ajo dhe, më vonë, e bija Keli qenë të detyruara të xhironin filma porno. Po, NASA e "njeriut në Hënë" dhe e Shatllit bën gjëra të këtij lloji. Edhe besimet shfrytëzohen rregullisht për të manipuluar njerëzit, duke bërë punën e mbuluesve të "respektueshëm" të torturave dhe të manipulimit mendor. Një qendër ku u programua mendja e Ketit ishte Salt Lake Siti, në Utah, qendra e Kishës Mormone. Një tjetër institucion, që strehon skllevër me mendje të pilotuar, ndodhet në Jungstoun të Ohajos dhe njihet si "*Charm School*". Kjo e fundit është një "shkollë" formimi për "skllevër seksuale", ku Keti e Keli, dhe një mori të tjerë me gra e fëmijë, u nënshtroheshin torturave si shkarkesa elektrike, heqje e gjumit dhe trauma seksuale. Keti pohon se "drejtori" i shkollës ishte një anëtar i familjes së bankierëve Milon, ndërsa midis të përfshirëve të tjerë të shumtë figurojnë deputeti amerikan Xhim Trafikanti e Dik Tornburgu, atëherë guvernator i Pensilvanisë dhe, më pas, kryeprokuror dhe sekretar i Kombeve të Bashkuara[17]. Ajo dhe shumë të tjerë me të cilët kam folur, apo të cilëve u kam lexuar dëshmitë, pohojnë se një pjesë e programimit të tyre të shoqëruar nga tortura është zhvilluar në *Disneyland*, në Kaliforni dhe në *Disneyworld*, në Florida. Hapja e parkut *Disney* pranë Parisit ka krijuar mundësi për të realizuar edhe në Evropë programime të ngjashme, me qëllim krijimin e skllevërve. Kompania *Disney* është njëra prej shoqërive më të rëndësishme të

Vëllazërisë dhe filmat e parqet e saj tematike janë të përkryera për të shtuar iluzionet që çorientojnë mendjen e atyre që vuajnë nga dyzimi i personalitetit. Kur parqet janë të mbyllur, aty zhvillohen rite satanike dhe programime bazuar mbi traumën. Një shembull i qartë i historisë për fëmijë, plot me simbolizëm bazuar tek programimi mendor, është epika e kompanisë *Metro-Goldwyn-Mayer* me titullin *Magjistari Oz*. Fjala "Oz" do të thotë Osirid, një tjetër personazh, që përsëritet në çdo tip programimi. Përsipër trupit të disa skllevërve vendoset "penisi i artë i Osiridit"[18]. Historia e *Magjistarit Oz* u botua në vitin 1900 nga Frenk Baumi, një anëtar i Shoqërisë Teozofike të Madam Blavatskit, ndërsa versioni kinematografik i përket vitit 1939. Kjo histori përmban shumë referime ndaj simbolizmit të shkollave misterike e të kontrollit mendor satanik dhe Fritc Springmejeri e Sisko Veleri kanë bërë një analizë të përkryer të kësaj në librin e tyre *The Illuminati Formula Used To Create An Undetectable Total Mind Controlled Alave* (Formula e Mendjendriturve e përdorur për të krijuar një skllav të padallueshëm me mendje krejtësisht të kontrolluar). Midis qendrave të tjera ku programohen mendjet figurojnë Las Vegasi, në Nevada, dhe rrethinat e tij, kazinotë e tij fantasike si *Grand* e *MGM*, ndërsa një prej qendrave ku mbahen "ankandet" e skllevërve është një lokalitet i humbur 20 milje larg qytetit[19]. Ende në moshë të njomë, Keti u ngacmua seksualisht, u përdhunua dhe u torturua nga njerëz shumë të famshëm. Midis tyre figuron Pier Trudoja, që ka qenë për një kohë të gjatë kryeministër i Kanadasë dhe që, si jezuit, vepronte në lidhje të ngushtë me Vatikanin; u përdhunua përsëri nga Xherald Fordi teksa ishte president i Shteteve të Bashkuara e nga Ronald Regani, kur edhe ai mbulonte detyrën më të lartë të shtetit dhe, mandej, shumë herë në mënyrën më shtazore të mundshme, nga Dik Çenej, shefi i stafit të Shtëpisë së Bardhë gjatë presidencës së Fordit dhe ministër i Mbrojtjes gjatë presidencës së Bushit. Keti është në gjendje ta përshkruajë zyrën e Çenejit në Pentagon me bollëk hollësish. Nëse pranohen provat shumë të hollësishme të dhëna nga Keti, mund të arrihet vetëm në përfundimin se Dik Çenej, ashtu si Xhorxh Bushi, është një njeri tejet i çekuilibruar, i aftë për akte tmerruese dhune e deri edhe vrasje. Keti tregon se Çeneji i tha një herë: "Mund të të vrisja – të të vrisja – me duart e mia. Nuk do të ishe as e para, as e fundit"[20]. Këta janë njerëzit që i dhanë udhë luftës së Gjirit, për të treguar se "dhuna nuk paguan"! Sikurse Keti ka shkruar në librin e vet dhe ka përsëritur me ngulm në intervistat e ndryshme, Xhorxh Bushi, njeriu që evokonte një "Amerikë më fisnike, më të hijshme", Dik Çenej dhe Bill Klintoni shpesh armatosen me pushkë e i ndjekin si gjah këta skllevër me mendje të kontrolluar, që janë kryesisht fëmijë. Me t'i kapur,

ata përdhunohen kafshërisht, nganjëherë edhe vriten. Kompleksi Mount Shasta, ku Bushi dhe Klintoni ndanin një zyrë, është, sipas Ketit, "kampi më i madh sekret i skllavërimit dhe i manipulimit mendor, që mund të njihet"[21]. Atje ajo ka parë një flotë të madhe helikopterësh të zez pa shenja dalluese që, sikurse kanë zbuluar hetuesit, janë pjesë e ushtrisë private të Vëllazërisë, e formuar për të kryer grushtin e shtetit kundër kundërshtarëve, kur çasti do të gjykohet i volitshëm.

Keti u detyrua të martohej me një satanist me mendje të pilotuar, që quhej Uajn Koks dhe merrte pjesë në kompleksin e muzikës *country* të Xhek Grinit. Edhe Grini, një agjent sekret i CIA-s, ishte një satanist, sipas rrëfimit të Ketit[22]. Detyra e Koksit ishte ta traumatizonte më tej, për të krijuar në mendjen e saj të tjera të ndara, që mund të shërbenin për t'i dhënë jetë një "personaliteti" të ri. Një natë, Koksi e çoi Ketin tek gërmadhat e stacionit hekurudhor të Nashvilit dhe, duke përdorur një elektrik dore, zbuloi një vagabond që ishte duke fjetur aty. E urdhëroi Ketin t'i jepte vagabondit "puthjen e lamtumirës" dhe pastaj i zbrazi pistoletën në kokë. E gjitha kjo qe mjaft e llahtarshme, por, i pakënaqur, nxori një thikë të madhe dhe i preu duart, që i futi në një çantë me zinxhir[23]. Sikurse Keti ka deklaruar publikisht shumë herë, Uejn Koksi është një *killer*, që pret rregullisht duart e viktimave të tij. Bëhet fjalë për nënshkrimin ritual të një satanisti. Në një intervistë të publikuar nga gazeta *Contact*, Keti ka thënë:

"Në vitin 1978, Uejn Koksi, manipuluesi im i parë i caktuar, vriste e gjymtonte me rregullsi dhe sipas një farë riti, vagabondë, fëmijë e të gjithë ata që "nuk mund të linte t'i shpëtonin" dhe, që nga baza e tij e Khatamit, në Luizianë, shpërndante hapur pjesë të trupit të viktimave të tij për qendrat e rëndësishme satanike në mjaft shtete, përfshirë pistën Litëll Rok/Misuri"[24].

Sipas Ketit, organizmat qeveritare janë në dijeni të kësaj, por ai është i mbrojtur nga çdo akuzë, sepse punon për to. Koksi e çoi Ketin në një tjetër vend të stacionit hekurudhor, në kullën e një depoje të vjetër hekurudhore dhe, atje, në një dhomë, të veshur me të zeza, i priste Xhek Grini, disa pjesëtarë të kompleksit të tij dhe të tjerë persona. Ishin vendosur përreth një altari të veshur me lëkurë të zezë dhe dhoma ishte zbukuruar me kadife të kuqe e ndricohej prej qirinjve. Ketin e detyruan të shtrihej mbi altar, ku iu nënshtrua përdhunimeve dhe torturave, teksa adhuruesit e Satanait realizonin një rit të magjisë së zezë bazuar mbi seksin, mbi gjakun e mbi kanibalizmin[25]. Vite më vonë, ndërsa ishte e "martuar" me një tjetër militant të CIA-s, Aleks

Hjustonin, u la shtatëzënë shumë herë dhe u detyrua të dështonte, me qëllim që fetusi të përdorej për rituale satanike.

Pylli Bohem

Ekziston një park lojrash me sfond seksual i rezervuar për politikanët amerikanë e të huaj të rangut të parë, si edhe për kriminelët, për bankierët, për afaristët e njerëzit e spektaklit, të gjithë anëtarë të Vëllazërisë Babilonase. Ky vend quhet Pylli Bohem dhe ndodhet 75 milje në veri të San Françiskos në Kaliforni, afër fshatit Monte Rio, gjatë lumit Rusian, në kontenë e Sonomës. Kam shkuar atje në vitin 1997, për t'i hedhur një sy zonës, por, kur i thashë recepsionistes së hotelit se ku doja të shkoja, ajo më këshilloi të kisha shumë kujdes, sepse disa që kishin shkuar atje për të bërë kërkime, nuk ishin kthyer më. Këtu, në Pyllin Bohem, Keti dhe të tjerë persona të pyetur nga unë, pohojnë se janë detyruar të kënaqin perversitetet e përdhunuesve të tyre, që shprehen nëpërmjet riteve satanike, torturave, flijimeve dhe pirjes së gjakut, brenda një cifligu privat prej 2.700 akrash, që shtrihet midis sekuojave. Siç shkruan Keti në librin e saj, "Skllevër në moshë të shtyrë, programimi i të cilëve tashmë ka skaduar, vriten me short, sipas një rituali të përpiktë, brenda Pyllit Bohem dhe unë e dija se një ditë kjo do të më kishte ndodhur edhe mua"[26]. Ajo thotë edhe se Pylli disponon një sërë dhomash të rezervuara për perversitete të ndryshme, ndërmjet të cilave një Dhomë e Errët, një Dhomë Lëkure, një Dhomë Nekrofile dhe një e njohur si *Underground Lounge* (Sallon i nëndheshëm), që tregohet si "*U.N.derground*". Kam parë një fotografi të bërë fshehurazi për Pyllin Bohem, që tregon ca njerëz me veshje të gjata të vendosur rreth një zjarri të madh, teksa nderojnë një buf guri të lartë rreth 12 metra (shiko pjesën e ilustrimeve). Bufi është simbol i Molokut, njëra prej shumë fytyrave të Nimrod/Balit. Moloku kërkon flijimin e fëmijëve dhe ishte në nderim të kësaj hyjnie që babilonasit, hebrejtë, kananeasit, fenikasit dhe kartagjenasit bëheshin fli mbi turrën e druve. Kjo fotografi ka vërtetuar zërat që qarkullonin prej vitesh, sipas të cilëve në Pyllin Bohem kremtoheshin rituale druide, gjatë të cilave disa njerëz me veshje të kuqe marshonin në procesion, duke i ngritur këngë Bufit të Madh, Molokut[27]. Këta anëtarë të Vëllazërisë të Pyllit Bohem, të famshëm në të gjithë botën, djegin një figurë kelte prej thuprash shelgu në fillim të ritualit, si simbol të "besimit" të tyre. Popullsia e Britanisë së Madhe është shtyrë me anë të manipulimit që ta kremtojë po këtë ritual më 5 nëntor, kur portreti i Gaj Fauksit digjet, për të kujtuar ditën kur ai u përpoq të hidhte në erë Parlamentin.

Një gazetë lokale, *The Santa Rosa Sun*, ka folur, në korrik të vitit 1993, për

kultin Kanan dhe për legjendën e Molokut në Pyllin Bohem, por hetimet e policisë mbi vrasjet e pandehura të kryera në atë vend natyrisht nuk çuan në asgjë. Frekuentuesit e zakonshëm të kësaj qendre satanizmi janë të njuhur si "roje pylli" dhe ndërmjet tyre figurojnë personazhe si Xhorxh Bushi; Xherald Fordi; Henri Kisingeri; Dik Çeneji; Alen Grinspani, kreu i Rezervës Federale; Xhek Kempi (kandidat në zgjedhjet amerikane të vitit 1996 si zëvendëspresident i Bob Dojlit); Aleksandër Hajgu, ish ministër i Mbrojtjes; Kasper Ueinbergeri e Xhorxh Shultci, ish sekretarë shteti; dhe një listë e gjatë midis më të njohurve politikanë, afaristë, gazetarë e njerëz të spektaklit të të gjithë botës, jo vetëm amerikanë. Stiv Bekteli, presidenti i kompanisë më të madhe të ndërtimit në botë, e ka frekuentuar Pyllin Bohem në vitet tetëdhjetë të shekullit XX, ndërsa shoqëria e tij fiton shumë kontrata falë gatishmërisë së shpenzimit të Bankës Botërore dhe të presidentit të saj A.V. Klausen, një tjetër "roje pylli" ky. Ky Pyll është një "kamp veror" dhe një qendër satanike e Elitës, që drejton planetin dhe, pikërisht këtu, krerët e shteteve marrin shumë prej vendimeve, që pastaj i zbulojnë publikisht. Kam një fotografi të vitit 1957, e cila tregon Ronald Reganin dhe Riçard Niksonin të ulur në tavolinën e Pyllit Bohem, duke dëgjuar të përqëndruar doktor Glen Siborgun, që qe përfshirë në zbulimin e plutonit dhe punoi për Projektin Manhatan, i cili prodhoi bombat që u lëshuan mbi Japoninë. Si Regani edhe Niksoni, që bënë pjesë në këtë klub satanik për më shumë se 40 vjet, do të bëheshin pastaj presidentë të Shteteve të Bashkuara. Në fakt, të gjithë presidentët republikanë, duke nisur nga Herbert Huveri më 1945 dhe pjesa më e mirë e atyre demokratë, kanë bërë pjesë në këtë klub, përfshirë Bill Klintonin.

Pikërisht në kontenë e Sonomës, jo larg Pyllit Bohem, u vra dymbëdhjetëvjeçarja Poli Klas, sipas gjasës nga disa satanistë, në tetor të vitit 1993. U rrëmbye nga shtrati i saj, teksa e ëma dhe e motra flinin në dhomën ngjitur. Gjyshi i saj, Xhoe, kishte mbështetur publikisht librin me titullin *Breaking The Circle Of Satanic Ritual Abuse* (Të thyesh rrethin e abuzimit satanik ritual), i shkruar nga satanisti i penduar Daniel Rider. Ky libër zbulonte lidhjet ekzistuese midis satanistëve dhe programuesve të mendjes të Projektit MKUltra e Monark. Edhe pse një njeri u akuzua për vrasjen e Polit, ai krim ka përkundrazi krejt shijen e një hakmarrjeje kundrejt gjyshit të vajzës së vogël. Një grua thirri FBI-në, për t'i thënë se i kishte shpëtuar një tufe shtrigash në kontenë e Sonomës dhe se Poli mund të ishte vrarë në harkun e atyre pesë ditëve të kremtimeve satanike, që mbaheshin me rastin e Hallouinit.

Ajo shtoi se Poli mund të gjendej afër Pitian Rodit, në numrin 12 të Higuejit që, pa shihni, kufizohet me një fermë prej 1.600 akrash të quajtur

Beltain Ranç. FBI-ja nuk e mori parasysh këtë sugjerim dhe trupi i Polit u gjet pastaj pikërisht afër Pitian Rodit. Ishte përdhunuar dhe i ishte prerë koka, por autoritetet deklaruan se ishte mbytur. Njeriu që e kishte rrëmbyer, Riçard Alen Dejvis, u akuzua për vrasje prej zyrës së prokurorisë distriktuale të kontesë së Sonomës vetëm sepse agjentët e policisë ushtruan presion që kjo të ndodhte.

Njëri prej atyre që e kanë kontrolluar Ketin, ka qenë koloneli i ushtrisë amerikane Majkëll Akuino, një njeri i rëndësishëm i Divizionit të luftës psikologjike të shërbimeve sekrete të Mbrojtjes. Në tre librat e mi të fundit kam folur për të si kreu i Kishës Satanike, e njohur si Tempulli i Setit, një organizatë që frymëzohet, me sa duket, tek shefi i SS-ve të Hitlerit, Hajnrih Himleri. Kur u mor vesh se Divizioni amerikan i luftës psikologjike kryesohej nga kreu i Kishë "satanike", përgjigjja zyrtare ishte se besimi fetar i një njeriu i përkiste vetëm atij njeriu! Por, sikurse Keti e zbuloi shpejt, njerëz si Akuinoja dhe pjesa tjetër e kësaj bande të çekuilibruarish të pushtuar nga satanaja, shkojnë përtej ligjeve, sepse falë aftësive të tyre intelektuale i kontrollojnë ligjet gjer në nivelet më të larta. Gruaja e Akuinos, që bashkëpunon me të, quhet Lilith Sinkler. Lilithi është një simbol i fiseve zvarranike dhe i familjes Sinkler/Shën Kler, për të cilën tashmë dini gjithçka[28]. Ajo ka themeluar Sektin Lilith brenda Kishës së Satanasë të Anton LaVejit dhe është anëtare e Këshillit të të Nëntëve të kësaj Kishe[29]. Kisha satanike e LaVejit është shembulli i mënyrës se si satanizmi gërshetohet me operacionet e kontrollit mendor. Shtetet e Bashkuara janë bërë atdheu i një morie organizatash satanike, që frymëzohen tek ato evropiane, të lindjes së mesme dhe të vendeve të tjera. Anton LaVeji, nxënës i Alejster Kroulit, e themeloi Kishën e Satanait në vitin 1966. Gjyshja nga nëna e LaVejit ishte me origjinë nga Transilvania, atdheu legjendar i "vampirit" gjakpirës, dhe ai i pëlqente filmat me llahtarë. Ka qenë LaVeji, thuhet, ai që e zbuloi Merilin Monronë, e cila punonte në klubet e natës dhe i përdori njohuritë e tij për të krijuar me të një yll kinemaje. Ai kishte lidhje me disa prej emrave më të rëndësishëm të botës industriale, politike dhe të asaj të spektaklit, përfshirë presidentin Xhon F. Kenedi, Frenk Sinatrën, Semi Dejvisin e ri, Piter Laufordin dhe Zhanë Mansfieldin. Semi Dejvisi ishte një ndër ithtarët e parë të Kishës Satanike të LaVejit dhe Zhanë Mansfieldi ishte një priftëreshë e lartë e saj. Majkëll Akuinoja i Divizionit të luftës psikologjike bashkëpunoi me LaVejin, para se të grindej me të dhe të themelonte sektin e tij, Tempullin e Setit.

Keti lindi një vajzë, Kelin, nga i "shoqi" Uejn Koksi dhe vogëlushja u përdor menjëherë siç ishte përdorur e ëma. Keti thotë se Keli është përdhunuar

shumë herë nga Xhorxh Bushi e Dik Ceneji. Satanizmi dhe pedofilia e Xhorxh Bushit janë tema që përsëriten në kërkimet e mia. Në librin e tij, *The Franklin Cover Up: Child Abuse, Satanism, And Murder In Nebraska*, senatori i shtetit të Nebraskës, Xhon U. DeKamp, ka hedhur dritë mbi një grup përdhunuesish fëmijësh të Omahës, i kryesuar nga politikani i lartë republikan Laurenc King[30]. Më von Kingu u arrestua për një vjedhje të një shumë si nja 40 milionë dollarë nga *Franklin Credit Union*-i. Dhe, pikërisht teksa drejtonte hetimet mbi këtë mashtrim, DeKampi zbuloi klubin e satanistëve, midis të cilëve figuronin disa krerë të policisë lokale dhe Harold Anderseni, botuesi i gazetës lokale, *The Omaha World-Herald*. Në disa prej "festimeve" të pedofilëve, për të cilat flet DeKampi, ka marrë pjesë edhe... Xhorxh Bushi. Një tjetër aktivitet i lidhur me Xhorxh Bushin, i përshkruar nga kërkues të ndryshëm, ka qenë Operacioni Bruston. Një pallat i Brustonëve, në Virxhinia, afër Uashingtonit, ka qenë përdorur gjatë presidencës së Bushit për të kompromentuar disa politikanë, të cilëve u ofroheshin fëmijë, me qëllim që të kishin me ta marrdhënie seksuale, të cilat filmoheshin. Para vizitës presidenciale në Australi në dhjetor të vitit 1991, e përditshmja *Inside News* shtroi pyetjen që vijon: "Xhorxh Bushi është kreu botëror i pedofilëve?". Abuzimet e kryera nga Bushi me fëmijët janë të njohura nga kushdo që ka marrë mundimin të vështrojë përreth, as edhe shumë larg. Si Keti edhe Keli janë detyruar të kryenin marrëdhënie me kafshë, për disa filma të xhiruar me urdhër të Ronald Reganit. "Xhaxha Ronit" asgjë nuk i pëlqente më shumë se sa të shikonte ata filma, të njohur si "përrallat e natës së mirë të xhaxha Ronit"[31]. Sipas rrëfimit të Ketit, këta filma xhiroheshin dhe prodhoheshin nga pornografi i Reganit, Majkëll Dante (i njohur edhe si Majkëll Viti). Danteja kishte lidhje me mafjan dhe me CIA-n (që janë pak a shumë e njëjta gjë) dhe ishte mik i ngushtë i politikanëve si Gaj Vanderjagti, Xheral Fordi, Dik Tornburgu, Xhim Trafikanti dhe Geri Akermani[32]. Ishte Danteja ai që instalonte telekamera të fshehta shumë të vogla, të cilat filmonin bëmat seksuale të politikanëve amerikanë e të huaj, me qëllim që t`i detyronin pastaj nëpërmjet shantazhit të mbështesnin Urdhërin e Ditës të Vëllazërisë. Sa "liderë" sot përshtatin politika kundër interesave të popullit, sepse, po të mos bëjnë kështu, provat e skandaleve të tyre seksuale do të bëheshin publike? Keti shkruan se pornografi kryesor i Reganit ishte Lerri Flint, drejtor i revistës pornografike *Hustler*[33]. Ai frymëzoi një film, me titullin *Populli kundër Lerri Flintit*. Sipas Ketit, edhe Flinti ka lidhje me CIA-n, mafian dhe Vatikanin[34]. Një herë edhe Bill Klintoni qe kompromentuar në këtë mënyrë nga shefi i tij, më falni, nga "kundërshtari" i tij Xhorxh Bushi. Ndodhi në qendrën e manipulimit mendor të Lampit, në

Misuri, një vend i njohur si Vila Zvicerane. Bushi e detyroi Kelin t`i praktikonte një *fellatio* (praktikë erotike, që konsiston në stimulimin me gojë dhe me gjuhë të organit seksual mashkullor) Klintonit, teksa ky i bënte një *cunnilingus* (praktikë erotike, që konsiston në stimulimin me gjuhë të organeve gjenitale të jashtme femërore) Ketit. Ja shkëmbimi i batutave, që Keti kujton:

"Klintoni del që nga poshtë meje dhe, duke kërkuar përreth në kërkim të telekameras, i thotë Bushit: «Nuk ishte nevoja të ma bëje këtë. Jam sidoqoftë nga ana jote. Nuk ka nevojë të kompromentosh pozitën time». Klintoni i referohej sipas gjasës taktikave të shantazhit në përdorim midis Elitës së Urdhërit të Trëndafilit. Prej eksperiencës që unë kam pasur në Pyllin Bohem, krerët kompromentoheshin gjithmonë nga filmime me kamera të fshehta të praktikave të tyre të çuditshme seksuale"[35].

(Urdhëri i Trëndafilit është një tjetër sekt i fshehtë).

Pas këtij takimi, Bushi dhe Klintoni diskutuan mbi mundësinë e pjesëmarrjes së të bijës së Klintonit, Çelsit, në skenat e abuzimit me fëmijët. Bushi u tregua i gatshëm ta "zvirdhte". Klintoni i tha se do t`i ishte dashur të fliste me Hilarin[36]. Klintoni dhe zëvendësi i tij, Al Gori, formonin vërtet një çift të bukur. Dy ish satanistë, që u përkisnin grupeve të ndryshme, kanë deklaruar se Al Gori e kishte zakon të pinte gjak[37]. E gjitha kjo ka një kuptim, duke qenë se Arizona Uilderi, Nëna Hyjneshë e Vëllazërisë, që arriti të dilte nga ajo organizatë, më ka thënë se e ka parë Al Gorin të merrte pjesë në rite flijimi, gjatë të cilave ka marrë tipare zvarranike[38]. Keti thotë se është përdhunuar, bashkë me Kelin, edhe nga një tjetër kryeministër kanadez, Brajan Mulronej, që praktikon rregullisht seks me skllavet mendërisht të manipuluara[39]. Nëna dhe vajza të reja me mendje të kontrolluar çoheshin, dhe çohen ende sot, tek Ujëvarat e Niagarës, paksa përtej kufirit kanadez, ku Mulroneji i përdhunonte[40]. Ishte Mulroneji ai që, gjatë mandatit të tij, i diktoi popullit kanadez Marrëveshjen Amerikanoveriore të Tregtisë së Lirë (NAFTA), e destinuar të bëhet versioni amerikan i Bashkimit Evropian. Marrëveshja u ideua, nëpërmjet manipulimeve të ndryshme, prej kolegut të tij përdhunues fëmijësh Xhorxh Bushit dhe, më pas, nga Bill Klintoni.

Mendja e Ketit ka qenë kontrolluar në mënyrë aq të efektshme, saqë ajo që "graduar" me rolin e njohur si Model Presidencial, një skllave me mendje të kontrolluar, e përgatitur të punonte me njerëzit në krye të Shtëpisë së Bardhë dhe të Pentagonit. U përdor ajo për të kaluar mesazhet midis Reganit, Bushit dhe ortakëve të tyre të huaj, si diktatori Bebi Dok Duvalie i Haitit,

presidenti i Meksikës Miguel De La Madridi dhe ai i Panamasë Manuel Noriega, një agjent operativ i shpërblyer nga CIA, aktiv në Shtetet e Bashkuara në rrethin e tregtisë së paligjshme të drogës. Keti tregon se ka marrë pjesë në një "festë" ku ishin të pranishëm oficerët e aviacionit me gratë e tyre, baronët e drogës si portorikani Hoze Busto dhe Oliver Northi, "heroi" (ndihem keq vetëm ta dëgjoj!) i skandalit iranian Iran-*Contras*, në të cilin u shkëmbyen armët me drogën. Në katin e sipërm ishin Noriega, Majkëll Akuino dhe senatori Alen Simpson, një "republikan" i Ujomingut[41]. Teksa zhvillohej e gjitha kjo, Xhorxh Bushi drejtonte një "luftë kundër drogës", për të shpëtuar "fëmijët e Amerikës". Kokainomani Bill Klinton pas ca vitesh do të bënte të njëjtën gjë. Keti tregon se e ka takuar Klintonin shumë herë dhe kujton në mënyrë të veçantë se një ditë, në Arkansas, ai kërkoi (me sukses) të bindte një përkrahës, Bill Hallin, të hynte në tregtinë e narkotikëve. Halli nuk duhej të shqetësohej, i tha Klintoni, sepse ishte një operacion i orkestruar nga Regani. Ja ajo çka tha Klintoni në prani të mendjes së kontrolluar të Ketit:

"Nyja themelore është të arrish të kontrollosh industrinë (e drogës), *për këtë arsye duam t`i kontrollojmë ata* (furnizuesit dhe klientët). *Ti kontrollo tipin poshtë teje dhe Daja* (Dajë Sami, qeveria e Shteteve të Bashkuara) *të mbulon. Çfarë ke për të humbur? Asnjë rrezik. Askush nuk do të të varë me kokë poshtë për t`u tharë në diell. Dhe nëse ndonjë gjë bie nga kamioni teksa kalon (këtu Klintoni qesh dhe thith një çikë tjetër kokainë), mund ta ngresh lart prapë"*[42].

Keti tregon se më vonë, atë natë, e shoqja e Bill Hallit e çoi tek Hilari Klintoni, në krahun e Vilës Zvicerane të rezervuar për mysafirët. Aty, zonja Klinton, një tjetër kokainomane[43], i praktikoi një *cunnilingus* Ketit dhe pastaj ngulmoi që edhe ajo t`ia bënte[44]. Si presidenti Klinton edhe *"first lady"* e tij e dinin që Keti ishte një skllave me mendje të kontrolluar dhe që të dy janë në dijeni të gjithçkaje, sikurse nga ana tjetër është edhe Al Gori. Heshtin sepse edhe ata janë pjesë e atij mekanizmi. Sipas disa studiuesve, Hilari Klintoni është magjistare e nivelit të gjashtë të Urdhërit të Mendjendriturve, përveçse një manipuluese skllevërish[45]. Klintoni dhe Bushi mund të duken si kundërshtarë që u përkasin partive të "ndryshme" politike, por në të vërtet janë pjesë e të njëjtit mashtrim. Keti O'Briani ka vërtetuar nëpërmjet përvojës së vet të drejtpërdrejtë atë që hetuesit janë duke mbështetur prej vitesh: Bushi ishte presidenti i vërtetë gjatë "viteve të Reganit", ishte president gjatë mandatit të vet zyrtar në Zyrën Ovale dhe vazhdon të manovrojë fijet gjatë epokës klintoniane, duke iu përgjigjur urdhërave të mësipërme. Keti thotë se

i ka takuar Klintonin dhe Bushin së bashku shumë vite përpara, kur as që mund të imagjinohej që Klintoni do të ishte bërë president. I takoi një herë tek Vila Zvicerane në Misuri. Infermieria në atë vend është e strehuar në një qendër të CIA-s për trauma gati vdekjeprurëse. Keti, e drejtuar nga sistemi i kontrollit mendor, sapo kishte dorëzuar një sasi të madhe kokaine me një rulotë, kur pa dy presidentët e ardhshëm:

"...vura re guvernatorin e Arkansasit, Bill Klintonin, në një tavolinë të qoshes me Hilarin, që fliste me zëvendëspresidentin e asaj kohe Xhorxh Bushin dhe dy ndihmësit e tyre të veçantë, "ushtarët e vegjël" (mendje të kontrolluara) *që kishin sjellë kokainën në infermieri. Padroni i mendjes sime, senatori amerikan Robert Bird, më tha se Bushi dhe të tjerët ishin duke e përgatitur Bill Klintonin për në presidencë, "për rastin nëse opinioni publik amerikan do të ishte lodhur nga republikanët dhe mendonte të zgjidhte ndonjë demokrat". Klintoni ndoqi verbërisht urdhërat e Bushit. Nga çasti që realizimi i asaj, të cilën Hitleri e quante Rendi i Ri i Botës, nuk njihte rreshtime politike, nuk të çudit fakti që përgjegjësi i fushatës presidenciale të Klintonit në vitin 1992 ishte Xhejms Karvili, gruaja e të cilit, Meri Metalin, kishter drejtuar fushatën e Bushit"*[46].

Një tjetër tipar i përbashkët midis Klintonit dhe Bushit është pasioni i tyre për gjahun ndaj qenieve të kontrolluara mendërisht, qofshin ata burra, gra, apo fëmijë, në "Lojën Shumë të Rrezikshme". Keti tregon një prej përvojave të saj në Vilën Zvicerane, kur Klintoni dhe Bushi, me qentë, i ndoqën si gjah atë, të bijën Keli dhe dy "ushtarë të vegjël" me mendje të manipuluar, njëri prej të cilëve paraqiste tipare trupore tipike të një "italiani":

"Vila Zvicerane dukej e shkretë, po të mos ishin Bill Klintoni dhe Xhorxh Bushi, të ndaluar në anë të pyllit me qentë e tyre, gati për t`u hedhur në "Lojën Shumë të Rrezikshme" të gjahut të njeriut... Bushi e Klintoni ishin të veshur në të njëjtën mënyrë, me pantallona imitimi, me këpucë të mëdha e xhaketë alpinistësh. Një ves karakteristik për të dy ishte të mbanin nga një beretë me shkrime kriptike. Këtë herë, bereta imituese e Bushit, kishte një zbukurin ngjyrë portokalli me shkrimin "i dashur gjahtar". Kurse bereta blu e Klintonit thoshte "drejtoje lart" dhe kishte të pikturuar një pushkë gjahu. Klintoni kishte një pamje të fryrë me atë pushkë gjahu, ndërsa Bushi ngjante me një qitës me përvojë me pushkën e tij të zezë.

«Rregullat e lojës janë të thjeshta», filloi të thoshte Bushi, duke më aktivizuar me ato fjalë, të cilat prej kohësh i paraprinin një «Loje Shumë të Rrezikshme».

Klintoni e ndërpreu: «Ti vrapo. Ne të ndjekim».

Bushi vazhdoi: «Kjo do të quhet Gjahu i Virgjëreshës (Klintoni qeshi nën hundë) dhe ja ku është». Tregoi Kelin, që ishte ende në krahët e mi. «Po të marr. Ajo është imja».

Klintoni ngriti zërin: «Do të kesh kohë për të luajtur me qentë, sepse do të të bllokojnë në vend, teksa ne...» (për t'u dhënë më shumë emfazë fjalëve të tij, bëri të rrëshqiste një fishek në karikator). Pastaj ia nguli sytë "ushtarit të vogël" me fytyrën dyllë të verdhë. "Ushtar i vogël" është një term që e kam dëgjuar shpesh të përdoret për të emërtuar forcat speciale të të rinjve të përbëra nga automatë me mendje të kontrolluar, që veprojnë në Rendin e Ri të Botës.

Të dy burrat zunë të vraponin nëpër pyll. Fillova edhe unë të vrapoj me Kelin në krah. Po ta gjykoje nga aftësia e të lehurave të qenve, nuk isha largur edhe shumë kur ata qenë zgjidhur. Pesë qentë që lehnin më gjetën dhe më rrethuan. Keli klithi kur njëri prej tyre i kafshoi këmbën dhe unë automatikisht i dhashë një shkelm në turi. Isha e bindur se qentë do të na kishin shqyer, para se Bushi dhe Klintoni të arrinin tek ajo lirishtë. Dukej sikur ishin angazhuar në një diskutim serioz, kur Bushi ngriti sytë e buzëqeshi.

«Është imja», tha duke iu referuar Kelit. «Gjithmonë ka qenë, nga ana tjetër. Shkojmë!».

Teksa po më parakalonte Klintoni, ende i zhytur në mendimet e tij, e dëgjova të murmuriste: «Besoja se ishe duke ia bërë ndonjë qeni, apo diçka e tillë». E përshkuam atë copë rrugë në heshtje, me Klintonin që drejtohej nga e djathta, ndërsa Bushi më çonte drejt dy helikopterëve. Dera e helikopterit pranë meje u hap dhe Klintoni shtyu brenda italianin. «Mora këtë. Do ta vendosim në ndenjësen e hedhjes». Bushi i bëri shenjë të ulej në karrigen prej lëkure, mbi të cilin një trëndafil i zi simbolizonte vdekjen, ndërsa qesh unë që u ula mbi ndenjësen e hedhjes.

«Eja këtu, vogëlushe», me këto fjalë Bushi mikloi Kelin. «Mund të ulesh në krah të Dajë Xhorxhit». E mori në prehërin e tij, ndërsa Klintoni u drejtua nga piloti që po ndizte motorin. «Sipër liqenit, Xhek», e urdhëroi Bushi pilotin.

Teksa fluturonim përmbi liqenin e thellë e të largët të Vilës Zvicerane, Bushi e vendosi Kelin mënjanë, u ngrit dhe hapi derën e helikopterit. Era e fortë ia fryu prapa flokët e lyrët, teksa i bërri shenjë të ngrihej njeriut (italianit).

«Hidhu poshtë», e urdhëroi. «Është një urdhër».

«Si urdhëron, zotëri», u përgjigj ai dhe u hodh jashtë pa parashutë, i veshur siç ishte me tutën e tij imituese dhe me këpucët e mëdha alpine. Me tmerr vrojtova rënien e tij drejt vdekjes në ujërat poshtë nesh dhe stërkalat që ngriti, para se të fundosej..." [47].

Shtetet e Bashkuara mund ta humbasin lirinë? Zot i madh! Amerika ka pushuar së qeni e lirë shumë kohë më parë, nëse vërtet ka qenë ndonjëherë. Skllevërit me mendje të kontrolluar janë programuar për të kontrolluar mendjen e të tjerë njerëzve dhe, sot, ekzistojnë fëmijë e të rritur të panumërt me mendje të kontrolluar. Në Shtetet e Bashkuara ekzistojnë prej këtyre ushtri tamam të vërteta si Trupat Delta, "Ushtarët e vegjël", ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar ekzistojnë grupime të tjera "elitare" (të përbëra shpesh prej psikopatësh) si SAS-i dhe Regjimenti i Parashutistëve. Emri "Delta" ka të bëjë me piramidat dhe edhe me deltën e Nilit të Egjiptit të lashtë. Programimi "Delta" krijon ca vrasës. E vetmja stërvitje, së cilës këta njerëz i janë nënshtruar, është kontrolli mendor klasik, përtej përvojave të tyre individuale. Fëmijët e stërvitur për të hyrë tek Trupat Delta pësojnë tmerre të papërshkrueshme, me qëllimin për t`i bërë të pandjeshëm perballë dhimbjes dhe vdekjes, qoftë ato që u përkasin atyre, qoftë ato që u përkasin të tjerëve. Vëllazëria e di se, për të pushtuar botën me anë të forcës, duhet së pari të ketë në dispozicion ushtarë me mendje të kontrolluar, që të mos u bëjë përshtypje nga ajo çka u bëhet bashkëqytetarëve, apo familjarëve të tyre. Përse në luftëra, si ajo në Bosnje dhe në vrasjet masive, si ato në Algjeri, njerëzit rrëfejnë për fëmijë që kanë shfarosur familjet e veta së bashku me pjesën tjetër të fshatit, apo të komunitetit? Sepse ata fëmijë janë të kontrolluar mendërisht, ja përse. E njëjta gjë ndodh me "atentatorët vetëvrasës" dhe në operacione të tjera me "kamikazët". Për një sy të pastërvitur, ky kontroll mendor nuk është i dukshëm, por këta njerëz ndjekin në realitet një program të përpiktë. Në fund të fundit, janë ca automatë të kontrolluar nga zvarranikët.

Kur skllevërit nuk rezultojnë më të vlefshëm, apo programet e tyre fillojnë të prishen, vriten. Të ashtuquajturve Modele Presidenciale, si Keti O'Brianit, nuk u lejohet të jetojnë përtej vitit të tridhjetë dhe, kur kjo arriti edhe për Ketin në vitin 1987/88, i thanë se ishte viti i saj i fundit i jetës. Fatmirësisht, ajo dhe e bija, që atëherë ishte tetë vjeçe, iu shkëputën vdekjes nga një afarist, që quhet Mark Filips. Ai ishte, sipas thënies së saj, një ekspert teknikash të kontrollit të përparuar të mendjeve, pasi kishte punuar për *Ampex Corporation*-in dhe për ministrinë e Mbrojtjes amerikane si nënsipërmarrës. Kjo i dha mundësi të vihej në lidhje me shkencëtarët dhe kërkuesit kryesorë të kësaj fushe.

LIBRI

Aleks Hjustoni, përdhunues, pedofil dhe trafikant droge, ishte një "njeri spektakli", një hipnotizues skene, mendja dhe goja e të cilit rezultonin të aktivizuara nga dikush tjetër – nga organizmi i kontrollit mendor i qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Ishte detyra e tij t`i mbante Ketin dhe Kelin brenda nivelit të tyre të programimit, duke u dhënë atyre udhëzimet që merrte, që parashikonin heqjen e ushqimit e të ujit dhe trauma të vazhdueshme. Hjustoni përdorte zhvendosjet e tij nëpër turne si mbulesë për të transportuar Ketin dhe Kelin drejt "destinacionit" të tyre dhe kjo e afroi Ketin me të vërtetën në lidhje me industrinë e muzikës *country* të Shteteve të Bashkuara, madje të industrisë së spektaklit në përgjithësi. Muzika *country*, zbuloi ajo, përdorej nga zyra qeveritare amerikane për të shpërndarë sasi të mëdha droge brenda shoqërisë amerikane dhe si mbulesë për eksperimentet e kontrollit mendor[49].

Shumë njerëz në industrinë e spektaklit janë të lidhur me konspiracionin, ose pilotohen për këtë qëllim. Ndërmjet tyre ka qenë edhe Merilin Monroja, njëra prej të "dashurave" të presidentit Xhon F. Kenedi. Të dy duhej të vriteshin. Sipas Springmejerit dhe Velerit, autorë të një libri mbi këtë argument, edhe këngëtarja Madona është një skllave me mendje të kontrolluar. Springmejeri thotë se ka shtënë në dorë një katalog të klubit të filmave porno *Vidimax*, që e ka selinë në Nju Xhersi. Kjo shoqëri shet video, në të cilat tregohen vrasje (*snuff video*), akte kanibalizmi dhe flijime[52]. Të dy këta autorë thonë se Madona ishte një skllave me mendje të kontrolluar, duke qenë se një grua që mbante emrin e saj, Luizë Çikone, dhe që jetonte në Nju Jork, në East Village, mori pjesë në një film, në të cilin përdhunohet dhe ku përdhunuesi i saj merret e flijohet. Duket se *Vidimax*-i ua shet ortakëve të tij këtë video me çmimin 19 dollarë[51]. Nëse, siç thonë, Madona vuan prej çrregullimeve të personalitetit të shumëfishtë, ka shumë të ngjarë që të mos kujtojë asgjë nga e gjitha kjo. Elvis Presli, një anëtar i Shoqërisë Teozofike, është quajtur skllav me personalitet të shumëfishtë nga një i mbijetuar dhe Sisko Veleri, e cila ka qenë vetë një skllave që ia doli të lirohej, thotë se ka prova për këtë. Ajo thotë se manipuluesi i Elvisit ishte menaxheri i tij, "koloneli" Tom Parker[52]. Kur Elvisi vdiq (po të pranojmë se kjo është e vërtetë), *Sun International Corporation* hodhi në treg një album të tij me titullin *Orion*, kopertina e të cilit paraqiste një disk diellor me krahë. Ky është një simbol i lashtë egjiptian dhe sumer i përdorur nga Urdhëri i Tempullit Lindor dhe nga grupe të tjera të Vëllazërisë. Një tjetër këngëtare me mendje të kontrolluar, sipas Ketit, është Loreta Lini, një skllave e CIA-s. Në dritën e kësaj shpjegohen problemet e saj mendore dhe emocionale. Menaxheri i Loretës, Ken Rileji, është një pedofil, përveçse është mik i ngushtë i manipuluesit të Ketit, Aleks

Hjustonit. Të dy ishin të lidhur me deputetin amerikan Geri Akerman, "demokrati" i Nju Jorkut që, sipas rrëfimit të Ketit, çoi deri në fund një operacion të ndërlikuar të trafikut të drogës në portin e Long Islandit[53]. Një tjetër prej grave të manipuluara, që u shpëtua prej Mark Filipsit, është Seidina "Dina" Rid, e bija e aktorit-këngëtar Xherri Rid. Seidina është përdorur shumë herë bashkë me Ketin për të xhiruar filma pornografikë nën kontrollin e të shoqit, sadistit David Rorik. Roriku qe stërvitur në teknikat e kontrollit mendor nga Aleks Hjustoni dhe i ati i famshëm i Seidinës dinte gjithçka, sipas asaj që pohon Mark Filipsi. Seidina ishte skllavja seksuale e parapëlqyer e princit Bandar bin Sulltan, ambasadorit saudit në Shtetet e Bashkuara[54]. Sikurse Keti pohon në librin e saj dhe në deklarime të tjera publike[55], edhe këngëtari Kris Kristoferson, një narkoman i alkolizuar, i lindur në një familje me anëtarë të CIA-s, është i përfshirë në këtë rreth me rolin e kontrolluesit dhe të manipuluesit të mendjeve të skllevërve. Keti tregon se është torturuar prej tij dhe prej Majkëll Akuinos me shkarkime elektrike të voltazhit të lartë[56]. Kristofersoni, një jezuit, është bashkëpunëtor i senatorit Robert K. Bird, kontrolluesit të Ketit. Në lidhje me këtë thuhej, në zhargonin e kontrollit mendor, se Birdi ishte i "martuar" me Ketin, edhe pse ajo zyrtarisht ishte gruaja e Aleks Hjustonit. Ja ajo çka Keti pohon për Kristofersonin në librin e saj:

"...në fund të verës së vitit 1987 Kristofersoni gati më mbyti për vdekje me penisin e tij, gjë që e eksitoi më tej, gjatë një takimi të organizuar prapë edhe një herë nga Birdi"[57].

Një tjetër psikopat dhe trafikant droge për llogari të qeverisë, i famshëm në të gjithë botën, është legjenda e *rock'n roll*-it Xherri Li Levis, mik i Elvis Preslit. Keti thotë se është kërcënuar shumë herë me fjalët: "Të shesim tek Xherri Lija". Gjatë një konference mbi kontrollin mendor, që mbajta në Shtetet e Bashkuara, njoha një grua, e cila, ashtu si Keti O'Briani, kishte qenë një Model Presidencial. Që nga fëmijëria e parë, që e kishte kaluar në Kaliforninë jugore, kishte qenë manipuluar nga komiku Bob Hopi i Pyllit Bohem. Ajo kishte punuar për një kohë të gjatë me Henri Kisingerin, programues shumë i aftë dhe me Nelson Rokfelerin, që për katër herë ka qenë guvernator i Nju Jorkut. Rokfeleri u bë zëvendëspresident i Shteteve të Bashkuara, kur pedofili Xherald Ford zëvendësoi Riçard Niksonin, si pasojë e skandalit të Uotergejtit. Po kjo grua ka deklaruar se ka qenë detyruar me forcë të kishte marrëdhënie seksuale me Xhon F. Kenedin në moshën 12 vjeçare, edhe pse, sipas pohimit

të vetë asaj, ishte trukuar në mënyrë që të tregonte sikur ishte 16 vjeçe. Bob Hopi përmendet edhe nga Springmejeri e Sisko Veleri në cilësinë e manipuluesit të skllevërve dhe të agjentit operativ të shërbimeve sekrete britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur u soll nëpër botë për të organizuar koncerte për trupat ushtarake[58]. Hopi dhe baroni i mediave, Rupert Murdoku, janë dekoruar të dy me titullin "kalorës" nga Kisha Katolike Romane e Los Anxhelsit, në Kaliforni. U bënë Kalorës të Urdhërit të Shën Grigorit dhe, ndërsa po shkruaja këtë libër, Hopit iu dha edhe titulli i kalorësit të nderit nga ana e mbretëreshës së Anglisë, gjë që e ngriti në të njëjtin nivel me Bushin, me Kisingerin dhe me pak të tjerë të zgjedhur, që Uindsorët i vlerësojnë për kushtimin e treguar ndaj çështjes. Bob "kukull" Hopi është përdorur për të tërhequr në rrjet shumë emra të spikatur të Hollivudit. Hollivudi dhe industria e spektaklit janë të mbushur si me skllevër edhe me manipulues.

Një tjetër personazh i famshëm, që Springmejeri dhe Veleri mendojnë se është një satanist, është predikuesi i "krishterë" më i famshëm i botës, Bill Grahami[59]. Springmejeri ka mbledhur një listë me njerëz që e kanë parë Grahamin "në aksion". Këta thonë se Grahami i shfrytëzon seksualisht skllevërit e Projektit Monark dhe se pastron fitimet e pista të drogës nëpërmjet organizatës së tij evangjelike. Grahami është një kukull e Vëllazërisë, që bën punën e lajmëtarit ndërmjet liderve të botës[60]. "Krishtërimi" është një mbulesë e përdorur nga shumë satanistë e programuesa dhe, sipas asaj që thotë doktoresha Loreda Foks në librin e saj *The Spiritual And Clinical Dimensions Of Multiple Personality Disorder*, "pjesa më e madhe e të mbijetuarve, me të cilët kam punuar, kishin prindër satanistë, që mbulonin funksione të rëndësishme brenda Kishës; shumë ishin priftërinj protestantë"[61]. Bill Grahami, një mason i shkallës së 33-të, është mik i ngushtë i Xhorxh Bushit dhe Henri Kisingerit. Sikurse është e njohur, ai dhe Bushi u "lutën" së bashku, pasi Bushi i kishte dhënë shenjën e nisjes vrasjes së një numri të pafund burrash, grash e fëmijësh, gjatë luftës së Gjirit. Një tjetër mik i Grahamit, Alen Dallasi, ka qenë drejtori satanist i CIA-s, që kontribuoi për financimin e Adolf Hitlerit. Të nesërmen e luftës, Dallesi ishte njëri prej ideatorëve kryesorë të Projektit MKUltra dhe Monark. Tri kryqëzatat e para të krishtera të Grahamit u financuan nga Uiliam Randolf Hearsti, manjati i botimeve gazetareske, përveçse anëtar i lartë i Vëllazërisë[62]. Njerëzit më të rëndësishëm që kanë marrë pjesë në kryqëzatat e Bill Grahamit dhe në Shoqatën e tij evangjelike janë masonë, midis të cilëve figuron edhe Uiliam M. Uatsoni, president i *Occidental Petroleum Corporation*, që është korporatë e atij njeriut fasadë të Vëllazërisë siç është Armand Hameri ("arm and hammer" në anglisht do të thotë "krah e çekan"). Kur familja e Bill Grahamit arriti në Shtetet e Bashkuara

për herë të parë, mori mbiemrin Frank dhe iu afrua Jakob Frankut, kreu i një degë sataniste e njohur si "sabatizëm" dhe, pastaj, pasi ishte ai që e drejtonte, "frankizëm"[63]. Një Model Presidencial më ka thënë se papa Gjon Pali II është një personalitet i shumëfishtë i programuar dhe kjo nuk të çudit.

Keti thotë se arriti të dilte, bashkë me të bijën, nga Projekti Monark, kur arriti Mark Filipsi. Ky tregon se punonte bashkë me Aleks Hjustonin në një afarizëm të madh, që përfshinte Hong Kongun dhe Kinën, kur, një përfaqësues i ministrisë së Mbrojtjes kineze, i zbuloi prapaskenën e jetës së Hjustonit dhe përzierjen e tij me CIA-n, me narkotikët, me pastrimin e parave të pista, me prostitucionin e të miturve dhe... me skllavërinë. Informatori i Filipsit, duke zotëruar prova dokumentare, i tha se Hjustoni ishte një njeri "me të vërtetë i keq" dhe se krimet e tij përputheshin me ato të Shtëpisë së Bardhë. Ja çfarë shkruan Mark Filipsi tek *Trance Formation Of America*:

"Përgjigjja ime e parë ndaj këtij "zyrtari" qe se Hjustoni ishte tepër budalla e i pandershëm për të qenë i lidhur me shërbimet sekrete amerikane. Ndaj këtij komenti ai u kundërpërgjigj menjëherë duke më treguar një fotografi të Hjustonit, e cila të bënte të të përziheshin zorrët: ai, me një ngërdheshje demoniake, ishte duke përdhunuar nga prapa një fëmijë të vogël e të frikësuar zezak, që më vonë e identifikova si haitian"[64].

Filipsi mori atëherë kontakt me një mik të vjetër, tani i vdekur, që kishte qenë gjeneral i aviacionit në divizionin e shërbimeve sekrete dhe kishte mbajtur lidhje të ngushta me krerët e tyre nacionalë e të jashtëm. Gjenerali i foli për tregtinë e skllevërve të CIA-s në të gjithë botën dhe i tha se Keti e Keli i ishin nënshtruar kontrollit mendor të bazuar mbi traumën. Mark Filipsi kujton:

"Isha si i trullosur. Fjalët e para që më dolën nga goja qenë: «Si mund të bëhet për t`i nxjerrë prej andej këto persona?»".

"Ai buzëqeshi e tha: «Unë nuk do ta bëja. Çfarë dëshiron të bësh me to, sapo të jenë jashtë?». Para se të përgjigjesha, më ndërpreu e tha: «Shiko. Ti je gjithmonë ai që ke qenë, por edhe për Dajën (Shtetet e Bashkuara) nuk ndryshon asgjë. Në tërësi, CIA, FBI-ja dhe mafia janë e njëjta gjë dhe lëvizin në fushë ushtarake»"[65].

Filipsi ngulmoi në dëshirën e tij për t'i nxjerrë prej andej dhe miku i vet i dha kodet e kontrollit mendor (të bazuara tek Zoti e tek krishtërimi) që do ta kishin bindur Ketin ta ndiqte. Historia e plotë tregohet në librin e tyre. Filipsi

tregon se i çoi në Alaskë, pasi i kishte siguruar autoritetet se nuk kishte ndërmend të zbulonte të vërtetën. U tha atyre se do t'i kishte "çuar në Alaskë dhe do ta kishte mbajtur gojën të mbyllur si një peshk". Shpresonte se kjo do t'u kishte kursyer atyre jetën. E ndihmuan edhe shumë njerëz të mirë të shërbimeve sekrete. Në Alaskë, Mark Filipsi vuri në përdorim dijet e veta, me ndihmën e fshehtë të njerëzve të takuar prej tij, për të shprogramuar mendjen e parcelizuar në të ndara të Ketit. Kjo punë vazhdoi për muaj të tërë. Por ai ia doli mbanë në synimin e tij dhe mendja e kujtesa e Ketit dolën përsëri në dritë. Kishte shumë për të treguar, tani që kujtonte me qartësi të kristaltë gjithçka që i kishte ndodhur asaj dhe Kelit. Fatkeqësisht, të shprogramoje Kelin rezultoi edhe më e vështirë dhe ajo vuajti prej një forme të rëndë të azmës të shkaktuar nga traumat e vazhdueshme, të cilave i ishte nënshtruar. Kontrolluesi i mendjeve i CIA-s, doktor Luis Xholin Uest dhe bashkëpunëtorët e tij u përpoqën t'ia merrnin Kelin Markut dhe Ketit dhe, më pas, autoritetet iu drejtuan "ligjit", për të siguruar përsëri kontrollin mbi të. Keli u bë një e burgosur politike nën ruajtjen e shtetit të Tenesesit. Mjetet e informacionit dhe publiku janë dëbuar nga sallat e gjyqit, ku është duke u zhvilluar procesi i saj dhe asaj i është mohuar e drejta që të ketë një avokat të pavarur. Gjykata ka ndaluar edhe fjalët si "president", "politikë", "Rendi i Ri i Botës", "kontroll mendor" dhe "Xhorxh Bush"[66]. Këto masa janë marrë për të "ruajtur" "sigurinë kombëtare" dhe u morën pas botimit të librit të tyre. Autoritetet s'pranojnë ta shprogramojnë Kelin nga projekti i kontrollit mendor të quajtur Monark-MKUltra, duke evokuar Aktin e Sigurisë Kombëtare, që u lejon atyre të kërkojnë pretekstin e "sigurisë kombëtare", sa herë që duan të mbulojnë diçka. Keti dhe Marku janë kërcënuar shumë herë me vdekje e, megjithatë, ua kanë dërguar informacionet e tyre, shpesh të mbështetura me dokumente e me shirita të inçizuar, një morie politikanësh amerikanë, zyrave qeveritare e grupeve të presionit. Por ato kanë qenë të shurdhëra.

Keti thotë se ka qenë e pranishme në shumë biseda mbi Rendin e Ri të Botës, që provojnë vlefshmërinë e temave me të cilat jemi marrë unë e shumë të tjerë, përfshirë planin e një grushti shteti ushtarak në Shtetet e Bashkuara. Sikurse provojnë përvojat e Ketit, përpjekja për të marrë kontrollin mbi botën nuk është një teori, është një gjë REALE, që është duke ndodhur tani. Keti thotë se e ka dëgjuar qoftë Reganin, qoftë Bushin të ngulmonin mbi faktin se e vetmja rrugë drejt "paqes në botë" kalon përmes "kontrollit mendor të masave". Ajo ka qenë e pranishme edhe në planifikimin e projektit Edukim 2000, i parashikuar nga Rendi i Ri i Botës, nën kontrollin e një tjetri prej programuesve të saj përdhunues, Bill Benetit, një manipulues mendor

zvarranik i formuar nga jezuitët, që u bë ministër i Arsimit Publik të Shteteve të Bashkuara, gjatë presidencave Regan-Bush[67]. Ajo u vu pastaj nën kontrollin e Lamar Aleksandrit, ish guvernator i Tenesesit, me të cilin Keti thotë se ka qenë e detyruar të marrë pjesë në një rit satanik në rrethinat e Neshvilit[68]. I vëllai i Bill Benetit, Bobi, edhe ai i akuzuar se e ka përdhunuar Kelin në Pyllin Bohem në vitin 1986, u bë më pas mbrojtës ligjor i Bill Klintonit[69]. Një tjetër detyrë që iu besua Bill Benetit ishte drejtimi i një "lufte kundër drogave", për llogari të Xhorxh Bushit! Eh, të paktën nuk mund të thuhet që Beneti nuk kishte përvojë në këtë fushë. Keti thotë se është përdorur për të kompromentuar dhe për t`u dhënë "favore" politikanëve të rëndësishëm që do të kishin mundur të mbështesnin projektin Edukim 2000. Ajo kuptoi se ky projekt, i njohur edhe si Amerika 2000 dhe Global 2000, kishte qëllimin të rriste aftësinë e "të nxënit" të fëmijëve dhe të shkatërrimit, në të njëjtën kohë, të aftësisë së tyre për të arsyetuar me kokën e vet[70]. Mendjet e fëmijëve tanë kontrollohen çdo ditë në shkollë dhe pjesa më e madhe e mësuesve të tyre as që e kuptojnë fare që e bëjnë këtë gjë, sepse janë të kushtëzuar nga i njëjti sistem.

Keti ka mundur të vërë re se Kombet e Bshkuara nuk janë tjetër veçse një instrument në duart e manipuluesve. Xhorxh Bushi i referohej Rendit të Ri të Botës si "lagjes" së tij dhe tregonte se si thjesht u kishte thënë krerëve të tjerë botërorë, si mbretit saudit Fahd, atë që duhej të bënin e të thoshin. Pa dyshim e njëjta gjë vlen edhe për Sadam Huseinin, me të cilin Bushi ka ndarë ryshfete nafte për një shumë të përgjithshme prej qindra milionë dollarësh. Sekretarja e shtetit amerikan (ish ambasadorja pranë Kombeve të Bashkuara) Medelinë Ollbrajt, është pjesë e Vëllazërisë. Unë e quaj "priftëresha më e lartë e politikës amerikane". Xhorxh Bushi e përshkroi njëherë në prani të Ketit si "...e para e kuvendit e të gjitha murgeshave (skllaveve)"[71]. Ollbrajt është në dijeni të ekzistencës së skllevërve të manipuluar nga qeveria amerikane, politikën e së cilës mbështet. Keti kujton se Brajan Mulroneji, kryeministri kanadez dhe përdhunues fëmijësh, e parashtroi planin e Rendit të Ri të Botës teksa gjendej bashkë me Reganin në të njëjtin *cocktail party* të Shtëpisë së Bardhë, ku Keti takoi Ollbrajtin. Ajo kujton të jetë çuar pastaj në një dhomë të Shtëpisë së Bardhë bashkë me skllave të tjera, njëra prej të cilave kontrollohej prej senatorit amerikan Arlen Spektor. Në atë kohë arriti Mulroneji për t`i përdhunuar, pasi kishte aktivizuar programin e skllavërisë seksuale[72]. Keti vuri re se njëra prej skllaveve kishte tatuazhin e një trëndafili të kuq tek kyçi i majtë i dorës dhe të njëjtin simbol e ka parë në trupin e shumë njerëzve të takuar gjatë atyre viteve, parfshirë Mulronejin. Është fjala për shenjën dalluese të Urdhërit të Trëndafilit, që është një degë e Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve. Ndërmjet

shumë personave të lidhur me Urdhërin e Trëndafilit figurojnë Klintoni, Bushi, Birdi, Beneti e Trudo. Por, sa e çuditshme që Partia Laburiste Britanike në vitet tetëdhjetë e zëvendësoi simbolin e saj me... trëndafilin e kuq.

Ajo çka është duke ndodhur shkon përtej çdo përfytyrimi. Një burimi im më ka treguar për mijëra fëmijë të mbajtur në kafazë pranë qendrës së armatimeve detare në China Lake, në shkretëtirën kaliforniane të Ridxhkrestit. Kjo strukturë ndodhet në të njëjtën zonë ku është gërmuar një gropë e përbashkët për fëmijët e vrarë gjatë riteve të Lankasterit, për të cilat fola më parë. Në këtë rajon, zona të gjera midis Los Anxhelesit, Luginës së Shën Bernardinos dhe Las Vegasit, në Nevada, janë të pushtuara nga forcat ushtarake amerikane.

Bëhet fjalë edhe për njërën prej zonave më të rëndësishme të planetit, që i kushtohet satanizmit. Springmejeri dhe Veleri shkruajnë se disa vende të programimit afër qendrës China Lake janë magazina dhe taverna *Papa Ludo* dhe kështjella Skoti, në atë që me të drejtë quhet Lugina e Vdekjes[73]. "Lokali publik" i rezervuar për personelin e CIA-s, që vepron pranë qendërs së armatimit detar China Lake, është *Hideaway Tavern*. Në veri-perëndim të fushës së aviacionit autoritetet kanë ravijëzuar mbi terren një ekzagramë (Yllin e Davidit – Vulën e Solomonit)[74]. Këto toka shtrihen deri në shkretëtirën e Nevadës, që janë të mbushura me qendra të Vëllazërisë, si brenda edhe jashtë qytetit të Las Vegasit, që është fortesa e tyre. E kam përshkuar me makinë këtë zonë dhe ju garantoj se bëhet fjalë për njërin nga vendet më turbullues të vizituar prej meje.

Springmejeri dhe Veleri thonë në librin e tyre se "grumbuj" me fëmijë, në rendin e njëmijë, dy mijë edhe tremijëve, mbaheshin të burgosur pranë qendrës së armatimit detar China Lake në kafazë, të varur në tavanin e tyre[75]. Kafazët, të njohur si "kafazë të varjes", ishin të elektrizuar dhe fëmijët torturoheshin me shkundje të fuqishme elektrike[76]. Një fëmijë, që i kishte mbijetuar Projektit Monark, thotë se ka parë pranë qendrës China Lake rreshta të pafund me kafazë dhe një prej programuesve të veshur si prift katolik[77]. Ai ka shtuar se korenti elekrik, që shkarkohej përgjatë kafazëve, nxirrte një si zukamë dhe se fëmijët flijoheshin nga njerëz që ishin të veshur me rrobë të zezë dhe vendoseshin përpara fëmijëve që ishin të mbyllur në kafazë. Kjo ndodhte mbi një pllakë mermeri, e cila bënte punën e altarit[78]. Jozef Mengele (doktor Grini, ose Grinbaum) dhe Euin Kameroni (doktor Uajti) kanë punuar që të dy në qendrën China Lake pas luftës. Atëherë quhej *Naval Ordinance Test Station* ose *NOTS*.

Aktiviteti që zhvillohet në China Lake është ngushtësisht i lidhur me

Institutin e Teknologjisë Pasadena, në Kaliforni[79]. Fëmijët trasportohen në këtë qendër me tren, me makinë dhe me aeroplan. Njëri prej mjeteve të transportit më të përdorur për të mbërritur në China Lake është aeroplani që niset nga pista e Santa Rozës, pranë Pyllit Bohem. Kjo pistë është ndërtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore si bazë stërvitjeje. FEMA, Agjensia Federale për Drejtimin e Emergjencës, ka këtu një stacion radiofonik[80]. FEMA është zyrtarisht agjensia qeveritare, që ndërhyn në raste fatkeqësish natyrore si uraganet dhe tornadot. Por, në realitet, bëhet fjalë për një prej strukturave të Vëllazërisë dhe në të gjitha Shtetet e Bashkuara janë duke u ndërtuar kampe përqëndrimi, që të jenë në gjendje të nxënë mijëra njerëz. Nuk bëhet fjalë për një teori: ekzistenca e disa prej këtyre vendeve është vërtetuar edhe nga filmat me metrazh të shkurtër. Këto qendra disponojnë linja hekurudhore të brendshme, sipas modelit nazist. Muret e rrethuara me tela me gjemba, që fillimisht shërbenin për të mos lejuar të hynte askush, tani shërbejnë për të mos lejuar të dalë askush. Pista e Santa Rozës është zyrtarisht e mbyllur e, megjithatë, aeroplanët ngrihen prej aty çdo natë dhe nuk i ndezin farët gjersa të ndodhen në një lartësi prej disa qindra metrash[81]. Ata ulen pastaj në qendrën China Lake herët në mëngjes. Nëse besoni se numri i fëmijëve të përfshirë është i tepruar, atëherë është mirë që të dini se bëhet fjalë vetëm për një pjesë të vogël të atyre që, në çdo cep të botës, i nënshtrohen programimit mendor dhe që pësojnë abuzime seksuale nga ana e rretheve satanike. Fëmijët arrijnë tek programet e kontrollit mendor nëpërmjet agjensive të birësimit (sidomos, duket, ato katolike), nëpërmjet rrëmbimeve të kryera në Botën e Tretë dhe falë prindërve që shesin fëmijët e tyre. Ka organizata, detyra e të cilave është të gjejnë fëmijë që të kenë pasuri gjenetike të përshtatshme për këto projekte. Më i njohuri ka qenë grupi CIA/FBI i quajtur Finders dhe fëmijët, të programuar kështu, stërviten edhe me qëllim që të gjejnë nga ana e tyre të tjerë fëmijë. Një rast që doli në dritë në shkurt të vitit 1992 nxori të përfshirë një avokat amerikan me emrin Patrik Gagel, i cili kishte eksportuar tremijë fëmijë nga Shtetet e Bashkuara në Peru me qëllim "birësimi", fëmijë për të cilët nuk u mor vesh më asgjë[82]. Gageli u arrestua nga policia peruane, por u lëshua më pas si pasojë e presioneve "nga lart"[83]. Don Ekeri, drejtor në Idaho i organizatës kërkimore mbi UFO-t e njohur si MUFON, ka shkruar fjalët që vijojnë në numrin e korrik-gushtit të vitit 1989 të revistës *UFO*:

"Sipas një raporti të fundit të sapo ardhur nga kontea e Uestkesterit, në Nju Jork, disa kërkues kanë zbuluar se në një zonë të vogël të kontesë, ku janë parë shumë UFO dhe ku thuhet se janë rrëmbyer shumë persona, kanë dalë më shumë

LIBRI 24

se 3.000 kallëzime fëmijësh të zhdukur. Pas një hetimi të zgjeruar nga ana e policisë lokale, këta fëmijë nuk janë gjetur ende pranë qendrave të pritjes, apo në distriktet me dritë të kuqe. Kërkuesit dhe forcat e rendit janë të tronditur"[84].

Elita me mendje të kontrolluar

Shkencëtarët e Vëllazërisë e kanë kuptuar se aftësia e veçimit të shpejtë kalon nga njëri brez në tjetrin nëpërmjet pasurisë gjenetike. Ja përse CIA vuri në shenjë Keti O'Brianin. Kjo e fundit ishte në fakt fëmijë prindërish, të cilët kishin pësuar nga ana e tyre abuzime seksuale kur kishin qenë fëmijë vetë dhe, kështu që, aftësia e veçimit, që ata kishin zhvilluar për të përballuar traumat e tyre të moshës së fëmijërisë, do të ishte trashëguar tek fëmijët e tyre. Kjo i bën fëmijët mjaft më të prirur ndaj veçimit, të bazuar mbi kontrollin mendor të nxitur nga trauma. Nuk ka shembull më të mirë të kësaj se sa ai i dhënë nga vetë familjet zvarranike. Këto ia nënshtrojnë në fakt fëmijët e tyre traumave dhe abuzimeve të frikshme dhe kjo "dëshmi" gjenetike, e kaluar nga brezi në brez, i ka bërë këto familje veçanërisht të prirura ndaj veçimit nëpërmjet kontrollit mendor. Duket se ato ia nënshtrojnë fëmijët e tyre një sërë provash rreth moshës 18 muajshe, për të përcaktuar se kush prej tyre është më i prirur ndaj veçimit. Pastaj, që nga fëmijëria, ata programohen të mendojnë ashtu siç Vëllazëria kërkon të mendojnë, në mënyrë që të çojnë përpara Urdhërin e Ditës dhe t'ia përcjellin brezit të ardhshëm. Njerëz me mendje të kontrolluar manipulojnë, pra, njerëz të tjerë me mendje të kontrolluar. Sipas përvojave të Sisko Velerit dhe të shumë viktimave e terapistëve të përfshirë, fëmijët e familjeve të Elitës ngjizen sipas ritualeve të lashta dhe programimi i tyre bëhet kohë më parë se të lindin. Njëri prej këtyre ritualeve, që paraprin lindjen, quhet ceremonia e Fëmijës Hënor. Nënat që lindin të ashtuquajturin "fëmijë i errët" quhen "Rozmari" – trëndafili i Maries. Roman Polanski, bashkëshorti i Sharon Tatit, aktores së vrarë nga sekti i Çarls Mansonit, ka xhiruar një film me titullin *Rosemary's Babi*. Filmi i Polanskit flet për një grua të fekonduar nga një demon i evokuar prej një sekti satanist. Gjatë shekujve është vërtetuar se, nëse torturohet një fëmijë që në barkun e nënës, ai fëmijë do të ketë një personalitet të veçuar, apo të "ndarë" dhe për këtë arsye, nënat traumatizohen gjatë lindjes, për të traumatizuar fëmijët. Në barkun e nënës futen disa gjilpëra, për të shpuar fëmijën. Shumë lindin paralel, për shkak të efektit që kjo ka mbi ta dhe e gjitha kjo bën pjesë në procesin e seleksionimit.

Pas lindjes, këtyre fëmijëve u caktohet një programues. Normalisht bëhet fjalë për një grua, por mund të jetë edhe një burrë. Fëmijëve të Vëllazërisë

shpesh u caktohet një programuese e njohur në nivelet e larta si Dama e Madhe[85]. Fëmijët "lidhen" me programuesit dhe nxiten të zhvillojnë vartësinë kundrejt tyre. Ideja është që t'i bindin këta fëmijë me anë të manipulimit t'i nderojnë programuesit e tyre dhe t'i shikojnë si një perëndi. Fëmijës i lejohet të zhvillojë një lidhje të ngushtë vetëm me programuesin dhe kjo lidhje bazohet mbi një formë adhurimi, vartësie dhe bindjeje. Pra fëmijëve u ngulitet një formë bindjeje e plotë kundrejt programuesit dhe, si rrjedhojë, kundrejt Urdhërit të Ditës e krerëve të Vëllazërisë. Sapo që procesi i të qarit i ka zhvilluar mushkëritë e tyre, u mësohet të mos qajnë, nëpërmjet një sërë ndëshkimesh e shpërblimesh, sipas asaj që është parashikuar nga sistemi i njohur si modifikim i sjelljes. Janë duke u bërë tashmë robotë. Një teknikë themelore është ajo që atyre u përcillet një dashuri e dhembshuri e fortë për 18 muajt e parë të jetës dhe, pastaj, papritmas, privohen nga kjo dashuri e trajtohen me egërsinë më të skajshme, kështu që trauma që fëmija pëson është shumë e madhe. Këtyre fëmijëve u lejohet edhe që t'u hyjë në zemër ndonjë kafshë, e cila pastaj vritet. Programuesi, të cilin fëmija e donte aq shumë, bëhet tani njeriu, të cilit fëmija ia ka frikën me të njëjtën forcë. Springmejeri dhe Sisko Veleri, kjo e fundit vetë viktimë e programimit të zbatuar nga qeveria, i komentojnë kështu këto fakte:

"Për të shtrembëruar shqisat e fëmijës dhe për të krijuar tek ai veçimin e personalitetit mund të përdoret me të vërtetë gjithçka. Të nuhaturit e fëmijës së ulur në bisht në kafazin e tij, do të mposhtet nga era e qelbur e jashtëqitjeve të veta, të erës së amoniakut dhe të ushqimit të prishur. Pirja e gjakut do të tjetërsojë përkundrazi ndjenjën e shijes. Për të ndryshuar të dëgjuarit do të mendojnë qentë e programuesve të veshur me rroba satanistësh, goditjet e forta, muzika rrok, zukama e rrymës elektrike dhe nxitjet me ultratinguj. Ndjenja e formave që, në rrethana normale, zhvillohet gradualisht, paragjykohet tani nga fakti që fëmija rrotullohet me shpejtësi të madhe dhe nxitet të besojë se po rrëzohet. Privohet edhe nga gjumi e drogohet...".

"...Faza e katërt është t'i heqësh çdo gjë të pëlqyeshme. Fëmija mbyllet brenda një kafazi dhe torturohet me shkarkesa elektrike. Shqisat e tij mbingarkohen gjersa ta lënë pa ndjenja... gjatë fazës së katërt fëmija ka uri, ka të ftohtë dhe është pa rroba. Kur më në fund sheh padronin e tij të dashur, apo sidoqoftë kujdestarin që do, pasi ka vuajtur për një periudhë kohe që shkon nga 42 deri në 72 orë, ndihet i emocionuar dhe e largon vuajtjen e orëve të mëparshme të mungesave. I duket sikur dikush vjen në ndihmë të tij. Në atë pikë, programuesi aq shumë i dashur,

tregon anën e tij më të ligë dhe fëmija për t'i bërë ballë faktit se kujdestari i tij i dashur jo vetëm që e kishte lënë vetëm, por tani i bën edhe keq, veçohet, në të njëjtën mënyrë që veçohen fëmijët si pasojë e traumës së lindjes së parakohshme"[86].

Si munden anëtarët e Vëllazërisë të jenë kaq çnjerëzorë? Munden, sepse i përkasin racës së zvarranikëve, ose më mirë, atij grupi të zvarranikëve të nivelit më të ulët të përmasës së katërt, që nuk provojnë të njëjtat emocione si tonat. Ky trajtim ka si qëllim, pjesërisht, të bëjë të mundur që çfarëdo vetëdije që të mishërohet tek ai fis me qëllimin për ta minuar atë pushtet, të mos ketë thuajse mundësi që të shfaqë identitetin e tij të vërtetë. Ata që caktohen për programimin janë zakonisht njerëz shumë të zgjuar, pasi njerëzit pak të zgjuar dhe krijues mund të programohen me vështirësi në nivelet e kërkuara.

Kandidatët e parapëlqyer të caktuar për programimin janë, ashtu si Keti O' Briani, anëtarë të fiseve kaukaziane me flokët të verdhë e me sytë të kaltër dhe absolutisht pa të metën më të vogël fizike. Familjet e Vëllazërisë nuk janë vetëm ato që mbajnë emrat klasikë të këtyre fiseve. Vëllazëria, në fakt, përdor edhe "riprodhuese", për t'i bërë të lindin fëmijët e saj jozyrtarë. Përdorin disa familje si punë inkubatriçesh, duke i detyruar gratë të lindin fëmijët e Vëllazërisë, ose duke i detyruar ato të rrisin fëmijë që janë të lidhur me familjet e vjetra të Vëllazërisë, edhe pse midis tyre nuk duket të ketë asnjë lloj farefisnie. Fëmijët shkëmbehen dhe u besohen prindërve birësues (si Sër Frensis Bekoni), ose disa nëna lindin krejt papritur, kur askush nuk e dinte se ishin shtatëzëna, sepse në realitet nuk ishin. Kjo i jep mundësi Vëllazërisë që të vendosë në pozita pushteti në botën politike, bankare, ekonomike, gazetareske e ushtarake, pa u ngritur ndonjë britmë proteste nga ana e opinionit publik për faktin se janë gjithmonë të njëjtat familje që zënë pozitat e kontrollit.

Mashtrimi i kujtesë së rreme

Kur Keti O'Briani dhe mijëra njerëz të tjerë të shpërndarë nëpër botë filluan të rikujtonin abuzimet që kishin pësuar, autoritetet reaguan nëpërmjet një organizate të quajtur Fondacioni i Sindromës nga Kujtesa e Rreme (FMSF), që është përpjekur t'i bëjë të pabesueshme historitë e tyre. Ai u krijua në Shtetet e Bashkuara në vitin 1992, nga Pamela Frejdi dhe i shoqi Piteri, një matematikan i Universitetit të Pensilvanisë, të cilët qenë akuzuar që të dy nga e bija, Xheniferi, se kishin abuzuar me të gjatë viteve të fëmijërisë së saj. Degëzime të Fondacionit të Sindromës nga Kujtesa e Rreme janë shfaqur në vende të tjera, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe, si rrjedhojë, shumë

gazetarë kanë shkruar artikuj tejet shkatërrues, që i hiqnin qafe kujtimet e kontrollit mendor e të abuzimeve seksuale të zbuluara nga viktimat, si iluzione. FMSF-ja thotë se viktimat e abuzimit ushqejnë kujtime të rreme dhe nuk arrijnë të rievokojnë atë që me të vërtetë ka ndodhur. Natyrisht, kjo është e mundur, por Fondacionit të Sindromës nga Kujtesa e Rreme nuk i mjafton që disa prej këtyre kujtimeve të jenë shtrembëruar. Dëshiron t'i heqë qafe të gjitha, gjë që është tejet absurde. Ai ka përndjekur terapistë skrupulozë, duke i akuzuar se i kanë vënë ato kujtime në gojën e pacientëve të tyre. Por nuk është shpjeguar se përse terapistët do të ishin të interesuar ta bënin një gjë të tillë, as se si ata njerëz, që nuk i kanë harruar kurrë abuzimet seksuale e satanike të pësuara prej tyre, mund të vuanin prej sindromës së kujtesës së shtrembëruar. Një kështilltar "shkencor" i FMSF, doktor Harold Merskeji, ka dëshmuar në gjyq se një grua, që ka rrëfyer se ka qenë përdhunuar nga mjeku i saj, mund të vuajë prej sindromës së kujtesës së rreme, kur ai mjek ishte pezulluar tashmë për episode të mëparshme të pedofilisë të pranuara nga ai vetë. Merskeji as që e vizitoi fare atë grua dhe tha se kishte arritur në atë përfundim vetëm pasi e kishte vrojtuar në gjyq!

Njëri prej krerëve të FMSF-së, doktor Ralf Undervageri, u përjashtua nga urdhëri kur doli në dritë publikisht se në vitin 1993 ai dhe e shoqja, Holida Uakefieldi, i kishin dhënë një intervistë një reviste holandeze për pedofilë me titullin *Paedika*, në të cilën pohohej se seksi me fëmijë ishte "një shprehje e pranueshme e vullnetit të dashurisë hyjnore". Tre anëtarë të komitetit konsultativ amerikan të Fondacionit të Sindromës nga Kujtesa e Rreme kanë qenë doktor Martin Orni, kontrollues i famshëm mendor i CIA-s i Universitetit të Pensilvanisë; doktor Ljuis Xhulion "Xholi" Uest i Universitetit të Kalifornisë, tjetër kontrollues i turpshëm mendor i CIA-s; Xhejms Randi, një magjistar i njohur si "Randi i pabesueshëm". Një tip me të vërtet i "pabesueshëm" po ta gjykosh nga një shirit i inçizuar prej tij, që unë e zotëroj, në të cilin propozon fëmijë për lojëra seksuale dhe mburret me "rrushin e tij të gjatë njëzet centimetra". Apo ndoshta ai shirit dhe ai transkriptim, që kam në shtëpi unë, janë vetëm frut i kujtesës sime të rreme? Randi është përdorur edhe për të bërë të pabesueshme fuqitë dhe fenomenet medianike, nëpërmjet një organizate qesharake të quajtur Komisioni i Hetimit mbi Fenomenet e Supozuara të Mbinatyrshme, ose CSICOP. Në krye të këtij komisioni është Pol Kurtci, president i *Prometheus Books*, botues i librave të Randit dhe të tjerëve mbi pedofilinë. Kurtci është profesor i merituar i filozofisë në *New York State University*, në Bufalo. Një tjetër anëtar i CSICOP-it, Vern Bullogu, profesor i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe sociale në Universitetin e

Nju Jorkut, është drejtori i *Human Sexsuality* në *Prometheus Books*. Ai është edhe anëtar i komitetit të revistës *Paedika*, revistës së pedofilëve holandezë, që ka intervistuar Ralf Undervagerin e Fondacionit të Sindromës nga Kujtesa e Rreme. Mjaft njerëz bëjnë pjesë si tek FMSF-ja edhe tek CSICOP-i. Për ata nuk ekziston asnjë ndryshim midis të bërit të pabesueshme të fenomeneve medianike, jetës përtej vdekjes, apo kujtimeve të abuzimeve të pësuara nga fëmijët gjatë ritualeve. Dhe çfarë kanë të përbashkët të dyja këto organizata? Vënë në zbatim Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë, duke fshehur kontrollin mendor dhe organizatat që ushtrojnë abuzime mbi fëmijët, dhe fshehin edhe natyrën e vërtetë të jetës. Nganjëherë mbetem vërtet i befasuar përballë "hetimeve" të disa "studiuesve të konspiracionit", që mohojnë ekzistencën e Projektit Monark dhe heqin qafe veprën jashtëzakonisht të hollësishme e të dokumentuar të autorëve si Springmejeri dhe Veleri. Në se i lexon këta autorë në dritën e provave të paraqitura këtu e gjetkë, pyet me vete pastaj nëse këta "studiues të konspiracionit" janë vetëm ca studiues të gjorë, apo përkrahin përkundrazi planin, që parashikon mbulimin e së vërtetës.

Ka qenë me të vërtetë e lehtë ta mbaje në padije popullsinë, duke shkatërruar provat e përzierjes së zvarranikëve në historinë njerëzore e duke përhapur një version të jetës, që nuk është gjë tjetër, veçse një degjenerim i së vërtetës. Zvarranikët mund të vazhdojnë diktaturën e tyre globale në format e saj të ndryshme më qesharake, pasi pjesës më të madhe të njerëzve nuk i bëhet vonë fare për atë që ndodh në botë dhe kush e kontrollon jetën e tyre e atë të fëmijëve të tyre. Janë aq shumë të shtypur nga detyrimi e nga frika, sa që e mbajnë kokën të ulur e sytë të mbyllur; ose shqetësohen më shumë për çmimin e birrës, për "skandalin" e fundit të telenovelave, apo se si po shkon skuadra e tyre e zemrës. Majkëll Akuinoja, satanisti i Departamentit të luftës psikologjike, i ka thënë një herë Keti O`Brianit: "95%-shi dëshiron të drejtohet nga 5%-shi tjetër dhe nuk do të dijë fare se çfarë ndodh në qeveri". Kjo është në mënyrë të trishtueshme e vërtetë. Cilido që mendon ende se rezultati i ndeshjeve të futbollit, apo çmimi i birrës është me të vërtetë i rëndësishëm në nivel planetar, do të bënte mirë të lexonte këtë që vijon. Bëhet fjalë për një dëshmi të lëshuar nga Keti mbi atë çka i ka ndodhur së bijës, Kelit:

"Keti u sëmur në mënyrë me të vërtetë të rëndë, pasi qe sekuestruar brenda "shtabit" të Xhorxh Bushit dhe pas marrëdhënieve të ndryshme seksuale që pati me të. Kishte ethe me temperaturën 40-41 gradë, villte dhe vuante prej dhimbjesh koke paralizuese mesatarisht për tri ditë rresht (të gjitha simtoma tipike të traumës nga voltazhi i lartë). *Këto ishin të vetmet shenja të dukshme, përveç shenjave të*

djegieve në lëkurë. Hjustoni më ndaloi të thërrisja ndonjë mjek dhe Keli më ndaloi ta lehtësoja, duke u ankuar me mundim se koka "i dhembte aq shumë, sa nuk arrinte ta lëvizte". Dhe nuk lëvizi për orë e orë të tëra. Ankohej shpesh edhe për dhembje të padurueshme në veshka dhe, zakonisht, i kullonte gjak zorra e trashë për një ditë apo dy, pasi Bushi e kishte përdhunuar. Prirja ime për t`u hequr si viktimë, e nxitur nga kontrolli mendor, më bënte të pazonjën ta ndihmoja apo ta mbroja. Të parit e vajzës sime të vogël në atë gjendje të frikshme nuk bënte gjë tjetër veçse e rëndonte gjendjen time të tjetërsimit mendor, duke vërtetuar paaftësinë time të plotë për t`iu përgjigjur kërkesave të saj, gjer ditën kur Mark Filipsi na shpëtoi, në vitin 1988".

"Zorra e trashë që kullonte gjak e Kelit ishte... njëra (prej) *shumë pasojave fizike të perversiteteve pedofile të Xhorxh Bushit. Më shumë se një herë e kam dëgjuar rastësisht të mburrej me abuzimet seksuale të kryera mbi të. E përdori të gjithë këtë, bashkë me kërcënimet me vdekje kundrejt saj, për "të vënë lë lëvizje fijet e mia" dhe të më kontrollonte. Pasojat psikologjike të qenies së përdhunuar nga një president pedofil janë vërtet shumë shkatërruese për mendjen, por Bushi i përforcoi traumat e pafundme ndaj mendjes së Kelit, duke shfrytëzuar instrumente të sofistikuara elektronike të kontrollit mendor të dhëna nga NASA dhe narkotikë. Bushi nguliti tek Keli edhe skrupuj të tipit "Kush dëshiron që të të ndihmojë" dhe "Shiko, se e vë re", duke e rritur kështu më tej ndjenjën e saj të pafuqisë. Torturat dhe traumat që unë pësova sistematikisht që fëmijë nuk janë asgjë, nëse i krahasoni me turturat kafshërore fizike e psikologjike që Xhorxh Bushi i shkaktoi sime bije"*[87].

Hajt, djema, e di që ka qenë i rëndë leximi i këtij kapitulli, por tani duhet të hapni sytë. E gjitha kjo duhet të marrë fund.

LIBRI 24

Kapitulli 17

Gjuha e fshehtë

Anëtarët e shoqërive të fshehta kanë përdorur gjithmonë një kod komunikues të bazuar mbi fraza, fjalë, shtrëngime të çuditshme duarsh dhe simbole. Përreth nesh mund të shohim edhe disa "nënshkrime", që Vëllazëria i përdor si shenja të fshehta. Siç nuk do të lodhem kurrë së theksuari, anëtarët e saj i mundon si në ankth ideja e ngulët e ritualeve dhe e simboleve, pasi janë të pajisur me një tru zvarranik. Në fakt, ky është një çelës leximi, që mund të na ndihmojë t`i njohim.

Simbolet e përdorur më shumë prej tyre janë pishtari i ndezur, që është simboli i dijes, dhe dielli. Kur një anëtar arrin një farë niveli brenda piramidës, thuhet se bëhet "i ndritur", duke iu referuar prapë edhe një herë simbolizmit të pishtarit të ndezur. Njëra prej legjendave, që përsëritet në botën e lashtë, ka për protagonist një hero, i cili u rrëmben zjarrin (dijen) "hyjnive", për t`ia dhënë popullit - domethënë popullit të zgjedhur. Gardianët, të quajtur Azazel dhe Shemyaza, ishin midis atyre që, sipas *Librit të Enoch*-ut, u dhanë qenieve njerëzore dijet shumë të përparuara. Figura simbolike që i përfaqëson më mirë këta Gardianë është hyu grek Prometeu, i cili thuhet se ka dalë nga malet e Kaukazit. Në shumë aspekte bëhet fjalë për një tjetër figurë mesianike,

LIBRI 24

që ka vdekur për popullin e tij dhe nuk është për t`u përjashtuar që historia e Jezusit të jetë frymëzuar pjesërisht tek legjenda e Prometeut. Sot pranë Qendrës Rokfeler të Nju Jorkut ka një statujë të artë të Prometeut (ari ishte metali diellor i perëndive) që mban në dorë dritën, zjarrin, siç tregon legjenda (shiko pjesën e ilustrimeve). Për Rokfelerët nuk është fjala për një statujë të thjeshtë, por për një simbol të krejt intrigës së thurur prej tyre. Statuja e Lirisë është në realitet Statuja e Privilegjeve (në anglisht "liberty" do të thotë "liri", por edhe "privilegj"), ato privilegje të cilat i gëzon Vëllazëria në kurriz të popullit amerikan. Kjo statujë ngrihet mbi një ishull në portin e Nju Jorkut dhe mban në dorë pishtarin e "lirisë" dhe amerikanët mendojnë se është një simbol i lirisë së tyre, në Tokën e të Lirëve. Asgjë nuk është më larg së vërtetës se sa kjo. Statuja e Lirisë iu dhurua Nju Jorkut nga masonët francezë dhe një kopje e saj gjendet mbi një ishull të Senës, në Paris (shih pjesën e ilustrimeve për këto simbole të tjerë të këtij kapitulli). Këto statuja të lirisë janë të gjitha paraqitje të mbretëreshës Semiramidë, të Isidës dhe të hyjnive të tjera me kokën të rrethuar nga rrezet e diellit. Ishte kjo paraqitja klasike e Dielli, e bërë nga njerëzit e lashtë. Pishtari, që këto statuja mbajnë në dorë, nuk është pishtari i lirisë, por pishtari i Mendjendrirurve të Elitës ariano-zvarranike. Statuja e Lirisë është një simbol i Vëllazërisë që thotë: "Ne e kontrollojmë këtë vend dhe jua themi hapur, por ju jeni tepër budallenj për ta kuptuar këtë". Pishtari është "nënshkrimi" më i përdorur i Vëllazërisë.

Pasi e kishte vrarë presidentin Kenedi në vitin 1963, Vëllazëria vendosi pastaj mbi varrin e tij në varrezën Arlington një pishtar të ndezur, flakën e përjetshme, që digjet edhe sot e kësaj dite. Pas vrasjes së Dallasit, masonët ngritën një obelisk në Sheshin Dejli, disa metra larg nga vendi ku u vra Kenedi. Në majën e tij vendosën imazhin e një pishtari të ndezur. Kur princesha Dajana u vra në tunelin e Ponte de l'Alma-s, në Pris, ai u bë "lapidari i përmortshëm" i saj, mbi të cilin njerëzit vendosnin lule, një paraqitje e artë e madhe e flakës "së përjetshme" e mbajtur në dorë nga dy Statujat e Lirisë, që, pa shihni, gjendeshin pikërisht sipër galerisë, në të cilën makina kishte shkuar të përplasej pas shtyllës së 13-të. Cfarë rastësie! Në ishullin, ku thuhet se është varrosur princesha, është vendosur një tjetër skulpturë, që paraqet një pishtar të ndezur. Vëllazëria është duke na thënë se ka vrarë Kenedin dhe Dajanën, por kush nuk di të interpretojë gjuhën e simboleve, nuk do ta kuptojë kurrë. Të njëjtën domethënie merr pishtari i ndezur gjatë olimpiadave. Më vjen për të qeshur kur shikoj që shtetet e ndryshme të botës presin me ankth të mësojnë se cili prej tyre do të zgjidhet si qendër e lojërave të ardhëshme olimpike. Gjithçka ka qenë vendosur shumë kohë përpara, sipas

planeve të Vëllazërisë dhe simbolizmit të saj. Të vinte vetvetiu të mendoje se me rastin e njëqind vjetorit të tyre, lojërat olimpike do të ishin mbajtur në tokën e origjinës, në Greqi, por përkundrazi iu caktuan Atlantës. Përse vallë Atlanta, duke qenë se pak vjet më parë lojërat olimpike ishin mbajtur pikërisht në Shtetet e Bashkuara dhe saktësisht në Los Anxhels? Një arsye e kësaj duhet kërkuar tek ideja e ngulët që Vëllazëria ushqen kundrejt simboleve dhe tek fakti që thuhej se Atlanta, perëndeshë e gjahtare, ishte një atlete aq shumë e zonja, sa që asnjë burrë nuk arriti ta mundte. Të gjithë ata që i mundte ishin të destinuar me vdekje dhe shumë u vranë, gjersa njëri prej tyre arriti ta gënjente e ta bënte që ta humbiste një vrapim, duke gjuajtur mollë të arta për ta hutuar. Thuhet që ajo dhe i shoqi u shndërruan në luanë dhe tërhoqën qerren e Nënës së Madhe të Perëndive[1]. Falë lojërave olimpike të Atlantës, u shpenzuan miliarda për të ndërtuar rrugë e për të përmirësuar infrastrukturat në një qytet, i cili thuhet se është njëri prej qendrave më të mëdha të Rendit të Ri të Botës të mijëvjeçarit të ri.

Një tjerë simbol kyç i Vëllazërisë është piramida, ose piramida pa majë. Planimetria e Sheshit Dejli, ku u vra Kenedi, të kujton një piramidë pa majë dhe Dejli (Dealey) do të thotë "vija e perëndeshës", nga "dea" plus "ley" (vija që bashkon pikat e rrjetës tokësore). Sikurse të gjithë e dinë, piramida pa majë, apo piramida me syrin që gjithçka sheh, është e paraqitur në pjesën e passhme të Vulës së Madhe të Shteteve të Bashkuara dhe të kartëmonedhës prej një dollari. Syri që gjithçka sheh është syri i Horusit, Luçiferit, Satanait, cilido qoftë emri që dëshironi të përdorni, dhe lidhet edhe me të ashtuquajturin "syri i tretë", vorbulla e *chakra*-ve e vendosur në mes të ballit, që na lejon të përdorim të pamit tonë të brendshëm. Sipas legjendës egjiptiane, Osiridi qe vrarë nga Seti dhe Seti qe vrarë nga Horusi, i cili në këtë luftim humbi njërin sy dhe prej këtej lindi shprehja Syri i Horusit. Sipas meje ai i referohet edhe zvarranikëve, që e vrojtojnë këtë botë që nga niveli më i ulët i përmasës së katërt dhe, nëse vështroni zmadhimin e syrit të ***Figurës 28***, do të vini re që deri edhe lëkura ka një pamje zvarranike. Masoni i shkallës së 33-të, përveçse president i Fisnikërisë së Zezë, Franklin Delano Rusvelti, urdhëroi të stampohej ky simbol mbi kartëmonedhën prej një dollari që nga viti 1933. Bëhej fjalë për një simbol të përdorur nga shoqëritë e fshehta evropiane shumë më parë se të dihej për ekzistencën e Shteteve të Bashkuara dhe që të kthen tek simbolizmi i botës së lashtë (shih ***Figurën 29***). Edhe numri i shteteve amerikane në çastin e pavarësisë (13) nuk është një rastësi e thjeshtë. Trembëdhjeta, dymbëdhjeta e shenjtë plus një, është një numër i lashtë mistik, siç e kemi parë shumë herë gjatë këtij libri. Në të dy anët e Vulës së Madhe do të gjeni

LIBRI 21

13 yje sipër kokës së shqiponjës. Motoja *"E Pluribus Unum"* përmban 13 gërma, sikurse edhe *"Annuit Coeptis"*. Shqiponja shtrëngon 13 gjethe me 13 rrushkë në kthetrën e djathtë dhe 13 shigjeta në atë të majtë. Shqiponja rrjedh nga simboli i feniksit, zogu i shenjtë diellor i egjiptianëve dhe fenikasve të lashtë. Simboli i Ritit Skocez të Masonerisë është shqiponja e pajisur me dy kokë të kundërta – simboli i Nimrodit.




Figura 28. Syri që Gjithçka Sheh mbi kartëmonedhën prej një dollari. Të jetë zvarranik?

Po ky simbol duket të paktën në dy portrete të Xhorxh Uashingtonit. Simboli i shqiponjës përdoret gjerësisht nga Vëllazëria dhe mund të gjendet në stemat e shumë vendeve, përfshirë Egjiptin, Libinë e Irakun. Bëhet fjalë për një prej simboleve më të zakonshëm të Gjermanisë naziste dhe duket edhe në zbukurimet e altarëve e të pulteve të leximit të përdorur nga Kisha e Krishterë. Vulat si ajo e Shteteve të Bashkuara mund ta kenë zanafillën të paktën tek Egjipti, tek Babilonia, tek Asiria dhe tek India e 4.000 vjetëve përpara Krishtit.

Fjalët latine sipër dhe poshtë piramidës së Vulës së Madhe dhe të kartëmonedhës prej një dollari njoftojnë ardhjen e një rendi të ri laik. Rendi i Ri i Botës është një shprehje me kod për të treguar planet e Vëllazërisë dhe të Xhorxh Bushit, që i është drejtuar shpesh këtij termi, kur ishte president.

Besojmë natyrisht se data e shkruar me numra romakë në fund të piramidës, 1776, i referohet Deklaratës amerikane të pavarësisë, që i përket pikërisht atij viti. Por diçka tjetër ka ndodhur më 1 maj (një datë shumë e dashur për satanistët) të po atij viti.

U krijua një seksion shumë i rëndësishëm i organizatës së Vëllazërisë, Urdhëri i Mendjendriturve Bavarezë, i themeluar nga profesori gjerman Adam Veishaupti.

Ky ishte një vit me të vërtetë i rëndësishëm për Vëllazërinë, duke qenë se u themelua edhe dinastia e Rotshildëve dhe Adam Smithi, ekonomisti skocez i kontrolluar nga Vëllazëria, publikoi një vepër të destinuar të bëhej shkollë *The Wealth Of The Nations* (Pasuria e kombeve). Veishaupti i përdori Mendjendriturit e tij për të depërtuar më tej brenda Masonerisë. Ai ishte




Figura 29. Piramida dhe Syri që Gjithçka Sheh, simboli i lashtë i Vëllazërisë mbi kartëmonedhën prej një dollari dhe pjesa e pasme e Vulës së Madhe të Shteteve të Bashkuara.

formuar pranë Urdhërit të Jezuitëve, apo Shoqërisë së Jezusit. Themeluesi i Urdhërit të Jezuitëve, spanjolli Injacio di Lojola, formoi një shoqëri të fshehtë brenda urdhërit të tij në dukje "katolik", anëtarët e së cilës morën emrin *Alumbrados*, "mendjendriturit". Veishaupti krijoi 13 shkallë midis Mendjendriturve të tij (i njëjti numër i niveleve të piramidës së Vulës së Madhe) dhe personalitetet më të rëndësishme zinin nëntë nivelet e para.

Obelisku dhe kupola janë mjaft të përhapura tek monumentet e ngritura nga Vëllazëria. Obelisku është një simbol i lashtë falik (*falus – organi mashkullor*) i energjisë mashkullore dhe i energjisë diellore, ndërsa kupola përfaqëson energjinë femërore, apo hënore. Ky simbolizëm është i pranishëm edhe tek Zyra Ovale (bark, femëror) e Shtëpisë së Bardhë, që del sipër Monumentit të Uashingtonit, obeliskut të madh prej guri (falik, mashkullor). Këto simbole tërheqin dhe prodhojnë energjinë që përfaqësojnë: janë një formë e mendimit të materializuar.

Obelisku simbolizon edhe penisin e perëndisë egjiptiane të diellit, Osiridit. Sipas legjendës, pasi Osiridi ishte prerë në 14 copa nga kundërshtari i tij Seti, mbretëresha Isidë i gjeti të gjitha ato copa, përveç penisit të tij. Një obelisk, që thuhet se ka ardhur nga Aleksandria e Egjiptit, ngrihet në Central Park të Nju Jorkut dhe binjaku i tij që ngritur në shekullin e nëntëmbëdhjetë, gjatë mbretërimit të mbretëreshës Viktoria, në ato që kishin qenë tokat e tempullarëve, gjatë lumit Tamiz, jo larg Parlamentit. Ai është i njohur si "Cleopatra`s Needle" dhe fillimisht ndodhej në On (Heliopolis), në qytetin egjiptian të Diellit, që i përket të paktën vitit 1500 para Krishtit, përpara se të zhvendosej në Aleksandri (shih pjesën e ilustrimeve). Një sfinks është vendosur në të dy anët e obeliskut në qendrën e tij aktuale londineze. Një tjetër obelisk egjiptian, i ndërtuar në Luksor 3.200 vjet më parë, gjendet sot në Sheshin Konkord të Parisit, disa minuta me makinë larg vendit ku ndodhi aksidenti i Dajanës.

Në anën tjetër të po këtij vendi ngrihet Kulla Ejfel, një tjetër obelisk gjigant i maskuar. Monumenti i Uashingtonit në Uashington DC është një obelisk shumë i madh. Kupola (nga një fjalë greke që do të thotë "vendi i hyjnive") tërheq e frenon energji, sikurse bën edhe piramida. Shumë shpesh do të shikoni se katedralet e mëdha kanë një kupolë madhështore, sepse ndërtuesit dhe arkitektët e tyre ishin në dijeni të fuqisë së gjeometrisë, për ta drejtuar energjinë në një vend të përpiktë. Kupola shumë e madhe e artë e faltores "islamike" të Malit të Tempullit në Jeruzalem, kupola e Shën Pjetrit në Vatikan, në Romë dhe kisha e Shën Maries që sundon profilin e Firences, nuk janë gjë tjetër veçse shembuj të qartë. Hidhuni një sy qyteteve më të rëndësishëm të Vëllazërisë dhe do të vini re se kanë të paktën një ndërtesë të rëndësishme të mbuluar me kupolë. Në Londër do të gjeni Katedralen e Shën Palit, e projektuar nga anëtari i Vëllazërisë Kristofer Uoreni, pasi Zjarri i Madh i Londrës kishte shkatërruar qytetin origjinal. Kopja e katedrales së Shën Palit gjendet në Paris dhe njihet si Panteon. Dhe vështroni pallatin e Kongresit në Uashington DC dhe do të zbuloni se bëhet fjalë për një tjetër version të Shën Palit (shih pjesën e ilustrimeve). Në Lejkastër Skuar, në Londër, ka një kishë çuditërisht të quajtur si Notre Dame de France; ajo që ndërtuar së pari në vitin 1865 në një vend të ngarkuar me reminishenca tempullarësh dhe pastaj u rindërtua në vitet pesëdhjetë të shekullit XX dhe paraqet një kësulë në formë kupole me rrathë koncentrikë[2]. Në Romë është kupola e Vatikanit dhe, përveç kupolës, do të gjeni edhe obeliskët e sheshit Shën Pjetri. Në kohën që po shkruaj, në Londër janë duke ngritur Kupolën e Mijëvjeçarit, afër meridianit zero të Grinuiçit, që, pa shihni, edhe ai që projektuar nga Kristofer Uoreni. Pikërisht me këtë vend sintonizohen të gjitha orët, zgjimet dhe oraret e botës (dhe, pra, mendja njerëzore kolektive) dhe në kemi një vizion të universit të përcaktuar nga e njëjta perspektivë kohore. Njësia matëse e përdorur në rrjetën kohore të Grinuiçit është koha diellore. Në bregun tjetër të Tamizit, përpara Kupolës së Mijëvjeçarit, është ndërtesa dhe obelisku më i madh i Evropës, pallati Canary Wharf. Në qytetet e Vëllazërisë do të gjeni pastaj gjithmonë ndonjë qiellgërvishtës në formë obelisku, dhe prania e tij shpjegohet mbi bazën e faktit se ai modifikon fushën energjitike e tërheq energjinë diellore. Edhe Big Beni, sahati i famshëm i Parlamentit të Uestminsterit, është një obelisk. Por Kupola e Mijëvjeçarit dhe pallati Canary Wharf kanë edhe një domethënie tjetër, mbi të cilën do të ndalem më pas.

Planimetria e qyteteve më të mëdha është projektuar sipas ligjeve të gjeometrisë së shenjtë, në të njëjtën mënyrë si katedralet e mëdha, tempujt dhe rrathët prej guri. Ashtu siç ndodhi për Londrën pas Zjarrit të Madh të

vitit 1666, qyteti i ri i Uashingtonit u projektua mbi bazën e këtyre ligjeve. Simbole, forma e kënde prodhojnë forma të ndryshme energjie dhe, sapo të kuptohen këto parime, mund të arrish të bësh të dridhet fusha energjitike e një vendi sipas gamës dridhëse që e mendon më të dobishme për qëllimet e tua. Kushdo që jeton apo punon brenda asaj fushe, do të pësojë rrymën e saj. Në atë vend mund të përqëndrohen edhe energji diellore e astrologjike.

Në Uashington kam hasur energjitë më të këqia, në të cilat isha ndeshur ndonjëherë, pas *Sitit* të Londrës. Një mason francez me emrin Pier Sharl L'Enfant, ishte ngarkuar të krijonte një Uashington të ri dhe ai u bazua mbi projekte të përgatitura zyrtarisht nga krerë të kalibrit të Tomas Xhefersonit e Xhorxh Uashingtonit, edhe pse arkitektët e vërtetë ishin sipas gjasës të tjerë të pajisur me kulturën më të gjerë ekzoterike. Xhefersoni, megjithatë, kishte lidhje të forta me ambientet kushtuar ekzoterizmit dhe, kur vdiq, një sistem me dymbëdhjetë doreshkrime të ngjashme me doreshkrimet e fshehta trëndafilkryqëtare, u gjet midis sendeve të tij personale nga trëndafilkryqëtari Spenser Luis[3]. Sipas disa studiuesve, Xhefersoni ishte një Mjeshtër i Madh i Urdhërit të Trëndafilkryqëtarëve. Ishte edhe ekspert astronomie e astrologjie, sikurse edhe Benjamin Franklini, që shkroi një *best-seller* mbi këtë argument me titullin *Poor Richard's Almanac*. L'Enfanti kishte marrë pjesë në luftën për pavarësi dhe, ashtu si Uashingtoni, ishte anëtar i grupit absolutisht të fshehtë dhe elitar të Shoqërisë së Cinçinatëve. Bëhej fjalë zyrtarisht për një shoqëri të fshehtë të oficerëve amerikanë e francezë të luftës së pavarësisë, pranimi në të cilën i trashëgohej djalit më të madh. Uashingtoni ishte president i përjetshëm i saj. Pjesët e ditarit të Uashingtonit dhe letrat e tij që kishin për temë L'Enfantin janë "zhdukur". L'Enfanti u pushua pas një viti, por projektimi i qytetit vazhdoi. Në vitin 1909 trupi i tij u zhvarros dhe, i mbrojtur me ekskortë ushtarake, u transportua në Kapitol Hill, për t'u ekspozuar sipas ceremonisë zyrtare për vetëm tri orë. Mijëra njerëz shkuan t'i jepnin lamtumirën e fundit dhe ai u varros përsëri në varrezën e Arlingtonit. Por përse e gjitha kjo? Në vendin ku ndodhet varreza e Arlingtonit ngrihej më parë Vernon Hauzi, rezidenca e Xhorxh Uashingtonit, në amfiteatrin e së cilës Urdhëri amerikan i Kalorësve Tempullarë kremtonte çdo vit lindjen e Diellit[4].

Dyzet hunj kufiri qenë vendosur në largësinë një milje larg njëri nga tjetri për të përcaktuar kufirin e pronës prej dhjetë miljesh katrore, mbi të cilin u ngrit Uashingtoni dhe, në qendër, u ndërtua pallati i Kongresit, Kapitol Hilli, që e merr emrin nga kodra e Kampidolios, e vendit të shenjtë në Romë, ku kishin selitë shoqëritë e fshehta. Asgjë e çuditshme, pra, që sekretarja amerikane e shtetit, Medelinë Ollbrajti, shkoi për pelegrinazh në kodrën e

LIBRI

Kampidolios me rastin e vizitës së saj të parë zyrtare në Evropë pas emërimit. Kapitol Hilli nuk është një ndërtesë qeveritare, është një tempull i Vëllazërisë së Satanait dhe, nën kupolën e saj, e njëjtë me atë të Shën Palit, ka një kriptë, poshtë së cilës, i shënuar me një yll me pesë cepa, ndodhet një varr bosh. Thonë se ishte caktuar për Xhorxh Uashingtonin, që vendosi pastaj të varrosej diku gjetkë, por ka edhe diçka tjetër. Trupat e Kenedit, Linkolnit, MekKinlejit, Garfieldit, Hardingut, Taftit, Huverit, Uilsonit, Stivensit, Duejit, Pershingut, MekArturit, L'Enfantit dhe të dy luftëtarëve të panjohur kanë qenë të vendosur të gjithë mbi katafalkun e gjetur në varr[5]. Për ata që, si unë, nuk e kanë dëgjuar kurrë këtë fjalë, një "katafalk" është ajo strukturë, mbi të cilën vendoset trupi për ta mbartur në një procesion, ose mbi të cilën ekspozohet. E gjejmë të njëjtin tip varri të mbuluar nga një kupolë nën bazilikën e Shën Pjetrit, në Vatikan. Pallati i Kongresit është tempulli i një shoqërie të fshehtë, e cila, nën emra të ndryshëm, i përket botës së lashtë. Brenda planimetrisë së Uashingtonit, përballë Kapitol Hillit dhe Shtëpisë së Bardhë, gjenden simbole astrologjike (që i referohen saktësisht vendeve në të cilat disa yjësi duken në qiell), ekzagrame, yje pesëcepësh satanikë, katrorë, një busull masonike, një "Shigjetë e Fatit", një kafkë me kockat dhe shumë të tjera. Për më shumë informacione dhe ilustrime iu këshilloj një studim të shkëlqyer të Charles L. Westbrook-ut të ri me titullin *The Talisman Of The United States, Signature Of The Invisible Brotherhood*. Rrugët e Uashingtonit janë të orientuara drejt pikave ku Dielli lind gjatë solsticit të dimrit dhe të verës, saktësisht sikurse kodrinëzat, tempujt dhe rrathët prej guri të lashtë të tipit të Stonehengenit (shih ***Figurën 30***). Të tjera rrugë kryqëzohen, duke formuar saktësisht këndе prej 33 gradësh, ndërsa të tjera ndjekin saktësinë e ekuinokseve dhe është edhe një ekzagramë e Yllit të Davidit (shih ***Figurën 31***).

E kam përshkruar tashmë më përpara se si Elita, jo vetëm ajo amerikane, mblidhet në Pyllin Bohem, në Kaliforninë veriore, për të marrë pjesë në rituale që zhvillohen poshtë një bufi prej guri të lartë rreth 12 metra. Bufi simbolizon Molokun, hyjninë e lashtë, së cilës i flijoheshin, dhe ende i flijohen, fëmijët. Edhe hyjnesha sumere, Lilithi, e njohur si Zonja e Gjinjve, paraqitej në formën e bufit[6]. Lilith është edhe një simbol i racës së zvarranikëve. Besimet pagane e shihnin si një magjistare. Në pjesën e ilustrimeve do të shihni "rojet e pyllit", që marrin pjesë në një ceremoni në Pyllin Bohem, përpara bufit gjigant. Kam mbetur i shtangur kur, duke vrojtuar një hartë të Uashingtonit, zbulova se rrugët brenda pallatit të Kongresit formonin pikërisht siluetën e një... bufi! Do të shihni edhe që ky buf është i ulur mbi një piramidë. Piramida dhe bufi që gjithçka sheh (shih *Figurën 32*). Për të treguar një grup bufash, në anglisht




*Figura 30. Planimetria e Uashingtonit DC, si të gjitha qytetet e mëdha, paraqet një masë të madhe me simbole ekzoterike. Rrugët përreth pallatit të Kongresit janë të orientuara drejt pikave ku Dielli lind dhe perëndon gjatë solsticit të dimrit dhe të verës. Është edhe një ekzagramë e Yllit të Davidit – **Figura 31.***

përdoret shprehja "parlament zogjsh". I njëjti simbol i bufit gjendet i fshehur tek kartëmonedha prej një dollari, nëse dini se ku ta kërkoni dhe nëse jeni të pajisur me lente zmadhimi. Ka të paktën tre yje pesëcepësh satanikë brenda planimetrisë së Uashingtonit. Me termin "satanik" i referohem yjeve pesëcepësh të kthyer me kokë poshtë, ose me anët me gjatësi të ndryshme, në mënyrë për t'ia prishur formën. Këto përmbysje me kokë poshtë e këto shtrëmbërime të yllit pesëcepësh mbajnë firmën e satanistëve, në të njëjtën mënyrë me të cilën nazistët përmbysën kryqin e thyer.

Një yll pesëcepësh është i kthyer drejt Kapitol Hillit (shih ***Figurën 33***), një tjetër drejt Shtëpisë së Bardhë (shih ***Figurën 34***) dhe një i tretë shtrihet nga obelisku gjigant, i quajtur Monumenti i Uashingtonit, gjersa mbulon një zonë të gjerë të qendrës së qytetit. Në qendër është shenja e Dashit, dashit ose qengjit. Yje pesëcepësh satanikë të ngjashëm mund të gjenden në planimetrinë e Romës, në qytetin e vjetër të Jeruzalemit, në zonën përreth Rene-le-Shatosë, në zonën ku ngrihet piramida e Gizës dhe, pa dyshim, në Londër e në vende të tjera. Matanë lumit Potomak, në Uashington, ndodhet rezidenca e ushtrisë amerikane, pallati i Pentagonit, që është i orientuar drejt yllësisë së Demit[7]. Një pesëkëndësh, natyrisht, paraqet qendrën e yllit pesëcepësh. Nëse e




Figura 32. Piramida dhe bufi që gjithçka sheh. Rrugët brenda kompleksit të pallatit të Kongresit dhe dy rrugët kryesore që të çojnë jashtë, formojnë një buf të ulur mbi një piramidë. Bufi simbolizon Molokun, në nderim të të cilit, prej mijëra vjetësh flijohen fëmijët.

përshkoni me makinë qendrën e yllit pesëcepësh të Shtëpisë së Bardhë, do të arrini tek një ndërtesë interesante, tek numri 1733 i Rrugës së Gjashtëmbëdhjetë. Vini re numrin: 1733. Numri 17 përsëritet shumë herë në historinë e Rëne-lë-Shatosë, dhe 33-shi është numri zyrtar i shkallëve të Ritit Skocez. Kjo ndërtesë ka krejt pamjen e një tempulli egjiptian me dy riprodhime te Sfinksit në pjesën e jashtme dhe me një imazh gjigant të diellit që lind. Një simbol i ngjashëm gjendet në "kolltukun e diellit", mbi të cilin ulej Xhorxh Uashingtoni. Kjo ndërtesë e çuditshme është selia supreme e shkallës së 33-të Ritit Skocez të Masonerisë. Shkalla e 33-të është e njohur si Shkallë Revolucionare dhe pjesa më e madhe e krerëve të qeverisë janë masonë të shkallës së 33-të, edhe pse e mohojnë me të gjitha mënyrat, ose përpiqen të mos merret vesh. Është fjala për një shkallë nderi dhe ata kanë bërë një betim besnikërie ndaj Urdhërit të Masonerisë, i cili shkon përtej çdo betimi të bërë ndaj kombit të vet. Në kopshtin prapa kësaj ndërtese kam parë, përtej një gardhi shkurresh, një bust të Xhorxh Uashingtonit, në të cilin, me tone himnizuese, ai përshkruhet si presidenti i parë mason i Shteteve të Bashkuara. Kjo ndërtesë strehon koleksionin më të madh botëror të objekteve të gjetura masonike (që u përkasin vetëm anëtarëve të këtij urdhëri).





Figura 33. Yjet pesëcepësh me kokë poshtë e të shtrembëruar të ravijëzuar nga rrugët e Uashingtonit, njëri e ka kreun tek pallati i Kongresit... tjetri tek Shtëpia e Bardhë – Figura 34.



Në *Smithsonian Museum*, jo larg nga Shtëpia e Bardhë, gjendet një statujë e konsiderueshme mermeri e Xhorxh Uashingtonit, që dikur ishte e ekspozuar në Kapitol Hill. Ajo qe porositur për Kongresin në shekullin XIX dhe qe gdhendur në Firence të Italisë nga Horazio Grinuogu. Kur statuja u shkarkua në arsenalin detar të Uashingtonit, njerëzit mbetën të shtangur përballë asaj pamjeje. Uashingtoni paraqitej i ulur mbi një karrige, lakuriq gjer në brez, me një çarçaf të mbështjellë përreth pjesëve të poshtme. Gjenerali Henri Uis, burrë shteti i Virxhinias, vërejti: "Nuk rron, as nuk ka rrojtur kurrë njeriu që e ka parë Uashingtonin pa këmishën e tij"[8]. Atëherë, përse ta paraqitnin në atë mënyrë? Dhe përsë dora e tij e djathtë ishte e drejtuar lart dhe ajo e majta poshtë? Nëse vështroni përsëri ***Figurën 21***, do ta kuptoni.

Ajo statujë ishte realizuar mbi modelin e Bafometit, apo Mendesit, apo Asmodeusit, të gjithë simbole satanike të "djallit". Thuhet se Asmodeu ka qenë roja e Thesarit të Solomonit dhe një portret i tij është gjetur midis sendeve personale të abatit Sonier, priftit misterioz të Rënë-lë-Shatosë, që e vendosi një statujë të Asmodeut në hyrje të kishës. Asmodeu përmendet nga Talmudi hebraik si i pari midis djajve. Një pikturë, që paraqet Uashingtonin, e realizuar nga "Caduceus"-i, përmban një masë simbolesh e gjeometrie ekzoterike. Dy shembuj janë dhënë nga dora e tij e ngritur në mënyrë të atillë që të përkojë me këndin e hënës që po lind dhe nga shpata e tij, këndi i së cilës përkon me pozicionin e diellit në solsticin e dimrit[9].


Planimetria rrugore e Uashingtonit është zgjeruar gjatë viteve, por kjo është bërë në përputhje me një plan, i cili duket se ka qenë vendosur që në fillim. E njëjta gjë duket se ka ndodhur në rastin e disa ndërtimeve të botës së lashtë, sidomos brenda vendit arkeologjik të Gizës. Monumentet përkujtimore në nderim të Xhefersonit dhe të Linkolnit i janë shtuar planimetrisë së Uashingtonit në vitet e para të shekullit XX. Ndërtesa kushtuar Xhefersonit, sipas historianëve, bazohet mbi modelin e Panteonit në Romë. Si të gjitha ndërtesat më të rëndësishme, edhe këto janë ndërtuar sipër "pasqyrash uji". Ndërtesa përfaqëson Diellin, ndërsa ujët përfaqëson Hënën, që reflekton Diellin. Monumenti i Uashingtonit, i lartë rreth 17 metra, obelisku më i madh prej guri në botë, u përfundua në vitin 1885. Guri i qoshes ishte vendosur nga Lozha e Madhe Masone e distriktit të Kolumbias. Teksa mbaja një sërë konferencash shtypi në Shtetet e Bashkuara, pashë një emision televiziv, në të cilin thuhej se autoritetet dëshironin të ndërtonin një monument përkujtimor brenda ishullit për këmbësorët, në zemër të qendrës rrugore të qytetit, në nderim të të rënëve të Luftës së Dytë Botërore. Në qendër, do të ishte skulptura e një pishtari të ndezur. Qytetet dhe qendrat e Vëllazërisë

vendosen në vende ku mund të mbahet në fre lehtësisht energjia diellore dhe tipe të tjera të energjisë kozmike. Charles L. Westbrook-u i ri, autori i librit *The Talisman Of The United States*, mori disa letra anonime, pasi qe publikuar libri i tij. Njëra prej të cilave përmbante një hartë të vogël të Shteteve të Bashkuara dhe një fije letre që mbante fjalët që vijojnë: "Është më i madh nga sa e mendon ti"[10]. Vijat e hequra mbi hartë zbulonin një skemë gjeometrike të ngjashme me atë të Uashingtonit, por në një shkallë më të madhe. Disa prej pikave që e formonin këtë skemë, ose që ishin nxjerrë në dukje prej tij, ishin Maunt Vernoni, në Ilionis, ku është varrosur Xhorxh Uashingtoni; Majami, që në vitin 1820 ishte quajtur "qyteti magjik"; dhe një vend i quajtur Pike`s Peak në kontenë e Xhefersonit, në Kolorado, paksa matanë kufirit me Arkansasin. Pike`s Peak-u, natyrisht, e merr emrin nga Albert Pajku.


Simboli i lashtë i rrethit dhe i kryqit, që kam përshkruar disa kapituj më përpara, përdoret ende sot nga gjuha e fshehtë. Është një shenjë që simbolizon ecjen e Diellit përmes 12 muajve dhe 12 shenjat e Zodiakut, kryqi dhe rrethi me Diellin mbi kryq (shih ***Figurën 35***). Kjo ka frymëzuar kryqin kelt (shih ***Figurën 37***) dhe emblemën e CIA-s (shih ***Figurën 38***). E kam gjetur simbolin e paraqitur në ***Figurën 39*** edhe në distriktin financiar londinez të *Sitit*, përpara katedrales së Shën Palit. Bëhet fjalë për rrethin e zodiakut me një diell të zi në qendër. Dielli i zi është një simbol i mëtejshëm i përmbysur, që tregon përdorimin negativ të energjisë diellore dhe të diellit galaktik, përreth të cilit rrotullohet sistemi diellor. Edhe nazistët flisnin për diellin e zi. Më duket se simboli i kalit të zi të asaj ndërmarrjes së ngritur nga Vëllazëria, sikurse është Banka e Lojdëve, ka të njëjtën natyrë. Kali i bardhë ishte një simbol fenikas i Diellit. Po ky simbol i rrethit dhe i kryqit përdorej nga fenikasit dhe mund të shihet në paraqitjet e tyre të hyjneshës Barati, sikurse edhe mbi shqytin e versionit të saj britanik, Britanisë. Planimetria e Parisit, i mbizotëruar nga Harku, apo nga "harku" i Triumfit, e rimerr këtë simbolizëm. Harku është në vetvete një simbol i Vëllazërisë. Dhe pikërisht tek ai zënë fill Lozhat e Harkut Mbretëror tek Riti i Jorkut të Masonerisë. Dëshmimi i parë i kësaj lozhe gjendet në analet e e qytetit të Frederiksburgut, në Virxhinia, që i përket datës 22 dhjetor 1753. Në Frederiksburg ndodhej Kisha e Diellit që lind, vend takimi i masonëve, ku persona si Benjamin Franklini, Xhorxh Uashingtoni e të tjerë Etër Themelues mblidheshin zakonisht. Tek simboli mason i harkut frymëzohet edhe një hark i madh çimentoje në Shën Ljuis të Misurit. Harku i Triumfit ndodhet në qendër të një rrethi, nga i cili nisen 12 rrugë. Mbi rrugën qarkuese, që sillet përreth Harkut të Triumfit, gjenden 12 pika, të cilat formojnë majat e një ylli me 12 cepa. Prapë edhe një herë gjejmë diellin në

LIBRI 24

qendër të rrethit të ndarë në 12 pjesë (shih pjesën e ilustrimeve). Rruga kryesore, që përshkon këtë rreth, përbëhet nga e famshmja Champs Elysées dhe, duke ndjekur këtë rrugë, vihet re se si e gjitha kjo është frut i një projektimi të ditur. Sapo të ndodheni nën Harkun e Triumfit, afër "flakës së përjetshme" të ushtarit të panjohur, vështroni ngulët në një drejtim, drejt përpara jush, dhe do të shikoni në largësi një hark të madh modern çimentoje. Nëse ktheheni e vështroni në drejtim të kundërt, prapë drejt përpara jush, do të shikoni, përtej Champs Elysées, obeliskun egjiptian të Sheshit Konkord, që i përket 3.200 vjetëve më parë. Matanë atij, në të njëjtin drejtim, do të gjeni një tjetër hark, të ngjashëm me Harkun e Triumfit, por shumë më të vogël, dhe ky nga ana e tij është i orientuar me piramidën e madhe prej xhami të ngritur përpara Muzeut të Luvrit gjatë presidencës së masonit të shkallës së 33-të, Franc Miteranit. Njerëzit mbetën të mahnitur, kur panë që një ndërtesë aq e huaj për atë mjedis po futej brenda skenës aq të bukur arkitektonike të Luvrit. Arsyeja e kësaj nuk kishte të bënte fare me arkitekturën dhe kishte të bënte shumë me kërkesën për të përforcuar konfiguracionin gjeometrik të qytetit. Një piramide të zezë të ngjashme dhe po aq të madhe i është vënë pranë një Sfinks shumë i madh dhe një obelisk në atë qytet të Vëllazërisë, sikurse është Las Vegasi.










*Figura 35. Rrethi i lashtë diellor dhe simboli i kryqit, siç paraqiten tek... kryqi kelt - **Figura 36. Figura 37** – Logoja e NATO-s.*

Figura 38. Kryqi dhe dielli mbi emblemën e CIA-s.

Luani shihet shpesh nëpër stemat dhe nëpër flamujt, sepse është një simbol i lashtë i Diellit, sikurse me shumë gjasë është edhe Sfinksi. Peshku simbolizon shenjën e Peshqve, por edhe mbretin legjendar babilonas Nimrod, që paraqitej në formën e peshkut. Pëllumbesha simbolizon shoqen e saj, mbretëreshën Semiramidë, dhe bëhet prapë edhe një herë fjalë për simbolizëm të shtrembëruar. Ndërsa pëllumbesha për pjesën më të madhe të popujve i





Figura 39. Rrethi i zodiakut me një diell të zi në qendër.

referohet paqes, për Vëllazërinë përkundrazi është një simbol i vdekjes dhe i shkatërrimit. Kjo përmbysje e simboleve i jep mundësi Vëllazërisë të përdorë publikisht simbole në mënyrë të atillë, që askush të mos i kuptojë. Sinn Fein-i, krahu politik ekstremist i IRA-s në Irlandën e Veriut, ka për simbol një pëllumbeshë, pikërisht për këtë arsye. Dhe pikërisht mbi këtë vlerë simbolike të pëllumbeshës është shpikur emri Kristofor Kolombi (*colomba – pëllumbeshë*) që, në fakt, zakonisht nënshkruante si Kolon. Emri "Kolombo" qe krijuar mbi bazën e simboleve të tjerë të përdorur nga Vëllazëria. Romakët nderonin një hyjni që e quanin *Venus Columba*, Afërdita Pëllumbesha. Qoftë Afërdita, qoftë pëllumbesha i shoqërohen mbretëreshës Semiramidë të Babilonisë. Fjala pëllumbeshë (colomba) sot në frëngjisht është ende "colombre". Kolumba është edhe një hyjneshë "Afërditë", që simbolizon anët negative, të vdekjes dhe të shkatërrimit, që i atribuohen energjisë femërore. Prej këtej rrjedhin emrat anglezë *British Columbia, Columbia Pictures, Columbia University, Columbia Broadcasting* (CBS), *Space Shuttle Columbia*, dhe Distrikti Kolumbia, në Virxhinia (virgjëresha Isidë-Semiramidë). Dhe, në lidhje me këtë, vështroni logot e shoqërive që mbajnë emrin "Columbia". *Columbia Pictures* ka në stemën e saj një grua me një pishtar të ndezur në dorë, ndërsa *Columbia Broadcasting* (CBS) paraqet një sy, syrin që gjithçka sheh. Pëllumbeshat shihen mbi kryqet malteze të skeptrave të monarkut britanik (shih pjesën e ilustrimeve). Skeptrat ishin simbole të pushtetit në Egjiptin e lashtë. Kryqi maltez, apo i bigëzuar (shih ***Figurën 40***), është gjetur në shpella në tokat fenikase të Kapadokias, Turqisë së sotme; ai i përket një periudhe mijëra vjet më parë dhe u bë kryqi i Kalorësve Ospidalierë (Kalorësit e Maltës), i Kalorësve Tempullarë dhe i nazistëve. Nëse vështroni fotografinë e ushtarit nazist në pjesën e ilustrimeve, do të shihni të gjitha simbolet e përmendur më lart: kryqin maltez, kryqin e thyer të përmbysur, kafkën me kockat dhe shqiponjën! Tre prej simboleve

më të rëndësishëm të Vëllazërisë janë pishtari i ndezur, trëndafili i kuq dhe pëllumbesha. Simbolet e tri partive kryesore politike të Mbretërisë së Bashkuar, të nënshtruara ndaj strukturës së kryesuar nga mbretëresha, janë pishtari i ndezur (konservatorët), trëndafili i kuq (laburistët), pëllumbesha (liberalë demokratët)! Në çastin që po shkruaj, krerët e tyre janë Toni Bler (Grupi Bilderberg), Uiliam Haigu (Grupi Bilderberg), Pedi Ashdaun (Grupi Bilderberg). Por bëhet fjalë vetëm për një rastësi, asgjë për t`u shqetësuar!








Figura 40. Kryqi maltez.
Figura 41. Logoja e Kombeve të Bashkuara mbi sfondin blu mason, me 33 ndarje brenda rrethit, në përputhje me 33 shkallët zyrtare të Ritit Skocez të Masonerisë.
Figura 42. Edhe "korniza" e jashtme është marrë nga Masoneria, siç mund ta shihni nga ky ilustrim.

Gjethet e dafinës, që duken në stemën e Kombeve të Bashkuara, gjenden në atë të Masonerisë (shih ***Figurën 41***) dhe rrethi është i ndarë në 33 seksione. Sfondi është blu, ngjyra tipike masone, si tek Shkallët Blu të Masonerisë. Edhe simboli i Bashkimit Evropian është blu. "Korniza", që qarkon logon e Kombeve të Bashkuara është marrë qartazi nga simboli i Masonerisë, që mund ta shihni në ***Figurën 42***. Do t`i gjeni katrorët e bardhë e të zinj të masonëve e të tempullarëve (dhe në një pafundësi grupesh të tjera të Vëllazërisë) në uniformat e forcave të policisë britanike dhe amerikane, sikurse edhe mbi dyshemetë e katedraleve të mëdha dhe në kishën e Rëne-lë-Shatosë. Kur presidentët amerikanë e vendosin dorën në zemër teksa dëgjojnë himnin kombëtar, kremtojnë një pjesë të një riti mason. Amerikanët, që gjithashtu janë kundër masonëve, bëjnë të njëjtën gjë, sepse nuk e kuptojnë atë simbolizëm. Një tjetër gjest tipik i Vëllazërisë qëndron tek të zgjaturit e krahut përpara, me dy gishtat më të skajshëm të drejtuar lart dhe dy gishtat e mesit të mbajtur poshtë me anë të gishtit të madh. Ky është simboli i djallit Bafomet, i brirëve të Nimrodit dhe ky është gjesti që Bill Klintoni ka bërë gjatë fjalës së

tij në ceremoninë e marrjes së detyrës së presidentit, në janar të vitit 1993. Bafometi simbolizon edhe Gardianin zvarranik Azazel, "dhinë". Një katror i dyfishtë, një katror i mbivënë mbi një tjetër në mënyra të ndryshme, përfaqëson një tjetër formë të simbolizmit tipik për shoqëritë e fshehta. Në gjuhën e fshehtë, një katror i vetëm do të thotë kontroll i asaj që është e vërtetë dhe e drejtë. Prej këtej ka lindur cilësori "kuadrat", në kuptimin i drejtë. Një katror i mbivënë mbi një tjetër do të thotë kontroll i gjithçkaje që është e drejtë dhe e gabuar, e gjithçkaje që është e saktë dhe e pasaktë, pozitive e negative. Me fjalë të tjera, "ne kontrollojmë gjithçka". Katrori i dyfishtë, ose ylli me tetë cepa, mund të shihet në tremenë e Parlamentit britanik dhe një listë e gjatë forcash policie mban një distinktiv të rrethuar nga i njëjti simbol (shih ***Figurën 43***). Shiriti në formën e V-së është një tjetër version i kësaj (shih ***Figurën 44***). Duhet vërejtur kjo stemë se si është e përbërë nga dy kuti tripërmasore, njëra sipër tjetrës, dhe jo nga dy V njëpërmasore. Është kjo logoja e shoqërisë së naftës së Vëllazërisë, *Chevron*, dhe të tjera shumëkombëshe të naftës paraqesin shumë simbole të tjerë, të cilët e kanë zanafillën tek kodi sekret i fuqisë, që kontrollon botën. Kryqi i dyfishtë i dinastisë së Lorenëve qëndron në zanafillë të shprehjes angleze "double cross" (kryq i dyfishtë), që do të thotë edhe të "mashtrosh", të "manipulosh" dikë. Po ky simbol gjendet tek *Exxon*-i, gjiganti i naftës i drejtuar nga Rokfelerët (shih ***Figurën 45*** e ***46***). *Texaco* paraqet një yll pesëcepësh të mbyllur brenda një rrethi me kryqin Tau (T-në) të Masonerisë (shih ***Figurën 47***). Simboli i *Atlantic Richfield Oil* (*ARCO*) është një piramidë pa majë e parë nga lart (shih ***Figurën 48***) dhe *Amoco* paraqet pishtarin e ndezur (shih ***Figurën 49***). Mendoni për emrat e disa kompanive të sigurimit të Vëllazërisë: *Sun Alliance, Sun Life,*



Figura 43. *Një katror i mbivënë mbi një tjetër në çfarëdo mënyre do të thotë "ne kontrollojmë gjithçka". Jo rastësisht e gjejmë mbi distinktivin e policisë së Suseksit, në Angli.*



Figura 44. Shiriti në formë V-je i *Chevron*-it. Duhet vërejtur ky imazh tripërmasor dhe jo njëpërmasor. Bëhet fjalë për dy kuti, që simbolizojnë një katror sipër tjetrit. Ne kontrollojmë gjithçka.




Figura 45. Kryqi i dyfishtë i dinastisë së Lorenëve, që sot gjendet në logon e kompanisë së naftës *Exxon* - **Figura 46.**



Britanic Assurance, *Eagle Star*. Pallati londinez i *Sun Alliance*, në Piccadilly Circus, është i zbukuruar me dy shtylla, me dy flakë dhe me një statujë të Britanisë (Baratisë) me shqytin ku paraqitet një rreth me kryqin, simboli i lashtë i Diellit! Vini re edhe emrat që u jepen anijeve hapësinore, aeroplanëve ushtarakë dhe anijeve luftarake si Hermes, Nimrod, Atlantidë, Kolumbia. Të gjithë referime ndaj Vëllazërisë.

Zambaku është një tjetër simbol i lashtë i përdorur gjerësisht sot, sidomos nga familjet mbretërore dhe do ta gjeni në kangjellat që rrethojnë shumë ndërtesa. Mund të shihet edhe mbi njërën prej portave me kangjella hekuri, nga e cila hyhet në Shtëpinë e Bardhë. Ka qenë përdorur nga Merovingët në Francë dhe, përveçse na kthen tek ata, ai simbolizon perëndinë Babilonase Nimrod, dhe Lilithin, emri i së cilës na kthen tek raca e zvarranikëve. Trëndafili i kuq është një tjetër simbol i Vëllazërisë dhe kambana, si tek Kambana amerikane e Lirisë, është një simbol i Bel, Bil ose Baal-it, perëndisë ariane të diellit, tipike për botën e lashtë. Simboli më i parashikuar për qëllimet e Vëllazërisë janë vandakët (fashi), prej nga ka rrjedhur




Figura 47. *Texaco*. Ylli pesëcepësh i futur në rrethin me kryqin *Tau*, T-në masonike.



Figura 48. *Atlantic Richfield Oil* dhe piramida pa majë e parë nga lart.



Figura 49. *Amoco*, tani e shkrirë me *British Petrolum*. Pishtari i ndezur.

termi "fashizëm". Mund t`i gjeni në bazën e simbolit amerikan të "lirisë" dhe në pallatin e kongreseve (shih *Figurën 50*). Bëhet fjalë për një simbol shumë të përhapur brenda Perandorisë Romake, i formuar nga shkopinj të lidhur bashkë përreth një sopate (asha). Nga kjo sopatë (asha) rrodhi shprehja "fuqitë e boshtit (ase)", me të cilën quheshin vendet fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky simbol të kthen tek bashkimi i popujve dhe vendeve nën një diktaturë të përbashkët të centralizuar, tamam sopata. Bëhet fjalë për një përshkrim të përkryer të Bashkimit Evropian, në të cilin kombet evropiane janë të varura ndaj ligjeve të përbashkëta të caktuara dhe të diktuara nga një diktaturë jo e zgjedhur, që e ka selinë në Bruksel. Bashkimi Evropian është një shtet fashist krejt në rregull, në përputhje me simbolin fashist.

Por simbolizmi nuk duhet të jetë patjetër negativ. Bëhet fjalë thjesht për një formë komunikimi, i cili është përdorur edhe për të mbajtur të gjallë dijen nga ana e atyre që ishin të shtyrë prej qëllimeve pozitive kundrejt njerëzimit. Dija është e natyrshme; është përdorimi që i bëhet asaj, që e bën atë pozitive apo negative. Tarokët, paraardhësit e letrave tona të lojës, përdoreshin për të trashëguar dijet e ndaluara. Kjo është arsyeja pse Kisha i dënoi tarokët, duke i quajtur një shprehje të së keqes. Në shekujt që pasuan zhdukjen e katarëve në Francë, tarokët u përhapën nga zhonglerët dhe ciganët.




Figura 50. Liri? Atëherë ç'hyn simboli fashist që shohim këtu dhe që të shpie tek gjithçka, përveç lirisë?

Disa studiues thonë se tarokët qenë sjellë në Evropë nga kryqëtarët që ktheheshin në shtëpi dhe që i kishin blerë nga sekte mistike të Lindjes së Mesme dhe kjo pjesërisht është e vërtetë. Por ajo që shpesh harrohet është roli i luajtur nga ciganët dhe arsyeja pse ata janë përndjekur kaq në mënyrë të dhunshme, edhe nga Adolf Hitleri. Ekziston një legjendë, që unë besoj se bazohet mbi të vërtetën, sipas së cilës priftërinjtë e Aleksandrisë shpëtuan sa libra që

LIBRI 24

mundën, kur biblioteka ekzoterike e Aleksandrisë u dogj nga Kisha Romake, dhe ata u bënë pastaj nomadë, një popull më vete, me gjuhën e vet dhe përdorën tarokët, për të përkthyer në gjuhë simbolike dijet e tyre. Kur ciganët përmenden për herë të parë në dokumente angleze, që i përkasin epokës së Henrikut VIII, përshkruhen si "njerëz me pamje ekzotike, që e quajnë veten egjiptianë"[11]. Termi "tarok" duket se rrjedh nga fjalët egjiptiane "tar", që do të thotë "rrugë" dhe "ro", që do të thotë "mbretëror"[15]. Rruga mbretërore drejt urtësisë, nëse dija përdoret në mënyrë të përshtatshme dhe jo për qëllime të mbrapshta. Midis tarokëve dallohen Arkanët më të Vegjël, ose "Sekretet e Vogla", të përbërë nga simbole shpatash, kupash, yjesh pesëcepësh e skeptrash, dhe Arkanët më të Mëdhenj, ose "Sekretet e Mëdha", të njohur si asë. Midis asëve figuronte "Zhongleri", që ka mbijetuar në letrat moderne të lojës. Zhongleri është palaçoja, që ia besonte transmetimin e mesazhit të tij humorit dhe batutave.

Letrat aktuale të lojës janë një version i zvogëluar i tarokëve. Ngjyra e zezë dhe e kuqe përfaqësojnë dy periudhat e mëdha të vitit, dimrin dhe verën, kur Dielli është në veri ose në jug. Katër llojet (simbolet) janë stinët. 13 letrat, që përbëjnë çdo lloj (simbol), përfaqësojnë 13 muajt hënorë të vitit dhe 52 letrat, që përbëjnë tufën, përfaqësojnë 52 javët e vitit. Në se i jepni Zhonglerit një pikë dhe Fantit, Mbretëreshës e Mbretit, përkatësisht 11, 12 e 13, shuma e përgjithshme e 52 letrave është e barabartë me 365, që janë ditët e vitit. Tek letrat e lojës gjejmë edhe simbole astrologjike. Loja tejet simbolike e shahut, "loja mbretërore", luhej në Kinë e në Indi shumë kohë përpara në krahasim me përhapjen e saj në Evropë. Një formë e lojës së shahut, më e ngjashme me damën, luhej nga faraonët në Egjipt. Fusha e shahut përbëhet nga 64 katrorë të bardhë e të zez, që simbolizojnë dyshemenë e Shtëpisë së Mistereve. "Skuadrat" e gurëve të bardhë dhe e gurëve të zez simbolizojnë luftën e përjetshme midis së mirës dhe së keqes, dritës dhe errësirës, ndërmjet shumë gjërave të tjera. 64 kutitë mbi fushën e shahut i referohen sistemit kinez ekzoterik i njohur si *I-Ching*, që përbëhet prej 64 ekzagramësh. Bëhet fjalë gjithmonë për të njëjtat dije të mbajtura fshehur, ose të paraqitura në mënyrë të ndryshme. Rapsodët (këngëtarët e baladave) dhe menestrelët të njohur si Trovatorë (Trubadurë) në Francën e shekujve XII e XIII i këndonin lavdërime "zonjës" së tyre. I njëjti emër "trovatore (trubadur)" na shpie në Afrikën e Veriut, pasi rrjedh nga termi arab "tarab dour", që do të thotë Shtëpia e Gëzimit, dhe na kujton pushtimin mysliman të Francës jugore. Ata fshihnin "zonjën" e tyre prapa Maries biblike që të mund të mbijetonin, por figura e vërtetë që qëndronte prapa "zonjës" së tyre ishte Isida. Më pas do të kenë

lindur legjendat e mbretit Artur dhe të kërkimit të tij të Gralit të Shenjtë, legjenda që qartazi kopjonin temat e Ungjijve dhe figurat e Mitras, Horusit etj, nëpërmjet simboleve të tyre të Diellit e të Tavolinës së Rrumbullakët astrologjike.

Këta janë vetëm disa prej simboleve që jo-anëtarët e shoqërive të fshehta, ose ata që as që janë munduar t'i kuptojnë, nuk arrijnë as edhe t'i shohin. Nëse jeni të pamësuar në këtë gjuhë simbolike, shpresoj që tani do të jeni në gjendje t'i lexoni më me lehtësi shenjat dhe simbolet e Vëllazërisë dhe do të kuptoni më mirë lojërat e qëllimet e saj.

LIBRI 24

Kapitulli 18

Të gjithë ushtarët dhe njerëzit e mbretëreshës

Në shumë anë, dinastia e Uindsorëve mishëron thuajse çdo element të kësaj historie. Ata rrjedhin nga një familje e Fisnikërisë së Zezë, e cila punon në mënyrë të vetëdijshme për vënien në zbatim të Urdhërit të Ditës së Vëllazërisë dhe mjafton të vështrosh prapa fasadës, për të rënë pingul në errësirë. Uindsorët janë familja zvarranike e profilit më të lartë të planetit dhe ata veprojnë në zemër të manipulimit global. Bëhet fjalë sidoqoftë prapë për "shërbëtorë servilë", që nuk zënë nivelet më të larta të piramidës, edhe pse janë shumë afër atyre niveleve.

Vetë ceremonia e kurorëzimit të sovranit britanik zbulon origjinën e vërtetë të Uindsorëve dhe të paraardhësve të tyre. Kur mbretëresha u kurorëzua si Elisabeta II, më 2 qershor 1953, të gjitha zbukurimet dhe objektet e ceremonisë, kurorat, skeptrat, veshjet, rruzulli dhe byzylykët, u morën nga Kulla e Londrës dhe u ruajtën për gjithë natën përpara asaj dite në Dhomën e Jeruzalemit të Abacisë së Uestminsterit. Në këtë dhomë ishin mbledhur studiuesit për të përkthyer "versionin e autorizuar" të *Biblës* së mbretit Xhejms, nën drejtimin e përgjithshëm të Sër Frensis Bekonit dhe Robert Flojdit, Mjeshtër i Madh i Manastirit të Sionit[1]. Familja mbretërore britanike gëzon ende të drejtat e

LIBRI 24

autorit mbi këtë përkthim! Dhoma e Jeruzalemit është e veshur me dru kedri me prejardhje libaneze, pasi ai ishte druri që thuhej se ishte përdorur për të ndërtuar Tempullin e Solomonit. Tapiceria që vesh dhomën paraqet Gjykimin e Solomonit. Abacia e Uestminsterit, "katedralja e krishterë", është, në fakt, një tempull pagan. Edhe dyshemeja është e veshur me pllaka të bardha e të zeza, si në një tempull mason.

Në fillim të ceremonisë së vitit 1953, mbretëresha rrinte ulur mbi Fronin e Kurorëzimit dhe poshtë të ndenjurave kishte Gurin e Fatit, që Eduardi I e kishte grabitur nga Abacia e Skunit në Skoci, në vitin 1246. Thuhej se ai gur ishte sjellë në Irlandë nga Izraeli nëpërmjet Egjiptit dhe është i njohur edhe si Kolona, apo Jastëku i Jakobit. Mendoj se në thelb kjo histori është e vërtetë, por mbi shumë hollësi e domethënie duhet ende të hidhet dritë. Arkipeshkëvi i Kantërberrit u kthye nga veriu, nga jugu, nga lindja e nga perëndimi (katër cepat e kryqit pagan) dhe të pranishmit e mbledhur aty thirrën: "Zoti e shpëtoftë mbretëreshën". E gjitha kjo të kthente simbolikisht tek historia e Testamentit të Vjetër, në të cilin përshkruhet kurorëzimi i "Saulit" si mbret i Izraelit, kur njerëzit thirrën: "Zoti e shpëtoftë mbretrin"[2]. Kjo britmë përsëritet tetë herë tek Testamenti i Vjetër, kur kurorëzohen mbretërit e Izraelit. Mbretëresha rrinte ulur mbi Fronin e Kurorëzimit, me simbolet egjiptiane të skeptrit dhe të bastunit në dorë. Në majën e skeptrit është kryqi maltez, ndërsa mbi bastun paraqitet një pëllumbeshë. Pastaj merr në dorë një rruzull, që ka të kaluar përmbi të një kryq maltez, krejt i ngjashëm me atë të përdoruar nga krahu hollandez i Fisnikërisë së Zezë. Babiloni është tani Londra dhe mbretëresha Elisabetë shihet nga Vëllazëria si pasardhëse simbolike e themelueses legjendare të Babilonisë, mbretëreshës Semiramidë, që paraqitej nën formën e "pëllumbeshës". Gjatë kurorëzimit, mbretëresha u lye edhe me vaj, një traditë e vjetër ariano-zvarranike, që i përket një periudhe mijëra vjet më parë. Fjala "Krisht" do të thotë "lyrë". Vaji i përdorur gjatë ceremonisë së kurorëzimit të mbretëreshës ishte e njëjta përzierje e përdorur së lashti në Lindjen e Mesme. Transportohej në një vazo të artë të quajtur Ampulë, që kishte formën e një... pëllumbeshe[3]. Kjo të kujton dhjamin "messeh" të përdorur në Egjipt nga Oborri Mbretëror i Dragoit. Lyerja me vaj gjatë kurorëzimit do të luante funksionin për ta ngritur sovranin në rangun e Priftit më të Lartë, në këtë rast, në rangun e Priftëreshës më të Lartë të Kishës së Anglisë, përveçse kryetare e shtetit. Ndërsa po kryhej e gjitha kjo, argjipeshkëvi i Kantërberrit thoshte:

"Ashtu si mbretërit, priftërinjtë dhe profetët lyheshin me vaj: dhe ashtu si Solomoni u lye nga prifti Zadok e nga profeti Natan, ashtu lyhu ti, mbretëreshë e

bekuar dhe e hirësuar e popujve, që Perëndia Zoti yt t`i ka besuar që t`i qeverisësh e t`i udhëheqësh..."[4].

Gjendemi përballë simbolizmit të Vëllazërisë në gjendje të pastër. Shprehja "Perëndia Zoti yt" të kthen tek "perënditë" e botës së lashtë, "perënditë" zvarranike. Kurora e përdorur në atë ceremoni i përket epokës së Eduardit II Rrëfyes. Ai që mbreti i Anglisë, që e ndërtoi fillimisht Abacinë e Uestminsterit në vitin 1065, ndërsa rindërtimi aktual i detyrohet Henrikut III, mbretit të kontrolluar nga tempullarët. Eduardi vdiq në vitin 1066, të njëjtin vit kur Uilliam Pushtuesi dhe mbështetësit e tij të familjes Shën Kler vërshuan në Angli dhe fituan Betejën e Hastingsit, duke ndjekur këshillat e Fisnikërsisë së Zezë të Venecies. Kurora e Kurorëzimit ka 12 gurë të çmuar të ngallmuar, bashkë me dy figura të kryqit maltez, që ishte njëri prej simboleve naziste më të rëndësishëm. Tek *Libri i Eksodit*, i shkruar nga levitët, flitet për koracën e Aaronit, mbi të cilën janë të ngallmuar 12 gurë të çmuar[5]. Të njëjtët gurë të çmuar, në të njëjtën renditje, paraqiten në kurorën britanike[6]. Arkipeshkëvi i vendosi duart e tij midis atyre të mbretëreshës, për të nderuar kreun e ri të Kishës dhe i puthi dorën e djathtë. Pastaj tha:

"Zoti i Gjithëfuqishëm... e vëntë mbretërimin tënd në rrugë të drejtë, që të mund të rrojë përgjithmonë, ashtu si dielli para tij dhe ashtu si një dëshmitar besnik në parajsë"[7].

Bëhet fjalë thuajse për një përsëritje fjalë për fjalë të fjalëve të përdorura gjatë aleancës midis Zotit dhe Davidit, tek Testamenti i Vjetër[8]. "Zoti i Plotëfuqishëm" ishte fillimisht Shadai apo Ishkuri, i biri i Mardokut, që thuhet se ishte i biri i shkencëtarit anunak Enki, tipit që, sipas pllakëzave sumere të përkthyera nga Zaharia Sitkini, krijoi hibridët midis njerëzve dhe anunakëve bashkë me Ninkharsagun. Uindsorët rrjedhin nga Fisnikëria e Zezë e Vëllazërisë dhe mbretëresha u kurorëzua në harkun e një ceremonie të Vëllazërisë, brenda tempullit të Vëllazërisë. Vetëm duke mbajtur parasysh këtë, do ta kuptoni atë që po bëheni gati të lexoni.

Gjaku i Uindsorëve

Elizabet Aleksandra Meri Uindsor, mbretëresha Elisabet II, rrjedh, si të gjitha familjet mbretërore evropiane, nga ajo figurë themelore për pushtimin e Britanisë së Madhe, sikurse ishte Uilliami III, princi d'Oranzh, njeriu të cilit i detyrohet lindja e Bankës së Anglisë. Ajo është në lidhje farefisnie edhe me

LIBRI 24

anëtarët e Fisnikërisë së Zezë që vërshuan në Ishujt Britanikë, si Uilliam Pushtuesi. Ajo rrjedh nga Robert Brusi, Kenet MekAlpini dhe mbreti i Skocisë, dhe është në lidhje farefisnie me mbretërit irlandezë, që kurorëzoheshin me ceremonitë e lashta të Tarës. Mbretëresha nënë, dikur Ledi Elizabetë Baues-Lion, rrjedh nga një familje e rëndësishme zvarranike e Vëllazërisë, që i përket aristokracisë skoceze dhe e lidhur me Brusët, me Stjuartët, me MekAlpinët e deri me mbretërit irlandezë.

I ati i saj ishte Klod Xhorxh Baues-Lioni, konti i 14-të i Strathmurit, dhe e ëma ishte Nina Selia Kavendish-Bentiku. Këto familje ia detyrojnë pjesën më të madhe të pasurive dhe të pushtetit të tyre Gulielm d'Oranzhit dhe atyre që e kontrollonin. Ishte Uilliami ai që e emëroi Bentikun kontin e parë të Portlandit, si shpërblim të shërbimeve të kryera prej tij, dhe Bentik/duka i dytë i Portlandit u martua me një trashëgimtare të familjes së pasur Kavendish, duke i dhënë jetë dinastisë Kavendish/Bentik, nga e cila rrodhi e ëma e mbretëreshës nënë. Nëpërmjet këtij bashkimi, Uindsorët u bënë farefis me Kavendishët, me dukët e Devonshirit të Katsuorth Hauzit. Titulli i kontit të Strathmurit i ishte dhënë fillimisht paraardhësit të mbretëreshës nënë, Patrik Lionit, si mirënjohje për mbështetjen që i kishte dhënë Uilliam d'Oranzhit[9]. Shkurt, paraardhësit e Uindsorëve patën një rol themelor në vendosjen e anëtarit të Fisnikërisë së Zezë, Uilliam d'Oranzhit, në fronin britanik, pasi kishte themeluar Bankën e Anglisë dhe kishte konsoliduar pushtetin e *Sitit* të Londrës. Mbretëresha Elisabetë, nëpërmjet paraardhësve të saj Hanover, përfaqëson linjën gjermane të Fisnikërisë së Zezë dhe të gjitha degëzimet e ndryshme, qofshin ato irlandeze, skoceze, gjermane, daneze, suedeze, apo çfarëdo tjetër, zënë fill nëpërmjet venecianëve të Fisnikërisë së Zezë deri tek fenikasit, tek egjiptianët, tek sumerët dhe tek zvarranikët. Këto prejardhje janë të pabesueshme dhe princi Karl mund të mburret me tre mijë prejardhje vetëm nga Eduardi III (1312-1377)[10], sovrani që krijoi grupin e Vëllazërisë të quajtur Urdhëri i Zharrëtierës. Edhe nëntëmbëdhjetë presidentë të Shteteve të Bashkuara rrjedhin nga Eduardi III[11], pra i përkasin të njëjtës linjë të princit Karl. Uindsorët kanë pasur deri madje një lidhje gjaku me atë kukullën e Vëllazërisë, sikurse ishte Muhameti, themeluesin zyrtar të Islamit[12].

Uilliam d'Oranzhi, Uilliami III, vdiq në vitin 1702. Ai dhe e shoqja nuk janë trashëgimtarë dhe kështu që e motra e Maries, Ana, u bë mbretëreshë. Ana ishte trashëgimtarja e fundit e dinastisë Stjuart, pasi edhe pse kishte pasur nga i shoqi Xhorxhi i Danimarkës 17 fëmijë, këta vdiqën të gjithë. Në vitin 1714 terreni ishte gati për marrjen e Kurorës britanike nga ana e familjes së Fisnikërisë së Zezë gjermane, Hanoverve. Këta ishin shumë të lidhur me

dinastinë Hese, që do të ishte bërë pastaj një trampolinë kërcimi për dinastinë e Rotshildëve. I pari mbret i Hanovërve qe Xhorxhi I. Ai nuk dinte as edhe të fliste anglisht dhe nuk pranoi ta mësonte. E filloi jetën e tij si një personazh i dorës së dytë i fisnikërisë gjermane, stërnip i Xhejmsit I të turpshëm, dhe e mbaroi si mbret i Britanisë së Madhe. Ky zotëri e mbajti të burgosur të shoqen Sofie për 32 vjet, duke e quajtur fajtore për tradhëti bashkëshortore me suedezin Filip fon Konigsmarkun, që u zhduk nga qarkullimi dhe që, sipas thashethemeve, gjendej nën trarët e dyshemesë së Pallatit Hanover të Xhorxhit. Xhorxhi II u bë mbret në vitin 1727 dhe vdiq në vitin 1760, teksa ishte i ulur në sqollin e banjës, për shkak të një forme akute të kapsllëkut. Po, vdiq prej heqjes së barkut – përkundrazi, prej mungesës së tij – dhe janë të pakët sovranët, për të cilët mund të thuhet se kanë vdekur në fron. I nipi i tij u bë mbret me emrin Xhorxhi III dhe mbretërimi i këtij përkoi me luftën amerikane të pavarësisë dhe me një shtrirje masive të fuqisë britanike. E pasuan mandej Xhorxhi IV dhe Uilliami IV, për të arritur pastaj tek mbretëresha Viktoria, që mbretëroi si mbretëreshë e Britanisë së Madhe dhe si mbretëreshë-perandore e Perandorisë nga viti 1837 deri në vitin 1901. Në atë epokë Perandoria Britanike (zvarranike) kontrollonte 40% të sipërfaqes tokësore dhe më shumë se një të pestën e popullsisë botërore. Bëhej fjalë për perandorinë më të madhe të parë ndonjëherë në botë. Viktoria u martua me princin Albert të dinastisë Saksoni-Koburg-Gota, që i përkiste Fisnikërisë së Zezë gjermane dhe të dy patën nëntë fëmijë, që u martuan me anëtarë të familjeve të tjera (ndoshta do të ishte më mirë të thuhej "të familjes") mbretërore evropiane. Viktoria kishte famën se ishte shumë e rreptë, por, ashtu si Rotshildët, Uinston Çurçilli dhe të tjerë shtylla mbajtëse të *Establishment*-it, edhe ajo e kishte zakon të përdorte kokainë e heroinë[13]. Në rezidencën mbretërore verore të Balmoralit, në Skoci, organizoheshin pritje me bazë droge[14]. Fëmija i parë i Viktorias, Alberti, u bë mbret me emrin Eduard VII, Mjeshtër i Madh i masonerisë angleze, që mbretëroi deri në vitin 1910. Ndodhi pikërisht atëherë, gjatë Luftës së Parë Botërore, që emri i dinastisë mbretërore u ndryshua nga emri gjerman Saksoni-Koburg-Gota në dinastinë Uindsor. Edhe emri gjerman Batenberg u ndryshua në të njëjtën periudhë, në vitin 1917, dhe u anglishtizua në Mountbaten. E vetmja arësye e këtij ndryshimi të papritur kishte të bënte me marrëdhëniet publike. Në atë kohë në fakt gjermanët dhe anglezët ishin duke u masakruar me njëri-tjetrin nëpër llogoret e Francës Veriore. Në vitin 1936 hipi në fron Eduardi VIII, që abdikoi për shkak se u martua me një amerikane të ndarë nga burri, Uolls Simpsonin, dhe u zëvendësua nga Xhorxhi VI, i ati i mbretëreshës Elisabetë dhe i shoqi i Elizabet Baues-Lionit, nënës mbretëreshë

LIBRI

aktuale. Xhorxhi vdiq në vitin 1952 dhe vajza e tij më e madhe u kurorëzua Elisabeta II në Abacinë e Uestminsterit, në vitin 1953. Në atë kohë ishte e martuar tashmë me një tjetër anëtar të Fisnikërisë së Zezë, princin Filip të Greqisë e të Danimarkës, baron i Grinuiçit, kont i Marionethit, dukë i Edinburgut. Ai kishte lindur në Korfuz, nga princi Andrea i Greqisë dhe nga princesha Alisë e Batenbergut, stërmbesë e mbretëreshës Viktoria. Filipi, një Batenberg, përshtati versionin e anglishtizuar Mountabaten dhe, pasi ishte martuar me Elisabetën, dinastia mbretërore britanike u bë dinastia Uindsor-Mountabaten. Ose më mirë Saksoni-Koburg-Gota-Batenberg. Kjo martesë e kombinuar qe orkestruar nga Lordi Ljuis "Dik" Mountbaten, i ungji i princit Filip. Filipi është një përfaqësues tipik i Fisnikërisë së Zezë (zvarranike) dhe kjo është arësyeja pse i është dukur jashtëzakonish acarues fakti që është i detyruar të ecë pas së shoqes, sipas asaj që është parashikuar nga protokolli mbretëror. Mbretëresha është stërmbesë e mbretëreshës Viktoria dhe edhe Filipi është në farefisni me Viktorian, nga ana e së ëmës. Një gjë për t'u mbajtur mirë në mend është fakti se "familjet" mbretërore të Evropës nuk janë aspak familje, por një familje e vetme e madhe, që rrjedh po nga ajo racë, e cila punon për të vënë në zbatim të njëjtin Urdhër të Ditës. Natyrisht, disa e bëjnë me më shumë entuziazëm se të tjerët, por pikërisht kështu funksionon kjo çështje. Një shembull i kësaj është mënyra se si fisi i princit Filip u vendos në fronin e Greqisë. Pasi shërbimet e fshehta britanike kishin organizuar një grusht shteti kundër mbretit "grek" Oto I (një gjerman!), duke e rrëzuar nga froni në vitin 1862, ato zgjodhën princin Vilhelm, nip i mbretit danez, si mbret të Greqisë. E di që e gjitha kjo tingëllon qesharake, por për Fisnikërinë e Zezë e gjitha kjo është si një shoqëri shumëkombëshe, vendet vakante të së cilës duhet t'i plotësojë. Princi Vilhelm i Danimarkës u bë mbreti Jorgo (Xhorxh) I i Greqisë (po, e lexuat tamam). Vilhelmi, më falni Xhorxhi, tashmë, Jorgo, u martua me të mbesën e carit rus Nikolla I dhe princi Filip është në farefisni me shtatë carë. Ai ka lidhje të forta gjaku me Gjermaninë dhe edhe me Norvegjinë, me Danimarkën, me Suedinë e me pjesën më të madhe të familjeve mbretërore evropiane. Njëri prej paraardhësve të tij është Kristiani, konti i Oldenbergut, i vdekur në vitin 1167 dhe, siç kam thënë më përpara, njëri prej dy njerëzve që themeluan dinastitë evropiane të Fisnikërisë së Zezë. Filipi ishte trashëgimtar për fronin grek, por teksa ishte ende fëmijë, një tjetër grusht shteti e shfronëzoi monarkun grek dhe familja e tij u transferua në Francë, ku ai filloi të frekuentonte një shkollë private në Paris. Në vitet 1931 e 1932 katër vajzat më të mëdha se Filipi u martuan me pinjollë të aristokracisë austro-gjermane. Margarita u martua me një nip të mbretëreshës Viktoria,

me princin austro-çek Gotfield fon Hohenlohe-Langenburg; Sesilia u martua me një stërnip të mbretëreshës Viktoria, Georg Donatusin, Grandukë i Hesit-mbi-Rin; i shoqi i Sofies ishte përkundrazi princi Kristof Hese; dhe Teodora u martua me Bertoldin, margraf i Badenit.

I ati i Bertoldit ishte Maks fon Badeni, kancelar gjerman gjatë Luftës së Parë Botërore. Maks fon Badeni themeloi një shkollë afër Liqenit Kostandin, në Gjermani, nëpërmjet sekretarit të tij personal Kurt Hanit, që kishte studiuar në Oksford, e cila u bë qendra kryesore e formimit për rekrutët e rinj të Vëllazërisë. Hani ishte në krye të divizionit të shërbimeve të fshehta pranë ministrisë së Jashtme të Berlinit gjatë luftës dhe që këshilltar i Maks fon Badenit në Konferencën e Paqes së Versajës të kontrolluar nga Rotshildët. Dhe, pikërisht në shkollën e tyre fashiste Scholss Salem, u dërgua Filipi për t'u "edukuar". Në atë kohë ajo shkollë ishte nën kontrollin e Partisë Naziste e të Rinisë hitleriane dhe në lëndët e saj figuronte edhe "shkenca raciale" naziste. Kjo e fundit duhet të ketë pasur një farë ndikimi tek Filipi, siç do ta shohim. Kurt Hani ishte larguar para se të arrinte Fipili, por nuk e kishte mbyllur ende karrierën e tij në sektorin e "edukimit". Fashist i bindur, Hani u transferua në Skoci, ku themeloi *Gordonstoun Academy*, shkollën ku u dërgua princi Karl, për t'u indoktrinuar. Fashisti Han u bë edhe këshilltar i ministrit të Jashtëm britanik. Pas katër vjetësh pranë shkollës naziste gjermane të Hanit, Filipi u dërgua në Gordonstoun, më 16 nëntor 1937, ndërsa fillimi i Luftës së Dytë Botërore ishte gjithmonë e më i afërt[15]. Sistemi i shkollave private angleze, sikurse edhe i barasvlerëshmi i tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjetkë, është themelor për rrjetin e Vëllazërisë. Bëhet fjalë për vendin ku rekrutohen dhe formohen njerëzit, që shndërrohen kështu në psikopatë, apo në subjekte mendërisht dhe emocionalisht të turbulluar, të cilët kanë mësuar të bëjnë pikë për pikë atë që u është thënë të bëjnë. Mjafton që të bisedoni me disa prej personave që e kanë eksperimentuar të gjithë këtë, për të kuptuar se çfarë është një operacion i kontrollit mendor. Në Britaninë e Madhe, fëmijët që u përkasin familjeve aristokrate e të pasura (dhe të tjerave që nuk e dinë se si janë gjërat) i merren familjes në moshën gjashtë vjeç dhe shkarkohen në kolegjet e tyre të para, apo në shkollat "përgatitore". Përgatitja, me të cilën i gënjen mendja, është ajo e indoktrinimit. Tashmë ndihen të braktisur dhe të frikësuar, pasi prindërit e tyre janë larguar, duke i lënë në një vend të huaj, në mes të njerëzve të huaj. E përsëris, këta fëmijë janë vetën gjashtë vjeçë. Arrini ta përfytyroni efektin që e gjitha kjo ka tek një fëmijë aq i vogël? Nga jeta formale dhe pa dhembshuri, tipike në një shkollë përgatitore, ata kalojnë pastaj në shkollën private. Shkollat *Eton* dhe *Harrow* janë më të famshmet

dhe princi Uilliam, trashëgimtar i fronit pas të atit, princit Karl, ka qenë dërguar në *Eton*. Në këto shkolla përgatitore e private, fëmijët ose u përmbahen ligjeve, rregullave dhe kontrollit mendor, ose bien pre e tërbimeve të rrobave të zeza, njerëzve të veshur me të zeza. Sistemi, ku nxënësit më të rinj rezoltojnë të jenë skllevër të nxënësve më të vjetër, ka ushqyer dëshirën për të sunduar e për të kontrolluar të tjerët dhe i ka futur të rinjtë tek "kënaqësitë" që lindin nga shkaktimi i vuajtjeve dhe i torturave ndaj të tjerëve. Dhe pikërisht nga këto shkolla e nga Universitetet e Oksfordit e të Kembrixhit, dalin persona fort të çekuilibruar, të cilët shkojnë pastaj të zënë pozitat e pushtetit financiar, politik, ushtarak e monarkik. Ata ndërmjet tyre që janë psikopatë nisin urdhërat dhe ata që janë tërësisht të privuar nga vetëdija e vet kryejnë atë çka u urdhërohet të bëjnë pa ngitur kundërshtime, ashtu siç u është mësuar. Mungesa e shoqeve femra nxit praktikat homoseksuale dhe shumë prej këtyre personave do të kenë pastaj probleme serioze në marrëdhëniet me gratë. Këtu nuk dua të dënoj homoseksualët, mjaft që këta të mos ia diktojnë homoseksualitetin e tyre të tjerëve. Jam vetëm duke shpjeguar atë që ndodh, kaq. Në këto shkolla ndodhin fakte me të vërtetë të çuditshme, të destinuara të lënë shenjë përgjithmonë në mendjet e atyre që janë të detyruar t'i frekuentojnë. Abuzimet seksuale janë vendosmërisht pjesë e gjithë kësaj. Toni Bler, i zgjedhuri i Vëllazërisë i bërë kryeministër më 1 maj 1997, ka frekuentuar shkollën private të quajtur *Fettes College*, në Edinburg të Skocisë, ku njëri prej miqve të tij më të shtrenjtë ishte kapelani i shkollës, reverendi Ronald Silbi Rajt, njëri prej dekanëve të Kishës së Skocisë. Më pas u vërtetua se Silbi Rajt ishte një pedofil i shfrenuar, që përfitonte prej nxënësve të shkollës *Fettes* dhe të shkollave të tjera[16]. Bleri, që është i afërt i Uindsorëve, shkoi pastaj në Universitetin e Oksfordit dhe u bë avokat pranë *Inns of Court* të Temple Barit, në Londër. Sistemi i shkollave private është i frikshëm dhe shkolla si *Gordonstoun* dhe *Scholss Salem*, të frekuentuara nga Filipi, përbëjnë një rast të skajshëm.

Familja e princit Filip mbështeti Partinë Naziste dhe në vitin 1935 princi Kristof, i shoqi i Sofies, motrës së Filipit, ishte tashmë një kolonel i SS-ve, që i përkiste skuadrës së bashkëpunëtorëve të Himlerit, përveçse ishte në krye të *Forschungsamt*-it, një grup i shërbimeve të fshehta elitë dhe i kontrolluar nga Hermann Geringu. *Forschungsamt*-i mblidhte informacione sekrete mbi hebrejtë e mbi të tjerë njerëz që nazistët donin t'i shkatërronin, bashkëpunonte me Gestapon dhe spiunonte edhe vetë anëtarët e Partisë Naziste. Ishin ata protagonistët e të famshmes "Natë e thikave të gjata", në të cilën Hitleri eleminoi kundërshtarët e tij më të rëndësishëm. Kristofi dhe Sofia e quajtën

Karl Adolf fëmijën e tyre të parë, në nderim të Adolf Hitlerit dhe princi Filip u mor me edukimin e tij. I vëllai i Kristofit, Filipi i Asias, ishte dhëndërr i mbretit të Italisë dhe luante rolin e ndërmjetësit zyrtar midis fashistëve italianë dhe Gjermanisë. Në të njëjtën kohë, edhe mbreti britanik, Eduardi VIII, ishte një përkrahës nazist dhe Filipi i ruajti lidhjet me të, pas abdikimit të tij të detyruar në vitin 1936. Arësyeja zyrtare e këtij abdikimi qe marrëdhënia midis Eduardit dhe amerikanes së ndarë nga burri Uolls Simpson. Pas vetëm 325 ditësh, Eduardi shkoi në mërgim në rezidencën austriake të Rotshildëve dhe, më pas, u transferua në Paris. Rezidenca pariziene e Eduardit u ble nga Mohamed Al Fajedi në vitet e ardhshëm nëntëdhjetë dhe Dajana e Dodi Fajedi e vizituan ditën që vdiqën. Njëri prej përkrahësve kryesorë të Eduardit ka qenë fashisti pedofil, përveçse satanist, Lordi Ljuis Mountbaten, i ungji i princit Filip dhe ai që e afroi Filipin tek familja mbretërore britanike. Mountbateni ishte stërnip i mbretëreshës Viktoria e i princit Albert dhe kishte lindur në Uindsor Kastle në vitin 1900. Mountbateni (Batenbergu) luftoi në dukje në krah të britanikëve gjatë luftës, por në realitet ruajti lidhjet me atë që ishte fisi i vet, përveç familjes Uindsor, nëpërmjet së motrës Luizë, princeshë e Suedisë dhe gruaja e mbretit Gustav. Luiza ishte tezja e princit Filip. Në fund të luftës, në qershor të vitit 1945, mbreti britanik Xhorxhi VI, i ati i mbretëreshës Elisabetë dhe i shoqi i nënës mbretëreshë, dërgoi ish oficerin e shërbimeve të fshehta Antoni Blant në Kështjellën Kronberg pronë e motrës së Filipit, Sofies, dhe e të shoqit të saj nazist Kristof i Asias, për të rivendosur lidhjet midis familjes mbretërore britanike dhe të afërmve naziste[17]. U zbulua më pas se Blanti bënte pjesë në një njësi të "KGB"-së, që kishte depërtuar brenda shërbimeve sekrete britanike, së bashku me Burgesin, Meklejin dhe Filbin. Njeriu i pestë, që nuk iu zu emri kurrë në gojë, ishte Lordi Viktor Rotshild. Kur Blanti më në fund u arrestua në vitet tetëdhjetë, duket se mbretëresha Elisabetë kishte kërkuar që të mos i bënin pyetje mbi misionin e tij të fshehtë në Kështjellën Kronberg[18]. Lord Mountbateni, ky kryemanipulues i Fisnikërisë së Zezë, ka mbuluar detyra të rëndësishme në momente jetësore të historisë. Ka qenë Komandant Suprem në Jug-Lindjen aziatike gjatë Luftës së Dytë Botërore (ku kreu shërbim edhe princi Filip); ka qenë i fundit mëkëmbësmbret i Indisë dhe guvernator i përgjithshëm gjatë tërheqjes britanike; dhe ka qenë oficeri i parë i Admiraliatit Britanik, maja e Marinës Britanike, në kohën e pushtimit britanik të Suezit në vitin 1958. Mountbateni u vra nga një bombë e IRA-s në Irlandë në vitin 1979, por duke qenë se këto grupe terroriste ia shesin njëri-tjetrit krimet e ndryshme, nuk ka qenë e mundur të vërtetohej me siguri urdhëruesi i vërtetë i kësaj vrasjeje.

Pasuria e Uindsorëve

Pasuria e Uindsorëve e kapërcen çdo përfytyrim. Përcaktimi që përdoret për mbretëreshën si "gruaja më e pasur e botës" nuk duket sidoqoftë i mjaftueshëm dhe nuk të çudit fakti që princi Filip të flasë për Uindorët si për një "ndërmarrje të familjes". Ata kanë trashëguar dhe grumbulluar pasuritë e paraardhësve të mbretëreshës, që i përkisnin Fisnikërisë së Zezë, në formën e tokave, shtëpive, thesareve të artit dhe të stolive e gurëve të çmuar. Disa prej këtyre janë pronë e mbretëreshës, ndërsa të tjera janë zyrtarisht pronë e "shtetit", që, si rrjedhojë, mund t'i kalojnë trashëgimtarëve të saj pa vënien e asnjë takse. Pronë e shtetit do të thotë pronë e Fisnikërisë së Zezë, që kontrollon shtetin. Kjo është vetëm një pjesë e pasurisë së Uindsorëve:

Mbretëresha zotëron më shumë se 300 rezidenca, përfshirë kështjella e pallate si Buckingham Palace, Windsor Castle, Kensington Palace (ku jetonte Dajana), St. James Palace (selia londineze e princit Karl), Holyrod House në Edinburg, Balmoral Castle në Skoci dhe Sandringham në Norfolk, ku Dajana njohu princin Karl. Ajo zotëron dukatin Lankaster, i rrethuar nga 40.000 akra (*masë sipërfaqeje anglosaksone e barabartë me 4046,856 m)* tokë, për më tepër bujqësore, por që përfshin edhe zona të rëndësishme të përshtatshme për ndërtime me vlerë shumë të madhe. Në vitin 1988, parlamenti miratoi një ligj për të zhvilluar e për të shitur një pjesë të këtyre trojeve përreth zonës londineze të quajtur Strand. Ashtu si shumë gjëra të tjera që ajo zotëron, edhe dukati i Lankasterit iu grabit, në këtë rast, Simon de Montfortit junior nga i biri i Henrikut III, pasi në vitin 1265 qenë mbytur përpjekjet e de Montfortit për t'i dhënë jetë një parlamenti të fortë. Po të shqyrtoni dokumentet, do të zbuloni sipas gjasës se de Montfortët ia kishin grabitur këtë pronë dikujt tjetër. Uindsorët zotërojnë një tjetër dukat, atë të Kornovaljes, i administruar nga princi Karl. Bëhet fjalë për një tjetër çiflig prej 44.000 akrash, që përfshin edhe ca ngastra në zonat më të shtrenjta të Londrës. Mbretëresha ka trashëguar, ose ka blerë, koleksionin më të madh privat të stolive, që ekzistonin në botë. Diamanti Koh-i-noor, asokohe më i madhi në botë, i që dhuruar mbretëreshës Viktoria, pasi Kompania e Indive Lindore kishte mundur maraxhanë e Punjabit në vitin 1851. Diamanti Kullimen ishte një peng paqeje dhuruar mbretërve britanikë pas luftës boere në Afrikën e Jugut, që ishte arkitektuar nga Sesil Rodi, Alfred Milneri, Rotshildët dhe Tavolina e Rrumbullakët. Të tjera dhurata kanë ardhur nga sheikë të naftës arabe dhe krerë të ndryshëm shtetesh. Më shumë se 7.000 piktura dhe 20.000 vizatime mjeshtrash të së kaluarës janë sot pjesë e Fondit

të koleksionit mbretëror, të kontrolluar nga mbretëresha. Ajo vetë zotëron një koleksion të madh veprash të tjera dhe, pas vdekjes së saj, e gjitha kjo do t'u kalojë trashëgimtarëve Uindsor, me kusht që njerëzit të mos zgjohen e t'i japin fund monarkisë.

Askush nuk e di me të vërtetë atë që zotërojnë Uindsorët, sepse në Parlament është e ndaluar edhe vetëm të diskutosh faktin që mbretëresha e mban të fshehtë madhësinë e pasurisë së saj[19]. Kjo fshehtësi është thelbësore për të shmangur indinjatën e "nënshtetasve" të saj dhe për t'i dhënë mundësi të përfitojë prej pozitës së vet për operacione *insider trading*, një praktikë e paligjshme. *Insider trading*-u parashikon që kush ka privilegjin të hyjë në informacione të rezervuara, t'i përdorë pastaj këto informacione për të kryer operacione finaciare me mjaft përfitim. Mbretëresha, me portofolin e saj kolosal të investimeve globale, është në pozicionin më të përshtatshëm për të realizuar përfitime të pakufishme. Ajo informohet në mënyrë të vazhdueshme nga kryeministrat, ministrat, funksionarët e lartë, shërbimet e fshehta dhe burime të tjera, për atë që ndodh në mënyrë të fshehtë në botë. Nëpërmjet këtyre dhe kanaleve të tjera ajo e di se ku mund të bëhen investimet më të mira e ato më të këqija dhe nëpërmjet rrjetit të saj sekret mund të bëjë të mundur që të përdoren sa më me përfitim ato informacione. Në vitin 1977 u zbulua se Banka e Anglisë, një krijesë e Fisnikërisë së Zezë, kishte krijuar një shoqëri të quajtur *Bank of England Nominees Ltd (BOEN)*, për të fshehur investimet e mbretëreshës[20]. Dinastia e Uindsorëve ka përfituar prej një marrëdhënieje veçanërisht fitimprurëse me *Sitin* e Londrës që nga mbretërimi i Eduardit VII, të birit të mbretëreshës Viktoria. Këshilltari kryesor financiar i Eduardit ishte Ernest Kasel, bankier i Fisnikërisë së Zezë. E bija dhe trashëgimtare e Kaselit, Edvina, do të martohej me Lordin Ljuis Mountbaten, ai që ushtroi ndikimin më të madh qoftë mbi princin Filip, qoftë mbi princin Karl. Edhe Eduardi VII, një mason i rangut të parë, ka qenë afër Rotshildëve, Saksonëve (një degëzim i fisit të Rotshildëve) dhe klonëve të familjeve amerikane Paisua-Rotshild, Morgan e Harriman. Të tjerë emra të financës së lartë me lidhje mbretërore të një kohe të gjatë janë Baringët dhe Morgan Grinfelli. Këshilltari finaciar global i Xhorxhit VI, të atit të mbretëreshës Elisabetë, ishte Sër Eduard Pikoku i *Barings Bank* dhe i Bankës së Anglisë. Mbreti i dha Pikokut Kryqin e Madh të Urdhërit viktorian mbretëror, gjë që tregon se këshillat e tij duhet të kenë qenë me të vërtetë fitimprurëse. Xhorxhi VI emëroi edhe Lord Kromerin si Lordin Çambelan të tij, rangu më i lartë i Oborrit Mbretëror. Kromeri ishte në të njëjtën kohë administrator i deleguar i *Barings Bank*.

Disa kërkues si Filip Beresfordi, autor i librit *The Book Of The British Rich*), thonë se mbretëresha Elisabetë investon tek shumëkombëshet më të mëdha si *Rio Tinto* (ish *Rio Tinto Zinc* ose RTZ), *Royal Dutch Shell, ICI* dhe *General Electric*. E gjitha kjo ka një kuptim, sepse këto janë shtyllat e Fisnikërisë së Zezë. Duket se mbretëresha ka bërë investime të qëndrueshme tek *Rio Tinto*, shoqëria më e madhe minerare në botë. Ajo u themelua në vitin 1873 nga Hug Metjusoni, kreu i operacionit të trafikut të drogës botërore të quajtur *Jardine Matheson*. Shoqëria *Rio Tinto* ka qenë në vijën e parë të shfrytëzimit të naftës së Detit të Veriut dhe, bashkë me shoqërinë *Texaco*, ka përdorur rafineritë e kompanisë *BP*, në të cilën thuhet se edhe mbretëresha ka investuar shuma të mëdha parash. Mbretëresha do të ketë realizuar kështu përfitime shumë të mëdha gjatë krejt operacionit, duke përfituar edhe prej informacioneve të rezervuara mbi potencialet e Detit të Veriut. Ndoshta konflikti i interesit më i dukshëm është për t'u kërkuar në përfshirjen e shoqërisë *Rio Tinto* në një kartel të formuar në vitin 1971 për të caktuar çmimin e uranit. Një juri e madhe federale dhe Komisioni mbi marrëdhëniet e jashtme të Senatit Amerikan i krijuar në vitin 1976 dhe i drejtuar nga Frenk Kurshi, zbuluan mashtrimin. Aty rezulton e përfshirë edhe një shoqëri australiane e quajtur *Mary Kathleen Uranium*. Kjo shoqëri i kishte nxitur fshehurazi vendasit australianë që të zinin trokat e pasura me uranium, në mënyrë që të kufizonin prodhimin e këtij minerali dhe të bënin të mundur kështu të ngrihej çmimi në tregun botëror[21]. Ky zvogëlim i sasisë së uranit i arkitektuar në këtë mënyrë pati pasoja serioze mbi shoqërinë amerikane *Westinghouse*, që u përpoq të ndërmerrte rrugët ligjore kundër shoqërisë *Rio Tinto*, e akuzuar se kishte manipuluar çmimet. Një gjykatë amerikane i urdhëroi administratotët e shoqërisë *Rio Tinto* t'u përgjigjeshin disa pyetjeve, por ky urdhër u shfuqizua nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë Britanike (Fisnikëria e Zezë dhe klonët e tyre). Qeveria australiane miratoi ca ligje që arritën të njëjtin efekt. Kjo ndodhi pasi kryeministri australian, Gug Vitlam, ishte shkarkuar nga detyra prej guvernatorit të përgjithshëm australian të mbretëreshës, Sër Xhon Kerrit. Vitlami ishte duke ndjekur një politikë që parashikonte blerjen e kartelëve minerarë dhe të lëndëve të para, si *Rio Tinto* dhe *Anglo-American*, për t'i penguar këto të fundit që të vazhdonin të grabitnin Australinë prej burimeve të saj, pa i dhënë asgjë në shkëmbim. Mbretëresha, falë shumave të mëdha të investuara në të dyja kompanitë, e hoqi Vitlamin, duke përdorur njërin prej "pushteteve vetëgjykimore" të shumta të saj, që mund t'u drejtohet sa herë ta shohë të nevojshme. Mbretëresha sot nuk ka pushtete? Merreni me mend! Pjesë e mashtrimit është pikërisht edhe ajo që t'i bësh njerëzit të besojnë se

mbretëresha nuk ka pushtete, duke i dhënë në të njëjtën kohë shumë pushtete. Sër Xhon Kerri, një ish agjent operativ i nivelit të lartë të shërbimeve të fshehta britanike, përveçse krahu i djathtë i Fisnikërisë së Zezë, u emërua anëtar i Këshillit të Kurorës dhe të Urdhërit Viktorian Mbretëror për besnikërinë dhe për shërbimet fitimprurëse të bëra ndaj portofolit të mbretëreshës. Për mandej u vra, kur e vërteta mbi heqjen e Gug Vitlamit rrezikonte të dilte në dritë[22].

Mbretëresha ka investime të shtrira në Amerikë dhe shumë prej këtyre janë të lidhura me themelimin e *Virginia Company* nga ana e Xhejmsit I dhe e Sër Frensis Bekonit, e cila lejoi që në fillim ndarjen e atyre tokave. Kurora britanike e zotëron ende Amerikën (sipas gjasës për llogari të Vatikanit) dhe, bashkë me Vëllazërinë londineze, mbretëresha gëzon një rentë të pabesueshme që i vjen nga lëndët e para dhe nga përfitime të tjera të akumuluara në territorin amerikan (*Virginia Company*). Në vitin 1966, dy deputetë amerikanë deklaruan në regjistrin e Kongresit se mbretëresha zotëronte një prej plantacioneve më të mëdha të botës në Skot të Misisipit, pranë kufirit me Arkansasin, të quajtur *Delta and Pine Company*. Në atë kohë vlente diçka si nja 44,5 milionë dollarë e, megjithatë, pronarja u jepte një shpërblim qesharak qindra punëtorëve të saj, që punonin në të zezë. Ndaluni një çast tek emri. Delta (trekëndësh, apo piramidë) është një simbol i rëndësishëm dhe pikërisht për këtë arsye njësia ushtarake e Elitës amerikane quhet *Delta Force*. Koleksioni pornografik i Bibliotekës së Kongresit është i njohur si Koleksioni Delta dhe delta, apo triada, gjendet në logot e qindra ndërmarrjeve amerikane, përfshirë kompaninë ajrore *Delta Airlines*. Nuk është një rastësi fakti që delta është edhe simboli i Kryemasones mbretërore. Prej këtej rrjedh edhe emri i organizatës kriminale kineze Triade (trekëndësh) dhe ai i grupit të Elitës i quajtur Komisioni Tripalësh. Adnan Kashogi, tregtar i famshëm armësh në nivel botëror, hapi një filial amerikan të shoqërisë së tij të quajtur *Triad America*. Kashogi, një i afërm i Fajedit, është ortak i Xhorxh Bushit, që është mik i ngushtë i mbretëreshës Elizabetë dhe i princit Filip. Që nga viti 1968, shoqëria *Delta and Pine* e mbretëreshës ka përfituar subvencionime qeveritare të barabarta me një vlerë prej 1,5 milionë dollarësh. Senatori MekIntiri tha në Kongres më 16 prill 1970 se qeveria i kishte "paguar mbretëreshës 120.000 dollarë me qëllim që të mos mbillte pambukun në tokat që zotëron në Misisipi"[23]. Revista *New Yorker* ka pohuar edhe që mbretëresha është pronarja më e madhe e zonave të degraduara të qytetit të Nju Jorkut dhe midis këtyre pronave figuron distrikti i teatrove, Rruga e Dyzetedytë[24]. Është e vërtetuar se ato që i mbajnë dhe i kontrollojnë financat botërore janë 3.000 deri 5.000 familje, por numri i njerëzve që e mbajnë me të vërtetë këtë kontroll është

LIBRI

shumë, shumë më i vogël: numërohen me të vërtetë me gishtat e një dore. Uindsorët i përkasin pa asnjë dyshim, ose sidoqoftë janë shumë afër, këtij rrethi të ngushtë. Ky kartel i Vëllazërisë kontrollon çdo sektor të rrjetit ekonomik global; bankat, kompanitë e sigurimit, lëndët e para, transportet, fabrikat, prodhimet e përfunduara, pjesën më të madhe të rishitësve (dhe, nëpërmjet manipulimit të çmimeve, gjithë pjesën tjetër), bursat dhe tregjet e lëndëve të para, qeveritë, mediat, shërbimet e fshehta, e kështu me radhë. E gjitha kjo është e koordinuar nëpërmjet shoqërive të fshehta dhe një prej mjeteve kryesore është organizata e krijuar nga *Siti* londinez e nga dinastia e Uindsorëve, e quajtur Klubi i Ishujve. Ajo që quajtur kështu në nderim të mbretit Eduardi VII, i biri i mbretëreshës Viktoria, që i pari mbajti titullin Princi i Ishujve. Sot me këtë titull zbukurohet princi Karl. Eduardi pati lidhje të ngushta me baronët e Fisnikërisë së Zezë të distriktit financiar të *Sitit* londinez dhe i ndihmoi të arkitektonin luftën e Krimesë, luftën ruso-japoneze, për të përgatitur Luftën e Parë Botërore dhe luftërat e opiumit kundër Kinës. Nga organizata qendrore e Klubit të Ishujve rrjedh rrjeti i jashtëzakonshëm i administratorëve që drejtojnë shoqëri në dukje "të pavarura" në një rrjet kontrolli e planesh të përbashkëta. Brenda këtij rrjeti figurojnë:

Banka e Anglisë; *Anglo-American Corp.* e Afrikës së Jugut; *Rio Tinto; Minorco Minerals and Resources Corp; De Beers Consolidated Mines and De Beers Centenary AG; N.M. Rothschild Bank; Barclays Bank; Lloyds Bank; Lloyds Insurance Market; Midland Bank; National Westminster Bank; Barings Bank; Schroders bank; Standard Chartered Bank; Hambros Bank; S.G. Warburg; Toronto Dominion Bank; Johnson Matthey; Klienwort Benson Group; Lazard Brothers; Lonrho; J.P. Morgan & Co.;* grupi *Morgan Grenfell; British Petroleum; Shell and Royal Dutch Petroleum; Cadbury-Schweppes; Bat Industries;* Sigurimet e Përgjithshme SpA të Venecies, në Itali; *Courtaulds; General Electric; Cazeenove & Co.; Gran Metropilitan; Hanson plc; HSBC Holdings (Hong Kong and Shngahai Bank); Imperial Chemical Industries; Inchscape plc; Inco Ltd;* grupi *ING; Jardine Matheson;* Kompania e lundrimit me avull gadishullore dhe lindore *(P&O); Pilkington Glass; Reuters Holdings; Glakso Wellcome; SmithKline Beecham; Unilever and Unilever NV; Vickers plc.*

Dhe lista mund të vazhdojë! Secila prej këtyre shoqërive ka lista të pabesueshme shoqërish ndihmëse që do të mbushnin shumë faqe. Vetëm kompania *Lonrho*, në çastin që po shkruaj, ka 640 shoqëri ndihmëse. Këto shoqëri, që e kanë qendrën në Londër, janë të lidhura me ato të pranishme

në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim, duke qenë se kartelët e Fisnikërisë së Zezë dhe të Uindsorëve kontrollojnë bankat e të gjithë botës dhe prodhimin botëror të mineraleve, energjisë dhe ushqimit. Njëra prej shoqërive të Fisnikërisë së Zezë të pranishme në Shtetet e Bashkuara është *Archer Daniels Midland*, e drejtuar nga anëtari i Bilderbergut Duajn Andreas, njëri prej financuesve kryesorë të politikanit amerikan thellësisht të korruptuar Bob Dolit, që gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 1996 "iu kundërvu" me të vërtetë dobët kundërshtarit Bill Klinton, që ishte zgjedhur nga Vëllazëria. Fisnikëria e Zezë e ka bërë *Sitin* e Londrës qendrën financiare botërore që nga koha kur arriti në masë në Britaninë e Madhe, si pasojë e Uilliam d'Oranzhit. Sot kjo qendër strehon më shumë se një të katërtën e volumit të afarizmit të jashtëm dhe në Bursën e Londrës janë kuotuar më shumë shoqëri të huaja se në çdo vend tjetër të botës. Nëntëdhjetë përqind e shkëmbimeve tregtare të kryqëzuara në Evropë kalojnë nëpërmjet *Sitit*, që është edhe emetuesi më i madh i *eurobond*-it. Tregjet kryesore të lëndëve të para e kanë qendrën këtu, si Tregu londinez i Metalit, Tregu ndërkombëtar i Naftës dhe Tregu londinez i Lëndëve të Para. *Siti* është qendra e tregut të sigurimeve dhe të risigurimeve ndërkombëtare në sektorin detar, ajror e tregtar. *Siti* kontrollon drejtimin financiar botëror të institucioneve të huaja dhe të qeverive dhe të gjitha këto organizata, që kanë në krye *Sitin*, kanë masonë në krye të tyre[25]. Më shumë se 500 banka të huaja kanë zyra në *Siti* dhe, në vitin 1993, bankave që kishin seli në Mbretërinë e Bashkuar u atribuohej 16 % e huave të dhëna në nivel botëror, një shifër tronditëse për këta ishuj të vegjël. Gërshetimet midis botës së bankave dhe asaj të shoqërive të ndryshme janë me të vërtetë të jashtëzakonshme. Këtu mund t'ju jap vetëm një pikë shembujsh, sa për të kuptuar se çfarë është duke ndodhur:

Sër Peter Ingram Walters: zëvendëspresident që nga viti 1992 i *HSBC Holdings* (*Hong Kong and Shangahai Bank*, bërthama qendrore e riciklimit të parave pista të nxjerra nga trafiqet e drogës); drejtor i *BP* (1973-90); president i *BP Chemicals* (1976-81); drejtor i *National Westminster Bank* (1981-89); drejtor i *Midland Bank* (1991-94); president i *Blue Circle Industries* (1990); drejtor i *London Business School* ((1981-91); drejtor i institutit nacional të çështjeve ekonomike e sociale (1981-90); drejtor i *SmithKline Beecham* (1989); drejtor i *Thorm EMI* (1989) dhe zëvendëspresident i saj (1990-).

Sër Martin Wakefield Jacomb: avokat pranë *Inner Temple* nga viti 1955 deri në vitin 1968; drejtor i Bankës së Anglisë (1986-95); drejtor i *Hudson's Bay Company* (1971-86); president i *Barclas de Zoete Wedd* (1986-91);

zëvendëspresident i *Barclas Bank* (1985); drejtor i gazetave të grupit *Telegraph* (1986-); drejtor i *Rio Tinto* (1991); president i *British Council* (1992).

Sër John Chipendale Keswick: drejtor i Bankës së Anglisë (1993-); president i *Hambros Bank* (1986-); drejtor i *Charter Consolidated*; drejtor i *De Beers* (1994-); drejtor i *Investment Trust* të Edinburgut; Trupat speciale të mbrojtjes së mbretëreshës për Skocinë; Kompania mbretërore e harkëtarëve.

Sër Christopher Anthony Hogg: drejtor i Bankës së Anglisë (1992-); president i *Courtaulds* (1980-94); president i *Reuters Holdings* (1985-); drejtor i *SmithKline Beecham* (1993-); Këshilli ndërkombëtar i *J.P. Morgan* (1988-); administrator i besuar i Fondacionit Ford (1987-).

Sër George Adrian Hayhurst Cadbury: drejtor i Bankës së Anglisë (1970-84); president, zëvendëspresident dhe administrator i deleguar i *Cadbury Schweppes* (1969-89); drejtori i *IBM* (1975-); ka bërë pjesë në Komitetin e blerjeve dhe shkrirjeve (1990-); president i Komisionit mbi aspektet e drejtimit të ndërmarrjes (1991-).

Lord Howe di Aberavon (Geoffrey Howe): drejtor i *Glaxo Wellcome* (1991-); anëtar i Këshillit të Kurorës dhe Ministër i Financave (1979-83); sekretar shteti për Punët e Jashtme dhe të *Commonwealth*-it (1983-89); zëvendëskryeministër (1989-90); drejtor i grupit *Sun Alliance and Insurance* (1974-79); drejtor i *BICC* (1991-); Fondi i investimit rus Framlington (1994); Këshilli ndërkombëtar i *J.P.Morgan*.

Lord William Rees-Mogg: drejtor i *General Electric* (1981-); drejtor i të përditshmes *Times* (1967-81); këshilltar administrate i gazetave të grupit *Times* (1968-81); president i *Sidgwick and Jackson* (1985-88); president i *Arts Council* (1982-88); president i *American Trading Company* (1992); president i *International Business Communications pcl* (1993-); drejtor i *J. Rothschild Investment Management* (1987-); drejtor i *St. James's Place Capital*; president i *Broadcasting Standards Council* (1988-93); drejtor i gazetave të grupit *Telegraph*.

Dhe, më në fund, ç'thoni për këtë kurrikulum prej Vëllazërie?

Lord Armstrong of Illminster: funksionar i Thesarit britanik (1950-64); ndihmës në ministrinë e Thesarit (1967-68); sekretar personal i ministrit të Financave (1954-55 dhe 1968); sekretari i parë personal i kryeministrit Eduard Heth (1970-75); nënsekretar shteti i përhershëm (1977-79); sekretar kabineti (1979-87); shef i funksionit publik kombëtar (1981-87); Fondacioni Trust (1975); drejtor i *Inchcape* (1988-); drejtor i *N.M. Rothschild* (1988-); drejtor i *Rio Tinto* (1988-); drejtor i *Shell* (1988-); drejtor i Operas mbretërore, *Covent Garden* (1988-)[26].

UBP 24

Përfytyroni pushtetin që ke mbi ngjarjet, kur kontrollon të gjitha këto shoqëri dhe qeveritë, që marrin vendime në gjendje për të ndikuar mbi këto shoqëri. Shtojini të gjithë kësaj kontrollin e mediave nëpërmjet kompanive si *BBC*, agjensisë së shtypit *Reuters*, *Hollinger Inc.*, *Thomson*, *News Corporation*, *Pearson*, *Reed Elsevier*, *Washington Post*, *New York Times*, *NBC*, *CBS*, *ABC* etj. etj... dhe ja ku e keni kontrollin e botës. Për më tepër, njerëzit nuk e dinë atë që është duke ndodhur dhe kështu që ju mund të vazhdoni në pafundësi, pa rrezik se mund të zbuloheni.

Njëra prej bankave pranë mbretëreshës është *Hambros plc*, një fortesë e Fisnikërisë së Zezë, që e ka selinë pranë Tuer Hillit, në Londër. Xhozef Hambro ishte bankier i mbretërve të Danimarkës, të Norvegjisë e të Suedisë dhe bëri shumë afarizëm me Rotshildët. I biri, Karl Hoakim Hambro, u transferua nga Kopenhageni në Londër në vitin 1839 dhe, katër vjet më pas, Parlamenti miratoi një ligj për ta shndërruar bankën *Hambros* në një bankë "britanike". Ashtu si Rotshildët, familja Hambros e vuri pjesën më të madhe të pasurisë së saj duke financuar luftërat dhe, prapë edhe njëherë ashtu si Rotshildët, përfshihet gjithmonë e më shumë në shërbimet e fshehta britanike. Xh.H. "Xhek" Hambro, presidenti i bankës që nga viti 1933, drejtoi "Corp"-in e Mbretërisë së Bashkuar, operacionin e luftës ekonomike të shërbimeve sekrete britanike gjatë Luftës së Parë Botërore. I biri, Sër Çarls Hambro, ishte drejtor i grupit elitar Operacione Ekzekutive Speciale (SOE), që formoi shoqërinë tani të njohur si *Hollinger Inc.*, gjigantin e mediave të kryesuar nga Konrad Blejku, i biri i një agjenti të SOE-s, që kontribuoi për ta organizuar. I biri i Sër Çarls Hambros, Lordi Hambro, tani është në krye të ndërmarrjes. Në kurrikulumin e tij figuron edhe *Guardian Royal Exchange Insurance* (president); Kompania e lundrimit me avull gadishullore dhe lindore, kompania që drejtonte trafikun e drogës gjatë luftërave të opiumit, sot e njohur si *P&O* (drejtor); *San Paolo Bank Holdings* (drejtor); dhe Partia Konservatore (shef i financave). Midis drejtorëve të *Hambros* bëjnë pjesë edhe Lordi Halifaks e Xhon Kleji, një drejtor i grupit gazetaresk *Guardian*, që thotë se është kundër *establishment*-it, kur në realitet është pjesë e intrigës. Ndërmjet drejtorëve të *Hambros* në detyrë gjatë viteve shtatëdhjetë figuron Lord Karringtoni, njeri shumë afër Henri Kisingerit dhe president i Grupit Bilderberg nga viti 1991. Dhe ndodhi pikërisht gjatë viteve shtatëdhjetë që *Hambros* bleu një pjesë të madhe të aksioneve të një banke të quajtur Bankë Private, e cila rezultoi pastaj e përfshirë në skandalin e Masonerisë P2 dhe rezultoi e lidhur me bankën në qendër të skandalit, Bankën Ambroziane. Koordinatori i këtij mashtrimi ishte Mikele Sindona, aksionisti më i madh i Bankës Private dhe

një tjetër prej shoqërive të tij financiare, Shoqëria Financiare Qendrore, kishte në përbërje të këshillit të saj administrativ Zhoslin Hambron dhe Evelin de Rotshildin. Rrjeti financiar i Sindonës financonte P2-në dhe thante Vatikanin me shuma shumë të mëdha parash. Nga ana e saj, P2-ja financonte e organizonte terrorizmin në Itali, përfshirë atentatin ku mbetën të vrarë 85 persona në stacionin e Bolonjës. Pas demaskimit të P2-së, pasoi vrasja, në stil të pastër masonik, e kreut të Bankës Ambroziane, Robert Kalvit, nën urën e Blejkfriarsit në Londër, jo larg qendrës financiare. Që bast se banda e Hambros ka marrë frymë e lehtësuar, kur ka mësuar se Kalvi nuk mundej më të fliste. Sindona më pas tha se vrasja ishte organizuar nga masonët amerikanojugorë. Çdo seksion i organizatës ngarkon një tjetër seksion për të kryer disa vrasje, në mënyrë që pastaj të jetë më e vështirë të zbulohet e vërteta. Shoqëria *Hambros*, si të gjitha të tjerat, qelbet aq shumë, sa që për ta mbuluar atë erë do të duhej krejt deodoranti i botës. Por mbajeni rezervë deodorantin tuaj më të mirë për mbretëreshën dhe për dinastinë e Uindsorëve. Këta të fundit janë të lidhur me të gjithë kriminelët më të shquar që janë duke grabitur planetin, duke mbjellë vdekje, shkatërrim e mjerim në të gjithë botën. Dhe të jetë e qartë kjo: nëse jeni britanikë, edhe ju jeni duke i paguar ata kriminelë, që kjo të ndodhë! Uindsorët natyrisht janë pjesë e të gjithë kësaj intrige dhe imazhi i tyre publik është një fasadë fund e krye, që fsheh pusin e zi, nga i cili veprojnë prapa kuintave. Ky kontroll që nga Londra derdhet në pjesën tjetër të botës, ku familjet e Elitës qeverisin në përputhje me Urdhërin zvarranik të Ditës.

Pushteti i Uindsorëve

Familja mbretërore britanike ka qenë gjithmonë pranë Masonerisë dhe urdhërat e lidhura me të, si Kalorësit e Zharrëtierës, Urdhëri i Kardit e Urdhëri mbretëror viktorian, gërshetohen me organizatat masonike. Kjo, natyrisht, vlen edhe për Urdhërin e Shën Gjonit të Jeruzalemit (Kalorësit e Maltës). Përhapja e Masonerisë në Angli në shekullin XVIII përkoi me ardhjen e dinastisë gjermane të Hanovërve. Mjeshtri i Madh aktual i Lozhës së Madhe angleze në Gret Kuin (Semiramidë/Isidë) Strit të Londrës është kushëriri i mbretëreshës, duka i Kentit. Princi Filip hyri në Lozhën detare me numër 2612 më 5 dhjetor 1952[27]. Vjehrri i tij, Xhorxhi VI, i ati i mbretëreshës dhe i shoqi i nënës mbretëreshë, ishte një mason i vendosur[28], sikurse kanë qenë edhe Eduardi VII dhe pjesa më e madhe e sovranëve të tjerë që nga lindja e Masonerisë. Mbretëresha është "Padrona e Madhe" e Masonerisë. Ajo shërbehet nga 390 anëtarë të të ashtuquajturit Këshill i Kurorës, i cili ka

marrëdhënie me të barasvlerëshmit e tij në të tjera vende të *Commonwealth*-it. Ligjërisht ai Këshill qëndron mbi Parlamentin, fortesë e pushteteve të saj vetëgjykimore. Midis anëtarëve të këtij Këshilli të Kurorës, që janë të emëruar të përjetshëm, figurojnë princi Filip, princi Karl, argjipeshkëvi i Kantërberrit dhe kryeministri. Këshilli i Kurorës mblidhet zyrtarisht nëntë herë në vit dhe ministrat e qeverisë qëndrojnë gatitur teksa mbretëreshës i raportohen masat qeveritare, që do të miratojë. Ky Këshill i Kurorës, i përbërë nga politikanë, oborrtarë dhe funksionarë publikë që i përkasin një rrethi të ngushtë, duhet të përkulet përpara mbretëreshës dhe t`i shtrëngojë dorën para se të vihet në rresht e të betohet për t`i kryer punët e veta në fshehtësinë më të madhe[29].

Një tjetër instrument manipulimi global i përdorur nga Uindsorët dhe nga Fisnikëria e Zezë përfaqësohet nga Agjentët e Kurorës. Kjo organizatë u krijua në vitin 1833 si "Agjentët e Kurorës për Kolonitë", për të drejtuar administrimin e përditshëm në territoret e Perandorisë dhe si grup bankierësh në shërbim të funksionarëve të qeverisë, të autoriteteve koloniale dhe të krerëve të shtetit. Ajo parashikon edhe furnizimin me shumë mallra, midis të cilave armë. Duke patur parasysh metodat dhe rastet e mëparshme të Perandorisë Britanike, do të jetë përfshirë me siguri në tregtinë e drogës. Agjentët e Kurorës janë të përfshirë prej një kohe të gjatë në krimin e organizuar dhe furnizojnë fshehurazi Afrikën me armë, që përdoren pastaj në luftëra, të cilat janë genocide të vërteta[30]. Ajo ishte, dhe është ende, një Agjensi e Kurorës, që punon për sovranin e, megjithatë, borxhi i saj i brendshëm është i garantuar nga qeveria britanike. Në vitet shtatëdhjetë të shekullit XX u ndihmua nga Banka e Anglisë, një operacion që kushtoi qindra milionë stërlina. Për shumë vite ajo ka administruar pasurinë personale të sulltanit të Brunejit, mik i mbretëreshës dhe financues i shumë projekteve private të princit Filip, të princit Karl dhe të Xhorxh Bushit. Sulltani financon edhe organizata jo zyrtare të shërbimeve sekrete britanike e amerikane[31], përveçse ka financuar ndërmarrjen e Mohamed Al Fajedit, të atit të Dodit. Agjensia Agjentët e Kurorës u "privatizua" në vitin 1996 me emrin Agjentët e Kurorës për Qeverinë dhe për Administratat e Përtejdetit s.r.l. Të "privatizosh", në gjuhën e Vëllazërisë do të thotë t`i transferosh pushtetet nga një agjensi qeveritare të formuar nga Fisnikëria e Zezë tek pronarë të veçantë, gjithmonë anëtarë të Fisnikërisë së Zezë. Agjentët e rinj të Kurorës bëjnë punën e shoqërisë kontrolluese të një liste të gjatë shoqërish e ndërmarrjesh dhe vazhdojnë ende të jenë një hallkë esenciale në rrjetin botëror. Presidenti i tyre, David H. Probert, është ish drejtori i fabrikës britanike të armëve, *Birmingham Small Arms Ltd*, dhe një tjetër drejtor është F. Kaseli (prapë ky emër), Shok i Urdhërit Bath

(një titull i dhënë nga mbretëresha) dhe ish drejtor ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe i Bankës Botërore për Britaninë e Madhe. Fondacioni Agjentë të Kurorës, që mban administrimin e besuar të kapitalit aksionar, kryesohet nga Sër David Rou-Ham, Kalorës i Kryqit të Madh të Perandorisë Britanike. Ky fondacion përfshin *Barclays Bank*, *Standard and Chartered Bank*, *Unilever*, *Tate and Lyle*, *Securicor* (një shumëkombëshe për "shërbime sigurimi"), *British Telecom*, *Prince of Wales Business Forum* (e kryesuar nga princi Karl) dhe Fondacionin Aga Khan. Gjithmonë e njëjta klikë. Agjentët e kurorës drejtojnë shërbimet doganore për Mozambikun dhe, nëpërmjet një shoqërie të quajtur *Europe SA*, janë ngarkuar të administrojnë fondet e caktuara për rindërtimin e Bosnjes... po, Bosnjes. Rezultojnë të përfshirë në një iniciativë sipërmarrëse të lidhur me një shoqëri që e ka selinë në Mynih, *ES-KO*, që prodhon të gjithë ushqimin e destinuar për forcat e paqes të Kombeve të Bashkuara në Angolë e në Bosnje[32]. Kështu që, sa më shumë luftëra të shpërthejnë, aq më shumë para mund të grumbullojnë Agjentët e Kurorës.

Një rol të rëndësishëm brenda thurjes ndërmjet Uindsorëve, Fisnikërisë së Zezë dhe *Sitit* të Londrës e luajnë të ashtuquajturat "shoqata profesionale të *Sitit*". Këto thonë se përfaqësojnë sektorët e ndryshëm industrialë, si fabrikantët e armëve, tipografët dhe tregtuesit e artikujve të kartolerisë, argjendarët e të tjerë. Në realitet bëhet fjalë për shoqëri të fshehta, që janë esenciale për kontrollin e institucioneve të *Sitit* dhe të shumë vendeve të tjera. Në vitet pesëdhjetë të shekullit XIV, si pasojë e murtajës e njohur si Vdekja e Zezë, qeverisja e *Sitit* kaloi nga kështillat e lagjes tek Shoqatat Profesionale të *Sitit*. Tempullarët ishin ende tepër aktivë prapa kuintave dhe pushteti i tyre dukej i përqëndruar në Gildën e Masonëve. Kjo organizatë numëron degëzime të ndryshme rreth e rrotull botës. Në vitin 1979, vit kur Margaret Theçeri u bë kryeministre, Kompania e Nderuar e Qytetarëve të Londrës në Amerikën e Veriut filloi të mblidhej në Nju Jork e në Toronto dhe, më 21 tetor 1991, u themelua Shoqata e Amëtarëve të Esnafëve të Qyetit të Londrës në Hong Kong dhe duket se të gjithë anëtarët e saj ishin arkitektë (masonë)[33]. Studiuesi, sot i vdekur, Piter Xhons në vitet nëntëdhjetë ka kryer kërkime mbi disa prej shoqatave profesionale për librin e tij *The Obedience Of Australia*, duke hedhur dritë mbi manipulimin që e shtyri mbretëreshën ta shkarkonte Gug Vitlamin nga detyra e tij e kryeministrit australian. Këta janë disa prej emrave që zbuloi në përbërje të atyre "shoqatave":

Inxhinierë: duka i Edinburgut.
Pilotë ajrorë dhe lundrues: duka i Edinburgut, princi Andrea.

LIBRI 24

Kasapë: nëna mbretëreshë, Lord Vesteji (i familjes së kasapëve, përveçse Lord i Parë i Urdhërit të Shën Gjonit të Jeruzalemit).

Tregtarë tekstilesh: Nëna mbretëreshë, Lord Vitelau (satanist i supozuar dhe ish zëvendëskryeministër i Margaret Theçerit), Lord Hailshami.

Punues dorezash: Margaret Theçer, dukesha e Devonshirit (Chatsworth House).

Peshqshitës: duka i Devonshirit (Chatsworth House), C.E.A Hambro (*Hambros Bank*, *Taylor Woodrow*, *P&O*), Lordi Inshkap (*Inchcape pcl*, *P&O*. Nëntoger londinez i madhërisë së saj).

Argjendarë: XH.H. Hambro.

Bakallë: Eduard Hethi (satanist dhe ish kryeministër britanik, grupi Bilderberg dhe ithtar i futjes së Britanisë së Madhe në komunitetit Evropian).

Prodhues kripe: duka i Kentit (Mjeshtër i Madh i Masonerisë angleze), Lordi Armstrong (njeriu që mbuloi listën e gjatë të detyrave brenda qeverisë dhe ndërmarrjeve të ndryshme, mbi të cilin u ndala më lart).

Industrialiastë tekstilesh: Sër Piter Gadsden (Mjeshtër i Madh pranë Lozhës së Madhe të Bashkuar), Lordi Karrington (president i Grupit Bilderberg, president i Institutit Mbretëror për Çështjet Ndërkombëtare dhe njëri prej agjentëve operativë kryesorë të Vëllazërisë).

Një tjetër emër që përsëritet në shumë prej këtyre shoqatave profesionale është MekAlpini, familja e ndërtuesve, me prirje sataniste. Të gjitha këto familje kanë lidhje me organizatat masonike. Ka më shumë masonë për metra katrorë në qendrën financiare të *Sitit* londinez se në cilindo vend tjetër të planetit Tokë. Banka e Anglisë ka lozhën e vet masone (Lozha nr. 263), sikurse e kanë edhe bankat e tjera si *Lloyds* (Lozhën e Kalit të Zi të Lombard Stritit, me Nr. 4155); është pastaj Lozha elitare e Bashkisë, që e ka selinë pranë Mension Hauzit që nga viti 1905. Mension Hauzi është rezidenca zyrtare e Lordit (mason) kryetar bashkie i Londrës dhe më shumë se 60 kryetarë bashkie kanë qenë Mjeshtra të Lozhës[34]. Mendoni për simbolin e *Lloyds*-ve, kalin e zi (diell i zi) të Lozhës së Lombard Stritit. Lombardia ka qenë një feud financiar i venecianë/fenikasve të Fisnikërisë së Zezë.

Uindsorët janë pjesë e këtij rrjeti zvarranik manipuluesish politikë e financiarë, satanistë e flijues fëmijësh. Në shkallë ndërkombëtare. Rrjeti numëron midis anëtarëve të tij, nëpërmjet shoqërive të fshehta të pafundme, më të spikaturit ndërmjet gjykatësve, funksionarëve të policisë, politikanëve, afaristëve, drejtuesve publikë, pronarëve të mjeteve të informacionit dhe drejtorëve të gazetave. Nën këta mbretër e gjeneralë të rrjetit qëndrojnë

rreshterët dhe këmbësorët, që nuk kanë as idenë më të vogël të rëndësisë së planeve, në të cilat rezultojnë të përfshirë. Kjo organizatë përzgjedh kryeministrat, duke manipuluar të gjitha partitë politike dhe emëron funksionarët kryesorë të qeverisë. Organizatat e Fisnikërisë së Zezë bëjnë të njëjtën gjë në vende të tjera, përfshirë Shtetet e Bashkuara, madje sidomos aty.

Miqtë e Uindsorëve

Mund të kuptosh shumë për sjelljet dhe për motivacionet e njeriut mbi bazën e miqve që e rrethojnë dhe të atyre që vendosin ta "nderojnë". Është e rrallë që mbretëresha t`ua japë titullin e kalorësit njerëzve që nuk janë pjesë e *Commonwealth*-it dhe lista e atyre që ka vendosur t`i stolisë me titullin "Kalorës Nderi" duket sikur i referohet një mbledhjeje pune midis agjentëve të Vëllazërisë. Titujt quhen "nderi", pasi kushtetuta amerikane e ndalon pranimin e titujve të dhënë nga sovrani i një shteti të huaj pa lejen e Kongresit. Të pakët janë sidoqoftë titujt e nderit të këtij tipi që jepen, sepse siç ka thënë një funksionar i qeverisë britanike: "Nuk duhet zhvleftësuar monedha"[35]. Kushedi nëse edhe ju mendoni se emrat që vijojnë e zhvleftësojnë monedhën: Henri Kisinger, satanist, vrasësh fëmijësh dhe vrasës i shumëfishtë, i është dhënë titulli Kalorës Komandant i Urdhërit të Shën Mikelit dhe Urdhërit të Shën Xhorxhit gjatë një ceremonie të mbajtur në kështjellën Uindsor. Ky titull normalisht u jepet diplomatëve të lartë britanikë dhe kjo nuk të çudit, duke qenë se Kisingeri u ka shërbyer gjithmonë interesave të Fisnikërisë së Zezë londineze. Kjo ka ndodhur edhe atëherë kur, si sekretar i shtetit amerikan dhe këshilltar kombëtar i sigurisë, manipuloi çështjen Uotergejt, për të hequr Riçard Niksonin e për ta zëvendësuar më pedofilin e përdhunuesin Xherald Ford dhe zëvendësin e tij Nelson Rokfeler. "Shërbëtorit servil" të Kisingerit, Brent Skoukroftit, drejtues i *Kissinger Associates* dhe midis më të besuarve këshilltarë të Xhorxh Bushit, i është dhënë titulli Kalorës Nderi i Perandorisë Britanike nga mbretëresha. E njëjta gjë i ka ndodhur Kasper Uinbergerit, një tjetër klon i Bushit, i cili ka qenë i përfshirë në skandalin Iran-*Contras*, ku u shkëmbye drogë kundrejt armësh. Vetë Xhorxh Bushi, pedofil, foshnjëvrasës, vrasës i shumëfishtë dhe satanist, është shumë mik i Uindsorëve. Mbretëresha e ka emëruar Kalorës Nderi i Kryqit të Madh të Urdhërit Bath, sikurse bëri edhe me atë kukullën e Vëllazërisë, përveçse përdhunues fëmijësh me mendje të kontrolluar, që i përgjigjet emrit Ronald Regan, dhe që është nga ana e vet një produkt i kontrollit mendor. Ky është titulli më i lartë që mbretëresha u jep atyre që nuk janë qytetarë të një vendi të *Commonwealth*-it. Urdhëri Bath

LIBRI 24

duket si një titull prej budallai ("bath" do të thotë edhe "banjë"), për atë që nuk merr vesh nga simbolizmi. Banja rigjeneruese e alkimisë simbolizon rilindjen dhe pastrimin. "Kalorësit e Urdhërit Bath" duhet të bëjnë një banjë para se të kryejnë veprime të llahtarshme dhe prej këtej rrjedh shprehja "banjë gjaku"[36]. Xhorxh Bushi dhe mbretëresha merren vesh aq mirë, sepse që të dy janë me gjak "mbretëror" evropian e zvarranik. Që të dy janë në gjendje që të ndryshojnë formë. Xhorxhi dhe e shoqja, Barbara Pirs Bushi, rrjedhin nga e njëjta familje angleze e Pirsëve, ashtu sikurse presidenti amerikan Franklin Pirs. Familja e Pirsëve është në fakt familja e fuqishme aristokrate e Persëve, e cila e ndryshoi emrin e vet në Pirs dhe emigroi në Amerikë, sapo u zbulua përfshirja e saj në dështimin e komplotit të barutit, që u përpoq të hidhte në erë Parlamentin. Njëra prej kështjellave të Persëve, ku u thur ky plan, quhej Sion Hauz[37]. Edhe pema gjenealogjike e Bushit mund të zërë fill tek mbreti anglez Alfredi i Madh dhe tek Karli i Madh, sovrani i famshëm, që në Francën e shekullit të tetë e të nëntë çoi përpara planin e Vëllazërisë. Rrjedhin po nga këta paraardhës 32 presidentë të tjerë të Shteteve të Bashkuara, që janë kështu të gjithë në farefisni me Bushin[39]. Mbretëresha i ishte me të vërtetë mirënjohëse Bushit dhe të tjerë miqve, që përdorën manipulimin për të "fituar" luftën e Gjirit. Komandanti ushtarak Norman "Furi" Shvarckopfi, që ka gënjyer paturpësisht rreth çështjes së sindromës së luftës së Gjirit, dhe Kolin Pauelli, shef i shtabit të përgjithshëm, u dekoruan që të dy nga madhëria e saj, mbretëresha hirplotë, me titullin e Kalorësit të Nderit të Perandorisë Britanike. Duglas Feirbenks, aktor dhe instrument në duart e ushtarakëve britanikë e amerikanë, ishte adjutant personal i satanistit dhe fashistit Lordit Mountbaten dhe u shpërblye me një sërë titujsh kalorsiakë, përfshirë atë të Kalorësit të Perandorisë Britanike.

Një tjetër emër që del është ai i Pol Melonit, mik i ngushtë i mbretëreshës, që e emëroi Kalorës Nderi të Perandorisë Britanike. Krahu hollandez i Fisnikërisë së Zezë, nëpërmjet mikut të princ Filipit, oficerit të SS-ve, princit Bernhard, e emëroi Melonin Kalorës të Urdhërit të Oranzh Nasaut. Titulli është në nderim të Uilliam d'Oranzhit dhe të shoqërisë së fshehtë Urdhëri i Oranzhit. Pol Meloni është një figurë qendrore për kontrollin anglez mbi Shtetet e Bashkuara, i ushtruar nga një numër tjetër i pabesueshëm familjesh, ndërmjet të cilave Rokfelerët, Harrimanët, Bushët, Kenedët dhe Morganët, që e kanë qendrën në Nju Jork, në Virxhinia (Uashington) dhe në Boston. Ja pse kjo organizatë është e njohur si *Establishment*-i Lindor. Miqësia ndërmjet Melonëve dhe Uindsorëve i përket një periudhe shumë kohe më parë. E ëma e Polit ishte një trashëgimtare e pasurisë Guines dhe i ati, Andrju Melon, u

bë këshilltar i Uindsorëve, teksa mbulonte detyrën e ambasadorit amerikan në Londër ("Oborri i Shën Xhejmsit") në vitet 1932 e 1933. E zëvendësoi një tjetër mashtrues i Vëllazërisë, Xhozef Kenedi, i ati i Xhon F. Kenedit. Meloni ka qenë tri herë ministër i Thesarit i Shteteve të Bashkuara nën presidentët Harding, Kulidxh e Huver, dhe përfaqësoi interesat e Fisnikërisë së Zezë. Ishte ai që financoi krijimin e kartelit të aluminit i njohur si *ALCOA*, për të kontrolluar çmimin dhe furnizimin e aluminit, në të njëjtën mënyrë me të cilën Vëllazëria ka bërë me naftën, me arin, me diamantet, me drogën e kështu me radhë. Ishin Meloni dhe *ALCOA* ata që i shtuan fluorin ujit, për të realizuar fitime nga një nënprodhim i aluminit, që në atë kohë bëheshin përpjekje për ta eleminuar. Nuk ka të bëjë aspak me shëndetin e dhëmbëve. Fluori qe përdorur në fakt për 40 vjet si helm për minjtë dhe vepron drejtpërdrejt mbi mendjen. Andrju Meloni ka financuar themelimin e shoqërisë *Gulf Oil*, që ka bashkëpunuar me *British Petroleum* (ish *Anglo-Persian*). Njëri prej operacioneve të tyre ka qenë grushti i shtetit kundër kryeministrit iranian, doktor Mohamed Mosadegut, në vitin 1953. Mosadegu donte t'i jepte fund shfrytëzimit të vendit të vet, por Elita anglo-amerikane komplotoi kundër tij dhe i diktoi popullit iranian regjimin e turpshëm e kriminal të shahut iranian. Njëri prej personave të përfshirë në grushtin e shtetit ishte Norman Shvarckopfi plaku, i ati i komandantit të luftës së Gjirit, aq shumë i nderuar nga mbretëresha. Andrju Meloni ka qenë frymëzues edhe i Planeve Dawes e Young, që financuan makinën naziste të luftës dhe shkaktuan kolapsin ekonomik, i cili çoi në ngjitjen në pushtet të Adolf Hitlerit në Gjermani. I biri i Andrju Melonit, Pol Meloni, qe rritur në Angli, por u kthye në Shtetet e Bashkuara, për të frekuentuar Universitetin e Jalës, qendër e Shoqërisë së Kafkës dhe e Kockave. S'e pranoi teserën e kësaj shoqërie, por hyri përkundrazi të bënte pjesë në sektin e Kartushit dhe të Çelësit, që ishte një tjetër filial i Vëllazërisë. Pas Jalës u kthye në Angli, për të studiuar në Universitetin e Kembridxhit, i frekuentuar nga shumë agjentë të ardhshëm operativë të shërbimeve të fshehta britanike. Prindërit e tij u ndanë dhe ai u shpërngul me të ëmën në Virxhinia, nja dyzet kilometra larg Uashingtonit. Kjo zonë ka qenë për një kohë të gjatë e zënë nga përfaqësuesit amerikanë të Fisnikërisë së Zezë, si Harrimanët. Mbretëresha dhe princi Filip kanë shkuar shpesh ta takojnë Pol Melonin në çifligun e tij të Rokbisë, në Virxhinia, sikurse edhe princi Karl dhe princesha Ana[40].

Princi Filip shkoi tek Meloni për të financuar fondacionin *World Wildlife Fund*. Ja çfarë i ka thënë në Bukingam Palas hetuesit të *Executive Intelligence Review*, Skot Tompsonit:

"Kam qenë i ngarkuar nga mbretëresha për ta falënderuar për letrën e tij... Mr. Pol Melonin. Mbretëresha e njeh Melonin prej vitesh dhe e ka vizituar çifligun e tij në Upervil, në Virxhinia, për herë të parë ndoshta në vitet Pesëdhjetë"[41].

Mbretëresha ndiqte gjurmët e ungjit të saj, përkrahësit të pafat të nazizmit, Eduardit VIII, dukë i Uindsorit, që abdikoi në vitin 1936 për t'u martuar me Uolls Simpsonin. E motra e Melonit, Ailsa, bënte pjesë në rrethin e ngushtë të miqve të dukës në Virxhinia.

Një tjetër prej miqve të ngushtë të mbretëreshës dhe të Melonëve është Uilliam Farish III. Mbretëresha mban disa prej pelave të saj për riprodhim pranë fermës së tij të Lane's End-it, afër Versajës, në Konektikat, ku shkon zakonisht. Edhe Pol Meloni shkon shpesh aty me aeroplanin e tij privat. Uilliam Farish III është një mik i ngushtë i mikut të mbretëreshës, Xhorxh Bushit. Farishi del në skenë teksa ushtronte funksionin e përgjegjësit të *"blind trust"*-it të Bushit, sistemit sipas të cilit presidentët nuk duhet të dinë se ku investohen paratë e tyre teksa janë në detyrë. Krejt e kundërta e mbretëreshës! Por natyrisht që është e gjitha një farsë dhe Bushi ka bërë një pasuri të tërë falë investimeve në periudhën kur ishte në detyrë, në të njëjtën mënyrë si mbretëresha. Gjyshi i Farishit, Uilliam Farish plaku, ishte president i *Standard Oil* të Rokfelerëve, në Nju Xhersi, gjatë Luftës së Dytë Botërore, teksa furnizonte me naftë e me *know-how* teknologjik nazistët dhe gjigantin e tyre kimik, *I.G. Farben*, që drejtonte kampin e përqëndrimit të Aushvicit. Në realitet *Standard Oil*-i dhe *I.G. Farben*-i ishin në thelb e njëjta shoqëri. Kudo që të vështroni, duket sikur Uindsorët nuk arrijnë dot t'i shmangin nazistët, simpatizantët dhe përkrahësit e nazistëve.

Genocidi i Uindsorëve

Aleancat e panumërta dhe intrigat anglo-hollandeze nuk kanë të bëjnë, në realitet, fare me popullin britanik e atë hollandez. Kur do t'i hapim më në fund sytë, do të reshtim së ulërituri: "Janë anglezët", "Janë hollandezët", "Janë amerikanët", "Janë gjermanët", "Janë francezët", "Janë të bardhët", "Janë zezakët", "Janë hebrejtë" apo, edhe, "Janë zvarranikët". Nuk janë këta popuj ata që janë përfshirë, por vetëm disa familje e fraksione brenda tyre. Ta kapësh me një racë, me një komb, apo me një besim fetar, është pikë për pikë ajo që dëshiron të na shtyjë të bëjmë Vëllazëria, sepse nëse popullsia do të jetë e ndarë brenda saj, do të bëhet e përçarë, grindëse dhe e ndarë në fraksione kundërshtare. Përça e sundo. Manipulimi realizohet nga një rrjet familjesh dhe nga "shërbëtorët servilë" të tyre, që veprojnë në të gjitha këto

LIBRI 24

vende e grupe, teksa e mbajnë popullsinë në një gjendje padije. Bashkëpunimi i ngushtë midis "Britanisë së Madhe" dhe "Vendeve të Ulëta" të shpie drejtpërdrejt tek krahu britanik dhe ai hollandez i Fisnikërisë së Zezë. Kjo është e dukshme në rastin e princit Filip, bashkëshort i mbretëreshës së Anglisë, dhe të princit Bernhard, bashkëshort i mbretëreshës Julia të Vendeve të Ulëta, që pastaj abdikoi në favor të së bijës Beatriçe. Filipi dhe Bernhardi rrjedhin nga e njëjta familje zvarranike dhe bëjnë pjesë që të dy në të njëjtën ideologji naziste. Filipi dhe familja e tij kanë lidhje të shumëfishta me nazizmin dhe Bernhardi ka qenë pjesëtar i SS-ve, skuadrat vrasëse të Himlerit. Lindi në Gjermani në vitin 1912 dhe u martua me kushërirën e princeshës Viktoria të Hohenzolernit, motër e Kaizerit Vilhelm. U rekretua nga shërbimet sekrete naziste në Universitetin e Berlinit në vitin 1934 dhe punoi për SS-të brenda kompanisë *I.G. Farben*, gjigantit kimik të lidhur ngushtë me *Standard Oil*-in e Rokfeler/Farishit dhe me shoqëritë angleze si *ICI*. Origjinat e Bernhardit shkaktuan reagime skandalizuese në Vendet e Ulëta, kur ai u martua me mbretëreshën Julia të dinastisë së turpshme të Oranzhëve, për t'u bërë i barasvlershëm me mikun e tij të zemrës, princin Filip. Bernhardi kontribuoi për të krijuar Grupin Bilderberg, që u mblodh zyrtarisht për herë të parë në vitin 1954 dhe, në vitin 1961, bashkëthemeloi, bashkë me Filipin, fondacionin *World Wildlife Fund* (sot *World Wide Fund For Nature*), i subvecionuar pjesërisht nga Melonët.

Le të qartësojmë menjëherë një gjë. *World Wide Fund For Nature* (WWF) nuk u krijua për të shpëtuar speciet në rrugën e zhdukjes. Ndërmarrjet e tij në atë fushë janë mjaft të frikshme, sikurse ka zbuluar një raport në vitin 1989, i papublikuar aspak, i një profesori të Oksfordit me emrin Xhon Filipson[42]. Disa muaj përpara se të themelohej WWF-ja, Filipsoni mori pjesë bashkë me mbretëreshën në një turne mbretëror të Indisë. Programi i këtij turneu parashikonte edhe një gjah tigrash, gjatë të cilit tigri ndillet nga dhi të lidhura, për t'u vrarë pastaj nga Filipi, "ambientalisti"[43]. Kur kjo histori u mor vesh nga publiku dhe fotografia e Filipit në këmbë përsipër tigrit doli nëpër gazeta, shkaktoi shumë bujë. Gjatë të njëjtit turne, këtë herë në Katmandu, Filipi mori pjesë në një gjah bashkë me Alek Duglas Homin (Lordi Hom), kryeministri konservator, president i Grupit Bilderberg dhe në farefisni me familjet skoceze të Vëllazërisë. Ian MekFaili, drejtori i parë ndërkombëtar i fondacionit WWF, i ka thënë një trupe televizive se një elefante dhe këlyshi i saj ishin marrë në nishan. Filipi i shtiu së ëmës dhe këlyshi ia mbathi me të katra i terrorizuar. MekFaili tha se kishte kontribuar për ta fshehur këtë episod, sepse WWF-ja po bëhej gati të themelohej dhe mendonte se ai fondacion do

të kishte qenë me leverdi për mbrojtjen e kafshëve. Megjithatë, pastaj ndryshoi mendim:

"...me zemër të copëtuar duhet të them se isha gabuar. Rinoceronti, elefanti dhe panda e kanë humbur anijen, dhe arka e re e Noes është nisur pa ata"[44].

Publiku ka mbetur gjithmonë i çorientuar në vënien re të sjelljes kontradiktore të Filipit, që, nga njëra anë ishte ithtar dhe themelues i WWF-së, nga tjetra, shfarosësh kafshësh e zogjsh thjesht për argëtim. E njëjta gjë duhet thënë për atë "ambientalistin" e WWF-së, siç është princi Karl, që i çon andej e këtej qentë e gjahut për ta bërë copë e çikë ndonjë dhelpër. Por, në realitet, këtu nuk ka asnjë kontradiktë. Filipit, ashtu si edhe Bernhardit, as që i bëhet vonë fare për mirëqenien e kafshëve. Fondacioni WWF është krijuar për arsye krejt të ndryshme. Është një instrument, nëpërmjet të cilit kontrollohen rezervat natyrore në Afrikë e gjetkë, ku grupe terroriste e mercenare mund të grumbullohen, të stërviten e të kalojnë kufijtë e ndryshëm, për të çuar genocidin në vende si Ruanda dhe Burundi. WWF-ja koordinon e financon masakrimin sistematik të njerëzve dhe kafshëve dhe ka bërë një pasuri të tërë falë tregtisë së paligjshme të fildishit, që përkundrazi duhej të kishte bërë të merrte fund kjo tregti. Sër Piter Scoti, ambientalist i famshëm, ka qenë një tjetër prej themeluesve të fondacionit WWF dhe, në vitin 1972, i porositi një raport një gjahtari të famshëm, Ian Parkerit, mbi tregtinë ilegale të dhëmbëve (fildishit) të elefantit dhe brirëve të rinocerontit. Parkeri dëshmoi se familja e presidentit kenian, Jomo Keniata, ishte në qendër të kësaj tregtie. Ai zbuloi edhe se "ambientalistët" kryesorë ishin në realitet ca gjahtarë pa leje. Pak orë pas dorëzimit të raportit tek Skoti, Parkeri arrestohet nga seksioni special i policisë keniane, që e rrahu për tri ditë dhe e kërcënoi të heshtte, nëse nuk dëshironte që e shoqja të vritej[45]. Raporti i Parkerit nuk u publikua kurrë nga Skoti dhe pak a shumë në të njëjtën periudhë princi Bernhard, si president i *WWF International* i dha Keniatës titullin e Urdhërit të Arkës së Artë, sepse kishte shpëtuar rinocerontin![46].

Në këtë pikë më mjafton të rendis disa prej emrave të Klubit 1001 të WWF-së, për të treguar origjinën e vërtetë të kësaj organizate. Bëhet fjalë për një grup të veçantë, i formuar nga princi Bernhard në vitin 1971, për të mbledhur para për "veprimtaritë" e WWF-së. Anëtarët, të rekrutuar vetëm mbi bazë ftese, si në të gjitha shoqëritë e fshehta, bëjnë një dhurim vjetor të majmë.

Ja vetëm një pikë prej elementëve të Klubit 1001 gjatë viteve të fundit:

Konrad Blejk: agjent i shërbimeve të fshehta britanike dhe kreu i perandorisë mediatike *Hollinger*, që qe krijuar në fillim nga i ati Xhorxh, një agjent operativ i shërbimeve të fshehta britanike. Blejku është anëtar i komitetit direktiv të grupit Bilderberg. **Princi Johanes fon Turm und Taksis** (i vdekur): njëra prej familjeve veneciane më të spikatura të Fisnikërisë së Zezë dhe të Perandorisë së Shenjtë Romake, shumë afër Rotshildëve. I ati, Maks, themeloi *Allgemeine SS*-të e Hitlerit, që e kishin shtabin e tyre të përgjithshëm pranë kështjellës së familjes të Regensburgut, në Bavari, qendër e Urdhërit të Mendjendriturve Bavarezë. **Tibor Rozenbaum** (i vdekur): përgjegjës i logjistikës së Mosadit dhe kreu i *Banque du Credit International* (*BCI*) të Gjenevës, që parapriu të famshmen *BCCI*, që mori emrin Banka e Mashtruesve dhe e Kriminelëve. Revista *Life* ka zbuluar se banka e Rozenbaumit riciklonte pará të pistë për llogari të rrjetit kriminal të Mejer Lanskit, që e ka qendrën në Shtetet e Bshkuara dhe Rozenbaumi ka qenë edhe një subvencionues i *Permindex*-it, skuadrës vrasëse të shërbimeve sekrete britanike, përgjegjëse për vrasjen e Xhon F. Kenedit. **Majori Ljuis Mortimer Blumfield** (i vdekur): agjent i shërbimeve të fshehta britanike, që kryesoi operacionin *Permindex*. **Robert Vesco:** i subvencionuar nga dega zvicerane e Rotshildëve dhe element lidhës midis Amerikës e kartelit të drogave të Medelinit, në Kolumbi. Njoftimet e fundit na e japin aktiv në Kubë. **Henri Kesuik:** president i *Jardin Matheson*, njëra prej organizatave më të rëndësishme të planetit kushtuar tregtisë së narkotikëve. I vëllai i tij, Xhon Kesuik, një financues i WWF-së, është president i *Hambros Bank* dhe drejtor i Bankës së Anglisë. **Sër Frensis de Guingand:** ish shefi i shërbimeve sekrete ushtarake britanike, sot me banim në Afrikën e Jugut. **Sër Kenet Kleinuort:** anëtar i familjes së bankierëve që qëndron prapa *Kleinwort Benson*. **Mbreti Huan Karlos i Spanjës:** anëtar i Fisnikërisë së Zezë dhe themelues e president nderi i WWF-së spanjolle. **Princi Henrik:** president i WWF-së daneze. **Doktor Luk Hofman:** zëvendëspresident i *WWF International* dhe drejtor i firmës farmaceutike zvicerane *Hoffman-La Roche*. **Xhon H. London:** president i kompanisë *Shell Oil* deri në vitin 1976 dhe drejtor i përgjithshëm i kompanisë *Royal Dutch Shell*. I dekoruar me titullin kalorës si nga familja mbretërore britanike edhe nga ajo holandeze dhe zëvendësues i Bernhardit në vitin 1977 si president ndërkombëtar i WWF-së[47].

Po, duket një grup i bukur ambientalistësh, apo jo? Martin Palmeri, këshilltar i Filipit në fushën ambientaliste, ka thënë se WWF-ja ishte një "organizatë misionare"[48]. Dhe është e vërtetë edhe kjo. Vala e parë e misionarëve e filloi veprën e shkatërrimit të Afrikës dhe të Amerikës jugore e

qendrore dhe, tani, vala e fundit, e maskuar nga organizata si WWF-ja, po përpiqet ta çojë në fund veprën e nisur. Ambienti është qendror për Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë dhe unë flas si një njeri që e ka parë lëvizjen nga brenda, kur kam qenë zëdhënës kombëtar i Partisë së Gjelbër Britanike në fund të viteve tetëdhjetë të shekullit XX. Atyre që i dënojnë ambientalistët si "ekofashistë" unë u them se, si të gjitha organizatat e përdorura nga Vëllazëria, përfshirë masonët, pjesa më e madhe dërrmuese e anëtarëve të tyre do të mbeteshin të mahnitur sikur ta dinin rolin që ata mbulojnë në Urdhërin e Ditës, mbi të cilin jam duke hedhur dritë. Pjesa më e madhe e atyre anëtarëve janë njerëz të mirë, në mënyrë të pabesueshme të padjallëzuar dhe nganjëherë në mënyrë të pabesueshme arrogantë, por sigurisht që nuk bëhet fjalë për fashistë. Prapë edhe një herë fashistët e vërtetë janë manipuluesit që formojnë bërthamën qendrore, të cilët duhet të identifikohen dhe nuk mund ta arrijmë këtë thjesht duke sulmuar të gjithë ata që flasin për ambientalizëm. Në një tjetër libër timin, ndalem mbi manipulimin e lëvizjes ambientaliste globale nëpërmjet organizatave si Klubi i Romës dhe individëve si superpronari i naftës (dhe i shumë gjëravę të tjera), kanadezi Mauric Strong. Nuk të çudit fakti që Strongu ka qenë një anëtar i Klubit 1001 të WWF-së, ashtu sikurse edhe Aleksandër Kingu, bashkëthemelues i Klubit të Romës në vitin 1968 bashkë me Aurelio Peçein, drejtues i *Fiat*-it dhe numri dy i Xhovani Anjelit, njërit prej anëtarëve më të spikatur të Fisnikërisë së Zezë e anëtar i rrethit të ngushtë të Grupit Bilderberg. Strongu është edhe afër Dalai Lamës dhe është një këshilltar i Kofi Ananit, sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ambienti përdoret në shumë mënyra për të nxitur Urdhërin e Ditës nëpërmjet taktikës problem-reagim-zgjidhje. Në qoftë se dëshirohet të diktohen "zgjidhje" globale, është e nevojshme të gjendesh *përballë* "problemesh" globale dhe ambienti është i përkryer për të gjithë këtë. Ju jep mundësi të miratoni ligje ndërkombëtare dhe të krijoni organizma botërore të centralizuara, që t'i mbrojnë këto ligje. Ato ligje do t'ju krijojnë mundësi t'i dëboni popullsitë vendase nga tokat e tyre të lashta, për të krijuar parqe natyraliste dhe zona të "mbrojtura" në të gjithë botën, sidomos në Afrikë e në Amerikat, që atëherë do të jenë nën kontrollin tuaj të centralizuar. Do të krijojnë një pikëmbështetje në zona strategjike, nga të cilat do të mundni të hidhni "luftëtarët për lirinë", me qëllim që t'u japin jetë luftërave civile. Marrëveshjet ndërkombëtare si Traktati mbi Biodiversitetin janë duke e dorëzuar kontrollin e zonave të gjera të Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve të tjera të Kombeve të Bashkuara[49]. Situata është e njëjtë në Afrikë, ku parqet

LIBRI 24

administrohen nga agjensi të huaja, mbi të cilat popullsia nuk ka asnjë kontroll. "Strategjia e biodiversitetit global" është hedhur nga Bashkimi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN), një organizatë zvicerane e themeluar nga Sër Xhulian Huksleji në vitin 1948, me një bazë ligjore të shkruar nga ministri i Jashtëm britanik. Ky i fundit qëndron në qendër të një rrjeti që përfshin 68 vende, 103 agjensi qeveritare dhe 640 organizata joqeveritare. Kjo organizatë ka bashkëpunuar me të tjera institucione si *World Resources Institute*, i financuar nga Rokfeleri dhe i drejtuar në Shtetet e Bashkuara nga Lejster Brauni (CFR), strategjia e të cilit u paraqit në Samitin e Rios mbi Tokën të vitit 1992 nga... Mauric Strongu, njeriu kukull i Fisnikërisë së Zezë dhe i Uindsorëve, që, së bashku me të shoqen, është duke u përpjekur edhe të përsërisë të njëjtin mashtrim në dëm të lëvizjes New Age. Njëri prej instrumenteve të tij kryesorë përfaqësohet nga Dalai Lama.

Klubi i Romës u themelua nga Vëllazëria pranë çifligut të Rokfelerëve në Itali në vitin 1968, për ta përhapur në nivel botëror lëvizjen ambientaliste. Të gjitha raportet më të mëdha botërore të ambientalistëve, që thonë se jemi duke kaluar një krizë ambientale dhe se duhet të bëjmë diçka, janë financuar dhe kryesuar po nga ata njerëz që janë duke shkatërruar ekologjinë e planetit dhe janë duke vrarë faunën e saj. Mauric Strongu është njëri prej zërave më të rëndësishëm të Klubit të Romës. Kanadaja është ende një vend i *Commonwealth*-it dhe vepron si një qendër operative e Uindsorëve dhe e Fisnikërisë së Zezë. Ja përse kaq shumë kanadezë, përfshirë Strongun, Konrad Blejkun, familjen gangstere të Bronfmanëve dhe kryeministrat si Pier Trudo e Brian Mulroneji, janë të përfshirë në këtë lojë. Strongu bën pjesë edhe në shoqërinë Rokfeler, që është ndër përfaqësuesit më të mëdhenj të Fisnikërisë së Zezë-Uindsor në Shtetet e Bashkuara. Strongu ka shërbyer për Fondacionin Rokfeler, që ndan një drejtim të përbashkët me të gjithë fondacionet e tjera të "pavarura" të Shteteve të Bashkuara, si Fordi dhe Karnegie. Megjithatë, roli i tij kryesor në njëzet vitet e fundit ka qenë të udhëhiqte manipulimin e lëvizjes ambientaliste. Kush ishte drejtori i parë i Agjensisë Ambientaliste të Kombeve të Bashkuara? Mauric Strongu. Kush ishte kryetari i Samitit mbi Tokën të mbajtur në Brazil në vitin 1992? Mauric Strongu. Kush e përpiloi raportin ndikues mbi ambientin me titullin *Our Common Future* (E ardhmja jonë e përbashkët), i njohur më mirë si Raporti Bruntland? Ortaku kanadez i Mauric Strongut, Xhimi MekNeil, "këshilltar" pranë Samitit të Rios. Kush e përpiloi dokumentin me titull *Global 2000, Report To The President*, gjatë administratës së Karterit? Sirus Vansi (CFR, TC, Bil) dhe të tjerë anëtarë të Vëllazërisë. Strongu bën pjesë tek instituti i turpshëm *Aspen Institute* në Kolorado, i

themeluar nga anëtari i Bilderbergut Robert O. Andersoni i kompanisë *Atlantic Richfield Oil* (ARCO). Shoqëria e tij ka si logo një piramidë pa majë. Andersoni financoi grupin ambientalist Miq të Tokës, që, në nivel krerësh, lidhet me grupe të tjera si *Greenpeace, WWF, Sierra Club, Survival International, Earth First, World Resources Institute*, Shoqërinë Zoologjike të Londrës, Shoqërinë Gjeografike Mbretërore, *Nature Conservancy*, Shoqërinë e Mbrojtjes së Faunës dhe Florës, Organizatën Kulturore, Shkencore dhe Edukative të Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe shumë të tjera. Këto furnizojnë një tjetër rrjet agjensish kombëtare e ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave të organizojnë operacione të fshehta, që shpesh nuk kanë të bëjnë fare me mbrojtjen ambientaliste.

Zotërimi me çdo mjet i Afrikës dhe i vendeve të tjera në rrugën e zhvillimit, i drejtuar nga princi Filip dhe nga WWF-ja, është pjesë e një operacioni të hershëm akoma sot e kësaj dite në zhvillim. Shoqëria Gjeografike Mbretërore, që u themelua në vitin 1830 dhe së cilës sovrani ia dha kartën themeluese në vitin 1859, ka sponsorizuar dërgimet në Afrikë të doktor David Livingstonit dhe të Sër Riçard Burtonit, që kontribuan në nisjen e kontinetit drejt shfrytëzimit dhe pushtimit nga ana e Fisnikërisë së Zezë evropiane. Në pushtimin evropian të Afrikës morën pjesë edhe organizata që kishin fituar statusin e Kurorës Britanike, përfshirë Kompaninë e Afrikës së Jugut të Sesil Rodit, Kompaninë e Afrikës Lindore Britanike dhe Kompaninë Mbretërore të Nigerit. Njëri prej shtyllave mbajtëse të Shoqërisë Gjeografike Mbretërore të shekullit XIX ishte Frensis Galtoni, themelues i lëvizjes së eugjenetikës (racës superiore), që akoma sot e kësaj dite vepron nën emrin e "kontrollit demografik". Bëhet fjalë për një çështje që e ka fort përzemër princ Filipi dhe miku i tij pedofil e satanist, amerikani Xhorxh Bush. Shoqëria Zoologjike e Londrës u themelua në vitin 1826 nga Sër Stamford Rafles, mëkëmbësmbret i Indisë për llogari të Vëllazërisë dhe themelues i Singaporit. Princi Filip ka qenë president i kësaj shoqërie, që është e lidhur me Shoqërinë Zoologjike të Nju Jorkut e të Frankfurtit, dy qendra të tjera të rëndësishme të Vëllazërisë. Këshillat e këtyre dy shoqërive dhe e fondacionit WWF janë të përbërë praktikisht nga të njëjtët njerëz.

Sierra Club u themelua në vitin 1892 nga Xhon Mjur me financimet e ardhura nga familja amerikane e Harrimanëve, që financuan edhe lëvizjen eugjenetike të Galtonit. Ishin krerët e *Sierra Club*-it ata që i dhanë jetë në vitin 1971 *Greenpeace*-it dhe David Ros Braoueri, ish drejtues i *Sierra Club*-it, themeloi në vitin 1969 lëvizjen Miqtë e Tokës. Miqtë e Tokës e kanë arritur rëndësinë e tyre më të madhe në Britaninë e Madhe nën drejtimin e Xhonatan

Porritit, i biri i ish guvernatorit të përgjithshëm të Zelandës së Re dhe, më pas, këshilltar i princit Karl. Themeluesi i FOE-s në Francë, Bris LaLond, ishte ortak i studios ligjore Rokfeler dhe u bë ministër i Ambientit i presidentit francez, masonit të shkallës së lartë dhe mikut të Rotshildëve, Fransua Miteranit, nën presidencën e të cilit u ngrit piramida me xham të zi pranë Muzeut të Luvrit. Ashtu si në rastin e princit Filip, njerëzit mbetën të befasuar kur i ndjeri Sër Xhejms Goldsmith u bë një ambientalist i ri fringo, pas një jete manipulimi financiar e "investimesh" të tilla, që nxisnin Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë dhe që shkatërronin ambientin. Por prapë edhe një herë kontradiktat zhduken dhe del në pah plani, për të cilin janë duke punuar. Goldsmithi, ish Goldshmidt, kishte një baba anglo-gjerman dhe një nënë franceze. I ati Frenk ishte mik i Uinston Çurçillit dhe u bë deputet konservator. Goldshmidët i kishin bashkuar forcat me kushërinj të tjerë të Rotshildëve, Bishofsheimët, për të formuar një shoqëri bankare, që të financonte Veriun gjatë luftës civile amerikane[50]. Familja e Goldsmithëve bënte pjesë në rrjetin financiar të Fisnikërisë së Zezë në Evropë dhe nuk ka dyshime mbi natyrën e "mendimit të papritur" të Goldsmithit, që vendosi papritmas t`i shiste të gjitha aksionet e tij para rënies katastrofike të tregut aksionar të vitit 1987. Vëllai i madh i Goldsmithit, Eduard "Tedi", ka themeluar revistën *The Ecologist* dhe ka lidhje me fondacionin WWF. Sipas disa raporteve të publikuara, Tedi dhe Xhejms Goldsmithi kanë që prej shumë kohësh lidhje të ngushta me bankierin e Uoll Stritit, Xhon Trein, vëlla i Rasëll Treinit, president i WWF-së në SHBA. Rasëll Treini është edhe administratori më i lartë i besuar i fondacionit *African Wildlife Foundation* dhe është mik i ngushtë i princ Filipit e i Xhorxh Bushit. Xhon Treini vjen nga një familje e Vëllazërisë dhe gjyshi i tij ishte themelues i grupit bankar *J.P. Morgan*. Ai u martua me një grua që i përkiste familjes veneciane të Çinëve, nga e cila pastaj u nda, dhe që ishte e bija e Vitorio Çinit, një njeri i radhëve të para në lëvizjen fashiste italiane të viteve tridhjetë të shekullit XX. Treini ka lidhje të ngushta me shërbimet e fshehta dhe është një "shërbëtor servil" si i Bushit edhe i Uindsorëve[51].

Organizata ambientaliste është vetëm njëri prej instrumenteve të rrjetit, nëpërmjet të cilit veprojnë princi Filip dhe iniciativat e fondacionit WWF kushtuar genocidit. Dua të nënvizoj se pjesa më e madhe e atyre që mbështesin WWF-në dhe bashkëpunojnë me këtë lëvizje janë njerëz të ndershëm, që nuk dyshojnë aspak për ekzistencën e Urdhërit të Ditës, edhe pse çdo ditë kontribuojnë për ta zbatuar. Kompanitë e Kurorës, që në harkun e shekullit XIX e zhvatën Afrikën dhe popullin e saj, përhapën mandej shumë institucione të barasvlerëshme me to, të cilat sot vazhdojnë veprën e ndërprerë nga

persona si Sesil Rodi. Kompania *Lonrho* (Londër-Rodezi), e kryesuar nga i famshmi dhe sot i ndjeri Tini Rouland, ka qenë një ndihmëse e kompanisë britanike Kompania e Afrikës së Jugut e Rodit, përgjegjësja më e madhe e genocidit dhe e luftës, që në Afrikë e ka përçarë dhe e ka vënë nën zgjedhë popullsinë. Në kohën që po shkruaj, kompania *Lonrho* numëron 640 kompani ndihmëse në 48 vende. Është industria më e madhe ushqimore e Afrikës, shpërndarësja më e madhe e automjeteve dhe industria më e madhe tekstile. Prodhon deri madje 90% të pullave postare të Britanisë së Madhe, më falni, të Madhërisë së Saj[52]. Tini Roulandi ka qenë pak më shumë se një kukull, mbi të cilin u shkarkua përgjegjësia e asaj që mbretëresha dhe Uindsorët ishin duke orkestruar për llogari të Fisnikërisë së Zezë. Forcat e vërteta, të cilave u detyrohet përmirësimi dhe zgjerimi i kompanisë *Lonrho* ishin Harlej Drejton, drejtor financues privat i Kurorës Britanike, dhe Angus Ogilvi, i shoqi i princeshës Aleksandra, kushërirë e parë e mbretëreshës[53]. Burime kanadeze më kanë pohuar se Ogilvi është shumë aktiv edhe në Kanada, në rrethin e afarizmave të Uindsorëve. Princesha Aleksandra drejton degën e WWF-së së Mbretërisë së Bashkuar[54]. Të tjerë shfrytëzues të mëdhenj të kontinentit afrikan janë sot kompanitë *Rio Tinto*, *Anglo-American*, *Minorco*, *De Beers*, *Barclays*, *Shell*, *N.M. Rothschild*, *Imperial Chemical Industries* (*ICI*) dhe *Unilever* dhe thuhet se të gjitha, ose thuajse të gjitha, gëzojnë investime të mëdha nga ana e mbretëreshës. Pa shihni, Lordi Melchet, nip i themeluesit të *ICI*-it, një shtyllë e kartelit kimik botëror, u bë kreu i *Greenpeace*-it në Britaninë e Madhe. Tri industritë minerare më të mëdha të botës, *Anglo-American*, *Roi Tinto* dhe *Minorco*, janë në realitet tri faqe të së njëjtës medalje. *Minorco* është shoqëria financiare ndërkombëtare e perandorisë Openhajmer, e familjes që ka monopolizuar tregun botëror të diamanteve së bashku me Rotshildët, nëpërmjet *De Beers*-it, shoqërisë së themeluar nga Sesil Rodi në vitin 1880. Njëzet drejtorë të *Minorco*-s janë edhe drejtorë të kompanisë *Anglo-American*, që është plot me vartës të shoqërisë *De Beers*.

Shkatërrimi i Afrikës mund të ndahet në tri faza të ndryshme. E para, pushtimi dhe kontrolli i hapur i kontinentit nga ana e degëve të ndryshme të Fisnikërisë së Zezë, britanikët, holandezët, gjermanët, portugezët e francezët. Pastaj, nga kolonializmi si pushtim fizik u kalua në pushtimin financiar nëpërmjet presidentëve dhe kryeministrave të korruptuar, të diktuar nga Vëllazëria. Kushdo që zë pozita pushteti pa qëndruar në lojë hiqet menjëherë dhe për largimin e tij përdoret vrasja, skandali, ose grushti i shtetit. Fytyrat ndryshojnë, por padronët mbeten të njëjtët. Rodezia u bë Zimbvave falë manipulimit të britanikes Margaret Theçer (Bil) dhe Lord Karringtonit (RIIA,

TC, Bil, Kom 300), por gjithçka që ndodhi ishte që diktatura e bardhë e Ian Smithit u zëvendësua me diktaturën e zezë të Robert Mugabes. Jeta e afrikanëve nuk ndryshoi, pasi ata që mbajnë kontrollin janë gjithmonë të njëjtët. Vetëm që sot është më e vështirë t'i shohësh, sepse veprojnë prapa kuintave. Faza e tretë e këtij operacioni afrikan ka qenë ajo për ta shndërruar këtë kontinent në një teatër lufte, duke shkatërruar çdo formë të shoqërisë civile dhe duke nxitur kështu diktimin e ligjit të NATO-s e të "forcave të paqes" të Kombeve të Bashkuara. Ambienti përdoret si pretekst për të grabitur gjithmonë e më shumë toka dhe kriza e borxheve "zgjidhet" nga bankat e Vëllazërisë, që propozojnë ta anulojnë "borxhin" në shkëmbim të të drejtave mbi burimet minerare – përgjithmonë.

Masakrat e kryera në vende si Algjeria, Ruanda e Burundi nuk kanë ndodhur vetvetiu, por kanë qenë organizuar deri në hollësitë më të vogla, saktësisht sikurse konflikti dhe genocidi në ish Jugosllavi, në Afganistan, në Kamboxhia, në Laos, në Sri Lanka etj. Është dëshmuar se Kryqi i Kuq Ndërkombëtar (kryqi i kuq është një simbol tempullar/fenikas) ka furnizuar me armë rebelët Tamil në Sri Lanka dhe zapatistët në Meksikë[55]. Kryqi i Kuq, është një fasadë e Vëllazërisë, edhe pse nëpunësit dhe vullnetarët e tij janë njerëz të ndershëm, krejtësisht të paditur për të gjithë këtë. Nuk është nevoja të kesh kaluar ndonjë test zgjuarësie për të kuptuar arsyen pse Elizabet Dojli, e shoqja e Bob Dojlit, është në krye të Kryqit të Kuq në Amerikë. Edhe të tjera organizata në dukje për qëllime mirëbërëse, si *Oxfam* dhe *Amnesty International* bashkëpunojnë për manipulimin e vënë në veprim nga Vëllazëria. Organizata Britanike *Afghan Aid* ka qenë një mjet, nëpërmjet së cilës terroristët *mujaheddin* qenë organizuar dhe përdorur për të bërë të mundur shpërthimin e luftës në Afganistan[56]. Njëri prej agjentëve të shërbimeve të fshehta, që kontribuoi në shpërthimin e luftës në Afganistan, ishte Lordi Betel, fisnik oborri i familjes mbretërore, që drejtoi Radion Kabuli i Lirë[57]. Operacionet e fshehta të Uindsor-Fisnikërisë së Zezë krijuan grupet "terroriste" dhe "luftëtarët e lirisë", pastaj ndezën fitilin dhe bënë sehir masakrimin e mijëra, nganjëherë miliona, njerëzve. Këta njerëz mund të mbështeten tek baronët e mediave si Blejk, Murdok, Tërner e Paker, që i shesin publikut një histori të shtrëmbëruar, nëpërmjet "gazetarëve", që për më tepër as që e kanë idenë e asaj që është duke ndodhur.

Rezervatet natyrore dhe parqet kombëtare zënë më shumë se tetë përqind të Afrikës subsahariane dhe, vetëm në Tanzani, 40%[58]. Poshtë disa prej këtyre tokave ekzistojnë rezerva të jashtëzakonshme mineralesh dhe, në disa raste, rezerva të pashfrytëzuara urani. Këto "parqe" ndodhen shpesh në pika

strategjike përgjatë kufijve dhe kush i drejton mund të nxjerrë prej tyre çfarëdo që të dëshirojë. Por kush i drejton? Agjensi si WWF-ja e princit Filip e të tjera organizata të Vëllazërisë, si Bashkimi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe Programi i Zhvillimit i OKB-së. Këto iniciativa përdorin njësi ushtarake e të shërbimeve të fshehta dhe, në këtë mënyrë, arrijnë të shkelin sovranitetin e kombeve afrikane. Dy shembuj të frikshëm janë Operacioni Stronghold dhe Operacioni Lok. Operacioni Stronghold duhej të mbështeste Departamentin e Drejtimit të Rezervave Faunistike dhe të Parqeve Kombëtare të Zimbvaves për shpëtimin e 700 rinocerontëve të zinj në luginën Zambesi, por më pas doli në dritë se komandanti i rojeve të parkut, Glen Tatami, dhe njerëzit e tij i vrisnin "gjuetarët pa leje" pa paralajmërim. Shifrat zyrtare tregojnë se, ndërmjet korrikut të vitit 1984 dhe shtatorit të vitit 1991, qenë vrarë 145 "gjuetarë pa leje", pjesa më e madhe nga një helikopter i financuar nga WWF-ja e princ Filipit dhe ekuipazhi i të cilit përbëhej nga nëpunës të WWF-së[59]. Por po të analizohen shifrat më me kujdes, zbulohet se pjesa më e madhe e të vrarëve kanë qenë të paarmatosur! Përse atëherë nuk u nënshtroheshin proceseve të rregullta? Sepse, kur kjo histori doli në dritë, parlamenti i Zimbvaves nxitoi të miratonte një ligj, që e quajti Dekret për mbrojtjen e kafshëve, i cili u garantonte rojeve të parkut imunitet ndaj çdo akuze[60]. WWF-ja mund të vriste tani këdo që dëshironte, në çdo çast, brenda rezervateve. Operacioni Lok, përkundrazi, parashikonte përdorimin nga ana e WWF-së të një skuadre të zgjedhur me njerëz të SAS-it, për të "neutralizuar" kartelet që bënin kontrabandën e kafshëve dhe të "produkteve" të nxjerra nga ato kafshë. Doli pastaj se këta njerëz të SAS-it kishin filluar të merreshin me tregtinë e paligjshme të fildishit dhe të brirëve të rinocerontit[61]. Kush e njeh mirë situatën e Afrikës e di se ata që i vrasin pjesën më të madhe të kafshëve të parqeve janë vartësit e WWF-së, që përkundrazi duhej t'i mbronin.

Ashtu si në rastin e Operacionit Stronghold, ardhja e skuadrave të SAS-it përkoi me një rritje të shpejtë të numrit të "gjahtarëve pa leje" të vrarë. Kjo nuk të çudit, nëse ke parasysh se stërvitja e skuadrave speciale si ato të SAS-it, regjimentit special të parashutistëve, Beretë Gjelbërtit, *Delta Force*, e të tjera të ngjashme, ka për qëllim formimin e psikopatëve të plotë. Organizimi i Operacionit Lok të WWF-së u drejtua nga koloneli David Stirling, themelues i forcave speciale të SAS-it gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këtu intrigat ndërlikohen. Mbretëresha dhe princi Filip e dinin saktësisht se çdo të kishte bërë skuadra e sulmit SAS e Stirlingut në përbërje të Operacionit Lok. Stirlingu është shumë afër Uindsorëve dhe ka luajtur një rol domethënës në ceremoninë e kurorëzimit të mbretëreshës me titullin e "Shkopit të Artë"[63]. Në cilësinë e

LIBRI 24

aristokratit skocez, Stirlingu ka qenë veçanërisht afër nënës mbretëreshë, një tjetër pinjolle e degës skoceze të Fisnikërisë së Zezë. Stirlingu, bashkë me të gjithë anëtarët e SAS-it, të MI5-ës, të MI6-ës (*MI5 dhe MI6 janë shërbime të fshehta të informacionit e të spiunazhit ushtarak anglez*) e kështu me radhë, i betohet për besnikëri monarkes, jo shtetit. Nuk mund të kesh një vend në Parlament pa bërë të njëjtin betim, pavarësisht se je zgjedhur nga populli. Stirlingu ka pohuar se ka pasur lidhje të ngushta me ministrin e Mbrojtjes dhe atë të Jashtëm britanik, dy hallka të tjera këto në zinxhirin Vëllazëri-Uindsor. Funksionari operativ i Stirlingut në Operacionin Lok ishte nënkoloneli Ian Kruk, njëri prej njerëzve me kapuç, që u shfaqën në ballkon, kur skuadra e tij SAS bombardoi ambasadën iraniane në Londër në maj të vitit 1980, përballë miliona spektatorëve televizivë[64]. Këta njerëz qenë pajtuar nga princi Filip dhe nga WWF-ja e tij për të mbrojtur faunën afrikane? Absolutisht jo. Përkundrazi, detyra e tyre ishte ta shndërronin Afrikën në një teatër të pafund lufte, sikurse ishte parashikuar nga plani i Fisnikërisë së Zezë dhe i Uindsorëve. Rezervatët e faunës përdoren si vende strehimi të sigurta për terroristët e sponsorizuar nga Vëllazëria dhe nga Uindsorët, përgjegjës të genocidit afrikan. Gati 20 përqind e Ruandës është e mbuluar nga këta rezervatë. Pushtimi i Ruandës i vitit 1990 nga ana e "Frontit Patriotik Ruandez" (RPF) u krye nëpërmjet Gorilla Park-ut e Akagera Park-ut në Ugandë, në kufirin ndërmjet Ruandës dhe Zairesë, dhe Volkans Park-ut në Ruandë.

Edhe RPF-ja (një organizatë terroriste e kontrolluar nga anglezët) i kishte shtabet e saj të përgjithshme në disa zona të parkut Virunga, në Zaire[65]. Disa muaj para këtyre fakteve, një "program për mbrojtjen e gorillës" ishte vënë në veprim në parqet Virunga, Gorilla dhe Volkans. Ky program drejtohej nga... fondacioni WWF. Në vitin 1994, "Fronti Patriotik Ruandez" vërshoi në Ruandë duke depërtuar nëpërmjet parkut Akagera dhe ndezi një konflikt që deri tani ka shkaktuar vdekjen e më shumë se një milion njerëzve. Kam vërtetuar se konflikti shpërtheu menjëherë pas një "misioni diplomatik" në Ruandë të Henri Kisingerit dhe Lordit Karrington, dhe pasoi shitjen e armëve Ruandës nga ana e izraelitëve, atëherë e drejtuar nga Jitzhak Rabini. Në realitet, pra, ky pushtim nuk qe aspak vepër e "Frontit Patriotik Ruandez" (RPF). Gati çdo anëtar i atij grupi ishte një ushtar i "Ushtrisë së Rezistencës Kombëtare" (NRA) të presidentit të Ugandës Museveni. RPF-ja dhe NRA-ja kanë të njëjtët krerë! David Tiriefuza i Frontit Patriotik Ruandez ishte ministri ugandez i Mbrojtjes, ndërsa Pol Kagameja, ministër i Mbrojtjes gjatë qeverisë së RPF-së, kishte qenë në krye të shërbimeve të spiunazhit dhe të

kundërspiunazhit të ushtrisë ugandeze, dhe Kris Bunieniezi i RPF-së është ish komandanti i brigadës së treqindegjashtë vrasëse të ushtrisë ugandeze[66]. E njëjta bandë, që sillej përreth Musevenit, qe përfshirë në përpjekjen për grusht shteti në Burundi në vitin 1993, në të cilin u vra presidenti Melkior Ndadajie dhe 100.000 njerëz humbën jetën[67]. Një tjetër aspekt i kësaj politike në Afrikë, ashtu sikurse edhe në Amerikën qendrore e jugore, synon të zvogëlojë midis popullsisë numrin e atyre që Henri Kisingeri i quan "gojë të tepërta për t'u ushqyer". Genocidi afrikan koordinohet në pjesën më të madhe jashtë Ugandës, që prej një kohe shumë të gjatë kontrollohet nga kartelët e agjensive të bankave, të shoqërive dhe të spiunazhit të Fisnikërisë së Zezë e të Uindsorëve. Ministrja britanike e Zhvillimit të përtejdetit ishte, në atë kohë, e mbrojtura e Margaret Theçerit, Linda Kalker, që u takua shumë herë me Musevenin dhe funksionarët e tij. Me përfundimin e presidencës së Nelson Mandelës, Afrika e Jugut do të bëhet një ndër objektivët kryesorë për të ndërsyer zezakët kundër zezakëve, në mënyrë që të justifikohet pastaj ndërhyrja e forcave të bardha të paqes. Deri tani kemi qenë të pranishëm vetëm në fillimin e kësaj situate problematike në kontinentin afrikan: është koha që popullsia afrikane të hapë sytë.

E njëjta taktikë identike zbatohet në Amerikat dhe në Australi, ku mund të shihen në veprim të njëjtit njerëz, të cilët përdorin të njëjtat teknika. Në Amerikën qendrore e jugore, qeveri të kontrolluara nga Vëllazëria janë duke "privatizuar" shoqëritë minerare, që i dorëzojnë në duart e kartelëve të Fisnikërisë së Zezë/Uindsorëve, sidomos të *Rio Tinto*-s, të *Anglo-American*-it, të *Barrick Gold*-it dhe të *Newmont Mining*-ut. *Barrick Gold*-i, që e ka selinë në Toronto, u themelua në vitin 1981 nga Adnan Kashogi, financieri saudit dhe tregtari botëror i armëve, i ungji i Dodi Fajedit. Piter Munk, ish funksionar i familjes mbretërore britanike, bëhet president i *Barrick Gold*-it, i cili duket se nga hiçi është bërë prodhuesi i dytë botëror i arit[68]. Kjo shpjegohet, nëse mbahet parasysh përfshirja aktive e organizatave të Xhorxh Bushit dhe të Harrimanit. Kashogi subvencionoi operacionin e drejtëpërdrejtë të presidentit Xhorxh Bush, që njihet me emrin Iran-*Contras* dhe që parashikonte furnizimin me armë në shkëmbim të drogës. Shoqëria minerare *Newmont Mining* e ka selinë në Denver të Kolorados, një qendër e Vëllazërisë, që është duke fituar gjithmonë e më shumë rëndësi. Duket sikur bëhet fjalë për një shoqëri amerikane, por prapë edhe njëherë rezulton e kontrolluar nga Londra. Ajo i përkiste grupit Hanson, që ia shiti Xhejms Goldsmithit, i cili, nga ana e tij, i dha 14% Xhorxh Sorosit, njërit prej më aktivëve dhe më të spikaturve manipulues financiarë të Vëllazërisë, veçanërisht për llogari të Rotshildëve.

Të tjerë aksionerë të *Newmont*-it janë Lordi Jakob Rotshild, fondacioni *Fidelity Mutual Fund* dhe organizatat kushtuar narkotrafikut, që e kanë qendrën në Boston[69]. Bashkë me sulmin në Amerikën e Jugut nga ana e korporatave minerare, është pushtuar edhe sistemi bankar i kontinentit nga ana e kartelit të *Sitit* të Londrës, i udhëhequr nga *HSBS* (*Hong Kong and Shanghai Bank* që zotëron *Midland Bank*-ën) dhe nga palët kundërshtare të tyre amerikane e kanadeze si *Citibank*, Banka e Montrealit dhe Banka e Skocisë së Re, apo *Scotiabank*[70]. Mbretëresha është komandatja supreme e të gjitha forcave të armatosura të Mbretërisë së Bashkuar dhe të vendeve të *Commonwealth*-it. Ushtria britanike është e rreshtuar në shumë zona strategjike të botës ose drejtpërdrejt, ose nëpërmjet operacioneve të paqes të NATO-s e të OKB-së. "Këshilltarët" britanikë janë aktivë në 30 vende. Çdo javë mbretëresha informohet nga Komisioni i përbashkët i shërbimeve sekrete për të gjitha operacionet e fshehta (kushedi nëse edhe ajo e informon për lëvizjet e saj?). Fisnikëria e Zezë/Uindsor ka edhe ushtritë e veta private. Midis këtyre figurojnë "Trupat e komisariatit dhe sistemet mbrojtëse srl". Trupat e komisariatit qenë krijuar, ashtu si edhe Agjentët e Kurorës, me lejen mbretërore të vitit 1859, kur Perandoria Britanike ishte në kulmin e fuqisë së vet. Ideja, thanë, ishte që të gjenin një punë për ushtarët që ishin liruar pas Luftës së Krimesë dhe shumë prej tyre u përdorën si roje sigurie të armatosura e pa uniformë pranë ndërtesave të Fisnikërisë së Zezë në *Siti* të Londrës. Pastaj u përhapën në Australi, në Afrikën jugore e lindore, në Zelandën e Re e në Kanada. Ishte krijuar një tjetër rrjet, për të dërguar në pika strategjike personelin ushtarak britanik të shoqëruar nga familjet.

Pas zgjedhjes së Margaret Theçerit në vitin 1979, Trupat e Komisariatit u riorganizuan dhe u krijua një divizion i ri që kryente "funksione speciale të sigurisë". U përdorën pjesëtarë të rinj të elitës ushtarake e paraushtarake dhe, mbretëresha, padrone e Trupave të Komisariatit, dha një pritje në Bukigham Palas në vitin 1986, për të kremtuar përhapjen e këtyre trupave. Në përbërje të Këshillit të Guvernatorëve të këtij korpusi figuronin, në çdo vend, shumë miq besnikë të mbretëreshës e të princit Filip. Midis tyre mund të përmendim gjeneral majorin David Aleksandër, i dekoruar me titullin Shok i Urdhërit Bath, dhe ish financierin e Filipit e marshallin e ajrit Sër Tomas Kenedin, i dekoruar me titullin Kalorës i Kryqit të Madh Bath, komandant i Perandorisë Britanike, ish komandant suprem i forcave ajrore mbretërore në Gjermani. Trupat e Komisariatit janë një forcë e krijuar dhe e kontrolluar nga Uindsorët. Disa prej shoqërive që figurojnë brenda këtij rrjeti janë *Sandline srl* dhe *Executive Outcomes and Defence System srl*. Ashtu si për Trupat e

Komisariatit, edhe në këtë rast bëhet fjalë për organizata që e kanë selinë ne Londër dhe që i rekrutojnë anëtarët e vet midis radhëve të *Special Air Services* (SAS) dhe të forcave ushtarake e policore të Mbretërisë së Bashkuar e të *Commonwealth*-it. Trupat kanë një zyrë të përhershme në Papua, në Guinenë e Re, qeveria vendase e së cilës u shkarkua në vitin 1994, sepse kishte negociuar një kontratë me *Sandline International*, që i përkiste përdorimit të mercenarëve të saj për të shtypur një kryengritje vendase. *Sandline*, nga ana e saj, ia jepte me nënsipërmarrje *Defence System srl*-së (*DSL*), që ka kontrata private e qeveritare me 40 vende. Asaj i drejtohen gati të gjithë kartelët e *Sitit* të Londrës, Klubi i Ishujve, dhe ajo ka degëzime në Uashington, në Xheksonvil, në Hong Kong, në Singapor, në Bogota, në Lima, në Maputo, në Kinshasa, në Luanda, në Port Moresbi, në Moskë, në Kazakistan, në Xherseji e në Sarajevë[71]. *Sandline* ka qenë përgjegjëse edhe e grushtit të shtetit në Sierra Leone, që largoi një qeveri të zgjedhur në mënyrë legjitime, menjëherë pasi ajo kishte anuluar një kontratë me vlerë 20 milionë dollarë në vit me atë shoqëri[72].

Në Sarajevë e në ish Jugosllavi *Defence Systems srl* ka bashkëpunuar me agjensinë e mbretëreshës, Agjentët e Kurorës. *Defence* ka kontrata të mëdha me Kombet e Bashkuara, me *World Bank*, me *BP*, me *Royal Dutch Shell*, me *S.G. Warburg*, me *Credit Suisse*, me Robert Flemingun, me Kleinvort Bensonin, me *British Airways*, me *Cadbury Schweppes*, me *Jardine Matheson*, me *Rothman*, me Rotshildët, me *Exxon*, me *Mobil*, me *Amoco*, me *Texaco*, me *Chevron*, me *Brown and Root*, me *General Motors*, me *Coca-Cola* dhe me *Bechell*[73]. Një përqëndrim i Fisnikërisë së Zezë i paparë kurrë ndonjëherë! *Defence Systems srl* u krijua në vitin 1981, prapë edhe një herë në vitet e regjimit Theçer, dhe pati një ngjitje shumë të shpejtë falë mbështetësve dhe mbrojtësve të saj. Në një farë kohe, më 1980, u bë ndihmëse e *Hambros Bank*[74]. Administratori i parë i deleguar i *DSL*-së ishte Alejster Morrisoni, anëtar i Urdhërit të Perandorisë Britanike dhe ish numëri dy i regjimentit të njëzetedytë të SAS-it. Presidenti i parë ishte gjeneral major viskonti Xhilbert Monkton i Brenklejit, Shok i Urdhërit Bath, anëtar i Urdhërit të Perandorisë Britanike, ish shef i shtabit të Ushtrisë Britanike të Rinit. I ati i tij bënte pjesë në kabinetin e Uinston Çurçillit dhe qe president i *Midland Bank*, ndërsa i biri ishte drejtor i rubrikës së të dielës të gazetës *Daily Telegraph* (*Hollinger*) dhe këshilltar i Margaret Theçerit. Filip Vërneri i shoqërisë lundruese *P&O* ka qenë një tjetër drejtor themelues i *Defence Systems* dhe një drejtues i ardhshëm i asaj shoqërie ka qenë edhe Riçard N. Beteli, një tjerër ish oficer i SAS-it. I ati i tij, Lordi Nicolas Betel, kishte qenë agjent i shërbimeve të fshehta britanike (MI6) dhe Xhentëllmen i Oborrit Mbretëror. Qe përzier edhe në manipulimin e luftës

LIBRI

në Afganistan gjatë viteve tetëdhjetë të shekullit XX dhe në organizatat terroriste, që lindën nga ajo luftë. *Defence Systems* është e lidhur me një shoqëri të ngjashme, me *Control Risks*, një seksion shumë i rëndësishëm i organizatës më të gjerë të themeluar në vitin 1974 me qëllimin për t'i shërbyer bankës *Lloyds* të Londrës[75]. Administrator i delegúar i shoqërisë *Control Risks* është majori Arish Turtle, ish oficer i SAS-it dhe, midis drejtorëve të saj, figuron gjenerali Sër Xhon Stanier, ish kryekomandant i forcave tokësore të Mbretërisë së Bashkuar dhe gjeneral adjutant i Mbretëreshës. Lordi Soames, eksponent i vjetër konservator dhe dhëndër i Uinston Çurçillit, ka qenë një tjetër drejtor i shoqërisë *Control Risks*. Soamesi ishte "këshilltar" i princit Karl në kohën kur princesha Dianë dha intervistën e saj të sinqertë në programin e kanalit *BBC Panorama*. Soamesi (i mbiquajtur "trashaluq"), ngriti dyshime mbi gjendjen e saj mendore. Kam përshtypjen se ajo ishte mendërisht më e qëndrueshme se Soamesi. Në atë intervistë tek *Panorama*, Diana zbuloi gjëra që asnjë burim pranë Uindsorëve nuk i kishte zbuluar kurrë. Sipas asaj që është shkruar nga Stefan Dorrili tek libri i tij *The Secret Conspiracy, Inside The Secret Service In The 90s* (Konspiracioni sekret, në mjedisin e shërbimeve sekrete të viteve Nëntëdhjetë), shoqëria *Control Risks* është më e rëndësishmja e shoqërive sekrete private, që varen nga Këshilli i Kurorës[76].

Defence Systems u ble nga shoqëria amerikane *Armor Holdings* për 26 milionë dollarë. *Armor*-i është një shoqëri fasadë e rrethit të Xhorxh Bushit dhe ideja ishte që t'i jepnin shoqërisë *Defence Systems* një pronar "amerikan", për të nxitur zgjerimin e saj në tregun aksioner amerikan. Një drejtor i saj, Riçard K. Bartlet, është president dhe administrator i besuar i shoqërisë *Nature Conservancy* të Teksasit, e themeluar nga Këshilli i Kurorës britanike në vitin 1946. Njëra prej shoqërive që përdor *Defence Systems* në Afrikën e Jugut është *British Petroleum*, e cila përdor kapitalet e shoqërisë *Control Risks*. Kompania *BP* është njëra prej ndërmarrjeve më ogurzeza të planetit dhe përbën një fasadë për ministrinë e Jashtme britanike, shërbimet e fshehta britanike dhe Kurorën. *British Petroleum* është një xhevahir për kartelët e Vëllazërisë dhe të Uindsorëve, për këtë arësye është krejt e kuptueshme që ata kartelë të përdorin rrjetin aksionar të Vëllazëri/Uindsorëve. Presidenti i *BP*-së, Sër David Simoni, u ftua të bënte pjesë në qeverinë e atij yllit që po lindte, siç ishte Toni Bler, i emëruar kryeministër më 1 maj të vitit 1997. Simoni është edhe drejtor i Bankës së Anglisë, i *Grand Metropolitan*-it, i *Rio Tinto*-s, i *Alliance AG*-së dhe është anëtar i Komitetit ndërkombëtar të këshilltarëve të *Deutsche Bank*[77]. Roli i tij brenda qeverisë ka të bëjë me "çështjet evropiane" dhe kjo është një shprehje që Bleri e përdor për të bindur Britaninë e Madhe të aderojë në

monedhën e përbashkët evropiane dhe në projektin e bankës qendrore, duke humbur kështu çdo mundësi të një qeverie të pavarur. Një tjetër shoqëri që do të doja të përmendja, duke folur për manipulimin e Afrikës dhe të Amerikave, është *Transparency International*, e cila bën pjesë në Fondacionin Agjentët e Kurorës dhe ka në përbërje të komitetit të saj drejtues drejtorin e Agjentëve të Kurorës. *Transparency International* përdoret për të destabilizuar qeveritë, me pretekstin e zbulimit të korrupsionit[78].

Këto shoqëri "aksionere", të lidhura me njëra-tjetrën dhe vepruese në të gjithë botën, janë ushtria private e Uindsorëve dhe e Fisnikërisë së Zezë, që e ka qendrën në *Sitin* londinez. Ju duhet ndonjë trazirë në Afrikë për të çuar përpara planet tuaja? Nuk ka problem. Ku e dëshironi? Në Ruandë? Në Algjeri? Në Kongo? Ç'thoni për Amerikën e Jugut? Ku e dëshironi? Në Bolivi? Në Peru? Në të gjitha këto zona është parashikuar, në një të ardhme jo shumë të largët, vënia në zbatim e një grushti shteti. Një provë e faktit që familja mbretërore është afër shërbimeve sekrete dhe vepron jashtë normave "demokratike" ka ardhur nga një intervistë e lëshuar nga koloneli David Stirlin, themeluesi i SAS-it, që ka bashkëpunuar me fondacionin *World Wide Fond for Nature* të princ Filipit në operacione sekrete afrikane. Para se të vdiste, ai u ka rrëfyer autorëve të librit *Who Killed Diana?*[79], se kishte marrë pjesë në një darkë në pallatin mbretëror të organizuar nga një anëtar i moshuar i familjes mbretërore në muajt e fundit të vitit 1974, apo në muajt e parë të vitit 1975. Do të kuturisja të mendoja se ka qenë fjala për princin Filip. Ishte edhe i ungji i princit Karl, Lordi Mountbaten, bashkë me dhjetë përfaqësues të shërbimeve sekrete britanike, përfshirë krerët e MI5-ës dhe të MI6-ës. Ata ishin të pranishëm jo në cilësinë zyrtare dhe Stirlingu vuri re se të gjithë oficerët ushtarakë iu betuan për besnikëri mbretëreshës, duke e konsideruar atë autoritetin më të lartë, edhe më të rëndësishëm se qeveritë e zgjedhura. Takimi ishte caktuar për të diskutuar për gjendjen e vendit dhe për nevojën e një ndërhyrjeje në çështje politike. Ishte parashikuar përdorimi i forcës, shtoi ai. Stirlingu u rrëfeu autorëve të librit për përfshirjen e tij në një operacion, që kishte pasur si qëllim kryerjen e një grushti shteti në Libi. Dhe në atë kohë ai ishte në krye të një organizate të quajtur GB75, e cila kishte si qëllim të garantonte shërbimet publike në periudha krizash. Xhon Mitçëlli, president i shoqërisë së lundrimit *Cunard*, ka pohuar se kishte qenë ftuar të merrte pjesë në grushtin e shtetit, pasi kishin nevojë për anijet e tij. Njëri prej orkestruesve të këtij plani ishte Sër Basil Smalpies, këshilltar financiar i mbretëreshës. Mitçëlli tha:

"Më kërkuan të merrja pjesë në grushtin e shtetit. Thanë se do të kisha parë të përfshirë ushtrinë. Lanë të kuptoja se do të kisha pasur mbulimin financiar më të madh... kalova në gjendje shoku"[80].

Dhe, megjithatë, njerëzit vazhdojnë të besojnë se ideja që ekzistojnë grupe, të cilat manipulojnë të fshehura në errësirë, është një shpikje absurde e ndonjë paranojaku. Në realitet provat për të gjithë këtë dhe për përfshirjen e Uindsorëve janë të pakundërshtueshme. Besojmë me të vërtetë se ky rrjet i formuar nga shërbimet sekrete dhe nga Uindsorët, që ishte duke programuar një grusht shteti të armatosur në Britaninë e Madhe, nuk do të kishte mundur të kurdiste vrasjen e princeshës Dajana, kur kjo filloi të kërcënonte pushtetin e tij? Ç'thoni! Ajo që kam përvijuar në këtë kapitull është vetëm një pjesë shumë e vogël e asaj që do të kishte për t'u thënë mbi Uindsorët, mbi Fisnikërinë e Zezë dhe mbi familjen fashiste zvarranike, që është aktive në Bukingham Palas, për llogari të rrjetit global të Vëllazërisë zvarranike. Uindsorët janë përgjegjësit e fshehtë, nëpërmjet organizatave të tyre globale, për vdekjen e miliona njerëzve. Duke qenë se policia e kontrolluar nga Vëllazëria nuk do të shkojë kurrë të trokasë në portën e Bukingham Palasit, janë njerëzit ata që, sipas meje, duhet të ushtrojnë aq shumë presion mbi këta Uindsorë dhe mbi *establishment*-in e tyre, për t'i detyruar të abdikojnë. Atëherë do të mundim të fillojmë të çmontojmë burimet e tyre të pushtetit, strukturën e jashtëzakonshme, që e ka qendrën në *Siti* të Londrës.

Uindsorët duhet ta mësojnë se loja e tyre ka marrë fund dhe se duhet të fillojnë të mendojnë për të abdikuar e të shpërngulen në Shtetet e Bashkuara. Ka të ngjarë madje që Urdhëri i Ditës i Vëllazërisë ta parashikojë që të abdikojnë shpejt, kush e di? Për zvarranikët, Urdhëri i Ditës është shumë më i rëndësishëm se çdo individ apo familje, deri madje edhe se familja e tyre.

LIBRI 24

Kreu 19

Perëndesha dhe mbreti

Agjencitë që kontrollohen nga kjo intrigë familjesh dhe nga interesa të lidhura me njëra-tjetrën janë përgjegjëse për vrasjen e Dajanës, princeshës së Uellsit. Nuk kam pikë dyshimi për këtë. Por, ju lutem, mos u mbështetni vetëm mbi opinionet e mia; mbani parasysh edhe provat, duke krijuar një opinion tuajin.

Shumë njerëz nuk e pranojnë hipotezën që Dajanën e vranë sepse thonë që nuk është e mundur të vrasësh një njeri në një vend publik e pastaj të fshehësh provat. Përveç kësaj, qe i nevojshëm dhe një bashkërendim mes agjencish shumë të ndryshme. Por, pikërisht kjo ndodhi në Shtetet e Bashkuara, kur vranë presidentin Xhon Ficxherald Kenedi, në vitin 1963, dhe kur, mbulimi i provave që lidhen me vrasjen e tij, qe edhe më i vështirë. Në fakt, nuk u organizua aspak që të dukej si ndonjë aksident. Vrasja e Kenedit qe një vrasje e kryer sipas të gjitha rregullave. Iu hodh truri në erë, me plot kuptimin e fjalës, para qindra njerëzve dhe, e gjithë skena, u bë e pavdekshme nga filmimi i një kalimtari, Abraham Zapruder. Në një tjetër libër timin, e kam trajtuar në mënyrë të thelluar vrasjen e Kenedit dhe aty mund të shihni se, të njëjtët njerëz që kërkuan dhe organizuan atë vrasje, u emëruan më pas si anëtarë të komisionit të "gjykatësit" të parë, njëherësh

masonit të shkallës së 33-të, Ërl Uoren, për të hedhur dritë mbi atë që kishte ndodhur! Mes anëtarëve të komisionit Uoren figurojnë Alen Djuls, shefi i CIA-s që Kenedi e kishte pushuar nga puna dhe përdhunuesi-pedofil, anëtar i Pyllit Bohem dhe pornografi Xherald Ford, që u bë, më pas, president i Shteteve të Bashkuara, kur Riçard Niksoni u largua pas skandalit të Uotergejtit. Kur deputeti Hejl Bogs, katoliku i vetëm në komision, ngriti dyshime mbi përfundimet e hetimeve, vdiq në një aksident ajror. Dhe gjithçka u rregullua më së miri.

Xhim Gerrisoni, prokurori shtetëror i Nju Orlinsit, qe i vetmi që ngriti një akuzë ndaj dikujt për vrasjen e Kenedit. Ky dikush qe agjenti operativ i CIA-s dhe miku i Uinston Çërçillit gjatë luftës, Klei Shou. Por Gerrisoni nuk arriti ta dënonte fajtorin Shou sepse shumë nga dëshmitarët kyç u vranë para hapjes së procesit. Gerrisoni u habit shumë kur konstatoi se si kaq shumë agjenci, në dukje pa asnjë lidhje me njëra-tjetrën, përfshi dhe policinë e Dallasit, FBI-në, shtypin dhe institucionet e Uashingtonit, kishin punuar si një front i vetëm për të kryer vrasjen dhe për të fshehur provat. Kjo u bë e mundur falë organizatave mbi të cilat kam hedhur dritë në këtë libër dhe që kanë futur njerëzit e tyre, zyrtarë dhe lakej, në të gjitha agjencitë e çdo lloj ngjyre. Dyzet vjet pas vrasjes së presidentit Kenedi në një rrugë publike, gjatë një takimi publik, nuk janë hedhur ende hapa përpara në hetime. Si zakonisht, "fajtori" u identifikua menjëherë prej atyre që ishin përgjegjësit e vërtetë dhe u eliminua, në mënyrë që të mos kundërshtonte "rrëfimin" zyrtar. Kështu, në vend të Harvi Li Osualdit të Dilej Plaza të Dallasit në 1963, vendosni Henri Polin në galerinë e Pon de l'Alma në Paris, në 1997. Pas dashit të kurbanit, autoritetet nuk morën në shqyrtim as edhe një version tjetër ndërsa interesi i opinionit publik u fashit qysh pas ndonjë jave, muaji ose viti. Kjo është një teknikë e njohur dhe e vjetër. U vra një president në një vend publik; Li Harvej Osualdi, dashi i kurbanit, u vra po në një vend publik pak ditë më vonë, ndërsa ata që kishin organizuar vrasjet morën pjesë në funerale, as u akuzuan dhe as u dënuan. Ende mendoni se princesha e Uellsit nuk mund të jetë vrarë në një aksident të ngritur me art dhe se kjo vrasje nuk mund të fshihej? Nuk e keni me gjithë mend, besoj.

Ngaqë i kam përshkruar në një libër tjetër prapaskenat e vrasjes së Kenedit, nuk kam ndërmend t'i përsëris këtu, por ka disa elementë të asaj historie që dua t'i shqyrtoj edhe një herë. Familja e Dajanës, Spenser, i përket Elitës, ashtu si dhe ajo e Kenedit, që rrjedh nga klani Kenedi i Irlandës dhe Skocisë së vjetër. Ata janë pasardhës të mbretit irlandez Brajan Boru, i njohur ndryshe si Brajan Kenedi që, më pas, u bë O'Kenedi. Ishin sundimtarët e

Ormondit, ajo që sot përbën pjesën veriore të Kontesë së Tajpererisë[1]. Rreth vitit 1600 mund të gjendet një degë skoceze e Kenedit që u bashkua me linjën irlandeze[2]. Kenedit skocezë u shndërruan në një degë të fuqishme të familjeve aristokrate të Skocisë dhe u martuan me gra nga familjet mbretërore skoceze. Një Kenedi i denjë për t'u përmendur ka qenë Arçibald Kenedi, konti i 15-të i Kesilis, i njohur më mirë si markezi i Ailsas. Jetoi nga 1872 deri më 1943 dhe mbajti detyra të rëndësishme në Lozhën e Madhe të Masonerisë skoceze, përfshi dhe atë të Princit të Madh[3]. Ishte dhe një anëtar i rëndësishëm i Lozhës së Shtëpisë së Kryqit të Shenjtë nr. 44 në Edinburg, e cila ka lidhje të forta me familjen mbretërore britanike[4]. Në shekullin XVIII, një farë Methju Kenedi udhëtoi nga Irlanda në Paris për të punuar bashkë me mikun e tij të ngushtë, njëherësh një nga njerëzit e njohur të Mendjendriturve, me emrin Sen-Zhermen, që kryesonte Lozhën e Mendjendriturve të Ermenonvilit, pranë Parisit[5]. Lozha merrte pjesë në rite të përgjakshme që kryheshin mbi një altar të ndërtuar me eshtra njerëzish[6]. Pikërisht ky Kenedi ka shkruar dhe një vepër me titull "Një disertacion kronologjik, gjenealogjik dhe historik i familjes mbretërore të Sjuartëve dhe lidhjet e saj me dinastinë Merovinjane në Francë. Dega së cilës i përkiste Xhon Ficxherald Kenedi ka lidhje me Fricpatrikët, një familje e fuqishme irlandeze, stema e së cilës përmban simbolet klasike të Vëllazërisë, pra zambakun, dragoin dhe luanin[7]. Duket se origjinat e Fricpatrikëve duhen kërkuar në Francë dhe kanë lidhje me historinë e Graalit të Shenjtë.

Familja e gruas së Xhon Kenedit, Xheki Buvie Kenedi (në vijim, Onasis), ka pasur lidhje me Auçinklosët, një nga familjet më të rëndësishme të Elitës skoceze, përmes martesës së motrës Xheki me një pjesëtar të klanit Auçinklos. Disa nga pasardhësit e familjes Auçinklos morën më vonë mbiemra të tjerë si Bandi, Grosvenor, Vanderbilt, Uinthrop e Rokfeler[8]. Hag D. Auçinklos i vjetri qe martuar me Ema Brjuster Xheningsin, vajzën e Oliver B. Xheningsit, i cili themeloi kompaninë "Standard Oil" bashkë me Xhon D. Rokfelerin. Xhejms Shelbi Dounardi e përshkruan Xheki Kenedi-Onasisin, Kerolin (Li) Buvierin dhe shkrimtarin Gor Vidal si "thjeshtrit" e Hag D. Auçinklosit[9]. Vidali i përshkruan Xhon dhe Xheki Kenedin si "zoti dhe perëndesha e Diellit"[10]. Origjina e familjes Buvie rrjedh nga Grenobla, në Francë, ku përmendet për herë të parë në vitin 1410 ndërsa paraardhësi i Xhekit, Eustash Buvie, kishte luftuar në regjimentin francez nën komandën e Xhorxh Uashingtonit[11]. Më parë, është thënë se Kenedit kishin krijuar lidhje edhe me familjen e dukëve të Devonshajërit të Çatsuërth Haus, një nga familjet më të njohura të Vëllazërisë. Martesa e Xhon Kenedit me Xheki Buvienë qe një martesë më

shumë e rregulluar nga Dega Lindore, familjet amerikane që drejtojnë Shtetet e Bashkuara sipas Urdhërit të Ditës të përcaktuar në Ishujt Britanikë dhe në Francë. Që të dyja këto familje kanë lidhje me qendrat e tyre në Londër dhe në Paris. Fakti që kjo martesë dhe presidenca e Kenedit njihen me emrin "Kamelot", me të gjitha ngjyrimet që lidhen me Mbretin Artur dhe me Marsin, nuk të habit aspak sepse simbolizmi i Mbretit Artur përdorej në Vëllazëri si një gjuhë e fshehtë. Familja Kenedi është përfshirë në trafiqe narkotikësh, në krimin e organizuar, në çështje që kanë lidhje me monarkinë britanike dhe në nisma që parashikonin krijimin e skllevërve të kontrolluar mendërisht, si Projekti Monark. Kjo i bën më të besueshme deklaratat e një skllaveje të tillë mendore të cilën e kam takuar dhe më tregoi se e kishin detyruar të kishte marrëdhënie seksuale me Xhon F. Kenedin kush kishte qenë njëmbëdhjetë vjeç - "megjithëse më bënë makijazh që të dukesha sikur isha gjashtëmbëdhjetë".

Presidenca Kenedi, në fakt, nuk ishte siç e përshkruan atëherë. Kenedi kishte shumë të dashura. Mes tyre, Merilin Monroja, Xhejn Mansfildi dhe Ca Ca Gabori ishin edhe të dashurat e Anton LaVejit, kryetarit të Kishës së Satanit. Xhejn Mansfildi qe një priftëreshë e lartë aty. Mes lidhjeve të tjera jetëgjata të Kenedit mund të përmendim ato me dy pjesëtare të familjes së Elitës skoceze. Ledi Xhin Kempbell, vajza e dukës së Argillit dhe Kej-Kej Hanon Auçinklosin[12] nga familja me të cilën kishte lidhje gruaja e tij. Pas kësaj ngjitjeje të Xhon Kenedit qëndronte i ati i tij, Xhozef Kenedi, anëtar i "Pilgrim Soshajëti" që ndodhej në krye të Vëllazërisë. Ky qe një batakçi i lidhur me mafien dhe organizata të tjera kriminale. Pasurinë e vuri kur Uinston Çërçilli i dha licencën e importit në Shtetet e Bashkuara të pijeve alkoolike nga Britania e Madhe. Xhozef Kenedi ishte mik me Rotshildët dhe Bronfmanët, një familje tjetër kriminale kjo e "hebrenjve" të Kanadasë, pronare e prodhuesit gjigand të pijeve alkoolike "Sigrams". Mes personave me të cilët shoqërohej Xhozef Kenedi në Rrethin e Shën Xhejmsit në Britaninë e Madhe, kur ishte ambasador i Shteteve të Bashkuara, figurojnë edhe Astorët dhe pasardhësit e Rotshildëve, Sasunët. Një mik i ngushtë i tij ka qenë dhe Sër Xhon Uiler-Benet, një nga drejtuesit e Institutit mbretëror të punëve të jashtme. Gruaja e Xhozef Kenedit, Roz, rridhte nga familja Ficxherald e Fisnikërisë së Zezë. Ficxheralët ishin një nga klanet më të fuqishme të Fisnikërisë së Zezë të Italisë që, në 1066-ën, mbështetën pushtimin e Anglisë nga ana e francezit Gijom Pushtuesi. Në këtë mënyrë, Fisnikëria e Zezë vendosi sundimin e vet mbi ishujt britanikë përmes familjeve të vjetra siç ishte ajo Sen Kler / Sinkler. Kështu, shkronja F e emrit Xhon F. Kenedi nuk është gjë

tjetër veçse iniciali i një familjeje të Fisnikërisë së Zezë që na kthen mijëra vjet më parë. Babai i Rozit dhe gjyshi i Xhon F. Kenedit ishte Xhon F. (Hani Fic) Ficxherald, kryetari i bashkisë së Bostonit. Ficxheraldët jetonin në Boston, në Hanover Strit, pranë vendit ku ndodhej dikur Taverna e Dragoit të Gjelbër, në të cilën qe krijuar Lozha e Shën Andreas që u përfshi, më pas, në manipulimin e luftës së pavarësisë dhe orkestroi të ashtuquajturën Boston Ti Parti[13].

Xhozef Kenedi qe anëtar i Urdhrit të Shën Gjonit, varianti anglez i Kalorësve të Maltës, dhe familja Buvie u lidh me atë Raciuilis e cila, në vitin 1610, kishte themeluar Kalorësit e Shën Gjonit / Kalorësit e Maltës në Poloni dhe ndihmoi në forcimin e urdhrit në Shtetet e Bashkuara[14]. Kenedit mbështetën lëvizjen e Bujtinës së Kalorësve të Maltës në Shtetet e Bashkuara, përmes Institutit Kenedi për studimin e riprodhimit njerëzor dhe bioetikës në Universitetin Xhorxhtaun, i cili kontrollohej nga jezuitët. Lëvizja e Bujtinës, megjithëse e maskuar si një lëvizje bamirësie, në të vërtetë qe një lëvizje fasadë që u finalizua duke siguruar një mbështetje të madhe për eutanazinë. Pjesa më e madhe e njerëzve të përfshirë në këtë lëvizje nisen nga mëshira por këtu unë po flas për ata që i manipulojnë këto lëvizje. Sepse, pasi të ligjërohet eutanazia, do t'i hapet rruga edhe vrasjeve të ligjëruara të atyre që Kisingeri i quan "gojët e padobishme që duhen ushqyer". Siç është dokumentuar mirë në biografitë e tij të shumta, Xhon F. Kenedi ka kaluar një fëmijëri pa dashuri, ndërsa u edukua nën rregullat e rrepta të të atit Xho dhe të nënës Roz. Lindjen e të vëllait Fredi as morën mundimin t'ia tregonin dhe vetëm pasi u kthye në shtëpi nga shkolla zbuloi se kishte një vëlla të ri. Mes vëllezërve Kenedi nuk pati asnjë përqafim, asnjë shfaqje dashurie, madje, as edhe një shfaqje vuajtjeje ndaj njëri-tjetrit. Edukimi i Kenedit na tregon të gjithë elementët tipikë të teknikave të kontrollit mendor që përdor Elita me bijtë e vet. Edhe princi Karl i është nënshtruar po të njëjtës teknikë edukimi nga i ati agresiv dhe i pakëndshëm, princi Filip. Xhon F. Kenedi u ngarkua qysh në moshë të njomë me detyra të larta që duhet t'i kryente për llogari të Vëllazërisë dhe u mbështet nga të gjithë emrat e njohur si Rotshildët, Taftët, Rokfelerët dhe baronët e medias si Henri Lus, shefi i "Time-Life" dhe Randolf Herst, manjati më i fuqishëm i gazetarisë amerikane. Kur Kenedi u fut në politikë, gazeta e Bostonit, në pronësi të Herstit, nuk pranoi t'i jepte asnjë hapësirë publicitare kundërshtarit të tij[15].

Por, pasi mundi Riçard Niksonin më 1960, Xhon F. Kenedi dhe vëllai i tij Bobi u bënë përkatësisht president dhe prokuror i përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara, ku nisën të zbatonin politika që ishin në kundërshtim me planet

e financuesve të tyre. Mes këtyre lëvizjeve ishte tërheqja nga lufta e Vietnamit, futja e kuotave të parave pa interes, lufta kundër krimit të organizuar (të paktën, në nivelin publik) dhe, siç thoshte Kenedi, një premtim për të ndarë CIA-n "në njëmijë pjesë". Nuk ka rëndësi kush je, po nuk bëre atë që të thonë të bësh, do të eliminohesh me çdo lloj mjeti, edhe nëse i përket një familjeje anëtare të Vëllazërisë. Urdhëri i Ditës është më i rëndësishëm se cilido individ apo familje. Nuk mund të besoj se ka pasur arsye të tjera pas kësaj vrasjeje që kishte pamjen e një vrasjeje sakrifice të menduar prej kohësh, sipas ligjeve dhe ritualeve të Vëllazërisë. Vendi ku u krye flijimi, Dallas, në Teksas, është pranë paralelit 33°, pra në gradën e 33-të hierarkisë. Maja e Ritit Skocez të Masonerisë është grada e 32-të, ndërsa grada e 33-të u rezervohet vetëm atyre që kanë kontribuar në mënyrë domethënëse për Veprën e Madhe, pra, për pushtimin e planetit Tokë. Dilej Plaza është një përqendrim simbolesh ezoterike dhe e ka marrë emrin zyrtar nga një mason i shkallës së 33-të, Xhorxh Banerman Dilej, një nga drejtuesit e parë të gazetës "Dallas Morning Njuz". "Dilej" do të thotë "linja ose vija e perëndeshës". "Lej" do të thotë edhe "rregull" ose "ligj" në gjuhën spanjolle, kështu që, një përkthim tjetër i mundshëm i kësaj fjale do të ishte "ligji i perëndeshës". Të dy variantet, sidomos i dyti, kanë një vlerë të madhe simbolike për Vëllazërinë. Dilej Plaza, vendi ku qe ngritur tempulli i parë i masonëve të Dallasit, ka formën e një piramide por pa kulm (shih **Figurën 51**). Aty ku duhet të ishte kulmi, ndodhet një urë hekurudhore. Piramida kryesore ndahet në dy piramida më të vogla nga Mein Strit, e cila kalon nëpër qendrën e saj. Kështu që bëhet fjalë për tri piramida, dy të vogla brenda një të madheje: triniteti ose treshja. Dy energji që ndërveprojnë mes tyre dhe prodhojnë një formë të tretë energjie. Nëse dikush mendon se bëhet fjalë për një rastësi të thjeshtë, ndoshta duhet të informohet pak më mirë për sfondin e shoqërive të fshehta të Vëllazërisë dhe të verifikojnë maninë e pabesueshme që ushqejnë ndaj simboleve dhe ritualeve të tyre. Kenedi u vra pranë së ashtuquajturës kodërza me bar, në të djathtë të piramidës, ndërsa Li Harvi Osualdi u vra ndërsa "ruhej" nga policia në një parkim nëntokësor, pranë bazës së piramidës së Hjustën Strit. Vetëm pak metra e ndajnë njërin vend nga tjetri. Ndërtesa e vjetër e gjykatës që shikon nga Dilej Plaza është zbukuruar me koka ulluku me skulptura. Mbi çatinë e gjykatës duket simboli i Urdhrit të lashtë të Dragoit ose Giarprit. Për shoqëritë e fshehta, Dilej Plaza është një tempull i Diellit.

Kenedi u vra në një tempull në qiell të hapur që i ishte kushtuar Diellit nga themeluesit e rrjetit të Vëllazërisë, mes të cilëve Kalorësit Tempullarë, Kalorësit e Maltës, Urdhri i Shën Gjonit të Jeruzalemit, Rozikrucianët dhe

Masonët. Siç shkruan Xhejms Shelbi Daunuordi: "Masoneria nuk vret kurrë asnjë njeri rastësisht dhe, në rastin e vrasjes së Kenedit, kaloi çdo cak dhe u përball me rreziqe të mëdha me qëllim që veprimi që po përgatiste të përputhej në gjithçka me ritin e lashtë të flijimit për t'u pajtuar me pjellorinë, që ishte Vrasja e Mbretit"[16].

Kenedi u qëllua pak pas mesditës, kur dielli ndodhej në pikën e tij më të lartë. Në lashtësi thuhej se, kur dielli ndodhet në pikën më të lartë në qiell, kryen punën e tij të atit në kohë (simbole të tjera të këtij lloji gjenden edhe në historinë e Jezusit). Kenedi u qëllua në shpinë, në kokë dhe në grykë dhe këto plagë iu shkaktuan edhe mitikut Hiram Abif, sipas legjendës dhe fillesave malonike. Bill Kuperi, një ish punonjës i shërbimeve të fshehta të marinës amerikane, beson se heroi mitik mason Hiram Abif, në fakt, është simboli i Zhak dë Molej, Mjeshtërit të Madh të Kalorësve Tempullarë në kohën e dëbimit të tyre nga Franca në vitin 1307. Dë Molej u dogj i gjallë në Il dë la Sité, qendrën e Parisit, nën hijen e Katedrales Notrë Dam, të cilën tempullarët e kishin ndërtuar mbi një vend të lashtë adhurimi për perëndeshën Diana. Vrasja e tij u urdhërua nga gjyqi katolik i Inkuizicionit me mbështetjen e mbretit Filipi i Bukur, i cili mund të kontrollohej fare mirë nga Manastiri i Sionit. Kuperi thotë se vrasja e Xhon F. Kenedit qe hakmarrja e Kalorësve Tempullarë kundër Kishës, shtetit dhe popullit. Kenedi ishte presidenti i vetëm katolik i Shteteve të Bashkuara, pra, i përkiste të njëjtës Kishë që kishte vrarë Zhak dë Molejin. Sot, në Dilej Plaza, pranë vendit ku u vranë Kenedi dhe Osualdi, mund të shihet obelisku që ngritën masonët pas këtyre vrasjeve. Obelisku, sipas legjendës egjiptiane, simbolizon penisin e Osiridit. Obelisku në Dilej Plaza ka në majë një flakë apo një pishtar të ndezur (shih pjesën e ilustrimeve). Flaka e përjetshme në varrin e Kenedit në varrezën e Arlingtonit ndodhet aty po për të njëjtën arsye. Flaka ose pishtari i ndezur është firma më e pakundërshtueshme e Vëllazërisë. Te varri i Kenedit, flaka është mbyllur brenda një rrethi, simboli i lashtë i diellit. Trupi i Kenedit u ekspozua, sipas




Figura 51. Piramida pa kulmin. Këtu, në Dilej Plaza, u vra Xhon F. Kenedi.

ceremonisë zyrtare, në qendër të një rrethi, brenda Kapitol Hillit. Obeliskun në Dilej Plaza përbëhet nga 14 gurë dhe ky numër përputhet me copat në të cilat u nda Osiridi nga Seti, sipas mitit egjiptian. Copa e vetme që gruaja-motër e tij, Iside, nuk mundi të gjente, ishte pikërisht penisi, që simbolizohet përmes obeliskut. Kështu që ajo ia zëvendësoi Osiridit penisin me një që e ndërtoi vetë dhe që u shndërrua më pas në simbolin e Vëllazërisë. Obelisku në Dilej Plaza u ndërtua dhe iu kushtua një lozhe malonike të Ritit Skocez. Nëpër kisha dhe katedrale jo rrallë janë gjetur simbole të penisit të fshehura nëpër altarë dhe, kur skuadra e hetuesve të prokurorisë së Nju Orlinsit bastisi shtëpinë e Klei Shout, gjeti disa të tillë.

Në këtë libër jam ndalur te parimet bazë të gjuhës së fshehtë, por nivelet deri ku arrin kjo gjuhë janë të pabesueshme. Shkenca e numrave dhe e emrave është një nga nivelet më të thella të komunikimit dhe simbolizmit dhe vetëm një anëtar i shkallëve të larta ose studiuesit e fushës mund t'i kuptojnë plotësisht. Numrat dhe emrat janë frekuenca vibruese ndërsa sinkronizmi i tyre i mahnitshëm i kushtohet, besoj, një ligji që unë e quaj tërheqja vibruese. Shumë nga "rastësitë" që kanë lidhje me numrat dhe emrat ndodhin sepse dikush ka dashur që të ndodhin, të tjera kanë të bëjnë thjesht me fushën e energjisë, ndërgjegjen e personit apo të personave që tërheqin drejt vetes fusha vibruese të cilat sinkronizohen me energjinë që prodhojnë. Kështu e krijojmë ne realitetin ku jetojmë. Uni i brendshëm, fusha jonë e vetëdijes vibruese, tërheq "fusha" të tjera – njerëz, vende, mënyra jetese, përvoja – që sintonizohen me energjinë që prodhojmë ne. Bëhet fjalë për një tërheqje vibruese mes fushave të energjive të ngjashme. Prandaj, përvoja jonë e jashtme fizike është një pasqyrim i pastër i asaj që ndodh brenda nesh. Atë që projektojmë si vibrime përmes sjelljeve dhe emocioneve e tërheqim përsëri drejt nesh në formën e njerëzve, vendeve, mënyrave të jetesës dhe përvojave që vibrojnë me të njëjtën frekuencë të cilën kemi projektuar ose transmetuar ne. Prandaj, kur ndryshojmë atë që ndodh brenda nesh, ndryshojmë edhe përvojën materiale sepse njëra është pasqyra e tjetrës. Kjo tërheqje "magnetike" mes vibrimeve të ngjashme që na bën të priremi drejt njerëzve të tjerë që jetojnë në një rrugë me një emër të veçantë ose drejt krijimit të marrëdhënieve me njerëz që kanë një emër të caktuar, etj, sepse çdo gjë ka kodin e saj vibrues, përfshi edhe tingujt, numrat, fjalët, ngjyrat dhe emrat. Në magjinë rituale, tinguj, fjalë, formula magjie e ngjyra të caktuara përdoren për të krijuar fushën e dëshiruar energjetike ose vibruese. Tingulli është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ja përse fenikasit merakoseshin më tepër për tingëllimin e fjalëve që përdornin sesa për mënyrën se si shkruheshin ato.

Mantrat, apo përsëritjet e vazhdueshme të së njëjtës fjalë ose tingull, ishin pjesë e kësaj kulture. Dhe, si çdo mjet tjetër, mund të përdoren për qëllime pozitive ose negative. Stërvitja e luftëtarëve japonezë samuraj përfshinte dhe mësime mbi modulimin e thirrjes luftarake, të ashtuquajturën "Kiai". Mendohet se kjo thirrje shkakton një farë uljeje të trysnisë së gjakut dhe një paralizë të pjesshme të atij që e dëgjon. Prandaj thuhet ndonjëherë se thirrja "të ngrin gjakun". Thirrjet me frekuencë të ulët, me tre deri në pesë dridhje për sekondë, mund edhe të vrasin. Studiuesi amerikan Xhejms Shelbi Daunard ka kryer disa studime në shkencën e tingujve, numrave dhe emrave, lidhur me vrasjen e Kenedit. Sipas Robert Anton Uillsonit, autor i librit "Kozmik Triger", teoria e Daunardit është "më absurdja, më e pabesueshmja dhe më qesharakja mbi Mendjendriturit". Ky është një pohim më tepër i faktit se Daunardi po ecte në pistën e duhur. Edhe kërkimet që kam kryer vetë më kanë çuar në këtë drejtim.

Kenedi u vra në 22 nëntor 1963. Atë ditë përkujtohej përvjetori i urdhrit të Papës Klementi V që autorizonte Inkuizicionin dominikan të niste torturat ndaj Kalorësve Tempullarë. Ky urdhër ishte lëshuar më 22 nëntor 1307. Nëntori është muaji i njëmbëdhjetë dhe, nëse i shtoni atij numrin 22, do të merrni përsëri 33. Xhon dhe Xheki Kenedi u nisën nga Fort Uorthi mëngjesin e 22 nëntorit 1963 dhe avioni u ndal në hyrjen 28 të aeroportit Lova Fild, në Dallas. Numri 28 është i çiftëzuar me emrin "Beale" sipas numerologjisë së kabalasë solomonase. *Beale* është një fjalë që ka pësuar disa ndryshime: Bel (El), Baal, Be al, Beal, Beale. Të gjitha këto fjalë tregojnë hyjni diellore. Shkalla e 28-të e Kalorësve Tempullarë është "shkalla e mbretit Diell". Xhon F. Kenedi ka lindur në banesën numër 83 në rrugën Beal, në Bruklin, Masaçusets, më 29 maj 1917. Shërbimi i "shoqërimit" të presidentit gjatë kësaj vizite fatale në Dallas qe organizuar nga dega e CIA-s e Nju Orlinsit, me seli pranë një tempulli masonik. Dallasi ndodhet afro pesëmbëdhjetë kilometra në jug të gjerësisë gjeografike 33°. Vargu i makinave të Kenedit kaloi rrugën Elm, ku dikur gjendej *Blu Front Tavern*, një vend takimi për masonët, dhe në orën 12:22 mbërriti në Dilej Plaza. Rruga Elm njihej ndryshe me emrin rruga "e përgjakshme" Elm, pasi në të kishin ndodhur shumë përplasje me armë dhe thika si dhe akte të tjera dhune. Në këtë rrugë ndodhen edhe zyrat kombëtare të *Teksako Oil*. Pranë Dilej Plaza rrjedh lumi Triniti i cili, dikur, përmbyste vazhdimisht sheshin, deri sa u ndërtuan disa mbrojtëse të posaçme kundër vërshimeve. Në këtë tempull nën qiell të hapur të Vëllazërisë së dikurshme mbërritën Xheki Kenedi, simboli i perëndeshës, mbretëresha e Dashurisë dhe Bukurisë, dhe dashi i kurbanit, mbreti Diell, Xhon F. Kenedi. Ai qe viktima

LIBRI 24

që do të flijohej në ritualin e lashtë që kërkon vrasjen e mbretit Diell: qe "Ceannaideach" që, në gjuhën galike, do të thotë Koka e Plagosur. Kenedi, sigurisht, u vra me një goditje në kokë. Kam marrë vesh nga burime shumë të besueshme se nuk vdiq para pranverës së ardhshme. Sipas këtyre burimeve, Kenedi që dukej si i pajetë nëpër fotografi ishte Xh. D. Tipeti, një polic sozi i Kenedit që thuhet se ishte vrarë nga Osualdi me një pushkë që nuk punonte!

Kur ishte 22 vjeç, Kenedi u përjetësua në një skulpturë që e tregonte si një engjëll me flatra; skulptura iu dhurua Vatikanit dhe u vendos brenda një kompleksi monumental ku engjëlli fluturon përmbi kokën e shenjtores Terezë që po bëhet gati të shkruajë[17]. Pas vrasjes, Kenedi u quajt disa herë "engjëlli" dhe, me të njëjtën fjalë, u quajt edhe aeroplani *Air Fors 1* që transportoi trupin e tij deri në Uashington[18]. Si Kenedi, ashtu dhe Osualdi, u varrosën në vende që kishin lidhje me "Arlingtonin". Kenedi në varrezën kombëtare të Arlingtonit, pranë Uashingtonit dhe Osualdi në varrezën Rozhill, pranë Arlingtonit, në Teksas. Arlington është një fjalë e lidhur me shtriganinë masonike dhe, në veçanti, me nekrofilinë, tërheqjen e sëmurë ndaj kufomave. Osualdi quhet shkurt Os ose Oz, perëndia egjiptiane Osirid, si te Magjistari i Ozit. Nëse ju interesojnë përkimet që paraqet shkenca e emrave dhe numrave, mendoni për rastësitë e mahnitshme mes vrasjes së Xhon F. Kenedit dhe Abraham Linkolnit, i cili u vra, po ashtu, nga Vëllazëria. Linkolni u zgjodh në Kongres në 1846 ndërsa Kenedi më 1946. Linkolni u zgjodh president në 1860, Kenedi në 1960. Vrasësi i Linkolnit, Xhon Uilks Buth lindi në 1839 ndërsa Li Harvi Osualdi, vrasësi i hamendësuar i Kenedit, lindi në 1939. Që të dy pasuesit e tyre quheshin Xhonson. Endrju Xhonson, që pasoi Kenedin, kishte lindur më 1808 ndërsa Lindon Xhonson, që pasoi Linkolnin, kishte lindur më 1908. Sekretarja e Linkolnit quhej Kenedi, sekretarja e Kenedit quhej Linkoln. Që të dy presidentët u vranë të premten, para syve të grave të tyre dhe që të dy vdiqën nga një goditje në kokë.

Zvendëspresidenti i Kenedit, Lindon Bains Xhonson e dinte qysh më herët për vrasjen dhe, sapo u bë president, përmbysi tërësisht zgjedhjet politike që kishin të bënin me Vietnamin, paratë pa interes dhe CIA-n, të cilat kishte nisur të zbatonte Kenedi. Perëndesha Nënë e Vëllazërisë, Arizona Uilder, thotë se ka parë vetë se si ai reptil kishte ndryshuar formë duke marrë pamjen e Xhonsonit, ndërsa merrte pjesë në ritualet flijuese. Emri i dytë i Xhonsonit, Bains, rrjedh nga klani skocez Bain, Baine, Bethi, Bini, Bith dhe Beth. Masonët me prejardhje nga ky klan kanë të njëjtët paraardhës me të[19]. Termi "Mek" do të thotë "biri i" dhe kështu "biri i Bainit" bëhet MekBain ndërsa klani i afërt me të, ai Beth, u bë MakBeth, mbreti skocez që u bë i famshëm në mbarë

botën falë veprave të "Uilliam Shekspirit" (Frensis Bejkën). "Bain" në frëngjisht do të thotë "banjë" dhe prej këtej ka rrjedhur dhe emri i Urdhrit të Bath-it që akordohet nga sovrani britanik. Para se të vrasin ose të shkaktojnë rrëmuja për llogari të Vëllazërisë, "Kalorësit e Bath-it" i nënshtrohen një banje pastrimi. Pas vdekjes së bashkëshortit, Xheki Kenedi kreu një udhëtim në ishullin Delo në Detin Egje i cili, sipas legjendës, është vendi ku kanë lindur perëndesha Diana dhe zoti i Diellit, Apolloni. Diana (hëna) dhe Apolloni (dielli) shfaqen shpesh përkrah njëri-tjetrit në simbolizmin e Vëllazërisë. Delo njihet ndryshe edhe si Ishulli i të Vdekurve sepse thuhet që një personifikim tjetër i perëndeshës Diana, e njohur si Hekata, është dhe ai i mbrojtëses së "arteve të ferrit". Xheki shkoi në Tempullin e Apollonit në Delfi, në Greqi, dhe, brenda një teatri grek, kreu një rit të lashtë të njohur si Përshëndetja e Diellit. Në këtë rit, sipas Xhejms Shelbi Daunardit, ajo u ndihmua nga "mjeshtëria e Aleister Kroulit"[20]. Një ndalesë tjetër u krye në ishullin e Santorinit, të famshëm për historitë me vampirë. Origjina e historive me vampirë duhet kërkuar në ato rite të Vëllazërisë në të cilat kërkohej thithja dhe pirja e gjakut, si në ato rite ku pretendohet të "thithet" energjia. Historitë me vampirë na lejojnë që ta shohim në sy të vërtetën, në atë mënyrë që të na shtyjë të besojmë se bëhet fjalë vetëm për fantazi. Kjo është diçka që Vëllazëria pëlqen ta arrijë përmes mjetit të saj më të madh të komunikimit, Hollivudit, një emër që rrjedh nga shkurrja e ashes (=*holly*), pyllit (=*wood*) të shenjtë (=*holy*) të magjistarëve druidë. Thuhet se Hollivudi është një vend magjik. Dhe është vërtet. Luan me mendjet tona dhe na manipulon iluzionet.

Ka shumë ngjashmëri mes vrasjes së Kenedit, vrasjes rituale të mbretit Diell, dhe asaj të princeshës Dajana që, sipas meje, qe një ritual flijimi i perëndeshës së Hënës e cila, për të lashtët, qe Diana. Ishte vendosur përpara se të bëhej president që Kenedi të vdiste në atë vend dhe në atë orë kohë dhe, po kështu, besoj se Dajana qe e destinuar të vdiste në atë orë e në atë vend të Parisit qysh shumë kohë përpara. Ka të ngjarë që kjo të jetë programuar qysh prej fëmijërisë së tyre, qysh nga lindja. E di se mund t'ju duket pak e zmadhuar, por kur hyn pak thellë në punët e Vëllazërisë, e kupton se anëtarët e saj nuk i hartojnë planet javë e muaj më përpara, por shekuj më përpara. Nga ai nivel i poshtëm i përmasës së katërt, ata gëzojnë një perspektivë shumë më të ndryshme të kohës nga ajo që kemi ne. Në krerët e fundit do të ndalem në mënyrë më të thelluar në këtë çështje dhe në vëmendjen që paraqesin këto rituale flijimi. Vrasja e katolikut Xhon F. Kenedi, mbretit Diell, për të kujtuar përvjetorin e përndjekjes që Kisha romane u bëri Kalorësve Tempullarë (ose ndonjë lloj tjetër rituali), mund të ishte projektuar qysh disa dhjetëvjeçarë

LIBRI

më herët ndërsa viktima që do të flijohej mund të jetë shtyrë qëllimisht drejt asaj karriere politike. Në të njëjtën mënyrë, fakti që Dajana kishte lindur në 1961 dhe i përkiste familjes Spenser mund të ketë qenë vendimtar që ajo të shndërrohej në simbolin e Dianës dhe, njëherësh, në një viktimë që do të flijohej në një kohë dhe në një vend të shenjtë kushtuar Dianës, në galerinë Pon dë l'Alma, në Paris. Mendoj se ka shumë mundësi që gjërat të kenë shkuar kështu. Ashtu siç janë kryer manovra të ndryshme për të shtyrë Kenedin drejt presidencës në 1960 dhe për ta flijuar pastaj, në 1963, po kështu mund të jenë rregulluar gjërat që Dajana të martohej me princin Çarls dhe, pastaj, ta mbyllte jetën në galerinë Pon dë l'Alma. Njerëzit besojnë se organizimi i vrasjes së Dajanës duhet të përfshinte një planifikim të vështirë dhe shumë kohë. Po, ka shumë të ngjarë të jetë kështu. Por koha nuk u mungonte.

Dajana Frensis Spenser lindi në Park Haus, në vilën mbretërore të Sandringemit, në Norfolk, më 1 korrik 1961, vajza e tretë dhe e fundit e viskontit të Althorpit, në vijim konti i tetë Spenser, dhe gruas së tij, Frensis Roshe. Prindërit u ndanë kur ajo qe gjashtë vjeç ndërsa ligjërisht e hodhën këtë hap në 1969. E ëma u martua pastaj me manjatin e letrës së mureve Piter Shand-Kid. Dajana kishte një vëlla më të vogël, Çarlsin, kontin e sotëm Spenser, dhe dy motra, Xhejn dhe Sara. Para Dajanës kishte lindur dhe një fëmijë tjetër por kishte vdekur dhe ajo qe e bindur se prindërit do të kishin dashur, në vend të saj, një trashëgimtar mashkull. Dajana thoshte se kishte kaluar një fëmijëri aspak të lumtur dhe, gjatë jetës së saj të shkurtër duhet të synonte vazhdimisht atë dashuri dhe ngrohtësi që nuk e kishte pasur në fëmijëri. Ngaqë kishte jetuar në Sandringem e kishte njohur mbretëreshën që në vogëli dhe kishte luajtur shpesh me fëmijët e saj. Thuhet se Çarlsi e kishte takuar për herë të parë Dajanën kur ajo qe ende e vogël, në karrocë. Asaj i kujtohej, megjithëse pa ndonjë ndjenjë malli, se çdo vit, gjatë pushimeve, e dërgonin në rezidencën e mbretëreshës ku shihte filmin *Çiti Çiti Bang Bang*. Përzgjedhja e filmit është interesante ngaqë autori i librit prej të cilit është krijuar filmi është Jan Flemingu, një agjent i shërbimeve të fshehta, mik me Aleister Kroulin dhe autori i romaneve të Xhejms Bondit. Filmi flet për një mbret e një mbretëreshë që i urrejnë fëmijët. Pajtojnë një rrëmbyes fëmijësh i cili i kap ata dhe i fut në një kafaz. Pastaj dërgohen në një kështjellë ku i mbyllin në një burg të nëndheshëm. Sipas të gjitha kuptimeve simbolike të realitetit, sigurisht që nuk mund të besohet se Uindsorët ia shfaqnin rastësisht këtë film Dajanës. Sigurisht që Dajana po thithte "vibrimet" e Uindsorëve në Sandringem. Në fakt, i kishte thënë Endrju Mortonit, siç e tregon vetë ky në një libër që ka shkruar: "Sa herë shkoja atje, gjeja një atmosferë të çuditshme

dhe zakonisht, i godisja me grushte e shqelma ata që më detyronin të shkoja."[21] Pra, Uindsorët i kishin pasur idetë e qarta për Dajanën, qysh nga lindja e saj. Kur ishte 13 vjeç, kur i ati trashëgoi titullin e kontit Spenser, Dajana u transferua nga Norfolku në Althorp, në Northampronshajër, vendlindjen e familjes Spenser. Dajanës nuk i pëlqeu aspak kur i ati u martua me Rainen, vajzën e shkrimtares Barbara Kartland, sepse nuk e duronte dot atë. Në librin "Dajana: historia e saj e vërtetë", ajo tregon se si, në shtator 1989, ia derdhi Raines të gjitha mërzitë që kishte mbledhur ndër vite: "I thashë se çfarë mendoja për të. Nuk kisha provuar ndonjëherë një inat të tillë. Mbaj mend se iu zbraza keq. I thashë: Veç ta dish sa shumë të urrejmë për atë që na ke bërë, shkatërrove shtëpinë (Althropin), harxhove të gjitha paratë e babait dhe për çfarë?" Prekshmëria që Dajana ndjente ndaj personave me probleme emotive rridhte nga shenjat që mbajti me vete për tërë jetën.

Spenserët i përkasin Elitës. Janë kushërinj me Spenser-Çërçillët dhe kanë lidhje me familjen Marlboraf të Pallatit Blenhajm, në Oksfordshajër, ku ka lindur Uinston Çërçilli. Mes paraardhësve të tyre figurojnë dhe duka i Marlborafit dhe sër Robert Uolpoli. Familja Spenser trashëgoi një pasuri të majme nga Sara, dukesha e Marlborafit. Spenserët krijuan lidhje familjare edhe me Kavendishët, dukët e Devonshajërit të Çatsuërth Haus dhe kjo degë u njoh më pas si Spenser-Kavendish. Dajana dhe princi Çarls kishin disa paraardhës të përbashkët si duka i tretë i Devonshajërit dhe, mbi të gjitha, mbretin Xhejmsi I, mbretin e parë Stjuart të Anglisë dhe Skocisë dhe financierin Frensis Bejkën. Mbreti Xhejms i dha një rol mjaft domethënës zgjerimit të Vëllazërisë, duke krijuar *Virxhinia Kompani* e cila zotëron ende dhe sot Shtetet e Bashkuara dhe duke botuar variantin biblik mbi mbretin Xhejms. Edhe Dajana rridhte, në disa rrugë të ndryshme, nga mbretërit Stjuart, Çarlsi II dhe Xhejmsi II të cilët e lidhnin, si në rastin e Xhejmsit I, me dinastinë franceze të Merovinjëve. Çarlsi II kishte aq shumë fëmijë jashtë martese saqë vetëm zoti e di se ku mund të jenë shpërndarë sot pasardhësit e tij. Një gjë është e sigurt, që Vëllazëria e di se ku ndodhen. Siç ndodh me të gjitha familjet e Elitës, Spenserët janë një degë e rëndësishme ndërsa Dajana kishte lidhje me shumë familje aristokrate, përfshi dhe atë të kontëve Lukan. Për më tepër, Spenserët kanë lidhje gjaku edhe me shumë familje amerikane. Lidhje të largëta kanë edhe me familjen Rokfeler. Ata kanë një histori të gjatë shërbimi ndaj mbretit dhe tradita qe mbajtur gjallë edhe nga i ati i Dajanës. Ai ka qenë shqytar i mbretit Xhorxhi VI (i cili u martua me nënën mbretëreshë) dhe i mbretëreshës Elizabet. Motra e Dajanës, Xhejn, u martua me sër Robert Fellous, sekretari privat i mbretëreshës në kohën kur vdiq Dajana. Që të dyja

LIBRI

gjyshet e Dajanës, kontesha Spenser dhe Ruth Ledi Fermoj, i përkisnin rrethit të ngushtë të nënës mbretëreshë, ashtu si dhe katër hallat e saj. Spenserët dhe nëna mbretëreshë qenë shumë miq ndërsa martesën e Dajanës me princin Çarls e lidhën vetë Ledi Fermoj dhe nëna mbretëreshë. E gjitha kjo merr një domethënie të veçantë nëse mendojmë se cila është natyra e vërtetë e nënës mbretëreshë.

Numërimi mbrapsht për martesën nisi kur Dajana takoi princin Çarls në Althorp, ndërsa ky kishte një marrëdhënie me motrën e saj, Sara, në vitin 1997. Dajana qe 16 vjeç por vetëm pas tre vjetësh Uindsorët nisën t'i përkushtohen seriozisht asaj. Me nënën mbretëreshë dhe Ledi Fermojin që thurnin planin pas kuintave, Dajana u ftua në një ballo në Pallatin Bakingem me rastin e 30 vjetorit të Çarlsit. Atëherë, në korrik 1980, një mik i Çarlsit, Filip dë Pas, i kërkoi të qëndronte me ta, në prani edhe të princit. Për ta thënë me fjalët e Dajanës, Çarlsi u rrëmbye prej saj dhe "praktikisht m'u qep hapur"[22]. I kërkoi të vizitonte me të Pallatin Bakingem ditën tjetër ndërsa, në shtator, e ftoi të kalonte pushimet bashkë me Uindsorët në rezidencën skoceze të Balmoralit. Më vonë, Çarlsi i kërkoi të martoheshin dhe ajo pranoi. "Të dua shumë" i tha Dajana. "Çfarë është dashuria?" i qe përgjigjur Çarlsi[23]. Kjo frazë e Çarlsit do të thotë shumë për Uindsorët dhe mënyrën se si i kishin rritur fëmijët. Ata nuk e kuptojnë se ç'është dashuria sepse japin dhe marrin shumë pak prej saj. Përfytyrojeni pak veten sikur jeni fëmijë dhe duhet të qëndroni në radhë, bashkë me të tjerët, që t'i shtrëngoni dorën mamasë suaj kur sapo është kthyer nga një vizitë nga përtej oqeanit. Kështu e trajtonin Çarlsin mbretëresha dhe princi Filip. Dajana punonte si edukatore kopshti kur historia e lidhjes doli në të gjitha gazetat dhe projektorët u drejtuan mbi të. Nga ai çast, nisi edhe makthi i saj me Uindsorët. Dajana e kuptoi me vonesë se Çarlsi nuk kishte qenë kurrë i sinqertë në ndjenjat që thoshte se ushqente për të. E kishte nuhatur qysh para martesës se ai kishte një lidhje me dashurinë e tij të vërtetë, Kamila Parker-Bouls e cila vazhdoi dhe u shtua pas martesës. Çarlsi dhe Kamila komunikonin duke përdorur emrat e koduar "Gledis dhe Fred". Kamila, ashtu si Uindsorët, qe e afërt me Rotshildët dhe, në përvjetorin e parë të vdekjes së Dajanës, ndodhej në ishullin e Korfuzit në detin Jon, ku po përfitonte nga mikpritja e lordit Xhakob Rotshild[24]. Ai kishte shpenzuar plot 16 milionë sterlina për të marrë dhe restauruar një banesë të shekullit të tetëmbëdhjetë të Spenserëve në Grin Park në Londër, pranë Pallatit Bakingem[25].

Uindsorët donin që Dajana t'u jepte trashëgimtarë nga gjaku Spenser dhe, për ta, ky do të ishte funksioni i vetëm i saj: ai i lindjes së fëmijëve. Një

javë pas fejesës me Çarlsin, nisi të vuante nga bulimia. Është një lloj çrregullimi në të ushqyer ku njeriu ha aq sa nis të vjellë. Dajana e përjetonte këtë gjendje tre ose katër herë në ditë dhe u dobësua së tepërmi. Siç e kam treguar në një nga krerët paraardhës, shumë njerëz që, gjatë fëmijërisë, kanë pësuar abuzime seksuale dhe satanike, kur rriten vuajnë nga bulimia. Dajana thoshte se bulimia iu shtua kur Çarlsi, pasi i kishte vendosur një herë dorën mbi ijë, i kishte thënë: "Qenke e rrumbullakosur këtej, ë?" Bulimia ka origjinë nervore, ashtu si shumica e sëmundjeve, dhe Dajana kishte probleme nervore qysh para martesës. Ja si e përshkruan sjelljen e Çarlsit:

"Kishte gjetur virgjëreshën, qengjin e flijimit dhe, në një farë mënyre, që tepër i dhënë pas meje. Por që shumë i paqëndrueshëm. Humori i tij që i paparashikueshëm, kishte ulje e ngjitje, ulje e ngjitje... Që i nënshtruar ndaj së ëmës, e kishte frikë të atin, ndërsa unë duhet të qëndroja gjithnjë në mes."[26]

Dajana u takua me të motrat dhe u tregoi se nuk ndjehej në gjendje ta hidhte hapin e martesës, sidomos për shkak të Kamilës, por ato i thanë se tashmë nuk kishte zgjedhje tjetër sepse" fytyra jote është stampuar mbi pecetat e çajit dhe është shumë vonë të tërhiqesh". Para dasmës, Dajana qëndroi disa kohë në Klarens Haus, rezidencën londineze të nënës mbretëreshë. Kur mbërriti aty, nuk kishte dalë askush për ta pritur dhe, siç tregoi më pas, i qe dukur sikur kishte shkuar në ndonjë hotel. Dajana dhe Çarlsi u martuan në katedralen e Shën Palit më 29 korrik 1981. Atë mëngjes, në Klarens Haus, qe ndjerë e pushtuar nga një ndjesi qetësie, një qetësi varri: "Ndjehesha si ndonjë qengj që po e çojnë te kasapi. E dija dhe nuk bëja dot asgjë"[27]. Sa profetike duken tani ato fjalë! Çifti e kaloi natën e parë në vilën e familjes Mauntbaten në Brodlands, në Hempshajër, para se të niseshin drejt ishujve grekë në bordin e jahtit mbretëror *Britania* (Barati). Bulimia u rëndua dhe Dajana nisi të sillte ndërmend vetëvrasjen, kaq e mërzitur qe. "Bashkëshorti më bënte të ndjehesha keq në të gjitha mënyrat e mundshme. Ndonjëherë kur ngjitesha të merrja pak frymë, më shtynte edhe më thellë. Më urrente shumë". Një nga detyrat mbretërore që iu caktua Dajanës në vitin 1982 qe të përfaqësonte mbretëreshën në varrimin e princeshës Grejs të Monakos, një viktimë tjetër e Vëllazërisë kjo, e cila vdiq nga një defekt në frenat e makinës. Princesha Grejs, që dikur kishte qenë aktorja Grejs Keli, drejtonte në Monako degën e Urdhrit të Tempullit të diellit bashkë me Zhan Luis Marsanin, një mik i ngushtë i burrit të saj, princit Ranieri. Kur pritej të lindte princi Uilliam, Uindsorët panë që po realizohej ëndrra e tyre. Dajanës

i thanë që lindja duhej kryer në përshtatje me programin e lojërave të polos së Çarlsit dhe Uilliami flokëverdhë me sy bojë qielli lindi më 21 qershor 1982, ditën e solsticit të verës. Po ç'dreq babai dhe burri qenka ai që ngul këmbë që gruas dhe djalit të tij t'u jepen ilaçe të panevojshme, vetëm e vetëm për të mos i prishur lojën e polos? Pastaj, kush e beson se kjo na qenka arsyeja e vërtetë? Uindsorët janë të dhënë pas astrologjisë dhe arteve ezoterike deri në atë pikë saqë nëna e një mikut tim, e cila është astrologe, arrin të përcaktojë me saktësi të madhe edhe ngjyrat e veshjeve që mbajnë çdo ditë mbretëresha dhe nëna mbretëreshë. I binte gjithnjë në shenjë sepse i dinte ngjyrat që shoqëroheshin me çdo ditë të vitit sipas parimeve ezoterike. Një familje kaq e dhënë pas satanizmit, mistereve ezoterike dhe kultit të diellit arrin të realizojë lindjen e trashëgimtarit pikërisht ditën e solsticit të verës, kur dielli është në kulmin e forcës së tij. Dhe pastaj ju mendoni se bëhet fjalë për një rastësi? E pamundur. Ai u quajt Uilliam (për nder të Gijom, apo Uilliam, Pushtuesit të Fisnikërisë së Zezë) Arthur (për nder të simbolit të mbretit Diell, mbretit Artur) Filip (për nder të dukës së Edinburgut) Luis (për nder të Luis Mauntbatenit). Princi Herri lindi në shtator 1984 dhe, që nga ai çast, Dajana nuk përbënte më asnjë dobi për Uindsorët. "Pastaj, befas, sapo lindi Herri, gjithçka mori të tatëpjetën, martesa, gjithçka po rrënohej" i ishte shprehur Dajana Endrju Mortonit[28]. Dajana dhe Çarlsi u ndanë më 1992 dhe u divorcuan ligjërisht në 28 gusht 1996. Pas afro një viti, ajo vdiq.

Dajana jetonte në pallatin Kensington të cilin ajo e quante shkurt "KP". Aty ka jetuar edhe princi Majkëll i Kentit, Mjeshtër i Madh i Masonëve anglezë. Taktika e përdorur nga Vëllazëria dhe Uindsorët synonte shkatërrimin e besueshmërisë së Dajanës dhe të vlerësimit që ushqente publiku ndaj saj. Në 1992, mediat bënë publike një telefonatë private mes saj dhe shitësit të makinave ku ajo kishte blerë makinën, Xhejms Xhilbej. Gjatë bisedës, Dajana thoshte se Çarlsi përbënte një torturë të vërtetë për të. I kishte thënë Xhilbejt: "Po largohem të pushtoj botën, të bëj atë që di të bëj e ta lë me gisht në gojë." Pavarësisht përpjekjeve për ta diskredituar apo, pikërisht nga këto përpjekje, popullariteti i Dajanës vazhdoi të rritej. Dhuntitë që bashkonin në një person të vetëm bujarinë, një imazh publik botëror dhe një dëshirë të fortë për të larë hesapet me Uindsorët, po bëhej një kërcënim për mbijetesën e vetë monarkisë. Mëshira dhe keqardhja e natyrshme që ndjente për njerëzit po i linte në hije Uindsorët e ftohtë duke i nxjerrë si të ikur kohe. Nëntëmbëdhjetë vjeçarja që kishte rënë në rrjetën e Uindsorëve, tashmë qe shndërruar në një grua të vetëdijshme për aftësitë e saj dhe e gatshme t'i vinte në punë ato. Nga hija, nxori në faqet e para të gazetave të gjithë botës problemin e minave

kundër-njeri dhe tregoi se kishte aftësi të arrinte të njëjtin rezultat për çfarëdo lloj gjëje me të cilën merrej. Për Uindsorët dhe për Vëllazërinë, kjo grua po bëhej shumë e rrezikshme. Madje, kishte dijeni edhe për shumë të fshehta të Uindsorëve dhe të "kishes". Dinte, siç i thonë një fjale, të nxirrte të fshehtat e varreve dhe, në nëntor 1995, gjatë intervistës së famshme në programin *Panorama* të BBC-së, la të kuptohej se qe gati të tregonte shumë gjëra. Kjo intervistë, në të cilën foli hapur për marrëdhëniet e saj jo të mira me familjen mbretërore, i dëmtoi shumë Uindsorët të cilët, ndoshta, iu trembën lëvizjeve të tjera të saj. Gjatë udhëtimeve që kam kryer nëpër botë, kam njohur një burrë i cili kishte marrë një telefonatë nga Dajana në mars 1997, pak para vdekjes së saj. Qe habitur shumë kur zëri nga ana tjetër qe prezantuar si princesha e Uellsit dhe, në fillim, nuk e kishte besuar, sidomos kur i kishte thënë se po telefononte nga një supermarket në Angli. Por Dajana dhe ky person kishin një të njohur të përbashkët. Një tjetër person që e njihte personalisht Dajanën më pohoi se ajo telefononte shpesh nga telefonat publikë, sidomos nga një dyqan i madh në Kesington, kur donte të sigurohej që të mos i përgjohej biseda. Dajana e adhuronte këtë njeri për kulturën dhe urtësinë që kishte. I tha se do të tregonte disa gjëra që do të shkundnin tërë botën dhe se donte një këshillë prej tij se cila do të qe rruga më e mirë. Ai nuk pranoi ta tregonte se çfarë i tha ajo por kur e pyeta nëse bëhej fjalë për përfshirjen e Uindsorëve në trafikun botëror të drogës, u përgjigj: "Oh, jo, për gjëra shumë më të këqija." Mund të krijoni vetë një ide më të mirë për atë çka kishte ndërmend të zbulonte ajo, nëse vazhdoni leximin. Siç do ta shohim, Dajana dinte më shumë gjëra nga sa mund të mendonin njerëzit. Por ky ishte vetëm njëri prej niveleve të komplotit për vrasjen e Dajanës. Nuk kam dyshim se krerët e organizatave të magjisë së zezë që kontrollojnë Vëllazërinë e kishin programuar prej kohësh vdekjen e saj sipas riteve të tyre të lashta. Këta dy nivele, nevoja praktike për të eliminuar Dajanën (nga anëtarët e nivelit të poshtëm) dhe ajo e vrasjes rituale të "mbretëreshës Dajana" (nga anëtarët e nivelit të sipërm) ishin të pranishëm pikërisht siç ndodhi në rastin e presidentit Kenedi.

Rrjedha e fundme e ngjarjeve që çuan në vdekjen e saj përfshin dhe një burrë me emrin Mohamed Al Fajed, "pronari" egjiptian i *Harrods*, dyqanit të madh të njerëzve të rëndësishëm që ndodhet në lagjen Najtsbrixh, në Londër, dhe njëherësh babai i Dodi Fajedit, që vdiq, në aksident, bashkë me Dajanën. Al Fajedi është dhe pronari i Hotel Ricit në Paris. Ky është njeriu që vazhdon të qahet se duhet hedhur "dritë " dhe "drejtësi" mbi vdekjen e Dajanës, megjithëse nuk do të qe i zoti ta njihte drejtësinë as sikur ajo ta kapte për

këmbe. Është shumë e lehtë të kuptohet se kur gënjen Mohamed Al Fajedi, sepse i dridhen buzët. Ai zhvilloi një betejë të gjatë e të pamëshirshme publike për kontrollin e *Harrodsit* dhe të shtëpisë së Frazerit bashkë me Tini Poulandin, kreun e një dege të Vëllazërisë të quajtur *Lonrho*, shoqëria Londër-Rodezi dhe përgjegjës për shumë manipulime në Afrikë dhe mes afrikanëve. Në një pikë të caktuar, hetimi i Departamentit të Tregtisë dhe të Industrisë për çështjen *Harrods* arriti në këto përfundime: "Gënjeshtrat e Mohamed Fajedit dhe aftësia e tij për të sjellë rrotull shtypin krijuan një fakt të ri: gënjeshtrat u bënë të vërteta dhe e vërteta u shndërrua në gënjeshtër."[29] Këto fjalë do të kishin qenë një epitaf mjaft i bukur për atë që revista satirike britanike "Prajvët Aj", mes të tjerash, e quajti dhe "faraoni i rremë". Ky hetim zbulonte edhe se Al Fajedi kishte gënjyer për origjinën e familjes. Thoshte se rridhte nga një familje e pasur egjiptiane dhe, falë kësaj pasurie, thoshte, kishte mundur të blinte *Harrodsin*. Në të vërtetë, familja e tij nuk qe aspak e pasur ndërsa vetë ai, nuk zotëronte asnjë trashëgimi për të qenë. Lindi më 27 janar 1929 në Aleksandri, si bir i një inspektori arsimi. Kishte shitur koka-kola në rrugë pastaj kishte bredhur derë më derë ku shiste makina qepëse Singer. Kur njohu Adnan Khashogin, tregtarin më të njohur të armëve në botë, jeta e tij ndryshoi përgjithmonë. Khashogi qe djali i mjekut vetjak të mbretit të Arabisë Saudite dhe familja e tij përdorte emrin "Al" Fajed (atëherë Mohamed Abdel Moneim Fajed) në çështjet tregtare. Më pas, u nda me familjen Khashogi dhe arriti të mbyllë shumë transaksione tregtare, ku nxori një thes me pará nga ndërmjetësimet financiare. Ndërmarrja e ndërtimit *Kosten*, në fillim, qe një nga burimet e tij kryesore të fitimit, por prej saj nuk mundi të merrte kurrë aq shumë pasuri sa pretendon. Për më shumë hollësi, ju këshilloj të lexoni librin e Tom Bauerit, "Fajedi, biografia e paautorizuar"[30] Bashkëpunimi i Fajedit me diktatorin e Haitit, Papa Dok, i ngjalli CIA-s interesin për këtë njeri dhe punët e tij. Në një raport të CIA-s për të, thuhet: "Të bën përshtypje fakti që është, njëherësh, edhe i përzemërt, edhe shpirtlig."[31]

Edhe pse qe bërë i pasur po ta krahasosh me standardet e zakonshme, sigurisht që nuk kishte aq pará sa të blinte *Harrodsin*, kështu që shfrytëzoi një pjesë të pasurisë së sulltanit të Bruneit, një prej njerëzve më të pasur të botës. Sulltani i dha atij paratë për *Harrodsin* dhe Al Fajedi ndërmjetësoi për blerjen e hoteleve prestigjiozë londinezë Savoj dhe Dorçester. Al Fajedi luan rolin e manjatit, por, në një lojë të përmasave shumë më të mëdha se ai, vetëm sa luan rolin e ushtarit, merr urdhra e bën çfarë i thonë. E gjitha kjo është e mahnitshme ngaqë na kanë bërë të besojmë se Mohamed Al Fajedi dhe mbretëresha përfaqësojnë dy pozicione të kundërta, me kontraste të forta,

pas incidentit të Dajanës. Duket pra, tepër qesharake, kur mëson se Al Fajedi merr urdhra nga sulltani i Bruneit ndërkohë që mbretëresha e Anglisë është mikeshë e sulltanit të Bruneit. Në fakt, ajo ka qenë si e ftuar në pallatin e tij nga data 16 deri më 20 shtator 1998.[32] Ç'do të thotë kjo? Nga mediat, sahanlëpirësja më e ndyrë e Al Fajedit është gazeta "Deili Mirrër", që është shndërruar në një lloj buletini personal për të. Kjo gazetë bëri përpjekje të jashtëzakonshme që të siguronte një intervistë me mua në qershor 1998, pavarësisht ngurrimit tim fillestar. Kur i thashë gazetarit se ç'mendim kisha për Al Fajedin, drejtori i gazetës, Pirs Morgan, nuk pranoi ta botonte artikullin. Morgani e interviston personalisht për gazetën Al Fajedin.

Ndjekja e urdhrave të të pasurve dhe të të fuqishmëve dhe sjellja pa skrupuj në botën e biznesit, doli se qe me mjaft përfitime për Al Fajedin. Ai zotëron disa makina *Mercedes* me xhama kundërplumb, një helikopter *Siroski* që kushton tre milionë e gjysmë sterlina, një xhet Golfstrim që kushton 13 milionë, një jaht 15 milionë sterlinash, *Jonikalin*, disa kështjella dhe mbi 200 hektarë tokë në Skoci, disa banesa luksoze në Gshtad, Nju Jork, Dubai, Gjenevë, Gironë, Londër, në Sarrej dhe në Los Anxheles, që të gjitha me personel shërbimi dhe plotësisht të pajisura.[33] Balnagauni, kështjella e tij skoceze, ndodhet pranë Loh Nesit. Për aq kohë sa do të bëjë atë që i thonë dhe do t'i shërbejë Vëllazërisë, pasuria do t'i shtohet. Kur të mos jetë më i dobishëm, do të zhduket. Do ta ndjenë në diell që ta thajnë. Një tjetër burim të ardhurash për Al Fajedin që ka lidhje dhe me sulltanin e Bruneit, është trafiku i armëve. Ish kunati i Al Fajedit dhe xhaxhai i Dodit, Adnan Khashogi, trafikant i njohur armësh dhe manipulues i zoti, ka organizuar shitje armësh, të ligjshme e të paligjshme, me vlerë miliarda dollarë. Shumë nga bisedat mbi këto transaksione zhvilloheshin në Hotelin Ric në Paris, pronë e Mohamed Al Fajedit (apo e sulltanit?) Kjo është një nga arsyet pse Al Fajedi kishte vendosur përgjues në Ric, për të kapur telefonatat e mysafirëve të tij të shquar. Në të vërtetë, siç do ta shohim, ai ka vendosur përgjues ngado dhe ka shërbyer si ndërmjetës në shitjen e armëve, ndërkohë që edhe Dodi e ka kryer shpesh rolin e ndërmjetësuesit jo zyrtar në operacionet e shkëmbimit të armëve kundrejt naftës mes shteteve të Gjirit dhe Amerikës[34]. Adnan Khashogi është mik i afërt me Xhorxh Bushin dhe, në vitet 1980, ka financuar një pjesë të trafikut të armëve në shkëmbim të drogës. Xhorxh Bushi, nga ana e tij, nuk është gjë tjetër veçse një lake i mbretëreshës dhe princit Filip. Al Fajedi është përfshirë në shumë intriga dhe marrëveshje të fshehta në të cilat janë përfshirë edhe fakte, njerëz e ngjarje të cilat ai kërkon t'i mbajë me çdo kusht të fshehta. Megjithatë, nuk është një nga ata që mund t'i zihet besë. Do të doja të theksoja

LIBRI

se edhe elita islame, ku bën pjesë sulltani i Bruneit, luan një rol domethënës brenda piramidës së Vëllazërisë dhe Lozha e Madhe e Kajros është një nga qendrat e shoqërive të fshehta më të fuqishme të botës. Nuk është për t'u habitur po të kihet parasysh tërheqja e madhe që ushqen Vëllazëria ndaj Egjiptit të lashtë, ritualeve dhe simboleve të tij. Pjesa më e madhe e këtyre familjeve, por jo të gjitha, janë ariane. Kjo farë është përzier nga pak me të gjitha racat e tjera, nga arabët e deri te "hebrenjtë", sidomos me këta të fundit. Një nga shoqëritë e fshehta më të rëndësishme në botën arabe është Urdhri i Faltores Mistike. Anëtarët e tij janë të lidhur me Kalorësit Tempullarë, me Ritin e Jorkut dhe Ritin Skocez të Masonerisë. Në Shtetet e Bashkuara, kanë bërë pjesë në të presidenti Frenklin Delano Rusvelt dhe pasuesi i tij, presidenti Herri S. Truman. Ekziston edhe një Faltore e Princit në të cilën bëjnë pjesë anëtarët me ngjyrë të Vëllazërisë, përfshi zëdhënësen gjashtëmbëdhjetë vjeçare të komunitetit me ngjyrë amerikan, Xhes Xhekson.

Al Fajedi ka mbështetur interesat e Vëllazërisë dhe të "kishës" në mënyra të ndryshme, duke krijuar, me kalimin e kohës, imazhin publik të një kundërshtari të sistemit. Për shembull, ai zbuloi se dy deputetë konservatorë, Neil Hamiltoni dhe Tim Smithi kishin marrë pará për të ngritur disa çështje në Dhomën e Komunëve. Kjo qe krejt e paligjshme. Al Fajedi qe në dijeni ngaqë ua kishte dhënë vetë paratë! Kjo histori e dëmtoi shumë qeverinë konservatore dhe e drejtoi të zgjedhurin e Vëllazërisë, Toni Bler, drejt një fitoreje dërrmuese të Partisë Laburiste në zgjedhjet politike të radhës. Al Fajedi, deri tani, i ka shpëtuar dënimit, pavarësisht denoncimit nga një punonjëse e re e *Harrodsit* që thotë se, bashkë me kolegë të tjera, ka pësuar dhunë seksuale prej tij. Tërheqja e Al Fajedit ndaj seksit është proverbiale. Një vajzë 17 vjeçare me ermin Samantha-Xhejn Ramsej tregon se, kur u ankua te shefi se Al Fajedi e kishte ngacmuar, ai i qe përgjigjur: "Edhe ty!" Kështu që, Al Fajedi vendosi ta pushonte, siç bën me të gjitha ato që nuk i pranojnë ngacmimet e tij seksuale ose mënyrën e tij të "drejtimit të kompanisë". Xhon Monksi, sekretar i përgjithshëm i kongresit të bashkimeve sindikaliste, thotë se në *Harrods* mbretëron një "regjim frike dhe terrori". Kur Samantha-Xhejni e denoncoi ngjarjen në komisariatin e policisë të Metilbornit, iu përgjigjën: "Nuk jeni e para që na drejtoheni ne. I kemi dosjet kaq të trasha për Al Fajedin, por asnjë provë konkrete. Është vetëm fjala juaj kundër fjalës së tij"[35]. Një dosje e plotë me denoncime nga vajza të ndryshme që paraqesin të njëjtën akuzë kundër të njëjtit person, për mendimin tim, fillon të jetë diçka që i afrohet shumë provës. Por Al Fajedi, njeriu që, sipas asaj që thuhet, "kisha" do të donte ta shkatërronte, vazhdon të jetojë i patrazuar. Dhe kjo është vetëm një pjesë e asaj që fshihet pas këtij mashtruesi, hileqari, ngacmuesi seksual, satanisti dhe njeriut fasadë të

sulltanit të Bruneit, të cilit i qe lënë krejtësisht në dorë siguria e Dajanës, ditët dhe orët para se të gjente vdekjen. Personalisht, unë nuk do t'i besoja të më ruante as macen. Meqë ra fjala, siç tregon Tom Baueri, Al Fajedi i kishte dhënë urdhër snajperëve të tij që të hiqnin qafe një mace që nuk i pëlqente. Al Fajedi e kishte njohur familjen Spenser përmes të atit të Dajanës, kontit "Xhoni" Spenser dhe njerkës Rein. E kishte ndihmuar "Xhonin" kur ishte në vështirësi dhe thoshte se e kishte si vëlla kontin.[36]. I kishte dhënë Reines, të cilën Dajana e urrente, një punë në këshillin administrativ të *Harrodsit*. Al Fajedi kishte sponsorizuar ngjarje prestigjioze sportive mbretërore, si konkursin mbretëror të kuajve të Uindsorëve dhe ndeshjet e polos por, në veçanti, kishte financuar nisjnat e bamirësisë që ndërmerrte Dajana. Bob Loftusi, shefi i sigurisë së *Harrodsit* nga 1987 deri më 1996, tregoi në qershor 1998, në emisionin "Dispeçs" të Kanalit Katër britanik se Al Fajedi e kishte urdhëruar që ta njoftonte menjëherë nëse Dajana do të hynte në dyqan. Kështu, Al Fajedi do të futej në repartin ku ajo po blinte gjëra që ta takonte "rastësisht". Për çdo krishtlindje, një furgon i gjelbër i *Harrodsit* ndalej para banesës së Dajanës, në pallatin Kensington, dhe i dorëzonte dhuratat për të dhe për fëmijët nga ana e "xhaxhi Mohamedit". Nga provat ekzistuese, duket qartë se ai bënte gjithçka mundej që të fitonte miqësinë e princeshës së Uellsit. Më 3 qershor 1997, e ftoi për disa ditë pushime në vilën e tij në bregdetin e San-Tropesë, në jug të Francës. Në 11 qershor, e mori atë që kishte kërkuar me aq ngulm: Dajana e kishte pranuar ftesën. Një ditë më pas, mbylli pagesën prej 15 milion sterlinash për blerjen e jahtit *Jonikal*, përmes shoqërisë së tij në Bermudë *Mohafa Shiping*. Pikërisht në këtë anije do të lindte së shpejti historia e dashurisë mes Dodit dhe Dajanës.

Më 11 korrik, Dajana arriti në San-Trope bashkë me dy djemtë, Uilliam dhe Herri. U vendosën, që të tre, në shtëpinë luksoze me tetë dhoma brenda pronës prej katër dynymësh të Al Fajedit, në lagjen Lë Park. Në atë kohë, Dodi Fajedi banonte në apartamentin e tij në Paris bashkë me të fejuarën, modelen amerikane Keli Fisher. Dyzetenjë vjeçari Dodi "i shërbente" të atit dhe jetonte mirë falë pasurisë së tij, pavarësisht se kishte korrur njëfarë suksesi në industrinë kinematografike si producent në hije i prodhimit kinematografik britanik "Çeriots of fajër" edhe pse falë parave të të atit. Që i njohur si plejboj dhe shpenzonte shumë pará. Njëherë, shpenzoi 100.000 dollarë për dy muaj me kartën tij të kreditit. Që i varur prej të atit dhe, edhe për punët e tij në kinematografi, çdo vendim duhej miratuar më parë nga Al Fajedi. Dodi bënte gjithçka që i thoshte i ati të bënte. Kishte tetë muaj i fejuar me Keli Fisherin dhe kishte bërë plane ta ftonte t'i kalonin pushimet në jahtin *Jonikal*. Por, mbrëmjen e 14 korrikut, Dodi mori një telefonatë nga i ati që e urdhëronte të

vinte menjëherë në San-Trope që të takonte Dajanën. Ja si e ka përshkruar Keli Fisheri këtë episod në një intervistë në programin "Dispeçs":

"(Dodi) tha që duhej të shkonte në Londër, por që, kur të kthehej, do të shkonim në San-Trope. Atë mbrëmje nuk më telefonoi por, më në fund, i telefonova unë në celular. I thashë: "Dodi, ku je?" dhe m'u përgjigj se ndodhej në Londër. Iu përgjigja: "Mirë, do të të telefonojë më vonë në apartament". Më tha: "Jo, jo, mos me telefono". Atëherë e pyeta përsëri: "Dodi, po ku je?" dhe më tregoi se ndodhej në Francën jugore. Tani e di se i ati i kishte kërkuar të shkonte atje pa mua".

Pas dy ditësh, Dodi e solli Kelin në San-Trope me një avion privat por, ndërsa ai qëndronte me Dajanën, Keli u prit në bordin e një varke tjetër të Fajedit. "Mbeta e bllokuar atje", vazhdon Keli. "Pastaj, më mbylli si në burg në një nga ato varkat, ndërsa ai i bënte lajka Dajanës". Më 31 korrik, Dajana u kthye në San-Trope për pushime të tjera bashkë me Dodin, që këtë herë qe vetëm. Keli Fisheri qe kthyer në Los Anxheles për t'iu kushtuar përgatitjeve të dasmës me Dodin e cila, siç thotë ajo, qe lënë të zhvillohej në 9 gusht. Por, dy ditë para kësaj date, të gjitha gazetat folën për një histori dashurie mes Dodit dhe Dajanës. Keli e mori vesh nga një shoqe e saj e cila kishte parë fotografitë në gazetë. Ja çfarë kujton ajo:

"U përpoqa t'i telefonoja në Londër sepse një ditë më pas duhej të vinte këtu. E provoova me numrin privat, por nuk m'u përgjigj askush. I telefonova sekretares dhe i kërkova të flisja me të, por ajo nuk ma kaloi. Në atë pikë, telefonin e mori në dorë Mohamedi dhe, pasi më lëshoi ca fyerje, më tha të mos telefonoja kurrë më. Iu përgjigja: "Ne jemi të fejuar, çfarë thua kështu?" Ai ma mbylli dhe unë i telefonova përsëri sekretares. Ajo më tha të mos telefonoja më sepse nuk kishte për të më kaluar askënd. Qe e tmerrshme" [37].

Dajana, e cila kishte pastruar tërë pallatin Kensington nga të gjitha pajisjet e përgjimit, u gjend tani, për ironi, në kthetrat e një njeriu të fiksuar pas përgjimeve. Vila e Al Fajedit në San-Trope kishte ngado përgjues, ashtu si dhe pronat e tjera të tij. Çdo gjë që thoshte Dajana regjistrohej. Bob Loftusi, ish-shefi i sigurisë në Harrods, thoshte se në dyqanin e madh përgjimet ishin "një veprimtari shumë e shtuar" dhe kryheshin gjithnjë nën mbikëqyrjen e Al Fajedit [38]. Henri Porteri, drejtori londinez i revistës "Vaniti Feir", kishte kaluar plot dy vjet duke hetuar për Al Fajedin dhe thotë se, disa herë, kishte konstatuar se ai që tepër i dhënë pas pajisjeve përgjuese me të cilat regjistronte biseda telefonike ndërsa, nëpër dhoma,

kishte vendosur dhe kamera të vogla ë fshehta dhe filmonte njerëzit me to. Përmes disa miqve të përbashkët, Porteri e kishte vënë në dijeni Dajanën për zakonet dhe veprimtaritë e Al Fajedit sepse, siç e ka thënë vetë "mendonte se kjo mund të qe e rrezikshme për të"[39]. Por dukej se Dajanës i thoshte mendja që dinte si të ruhej dhe, pavarësisht se e dinte që Al Fajedi "ndonjëherë sillej si zuzar", nuk mendonte se mund të paraqiste ndonjë kërcënim për të. Në të vërtetë, ai është shumë më tepër se një zuzar i thjeshtë dhe jo vetëm "ndonjëherë", por shumë shpesh. Ajo iu kishte thënë miqve: "E di që është zuzar, por nuk bëj dot gjë për këtë." Gjatë emisionit "Dispeçs" u fol dhe për ekzistencën e provave të dokumentuara të faktit se Al Fajedi kishte vendosur përgjues në dhomat e Hotel Ricit dhe, nisur nga ngjarjet e mëparshme dhe punët që zinin fill në Ric, do të habiteshim po të mos i kishte vendosur. Keli Fisheri thotë se, gjatë gjithë periudhës që qëndroi në banesat e Al Fajedit, vuri se si kishte ngado përgjues. Qe diçka që dihej, tha, dhe Dodi ia kishte pohuar se kishte ngado përgjues. Ajo e vazhdoi kështu rrëfimin: "Në të vërtetë, kur e pyeta për Dajanën, m'u përgjigj: "Nuk flas dot në telefon. Flasim në Los Anxheles." E dija se çfarë donte të thoshte." Dajana "mbrohej" nga shërbimet e sigurisë së Al Fajedit ndërsa i kontrolloheshin edhe bisedat më private.

Dajana shkoi bashkë me Dodin në rezidencën e stilit elizabetian të Al Fajedit që quhej Barrou Grin Cort në Sarrej, e cila i përkiste dikur satanistit Lord MekElpajn. Në të gjithë shtëpinë, Al Fajedi kishte vendosur statuja gjysmë të zhveshura perëndish greke. Më 21 gusht, pavarësisht paralajmërimeve të Henri Porterit, Dajana u kthye në San-Trope për pushime të tjera me Dodin. Al Fajedi nxirrte përfitimet e veta nga kjo gjendje, mblidhte gazetarë e fotografë dhe përfitonte nga publicisti Maks Kliford[40]. Makinacioni që kishte ngritur Al Fajedi bënte që të dilnin lajme mbi lëvizjet e çiftit me qëllim që të sigurohej një publicitet sa më i madh. Pas incidentit, Al Fajedi fajësoi gazetarët se nuk e kishin lënë për asnjë çast të qetë princeshën, një deklaratë që, në ato rrethana, të lë pa mend. Historia mes Dajanës dhe Dodit tashmë qe në kulmin e saj dhe Al Fajedi e nxiste të birin ta forconte edhe më tej lidhjen[41]. Dhe, çfarë thoshte Al Fajedi, Dodi e bënte. Asgjë nuk i lihej rastësisë. Muzika e pëlqyer e Dajanës, kolona zanore e "Pacientit anglez", dëgjohej vazhdimisht në sfond ndërsa çifti shëtiste me jahtin *Jonikal*. Dajana dhe Dodi kishin shumë gjëra të përbashkëta. Kishin lindur, që të dy, në familje të pasura, me baballarë të ftohtë e të larguar. Kishin provuar që të dy dështimin e martesës së prindërve, pas largimit të nënave. Madje kishin ndjekur shkolla të njohura, jo larg njëra-tjetrës, në Zvicër. Por nuk duhet ta përjashtojmë qysh në fillim mundësinë se janë përdorur dhe teknika manipulimi mendor mbi të dy subjektet. Kam njohur disa njerëz që kanë qenë skllevër të

kontrollit të mendjes, të programuar për t'u dashuruar çmendurisht me dikë që, në kushte normale, nuk do t'u kishte ngjallur as interesin më të vogël. Po ashtu, ka shumë shembuj "magjepsjeje dashurie" që shtriganët i përdorin për ta bërë dikë që të dashurohet çmendurisht me ta. Miku im shkencëtar, Dajan Desboraf, thotë se ndjenja e të dashuruarit është e lidhur me prodhimin e feniletilaminës. Bëhet fjalë për një lëndë kimike e cila ul dhe aftësinë për t'i dalluar mirë gjërat, prej nga rrjedh dhe shprehja "dashuria është e verbër". Prodhimi i kësaj lënde kimike ndodh falë çlirimit në trup të endorfinës, një lëndë kimike asnjanëse dhe natyrore që ndihmon kujtesën, të mësuarit, uljen e ndjesisë së dhimbjes, rrit ndjesitë seksuale dhe rregullon hormonet. Nëse, përkohësisht, nxitet çlirimi i këtyre lëndëve në dy njerëz njëkohësisht, ata do të dashuroheshin brenda një çasti.

Mendoj se ka shumë mundësi të ketë ndodhur kjo duke parë se, që të dy, ishin përgatitur në këtë drejtim. Flitej për fejesë, por është e pamundur të thuhet se kur do të formalizohej ajo, sepse ka variante të ndryshme për këtë. Unë vetë kam dyshimet e mia. Dajana dhe Dodi u larguan nga Franca jugore në orën 13:30 të 30 gushtit dhe, në aeroportin Olbia, i hipën xhetit *Golfstrim* të Al Fajedit, i cili i çoi në Paris. Duket se donin të qëndronin vetëm një natë në apartamentin e Dodit, i cili ndodhet përballë Harkut të Triumfit, para se të shkonin në Londër, ku Dajana priste të takonte djemtë. Kjo qe nata e fundit e jetës së saj. Në orën 15:20, avioni u ul në aeroportin Lë Burzhe të Parisit ku po i prisnin të paktën 20 fotografë nga ata që ndjekin njerëzit e rëndësishëm, "paparazë" (një fjalë italiane që do të thotë "insekte që zukatin"). Po i priste një *Mercedes* i pasuar nga një *Renxh Rover* i gjelbër. Bëhej fjalë për një masë normale sigurie, madje, për më të voglën që mund të merret për mbrojtjen e një njeriu të famshëm. Në *Mercedes*, bashkë me Dajanën dhe Dodin, ndodhej dhe truproja e Dodit, Trevër Ris-Xhons, njëzetetetë vjeç, ish pjesëtar i regjimentit të zgjedhur ushtarak britanik të parashutistëve. Krahas trupave SAS, parashutistët janë një nga regjimentet më të stërvitura (dhe më të kontrolluar mendërisht) të forcave të armatosura britanike. Në *Renxh Rover* ndodheshin shoferi Henri Pol, atëherë shef i sigurisë në Ric dhe truproja tjetër, Kes Uingfild. Nga aeroporti shkuan në Vilën Uindsor, në pyllin e Bulonjës, dikur rezidencë e dukës dhe dukeshës së Uindsorit. Duka dhe dukesha jetuan këtu pasi duka, atëherë mbreti Eduardi VII, hoqi dorë nga froni britanik ngaqë qeveria e "kishës" nuk qe dakord që të martohej me amerikanen e divorcuar Uollis Simpson. Atëherë u transferuan që të dy në Paris ku njiheshin si duka dhe dukesha e Uindsorëve. Ajo që shërbente dikur si shtëpia e tyre sot është pronë e Mohamed Al Fajedit dhe thuhet se ai kishte

ndërmend t'ia falte Dajanës dhe Dodit si dhuratë për martesën. Por zërat për martesë nuk kanë asnjë bazë, megjithëse Al Fajedi u përpoq t'i përhapte ngado. Makina e tij publicitare e bëri publikun të besonte se çifti kaloi mjaft kohë brenda vilës duke diskutuar për mobilimin, por truproja Kes Uingfild thotë se ata u ndalën aty vetëm "afro dhjetë minuta"[42]. Prej aty u nisën drejt Hotel Ricit ku mbërritën në 16:20.

Hoteli Ric gjendet në Plas Vendom. Të gjitha ndërtesat që rrethojnë sheshin, në katin e parë, paraqesin simbole të Diellit dhe të kryqit, shumë të ngjashme me simbolet e përdorura nga njerëzit e lashtë për të përshkruar trajektoren e Diellit gjatë vitit dhe për të cilën kam folur më herët në këtë libër. Dielli qe edhe simboli i mbretit Luigji XIV, i njohur me emrin "mbreti Diell". Në rezidencën e tij të viteve 1600 në Versajë, disa dhoma qenë zbukuruar me figura të Apollonit, perëndisë së Diellit dhe Dianës, perëndeshës së Hënës. Në Versajë ndodhej edhe një statujë e perëndeshës Diana. Në qendër të Plas Vendom ngrihet një shtyllë e madhe që mban në majë statujën e Napoleonit, e cila të kujton kolonën e famshme të Nelsonit në Trafalgar Skuer, në Londër. Në këtë pikë, Dajana kishte të njëjtën mbrojtje si ajo në aeroport, por që mund të përforcohej nëse do t'i qe kërkuar shërbimit policor francez të mbrojtjes së figurave të shquara. (SPHP). Ky shërbim zakonisht merret me mbrojtjen e VIP-ave që vizitojnë qytetin por, për ta pasur, duhet bërë më parë një kërkesë formale, gjë që, në këtë rast, nuk qe bërë. Gjithë mbrojtja e Dajanës përbëhej, qysh nga fillimi, vetëm nga njerëzit e Al Fajedit. Po të qe kërkuar mbrojtja e policisë franceze, Dajana do të qe ende gjallë. Kur ndonjë person i shquar si Madona shkon të vizitojë Parisin, policia vendos makina shoqërimi para dhe pas asaj ku qëndrojnë personat dhe, në krye e në fund të vargut, vendosen nga dy motoçikleta. Makinat drejtohen nga shoferë të specializuar dhe mbajnë edhe njerëz të armatosur të shërbimeve të sigurisë. Sipas dokumenteve, SPHS-ja i kishte propozuar tri ose katër herë të shoqëronte Dajanën, por këto kërkesa qenë hedhur poshtë nga Dodi. Mbase dikush të cilit ai nuk i thoshte dot jo, e kishte urdhëruar të mos i pranonte këto oferta. Një agjent i SPHP-së i kishte thënë Dodit: "Nëse nuk do makinën tonë, atëherë prano shoqërimin me dy makina policie kur të lëvizësh nëpër qytet"[43]. Por edhe kjo këshillë nuk qe marrë parasysh.

Dajana dhe Dodi shkuan menjëherë në Suitën Perandorake të shekullit të shtatëmbëdhjetë në Ric, e cila kushton 6000 dollarë nata. Prej aty, Dajana i telefonoi një miku të saj, gazetarit të *"Deili Meil"*, Riçard Kej. I tha se, në nëntor, kishte ndërmend të tërhiqej nga skena publike ndërsa ai tregoi më vonë se nuk e kishte dëgjuar kurrë të qe kaq e lumtur. Çifti prenotoi një

tryezë në restorantin *She Benua* për në orën 20:45 me idenë që, pastaj, ta kalonin natën në apartamentin e Dodit. Në 18:30, Dodi kaloi në Plas Vendom dhe hyri në bizhuterinë Reposi, ku bleu një unazë me diamante për Dajanën, të cilën ia dhuroi më pas në Ric. Pak pas orës 19:00, çifti po udhëtonte me makinën *Mercedes* përgjatë Shans Elizesë, deri te apartamenti i Dodit në rrugën Arsen-Husaj, pranë Harkut të Triumfit. Aty, hapën valixhet dhe u përgatitën për darkën. *Renxh Roveri* i shoqërimit ndodhej aty së bashku me një makinë tjetër që transportonte truproja në rast nevoje për mbrojtje shtesë. Pse këto masa sigurie u quajtën të domosdoshme në orët e para të mbrëmjes por jo në orët e para të mëngjesit, kur ndodhi incidenti? Apartamenti i Dodit njihej edhe si "apartamenti i Yllit" për shkak të emrit të Plas dë l'Etual (sheshi i yllit), rruga që, si një yll ose si Dielli, rrethon Harkun e Triumfit. Për të mbërritur në apartament, Dodi dhe Dajana u nisën nga Plas Vendom, kaluan rrugën Rivoli dhe, në mes të Plas dë la Konkord, u kthyen djathtas në Shans Elize, vazhduan drejt deri te rruga e famshme ku gjendet apartamenti i Dodit (shih **Figurën 52**).




Figura 52. Rruga që përshkruan Dodi dhe Dajana për të arritur në apartamentin e Dodit në orët e para të mbrëmjes së 30 gushtit. Një trajektore e drejtë, pa asnjë shmangie përmes tunelit të Pon dë l'Alma.

LIBRI 24

Mbajeni mend këtë itinerar, sepse ka një rëndësi thelbësore. Në orën 19:15, sa mbërritën në apartament, truprojat dolën nga makina për të shtyrë tutje paparacët. Dajana dhe Dodi nisën të shqetësohen për idenë e darkës në restorantin *She Benua*, i cili nuk ofronte asnjë lloj mbrojtjeje, dhe vendosën të ktheheshin në Ric e të hanin darkë aty.

Ndoqën të njëjtën rrugë, nëpër Shans Elize dhe rreth Plas dë la Konkord. Çifti, bashkë me truprojat Uingfild dhe Ris-Xhons, hyri në Ric, çast ky i përjetësuar nga pamjet e famshme që u filmuan në orën 21:47. Ndërsa paparacët mblidheshin me shumicë jashtë dhe ndërsa qarkullonin zëra për një fejesë të afërt, Dajana nisi të jetonte tri orët e fundit të jetës. Por kush qe ai që, gjatë gjithë ditës, i kishte nxitur këto zëra dhe i kishte informuar pareshtur paparacët për zhvendosjet e Dajanës, duke krijuar dhe atë turmë paparacësh që kushtëzoi atë darkë lëvizjet dhe vendimet e Dajanës dhe Dodit? Më duket se e kam një emër: Al Fajedi. Po kush ishin disa prej "paparacëve" që i ndërlikuan jetën Dajanës dhe vendosën ndryshimin e planeve për atë darkë? Pamjet e filmuara nga një kamera e brendshme në Ric tregojnë se disa njerëz që kishin qenë, gjithë ditën, jashtë lokalit, në atë orë ndodheshin ende atje, mes turmës[44].

Tani, gjërat qenë ndërlikuar. Pasi foli në telefon me të atin që gjendej në Orteks, në Sarrej, Dodi Fajedi bëri të ditur një plan vërtet absurd. Për të hequr qafe paparacët, *Mercedesi* me të cilin kishin lëvizur gjithë ditën, bashkë me *Renxh Roverin* shoqërues do të shfaqeshin para hyrjes kryesore si grackë për paparacët. Ndërkohë, një *Mercedes* tjetër do të dilte nga dera e prapme për të shoqëruar çiftin, shpejt e shpejt, drejt apartamentit në Shans Elize. Dodi mori në telefon Henri Paulin, shefin dyzetenjë vjeçar të sigurisë në Ric, dhe i tha të vinte menjëherë në hotel. Ai e kishte lënë punën në orën 19:00 dhe, kur u kthye, ora kishte shkuar 22:00. Askush nuk e di se ku kishte qenë Pauli në ato tri orë. Dodi tha se i ati, Mohamed Al Fajedi, e kishte autorizuar personalisht Henri Paulin ta drejtonte ai *Mercedesin*.

Sipas mendjes sime, me kodin e Dodit kjo do të thoshte: "Im atë më tha të bësh kështu." Henri Pauli nuk qe ndonjë shofer i specializuar dhe nuk kishte patentë drejtimi të përshtatshme për këtë lloj shërbimi. L. Fleçer Prauti, një ish kolonel i forcave ajrore amerikane që ka bashkëpunuar ngushtë me shërbimet e fshehta, tha një herë:

"Askush nuk ka pse organizon vrasje... ajo thjesht ndodh. Roli aktiv luhet në fshehtësi duke bërë që ajo të ndodhë. Shenja e vetme e madhe është kjo: Kush e ka fuqinë të heqë ose të pakësojë normat e zakonshme të sigurisë?"[45]

Shumë e drejtë. Nëse zbatojmë rregullën e Prautit në rastin e Dajanës dhe pyesim se, atë natë, kush e ka pasur fuqinë - dhe e përdori - për të ulur normat e zakonshme të sigurisë për të, kemi një përgjigje mjaft interesante: Mohamed Al Fajedi. Në këto rrethana, ai duhet t'i përgjigjet një pyetjeje të thjeshtë: pse u pakësua eskorta shoqëruese? Kur u vra presidenti Kenedi, në makinën e tij nuk kishte truproja, ndërsa në atë që e ndiqte ndodheshin katër (shih pjesën me ilustrime). Edhe ai ndodhej në një makinë të zbuluar, në një çast të rrezikshëm dhe në një qytet të rrezikshëm. Kur u vra Martin Luter Kingu në motelin Lorren në Memfis, Tenesi, më 4 prill 1968, policí me ngjyrë i ngarkuar me ruajtjen e tij u dërgua në shtëpi kundër dëshirës së tij, shumë orë para atentatit. Dy agjentët e vetëm me ngjyrë në stacionin më të afërt u dërguan me detyra në stacione të tjera, po atë ditë. Dashi i kurbanit për këtë vrasje u bë një tip me emrin K. Xhejms Ërl Rei. As vetë familja e Kingut nuk besoi në fajësinë e tij. Madje aq shumë sa, para disa vitesh, mori pjesë dhe në varrimin e tij. Kur Bobi Kenedi u vra pasi kishte mbajtur fjalimin në Hotel Ambasadors në Los Anxheles, më 4 qershor 1968, kjo ndodhi sepse u cenua shërbimi i sigurisë. Plani parashikonte që Kenedi të zbriste nga foltorja dhe, duke kaluar mes turmës, të mbërrinte deri te dalja. Por, menjëherë pas fjalimit, "ndihmësit" e Kenedit, sidomos Frank Mankievici, e bindi se do të qe më e sigurt sikur të dilnin nga kuzhina e hotelit. Sapo hyri në kuzhinë, Kenedi gjeti aty skllavin me mendje të kontrolluar Sirhan Sirhan, i cili po e priste me revolver në dorë. Ka më shumë të ngjarë që Kenedit t'i kenë qëlluar disa nga pjesëtarët e skuadrës së tij të "sigurisë", sidomos Thejn Euxhen Sizar, një "truprojë" i punësuar së fundmi dhe i afërt me grupimet e së djathtës ekstreme dhe me shërbimet e fshehta. Por, me Sirhan Sirhanin në skenë, me revolver në dorë, ja ku kishin para syve dhe dashin e kurbanit me mendje të kontrolluar mbi të cilin mund të derdhnin të gjitha përgjegjësitë. Kjo që gjithçka që u duhej. Sirhan Sirhani kishte ndjekur një kurs "zhvillimi mendor" me Rozikrucianët disa javë para vrasjes së Kenedit. Frank Mankievici, i cili shoqëroi Kenedin deri në kuzhinë, kishte punuar më herët me marrëdhëniet me publikun për llogari të fasadës amerikane të Mosadit, Lidhjes Anti-Shpifje. Pastaj, u shfaq në skenë si drejtor i publicitetit për filmin e Oliver Stonit "JFK", i cili duhej të qe një akuzë për vrasjen e presidentit Kenedi. Në të vërtetë, nuk qe aspak i tillë. Kur, në vitin 1995, kryeministri i Izraelit, Jitzhak Rabin, u vra me armë zjarri në Tel Aviv, një filmim i jashtëzakonshëm i kryer nga një shikues, tregoi se si reparti i njerëzve të sigurisë të Rabinit qe tërhequr njëherësh prapa për të lejuar vrasësin që ta qëllonte lirshëm objektivin. Mund ta përfytyroni vetë skenën. Po në çastet e fundit të jetës së Dajanës, çfarë ndodhi?

Agjentët shoqërues u tërhoqën me urdhër të Mohamed Al Fajedit, i cili veproi përmes të birit. Ky është fakt. Për gjithë ditën kishte udhëtuar me të njëjtin *Mercedes* të ndjekur nga *Renxh Roveri* shoqërues. Kur, befas, transferohet në një *Mercedes* tjetër pa asnjë lloj mbrojtjeje. Bëhet fjalë për një vendim të jashtëzakonshëm për një njeri të dhënë aq shumë pas sigurisë. Bob Loftusi, ish shefi i sigurisë në Harrods, është shprehur:

"Po të krahasojmë shërbimet shoqëruese të Al Fajedit, që janë shumë profesioniste dhe të një niveli mjaft të lartë, masat e marra për nënën e mbretit të ardhshëm të Anglisë të bëjnë të mendosh për një operacion të denjë vetëm për filmat me Miki Maus"[46]

Madje, ai shton se "Al Fajedi kishte një fiksim krejt paranojak për mbrojtjen e tij personale". Edhe kur ecte brenda dyqanit të tij të madh shoqërohej nga tre ose katër truproja me veshje civile, të cilët e ndiqnin ngado, përveç katër rojave të tjera me uniformë që bënin një lloj "stafete" duke krijuar dy rrathë agjentësh përqark tij. Dhe kjo, brenda dyqanit të tij! Kjo lloj sjelljeje mos është fryt i paranojës apo vjen nga vetëdija e botës së mjerë e të ndyrë në të cilën veprojnë trafikantët e armëve dhe ngatërrestarët e Vëllazërisë, ku lëviz dhe Al Fajedi? Njerëz që nuk kanë skrupuj as të vrasin fëmijë, lëre pastaj ndonjë plakaruq pasanik si puna e tij. Për të njëjtat arsye, edhe Dodi Fajedi i kushtonte shumë rëndësi sigurisë vetjake. Të thuash të vërtetën, përzgjedhja e shumë rojave të sigurisë së Al Fajedit i përshtatej përmasave të egos së tij. Për më tepër, ai i rekrutonte ata mes trupave SAS dhe regjimentit të parashutistëve ndërsa kërkonte ndihmën e një organizate të Vëllazërisë me emrin *Kontroll Risks* për zgjedhjen e tyre. Tom Baueri tregon në librin e vet se pas shkurreve të vilës në Oksted fshihen truproja të armatosura me uniforma luftimi dhe fytyra të lyera. Sa herë që Al Fajedi udhëtonte me *Mercedesin* e tij, shoqërohej nga *Renxh Roveri* që mbante edhe pajisje mjekësore dhe sigurie, ndërsa Dajanës nuk ia ofroi këtë lloj shërbimi. Madje, për të, solli një *Mercedes* tjetër i cili u dërgua në hyrjen e pasme të Ricit nga një shoqëri makinash me qira me emrin *Etual Limuzin*, pra, me të njëjtin emër si apartamenti i Dodit. *Etual Limuzin* e ka selinë në Ric dhe punon ekskluzivisht me kontratat që siguron nga hoteli dhe mysafirët e tij. Me fjalë të tjera, kontrollohet tërësisht nga Mohamed Al Fajedi dhe nga kushdo që e kontrollon vetë atë. *Mercedesi* i ri qe një S-280, më e lehtë se seria 600 që kishin përdorur gjatë gjithë ditës dhe pa xhama të errët. Kishte dhe makina të tjera në dispozicion, por u zgjodh pikërisht kjo. Një drejtues i *Etualit*, Nils Zigel, u

tha hetuesve të vdekjes së Dajanës se e kishte dorëzuar personalisht makinën në hyrjen e pasme të Ricit, por emisioni "Dispaçs" tregoi se kjo nuk qe e vërtetë. Makina qe dorëzuar nga një shofer me emrin Frederik Lykar, siç e tregon dhe videoja e filmuar nga telekamerat e brendshme. Lykari tha se i qe dukur shumë e çuditshme që kompania *Etual* i kishte lejuar Henri Paulit, një njeriu që nuk kishte cilësitë e duhura si shofer, të drejtonte një nga makinat e saj. Atëherë, pse e bëri? Sepse i kishte thënë Al Fajedi, ja përse. Brajan Dad, ish shefi i shërbimeve të shoqërimit të Al Fajedit gjatë viteve 1980, e përshkoi kështu gjithë këtë episod në emisionin "Dispaçs":

"Bëhej fjalë për një makinë të re. Nuk kishin kohë ta kontrollonin. Por duhej kontrolluar më parë. Në atë makinë mund të qe vendosur ndonjë bombë, për shembull. Ky plan qe vërtet marrëzi. As që duhej marrë parasysh, e jo më të zbatohej. Makina shoqëruese gjendej aty, jo vetëm për të larguar paparacët por edhe, nëse do të duhej, ndonjë motoçiklist me ndonjë pasagjer prapa tij që mund të donte të qëllonte ose të vendoste ndonjë bombë të magnetizuar në makinë. Prandaj duhet makina shoqëruese - për të bllokuar veprimet e këtij lloji. Pse nuk kishin një makinë të tillë shoqëruese, një zot e di (por unë besoj se mund t'ia jap përgjigjen kësaj pyetjeje edhe pa ndërhyrjen e zotit)".

"Kisha në dispozicion të paktën gjashtë ose tetë truproja profesioniste që mund ta kishin kryer atë detyrë dhe Trevor Ris-Xhonsi dhe Kes Uingfildi, pas asaj që pashë të ndodhte, nuk do të kishin qenë në Paris atë natë."

Mercedesi me Henri Paulin në timon u nis shpejt nga dalja e pasme e Ricit në orën 12:20 ndërsa Pauli donte t'u tregonte paparacëve se qe e kotë ta ndiqnin, sepse nuk do ta kapnin dot. Dajana dhe Dodi ishin ulur prapa ndërsa përpara qe Trevor Ris-Xhonsi, ish parashutisti i njohur si "sypatremburi". Ris-Xhonsi tha se nuk qe dakord me ndryshimin e planeve. Nuk e kishte vendosur rripin e sigurisë, sipas rregullave, sepse truprojat duhet të jenë të lirë që të reagojnë shpejt. Makina u lëshua me shpejtësi të madhe në rrugën Kambon dhe u kthye djathtas në rrugën Rivoli, deri në Plas dë la Konkord, ku ndaloi vetëm një çast në semafor. Paparaci Romuald Rat, i ulur në ndenjësen e prapme të një motoçiklete, iu afrua shumë *Mercedesit* por, atë çast, tregon se Henri Pauli u nis megjithëse semafori qe ende i kuq, dhe u drejtua nga rruga me dy korsi në anë të Senës që quhet Kur lë Ren. Makina pastaj u fut në një galeri, doli nga ana tjetër dhe u zhyt po aq shpejt në tunelin e shkurtër të Pon dë l'Alma. Këtu u përplas me shtyllën e 13-të në

qendër të tunelit të betonuar që nuk ka mbrojtëse anësore. Herri Pauli dhe Dodi Fajedi vdiqën në vend. Sipas raportit të autopsisë, Dajana u shpall klinikisht e vdekur pas 20 minutash, pra shumë më përpara se të mbërrinte në spital. Trevor Ris-Xhonsi i mbijetoi përplasjes sepse, ndryshe nga Dajana dhe Dodi, e kishte vendosur rripin e sigurisë. Kjo pikë është mjaft domethënëse. Ris-Xhonsi nuk e kishte vendosur rripin kur u nisën nga Rici, sipas rregullave normale që ndjekin truprojat. Edhe kur Romuald Rati shkrepi fotografinë kur kishin ndaluar te semafori në Plas dë la Konkord, Ris-Xhonsi përsëri qe pa rrip sigurie. Por, një minutë më pas, kur makina u përplas me shtyllën, rripi qe i vendosur. Pse? Nëse vendosi të vinte rripin ngaqë, për ndonjë arsye e nuhati rrezikun, pse nuk i thirri edhe Dodit dhe Dajanës të bënin të njëjtën gjë? Në fund të fundit, ai vihet për një sekondë dhe arsyeja për të cilën qe atje ishte pikërisht mbrojtja e tyre. Ris-Xhonsi duhet t'iu përgjigjet këtyre pyetjeve, por ja që nuk u është përgjigjur.

Disa truproja e lidhin rripin e sigurisë kur makinat ecin me shumë shpejtësi, por Ris-Xhonsi nuk na thotë këtë. Thotë se nuk e di pse e vendosi rripin. Nëse po shkonin për te apartamenti i Dodit, do të kishin mbërritur aty për një minutë. Gjithçka thotë është se i kujtohet që pas u vinin dy makina, njëra prej të cilave e bardhë, dhe një motoçikletë, çka konfirmon faktin se gjendemi para një tymnaje. Por një fakt i thjeshtë nga gjithë kjo histori është lënë në hije nga gjithë artikujt e gazetave, revistave, nga dokumentarët televizivë dhe debatet që kam parë dhe nga të gjithë ata që kanë bërë kërkime mbi këtë çështje, me ndonjë përjashtim të vogël. Të gjithë e marrin për të mirëqenë se çifti qe drejtuar për në apartamentin e Dodit pranë Harkut të Triumfit kur u përplas makina. Mirëpo, këtu kemi një problem të madh:

Tuneli Pon dë l'Alma nuk gjendet në rrugën që të çon në shtëpinë e Dodit, por në drejtimin e kundërt.

Kam qenë vetë në Paris dhe kam bërë në këmbë rrugën që ndoqi makina atë natë, madje e kam rrahur shumë gjithë atë zonë. Rruga që të çon drejt e në apartamentin e Dodit përputhet me atë që kishin përshkuar më herët atë mbrëmje. Ecni drejt Plas dë la Konkord, në gjysmë të rrugës, kthehuni djathtas drejt Shans Elizesë dhe vazhdoni drejt deri sa të arrini në apartamentin e Dodit, në anën e djathtë pranë Harkut të Triumfit (shih **Figurën 53**). Në atë orë të natës, rruga bëhet brenda pak minutash, ndërsa Henri Pauli veproi krejt ndryshe. E kapërceu kthesën për në Shans Elize, kaloi me semafor të kuq dhe u lëshua në rrugën me dy korsi drejt Pon dë l'Alma. Në këtë mënyrë,

ata po i LARGOHESHIN apartamentit të Dodit. Kam dëgjuar të thuhet se Pauli e zgjati rrugën për të shmangur fotografët dhe trafikun por, sido që të ishte, fotografët me siguri që do t'i prisnin përpara apartamentit të Dodit para se të mbërrinin ata. Ajo që dua të theksoj është se rruga që zgjodhi Henri Pauli nuk të çon drejt apartamentit të Dodit, por të detyron të kalosh përmes tunelit Pon dë l'Alma, i cili ka një domethënie të jashtëzakonshme, siç do ta shihni së shpejti. Të habit fakti se pasi Pauli e kapërceu kthesën për në Shans Elize dhe u nis drejt Pon dë l'Alma, Ris-Xhonsi lidhi rripin. Ai thotë se nuk i kujtohet arsyeja, por po e ndihmoj unë. Arsyet janë vetëm dy. Ose e dinte se çfarë do të ndodhte, ose e kuptoi kur Henri Pauli nisi të thërriste në semaforë se kishte diçka që nuk shkonte dhe kështu që lidhi rripin për t'u mbrojtur. Po përsëri, nëse është e vërtetë kjo hipoteza e dytë, pse nuk i tha Dajanës dhe Dodit të bënin të njëjtën gjë? Pastaj, nëse Ris-Xhonsi, kishte nuhatur një rrezik të mundshëm, pse Dajana dhe Dodi nuk e vunë re këtë dhe nuk morën të njëjtat masa mbrojtëse? Më vjen keq nëse e gjithë kjo histori e turbullon familjen e Ris-Xhonsit, por, në këto rrethana, ka ende pyetje të cilat kërkojnë përgjigje.




Figura 53. Ndryshimi i rrugës që i kushtoi jetën Dajanës. Në vend që të shkonte drejt apartamentit të Dodit, Henri Pauli e lëshoi makinën në drejtimin e kundërt me destinacionin final. Thuhet se vendosi të zgjaste rrugën për të hequr qafe paparacët, por sa "rastësi" e pabesueshme që, për të bërë këtë, kaloi pikërisht në tunelin Pon dë l'Alma, një nga vendet më të shenjtë kushtuar perëndeshës Diana sipas Vëllazërisë Babilonase!

Sa u krye akti, u gjend dhe dashi i kurbanit. Metodat janë vërtet të parashikueshme por, për sa kohë vazhdojnë të funksionojnë, nuk shihet nevoja për t'i ndryshuar. Li Harvej Osualdi, Sirhan Sirhani dhe Xhejms Ërl Reji i vrasjes së Dajanës qe shoferi Henri Paul. Pasi u luajt karta e paparacëve, e cila rroku vëmendjen e publikut dhe të mediave në ditët që pasuan përplasjen, u bë e ditur se Pauli e kishte kaluar tre ose katër herë kufirin e alkoolit që mund të konsumohet para se të ulesh në timonin e makinës, sipas ligjit francez dhe se, në gjakun e tij, u gjetën edhe gjurmë ilaçesh antidepresive, përfshi edhe fluoksetinë, një përbërës aktiv i famëkeqit *prozak*. "Shkaku i aksidentit është i qartë", na u tha. "Shoferi qe i dehur". Manovrimi me kampionët e gjakut ose futja e alkoolit në gjak është një lojë fëmijësh, siç është edhe futja në të e "topthave" shumë të vegjël që çlirojnë gradualisht alkool në qarkullimin e gjakut. Para se të largohej nga Rici nuk dukej asnjë shenjë e faktit se, siç treguan analizat e gjakut, ai të kishte pirë tetë skoç me stomak të zbrazët. Një psikolog që u intervistua atë kohë për një dokumentar të *Independent Televizhën* me titullin "Dajana - të fshehtat e përplasjes", nuk vuri re asnjë provë dehjeje pasi pa pamjet e filmuara ku qe shfaqur ai atë natë, të cilat ishin marrë nga telekamerat në Ric, por kjo mund të ketë edhe një shpjegim të cilit do t'i kthehem më vonë. Vetëm dy ditë më parë, Pauli i qe nënshtruar një vizite të hollësishme mjekësore që i duhej për të rinovuar patentën e pilotit, gjatë së cilës nuk u vu re asnjë shenjë e abuzimit me alkoolin, ndryshe nga propaganda pas aksidentit. Është vënë re edhe një anomali tjetër e zbuluar nga dokumentari i *ITV*-së në 1998. U zbulua se hemoglobina e gjakut të Henri Paulit përmbante 20,7% monoksid karboni dhe kjo vlerë është shumë e lartë, sepse monoksidi i karbonit në trup përgjysmohet çdo 4-5 orë nga ekspozimi ndaj tij. Hemoglobina mban oksigjenin. Debi Dejvis e Grupit të mbështetjes kundër monoksidit të karbonit thotë se me këto nivele në gjak, Henri Pauli nuk do të qe në gjendje as të dallonte dorën e majtë nga e djathta për shkak të sasisë së pakët të oksigjenit që arrin në tru. Doktor Alaster Hej, ekspert për helmimin nga monoksidi i karbonit, është i të njëjtës mendje me Dejvisin në këtë pikë por nuk e shpjegon dot pse Pauli nuk shfaqte asnjë nga shenjat e simptomave që mund të shkaktonte kjo gjë:

"E kam të vështirë ta kuptoj të gjithë këtë. Një nivel prej 20% i monoksidit të karbonit në gjak dhe (një nivel i lartë i alkoolit në gjak) *shkakton te subjekti një kohë reagimi shumë të ngadaltë, një ngadalësim të përgjithshëm në kapjen e gjërave, ndoshta edhe një ndjesi dhimbjeje, ndërkohë që asnjë prej këtyre gjërave nuk duket nga pamjet që kemi prej tij. Është tamam enigmë."*[47]

Ka ende shumë gjëra që duhen zbuluar për Henri Paulin. Shoku i tij i ngushtë, Klod Garrek, tha në dokumentarin e *ITV*-së se Pauli mbante kontakte me shërbimet e fshehta franceze dhe të huaja gjatë gjithë kohës që punonte në Ric. Kjo nuk është për t'u habitur sepse agjencitë e shërbimeve të fshehta rekrutojnë shpesh punonjës të sigurisë nëpër hotelet më të mëdhenj dhe Rici, me klientelën e vet të zgjedhur dhe famën që kishte marrë për spiunazhin dhe trafikun e armëve, mund të qe një nga objektivat kryesore të tyre. Me siguri që Pauli kishte disa burime të mistershme fitimprurëse. Fitonte rreth 20-25 mijë dollarë në vit në Ric. Përveç kësaj, qe një pilot i zoti me 605 orë fluturim mbi supe, të cilat i jepnin rreth 300 stërlina për një orë fluturim. Kishte disa llogari bankare. Dy në një bankë jashtë Parisit dhe tri të tjera, përveç një kasaforte, në *Bank Nacional dë Paris* pranë Ricit. Kishte tri llogari në degën e afërt të bankës *Barklejs* dhe një llogari rrjedhëse dhe katër llogari kursimi në *Kes d'Eparnj dë Paris*. Në tetë muajt përpara aksidentit, në një nga këto llogari iu derdhën pesë herë shuma nga 4000 stërlina. Kishte gjithsej 122.000 stërlina (1,2 milion franga) dhe askush nuk e dinte nga i vinin. Pastaj është dhe çështja se ku gjendej Pauli gjatë atyre tri orëve nga 19:00, kur la shërbimin, deri më 22:00 kur e mori Dodi në celular dhe i kërkoi të kthehej në Ric. Lëvizjet e tij gjatë këtij intervali kohe janë të mbështjella nga misteri. Një mister shumë i rëndësishëm.

Për të kuptuar si funksion Vëllazëria duhen kryer kërkime shumë më të hollësishme në një seri të gjerë çështjesh që kanë lidhje me të. Duhet ditur gjithçka, nga historia e lashtë deri te simbolizmi satanik dhe ritual, nga rrjeta magnetike tokësore deri te fuqia e Diellit, nga sistemi bankar deri te kontrolli i mendjes. Gazetarët që kanë shkruar artikuj dhe prodhuar dokumentarë mbi aksidentin nuk kanë pasur as njohuritë më të vogla për këto prandaj nuk do ta zbulojnë dot kurrë të vërtetën, sepse nuk e kuptojnë se ç'kanë në dorë. Vizioni i tyre për atë që është e mundur rezulton shumë i kufizuar nga vizioni i tyre i indoktrinuar i realitetit. Nuk e kuptojnë, për shembull, se ekzistojnë organizata brenda organizatave, çka do të thotë se një grup mund të veprojë përmes agjencive në dukje pa lidhje me njëra-tjetrën, si shërbimet e fshehta britanike ose franceze me policinë pariziane dhe shërbimet mjekësore dhe me të gjithë ata që kryejnë hetime mbi shkaqet e aksidentit. Dua të them se nuk është nevoja të ikësh shumë larg për të gjetur prova në mbështetje të kësaj. Mjaft të mbajmë parasysh vrasjen e Kenedit. Pikërisht mungesa e hetimeve të gjera i shtyn gazetarët si Martin Gregori të pohojnë në mënyrë kategorike, në emisionin "Dispeçs", se "nuk ekziston as prova më e vogël e besueshme që të mbështesë tezën e konspiracionit" dhe se ideja e përfshirjes

së princit Filip është "absurde". Po pyes veten nëse, pasi keni lexuar faktet e mësipërme, vazhdoni ta quani ende absurde idenë se ishte përgatitur një komplot për vrasjen e Dajanës apo quani të tilla tezat e Martin Gregorit. Bëhet fjalë për një koment të pavlerë në një emision që, nga ana tjetër, shpërndau informacione të vlefshme për Al Fajedin. Pastaj, patëm dhe hetimin mbi aksidentin, që u krye nga Xhon Stalker, ish shef policie i Mançesterit dhe rrethinave, hetim i cili u botua në të përditshmen "Njuz of dhë Uërlld" dhe që e përjashtoi tezën e vrasjes së Dajanës. Të bën të qeshësh fakti se Stalkeri deklaroi, me të drejtë, se kishte qenë viktimë e një komploti që synonte ta largonte nga detyra që mbante, pak pasi ai mori dijeni mbi taktikat që përdorte policia e Irlandës së Veriut, e njohur me inicialet RUC, e cila kishte leje të qëllonte ndaj kujtdo që dyshohej si terrorist dhe vetëm pastaj mund ta merrte në pyetje për këtë. Kjo qe e ashtuquajtura polici që qëllon për të vrarë. Duke mënjanuar çdo hipotezë komploti që qe finalizuar me vrasjen e Dajanës, Stalkeri pyet: "Për ç'qëllim do ta mbulonin francezët vrasjen e një anglezi?"[48] Çiltërsia e kësaj pyetjeje është kaq marramendëse saqë më vjen të pi një gotë me ujë kur e dëgjoj. Ndërkaq, në të njëjtën kohë, Stalkeri shtron edhe pyetje të zgjuara mbi aksidentin dhe pasojat e tij: "Pse truprojat e sigurisë që i dha Al Fajedi Dajanës u katandisën në vetëm një të tillë, për më tepër të papërshtatshëm dhe pa një mbulim të mirë? Pse policia nuk iu drejtua publikut për të mbledhur më tepër informacione? Pse nuk u krye autopsia *post-mortem* e trupit të Dodi Al Fajedit?" Përgjigjja: pikërisht për shkak të atij komploti të cilin ju, zoti Stalker, e mohoni.

Një nga aspektet më interesante mbi të cilin duhet hedhur dritë nëse duam ta kuptojmë vërtet se si u vra Dajana është fuqia dhe potenciali i kontrollit mendor. Po ju jap disa shembuj. Në vitet 1980, tridhjetë shkencëtarë ndër më të mirët që punonin për projekte të fshehta, shumica programues kompjuterësh, vdiqën në rrethana shumë të çuditshme dhe të errëta. Një nga shoqëritë më të mëdha të përfshira në këtë çështje qe *Markoni*, por kishte dhe të tjera si *Plesej* dhe *British Aerospejs*. Në vitin 1986, Vimal Daxhibhai që punonte për *Markoni Andëruotër Sistems*, shkoi me makinë nga Londra në Bristol, një qytet me të cilin nuk kishte asnjë lloj lidhjeje, dhe u hodh nga ura e famshme e varur e Bristolit. Para pak muajsh, edhe Arshad Sharif, programues kompjuterësh te *Markoni Andëruotër Sistems* shkoi nga Londra në Bristol dhe vari veten. Pse pikërisht në Bristol? Bëhet fjalë për një port të vjetër të Kalorësve Tempullarë dhe emri i këtij qyteti rrjedh nga Barati, perëndesha e fenikasve. Një njësi e zgjedhur agjentësh të fshehtë britanikë, e quajtur Komiteti i të 26-ve, e ka selinë në këtë qytet me merret me pistën e

kompleksit ajror hapësinor britanik që transporton brenda e jashtë vendit agjentë britanikë dhe të huaj. Një herë, mora një mesazh nga një gjë që dukej se ishte një aeroplan, nga një tip që thoshte se përfaqësonte CIA-n. Thoshte se po mbërrinte në pistën ajrore hapësinore britanike dhe se do të më rregullonte për festa. "Kompania (pra CIA) nuk është e kënaqur me ty", më tha. Oh, mendova, më vjen keq, shpresoj të vijnë në humor së shpejti. I hipa makinës që të shkoja atje sa për të verifikuar, por nuk u bë njeri i gjallë. Mbase qe ndonjëri që kishte nevojë për ndihmë ose thjesht donin të shihnin si mund të reagoja ndaj kërcënimeve. Sido që të ishte, kishin zgjedhur aeroportin e duhur. Në atë kohë, pra gjithnjë nga vitet 1980, jo vetëm në Bristol, u regjistrua një valë vdekjesh të çuditshme të njerëzve të vijës së parë në sektorin industrial të "mbrojtjes".

Ç'mund ta shtyjë një njeri t'i hipë makinës, të udhëtojë për më shumë se dy orë deri te ura e varur në Bristol e të hidhet prej andej? Gjithçka duket si pa lidhje me vrasjen e Dajanës, por ja që nuk është kështu. Në fakt, po flas për kontrollin mendor. Një shkencëtar i CIA-s më ka thënë se i qe nënshtruar një lloj kontrolli mendor që e pengonte të sillte ndërmend gjëra që ai i dinte, pasi kishte përfunduar një projekt. Po ju jap një shembull të kontrollit mendor në një rast shumë të ngjashëm me atë të Parisit. Dejvid Sandsi qe një shkencëtar shumë i zoti që punonte në një sektor tepër delikat të mbrojtjes por, në moshën 37 vjeçare, po mendonte të largohej nga ajo punë e të ndryshonte jetën. Qe i martuar, me dy fëmijë të vegjël, një djalë gjashtë vjeç dhe një vajzë tre vjeç. Sandsi dhe gruaja sapo qenë kthyer nga një pushim i këndshëm në Venecie, kur ai vdiq në rrethana të mistershme. Megjithëse nuk duken edhe aq të mistershëm pasi fillon të kuptosh se si funksionon kontrolli mendor. Punonte për kompaninë *Isams* e cila merrte shpesh porosi nga ministria e mbrojtjes. Duket se, ndërsa Sandsi dhe gruaja ishin në Venecie, shoqërinë e kishin vizituar disa punonjës të seksionit special të policisë britanike, *Speshëll Branç*. Pastaj, të shtunën, më 28 mars 1987, Dejvid Sandsi i tha gruas se po dilte të mbushte makinën me benzinë por, pas gjashtë orësh, ende nuk qe kthyer. Askush nuk e dinte se ku ndodhej, por unë besoj se e di. Gruaja Ana lajmëroi policinë dhe shefi i policisë Xhon Hiskok ndodhej në shtëpi kur Sandsi u kthye, në orën 22:20. Pyetjes "Ku ishe?" iu përgjigj se kishte bërë një shëtitje me makinë për të qartësuar disa ide. Gruaja tha se nuk e kishte zakon të largohej aq gjatë nga shtëpia dhe tregoi se iu duk sikur ai nuk e kishte kuptuar se sa kohë qe larguar. Dukej i turbulluar, por i lumtur, shtoi. Pas dy ditësh, të hënën, më 30 mars, i hipi makinës së tij *Austin Maestro* të cilën e mbante në gjendje të shkëlqyer dhe u nis, si zakonisht, nga shtëpia

në Içen Abas, pranë Uinçesterit deri në *Isams* në Kamberlej, në Sarrej. Gruaja thotë se nuk vuri re asgjë të çuditshme në sjelljen e tij dhe se kushtet në rrugë qenë të mira. Por kishin kaluar vetëm 30 minuta që kur qe nisur dhe, ndërsa ecte në rrugën A33 në Popham, pranë Besingstokut, mori befas një kthesë në formë U-je dhe u nis me shpejtësi të madhe në drejtim të kundërt me destinacionin. Duke ecur në një rrugë të lagësht me shpejtësi afro 120 kilometra në orë, Sandsi u përplas me makinë pas një ndërtese që kishte qenë dikur kafene dhe mbeti i vrarë në shpërthimin që pasoi përplasjen. Në rrugë nuk u vu re asnjë shenjë shmangieje. Madje as qe përpjekur të frenonte[49]. Kështu që, është e qartë se, gjatë atyre orëve kur qe larguar nga shtëpia, mendja e tij qe programuar dhe, për të aktivizuar atë program, mjaftonte vetëm një fjalë, një sinjal, një tingull ose një veprim që ta ndizte. Atë çast, mund të kalonte edhe nga personaliteti i tij normal në atë të një njeriu që synonte vetëm përplasjen me ndërtesën e një kafeneje dhe të hidhej në erë. Programimi subkoshient e mund mendjen e vetëdijshme dhe njeriu zëvendësohet me robotin.

Jam i bindur se kjo i ka ndodhur edhe Henri Paulit në Paris. Sandsi u zhduk për 6 orë para se të shkonte dhe të përplasej me kafenenë. Pauli u zhduk për 3 orë para se të përplasej me shtyllën e 13-të në tunelin Pon dë l'Alma. Sipas meje, pikërisht kjo ndodhi në Paris. Organizatat e Vëllazërisë punonin nëpërmjet shumë njerëzve dhe agjencive që të siguroheshin që Dajana do të qëndronte në Paris atë natë sepse, në thelb, plani synonte përmbushjen e një rituali satanik sipas të gjitha rregullave dhe koha, rrethanat dhe vendi i vdekjes duhet të përcaktoheshin me saktësinë më të madhe. Dajana qe nën mbrojtjen e rojave të Al Fajedit gjatë kohës përpara aksidentit dhe sidomos, gjatë ditëve para tij. Të gjitha bisedat e saj regjistroheshin dhe kontrolloheshin nga përgjuesit e Al Fajedit. Gjatë orëve kur u zhduk, Henri Pauli, agjenti i shërbimeve të fshehta franceze dhe bullgare, u programua për rolin që do të kryente ose, ndoshta, iu dha dora e fundit një programi tashmë të instaluar. Vdekja rituale e Dajanës qe organizuar nga kupola e Vëllazërisë, përballë së cilës njerëz si Al Fajedi janë krejt të pafuqishëm, ushtarë të një loje që ndoshta as vetë nuk e kuptojnë mirë. *Mercedesi* që u dërgua në hyrjen e prapme të Ricit qe vjedhur para disa javësh, para se të niste marrëdhënia midis Dodit dhe Dajanës, dhe, sapo qe gjetur, i ishte nënshtruar të ashtuquajturave riparime. Ndodhej përpara restorantit *Tajvo*, kur porta anësore e shoferit qe hapur dhe drejtuesi i mjetit qe tërhequr jashtë nga tre njerëz të armatosur që flisnin arabisht. Makina u gjet pas dy javësh pa rrota dhe pa njërën derë, i mungonin edhe sistemi elektronik dhe

LIBRI

mekanizmat e kontrollit të frenave. Al Fajedi, siç e pamë, kontrollonte shoqërinë *Etual Limuzin*, e cila ofroi makinën. Nuk të habit fakti se autoritetet franceze nuk e pranuan ofertën e ekspertëve të *Mercedesit* për shqyrtimin e makinës pas aksidentit.

Kur Henri Pauli mori shërbimin atë mbrëmje, dukej krejtësisht normal. Programimi gjendej thellë në psikikën e tij dhe në pritje të aktivizohej. Mbase kishte pirë dhe ndonjë gotë të vogël në barin e Ricit, por sasia e pirë sipas raportit mjekësor bie në kundërshtim me sjelljen e tij. Hipoteza që mund të ketë qenë ndonjë i alkoolizuar kundërshtohet edhe nga analizat mjekësore. Por nëse, siç them unë, Henri Pauli kishte një "personalitet të shumëfishtë" dhe mendje të kontrolluar, atëherë mund të dehej vetëm në një sektor të mendjes dhe të qe esëll në një tjetër. Kam dëgjuar të thuhet nga njerëzit që e kanë kaluar vetë këtë gjendje dyzimi të personalitetit se kjo është diçka e zakonshme. Dikush që ndodhej pranë Paulit atë natë, pra manipuluesi i tij, aktivizonte personalitetet e ndryshme të tij. Në këtë mënyrë, ai mund të kishte në gjak edhe një nivel të lartë alkooli i cili nuk i prekte disa pjesë të caktuara të mendjes. E njëjta gjë vlen edhe për monoksidin e karbonit. Programimi i Henri Paulit u aktivizua vetëm një çast më parë ose më pas largimit të *Mercedesit* nga Rici. Si shkëndijë mund të ketë shërbyer një tingull, një sinjal, një ngjyrë ose, çka ka më tepër mundësi, një fjalë ose një frazë. Kur programimi i pavetëdijshëm i Paulit mbizotëronte mbi mendjen e vetëdijshme, ai u drejtua nga Plas dë la Konkord dhe pastaj ia shkeli gazit në rrugën me dy korsi drejt Pon dë l'Alma. Ris-Xhonsi lidhi rripin, por duket se nuk e paralajmëroi Dodin dhe Dajanën për rrezikun dhe ata nuk ndoqën shembullin e tij. Kur Pauli hyri në tunelin Pon dë l'Alma me një shpejtësi prej afro 120 kilometrash në orë (disa gazetarë thonë që po ecte më ngadalë) frenoi fort, rrëshqiti përgjatë murit të djathtë të galerisë dhe pastaj e lëshoi makinën drejt shtyllës së 13-të. Këtë na e vërteton vetë shtylla e 13-të. Vëllazëria, gjatë gjithë historisë së saj, ka qenë kaq e dhënë pas numrit 13-të saqë, të mendosh se bëhet fjalë për një rastësi të thjeshtë, do të thotë ta lësh fantazinë që ta kalojë mundësinë reale. Në atë galeri gjenden 30 shtylla ndërsa makina goditi të 13-n sepse kështu qe vendosur. Dajana ushqente një fare frike nga numri 13-të dhe nuk kishte pranuar që në një seri fustanesh që kishte marrë nga firma Kristis, qershorin para vdekjes, të kishte ndonjë me numrin 13. Nëse, siç ka sugjeruar një dëshmitar, aksidenti u shkaktua nga përplasja mes *Mercedesit* dhe një makine *Fiat Uno* të bardhë ose, nga një motoçiklist që verboi Paulin me dritën e tij të fortë, këto nuk do të kishin qenë aspak mënyra të sigurta që makina të godiste shtyllën e 13-të. Ndërsa një njeri me vetëdije të programuar thellësisht mund

ta godiste objektivin e duhur edhe me atë shpejtësi.

Mark Filipsi është njeriu që ka ndihmuar në çprogramimin e mendjes së Kethi O'Brienit, kur kjo qe shndërruar në një skllave e kontrolluar mendërisht nga CIA. Ka punuar në këtë fushë pjesën më të madhe të jetës dhe, pasi unë kisha nxjerrë disa përfundime për ngjarjen e Parisit, i telefonova për ta pyetur nëse qe e mundur të kontrollohej mendja e Henri Paulit në mënyrë që ta çonte atë të përplasej me atë shtyllë me gjithë shpejtësinë. Marku nuk kishte pikë dyshimi: "Po, po, patjetër, absolutisht po." Madje më bëri të ditur se pavetëdija vepron shumë më shpejt se mendja e vetëdijshme dhe se 120 kilometra në orë nuk janë ndonjë shpejtësi e madhe krahasuar me aftësitë menduese dhe reaguese të saj. Pastaj, nëse shpejtësia ka qenë më e vogël, siç thonë disa gazetarë, atëherë ka qenë edhe më e lehtë. "Teknikat e përdorura për programimin e mendjes së tij gjatë atyre tri orëve që u zhduk, janë të shumta", thotë Marku. Për të shkaktuar atë përplasje mund të kenë përdorur shumë mjete, mes të cilave një makinë tjetër, një mjet shpërthyes, armë për ta trembur e hutuar dhe shumë mënyra të tjera me të cilat mund të mbushet një libër i tërë. Por përsëri ato nuk mund të siguronin përplasjen me shtyllën e 13-të, diçka që ai e kreu me përsosmëri. Për të bërë këtë, u duhej një shofer me vetëdije krejtësisht të programuar.

Besoj se historitë për makinën e mistershme *Fiat Uno* dhe motoçiklistin me drita verbuese shërbejnë për të shmangur nga rruga e duhur kërkuesit e së vërtetës. Është shpenzuar shumë kohë dhe energji duke spekuluar për atë *Fiat* edhe nga vetë skuadra e hetuesve të Al Fajedit. Sa herë që organizohen vrasje të këtij lloji, shfaqen gjithnjë disa "tregues" të rremë dhe "pista" që tërheqin vëmendjen. Vrasja e Kenedit, në këtë drejtim, ka qenë emblematike. Një shkak tjetër i mundshëm i përplasjes ka qenë kontrolli nga jashtë i makinës. Randalf Fajns, i famshëm për ekspeditat polare, ka qenë oficer i trupave mbretërore skoceze dhe pjesëtar i trupave SAS. Ka shkruar një libër mbi një grup të fshehtë vrasësish që quhej "Klinika" dhe mbi mënyrat me të cilat vrisnin njerëz duke i paraqitur vrasjet si aksidente. Vdekja e majorit Majkëll Marman është veçanërisht domethënëse për atë që mund të ketë ndodhur në Paris. Ky po drejtonte një makinë *Citroen 2CV* në rrugën A303, pranë Stonhenxhit, në nëntor 1986, kur një *BMV* që po vinte përballë doli befas në krahun tjetër të rrugës me sa shpejtësi që kishte dhe e vrau në vend. Fajnsi thotë se *BMV*-ja manovrohej nga larg dhe se frenat ishin nxjerrë jashtë përdorimit përmes një telekomande e cila qe në gjendje të nxirrte jashtë funksionit gjithë sistemin e zakonshëm falë çlirimit të ajrit të ngjeshur nga një cilindër i vogël që përdoret për zhytjet nënujore dhe që mund të qe fshehur

në motorin e saj. Telekomanda mund të jenë vënë në përdorim nga një *Vovlo* që ndiqte nga pas *BMV*-në, thotë Fajnsi. *BMV*-ja drejtohej nga sër Piter Harsli, një marshall në pension i trupave ajrore, i cili i mbijetoi përplasjes. Fajnsi shton se "Klinika" e dinte se Harsli do të gjendej atë çast në të njëjtën pjesë rruge ku do të kalonte objektivi i tyre. Në autobiografinë e titulluar "Zhurma nga dhoma tjetër", Harsli tregon se i kishte dhënë gaz makinës deri në shpejtësinë 90 kilometra në orë kur ajo nisi të sillej në mënyrë të çuditshme. Atëherë kishte parë një *Volvo* ngjyrë gri që po i afrohej shpejt nga prapa dhe kishte kërkuar të largohej prej saj. Por *BMV*-ja u kthye vetë majtas duke lëshuar një zhurmë të mprehtë frenash, pastaj djathtas e pastaj përsëri majtas, në drejtimin e kundërt. Kjo ngjason së tepërmi me atë që i ndodhi *Mercedesit* para se të përplasej me shtyllën e 13-të. Në këtë pikë, Harsli po përpiqej me dëshpërim të mbante makinën nën kontroll, siç e përshkruan dhe vetë:

"Me bisht të syrit, pashë Volvon gri që i dha gaz dhe eci para meje. Makina ime dukej sikur po bënte ç't'i thoshte mendja, duke ecur nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Befas, e pashë veten në mes, kapërceva rripin me bar që ndan dy pjesët e rrugës dhe përfundova nga korsia e drejtimit të kundërt. Pata kohë të shihja një makinë të vogël që po më afrohej. U përplas në pjesën anësore të makinës sime me një forcë të madhe. Në një pjesë të sekondës, pashë fytyrën e tmerruar të shoferit dhe dëgjova thirrjen e tij të ngjirur"[50].

Ka mundësi që edhe *Mercedesi* i Dajanës të jetë kontrolluar në këtë mënyrë sepse, është e qartë që edhe timoni i *BMV*-së së Harslit kontrollohej nga largësia. Vetëm një manovrues shumë i zoti nga distanca do të qe në gjendje ta përplaste *Mercedesin* pas shtyllës së 13-të. Një mbështetje ndaj tezës se, në këtë përplasje, nuk qe përfshirë asnjë makinë tjetër vjen prej Erik Petelit, i cili thotë se e pa më sytë e tij aksidentin. Peteli thotë së po hynte në tunel me motoçikletë kur *Mercedesi* e parakaloi. Nuk kishte asnjë makinë tjetër aty. Ja si tregon:

"Në pasqyrën e motorit, pashë një makinë që po afrohej nga pas me dritat e ndezura. U zhvendosa për t'i hapur rrugën të kalonte dhe më kaloi anash si shigjetë, megjithëse unë po ecja me afro 100 kilometra në orë. Pas një çasti, dëgjova një zhurmë shurdhuese dhe pashë aksidentin. Makina u rrotullua rreth vetes në mes të rrugës... Ndalova. Përreth nuk kishte as makina e as motorë të tjerë; mund të shihja gjithë tunelin, deri te dalja. Kabina e *Mercedesit* qe shtypur fare. Dera e pasme e djathtë kishte mbetur pak e hapur.

Hodha sytë dhe pashë një grua. Dukej sikur ndenjësja e prapme e kishte shtyrë fort përpara dhe koka i gjendej mes dy ndenjëseve të para."[51]

Peteli thotë se nga veshi i djathtë po i dilte gjak dhe, kur i largoi flokët nga fytyra dhe i vendosi krahun nën kokë, e njohu që ishte princesha Dajana. Rrihte lehtë qepallat por nuk arriti t'i hapte sytë, shton ai. Peteli thotë se qëndroi në vendngjarje për afro një minutë para se t'i hipte motorit për të lajmëruar policët, të cilëve u tha se Dajana kishte pësuar aksident. Policët kishin qeshur dhe i kishin thënë të mos u harxhonte kot kohën. I dëshpëruar, Peteli u hodh deri te komisariati i Avenysë Mozart, aty pranë. Avokati i tij, Antuan Degin, thotë se Petelin e lanë të priste plot 25 minuta, pastaj e futën në një zyrë ku i vunë prangat. Ngaqë kishte lajmëruar për "aksidentin"? Pastaj, kur e lëshuan, i thanë të ndiqte nga pas një makinë policie deri në një komisariat tjetër ku lëshoi dhe një deklaratë të cilën e nënshkroi pa e lexuar. "Ndjehesha i poshtëruar", tha më pas, "dukej sikur nuk u interesonte aspak ai aksident". Më pas, nuk mori asnjë lajm nga autoritetet deri sa t'i drejtohej një avokati i cili u tregoi rrëfimin e tij hetuesve zyrtarë.

Sa herë që në ndonjë vend publik ndodh ndonjë vrasje, ndodhin dy gjëra. Ose përgjegjësia i shkarkohet një njeriu duke e shndërruar kështu në "dashin e kurbanit" dhe sot, si të tillë shërbejnë njerëzit me mendje të kontrolluar, ose kërkohet që hetuesit të largohen nga e vërteta në mënyra nga më të ndryshmet. Metoda e parë zbatohet duke kryer menjëherë ndonjë arrestim dhe duke ia veshur të tërë fajin një personi dhe, në këtë pikë, nuk del nevoja për asnjë hetim shtesë sepse të gjithë e dinë se kush është fajtori. Zbatimin e kësaj teknike e kemi parë në rastin e Li Harvej Osualdit, Sirhan Sirhanit, Timoti MekVeigut dhe Henri Paulit. Radha është pa fund. Metoda e dytë, nxjerrja nga binarët, garanton që orët dhe ditët vendimtare pas ngjarjes të shpenzohen duke ndjekur një sërë historish e "pistash" të rreme. Kjo teknikë u përdor në Paris me paparacët, dritat verbuese të motoçikletës apo me makinën *Fiat Uno*. Kur njerëzit përballen me një varg historish e teorish nga më të ndryshmet ngatërrohen dhe mendja e ngatërruar mbyllet dhe humbet interesin. Kështu, në fillim ju thonë se faji qe i paparacëve, pastaj se nuk ishte kështu. Pastaj ju thonë se shpejtësimatësi i makinës shënonte 120 kilometra në orë e pastaj se shënonte zero.

M'u duk qysh në fillim shumë e çuditshme që u gjendën aq shumë amerikanë pranë vendit të aksidentit. Pon dë l'Alma dhe Plas dë l'Alma, para vdekjes së Dajanës, nuk ishin vende ku mblidheshin turistë. Në atë vend nuk ka asgjë, përveç një ose dy restoranteve, një tuneli dhe një labirinti rrugësh

që kryqëzohen mes tyre. E megjithatë, nga ora 12:25 e asaj nate, shumë turistë amerikanë thonë se kishin qenë të pranishëm në atë që ndodhi. Numri i dëshmitarëve është i pazakontë po të kemi parasysh orën e vonë dhe faktin se Parisi zbrazet në atë periudhë të vitit sepse shumë banorë të tij shkojnë me pushime nëpër plazhet e bregdetit francez. Mund ta kuptoj se disa njerëz mund ta kenë parë aksidentin dhe atë që ndodhi më pas që nga brenda makinave të pakta që lëviznin në atë orë por, pasi e vizitova vetë vendin, duket qartë se nga rrugët kryesore të këmbësorëve nuk mund të shihet asgjë brenda tunelit. Policia nuk ndoqi procedurën normale të kontrollit të vendit të aksidentit dhe, kështu, shumë prova u zhdukën shpejt. Ajo as nuk pyeti dëshmitarë të rëndësishëm që të filtronte disa informacione bazë, ndërsa në sektorë të tjerë të hetimit u rezervua së tepërmi[52]. E tërë çështja qelbet erë.

Sot, vrasësit dhe komplotet për vrasje duhet të përballen me një tjetër sfidë, atë të telekamerave të lidhura në pika të ndryshme të qytetit. Buzëqesh, po del në televizor. Do të qe e pamundur të mbaheshin të fshehta metodat dhe njerëzit e përdorur për të vrarë Dajanën nëse gjithçka do të qe filmuar. Por, po ishe i vëllazërisë dhe ke lidhje me majat e politikës, policisë dhe shërbimeve të fshehta, telekamerat e shpërndara nëpër rrugë nuk është se përbëjnë ndonjë problem të pakalueshëm. Mjafton të fiken! Në rrugën nga hoteli Ric deri në Pon dë l'Alma gjenden plot 17 telekamera, përfshi dhe ato që ndodhen brenda në tunel. Nëse, atë natë, do të kishin punuar, nuk do të kishte asnjë lloj misteri sepse mjaft të shikoheshin filmimet në një televizor. Një telekamera është vendosur pikërisht në hyrje të tunelit dhe do të kishte filmuar çfarëdo makine *Fiat Uno* apo motoçikletë me drita verbuese. Por kjo telekamerë, ashtu si të gjitha të tjerat, qe shuar në çastin e duhur. Asnjëherë më parë i tërë sistemi nuk ishte qenë jashtë funksionit në të njëjtën kohë dhe policia nuk pranoi të jepte shpjegime për këtë. Sistemi ka linjë ushqyese të veçantë dhe monitorohet nga policia dhe nga agjencitë e shërbimeve të fshehta, sepse telekamerat përdoren për të kontrolluar edhe gjëra më të rëndësishme se qarkullimi rrugor. Pikërisht atëherë kur sistemi i telekamerave doli jashtë funksionit, edhe frekuencat e komunikimit me radio të policisë në qendër të Parisit nuk punonin. Sajmën Regani, në librin e tij të shkëlqyer "Kush e vrau Dajanën?", citon një burim me emrin Andre të cilit, si shumë të tjerëve, i pëlqen të kapë mesazhet e radiove të policisë. Andreja qe ulur në një stol pranë Kullës Eifel, pak minuta në këmbë larg Pon dë l'Alma, atë natë që vdiq Dajana. Si zakonisht, po përdorte një marrës me të cilin kapte komunikimet e policisë. Por befas, në orën 12:20 të natës, të gjitha linjat ranë. Qe një lloj bllokauti radiofonik. Zgjati 20 minuta dhe pastaj, thotë Andeja, sinjali u kthye.

Pati një mbivendosje të madhe zërash, sikur të gjithë donin të flisnin njëherësh. "Nuk kisha kapur asnjëherë një kaos të tillë radiofonik" tregon ai. "Qe e jashtëzakonshme". Pikërisht kur ranë linjat, Dajana po dilte nga hoteli Ric në udhëtimin e fundit të saj. Kur u kthye komunikimi, ajo tashmë gjendej pa ndjenja në tunel, nën kontrollin e mjekut të ndihmës së shpejtë dhe, sipas vetë mjekut, pas pak minutash do të shpallej klinikisht e vdekur. Pra, nuk paska asnjë lloj prove sado të vogël që bëhet fjalë për komplot? O Zot, po kjo është e qartë si drita e diellit! Ndërsa policia franceze, dhjetë ditë pas aksidentit, paraqiti një raport me 350 faqe që jepte prova se bëhej fjalë për aksident dhe hidhte poshtë çdo mundësi tjetër.

Ata "mjekët e ndihmës së shpejtë" na drejtojnë nga një pikë tjetër thelbësore e historisë. Siç më bëri të ditur një burim shumë i afërt me shërbimet e fshehta britanike, për aktorët e përfshirë në këtë ngjarje nuk është aspak e vështirë të shkaktojnë një aksident rrugor por e vështirë është të sigurohen që objektivi do të vdesë. Ja përse duhet që këta persona të kenë kontroll edhe mbi mjekët pasi, nëse ndodh që objektivi të mos vdesë, të ketë arsye të besueshme që të vdesë. Ndodhi një aksident. Detyra e mjekëve (ose e kujtdo që kryen këtë funksion) është të sigurohen që objektivi të mos mbijetojë, pavarësisht kushteve fillestare. Edhe ata që nuk e pranojnë hipotezën se Dajana u vra, shtrojnë pyetjen e arsyes së asaj vonese të pazakontë për dërgimin e saj në spital kur, sipas raportit zyrtar mjekësor, kishte një plagë e cila duhej trajtuar me urgjencë. Mjekët thonë se vena kryesore polmonare pranë zemrës i qe çarë dhe i kishte mbushur mushkëritë me gjak. Dajana qëndronte e shtrirë në tunel ndërsa hemorragjia e brendshme po e shuante, nëse mund të shprehem kështu. Mënyra e vetme për ta shpëtuar qe ndërhyrja e menjëhershme kirurgjike. Atëherë, pse u desh më tepër se gjysmë ore para se ta çonin në spital? Vetëm një minutë pas përplasjes, mjeku Frederik Meje me një "mik" amerikan të quajtur Mark Bat, hynë në tunel nga drejtimi i kundërt. Një hetues privat që e njoh ka kryer kërkime të shumta për Majenë dhe Batin, madje vazhdon ende të kërkojë, dhe ka zbuluar se për ta nuk është thënë çdo gjë që dihet. Aksidenti ndodhi në 12:25 të natës dhe, në 12:26 mjeku Meje tha se kishte parë *Mercedesin* e shkatërruar, kishte ndaluar makinë e vet, kishte ndezur dritat e emergjencës dhe kishte vrapuar drejt *Mercedesit*. Aty kishte zbuluar se brenda makinës gjendeshin dy njerëz të vdekur e dy të gjallë dhe kishte lajmëruar ambulancën. Ky burri nuk duket dhe aq i zgjuar. Në fakt, është një nga 160 mjekët e Parisit që qëndrojnë përherë në dispozicion të rasteve emergjente nëpër spitale dhe shtëpi banimi, anëtar i sistemit francez të sigurisë "SOS Medsë". Kishte ndihmuar shumë

LIBRI 24

herë viktimat në raste aksidentesh kur kishte punuar për shërbimin SAMU, shërbimin e ambulancave franceze. Ky mjek i specializuar për rastet emergjente thotë se në makinë i gjendej vetëm një bombol oksigjeni me të cilën mund të ndihmonte Dajanën. Mejeja qe përgjegjës për Dajanën dhe kushtet e saj në ato 15-20 minuta vendimtare para se të mbërrinin punëdhënësit e tij të dikurshëm, ekipi i urgjencës SAMU. Ai tregon se Dajana nuk foli asnjë fjalë, por kjo bie në kundërshtim me deklaratën që botoi gazeta londineze "Tajms" sipas së cilës "Vazhdonte të thoshte se ndjente shumë dhembje ndërsa unë po përpiqesha t'i vendosja maskën e oksigjenit në gojë." Edhe Trevor Ris-Xhonsi, truproja, thotë se i kujtohet që e kishte dëgjuar zërin e saj nga ndenjësja e prapme e makinës: "Në fillim dëgjova një rënkim. Pastaj dëgjova të shqiptohej emri i Dodit... nuk mund të ishte gjë tjetër veçse zëri i Dajanës", është shprehur për gazetën "Deili Mirrër"[53]. Mirëpo, vërtetësia e kësaj thënieje mund të jetë e diskutueshme. Ajo që është e qartë është se Dajana qe e vetëdijshme ose, të paktën, gjysmë e vetëdijshme, kur kishte mbërritur Mejeja. Ky i tregoi më pas Lerri Kingut, në emisionin e tij në "CNN" se "nga jashtë dukej sikur nuk qe dëmtuar shumë. Në fillim... nga jashtë, dukej në kushte të mira. Por plaga e brendshme po i rridhte gjak... Vërtet e çuditshme. Pjesa ku qe ulur ajo qe vendi i vetëm i padëmtuar rëndë i makinës". Nga njëra anë, Mejeja kishte deklaruar për një revistë mjekësore franceze: "Mendoja se ajo mund të shpëtonte" ndërsa, në një rast tjetër, është shprehur: "Gjendja qe e pashpresë. Nuk mund të bëhej asgjë për ta shpëtuar". Edhe Kingu thotë se, pavarësisht se Dajana ishte gruaja më e fotografuar në botë dhe paparacët vazhdonin të shkrepnin fotografi ndërsa ai përpiqej ta shpëtonte në tunel, nuk e kuptoi që bëhej fjalë për princeshën Dajana deri sa pa lajmet në mëngjes. Na mbushi mendjen! Po fluturokan përsëri gomarë në qiell! Kur erdhi ambulanca, Mejeja thotë se u largua, pasi nuk kishte ç'të bënte më aty.

Shpjegimi zyrtar për vonesën e pabesueshme me të cilën u dërgua Dajana në spital ishte se ajo qe bllokuar brenda makinës së shtypur. Kjo është një gënjeshtër aq e madhe sa nuk ka thes që ta mbajë. Një nga pjesëtarët e ekipit të ndihmës i tha gazetës franceze "Le Parizië" se, kur mbërriti ai, Dajana qe shtrirë me pjesën më të madhe të trupit jashtë makinës dhe me këmbët mbi ndenjësen e prapme. "Gati i kishte humbur ndjenjat, por qe ende gjallë... rënkonte e luftonte dobët. Pëshpëriti disa herë: O Zot". E përditshmja "Dhë Skotsman" në një shkrim të botuar më 11 shtator 1997, na siguron se Dajana qe nxjerrë nga makina pak pas mbërritjes së zjarrfikësve dhe se shfajësimi që "qe bllokuar" nuk qëndron. Një tjetër arsye e vonesës ishte se mjekëve të ndihmës së shpejtë iu desh t'i bënin një transfuzion gjaku. Ja dhe një

gënjeshtër tjetër e madhe. Ekipet SAMU nuk mbajnë me vete pajisjet e nevojshme për transfuzione gjaku sepse nuk kanë si ta dinë grupin e gjakut të viktimës. Kur ambulanca u nis, më në fund, nga tuneli, shoferit iu kërkua të mos ecte më shpejt se me 40 kilometra në orë dhe, sipas disa gazetarëve, u deshën plot 40 minuta për të përshkruar ato 6 kilometra deri në spitalin La Pitie-Salpetrier. Katër spitale të tjerë që ishin në gjendje të ofronin ndërhyrjet urgjente për Dajanën ndodheshin më afër vendngjarjes. Përveç kësaj, ambulanca ndaloi dhe dy herë gjatë rrugës për "ndërhyrje delikate". Një prej ndalesave u bë fare pranë spitalit. Dajana mbërriti në La Pitie-Salpetrier rreth orës 2:10, një orë e 45 minuta pas aksidentit. Nga cilido këndvështrim mjekësor, kjo vonesë ishte tejet absurde, veç në mos qoftë e qëllimshme. Nuk duhet të jesh ndonjë gjeni që ta kuptosh se përse, përveç paaftësisë në dukje, nuk u kryen hetime mbi sjelljen e mjekëve atë natë. Dajanën po e priste në spital një ekip kirurgësh i drejtuar nga profesor Bryno Riu, kirurgu që kishte radhën e shërbimit dhe i cili, siç u mësua më pas, e kishte marrë vesh për aksidentin ndërsa inspektonte radhët me të sëmurë. Jo vetëm mua, por edhe të tjerëve u duket e çuditshme që një kirurg i famshëm të "inspektojë të sëmurët" në orët e para të mëngjesit. Kur mbërriti Dajana, bashkë me të ishin edhe profesor Pierr Koriati, shefi i anestezisë, profesor Alen Pavie, kardiolog dhe profesor Pierr Benaze, një kirurg tjetër shumë i njohur. Kishin mbajtur lidhje të vazhdueshme me skuadrën e ndihmës së shpejtë në vendin e ngjarjes. Na u tha se këta mjekë i hapën kraharorin Dajanës, i mbyllën venën e çarë dhe, për një orë e gjysmë, "luftuan për ta shpëtuar", para se të dorëzoheshin të mundur. E gjitha kjo më duket e pabesueshme sepse, sipas autopsisë, Dajana kishte vdekur klinikisht qysh në orën 12:45, kur gjendej ende brenda tunelit. Kështu që kishte vdekur një orë e 25 minuta para se të mbërrinte në spital dhe prej tri orësh nga çasti kur mjekët dolën nga salla e operacionit për të lajmëruar se kishte vdekur. Shqyrtimi i trupit në një vend ku mund ta kontrollosh atë me hollësi është një hap jetësor për këta vrasës. Trupi i presidentit Kenedi u transportua me aeroplan menjëherë nga Dallasi drejt një qendre të Vëllazërisë, bazës detare Bethesda, pranë Uashingtonit, për t'i bërë autopsinë. Aty, truri i presidentit (ose i sozisë së tij) u zhduk dhe, siç doli nga komisioni amerikan i shqyrtimit të vrasjeve, shënimet dhe dosja e parë e autopsisë ishin djegur.

Atëherë, kush qëndron pas vrasjes së Dajanës? Është e rëndësishme të theksojmë se ata që dhanë urdhrin dhe ata që e zbatuan nuk janë të njëjtët njerëz. Kemi të bëjmë me një Vëllazëri, një rrjetë merimange dhe, ndërsa është e mundur që urdhri të jetë nisur nga merimanga ose merimangat në

qendër, zbatimi i tij është kryer nga mizat. Nuk ka të ngjarë të jetë kryer drejtpërdrejt nga shërbimet e fshehta britanike sepse do të qe shumë i zbuluar. Agjencitë e shërbimeve të fshehta kontraktojnë vrasës për qytetarët e vet me qëllim që të qëndrojnë vetë larg vendit të krimit dhe që pastaj "ta mohojnë me argumente" përfshirjen e tyre në të. Për shembull, ka prova që presidenti Kenedi u gjuajt nga një skuadër qitësish të zgjedhur, të përjashtuar nga shërbimet e fshehta franceze OAS, nëse edhe këto shërbime qenë përfshirë në komplot. Olof Palme, kryeministri suedez i Bilderbergut, u vra në Stokholm në 1986 me urdhër, mes të tjerëve, edhe të Xhorxh Bushit. Por vrasja u krye nga pjesëtarë të BOSS-it, agjencisë së shërbimeve të fshehta afrikano-jugore. Ministri i jashtëm britanik ka skuadrën e vet vrasëse që quhet Grupi 13 (përsëri ky numër!) ndërsa shërbimet e fshehta britanike mbajnë mbi supe një histori të gjatë e të errët vrasjesh të eksponentëve të politikës dhe ekonomisë. Shërbimet e fshehta britanike përbëhen nga MI5 (*Militëri intelixhens* 5), përgjegjës për sigurinë e brendshme, dhe nga MI6, që merret me çështjet e jashtme. MI5-a bëri një deklaratë, në 1988, se nuk vriste njerëz. Është e vërtetë, nuk e bën këtë. Ngarkon të tjerë që ta bëjnë. Ky përgënjeshtrim patetik u deklarua pasi ish agjenti i MI5-ës, Dejvid Shejlër, tha se MI6-a kishte organizuar një komplot për të vrarë kolonelin libian Gedafi. Përpjekja kishte dështuar sepse bomba nuk u vendos nën makinën e duhur. Shejlëri drejtonte atëherë sektorin libian të MI5-ës dhe, duke pasur parasysh pozicionin që mbante, nuk kishte si të mos e dinte këtë. Robin Kuku, i cili tani është aq shumë jashtë rrjedhës së botës saqë duhet dikush që ta kthejë mbrapsht, tha atëherë se e kishin siguruar që kjo nuk kishte ndodhur kurrë. Epo mirë, mund ta flemë mendjen tani. Prokurori i përgjithshëm i ndaloi Dejvid Shejlërit të shfaqej në emisionin televiziv "Dajana - të fshehtat e përplasjes". Më pas, Shejlëri u arrestua dhe u burgos në Paris, në pritje të ekstradimit për në Londër. Pse gjithë kjo, nëse ato që thotë ai nuk paskan pikë kuptimi? Dihet, sepse ka të drejtë. Meqë ra fjala, betimi i punonjësve të shërbimeve të fshehta britanike nuk i drejtohet qeverisë, por mbretërisë. E njëjta gjë ndodh edhe me anëtarët e parlamentit dhe ushtarakët. Si përfundim, shefja e tyre është mbretëresha edhe pse, të thuash të drejtën, shefi i vërtetë është ai që kontrollon mbretëreshën sepse, në majë, nuk qëndron ajo.

I loji i organizatës që ka shumë të ngjarë të jetë përfshirë në vdekjen e Dajanës, në nivelin operativ, përfaqësohet nga Rrethi Pinej ose *Lë Sirklë*, i cili përfshin në gjirin e vet shumë figura të "kishës". *Lë Serklë* është një degë e grupit edhe më elitar *Safari Klab*, të themeluar nga konti Aleksandër dë Maranshe i cili, gjatë viteve 1970, ka qenë drejtor i shërbimeve franceze të

dokumentacionit të jashtëm dhe spiunazhit. *Safari Klab* organizoi aleancën mes një shoqërie franceze fasadë të Vëllazërisë, të quajtur grupi *Bull* dhe gjigandit informatik *Haniuell* i cili është, do të habiteni me këtë, prodhuesi më i madh botëror i minave tokësore. Kjo aleancë ka furnizuar me mina të dyja palët e përfshira në luftën e Bosnjës. *Safari Klab* e nisi veprimtarinë si ortak i policisë së fshehtë shiite të Iranit, të quajtur SAVAK, të Sadam Huseinit në Irak, të Anuar Sadatit në Egjipt dhe të shërbimeve të fshehta saudite. Pastaj u përfshi në tregtinë dhe furnizimet me armë. Nga *Safari Klab* rrodhi Rrethi Pinej ose *Lë Serklë*, i cili e mori emrin nga kryeministri francez Antuan Pinej, që mori pjesë në takimin e parë mes Bilderbergut dhe Osterbekut, në Holandë, në maj 1954. Mes anëtarëve të tjerë të *Lë Serklë* figuron edhe familja e Habsburgëve. Për të pasur një ide mbi përbërjen e tij dhe sferat e ndikimit, duhet ta dini se, në radhët e tij kanë milituar: Nikolas Elioti, shefi i departamentit të MI6-ës, Uilliam Kolbi, ish drejtor i CIA-s, koloneli Bota i shërbimeve të fshehta ushtarake zvicerane, Stefano Dele Kiaie, anëtar i njohur i shërbimeve të fshehta italiane, Xhulio Andreoti, ish kryeministër italian që i përket Lozhës masonike P2 dhe mbështet zyrtarisht mafien, Silva Munozi, ish ministri fashist i Frankos në Spanjë dhe anëtar i shoqërisë së fshehtë elitare Opus Dei, Franc Jozef Shtrausi, ministër gjerman i mbrojtjes dhe Imzot Bruneloja, agjent në Vatikan. Në Amerikë, një nga degët e *Lë Serklë* është *Heritejxh Foundejshën* në Uashington që financohet nga CIA. Funksioni i këtyre organizatave është të veprojnë si forca bashkërenduese mes agjencive të panumërta dhe vendeve të ndryshme që ndjekin të njëjtin qëllim. Rrjeti *Safar Klab - Lë Serklë* shërben si urë lidhëse mes arabëve, francezëve dhe britanikëve. Në rastin tonë, ai siguroi që Dajana të gjendej në Paris në çastin e duhur, që të mbeste pa shoqërues, që vrasja të kryhej dhe përgjegjësit ta hidhnin lumin pa u lagur. Si thotë Xhon Stalkeri? "Pse duhet të mbulonin francezët vrasjen e një anglezi?" Interesante është dhe ajo që na thotë Sajmën Regani në librin e tij "Kush e vrau Dajanën?" sipas të cilit *Lë Serklë* destabilizoi qeverinë Gaf Uitlem në Australi në vitin 1975. Natyrisht që edhe mbretëresha luajti rolin e saj. Siç e kam shpjeguar tashmë, në fund Uitlemin e hoqi qafe guvernatori i Australisë, Filip Kerr. Nëse Uinsdorët dhe *Lë Serklë* bashkëpunuan atëherë për të rrëzuar një qeveri australiane të zgjedhur në mënyrë të rregullt, pse nuk paskan bashkëpunuar tani për të eliminuar Dajanën?

Parisi, me lidhjet e tij të shumta shekullore me Vëllazërinë, ka qenë gjithnjë një nga teatrot më të njohura për vrasje dhe komplote. Amshel Rotshildi, që i përket degës angleze të familjes, u vra pikërisht atje, në dhomën e një hoteli,

më 1996, në atë që shumë njerëz e quajnë një luftë të brendshme të Vëllazërisë me të cilat është e mbushur historia. Për një organizatë si *Të Serklë* ose shumë organizata të tjera homologe në tokën britanike, është e thjeshtë t'i vendosin njerëzit e tyre në pozicionet e duhura. Eskorta e Al Fajedit është e mbushur plot me ish pjesëtarë të njësive elitare ushtarake e policore britanike, të cilët i njohin mirë rrjedhojat e një përgjigjeje negative ndaj kërkesave të Vëllazërisë, megjithëse mund të mos duan të përfshihen drejtpërdrejt në të. Në të njëjtën mënyrë, këto struktura si rrjeta merimange sigurojnë që hetimet e krimeve të kryhen nga njerëzit e tyre, siç ndodhi në rastin e Kenedit. Edhe hetimi privat që kreu Mohamed Al Fajedi për vdekjen e Dajanës u drejtua nga Pierr Otavuali, ish shefi i sektorit kriminalistik, departamenti i hetimit të krimeve i policisë franceze. Bëhet fjalë për të njëjtën organizatë përgjegjëse edhe për hetimin zyrtar. Përfaqësuesi ligjor i Al Fajedit në Paris është një ish ministër i drejtësisë franceze ndërsa mbikëqyrja e përgjithshme në Londër i është besuar Xhon Meknamaras, shefit të tij të sigurisë, një ish shef i administrimit të selisë qendrore të policisë metropolitane londineze të Skotland Jardit. Në pranverën e 1998-ës, Meknamara mori pjesë në një operacion të agjencisë së shërbimeve të fshehta izraelite, Mosad, i cili u përmbyll me arrestimin e një ish agjenti të CIA-s me emrin Osuald Lë Uinter, një amerikan 67 vjeçar, me origjinë austriake. Lë Uinteri kishte kontaktuar Al Fajedin duke i thënë se zotëronte dokumente që tregonin përfshirjen e MI6-ës dhe CIA-s në vrasjen e Dajanës. I kërkoi 10 milionë dollarë në shkëmbim dhe, pas një takimi me Meknamaran, iu dhanë 15000 dollarë paradhënie. U organizua një takim tjetër në Vjenë, Austri, ku do të shkëmbeheshin dokumentet më të rëndësishme kundrejt pjesës së mbetur të parave. Ndërkohë, Al Fajedi kontaktoi me një mik të vetin në FBI, ky i fundit bisedoi me CIA-n. Lë Uinteri u përgjua dhe u tërhoq drejt hotelit Ambasador në Vjenë, të mërkurën në 22 prill ku, me mbështetjen e policisë austriake dhe një grupi agjentësh të FBI-së, të CIA-s, ndoshta edhe të Mosadit, u kap në grackë. E gjitha kjo për një të dyshuar si mashtrues? Kjo histori do të kishte mbetur e panjohur po të mos e kishte rrjerrë Peter Groligu, një gazetar austriak i të përditshmes "Kurier". Ai e tregoi gjithë ngjarjen dhe zbuloi se, gjatë kontrollit në dhomën e Lë Uinterit në hotel u gjetën katër dokumente, dy prej të cilëve të koduar, që dukeshin si dokumente autentike të CIA-s. Prej këtij çasti, CIA pranoi se kishte regjistruar disa biseda telefonike të Dajanës në ose drejt Amerikës dhe përmbajtjen e tyre ua kishte dhënë shërbimeve të fshehta britanike. Lë Uinteri u arrestua dhe u mbajt në qeli. Historia që u tregua nga Groligu e detyroi Al Fajedin të pranonte se ajo ishte e vërtetë. Sipas jush, Lë Uinteri u arrestua nga një grup

LIBRI 24

i tillë agjentësh sigurie ngaqë po i shiste Al Fajedit një histori të vërtetë apo të rreme? Një burim tjetër i shërbimeve të fshehta thotë se zhurma nuk qe e rastësishme. Riçard Tomlinson, një ish agjent i MI6-ës britanike u ofroi hetuesve francezë prova për vrasjen e Dajanës. Në 1997, Tomlinsoni u dënua me gjashtë muaj burg në bazë të ligjit për të fshehtat zyrtare duke u akuzuar se kishte kërkuar të shiste kujtimet e tij. Në gusht 1998 u arrestua përsëri, nën kërcënimin e armëve të zjarrit, në Paris, me kërkesën e qeverisë britanike, e cila shqetësohej për lidhjet e tij me spiunin e MI5-ës, Dejvid Shejlër, edhe ky arrestuar dhe burgosur në Paris[54]. Me sa duket, Tomlinsoni i ka thënë Herv Stefanit, gjykatësit të ngarkuar me "hetimet", se vdekja e Dajanës qe vrasje. Sipas një lajmi të dhënë nga një edicion i *BBC*-së më 28 gusht 1998, ai i kishte thënë gjykatësit se Henri Pauli ishte agjent i shërbimeve të fshehta britanike, ashtu si dhe "një nga truprojat e tjerë". Se cili prej tyre, kjo nuk u saktësua. Ndërkohë, Herv Stefani, një vartës i vëllazërisë, po përpiqej sa mundej që të mbronte vijën e aksidentit.

Pyetja më e rëndësishme që duhet të shtrojmë kur kërkojmë të identifikojmë përgjegjësit e një krimi është: "Kush përfiton prej tij?" Siç shprehet autori romak Seneka: "Ai që përfiton më tepër nga një krim, ai është i dyshuari kryesor." Në rastin tonë, përfitimin më të madhe patën Uindsorët. Sepse Dajana nuk jeton më që të vazhdojë, me veprimet e saj dhe në bazë të të fshehtave që njihte, fushatën e shkatërrimit të pashmangshëm të besueshmërisë së monarkisë dhe të vlerësimit që ushqen opinioni publik ndaj këtij institucioni. Nuk jeton më që të ushtrojë ndikimin e saj mbi edukimin dhe sjelljen e mbretit të ardhshëm, princit Uilliam, dhe vëllait të tij Herri. Uindsorët tashmë kanë kontroll të plotë mbi ta dhe mund t'u japin formën që dëshirojnë. Më parë nuk mund ta bënin këtë sepse, ndikimi i Dajanës qe shumë i fortë. Shpresoj që kujtimi i saj t'u japë forcë princërve t'i kundërvihen indoktrinimit. Rruga për martesën e Çarlsit me Kamila Parker-Boulsin u hap sepse Dajana nuk përbën më pengesë dhe ka përmbushur detyrën mbretërore për t'u dhënë Uindsorëve trashëgimtarë me gjak Spenseri edhe pse, siç do ta shohim, Uilliami mund të mos jetë djali i Çarlsit. Njerëz të tjerë kanë hedhur hipotezën se Dajana u vra për shkak të fushatës së saj kundër minave anti-njeri. Kjo nuk është e vërtetë, të paktën, jo drejtpërdrejt. Prodhuesit e minave anti-njeri përfituan nga fushata e saj, sepse nxorën fitime të majme nga çmontimi i minave që kishin prodhuar vetë. Një minë e blen me 30 stërlina, por çmontimi i saj ka një kosto të paktën 3000 stërlina. Kostoja e heqjes dhe çmontimit të gjithë minave në botë kushton rreth 330 miliard stërlina. Jo, prodhuesit e minave anti-njeri nuk e penguan fushatën e Dajanës, madje

kishin arsye që ta mbështesnin. Por ajo tregoi se qe në gjendje të nxirrte në dritë dhe të bënte publike një dukuri deri atëherë të mbajtur të fshehur. Ndoshta, në atë pikë, u shtrua pyetja: "Cila do të jetë lëvizja e saj e radhës?" Pastaj, ç'ishte ajo gjë që Dajana kishte ndërmend të nxirrte së shpejti, siç i tha informatorit tim, dhe që "do të trondiste gjithë botën?" Henri Kisingeri, një nga manipuluesit më të mëdhenj të Vëllazërisë të shekullit XX, e kishte takuar disa herë Dajanën, madje mori pjesë, pa pikë turpi, dhe në funeralin saj. Në një intervistë që dha pas vdekjes së saj, tha se "ajo qe e pakontrollueshme nga ana politike dhe diplomatike". Sipas stilit të Kisingerit, kjo do të thotë: "Kjo është një nga arsyet pse u vra." Njësoj siç kishte ndodhur me Kenedin, kishte shumë arsye për të cilat niveli operativ i piramidave të vëllazërisë donte kokën e saj. Por, siç vazhdoj ta theksoj, ky ishte vetëm një nivel. Maja përbëhet nga anëtarët e magjisë së zezë të Elitës, nga ata me gjak të pastër dhe nga hibridët zvarranikë. Për krerët e vëllazërisë, vdekja e Dajanës, ashtu si ajo e Kenedit, qe një vrasje rituale. Ishte planifikuar prej kohësh edhe për efektin që do të kishte mbi njerëzit dhe mbi fushën magnetike tokësore, si dhe për të simbolizuar futjen e Rendit të Ri Botëror. Mos e nënvlerësoni fuqinë e jashtëzakonshme që kanë ritualet dhe simbolet mbi psikikën njerëzore dhe mbi fushën magnetike tokësore. Këta njerëz nuk janë më kot të dhënë aq shumë pas tyre. Simbolizmi satanik i Vëllazërisë që mbështjell vdekjen e Dajanës është i pafundmë dhe, për të kuptuar klimën që rrethoi vrasjen e saj na duhet, edhe një herë tjetër, të kthehemi shumë mbrapa në kohë. Diana qe një nga hyjnitë më të mëdha të botës së lashtë; përfaqësonte energjinë femërore dhe njihej edhe si Barati, Britania, Isida, Artemisa, Afërdita, që të gjithë emra të ndryshëm për të përshkruar të njëjtën energji. Nëse kthehemi shumë mbrapa në kohë, do të gjejmë një tjetër figurë simbolike për këtë hyjni, atë të Ninkharsagut. Diana njihej si perëndesha e Hënës. Një degë e Elitës që adhuronte perëndeshën Diana ishte ajo e frankëve sikambër, origjina e të cilëve mund të na kthejë deri në Trojë (përsëri ky emër!) përmes Azisë së Vogël, Turqisë së sotme, maleve të Kaukazit (përsëri!) e pastaj, deri në Evropë. Dikur jetonin në perëndim të Danubit dhe u vendosën në Gjermani ndërsa romakët i thërrisnin me fjalën *skit* që do të thotë "të pastër" ndërsa qendrën e kishin në Këln. Pushtuan disa pjesë të Galisë që e kishin shtënë në dorë romakët, një sipërfaqe toke që sot i takon Belgjikës dhe Francës veriore, prej ku rrodhën dhe familjet "fisnike" skoceze. Nga frankët sikambër rrodhi dhe emri "Francë". Në kohën e mbretit Meroveo, i cili u quajt Mbrojtësi i Frankëve në vitin 448, ky popull u njoh me emrin Merovinjë ndërsa princesha Dajana kishte lidhje me ta përmes degës së Stjuartëve. Duket

se shumë njerëz besojnë se Merovinjët janë pasardhës të Jezusit, por nuk ma merr mendja që të kenë rrjedhur nga një familje mitike. Bëhet fjalë për një përpjekje për të humbur gjurmët. Sido qoftë, ekziston një degë elitare që na çon te raca ariane e Lindjes së Mesme dhe të Afërt dhe që pastaj duket sikur është zhdukur nga planeti. Merovinjët ishin mbretër shtriganë të njohur për dijet e tyre ezoterike dhe fuqitë magjike që kishin trashëguar nga degë të nëndheshme dhe ceremoni të fshehta. Franku, themeluesi i frankëve, thoshte se rridhte nga Noeja dhe se paraardhësit e tij dikur banonin në Trojën e lashtë, e cila u bë e famshme për kalin e drunjtë. Qyteti francez Trojes, ku u themelua zyrtarisht organizata e Tempullarëve, e ka marrë emrin nga toka e origjinës së frankëve sikambër. *Iliada* na tregon se Troja u themelua nga djali i Zeusit, Titani Dardan (anëtar i llojit të Gjigandëve) i cili paraqitet ose si shqiponjë, ose si gjarpër. Thuhet se Zeusi kishte lindur në Spartë, në Arkadi, dhe se spartanët emigruan më pas në Francë. Nga këto degë, dhe jo nga Jezusi, rrjedhin Merovinjët. Qyteti i Parisit u themelua nga frankët sikambër në shekullin VI, kur tashmë njiheshin me emrin Merovinjë. E mori emrin nga princi Parid, djali i Priamit, mbret i Trojës. Marrëdhënia mes Paridit dhe Helenes së Spartës shkaktoi, sipas asaj që thuhet, luftën e Trojës ku spartanët siguruan fitoren pasi u fshehën brenda një kali të drunjtë që u fut në qytet. Si trojanët, ashtu dhe spartanët, i përkisnin të njëjtës popullsi ariane dhe, brenda tyre, figuronin edhe degët zvarranike. Parisi, në ato kohë, përbëhej vetëm nga një ishull në mes të Senës, të njohur me emrin *Il dë la Site*, pra Ishulli i Qytetit. Katedralja Notrë Damë, e ndërtuar nga Tempullarët në një vend kushtuar perëndeshës Diana, ngrihet sot në *Il dë la Site* dhe pikërisht aty u dogj i gjallë Mjeshtëri i Madh i Tempullarëve, Zhak dë Molej. Merovinjët e themeluan qytetin e Parisit sipas një prej pikave kryesore të shtjellës, çka shpjegon edhe arsyen se përse katedralja Notrë Damë është ndërtuar në atë vend. Themeluesi i dinastisë merovinje, Meroveoja, qe ithtar i kultit të Dianës dhe kjo nuk është për t'u habitur duke pasur parasysh se epiqendra e këtij kulti ishte tempulli i famshëm i Hefesit, në Azinë e Vogël, jo larg vendit ku thuhet se ngrihej dikur Troja. Ky tempull është një nga shtatë mrekullitë e botës së lashtë. Diana konsiderohej si mbretëresha e parajsës, njësoj si Semiramida. Brenda bërthamës origjinare të Parisit - si dhe brenda qytetit të sotëm - merovinjët ndërtuan një mjedis të nëndheshëm kushtuar kultit të Dianës ku kryheshin ritualet dhe flijimet për nder të saj. Vendi u ndërtua rreth viteve 500-750. Pikërisht aty mbretërit rregullonin përmes dyluftimeve edhe zënkat për çështje pronësie. Sipas legjendës, kushdo që vritej në këtë vend, shkonte drejt e në parajsë dhe ulej në të djathtë të Zotit. Tani, kini të

qartë diçka: vendin ku më parë i kushtoheshin flijime Dianës sot e ka zënë... tuneli Pon dë l'Alma!

Fjala "pon" (pont) rrjedh nga "pontifeks", prift i lartë romak dhe do të thotë "kalim" ose "urë"! "Alma" rrjedh nga "Al-mah" një fjalë nga Lindja e Mesme e cila përshkruan, merreni me mend... perëndeshën e Hënës. Prandaj, emri "Pon dë l'Alma" do të thotë "vendi i perëndeshës së Hënës" dhe perëndesha e Hënës është Diana. Mund të përkthehej edhe "ura e shpirtit" por me emrin "alma" quheshin edhe virgjëreshat që i ishin kushtuar kultit të Dianës! Ja përse Henri Pauli u programua që ta shmangte apartamentin e Dodi Fajedit dhe të drejtohej pikërisht nga tuneli Pon dë l'Alma. Ja përse skuadrat e ndihmës e mbajtën aq gjatë Dajanën në tunel në vend që ta çonin në spital, ku mund të kishte shpëtuar. Ishte marrë vendimi që ajo nuk duhej shpëtuar dhe kështu që e larguan prej aty vetëm pas vdekjes klinike, siç pohon raporti i autopsisë. Sipas ritualit fanatik të përshtatur nga vëllazëria, Dajana duhet të vdiste në atë vend të nëndheshëm ku dikur ndodhej vendi i flijimeve dhe kjo duhet të ndodhte në një natë me hënë të plotë të muajit gusht i cili, sipas legjendës, i kushtohet Dianës, variantit romak të Isidës, që quhet ndryshe edhe Juno Augusta. Satanistët që i ofruan Dajanës ndihmën e parë siguruan që ajo të mos dilte e gjallë nga tuneli (nga dhoma e flijimit). Thuhet se vdiq nga gjakrrjedhja dhe, nëse është e vërtetë, ka ndodhur në përputhje të plotë me ritualet flijuese. Po shkaqet e hemorragjisë ishin vërtet ato që u thanë apo u shkaktuan nga ndonjë lëndë kimike? Dimë që Dajana u shpall klinikisht e vdekur në orën 12:25 pas mesnate, megjithatë u dërgua në spitalin La Pitie Salpetrier dhe u mbajt në sallën e operacionit për një orë e gjysmë, ndërsa ekipi mjekësor, e përbërë nga profesor Bryno Riu, Pierr Koriat, Alen Pavie dhe Zhan-Pierr Benazat, i hapi kraharorin dhe "luftoi për ta shpëtuar". Si mund të shpëtohet një njeri që, kur ka ardhur në spital, ka një orë e pesëmbëdhjetë minuta që ka vdekur? Kur mbaruan, ministri francez i punëve të brendshme, Zhan-Pierr Shevenmo, vendosi, sipas kryekëshilltarit të tij Sami Mani, që të ndalohej rreptësisht hyrja në dhomën ku ndodhej trupi i Dajanës[55]. Shevenmoja qe një nga VIP-at e shumtë që u derdhën drejt tunelit dhe vëzhguan operacionet e ndihmës në vendin e lashtë të flijimit[56]. Perëndesha Nënë e Vëllazërisë, Arizona Uilder, tha se Gi dë Rotshildi kishte folur për vdekjen e Dajanës qysh muajt e parë të 1998-ës, ndërsa përpiqej të riprogramonte Arizonën brenda një shtëpie të Sherman Oaksit, në Los Anxheles. Rotshildi përdorte pseudonimin doktor Berrington. Tha se atë natë ndodhej në tunel për "të vjedhur shpirtin e Dajanës" përmes vështrimit të tij të lig hipnotizues që zvarranikët e përdorin ndërsa vështrojnë viktimën e

tyre në grahmat e fundit. Ju tregova për këtë kur fola për Pindarin. Një informatorja ime daneze më ka thënë se, gjatë vitit të fundit të studimeve për mjekësi në Universitetin e Kopenhagenit, në 1983, kishte vënë re se pacientet që vuanin nga turbullime të rënda mendore përdoreshin për eksperimente të mbjelljes së spermës së modifikuar gjenetikisht. Barra, më tregonte, qe jashtëzakonisht e dhimbshme dhe shpesh nuk përfundohej. Ndonjëherë, pacientja vdiste dhe fetusi i hiqej fshehur. Ja se çfarë më ka thënë: "Mjekët që kryenin këto eksperimente ishin profesorë, shefa departamentesh, akademikë nga më të shquarit e fushës. Kishin formuar një si vëllazëri... shumë prej tyre kishin dhe dhunti mediumesh dhe merreshin me magjinë e zezë. Në duart tyre qarkullonin shumë pará". Një histori që mund të ndeshet me mijëra herë të tjera në mbarë botën.

Perëndesha Diana njihej dhe me emrin tjetër, Hekata. Një nga treshet apo trinitë e lashta përbëhej nga Diana, Hëna dhe Hekata, për të cilat thuhej se janë tri aspekte të ndryshme të së njëjtës energji femërore. Në Tokë, ajo quhej Diana, në qiell, Hëna dhe në ferr, Hekata. Hekata është një nga perëndeshat më të rëndësishme për satanistët dhe përfaqëson një pamje tjetër të Afërditës dhe Venusit, dy emra të ndryshëm për të njëjtën energji. Pas vdekjes së burrit, Xheki Kenedi shkoi në ishullin grek të Delos, në Egjeun jugperëndimor, vendi legjendar i origjinës së Dianës dhe Apollonit, ku thuhej se kishte mbretërinë e saj edhe Hekata, perëndesha e arteve të ferrit. Prandaj Deloja njihet ndryshe edhe si Ishulli i të Vdekurve. Hekata përfaqësohej ose si virgjëreshë ose si prostitutë ndërsa udhëkryqet ishin vende kushtuar asaj. Pikërisht nëpër udhëkryqe i kryejnë ritet e tyre Mjeshtërit e Mëdhenj dhe shtriganët e Masonëve. Udhëkryqet paraqesin kulmet që krijojnë vijat magjike që kryqëzohen mes tyre. Në ritet magjike seksuale, veshja e rrobave të seksit tjetër dhe kryerja e akteve biseksuale bën pjesë në të ashtuquajturit "Rite udhëkryqesh". Gratë e përfshira në ta quhen "lezbike me role femërore". Udhëkryqet janë edhe vende ku kryhen flijime njerëzish dhe kafshësh ndërsa Hekata njihet si "perëndesha e seksit dhe e vdekjes", përveçse e shtriganisë dhe arteve magjike. Afër Pon dë l'Alma, pikërisht në vendin ku vdiq Dajana, rruga që kalon nën tunel kryqëzohet me një rrugë tjetër që del përmbi Pon dë l'Alma. Në fakt, ky vend është një labirint i vërtetë rrugësh. Ndërsa Dajana vdiq në orët e para të mëngjesit të 31 gushtit. Sipas kalendarit satanik, dita kushtuar Hekatës është 31 gushti, por në bazë të ligjit satanik që parashikon kthimin përmbys të simboleve dhe të numrave, dita e flijimeve për nder të Hekatës është... 31 gushti!

Mbajini pak parasysh këta simbole. Dajana, që mbante këtë emër për

nder të perëndeshës së Hënës, udhëtoi me makinë nga Rici dhe përshkoi Plas dë la Konkord, ku kaloi përpara obeliskut egjiptian të ndërtuar para 3200 vjetësh dhe të sjellë në Paris nga luksorët, maja ose piramida e të cilit, me ngjyrë të artë verbuese, simbolizon penisin e Osiridit. Pikërisht aty, vetëm një minutë larg vendit ku vdiq Dajana, mbretëreshës Mari Antuanetë iu pre koka në gijotinë gjatë revolucionit francez të drejtuar nga Vëllazëria, një flijim tjetër simbolik i energjisë femërore. Makina e Dajanës, pastaj, u lëshua me tërë shpejtësinë drejt tunelit Pon dë l'Alma, urës dhe vendit kushtuar perëndeshës Hënë, ku makina u përplas me shtyllën e 13-të e cila, për arsye që dihen dhe për të tjera që do t'i shpjegoj më vonë, ka një vlerë të lartë simbolike. Në këtë pikë, u la te vdiste pikërisht në vendin ku në kohët e lashta ndodhej dhoma e flijimeve kushtuar perëndeshës Diana dhe, në përputhje me ritet satanike, qe një vdekje e shkaktuar nga gjakrrjedhja. Përveç kësaj, ajo vdiq pranë një udhëkryqi të formuar nga një rrugë nëntokësore dhe një tjetër sipërfaqësore, ndërsa udhëkryqi është vendi i shenjtë i perëndeshës satanike Hekata, një pamje tjetër e energjisë që përfaqëson "Dajana". E gjitha kjo ndodhi ditën e caktuar për flijime në nder të Hekatës, në 31 gusht.

Mos vallë ka ndonjë që ende dyshon se bëhet fjalë për një rit flijimi? Për ata më dyshuesit nuk kam shpjeguar ende të gjithë simbolet që rrethojnë vdekjen e saj. Sillni ndër mend atë që ka shkruar Dejvid Berkovici, vrasësi në seri satanik i Nju Jorkut, i njohur si Djali i Semit, lidhur me ata që janë përfshirë në rrjetin satanik:

> "*Satanistët* (ata të vërtetët) *janë njerëz të veçantë. Nuk janë as fshatarë injorantë dhe as indigjenë gjysmë analfabetë. Përkundrazi, radhët e tyre gëlojnë nga mjekët, avokatët, biznesmenët dhe qytetarët që mbajnë detyra të larta... Nuk bëhet fjalë për një grup të paditurish që gabojnë lehtë. Ata ruajnë fshehtësinë dhe i bashkon nevoja dhe dëshira e përbashkët për të shkatërruar shoqërinë. Alister Krouli ka thënë: dua blasfeminë, vrasjen, dhunimin, revolucionin, gjithçka që është e keqe*"[57].

Ia vlen të ndalemi edhe njëherë te lidhja që satanistët kanë me energjinë femërore. Sfida me të cilën përballemi të gjithë është ajo e gjetjes së baraspeshës mes energjive mashkullore dhe femërore, duke përftuar kështu aspektet më të mira nga këto të dyja dhe jo shfaqjet e skajshme të tyre. Ndërsa satanistët kërkojnë të shprehin vetëm skajet duke shfaqur kështu mungesën e harmonisë dhe konfliktin. Ata përdorin shprehjet më negative të energjisë femërore (manipulimin e fshehur nga pas kuintave) për të krijuar ngjarje dhe rrethana në të cilat mund të shfaqen publikisht format e skajshme të energjisë

mashkullore (burrat *maho*, ushtarët, terrorizmi). Për këtë arsye, duket sikur bota kontrollohet dhe sundohet nga energjia mashkullore, sikur është një "botë e burrave", por në të vërtetë, botën nuk e sundojnë burrat por e sundojnë format e skajshme të energjisë mashkullore dhe femërore. Nuk po flas për burra e për gra, por për energji mashkullore dhe femërore e cila mund të shprehet si përmes burrave, ashtu dhe përmes grave. Për shembull, manipuluesit e Vëllazërisë, si Henri Kisingeri, nuk kanë parë kurrë një pushkë të qëllojë për shkak të një zënke. Nuk luftojnë kurrë fizikisht (energjia mashkullore) në luftërat që krijojnë. Ata manipulojnë ngjarjet në hije dhe nga pas shpine, një karakteristikë tipike e energjisë femërore negative, simbol i së cilës është historia e kalit të Trojës. Energjia femërore është edhe forcë krijuese, por mund të krijojë me qëllime pozitive ose negative. Vëllazëria ka qëllime tepër të këqija, por i ndjek në mënyrë tepër krijuese ato. Për këtë arsye, sipas simbolizmit ezoterik, energjia femërore (Diana, Semiramida, Isida, Barati, Britania) përshkruhet me emra të ndryshëm sipas formave të ndryshme që merr. Egjiptianët e tregonin Isidën të bardhë në variantin e saj pozitiv ose të zezë për të treguar natyrën e saj negative. Po kështu, kemi simbolizmin e Dianës (energjia femërore pozitive) dhe të Hekatës (energjia femërore negative). Bëhet fjalë thjesht për emra simbolikë të ndryshëm, për forma të ndryshme të energjisë femërore. Satanistët e Vëllazërisë shfrytëzojnë energjinë e Hekatës, prandaj e nderojnë këtë hyjni. Por, në të vërtetë, nderojnë energjinë femërore të skajshme negative dhe, për këtë arsye, në ritet satanike, kryepriftëresha konsiderohet po aq e rëndësishme sa edhe priftërinjtë, madje dhe më tepër. Në qendrën satanike të Elitës, në Belgjikë, Kështjella e Territ, për të cilën iu kam folur në kreun e mëparshëm, krerët nuk përfaqësohen nga mbreti, por nga nëna mbretëreshë. Kështu, në tunelin Pon dë l'Alma, energjia femërorë pozitive (dashuria, mëshira, intuita) e simbolizuar nga Diana, u zëvendësua nga energjia femërore negative (manipulimi, vdekja rituale) e simbolizuar nga Hekata e udhëkryqeve.

Edhe vdekja e Dodi Fajedit qe thelbësore për simbolizmin satanik. Duke mbajtur parasysh rrethanat e vdekjes së tij, nuk qe thjesht rastësi fakti që emri i tij i vërtetë, Emad El Din, në arabisht do të thotë "shtylla e besimit". Dodi qe emri përkëdhelës me të cilën e thërriste familja që prej fëmijërisë. Por, edhe ky emër është mjaft interesant. Në fakt, ngjason shumë me Dido. "Dido" është pikërisht emri me të cilin ai thërriste Dajanën. Dido (Didona), në mitologjinë greke, është themeluesja legjendare e mbretërisë së Kartagjenës (një qytetërim i lashtë arian i lidhur me fenikasit) dhe vajza e Belusit, mbretit të qytetit fenikas të Tiros. Kur burri i Didonës u vra nga vëllai i saj Pigmalioni,

ajo u arratis bashkë me mbështetësit e saj në Afrikën e Veriut prej ku, me ndihmën e mbretit vendas, Larbus, rimori Kartagjenën. Ky i fundit e kërcënoi Didonën se do ta vriste po të mos martohej me të, por ajo zgjodhi vetëvrasjen. Simbolet më domethënëse për vdekjen e Dodi Fajedit mund të gjenden në tokën e tij të origjinës, në Egjipt. Vëllazëria është tepër e dhënë pas simboleve të lashta egjiptiane të trinisë Osiridi-Horusi-Isida (Nimrodi-Tamuzi-Semiramida) që, të përkthyer në gjuhën e krishterimit, përfaqësohen nga ati, biri dhe shpirti i shenjtë. Mes shumë gjërave të tjera, trinia simbolizon bashkimin mes energjisë mashkullore dhe energjisë femërore prej të cilave lind një forcë e tretë, një jetë e re. Për egjiptianët, pra, edhe për Vëllazërinë, biri i Zotit ishte Horusi. Ky kishte lindur nga Isida pasi burri i saj, Osiridi, u vra nga Seti. Ajo mblodhi bashkë 14 pjesët e trupit të tij të copëtuar, por nuk arriti t'i gjente penisin. Kështu, krijoi një penis artificial dhe u mbars vetë për të lindur më pas Horusin, mbretin Diell - mbreti Diell Horus ishte Osiridi i rilindur. Në Paris u krye edhe një herë një pjesë e këtij rituali. Makina kaloi pranë obeliskut egjiptian me majë të artë në formë piramide, penisi i Osiridit, në Plas dë la Konkord. Brenda makinës ndodheshin Dajana (një emër tjetër i Isidës) dhe egjiptiani Dodi Fajed, që përfaqësonte Osiridin. Kam dëgjuar të thuhet nga shumë njerëz se Dajana qe shtatzënë. Fetusi i saj simbolizonte Horusin, Zotin Diell. Në Egjiptin e lashtë thuhej se Osiridi duhej të vdiste që vendin e tij ta zinte Horusi. Për shumë njerëz kjo mund të duket edhe e çuditshme por, nëse studioni maninë e pabesueshme që ushqejnë këta persona ndaj ritualeve dhe simbolizmit, do ta kuptoni se e gjithë kjo ngjarje absolutisht ka kuptim. Mbase Dajana nuk e dinte që ishte shtatzënë. Mund t'ia kenë hequr fetusin në atë sallën e operacionit në Paris kur "luftonin për ta shpëtuar", katër orë pas vdekjes. Dikush më ka thënë se qelizat e këtij fetusi do të përdoren për të krijuar klone që zotërojnë këtë trashëgimi gjenetike. Këta klone do të jenë "mbretërit Diell" sipas ritualit të Vëllazërisë. Klonimi i qenieve njerëzore realizohet tashmë prej kohësh, siç e ka treguar qartë klonimi i deleve në Institutin Roslin, pranë kishës Roslin, në Skoci. Shkenca e fshehtë e Vëllazërisë është në pararojë në fushat e pranuara publikisht dhe, për këtë arsye, shpesh njerëzit nuk e besojnë atë që Vëllazëria është në gjendje të bëjë falë ilaçeve dhe teknologjisë. E njëjta gjë ndodh edhe me teknikat e kontrollit mendor dhe jam i sigurt se Dajana dhe Dodi kanë qenë nën ndikimin e manipulimit mendor për shumë javë, me qëllim që rituali të zhvillohej sipas planit. Nëse hipnotizuesi i shfaqjeve arrin të zotërojë mendjen e dikujt mes publikut, mendoni se ç'mund të bëjnë manipuluesit mendorë më të zotë. Pon dë l'Alma është një nga vendet më të shenjta të botës për Vëllazërinë dhe, siç

ka ndodhur në rrjetin urban të të gjitha qyteteve të saj kryesore, anëtarët kanë siguruar që, edhe në atë pikë të Parisit, të jenë të pranishëm simbolet e duhura: ura, dhoma e nëndheshme, kryqëzimet dhe emri i njëjtë. Që nga zgjimi im shpirtëror në 1990, intuita e pavetëdijshme më ka udhëhequr drejt disa qendrave me energji të madhe tokësore. Shpesh, nuk e kam kuptuar dhe vetëm më pas i kam rënë në të se jam tërhequr drejt majave më të mëdha të sistemit të rrjetit magnetik tokësor dhe, shpesh, edhe drejt atyre që, për Vëllazërinë, kanë një rëndësi të veçantë. Më 1994, isha me pushime bashkë me familjen në Francë, në brigjet e Normandisë, kur vendosëm të shkonim dhe të vizitonim Parisin. Qe një udhëtim i gjatë me makinë, por nuk e kishim parë kurrë atë qytet. Mbërritëm në Versajë, jashtë Parisit, dhe morëm trenin që aty deri te stacioni i Kullës Eifel. Dita qe e nxehtë dhe e lagësht, zona qe e mbushur me njerëz, ndërsa qarkullimi qe i dendur. Kjo ndërthurje gjërash qe aq e pakëndshme, saqë vendosëm të mos qëndronim gjatë aty. Para së t'i hipnim trenit për në Versajë, vendosëm të bënim një shëtitje të shkurtër. Kaluam Senën mbi një urë të vogël pranë Kullës Eifel dhe ecëm rreth njëqind metra gjatë bregut të majtë të lumit, ku gjetëm një vend për t'u ulur. Pas dhjetë minutash, u ngritëm, kaluam nëpër urën më të afërt dhe u kthyem në stacion për t'u larguar nga qyteti. Qëndruam aty pak më shumë se një orë dhe kjo që iu tregova qe gjithçka që kam bërë në Paris deri kur u ktheva përsëri për të bërë hetime mbi vdekjen e Dajanës, të cilat më duheshin për këtë libër.

Kur u ktheva në Paris, u trondita sepse gjeta përsëri stolin ku ishim ulur për t'u çlodhur në 1994-ën. Ndodhej mbi tunelin Pon dë l'Alma, shumë pranë shtyllës së 13-të me të cilën u përplas makina! Përveç kësaj, pranë stolit, mbi hyrjen e tunelit, ngrihet një pishtar i madh i ndezur (shih pjesën e ilustrimeve). Natyrisht që kjo është firma më e padiskutueshme e Vëllazërisë. Pas vrasjes rituale të presidentit Kenedi, masonët ngritën një obelisk në Dilej Plaza, i cili mbante në majë një pishtar të ndezur. Një flakë tjetër u vendos mbi varrin e tij. Ndërsa ajo mbi tunelin Pon dë l'Alma ngrihet mbi një bazë të zezë dhe nuk ka simbol satanik më të qartë se ky. Duhej të ishte një lloj "Flakë e Lirisë" (një kopje e pishtarit që mban në dorë Statuja e Lirisë) në kujtim të atyre që vdiqën në Luftën e Dytë Botërore, por vendi ku u vendos u zgjodh i tillë që të qe edhe një lloj faltoreje kushtuar Dianës. Një artikull gazete thoshte se autoritetet franceze po mendonin të ngrinin një monument përkujtimor për nder të Dajanës afër Pon dë l'Almas, një si lloj vijimësie të shtyllës së 13-të mbi sipërfaqe! Nuk ka si të ketë gjë më të sëmurë dhe më simbolike. Gjëja e fundit që kam dëgjuar është që po mendojnë të hapin një kopsht botanik në përkujtim të vdekjes së saj dhe se do të shembin një ndërtesë për të krijuar

hapësirën e nevojshme. Kopshti botanik është në një zonë të Parisit të cilën Dajana nuk e kishte vizituar kurrë, pasi, me sa dukej, nuk qe e dhënë pas botanikës. Atëherë përse? Së pari, duhet ta dini se kopshti botanik është një vend i lashtë dhe, mbi të gjitha, një monument kaq i pavend dhe i çuditshëm ku duhej të digjej përjetësisht flaka përmbi tunel në kujtim të Dajanës. Flaka e Lirisë u vendos përmbi hyrjen e galerisë në vitin 1987 dhe jam i sigurt se vrasja e Dajanës në atë vend qe programuar shumë më herët. Është e besueshme se, po të kemi parasysh planifikimin afatgjatë dhe kujdesin e madh kundrejt ritualeve dhe hollësive simbolike, ajo qe programuar prej dhjetëvjeçarësh. Sigurisht, shumë më parë se qengji i flijimit të binte në rrjetën e Uindsorëve dhe të martohej me Çarlsin. Zgjedhja e Katedrales së Shën Palit si vend për celebrimin e martesës i përshtatej simbolizmit të Vëllazërisë. Shën Pali, me kupolën e saj të madhe, është projektuar nga sër Kristofer Ren, një anëtar i lartë i Vëllazërisë. Struktura e saj i ngjan pallatit të Kongresit në Uashington por edhe Panteonit të Parisit. Brutusi, trojani që u bë i pari mbret i bretanëve, rreth vitit 1103 p.e.s., qe themeluesi i "Trojës së re" të njohur sot si Londra. Ai qe ithtar i perëndeshës Diana dhe thuhet se kishte ngritur një tempull për nder të saj në vendin që sot quhet kodra Ladgejt, aty ku dikur ngrihej një rreth i vjetër me gurë[58]. Ky vend gjendet në zemër të qendrës financiare të Londrës, qendër e kontrolluar nga Vëllazëria ndërsa sot, mbi këtë vend kulti të Dianës ngrihet... Katedralja e Shën Palit. Në Paris, Katedralja Notrë Dam (Zonja jonë) ngrihet mbi një vend që, në lashtësi, i kushtohej Dianës dhe ambulanca me trupin e princeshës kaloi para Notrë Damit gjatë atij udhëtimi të çuditshëm drejt spitalit. Kështu, Dajana u martua në një vend që dikur i qe kushtuar perëndeshës Diana dhe vdiq në një vend ku në lashtësi gjendej dhoma e flijimeve për nder të perëndeshës Diana. Ajo u përdor nga Uindsorët për të lindur trashëgimtarët, ndërsa Diana ishte hyjnia e lashtë e gjuetisë, pjellorisë dhe lindjes.

Kur princi Çarls dhe motrat e Dajanës mbërritën në Paris që të shoqëronin arkivolin për në Londër, ai u mbulua me simbolet mbretërore, me flamurin e Uindsorëve i cili përmban luanin si simbol të Diellit. Vini re, jo me flamurin kombëtar, por me flamurin e Uindsorëve. Një tjetër gjë e çuditshme u vu re në morgun Hamersmith të Londrës. Kur mbërriti arkivoli i saj, po dilte ai që mbante brenda Dodin dhe, te hyrja, dy arkivolet u kryqëzuan. Sa ishte probabiliteti statistikor që të ndodhte kjo, po të kemi parasysh se kishin udhëtuar veçmas nga Parisi? U tha se Dodi duhej varrosur brenda 24 orësh nga vdekja, sipas ligjit mysliman, dhe i ati i kishte shpejtuar së tepërmi gjërat që ky afat të respektohej. Trupi i tij nuk iu nënshtrua autopsisë, por u quajt i mjaftueshëm një shqyrtim i shpejtë nga jashtë.

Në këtë pikë, vëllai i Dajanës, Çarlsi, kont i Spenserve, atëherë 33 vjeç, u shfaq në skenë kur sapo kishte mbërritur nga rezidenca e tij në Kejp Taun, në Afrikën e Jugut. Kur konti i Spenserve, biri hyjnor i mbretëreshës, shqiptoi fjalimin e tij përurues në Dhomën e Lordëve në 1993, zgjodhi një temë mjaft të çuditshme, *Satanizmi te Spenserët në Althorp, në Northemptonshajër*. Pranoi se kjo dukuri praktikohej ende, por siguroi se do të bënin të pamundurën për ta çrrënjosur. Ç'argument i veçantë për fjalimin e tij të parë në Parlament! Perëndesha Nënë e Vëllazërisë, Arizona Uilder, pohon se e ka parë kontin Spenser dhe të atin e tij të merrnin pjesë në disa rite flijimi të drejtuara prej saj. Konti Spenser lajmëroi se, pavarësisht vullnetit të Dajanës, trupi i saj nuk do të varrosej në varrin e familjes në fshatin Grejt Bringtën. Konti Spenser tha se dëshironte të shmangte kështu dyndjen e turistëve ne fshat, prandaj kishte vendosur që Dajana të varrosej në një ishull të vogël artificial në mes të liqenit në Althorp. Ky liqen quhet "L'Oval" dhe, nëse shihet nga lart, i ngjan një pike brenda një rrethi, një tjetër simbol i Diellit. Flaka brenda rrethit ndodhet edhe te varri i Kenedit. Për më tepër, në këtë ishull, Spenseri kishte vendosur simbolin aq të dashur për Vëllazërinë të flakës dhe, në një pikë, edhe Mohamed Al Fajedi shfaqi interes të vendoste një "flakë të përjetshme" për nder të Dajanës dhe Dodit në çatinë e *Harrodsit*, për të kujtuar një vjetorin e vdekjes së tyre, në gusht 1998.[59]

Ishujt janë një element i kudondodhur në legjendat e perëndeshës Diana që, sipas traditës, kishte lindur në ishullin Delo, në Detin Egje. Ai quhet ndryshe Ishulli i të Vdekurve, për nder të Hekatës, mbrojtëses së "arteve të ferrit", shfaqja negative e energjisë së perëndeshës Diana. Diana është një emër tjetër për Brio-Martisin, perëndeshën e Kretës, ishullin e kolonizuar dhe qytetëruar nga fenikasit që formuan aty qytetërimin monoik. Brito-Martis, në të vërtetë, qe një perëndeshë fenikase, sipas legjendës greke dhe romake. Ajo ishte "vajza" e hyjnisë Foiniks (ky është shqiptimi i duhur), mbret i Fenisias dhe, ashtu si Diana, qe e armatosur me armë gjuetie. Legjenda thotë se Brio-Martisi (Diana) u largua me varkë nga Fenisia drejt Argos, në Greqinë jugore, pastaj në Kretë, ku nisi t'i vinte rrotull një adhurues i bezdisshëm, Minosi. U arratis prej andej dhe lundroi nëpër det deri sa mbërriti në Exhinë, një ishull në Egje ku ndodhet një tempull kushtuar Artemisës ose Dianës. Në legjenda gjejmë një lidhje të ngushtë mes ishujve dhe Dianës. Konti Spenser e vendosi varrin e Dajanës mes pemëve të ishullit dhe ky është një përfaqësim i qartë simbolik, sepse njerëzit e lashtë zakonisht e nderonin perëndeshën Diana në mes të pyllit, që mbahej si vendi më i shenjtë prej saj. Sër Xhejms Frejzëri, në librin e tij "Dega e artë" përshkruan ritin për nder të Dianës të

LIBRI 24

njohur me emrin Mbreti i Pyllit pranë liqenit Nemi (përsëri liqeni si pjesë thelbësore e mitit të Dianës). Edhe Zonja e Liqenit është një simbolizëm i qartë i Vëllazërisë. Frejzeri thotë se, në bregun verior të liqenit Nemi, pranë Arisias, gjendej pylli i shenjtë ku adhurohej Diana Nemorensis ose Diana e pyllit, perëndesha e gjuetisë. Liqeni Nemi është vendi i shenjtë më i njohur i perëndeshës Diana dhe aty, sipas Frejzerit, rritej një pemë rreth së cilës ecte një prift me një shpatë në dorë. Kush kërkonte të bëhej prift i kultit të Dianës duhet të vriste atë që luante këtë rol dhe do të zëvendësohej vetëm nga ai që do të arrinte ta vriste pas kësaj. Ky rol të jepte dhe titullin mbret - Mbret i Pyllit - dhe një radhë e gjatë priftërinjsh-mbretër që festonin kultin e Dianës humbën jetën në vdekje të dhunshme. Kështu, perëndesha Diana shoqërohet gjithnjë me ishujt dhe me një liqen si dhe adhurohej mes pemëve. Konti Spenser e vendosi varrin e motrës mes pemëve, në një ishull në mes të liqenit.

Pastaj, kemi dhe atë historinë e çuditshme të mjellmave të zeza. Në qershor 1998, konti Spenser, në një intervistë për kanalin *BBC*, tregoi se kishte parë një ëndërr në periudhën mes aksidentit dhe funeralit të Dajanës. Në ëndërr, dikush i thoshte që të vendoste katër mjellma të zeza në liqenin rreth ishullit. Mëngjesin tjetër, kur thirri përgjegjësin e vilës dhe e pyeti se ku mund të gjente katër mjellma të zeza, ai i qe përgjigjur: "Atëherë, e paskeni marrë vesh?" "Çfarë kam marrë vesh?" e kishte pyetur Spenseri. "Na kanë ofruar katër mjellma të zeza", iu përgjigj ai. Ndoshta kjo histori është e vërtetë por, sipas meje, më shumë ka të bëjë me buallicat se sa me mjellmat. Mjellmat e zeza janë simbol i okultizmit dhe, natyrisht, shfaqen në baletin *Liqeni i Mjellmave*, aty ku mjellma e zezë, e cila përfaqëson energjinë femërore negative, vret mjellmën e bardhë, simbolin e energjisë pozitive. Me fjalë të tjera, Hekata vret Dianën. Çfarë simbolesh mund të gjeni në *Liqenin e Mjellmave* përveçse mjellmat e zeza në një liqen, si në Althorp? "Mjellmë" është dhe një fjalë përbuzëse që përdornin druidët. Skllevërve të tjerë të Projektit Monark që rebelohen u thuhet se "do të shndërrohen në mjellma" dhe Dajana, sigurisht, ngriti krye kundër Uindsorëve. Edhe numri i mjellmave nuk është rastësor. Programimi i Monarkut parashikon një shprehje që tingëllon "katër portat e parajsës" dhe numri katër mund të përfaqësojë edhe katër fazat e Hënës. Konti Spenser ngriti një "tempull" për nder të Dajanës pranë liqenit. Në një sërë banesash të aristokracisë britanike vihen re tempuj ose vende kushtuar perëndeshës Diana, mes tyre dhe Pallati Blenhajm, rezidenca e Marlborafëve dhe Çetsuorth Haus, selia e Kavendishëve, dukëve të Devonshajërit, familje këto, që të dyja, të lidhura me Spenserët. Dajana u transportua e futur brenda një arkivoli me profil plumbi. Plumbi është metali

i përdorur në ritet magjike dhe shoqërohet me Saturnin, prej të cilit ka të ngjarë të ketë rrjedhur emri "Satana". Ngjyra e lidhur me Saturnin dhe satanizmin është e zeza. Për më tepër, Dajana hyri në mbretërinë e të vdekurve në dy ditë kyçe për Vëllazërinë, të shtunën (në anglisht "Saturn-dej") dhe të dielën (në anglisht "San-dej"). Mjeku-filozof italian i shekullit XV, Marsilio Fiçino, ka prodhuar shumë hajmali fatsjellëse. Atë të Saturnit e ka prodhuar me plumb të pastër. Thuhej se mbronte personin që e mbante nga vdekja me vrasje dhe pusí, ndërsa gratë i mbronte në çastet e lindjes. Mbi plumbin e arkivolit të Dajanës, gjatë ceremonisë së përmortshme, ishin vendosur zambakë, lulja e Lilithit, një variant tjetër i Hekatës, dhe simbol i llojit zvarranik. Zambakët ishin zgjedhur nga konti Spenser, vëllai i Dajanës. Zambaku konsiderohej i shenjtë dhe nga Astarti, një variant tjetër i Dianës, dhe përdorej si simbol i pjellorisë së virgjëreshës Mari. Thuhet se "virgjëresha e bekuar" Junonë, të cilës i kushtohet muaji gusht, kishte mbetur shtatzënë me djalin e saj shpëtimtar, Marsin, duke u ulur mbi një zambak magjik. Zambaku është simbol i racave zvarranike. Në vitin 656, Këshilli i 10-të i Toledos vendosi zyrtarisht që dita në të cilën Junona mbeti shtatzënë me Marsin të shndërrohej në festën e krishterë të Nënës së Zotit, ose Ditën e Marisë, duke ngulur këmbë se bëhej fjalë për përkujtimin e mbarsjes së papërlyer të Jezusit me ndihmën e një zambaku.[60] Për francezët, Dita e Marisë njihet me emrin Notrë Dam dë Mars. Simboli i zambakut, me ndihmën e të cilit perëndesha lindi zotin-shpëtimtar (si në rastin e Isidës de Horusit) është mbresëlënëse, nëse sjell ndërmend faktin se Dajana qe shtatzënë në çastin e vdekjes dhe se si, e gjitha kjo, është lidhur me legjendën e Osiridit, Isidës dhe Horusit.

Janë ngritur disa dyshime rreth faktit nëse Dajana u varros apo jo vërtet në ishull. Në verën e 1998-ës, revista amerikane "Star" citoi një "burim të besueshëm" anonim nga Pallati Bakingem, sipas të cilit Dajana qe djegur fshehurazi. Sipas një artikulli të "Los Anxheles Tajms" edhe disa banorë të fshatit Grejt Bringtën nuk besojnë se ajo u varros në ishull. Nga burime të miat di se këto dyshime e kanë një bazë. Një banore e fshatit tregoi për gazetën "Los Anxheles Tajms" se, natën kur arkivoli qe sjellë për varrimin, fshati "qe pushtuar" nga ushtarë, policë dhe njësi të forcave speciale, ndërsa të gjithë banorëve iu kërkua të mos dilnin nga shtëpitë. Ajo tha se krematori i kishës qëndroi i ndezur deri vonë atë mbrëmje. Beti Endrjus, ish kuzhinierja e governantit të Althorpit, citohet nga revista "Star" të ketë thënë: "Banorët e fshatit kanë një ndjesi të çuditshme, sikur të mos u jetë thënë e gjithë e vërteta".

Ndërsa mblidhja të dhëna për këtë libër, më njohën me Kristin Ficxheraldin, një shëronjëse e shquar dhe mjaft e zonja, mikeshë e ngushtë e Dajanës për nëntë vite rresht. Duke pasur parasysh njohuritë e Kristinës në çështjet ezoterike, Dajana fliste me të për gjëra që nuk do të kishte guxuar t'ia thoshte dikujt tjetër nga frika se mos e merrnin për të çmendur. Është e qartë se Dajana ishte në dijeni të natyrës së vërtetë të historisë gjenetike të familjes mbretërore dhe të kontrollit zvarranik. Ajo i quante Uindsorët me emrat "hardhucat" ose "zvarranikët" dhe shpesh thoshte me tërë seriozitet: "Nuk janë qenie njerëzore". Dajana thoshte se, pas fuqisë së Uindsorëve, qëndronte nëna mbretëreshë bashkë me princin Filip. Por marrëdhëniet hierarkike ishin të tilla që Filipi duhej t'i bindej nënës mbretëreshë, shtonte ajo. Nëna mbretëreshë ka lidhje me një listë të gjatë grupesh dhe shoqërish që janë në krye të Vëllazërisë dhe të Tempullit të Brendshëm, një shoqëri e fshehtë kjo dhe mjaft elitare e cila përfshin nivelet më të larta të profesionit, të cilat kanë lidhje me Tempëll Bar, në Londër. Nëna mbretëreshë dhe mikesha e saj e dashur, gjyshja e Dajanës, Ruth Ledi Fermori, e kishin shtyrë Dajanën të martohej me Çarlsin përmes manipulimeve. Ja përse Dajanën e kishin ftuar në rezidencën e nënës mbretëreshë, Klarens Haus, javët para martesës dhe, pikërisht prej aty u nis ditën që u bë martesa me Çarlsin në katedralen e Shën Palit. "Dajana më thoshte gjithnjë se nëna mbretëreshë qe e ligë", thotë Kristin Ficxheraldi. "Këtë fjalë përdorte, e ligë. Thoshte se e urrente nënën mbretëreshë dhe se ajo ia kthente me të njëjtën monedhë." Pjesa më e madhe e njerëzve që jetojnë në Britaninë e Madhe mbeten të habitur nga kjo sepse propaganda e ka shndërruar nënën mbretëreshë në një lloj gjysheje të kombit. "Ah, po, nëna mbretëreshë, ajo plaka e dashur, dashamirëse dhe e sjellshme". Por ja që kjo grua nuk është ashtu si duket. Nuk do të resht kurrë së thëni këtë. Gjatë periudhës që kaloi në Klarens Haus para martesës, Dajana zbuloi se i jepeshin fshehur ilaçe antidepresive, si valium, për të kuruar buliminë. Po çfarë i jepej tjetër? "E drogonin", më tha Kristina, "jam e sigurt, e drogonin qysh në fillim". Kristina kishte biseduar disa herë me Dajanën dhe ajo i qe hapur e i kishte treguar makthin që jetonte me Uindsorët. Përmes burimeve të tjera, Kristina kishte mësuar edhe gjëra të tjera të rezervuara për familjen mbretërore britanike.

Kjo është hera e parë që ajo flet publikisht për përvojat e saj me Dajanën dhe për atë që di për planet e zvarranikëve. Shikoni se ç'më ka treguar:

"Nëna mbretëreshë... ajo i ngjan një misteri të vërtetë. Nëna mbretëreshë është më e moshuar nga sa kujtojnë njerëzit. Të jemi të sinqertë, anëtarët e familjes

mbretërore nuk vdesin por pësojnë metamorfoza. Bëhet fjalë për një lloj klonimi, por të ndryshëm nga ai i zakonshmi. Marrin copa mishi dhe, në bazë të tyre, ndërtojnë trupin. Meqë bëhet fjalë për hardhuca, për qenie me gjak të ftohtë, e kanë më të lehtë se ne të bëjnë këto ndyrësira si të Frankenshtajnit. Trupe të ndryshme janë vetëm vibrime elektrike të ndryshme dhe ata zotërojnë mikro-rryma të fshehta, tepër mikroskopike, tepër specifike, valë radiofonike që, në të vërtetë, krijojnë trupa. Me këto energji operoj dhe unë kur shëroj njerëz. Ata e njohin vibrimin e jetës dhe, ngaqë kanë gjak të ftohtë, ngaqë janë zvarranikë, nuk dëshirojnë aspak të krijojnë harmoninë e përkryer që mund të mbizotërojë mbi Tokë ose ta shërojnë nga dëmi që i është krijuar. Toka, prej shumë kohësh, është sulmuar nga jashtëtokësorë të ndryshëm. Prej kohësh përdoret si top futbolli. Ky planet është si një lloj stacioni autobusi për shumë alienë. Këta alienë mund t'i bëjnë ballë çdo gjëje, përfshi dhe gazet helmuese. Vazhdojnë të zbresin dhe të shfaqen nga brendësia e tokës. Në fillim, kishin pamjen e zvarranikëve, por marrin pamjen tonë kur shfaqen përmes vibrimit elektrik, siç ju fola më sipër. Mund të marrin pamjen që duan. Të gjitha njohuritë e vërteta i sekuestruan dhe i shkatërruan dhe ofruan të tjera në vend të tyre. Nëna mbretëreshë është "kryetarja e thithëlopave" në këtë pjesë të Evropës dhe, në çdo kontinent, ka të tjerë si ajo. Pjesa më e madhe e njerëzve nuk dinë asgjë për këta zvarranikë, kanë frikë nga këta persona sepse janë shumë të fuqishëm.

Balmorali është një vend vërtet i pakëndshëm. Është një vend ku duan të bëjnë disa gërmime. Thonë se mund të gjenden fosile zvarranikësh ngaqë është një vend shumë i lashtë. Mos kujtoni se nëna mbretëreshë dhe mbretëresha Viktoria janë ndryshe nga njëra-tjetra. Mendojini sikur të bëhet fjalë për të njëjtin person që, herë pas here, merr trup të ndryshëm. Kur mishi vdes, ajo energji transferohet menjëherë brenda një trupi tjetër. Është diçka e ngjashme, madje më e keqe, se ajo që bëjnë vampirët. Këta persona nuk vijnë t'iu thithin gjakun me dhëmbët e mprehtë. Ushqimi i tyre është frika, ata mund të thithin frikën dhe ta shfaqin atë si diçka të prekshme. E fshehta e tyre është rryma vibruese. Falë kësaj rryme vibruese, mund të shfaqin çdo lloj gjëje si një gjë tjetër. Si puna e pamjeve holografike. Që të gjithë jemi minerale dhe ujë që vibrojmë. Ndërsa ajo ku jetojmë është një iluzion. Kjo është gjithë e fshehta. Edhe po të bjerë monarkia, dijeni që nuk ka marrë ende fund, do të shfaqet në një formë tjetër. Zvarranikët nuk janë mundur kurrë, por ky është çasti kur i janë afruar kësaj. Arsyeja që sot ndjehen kaq të kërcënuar duhet kërkuar në faktin se toka po kalon një kohë krize të fortë dhe njerëzit po i rifitojnë aftësitë e tyre intelektuale. Kjo është koha më e frikshme për zvarranikëtt dhe do të dalin prej saj të mundur. Por duhet të kalojnë edhe disa shekuj para se t'u vijë fundi. Ndryshimi kësaj here është që do ta kenë më të vështirë dhe duhet të kënaqen me diçka më pak, ndërsa banorët e tokës do të përfitojnë diçka më shumë. Por edhe sikur këta zvarranikë

LIBRI

të jenë të trashë, përsëri bëhet fjalë për kafshë të trishtuar dhe patetikë, ndërsa njerëzimi i afrohet me ritme të qëndrueshme dritës. Ata janë patetikë, të përqendruar te ligësia dhe në fund nuk do t'ia hedhin. Nuk mund të flas gjithandej për këto gjëra sepse përndryshe do të më thonë: Kristina, merr një kapuç të bardhë, vëre në kokë dhe largohu. Por nuk dua që njerëzit të vazhdojnë të flasin broçkulla".

U trondita kur dëgjova nga dikush tjetër, i ndryshëm nga mua, që të fliste për këto gjëra të cilat, sipas kërkimeve të mia, e di që janë të vërteta. Kur m'i tregoi këto gjëra për herë të parë, ajo nuk qe në dijeni të studimeve që kisha kryer unë për zvarranikët. Kristin Ficxheraldi, falë burimeve të saj të privilegjuara dhe njohurive mbi metafizikën kishte mundur të kuptonte të fshehtën më të madhe, që zvarranikët e kontrollojnë botën nga një përmasë tjetër dhe veprojnë përmes trupave që duken si njerëzorë. Edhe se Uindsorët janë një nga llojet e zvarranikëve. Kristina kishte dijeni edhe për ritet satanike, ritet seksuale dhe praktikën e përhapur të flijimit të fëmijëve. Ajo thotë se zvarranikët duan thelbin e pastër të para-adoleshentëve. "Po të vini re se ku gjenden të gjitha kështjellat dhe shumë fëmijë rrugësh të Botës së Tretë, do ta kuptoni se ata po tërheqin fëmijë në masë". Shton se zvarranikët duan thelbin e jetës fëmijërore sepse nuk mund të vazhdojnë të shfaqen pa këtë energji të pastër. "Thelbi i papastër i neve të rriturve nuk ka asnjë vlerë për ta", thotë ajo. "Me tërë ritualet, thikat dhe sodominë, këta persona e kanë shumë të lehtë të grabisin një copë nga shpirti juaj". Kristina më foli edhe për rite seksuale dhe orgji në të cilat kanë marrë pjesë Uindsorët. Fjala "orgji" rrjedh nga fjala greke "orgi" që do të thotë kult i fshehtë dhe ka të bëjë me ritet seksuale të feve të lashta. Kristina thotë:

"Ishte një rreth të zgjedhurish që merrnin pjesë nëpër orgji rituale në pallatin Bakingem. Këtë ma ka thënë vetë një nga pjesëmarrësit. Vinin të gjithë në çifte. Në njëfarë pike, dritat fikeshin dhe të gjithë shkëmbeheshin, pastaj bënin atë që dihet. A e dini se, në orën gjashtë të mëngjesit, maxhordomi i binte ziles dhe të gjithë shkonin e flinin? Këta persona janë vërtet të këqij, janë të këqij, seriozisht. Asgjë dhe askush nuk është më i lig se ata. Dajana thoshte shpesh se, sikur të tjerët ta dinin se si ishin vërtet, nuk do t'i donin kurrë, por unë e dija si ishin. Pastaj mora vesh për tërë ato orgji që zhvilloheshin në pallat. Dhe të gjithë këta persona seriozë vazhdojnë të hiqen si të devotshëm, pa e ndryshuar aspak sjelljen. Seksi është një aspekt shumë i rëndësishëm i ritualeve të tyre, sepse bëhet fjalë për energjinë kundaline e cila, siç e dini, është bërthama krijuese. Orgjitë më pas u pezulluan sepse një çift vdiq, numri i duhur u prish dhe nuk donin të pranonin në këtë rreth asnjë tjetër. Sepse kjo që pjesë e ritualit. Për ata gjithçka është ritual... Të gjitha

stemat, gjithë ai pompozitet dhe ato ceremoni. Energjia negative tërheq energji tjetër negative".

Shumë nga zonjat shoqëruese të mbretëreshës, i kishin treguar Kristin Ficxheraldit për princin Filip dhe lidhjet sentimentale të tij. "Familja mbretërore ka një mori trashëgimtarësh të panjohur, të shpërndarë në tërë botën", komenton Kristina. Nuk është e rastësishme që ish funksionari i shërbimeve të fshehta britanike, Piter Rajt, pohon në librin e tij të debatueshëm "Spajkeçër" se "pallati ndër shekuj i ka mbuluar gjithnjë skandalet". Kristina thotë se edhe informacionet mbi një libër tjetër, "Dhë Rojals" janë të vërteta pavarësisht se, sipas mendimit të saj, autorja amerikane Kiti Keli "ka lënë pas dore shumë aspekte sepse nuk ka dashur të përzihet me to". Siç do ta kuptoni shumë shpejt, nuk bëhet fjalë për ndonjë shaka. Kristina më ka folur edhe për anëtarë të tjerë të fisit mbretëror, përfshi xhaxhain e princit Filip, lordin Mauntbajten, edhe ky satanist. Më ka thënë: "Edhe lordi Mauntbaten që hajvan i madh. Ai e bëri për vete Çarlsin dhe e futi në rrugë të shtrembër". Kështu, kjo që familja që mori një nëntëmbëdhjetë vjeçare të pafajshme dhe e shfrytëzoi, për ta thënë me fjalët e vetë Dajanës, si "pelë ndërzimi" për të lindur trashëgimtarët e Uindsorëve me gjene të Spenserëve. Por kishte diçka më të madhe se kaq. Shumë më të madhe.

Pak javë para se ky libër të futej për shtyp dhe pak muaj pasi Kristina më kishte ofruar këto informacione në Angli, më kontaktoi një mik amerikan i cili, po çprogramonte një skllave me mendje super të kontrolluar nga Projekti Monark. Ai mendonte se bëhej fjalë për gruan që mbante rolin më të lartë brenda shkallëve hierarkike sataniste në Shtetet e Bashkuara dhe një nga tri Nënat Perëndesha që kryenin rite satanike për nivelet më të larta të Vëllazërisë nga e gjithë bota. Ajo i kishte përshkruar mikut tim ndërtimin e brendshëm të shumë vendeve të fshehta të nëndheshme, të cilat i kishte vizituar personalisht. Përshkrimet qenë shumë të hollësishme. Miku im e krahasoi rrëfimin e saj me atë të burimeve të tjera dhe vërtetësia e kujtimeve të saj u konfirmua në çdo hap. Atë që i kishte treguar mikut tim, dhe që unë e mësova përmes një kasete audio dhe një tjetre video, përputhet me informacionet që më kanë dhënë skllevër të tjerë të mendjes dhe Kristin Ficxheraldi për Uindsorët dhe natyrën e tyre të vërtetë. Arizona ka thënë se kishte kryer rituale satanike në kështjellën Glemis në Tejsajd, në Skoci, shtëpia ku kishte kaluar fëmijërinë nëna mbretëreshë, e cila e ka ende në pronësi, si dhe në Balmoral, rezidencën skoceze të mbretëreshës. Prirja e madhe që Vëllazëria ka ndaj Skocisë, shton ajo, shpjegohet me faktin se, në atë vend, ekzistojnë

disa hyrje drejt brendësisë së tokës ku jetojnë zvarranikët e vërtetë. Kështjella e Glemisit ngrihet mbi rrënojat e një shtëpie të lashtë gjuetie mbretërore të shekullit XI, ndërsa ndërtesa aktuale është ngritur më 1687. Ajo përmendet edhe në historinë e Makbethit të Shekspirit, më falni, të Frensis Bejkënit. Arizona thotë se mbretëresha, princi Filip, princi Çarls dhe princesha Ana, marrin të gjithë pjesë në rite ashtu si edhe e fejuara e Çarlsit, Kamila Parker-Bouls. A nuk po fillon gjithçka të marrë kuptim?

Ajo thotë se, gjatë riteve flijues, mbretëresha mban një mantel ngjyrë ari të mbushur me rubin dhe onikse të zinj. Mbretëresha dhe Çarlsi kanë kupa vetjake, të mbushur me gurë të çmuar, çka tregojnë shkallën e lartë të Mendjendrituve të Vëllazërisë. Nëna Perëndeshë thotë se mbretëresha bën vërejtje të pashpirt për anëtarët më të ulët, por ka frikë nga një burrë me emrin e koduar "Pindar" (markezi dë Libero) i cili, në hierarkinë katanike, qëndron më lart se ajo. Duket se Pindari ngjan me princin Çarls dhe Arizona thotë se ai është babai i vërtetë i Çarlsit. Ajo thotë edhe se viktimat që flijohen gjatë riteve që kryhen në kështjellën Glemis, në përgjithësi, janë më të vegjël se pesë vjeç dhe se ceremonitë ruhen nga Garda e Zezë skoceze. Ajo thotë edhe se lordi Mauntbajten është pedofil dhe se Uindsorët janë zvarranikë me pamje njeriu. Intervista që më dha mua është regjistruar, njësoj si ato të Kristin Ficxheraldit dhe mund të kërkoni një kopje po ta doni. Intervistën me Arizonën mund ta porosisni në videokasetë duke dërguar një kërkesë në adresën që gjendet në fund të librit. E theksoj edhe njëherë se kjo Nënë Perëndeshë nuk e kishte idenë se çfarë më kishte thënë më parë Kristin Ficxheraldi, megjithatë deklaratat e tyre përputhen në shumë pika. Arizona është e sigurt se Dajana e dinte për natyrën zvarranike të Uindsorëve (komentet që Dajana kishte bërë para Kristin Ficxheraldit e vërtetojnë këtë hipotezë) për arsye se zvarranikët e ndryshojnë shpesh formën gjatë gjumit. Ja një përmbledhje e asaj që thotë Arizona për familjen mbretërore:

Nëna mbretëreshë: *"Është shumë e ftohtë dhe e kege. Në oborr, askush nuk i zë besë. Emri i saj i është dhënë një altari (programi kontrolli mendor). E quajnë "Mbretëresha e Zezë". E kam parë duke kryer flijime njerëzore. Një natë, e mbaj mend ndërsa i ngulte thikën njërit nga dy djemtë që po flijoheshin. Njëri ishte 13 vjeç dhe tjetri 18. Nëna mbretëreshë nuk është aspak një qenie e padëmshme. Kur ajo i pamjen e një* zvarraniku *bëhet e gjatë dhe e fortë. Disa prej tyre bëhen aq të fortë, saqë mund t'ia shkulin lehtësisht zemrën nga gjoksi njeriut dhe të gjithë shtojnë disa centimetra kur ndryshojnë formë."* (Mikërisht siç thotë edhe ajo zonja që, bashkë e shumë të tjerë, ka parë Eduard Hethin).

Mbretëresha: *"E kam parë të flijojë njerëz, të ushqehet me mishin e tyre e t'u pijë gjakun. Një herë, u eksitua aq shumë nga pamja e gjakut saqë nuk arriti t'ia priste fytin viktimës nga e majta në të djathtë, sipas rregullave të ritit, por dukej sikur u çmend dhe nisi ta godite si e marrë me thikë, pasi qe shndërruar në* zvarranike. *Kur ndryshon formë, fytyra prej* zvarraniku *i zgjatet si një çengel dhe ka një ngjyrë të zbehët në të bardhë. Edhe nëna mbretëreshë ka gati të njëjtën pamje me disa ndryshime të lehta* (ky përshkrim u ngjason shumë vizatimeve të zotave e të "zogjve" të Egjiptit të lashtë dhe të zonave të tjera). *Ka ca lloj xhungash në kokë dhe një vështrim vërtet të frikshëm. Është shumë agresive."*

Princi Çarls: *E kam parë të marrë pamje* zvarraniku *dhe të bëjë të gjitha gjërat që bën mbretëresha. E kam parë të flijojë fëmijë. Mes tyre zhvillohet një rivalitet i ashpër për atë se kush do t'i hajë disa pjesë të caktuara të trupit dhe se kush do ta thithë frymën e fundit të viktimës, duke i marrë kështu shpirtin. Mes pjesëmarrësve në këto rite kam parë edhe princin Andrea, princin Filip dhe motrën e Çarlsit* (Ana), *por jo kur kam qenë e pranishme. Kur Andrea ndryshon formë, i ngjan më shumë hardhucës. Më shumë se çdo gjë tjetër, u pëlqen vrasja, flijimi dhe konsumi i mishit njerëzor. Nuk u intereson nëse dikush i sheh ndërsa marrin pjesë në këto rituale, kjo është natyra e tyre dhe nuk e kanë problem ta shfaqin. Në fund të fundit, kujt mund të shkosh e t'ia tregosh këto e të presësh që të të besojë? Mendojnë se është e drejta e tyre që prej lindjes dhe i zbavit së tepërmi. I zbavit jashtëzakonisht."*

Në bazë të provave që kam paraqitur në këtë pjesë kushtuar vdekjes së Dajanës, nuk jam habitur aspak kur dëgjova Nënën Perëndeshë të tregonte këtë episod për Mohamed Al Fajedin:

"Pashë Mohamed Al Fajedin gjatë një riti që mbahej pranë kështjellës së Nënave të Territ, në Belgjikë, në vitet 1980. Merrnin pjesë edhe mbretëresha dhe nëna mbretëreshë. Nëna mbretëreshë po fliste me të ndërsa ai vështronte përreth sikur nuk u zinte besë syve për atë që po shihte të ndodhte. Që 24 dhjetor dhe celebrohej riti i mbretit të vjetër dhe mbretit të ri. Gjërat më të këqija nuk i lanë t'i shihnin. Që njësoj si t'u kishin thënë: "Tani, kalojmë te thelbi". Por iu desh të shihte një të sapolindur që prezantohej si mbreti i ri, pas flijimit të një plaku. Ishin nëna mbretëreshë, mbretëresha, Pindari, Rotshildët dhe disa persona që nuk i njihja, përfshi një tip me emrin Toni Bler. Ky po përgatitej sepse, nga sa kuptova, disa persona përzgjidheshin dhe përgatiteshin për kryerjen e disa roleve. Dhe, që të merreshe në konsideratë si i aftë për këto role, duhet të pranoje realitetin,

domosdoshmërinë dhe sovranitetin e Mendjendriturve, *si dhe faktin që të zotët e anijes janë* zvarranikët. *Sjellja e Toni Blerit që e llojit: "Ky është vendi im". I ati i Dodi Fajedit nuk dukej se ndjehej rehat, por kjo nuk mund të thuhet për Toni Blerin. Më kujtohet se e kam parë ndërsa bisedonte diçka me familjen mbretërore. E kam parë Blerin, Al Fajedin dhe familjen mbretërore edhe në Balmoral."*

Pasi mëson këto prapaskena të pabesueshme, arsyeja dhe mënyra e vrasjes së Dajanës bëhen mjaft të qarta. Të gjithë u përfshinë në të dhe ende janë të përfshirë. Vrasja e Dajanës qe programuar prej shumë kohësh, ndoshta që nga lindja, ndërsa në vitet 1980, pak a shumë kur Al Fajedi shkoi në kështjellën e Nënës së Territ bashkë me familjen mbretërore dhe Toni Blerin, simboli i pishtarit të ndezur u vendos mbi Pon dë l'Alma. Arizona thotë se Dajana qe produkt i programit të personalitetit të shumëfishtë, të cilit i qe nënshtruar që kur kishte qenë pesë vjeç. Ajo thotë se Dajana qe shtatzënë prej tre muajsh kur vdiq. Ndoshta Dajana nuk e dinte, vazhdon, sepse teknikat e Vëllazërisë janë të tilla që gratë të vazhdojnë të kenë një cikël të rregullt edhe për njëfarë kohe, para se ta mësojnë se janë shtatzënë. Arizona më tregoi se, kur iu nënshtrua një fekondimi artificial me spermën e Pindarit, gjatë kohës kur qe mendërisht e kontrolluar, vazhdoi ta kishte ciklin të rregullt për tre muaj derisa një mjek i tha se e kishte kaluar muajin e tretë të shtatzënisë. Gjithnjë sipas saj, Dajana mund të mbante fëmijën e Pindarit dhe jo të Dodi Fajedit (flijimi i një gruaje shtatzënë është vërtetë një ritual i fuqishëm). Nëse Dajana, ashtu siç ka shumë të ngjarë të jetë, qe një produkt i programit të kontrollit mendor, ai që planifikoi vrasjen e saj qe siguruar më parë që kryerja e ritit të qe e përsosur. Ajo duhej ta pranonte ftesën e Al Fajedit në çastin duhur, do të dashurohej me Dodin, do të pranonte ta kalonte me të natën në Paris e kështu me radhë. Ka mundësi, ashtu si Arizona, të qe fekonduar artificialisht dhe, më pas, këtë gjë t'ia kishin fshirë nga mendja. Arizona thotë se e di që Dajana qe fekonduar me spermën e Pindarit dhe pastaj kishte lindur djalin e saj Uilliamin, fëmijën flokëverdhë me sy bojëqielli, që lindi ditën e solsticit të verës. Nuk ka dyshime rreth faktit se Dajana qe "një personalitet i shumëfishtë". Ja se çfarë thotë për këtë:

"Arrinte të bënte gjëra me sy duke i rrotulluar ata, gjëra këto mjaft të zakonshme për personalitetet e shumëfishta. Ndonjëherë qe shumë e ndrojtur, pastaj befas hapej dhe bëhej shumë e shoqërueshme. Në këtë mënyrë, shfaqte "altare" (programe) të ndryshme: herë si person i ndrojtur, herë jo e ndrojtur, herë gjaknxehtë e herë jo. Pastaj, kishte dhe peshën e trupit që herë i rritej, e herë i zvogëlohej. Bulimia dhe

dëmtimi i vetes janë simptoma të personalitetit të shumëfishtë. Disa e dëmtojnë veten kur nuk janë të kënaqur ose kur kanë kujtime të këqija. Në rastin e Dajanës është e qartë. Një njeri në gjendjen e saj nuk mund t'ia thoshte botës se ka diçka që nuk shkon dhe pastaj ta kalonte gjithë jetën duke kërkuar ta fshihte. Kështu që përdorte "dola për të blerë gjëra", "shkova të blija ca fustane", ose "po bëja një shëtitje", por asnjë prej tyre nuk qe e vërtetë".

Prania e simboleve të Osiridit, Isidës dhe Horusit në tunelin Pon dë l'Alma atë natë vërtetohet edhe nga Arizona: "Dajana qe Isida, Dodi Fajedi qe Osiridi, ndërsa fëmija qe Horusi. Nuk besoj se ngjarja simbolizon lindjen e fëmijës sesa lindjen e një epoke, epokës së Horusit që nis në vitin 2000. Kjo do të thotë Rendi i Ri Botëror, Epoka e Horusit, fëmijës së tmerrshëm." Ajo shtoi se fetusi u nda mes disa udhëheqësve të nivelit të lartë të Vëllazërisë dhe Mendjendriturve dhe u konsumua gjatë riteve flijuese. Në bazë të përvojës së saj të gjatë me ritet flijuese, qe e sigurt se edhe disa pjesë të trupit të Dajanës u konsumuan në to. Po shtroj përsëri pyetjen nëse trupi i saj vërtet gjendet në ishullin e parkut Althorp. Është e rëndësishme edhe të pyesim se çfarë bënë Toni Bleri dhe anëtarët e familjes mbretërore kur mbërritën në Balmoral menjëherë pas vdekjes së Dajanës. Një aspekt tjetër tipik i praktikave rituale është dhe fakti se Dajana i kishte flokët e verdha dhe sytë bojëqielli. Të tillë i ka edhe Kethi O'Brajan dhe vetë Arizona megjithëse, kur e njoha, i kishte lyer për të prishur magjinë. Më tha se, edhe kur viktimat e flijimit ishin mace, Elita i zgjidhte me qime të verdha dhe sy bojëqielli. Këto tipare kanë një domethënie të veçantë për ta. Që të mbijetojnë në këtë përmasë, kanë nevojë pikërisht për këtë lloj gjaku. Pjesa më e madhe e skllevërve Monark kanë flokë të verdhë dhe sy bojëqielli. "Në planetin tonë, sytë bojëqielli nuk ekzistonin para mbërritjes së jashtëtokësorëve", thotë Arizona.

Në 1989-ën, Dajana i tha Kristin Ficxheraldit se i dukej sikur do ta vrisnin. "Në atë kohë m'u duk e çuditshme", thotë Kristina, "sepse fëmijët i kishte ende të vegjël dhe duhej t'i rriste". Por kishte sinjale të qarta të faktit se, në përgjithësi, Uindsorët dhe Vëllazëria përbënin një rrezik për Dajanën. Nga fundi i viteve 1980, kur martesa e saj qe shndërruar në një farsë, Dajana pati një marrëdhënie me detektivin e saj privat, Berri Manaki, por ai vdiq në një "aksident" me motoçikletë në vitin 1988. Në 1990-ën, gjatë kohës së luftës së Gjirit, Dajana pati një marrëdhënie tjetër me kapitenin Xhejms Hjuit. Një ditë, gjatë atyre kohëve, ajo shkoi në qendrën e garnizonit të Londrës në një gjendje të tmerrshme. Ja se çfarë kujton Kristina:

LIBRI 21

"Nuk mbante dot të qarat dhe e pyeta: "Ç'ka ndodhur?" Qante me dënesë, e dëshpëruar, me ngashërime. Hyri me vrap. U përpoqa ta ndihmoja, e shtrëngova dhe e përqafova, e qetësova dhe i thashë të më tregonte se ç'kishte ngjarë. "Nuk arrij ta besoj, nuk e besoj, e vranë, e vranë", dëneste. I thashë: "Kë vranë?" Atëherë më tregoi për detektivin (Berri Manakin) *të cilit i kishin këputur kokën ndërsa ecte me motoçikletë dhe se si, në fillim, kishte kujtuar se kishte qenë thjesht aksident. Por tani e dinte se e kishte vrarë familja mbretërore sepse kryedetektivi i princit Çarls i kishte thënë vetë se por të mos i jepte fund me Hjuitin, edhe atij do t'i ndodhte e njëjta gjë. I kishte thënë edhe që të mos e kujtonte veten të pazëvendësueshme."*

Zyrtarisht, Berri Manaki vdiq në një "aksident rrugor". Sa të rrezikshme që na qenkan këto rrugët nëse nuk i pëlqeni Uindsorëve. Kristina tregon se Dajana qe dashuruar vërtet me Manakin dhe se, më pas, shkonte çdo ditë te varri i tij. Duket se Dajana nuk e kishte marrë vesh vdekjen e tij deri sa, bashkë me princin Çarls, u shoqërua në aeroportin prej ku do të niseshin për në Festivalin kinematografik të Kanës. Çarlsi priti deri sa ajo u bë gati të dilte jashtë makinës, përpara fotografëve që po prisnin, dhe i tha: "Oh, m'u kujtua, dje dëgjova nga njësia mbrojtëse se i gjori Berri Manaki vdiq. Diçka si aksident me motor. Sa keq, ë?" Dajana shpërtheu në të qara, por Çarlsi shtoi me sarkazëm: "Shkojmë e dashur, po na pret shtypi".[61] E theksoj edhe një herë se, sipas princeshës, lajmi për vrasjen e Manakit si dhe kërcënimet personale ndaj vetë Dajanës kishin ardhur prej kryedetektivit të princit Çarls. Mendoni se këto lajme dhe kërcënime mund të vinin pa dijeninë e Çarlsit? Sigurisht që jo. Në 1998, në dokumentarin e "Indipendent Televizhën" me titull "Dajana - të fshehtat e përplasjes", Xhejms Hiuiti pohoi se edhe atë e kishin paralajmëruar të mos vazhdonte të takohej me Dajanën, përndryshe rrjedhojat nuk do të ishin të këndshme. Ja se çfarë tha:

"Telefonatat ishin anonime por, nuk kishte dyshim se, ai që fliste, ishte në dijeni të gjendjes. Po më kërcënonin. Thanë se, për mua, nuk do të qe mirë ta vazhdoja atë marrëdhënie."

Paralajmërime të tjera, tha, i kishin ardhur edhe nga agjentët vetjakë të eskortës së Dajanës, nga Shtëpia Mbretërore dhe nga një anëtar i familjes mbretërore të cilit nuk ia tregoi emrin:

"Një (pjesëtar i familjes mbretërore) *më tha se e kishin marrë vesh të gjithë marrëdhënien time. Kjo gjendje nuk mund të çonej më përpara, nuk mund të*

garantojmë paprekshmërinë dhe sigurinë tënde kështu që të këshillojmë ta ndërpresësh menjëherë".

Xhejms Hjuiti u citua më pas nga gazeta "Tajms" lidhur me këto kërcënime dhe komentet e tij përputheshin krejtësisht me historinë që Dajana i kishte treguar Kristin Ficxheraldit, që Hjuiti tha se paralajmërimi më i hapur që ai kur i thanë se do të kishte të njëjtin fund si Berri Manaki.[62] Ka ende ndonjë që mendon se Uindsorët dhe organizatat e tyre nuk janë përfshirë në vrasjen e princeshës Dajana? Apo tashmë janë bindur të gjithë se kishin dijeni të plotë të fakteve dhe një rol aktiv në vendimin për të vrarë nënën e princërve Uilliam dhe Herri? Sipas artikujve të disa gazetave amerikane, Sjuzan Barrantes, nëna e Sara "Fergi" Fergusonit, u kishte thënë disa miqve të vetë se Dajanën do ta vrisnin, pak javë para se të gjendej vetë me kokë të këputur në një aksident të mistershëm me makinë në Argjentinë, më 19 shtator 1998.[63] Posta private e Dajanës i dorëzohej Kristin Ficxheraldit, përfshi edhe letrat e dërguara nga një ish-pjesëtar i grupit të zgjedhur SAS i cili shqetësohej për sigurinë e Dajanës. E paralajmëronte për atë që luhej pas krahëve të saj. "Duhet ta dini se gjysma e agjentëve të MI6-s mbante anën e Dajanës", thotë Kristina. Një ditë, një klientë që kishte lidhje me agjencitë e sigurisë pa një nga këto letrat që i dërgoheshin asaj. Ja si e përshkruan Kristina:

"Tha, jam vërtet e shqetësuar për ty, nuk e di se në ç'ngatërresë je futur. Dajana është plotësisht e çmendur dhe do të na marrë edhe ne me vete, do të përfundosh diku atje jashtë e vdekur, do të të vrasin fëmijët, njësoj si macet, çdo gjë do të shkojë mbrapsht. Nuk po u besoja veshëve. Ajo ziente nga urrejtja. Ditën tjetër Dajana erdhi dhe i dhashë postën. I thashë se jo të gjithë ata që të përkulen të duan me gjithë zemër të mirën. I tregova se ç'më kishte ndodhur dhe ajo u nxi nga inati. Kur vdiq, të gjithë thanë "e hoqën qafe, apo jo?" Ajo klientë qe e vetmja që u indinjua nga kjo tezë. Shërbimi MI6 nisi të më mbikëqyrë, telefonat më kontrolloheshin, shtëpia m'u kontrollua ndërsa familja mbretërore më kishte mbajtur nën mbikëqyrje gjatë gjithë kohës kur takohesha me Dajanën".

Kristina dhe burimet e saj nuk kanë pikë dyshimi për atë që ndodhi në Paris: "E hoqën qafe, e lanë të vdiste në mes të rrugës. Përgjegjësitë për gjithë këtë mbanin pozicione të larta në elitën e ushtrisë", thotë Kristina. "Nuk bëhet fjalë për "ketrat e fshehtë" (shërbimet e fshehta britanike) por për diçka që qëndron më lartë", shpjegon ajo. Thotë edhe se "Mohamed Al Fajedi me atë mendjen e tij të vockël kërkon të bëhet pjesë e klasës sunduese zvarranike,

LIBRI 24

sepse i pëlqejnë të gjitha këto gjëra". Kristina beson se historia e dashurisë mes Dajanës dhe Dodit ka qenë e planifikuar. Ja si shprehet ajo:

"Dajana binte shumë lehtë në dashuri, ndërsa ai kishte një buzëqeshje që ta fitonte zemrën. Asaj nuk i kishte ecur kurrë me historitë sentimentale sepse ndihmonte të tjerët që vuanin nga e njëjta frikë si e saja. Kështu, burrat me të cilët ishte lidhur, kishin të gjithë probleme emocionale dhe për ta, ajo qe si një lloj shëruese. Shumica e njerëzve që kanë qenë me Dajanën e kanë përdorur atë, mendoj se edhe Dodi po kështu veproi. Mbase dhe ai e përdori për egon e tij, për shkak të njohjeve që kishte ajo dhe për llogari të të atit. Familja mbretërore e vrau për shkak të energjisë së saj të butë, sidomos gjatë periudhave të shtatzënisë. Nuk besoj se u plagos aq rëndë sa thonë. Po t'i kishin kontrolluar trupin, do ta shihnin se prerja që i bënë kirurgët niste nga fundi i barkut dhe ngjitej deri te gryka. Madje i kishin hequr edhe gjëndrën e timusit që shërben për komunikimin ndëryjor. Nga burime shumë të besueshme e di që ishte shtatzënë dhe se fetusin ia hoqën, e ndanë në shumë copa të cilat i dërguan ngado. Këto qeliza do të përdoreshin për të krijuar fëmijë të tjerë. Edhe disa pjesë të trupit të saj u përdorën nëpër rituale. Dajana kontrollonte gjithnjë pallatin Bakingem për të gjetur përgjuesit, por, këtë herë, përgjuesit i kishin vendosur te Dodi dhe informoheshin vazhdimisht për gjithçka ndodhte. Nuk qe hera e parë që mendoja se qe shtatzënë, kishte ndodhur dhe më parë, por atëherë nuk ishte. Kishte ndodhur me Hjuitin".

Kristin Ficxheraldi dhe Dajana kishin folur bashkë për disa të fshehta të jetës së saj dhe pak të tjerë e njihnin si ajo. Nuk mund të lihen në hije disa nga rrëfimet e saj mbi atë se si e kishin trajtuar Uindsorët për vite me radhë, kërcënimet që kishte marrë nga detektivi personal i Carlsit, ritet flijuese dhe pohimi se përgjegjësit e vërtetë të vdekjes së Berri Manakit ishin vetë Uindsorët. Duhet të nxisim një fushatë që t'i detyrojë Uindsorët t'u përgjigjen disa pyetjeve lidhur me këto gjëra dhe me rastet e Al Fajedit, Trevor Ris-Xhonsit, kontit Spenser e të tjerëve që kam përmendur. Uindsorëve u duhet hequr pushteti, dinastia e tyre mbretërore duhet rrëzuar dhe duhen bërë publike krimet e tyre kundër njerëzimit. Jo vetëm kaq: duhen nxjerrë edhe emrat e bashkëpunëtorëve të tyre politikë, punonjësve të sigurisë, mjekëve. Familja mbretërore, konti Spenser dhe kryeministri britanik, Toni Bler, e kanë hedhur poshtë tezën sipas së cilës Dajana u vra dhe kanë bërë thirrje që t'u jepet fund këtyre zërave "për të mirën e djemve të saj". Por këto kërkesa nuk duhen lënë pas dore, përndryshe Vëllazëria do të vrasë dikë tjetër dhe përsëri fajtorët do t'ia hedhin pa u lagur.

Konti Spenser arriti deri në atë pikë saqë lëshoi një deklaratë në emër të familjes Spenser, në shkurt 1998, ku pyeste: "A ka ndonjë gjë pozitive në gjithë këto spekulime? Po ju pyes sepse, sigurisht, në to ka shumë gjëra negative. Të gjithë ne, familjarët e saj, kërkojmë që kujtimi i Dajanës të respektohet dhe këto spekulime sensacionale të lihen jashtë arenës publike sepse pengojnë përpjekjet tona për të përballuar humbjen e saj."

Kush i ka lexuar provat e paraqitura në këtë pjesë dhe sheh se njerëzit si konti Spenser dhe Toni Bleri vazhdojnë të thonë se nuk ka asnjë bazë për të folur për komplot, çfarë duhet të mendojë? Po sikur Dajana të qe motra juaj, a nuk do të donit të dinit me çdo kusht se çfarë i ka ndodhur? Po sikur të ishin kryeministër dhe një princeshë e famshme e dashur për njerëzit të vritej, a nuk do të ngulnit këmbë që e vërteta të dilte në shesh? Atëherë, përse nuk mendojnë edhe këta njësoj si ju? Marrëdhëniet mes Dajanës dhe të vëllait të saj nuk ishin aspak të mira, për të mos e zgjatur më tej. Pasi u bënë të njohura prapaskenat, fjalimi i famshëm që mbajti konti Spenser në varrimin e Dajanës del si krejtësisht hipokrit. I tillë ishte dhe dënimi i paméshirshëm që u bëri mediave, përmes një deklarate që lëshoi nga shtëpia e tij në Kejp Taun, menjëherë pas vdekjes së të motrës, një deklaratë që, si ajo e Al Fajedit, ushqeu edhe më tepër tezën sipas së cilës përgjegjësit e aksidentit ishin paparacët. Ja se çfarë thotë për të Kristin Ficxheraldi:

"Carls Spenseri është gomar i madh, është fare hajvan. Madje, hajvan zemërlig. Kur Dajana po kalonte një krizë të thellë dhe kishte nevojë për të ndërruar shtëpinë, ai i kishte thënë: "Nuk ke pse m'i shkarkon mua problemet e tua". Nuk i ofroi asnjë nga shtëpitë e tij. Nuk bëhet fjalë për ndonjë njeri të fuqishëm. Di ta nuhasë rrezikun dhe pushtetin rreth tij dhe tërhiqet prej tij. Në shtëpinë e Spenserve praktikohet satanizmi. Dajana e dinte këtë".

Dajanën e donin miliona njerëz, siç e pamë pas vdekjes së saj, njerëz që nuk dinin as edhe gjysmën e vuajtjeve që Dajanës i duhej të duronte pasi ra në kthetrat e Uindsorëve. Nga shumë aspekte, fati i Dajanës të kujton atë të Merilin Monrosë, që u përdor nga "kisha", u shtrydh e u vra. Merilini pati një lidhje me presidentin Kenedi, por edhe me vëllain e tij, Bobi, dhe kur nisi të bëhej e rrezikshme, kur nuk qe më e dobishme, e vranë për shkak të atyre që dinte. Bëhet fjalë për një shembull tjetër të jashtëzakonshëm të sinkronizimit. dhe janë të shumta "përkimet" mes jetës së saj dhe të Dajanës. Që të dyja kishin lindur ditën e parë të muajit dhe vdiqën në moshën 36 vjeçare, në gusht. Që të dyja ishin martuar në datat 29 me burra dymbëdhjetë vjet më të mëdhenj se to. Merilini quhej Mbretëresha e Diamanteve ndërsa Dajana

Mbretëresha e Zemrave. Që të dyja qenë shndërruar në frymëzim për Elton Xhonin, i cili kompozoi këngën "Një qiri në erë" dhe e këndoi në varrimin e Dajanës. Që kur Kristin Ficxheraldi foli për herë të parë me mua, kërcënimet për të shkatërruar jetën e saj profesionale u shtuan. Telefoni i saj pushoi së rëni dhe, kur e takova një herë, më tha se për një javë mezi kishte mbledhur aq klientë sa, më parë, i vinin në një ditë të vetme. Është e pakuptueshme po të mendosh se bëhet fjalë për një nga shëronjëset më të afta që veprojnë në qendër të Londrës. Por ajo është e bindur që e vërteta duhet të dalë në dritë, pavarësisht se çfarë do t'i bëjnë autoritetet: "Nuk dua luftë, dua vetëm që të mos na tregojnë më përralla", është shprehur vetë ajo. Lidhur me jetën e Dajanës dhe bisedat që zhvillonin bashkë, kujton:

"E gjora, ndodhej në një shtëpi ku askujt nuk i bëhej vonë për të. Kjo është vërtet e tmerrshme. Ndjehej krejt e vetme në një çerdhe nepërkash. Zakonisht, përpiqesha t'i jepja zemër. Mua më kishte gjetur dhe te mua vinte. E lashë të priste pesëmbëdhjetë ditë, pastaj e ekzaminova. Kishte nga ata që thoshin se e kisha futur në një terapi tërbimi. Nuk është e vërtetë. Unë e dëgjoja, mbaja mend gjithçka dhe mendoja: "O Zot!" Po nuk ma merrte mendja se do ta vrisnin. Nuk arrij ta kuptoj se si mund të fshehin informacione kaq të dukshme. Dhoma ime është dhoma e së vërtetës, është vend i sigurt dhe unë nuk gjykoj askënd për ngatërresat që bën, ja përse, deri tani, nuk kam folur për këto gjëra. Por kur duhet thënë e vërteta, duhet thënë e plotë. Nuk ishte aspak e çmendur, besoj se, qysh fëmijë, kishte pësuar abuzime mendore dhe fizike. I ati qe tip i ashpër por edhe njerka (Rein) nuk mbetej pas".

"Familja mbretërore kishte frikë. Dajana kishte rrëmbyer dashamirësinë e publikut dhe, pak nga pak, të gjithë botës. Ata e njihnin mirë vlerën e saj dhe, për shumë kohë, u ushqyen si vampirët me mendjen e saj. Gjithçka që donte ishte të martohej e të kishte fëmijë, e gjora vajzë. Donte të jetonte atë që nuk e kishte provuar kurrë. Të tjerët e donin sepse qe e hareshme dhe, kudo shkonte, përcillte dashuri. Qe vërtet e pabesueshme. Gjëja e trishtuar këtu ishte se ajo nuk e kuptonte dhe kishte vazhdimisht nevojë që t'ia pohonin vlerat që mbante. Për fat të keq, e kërkonte në vendin e gabuar këtë. Kur kërkoi të shkëputej, nisëm të dalim e të bëjmë gjëra normale. Bëri kung-fu me burrin tim për pesë vjet. Donte të ndjehej normale, të kapte dikë për krahu e të bënte një shëtitje në rrugë. E dinte se çfarë i donte zemra. Që vërtet e jashtëzakonshme".

Dajana nuk arrinte ta besonte se sa të ftohtë qenë Uindsorët dhe bota e vuri re këtë në ditët pas vdekjes së saj. Qëndruan të fshehur në Balmoral, në

Skoci, ndërsa njerëzit, me miliona, qanin Dajanën dhe shprehnin dhimbjen si kurrë më parë. Vetëm trysnia që publiku ushtroi përmes mediave e detyroi mbretëreshën, kundër dëshirës së saj, t'i kushtonte Dajanës një "përkujtim" të ftohtë e patetik përmes televizionit, një natë para varrimit. "Të ftohtë" është një fjalë shumë e përdorshme kur flitet për mbretëreshën, Filipin dhe Çarlsin dhe përkon së tepërmi me profilin mendor dhe shpirtëror të Vëllazërisë dhe organizatave të saj. Bill Kuperi thotë se anëtarët që kishte njohur kur punonte për shërbimet e fshehta të marinës amerikane nuk kishin "as ndërgjegje, as moral, as vrarje ndërgjegjeje, as ndjenja dhe as emocione". Kjo përputhet plotësisht me profilin e karakterit të Uindsorëve dhe, sipas atyre që i kanë njohur, edhe të zvarranikëve të nivelit të poshtëm të përmasës së katërt. Natyrisht, kjo e ka një arsye.

Njerëzve u janë zënë sytë prej mijëvjeçarësh. U janë zënë sytë për historinë e tyre, për identitetin e vërtetë dhe natyrën e jetës. U janë zënë sytë për origjinën e vërtetë dhe për planet e atyre që lejuan t'i qeverisin. Kështu që, nuk është për t'u habitur që edhe shprehja "i zë sytë" rrjedh nga Masoneria. Doktor Albert MekKej, mason i shkallës së 33-të dhe një nga historianët më të shquar masonë të shekullit XIX, në *Enciklopedinë e Masonëve*, e përkufizon kështu këtë shprehje: simbol i fshehtësisë, heshtjes dhe errësirës, ku ruhen të fshehtat e artit tonë nga sytë e profanëve.

Lloji njerëzor vërtet që i ka pasur sytë të zëna.

Pak muaj pasi më kishte dërguar një intervistë të regjistruar për këtë libër, mora një letër nga avokatët e Kristin Ficxheraldit, nga studioja Tarlo Lajëns e Uopingut, në Londër, përmes së cilës ajo i tërhiqte mbrapsht të gjitha deklaratat e saj dhe më informonte se qe kundër botimit të këtij libri. Më kërcënonte se do të ndërmerrte veprime ligjore në rast se do ta citoja. Unë nuk e mora parasysh këtë kërcënim sepse deklaratat qenë regjistruar në prani të mikeshës së saj, Xhuli Lou, e cila pohon autenticitetin e tyre dhe se Kristina qe në dijeni të plotë se si do të përdoreshin fjalët e saj. Xhuli pohon se Kristina i kishte treguar këto informacione edhe herë të tjera në të shkuarën. Ka ardhur koha që, për atë që është e drejtë të çohemi në këmbë e jo t'ua mbathim këmbëve. Nëse njerëzit janë lodhur me mashtrime, ka ardhur koha të veprojmë e jo të flasim. Përndryshe, si mund t'i japim fund gjithë kësaj?

LIBRI 24



LIBRI 24

Kreu 20

Përmbushja e magjepsjes

Pirja që Vëllazëria ushqen ndaj riteve dhe simboleve nuk është thjesht sjellja e çuditshme që mund të shohim nga jashtë. Është një mjet për përmbushjen e një magjepsjeje mbi mendjen dhe emocionet njerëzore. Kjo ndodh prej mijëra vjetësh dhe është shumë e rëndësishme të kuptohet ky aspekt nëse, si në rastin tonë, duam të shkëputemi nga kontrolli i këtyre zvarranikëve.

Gjithçka ekziston është pjesë e fushës energjetike, një model i vetëm energjie vibruese i krijuar nga mendimi dhe emocionet. Gjithçka ekziston është energji, por këta modele të pafundmë krijojnë forma të pafundme, ashtu si uji që shfaqet në formë lëngu, resh, avujsh ose akulli. Pamja dhe vetitë janë të ndryshme, por përsëri bëhet fjalë vetëm për ujë. Disa modele energjie shfaqen si trupa njerëzorë, të tjera si mendje njerëzore, të tjera si zogj, pemë, insekte, ujë, qiell dhe ajër. Në nivelin e energjisë së pastër, çdo gjë është e lidhur me të tjerat. Nuk ekziston asnjë "ne" dhe asnjë "ata", por vetëm një "ne" dhe, si përfundim, një "unë". Në nivelin potencial, kemi mundësi ndërveprimi me çdo formë tjetër energjie dhe, qysh në çastin kur energjia dhe vetëdija bëhen e njëjta gjë, mund të ndërveprojmë edhe me çdo lloj vetëdijeje, me mendjen e pafundme që e quajmë "Zot". Ky "Zot" nuk është i shkëputur prej nesh, është vetë ne dhe ne jemi ai. Ne jemi

një pamje e mendjes së pafundme – ashtu siç janë edhe këta zvarranikë dhe gjithçka tjetër që ekziston – prandaj kemi aftësinë dhe mundësinë të futemi brenda mendjes së pafundme sepse, në nivelin më të lartë të shprehjes sonë, ne të gjithë nuk jemi gjë tjetër veçse ajo vetë. Jemi si ato pikat e oqeanit të pafund, të veçanta deri në një farë pike, por që formojnë, së bashku, një të tërë, shumën e përgjithshme të pikave. Pa pikat, nuk ekziston as oqeani. Por çështja është kjo: me sa pjesë të këtij oqeani jemi bashkuar? Nëse është vetëm një pjesë e vogël, do të vazhdojmë të jetojmë në një lloj fshikëze, në një lëvozhgë veze, siç e quaj unë, të shkëputur nga potenciali i pafundmë i njohjes, dashurisë, mëshirës dhe urtësisë (shih **Figurën 54**). Do të jetojmë një jetë që do të sundohet nga shqetësime e frikëra, do të vazhdojmë të besojmë se jemi veç qenie të zakonshme e të paaftë për të kontrolluar fatin tonë. Por, nëse e hapim mendjen dhe zemrën e dalim nga ajo fshikëz, do të kemi mundësi më të mëdha për të prekur përmasat e pafundme dhe, në këtë mënyrë, do të kuptojmë se jemi diçka më tepër se një trup fizik që çon një jetë pa ndonjë domethënie. Jeni një vetëdije e pafundme që eksperimenton në këtë botë si pjesë e udhëtimit të përjetshëm të evolucionit përmes përvojës (shih **Figurën 55**). Kështu, do të jeni çdo gjë dhe do të keni potencialin për të mësuar çdo gjë e për të bërë çdo gjë.




Figura 54. Burgu




Figura 55. Liria

LIBRI 24

Cila nga këto dy gjendje është më e lehtë për t'u kontrolluar? Përgjigjja është krejt e qartë dhe shpjegon shumë gjëra për botën që kemi parë gjatë historisë së njohur të njerëzimit. Ja përse njohja e identitetit tonë të vërtetë është shkatërruar gjithnjë në arenën publike. Qeniet njerëzore të vetëdijshme për natyrën e tyre të vërtetë, për fuqinë dhe vlerën që kanë, nuk mund të manipulohen sipas mënyrave që pamë. Vetëm duke larguar njerëzimin nga vetëdija e tij u bë e mundur orkestrimi i Urdhërit të Ditës të zvarranikëve të Vëllazërisë gjatë mijëra viteve. Krijimi i fesë dhe "shkencës" zyrtare ka luajtur një rol thelbësor në gjithë këtë dhe, siç e kemi parë, të njëjtat shoqëri të fshehta kanë ndikuar në krijimin e të dy këtyre institucioneve. Individualizimi i konceptit të "Zotit" te njeriu, pra, duke i dhënë atij një formë fizike, i dha fund idesë se Zoti është çdo gjë. Të thuash se je Zot, do të thotë të tërheqësh drejt vetes përçmimin dhe dënimin, siç më ndodhi mua kur fola publikisht për këto gjëra në Britaninë e Madhe, muajt e parë të viteve 1990. Të thuash atë që është, të pohosh atë që *të gjithë* ne jemi, është shndërruar në blasfemi. Për atë që nuk ia mbush mendjen feja, është kjo feja tjetër që thotë se bota është e gjitha këtu dhe se nuk ekziston një përmasë e pafundme, as një natyrë e përjetshme e jetës. Por Vëllazëria ka synuar programimin dhe manipulimin e perceptimit që ka njerëzimi për veten e tij dhe për krijimin deri në atë pikë saqë na ka larguar nga pafundësia jonë shumëpërmasore dhe na ka lënë të shfrytëzojmë vetëm një pjese të vockël të potencialit tonë. Por zvarranikët janë edhe një shprehje e së pafundmes dhe na ofrojnë një përvojë që mund ta shfrytëzojmë për t'u zhvilluar, njësoj si ai që, duke sfiduar kontrollin e zvarranikëve, u ofron njëherësh atyre një përvojë më shumë. Qeniet njerëzore po e mësojnë se çfarë ndodh kur heq dorë nga fuqia që ke dhe se ky grup zvarranikësh, së shpejti, duhet të përballet me rrjedhojat e abuzimit me pushtetin. Në fund të fundit, bëhet fjalë për një lojë, një lojë që quhet evolucion, që na lejon të mësojmë si është vendosur kontrolli mbi mendjen dhe emocionet tona. Ajo që kam përshkruar në këtë libër është një përvojë evolutive që u përket të gjitha palëve të përfshira në të. Ne, që të gjithë, marrim vendime, kryejmë zgjedhje dhe përballemi me rrjedhojat. Sot ndodhemi përballë këtyre rrjedhojave. Nëse bëjmë zgjedhje të reja, do të krijojmë rrjedhoja të tjera. Mund ta kontrollojmë vetë fatin tonë dhe njerëzit po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për këtë.

Zvarranikët e kanë burgosur pjesën më të madhe të vetëdijes njerëzore brenda nivelit të poshtëm të përmasës së katërt, në burgun vibrues të frikës, ndjenjës së fajit dhe mungesës së shpresës. Vetëm duke hapur zemrat dhe mendjet, mund t'i shpëtojmë atij dhe të bashkohemi më "unin" tonë të pafundmë. Përgjigjja është dashuria.




Figura 56. Burgu i vibrimeve

Zvarranikët e manipulojnë që nga niveli i poshtëm këtë përmasë të katërt, të ashtuquajturën gama e frekuencës qiellore të poshtme. Për të kontrolluar këtë planet, duhet ta mbajnë masën e njerëzve në një nivel jo më të lartë se ky, duke e larguar nga gjithçka që qëndron më lart (**shih Figurën 56**). Kur të jetë kuptuar kjo, do të shihet se gjithçka ka ndodhur dhe ndodh ende në botë, e ka një farë kuptimi. Për të mbajtur psikikën njerëzore në një gjendje izolimi dhe padijeje, thelbësor është manipulimi i emocioneve me vibrime të ulëta, frikës, ndjenjës së fajit, pendesës, nënvlerësimit të vetes dhe dënimit të të tjerëve që, në fund të fundit, janë të gjitha shprehje të frikës. Këto janë emocionet që rrjedhin sipas gamës së frekuencës së nivelit të poshtëm të përmasës së katërt dhe, pasi ne e lëmë veten të sundohemi prej tyre, biem nën kontrollin e vetëdijes zvarranike. Vini re se po flas për sundimin. Është mirë që këto emocione të konsiderohen si pjesë të përvojës jetësore. Kjo është e rëndësishme për evolucionin tonë drejt një kuptueshmërie dhe urtësie më të madhe. Pikërisht kur kontrollohesh prej këtyre emocioneve, qendra e psikikës tënde lidhet me nivelin e poshtëm të përmasës së katërt në mënyrë të tillë që vetëdija e zvarranikëve mund të futet brenda modeleve tona të mendimit. Për të arritur këtë, Vëllazëria përdor ritet e tmerrshme satanike dhe flijimet, që shërbejnë për sintonizimin e pjesëtarëve të vet në valët e frekuencat e zvarranikëve. Madje përpiqen edhe t'i nxisin ato tipare të karakterit në sistemin tonë R, në pjesën zvarranike të trurit që shfaqet nën format e agresivitetit, pirjes rituale, dëshirës për një strukturë hierarkike e kështu me radhë.

Ajo që dua të nxjerr në pah për natyrën e jetës nuk është ndonjë lloj teorizimi. Është diçka që mund të provohet. Disa shkencëtarë dhe studiues amerikanë kanë provuar se një emocion i ngjashëm me frikën i përket një modeli vijues të ulët me gjatësi vale të madhe ndërsa ndjenja që e quajmë

dashuri përkon me një model vibrues më të lartë dhe me gjatësi vale më të vogël. E gjitha kjo është krejt e kuptueshme, siç e tregon autori, kërkuesi dhe arkeologu Greg Brejdën në filmin e tij "*Zgjimi në pikën zero*"[1]. Lënda gjenetike e trupit njerëzor përbëhet nga një marrës dhe një transmetues mjaft të sofistikuar frekuencash. Disa eksperimente kanë treguar se, kur një pjesë ADN-je, trashëgimia gjenetike e trupit njerëzor, futet brenda një tufe elektronesh, elektronet vendosen në mënyrë të tillë që të formojnë një strukturë të ngjashme me atë të vetë ADN-së. Kur ADN-ja largohet, elektronet zënë vendet e tyre të zakonshme. Me fjalë të tjera, ADN-ja ndikon vazhdimisht mbi energjinë që na rrethon. Kushtet në të cilat gjendet qenia jonë ndikojnë mbi botën, sekondë pas sekonde.

Duke ndryshuar sjelljet dhe kushtet e qenies sonë, ne ndryshojmë gjithçka tjetër, sepse jemi pjesë e kësaj gjithçkaje, madje, *jemi* vetë gjithçkaja.

Vazhdoni ende të ndjeheni të zakonshëm e të pafuqishëm? Ne zotërojmë brenda vetes një seri mikroantenash që quhen aminoacide, të cilat ndërveprojnë me ADN-në dhe, sipas Brejdënit, ekzistojnë 64 kode gjenetike njerëzore ose antena, në gjendje të transmetojnë dhe të kapin frekuenca. E thënë shkurt, 64 antena që na lidhin me frekuenca më të larta dhe përmasa më të larta se qenia jonë. Por, sipas Brajdënit, vetëm 20 prej tyre janë të aktivizuara ndërsa 44 të tjerat qëndrojnë vazhdimisht "të fikura". Kjo do të thotë se aftësia që kemi për t'u lidhur me fuqinë tonë të plotë, me urtësinë dhe potencialin që kemi, paragjykohet së tepërmi. Nuk ka dyshim se edhe fakti që ne kemi në shfrytëzim vetëm një pjesë të potencialit të trurit është rrjedhojë e kësaj. Nga studimet që janë kryer së fundi në Institutin HartMath dhe institute të tjera amerikane ka dalë se këto "antena" që janë pjesë e ADN-së aktivizohen ose çaktivizohen nga gjatësi vale të emocionit që filtrohet vazhdimisht përmes ADN-së. Emocioni i frikës (prej të cilit rrjedhin të gjitha emocionet e tjera negative) ka valë me gjatësi të madhe dhe lëvizje të ngadalta dhe aktivizon vetëm disa nga antenat tona potenciale (shih **Figurën 57**). Ndërsa dashuria (prej së cilës rrjedhin të gjitha emocionet pozitive) ka gjatësi vale të shkurtër, lëviz shpejt dhe aktivizon një numër më të madh antenash (shih **Figurën 58**). Kështu, kur jemi nën ndikimin e frikës, largohemi nga çdo mundësi lidhjeje me të pafundmen dhe e jetojmë jetën brenda një pike të vogël vetëdijeje, ngjashëm me gjendjen brenda lëvozhgës së vezës. Kur përjetojmë ndjenjën e dashurisë, lidhemi me "unin" tonë shumëpërmasor dhe potenciali ynë bëhet i pafundmë sepse ne vetë jemi bërë të pafundmë. Lidhemi kështu me pafundësinë, me "Zotin".

E gjitha kjo mund të shpjegohet edhe ndryshe. Vetëdija jonë është një

seri fushash energjetike të lidhura mes tyre. Zotërojmë intelekt, emocione, shpirt e kështu me radhë, të gjitha këto aspekte që përkojnë me frekuenca të ndryshme dhe që bashkëveprojnë me njëra-tjetrën përmes një sërë shtjellash të njohura me emrin *çakra*, një fjalë sanskrite që do të thotë "rrota drite". Siç e kam thënë dhe më sipër, përmes këtyre *çakrave* prishjet e baraspeshës motive transferohen në nivelin mendor dhe pastaj, nëse mbesin aty, kalojnë në atë fizik. Kjo është arsyeja që stresi shkakton sëmundje dhe po kjo është arsyeja që, kur kemi probleme emocionale, nuk jemi as të kthjellët mendërisht. Shtatë *çakrat* kryesore janë të vendosura mes fundit të shtyllës kurrizore dhe pjesës së sipërme të kokës, siç shihet në **Figurën 59**. Tre të poshtmet na lidhin me Tokën, tre të sipërmet na lidhin me shpirtin, me "oqeanin". Në kushte ideale, një qenie njerëzore është lidhja mes përmasës fizike dhe asaj shpirtërore: mes qiellit dhe tokës.

Pika e baraspeshës brenda sistemit të *çakrave* përfaqësohet nga *çakra* e




Figura 57. Frika ka valë me gjatësi të madhe dhe të ngadalta. Ajo aktivizon shumë pak "antena" të ADN-së sonë që na lejojnë të lidhemi me gjithësinë.




Figura 58. Dashuria ka valë me gjatësi të shkurtër dhe shpejtësi të lartë. Ajo aktivizon shumë më tepër antena, duke na lidhur me gjithçkanë.

zemrës, përmes së cilës shprehet ndjenja e dashurisë ose urrejtjes, shprehja më e lartë dhe më e ulët e kësaj game frekuencash të *çakrave*. Prej këtej ka rrjedhur dhe simbolizmi që lidh zemrën me dashurinë. Sot, dashuria lidhet me zemrën fizike por, në të vërtetë, ky simbolizëm është frymëzuar nga zemra shpirtërore, *çakra* e zemrës.

Kur shprehim dashurinë në sensin më të pastër dhe më të vërtetë, dashurinë e pakushtëzuar dhe absolute, siç e quajmë, *çakra* e zemrës hapet si një lule dhe rrotullohet me gjithë shpejtësinë e forcën e saj. Fuqia e lules! Kjo sintonizon gjithë nivelin më të ulët të vetëdijes sonë në frekuencën e dashurisë së pastër dhe, në këtë mënyrë, na lidh me përmasat më të larta që sinton-

izohen me këtë frekuencë dashurie. Nuk ka rëndësi se kush jeni dhe se çfarë keni bërë, shpirti është dashuri në gjendjen e saj më të pastër. Nuk ka rëndësi nëse jeni zvarranikë të një përmase tjetër, mbretëresha e Anglisë, Xhorxh Bushi, Henri Kisingeri apo kushdo qoftë tjetër, shpirti mbetet gjithnjë dashuri në gjendjen e pastër. Ajo që ka ndodhur është se vetëdija e poshtme e këtyre njerëzve është larguar nga niveli më i lartë i vetë tyre dhe, pasi ndodh kjo, vetëdija e poshtme është në gjendje të kryejë veprime jashtëzakonisht të tmerrshme. Po si mund të lidhen këta njerëz me "unin" e tyre të vërtetë – me dashurinë e pastër – ndërsa janë sintonizuar me një urrejtje të tillë? Nuk munden. Siç ndodh me të gjithë ne, mënyra e vetme për t'u lidhur me dashurinë e pastër është të shprehin dhe të jetojnë dashurinë e pastër. Për të arritur këtu, natyrisht, duhet të heqin dorë nga dëshira për të kontrolluar dhe sunduar të tjerët,sepse, për sa kohë që do të vazhdojnë të zbatojnë Urdhërin e Ditës, do të mbeten të izoluar nga "uni" i tyre i pafundmë.





Figura 59. Sistemi i çakrave.

Janë përpjekur të manipulojnë njerëzimin dhe ta kufizojnë brenda një niveli edhe më të ulët vetëdijeje. Zvarranikët dhe grupe të tjera të nivelit të ulët të përmasës së katërt ndodhen në një burg vetëdijeje dhe duan që njerëzimi të jetojë brenda një burgu edhe më të vogël. Është mjaft interesant përfaqësimi i zvarranikëve të mbyllur brenda një burgu të kohë-hapësirës të piktorit surrealist holandez M. C. Esker, të cilin mund ta shihni dhe në **Figurën 60**. Besoj se e tillë është gjendja sot dhe, për sa kohë që nuk do të ndryshojnë, do të mbesin brenda këtij burgu, pa mundur të zhvillohen drejt së

pafundmes. Qëllimi i vetëm është të na mbajnë të gjithëve ne aty brenda, bashkë me ta. Sigurisht që metoda e përdorur nga zvarranikët për të arritur qëllimin, gjatë këtyre mijëvjeçarëve, është mbështetur pikërisht këtu, sidomos falë përdorimit të frikës. Luftërat e vazhdueshme, konfliktet, atentatet terroriste, shqetësimet financiare e shumë ngjarje të tjera negative janë planifikuar nga Vëllazëria për të mbajtur njerëzimin në një gjendje frike, pra, larg nga "uni" i vërtetë. Nxitja e urrejtjes, mërisë, hakmarrjes dhe ndëshkimit (bëhet përsëri fjalë për shfaqje të ndryshme të frikës) jo vetëm që kanë ndihmuar në rëndimin e gjendjes, por kanë krijuar edhe kushtet për konflikte e frikëra të reja. Një frikë edhe më e madhe, madje e stërmadhe, shkaktohet nga feja. Frika nga Zoti (frika nga vetvetja) është frika nga vdekja e nga ndëshkimi "i tij". E njëjta gjë ndodh me "shkencën" dhe me frikën nga vdekja dhe harresa. Njerëzimi mbahet nën frë me frikën dhe shprehjet e ndryshme të saj dhe kjo është arsyeja që jemi larguar nga "uni" i vërtetë. Vëllazëria Babilonase ka bërë çmos që ne të mos kishim dijeni për gjithë këtë, duke kontrolluar atë që mësohej nëpër shkolla dhe në universitete, institucione ku përhapet "shkenca" dhe po ashtu, në atë që mediat e quajnë të mundur e të besueshme në kundërshtimin e tyre arrogant dhe patetik ndaj gjithçkaje që i kundërvihet "normës".



Piktura [illegible] dhe hapësirës. Janë burgosur në nivelin e ulët të Përmasës së Katërt prej vetë sjelljes së tyre dhe, për sa kohë të mos hapin zemrat, nuk mund t'i shpëtojnë këtij burgu. Zvarranikët, më tepër se kushdo tjetër, kanë nevojë për dashuri.

Njerëzit e kalojnë kohën duke vështruar se çfarë shfaqet në një ekran kinemaje, duke kujtuar se po marrin pjesë në këtë realitet, ndërkohë që, në të vërtetë, natyra e botës mbetet e fshehur për ta. Gazetarët nuk tregojnë atë që ndodh në botë por atë që duhet shfaqur në

ekran. Unë e quaj kanalin CNN, "kanalin e trillimeve". Manipuluesit nxjerrin edhe një përfitim tjetër prej frikës. Sa herë që dikush ka frikë, ia beson pushtetin e vet dikujt tjetër që beson se mund ta mbrojë. Teknika që unë e quaj problemi-kundërveprimi-zgjidhja ka të bëjë me manipulimin e frikës. Pikërisht frika dhe një rrjedhojë e saj, mëria, i shtyn njerëzit të kërkojnë që "të bëhet diçka" pas luftërave dhe atentateve që, pastaj, u lejon njerëzve fasadë të Vëllazërisë të bëjnë diçka.

Ajo për të cilën po flasim këtu është kontrolli mendor dhe emotiv në masë. Nëse nisemi nga përkufizimi i kontrollit mendor si manipulim i mendjes së një njeriu në mënyrë që ai të mendojë dhe të veprojë siç duam ne, atëherë, sa njerëz, në planetin Tokë, nuk janë të kontrolluar mendërisht sot? Vdekja e presidentit Kenedi dhe princeshës Dajana kanë të bëjnë shumë me këtë çështje. Çfarëdo që të thonë njerëzit për karakterin e vërtetë të Xhon F. Kenedit, të gjithë kishin ndjesinë se ai përfaqësonte një farë shprese për të ardhmen. Nuk ka rëndësi se çfarë bënte ose cfarë nuk bënte. Njerëzit mendonin se ai bënte gjënë e duhur dhe kjo kishte rëndësi. Ashtu siç më kanë thënë shumë amerikanë gjatë viteve të fundit, në psikikën amerikane vdiq diçka kur u vra ai. Quajeni shpresë, pafajësi ose me një emër tjetër, si të doni ju. Diçka thellë në shpirtin e Amerikës vdiq bashkë me të. Ndjesia e përgjithshme ishte se të mirët vdesin qysh të rinj ndërsa e keqja duket se fiton gjithnjë. Kështu ndodhi edhe me Dajanën, gruan, pamja e së cilës u shoqërizua, në këtë rast me të drejtë, me shprehjen më të çiltër të dashurisë. Vala e emocioneve që shkaktoi vdekja e saj nuk kishte si objekt vetë atë si qenie njerëzore, por atë si simbol dashurie. Kjo dhimbje e papërmbajtur kolektive ishte, nëse konsiderohet përtej pamjes së jashtme, dhimbja për diçka që vdiq bashkë me të. Kishte vdekur dashuria. Kishte vdekur mirësia. Të mirët vdesin të rinj dhe e keqja gjithnjë fiton. Këta janë vetëm dy shembuj të përgjithshëm se si manipulohet psikika e masave deri në atë pikë saqë bëhet e pafuqishme dhe e dëshpëruar, nga mjekët e mendjes së Vëllazërisë që punojnë nëpër organizatat si ajo Tejvistok e Londrës. Njerëzit në gjendje frike, pafuqie dhe dëshpërimi izolohen krejtësisht dhe bëhen dele, tufa që çojnë një jetë të nënshtruar, siç duan të tjerët që të jenë.

Por manipulimi i mendjes dhe emocioneve njerëzore si dhe shkëputja nga oqeani i pafundmë shkon edhe më tej se kaq. Mbani mend se, ndërsa zvarranikët e nivelit të poshtëm të përmasës së katërt janë të bllokuar shpirtërisht dhe emocionalisht, paraqiten tepër të mprehtë mendërisht dhe zotërojnë një nivel më të lartë njohurish. Këto njohuri janë mbledhur brenda rrjetit të shoqërive të fshehta që nga lashtësia dhe, njëherësh, i janë hequr

publikut përmes shkatërrimit të kulturave indigjene, tmerreve të Inkuizicionit dhe djegies së bibliotekave të mëdha ezoterike siç ishte ajo e Aleksandrisë. Baraspeshë = harmoni. Prishje e baraspeshës = mungesë harmonie. Është e thjeshtë: për të krijuar një gjendje mungese harmonie duhet prishur baraspesha. Kjo doli në pah si roli thelbësor i teknikave të Vëllazërisë. Energjia e baraspeshuar femërore është energjia e intuitës dhe e lidhjes. Pikërisht prej këtej rrjedh dhe ideja e "intuitës femërore". Ka shumë të ngjarë që trupi femëror ta shfaqë dhe përhapë energjinë femërore. Ja pse shumica e orakujve, parashikuesve dhe manipuluesve, si në botën e lashtë ashtu dhe në tonën, kanë qenë dhe janë gra. Nuk është se rregulli nuk ka përjashtime. Edhe burrat kanë po aq mundësi të prekin polaritetin femëror të tyre dhe të ta përdorin këtë fuqi krijuese për t'u ngjitur në nivelet më të larta të intuitës. Por Vëllazëria nuk synon këtë lloj përqasjeje. Ajo kërkon që njerëzimi të mbetet brenda burgut të vetëdijes. Kështu që ka bërë të mundur ndrydhjen e përdorimit të energjisë femërore të baraspeshuar. Ka përdorur fenë për të skllavëruar burrat dhe gratë, duke i penguar të shprehin potencialin e tyre të plotë. Në të njëjtën kohë, ka shtypur përmasën femërore brenda meshkujve duke krijuar modelin e asaj se si duhet të jetë mashkulli – *maço* dhe agresiv – çka quhet një burrë "i vërtetë" (që, në të vërtetë, është vetëm një fëmijë i humbur dhe i trembur). Këta burra "të vërtetë" kanë qenë dhe janë privuar kaq shumë nga energjia femërore e tyre saqë intuita dhe aftësia për t'u lidhur me nivelet më të larta të "unit" të tyre gati janë shuar. Ndërsa anëtarët e Vëllazërisë i kanë përdorur frekuencat negative të energjisë femërore (Hekata) për t'u lidhur me zotërinjtë e tyre zvarranikë të nivelit të poshtëm të përmasës së katërt dhe për të manipuluar botën në mënyrë të fshehtë, nga pas kuintave. Shtypja dhe shtrembërimi i energjisë seksuale, forcës krijuese, është një mjet tjetër thelbësor për të kufizuar potencialin njerëzor dhe për t'i penguar që t'i shfaqin aftësitë krijuese dhe fuqinë vetëvendosëse.

E lidhur me manipulimin e energjisë femërore është edhe manipulimi i kohës. Ky është një aspekt tjetër i simbolizmit të tunelit Pon dë l'Alma. Vëllazëria ka sintonizuar vetëdijen njerëzore në një perspektivë të rreme kohore, duke e izoluar njerëzimin, në këtë mënyrë, nga pjesa tjetër e krijimit që vepron në një nivel tjetër kohor. Pra, njerëzimi nuk është më i sinkronizuar me pjesën tjetër të gjithësisë. Prandaj, nuk ka pse na habit fakti që mungesa e baraspeshës është kaq e përhapur. Në të vërtetë, koha nuk ekziston. Thjesht, gjithçka ndodh ndërsa e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja ekzistojnë njëherësh. Vetëm perceptimi ynë mbi kohën bën që të na duket sikur ngjarjet ndodhin në një kohë lineare. Por edhe në kohën lineare, nuk jemi më të

sintonizuar me rrjedhën e natyrshme. Natyra është sintonizuar me kohën hënore, 13 cikle me nga 28 ditë. Cikli menstrual i femrave është sintonizuar me atë të Hënës dhe, jo rastësisht, Hëna pasqyron drejt Tokës energjinë mashkullore të Diellit në formë femërore. Satanistët i kryejnë ritet dhe flijimet e tyre çdo muaj kur hëna është e plotë, kur energjia femërore është në kulmin e fuqisë së saj. E thithin këtë energji dhe shfaqin polaritetin negativ të saj: Hekatën. Sa më e madhe të jetë energjia negative femërore (intuitive) që mund të marrin, aq më e fuqishme është lidhja me "demonët" e përmasave të tjera me të cilët përpiqen të komunikojnë. Ja përse programojnë mediume të ndjeshme si Arizona Uilder që t'i përdorin më pas për ritet e tyre. Popullatat indigjene të botës, të cilat e matin kohën sipas fazave të hënës, janë më të sintonizuar me natyrën sepse veprojnë në të njëjtin fluks energjetik kohor si dhe vetë natyra. Ato janë në harmoni me natyrën. Në vitin 1572, papa Gregori lajmëroi futjen në përdorim të kalendarit të ri, kalendarit gregorian, që hyri në fuqi në vitin 1582. Bëhet fjalë për mashtrimin tjetër të Vëllazërisë. Kalendari gregorian u shndërrua në një mjet të zakonshëm të matjes së kohës. Kjo do të thotë se mendja njerëzore është sintonizuar me një rrjedhë "kohore" të sajuar sa herë që sheh sahatin ose kalendarin për të planifikuar një veprim. Po ku ndodhet qendra e këtij sistemi kohor, pika zero prej ku sintonizojnë gjithë njerëzit e botës sahatet e tyre? Ndodhet në Grinuiç, në Londër, nga ana tjetër e lumit Tamiz, përballë qendrës financiare të qytetit, bërthamës operative të Vëllazërisë! Nga se u frymëzua kalendari gregorian? Nga kalendari i... Babilonisë. Emri i vjetër grek i Rojave ose i bijve të zotave që u bashkuan me vajzat e njerëzve është Grigorë[2]. Bëhet fjalë, pra, për kalendarin e Gregorëve, të zvarranikëve.

Priftërinjtë zvarranikë të Vëllazërisë që banonin në Babiloni, mijëra vjet më parë, bënë të njëjtën gjë me kohën. Kalendari gregorian është farsë. Është diçka e ngjashme, vetëm se në nivelin kohor, me atë dollapin ku hedh të gjitha rrobat dhe pastaj i ngjishesh pas derës që të mos e lësh të hapet. Rrobat janë brenda dollapit, po ç'rrëmujë që është bërë! Kemi një vit të përbërë nga 12 muaj, një ditë me 24 orë, një orë me 60 minuta dhe mbizotëron një rrëmujë e tillë saqë disa muaj kanë 30 ditë, të tjerë 31 dhe një tjetër 28 ose 29 çdo katër vjet. Kështu u vjen për shtat. Arsyeja pas kësaj nuk është matja më e saktë e kohës. Ideja është që të largohej vetëdija njerëzore nga matja hënore e kohës, kështu që kalendari gregorian e hoqi hënën e trembëdhjetë. Duhet të ishin 13 muaj hënorë me nga 28 ditë por, në vend të kësaj, u gjendëm me 12 muaj dhe 12 cikle hënore. Hierarkia e Vëllazërisë vazhdon ende të përdorë kalendarë sipas kohës hënore – dhe kjo është një arsye tjetër e tërheqjes së

tyre pas numrit 13.

Përplasja e makinës së Dajanës (perëndeshës së Hënës) me shtyllën e 13-të qe një kujtesë simbolike për heqjen e hënës së trembëdhjetë nga perceptimi njerëzor i kohës. Dhe, kur njerëzit largohen nga rrjedha natyrore e kohës, kjo i largon ata nga gjithçka tjetër që vepron brenda kësaj rrjedhe kohore. Kështu, "qytetërimi" perëndimor (dhe gjithnjë e më global) i ka humbur lidhjet me botën natyrore dhe nuk është më në sintoni me mjedisin rrethues.

Mijëvjeçari është një pikë mjaft domethënëse në matjen e kohës. Mijëvjeçari përputhet me vitin 2000 vetëm në bazë të kalendarit gregorian por, nga çasti kur psikika njerëzore sintonizohet me këtë matje të kohës, Vëllazëria planifikon të manipulojë kohën përtej mijëvjeçarit. Sa më tepër afrohej kufiri i mijëvjeçarit, në bregun tjetër të Tamizit po ngrihej ndërtesa më e lartë e botës pranë Observatorit londinez të Grinuiçit, pikës zero të së ashtuquajturës Ora e Meridianit të Grinuiçit. Kjo ndërtesë e quajtur Kanari Uorf, u ngrit nga një konsorcium shoqërish të Vëllazërisë. I ngjan një obelisku të stërmadh qelqi. Si rrjedhim, qeveria britanike vendosi të shpenzonte gati një miliard, po, një miliard, stërlina për ndërtimin e një kupole të madhe, Milenium Dom, ku do të zhvilloheshin festimet kryesore për ardhjen e mijëvjeçarit të ri. Kjo kupolë ndodhet pranë Tamizit ndërsa, nga ana tjetër, pranë meridianit zero, ngrihet obelisku Kanari Uorf (shih pjesën me ilustrime). Obelisku dhe kupola janë, që të dyja, simbole të rëndësishme gjeometrike të Vëllazërisë, të cilat thithin energji diellore dhe kozmike. Përgjegjësi i projektit Milenium Dom ishte Piter Mandelsoni, njeriu i njohur me emrin "Princi i Errësirës" i cili u detyrua të jepte dorëheqjen pas disa zbulimeve të bujshme mbi trashëgiminë e tij financiare. Mandelsoni qe ushtar i Partisë Laburiste, kur përshtati si shenjë të vetën simbolin e trëndafilit të kuq.

Jam i sigurt se, në njërën mënyrë apo në tjetrën, Vëllazëria ka ndërmend të manipulojë kohën në nivelin zero të Grinuiçit për ta çorientuar edhe më tepër vetëdijen njerëzore dhe për të nxitur prishjen e baraspeshës dhe konfliktet. Simboli i Milenium Dom është një grua e zhveshur, me këmbë të gjata, e cila zgjatet drejt Diellit në çastin kur dielli lind në meridianin e Grinuiçit. Është pagëzuar me emrin "Britania e Re" dhe thuhet se përfaqëson "ikonat femërore nga prehistoria deri në ditët tona". Ikonat ose ikona që, mes shumë emrave të tjerë, përshkruhet edhe si mbretëresha Semiramidë? Artistit që realizoi këtë vepër iu dhanë 90.000 stërlina, burimi i të cilave ishte lotaria kombëtare. Loja me kohën përfaqëson për Vëllazërinë një armë themelore kundër vetëdijes njerëzore. Jam i sigurt se, në fillim, kanë ekzistuar edhe 13 shenja astrologjie dhe se e trembëdhjeta përfaqësohej nga merimanga.

Kjo shenjë, besoj, qe e tillë që t'i përfshinte gjithë të tjerat, duke forcuar energjinë e secilës dhe mendoj se ajo gjendej në qendër të rrethit astrologjik. Është interesant fakti se në Pyllin Bohem përdoret si moto kjo thënie e nxjerrë nga Shekspiri (nga Frensis Bejkëni): "Merimangat që thurin rrjeta nuk vijnë këtu".

Gjithçka është vetëdije në forma të ndryshme dhe ne ndërveprojmë me fusha të tjera energjetike që vibrojnë në çdo çast të jetës. E kuptojmë shpesh këtë, në rastet kur takojmë dikë dhe perceptojmë "vibrimet" e tij ose kur hyjmë në ndonjë shtëpi dhe ndjehemi ose në siklet ose rehat si në shtëpinë tonë. Ajo që ndjejmë është energjia e një njeriu ose vendi. Meqë jetojmë brenda fushave energjetike të Tokës, ndikohemi vazhdimisht nga gjendja e tyre vibruese. Vëllazëria e zvarranikëve është e vetëdijshme për këtë dhe kjo është edhe një arsye më tepër e simboleve dhe riteve pas të cilave janë aq të dhënë anëtarët e saj. Gjithçka është sintonizuar në një frekuencë të caktuar dhe simbolet janë shembulli i qartë i kësaj. Simboli është përfaqësimi fizik i një mendimi. Ajo që përfaqëson simboli përkon me energjinë që çliron ai. Obelisku simbolizon energjinë seksuale mashkullore, penisin, energjinë që lind dhe tërheq. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për pishtarin e ndezur apo diçka të ngjashme. Nëse këto simbole vendosen brenda shtjellave të fuqishme dhe pikave kyçe të rrjetës magnetike tokësore, me vibrimet e tyre ndikojnë mbi fushën energjetike globale në mënyrë edhe më të fortë. E njëjta gjë ndodh në rastin e formave gjeometrike të qytetit dhe formave gjeometrike të disa ndërtesave. Vrasja e presidentit Kenedi brenda një shtjelle të tillë të fuqishme energjie siç është Dilej Plaza dhe energjia e mendimit njerëzor, e përbërë nga tmerri, dhimbja dhe frika që u përqendruan aty, ka një efekt jashtëzakonisht të madh mbi rezonancën vibruese të energjisë tokësore. E njëjta gjë, por në shkallë më të madhe, vlen edhe për vrasjen e Dajanës dhe për vendin, të mbushur me energji hënore, ku ndodhi ajo, në Paris. Bëhet fjalë për një pjesë të përmbushur të magjepsjes së zvarranikëve mbi mendjen dhe emocionet njerëzore me qëllim largimin tonë nga fuqia jonë e vërtetë dhe e pamundur. Sa më negative të jenë emocionet që na shtyjnë të provojmë ngjarje të tilla dhe të tjera si këto, aq më tepër frikë do të gjenerojnë brenda fushave tokësore dhe spiralja do të rrëshqasë gjithnjë drejt thellësisë.

Këtu kemi mbërritur në një pikë tepër të rëndësishme për të shtjelluar një argument tjetër. Studimet kanë treguar se ekziston një impuls, një sinjal elektrik, që lind nga qendra e galaktikës së Udhës së Qumështit dhe ecën drejt Diellit (dhe diejve të tjerë) e drejt Tokës. Ky impuls kapet nga zemra e njeriut, transmetohet në tru ku degëzohet dhe shpërndahet pastaj nëpër të

gjitha qelizat e trupit. Kur ky impuls, kjo rezonancë, transmetohet përmes një sekuence të paprekur dhe të pandryshuar, qenia njerëzore bëhet njësh me hapësirën. Çdo qelizë lidhet dhe është në harmoni me impulsin kozmik. Ndërsa emocionet me vibrime të ulëta dhe prishja e baraspeshës e trazojnë atë, ndërpresin qarkun dhe, rrjedhimisht, lidhjen tonë me Tokën dhe me Gjithësinë. Lidhja mes zemrës dhe trurit, në shumicën e njerëzve, është e ndërprerë si pasojë e ndarjes së kokës nga zemra, të intelektit nga intuita, të fizikes nga shpirtërorja. Arsyeja që Vëllazëria e zvarranikëve po e çon përpara Urdhërin e Ditës me kaq shpejtësi është ngaqë ajo e di që ka në duar një sfidë të jashtëzakonshme. Krijimi udhëhiqet nga cikle energjie. Këto cikle i shohim edhe në nivelin e stinëve: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri. Por ekzistojnë edhe cikle shumë më të mëdhenj, të cilët janë shprehur përmes numrave dhe simboleve nga popujt e lashtë si sumerët, egjiptianët, kinezët, majat e Amerikës Qendrore dhe popujt indigjenë të Amerikës si fisi Hopi i Arizonës. Këta popuj kanë matur ciklet e energjisë hënore, diellore dhe të natyrave të tjera kozmike të cilat ndikojnë mbi fushat energjetike të Tokës duke shndërruar kështu planetin tonë. Sot gjendemi në mes të atij që ndoshta është cikli më i madh i shndërrimit, një nga ata që, sipas vlerësimeve, ndodhin njëherë në 26000 vjet. Kalendari i majave parashikon se pika kritike do të jetë 12 dhjetori 2012. Kjo është pika e vërtetë thelbësore e shndërrimit dhe jo mijëvjeçari i krijuar me sajesa. Këto cikle vetëdijeje janë si porta ose hyrje që hapen për ata që janë gati të kalojnë në nivele më të larta vetëdijeje. E përfytyroj këtë proces si një lloj sahati me zog ku, në çastet e duhura (cikle) porta hapet. Po e humbe mundësinë ta përdorësh këtë portë, cikli fillon nga fillimi derisa të hapet porta e radhës. Por ky para të cilit ndodhemi sot i ngjason jo më shumë një porte por një mali me mundësi porsa i përket shndërrimit global i cili do të sfidojë të gjitha besimet e deritanishme. Tekstet e shkollave fetare dhe okulte e kanë përshkruar haptas ose simbolikisht prej mijëra vjetësh. Tani zotërojmë edhe prova fizike, shpirtërore dhe, përherë e më tepër, edhe shkencore, të cilat na konfirmojnë mbërritjen e afërt të të ashtuquajturës "Kthesa e Madhe e Kohëve".

Një sërë ngjarjesh, që i ka përshkruar Greg Brejdëni në *"Zgjimi në pikën zero"*, na konfirmojnë se kohët po ndryshojnë. Në 1991, u kap një frekuencë e re që vinte nga qendra e spirales së Udhës së Qumështit, ndërsa në vitin 1994 u dërgua në hapësirë sonda *"Odiseja"* për të studiuar ndryshimet e Diellit. Duke nisur nga mesi i viteve 1980, është vënë re një rritje e stuhive diellore dhe bombardimeve me rreze X ndërsa sonda ka zbuluar se fusha magnetike e Diellit po e zvogëlonte me shpejtësi intensitetin. Vlerat e

regjistruara në pole dhe në ekuator ishin shumë më të vogla se parashikimet. Ndërkaq, ndërsa Dielli po ftohet, planetët e sistemit diellor, sidomos ata të jashtmit, po ngrohen. Kjo do të thotë se burimi i ngrohtësisë së planetëve ndodhet brenda tyre dhe mund të jetë nxitur nga ndryshimet magnetike dhe elektrike të Diellit. Ndërsa në Diell ndodhnin këto ndryshime, në një stuhi që kishte shpërthyer në Jupiter, të dokumentuar për herë të parë nga kinezët 3000 vjet të shkuara, u vunë re ndryshime të papritura. Një shtjellë e madhe brenda stuhisë së Jupiterit nisi të rrotullohej në drejtimin e kundërt. Valët goditëse dhe dukuri të tjera të shkaktuara nga përplasja e kometës Shomejkër-Levi me Jupiterin në vitin 1994 ushtruan ndikime të tjera mbi sistemin diellor, përfshirë dhe Tokën. Ajo që u duk qartë ishte se ndryshimet e fushës magnetike diellore u pasqyruan deri këtu.

Toka është një magnet gjigand me nivele të ndryshme që rrotullohen për të krijuar fushën magnetike. Sa me shpejt të rrotullohet Toka, aq më e fortë dhe e dendur bëhet fusha magnetike. Para 2000 vjetësh, kjo fushë magnetike arriti kulmin e intensitetit të këtij cikli dhe, që atëherë, ky intensitet po zvogëlohet sa më tepër e zvogëlon planeti shpejtësinë e rrotullimit. Fusha tani është 50 % më e dobët se para 1500 vjetësh dhe shpejtësia e dobësimit po vjen duke u rritur. Nuk duhet të na zërë paniku sepse gjithçka është pjesë e një cikli natyror, një variant shumë më i gjatë dhe më i fuqishëm se ndërrimi i stinëve. Krahas kësaj dukurie, vjen edhe lajmi se frekuenca zanore e Tokës, e thënë ndryshe rrahja e zemrës së saj, po rritet me shpejtësi. Kjo frekuencë, që quhet Frekuenca zanore bazë ose Rezonanca e gropës Shuman, u zbulua më 1899. Nga ky vit e deri në mes të viteve 1980, ajo ruante një impuls të pandryshueshëm prej 7.8 herc ose 7 cikle në sekondë. Duke nisur nga viti 1986-87, shpejtësia e këtij impulsi nisi të rritej. Në fund të vitit 1995, ishte 8.6. ndërsa të dhënat e fundit tregojnë se e ka kaluar vlerën 10 dhe vazhdon të rritet. Greg Brejdëni beson se në vitin kur majat thoshin se do të ndodhë shndërrimi, 2012-ën, rezonanca tokësore mund të jetë rreth 13 cikle në sekondë ndërsa fusha e saj magnetike do t'i afrohet vlerës zero. Ai thotë se Pika Zero do të jetë kur fusha magnetike tokësore thuajse të jetë zhdukur sepse planeti do të ndalojë rrotullimin. Kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë më forcë rëndese, sepse ajo përcaktohet nga dukuri të tjera dhe jo nga rrotullimi i planetit. Kjo mund të ketë ndodhur të paktën 14 herë në 4.5 milionë vitet e fundit. Është llogaritur se hera e fundit ka qenë 11-13000 vjet të shkuara, koha në të cilën besohet se u zhduk Atlantida dhe nisi ristrukturimi i Tokës pas katastrofës së tmerrshme që ndodhi rreth vitit 10500 p.e.s. Para 13000 vjetësh ndodheshim në mes të Ciklit të Madh prej 26000

vjetësh që tani po i afrohet fundit dhe që do të mbyllet me një ndryshim të madh. Nuk po them se toka do të ndalojë rrotullimin, por as e hedh poshtë këtë mundësi.

Megjithatë, edhe më vonë është verifikuar një zhvendosje e polit magnetik, 3500-3600 vjet më parë, siç del nga shqyrtimi i akujve të Groenlandës dhe të rajoneve polare. Sa herë që Toka ka përjetuar uljen e shpejtë të intensitetit të fushës magnetike që kemi sot, kjo ka sjellë zhvendosjen e poleve, ku veriu dhe jugu magnetik kanë ndërruar vendet. Sipas Brejdënit, Toka do të ndalojë rrotullimin për disa ditë para se të nisë të rrotullohet në drejtim të kundërt. E njëjta gjë vërehet kur ndërron kahu i një rryme elektrike që përshkon një shufër hekuri, e cila shkëmben edhe polet. Kur planeti të rrotullohet në kah të kundërt, do të ndryshojë dhe drejtimi i rrjedhjes së elektricitetit, rrjedhimisht edhe polet. Nëse planeti do të ndalojë rrotullimin, Toka do ta ketë njërën faqe të ndriçuar për njëfarë kohe dhe tjetrën të errët. Mijëra vjet më parë, njerëzit e lashtë e kanë përshkruar këtë. Peruanët kanë folur për një "natë të gjatë" që zgjati sa tre ditë me radhë, ndërsa në Bibël flitet për një ditë që zgjati 20 orë, dita më e gjatë. Fisi i indianëve Hopi tregon se dielli një ditë lindi dy herë. Në fillim lindi në perëndim dhe perëndoi në lindje. Pastaj lindi nga lindja dhe perëndoi nga perëndimi, sipas asaj që, prej asaj kohe, u kthye cikli normal. Ka edhe histori të tjera që thonë se dielli lindte nga perëndimi dhe perëndonte nga lindja, një dëshmi e faktit se Toka rrotullohej në kah të kundërt me sot. Në fillim të viteve 1990, kur unë po zbuloja këto gjëra, mora disa informacione nga ana e një të interesuari që më thoshte: "Bota po ndryshon, veriu do të shkëmbehet me jugun dhe lindja me perëndimin. Kështu është rregulluar që nga fillimi i kohërave"[3]. Duket si tezë e drejtë. Edhe Brajan Desborafi, shkencëtar dhe studiues nga Kalifornia më ka folur për disa ngjarje të mëdha gjeofizike, të cilat kalohen krejtësisht në heshtje nga mediat. Ai pohon faktin se fusha gjeomagnetike e tokës po dobësohet sipas një shkalle eksponenciale dhe, së shpejti, do të bëhet zero. Njësoj si unë, ai beson se, së shpejti, do të përjetojmë shndërrime epokale gjeologjike. Shërbimi gjeologjik amerikan thotë se fusha magnetike e Tokës bëhet zero çdo 500 000 vjet, pastaj rishfaqet përsëri dhe këto janë periudhat në të cilat verifikohen katastrofa tokësore, tërmete, dhe kur shpërthejnë vullkane për shkak të ndalesës së përkohshme të rrotullimit të tokës. Besoj se këto dukuri do të jenë të shpeshta. Sipas burimeve të Brajanit, fusha magnetike e Tokës tashmë është pranë zeros dhe duket se ka nisur shndërrimi masiv i hidrogjenit në helium. Ai thotë se stuhitë diellore çlirohen nga pjesët mbi dhe nën ekuatorin e Diellit, në një gjerësi 19,5 gradë. Kjo është pika ku ndodh

shkëmbimi i energjisë mes sferave rrotulluese dhe pikërisht në këtë gjerësi tokësore ndodhen edhe piramidat. Energjia e marrë nga Dielli në këto gjerësi do të jetë shumë e lartë.

Pamë lidhjet që ekzistojnë mes ndryshimeve të rezonancës së qendrës së galaktikës, ndryshimeve diellore dhe atyre tokësore. Prej këtu, kalohet më pas te zemra e njeriut, te truri dhe te çdo qelizë e organizmit. Sa më shumë që të hapet zemra, aq më i fuqishëm do të jetë ky fluks, aq më shpejt do të sikronizohemi me vibrimet dhe do të kalojmë në një gjendje më të lartë vetëdijeje. Nëse mbyllim zemrën dhe mendjen, do të pengojmë çdo formë ndryshimi dhe një sasi gjithnjë e më të madhe e energjisë sonë do të shpenzohet pikërisht për të luftuar këto energji që shndërrojnë jetën tonë, duke na çliruar. Përveç kësaj, trupi ynë do të qëndrojë jashtë çdo sintonizimi me energjitë që na rrethojnë dhe rrjedhojat mendore, shpirtërore dhe fizike, do të jenë të dukshme. Ose do të qëndrojmë në këmbë mes këtij lumi që rrjedh, duke u përpjekur t'i kundërvihemi rrymës, ose do ta lëmë veten, të shtrirë mbi një dyshek pluskues, të na marrë rryma. Varet nga ju që, çfarëdo gjëje të ndodhë, të jetoni përgjithmonë. Nëse e lëmë këtë dritë me frekuencë të lartë të bjerë mbi ne, trupat tanë do të mbrohen dhe ne nuk kemi për t'u plakur. Do të jetojmë në trupa fizikë për një periudhë të pacaktuar, nëse e dëshirojmë këtë, ndërsa fuqitë tona mendore dhe psikike nuk do të njohin më kufij. Pastaj, nëse është e vërtetë se po futemi në një Brez Fotonik, atëherë do të përjetojmë gjëra mahnitëse. Njerëzit e lashtë kishin dijeni për këto zhvillime të mëdha epokale dhe të gjithë kalendarët e egjiptianëve, majave, tibetianëve, kinezëve e të tjerëve përfundojnë në një periudhë që po merr fund, edhe për ne. Kalendari egjiptian nis qysh para 39000 vjetësh ndërsa ai i majave para afro 18000 vjetësh. Majat thoshin se ekziston një periudhë kalimtare nga bota e vjetër në botën e re, në kohën kur koha e re zëvendëson të vjetrën. Këtë periudhë ata e quanin "mungesa e kohës" dhe thoshin se do të fillonte në korrik 1982, ndërsa ndryshimi do të ndodhë në 12 dhjetor 2012. Efekti i gjithë kësaj mbi njerëzimit është i lehtë të shihet. Kam vizituar më tepër se 20 vende gjatë viteve të fundit dhe në të gjitha kam gjetur shenja rizgjimi. Ky proces ende nuk ka përfshirë shumicën e njerëzve, por numri po rritet dita-ditës, paralelisht me zgjimin shpirtëror të shumicës dhe daljen e tyre nga topitja. Vibrimi përherë e më i shpejtë i Tokës dhe i gjithë galaktikës të krijon ndjesinë se koha po kalon përherë e më shpejt. Bëhet fjalë për një iluzion sepse, në të vërtetë, koha nuk ekziston. Por ne e kemi këtë ndjesi sepse frekuenca po e shton përherë e më tepër shpejtësinë e vet. Më kujtohet se, nga fillimi i viteve 1990, mora një mesazh nga një medium që më thoshte

se po i afroheshim ditës kur koha do të merrte një shpejtësi të frikshme. Ky çast është pranë. Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, bëhet fjalë vetëm për një cikël natyror, por sfidat që do të na dalin përpara dhe mundësitë që do të na paraqiten do të jenë të panumërta.

Gjithësia, ashtu si bota fizike në tërësinë e saj, është veç një hologramë: breza drite që ndërthuren për të krijuar një formë, në dukje, tri përmasore. Pak a shumë si të hedhim gurë në një pellg e të vëzhgojmë valët që përplasen e ndërthuren duke formuar figura të ndryshme mbi sipërfaqe. Dy shkencëtarë amerikanë, Terrans dhe Denis MekKina, thonë se gjithësia është një hologramë 64 valësh ose shkallësh. Kjo është arsyeja pse ka edhe 64 hekzagrame te *I-Çingu*, 64 çelësa te Pema e Jetës dhe 64 kode të ADN-së. Analizat që kanë kryer ata me kompjuterë tregon se që të gjitha këto 64 valë do të shkrihen me njëra-tjetrën, duke kapur pikën më të lartë në vitin 2012. Ja përse, në këto pak vite që do të vijnë, do të ndodhin ndryshime të pabesueshme. MekKinat thonë se shpejtësia e ndryshimit dyfishohet brenda një intervali gjithnjë e më të vogël, duke u shfaqur në formën e hopeve apo kërcimeve në zhvillimin teknologjik të këtij shekulli. Duke vështruar më përpara në kohë, ata thonë se kjo do të ndodhë deri në vitin 2012 kur, brenda 384 ditësh, do të ndodhin më shumë ndryshime në vetëdijen tonë se në gjithë ciklet e mëparshme të marrë së bashku. Pas kësaj, do të vijojë një cikël prej gjashtë ditësh në të cilin ngjarjet do të zhvillohen me shpejtësi edhe më të madhe ndërsa në 135 minutat e fundit do të vërehen edhe 18 ndryshime të mëdha të vetëdijes njerëzore, të cilat do të kulmojnë në një pjesë të fundit të sekondës, të barabartë me 0,0075 sekonda, kur do të ndodhin 13 ndryshime. Nuk besoj se, kur të ndodhin këto gjëra, do të rrimë përpara televizorit dhe të shikojmë ndonjë emision të llojit "Po, çmimi është në rregull". "E di, zemër? Gjatë ndërprerjes së fundit publicitare, më duket se jeta imë pësoi një sërë ndryshimesh thelbësore. Do një filxhan çaj?"

Ndërsa shkruaj këto gjëra, cikli i rrezatimeve diellore po rritet me shpejtësi, ndërsa kulmi është periudha mes viteve 1999 dhe 2002 (shih **Figurën 61**). Ky nuk është shndërrimi, por është pjesë e ciklit që paraprin. Një burim të mirë informacionesh mbi këtë temë mund të gjeni në faqen e internetit *Solar Web Site*[4]. Është domethënës fakti se kulti diellor të cilin ndjekin njerëzit-zvarranikë parashikon një matje të kohës sipas së cilës vitit 2000 përfaqëson kulmin e rrezatimeve diellore brenda këtij cikli (të njohur si cikli 23). Ka shumë të ngjarë që këto stuhi diellore me energji të lartë të rritin shpeshtësinë e stuhive, ndryshimet meteorologjike, shfaqjet e agimeve polare në qiell dhe ndoshta do të shkaktojnë edhe ndërprerje të energjisë e defekte në satelitë. Bazat dhe

qytetet nëntokësore të ndërtuara nga Elita këtë shekull po përgatiten për ndryshime epokale që do të vërehen nga sot e deri në vitin 2012.

Viti	Jan.	Shk.	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tet.	Nënt.	Dhjet.
1997	019	022	027	030	034	040	044	050	054	060	066	071
1998	077	082*	088	093	099	103	109	113	119	123	128	131
1999	136	139	142	146	148	151	153	154	156	157	158	159
2000	**160**	**160**	**160**	**160**	**159**	**158**	**157**	**156**	**155**	**154**	**152**	**150**
2001	148	146	142	140	137	134	131	128	124	121	118	114
2002	111	107	103	100	097	093	089	086	082	079	076	072
2003	069	066	062	060	057	053	051	048	046	043	041	039
2004	036	034	032	030	028	027	024	023	021	020	109	017
2005	016	014	013	012	012	011	010	009	009	008	***	***

Figura 61. *Rritja e vrullshme e rrezatimit diellor që bombardon Tokën në vitet para dhe pas Mijëvjeçarit. Shifrat tregojnë rrezatimin më të lartë për çdo muaj.*

Sateliti *Telstar 401* u shkatërrua, me sa duket, nga një intensitet elektronesh më i lartë se normalja, por mjaft më i vogël se ato që do të ndodhin së shpejti. Në mars 1989, rrjeti elektrik i Kebekut, në Kanada, ra brenda dy minutash pas një stuhie diellore dhe, nga njëri çast në tjetrin, na presin stuhi edhe më të forta. Parashikohet se vitet kur këto stuhi gjeomagnetike do të kenë kulmin e tyre janë ata nga 1999 deri më 2002, por stuhi do të forta do të regjistrohen nga viti 1999 deri në 2005-ën ndërsa viti 2005 do të jetë dhe ai me numrin më të madh të stuhive të vogla, pikërisht gjatë kohës kur të jetë afër përmbylljes së tij cikli i 23-të diellor[5]. Mendohet se stuhitë më të mëdha diellore të këtij cikli diellor do të jenë 10000 herë më të fuqishme se ato që janë vëzhguar nga mesi i viteve 1990[6].

Vëllazëria zotëron një teknologji në gjendje të ndikojë mbi kushtet meteorologjike dhe me siguri që e përdor atë. Dukuritë që përshkrova në këtë pjesë janë arsyeja e vërtetë e ndryshimeve epokale që ndikojnë edhe mbi kushtet meteorologjike dhe të cilat po bëhen përherë e më të dukshme, nga muaji në muaj. Ende nuk kemi parë më të madhen. Siç jam shprehur një herë nga fillimi i viteve 1990, do të jemi dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha klimatike dhe të përmbysjeve gjeologjike, ndërsa Toka do të ristrukturohet duke u përgatitur për ndryshimin e madh, njësoj si dhe qeniet njerëzore. Ne dhe Toka duhet të sinkronizojmë vetëdijen dhe përmasën fizike me frekuenca përherë e më të shpejta që po përfshijnë planetin. Vëllazëria po përpiqet me

dëshpërim t'i fshehtë këto fakte duke ia veshur ndryshimet klimatike "efektit serrë" ose dukurisë "El Ninjo". Por ajo e di se, sapo njerëzit ta kuptojnë se arsyeja është krejt e ndryshme, kartat do të hapen dhe e vërteta do të dalë në dritë. Lëvizjen e Epokës së Re e krijoi vetë Vëllazëria me qëllim që të vononte sa më shumë rizgjimin tonë. Vetë emri Epoka e Re (angl. *New Age*) është huazuar nga një revistë e njohur masonike. Një skllave me mendje të kontrolluar nga qeveria amerikane, e cila më pas arriti të çlirohej nga programi, më tregoi se lëvizja Epoka e Re u themelua fshehur nga Henri Kisingeri dhe nga disa të tjerë në vitet 1970, kur ai ndodhej nën kontrollin e tyre. Sa herë që kam shtruar këtë pyetje, ithtarët e Epokës së Re e kanë hedhur poshtë duke thënë se Vëllazëria nuk do që populli të përqafojë një vizion të ri për jetën. Jo, nuk do ta donte nëse do të bëhej fjalë për një botë ideale, por kjo nuk është bota ideale për ta sepse ndryshimet energjetike po e zgjojnë popullin. Vëllazëria e dinte se kjo kohë do të vinte dhe se cilat do të ishin pasojat. Anëtarët e saj nuk mund t'i hipin ndonjë anijeje hapësinore e të shkojnë të ndryshojnë Diellin ose të shkojnë në qendër të galaktikës për të ndryshuar vibrimin e ri. Alternativa e tyre e vetme ishte shtypja e vetëdijes që po zgjohej dhe futja e saj në një rrugë pa krye, në një fe tjetër të përbërë nga rregulla dhe receta, të cilat nuk do të përbënin asnjë rrezik për Urdhëri e Ditës së Vëllazërisë. E gjitha kjo u bë falë lëvizjes Epoka e Re. Shumë nga anëtarët e saj janë njerëz të zgjuar e të bindur se po bëjnë një punë të mirë, por shumica nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh sot në botë. Ata përdoren nga organizata të tjera bija të Vëllazërisë dhe përpunohen nga frekuenca psikike dhe komunikime të nisura nga niveli i ulët i përmasës së katërt. Ulen rrotull qirinjve ose presin "komandën Ashtar" të vijë e t'i marrë me ndonjë anije hapësinore. Ashtari është shpikje e Vëllazërisë, fryt i një loje fjalësh të emrave të perëndive të lashta Ashterot dhe Ishtar, një emër tjetër ky i mbretëreshës Semiramidë. Shumica e anëtarëve të Epokës së Re nuk pranojnë të flasin për manipulimin e Vëllazërisë sepse "kjo është diçka shumë negative". Po, kështu është dhe e tillë do të mbetet deri sa të mos bëhemi të vetëdijshëm dhe të përpiqemi të realizojmë diçka të re. T'ia mbathim ose të fluturojmë nuk përbën ndonjë ndryshim të madh. Pjesa më e madhe e Epokës së Re nuk ka të bëjë me shpirtin për sa i përket ndryshimit, por me shpirtin si shmangie nga realiteti. Ajo e ndrydh dhe e vonon zgjimin, nuk e ndihmon atë.

Është e qartë se po bëhemi gati të mësojmë disa të reja për zvarranikët, sepse energjitë e ngarkuara me frekuenca të larta po e shtojnë në mënyrë dramatike numrin e njerëzve që mund t'i dallojnë zvarranikët e nivelit të poshtëm të përmasës së katërt. Arizona Uilderi më ka thënë se numri i

ritualeve flijuese do të rritet së tepërmi duke nisur nga vitet 1980, sepse zvarranikët kanë nevojë për gjithnjë e më tepër gjak njerëzor dhe energji për të ruajtur pamjen e tyre të jashtme prej njeriu. Kanë gjithashtu nevojë të funksionojë ngado kontrolli përmes mikroçipeve, para se të zbulojnë identitetin e tyre të vërtetë prej zvarranikësh, sa më tepër që përparojnë ndryshimet vibruese. Këto ndryshime po ua heqin zvarranikëve mbulimin e tyre vibrues duke shfaqur identitetin e vërtetë të tyre. Për këtë ngjarje po përgatitet edhe një seri e gjatë filmash dhe programesh televizive për të rritur dhe fëmijë mbi zvarranikët humanoidë, të mirë apo të këqij. Ju kam folur tashmë për dy prej tyre "*Mbërritja*" dhe "*Beteja e fundit*", por mund të citojmë dhe shumë të tjera. Në filmin "*Stargejt*" që flet për historinë e një udhëtimi në kohë drejt Egjiptit të lashtë që kontrollohej nga jashtëtokësorët, natyra e mundshme zvarranike e "alienit" tregohet kur, në fund, atij i hiqet lëkura. Edhe filmi "*Stargejt: SG1*" trajton temën e zvarranikëve me pamje njerëzore. Filmat "*Armiku im*" dhe "*Arratisje në ëndërr*" në të cilët është protagonist Denis Skuejd, flasin për humanoidë zvarranikë, ndërsa filmi "*Teodor Reks*" flet për një dinosaur më të gjatë se dy metra që ecën mbi dy këmbë. Seria televizive "*Babilon 5*" flet për humanoidë zvarranikë me emrin Narns. Të njëjtën temë e ndeshim edhe te filmat "*Star Trek*", "*Brezi tjetër*", "*Pjesë e hapsirës*", "*Kërkimi në det DSV*", "*Kufijtë e jashtëm*", e të tjerë. Edhe filmat "*Jurasik park*" dhe "*Bota e humbur*" të Stivën Shpilbergut sjellin në jetë dinosaurët, ndërsa një film i animuar për fëmijë me titull "*Ne u kthyem*" ka si protagonistë dinosaurë me dy këmbë që flasin. Në një skenë, një Tiranosaurus Reks hipet në një anije hapësinore, pajiset me inteligjencë dhe dërgohet përpara në kohë, deri në ditët e sotme. Filmat dhe seritë televizive për fëmijë gëlojnë nga personazhet zvarranike. "*Vëllezërit e Marios*" mbështetet mbi idenë se dinosaurët nuk u zhdukën nga meteorët: përplasja krijoi një përmasë paralele ku donosaurët vazhduan të jetonin dhe të shumoheshin duke u evoluar në humanoidë inteligjentë. Protagonistët e filmit futen në një kalin nëntokësor nga i cili arrijnë në përmasën tjetër dhe luftojnë me dinosaurët humanoidë për të kundërshtuar pushtimin e kësaj përmase prej tyre. "*Dinotopia*" dhe "*Dinotopia: Bota e nëndheshme*" dy libra për fëmijë të shkruar nga Xhejms Garnej tregojnë për një botë nëntokësore ku zvarranikë dhe dinosaurë inteligjentë jetojnë në thellësi të tokës bashkë me qeniet njerëzore. Në filmin "*Toka e të humburve*" një familje udhëton prapa në kohë derisa mbërrin në tokën e sunduar nga dinosaurët ku sulmohet nga disa humanoidë zvarranikë të quajtur Slistakë. Në një episod, një zvarranik humanoid studion qeniet njerëzore që rrezatojnë "ngrohtësi emocionale"- energjia emocionale

LIBRI24

njerëzore me të cilën ushqehen zvarranikët. Seria për fëmijë *"Barni"* flet për një zvarranik të mirë, ndërsa *"Breshkat mutande ninxha"* janë zvarranikë amfibë që luftojnë krimin dhe padrejtësinë. Në fillim të viteve 1990, *"Dinosaurët"* qe një program televiziv për një familje të mrekullueshme dinosaurësh që mbante mbiemrin interesant Sinkler! Madje njëri prej tyre quhej Erl! Edhe filma vizatimorë si *"Disqet fluturues Dino"*, *"Lidhja e mutantëve"*, *"G. I. Xho"* dhe *"Shtëpia Dino"* flasin për qenie zvarranike me inteligjencë[7]. Rastësi? Sigurisht që jo.

Prej shumë kohësh, Vëllazëria e zvarranikëve kërkon të pengojë njerëzimin që ky të përmbushë ndryshimet e vetëdijes. Natyra hierarkike piramidale e kësaj strukture u ka lejuar ta përhapin planin e tyre mes një morie institucionesh dhe agjencish. Në fillim na sulmuan në nivelin fizik me ilaçe, shtojca ushqimore dhe fluor në ujë. Metodat e lashta të kurimit (që sot njihen me emrin mjekësi alternative ose plotësuese) u akuzuan nga mjekët e shumtë që gëlojnë brenda masonëve dhe kontrollohen nga kartelet farmaceutikë të Vëllazërisë. Vetëm perandoria e Rokfelerëve zotëron aktualisht më shumë se 60% të industrive farmaceutike në Shtetet e Bashkuara. Këto, së bashku me degë të tjera të kartelit farmaceutik, financojnë "kërkimet" e kurave të reja dhe, natyrisht, këto "kura" janë gjithnjë farmakologjike. Ekziston një libër i shkëlqyer që hedh dritë mbi këtë dukuri. Titullohet *"Mafia mjekësore"*, është shkruar nga një mjek kanadez, Gilen Langto, dhe është botuar nga shtëpia botuese "Brixh of Lov". Karteli farmaceutik është i lidhur me kompanitë më të mëdha "ushqimore" si *Nestle, Kelog, Prokter en Gembëll*, e të tjera. Përmes këtij rrjeti, Vëllazëria mund të orkestrojë një sulm të përqendruar mbi trupin njerëzor dhe proceseve të tij mendore nëpërmjet ilaçeve, vaksinave dhe shtojcave ushqimore. Në këtë proces hyjnë edhe kafshët dhe ushqimet gjenetikisht të modifikuara. Kur një nga shkencëtarët e përfshirë në zhvillimin e ushqimeve gjenetikisht të modifikuara ngriti publikisht dyshime rreth sigurisë së tyre, u pushua menjëherë nga puna. Kjo ndodh kur jeton në një vend që dhunon lirinë e shprehjes! Fluori i hedhur në ujë shërben si qetësues i mendjes, po ashtu edhe disa ëmbëlsues si aspartami, i cili gjendet sot thuajse në të gjitha pijet. Këto lëndë shtohen me qëllim që të vështirësojnë aftësinë e trurit dhe të qelizave për t'u sinkronizuar me frekuencat e reja. Kush punon në fabrikat ushqimore nuk e ka idenë për atë që po bën sepse mjaftohet me ndjekjen e urdhrave. Vendimet merren shumë më lart. E njëjta gjë ndodh dhe me vaksinat, një nga mashtrimet më të mëdha të sektorit mjekësor. Mjekët (pjesa më e madhe e tyre) dhe personeli ndihmës i tyre as që e kanë idenë për dëmet që i shkaktohet trupit dhe mendjes së një fëmije

kur atij i bëhen vaksina. Por ata që orkestrojnë programet e vaksinimeve janë plotësisht në dijeni të kësaj. Vëllazëria ka krijuar dhe një rrjet teknologjik të ndërlikuar për të kapur vetëdijen kolektive njerëzore dhe për ta larguar atë nga "uni" shumëpërmasor. Gjithçka nis nga hapësira falë një teknologjie të "Luftës së Yjeve", brenda rrjetit elektromagnetik që rrethon Tokën. Ky aparat teknologjik përfshin transmetuesit me frekuencë jashtëzakonisht të ulët (ELF) që përhapin sinjale në të gjithë botën, transmetimet me mikrovalë që përdoren si sulme të drejtpërdrejta ndaj atyre që Vëllazëria synon t'i eliminojë ose t'i nxjerrë jashtë loje nëpërmjet manipulimit mendor, rrjetet e telefonisë celulare që i shkaktojnë një dëm të madh trupit dhe mendjes dhe lejojnë të gjendet zotëruesi i telefonit edhe kur ai e ka fikur aparatin, emisionet televizive, furrat me mikrovalë dhe aparatura të tjera dhe, natyrisht, mikroçipet. Arsyeja kryesore e fushatës në mbështetje të pajisjes së popullatës me mikroçipe ka si qëllim të mos na lejojë të hapim sytë dhe të largohemi nga impulset që mund të na çlirojnë. Një shkencëtar i CIA-s më ka thënë se vendosja e mikroçipeve popullatës do t'i lejojë Vëllazërisë të ketë kontroll të plotë mbi mendimet, emocionet dhe shëndetin e njeriut.

Një burim që punon në botën financiare dhe ka pasur përvoja të drejtpërdrejta mbi ekzistencën e zvarranikëve, më ka dhënë disa informacione interesante mbi sistemet moderne energjetike. Ai kishte punuar me disa shpikës të energjisë së lirë dhe kishte mësuar se teknologjia e bazuar në energjinë e lirë funksiononte sipas "kahut orar" dhe qe në harmoni me rrotullimin e *çakrave*. Por pjesa më e madhe e formave të energjisë konvencionale funksionojnë në "kahun kundërorar", në kah të kundër me *çakrat*. Sipas tij, e gjitha kjo synonte mbylljen e sistemit të *çakrave* dhe largimin e njerëzimit nga nivelet më të larta të vetëdijes. Kjo është një arsye për të cilën Vëllazëria zvarranike e ka shtypur, shpeshherë edhe përmes dhunës, zhvillimin e atij sektori të mbështetur mbi energjinë e lirë. Rrjeti elektrik i zakonshëm i shtëpive tona punon me 60 cikle në sekondë (60 herc), çka dëmton fizikun dhe veprimtarinë trunore të emetimit të valëve. Brajan Desborafi më ka thënë se shumë njerëz që e kanë shtratin e gjumit pranë murit ku kalojnë fije elektrike ankohen për probleme në shpinë e trazime të tjera. Shqetësimet shpesh zhduken nëse shtrati largohet rreth një metër nga muri. Jetojmë brenda një oqeani që gëlon nga valët elektromagnetike të çliruar nga teknologjia "moderne" dhe kjo e kushtëzon së tepërmi shëndetin tonë mendor, emocional dhe trupor. Mendja, trupi dhe emocionet e njeriut ndodhen nën një sulm të përhershëm në këtë numërim mbrapsht që na ndajnë nga Ndryshimi i Madh, sepse Vëllazëria kërkon me dëshpërim që njerëzimi,

si një i tërë, të mos e kryejë këtë kërcim që do ta çonte drejt vetëdijes së përtej frekuencave zvarranike.

Vëllazëria ka strukturuar edhe sistemin "shkollor" dhe mediat, në mënyrë që t'i burgosë njerëzit në atë që unë e quaj me fjalët "burgu i trurit të majtë". Pjesa e majtë e trurit është zona që merret me vizionin material të botës, me mendimin "racional" dhe me gjithçka që mund të shihet, preket, dëgjohet dhe nuhatet (shih **Figurën 62**). Pjesa e djathtë e trurit rregullon intuitën dhe lidhet me përmasa më të larta. Pikërisht këtu ndodhet delli artistik dhe krijues që frymëzohet nga karakteri unik i mendimit dhe shprehjes sonë.




Figura 62. Sistemi i Vëllazërisë kërkon të burgosë psikikën njerëzore në pjesën e majtë të trurit, intelektin "racional" që beson vetëm te ajo që sheh, prek, dëgjon ose nuhat. Sistemi shkollor dhe mediat janë ndërtuar në mënyrë të tillë që sigurojnë pikërisht këtë dhe pjesa më e madhe e mësuesve, profesorëve, shkencëtarëve dhe gazetarëve janë edhe vetë të burgosur të pjesës së majtë të trurit.




Figura 63. Kur hapim zemrat dhe mendjet, vëmë në veprim pjesën e djathtë të trurit, intuitën dhe frymëzimin që ka lidhje me hapësirën.

Sistemi shkollor dhe përhapja e tij, bashkë me mediat dhe shkencën, synojnë pjesën e majtë të trurit dhe kërkojnë shtypjen e së djathtës. Ja përse, në të gjithë botën, janë ndërprerë fondet kushtuar mësimit të arteve dhe janë vendosur programe të rrepta në përputhje me veprimtarinë e pjesës së majtë të trurit. Shkolla e mbush pjesën e majtë me informacione, shumica e të cilave të rreme e të pasakta, dhe pretendon të përforcojë dhe ngulitë ato përmes

provimeve. Ai që ia del mbanë, si ndonjë robot, vlerësohet shumë mirë. Ndërsa ai që i filtron përmes pjesës së djathtë të trurit dhe thotë: "Ej, këto janë marrëzi", ndëshkohet, megjithëse thotë të vërtetën. A nuk është fantastike kjo lloj shkolle?

Ngaqë frika është arma më e fuqishme e zvarranikëve, plani i tyre parashikon edhe sajimin e ngjarjeve, reale dhe të paqena, të cilat do të ngjallin frikë të madhe gjatë viteve që na ndajnë nga 2012-a. Mes këtyre planeve është dhe shpërthimi i Luftës së Tretë Botërore ose nxitja e botës myslimane për të nisur një "luftë të shenjtë" kundër Perëndimit, madje dhe përdorimi i kinezëve për të nxitur një konflikt në shkallë globale. Mbase kanë ndërmend t'i përdorin të dyja këto strategji. Bombat e vendosura në ambasadat amerikane në Afrikë në vitin 1998 dhe kundërpërgjigjja e amerikanëve që bombarduan objektiva islamike, janë pjesë e kësaj. Një nga planet më të rëndësishme të tyre është edhe Projekti Blubim. Në këtë skenar luftërash yjore, mes të tjerash, parashikohet përdorimi i satelitëve që lëshojnë rreze lazer mbi pjesë të ndryshme të botës me qëllim që të projektojnë në qiell pamje UFO-sh, të Jezusit, Muhametit, Budës, Krishnës, etj. Në çastin kur secila fe të bindet se iu shfaq në qiell shpëtimtari i vet, mundësitë që të hidhet në një konflikt fetar kundër të tjerëve janë të mëdha. Disa mesazhe do të transmetohen (madje kanë filluar) në frekuenca jashtëzakonisht të ulëta (ELF), frekuenca shumë të ulëta (VLF) dhe frekuenca të ulëta (LF) si dhe në bandën e mikrovalëve, në mënyrë që të kapen nga truri njerëzor. Kjo teknologji tashmë është sofistikuar dhe shumë njerëz besojnë se "Zoti" ose "shpëtimtari" po u flet, ndërkohë që, në të vërtetë, bëhet fjalë vetëm për një manipulim të kryer nga Vëllazëria. Shumë informacione të tilla përcillen nga këto burime. Projekti Blubim parashikon edhe shfaqjen e dukurive "të mbinatyrshme" të çdo lloji që synojnë terrorizimin e popullsisë dhe, mu në mes të terrorit dhe konfliktit, edhe përmes pamjeve holografike të projektuara në qiell, të shfaqet duke ardhur "shpëtimtari" i Vëllazërisë. Nga koha kur ka filluar Projekti Blubim, duhet theksuar se dukuria e rrathëve të shfaqur mbi sipërfaqet me të mbjella nuk ka si të ketë origjinë jashtëtokësore ose "të mbinatyrshme", siç beson shumica e studiuesve. Edhe mund ta ketë, por nuk është e thënë që të jetë patjetër kështu. Në periudhën para shfaqjes së parë të këtyre rrathëve të ndërlikuar mbi tokë, që ndodhi gjatë viteve 1980, ishte përpunuar një teknologji në gjendje t'i krijonte ata. Bëhet fjalë për një aparaturë me rreze gama me frekuencë të lartë, e cila qe ndërtuar për ushtrinë. Disa nga karakteristikat kryesore të rrathëve të vërtetë që janë shfaqur mbi sipërfaqet e mbjella (sepse shumë prej tyre janë të rremë) janë: kërcejtë apo degët përkulen drejt nyjës

më të ulët dhe nuk thyhen, struktura qelizore modifikohet, kafshë të ngordhura pranë rrethit karbonizohen, në çastin e krijimit të rrethit dëgjohet një zhurmë me frekuencë të lartë ose një lloj kërcitjeje, ndonjëherë shihen edhe dritë në formë plazme. Këto efekte shkaktohen nga aparati me rreze gama. Ja se çfarë thotë për këtë çështje shkencëtari dhe studiuesi Brajan Desboraf:

"Rrezet gama me frekuencë të lartë shkaktojnë një rritje të lagështirës brenda nyjave të kërcejve, të cilët fryhen dhe zbuten, duke bërë që kërcelli të përkulet në drejtim të rrezes. Rreze të tilla mund të kryejnë operacione tepër të holla. Tingujt me frekuencë të lartë që çlirohen nga rrathët e sapokrijuar mbi terren tregojnë se sistemi i rrezeve të përdorura në këtë proces të dyfishtë shfrytëzon një sistem teknologjik të krijuar nga Mosbauri. Toka në brendësi të rrethit lëshon rrezatime dhe gjallesat e pafat që goditen nga rrezja, karbonizohen... Para se të fillohet të krijohet një rreth i tillë mbi tokë, rrezes gama i duhet rregulluar fokusi dhe intensiteti. Kjo shpjegon edhe depresionet rrethore që zakonisht gjenden pranë rrethit kryesor."

Disa njerëz pyesin se, nëse këta rrathë janë krijuar nga autoritetet, atëherë përse u bënë aq shumë përpjekje për të mos i quajtur si autentikë saqë sot mediat nuk po merren më me ta. Pyetja qëndron, por qëndron edhe fakti se teknologjia njerëzore sot është në gjendje t'i krijojë dhe duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë. Brajan Desborafi thotë se fluturimi TWA 800, avioni xhet që shpërtheu pak pasi u ngrit nga Nju Jorku, u godit me një armë me rreze Mosbaur. Autopsia e viktimave tregoi se gjaku u qe ngurtësuar nëpër vena ndërsa truri "u qe bërë si qull misri". Këtë është në gjendje të bëjë kjo armë dhe, atë çast, avioni po fluturonte mbi stacionin e kërkimeve të marinës në Brukhejvën, aty ku qe ndërtuar arma.

Mashtrimi me UFO-t

Qëllimi kryesor i projektit Blubim është të bindë njerëzit se Toka do të pushtohet nga jashtëtokësorët. Është shumë e rëndësishme të mos u zemë besë këtyre marrëzive. Jashtëtokësorët nuk po na pushtojnë, ata janë këtu prej mijëra vjetësh dhe, me sa duket, kanë një pamje të ngjashme me timen dhe tuajën. Në vitin 1938, aktori Orson Uells bëri sikur transmetoi drejtpërdrejt në radio kronikën e një zbarkimi "alienësh" në Nju Xhersi. Në të vërtetë, nuk ndodhej atje, por përdori disa aktorë dhe efekte speciale nga brenda një studioje radiofonike. Programi, një variant radiofonik i "romanit" *Lufta e botëve* të H. G. Uellsit, shkaktoi tmerr dhe panik në vendet ku thuhej se gjendeshin pushtues marsianë. Madje një njeri vrau veten ndërsa u shkaktuan

rrëmujat në qarkullim nga njerëzit që përpiqeshin të iknin ngaqë kujtonin se kishin ardhur vërtet marsianët. Uellsi tha se qe vetëm një lojë dhe se njerëzit e kishin keqkuptuar. Në të vërtetë, bëhet fjalë për një eksperiment për të parë se si do të reagonte popullsia përballë një gjendjeje të tillë dhe, për ta kryer, përdorën një histori të shkrimtarit H. G. Uells, një klon i Vëllazërisë që mbështeste Urdhërin e Ditës zvarranik, përfshi dhe kontrollin kolektiv mendor. Mendojeni pak. Nëse duhet ndonjë arsye për të centralizuar të gjitha qeverisjet, financat, ushtritë, policinë dhe institucionet e tjera, duhet të bëni sikur diçka po e kërcënon planetin si një të tërë. Ku ka mënyrë më të mirë se t'i bësh njerëzit të besojnë se planeti i tyre po pushtohet nga hapësira? Kështu krijohet një problem global, një kërkesë globale që "të bëhet diçka" dhe mundësia për të ofruar një zgjidhje globale: një qeveri dhe një ushtri botërore për t'i bërë ballë këtij "kërcënimi". Pikërisht ky plan ka filluar të zbatohet.

Në vitet 1960, gjatë administratës Kenedi, u ndërtua një grup me 15 ekspertë të fushave të ndryshme që të kryente një studim mbi metodat e kontrollit të popullatës dhe centralizimit të pushtetit pa përdorim të luftërave. Ky studim u njoh më pas me emrin Raporti i Malit të Hekurt, një strukturë e nëndheshme në shtetin e Nju Jorkut ku u mbajtën takimet e para dhe të fundit të tij. Një nga anëtarët i tregoi një shoku përmbajtjen e raportit ndërsa ai ua tregoi atë të tjerëve. Dy nga sugjerimet që jepeshin për centralizimin e pushtetit ishin: të krijohej një kërcënim për mjedisin dhe një kërcënim për pushtimin nga jashtëtokësorët. Raporti u plotësua në vitin 1966 ndërsa në 1968-ën u themelua Klubi i Romës, një fasadë e Vëllazërisë për të cilin kam folur më parë dhe, prej të cilit, lindi më pas lëvizja mjedisore. Sugjerimi i Raportit të Malit të Hekurt lidhur me mjedisin po ndiqet me rreptësi. Ndërsa tani po luajnë edhe kartën e jashtëtokësorëve. Për dhjetëvjeçarë me radhë, ideja e jashtëtokësorëve doli jashtë loje dhe u fut në arkivat e mediave por befas erdhi çasti i duhur për ta marrë përsëri seriozisht këtë dukuri. "Kërkimi" mbi UFO-t në Shtetet e Bashkuara financohet nga Lorans Rokfeleri dhe në këtë kërkim është futur edhe një grup me nëntë shkencëtarë të udhëhequr nga fizikani i Stenfordit, Petre Starrok. Starroku ka deklaruar në televizionet amerikane se ka gjetur "materiale të pakundërshtueshme" të faktit se po ndodh diçka që i shpëton të kuptuarit tonë. Pyes veten se për çfarë mund të bëhet fjalë. Mendoni pak për seritë e pafundme televizive mbi jashtëtokësorët të cilat synojnë të ngjallin frikë dhe për filma si "Dita e Pavarësisë" (të prodhuar nga 29-th Sentëri Foks, pronë e Rapert Mardokut). Më lejoni të shtoj se Rapert Mardoku vetë është pronë e Vëllazërisë.

Këto mesazhe mbështeten edhe nga "dëshmitë" e panumërta për UFO-

t dhe përvojat e një numri të gjerë njerëzish që thonë se janë grabitur nga jashtëtokësorët. Nuk po them se dukuri të këtij lloji nuk mund të ndodhin, sepse nuk e di këtë, por mund të them diçka tjetër për këtë. "Të rrëmbyerit" kujtojnë njërën, disa ose që të gjitha këto gjëra: humbje e ndjesisë së kohës, zhurma të ngjashme me shpërthime apo gjëmime, ndjesi seksuale dhe erë squfuri. Brajan Desborafi vëren se të gjitha këto ndjesi janë tipike për kontaktet me fushat magnetike me intensitet të lartë dhe shkaktohen nga ndryshimet neurokimike në tru, siç e shpjegon ai me hollësi. Në vitin 1930, profesor Kacamali zbuloi se halucinacionet mund të krijoheshin nga frekuenca elektromagnetike prej 500 megaherc. Këto dukuri mund të krijohen edhe nga zonat e tensionit gjeopatik në Tokë dhe nga linjat e tensionit të lartë sepse, që të dyja, prodhojnë fusha elektromagnetike por mund të krijohen edhe nga teknologjia elektromagnetike të cilën Vëllazëria e përdor në projektet e saj të kontrollit mendor. Fushat elektromagnetike kanë një efekt dhe potencial të madh në futjen e njerëzve në gjendje në ndryshme vetëdijeje dhe në krijimin e shumë dukurive "të mbinatyrshme". Për sa kohë nuk e kuptojmë këtë, do të vazhdojnë të na propozojnë shpjegime të mbinatyrshme për këto dukuri tepër të natyrshme. Kjo vlen edhe për topat dhe dritat e plazmës në qiell që shkaktohen normalisht nga projektimet elektromagnetike tokësore. Shpërthimi i lajmeve për UFO-t nisi pas Luftës së Dytë Botërore, kur gjermanët prodhuan disa forma "disqesh fluturuese". Projekti Paperklip qe një operacion i përbashkët i shërbimeve të fshehta amerikane dhe angleze për të nxjerrë jashtë Gjermanisë shkencëtarët kryesorë, inxhinierët, gjenetistët dhe manipuluesit mendorë nazistë e për t'i dërguar në Amerikën veriore e qendrore. Kështu, nocionet për UFO-t do të kalonin nga ana tjetër e Atlantikut dhe, pas pak kohësh, njoftimet për disqet fluturuese u shtuan me shpejtësi në Shtetet e Bashkuara. Episodi i njohur i Rosuellit i përket vitit 1947. Gjymtimi i bagëtive iu vesh jashtëtokësorëve sepse u tha që njerëzit nuk zotëronin asnjë teknologji që të ishte në gjendje të priste në atë mënyrë kafshët ose t'u merrte gjakun. Por Brajën Desborafi vëren se kjo nuk është aspak e vërtetë. Një lazer i lëvizshëm, i nevojshëm për këto operacione, ishte ndërtuar në laboratorin aeronautik amerikan të Filipsit dhe iu dha për përdorim një personeli të specializuar të reparteve speciale. Pas kësaj, nisën provat me kafshët. Disa raste u verifikuan pranë laboratorit të armëve kimike në Dulse, Nju Meksiko, dhe Desborafi thotë se kafshët u gjymtuan për të realizuar disa studime në kuadër të kërkimeve që po kryheshin atje. Kjo e shpjegon edhe arsyen se përse shumë krerë kafshësh qenë shënuar me një bojë lumineshente e cila qe e dukshme vetëm natën. Kafshët merreshin me mjete fluturuese, u hiqeshin disa pjesë të trupit dhe pastaj lëshoheshin në zona të tjera me qëllim që të mos liheshin

gjurmë dhe të krijohej një farë "misteri". Shumë studiues të painformuar të dukurive mbi UFO-t, thonë se aeroplani i Rosuellit duhet të jetë jashtëtokësor sepse është ndërtuar me një lëndë me strukturë jo-kristalore dhe nuk ka mundësi të jetë ndërtuar në tokë ose të jetë prodhuar me mjetet që përdorin njerëzit. Kjo gjë nuk është e vërtetë. Desborafi thotë se procesi i prodhimit të këtyre metaleve quhet ftohje dhe sprucim. "Metali i shkrirë hidhet mbi një sipërfaqe të ftohur në mënyrë kriogjenike e cila jep kështu një produkt jo-kristalor. Po kështu, kur metali ngjishet në temperatura pranë zeros absolute, ky metal, kur kthehet në temperaturën e mjedisit, arrin një fortësi si të diamantit."[8]

Komuniteti i "studiuesve" për UFO-t gëlon nga manipulues të Vëllazërisë dhe pjesëtarë të një njësie të shërbimeve të fshehta me emrin "Voliera" sepse emrat e koduar të tyre janë të gjithë emra zogjsh. Pyes veten se si ka mundësi që "ish" agjentë të shërbimeve të fshehta flasin kaq hapur për projektet e fshehta kur kjo duhet të sillte masa të rrepta ndaj tyre si dhe humbjen e pensionit për shkak të shkeljes së betimit për ruajtjen e të fshehtës. Pastaj, ekziston dhe një teknologji që njihet me shkurtesën EDOM (tretja elektronike e kujtesës) e cila përdoret mbi agjentët operativë të shërbimeve të fshehta për të fshirë nga kujtesa e tyre ato informacione që autoritetet nuk duan të dalin. Të tjerë anëtarë ose agjentë operativë të grupit "Voliera" janë hipnotizues të cilët "ndihmojnë të rrëmbyerit" që të risjellin ndërmend "kujtimet" e rrëmbimit nga "alienët". Shumë nga ata që kanë pasur kontakt me "alienët" janë të lidhur me projekte të fshehta. Xhorxh Adamski punonte bashkë me disa shkencëtarë të tjerë të laboratorit elektronik të marinës në Point Loma dhe të një instituti të ngjashëm në Pasadena, kur lajmëroi botën se kishte takuar jashtëtokësorë. Mikroçipet që thuhet se jashtëtokësorët u kanë vendosur në trup të rrëmbyerve në të vërtetë janë vendosur nga tokësorët. Ata janë ndërtuar nga një shoqëri inxhinierike nga *Motorola, Xheneral Elektriks, IBM* dhe *Boston Medikal Senter*. Një shembull është çipi *IBM 2020* i përdorur në programin e kontrollit mendor të Projektit Monark. Edhe disa mjekë dhe dentistë që punojnë për agjencitë e inteligjencës fusin mikroçipe në pacientë të paditur. Po botohen përherë e më tepër libra mbi alienët e këqij që po pushtojnë planetin dhe unë po pyes se cili është qëllimi i gjithë kësaj. Po ia lë përgjigjen Henri Kisingerit, duke cituar një pjesë nga një fjalim që ka mbajtur në vitin 1992 në një takim në Evian-Le Bë, në Francë. Më duket se është shkruar nga një delegat zviceran. Kisingeri thotë:

"Sot, Amerika do të ndjehej e poshtëruar sikur trupat e OKB-së të hynin në Los Anxheles për të vendosur rendin; nesër do t'ua dinte për nder. Kjo është sidomos

e vërtetë në rastin e ndonjë kërcënimi të jashtëm, qoftë ky real apo jo, por që do të vinte në rrezik ekzistencën tonë. Atëherë, të gjithë popujt e botës do t'u kërkonin udhëheqësve të tyre t'i çlironin nga kjo e keqe."

"Gjëja e vetme nga e cila kanë frikë të gjithë njerëzit është e panjohura. Përballë një skenari të tillë, ne heqim dorë me dëshirë nga liritë individuale në shkëmbim të shpëtimit dhe sigurisë nga ana e qeverisë botërore."

Kjo është arsyeja e mashtrimit me UFO-t. Problemi-kundërveprimi-zgjidhja. Jashtëtokësorët nuk po e pushtojnë tokën, tashmë janë këtu dhe janë ata që, duke vepruar përmes trupave fizikë, kërkojnë të na "shpëtojnë"! Studiuesi i dukurive UFO, profesori Norio Hajakaua, thotë se ky plan quhet "Projekti Panik" dhe se do të përdoret një teknologji e sofistikuar për të krijuar iluzionin optik të një pushtimi nga UFO-t. Kjo do t'u japë qeverive dhe Kombeve të Bashkuara pretekstin për të shpallur një Shtet global me të gjitha pushtetet e jashtëzakonshme dhe dekretet e duhura presidenciale. "Virusi" informatik Y2K që parashikohet të mbjellë kaos në hyrjen e mijëvjeçarit të ri, është një tjetër "problem" i manipuluar që synon të njëjtën gjë. Siç e kam përshkruar me hollësi më parë, dekretet presidenciale që janë miratuar këtë shekull nga presidentët e Shteteve të Bashkuara, pa debat apo miratim parlamentar, i lejojnë qeverisë të marrë në dorë transportin, energjinë, shtëpinë tuaj dhe gjithë mjetet e informimit. Këto dekrete presidenciale i lejojnë qeverisë të vendosë se ku duhet të jetoni dhe se çfarë pune duhet të bëni. Mund t'ju marrin fëmijët, gjithçka mund të ndodhë kur dekretet presidenciale të vihen në zbatim gjatë ndonjë "emergjence" të krijuar me art. Do të zbuloni se çdo qeveri, në rrethana të ngjashme, ka të njëjtën fuqi. Aspekte të tjera të Urdhërit të Ditës së Vëllazërisë, në vitet nga 2000 deri në 2012, përfshijnë: një rrënim financiar global me qëllim futjen e një paraje të vetme elektronike, një seri konfliktesh dhe aktesh terroriste, një seri ngjarjesh të tjera që synojnë terrorizimin e popullsisë dhe shtyrjen e saj drejt një gjendjeje nënshtrimi.

Por nuk është e thënë që patjetër të ndodhë kështu. Ti nuk je një qenie njerëzore "e zakonshme" dhe "e pafuqishme". Ti je pjesë e vetëdijes së përjetshme, një gjeni në pritje të dalësh në pah. Gjithçka që të duhet është të hapësh zemrën dhe mendjen, të lidhesh me këtë gjenialitet dhe të zotërosh fuqinë e pafundme me të cilën mund t'i japësh formë fatit tënd. Kjo është arsyeja jonë në këtë çast të pabesueshëm mundësie dhe, pas shumë kohe, do të shohim për herë të parë se liria do të kthehet në këtë planet.

LIBRI 24

Kreu 21

Prishja e magjepsjes

Ato që dua të nxjerr në pah këtu janë informacionet që Vëllazëria kërkon t'i mbajë të fshehta më tepër se çdo gjë tjetër. Vetëdijen për faktin se zot i fatit tënd je ti vetë dhe askush tjetër. Ke qenë dhe do të jesh gjithnjë.

Pasi keni lexuar deri këtu, një gjë do t'ju duket e çuditshme. Në fund të fundit, a nuk e kam përshkruar me hollësi se si e kontrollon botën Vëllazëria prej mijëra vjetësh? Po, po si e ka arritur këtë? Duke manipuluar mënyrën në të cilën mendon dhe ndien njerëzimi. Mendimet dhe ndjenjat tona krijojnë përvojën fizike dhe, nëse lejojmë një forcë të jashtme të manipulojë mendjet dhe emocionet tona, i kemi lejuar të kontrollojë edhe përvojën fizike dhe fatin tonë. Por, të gjithë këtë, mund ta ndryshojmë brenda një çasti nëse marrim në duar kontrollin e mendimeve dhe emocioneve tona. Krijimi i realitetit tonë dhe përcaktimi i vetë fatit tonë, në thelb, është një proces shumë i thjeshtë që mund të përmblidhet kështu: "Ç'të mbjellim do të korrim". Pikërisht kështu funksionon...

Mendja dhe emocionet tona janë sintonizuar në gjatësi valësh me frekuenca të ndryshme sipas asaj që mendojmë dhe sipas asaj që ndiejmë. Kjo vlen jo vetëm për "unin" e vetëdijshëm, por dhe për pavetëdijen, këtë

kazan mendimesh, qëndrimesh dhe ndjijimesh të shtypura, të cilin parapëlqejmë të mos e trazojmë. Mund të sintonizohemi me vibrimin e inatit, pa qenë të vetëdijshëm për këtë emocion në një çast të dhënë. Për shembull, një i rritur që ka grumbulluar brenda tij inatin gjatë fëmijërisë dhe e ka shtypur atë, do të vazhdojë të transmetojë këtë frekuencë edhe pa qenë i vetëdijshëm. Kjo do të tërheqë drejt këtij njeriu, sipas ligjit të tërheqjes vibruese, njerëz të tjerë të inatosur, qofshin këta të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm për këtë. Këtë e di sepse e kam provuar vetë. Për ta thënë me fjalët e një kënge që kam dëgjuar në Shtetet e Bashkuara: "Kur e mban brenda vetes inatin, kush do të të qepet nga pas? Një tufë njerëzish të inatosur". Vibrimet tona mendore dhe emocionale të të gjitha llojeve transmetohen si një seri modelesh valësh, të cilat tërheqin drejt nesh modele të ngjashme valësh në formën e njerëzve, vendeve, mënyrave të jetesës dhe përvojave. Atë që shprehim nga jashtë, e tërheqim drejt nesh. Brenda kësaj përzierjeje vibrimesh, figurojnë edhe mendimet dhe ndjenjat e vetëdijshme dhe modelet astrologjie që i bëjmë tanët në çastin e lindjes. Kur lindim, thithim modelin energjetik të fushës tokësore të pranishëm në çastin dhe vendin në të cilin hyjmë në këtë botë. Ky model varet edhe nga vendndodhja e planetëve brenda ciklit të tyre, prej ku ndikojnë tokën me energjitë që zotërojnë. Fusha energjetike ndryshon çdo sekondë, prandaj vendi dhe koha e lindjes ka rëndësi thelbësore për fushën energjetike që trashëgojmë. Vendi dhe koha kur lindim që na jep një model të caktuar energjetik, përcakton dhe programin tonë të jetës. Mendoni pak se sa njerëz që ushtrojnë të njëjtin profesion, pak a shumë, kanë lindur në të njëjtën periudhë të vitit. Vëllazëria Babilonase, mbi të gjitha nëpërmjet krishtërimit dhe "shkencës", është përpjekur ta dënojë astrologjinë si diçka të keqe ose qesharake, duke nxitur njerëzit të mos e përfillin atë. Të krishterët, në këtë drejtim, kanë bërë një punë të shkëlqyer për Vëllazërinë, pavarësisht se shumë prej tyre nuk kishin asnjë ide se po çonin përpara Urdhërin e Ditës.

Kjo përzierje vibrimesh që bashkëveprojnë, tërheq drejt nesh edhe një refleks të vetë këtyre vibrimeve. Nëse mendojmë se jemi viktima dhe nuk e kontrollojmë dot jetën tonë, do të sintonizohemi me këto energji (njerëz dhe përvoja) që përputhen me këtë frekuencë. Kështu, do të krijojmë një përvojë fizike ku vetja jonë shfaqet si e pafuqishme dhe si viktimë. Po menduam se gjërat më të mira në jetë u ndodhin vetëm të tjerëve, do të ndodhë vërtet kështu, sepse nuk do të lidhemi me ato energji të cilat shfaqin gjërat më të mira të jetës. Po mendove se kurrë nuk do të kesh shumë pará, vërtet që nuk do të kesh kurrë. Paraja është një formë energjie dhe, nëse do që ta tërheqësh këtë energji, duhet të krijosh një lidhje vibruese me të. Të mendosh, me vetëdije

ose pa vetëdije, se nuk do të kesh kurrë pará, të pengon të sintonizohesh me këtë energji dhe do të mbetesh i varfër. Vëllazëria i di këto gjëra dhe ka krijuar një fluks energjetik që e tërheq paranë drejt saj. Edhe frika nga diçka është një mjet i sigurt për të tërhequr drejt vetes atë që të frikëson. Energjia e frikës tërheq energji të ngjashme dhe prandaj ajo të cilës i trembesh kthehet në një përvojë të vërtetë reale. Frika se mos mbetesh pa pará të lë vërtet pa pará. Frika se mos mbetesh i vetëm dhe i padëshiruar shndërrohet në një përvojë reale nëse nuk përballesh me burimin e energjisë që i shfaq këto gjëra: me veten tënde. Prandaj nuk ke pse qorton askënd tjetër për jetën tënde. Ose e ke krijuar ti të tillë, me mendimet dhe ndjenjat e tua, ose e ka bërë Vëllazëria, sepse ti vetë ke lejuar që mendimet dhe ndjenjat e tua të manipulohen nga feja, mediat, politika, mjekët, mësuesit e gjithë të tjerët. Sido që të jetë, përgjegjësi kryesor për jetën tënde je vetëm ti. Kam frikë se nuk ka rrugëdalje, je zhytur kokë e këmbë. Por, në thelb, ky lajm është diçka e mrekullueshme. Do të thotë se, nëse e ke krijuar vetë këtë realitet që tani nuk po të pëlqen, mund të krijosh, po kaq lehtë, një realitet të ri që të pëlqen. Kontrolli varet prej teje. Përgjigjet i ke vetë ti. Ti je qendra e gjithësisë tënde dhe mund të bësh ç'të dëshirosh. Thjesht je i pabesueshëm. Më beso, ndërgjegjësohu për këtë dhe bota do të ndryshojë.

Në librin tim "*Jam vetvetja, jam i lirë*", theksoj domosdoshmërinë për të çliruar fuqitë mendore dhe emocionale për të qenë të lirë. Por duhet të bëjmë edhe diçka më tepër. Duhet të çlirojmë veten, sigurisht, por është mjaft e rëndësishme të çlirojmë edhe njëri-tjetrin. Vëllazëria, përmes manipulimit, na ka shtyrë nëpër burgje personale dhe na ka manipuluar përsëri si të burgosur që të mbikëqyrim njëri-tjetrin. Njerëzimi është edhe tufa e deleve, edhe qeni që i ruan. Vëllazëria ka vendosur "norma" fetare, politike, mjekësore dhe shkencore duke i kontrolluar këta sektorë, norma që përhapen nga mjete të hipnotizuara informimi. Kështu, shumica e njerëzve jeton duke i respektuar këto norma dhe u lejon të tjerëve të programojnë mundësitë, potencialin dhe natyrën e identitetit të vetë. Kjo është një lëvozhgë veze dhe, nëse do t'ua japësh të tjerëve karakterin tënd unik dhe fuqinë e pafundme, je i lirë ta bësh. Por është fakt se, kush jeton në këto burgje, nuk është i kënaqur dhe ngul këmbë që edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Nuk i mjafton të besojë vetë në fe, kërkon që besimin e tij t'ua imponojë edhe gjithë të tjerëve duke i dënuar nëse nuk pranojnë vizionin që ka feja për jetën. Luftërat fetare as do të ishin bërë sikur njerëzit të kishin respektuar të drejtën e tjetrit për të besuar në atë që do dhe jo të përpiqeshin t'i imponoheshin. Jam gati t'i pranoj të gjithë ata që marrin pjesë në rite satanike me kushtin që të gjithë pjesëmarrësit

të kenë kontroll të plotë mbi aftësitë e veta mendore. Ka njerëz që duan të flijojnë njëri-tjetrin. Mos vallë veprojnë në bazë të zgjedhjes së lirë kështu? Vazhdoni, ju lutem, po pastaj të qëndrojë njëri për të pastruar, ju lutem! Si rrjedhojë, njerëzit do të mësojnë nga përvoja dhe do të zhvillohen drejt një niveli më ta lartë intelektual. Nëse Xhorxh Bushi, Henri Kisingeri, Uindsorët dhe pjesa tjetër e grupit duan të themelojnë ndonjë komunitet elitar dhe ta drejtojnë si ndonjë shtet fashist, ku pjesëtarët të kenë zgjedhur lirisht të jenë pjesë e tij, le ta bëjnë. Nuk jam kundër. Çështja fillon të më interesojë vetëm kur kjo u imponohet të tjerëve duke i manipuluar fshehur ose duke kryer akte dhunë mendore, fizike ose farmakologjike. A jemi aq të pjekur sa të mendojmë për veten tonë dhe t'u kërkojmë të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë? Apo po kërkojmë tepër? Nëse është kështu, atëherë jemi në telashe të mëdha.

Mënyra e vetme në të cilën pakica mund të kontrollojë botën është përmes mbështetjes te masat. Dhe ne ia kemi dhënë këtë mbështetje. Kam folur shpesh nëpër tribuna të lirisë dhe më kanë duartrokitur me zjarr por, a e kemi kuptuar vërtet se ç'do të thotë kjo fjalë? "Po, e duam lirinë!" Oh, vërtet? Atëherë, pse shumë nga këta njerëz që duartrokasin për lirinë vazhdojnë të thonë se kush nuk është i krishterë është një qenie njerëzore më e ulët, ndonjëherë edhe djall me brirë? Përse ngulin këmbë (myslimanët, hindutë, si dhe hebrenjtë) që bijtë e tyre të rriten, që nga lindja, duke besuar në atë që besojnë vetë ata, duke kundërshtuar çdo vizion apo informacion tjetër? Sa herë më kanë pyetur, gjatë konferencave që kam mbajtur në Amerikë, nëse jam i krishterë, sikur kjo do të rriste besueshmërinë time? Nevoja e vetme e këtyre pyetjeve është të tregohet se ai që e bën, është në një gjendje skllavërimi mendor nga një sistem besimi të krijuar nga Vëllazëria. Kështu është puna. Burgosemi brenda asaj që na shtyjnë ta *besojmë*. Fuqia që ka feja për të burgosur mendjen është e pabesueshme. Vëllazërisë nuk i intereson se ku beson ti, e rëndësishme është të besosh në diçka dhe të përjashtosh gjithë mundësitë e tjera. Do të isha i lumtur t'i ndryshoja opinionet e mia mbështetur në disa ose të gjitha informacionet që përmban ky libër nëse këto informacione më çojnë vërtet drejt kësaj. Nuk jam kapur në mënyrë të pazgjidhshme pas tyre, sepse po kërkoj të vërtetën, cilado qoftë ajo. Nëse është e ndryshme nga kjo që mendoj tani, në rregull, kështu qoftë. Dogmat e rrepta mbrohen nga çdo ide e re, sepse dogma ndihmon për krijimin e identitetit të një personi, për sigurinë e tij kështu që, është më e leverdishme ta mbështesësh sesa të përballesh me sfidën mendore dhe emotive që kërkon kundërshtimin e kësaj dogme. Por tani tadodhemi përballë një çasti ndryshimesh epokale ku të gjitha dogmat po thërrmohen. Të ardhmen mund ta shkruani më lehtë mbi një letër të bardhë

sesa mbi një letër të mbushur me shënime të vjetra. Në një pjesë kopshti të zbrazët mund të mbillni më lehtë lule se në një pjesë të mbuluar nga barërat. Ka ardhur çasti të çlirojmë mendjen nga dogmat dhe ta hapim ndaj çdo mundësie. Vetëm atëherë do të jemi të lirë të trokasim në portën e pafundësisë.

Në këtë libër kam përshkruar vetëm atë kuadër që u intereson më tepër dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë njerëzve. Por ka edhe gjëra të tjera që duhen mbajtur parasysh. Është e rëndësishme të kuptojmë se edhe dy pohime që duket sikur bien ndesh me njëra-tjetrën, mund të jenë të dyja të vërteta, sipas nivelit prej ku kryhet vëzhgimi. Një shembull është të thuash se, nga njëra anë, bota nuk është e përsosur dhe, nga ana tjetër, se gjithçka ndodh në Tokë është e përsosur. Si mund të jenë të vërteta të dyja këto pohime? Ja që janë. Nga pikëpamja e jetës së përditshme, bota nuk është e përsosur. Kemi luftëra, uri, sëmundje, mjerim e dhimbje të çdo lloji. Kjo është e vërtetë. Por nga pikëpamja e zhvillimit të njerëzimit, gjithçka është e përsosur. Edhe kjo është e vërtetë. Mënyra e vetme nëpër të cilën mund të zhvillohemi është duke mësuar nga përvoja, pra, duke përjetuar rrjedhojat e mendimeve dhe veprimeve tona. Sikur veprimet tona të mos kishin asnjë rrjedhojë të pakëndshme, si mund të mësonim të zhvilloheshim drejt niveleve më të larta të të kuptuarit? Do t'i ngjanim atij fëmijës që mbush më vizatime gjithë muret e shtëpisë ose gjuan dritaret me gurë. Nëse fëmija nuk do të përjetonte pasojat dhe nuk do të kuptonte se kjo sjellje dëmton shtëpinë, çfarë do të ndodhte? Fëmija do të vazhdonte të vizatonte e të thyente dritare ngado. Njerëzimi ka hequr dorë nga të menduarit e vet prej shumë mijëvjeçarësh dhe, nëse duam që ta marrim përsëri atë fuqi që kontrollon me vetëdije fatin tonë, duket të pësojmë dhe ca shqelma prapanicës, do me thënë, të përjetojmë rrjedhojat e veprimeve tona, të paktën deri sa të ndizet drita. Prandaj sot ka luftëra, konflikte dhe manipulime të çdo lloji. Nuk është se i urrej këta zvarranikët. Dua t'i dashuroj, sepse pikërisht për këtë kanë nevojë më tepër se për çdo gjë tjetër. Sjellja e tyre kushtëzohet vetëm nga mungesa e dashurisë për veten sepse, vetëm duke e dashur veten ashtu siç je, mund të fillosh vërtet të duash të tjerët ashtu si janë. Prandaj, ju dua, mbretëreshë e Anglisë, princi Filip, Pindar, Henri Kisinger, Xhorxh Bush, Eduard Heth e gjithë ju të tjerëve. Sikur këta persona ta donin veten e tyre, ky makth (dhe makthi i tyre) do të merrnin fund. Për sa kohë nuk e bëjnë këtë, lidhja mes zemrës dhe shpirtit të tyre të pafundmë (dashurisë së pastër) do të mbetet e fjetur dhe ata do të vazhdojnë të shfaqin të njëjtat qëndrime dhe këto sjellje si këto që pamë. Dua ta theksoj edhe një herë, para se ta mbyll, se kur flas për zvarranikët, flas vetëm për ata që përpiqen të manipulojnë njerëzimin, jo për të gjithë specien. Shumë nga

LIBRI 24

speciet zvarranike po përpiqen të na ndihmojnë që të prishim këtë magjepsje. Në fund të fundit, të gjithë jemi pjesë të Së Tërës.

E di se shumë njerëz që kanë dijeni për ekzistencën e Vëllazërisë dhe të Urdhërit të Ditës së saj mendojnë se mënyra e vetme për t'u kundërpërgjigjur është të marrim armë e të përgatitemi për një mbrojtje të armatosur të lirive tona. Por kjo më duket si përgjigja më e përshtatshme që ata të krijojnë pikërisht atë shtetin fashist për të cilin thonë se duan ta luftojnë. Ideja e kundërpërgjigjes së dhunës me dhunë është kaq kontradiktore dhe kaq e marrë saqë vetvetiu lind pyetja se sa qeliza trunore janë aktivizuar për ta ideuar. Çfarë merr kur i përgjigjesh dhunës me dhunë? Një dhunë të dyfishtë. Po, na qenka një kontribut i madh për paqen! Por, nëse dikush përdor dhunën kundër sistemit, i jep publikisht të drejtën Vëllazërisë që të përdorë armë të sofistikuara teknologjike për të shtypur këtë kundërshtim në emër të "ligjit". Mendoj se duhet të bëhemi pak më të zgjuar e të heqim dorë nga grumbullimi i armëve. Në Shtetet e Bashkuara kam takuar disa nga Patriotët e Krishterë më ekstremistë. Njëherë, i thashë njërit prej tyre: "Nuk e di se cilin urrej më shumë, botën që kontrollohet nga Vëllazëria apo botën që doni të ndërtoni ju". Ky tipi fliste për liritë dhe për nevojën e mbrojtjes së tyre me armë duke shtuar njëkohësisht se zezakët ishin qenie më të ulëta se të bardhët nga ana gjenetike dhe se indigjenët amerikanë vetëm sa po "ruanin" tokat e Amerikës "deri sa të mbërrinin të bardhët". Përputhej plotësisht dhe qe i dashuruar me atin e tij shpirtëror, Tomas Xhefersonin. Po përsëri gjendemi përballë së njëjtit problem. Tipa si ky, herët ose vonë, do të përfundojnë në përplasje të armatosura me trupat e Vëllazërisë. Është e pashmangshme që, nëse nuk ndryshojmë qëndrim, dy gjendje të njëjta por që fshihen pas emrash të ndryshëm (Vëllazëria dhe ekstremistët Patriotët e Krishterë) të tërheqin njëra-tjetrën në arenën e dhunës. Që të dyja besojnë te përdorimi i forcës sepse janë sintonizuar në të njëjtën bandë frekuencash. Mund të quhen si të duan, por nuk janë aspak të kundërta, janë dy anë të së njëjtës medalje. Mes tyre duhet të ndodhë një përplasje që t'u lejojë të zhvillohen dhe të mësojnë se dhuna nuk zgjidh asgjë. Kurrë nuk ka zgjidhur gjë dhe as do ta bëjë ndonjëherë. Kur Patriotët e Krishterë flasin për shoqërinë e tyre alternative që duhet të zëvendësojë atë të planifikuar nga Vëllazëria, thonë se duan "një komb nën një Zot të vetëm". Mirë, po cilin variant të Zotit? Të Zotit të krishterë? Të Zotit mysliman? Të Zotit hindu? Të Zotit sipas përfytyrimit të Ethelit në Nju Jork apo të Billit në Los Anxheles? Jo, thonë, natyrisht që të Zotit të krishterë, variantit të atij Zoti në të cilin besojnë vetë ata. Në të vërtetë, nuk duan të zëvendësojnë Urdhërin e Ditës së Vëllazërisë me lirinë, por me

LIBRI 24

variantin e tyre të diktaturës. Edhe një herë, nga çasti kur dy palë kërkojnë t'u imponojnë të tjerëve vullnetin e vet dhe të shtypin besimet dhe mënyrat e tjera të jetesës, janë të destinuar të tërhiqen drejt njëra-tjetrës sepse veprojnë brenda të njëjtës bandë frekuencash. Ajo që mund të thuhet në rastin e të krishterëve ekstremistë, mund të thuhet edhe për ekstremistët myslimanë, hindu, hebrenj dhe të gjithë përfaqësuesve ekstremistë të feve të tjera. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për indigjenët amerikanë kur mbërritën evropianët. Kultura indigjene amerikane karakterizohej nga një urtësi e madhe dhe shfaq një kuptueshmëri shumë më të gjerë për lidhjet mes të gjitha gjërave. Por të mos entuziazmohemi shumë nga kjo kulturë, siç bëjnë shumë ithtarë të Epokës së Re, të cilët kanë një vizion të idealizuar të saj. Para mbërritjes së të bardhëve, shumë fise indigjenësh amerikanë luftonin mes tyre. Masakrat dhe konfliktet ishin të përditshme. Një mentalitet i tillë luftarak tërheq drejt vetes atë energji që përligj përdorimin e dhunës. Sa herë që ka dy grupe që mendojnë se dhuna është një rrugë që mund të ndiqet, përplasja do të jetë e afërt.




Figura 64. Kur njerëzit detyrohen të mbyllin ndërgjegjen, largohen nga shpirti i përjetshëm ndërsa e gjithë dashuria, urtësia, dituria dhe frymëzimi qëndrojnë në pritje për t'u aktivizuar. Nuk është nevoja të kërkojmë ndriçime: jemi të ndriçuar. Vetëm se duhet të heqim pengesat e frikës që na ndajnë nga ndriçimi, të dalim jashtë "lëvozhgës së vezës".

Për fat të mirë, shumë të krishterë, myslimanë, hindu, hebrenj dhe indigjenë amerikanë nuk shfaqin qëndrime ekstreme dhe ofrojnë alternativa më të mira se ajo e dhunës. Ose do të nxjerrim mësimet e duhura nga përvojat më të ashpra e më të dhimbshme ose do të përdorim mençurinë dhe dashurinë për ta kuptuar ashtu si duhet gjendjen dhe për të ndryshuar kushtet pa shkrehur as edhe një armë zjarri. Kështu, përplasjet do të shmangen sepse nuk do të ketë asnjë tërheqje vibruese mes Vëllazërisë dhe atyre që duan të prishin planet e saj. Mund t'ia dalim kësaj pa shkuar deri te përplasja. Lidhja

vibruese që zvarranikët kanë vendosur me qeniet njerëzore mbështetet mbi emocionin e frikës. Edhe ata vetë janë të frikësuar, prandaj sillen në këtë mënyrë. Nëse arrijnë ta zhytin njerëzimin në një gjendje frike, atëherë vendoset lidhja vibruese që u lejon të kontrollojnë psikikën njerëzore. Në një farë mënyre, luajnë në fushën e tyre sepse janë ekspertë në çështjet e frikës. Ky grup zvarranikësh, në thelb, është një shprehje. Nëse duam të ndalojmë Vëllazërinë e zvarranikëve duke kërkuar të përplasemi me ta në terrenin e frikës, duke shkuar drejt urrejtjes, agresionit dhe dhunës, atëherë mjerë ne. E kemi humbur ndeshjen qysh nga fillimi. Por nëse këtë sfidë e përballojmë me një gamë frekuencash ku Vëllazëria nuk futet dot - me gamën e dashurisë - do të shndërrojmë botën dhe kontrolli zvarranik do të zhduket. Kjo do të ndodhë për shumë arsye. Së pari, do t'i hapim zemrat ndaj dashurisë, *çakra* e zemrës do të rrotullohet me shpejtësi e forcë të madhe, duke ngritur frekuencën e vetëdijes sonë individuale në shprehjen më të lartë vibruese të jetës, të dashuria e pastër. Ngaqë shpirti ynë është dashuri e pastër, na lidh me forcën madhështore të "unit" shumëpërmasor (shih **Figurën 64**). Lëvozhga e vezës shpërthen.

Valët e shkurtra dhe të shpejta të dashurisë aktivizojnë edhe "antenat" e ADN-së sonë që na lidhin me hapësirën dhe hapja e *çakrës* së zemrës na lejon të sintonizohemi me impulset hapësinore të Tokës, Diellit dhe të qendrës së galaktikës, duke na përçuar rrahjen e ndryshueshme të trurit tonë në çdo qelizë të trupit. Kjo do të na ndryshojë rrënjësisht mendjen, emocionet dhe formën fizike, sa më shumë që të sintonizohen këto me vibrime përherë e më të shpejta, në këtë periudhë ndryshimi dhe evolucioni të pabesueshëm. Një hop i mëtejshëm i frekuencave individuale do të na ngrejë jashtë pusit vibrues të frikës, duke na nxjerrë në nivele shumë më të larta të përmasës së katërt. Kontrolli i zvarranikëve do të marrë fund sepse ata, si ta thuash, do të sintonizohen me një stacion tjetër radiofonik dhe duhet të përballen me rrjedhojat e veprimeve të tyre në rrugën drejt ndriçimit. Zgjedhja është e jona: frikë ose dashuri, burg ose liri.

Sikur zvarranikët të mos ekzistonin, duhej t'i shpiknim vetë sepse, prania e tyre përfaqëson diçka që vetëdija njerëzore duhej ta përjetonte. Po të mos ndodhte kështu, zvarranikët do të kishin manipuluar dikë tjetër. Ne nuk i terrhoqëm. Ata na bënë një dhuratë në rrugën e zhvillimit tonë, dhuratën e përjetimit të rrjedhojave të frikës dhe të lënies së fuqisë tonë të fundme në duart e një tjetri, qoftë ky prindi, shefi, apo një i dashëm me ne, apo qoftë edhe Vëllazëria zvarranike. Procesi zhvillues ka të bëjë me dashurinë, jo me ndrydhjen. Nuk na ndëshkon për veprimet që kryejmë, por na tregon

rrjedhojat e tyre, çka është shumë e ndryshme. Pa këtë, zhvillimi ynë nuk është i mundur. Gjatë rrugës sonë mësuam dashurinë e niveleve të vetëdijes (aspekte të tjera të "unit") që përpiqeshin të na ndihmonin të donim dhe të ndriçoheshim, të ishim zotër të vetes. Duhet të zgjedhim se sa prej këtyre përvojave na shërbejnë për të mësuar diçka dhe për të ecur përpara. Do të ndryshojmë tani apo duhen ende luftëra, uri dhe vuajtje, përpara se të ndizet llamba? A do të hyjmë në këtë portë që po afrohet dhe paraqet kushtet e një jete krejt të re? Apo do të qëndrojmë këtu ku jemi dhe të përballemi me një tjetër cikël mishërimi dhe rimishërimi në pritje të një mundësie të re? Grupi zvarranik për të cilin iu fola është tronditur fort, sepse ka ndërprerë lidhjen me ato nivele të "unit" që vibrojnë me ritmin e dashurisë. Por zvarranikët janë një pjesë e së tërës, janë ti dhe unë, janë një aspekt i asaj gjëje të lartë që e quajmë Zot. Prandaj, nëse i urrejmë, kemi urryer veten tonë. Nëse ushtrojmë dhunë ndaj tyre, kemi ushtruar dhunë ndaj vetes tonë. Kjo nuk do të qe e leverdishme. Unë them: fali se nuk e dinë se ç'bëjnë. Me falje dhe dashuri nuk kuptoj që t'i lemë të bëjnë ç'të duan. Ata kërkojnë të na imponojnë vullnetin e tyre, prandaj kundërpërgjigja jonë është e përligjur. Po nëse kontrolli i Vëllazërisë rrjedh prej faktit se ne kemi hequr dorë nga të menduarit, nga fuqia dhe përgjegjësia jonë, dhe kërkojmë që edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë, atëherë fajin e kemi *ne* dhe jo vetëm sjellja e zvarranikëve. Nëse marrim në dorë fuqinë tonë dhe çlirojmë veten dhe të tjerët nga imponimi i mendimeve, fesë dhe mënyrës së jetesës, atëherë nuk ka rëndësi se çfarë bënë Vëllazëria. Centralizimi i kontrollit do të jetë i pamundur sepse nuk mund të centralizohet shumëllojshmëria por vetëm uniformiteti. Tri gjëra do të shndërrojnë jetën në Tokë dhe do të heqin kontrollin e zvarranikëve nga psikika njerëzore:

1. Të çlirohemi nga frika e asaj që mendojnë të tjerët për ne duke shprehur karakterin tonë unik të vizionit dhe mënyrës së jetesës, edhe kur janë të ndryshme nga "norma" (madje, pikërisht për këtë t'i shprehim). Në këtë pikë, nuk jemi më dele që ndjekim tufën.

2. T'u lejojmë gjithë të tjerëve të bëjnë të njëjtën gjë, pa pasur frikë se do të na tallin ose do të na dënojnë për krimin e të qenurit të ndryshëm prej tyre. Në këtë mënyrë nuk do të jemi më qeni që ruan tufën dhe i detyron të gjithë të sillen sipas asaj që ne quajmë të drejtë.

3. Askush të mos kërkojë t'u imponojë të tjerëve atë që beson vetë, por të respektojë zgjedhjen e tyre të lirë.

Urdhëri i Ditës së Vëllazërisë nuk mund të zbatohet më pas këtij ndryshimi në sjelljen tonë. Njerëzit më pyesin se si duhet të veprojnë përballë zbulimeve të mia, por unë nuk i përgjigjem kurrë kësaj pyetjeje. I vetmi që e di se ç'është e mirë për ty, je vetë ti. E fshehta qëndron në hapjen e kanalit të lidhjes drejt përmasës tënde më të lartë në mënyrë që të lidhesh me nivelin më të lartë të urtësisë, të dashurisë dhe të frymëzimit, të cilat të udhëheqin drejt asaj që është më e drejtë për ty. Nuk është nevoja të rrimë nëpër dhoma plot tym ose të krijojmë parti të reja politike. Duhet ta heqim lëvozhgën e emocionit të vibrimeve të ulëta - frikën - dhe, sipas ligjit të tërheqjes vibruese, do të lidhemi me të gjithë njerëzit dhe institucionet që na duhen për të shndërruar planetin. Kur ne të futemi në rrugë të mbarë, edhe bota do të jetë në rrugë të mbarë. Ajo që quajmë shoqëri është shuma e mendimeve dhe ndjenjave njerëzore. Është pasqyrimi i sjelljeve tona. Po i ndryshuam këto sjellje, ndryshojmë shoqërinë. Mjafton një ndryshim i tillë për të zotëruar lirinë e vërtetë, lirinë e shprehjes dhe karakterin unik që na ka dhënë Zoti. Kështu mund të gëzojmë shumëllojshmërinë e cilësive, të perceptimeve dhe të frymëzimeve që ekzistojnë në psikikën kolektive njerëzore. Forca krijuese gjendet brenda nesh dhe kërkon me dëshpërim të shfaqet. Ndrydhja e kësaj energjie na ka çuar drejt këtij zhgënjimi dhe, rrjedhimisht, në dhunë dhe depresion. Përfytyro të jesh një artist ose balerin i talentuar, por trysnitë që ushtrojnë njerëzit rreth teje, qofshin këta dhe prindërit, si dhe rregullat e sistemit, të detyrojnë të punosh në ndonjë bankë apo të rrish pranë një makinerie fabrike gjatë gjithë ditës. Ose rastin kur ti do të shprehën krijimtarinë tënde dhe të japësh një kontribut në botë, por manipulimi i sistemit financiar nga ana e Vëllazërisë bën që të mos jesh në gjendje të gjesh as një punë. Ajo forcë krijuese që ke brenda vetes nuk mund të shtypet, kështu që shfaqet në mënyrë jo të baraspeshuar, në formë zemërimi, dëshpërimi ose ndrydhjeje, prandaj vazhdojnë të përhapen dhuna, konsumi i drogës dhe pijeve alkoolike, me qëllim ndrydhjen e vuajtjeve emocionale. Nëse e respektojmë vlerën e krijimtarisë dhe kërkojmë mënyra për ta shprehur atë, këto gjëra nuk do të ndodhnin në masën në të cilën ndodhin sot. Në vend të kësaj, ne kërkojmë sot një lloj krijimtari që, ose të jetë një burim fitimi, ose të kontribuojë për ekonominë - ekonominë e Vëllazërisë. Dimë çmimin e shumë gjërave, por jo vlerën e tyre. Sikur ta hapnim zemrën drejt një vizioni më të madh mundësish, do të çlironim atë forcë krijuese të pranishme brenda secilit prej nesh, duke i lejuar të shprehë karakterin e saj unik. Në ç'botë shumëllojshmërish dhe frymëzimesh që do të jetonim atëherë! Në një botë që udhëhiqej nga fluksi i forcës krijuese dhe jo nga kërkesat për fitim të bankierëve të Vëllazërisë.

LIBRI 24

Në fillim të librit ju fola të mendoni për atë që nuk ua nxë mendja. Informacionet e paraqitura këtu ju kanë shtyrë në këtë drejtim. Që të mbani parasysh provat e faktit se zvarranikët e një përmase tjetër ekzistence e manipulojnë njerëzimin prej mijëra vjetësh. Të mbash parasysh se ti nuk je aspak i zakonshëm dhe i pafuqishëm, por i jashtëzakonshëm dhe i fortë. Të dyja këto gjëra janë të pabesueshme për shumicën e njerëzve, duke mbajtur parasysh nivelin aktual te kushtëzimeve. Por mund të *ndjehen*. Ka goxha ndryshim. Njeriu mendon me mendje dhe kjo mund të programohet lehtësisht mes syve e veshëve, falë dozës së përditshme të gënjeshtrave, mashtrimeve dhe falsifikimeve që ofron media dhe gjithë klonet e Vëllazërisë, të cilëve u intereson drejtpërdrejt e gjitha kjo. Por kur *ndjejmë* diçka, jemi kthyer drejt thelbit të zemrës sonë, drejt intuitës, drejt lidhjes së drejtpërdrejtë me hapësirën. Sa herë kanë hyrë në konflikt mendimet dhe ndjenjat e tua? Ajo që ma ndryshoi më tepër se çdo gjë tjetër jetën ishte vendimi për të ndjekur intuitën sa herë që ajo ishte në konflikt me mendimet. Sa herë që e kam bërë këtë, intuita më ka dalë mjaft e saktë. Ndonjëherë mund të jetë e dhimbshme dhe e sikletshme, sepse intuita nuk e njeh nevojën e ndjekjes së "normave" dhe, shpesh, u kundërvihet konvencioneve. Por do t'ju udhëheqë gjithnjë drejt asaj që është më e mira për ju dhe për udhëtimin e përjetshëm të evolucionit përmes përvojës. Kështu, kur pjesa më e madhe e njerëzve ndjen instinktivisht se duhet bërë diçka, mendja e tyre nis të gjejë arsyet për të cilat është më mirë të mos bëhet ajo gjë. "Nuk mund ta bësh, çfarë do të thonë fqinjët, po familja, po kolegët, po ata djemtë që po pinë në bar?"... "Nuk mund ta bësh, duhet paguar kësti, makina, familja, polica e sigurimit të jetës"... "Nuk mundesh, nuk mundesh, nuk mundesh". Sigurisht që mundesh, mundesh, MUNDESH. Në vetvete, mendja nuk është negative. Të mban me këmbë në tokë, magazinon dhe përpunon informacionet dhe luan një rol themelor. Por kur shndërrohet në forcën e vetme që na kontrollon dhe, e vetme, na shtyn të marrim vendime, kthehemi në robër të saj. Roli i intelektit është të materializojë drejtimin dhe frymëzimin që na vijnë nga intuita, dhe jo të na diktojë vullnetin e saj. Mos puno ti për mendjen, por detyroje mendjen të punojë për ty.

Kështu, gjëja më e rëndësishme nuk është se çfarë mendoni për informacionet e këtij libri, por se çfarë *ndjeni* për to. Disa prej tyre do t'ju tronditin mendjen, por intuita nuk do të pësojë asnjë tronditje. Në këtë nivel, për një gjë të caktuar ose do të kesh një ndjesi të mirë ose nuk do të kesh fare. Nëse nuk ke, lërë të kalojë. Nuk po përpiqem t'ju "konvertoj" në ndonjë lloj feje. As nuk më intereson se çfarë mendoni ose ndjeni lidhur me mua ose me

librat e mi. Por më intereson shumë që ta dini të drejtën tuaj për të ndjerë diçka për atë që ju është mohuar. Si kundërveproni përballë kësaj, nuk është as puna ime dhe as ndonjë burim shqetësimi për mua. Por do të shihni se si Urdhëri i Ditës, për të cilin ju kam folur në këtë libër, do të materializohet pikërisht para syve tuaj, në jetën e përditshme. Nuk do t'i shihni më me të njëjtin sy lajmet në televizor, as gazetën dhe as fjalimet politike dhe ekonomike. Do të shihni se edhe klima do të ndryshojë dhe do të verifikohen përplasje gjeologjike sa më shumë që të rritet shndërrimi i fushave energjetike tokësore. Do të ndjeni se si do të dendësohen vibrimet në zemrën dhe mendjen tuaj. Perceptimi për jetën dhe veten tuaj do të hapet ndaj një mundësie dhe potenciali të papërfytyrueshëm. Të mendosh të pamundurën do të shndërrohet në një mënyrë jetese për ata që do ta kapin mundësinë për t'u lidhur me gjithçka që ekziston. Ndoshta shumë njerëz do ta konsiderojnë si negativ këtë libër sepse nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh. Këto informacione po dalin në sipërfaqe pas mijëra vjetësh dhe përherë e më shumë njerëz po bëhen të vetëdijshëm për identitetin e tyre. Përgjegjës për të dyja këto gjëra janë ndryshimet vibruese. Po afrohet një shërim por, që të jetë përfundimtar, duhet të merrerni me shkaqet e sëmundjes. Sa më tepër që rritet frekuenca, aq më shumë del në sipërfaqe ajo që është mbajtur e fshehur, në nivelin individual dhe kolektiv, duke sjellë me vete dhe shërimin. Ja përse njerëzit që janë hapur ndaj ritmit hapësinor të ndryshimit kanë zbuluar se jeta e tyre e mëparshme ka qenë thjesht një iluzion. Mund të thyhen marrëdhëniet sentimentale, mund të humbasësh vendin e punës, familjarët dhe njerëzit që dikur i ke quajtur miq, mund të të largohen. Njerëzit mund të përjetojnë përvoja nga më të ndryshmet. Në rastin tim, më përqeshën publikisht shumë njerëz, sepse vetë mua nuk më pëlqejnë gjërat gjysmake. Për një çast, mund të mendoja se kisha bërë ndonjë gabim të madh, por në të vërtetë bëhej fjalë për të kundërtën. Ne e krijomë vetë realitetin tonë, e kontrollojmë vetë fatin tonë dhe këtë e bëjmë përmes vullnetit që kemi. Shumë njerëz më kanë thënë se në jetën e tyre nuk ndodh kurrë asgjë ose se gjërat nuk u shkojnë kurrë mbarë. Por kur i pyes se çfarë dëshirojnë të kenë, përgjigjen: "Të them të drejtën, nuk e di". Kështu, nuk ka si të ndodhë ndonjë gjë. Por nëse e fokusoni vullnetin tuaj mbi një qëllim të veçantë, do të dini gjithnjë se çfarë duhet të bëni për ta realizuar dhe, e gjitha kjo, do të shfaqej në formën e një modeli vibrues i cili tërheq pasqyrimin e vet drejt njerëzve, përvojave dhe mundësive. Për shumicën e njerëzve, udhëtimi mbaron këtu. Sapo përballen me atë që duhet të bëjnë për të realizuar qëllimin e tyre, befas mendojnë se, në fund të fundit, nuk kishte qenë ndonjë ide e mirë! Pikërisht këtu qëndron problemi. A thoni se doni diçka? Mirë, po sa e doni? Pak

fare? Atëherë, mos shpenzoni kot kohën. E doni me çdo qelizë të qenies suaj? Atëherë futjuni punës, sepse do të bëhet e juaja.

Kam njohur shumë njerëz që thonë se duan të ndryshojnë veten dhe jetën e tyre, se duan të sintonizohen me një vibrim të ri. Por kur përballen me sfidat që do të sjellin këto ndryshime, nuk duan t'ia dinë më dhe i kthehen jetës së mëparshme. Megjithatë, këto sfida janë të kapërcyeshme. Arsyeja që duhet të përballemi me konflikte personale dhe motive, që nga fillimi i këtij udhëtimi, duhet kërkuar në faktin se kemi nevojë të pastrojmë pusin tonë të errët nga mbetjet emocionale të shtypura e të papërpunuara, të cilat i kemi grumbulluar në vetëdijen tonë dhe kemi frikë t'u dalim përpara. Nëse nuk i eliminojmë këto plehra emocionale nga kjo dhe nga forma të tjera fizike të jetës, nuk do të arrijmë të lidhemi me "unin" tonë shumëpërmasor. Nuk do të çlirohemi dot as nga manipulimi i kontrollit që ushtrojnë zvarranikët e nivelit të poshtëm të përmasës së katërt. Prandaj, kur themi se dëshirojmë të shndërrojmë jetën tonë, ky qëllim tërheq drejt nesh njerëzit dhe përvojat e nevojshme për të nxjerrë në sipërfaqe emocionet e shtypura, të cilat duhet t'i shohim dhe përpunojmë. E njëjta gjë mund të ndodhë në rrafshin kolektiv kur informacionet e paraqitura në këtë libër të bëhen publike: atëherë, do të kemi mundësi t'i shohim, t'i shqyrtojmë e t'i përpunojmë. Shumica e ithtarëve të Epokës së Re e mohojnë ekzistencën e këtij pusi të errët kolektiv sepse nuk dëshirojnë të përballen me pusin e errët vetjak. U pëlqen më tepër të ulen rreth një qiriri e të bëjnë sikur janë ndriçuar kur, në të vërtetë, zhyten më tepër në këto emocione, duke mbajtur një kristal në dorë. Informacionet që përmban ky libër janë pjesë e shërimit të planetit Tokë dhe të vetëdijes njerëzore, e cila do të vijë kur të zhduket velloja që mbulon gjithçka fshihet dhe mohohet në ditët tona.

Po jetojmë një çast të mrekullueshëm. Po sintonizohemi me vallen kozmike, me erën e ndryshimit, me ritmin e lidhjes me gjithçka që është, që ka qenë dhe do të jetë. Ti je këtu për të dhënë ndihmesën tënde, për veten dhe për gjithë botën. Ke mundësi ta bësh tani, tani, tani. Kape këtë mundësi dhe jepi fund absurditetit. Pak persona mund të kontrollojnë miliona të tjerë vetëm se këta miliona duan që të jetë kështu. Po nuk ka pse të jetë patjetër kështu. Ne mund ta ndryshojmë këtë gjendje vetëm duke kërkuar të jemi vetvetja, duke u lejuar dhe të tjerëve të jenë vetvetja e të çmojnë dhuratën e jetës. Kur është koha të kemi frikë dhe të fshihemi. Është koha të këndojmë e vallëzojmë.

Merrni partnerët, ju lutem. Nisemi!

Shtojca I

Lidhjet e gjakut mes familjeve Uindsor dhe Bush

Lidhjet e gjakut mes familjeve të Elitës u përkasin kohëve të vjetra të perëndive dhe hibridëve njerëz-jashtëtokësorë që qeverisnin dikur Sumerinë, Egjiptin, Babiloninë dhe Greqinë. Përfshijnë dhe faraonët e Egjiptit deri në vitin 1550 p.e.s. dhe ata më të vonshëm, mes të cilëve bën pjesë Ramsesi II (1295-1228 p.e.s.) që konsiderohej si faraoni më i madh. Ai qe arkitekti më i madh i dinastisë së tij (gjeometria e shenjtë) dhe emri i shfaqet në të gjithë dorëshkrimet e lashta. Minierat e Namibisë e pasuruan jashtëzakonisht shumë.

Mes emëruesve të përbashkët të degës së një gjaku gjejmë Filipin e Maqedonisë (382-336 p.e.s.) i cili u martua me Olimpian dhe, nga kjo lidhje, lindi Aleksandri i Madh (356-323 p.e.s.), një tiran i madh që pushtoi Greqinë, Persinë, Sirinë, Babiloninë, Finikinë dhe Egjiptin, bashkë me shuam toka të Sumerisë dhe Indisë, para se të vdiste në Babiloni në moshën 33 vjeçare. Gjatë sundimit të tij në Egjipt, themeloi qytetin e Aleksandrisë dhe mori mësime nga filozofi i madh grek Aristoteli, nxënësi i Platonit. Lidhjet e gjakut dhe dituritë ecin përherë me të njëjtin hap. Dega vazhdon pastaj me emrat më të njohur të historisë: Kleopatra, mbretëresha e Egjiptit (60-30 p.e.s.) e cila u martua me perandorin e famshëm romak Jul Cezarin dhe lindi

LIBRI 24

Ptolemeun XIV. Lindi dhe dy binjakë me Mark Antonin, i cili kishte lidhje gjaku me këtë degë. Po ashtu, dega përfshin dhe Herodin e Madh, atë të historive të Jezusit. Konstandinin e Madh, perandorin që shndërroi kultin e vjetër të krishterimit në fenë që njohim sot, personazhet e dinastisë së Merovinjëve, mes të cilëve Dagobertët, të lidhur me parinë e Sionit dhe me Rënë-lë-Shatonë, vendin e mistershëm në jug të Provensës, në Francë.

Nga Merovinjët deri në ditët tona, në këtë degë figurojnë dhe emrat e Karlit të Madh (742-814), i cili sundoi si perandor gjatë Perandorisë Romake, një sërë mbretërish të Francës, mes të cilëve Roberti I, Roberti II, Filipi I dhe III, Luigji I, II, VI, VII, VIII, IX, XIII, XV, XVI. Ky i fundit u martua me Mari Antuanetën që rridhte nga vetë fisi i tij dhe që u ekzekutua nga revolucionit francez. Ata patën një fëmijë që u quajt Daniel Peizër, forca e fshehtë që qëndron pas gjigandëve financiarë dhe industrialë si Karnezhi dhe Morgan. Kjo degë përfshin edhe familjen De Mediçi, financuesit e Kristofor Kolombit, artistit Leonardo Da Vinçi dhe mjeshtërit të lartë të parisë së Sionit. Katerina de Mediçi, mbretëresha e Francës që vdiq më 1589, si mjek të vetin kishte Nostradamusin. Rene D'Anzhu, Duka i Lorenës dhe gjithë shtresa që përftonte shërbimet e Nostradamusit dhe Kolombit, i përkisnin të njëjtit fis. Po kështu edhe Gotfridi dhe dinastia mbretërore e Anglisë; mbreti Xhorxh që nënshkroi Kartën e Madhe, mbreti Henrik I, II, III, Maria Stjuarti e dinastisë së Stjuartëve dhe Xhejmsi I i Anglisë, i cili përhapi variantin anglez të Biblës së Shenjtë. Linja e gjakut të Xhejmsit mund të na çojë deri te faraonët egjiptianë, mes të cilëve Ramsesi II. Të të njëjtit gjak janë edhe mbretërit Xhorxh I, II, III, Eduardi I, II, III, mbretëresha Viktoria, Eduardi VII, Xhoxhi V dhe VI dhe nëna mbretëreshë e sotme, mbretëresha Elizabeta II, princi Çarls dhe fëmijët e tjerë të Elizabetës, Ana, Andrea dhe Eduard, princërit Uilliam dhe Herri që lindën nga martesa e Çarlsit me princeshën Dajana, presidentët e Shteteve të Bashkuara Xhorxh Uashington, Xhon Adams, Xhon Kuinsi Adams, Tomas Xheferson, Frenklin Delano Rusvelt dhe Xhorxh Bush. Vija vazhdon deri te presidenti i fundit Xhorxh Bush i Riu dhe vëllai i tij Xheb Bush, guvernatori i Floridës. Po ta thelloni kërkimin gjenealogjik, do të zbuloni se të gjithë presidentët i përkasin po kësaj dege. Tridhjetë e tre prej tyre i përkasin degës që ka rrjedhur nga Karli i Madh dhe nëntëmbëdhjetë nga dinastia angleze e Eduardit III. Kjo degë përfshin edhe familjet më të rëndësishme skoceze si Zotërinjtë e Gellouejit dhe Kaminsët, Mari Luizën e Austrisë që u martua me Napoleon Bonapartin, kajzerin Vilhelmi II, mbretin i Gjermanisë në kohën e Luftës së Parë Botërore, Habsburgët, familjen më të fuqishme të Evropës gjatë perandorisë romake dhe Maksimilianin e Habsburgëve, perandorin e Meksikës

që vdiq më 1867. E njëjta linjë gjaku mund të ndiqet duke nisur që nga Priami, mbreti i Trojës dhe dy palët e përfshira në luftërat trojane për të mbërritur deri te Huan Karlosi i Spanjës. Xheozef Smithi dhe Bringem Jangu, themeluesit e Mormonëve, i përkasin po kësaj dege. Po kështu edhe Çarls Teiz Rasëlli, themeluesi i fesë së Dëshmitarëve të Jehovait. Kjo është vetëm një prej degëve të zvarranikëve. Kjo dinasti, përveç këtyre emrave përmban edhe shumë të tjerë.

Pemët e hollësishme gjenealogjike mund t'i gjeni në internet në faqen: http://www.widomaker.com/~piso/ ose mund t'i gjeni përmes faqes time www.davidicke.com . Burime të tjera gjenealogjike përfshijnë Shoqërinë Historike Gjenealogjike të Nju Inglëndit dhe një gjenealogjist amerikan që ka studiuar për 26 vjet dhe gjetur lidhjet e gjakut të familjeve të Elitës. Ky kërkon të mbetet anonim, për arsye që dihen.

A ka gjenealogjistë të tjerë që duan të punojnë mbi këto linja gjenetike? Nëse po, më kontaktoni përmes faqes sime: www.davidicke.com

Shtojca II

Hitleri rridhte nga Rotshildët

Historia zyrtare është një mbulesë për të fshehur të vërtetën dhe atë që ka ndodhur realisht. Kur kjo mbulesë largohet, varianti që na shfaqet nuk është kurrë ai reali. Merrni, për shembull, Rotshildët, linja gjenetike e të cilëve më parë njihej me emrin Bauers, më të njohurit mes fiseve të errëta të Mesjetës gjermane. Njihen me emrin Rotshild (mburoja e kuqe) që prej shekullit XVIII, kur Majer Amsheli themeloi në Frankfurt një dinasti financiare. Rotshildët bashkëpunonin me Shtëpinë e Mendjendriturve të Heses dhe me grupe të tjera. E morën emrin nga mburoja e kuqe ose nga figura me gjashtë cepa e yllit të Davidit që gjendej në fasadën e shtëpisë së tyre në Frankfurt. Ylli i Davidit ose Vula e Solomonit është një simbol i lashtë ezoterik i cili u shndërrua në simbol të popullit hebre pasi Rotshildët nisën ta përdornin për veten e tyre. Nuk ka absolutisht asnjë lidhje me Davidin ose me Solomonin, siç pretendon historia hebreje. Rotshildët janë një nga degët kryesore të Shtëpisë së Mendjendriturve dhe të familjeve gjysmë-zvarranike të planetit. Më vjen qysh tani në vesh zëri që më dënon si antisemit, sepse Rotshildët e deklarojnë veten si hebrenj. Organizata të tilla si Lidhja kundër urrejtjes dhe B'nai B'rith kanë bërë përpjekje të mëdha për të hedhur poshtë pohimet e mia mbi këtë familje dhe për të më penguar mbajtjen e

LIBRI 24

konferencave (shih faqen time ne internet). Është për t'u theksuar se këto organizata janë krijuar nga vetë familja Rotshild. Një rastësi tjetër, asgjë për t'u shqetësuar! B'nai B'rith do të thotë "bij të aleancës". Kjo shoqëri u krijua nga Rotshildët në vitin 1843 si një armë e fshehtë kundër luftës që i bëhej kësaj familjeje dhe për të bllokuar kërkimet e të ashtuquajturve antisemitë. Shumë nga anëtarët e saj mbështesnin skllavërinë gjatë Luftës Civile Amerikane ndërsa sot dënojnë udhëheqësit me ngjyrë duke i quajtur antisemitë ose racistë. Çdo vit, Lidhja kundër urrejtjes ndan çmimin Pishtar i Lirisë (simboli klasik i Mendjendriturve) i cili u jepet mbështetësve më të mëdhenj të saj. Ky çmim mirënjohjeje i është dhënë Morris Dalicit, mik i afërt i të njohurit Majer Lanski, krimineli i madh që ka terrorizuar Amerikën. Zgjedhje e përkryer. Natyrisht ndjenjat që mbajnë gjallë flakën e dënimit të grupeve të ashtuquajtura anitisemite të sotme e kanë bazën te persekutimi i hebrenjve nga nazizmi. Të kryesh hetime ose të përmendësh emrat e Rotshildëve dhe të njerëzve të tjerë që deklarohen si hebrenj, mjafton që të të quajnë antisemit, racist, nazist, apo me përkufizime të tjera që përdorin për të poshtëruar gjithë kërkuesit dhe për t'u prerë rrugën të gjithë atyre që kanë mundësi të flasin në publik për këto argumente. Dhe mua më kanë akuzuar disa herë, për herë të fundit në Kanada, njerëz të këtyre dy organizatave që përmenda dhe të cilat, e përsëris, janë krijuar dhe ende kontrollohen nga Rotshildët. Siç e kam thënë dhe dokumentuar, përmes kërkimeve të shumta dhe të thella, Adolf Hitleri dhe nazistët e tij u krijuan nga vetë Rotshildët. Ata organizuan ngjitjen drejt pushtetit të Hitlerit përmes disa shoqërive të fshehta gjermane si Shoqëria Tule dhe Shoqëria Vril. Rotshildët e themeluan perandorinë hitleriane me ndihmën e Bankës së Anglisë dhe burimeve të tjera angleze dhe amerikane siç ishte Rotshild Loeb Bank, e cila organizoi dhe revolucionin rus. Zemra e makinës politike të Hitlerit qe I. G. Farben, gjigandi kimik që kontrollohej nga Rotshildët përmes një prej degëzimeve të saj të quajtur Varburgs. Paul Varburi, që më 1913 hyri në Bankën Qendrore të Amerikës dhe në Federal Rizërv, qe një nga drejtuesit e I. G. amerikane. Megjithatë, I. G. e Hitlerit, e cila organizoi edhe kampin e përqendrimit të Aushvicit, në të vërtetë qe degë e kompanisë Standard Oil, e cila kontrollohej zyrtarisht nga Rokfelerët (në të vërtetë perandoria e Rokfelerëve u krijua nga Rotshildët). Rotshildët zotëronin dhe agjencitë gjermane të lajmeve gjatë të dyja luftërave botërore duke kontrolluar kështu rrjedhën e informacioneve në Gjermani dhe në botë. Kur trupat aleate hynë në Gjermani, zbuluan se ndërmarrjet industriale I. G. Farben, bërthama e operacioneve luftarake të Hitlerit, nuk ishin goditur nga bombardimet, njëso si dhe uzinat e Fordit,

mbështetëse të tjera të Hitlerit, në zotërim të Mendjendriturve (Iluminatëve). Uzina të tjera pranë tyre qenë rrafshuar nga sulmet ajrore. Kështu, forca pas Adolf Hitlerit, forca pas Mendjendriturve, qe familja e Rotshildëve, kjo linjë gjaku hebreje e cila thotë se mbështet dhe mbron besimin dhe popullin hebre. Në fakt, ata e kanë përdorur dhe kanë abuzuar me popullin hebre për të arritur qëllimet e tyre të tmerrshme. Rotshildët, ashtu si gjithë Mendjendriturit në përgjithësi, e trajtojnë pa respekt popullin hebre. Hebrenjtë janë, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë globale, veçse bagëti që përdoren për të vendosur në një kontroll global një rrjet linjash gjenetike të ndërthurura, të kryqëzuara me një kod gjenetik zvarranik dhe që studiuesit e njohin me emrin Mendjendriturit. Në fakt, Mendjendriturit janë kaq të dhënë pas kësaj dege për shkak të kodit të tyre zvarranik saqë Hitleri, i cili hipi deri në majë të një pushteti aq të madh, nuk kishte si të qe gjë tjetër veçse një zvarranik. Nëse i hidhni një sy Shtojcës I, do të shihni sesi e njëjta linjë gjaku ka mbajtur pushtetin mbretëror, aristokrat, financiar, politik, ushtarak dhe mediatik të botës për mijëra vjet. Është e njëjta degë prej së cilës kanë dalë 42 presidentët e Shteteve të Bashkuara duke nisur që nga Xhorxh Uashingtoni në vitin 1789. Është e njëjta degë e Bushit dhe e rivalit të tij Al Gor. Edhe udhëheqësit e Luftës së Dytë Botërore Rusvelti, Çërçilli dhe Stalini, i përkisnin po kësaj dege, masonëve dhe satanistëve. Veprimet e tyre u manipuluan ndërsa vetë lufta u nis nga Rotshildët dhe Mendjendriturit e tjerë. Prandaj, nëse besojmë se pikërisht ky grup lejoi ngjitjen drejt pushtetit të Hitlerit, kjo do të thotë se Hitleri duhet t'i përkiste këtij grupimi. Nuk ka mundësi!... Hitleri nuk mund t'i përkasë grupit të Rotshildëve sepse, siç e dimë, Rotshildët janë mbrojtësit e popullit hebre ndërsa Hitleri i përndoqi hebrenjtë, komunistët, ciganët e të gjithë ata që i kundërviheshin. Rotshildët janë hebrenj, nuk do t'i kundërviheshin kurrë popullit të tyre, do të thoni ju. Vërtet?!! Por sipas studiuesve e hulumtuesve, Hitleri jo vetëm që u mbështet nga Rotshildët, por qe një prej tyre. Ky zbulim përputhet për mrekulli me veprimet e Rotshildëve dhe të degëve të tjera të Mendjendriturve në Gjermani që sollën Hitlerin dhe diktaturën në pushtet në atë vend. Madje ai mbështetej edhe nga familja mbretërore britanike, nga familja Uindsor (në të vërtetë nga familja gjermane e Saksoni-Koburg-Gothas) dhe, mes të tjerësh, edhe nga heroi i luftës britanike, lordi Mauntbaten, një Rotshild dhe satanist. Të afërmit e tij me gjak mbretëror në Gjermani, që nuk do ta kishin besuar kurrë se do të mbështesnin një djalosh rrugësh si Hitleri, në të vërtetë u bënë nga mbështetësit më të zjarrtë të tij. Sigurisht, ngaqë e dinin se kush ishte në të vërtetë Hitleri. Psikanalisti Uollter Langer, në librin e tij *"Mendja e Hitlerit"* ka shkruar: "Babai i Adolfit, Alois

Hitler, qe djali i paligjshëm i Maria Ana Shiklgruberit. Besohet se i ati i Alois Hitlerit (Shiklgruberit) është Johan Georg Hidleri. Disa dyshojnë seriozisht se ai mund të jetë babai i Aloisit. U përgatit në atë kohë një dokument austriak që thoshte se Ana Maria banonte në Vjenë para dhe gjatë kohës kur duhet të ishte shtatzënë. Në këtë kohë, punonte si shërbyese në shtëpinë e baronit Rotshild. Kur kjo familje zbuloi se qe shtatzënë, u dërgua në shtëpinë e saj, ku lindi Aloisin." Informacionet që ofron Langeri vijnë nga një zyrtar i Gestapos, Hansjurgen Këhler i cili, në vitin 1940, botoi një libër me titull "*Nga brenda Gestapos*". Studimet mbi prejardhjen e Hitlerit dhe familjen e tij i mbështet në dokumentet e kancelarit austriak Dolfus, të cilët i zotëronte Hejdrihu, shefi i madh i shërbimeve të fshehta naziste. Këhleri shkruan: "Dosja blu përmban dokumentet që ka mbledhur Dolfusi. Kancelari austriak, një burrë i vogël me zemër të madhe, i kishte mbledhur personalisht dokumentet që përmban kjo dosje për Hitlerin. Nuk e kishte pasur të vështirë. Si kryeministër i Austrisë, kishte pasur të drejtë të lexonte të dhënat vetjake të Hitlerit, pasi ky kishte lindur në tokën austriake. Kancelari austriak arriti të bashkonte pjesët e mozaikut duke mbledhur certifikata lindjeje, dokumente identiteti dhe protokolle të ndryshme, duke krijuar në mënyrë logjike identitetin e tij... Nëna e Aloisit kishte shkuar në Vjenë qysh e re dhe kishte gjetur punë në një nga familjet më të pasura të Vjenës. Por nuk pati fat: e mashtruan, e braktisën dhe u kthye në fshatin e saj. Kush ishte kjo familje? Nuk qe problem të gjendej. Kancelari Dolfus arriti ta zbulonte: ishte familja Rotshild. Babai i babait të Hitlerit qe një prej tyre".

Prandaj dhe Hitleri qe aq i vendosur të pushtonte Austrinë, që të shkatërronte çdo gjurmë të prejardhjes së tij. Një lexues kishte shkruar në faqen time në internet: "Më duket se Hitleri e dinte origjinën e tij edhe përpara se ta zbulonte kancelari. Ashtu si i ati para tij, edhe ai vetë shkoi në Vjenë. I ati qe larguar nga fshati në moshë të re për të kërkuar fatin në Vjenë. Pas vdekjes të së ëmës, në 1907, Adolfi u nis për në Vjenë, ku qëndroi i fshehur për dhjetë muaj. Ajo që ndodhi gjatë kësaj periudhë mbetet ende mister. Me sa duket, ka qëndruar pranë familjes së tij, te Rotshildët".

Rotshildët dhe Mendjendriturit kanë shumë pasardhës, por i mbajnë të fshehta programet e tyre të lindjeve ndërsa fëmijët rriten me emra të tjerë nga prindër të tjerë. Ashtu si Klintoni që është gati e sigurt se është bir i Rokfelerëve, i lindur pikërisht në këtë mënyrë, këta "bij të zakonshëm me prejardhje të thjeshtë", më pas, kanë sukses të madh në fushën që u është përcaktuar të ndjekin. Edhe Hitleri vetë me siguri që ka lindur fëmijë "jo zyrtarisht" me qëllim ruajtjen e degës së tij dhe sigurisht që njerëz të saj jetojnë ende dhe sot.

Atëherë, cili prej Rotshildëve është gjyshi i Hitlerit? Aloisi, babai i Adolfit, lindi në Vjenë në 1837, kur i vetmi Rotshild që jetonte aty ishte Solomon Majeri. Gruaja e tij ishte larguar pas prishjes së martesës. Djali i tyre, Anselm Solomon, e kalonte pjesën më të madhe të kohës në Paris dhe Frankfurt. Solomon Majeri na del kështu si kandidati numër një. Herman Fon Goldshmid, djali i një nëpunësi të Solomon Majerit, në 1917 shkroi një libër në të cilin thotë: "Nga viti 1840, ai tregonte hapur një lloj entuziazmi për vajzat e reja, një lloj pasioni për vajzat e vogla dhe aventurat e tij ishin raportuar disa herë në polici." Nëna e re e Hitlerit, duke jetuar nën një çati me të, pse nuk duhet të ishte objekt i vëmendjes së tij? Pse mbeti shtatzënë kjo vajzë ndërsa punonte atje? Pse nipi i saj u bë më pas kancelar i Gjermanisë, me mbështetjen e Rotshildëve, dhe shpërtheu Luftën e Dytë Botërore, kaq të rëndësishme për ta? Po Mendjendriturit pse kërkonin me kaq ngulm të shtrinin pushtetin në të dyja krahët e konfliktit? A janë Rotshildët një nga degët kryesore të Mendjendriturve? Mos vallë është vetëm rastësi? Hitleri qe një Rotshild!

Shënime

KAPITULLI 1

1. T.W. Doane, *Bible Myths, And Their Parallels In Other Religions* (Mite të Biblës dhe paralelet e tyre në besimet e tjera), Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA, USA 99347, botimi i parë më 1882, fq.10.

2. Për informacionet mbi pllakëzat sumere dhe mbi anunakët jam bazuar tek seria e librave të Zecharia Sitchin-it, të njohura përgjithësisht si *The Earth Chronicles* (Kronika të Tokës). Titujt e tyre të veçantë janë: *The 12th Planet* (Planeti i dymbëdhjetë), *The Stairway To Heaven* (Shkalla drejt Parajsës), *The Wars Of Gods And Men* (Luftërat ndërmjet perëndive dhe njerëzve), *The Lost Realms* (Mbretëritë e humbura) dhe *When Time Began* (Në fillim të kohës). Një tjetër vepër e tij është *Genesis Revisited* (Gjeneza e rivizituar). Janë të gjithë libra të botuar nga Avon Books, 1350 Avenue of the Americas, New York, USA.

3. *Genesis Revisited* (Gjeneza e rivizituar), fq.22.

4. *Po aty*, fq.161.

5. *Po aty*, fq.198.

6. *Po aty*, fq.199.

7. *Po aty*.

8. *Po aty*, fq.200.

LIBRI 24

9. Për një dokumentim të plotë mbi këto legjenda botërore dhe mbi bazën e tyre shkencore, shiko librin e shkëlqyer të D.S. Allen e J.B. Delair të titulluar *When The Earth Nearly Died* (Kur Toka rrezikoi të vdiste), Gateway Books Wellow, Bath, Inghilterra, 1995.

10. *Po aty*, fq.31.

11. *Po aty*, fq.32.

12. Maurice Ewing, "New Discoveries On The Mid-Atlantic Ridge" (Zbulime të reja në kreshtën medioatlantike), në *National Geographic*, nëntor 1949, fq.614-616.

13. *When The Earth Nearly Died*, fq.32-33.

14. *Po aty*, fq.34.

15. Charles Berlitz, *Atlantis, The Eighth Continent* (Atlantida, kontinenti i tetë), Fawcett Books, New York, 1984, fq.96-101.

16. *Po aty*.

17. *When The Earth Nearly Died*, fq.25-28.

18. Brian Desborough, "The Great Pyramid Mystery, Tomb, Occult Initiation Center, Or What?" (Misteri i piramidës së madhe: varr, qendër ceremonish okulte apo çfarë tjetër?), një dokument i dhënë nga autori dhe i botuar edhe në gazetën *The California Sun* e Los Anxhelesit.

19. *Po aty*.

20. *Po aty*.

21. *Po aty*.

22. *When The Earth Nearly Died*, paraqet një dokumentim mbresëlënës për të treguar se Era Akullnajore është diçka mitike.

23. "The Great Pyramid Mystery".

24. *Po aty*.

25. *Po aty*.

26. *Po aty*.

27. *Po aty*.

28. *Po aty*.

29. *Po aty*.

30. *Po aty*.

31. *Po aty*.

32. *Po aty*.

33. *Po aty*.

34. Preston B. Nichols e Peter Moon, *Pyramids Of Montauk* (Piramidat e Montaukut), Sky Books, New York, 1995, fq.125.

35. *Po aty*, fq.129.

LIBRI

KAPITULLI 2

1. Arthur David Horn, *Humanity's Exstraterrestrial Origins, ET Influences On Humankind's Biological And Cultural Evolution* (Origjinat jashtëtokësore të njerëzimit, ndikimet jashtëtokësore mbi evolucionin biologjik e kulturor të gjinisë njerëzore), A e L Horn, PO Box 1632, Mount Shasta, California, 96067, 1994.

2. Jason Bishop III, *Matrix 11* (Matriks 11), nën kujdesin e Valdamar Valerian, Arcturus Book Service, USA, 1990, fq.96.

3. John Bathurst Deane, *The Worship Of The Serpent* (Kulti i gjarpërit), J.G. e F. Rivington, Londra, 1833.

4. *Bible Myths*, fq.11.

5. *Po aty*, fq.15.

6. *Po aty*, fq.12.

7. Francis Hitching, *The World Atlas Of Mysteries* (Atlasi botëror i mistereve), Pan Books, Londra, 1981, fq.10, pjesa e titulluar "Vdekja e dinosaurve".

8. *Po aty*.

9. *Po aty*.

10. John Rhodes, faqe interneti mbi formëzvarranikët, http://www.reptoids.com.

11. Dale Russell, *Exponential Evolution: Implications For Intelligent Exstraterrestrial Life* (Evolucion eksponencial: ndërlikime për një jetë jashtëtokësore me arsye), Advanced Space Research, 1983.

12. *The World Atlas Of Mysteries*, fq.159.

13. *Po aty*.

14. Herbert S. Zim e Robert H. Baker, *Stars, A Golden Guide* (Guida Golden e yjeve), Golden Press, New York, 1985, fq.58.

15. Graham Hancock, *Quest For The Lost Civilisation* (Në kërkim të qytetërimit të humbur), Channel Four, 1998.

16. Phillip Calahan, *Ancient Mysteries And Modern Visions* (Mistere të lashta dhe vegime të ditëve tona), Acres, Kansas City, USA, 1984.

17. Shiko faqen e internetit të John Rhodes, http://www.reptoids.com.

18. Është për sa shkruan John Rhodes në faqen e tij të internetit.

19. William Bramley, *Gods of Eden* (Perëndi të Edenit), Avon Books, New York.

20. Revista *Nexus*, prill-maj 1994, fq.52-54.

21. "Explorations In Grand Canyon" (Zbulime në Kanionin e Madh), tek *Arizona Gazette*, 5 prill 1909.

22. John Rhodes, *The Human-Reptilian Connection* (Lidhja njerëzoro-zvarranike), e shtypur privatisht dhe e shpërndarë në vitin 1993.
23. *Po aty.*
24. *Po aty.*
25. *Po aty.*
26. *Po aty.*
27. Cathy O'Brien e Mark Phillips, *Trance Formation Of America* (Formimi trans i Amerikës), Reality Marketing Inc., Las Vegas, Nevada, USA, 1995.
28. *Po aty*, fq.165-166.
29. *Po aty*, fq.165.
30. *Po aty*, fq.209-210.
31. *Po aty.*
32. *Po aty*, fq.174.
33. Hunter S. Thompson, *Fear And Loathing In Las Vegas* (Frikë dhe neveri në Las Vegas), Vintage Books, New York, 1998, botimi i parë më 1971.
34. *Cymatics, The Healing Nature Of Sound* (Semantika, vetitë kuruese të tingullit), video e disponueshme pranë MACROmedia, PO Box 279, Epping, NH 03042, USA.
35. *Los Angeles Times e Herald Examiner*, 21 korrik 1988.
36. *The Arrival* (Arritja), Steelworks Films, 1988.
37. *They Live* (Ata jetojnë), Alive Films, 1988.
38. *Alien Resurrection* (Ringjallje alienë), 20th Century Fox, 1997.
39. *V: The Final Battle* (V: beteja finale), Warner Brothers Television, 1984 dhe Warner Brothers Home Video, 1995.
40. Alex Christopher, *Pandora's Box Volumes I and II* (Vazoja e Pandorës, volumi i parë dhe i dytë), të disponueshëm pranë Pandora's Box, 2663 Valleydale Road, Suite 126, Birmingham, Alabama 35224.
41. Alex Christopher gjatë një bisede në radion KSEO, në USA, më 26 prill 1996, transkriptuar nga Leading Edge Research Group.
42. Jason Bishop III, i cituar tek *Leading Edge.*
43. Jason Bishop III, *Matrix 11*, nën kujdesin e Valdamar Valerian, Arcturus Book Service, USA, 1990, fq.96.
44. *Po aty.*
45. *Matrix 11*, fq.100c-100d.
46. Andrew Collins, *From The Ashes of Angels, The Forbidden Legacy Of A Fallen Race* (Nga hiri i engjëjve, trashëgimi i ndaluar i një race të rënë nga qielli), Signet Books, Londra, 1997, fq.35.
47. *A Genesis Apocryphon* (Një apokrif i Gjenezës), përkthim i një pjese të

Rrotullave të Detit të Vdekur të Naham Avigad e YigaelYadin, botuar në vitin 1956 nga Universiteti hebraik i Jeruzalemit.
48. *Firdowsi, The Shah Nameh Of The Persian Poet Firdausi* (Firdovsi, Shahu Nemeh i poetit persian Firdusi), përkthyer nga James Atkinson, Frederick Warne, Londra, 1886.
49. Christian O'Brien e Joy O'Brien, *The Genius Of The Few – The Story of Those Who Founded The Garden of Eden* (Talenti i ta paktëve – Historia e atyre që krijuan Kopshtin e Edenit), Turnstone Press, Wellingborough, Inghilterra, 1985.
50. *From The Ashes Of Angels*, fq.268-269.
51. *Po aty.*
52. L.A. Waddell, *The Phoenician Origin Of Britons, Scots And Anglo-Saxons* (Origjina fenikase e britanikëve, e skocezëve dhe e anglosaksonëve), The Christian Book Club of America, Hawthorne, California, botimi i parë më 1924, fq.65.
53. *From The Ashes Of Angels*, fq.191.
54. *Po aty.*
55. *Libri i Dytë i Enoch*-ut, 1, 4-5.
56. *Rivelazione*, 12, 9.
57. *Po aty*, 20, 2-3.
58. Geza Vermes, *The Dead Sea Scrolls In English* (Rrotullat e Detit të Vdekur në anglisht), Penguin Books, Harmondsworth, 1990.
59. *Po aty*, fq.7.

KAPITULLI 3

1. Brian Desborough, *The Great Pyramid Mystery.*
2. *Po aty.*
3. *Po aty.*
4. *Po aty.*
5. *Po aty.*
6. Geoffrey Higgins, *Anacalypsis* (Anakalipsi), botimi i parë në vitin 1836, ribotuar në vitin 1972 nga Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA, USA 99347, vol.1, fq.368.
7. *The Great Pyramid Mystery.*
8. *Po aty.*
9. *Po aty.*
10. *Po aty.*
11. *Po aty.*

LIBRI

12. *Po aty.*
13. *Po aty.*
14. *Po aty.*
15. *Po aty.*
16. *Libri i Parë i Enoch*-ut, 7, 2-6.
17. *The Universe* (Universi), Life National Picture Library, Time-Life International, Vendet e Ulta, 1964, fq.85-94.
18. *Po aty.*
19. *Po aty.*
20. Adrian G. Gilbert e Maurice M. Cotterell, *The Mayan Prophecies* (Profecitë e majave), Element Books, Shaftesbury, Angli, 1995.
21. I cituar tek *The Occult Conspiracy*, fq.28.
22. Manly P. Hall, *The Secret Teachings Of All Ages* (Doktrinat e fshehta të të gjitha kohërave), The Philosophical Research Society, Los Angeles, California, 1988, fq.A1.
23. *From The Ashes Of Angels*, fq. 93.
24. L.A. Waddell, *The Phoenician Origin Of Britons*, fq.11.
25. *Po aty*, fq.13.
26. E.Raymond, *Missing Links Discovered In Assyrian Tablets* (Hallkat që mungojnë, të zbuluara në pllakëzat asire), Artisan Sales, Thousand Oaks, California, 1985, fq.145.
27. *The Phoenician Origins Of Britons*, fq.48.
28. *Po aty*, fq.39.
29. *Po aty*, fq.40.
31. *Po aty*, fq.231.
32. Richard Hoagland, *Monuments On Mars* (Monumente të Marsit), North Atlantic Books, California, USA, 1996.
33. *The Cosmic Connection*, fq.108.
34. *The Great Pyramid Mystery.*
35. *Rig Veda.*
36. *The Phoenician Origin Of Britons*, fq.65.
37. *Po aty.*
38. *Po aty*, fq.62.
39. *Po aty*, fq.27.
40. *Po aty*, fq.54.
41. Bob Quinn, *Atlantean, Ireland's North African And Maritime Heritage* (Atlantida, trashëgimia afrikanoveriore dhe detare e Irlandës), Quertet Books, Londra, 1986, fq.19. Një përmbledhje me të vërtetë e vlefshme me prova që e

rikthejnë Irlandën tek Afrika e Veriut.
42. Heinz Edgar Kiewe, "The Sacred History of Knitting" (Historia e shenjtë e bluzës), cituar tek *Atlantean*, fq.155-160.
43. *Atlantean*, fq.30.
44. Steve Jones, *In The Blood* (Në gjak), Harper Collins, Londra, 1996, fq.126.
45. *The Secret Teachings Of All Ages*, fq.XXII-XXIII.
46. *Po aty.*

KAPITULLI 4

1. *The Phoenician Origin Of Britons*, fq.47.
2. Arthur Dynott Thomson, *On Mankind, Their Origin And Destiny* (Mbi njerëzimin, origjina dhe fati i tij), Kessinger Publishing, PO Box 160, Kila, MT 59920, USA, botimi i parë në vitin 1872, fq.27.
3. *Po aty*, fq.8-9.
4. *Po aty*, fq.9.
5. Michael Drosnin, *The Bible Code* (Kodi biblik), Weindenfeld and Nicolson, Londra, 1997.
6. *On Mankind, Their Origin And Destiny*, fq.17.
7. *Po aty*, fq.6.
8. *Po aty*, fq.18-19.
9. *Po aty*, fq.19.
10. *Po aty*, fq.41.
11. *Po aty*, fq.12.
12. *Po aty.*
13. *Po aty*, fq.20.
14. *Po aty*, fq.11.
15. *The Secret Teashings Of All Ages*, fq.L.
16. *The Phoenician Origin Of Britons*, fq.147.
17. Këto shembuj (dhe ka të tjerë të pafund) janë cituar nga Israel Shahak tek *Jewish History, Jewish religion* (Historia hebraike, besimi hebraik), Pluto Press, Londra, 1994.
18. Benjamin Freedman, *Facts Are Facts* (Faktet janë fakte), cituar nga Jan Van Helsing tek *Secret Societes And Their Power In The 20th Century* (Shoqëritë e fshehta dhe pushteti i tyre në shekullin XX), Ewertverlag, Gran Canaria, Spagna, 1995, fq.99.
19. Alfred M. Lilenthal, *What Price Israel?* (Me çfarë çmimi Izraelin?), Henry Regnery, Chicago, 1953, fq.213-214.

LIBRI 24

20. Arthur Koestler, *The Thirteenth Tribe – The Khazar Empire And Its Heritage* (Fisi i trembëdhjetë – Perandoria Khazar dhe trashëgimia e saj), Hutchinson, Londra, 1976.

21. *The Book Your Church Does't Want You To Read* (Libri që kisha juaj nuk dëshiron ta lexoni), nën kujdesin e Tim C. Leedom, Kendhall/Hunt Publishing, Iowa, USA, 1993, fq.137. I disponueshëm tek Truth Seeker Company, PO Box 2872, San Diego, California, 92112.

22. *Po aty*, fq.135.

23. Albert Churchward, *Of Religion* (Mbi besimin fetar), botuar për herë të parë në vitin 1924 dhe sot e gjendshëm pranë Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA 99347, Shtetet e Bashkuara.

24. T.W. Doane, *Bible Myths* (Mite biblike), Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA 99347, Shtetet e Bashkuara. Botuar për herë të parë në vitin 1882, rishtypur në vitin 1948 dhe i gjendshëm në adresën e mësipërme. Jua këshilloj nxehtësisht, veçanërisht nëse jeni të krishterë.

25. *The Phoenician Origin Of Britons*, parathënie, fq.XI.

26. *Po aty*.

27. Jordan Maxwell, *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.19-31.

28. *The Secret Teachings Of All Ages*, fq.CLXXXIII.

29. *Po aty*, fq.CLXXXIII.

30. Barbara G. Walker, *The Woman's Encyklopedia Of Myths And Secrets* (Enciklopedia femërore e miteve dhe sekreteve), Harper Collins, San Francisco, 1983.

31. Jordan Maxwell, *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.27.

33. John Allegro, *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.228-233.

34. Laurence Gardner, *Bloodline Of The Holy Grail* (Fisi i Gralit të Shenjtë), Element Books, Shaftsbury, 1996, fq.63.

35. Alan Albert Snow, drejtor i Institutit të Studimeve mbi Origjinat judeo-kristiane, *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.63-66.

36. *On Mankind, Their Origin and Destiny*, fq.368.

37. *Aktet e Apostujve*, 24, 5.

38. Albert Snow, *Astrology In The Dead Sea Scrolls* (Astrologjia tek Rrotullat e Detit të Vdekur), *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.65.

39. *Psalme*, 80, 8.

40. *Isaia*, 5, 7.

41. *The Occult Conspiracy*, fq.14.

42. *Jordan Maxwell, The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.29.

43. *Luka*, 2, 7.

44. *Bloodline Of The Holy Grail*, fq.37.

45. *Po aty*, fq.36-37.

46. *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.182-183.

47. Christopher Knight e Robert Lomas, *The Hiram Key* (Çelësi Hiram), Arrow Books, London, 1997, fq.310.

48. John E. Remsburg, *The Book Your Church Doesn't Want You To Read*, fq.171.

49. *Po aty*.

50. *Po aty*, fq.172.

KAPITULLI 5

1. Abelard Reuchlin, *The True Autorship Of The New Testament* (Autori i vërtetë i Testamentit të Ri), the Abelard Reuchlin Foundation, PO Box 5652, Kent, WA, USA, 1979.

2. *Po aty*, fq.1.

3. *Po aty*, fq.4-5.

4. *Po aty*, fq.12.

5. *Po aty*, fq.5.

6. *Po aty*, fq.22.

7. Michael Howard, *The Occult Conspiracy* (Konspiracioni i fshehtë), Destiny Books, Rochester, Vermont, 1989, fq.18.

8. *Bloodline Of The Holy Grail*, fq.132.

9. *The True Autorship Of The New Testament*, fq.11.

10. *Po aty*, fq.14.

11. *Aktet*, 9, 17-18.

12. *Leter Romakëve*, 16, 11.

13. *The True Autorship Of The New Testament*, fq.15.

14. *Po aty*, fq.15.

15. *Po aty*, fq.16.

16. *Po aty*, fq.15.

17. *Po aty*, fq.27.

18. Arthur Findlay, *The Curse Of Ignorance, A History Of Manking* (Mallkimi i injorancës, histori e gjinisë njerëzore), Headquarters Publishing Company, Londër, botimi i parë në vitin 1947, vol.1, fq.549.

19. *Mateu*, 16, 18-19.

LIBRI 24

20. *Mateu*, 16, 23.
21. *Thye Occult Conspiracy*, fq.18.
22. *Po aty.*
23. *Po aty.*
24. *The Curse Of Ignorance*, vol.1, fq.549.
25. *Po aty*, fq.637.
26. Morton Smith, *The Book Your Church Doesen't Want You To Read*, fq.176.
27. *Marku*, 10, 17-23.
28. Morton Smith, *The Secret Gospel* (Ungjilli i fshehtë), Victor Gollancz, Londra, 1974.
29. Cituar nga Eustace Mullins tek *The Curse Of Cannan* (Mallkimi i Kananit), Revelation Books, PO Box 11105, Staunton, VA, fq.44.
30. Fritz Springmeier, *The Top 13 Illuminati Bloodlines* (13 familjet e para të Mendjendriturve), Springmeier, Lincoln, Portland, Oregon, 1995, fq.151.
31. William Cooper, *Behold A Pale Horse* (Vrojto një kalë të bardhë), Light Technology Publishing, PO Box 1495, Sedona, Arizona, USA, 1991, fq.212-213.

KAPITULLI 6

1. *From The Ashes Of Angels*, fq.12.

KAPITULLI 7

1. Geoffrey Higgins, *Anacalypsis*, ribotuar në vitin 1972 nga Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA 99347, USA, botimi i parë në vitin 1836.
2. Michael Baigent, Richard Leigh e Henry Lincoln, *Holy Blood, Holy Grail* (Gjak i shenjtë, Gral i shenjtë), Corgi Books, London, 1982, fq.449-450.
3. Joy Hancox, *The Byrom Collection* (Përmbledhja Byrom), Jonathan Cape, London, 1992, fq.131.
4. *The Occult Conspirancy*, fq.48.
5. David Wood e Ian Campbell, *Geneset* (Një tërësi genesh), Bellevue Books, Sunbury on Thames, Inghilterra, 1994, fq.104-105.
6. Lynn Picknett e Clive Prince, *The Templar Revelation* (Zbulimi i Templarëve), Bantam Press, London, fq.45.
7. *Po aty.*
8. *Po aty.*
9. *Po aty.*
10. *Po aty*, fq.49.

LIBRI 24

11. *Po aty*, fq.68.
12. *Po aty.*
13. *Geneset*, fq.34.
14. *Holy Blood, Holy Grail*, fq.33.
15. *Geneset*, fq.36.
16. *Po aty.*
17. *The Templar Revelation*, fq.43.
18. *Po aty.*
19. *Holy Blood, Holy Grail*, fq.27.
20. *Po aty*, fq.159.
21. *Po aty.*
22. Cituar nga Francis King tek *Satan And Swastica* (Satanaja dhe kryqi i thyer), Mayflower Books, London, 1976.
23. *Holy Blood, Holy Grail*, fq.29.
24. *Po aty*, fq.97.
25. *Po aty.*
26. *Geneset*, fq.33.
27. *Po aty*, fq.33.
28. *The Woman's Encyclopedia Of Myths And Secrets*, fq.866-867.
29. *Po aty.*
30. *Po aty.*
31. Richard Andrews e Paul Schellenberger, *The Tomb Of God* (Varri i Perëndisë), Little Brown, Londra, 1996, fq.177.
32. *Po aty*, fq.187.
33. *Po aty*, fq.132.
34. *Po aty*, fq.259.
35. *Po aty*, fq.172-173.

KAPITULLI 8

1. *The Occult Conspiracy*, fq.51.
2. Michael Baigent e Richard Leigh, *The Temple And The Lodge*, Arcade Publishing, New York, 1989, fq.106.
3. *Holy Blood, Holy Grail*, fq.446-447.
4. *Po aty.*
5. *Po aty*, fq.141.
6. Gerard de Sede ka shkruar një sërë librash, midis të cilëve *L'Or de Rennes* (Ari i Renesë), Paris, 1967; *La Race Fabuleuse* (Raca përrallore), Paris, 1973; *Le Vrai Dossier de l'Enigme de Rennes* (E vërteta mbi enigmën e Renesë),

Vestric, 1975; *Les Templiers Sont Parmi Nous* (Tempullarët janë midis nesh), Paris, 1976, dhe *Signe: Rose+Croix* (Simboli i trendafilit dhe i kryqit), Paris, 1977.

7. *The Occult Conspiracy*, fq.47.
8. *Po aty*, fq.74.
9. Manly P. Hall, *The Secret Teachings Of All Ages.*
10. *The Curse Of Ignorance*, vol.II, fq 30.
11. *Po aty*, fq.32.
12. *The Occult Conspiracy*, fq.51-52.
13. George C. Andrews, *Exstra-Terrestrials Among Us* (Jashtëtokësorët midis nesh), Llewellyn Publications, St Paul, Minnesota, USA, 1993, fq.76.
14. *The Secret Teachings Of All Ages*, fq.CLXV-CLXVIII.
15. *Po aty.*
16. *Po aty.*
17. *Po aty.*
18. *The Templar Revelation*, fq.137.
19. *The Secret Teachings Of All Ages*, fq.CLXVI.
20. *Po aty*, fq.CLXV.
21. *Po aty*, fq.CLXVI.
22. *Po aty*, fq.CLXVI.
23. *Po aty*, fq.CLXXIV.
24. *Po aty.*
25. *Po aty.*
26. *The Occult Conspiracy*, fq.17.
27. *The Curse Of Ignorance*, vol.II, fq.219.
28. *The Curse Of Cannan*, fq.44.
29. Frederick J. Pohl, *Prince Henry Sinclair – His Exspedition To The New World In 1398* (Princi Henri Sinkler dhe ekspedita e tij e vitit 1398 në Botën e Re), Nimbus Publishing, Halifax, New Scotland, botimi i parë në vitin 1967, fq.18.
30. *Po aty.*
31. *The Temple And The Lodge*, fq.119.
32. *Po aty*, fq.120.
33. *Po aty.*
34. Cituar tek *The Curse Of Cannan*, fq.83.
35. *Po aty*, fq.83.
36. *Po aty*, fq.84.
37. *The Temple And The Lodge*, fq.187.

LIBRI 24

38. *Po aty*, fq.189.
39. *The Curse Of Cannan*, fq.40.
40. *The Templar Revelation*, fq.139.
41. *Po aty*, fq.139-140.
42. *The Occult Conspiracy*, fq.56.
43. Ian T. Taylor, *In The Minds Of Men – Darvin And The New World Order* (Në mendjen e njerëzve – Darvini dhe Rendi i Ri i Botës), TFE Publishing, Toronto, Canada, 1984, fq.55. Bëhet fjalë për një studim të shkëlqyer mbi atë mashtrimin e quajtur "shkencë".
44. *Po aty*, fq.58.
45. *Po aty*, fq.55.
46. *Po aty*, fq.59-65.
47. Nga një vepër që ai e ka quajtur *Sprovë*, që i takon vitit 1878.
48. *In The Minds Of Men*, fq.63.
49. *Po aty*, fq.29.

KAPITULLI 9

1. *Prince Henry St Clair's Voyage To The New World*, fq.160.
2. Manly P. Hall, *America's Assignment With Destiny, The Adepts In The Western Tradition.* Philosophical Research Society, Los Angeles, 1979, pjea e pestë, fq.50.
3. James Shelby Dwnard, "Sorcery, Sex, Assassination, and the Science of Symbolism" (Shtrigëri, seks, vrasje dhe shkenca e simbolizmit), një artikull i botuar në librin *Secret And Suppressed* (Sekret dhe okultizëm), nën kujdesin e Jim Keith, Feral House, PO Box 3466, Portland, Oregon 97208, 1993, fq.62.
4. *Po aty*, fq.61.
5. *Po aty.*
6. *Po aty*, fq.62.
7. *The Temple And The Lodge*, fq.238.
8. John Daniel, *Scarlet And The Beast* (Skarleti dhe bisha), vol.III, *English Freemasonry, Banks And The Drug Trade* (Masoneria angleze, bankat dhe trafiku i drogës), JKI Publishing, Tyler, TX, USA, fq.63.
9. *Po aty.*
10. *Po aty*, fq.64.
11. Anton Chaitkin, *Treason In America* (Tradhëti në Amerikë), botimi i dytë, New Benjamin Franklin House, New York, 1984, fq.217.
12. *Scarlet And The Beast*, fq.64.
13. *Po aty*, fq.75.

14. *Po aty.*
15. *Po aty*, fq.76.
16. *The Temple And The Lodge*, fq.237.
17. *Po aty.*
18. Lord Stormont në një letër drejtuar Xhorxhit III, *The Correspondence Of George The Third* (Korrespondenca e Xhorxhit III), vol.V, fq.24, letra nr.2952, 1 mars 1780.
19. *The Temple And The Lodge*, fq.238.
20. *America's Assignment With Destiny*, fq.101-102.
21. *Po aty*, fq.102.

KAPITULLI 10

1. Hirsch M. Goldberg, *The Jewish Connection* (Lidhja hebraike), Stein and Day, New York, 1976, fq.197.
2. O.J. Graham, *The Six Pointed Star* (Ylli me gjashtë cepa), cituar nga Fritz Springmeier tek *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, Springmeier, 5316 S.E. Lincoln, Oregon, USA, 1995, fq.184.
3. Ky citim shfaqet në shumë libra mbi Rotshildët, përfshirë *Secret Societes And Their Power In The 20th Century* (Shoqëritë e fshehta dhe pushteti i tyre në shekullin XX), të Jan Van Helsing, botuar nga Ewertverlag, Gran Canaria, Spagna, 1995. Citimi gjendet në fq.39.
4. *The Templar Revelation*, fq.131.
5. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.173.
6. *Po aty.*
7. *Po aty.*
8. *Po aty.*
9. *Po aty*, fq.171.
10. Albert Schweitzer, *The Quest For The Historical Jesus* (Kërkimi i Jezusit historik), Macmillan Publishing, New York, 1968, fq.158.
11. Homer Smith, *Man And His Gods* (Njeriu dhe perënditë e tij), Grossetts University Library, New York, 1956, fq.190.
12. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.176.
13. *Po aty.*

KAPITULLI 11

1. John Coleman, *Committee Of 300, The Conspirators Hierarchy* (Komiteti i 300-ve, hierarkia e konspiratorëve), Joseph Holding Company, Nevada, USA, 1995.

LIBRI 24

2. Fritz Springmeier e Cisco Wheeler, *The Illuminati Formula Used To Create An Undetectable Total Mind Controlled Slave* (Formula e Mendjendriturve për të krijuar një skllav jo të dallueshëm me mendje krejtësisht të kontrolluar), Springmeier, S.E. Clackamas Road, Clackamas, Oregon, 97015, 1996, fq.61. Që këtej e tutje do t'i referohem këtij libri si *The Illuminati Formula.*
3. *Po aty.*
4. *The Occult Conspiracy.*
5. *Po aty*, fq.117.
6. Frazë e shqiptuar në një audiencë dëgjimi të Komisionit të pasluftës Graham, që hetoi mbi Baruch-in.
7. Norman Dodi i bëri të ditura këto zbulime në një intervistë me shkrimtarin William H. McIllhany II, për librin e tij të vitit 1980 me titullin *The Tax Exempt Foundations* (Arlington House, Westport, USA). Komisioni i veçantë i hetimit mbi Fondacionin e përjashtuar nga taksat referoi në vitin 1954. E kishte marrë emrin nga kryetari i tij, deputeti B.Karol Ris i Teneses.
8. *Po aty.*
9. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.154.
10. Gazeta *The Spotlight*, 16 maj dhe 12 shtator 1994.
11. *Bulletin Of Atomic Scientists*, tetor 1946.
12. Dokumente të politikës së jashtme britanike, 1919-1939, seria e parë, vol IV, fq.245-247.
13. *The Occult Conspiracy*, fq.93.
14. *Po aty.*
15. *Po aty.*
16. *Po aty.*
17. *Po aty*, fq.94.
18. *Po aty*, fq.96.
19. Revista *Scallywag*, numur 26, 1994, fq.35.
20. *Po aty.*
21. Një ilustrim që portretizon këtë ngjarje paraqitet tek *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.100.
22. *The Churchills* (Çurçillët), televizion i pavarur, maj 1995.
23. Cituar nga A.H.M. Ramsey tek *The Nameless War* (Lufta pa emër), Omni Publications, London, 1952.
24. Regjistri i Kongresit, Kongresi 76të, vol.84, nr.82, fq.6597-6604.
25. Jim Keith, *Casebook On Alternative 3* (Regjistri mbi alternativën 3), IllumiNet Press, Lilburn, USA, 1994, fq.25.
26. *The Curse Of Cannan*, fq.54.

27. *Po aty.*
28. *Po aty.*
29. *Po aty.*
30. James Perloff, *The Shadows Of Power: The Coincil On Foreign Relations And The American Decline* (Hijet e pushtetit: Këshilli mbi Marrëdhëniet e Jashtme dhe rënia amerikane), fq.71.

KAPITULLI 12

1. Cituar nga J.H. Brennan tek *Occult Reich* (Rajhu okult), Futura, London, 1974 dhe nga Francis King tek *Satan And Swastica* (Satanaja dhe kryqi i thyer), Mayflower Books, London, 1976.
2. Vargje nga *The Book Of Law*. Cituar nga George C. Andrews tek *Exstraterrestrials Among Us* (Jashtëtokësorët midis nesh), fq.159-160.
4. Cituar nga Trevor Ravenscroft tek *The Spear Of Destiny* (Shigjeta e fatit), Samuel Weiser, Maine, USA, 1973, fq.106.
5. Alan Bullock, *Hitler, A Study In Tiranny* (Hitleri, një studim mbi tiraninë), Pelican Books, London, 1960.
6. Hermann Rausching, *Hitler Speaks* (Flet Hitleri), London, 1939.
7. *Po aty.*
8. Thuhet se Rudolph Hess (Rodolf Hes) është mbajtur në burgun e Spandaut deri në vdekjen e tij në vitin 1987. Por doktor Euin Kamerun, që u bë një "doktor i mendjes", thotë se ka mësuar nga kreu i CIA-s, Alen Dallesi, se "Hess"-i i Spadaut ishte një sozi. Kur Kameruni provoi t`i verifikonte identitetin, duke e vizituar "Hess"-in e duke i gjetur një plagë që i takonte Luftës së Parë Botërore, nuk u lejua ta bënte.
9. George C. Andrews, *Exstraterrestrial Friends And Foes* (Jashtëtokësorë miq dhe armiq), Illuminet Press, Lilburn, GA, USA, 1993, fq.53.
10. Jan van Helsing, *Secret Societes And Their Power In The 20th Century* (Shoqëritë e fshehta dhe pushteti i tyre në shekullin XX), ETC.
11. *Po aty*, fq.179-180.
12. *Po aty*, fq.180.
13. J.H. Brennan, *Occult Reich.*
14. John Rhodes, faqe në internet mbi formëzvarranikët.
15. Raymond Bernard, *The Hollow Earth, The Greatest Discovery In History* (Toka e zgavërt: zbulimi më i madh i historisë), Carol Paperback, New York, 1991.
16. *Po aty*, fq.38.
17. Alec MacLellan, *The Lost World Of Agharti, The Mystery Of Vril Power*

(Bota e humbur e aghartëve, misteri i forcës Vril), Souvenir Press, 43 Great Russell Street, London, WC1B 3PA, 1982, fq.33. Bëhet fjalë për një tjetër sintezë të shkëlqyer të provave që dëshmojnë ekzistencën e popujve brenda-tokësorë.
18. *Po aty.*
19. *Po aty.*
20. *Secret Societes And Their Power In The 20th Century*, fq.179.
21. *Po aty*, fq.190-191.
22. Video *UFO – The Secrets Of The Third Reich* (UFO – Sekretet e Rajhut të Tretë), European UFO Archive, PO Box 129, Vendet e Ulëta -8600 AC Sneek.
23. *Secret Societes*, fq.193.
24. Webster Griffin Tarpley e Anton Chaitkin, *George Bush, The Unauthorised Biografy* (Xhorxh Bushi, një biografi jo e autorizuar), Executive Intelligence Review, Washington DC, 1992, fq.49.
25. Leonard G. Horowitz, *Emerging Viruses* (Viruse që dalin në dritë), Tetrahedron Inc., Rockport, MA, USA, 1996.
26. *Exstraterrestrial Friends And Foes*, fq.53.

KAPITULLI 13

1. *The Illuminati Formula*, fq.7.
2. Anthony C. Sutton, *Wall Street And The Rise Of Hitler* (Uoll Striti dhe ngjitja e Hitlerit), Heritage Publications, Melbourne, Australia, and Bloomfield Books, Sudbury, Suffolk, Inghilterra, 1976, fq.39, dhe *Trilateralsim, The Trilateral Commission And The Élite Planing For World Management* (Trilateralizmi, Komisioni Trilateral dhe planet e Elitës për qeverinë botërore), nën kujdesin e Holly Sklar, South End Press, Boston, USA, 1980, fq.182.
3. Cituar tek *The Conspirators Hierarchy: The Story Of The Commitee of 300* (Hierarkia e konspiratorëve: historia e Komitetit të 300-ve), fq.15.
4. Fintan O'Toole, *Brand Leader, An Investigation Of Tony O'Reilly* (Prodhimi më i shitur i klasit të tij, një hetim mbi Tony O'Reilly-n), Granta, fq.72.
5. *Po aty*, fq.61-62.
6. *Po aty*, fq.47.
7. *Po aty*, fq.58.
8. Revista *Private Eye*, nr.956, e premte 7 gusht 1998, fq.6.
9. *Po aty.*
10. Cituar nga Eustace Mullins tek *The World Order, Our, Secret Rulers* (Rendi i botës, krerët tanë të fshehtë), Ezra Pound Institute of Civilisation,

LIBRI 24

Staunton, VA, USA, 1984, fq.248.

11. Merry e Serge Bromberger, *Jean Monnet And The United States Of Europe* (Zhan Moneja dhe Shtetet e Bashkuara të Evropës), Coward-McCann Publishers, New York, 1969, fq.123.

KAPITULLI 14

1. *Scarlet And The Beast*, fq.15.
2. *Po aty.*
3. *Po aty.*
4. *Po aty*, fq.11.
5. *Po aty*, fq.13.
6. *Po aty*, fq.31.
7. *US News And World Report*, 4 gusht 1986.
8. *Scarlet And The Beast*, fq.23.
9. *Po aty.*
10. "State Organised Crime, The Presidential Address" (Krimi i organizuar nga shteti, diskutimi presidencial), i William J. Schambliss, në Shoqatën amerikane të kriminologjisë, 1988.
11. Rodney Stich, *Defrauding America* (Duke mashtruar Amerikën), Diablo Western Press, Alamo, California, 1994, fq.355.
12. *Po aty.*
13. Michael Collins Piper, *Final Judgement, The Missing Link In The JFK Assassination* (Gjykimi final. Hallka që mungon në vrasjen e J.F.Kenedit), The Wolfe Press, Washington DC. 1995, fq.92.
14. *Defrauding America*, fq.295.
15. *Scarlet And The Beast*, fq.33 dhe fq.35.
16. *Po aty*, fq.36.

KAPITULLI 15

1. Nigel Davies, *Human Sacrifice, In History And Today* (Flijimi njerëzor, në histori dhe sot), William Morrow and Company, New York, fq.46.
2. *Po aty*, fq.21.
3. *Po aty*, fq.22.
4. *Po aty*, fq.53, fq.56, fq.57.
5. *Po aty*, fq.51.
6. *Po aty*, fq.33.
7. *The Illuminati Formula*, fq.46.
8. *The Curse Of Cannan*, fq.67.

LIBRI 24

9. *Waco: The Rules Of Engagement* (Vako: rregullat e ithtarëve), Fifth Estate Productions, shpërndarë nga Somford Entertainment, Los Angeles, CA, USA.
10. Andrew Boyd, *Blasphemous Rumours* (Zëra blasfemues), Fount Paperbacks, sigla botuese e Harper Collins, London, 1991, fq.142. Bëhet fjalë për një studim shumë të ekuilibruar dhe i kryer në mënyrë të përkryer mbi këtë lëndë dhe sfidoj cilindo që e ka lexuar këtë libër që të vazhdojë të thotë se abuzimet e lidhura me ritualet satanike janë diçka mitike.
11. *Human Sacrifice*, fq.64.
12. Aleister Crowley, *Magic Theory And Practice* (Teoria dhe praktika magjike), Dover, USA, 1929, fq.94-95.
13. *The Templar Revelation*, fq.109.
14. *The Occult Conspiracy*, fq.39-40.
15. *The temple And The lodge*, fq.53.
16. *The Hiram Key*, fq.364.
17. *The Curse Of Cannan*, fq.37.
18. *Po aty.*
19. *Po aty.*
20. *Po aty.*
21. *Po aty*, fq.38.
22. *Blasphemous Rumours*, fq.114.
23. *Po aty.*
24. *The Illuminati Formula*, fq.46.
25. *Po aty.*
26. *The Top 13 Illuminati Bloodlines.*
27. *Po aty*, fq.93.
28. *The illuminati Formula*, fq.213.
29. *Po aty.*
31. *Po aty*, fq.214.
32. "Satanic Links To Belgian Murder Trial" (Lidhje satanike me procesin për vrasjen belge), *The Sunday Times*, 29 dhjetor, 1996.
33. *Po aty.*
34. *Po aty.*
35. "Lord McAlpine and the Paedophile Ring" (Lordi McAlpin dhe rrethi i pedofilëve), *Scallywag*, numuri 22, 1994.
36. Peter Jones, *The Obedience Of Australia* (Bindja e Australisë), XPO-imprint, 26 Burlington Close, London, W9 3LZ, 1995, fq.10-11.
37. *Exstraterrestrial Friends And Foes*, fq.70.
38. *Po aty*, fq.69

39. "The Monster Man of PIE" (Njeriu i përbindshëm i PIE-së)
40. Gazeta *Contact*, 4 prill 1995, fq.23.
41. *The Illuminati Formula*, fq.22.
42. *Po aty.*
43. *National Enquirer*, 28 prill 1998, fq.39, që citon një libër të doktor Wecht me titullin *Who Killed JonBenet Ramsey* (Kush e ka vrarë XhonBenet Ramsejin).
44. Cituar tek *Blasphemous Rumours*, fq.212.
45. *Po atë*, fq.183.
46. *The News Of The World*, 24 gusht 1997, fq.30-31.
47. *Cituar tek blasphemous Romours*, fq.30.
48. Shkruar nga Joan Baez, Wally Wilson, Kenny Greenberg e Karen O'Connor, botuar nga Gabriel Earl Music/Sony Cross Keys Publishing Company/Greenberg Music.

KAPITULLI 16

1. *The Illuminati Formula*, fq.1.
2. *Po aty*, fq.371-372.
3. *Po aty*, fq.355.
4. *Po aty*, fq.2.
5. *Po aty.*
6. *Po aty*, fq.11.
7. *Po aty*, fq.355.
8. *Po aty*, fq.56.
9. *Po aty*, fq.1.
10. Cathy O'Brien e Mark Phillips, *Trance Formation Of America*, botuar nga Macro Edizione, shtator 2001.
11. *Po aty*, fq.13.
12. *The Illuminati Formula*, fq.40.
13. *Po aty*, fq.102.
14. *Trance Formation Of America*, fq.100.
15. *Contact*, "Projekti Phoenix", 7 shkurt 1995, fq.17.
16. *Po aty*, fq.18.
17. *Trance Formation Of America*, fq.115.
18. *The Illuminati Formula*, fq.369.
19. *Po aty*, fq.381.
20. *Trance Formation Of America*, fq.100.
21. *Po aty*, fq.194.
22. *Po aty*, fq.101.

23. *Po aty.*
24. *Contact*, 7 mars 1995, fq.33.
25. *Trance Formation Of America*, fq.127.
26. *Po aty*, fq.170.
27. *The Women's Encyclopedia Of Myths And Secret*, fq.754-755.
28. *The Illuminati Formula*, fq.369.
29. *Po aty.*
30. John W. DeCamp, *The Franklin Cover Up: Child Abuse, Satanism And Murder In Nebraska* (Mbulesa Franklin: ngacmime seksuale tek fëmijët, satanizëm dhe vrasje në Nebraska), AWT Inc., Lincoln, Nebraska, 1992.
31. *Trance Formation Of America*, fq.127.
32. *Po aty*, fq.128.
33. *Po aty*, fq.111.
34. *Po aty*, fq.162.
35. *Contact*, 12 shtator 1995, fq.15.
36. *Po aty.*
37. *The Illuminati Formula*, fq.378.
38. *Po aty.*
39. *Trance Formation Of America*, fq.183.
40. *Po aty*, fq.178.
41. *Po aty*, fq.150.
42. *Po aty*, fq.155.
43. *Contackt*, 12 shtator 1995, fq.15.
44. *Trance Formation Of America*, fq.144.
45. *The Illuminati Formula*, fq.375, fq.348.
46. *Contact*, 12 shtator 1995, fq.15.
47. *Po aty*, fq.13.
49. *Po aty*, fq.15.
50. *Po aty.*
51. *Po aty.*
52. *Po aty*, fq.355.
53. *Trance Formation Of America*, fq.124.
54. *Po aty*, fq.31.
55. *Po aty*, fq.117.
56. *Po aty*, fq.120.
57. *Po aty.*
58. *The Illuminati Formula*, fq.353.
59. *Po aty*, fq.126-150.

LIBRI 24

60. *Po aty*, fq.128-132.
61. Loreda Fox, *The Spiritual And Clinical Dimensions Of Multiple Personality Disorder* (Përmasat shpirtërore dhe klinike të çrregullimit të personalitetit të shumëfishtë), Salida, Colorado, fq.196.
62. *The Illuminati Formula*, fq.133.
63. *Po aty*, fq.143.
64. *Trance Formation Of America*, fq.12.
65. *Po aty*, fq.13-14.
66. *Po aty*, fq.223.
67. *Po aty*, fq.179.
68. *Po aty*, fq.172.
69. *Po aty*.
70. *Po aty*, fq.175.
71. *Po aty*, fq.176.
72. *Po aty*, fq.177.
73. *The Illuminati Formula*, fq.34.
74. *Po aty*.
75. *Po aty*, fq.32.
76. *Po aty*.
77. *Po aty*, fq.34.
78. *Po aty*.
79. *Po aty*, fq.33.
80. *Po aty*.
81. *Po aty*.
82. *Po aty*.
83. *Po aty*.
84. *Exstraterrestrials Friends And Foes*, fq.74.
85. *The Illuminati Formula*, fq.73.
86. *Po aty*, fq.23.
87. *Trance Formation Of America, fq.158*.

KAPITULLI 17

1. *The Woman's Encyclopedia Of Myths And Secrets*, fq.73-74.
2. *The Templar Revelation*, fq.36-39.
3. Charles L. Westbrook junior, *The Talisman Of The United States, Signatures Of The Invisible Brotherhood* (Talismani i Shteteve të Bashkuara, nënshkrimi i Vëllazërisë së padukshme), fq.48. Për të siguruar një kopje, lidhuni me buletinin *The Talisman*, PO Box 54, Ayden, NC 28513, Shtetet e Bashkuara.

4. *Po aty*, fq.50.
5. *Po aty*, fq.12.
6. *The Woman's Encyclopedia Of Myths And Secrets*, fq.754-755.
7. *The Talisman Of The United States*, fq.67.
8. *Po aty*, Fq.69.
9. *Po aty*, fq.79.
10. *Po aty*, fq.116.
11. *The Sekret Teachings Of All Ages*, fq.CXXIX.

KAPITULLI 18

1. Thomas Foster, *Britain's Royal Throne* (Froni mbretëror britanik), Acadia Press, Victoria, Australia, 1996, fq.2.
2. *Samuele*, 10, 24.
3. *Britain's Royal Throne*, fq.6.
4. *Po aty*, fq.8.
5. *Eksodi*, 28, 1-21.
6. *Britain's Royal Throne*, fq.12.
7. *Po aty*, fq.14.
8. *Psalme*, 89, 35-37.
9. *The Curse Of Cannan*, fq.85.
10 .*In The Blood*, fq.62.
11. Gary Boyd Roberts, *Ancestors Of The American Presidents* (Paraardhësit e presidentëve amerikanë), New England Historic Genealogical Society.
12. *Po aty*.
13. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.99.
14. *Po aty*.
15. Informacionet rreth lidhjeve të Filipit me nazizmin jepen nga shumë burime, por këto që kam përvijuar këtu, së bashku me një sërë informacionesh të tjera mbi Uindsorët, mund të gjenden në një sërë artikujsh të shkrirë bashkë në një dokument me titullin "The True Story Behind The Fall of the House of Windsor" (Historia e vërtetë prapa rënies së familjes së Uindsorëve), botuar në shtator të vitit 1997 nga *Executive Intelligence Reviev* (*EIR*) në Shtetet e Bashkuara. Unë nuk pajtohem me të gjitha përfundimet në të cilat arrin *EIR*-i, veçanërisht kur mbron Bill Klintonin, që është përkundrazi i përzier në intrigë ashtu si të tjerët, por është e vërtetë se *EIR*-i ka kryer kërkime me të vërtetë të thelluara. Ky raport mbi Uindsorët është i shtrenjtë, por ia vlen ta blesh, nëse dëshironi të mësoni më shumë. Adresa ku të drejtoheni është: *Executive Intelligence Reviev*, PO Box 17390, Washington DC 20041-0390. Në

pjesën që mbetet të këtij kapitulli, do ta citoj këtë dokument me emrin e autorit dhe titullin e artikullit, të ndjekur nga (*EIR*).

16. "Blair`s School Mentor Was Sex Abuser" (Udhëheqësi shkollor i Blerit ishte një pedofil), *The Sunday Times*, 25 maj 1997.

17. Scott Thompson, "The Nazi Roots Of The Hous of Windsor" (Rrënjët naziste të familjes së Uindsorëve), (*EIR*), fq.73.

18. *Po aty*, fq.71.

19. Scott Thompson, "The Ultimate Insider Trader is the Queen" (Mbretëresha praktikon *insider trading*-un e vërtetë), (*EIR*), fq.73.

20. *Po aty.*

21. *Po aty*, fq.74.

22. Për të patur një kuadër të plotë, shiko librin e Peter Jones-it The *Obedience Of Australia* (Bindja e Australisë), botuar nga XPO-imprint, 26 Burlington Close, London, 1995.

23. "The Ultimate Insider Trader is the Queen", fq.74.

24. *Po aty.*

25. Stephen Knight, *The Brotherhood* (Vëllazëria), Granada Books, London, 1985, fq.223.

26. Anthony K. Wikrent, "The Anglo-Dutch Corporate Empire", (*EIR*), fq.113-132.

27. *The Brotherhood*, fq.211.

28. *Po aty.*

29. *The Mail On Sunday*, 12 gusht 1998, fq.9.

30. Dean Andromidas, "Crown Agents: the Queen`s Managers (Agjentët e Kurorës: administratorët e mbretëreshës), fq.141-142.

31. *Po aty*, fq.141-142.

32. *Po aty*, fq.141.

33. *The Obedience Of Australia*, fq.55.

34. *The Brotherhood*, fq.217.

35. Scott Thompson, "The Queen`s Honorary Knights in America (Kalorësit e nderit të mbretëreshës në Amerikë), (*EIR*), fq.81.

36. James Shelby Downard, "Sorcery, Sex, Assassination and the Science of Symbolism" (Magji, seks, vrasje dhe shkenca e simbolizmit), një artikull i nxjerrë nga libri *Secret And Suppressed*, nën kujdesin e Jim Keith (Feral House, PO Box 3466, Portland, Oregon 97208), 1993, fq.65.

37. Brian Downing Quing, "Who Dismantled Our Constitution" (Kush e shkatërroi Kushtetutën tonë), revista *Grapevine*, 2 janar 1995.

38. *Po aty.*

39. Këto informacione më janë dhënë nga një amerikan që ka kaluar vite për të zbuluar pemën gjenealogjike të njerëzve të rëndësishëm të Amerikës. Ai punon nën pseudonimin John Gaunt.

40. Scott Thompson, "Sir Paul Mellon, Lord of Loudon", (*EIR*), fq.79.

41. Po aty.

42. "The Oligarch`s Real Game Is Killing Animals and Killing People" (Loja e vërtetë e oligarkëve është të vrasin kafshët dhe të vrasin njerëzit), (*EIR*), fq.32.

43. *Po aty*, fq.31.

44. *Po aty.*

45. *Po aty*, fq.32.

46. *Po aty.*

47. Scott Thompson, "The 1001 Club: a Nature Trust" (Clubi 1001: një fondacion ambientalist), (*EIR*), fq.15.

48. Mark Burdman, "Martin Palmer, Prince Philip`s Guru" (Martin Palmeri, udhëheqësi shpirtëror i princit Filip), (*EIR*), fq.91. Autori citon nga libri i Palmerit *Dancing To Armageddon*.

49. "Globalized Grizzlies", *The New American*, 18 gusht 1997.

50. *The Times*, 21 korrik 1997, fq.23.

51. "Prince Philip`s Friends Ran 'Get LaRouche' Plot", (*EIR*), fq.17.

52. *The Anglo-Dutch Corporate Empire*, fq.125-126.

53. *Po aty.*

54. *Po aty.*

55. Joseph Brewda, "The Invisible Empire of the NGO-s", (*EIR*), fq.91.

56. *Po aty*, fq.89-90.

57. *Po aty*, fq.90.

58. Linda de Hoyos, "World Wide Fund For Nature Commits Genocide in Africa" (WWF-ja kryen një genocid në Afrikë), (*EIR*), fq.24.

59. "The Oligarch`s Real Game is Killing Animals and Killing People", (*EIR*), fq.34.

60. *Po aty.*

61. *Po aty*, fq.35.

62. *Po aty*, fq.34.

63. *Po aty*, fq.35036.

64. *Po aty*, fq.36.

65. Linda de Hoyos, "The British Royal Family`s Policy at Work: Mass Death in Rwanda" (Zbatimi i politikës së familjes mbretërore: vdekje në masë në Ruandë), (*EIR*), fq.38.

LIBRI 24

66. *Po aty.*
67. *Po aty.*
68. Richard Freeman and Cynthia Rush, "British Cartels Break Up Brazil's CVRD, Target Continents Raw Materials" (*EIR*), fq.192.
69. *Po aty*, fq.193.
70. Dennis Small, "British Banks Establish Death Grip Over Ibero-America", (*EIR*), fq.187.
71. Roger Moore, "Executive Outcomes vs the Nation State", (*EIR*), fq. 147.
72. *Po aty.*
73. Dean Andromidas, "Defence Systems Ltd: A Croën Jewel", (*EIR*), fq.148.
74. *Po aty*, fq.149.
75. *Po aty.*
76. Cituar nga Javier Alamario, "British Run Private armies in Colombia", (*EIR*), fq.199.
77. "The Anglo-Dutch Corporate Empire", (*EIR*), fq.113.
78. "Directors, Councillors, of Crown Agents", (*EIR*), fq.143.
79. Peter Hounan e derek McAdam tek *Who Killed Diana?* (Kush e vrau Dianën?), Vision Books, London, 1998.
80. *Po aty*, fq.124.

KAPITULLI 19

1. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.89.
2. *Po aty*, fq.90.
3. *Po aty.*
4. *Po aty.*
5. *Po aty.*
6. *Po aty*, fq.91-92.
7. *Po aty*, fq.89.
8. *Po aty.*
9. *Secret And Suppressed*, fq.66.
10. *Po aty.*
11. *Po aty*, fq.68.
12. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.94.
13. *Secret And Suppressed*, fq.80.
14. *The Top 13 Illuminati Bloodlines*, fq.99.
15. *Po aty*, fq.102.

LIBRI 24

16. *Secret And Suppressed*, fq.19, fq.65, fq.85.
17. *Po aty*, fq.66.
18. *Po aty.*
19. *Po aty*, fq.65.
20. *Po aty*, fq.69.
21. Andrew Morton, *Diana, Her True Story* (Diana, historia e saj e vërtetë), Michael O'Mara Books, London, 1992, rishtypur si: *Diana: Her True Story In Her Own Words* (Diana: historia e saj e vërtetë, treguar prej saj), 1997.
22. *Po aty.*
23. *Po aty.*
24. *Daily Mail*, e enjte, 27 gusht 1998.
25. *Po aty.*
26. *Diana: Her true Story.*
27. *Po aty.*
28. *Po aty.*
29. Revista *Private Eye*, nr. 956, e premte, 7 gusht 1998, fq.5.
30. Tom Bower, *Fayed, The Unauthorised Biography* (Fajedi, biografi jo e autorizuar), Macmillan, London, 1998.
31. *Po aty*, fq.22.
32. *Daily Mail*, e premte, 26 gusht 1998.
33. Simon Reagan, *Who Killed Diana?*, një botim Scallywag, Amsterdam, 1998, fq.57.
34. *Po aty*, fq.62.
35. *The News Of The World*, e diel, 18 janar 1998, fq.18-19.
36. Peter Hounam e Derek McAdam, *Who Killed Diana?*, fq.17.
37. *Dispatches*, Channel Four, qershor 1998.
38. *Po aty.*
39. *Po aty.*
40. *Fayed, The Unauthorised Biography*, fq.425.
41. *Po aty*, fq.420.
42. *Po aty*, fq.421.
43. Peter Hounam e Derek McAdam, *Who Killed Diana?*, fq.64.
44. *Po aty*, fq.73-74.
45. Jim Marrs, *Crosfire: The Plot That Killed Kennedy* (Zjarr i kryqëzuar; komploti që vrau Kenedin), Carrol and Graf Publishers, New York, 1989, fq.382.
46. *Dispatches.*
47. *Diana – Secrets Of The Crash, ITV*, 1998.

48. *"Diana, the Unsolved Mystery"* (Diana, misteri i pazgjidhur), *News Of The World*, News Special, 18 janar 1998.

49. Informacionet mbi vdekjen e David Sandit janë nxjerrë nga libri i Tony Collins-it me titullin *Open Verdict* (Verdikt i hapur), një raport me 25 vdekje misterioze në sektorin e mbrojtjes. Libri është botuar nga Sphere Books, London, 1990.

50. Peter Horsley, *Sounds From Another Room* (Tinguj nga një tjetër dhomë), Leo Cooper, Inghilterra, 1997. Historia tregohet edhe nga Peter Hounam e Derek McAdam tek *Who Killed Diana?*, fq.126-133.

51. Peter Hounam e Derek McAdam, *Who Killed Diana?*, Vision Paperbacks, London, 1999, fq.175-177.

52. *The News Of The World*, News Special, 18 janar 1998.

53. *Daily Mirror*, e hënë, 2 mars 1998, fq.2.

54. *Daily Mail*, Londër, 29 gusht 1998, fq.1-2.

55. *Dispatches*.

56. Peter Hounam e Derek McAdam, *Who Killed Diana?*, fq.145.

57. Cituar tek *Blasphemous Rumours* (Llafe blasfemuese), fq.212.

58. *The Phoenician Origin Of Britons*, fq.64.

59. "Fayed`s rooftop flame of love for Dodi and Diana" (Flaka e dashurisë e Dodit dhe Dianës mbi çatinë e Fajedit), *Daily Exspress*, Londër, e premte, 24 korrik 1998, fq.3.

60. *The Women's Encyclopedia Of Myths And secrets*, fq.543.

61. Kitty Kelly, *The Royals* (Familja mbretërore), Warner Books, New York, 1997, fq.347.

62. *The Times*, e mërkurë, 3 qershor 1998.

63. "Fergie`s Mom Was Murdered" (E ëma e Ferxhit ka qenë vrarë), *The Globe*, 6 tetor 1998.

KAPITULLI 20

1. Gregg Braden, *Awakening To Zero Point* (Zgjim në pikën zero), Laura Lee Productions, 1996.

2. *From The Ashes Of Angels*, fq.18.

3. David Icke, *The Truth Vibrations* (Dridhjet e së vërtetës), Gateway Books, Wellow, Bath, Inghilterra, botuar për herë të parë nga Aquarian Books në vitin 1991.

4. http://solar.uleth.ca/solar/.

5. "Solar Cycle Status Report" (Raport mbi gjendjen e ciklit diellor), marrë nga Solar Website, 4 korrik 1997.

6. *Po aty*.

7. John Rhodes, faqe interneti mbi zvarranikët.

8. Brian Desborough, "An Overview of UFO Contact and Abduction Phenomena" (Një panoramë mbi fenomenet e përshquarjes dhe të rrëmbimeve UFO), shënime dërguar autorit, 1998.

LIBRI 24

Bibliografia

Alder, *The Battle of the Trees* (Freedom Hose, Creta, Grecia, 1995).

Allen D.S. e Delair J.B., *When the Earth Nearly Died* (Gateway Books, Wellow, Bath, Inghilterra, 1995).

Andrews, George C., *Exstraterrestri amici e ostili* (Macro Edizioni, 2001).

Andrews, George C., *Exstraterrestrial among us* (Llewellyn Publications, St.Paul, Minnesota 55164-o383, USA, 1996).

Andrews, Richard e Schellenberger, Paul, *The Tomb of God* (Little Brown and Company, Londra, 1996).

Baigent, Michael, Leigh, Richard e Lincoln, Henry, *Holy Blood, Holy Grail* (Corgi Books, Londra, 1982).

Baigent, Michael e Leigh, Richard, *The Temple and the Lodge* (Arcade Publishing, New York, 1989).

Berlitz, Charles, *Atlantis, the Eighth Continent* (Fawcett Books, New York, 1984).

Bernard, Dr. Raymond, *The Hollow Earth, The Greatest Discovery in History* (Carol Paperbacks, New York, 1991).

Boyd, Andrew, *Blasphemous Rumours* (Fount Paperbacks, një fondacion i Harper Collins, Londra, 1991).

Bramley, William, *Gods of Eden* (Avon Books, New York).

Brennan, J.H., *Occult Reich* (Futura, Londra, 1974).

Bromberger, Merry e Serge, *Jean Monnet and the United States of Europe* (Coward-McCann Publishers, New York, 1969).

LIBRI 24

Bryant, Alice e Seebach, Linda, *Healing Shattered Reality: Understand Contactee Trauma* (Wild Flower Press, Tigard, Oregon, 1991).
Bullock, Alan, *Hitler a Study in Tyranny* (Pelican Books, Londra, 1960).
Chaitkin, Anton, *Treason in America* (botimi i dytë - New Benjamin Franklin House, New York, 1984).
Christopher, Alexs, *Pandora's Box Volumes 1 and 2* (i disponueshëm pranë Pandora's Box, 2663 Valleydale Road, Suite 126, Birmingham, Alabama 35224).
Churchward, Albert, *Of Religion* (botimi i parë 1984, tani i disponueshëm pranë Health Research, Mokelumne Hills, CA 95245).
Coleman, John, *Conspirators Hierarchy* (Joseph Holding Company, Nevada, USA, 1995).
Collins, Andrew, *From The Ashes of Angels, The forbidden Legacy of a falen Race* (Signet Books, Londra, 1997).
Collins, Piper, Michael, *Final Jugdement, the missing Link in the JFK Assassination* (The Wolfe Press, Washington DC, 1995).
Collins, Tony, *Open Verdict* (Sphere Books, Londra, 1990).
Cooper, William, *Behold a pale Horse* (Light Trchnology Publishing, PO Box 1495, Sedona, Arizona, USA, 1991).
Crowley, Aleister, *Magick in the Theory and Practice* (Dover, USA, 1929).
Daniel, John, *Scarlet and the Beast, vol. III, English Freemasonry, Banks, and the Drug Trade* (JKI Publishing, Tyler, TX, USA, 1995).
Davies, Nigel, Human Sacrifice, nw *History and taday* (William Morrow and Company, New York).
Deane, Rev. John Bathhurst, *The Worship of the Serpent* (J.G. and F. Rivington, Londra, 1833).
Doane, T.W., *Bible Myths, and their parallels in other Religions* (Health Research, PO Box 850, Pomeroy, WA, USA, 99347,1882).
Drosnin, Michael, *The Bible Code* (Weindelfeld and Nicolson, Londra, 1997).
Editors of *Executive Intelligence Review*, Dope Inc. (Executive Intelligence Review, Washington DC, 1992).
Findlay, Arthur, *The curse of Ignorance, a history of Mankind* (Headquarters Publishing Company, Londra, 1947) 2 vol.
Foster, Thomas, *Britain's Royal Throne* (Acadia Press, Victoria, Australia, 1986).
Fox, Dr. Loreda, *The spiritual and clinical Dimensions of multiple personality Disorder* (Salida, Colorado).
Gardner, Laurance, *Bloodline of the holy Grail* (Element Books, Shaftesbury, Dorset, 1996).
Golberg, Hirsch M., *The Jewish Connection* (Stain and Day, NY, 1976).
Hall, Manly P., *America's Assignment with destiny, the adepts in the western tradition* (Philosophical Research Society, Los Angeles, California, The Diamond Jubilee edition, 1998).
Hancox, Joy, *The Byrom collection* (Johnathan Cape, Londra, 1992).
Hasemann, Michael, *The cosmic Connection* (Gateway Books, Wellow, Avon, Inghilterra, 1993).
Higgins, Geoffrey, *Anacalypsis* (1836, 1972, Health research, PO Box 850, Pomeroy, WA, USA, 99347), vol. I.
Hitching, Francis, *The World Atlas of Misteries* (Pan Books, Londra, 1981).
Hoagland, Richard, *Monuments on Mars* (North Atlantic Books, California, USA, 1996).

Horn, Dr. Arthur David, *Humanity's exstraterrestrial origins, ET influences on Humankind's Biological and cultural Evolution* (A and L Horn, PO Box 1632, Mount Shatsa, California, 96067, 1994).
Horowitz, Dr. Leonard G., *Emerging viruses* (Tetrahedron Inc., Rockport, MA, USA, 1996).
Horsley, Sir Peter e McAdam, Derek, *Who killed Diana?* (Vision Vooks, Londra, 1998).
Howard, Michael, *The occult conspirancy* (Destiny Books, Rochester, Vermont, 1989).
Jones, Peter, *The obedience of Australia* (XPO-imprint, 26 Burlington Close, Londra, W9 3LZ, 1995).
Jones, Steve, *In the Blood* (Harper Collins, Londra, 1996).
Knight e Lomas, Christopher e Robert, *The Hiram key* (Arrow Books, Londra, 1997).
King, Francis, *Satan and Swastika* (Mayflower Books, Londra, 1976).
Keith, Jim, *Casebook on alternative 3* (Illuminet Press, Lillburn, USA, 1994).
Keith, Jim, *Secret and suppressed* (Feral House, PO Box 3466, Portland, Oregon, 97208, 1993).
Knight, Stephen, *The brotherhood* (Granada Books, Londra, 1985).
Koestler, Arthur, *The thirteenth Tribe-the Khazar empire and its heritage* (Hutkinson, Londra, 1976).
Leedom, Tim C. (editor), *The book your church doesn't want you to read* (Kendall/Hunt Publishing, Iowa, USA, 1993. Që gjendet pranë Truth Seeker Company, PO Box 2872, San Diego, California, 92112).
Lilenthal, Alfred M., *What Price Israel?* (Henry Regnery, Chicago, 1953).
MacLellan, Alec, *The lost Word of Agharti, the Mystery of Vril Power* (Souvenir Press, 43 Great Russell Street, Londra, WC1B 3PA, 1982).
Marrs, Jim, *Crosfire: The plot that killed Kennedy* (Carrol and Graf Publishers, New York, 1989).
Morton, Andew, *Diana, her true story* (Micheal O'Mara Books, Londra, 1992. Ribotuar si *Diana, her true story, in her own words*, 1997).
Mullins, Euctace, *The curse of Cannan* (Revelation Books, PO Box 11105, Staunton, VA, 1987).
Mullins, Euctace, *The world order, our secret rulers* (Ezra Pound Institute of Civilisation, Staunton, VA, 24401, USA, 1992).
Nichols, Preston B. e Moon, Peter, *Pyramids of Montauk* (Sky Books, New York, 1995).
O'Brien Cathy, e Phillips Mark, *Tranceformation of America* (Macro Edizioni, Diegaro di Cesena, FC, Italia, 2001).
O'Brien, Christian e O'Brien, Joy, *The genius of the few - the story of those who founded the garden of Eden* (Turnstone Press, Wellingborrough, Inghilterra, 1985).
O'Toole, Fintan, *Brand leader, an investigation of Tony O'Reilly* (Granta).
Perloff, James, *The Shadow of Power: the Council on foreign Relations and the American Decline.*
Picknett, Lynn e Prince, Clive, *The Templar Revelation* (Bantam Press, Londra, 1997).
Pohl, Frederick J., *Prince Henry Sinclair. His exspedition to the New World in 1938* (Nimbus Publishing, Halifax, Novia Scotia, botimi i parë 1967).
Quinn, Bob, *Atlantean, Ireland's North African and maritime Heritage* (Quartet Books, Londra, 1986).
Ramsey, A.H.M., *The Nameless War* (Omni Publications, Londra, 1952).
Ravenscroft, Travor, *The spear of destiny* (Samuel Weiser, Inc., Maine, USA, 1982).
Raymond, Caot E., *Missing links discovered in Assyrian Tablets* (Artisans Sales, Thousand

LIBRI 24

Oaks, California, 1985).
Reagan, Simon, *Who killed Diana?* (Scallywag publication, Amsterdam, 1998).
Reuchlin, Abelard, *The true authorship of the new Testament* (The Abelard Reuchlin Foundation, PO Box 5652, Kent, WA, USA, 1979).
Staniland, Wake C., *Serpent worship and other essays* (Bantom Press, Largs, 1990).
Schweitzer, Albert, *The quest for the historical Jesus* (Macmillan Publishing, New York, 1968).
Shahak, Israel, *Jewish history, Jewish Religion* (Pluto Press, Londra, 1994).
Sitchin, Zecharia, *The 12th planet, Stairway to Heaven, The lost Realms, When time began, The wars of Gods and men, Genesis revisited* (Avon Books, New York).
Sklar, Holly (editor), *Trilateralism, The trilateral commissionand the elite planning for world management* (South End press, Boston, USA, 1980).
Smith, Homer, *Man and his Gods* (Grassetts University Library, 1974).
Smith, Morton, *The secret Gospel* (Victor Gollancz, Londra, 1974).
Springmeier, Fritz e Weeler, Cisco, *The Illuminati formula to create an undetectable total mind controlled slave* (Springmeier, SE Clackamas Road, Clackamas, Oregon, 97015, 1996).
Springmeier, Fritz, *The top 13 Illuminati bloodlines* (Springmeier, SE Clackamas Road, Clackamas, Oregon, 97015, 1996).
Stitch, Rodney, *Defrauding America* (Diablo Western Press, Alamo, California, 1994).
Sutton, Anthony C., *Wall street and the rise of Hitler* (Heritage Publications, Melbourne, Australia).
Tarpley, Webster Griffin e Chaitkin, Anton, *George Bush, the unauthorised biography* (Executive Intelligence Review, Washington DC, 1992).
Teylor, Ian T., *In the minds of men, Darvin and the new World order* (TFE Publishing, Toronto, Canada, 1984).
Thompson, Hunter S., *Fear and Loathing in Las Vegas* (Vintage Books, New York, 1998, botimi i parë më 1971).
Thompson, Arthur Dynott, *On mankind, their origin and destiny* (Kessinger Publishing, PO Box 160, Kila, MT 59920, USA, botimi i parë më 1872).
Valerian, Valdamar, *Matrix II* (Arcturus Book Service, USA, 1990).
Van Helsing, Jan, *Secret societes and their power in the 20th century* (Ewertverlag, Gran Canaria, Spain, 1995).
Vermes, Geza, *The dead sea scrolls in English* (Penguin Books, Harmondsworth, 1990).
Waddell, L.A., *The Phoenician Origin of Britons, Scots and Anglo Saxon* (The Christian Book Club of America, Hawthorne, California, botimi i parë më 1994).
Walker, Barbara G., *The woman's Encyclopedia of Myths and Secrets* (Harper Collins, San Francisco, 1983).
Westbrook, Charles L., *The Talisman of the United States, Signature of the invisible Brotherhood* (për të prenotuar një kopje, lidhuni me *the Talisman newsletter*, PO Box 54, Ayden, NC, 28513, USA).
Wood, David e Campell, Ian, *Geneset* (Bellevue Books, Sunbury on Thames, Inghilterra, 1994).
Zim, Herbert S. e Baker, Robert H., *Stars, a golden Guide* (Golden Press, New York, 1985).

LIBRI 24

Treguesi i lëndës

HYRJE
Ditë vendimtare 5

KAPITULLI 1
A kanë zbritur marsianët në Tokë? 13

KAPITULLI 2
"Mos flisni për zvarranikët!" 35

KAPITULLI 3
Vëllazëria Babilonase 77

KAPITULLI 4
Djej hyjnorë 113

KAPITULLI 5
Të pushtuar me anë të kryqit 145

PJESA II **171**

KAPITULLI 6
Sundo, o Britani 173

KAPITULLI 7
Kalorës të Diellit 189

KAPITULLI 8
E njëjta fytyrë, tjetër maskë 221

KAPITULLI 9
Toka e të "lirëve" 249

KAPITULLI 10
Pará nga hiçi 275

KAPITULLI 11
Babilonia globale 299

PJESA III **327**

KAPITULLI 12
Dielli i zi 329

KAPITULLI 13
Rrjeti sot 357

KAPITULLI 14
Nën ndikim 385

KAPITULLI 15
Bijtë e Satanait 395

KAPITULLI 16
Ku kanë përfunduar të gjithë fëmijët? 423

KAPITULLI 17
Gjuha e fshehtë 465

KAPITULLI 18
Të gjithë ushtarët dhe njerëzit e mbretëreshës 487

KREU 19
Perëndesha dhe mbreti 529

KREU 20
Përmbushja e magjepsjes 605

KREU 21
Prishja e magjepsjes 635


SHTOJCA I
Lidhjet e gjakut mes familjeve Uindsor dhe Bush 649

SHTOJCA II
Hitleri rridhte nga Rotshildët 653

Shënime 659

Bibliografia 689

LIBRI 24



DAVID ICKE, studiues i historisë sekrete dhe i konspiracionit, ka shkruar 20 libra dhe nga viti 1990 e deri më sot ka udhëtuar në 40 vende të botës. Ai i është përkushtuar gjurmimit se "kush dhe çfarë" e kontrollon botën në të vërtetë. Hulumtimi i tij i zhdërvjellët paraqet diktaturën fashiste të "Big Brother-it", parashikur nga George Orwell në librin e tij "1984", si dhe listat e komplotistëve në historinë e Illuminatit, në lidhje me forcat ende të panjohura në dimensione të tjera të realitetit deri në lidhje jashtëtokësorësh. Librat e tij zbulojnë një dorë të fshehtë e të padukshme pas ngjarjeve të tilla si sulmi i 11 Shtatorit, luftërat e shkaktuara në Lindjen e Mesme, duke i artikuluar si një teknikë të manipulimit masiv të mendjes, që ai e ka quajtur në mënyrë të trefishtë: problem-reaksion-zgjidhje. Gjithçka që David Icke ka shkruar në dekadën e fundit të shekullit XX për një befasi të saktë rezultojnë si parashikime të ngjarjeve të dekadës së parë të shekullit XXI.

Si në asnjë bibliotekë tjetër informacioni në botë, në librat e këtij autori tregohen të dhëna që nganjëherë duken të ndryshme dhe pa lidhje, por që në të vërtetë janë pjesë e një Axhende Globale që në zanafillë të historisë, të simbolizmit dhe të vijimësisë së brezave të Illuminatit, Shoqërive Sekrete, Të mbikëqyrjes të "Big Brother", të manipulimit të luftrave, politikës, të bankave, biznesit, të mendjeve, të praktikimit të Mikroçipëve, të së vërtetës së 11 Shtatorit, të luftës kundër terrorizmit, të Kontrollit të Mendjes, dhe të instrumentalizimit të fesë.

David Icke na tregon kështu qartë se të gjithë ne jetojmë në një botë virtuale, në një realitet prej ëndrre, pikërisht siç është portretizur ky realitet në seritë e filmave Matriks.

Në hulumtimet e tij shpesh të diskutuara dhe të sulmuara rëndë dhe me mosbesim David Icke ka stimuluar një hetim të guximshëm në subjekte dhe në zona ku nuk është futur asnjë autor dhe studiues me kaq njohuri. Ai zbulon informacione të mbartura nga një bashkësi sekrete njerëzish të padukshëm dhe të "nëndheshëm" duke zbuluar se kjo bashkësi është ajo e skllevërve të një programi të fshehtë dhe funksional.

Tani pas 18 vitesh pune të vështirë, emri i autorit është bërë tepër i njohur duke fituar një popullaritet të jashtëzakonshëm dhe besueshmëri maksimale. Mijëra e mijëra njerëz në mbarë botën kanë filluar të ndërgjegjësohen për idenë e komplotit të zbuluar në librat e tij duke patur një normë në rritje të pabesueshme të kësaj njohjeje, ndryshe nga tradita kulturore e profecive të lashta të njerëzimit, nga dykuptimësia e kësaj tradite për të arritur në një arsyetim më të qartë.

Kjo njohje është fillimi i udhëtimit, duke besuar në informacione më të plota në të ardhmen.

David Icke është i njohur si lider në fushën e tij, është frymëzim për një brez të ri të studiuesve të teorive mbi konspiracionin botëror.